REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PLANI KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT 2012-2015

Korrik 2012

PASQYRA E LËNDËS

HYRJE 1

1. KRITERET POLITIKE 7

1.1. DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS 7

1.1.1. PARLAMENTI 8

1.1.2. ZGJEDHJET 11

1.1.3. QEVERIA 13

1.1.3.1. PUSHTETI QENDROR 13

ORIENTIMI, KOORDINIMI DHE MONITORIMI I PROCESIT TE INTEGRIMIT EVROPIAN 14

1.1.3.2. PUSHTETI VENDOR 21

1.1.4. ADMINISTRATA PUBLIKE 23

1.1.5. SISTEMI GJYQËSOR 25

1.1.6. MASAT ANTI-KORRUPSION 45

1.2. TË DREJTAT E NJERIUT 54

1.2.1. TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE 54

1.2.1.1. SISTEMI PENITENCIAR 55

1.2.1.2. SHËRBIMI PËRMBARIMOR 60

1.2.1.3. SHËRBIMI I PROVËS 62

1.2.2. TË DREJTAT EKONOMIKE DHE SOCIALE 65

1.2.2.1. MBROJTA SOCIALE 65

1.2.3. TË DREJTAT E MINORITETEVE DHE MBROJTJA E MINORITETEVE 67

1.3. TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME 81

1.3.1. REGJISTRIMI FILLESTAR 81

1.3.2. KTHIMI DHE KOMPENSIMI I PRONAVE 85

1.4. ÇËSHTJET RAJONALE DHE DETYRIMET NDËRKOMBËTARE 88

1.4.1. BASHKËPUNIMI RAJONAL 88

1.4.2. MARRËDHËNIET DYPALËSHE 89

2. KRITERI EKONOMIK 96

2.1. ZHVILLIMET EKONOMIKE 97

2.2. EKZISTENCA E NJË EKONOMIE TREGU FUNKSIONALE 97

2.2.3. NDËRVEPRIMI I FORCAVE TË TREGUT 103

2.2.4. HYRJA DHE DALJA NGA TREGU 105

2.2.5. SISTEMI LIGJOR PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE (TË DREJTAT E PRONËSISË; ZBATIMI I LIGJIT DHE I KONTRATAVE; EFEKTSHMËRIA E GJYQËSORIT) 106

2.2.6. ZHVILLIMI I SEKTORIT FINANCIAR 107

2.3. KAPACITETET PËR TË PËRBALLUAR PRESIONET KONKURRUESE DHE FORCAT E TREGUT BRENDA BASHKIMIT 111

2.3.1. EKZISTENCA E NJË EKONOMIE TREGU FUNKSIONALE 112

2.3.2. KAPITALI NJERËZOR DHE KAPITALI FIZIK 112

3. AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT 126

3.1. LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE 126

3.1.1. ÇËSHTJET HORIZONTALE 126

3.1.2. DIREKTIVAT E PERQASJES SE VJETER 132

3.1.3. DIREKTIVAT E PERQASJES SE RE 138

3.1.4. TRASHEGIMIA KULTURORE 144

3.2. LIRIA E LËVIZJES SË PUNËTORËVE 147

3.2.1. AKSESI NË TREGUN E PUNËS 147

3.2.2. BASHKËRENDIMI I SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE 154

3.3. E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME 159

3.3.1 & 2: E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME NDËRKUFITARE 159

3.3.3. SHËRBIMET POSTARE 163

3.3.4. NJOHJA E NDËRSJELLË E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE 166

3.4. LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT 170

3.4.1. REGJIMI I LËVIZJEVE TË KAPITALIT DHE PAGESAVE AKTUALE 170

3.4.2. SISTEMI I PAGESAVE 174

3.4.3. PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE 178

3.5. PROKURIMI PUBLIK 184

3.6. E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE 190

3.6.1. E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE 190

3.6.2. KONTABILITETI DHE AUDITIMI 195

3.7. TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE 202

3.7.1. TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA TË LIDHURA 202

3.7.2. PRONËSIA INDUSTRIALE 207

3.8. POLITIKA E KONKURRENCËS 216

3.8.1. POLITIKAT E KONKURRENCËS 216

3.8.2. NDIHMA SHTETËRORE 223

3.9. SHËRBIMET FINANCIARE 228
3.9.1. BANKAT 228
3.9.2. SIGURIMI DHE PENSIONET PROFESIONALE 237
3.9.3. TREGU I KAPITALEVE 246
3.10. SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA 253
3.10.1. TELEKOMUNIKACIONET DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT 253
3.10.2. SHOQËRIA E INFORMACIONIT 256
3.10.3. POLITIKA AUDIO-VIZUALE 262
3.11. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL 269
3.11.1. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL 269
3.11.2. TOKA BUJQËSORE, ADMINISTRIMI DHE MBROJTJA E SAJ 272
3.11.3. PRODHIMI BIMOR 276
3.11.4. BLEGTORIA 279
3.11.5. PRODHIMI ORGANIK BUJQËSOR 288
11.3.6. PRODUKTET SUBJEKT I ORGANIZIMIT TË TREGUT 296
3.11.7. POLITIKAT E CILËSISË 300
3.12. SIGURIA USHQIMORE, VETERINARIA DHE FITOSANITETI 304
3.12.1. SIGURIA USHQIMORE 304
3.12.2. POLITIKAT VETERINARE 315
3.12.3. POLITIKAT FITOSANITARE (MBROJTJA E BIMËVE) 327
3.12.4. FARAT DHE MATERIALET FIDANORE 330
3.13. PESHKIMI 337
3.14. POLITIKA E TRANSPORTIT 345
3.14.1. TRANSPORT TOKËSOR 345
3.14.1.1. TRANSPORTI RRUGOR 345
3.14.1.2. TRANSPORTI HEKURUDHOR 354
3.14.1.3. TRANSPORTI I KOMBINUAR 358
3.14.2. TRANSPORTI DETAR (UJOR) 360
3.14.3. TRANSPORTI AJROR 365
3.15. ENERGJIA 371
3.15.1. SIGURIA E FURNIZIMIT 371
3.15.1.1. SEKTORI HIDROKARBUR 376
3.15.2. TREGU I ENERGJISË 381

3.15.3. EFIÇENCA E ENERGJISË DHE BURIMET E RINOVUESHME TË ENERGJISË 386
3.15.4. SIGURIA BËRTHAMORE DHE MBROJTJA NGA RREZATIMET 388
3.16. TATIMET 394
3.16.1. POLITIKAT TATIMORE 394
3.16.2. TATIMI DIREKT 397
3.16.3. TATIMI INDIREKT 398
3.16.4. NDIHMA E NDËRSJELLË 399
3.16.5. ZYRA E TË ARDHURAVE PUBLIKE 400
3.17. POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE 402
3.17.1. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME 402
3.17.2. POLITIKA MONETARE 402
3.17.3. POLITIKA EKONOMIKE 406
3.18. STATISTIKAT 412
3.18.1. STATISTIKAT DEMOGRAFIKE-SOCIALE 416
3.18.1.1. STATISTIKAT DEMOGRAFIKE 416
3.18.1.2. STATISTIKAT E TREGUT TË PUNËS 418
3.18.1.3. SHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE DHE NIVELI I JETESËS 421
3.18.2. STATISTIKAT E MJEDISIT 424
3.18.3. STATISTIKAT MAKROEKONOMIKE 427
3.18.3.1. LLOGARITË KOMBËTARE VJETORE: VLERËSIMI I PBB-SË ME METODËN E PRODHIMIT 427
3.18.3.2. VLERËSIMI I PBB-SË ME METODËN E SHPENZIMEVE 430
3.18.3.3. LLOGARITË VJETORE TË SEKTORËVE INSTITUCIONAL 432
3.18.3.4. STATISTIKAT MBI TABELAT BURIM-PËRDORIM DHE INPUT-OUTPUT 434
3.18.3.5. STATISTIKAT RAJONALE 436
3.18.3.6. ADMINISTRATA PUBLIKE 438
3.18.3.7. STATISTIKAT E LLOGARIVE KOMBËTARE TREMUJORE 441
3.18.3.8. STATISTIKAT E ÇMIMEVE 443
3.18.3.9. TREGTIA E JASHTME 445
3.18.4. STATISTIKAT PËR BIZNESIN 446
3.18.5 STATISTIKAT MONETARE, FINANCIARE, TË TREGTISË DHE STATISTIKAT E BILANCIT TË PAGESAVE 449
3.18.6.STATISTIKAT BUJQËSORE 453
3.18.7. REGJISTRAT 456

3.18.8. KLASIFIKIMET 458
3.19. POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI 461
3.19.1. LEGJISLACIONI I PUNËS 461
3.19.2. KËRKESAT E SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË 463
3.19.3. DIALOGU SOCIAL 478
3.19.4. PUNËSIMI DHE FONDI SOCIAL EVROPIAN 482
3.19.5. PËRJASHTIMI SOCIAL 488
3.19.6. SIGURIA SOCIALE 504
3.19.7. ANTIDISKRIMINIMI DHE SHANSET E BARABARTA 513
3.20. NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE 526
3.20.1. POLITIKAT INDUSTRIALE 526
3.20.1.1. POLITIKAT E TURIZMIT 529
3.20.2. PRIVATIZIMI DHE RISTRUKTURIMI 532
3.20.3. KLIMA E BIZNESIT 535
3.20.4. POLITIKAT E SME-VE 538
3.21. RRJETET TRANS-EUROPIANE 549
3.21.1. RRJETET TRANS-EUROPIANE TË TRANSPORTIT 549
3.21.2. RRJETET TRANS-EUROPIANE TË ENERGJISË 556
3.22. POLITIKAT RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURORE 565
3.23. BASHKEPUNIMI NE FUSHEN E GJYQESORIT DHE TE DREJTAVE THEMELORE 574
3.23.1. SISTEMI GJYQËSOR 574
3.23.2. POLITIKAT KUNDËR KORRUPSIONIT 593
3.23.3. TË DREJTAT THEMELORE 606
3.24. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA 645
3.24.1. KUFIJTË E JASHTËM 645
QENDRA NDËRINSTITUCIONALE OPERACIONALE DETARE 650
3.24.2. MIGRACIONI 656
MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA 667
3.24.3. POLITIKA E VIZAVE 675
3.24.4. AZILI 679
3.24.5. BASHKËPUNIMI POLICOR DHE LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR 684
LUFTA KUNDËR TRAFIQEVE TË PALIGJSHME 685

NJËSIA ANTITRAFIK 694
HETIMI I ASETEVE KRIMINALE 696
AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA 700
RRITJA DHE FORCIMI I KAPACITETEVE TË POLICISË SHKENCORE 701
LUFTA KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE 703
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TE PARAVE 708
PROKURORIA E PERGJITHSHME 717
3.24.6.LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT 718
3.24.7. BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR DROGËS 724
PARANDALIMI DHE LUFTA KUNDËR KULTIVIMIT TE BIMËVE NARKOTIKE 730
MINISTRIA E SHËNDETËSISË 732
3.24.8. BASHKËPUNIMI DOGANOR 733
3.24.9. BASHKËPUNIMI GJYQËSOR NË ÇËSHTJE CIVILE DHE PENALE 736
3.25. KËRKIMI SHKENCOR 746
3.26. ARSIMI DHE KULTURA 751
3.26.1. ARSIMI 751
3.27. MJEDISI 778
3.27.1. CILESIA E AJRIT 778
3.27.2. LEGJISLACIONI HORIZONTAL 785
3.27.3. NDRYSHIMET KLIMATIKE 791
3.27.4. MENAXHIMI I MBETJEVE 797
3.27.5. MENAXHIMI I UJIT 801
3.27.6. MBROJTJA E NATYRES 812
3.27.7. NDOTJA INDUSTRIALE, MENAXHIMI I RISQEVE DHE AKSIDENTEVE 817
3.27.8. ORGANIZMAT E MODIFIKUARA GJENETIKISHT 821
3.27.9. KIMIKATET 824
3.27.10. ZHURMAT 831
3.27.11. PYJET DHE KULLOTAT 835
3.28. MBROJTJA E KONSUMATORËVE DHE SHËNDETI PUBLIK 844
3.28.1. MBROJTJA E KONSUMATORËVE 844
3.28.2. SHËNDETI PUBLIK 847
3.29. BASHKIMI DOGANOR 854
3.30. MARRËDHËNIET ME JASHTË 868

3.30.1. POLITIKA E PËRBASHKËT TREGTARE 868
3.30.2. BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIM DHE NDIHMA HUMANITARE 872
3.31. POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES 873
3.31.1. DIALOGU POLITIK 873
3.31.2. BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE 879
3.31.3. KONTROLLI I ARMATIMIT 881
3.31.4. ZBATIMI I MASAVE KUFIZUESE DHE SANKSIONET EKONOMIKE 883
3.31.5. POLITIKA EVROPIANE E SIGURISË DHE MBROJTJES 885
3.32. KONTROLLI FINANCIAR 889
3.32.1. AUDITIMI I JASHTËM (SHTETËROR) 889
3.32.2. AUDITIMI I BRENDSHËM 893
3.32.3. MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI 899
3.32.4. INSPEKTIMI FINANCIAR PUBLIK 902
3.32.5. MBROJTJA E MONEDHAVE DHE KARTËMONEDHAVE NGA FALSIFIKIMI 906
3.33. DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE 909
4. PËRGATITJA E VERSIONIT KOMBËTAR TË LEGJISLACIONIT EUROPIAN 916

HYRJE

Marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian

Shqipëria dhe Komuniteti Ekonomik Evropian[1] filluan marrëdhëniet e tyre diplomatike në qershor 1991. Ky akt u pasua në 11 maj 1992 me nënshkrimin e Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian[2].

Në vitin 1999, Bashkimi Evropian propozoi fillimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit për 5 vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë edhe Shqipërinë. Në vazhdim, Këshilli Evropian i mbledhur në Feira deklaroi se të gjitha vendet e përfshira në Procesin e Stabilizim-Asociimit do të konsideroheshin si kandidate potenciale për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Samiti i Zagrebit i mbledhur me datë 24 nëntor 2000 inicioi zyrtarisht fillimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit. Në këtë Samit, Bashkimi Evropian theksoi se perspektiva evropiane e të pesë vendeve të Ballkanit Perëndimor do të përcaktohej nga përparimi i tyre drejt një demokracie të qëndrueshme, shtetit ligjor, konsolidimit të ekonomisë së tregut dhe bashkëpunimit rajonal.

Me datë 31 janar 2003, Presidenti i Komisionit Evropian Romano Prodi filloi zyrtarisht negociatat për nënshkrimin e një Marrëveshjeje Stabilizim-Asociimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian dhe shteteve të tij anëtare.

Këshilli Evropian i mbledhur në Selanik (21 qershor 2003) konfirmoi të ardhmen e vendeve të Ballkanit Perëndimor si anëtare të ardhshme të Bashkimit Evropian.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian dhe shteteve të tij anëtare u nënshkrua në 12 qershor 2006. Republika e Shqipërisë e ratifikoi këtë Marrëveshje me Ligjin Nr. 9590, datë 27.7.2006 "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare". Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit hyri në fuqi me datë 1 prill 2009 mbas ratifikimit të saj nga Parlamenti i Bashkimit Evropian dhe të gjitha shtetet anëtare.

Viti 2009 shënoi po ashtu, një moment të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë. Me datë 28 prill 2009, Kryeministri i Shqipërisë, Z. Sali Berisha paraqiti kërkesën zyrtare për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Në përgjigje të paraqitjes së kërkesës për anëtarësim të Shqipërisë, Këshilli i Bashkimit Evropian me datë 16 nëntor 2009, i kërkoi Komisionit Evropian që të hartonte dhe t'i paraqiste Shqipërisë Pyetësorin për përgatitjen e Opinionit të tij për marrjen e statusit të vendit kandidat. Me datë 16 dhjetor 2009, Komisioni Evropian i paraqiti Shqipërisë Pyetësorin e përbërë nga 2284 pyetje dhe mbi 2000 nënpyetje.

[1] Sot Bashkimi Evropian
[2] Kjo Marrëveshje hyri në fuqi me 5 nëntor 1992.

Për përgatitjen për plotësimin e përgjigjeve të Pyetësorit u zhvilluan më shumë se 60 sesione trajnimi të veçanta me punonjës të administratës publike. Për hartimin dhe rishikimin e 3853 faqeve me përgjigje u angazhuan rreth 1200 nëpunës civilë. 24 ekspertë dhe akademikë shqiptarë, 28 ekspertë ndërkombëtarë dhe 67 përkthyes u angazhuan po ashtu në këtë proces. Përgjigjet e Pyetësorit u dorëzuan zyrtarisht në Bruksel me datë 14.4.2010.

Komisioni Evropian cilësoi në Raportin Analitik të tij mbi aplikimin e Shqipërisë për statusin e vendit kandidat, se "*Ministria e Integrimit së bashku me grupet e punës, kanë menaxhuar në mënyrë të kënaqshme procesin e përgjigjeve të pyetësorit*".

Në kuadër të marrjes së statusit të vendit kandidat, një vëmendje e veçantë i është kushtuar organizimit të strukturave negociuse, procedurave të negocimit dhe përgatitjes së nëpunësve civilë për këtë proces, në përputhje edhe me eksperienca e suksesshme të vendeve të tjera të rajonit.

Bashkimi Evropian si një pikësynim strategjik

Qeveria e Integrimit Evropian e krijuar pas zgjedhjeve të vitit 2009 është e angazhuar për vazhdimin me hapa të sigurtë dhe ritme të përshpejtuara të proceseve integruese me synimin e përgatitjes për anëtarësim të Shqipërisë, brenda mandatit katërvjeçar të saj.

Në programin e Qeverisë përcaktohet se integrimi evropian mund të arrihet vetëm përmes:

- Forcimit të demokracisë, shtetit të së drejtës, luftës, kundër korrupsionit, rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë publike dhe garantimit të të drejtave themelore të qytetarëve,
- Zhvillimit ekonomik të shpejtë dhe të qëndrueshëm, zhvillimit të mëtejshëm të tregut të lirë e konkurrencës e përdorimit eficent të burimeve publike e private,
- Arritjes së standardeve evropiane në të gjitha fushat e aktivitetit publik, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit dhe zbatimit të tij konsekuent dhe eficent nga të gjitha institucionet publike shqiptare,
- Zhvillimit të kapaciteteve njerëzore të administratës publike shqiptare, përmes përmirësimit dhe forcimit të strukturave administrative, zhvillimit të mëtejshëm të koordinimit ndërinstitucional dhe kualifikimit të mëtejshëm të punonjësve të administratës publike shqiptare në nivel qendror dhe vendor.

Qëllimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2012 – 2015

Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2012 – 2015 ka një pikësynim të dyfishtë. Së pari, ai është dokumenti bazë për të gjitha institucionet publike shqiptare për përcaktimin e prioriteteve, planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ratifikuar me Ligjin Nr. 9590, datë 27.7.2006 "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes se Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare". Kjo

Marrëveshje ka hyrë në fuqi me datë 1 prill 2009 pas ratifikimit nga Bashkimi Evropian dhe të gjitha shtetet e tij anëtare.

Me ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Shqipëria ka marrë mbi vete një sërë detyrimesh të cilat duhet të realizohen brenda afateve të caktuara. Afati përfundimtar për realizimin e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është data 31 mars 2019.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit paraqet drejtimet kryesore në të cilat duhet të punojë Shqipëria për plotësimin e kritereve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, të njohura ndryshe edhe si Kriteret e Kopenhagenit, dhe më konkretisht:

- Demokracia dhe shteti i së drejtës, duke përfshirë respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare,
- Krijimi i një ekonomie tregu funksionale, të aftë për të përballuar trysninë e konkurrencës nga Shtetet e tjera Anëtare të Bashkimit Evropian,
- Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis*, ngritja e strukturave administrative dhe adaptimi i procedurave administrative për të garantuar zbatimin e plotë, të saktë dhe uniform të këtij legjislacioni. Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton detyrimin e Shqipërisë për të realizuar përafrimin gradual të legjislacionit të saj me *acquis*.

Aftësia e Shqipërisë për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit do të shërbejë si një shprehje dhe provë e gatishmërisë së saj për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Po ashtu, zbatimi me sukses i kësaj Marrëveshje do të përbëjë një eksperiencë të çmuar në hapat e mëtejshëm të Shqipërisë gjatë procesit të negocimit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Së dyti, bazuar në përparimin e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian dhe si pjesë e pritshmërisë për marrjen e statusit të vendit kandidat brenda vitit 2012, PKZMSA 2012 – 2015 ka si pikësynim final prioritizimin, planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e përafrimit të plotë të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian si një kusht thelbësor për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Për realizimin e këtyre dy qëllimeve komplementare është i domosdoshëm planifikimi i hapave të mëtejshëm për realizimin e reformave të domosdoshme. Planifikimi është parakusht për bashkërendim efikas, zbatim dhe monitorim të zbatimit dhe zhvillimit të strategjive dhe përpjekjeve të Shqipërisë në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

PKZMSA 2012 – 2015 përfshin të gjitha masat ligjore dhe aktivitetet që ministritë e linjës, institucionet e varësisë së tyre dhe institucionet e pavarura do të ndërmarrin për të plotësuar dy qëllimet e mësipërme gjatë periudhës 1 janar 2012 deri me 31 dhjetor 2015.

PKZMSA 2012 – 2015 u hartua duke pasur në konsideratë zhvillimet më të fundit në procesin e integrimit evropian të Republikës së Shqipërisë dhe më konkretisht:

- Rezultatet pozitive të arritura gjatë zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,

- Perspektivën e marrjes së statusit të vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian,
- Raportin Analitik të Komisionit Evropian të vitit 2010 dhe Raportin e Progresit të Komisionit Evropian të vitit 2011,
- Rekomandimet e institucioneve të përbashkëta të ngritura në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit: Këshillit të Stabilizim-Asociimit, Komitetit të Stabilizim-Asociimit, Komitetit Parlamentar për Stabilizim-Asociimin dhe Nënkomiteteve për fushat e ndryshme të *acquis*.

PKZMSA 2012 – 2015 do të rrisë transparencën e institucioneve publike shqiptare dhe do të lehtësojë monitorimin dhe vlerësimin e tyre nga shoqëria civile. Po ashtu, PKZMSA do të ndihmojë biznesin shqiptar që të planifikojë më mirë aktivitetin e tij prodhues dhe tregtues në përputhje me legjislacionin e ri i cili do të miratohet në periudhën 2012 – 2015 dhe shkallën e përafrimit të tij me *acquis* e Bashkimit Evropian.

Struktura e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2012 – 2015

PKZMSA 2012 – 2015 përbëhet nga këto pjesë:

- Hyrja
- Kriteri politik
- Kriteri ekonomik
- Aftësia për të plotësuar standardet evropian, (e ndarë në 33 kapituj)
- Krijimi i versionit kombëtar të *acquis*
- Shtojcat

Hyrja paraqet një pamje të përgjithshme të marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Evropian, parashtron objektivat, strukturën dhe metodologjinë për përgatitjen e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Kriteri politik trajton çështjet e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës, reformat në administratën publike dhe në sistemin e drejtësisë, luftën kundër korrupsionit, lirinë e medias, të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare, institucionet e vuajtjes së dënimit dhe sistemin e drejtësisë për të miturit, sistemin e provës, si dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.

Kriteri ekonomik trajton çështjet e stabilitetit makroekonomik, rritjes ekonomike, reformat në investimet publike dhe private, borxhin publik, politikat monetare, dhe bilancin e pagesave.

Standardet evropiane – Aftësia për të përballuar detyrimet e anëtarësimit, është e ndarë në 33 kapituj që i korrespondojnë kapitujve të *acquis*, të quajtur ndryshe edhe kapituj negociues. Kapituj të veçantë janë të ndarë edhe në nënkapituj. Çdo kapitull/ nënkapitull i kësaj pjese përbëhet nga pjesa hyrëse dhe nga pjesa programuese.

Pjesa hyrëse ofron në formë përshkruese informacion mbi situatën aktuale, sfidat dhe strategjitë për adresimin e prioriteteve në fushën apo nënfushën përkatëse.

Pjesa programuese parashikon në detaje prioritetet e zbërthyera në iniciativa ligjore, aktivitete zbatuese dhe institucionet përgjegjëse për realizimin e tyre.

Për çdo kapitull të *acquis* të përfshirë në PKZMSA, iniciativat ligjore dhe aktivitetet zbatuese janë grupuar sipas afatit të realizimit të tyre në:

- Iniciativa dhe aktivitete afatshkurtra 2012-2013
- Iniciativa dhe aktivitete afatmesme 2014-2015

Përcaktimi i prioriteteve është bërë në përputhje me detyrimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Partneritetit Evropian dhe rekomandimet e institucioneve të përbashkëta të krijuara në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Krijimi i versionit kombëtar të *acquis* është një pjesë e veçantë në të cilën paraqitet vizioni i Ministrisë së Integrimit në lidhje me përkthimin e *acquis* në gjuhën shqipe. Përkthimi i *acquis* në gjuhën shqipe ka një qëllim të dyfishtë. Së pari, përkthimi i *acquis* në gjuhën e vendit kandidat është një nga kushtet e anëtarësimit. Së dyti, përkthimi i *acquis* do të ndihmojë institucionet publike shqiptare në procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis*. Në këtë pjesë do të pasqyrohen po ashtu edhe rezultat e arritura dhe ato të pritshme në lidhje me këtë proces.

Shtojcat

Shtojcat e PKZMSA 2012 – 2015 janë pjesë integrale e Planit dhe në përputhje të plotë me informacionin e përmbajtur në pjesët Kapitulli politik, Kapitulli Ekonomik dhe Standardet Evropiane. Në shtojca bëhet edhe një detajim i mëtejshëm i informacionit të paraqitur në këto pjesë.

Shtojca 1: Iniciativat ligjore sipas fushave

Përfshin listën e iniciativave ligjore të cilat parashikohen të ndërmerren nga institucionet publike shqiptare. Lista është e ndarë së pari sipas pjesëve dhe më tej në kapituj dhe nënkapituj. Në këtë listë përcaktohet titulli i aktit që do të miratohet, institucioni përgjegjës për hartimin e tij, institucionet bashkëpunuese në hartimin dhe zbatimin e tij (nëse ka të tilla), afati i miratimit, afati i hyrjes në fuqi, aktet e *acquis* të cilat ai përafron (nëse akti përafron) dhe shkalla e përafrimit të aktit/ akteve të *acquis* së Bashkimit Evropian.

Shtojca 2: Implikimet financiare sipas institucioneve

Shtojca 2 paraqet implikimet financiare (kostot) për realizimin e masave kombëtare (iniciativa ligjore dhe aktivitete zbatuese) duke filluar që nga momenti i hartimit të aktit ligjor, konsulenca e marrë në lidhje me të, shpenzimet për përkthimin e kryer nga institucioni të akteve apo dokumenteve të ndryshme, shpenzimet për marrjen në punë të nëpunësve shtesë, shpenzimet në infrastrukturë apo operative për zbatimin e këtij akti në praktikë.

Shtojca 3: Implikimet financiare sipas kapitujve
Në shtojcën 3, informacioni mbi implikimet financiare paraqitet bazuar në ndarjen në pjesë dhe më tej në kapituj dhe nënkapituj të PKZMSA 2012 – 2015. Për çdo kapitull/ nënkapitull të veçantë tregohen shpenzimet e detajuara të çdo institucioni i cili ka të regjistruar masa kombëtare në këtë kapitull/ nënkapitull.

Monitorimi dhe raportimi mbi Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

Çdo ministri apo institucion i veçantë është përgjegjës për realizimin e masave kombëtare të parashikuara për të në PKZMSA 2012 – 2015. Një rol veçanërisht të rëndësishëm duhet të luajnë drejtoritë/ njësitë e integrimit në ministritë dhe institucionet e linjës. Ato duhet të ndjekin në mënyrë të vazhdueshme realizimin dhe problematikën për çdo masë të veçantë. Është përgjegjësi e tyre që të koordinojnë edhe raportimin e ministrisë/ institucionit në lidhje me realizimin e Planit.

Për realizimin e masave të caktuara, është i domosdoshëm forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional veçanërisht në kuadër të grupeve ndërinstitucionale të punës të krijuara në bazë të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 183, datë 11.12.2009 "Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull të *acquis communautaire*, duke përfshirë edhe kapitujt e kriterit politik dhe ekonomik"

Ministritë dhe institucionet e tjera do të raportojnë çdo 3 muaj (java e tretë) me shkresë dhe në Sistemin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit – Plani Kombëtar. Specialistët e ministrive dhe institucioneve të tjera janë trajnuar në mënyrë të posaçme për përdorimin e këtij Sistemi.

Ministria e Integrimit monitoron dhe raporton çdo 3 muaj mbi zbatimin e PKZMSA 2012 – 2015 në Këshillin e Ministrave. Duke pasur parasysh rëndësinë e Planit dhe përvojën e fituar gjatë hartimit të përgjigjeve të Pyetësorit, çdo specialisti të Ministrisë së Integrimit i është caktuar kapitulli ose kapitujt për të cilët ai do të jetë përgjegjës për të ndjekur procesin e përafrimit të legjislacionit, realizimin e detyrave dhe hartimin e raporteve mbi PKZMSA 2012 – 2015.

1. KRITERET POLITIKE

1.1. DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS

Objektivi strategjik

Në kuadër të konsolidimit të demokracisë parlamentare dhe të shtetit të së drejtës, Qeveria Shqiptare është e angazhuar plotësisht në ndërmarrjen dhe zbatimin në gjerësi dhe thellësi të reformave lidhur me forcimin e procesit legjislativ, sistemin zgjedhor, pushtetin qëndror dhe atë vendor, administratën publike, sistemin e drejtësisë; reforma këto të sugjeruara dhe të mbështetura nga partneret ndërkombëtare në bashkëpunim me institucionet e tjera kushtetuese që përfshihen në çështjet e reformave dhe performancës së shtetit të së drejtës si dhe në përputhje me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes se Stabilizim-Asociimit.

Qeveria shqiptare është e angazhuar në marrjen e masave konkrete për funksionimin e duhur të parlamentit bazuar në dialog politik konstruktiv dhe të qëndrueshëm mes të gjitha palëve, përmirësimin e funksioneve rregullatore dhe rritjen e kapaciteteve administrative të Parlamentit me qellim forcimin e proçesit legjislativ, i cili kontribuon në plotësimin me efikasitet të detyrimeve që rrjedhin nga MSA BE-Shqipëri, gjatë periudhës se paraaderimit në BE.

Qeveria Shqiptare angazhohet për një reformë të thellë të vërtetë të administratës publike, trajtim dhe vlerësim bazuar në meritën, përkushtimin e nëpunësve të saj, krijimin e një rrjeti institucional efektiv dhe efecient, si dhe të një administrate të qëndrueshme, të përkushtuar ndaj zbatimit të ligjit dhe të ofrimit të shërbimeve më të mira për qytetarët, me nëpunës civilë të rekrutuar dhe të vlerësuar sipas meritës dhe përkushtimit në kryerjen e detyrave individuale. Qeveria Shqiptare do të ketë si objektiv final krijimin e një administrate publike efiçente dhe të aftë të përballojë realizimin e plotë të angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Çdo veprim që do të ndërmarrë Qeveria shqiptare në kuadrin e reformës në sistemin e drejtësisë dhe ndërtimit të shtetit të së drejtës, ka si qëllim dhe objektiv final krijimin e një sistemi drejtësie bashkëkohor, të aftë të sigurojë garantimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë, ndershmërisë dhe efektivitetit të drejtësisë shqiptare, të respektojë parimet e proçedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, duke mbrojtur të drejtat, interesat dhe liritë e ligjshme të njeriut, të kontriboje në administrimin e drejtesisë penale, si dhe të implementojë acquis communautaire dhe të pasqyrojë standardet e Bashkimit Evropian në fushën e drejtësisë.

Lufta kundër korrupsionit përbën një prioritet absolut të Qeverisë Shqiptare. Duke pasur si vizion themelor reduktimin progresiv dhe të qëndrueshëm të korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e vlerave në qeverisje, drejtimet kryesore ne luftën ndaj këtij fenomeni janë:

- Nërmarrja e reformave për parandalimin e tij;
- Forcimi i integritetit të institucioneve dhe promovimit të vlerave të qeverisjes;

- Monitorimi i gjithanshëm i fenomenit të korrupsionit, luftës kundër tij nga shoqëria civile dhe forcimi i rolit të saj;
- Ndëshkimi administrativ dhe ligjor të zyrtarëve të korruptuar.

Zbatimi i përgjegjshëm i strategjisë antikorrupsion në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim e Integrim (SKZHI), synon reduktimin progresiv e të qëndrueshëm të korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e vlerave në qeverisje nëpërmjet kultivimit e forcimit të mendësisë së shërbimit ndaj qytetarëve nga administrata publike, zbatimit të efektshëm e të barabartë të ligjit, përmirësimit të transparencës e informimit, zhvillimit të shpejtë e të qëndrueshëm ekonomik e njerëzor, cilësisë, përgjegjshmërisë e efektivitetit në qeverisje.

1.1.1. PARLAMENTI

Situata aktuale

Kuvendi i Shqipërisë luan një rol themelor ne sistemin demokratik të Republikës së Shqipërisë. Ai është organi më i lartë ligjvënës, në të cilin shqyrtohet dhe miratohet legjislacioni i propozuar. Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi ushtron edhe funksionin e kontrollit politik ndaj qeverisë si dhe monitoron zbatimin e detyrimeve që rrjedhin për Republikën e Shqipërisë nga MSA BE - Shqipëri, nëpërmjet instrumenteve të kontrollit parlamentar të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit.

Kuvendi është institucioni ku zhvillohet dialogu politik konstruktiv dhe i qëndrueshëm ndërmjet të gjitha forcave politike për realizimin e reformave të kërkuara dhe përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në kuadër të procesit të Integrimit Europian të Shqipërisë.

Një rol shumë të rëndësishëm Kuvendi i Shqipërisë luan për reformën parlamentare, reformën zgjedhore, reformën ne media dhe në miratimin e ligjeve të cilat janë rëndësishme për të ardhmen Europiane të vendit.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e amenduar me Ligjin nr. 9675, datë 13.01.2007 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" dhe me Ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë";
- Ligji nr. 7756, datë 11.10.1993 "Për Shtypin", i ndryshuar me Ligjin nr. 8239, datë 3.09.1997;
- Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë";
- Ligji nr 8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit";
- Ligji nr 8550, datë 18.11.1999, "Për statusin e deputetin";

- "Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë" miratuar me vendim të Kuvendit nr. 166 datë 16.12.2004, e amenduar me vendimet e Kuvendit nr. 15 datë 27.12.2005, nr. 193, datë 7.7. 2008, nr. 21, datë 4.3.2010 dhe nr. 41, datë 24.06.2010.

Kuvendi i Shqipërisë luan një rol shumë të rëndësishëm për realizimin e reformës në media. Kuadri ligjor aktual lidhur me mediat audiovizuale përbëhet nga këto akte:
Ligji Nr. 8410, datë, 30.09.1998 "*Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë*" (Fletorja Zyrtare: Viti 1998, Nr 24; Data e botimit: 20-10-1998), i cili është ndryshuar me ligjet e mëposhtme:

- Ligji nr. 8655 datë, 31.07.2000, "Për disa Ndryshime në ligjin Nr. 8410, datë, 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë" (Fletore zyrtare: nr 24, datë 07.08. 2000);
- Ligji nr. 8794, datë 10.05.2001, "Për disa Ndryshime në ligjin Nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar" (Fletore zyrtare: nr 34, datë 15.06.2001);
- Ligji nr. 9016, datë 20.02.2003, "Për disa Ndryshime në ligjin Nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar", (Fletore zyrtare: nr 18, datë 21.03. 2003);
- Ligji nr. 9124 datë 29.07.2003, "Për disa shtesa në Ligjin Nr. Nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar", (Fletore zyrtare: nr 71, datë 19.08.2003);
- Ligji nr. 9531, datë 11.5.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. Nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar", (Fletore zyrtare: nr. 65, datë 28.06.2006);
- Ligji nr. 9677, datë 13.01.2007, "Për disa Shtesa dhe Ndryshime në ligjin Nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar", (Fletore zyrtare: nr. 2, datë 14.01.2007);
- Ligji Nr. 9962, datë 21.07.2008, "Për një shtesë në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar" (Fletore zyrtare: nr. 125, datë 01.08.2008).
- Ligji Nr. 9742 datë, 28.05.2007 "Për Transmetimet Numerike në Republikën e Shqipërisë".

Ligji Nr. 8410, datë, 30.09.1998 "*Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë*" ka përafrim të pjesshëm me aktet kryesore të *acquis të BE-së* që rregullojnë fushën e medias dhe shërbimet audiovizive si më poshtë:

- Direktiva 2002/19/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, dt. 7 Mars 2002 "*Mbi aksesin në, dhe ndërlidhjen (interkoneksionin) e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe faciliteteve që lidhen me to*" (Direktiva e Aksesit), 32002L0019, Gazeta Zyrtare nr. 108, seria L e datës 24.4.2002, fq. 7–20;
- Direktiva 2002/20/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, dt. 7 Mars 2002, "*Mbi autorizimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike*" (Direktiva e Autorizimit), 32002L0020, Gazeta Zyrtare nr. 108, seria L e datës 24.4.2002, fq. 21–32;
- Direktiva 2002/21/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, dt. 7 Mars 2002, "*Mbi një kuadër të përbashkët rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike*" (Direktiva e Kuadrit), 32002L0021, Gazeta Zyrtare nr. 108, seria L e datës 24.4.2002, fq. 33–50;
- Direktiva 2002/22/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, dt. 7 Mars 2002, "*Mbi shërbimin universal dhe të drejtave të përdoruesit lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike*", (Direktiva e Shërbimit Universal), 32002L0022, Gazeta Zyrtare nr. 108, seria L e datës 24.4.2002, fq. 51–77;

- Direktiva e Komisionit 2002/77/KE, dt. 16 Shtator 2002, "*Mbi konkurrencën në tregjet e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike*", 32002L0077, Gazeta Zyrtare nr. 249, seria L e datës 17.9.2002, fq. 21-26

Masat ligjore afatshkurtra

Miratimi i projektligjit "*Per mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", ku do të përfshihet edhe rregullimi i transmetimeve numerike. Ky projekt-ligj synon të arrijë një përafrim të plotë me:

- Direktivën e Shërbimit Mediatik Audiovizual (AVMSD-Audio Visual Media Service Directive), 2010/13/BE;
- Kërkesat e paketës së Direktivave për komunikimet elektronike në lidhje me transmetimet radio televizive, në veçanti me kërkesat e Direktivës kuadër, 2002/21/KE e amenduar me Direktivën 2009/140/KE; Direktivës së autorizimit, 2002/20/KE e amenduar me Direktivën 2009/140/KE, Direktivës së aksesit 2002/19/KE e amenduar me Direktivën 2009/140/KE, dhe Direktivës së shërbimit universal 2002/22/KE e amenduar me Direktivën 2009/136/KE;
- Direktivën e aksesit të kushtëzuar 98/84/KE.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Përsosja e mëtejshme e funksionit kushtetues të ligjbërjes dhe ushtrimit të kontrollit parlamentar;
- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Kuvendit të Shqipërisë dhe i Komisioneve të Përhershme të Kuvendit, duke përfshirë edhe Komisionin për Integrimin Europian, për të përmbushur rolin e tyre në kuadër të procesit të integrimit evropian të Shqipërisë dhe të përafrimit të legjislacionit Shqiptar me *Acquis* të BE-së;
- Përsosja e mëtejshme e rolit të Parlamentit në monitorimin dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA BE Shqipëri;
- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative të Kuvendit në çështjet e integrimit Europian, duke vazhduar trajnimin e stafit të Kuvendit mbi kuadrin ligjor dhe institucional të BE-së.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Implementimi i projektit "*Forcimi i Kuvendit të* Shqipërisë", në kuadër të Programit IPA 2010 për Shqipërinë. Në kuadër të implementimit të këtij projekti, parashikohen 5 komponentë/aktivitete:
- Përmirësimi i proçedurave ligjore për një proçes përafrimi më efikas me Bashkimin Europian,
- Forcimi i kapaciteteve legjislative të koordinimit dhe ndërgjegjësimit të Komisionit për Integrimin Europian dhe të gjitha Komisioneve të tjera Parlamentare, lidhur me çështjet/aktivitetet e integrimit Europian,
- Forcimi i kapacitetit mbikëqyrës i të gjitha Komisioneve Parlamentare mbi veprimtaritë e qeverisë,

- Përmirësimi i aktiviteteve të komunikimit dhe të informimit të Parlamentit,
- Forcimi i kapaciteteve administrative të strukturave të tjera parlamentare, Shërbimi i Financave dhe Buxhetit dhe Shërbimi i Burimeve Njerëzore.

1.1.2. ZGJEDHJET

Situata aktuale

Zhvillimi i zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë, bëhet mbi bazën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë miratuar me Ligjin Nr.8417, datë 21.10.1998, ndryshuar me ligjin Nr.9904, datë 21.04.2008, dhe ligjin nr.9675, datë 13.01.2007, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, Ligji nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizmin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", si dhe ligjeve të tjera të dala në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës dhe aktet nënligjore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbeshtetur në detyrimet që përcaktohen në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore dhe referuar praktikave më të mira zgjedhore, me qëllim realizimin e zgjedhjeve vendore të datës 8 maj 2011 sipas standarteve më të mira, ndërmori në periudhën parazgjedhore masat e duhura të cilat parashikohen në planin orientues të veprimit të miratuar me Vendimin nr. 29, datë 01.10.2010. Në këtë plan u paraqitën të gjithë hapat dhe procedurat (vendime, udhezime dhe veprimeve konkrete) që duheshin ndjekur në periudhën para zgjedhore, ditën e zgjedhjeve, procesin e numërimit të votave dhe periudhën pas zgjedhore, të shoqëruara me afatet kohore të realizimit të tyre.

KQZ për administrimin e këtij prosesi zgjedhor ka nxjerrë gjithësej 1229 akte, dhe 1 udhëzim. Për këto zgjedhje ishin në fuqi dhe u zbatuan 21 Udhëzimet e miratuara nga KQZ gjatë vitit 2009, të cilat përcaktojnë në mënyrë të qartë të gjithë procedurat që do të ndiqeshin prej subjekteve zgjedhore si dhe komisioneve të niveleve më të ulta, me qëllim garantimin e një procesi të drejtë zgjedhor, administrimit transparent të tij, si dhe të barazisë për të gjithë subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në të. Këto akte ishin të qarta dhe rregullonin në përgjithësi marrëdhëniet në lidhje me organizimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore.

Ky proces është zhvilluar në transparencë të plotë dhe me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuar dhe përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare që kanë asistuar dhe monitoruar punën e KQZ-së gjatë periudhës zgjedhore.

Për zgjedhjet për organet e Qeverisjes Vendore jane rregjistruar si subjekte zgjedhore gjithësej 56 parti politike, të cilat në të gjitha zonat zgjedhore rregjistruan gjithësej, 6806 lista shumemërore dhe 872 kandidatë per kryetar bashkie/komune.
Për Bashkinë e Tiranës, në KQZ u rregjistruan në lista shumemërore, gjithësej 36 subjekte zgjedhore dhe tre kandidatë për kryetar bashkie.

Nga verifikimi qe KQZ beri kryesisht në listat shumemërore te partive politike te depozituara në KZAZ rezultoi se nga 54 parti te cilat depozituan lista shumemërore, 53 prej tyre nuk respektuan kriterin e gjinise ne një numër të konsiderueshem zonash zgjedhore.

Procesi dhe dita e zgjedhjeve në tërësi ka qenë pa dyshim standardi më demokratik i realizuar, jo vetëm nga administrata zgjedhore por edhe nga qytetarët shqiptarë, të cilët treguan një interes dhe pjesëmarrje të dukshme në rritje ditën e zgjedhjeve. Më datë 8 Maj, zgjedhjet u zhvilluan normalisht në 382 njësi vendore nga 384. Vetëm në 2 komuna, apo 0.5% të njësive vendore në rang vendi, zgjedhjet nuk u zhvilluan.

Përveç, administrimit të problematikës teknike dhe monitorimit të procesit në tërësi, KQZ, për herë të parë aplikoi me sukses informimin e publikut për pjesëmarrjen në votim, projekt ky i miratuar paraprakisht me vendim të KQZ-së. Pjesëmarrja në zgjedhje ditën e votimit në rang vendi ishte 51.1 %. Në përfundim të votimit, KQZ për herë të parë përfshiu në këtë informim publik edhe të dhënat për pjesëmarrjen e femrave në votim në rang vendi, i cili ishte 45.4%.

Për 384 postet për kryetarë njësie vendore, përfrshi dhe 11 njësitë bashkiake të Tiranës, garuan 872 kandidatë, nga të cilat 15 ose 1.72 përqind ishin femra. Ndër kandidatët fitues për kryetar, 5 ose 1.33 përqind ishin femra. Në listat shumemërore për këshilltarë të paraqitura nga 54 parti politike në të gjitha njësitë vendore, ishin gjithsej 74739 kandidatë, nga të cilat 22604 ose 30.2 përqind femra. KQZ me vendimet përkatëse miratoi shpërndarjen e 6152 mandateve për të 384 njësitë vendore, duke nominuar dhe këshilltarët fitues nga listat shumemërore të 49 partive që arritën të fitonin të paktën një mandat në këshill. Këshilltare femra u zgjodhën gjithsej 757 ose 12.4 përqind. Këshilltarë të propozuar nga zgjedhësit u zgjodhën 18 nga 62 që garuan në të gjitha njësitë vendore.

Procesi ankimor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore ne ndryshim nga zgjedhjet për Kuvendin 2009, është një proces i cili zgjat më tepër dhe shoqerohet me nje numër relativisht te madh ankimesh. Në fazën para datës së zgjedhjeve në KQZ u paraqitën gjithësej 58 Kërkesa ankimore nga subjketet zgjedhore. Kryesisht kërkesat ankimore janë paraqitur nga kandidatëte mbështetur nga zgjedhësit kundër vendimeve të KZAZ-ve për mosrregjistrimin e tyre si kandidat.

Me vendim nr. 1229, datë 15.09.2011 “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 08.05.2011”. KQZ shpalli rrezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore 2011.

Struktura institucionale

Burimet njerëzore në KQZ të pozicionuar sipas strukturë-organikës të institucionit, të aftë, të kualifikuar për përgatitjen, dhe mirëorganizimin e proceseve zgjedhore, janë burime të qëndrueshme konsulente për të gjithë aktorët dhe faktorët të përfshirë në zgjedhje.

Aktualisht KQZ ka 55 punonjës organikë, 7 anëtarë dhe 48 punonjës të administratës, nga të cilët 30 trajtohen me statusin e nëpunësit civil dhe 18 trajtohen si punonjës mbështetës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 8 Maj 2011, në zbatim të vendimeve të tij, punësoi:

- 293 punonjës të përkohshëm, nga të cilët 91 ndihmës specialistë dhe 202 punonjës mbështetës, si asistent të punonjësve të përhershëm të Administratës së KQZ-së,
- 24 Inspektor dhe Nd/inspektor Rajonal Zgjedhor,
- 40 trajnues, të cilët kryen trajnimin e anëtarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit të Zgjedhjeve,
- 220 trajnues, të cilët kryen trajnimin e anëtarëve të Qendrave të Votimit dhe Grupeve të Numërimit të votave.

Për realizimin e zgjedhjeve në bazë të Kodit Zgjedhor aktual KQZ ngre komisionet e nivelit të dytë, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe Komisionin e Qendrës së Votimit (KQV). KZAZ dhe KQV përbehen nga shtatë anëtar të cilët propozohen nga partitë parlamentare të mazhorancës dhe opozitës.

1.1.3. QEVERIA

1.1.3.1. PUSHTETI QENDROR

Shqipëria ka bërë përparim të dukshëm në përmbushjen e kritereve që lidhen me stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoritetve. Fokusi i Qeverisë Shqiptare në vazhdimësi është reformimi i sistemit gjyqësor me qëllim marrjen e masave konkrete për përmirësimin në ofrimin e shërbimeve të tij ndaj qytetarit si dhe për garantimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë, ndershmërisë dhe efektivitetit të drejtësisë.

Vizioni i Qeverisë Shqiptare është që vendi të gëzojë të gjitha përfitimet e një zhvillimi të qëndrueshëm. Ekzekutivi shqiptar alokoi politika të përqëndruara drejt një dinamizimi të kapitalit ekonomik, sikurse investimeve domethënëse në infrastrukturën kombëtare. Shpërndarja dhe cilësia e shpenzimeve publike kanë luajtur një rol të rëndësishëm si leve tërheqëse për investimet private, si dhe në vazhdimësinë e rritjes ekonomike edhe gjatë një periudhe shumë sfiduese për të gjithë ekonominë globale.

Reformat ekonomike dhe sociale të ndërmarra kanë sjellë rezultate të prekshme në reduktimin e varfërisë. Progresi i deritanishëm në drejtim të mbrojtjes dhe përfshirjes për grupet e përjashtuara, ngritja e fuqizimi i strukturave sektoriale për grupet në nevojë, krijimi i modeleve të reja vlerësuese, si dhe numri i shërbimeve në rritje, flasin për mbështetjen gjithnjë e më të madhe për PAK, të moshuarit, fëmijët, të rinjtë dhe gratë në nevojë. Punësimi dhe hapja e vendeve të reja të punës kanë qenë ndër prioritet kryesore, në kushtet e reformimit të thellë të ekonomisë, sidomos të sektorëve industrialë dhe prodhues. Politikat aktive të punësimit përmes programeve të veçanta që po zbatohen, janë mjet për reduktimin e papunësisë dhe përjashtimit social për grupet në nevojë. Rritja e aksesit në arsim dhe kualifikim profesional për grupet e veçanta janë në funksion të zhvillimeve të tregut të punës dhe përqasjeve e reja synojnë që t'i zgjerojnë këto ndërhyrje në kuadrin e integrimit dhe zhvillimeve Europiane.

Struktura institucionale

Në bazë të nenit 95 (2) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pushteti ekzekutiv në Republikën e Shqipëria ushtrohet nga Këshilli i Ministrave. Këshilli i Ministrave, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ushtron çdo funksion shtetëror, që nuk i është caktuar organeve të pushteteve të tjera ose të organeve të qeverisjes vendore.Këshilli i Ministrave fillon të ushtrojë funksionet e tij pas betimit zyrtar para Presidentit të Republikës.
Neni 95 (1) i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcakton strukturën e Këshillit të Ministrave, si një institucion kushtetues kompleks i përbërë nga tri organe:
- Kryeministri;
- Zëvendëskryeministri;
- Ministrat e Qeverisë.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme publike. Ai ka të drejtë të marrë vendime në bazë të propozimeve të bëra qoftë nga Kryeministri, ose nga Ministra.

Përveç kuadrit të përgjithshëm rregullator të parashikuar në Kushtetutë, funksionimi i Këshillit të Ministrave është parashikuar edhe me një ligj. të veçantë, Ligji nr 9000, datë 30.01.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", i cili rregullon organizimin dhe marrëdhëniet midis tyre të: Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ministrave dhe institucioneve në vartësi të tyre, dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave. Ky ligj përcakton edhe aktet nënligjore të lëshuara nga këto organe dhe rregullon strukturën administrative të Këshillit të Ministrave. Në bazë të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kryeministri si kryetar i Këshillit të Ministrave, në kuptim të këtij neni është i ngarkuar me politika të përgjithshme qeverisëse dhe ka përgjegjësinë për të dhënë drejtimet kryesore ndaj politikave qeverisëse, sikurse për të koordinuar dhe mbikëqyrur aktivitetet e anëtarëve të këtij Këshilli.

ORIENTIMI, KOORDINIMI DHE MONITORIMI I PROCESIT TE INTEGRIMIT EVROPIAN

Objektivi Strategjik

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian, përbën objektivin strategjik themelor për qeverinë dhe shtetin shqiptar. Për këtë qëllim, përshpejtimi dhe garantimi i procesit të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), përmirësimi i vazhdueshëm i koordinimit dhe monitorimit të procesit të integrimit evropian si dhe forcimi i mëtejshëm i strukturave dhe i bashkëpunimit ndërinstitucional përbëjnë një angazhim të vazhdueshëm të Qeverisë shqiptare, si elementë shumë të rëndësishëm për të përshpejtuar integrimin në BE.

Në këtë kuadër, synohet koordinim dhe monitorim i zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në PKZMSA nëpërmjet raportimeve tremujore, me fokus vlerësimin e zbatimit të detyrimeve të

MSA-së, prioriteteve të Dokumentit të Partneritetit Evropian, rekomandimeve të progres raporteve dhe të takimeve të strukturave të përbashkëta BE-Shqipëri. Kontaktet e vazhdueshme dhe takimet periodike me të gjitha strukturat e përfshira, do të shërbejnë për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përgatitjen për realizimin në mënyrë të efektshme të sfidave të ardhshme në kuadër të intensifikimit të mëtejshëm të procesit të integrimit evropian.

Objektivat politikë të Qeverisë janë:

- Përgatitja e vendit për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, si objektivi strategjik themelor për qeverinë dhe shtetin shqiptar,
- Ngritja e strukturave të nevojshme institucionale për fillimin e procesit të *screening* dhe negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian,
- Përshpejtimi dhe garantimi i procesit të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit,
- Përmirësimi dhe rritja e efiçencës së koordinimit dhe monitorimit të procesit të integrimit evropian, si elementi kyç për të përshpejtuar procesin e integrimit në Bashkimin Evropian,
- Forcimi i strukturës së Ministrisë së Integrimit si një angazhim i vazhdueshëm nga ana e Qeverisë shqiptare për të përballuar kërkesat e integrimit të vendit,
- Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian në përputhje me Nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,
- Krijimi i versionit Kombëtar (në gjuhën shqipe) i *acquis* dhe përkthimi i legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e BE-së si një nga detyrimet kryesore për anëtarësimin e Shqipërisë në BE,
- Forcimi i bashkëpunimit me vendet e rajonit dhe vendet e tjera kandidate, në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave dhe teknikave për procesin e përkthimit të Legjislacionit Europian,
- Akreditimi i strukturës së menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian (IPA) për komponentin I të IPA-s;
- Thithja dhe menaxhimi më i mirë i asistencës së Bashkimit Evropian dhe menaxhimi i decentralizuar i fondeve të BE;

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Vitet e fundit përbëjnë një periudhë tepër të rëndësishme për integrimin evropian të Shqipërisë. Me 1 Prill 2009 hyri në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, rreth 3 vjet pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përkohshme (1 dhjetor 2006). Në 28 prill 2009, depozitimi i aplikimit për marrjen e statusit të vendit kandidat në BE pranë Presidencës Çeke të BE-së, kurorëzoi një proces të gjatë bashkëpunimi dhe dialogu konstruktiv me vendet anëtare të BE-së dhe me Komisionin Evropian. Plotësimi i kushteve për mundësimin e marrjes së këtij statusi është sfida më e madhe për qeverinë shqiptare në periudhën afatmesme.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar menaxhimit të procesit të integrimit evropian. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe në zbatim të saj, Qeveria shqiptare ngriti strukturat e përbashkëta me BE, të cilat shqyrtojnë çështjet më të rëndësishme në drejtim të realizimit të objektivave të kësaj Marrëveshjeje.

Gjithashtu, Qeveria shqiptare ka ngritur dhe ka vënë në funksionim hierarkinë e plotë të strukturave kombëtare për drejtimin, mbikëqyrjen dhe koordinimin e procesit të integrimit evropian, duke njohur dhe vlerësuar rëndësinë strategjike të këtyre strukturave për përcaktimin e politikave kryesore dhe koordinimin e aspekteve teknike të procesit të integrimit.

Në përgjigje të paraqitjes së kërkesës për anëtarësim të Shqipërisë, Këshilli i Bashkimit Evropian, i kërkoi Komisionit Evropian që të hartonte dhe t'i paraqiste Shqipërisë Pyetësorin për përgatitjen e Opinionit të tij për marrjen e statusit të vendit kandidat.

Komisioni Evropian, në Raportin Analitik dhe Opinionin e vitit 2010, duke njohur arritjet e bëra nga Shqipëria, në drejtim të përmbushjes së kritereve të anëtarësimit përcaktoi gjithashtu se për hapjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Shqipëria duhet të avancojë më tej drejt përmbushjes së plotë të këtyre kritereve dhe në veçanti të 12 prioriteteve, plotësimi i të cilave kontribuon në qëndrueshmërinë e institucioneve dhe të shtetit ligjor.

Në drejtim të adresimit të 12 prioriteteve kyçe, institucionet publike shqiptare morën masat për të bërë një analizë të plotë të tyre. Procesi analizues dhe hartues synoi të evidentojë pikat e dobëta, si dhe të formulojë një grup masash afatshkurtra me hapa dhe përgjegjësi të qarta, të pasqyruar këto në një Plan Veprimi (PV). Plani i Veprimit u diskutua në takime konsultative me përfaqësues nga Komisionet Parlamentare për Integrimin Evropian dhe për Çështjet e Jashtme, përfaqësues të shoqërisë civile, nga organizata ndërkombëtare dhe me Komisionin Evropian. Si rezultat i gjithë këtij procesi, në qershor 2011, Komiteti Ndërministror për Integrimin miratoi Planin e Veprimit për adresimin e 12 prioriteteve kyçe të Opinionit të Komisionit Evropian (KE) 2010.

Në vijim të rekomandimeve të Progres Raportit të Komisionit Evropian 2011, si dhe listës së sugjerimeve të KE mbi Planin e Veprimit të përcjella në Nëntor 2011, Ministria e Integrimit mori masa për rishikimin e Planit të Veprimit. Qëllimi kryesor i këtij procesi rishikimi ishte zbërthimi në masa konkrete dhe realiste i detyrimeve për përmbushjen e 12 prioriteteve të caktuara në Opinionin e KE.

Rishikimi i PV u realizua pas një procesi analizues i cili shërbeu për të identifikuar dhe formuluar një set masash me hapa dhe përgjegjësi të qarta, të cilat do të zbatohen dhe monitorohen.

Procesi i rishikimit është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Parlamentar të Integrimit Evropian. Një ndër risitë e këtij procesi, ka qenë rritja e përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e hartimit. Grupet e punës, gjatë fazës së rishikimit kanë përfshirë edhe

përfaqësues të shoqërisë civile. Gjithashtu konsultime të vazhdueshme janë bërë edhe me misionet e asistencës së BE-së në Shqipëri.

Pas gjithë këtyre fazave konsultuese me te gjithë aktoret e përfshirë dhe finalizimit të tij nga institucionet e përfshira në këtë proces, Plani i Veprimit i rishikuar u miratua në mbledhjen e Komitetit Ndërministror të Integrimit, me 21 mars 2012. Zbatim i angazhimeve të marra në këtë PV po monitorohet në mënyrë të vazhdueshme. Për këtë qellim Ministria e Integrimit raporton periodikisht pranë shërbimeve te Komisionit Evropian ashtu edhe pranë aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë proces.

Një detyrim shumë i rëndësishëm në procesin e integrimit është edhe krijimi i versionit kombëtar të legjislacionit evropian në gjuhën kombëtare, si një nga kushtet që duhet të plotësohen për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ministria e Integrimit ka përgatitur të gjithë bazën ligjore për organizimin e këtij procesi. Po ashtu, në funksion të procesit të përkthimit është vënë në përdorim programi i specializuar i përkthimit Trados, i cili do të garantojë cilësinë e mirë të përkthimit dhe do të ulë koston e këtij procesi.

Në ndihmë të punonjësve të administratës publike që merren me përafrimin e legjislacionit, përkthyesve, studiuesve dhe publikut të gjerë është krijuar, vënë në përdorim dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme Alterm, një fjalor elektronik on-line, i cili përmban për momentin 18,3016 terma të legjislacionit evropian të përkthyera në gjuhën shqipe.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Kuadri ligjor mbi procesin e integrimit evropian përbëhet nga aktet e mëposhtme:

- Ligji nr. 9590, datë 27.07.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve të tyre anëtare,
- Ligji nr. 9252, datë 8.7.2004, "Për punën e kuvendit në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian"
- Vendimi i Këshilli të Ministrave Nr. 580. datë 10.09.2004 "Për fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Integrimit Evropian"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 201, datë 29.03.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 28.08.2003 "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 7.1.2009 "Për një shtesë në Vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", të ndryshuar
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 179, datë 22.02.2006 "Për krijimin e njësive të integrimit në Ministritë e linjës",
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 07.01.2009 "Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 179, datë 22.02.2006 "Për krijimin e njësive të integrimit në Ministritë e linjës"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 07.03.2007 "Për procedurat e përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Evropian"

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 12.1.2011 "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve, ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar, të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA) Komponenti I"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 850, datë 14.12.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 23, datë 12.1.2011 "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve, ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar, të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA) Komponenti I"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1019, datë 08.10.2009, "Për ngarkimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme për ndjekjen e procesit të integrimit të vendit në Bashkimin Evropian"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 30.6.2010 "Për përcaktimin e autoriteteve dhe përgjegjësive për menaxhimin e decentralizuar të asistencës së BE në kuadër të IPA, Komponenti III: Zhvillimi rajonal dhe Komponentit IV: Zhvillimi i burimeve njerëzore"
- Urdhri i Kryeministrit nr. 154, datë 13.7.2006, "Për caktimin e Ministrit të Integrimit koordinator kombëtar i programit "Instrumenti i Ndihmës së Para-aderimit""
- Urdhri i Kryeministrit nr. 46, datë 1.04.2009 "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e strukturave të bashkërendimit ndërministror për realizimin e angazhimeve të marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit"
- Urdhri i Kryeministrit nr. 183, datë 11.12.2009 "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull të Acquis Communautaire, përfshirë dhe kapitujt për Kriterin Politik dhe atë Ekonomik"
- Udhëzim nr. 1, datë 14.05.2009 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërblimit së përkthyesve të jashtëm për përkthimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian në shqip dhe të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët zyrtare të BE"
- Udhëzim nr. 2, datë 14.05.2009 "Për funksionimin e Komisionit të Posaçëm për miratimin e materialeve të përkthyera të legjislacionit të Bashkimit Evropian në shqip"
- Udhëzim Nr. 3 datë 6.07.2009 për disa ndryshime në udhëzimin nr 1 datë 14.05.2009 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërblimit së përkthyesve të jashtëm për përkthimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët zyrtare të BE-së"

Struktura institucionale

Komisioni Parlamentar i Integrimit, i cili përcakton pozicionet parlamentare në raport me institucionet e tjera publike shqiptare dhe i monitoron ato mbi zbatimin e reformave të ndërmarra në kuadër të procesit të integrimit.

Ministria e Integrimit, është institucioni përgjegjës për drejtimin, koordinimin dhe monitorimin e procesit të integrimit, nëpërmjet orientimit të politikave sektoriale, kontrollit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, koordinimit dhe programimit të ndihmës financiare të BE-së dhe informimit të publikut,
Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) dhe Misioni i Shqipërisë në Bashkimin Evropian. MPJ është përgjegjëse për promovimin, njohjen, dhe mbështetjen e Procesit të Integrimit në nivelet më të larta politike të Bashkimit Evropian.

Njësitë e Integrimit në Ministritë e Linjës, të ngritura mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave rr. 179, datë 22.02.2006 "Për krijimin e njësive të integrimit në Ministritë e linjës". Në të gjitha Ministritë e linjës janë ngritur njësitë e integrimit, të cilat bashkërendojnë dhe mbështesin punën e institucioneve respektive për reformat e ndërmarra në kuadër të procesit të integrimit. Ato janë gjithashtu përgjegjëse për programimin dhe zbatimin e projekteve IPA në institucionet përkatëse.

Komiteti Ndërministror për Integrimin Evropian (KNIE) nën drejtimin e Kryeministrit, është struktura më e lartë institucionale, përgjegjëse për drejtimin në nivel të lartë politik dhe monitorimin e të gjithë procesit të integrimit evropian të Shqipërisë,
Komiteti i Koordinimit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian (KKNIE), i cili drejtohet nga Ministri i Integrimit dhe është përgjegjës për drejtimin në nivel të lartë administrativ të procesit të integrimit, dhe koordinimin e këtij procesi në nivel institucional.

Grupet Ndërinstitucionale të Punës për çdo kapitull të acquis communautaire, të ngritura mbi bazën e Urdhrit të Kryeministrit nr. 183, datë 11.12.2009 "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull të Acquis Communautaire, përfshirë dhe kapitujt për Kriterin Politik dhe atë Ekonomik".

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Zhvillimi i takimeve të institucioneve të përbashkëta BE – Shqipëri, të ngritura në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (Këshilli i Stabilizim-Asociimit, Komiteti i Stabilizim-Asociimit, Komiteti Parlamentar për Stabilizim-Asociimin dhe Nën-komitetet);
- Vlerësimi i përputhshmërisë së projekt-akteve normative shqiptare me legjislacionin evropian;
- Përgatitja e një Baze të dhënash (database) mbi legjislacionin e përafruar dhe shkallën e përafrimit, ku të kenë të drejtë hyrje (akses/ interaktiv) të gjitha Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore dhe të pavarura;
- Rishikimi periodik i Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, në zbatim të prioriteteve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Partneritetit Evropian, vlerësimeve të Raportit Vjetor të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe rekomandimeve të strukturave dy paleshe;
- Trajnime dhe seminare për ngritjen e kapaciteteve raportuese dhe zbatuese të njësive të Integrimit Evropian në Ministritë e linjë dhe institucionet e tjera qendrore dhe të pavarura;
- Trajnimi i nëpunësve të administratës publike mbi çështjet e integrimit evropian;
- Vënia në funksionim e Sistemit të Menaxhimit të Dokumentacionit për Drejtorinë e Përkthimit të Legjislacionit;
- Aftësimi dhe trajnimi i stafit të Drejtorisë së Përkthimit të Legjislacionit si dhe i përkthyesve të brendshëm dhe të jashtëm në përdorimin e programeve të specializuar të përkthimit;
- Hartimi i metodologjisë së përkthimit dhe informimi i institucioneve të cilat do të jenë të përfshira në këtë proces,

- Organizimi dhe koordinimi i procesit të përkthimit dhe rishikimit të versionit kombëtar të Legjislacionit Evropian;
- Hartimi i paketës së projekteve të Programit vjetor IPA, komponenti i I,
- Ngritja e Bazës së të dhënave elektronike për projektet IPA- komponenti I, në MIE;
- Menaxhimi i Programeve të Bashkëpunimit Rajonal;
- Hartimi i Kuadrit Strategjik të Koherencës dhe Programeve Operacionale për Komponentët III dhe IV të IPA;
- Dorëzimi i paketës së akreditimit për menaxhimin e decentralizuar të komponentit I të IPA;
- Përgatitja e paketës për akreditimin e komponentëve II-V të IPA;
- Botimi i dokumenteve, broshurave në kuadër të informimit të publikut mbi Bashkimin Evropian dhe procesin e integrimit;
- Informimi, sensibilizimi dhe komunikimi me grupet e interesit, lidhur me procesin e integrimit, përfitimet dhe detyrimet që rrjedhin nga marrja e Statusit dhe Anëtarësimit;
- Organizimi i trajnimeve për fuqizimin e kapaciteteve raportuese.

Masat legjislative afatmesme

- Analiza dhe rishikimi i kuadrit ligjor ekzistues për procesin e integrimit,
- Rishikimi dhe miratimi i PKZMSA-së.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Zhvillimi i takimeve të institucioneve të përbashkëta BE-Shqipëri, të ngritura në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (Këshilli i Stabilizim-Asociimit, Komiteti i Stabilizim-Asociimit, Komiteti Parlamentar për Stabilizim-Asociimin dhe Nën-komitetet);
- Rishikimi i PKZMSA-së në zbatim të prioriteteve të MSA-së, Partneritetit Evropian, vlerësimeve të Raportit Vjetor të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe rekomandimeve të strukturave dy paleshe;
- Vlerësimi i përputhshmërisë së projekt-akteve normative shqiptare me legjislacionin evropian;
- Aftësimi dhe trajnimi i stafit të Drejtorisë Përkthimit të Legjislacionit si dhe i përkthyesve të brendshëm dhe të jashtëm në teknikat e përkthimit dhe përdorimin e programeve të specializuar të përkthimit;
- Organizimi dhe koordinimi i procesit të përkthimit dhe rishikimit të versionit kombëtar të Legjislacionit evropian;
- Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve dhe vizitave studimore në vende të ndryshme, anëtare të BE-së;
- Sigurimi i pajisjeve të nevojshme IT në funksion të procesit të integrimit;
- Programimi, miratimi i marrëveshjeve financiare IPA;
- Koordinimi i Programeve IPA të Bashkëpunimit Rajonal;
- Dorëzimi i paketës për akreditimin e sistemit të menaxhimit të decentralizuar të IPA-s në Shqipëri për komponentët II-V;
- Botimi i dokumenteve, broshurave në kuadër të informimit të publikut për procesin e integrimit;

- Informimi dhe komunikimi me grupet e interesit.

Efektet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**159.463.000**	**171.811.000**	**173.770.000**	**172.067.000**
Mbulohen nga buxheti i	**89.323.000**	**171.811.000**	**173.770.000**	**172.067.000**
Mbuluar nga ndihma e huaj	**70.140.000**	**0**	**0**	**0**
Ndryshim	**-**	**-**	**-**	**-**

1.1.3.2. PUSHTETI VENDOR

Situata aktuale

Reformat e deritanishme institucionale në fushën e decentralizimit synojnë ofrimin e shërbimeve sa më cilësore pranë qytetarëve, forcimin e demokracive lokale dhe rajonale, ushtrimin e lirë të mandatit të të zgjedhurve vendorë, konsolidimin e shtetit ligjor dhe integrimin e Shqipërisë në hapësirat euroatlantike, luftën kundër korrupsionit, kontrollin e brendshëm dhe të jashtëm, aksesin në vendimarrje dhe rolin moniturues të shoqërisë civile dhe komuniteteve vendore.

Për një qeverisje të mirë, të vogël e transparente edhe në njësitë vendore, progres është bërë në transferimin e autoritetit fiskal, siç ishte ai për mbledhjen e taksës së biznesit të vogël, por edhe i dhjetëra taksave të tjera si dhe thjeshtëzimin e të tërë sistemit të taksave në Republikën e Shqipërisë; përgatitjen e Njësive Vendore të Shqipërise për të mundësuar një integrim të natyrshëm dhe të shpejtë të Shqipërisë në strukturat dhe fondet evropiane dhe për të bërë të mundur përthithjen e fondeve strukturore në të ardhmen; ngritjen e zyrave apo qendrave të informimit publik në çdo njësi të qeverisjes vendore; përdorimin e fondeve buxhetore vendore nga ato për shpenzime administrative, në fonde për investime e shërbime publike; rritjen dhe zgjerimin e praktikave të bashkëpunimit ndërkomunal, ndër rajonal dhe sidomos ato me vendet e tjera të rajonit, e vende të tjera të hapësirës evropiane.
Në vitet në vazhdim, do të vazhdojë puna në lidhje më përmirësimin e sistemit të financave vendore nëpërmjet hartimit dhe miratimit të një ligji integral për Financat e Pushtetit Vendor. Gjithashtu do të bëhet rishikimi i nivelit të dytë të qeverisjes vendore nëpërmjet draftimit dhe adoptimit të legjislacionit të nevojshëm lidhur me madhësinë, përcaktimin e kompetencave, mënyrën e zgjedhjes si dhe sigurimin e burimeve të qëndrueshme dhe të pavarura për qarkun.

Përsa i përket pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në njësitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, është kryer inventarizimi i plotë i tyre për 363 njësitë. Në këtë kontekst, janë miratuar listat paraprake të inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore për 220 njësi të qeverisjes vendore. Ndërsa për 120 njësi të qeverisjes vendore janë miratuar listat përfundimtare. Këto prona janë marrë në pronësi ose në përdorim nga njësite e

qeverisjes vendore. Në lidhje me ujësjellës kanalizimet ka përfunduar transferimi i sistemit të ujësjellës-kanalizimeve si dhe janë themeluar dhe regjistruar në QKR 25 shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve. Procesi do të vazhdojë me konsolidimin e tyre.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji Nr. 8548, datë 11.11.1999, "Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore".
- Ligji nr.8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore";
- Ligji Nr. 8653, datë 31.7.2000, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 8699, datë 23.11.2000, "Për ratifikimin e konventës në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar të bashkive dhe autoriteteve territoriale dhe 2 protokollet e saj shtesë".

Struktura institucionale

Qeverisja vendore në Shqipëri është organizuar në dy nivele:
1. *Komunat dhe Bashkitë*, janë njësi bazë të qeverisjes vendore dhe përbëjnë nivelin e parë të qeverisjes. (Kushtetuta neni 108/1)
Ato kryejnë të gjitha detyrat e vetëqeverisjes, me përjashtim të atyre që janë dhënë me ligj njësive të tjera të qeverisjes vendore. Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore (neni 108/4).
Në bazë të nenit 109 të Kushtetutës, organet përfaqësuese të njësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilët zgjidhen çdo 4-vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.
Organi ekzekutiv i bashkisë ose komunës është Kryetari i bashkisë/ komunës, cili zgjidhet çdo 4-vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.
Në bazë të ligjit 8654,date 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë", Bashkia Tiranë ka një status të vecantë dhe është e organizuar në 11 Njësi Bashkiake. Organet përfaqësuese, këshillat përkatës dhe kryetari i Njësive Bashkiake zgjidhen direkt nga zgjedhësit, nje herë në 4 vjet, në mënyrë të njëjtë si të gjitha Bashkitë dhe Komunat. Kompetencat e Njësive Bashkiake janë më të kufizuara dhe janë të përcaktuara në ligjin e sipërcituar.
2. *Qarku*, përbën nivelin e dytë të qeverisjes vendore. Qarku përfaqëson një unitet administrativo-territorial, të përbërë nga disa komuna dhe bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkëta. Qendra e qarkut vendoset në në një nga bashkitë që përfshihet në të. Shtrirja territoriale, emri dhe qendra e qarkut përcaktohen me ligj. Kufijtë e qarkut përputhen me kufijtë e komunave dhe bashkive që e përbëjnë atë.
Organi përfaqësues i qarkut është këshilli i qarkut. Kryetarët e komunave dhe bashkive janë anëtarë të këshillit të qarkut. Anëtarët e tjerë të tij zgjidhen me lista përpjesëtimore ndër këshilltarët bashkiak ose komunal nga këshillat përkatës.

Kompetencat e njësive vendore janë:

- Rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit te tyre;
- Të ushtrojnë të drejtat e pronës, administrojnë të ardhurat e tyre ne menyre te pavarur, si dhe të ushtrojnë veprimtari ekonomike;
- Kanë të drejtë të mbledhin dhe të shpenzojnë të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve te tyre;
- Kanë të drejtë për të vendosur taksa në nivel vendor;
- Caktojnë rregullat për organizimin dhe funksionimin e tyre në përputhje me ligjin;
- Krijojnë simbolet e qeverisjes vendore dhe titujt vendorë të nderit;
- Ndërmarrin nisma për çështje vendore përpara organeve të caktuara me ligj.

1.1.4. ADMINISTRATA PUBLIKE

Situata aktuale

Reforma në administratën publike mbetet një ndër prioritetet e qeverisë Shqiptare, qoftë kjo në planin e përmirësimit të kuadrit ligjor dhe zbatimit rigoroz të tij, ashtu dhe të forcimit të kapaciteteve për një administratë publike gjithmonë dhe më profesionale.

Që nga miratimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike, miratuar me Vendimin nr. 1017, datë 18/09/2009, të Këshillit të Ministrave, Ministria e Brendshme ka vazhduar të kryejë reforma të thella në administratën publike për krijimin e një rrjeti institucional efikas, si dhe të një administrate të qëndrueshme dhe të përkushtuar ndaj zbatimit të ligjit. Gjatë kësaj periudhe është punuar për forcimin dhe konsolidimin e parimeve të shërbimit publik, mbi bazën e meritës dhe të performancës. Është punuar për përmirësimin e cilësisë profesionale në administratën publike nëpërmjet një procesi të hapur e konkurrues rekrutimi e karriere, motivimi e shpërblimi të performancës së mirë, si dhe trajnimit të vazhdueshëm.

Në kuadër të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, është hartuar Letra e Politikave si dhe projektligji "Për nëpunësin civil", dokumente të cilat janë konsultuar paraprakisht me të gjitha grupet e interesit, përkatësisht me përfaqësues nga ministritë e linjës, institucionet e pavarura, institucionet e varësisë së Kryeministrit, ose ministrave të linjës, profesorë dhe akademikë të universiteteve shqiptare, përfaqësues të partive politike opozitare si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.
Në këndvështrim të ndryshimit të kulturës administrative të mënyrës së funksionimit të administratës publike, është hartuar Letra e Politikave si dhe projektligji "Mbi funksionimin dhe organizimin e administratës publike". Ky projektligj është duke u rishikuar nga ekspertë të SIGMA-s dhe mbas pasqyrimit të sugjerimeve përkatëse në këtë dokument, parashikohet të dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave në qershor 2012.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Në lidhje me fushën e funksionimit të administratës publike ekziston një bazë e gjerë legjislative, ku si legjislacion parësor mund të përmendet:

- Ligji nr. 8549 datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil";
- Ligji nr. 9131 datë 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike";
- Ligji nr. 8487, datë 13.05.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9000 datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave";
- Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative"
- Ligji nr. 8503 datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare";
- Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përmirësimi i mënyrës së funksionimit dhe organizmit të administratës publike, përmirësimi i procesit të rekrutimit të nëpunësve civilë, duke u bazuar në profesionalizëm si dhe reduktimin e fenomenit te subjektivizmit në procesin e konkurimit, uljen e kostove të procedurës së konkurimit nëpërmjet organizimit të testimeve masive, si dhe zgjerimin e fushës së veprimit të Ligjit "Statusi i Nëpunësit Civil" dhe përfshirjen e institucioneve të varësisë, të cilat janë aktualisht jashtë kësaj fushe veprimi.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Hartimi dhe miratimi i Projektligjit "Për nëpunësin civil";
- Hartimi dhe miratimi i Projektligjit "Mbi organizimin dhe funksionimin e administratës publike".

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Diskutimin e ndryshimeve që sjell miratimi i këtyre projektligjeve me grupet e interesit, ministritë e linjës, institucione të ndryshme të administratës publike, Anëtarët e Komisionit për Çështjet Ligjore,Komisionit të Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe përfaqësues të shoqërinë civile.
- Reflektimi i këtyre diskutimeve dhe rekomandimeve të propozuara në takimet konsultative, aprovimi nga Këshilli i Ministrave dhe dërgimi i projektligjit në parlament.
- Pilotimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Burimeve Njerëzore (SMIBNJ) në pesë institucione. Faza e pilotimit është 6 muaj, deri në fund të muajit prill 2012. Gjatë kësaj faze, do të testohet moduli i Burimeve Njerëzore, Moduli i Pagave dhe lidhja me sistemin e thesarit në Ministrinë e Financave.
- Monitorimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 474 datë 16.06.2011 "Për përcaktimin e standardeve të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike".

- Monitorimi i ministrive të linjës dhe aparatit të Këshillit të Ministrave, në lidhje me Urdhrin e kryeministrit Nr. 174, date 01.10.2010 për "Marrjen e disa masave për përmirësimin e legjislacionit të shërbimit civil në ministritë dhe aparatin e këshillit të ministrave". Raportimi periodikisht te Kryeministri mbi progresin që është bërë për implementimin e Urdhrit.
- Zbatimi i Planit të Trajnimit të Institutit të Trajnimit të Administratës Publike.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatmesme synohet rritja e qëndrueshmërisë së punonjësve të administratës publike nëpërmjet zbatimit me rigorozitet të procedurave të përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, forcimit të kapaciteteve nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm si dhe hartimi i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit për Nëpunësin Civil. (Këto akte janë parashikuar të hartohen dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave, 6 muaj pas miratimit të ligjit për Nëpunësin Civil).

Masat legjislative afatmesme janë si vijon:

- Hartimi i projektvendimit "Për planifikim vjetor të pranimit në shërbimin civil";
- Hartimi i projektvendimit "Për përshkrimin dhe klasifikimin e punës në shërbimin civil";
- Hartimi i projektvendimit "Për pranimin, emërimin, periudhën e provës dhe karrierën në shërbimin civil";
- Hartimi i projektvendimit "Për Trupën e nivelit të lartë drejtues dhe nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese";
- Hartimi i projektvendimit "Për transferimin e përkohshëm dhe përhershëm në shërbimin civil";
- Hartimi i projektvendimit "Për disiplinën dhe lirimin nga shërbimi civil";
- Hartimi i projektvendimit "Për vlerësimin e rezultateve në punë në shërbimin civil".

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Hartimi dhe konsultimi i të gjitha akteve nënligjore në zbatim të Ligjit për Shërbimin Civil me grupet e interesit dhe reflektimin e sugjerimeve të propozuara;
- Shtrirja e funksionimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Burimeve Njerëzore (SMIBNJ) për të gjitha institucionet;
- Rritja e numrit të punonjësve të trajnuar në krahasim me vitet paraardhëse, rritja e numrit të kurseve të trajnimit të organizuara, të pjesëmarrjes në trajnimet e detyruara dhe të nivelit të vlerësimit në fund të trajnimit.

1.1.5. SISTEMI GJYQËSOR

Objektivi strategjik

Çdo veprim që do të ndërmarrë Qeveria shqiptare në kuadrin e reformës në sistemin e drejtësisë dhe forcimit të shtetit të së drejtës, ka si qëllim dhe objektiv final krijimin e një

sistemi drejtësie bashkëkohor, të aftë të sigurojë garantimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë, ndershmërisë dhe efektivitetit të drejtësisë shqiptare, të respektojë parimet e proçedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, duke mbrojtur të drejtat, interesat dhe liritë e ligjshme të njeriut, të kontriboje në administrimin e drejtesisë penale, të zgjidhë mosmarrëveshjet në mënyrë efektive dhe të drejtë si dhe të implementojë acquis communautaire dhe të pasqyrojë standardet e Bashkimit Evropian në fushën e drejtësisë.

Qeveria Shqiptare është e angazhuar plotësisht në zbatimin në gjerësi dhe thellësi të reformave në sistemin e drejtësisë, të sugjeruara dhe të mbështetura nga partneret ndërkombëtare, ne bashkëpunim me institucionet e tjera kushtetuese që përfshihen në çështjet e reformave dhe performancës së sistemit të drejtësisë si dhe në përputhje me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (Neni 1, 2 , 13, 70 dhe 78 i MSA-së) .

Në kuadër të krijimit të një sistemi drejtësie bashkëkohor, Qeveria shqiptare synon rritjen e cilësisë në dhënien e drejtësisë si shërbim ndaj qytetarëve dhe forcimin e shtetit ligjor nëpërmjet formimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve me integritet, aftësi dhe cilësi të larta profesionale dhe etike. Ky objektiv përcakton si prioritet rritjen e aksesit në drejtësi, rritjen e profesionalizmit të aktorëve kryesorë të sistemit të drejtësisë përmes një programi trajnimi të niveleve bashkëkohore dhe standarteve evropiane dhe përmirësimit të sistemit të drejtësisë shqiptare duke siguruar një trajnim profesional pas universitar për gjyqtarë dhe prokurorë.

Situata aktuale

Qeveria shqiptare është e angazhuar në përmbushjen me vizion të qartë dhe ritëm të lartë të të gjitha funksioneve të saj, ku rolin më të rëndësishëm e zë Reforma në Drejtësi. Reforma në Drejtësi është konceptuar në marrjen e masave me karakter ligjor, institucional dhe administrativ, të cilat synojnë forcimin dhe konsolidimin e shtetit ligjor, rikthimin e besimit të qytetarëve te drejtësia, luftën pa kompromis kundër korrupsionit si dhe rritjen e transparencës së punës së organeve të drejtësisë.

Në kuadër të konsolidimit të sistemit gjyqësor, institucionet përgjegjëse kanë për qëllim të kërkojnë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integrimit evropian të Republikës së Shqipërisë.

Kështu, Ministria e Drejtësisë, në përputhje me ligjin, mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me organet e pushtetit gjyqësor dhe me prokurorinë, duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë.

Ministria e Drejtësisë do të vazhdojë përpjekjet dhe reformat e saj në konkretizimin me objektiva strategjikë të listuara si më poshtë:

- Konsolidimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të organeve të sistemit të drejtësisë në drejtimin strukturor, funksional dhe financiar;

- Konsolidimi i dialogut ndërisntitucional dhe bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë, gjyqësorit, prokurorisë, Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit dhe gjithë aktorëve të tjerë me kontribut në fushën e drejtësisë, me qëllim ndërtimin dhe konsolidimin e besimit dhe konsensusit të nevojshëm mes forcave politike parlamentare për reformën në drejtësi dhe përmirësimin e performancës së sistemit gjyqësor;
- Konsolidimi i përgjegjshmërisë së sistemit të drejtësisë për të qenë i pandikuar, i paanshëm dhe konsistent në sigurimin e mbrojtjes ligjore të barabartë për të gjitha palët;
- Konsolidimi i efektivitetit të pushtetit gjyqësor për të qenë efektiv, efiçent dhe i hapur;
- Fuqizimi i bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë, në përputhje edhe me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit;
- Konsolidimi i aksesit në organet e drejtësisë për të qenë i hapur për çdo person dhe për të qenë aktivisht i angazhuar në inkurajimin e formave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjve;
- Konsolidimi i besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë;
- Konsolidimi i qeverisjes së mirë, përmes luftës kundër korrupsionit dhe fenomenev të tjera negative që pengojnë zhvillimin e integrimit të vendit dhe garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës;
- Konsolidimi i shtetit demokratik bazuar në liritë dhe të drejtat themelore të individëve, duke realizuar integrimin e vendit në BE;
- Përmirësimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore;
- Përcaktimi i kompetencave të Inspektorateve të kontrollit të gjykatave;
- Konsolidimi i performancës së shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror dhe privat;
- Përmirësimi i sistemeve të burgimit dhe paraburgimit në kaudër të garantimit të të drejtave themelore të individit;
- Përmirësimi i infrastruktures se sistemit të drejtesise;
- Përmirësimi i proçesit të hartimit të legjislacionit, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve dhe konsolidimin profesional të tyre, rritjen e vëmendjes ndaj acquis communautaire me qëllim përshpejtimin e proçesit të përafrimit të legjislacionit.

Po në kuadër të përmirësimit të sistemit gjyqësor, Shkolla e Magjistraturës ka si objektiv strategjik rritjen e cilësisë në dhënien e drejtësisë si shërbim ndaj qytetarëve si dhe forcimin e shtetit ligjor nëpërmjet formimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve me integritet, aftësi dhe cilësi të larta profesionale dhe etike.
Sfida përballë së cilës gjendet Shkolla është arritja e standarteve evropiane në drejtim të dhënies së drejtësise nëpërmjet trajnimit me efikasitet të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këtë kontekst, ky objektiv përcakton si prioritet rritjen e aksesit në drejtësi, rritjen e profesionalizmit të aktorëve kryesorë të sistemit të drejtësisë përmes një programi trajnimi të niveleve bashkëkohore dhe standarteve evropiane dhe përmirësimit të sistemit të drejtësisë shqiptare duke siguruar një trajnim profesional pas universitar për gjyqtarë dhe prokurorë. Ky objektiv ka si qëllim rritjen e cilësisë në dhënien e drejtësisë, si shërbim ndaj qytetarëve dhe forcimin e shtetit ligjor, nëpërmjet formimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve me integritet, aftësi dhe cilësi të larta profesionale dhe etike.

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Formimit Fillestar Profesional i kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë brenda një programi 3 vjeçar. Ligji njeh detyrimin e emërimit si gjyqtarë dhe prokurorë të gjithë kandidatëve që përfundojnë me sukses Shkollën. Emërimi bëhet nga Këshilli I Lartë I Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme sipas detyrimit ligjor duke respektuar parimin e meritokracisë (klasifikimin e tyre në bazë të rezultateve të arritura në shkollë).
- Formimit të Vazhduar Profesional për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, përfundimi me sukses i të cilit lidhet ngushtë me kualifikimin dhe karrierën e tyre. Procesi i trajnimit organizohet në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme dhe lehtësohet nga pikat e kontaktit në gjykata dhe prokurori.
- Trajnimit të profesioneve te tjera ligjore në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë (Zyrën e Përmbarimit, Avokatin e Shtetit), Dhomën Kombëtare të Avokatisë apo Shoqata dhe Organizata ndërkombëtare, të cilat realizohen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.
- Publikimet e ndryshme shkencore dhe puna kërkimore. Shkolla boton revistën e saj "Jeta Juridike" çdo tremujor, e cila është një botim shkencor që trajton tematikë të ndryshme në lidhje me çështje të rëndësishme si: njohja me legjislacionin e ri, njohje me praktikën gjyqësore, njohje me përvojën ndërkombëtare teorike dhe praktike, shkrime nga juristë të rinj, promovime të librave të rinj juridikë, informacion për aktivitetet e zhvilluara nga shkolla, etj. Po ashtu, Shkolla publikon me sukses edhe botime te tjera profesionale në fushën e drejtësisë si libra profesional në kuadër të realizimit të programit mësimor si dhe revistën periodike çdo 6 muaj "Magjistrati" me ekstrakte nga temat e kandidatëve për magjistratë.

Në kuadrin e zbatimit të planit kombëtar të zbatimit të MSA, Shkolla e Magjistraturës ka marre angazhimet e mëposhtme:

- Rritja e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe orientimi i sistemit gjyqësor drejt praktikave më të mira evropiane për ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët nëpërmjet një trajnimi të vazhduar dhe të përshtatshëm mbi tematika si civile, penale, tregtare, administrative, kushtetuese, familjare, etikes profesionale, çështje tregtare, të drejtës evropiane dhe çështje qe lidhen me zbatimin e MSA-se, të drejtat e njeriut, acquis communautaire, prokurimin publik, pronësinë intelektuale, krimin ekonomik dhe korrupsioni, shkrimi dhe arsyetimi ligjor, mbrojtja e të dhënave personale, drejtësia për të miturit, administrimi i gjykatave dhe të çështjeve, praktika e GJEDNJ dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, trajnime për unifikimin e kërkesave të ndihmës juridike, penale dhe civile për gjyqtarët, prokurorët, stafin e Ministrisë së Drejtësisë dhe të tjerë të interesuar, si dhe zhvillime të reja të legjislacionit etj.
- Përmirësimi i procesit të seleksionimit të kandidatëve për magjistratë, formimit dhe vlerësimit të tyre nëpërmjet:

– përmirësimit të kritereve dhe procedurave si dhe akteve nënligjore në lidhje me këtë proces,
– hartimit të skemës së seleksionimit dhe vlerësimit të dijeve të kandidatëve, në bashkëpunim me Ambasadën Britanike dhe Fondacionin Slynn.

- Përmirësimi i metodologjisë se mësimdhënies në trajnimin fillestar nëpërmjet rishikimit në vijimësi të kurrikulave të shkollës për t'iu përshtatur zhvillimeve dhe nevojave të reja të sistemit, studimit dhe parashikimit të ekspertizës në përputhje me eksperiencat

kombëtare dhe praktikën e Shkollës së Magjistraturës për integrimin lidhur me etikën, problemet sociale, diskriminimin gjinor, duke i përfshirë kritere të tilla në zgjedhjen, trajnimin dhe vlerësimin e procesit.

- Trajnimi i trajnerëve është tashmë një element i përhershëm i veprimtarisë akademike të Shkollës dhe ka në fokus pedagogët me kohë të plote dhe ata me kohë të pjesshme. Ai i dedikohet analizës dhe vlerësimit të metodologjisë pedagogjike dhe protokolleve që adoptohen nga trajnerët shqiptarë në lidhje me organizimin dhe koordinimin e seminareve, si dhe në lidhje me metodologjinë e përdorur gjatë zhvillimit të tyre. Njëkohësisht marrja e përvojës së vendeve të BE-së nëpërmjet seminareve të përbashkëta për trajnimin e trajnerëve është pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së Shkollës në këtë drejtim. Nëpërmjet tyre synohet të realizohet asimilimi i metodologjisë më të avancuar të trajnimit, të aplikuar nga Shkollat e vendeve të Bashkimit Evropian.
- Ngritja e nivelit të njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm me gjuhët e përdorura ne institucionet ligjore Evropiane, për të cilin lënda e gjuhës angleze ligjore është futur si lëndë mësimore në Programin e Formimit Fillestar për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë. Ky komponent po realizohet në sajë të ekspertizës së ofruar nga USAID dhe Ambasada Amerikane.

Gjithashtu, në kuadër të konsolidimit të sistemit të drejtësisë, objektivi madhor i Prokurorisë është të ushtrojë ndjekjen penale, të perfaqesoje në emer të shtetit akuzën në gjyq, duke respektuar parimet e proçedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, duke mbrojtur të drejtat, interesat dhe liritë e ligjshme të njeriut, e të kontriboje në administrimin e drejtesisë penale.

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Përmirësimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të prokurorisë në ndjekjen penale, në hetim dhe gjykim;
- Përzgjedhjes për emërimin dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve me anë të vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale të tyre;
- Përmirësimit dhe funksionimit të Inspektoratit të Prokurorisë së Përgjithshme për të vlerësuar dhe verifikuar në vazhdimësi qëndrueshmërinë në detyrë të prokurorëve;
- Rritjes se vazhdueshme e transparencës në procesin penal;
- Ruajtjes së pavarësisë dhe paanshmërisë së prokurorisë si elemente thelbësore për besimin e publikut në administrimin e drejtësisë;
- Implementimit të programeve të menaxhimit të informacionit për të rritur eficensën e ndjekjes penale;
- Përmirësimit të menaxhimit të çështjeve në prokurori me synim kontrollin në vazhdimësi të ndjekjes penale, rritjen e efektivitetit dhe parandalimin e fenomeneve korruptive;
- Përmirësimit të kapaciteteve të administratës së prokurorisë si njohje e rolit të tyre të rëndësishëm në mbështetje të punës së prokurorit;
- Bashkërendimit dhe standardizimit të bashkëpunimit të prokurorisë me policinë gjyqësore dhe organet e tjera të zbatimit të ligjit si domosdoshmëri për suksesin e ndjekjes penale;
- Garantimit dhe funksionimit efikas të Njësive të Përbashkëta Hetimore kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokurorinë e

Rrethit Gjyqësor Fier, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Prokurorisë për Krime të Rënda;

- Mbrojtjes së dëshmitarëve, personave të dëmtuar dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë si masa të domosdoshme në luftën kundër krimit të organizuar.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 "Për miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;
- Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" , i ndryshuar
- Ligji nr. 7895 datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar
- Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;
- Ligji nr. 8116, datë 29/03/1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligj nr. 8136, datë 31.7.1996 "Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës të Shqipërisë";
- Ligji nr. .8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", të ndryshuar;
- Ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", të ndryshuar
- Ligji nr. 8677, datë 02.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", i ndryshuar;
- Ligji nr. 8678, date 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 8888, datë 25.4.2002 "Për ratifikimin e "Konventës për krimin në fushën e kibernetikës";
- Ligji nr. 9068, date 15.5.2003 "Për ratifikimin e "Konventës Evropiane për vlefshmërinë ndërkombëtare te gjykimeve penale";
- Ligji nr. 9081, date 19.6.2003 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverise se Republikës te Shqipërisë dhe Qeverise se Shteteve te Bashkuara te Amerikës për dorëzimin e personave ne gjykatën ndërkombëtare penale";
- Ligj nr. 9090, datë 26.6.2003 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", in ndryshuar;
- Ligji nr. 9091, datë 26.6.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8502, datë 30.6.1999 "Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare";
- Ligji nr. 9109, datë 17.7.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;
- Ligji nr. 9110, date 24.7.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime te renda";
- Ligj nr. 9245, date 24.6.2004 "Për ratifikimin e "Protokollit shtese te Konventës Penale për korrupsionin";

- Ligji nr. 9235 datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar;
- Ligji nr. 9284, date 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar";
- Ligji nr 9397, date 12.05.2005 "Për shërbimin e Kontrollit te Brendshëm ne Sistemin e Burgjeve';
- Ligji nr. 9443, date 16/11/2005 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Hagës "Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve";
- Ligji nr. 9446, datë 24.11.2005 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën, "Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës";
- Ligji nr. 9492 datë 29.05.2006 "Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit";
- Ligji nr. 9614 datë 21.09.2006 "Për çertifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore";
- Ligji nr. 9639 datë 09.11.2006 "Për ratifikimin e protokollit nr. 13 të Konventës Evropiane "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat";
- Ligji nr. 9646 datë 27.11.2006 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit";
- Ligji nr. 9678, date 13.01.2007, "Për amnistinë";
- Ligji nr. 9695, datë 19.3.2007 "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit";
- Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji 10 031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat";
- Ligji nr. 10 032, datë 11.12.2008 "Për policinë e burgjeve";
- Ligji nr. 10 039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike";
- Ligji nr. 10071, datë 09.02.2009, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual";
- Ligji nr. 10092, datë 09.3.2009 "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave";
    - Ligjin Nr.8417, datë 21.10.1998 për përbërjen dhe drejtimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
    - Ligjin Nr.8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë";
    - Ligji nr. 8136 date 31.07.1996 "Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë";
    - Ligji nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme";
    - Ligj nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".
    - Ligj nr. 53/2012, datë 10.05.2012 "Për marrëdhëniet juridiksionale në çështjet penale me task forcën hetimore speciale të EULEX-it";
    - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 24, datë 19.01.2007 "Për procedurën e lëshimit të dokumenteve nga disa zyra të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe ndryshimin e tarifave për to";

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1025, datë 09.07.2008 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1292, datë 24.09.2008 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, të truallit dhe të godinës së gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apeleve”, , i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave përcaktimi i procedurave për krijimin e fondit të kompensimit fizik;
- Vendimi nr. 20, datë 14.1.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të administratës gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit”;
- Vendimi nr. 101, datë 27.01.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe nivelit të pagave të Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Vendim nr. 200, datë 19.2.2009, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave “Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar”;
- Vendimi nr. 302, datë 25.03.2009 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, mbikëqyrjen e ekzekutimit te dënimeve alternative;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 303, datë 25.03.2009, “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e ngjyrës, uniformës dhe shenjave në mjetet e Policisë se Burgjeve”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për llojet e armëve dhe mënyrën e përdorimit të tyre;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e flamurit dhe të stemës së Policisë së Burgjeve”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e veçantë personale, familjare dhe të pronës së gjyqtarëve, sigurimin e jetës dhe pronës së tyre”;
- Vendimit nr 271, datë 06.04.2011 “Për veprimtarinë akademike, në zbatimin e programit të Formimit Fillestar dhe Vazhdues në Shkollën e Magjistraturës”;
- Udhëzim i Përbashkët nr.03,date 15.12.2011 "Për procedimin disiplinor të punonjësve të policisë gjyqësore";
- Udhëzim i Përbashkët nr.2, datë 07.11.2011 “Për kryerjen dhe përfundimin e hetimeve të kallëzuara drejtpërdrejt në prokurori apo të filluara kryesisht”;
- Urdher i Prokurorit te Pergjithshem nr.165, date 19.09.2011 "Per percaktimin e kritereve per dhenien e shteses se pages per veshtiresi pune per oficeret e policise gjyqesore";
- Udhëzim i Prokurorit te Pergjithshem nr. 01, datë 19.09.2011 “Për përcaktimin e kritereve për shpërblimin për merita profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore”;

- Urdhri i përbashkët nr. 582, datë 24.01.2007, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme, për realizimin e plotë de facto të sistemit të paraburgimit në administrimin e Ministrisë së Drejtësisë;
- Urdhri nr. 3155, datë 28.04.2008 "Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale", i ndryshuar;
- Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 4793, datë 02.07.2008 "Për miratimin e Rregullores së Agjencisë së Kompensimit dhe Kthimit të Pronave";
- Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 5745, datë 13.08.2008 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimin dhe Funksionimin të Ministrisë së Drejtësisë;
- Urdhri nr. 275/1, datë 14.01.2009 i Ministrit të Drejtësisë "Rregullorja e Brendshme e Avokaturës së Shtetit";
- Urdhri nr. 747, datë 28.01.2009 i Ministrit të Drejtësisë "Për procedurat që duhen ndjekur nga administrata gjyqësore për lëshimin e vërtetimeve dhe akteve të tjera, në zbatim të Vendimit nr. 1, datë 07.01.2009, të Këshillit të Ministrave "Për pajisjen për herë të parë, me letërnjoftim të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese për ata që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve";
- Urdhri nr. 1186, datë 11.02.2009 i Ministrit të Drejtësisë, ''Për miratimin e Rregullores së organizimit dhe strukturës së Zyrës së Gjendjes Gjyqësore'';
- Urdhri nr. 2583, datë 01.04.2009 i Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e rregullores "Për arkivat e sistemit gjyqësor dhe Manualin e Programit të Menaxhimit të Dosjeve Gjyqësore";
- Urdhri nr. 3146, datë 16.4.2009 i Ministrit të Drejtësisë "Për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit te Apelimit te Masave Disiplinore";
- Urdhri nr. 2438/3, datë 28.05.2009 i Ministrit të Drejtësisë "Për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit për Dhënien e Gradave për Rolin e Lartë";
- Urdhrin nr. 3851 datë 08.05.2009 të Ministrit të Drejtësisë "Kodi i Etikës së Përmbaruesve Gjyqësorë shtetërorë dhe privatë " si dhe Rregullorja "Për përbërjen e komisionit vlerësues, rregullave të funksionimit të tij, procesi i përzgjedhjes, kritereve dhe procedurave të organizimit dhe të shpalljes së rezultateve të provimit për përmbarues gjyqësor privatë;
- Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë (nr. 8311 prot,., datë 4.12.2011) dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë (nr. 1911 prot., datë 5.12.2011) "Për harmonizimin e procedurave të inspektimit gjyqësor dhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave", të nënshkruar më datë 5 dhjetor 2011;
- Urdhri i përbashkët nr. 1779/15, datë 26.12.2011, midis Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit "Për caktimin e kritereve të standardizuara në ndërtimin dhe rikonstruksionin me cilësi të burgjeve dhe paraburgimit";
- Memorandumi i Bashkëpunimit, nr. 2381, datë 20.03.2012, midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë "Për Ngritjen e Institutit Mjekësor për Trajtimin e Personave me Probleme të Shëndetit Mendor që kanë Kryer Vepra Penale";
- Memorandumi i Bashkëpunimit, 05.12.2008, midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për arsimimin e të ndaluarve dhe burgosurve;
- Marreveshja e Perbashket, Nr.2803/7, date 15.12.2011 "Per trajnimin e vazhdueshem te oficereve dhe agjenteve te Policise Gjyqesore";

- Urdhri nr. 4763, datë 08.06.2009 të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Komitetit Shqiptar të Birësimeve".

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në garantimin dhe përmirësimin të sistemit gjyqësor janë:

Presidenti i Republikës

Presidenti i Republikës është kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe autoriteti që emëron gjyqtarët, me cilësinë si President i Republikës dhe jo si kryetar i KLD- së. Gjithashtu, ai emëron dhe shkarkon prokurorët e të gjithë niveleve, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm.

Presidenti i Republikës ushtron edhe disa kompetenca rregullatore në fushën e organizimit të sistemit gjyqësor: përcakton numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve, numrin e gjykatave, qendrën e tyre të veprimtarisë dhe kompetencën territoriale, etj.
Gjyqtaret e shkalles se pare dhe apelit emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të KLD-së brenda kritereve të përcaktuara në ligj, ndërsa numri total i gjyqtareve dhe juridiksioni territorial i gjykatave caktohen nga Presidenti i Republikës me propozim te Ministrit te Drejtësisë, pasi të jetë marrë mendimi i KLD-së.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Këshilli i Lartë i Drejtësisë është organ kushtetues i rregulluar posaçërisht në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr.8417, datë 21.10.1998. Kjo normë kushtetuese ka përcaktuar përbërjen dhe drejtimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kompetencën e tij për transferimin e gjyqtarëve si edhe rastet e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit po nga ky Këshill.

Në zbatim të dispozitës kushtetuese referuar më lart, Kuvendi, ka miratuar Ligjin Nr.8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë" duke e përcaktuar Këshillin si autoritetin e vetëm shtetëror përgjegjës për të realizuar mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën dhe për kontrollin e veprimtarisë së gjykatave të shkallëve të para dhe të apeleve.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, përbëhet nga pesëmbëdhjetë anëtarë e kryesohet nga Presidenti i Republikës. Anëtarë të tij për shkak të funksionit që ushtrojnë, janë Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Ministri i Drejtësisë. Në përbërje të Këshillit janë gjithashtu nëntë gjyqtarë të të gjitha niveleve, të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare dhe tre anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi. Anëtarët e zgjedhur të tij, qëndrojnë në detyrë për 5 vjet pa të drejtë rizgjedhje të menjëhershme. Struktura e Këshillit, tre të pestat e të cilit janë të zgjedhur nga vetë gjyqtarët (në përputhje dhe me Kartën Europiane mbi Statutin për Gjyqtarët), garanton një mbikëqyrje të pavarur të sistemit gjyqësor. Veprimtaria e përditshme e tij, organizohet nga Zëvendëskryetari (i zgjedhur nga vetë anëtarët e Këshillit me propozim të Presidentit të Republikës) si dhe administrata që i është vënë në dispozicion nga ligji. Njëkohësisht, në

varësi të drejtëpërdrejtë të Zëvendëskryetarit është dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë i përbërë nga Kryeinspektori dhe inspektorët.

Në mënyrë të përmbledhur, detyrat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të parashikuara në këtë ligj, janë:

- Propozimi drejtuar Presidentit të Republikës për emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të apelit;
- Vendos për transferimin e gjyqtarëve vetëm me pëlqimin e tyre duke përjashtuar rastet e riorganizimit të pushtetit gjyqësor;
- Emëron dhe shkarkon kryetarët e gjykatave të shkallëve të para dhe të apelit;
- Vendos kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve dhe kontrollon gjithë procesin e vlerësimit;
- Shkarkon gjyqtarët e gjykatave të shkallëve të para dhe të apelit kur nga ana e tyre kryehen shkelje shumë të rënda të - Merr masa disiplinore për gjyqtarët e gjykatave të shkallëve të para dhe të apelit;
- Kujdeset për kualifikimin e gjyqtarëve duke i dhënë mendim Shkollës së Magjistraturës, për programin e formimit vazhdues të organizuar prej saj.

Në raport me gjykatat, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, realizon kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të apeleve, nëpërmjet inspektimeve tematike apo të përgjithshme si të gjyqtarëve ashtu edhe të gjykatave.

Një tjetër kompetencë e Këshillit është emërimi dhe shkarkimi i inspektorëve të Inspektoratit të tij, duke respektuar si urdhërimet e Ligjit Nr.8811, datë 17.05.2001 dhe Rregulloren "Për organizimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë".

Detyra të tjera i janë ngarkuar Këshillit nga Ligji Nr.9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", ku përmendet roli konsultativ në përcaktimin e kompetencës tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së gjykatave të shkallëve të para e të apelit apo për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr.10 019, datë 29.12.2008, i ka ngarkuar Këshillit realizimin e procesit të hedhjes së shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor është një ent publik i pavarur, që administron buxhetin e sistemit gjyqësor, siç parashikohet në Kushtetutë. Zyra drejtohet nga një bord, i përbërë nga 8 gjyqtarë të tre niveleve dhe një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, dhe nga një drejtor, i emëruar nga ky bord.

Gjykata Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e sistemit gjyqësor, por ajo, në zbatim të kompetencave të saj dhe kërkesave përkatëse, ka dhënë disa vendime që kanë ndikuar mbi elementë të ndryshëm të funksionimit të sistemit gjyqësor:

- Gjykata Kushtetuese ka dhënë disa vendime, me të cilat ka detyruar KLD- në të respektojë elementë të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si p.sh: "e drejta e gjyqtarit për t'u dëgjuar paraprakisht, e drejta e mbrojtjes, etj";
- Me vendimin nr. 11, datë 27.05.2004, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën e Gjykatës së Lartë për shfuqizimin e disa neneve të ligjeve "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë" dhe "Për organizimin dhe funksionimin e KLD- së", të cilat kishin të bënin me kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë në fushën e inspektimit të gjykatave dhe gjyqtarëve.

Konferenca Gjyqësore Kombëtare

Konferenca Gjyqësore Kombëtare përmendet për herë të parë në Kushtetutë, sipas së cilës ky organizëm zgjedh 9 anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. KGjK u krijua më 3- 4 Dhjetor 1999, si bashkim vullnetar i gjyqtarëve të tre niveleve. KGjK funksionon në bazë të një statuti, megjithëse është organ i krijuar nga Kushtetuta. Nga ana tjetër, KGjK nuk është as shoqatë, sepse nuk është regjistruar si e tillë.

Prokuroria

Organizimi i prokurorisë është i ngjashëm me atë të sistemit gjyqësor, por prokuroria është organ i centralizuar dhe nuk është pjesë e këtij sistemi.

Kushtetuta parashikon se Prokurori i Përgjithshëm është i pavarur dhe kompetent për ndjekjen e çështjeve penale dhe përfaqësimin e akuzës ne gjyq në emër të shtetit. Prokuroria është organ i centralizuar dhe hierarkik; prokuroret u nënshtrohen urdhrave te prokuroreve te niveleve me te larta. Prokurori i Përgjithshëm miraton strukturën, organiken dhe rregullat e funksionimit te prokurorive pranë gjykatave dhe ne Prokurorinë e Përgjithshme, si edhe nxjerr urdhra për ushtrimin e detyrave te prokuroreve dhe delegimin e përgjegjësive te caktuara.

Çdo gjykatë ka një prokurori pranë saj dhe prokurorët ndjekin çështjet brenda juridiksionit të gjykatës pranë se cilës ndodhen. Kodi i Procedurës Penale parashikon rregullat lidhur me funksionimin e prokurorive.

Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqim të Kuvendit, ndërsa prokurorët emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm.

Avokati i Popullit

Avokati i popullit, është krijuar me Ligjin nr. 8454, date 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", ndryshuar me Ligjin Nr. 8600, date 10.4.2000. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta te organeve te administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Shkolla e Magjistraturës

Institucioni përgjegjës për formimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve është Shkolla e Magjistraturës, e cila e realizon këtë veprimtari në bashkëpunim me KLD dhe Prokurorinë e Përgjithshme.

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë organizohet dhe funksionon në përputhje me Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë, me ligjin nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", me dispozitat ligjore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, si dhe me dispozita të tjera ligjore dhe nënligjore (deri tek Rregullorja e Brendshme e organizmit dhe funksionimit) që parashikojnë rregulla të organizimit, funksionimit dhe kompetencave për Ministrinë e Drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet dhe në zbatim të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", ushtron funksione dhe kanë kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit te vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera te drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

Masat legjislative afatshkurtra

Aktet ligjore të planifikuara për vitin 2012 janë listuar më poshtë. Përsa i përket kapaciteteve administrative, hartimi i këtij projektakti nuk implikon shpenzime shtesë pasi ato janë të parashikuara në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë. Në lidhje me zbatimin e këtij akti ai ka karakter gjithëpërfshirës.

Masat legjislative për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ky projektligj do të përafrojë pjesërisht Direktivën e Këshillit 86/653/KKE e datës 18 dhejtor 1986 për 'Koordinim e ligjeve të Shteteve Anëtare lidhur me agjentët tregëtar të vetëpunësuar', *CELEX 31986L0653,* Direktivën e Këshillit 85/374/KEE e datës 25 korrIk 1985 për 'Përafrimin e ligjeve, regullave dhe dispozitave të Shteteve Anëtare lidhur me përgjegjshmërinë për produktet e dëmtuara'; *CELEX: 01985L0374-19990604***;** si dhe Direktivën 2000/35/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 29 qershor 2000 për 'Luftimin e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare'; *CELEX: 32000L0035;*
- Projektligj "Për disa shtesa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile", i ndryshuar";
- Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar";
- Projektligj "Për Kodin e Procedurave Administrative";

- Projektligj “Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Urdhrin Rajonal për Arrestimin në Shtetet e Europës Juglindore”;
- Projektligj “Për aderim në Konventën e Luganos“Për juridiksionin, njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështje civile dhe tregtare”;
- Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në çështjet tregtare dhe civile”;
- Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale”;
- Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Serbisë “Për ekstradimin”;
- Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Serbisë “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën civile dhe penale”;
- Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Serbisë “Për njohjen e vendimeve në fushën penale”;
- Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Bosnje Hercegovinën “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën civile dhe penale”;
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8730 datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarimor gjyqësor;
- Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr.10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”;
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë;
- Projektligji “Për arbitrazhin”;
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë mbi të Drejtat e Pronësisë”;
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores se organizimit dhe funksionimit të brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore për pasuritë e paluajtshme” ;
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statusit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”;
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e nivelit të pagave të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”;
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të ushtrimit të drejtës së aksesit të informacionit nga personat juridik/fizik, vendas apo të huaj”;
- Projektvendimi Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së shërbimeve të ofruara nga ZRPP”;
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”;

- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar";
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për procedurën e kalimit në pronësi të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më datë 10.08.1991, dhe truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie te detyrueshme për regjistrim";
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për kryerjen e përmirësimit dhe përditësimit të të dhënave gjate afishimit publik të regjistrimit te pasurive te paluajtshme";
- Projektudhëzim i Këshillit të Ministrave "Për caktimin e kriteret dhe procedurat për regjistrimin e lejes së ndërtimit dhe akteve noteriale të lidhura për zhvillimin në cilësinë e investitorit dhe pronarëve të truallit apo blerësve/porositësve të njësive individuale, te objektit ne fazën e karabinasë dhe të objektit të përfunduar";
- Projektudhëzim i Këshillit të Ministrave "Për procedurën e regjistrimit të pasurive të fituara me vendim gjykate, akt administrativ apo noterial, në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme".

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Analiza e nevojave për ndërhyrje në projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe adresimi i rekomandimeve të evidentuara;
- Organizimi i konferencës me ekspertë shqiptarë mbi reformën në Gjykatën e Lartë lidhur me problemet e këtij institucioni, të tilla si: emërimin e anëtarëve, organizimi i brendshëm, ulja e ngarkesës dhe promovimi i funksioneve të unifikuara sipas doktrinës;
- Përgatitja nga grupi i punës i analizës mbi nevojat për ndërhyrje në Kodin e Procedurës Penale dhe adresimi i rekomandimeve të evidentuara;
- Përgatitja nga grupi i punës i analizës mbi nevojat për ndërhyrjeve në Kodin e Procedurave Administrative dhe adresimi i rekomandimeve të evidentuara;
- Përgatitja e draft manualit për inspektimet mbështetur në memorandumin e bashkëpunimit;
- Shkëmbimi i ndërsjelltë i statistikave mbi ankesat e ndaj gjyqtarëve të paraqitura në MD dhe KLD dhe analiza e tyre me qëllim evidentimin e mbivendosjeve të mundshme të tyre;
- Krijimi i formatit të standardizuar të raporteve të inspektimit të MD-së dhe KLD-së;
- Përgatitja e raportit të përbashkëta mbi implementimin e Memorandumit;
- Hartimi dhe nënshkrimi i memorandumit të përbashkët ndërmjet titullarëve të institucioneve;
- Implementimi i memorandumit nëpërmjet ushtrimit të inspektimeve sipas kompetencave të MD-së dhe KLD-së;
- Përgatitja e analizës së nevojave për ndërhyrjeve në projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2011 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar dhe adresimi i rekomandimeve të evidentuara;

- Mbledhja e dokumenteve dhe formularëve për projektaktin e vlerësimit paraprak të gjyqtarëve në 24 gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit (30 gjykata gjithsej);
- Plotësimi i vlerësimit profesional i gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Përgatitja e projektaktit final mbi vlerësimin e 24 gjykatave;
- Paraqitja e projektaktit final për vlerësimin e gjykatave në 23 gjykata dhe gjykata apeli (nga 30 gjykatat gjithsej) në KLD me propozimet për shqyrtim dhe miratim;
- Mbledhja e të dhënave dhe përgatitja e projektaktit paraprak për vlerësimin e 6 gjykatave të tjera;
- Përgatjta e projektaktit final dhe paraqitja në KLD për shqyrtim dhe miratim;
- Hartimi dhe miratimi i kritereve të qarta dhe transparente për transferimin, promovimin dhe vlerësimin e gjyqtarëve bazuar në meritë dhe raportimi i masave të ndërmarra nga Komisioni i Transferimit, Promovimit dhe Vlerësimit të Gjyqtarëve (KLD);
- Raportimi i Komisionit të Transferimit, Promovimit dhe Vlerësimit të Gjyqtarëve në KLD me qëllim paraqitjen e masave konkrete të marra për transferimin e gjyqtarëve mbi baza merite dhe të kriterere objektive (KLD);
- Ushtrimi i 3 kontrolleve mbi veprimtarinë gjyqësore në bazë të ankesave të qytetarëve dhe atyre të programuara/tematike. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet ankesave në lidhje me rregullat e etikës;
- Përgatitja e raporteve në përfundim të çdo inspektimi dhe paraqitja e tyre pranë subjekteve të inspektuara dhe të interesuara;
- Analiza e rezultatave dhe ndjekja e rekomandimeve të raporteve të inspektimit deri në paraqitjen e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor pranë KLD-së, në kuadër të përcaktimit të një praktike të qëndrushme për inspektimin gjyqësor;
- Ushtrimi i 3 kontrolleve mbi veprimtarinëe prokurorëve;
- Përgatitja e raporteve në përfundim të çdo inspektimi dhe paraqitja e tyre pranë drejtuesit të prokurorisë së rrethit gjyqësor që është inspektuar, Prokurorit të Përgjithshëm, Presidentit të Republikës dhe subjektit që ka paraqitur ankesën;
- Analiza e rezultatave dhe ndjekja e rekomandimeve të raporteve të inspektimit deri në paraqitjen e rekomandimit të Ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor;
- Përgatitja e raportit vjetor të Ministrisë së Drejtësisë mbi inspektimet e ushtruara ndaj organit të akuzës;
- Hartimi i rekomandimeve vjetore në emër të Këshillit të Minitrave për Prokurorin e Përgjithshëm për luftën kundër kriminalitetit;
- Organizimi dhe funksionimi i administratës gjyqësore, karriera dhe statusi i punonjësve të saj;
- Përgatitja nga grupi i punës i analizës mbi nevojat për ndërhyrje në ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore dhe adresimi i rekomandimeve të evidentuara;
- Implementimi i programit të trajnimeve vazhduese të administratës gjyqësore, në lidhje me: menaxhimin e gjykatës dhe marrëdhënies me kancelarë të tjerë; - Çështjet e buxhetit dhe financiare; -Marrëdhëniet me ministritë dhe organe të tjera; - Zhvillimin e një takimi; - Marrëdhëniet me palët ndërgjyqëse dhe publikun; - Marrëdhëniet me shtypin dhe median dhe - Etikën dhe konfliktin e interesave;

- Përgatitja nga grupi i punës i analizës mbi nevojat për ndërhyrje në projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8363, datë 1.7.1998 "Për krjimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor" dhe adresimi i rekomandimeve të evidentuara;
- Kontrolli i veprimtarisë së ZQRPP, Agjencise se Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe institucioneve të tjera vartëse, nëpërmjet inspektimeve të kryera nga ministria;
- Zbatimi efektiv i rregullave për selektimin e kandidatëve për magjistratë, trajnimi dhe vlerësimi i tyre;
- Përgatitja e analizës së nevojave për ndërhyrje në projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996 "Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe adresimi i rekomandimeve të evidentuara;
- Statusi dhe trajtimi i inspektorëve të Ministrisë së Drejtësisë.
- Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit ICMIS, për një mirëfunksionim të punës në gjykata;
- Monitorimi i rezultateve të shortit elektronik;
- Përmirësimi i aksesit të qytetarëve në sistemin elektronik (monitorimi dhe zyra e informimit);
- Vendosja e modulit të inspektimit në gjykata (inspektoriati i MD-së & KLD-së) ;
- Realizimi i ndërveprimit ndërmjet bazës së të dhënave të gjykatës së shkallës së parë me gjykatat e apelit;
- Ristrukturimi dhe zhvillimi i protalit elektronik gjykata.org dhe hedhja e të dhënave në interes të qytetarëve, përfshirë edhe publikimin e vendimeve gjyqësore;
- Përditësimi i vendimeve gjyqësore në Qendrën e Dokumentimit të KLD-së, që mundëson publikimin e vendimeve gjyqësore;
- Zhvillimi i modulit të statistikave;
- Fillimi i procesit të regjistrimit audio – video të gjykatave, fillimisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë;
- Zhvillimi i 4 trajnimeve me personelin e administratës gjyqësore dhe gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe personelit të MD-së për modulin e ri të të regjistrimit audio;
- Vazhdimi i instalimit në sistemin ICMIS të modulit për regjistrimin audio, në këto gjykata: Gjykatat e Apelit Korçë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, Gjykata e Rrethit Pogradec dhe Gjykata e Apelit Korçë; Gjykatat e Apelit Durrës: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Gjykata e Apelit Durrës;
- Monitorimi video i seancave gjyqësore në Gjykatën e Tiranës (projekt pilot);
- Trajnimi vazhdues i gjyqtarëve dhe prokurorëve përfshirë Gjykatën e Lartë, me fokus të drejtat e njeriut, dhuna në familje, etika, çështjet tregatre; MSA dhe acquis; legjisalcionin europian, jurisprudenca mbi Konventën për të Drejtat e Njeriut; praktika e GJEDNJ-së; format alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve; diskriminimi, Kodi i Etikës dhe zhvillimet e reja të legjislacionit;
- Vazhdimi i rishikimit të kurrikulave të Shkollës së Magjistraturës në lidhje me zhvillimet e e reja dhe sistemin e drejtësisë;
- Konsolidimi i Shkollës së Magjistraturës nëpërmjet trajtnimit të trajnerëve, përmirësimit të kushteve dhe rishikimit të organigramës;
- Dixhitalizimi i regjistrit të noterisë dhe lidhja me ZQRPP.

- Studim projektim për ndërtimin e Gjykatës Administrative;
- Investimi për përmirësimin e infrastrukturës gjyqësore nëpërmjet ndërtimit të ndërtesave të reja në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec;
- Investimi për përmirësimin e infrastrukturës elektronike të gjykatave dhe të kushteve të punës dhe shërbimeve në salla dhe zyrat e gjyqtarëve si dhe instalimi i elementeve të sigurisë;
- Zbatimi efektiv i kuadrit ligjor për ndihmën juridike;
- Raportimi i punës së Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridke pranë Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave dhe Dhomës Kombëtare të Avokatëve;
- Liçencimi dhe regjistrimi i ndërmjetësve në zbatim të ligjit të ri për ndërmjetësimin;
- Raportimi nga Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve pranë Ministrit të Drejtësisë;
- Trajnimi i ndërmjetësve për zgjidhjen e konflikteve;
- Trajnimi dhe forcimi i kapaciteteve dhe rolit të profesioneve të lira në lidhje me standardet europiane dhe zhvillimin e legjislacionit;
- Përmirësimi i rolit të profesioneve të lira (noter, avokat, ndërmjetës, arbitra) nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të tyre dhe monitorimit të vazhdueshëm;
- Rritjes së rolit dhe kapaciteteve të Avokaturës së Shtetit nëpërmjet trajnimeve dhe përmirësimit të kushteve të punës;
- Implementimi i sistemit elektronik ALBIS;
- Gjenerimi i të dhënave statistikre dhe raporteve mbi përmirësimin e shërbimit;
- Zgjerimi i shërbimit përmbarimor privat ndaj shërbimit përbarimor shtetëror nëpërmjet ndryshimeve në ligj dhe certifikimit të përmbaruesve privatë;
- Ushtrimi i 4 inspektimeve tematike në shërbimin përmbarimor privat;
- Përgatitja e raporteve të inspektimit në përfundim të çdo inspektimi dhe paraqitja e tyre tek subjektet e kontrolluara dhe tek të interesuarit;
- Analiza e rezultateve dhe ndjekja e rekomandimeve të raporteve të inspektimit deri në paraqitjen e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor pranë Komisionit Disiplinor të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë;
- Hartimi i programit për trajnimin vazhdues ptë përmbarauesve gjyqësorë privatë;
- Trajnimi i vijueshëm i përmbaruesve gjyqësorë privatë në zbatim të programit të miratuar;
- Hartimi i specifikimeve teknike të pajisjeve dhe programeve, lidhur me implementimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve;
- Kontraktimi me 2 ekspertë të huaj për një periudhë 2 mujore për të asistuar projektimin e CMS. Kjo është faza e fundit pas së cilës do të zhvillohet tenderi për projektin në fjalë;
- Gjenerimin e statistikave të sakta dhe të përputhshme;
- Vizita monitoruese në vendet e kufizimit të lirisë nga Njësia kundër Torturës, Avokati i Popullit;
- Vazhdimi i punës kërkimore shkencore dh botimi i revistave shkencore "Jeta Juridike" si dhe botime të tjera profesionale për periudhen 2012 e në vazhdim;
- Vazhdimi i trajnimit të magjistratëve mbi gjuhët e përdorura në institucionet evropiane;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale të Shkollës nëpërmjet:

- Blerjes së pajisjeve elektronike, orendi-zyrash etj . (2012-2013)
- Pasurimi i fondit të bibliotekës; (2012-2013)

Masat legjislative afatmesme

Masat legjislative afatmesme janë si vijon:

- Përmirësimi i kuadrit ligjor.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Implementimi i memorandumit nëpërmjet ushtrimit të inspektimeve në përputhje me kompetencat përkatëse të MD-së dhe KLD-së;
- Kontrolli i veprimtarisë gjyqësore dhe veprimtarisë së administratës gjyqësore nëpërmjet inspektimeve të kryera nga ministria;
- Përgatitja e raporteve të inspektimit në përfundim të çdo inspektimi dhe paraqitja e tyre pranë subjekteve të inpektuara dhe të interesuara;
- Analiza e rezultatave dhe ndjekja e rekomandimeve të raporteve të inspektimit deri në paraqitjen e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor, në kuadër të përcaktimit të një praktike të qëndrushme për inspektimin gjyqësor;
- Kontrolli i veprimtarisë së prokurorëve ;
- Përgatitja e raporteve të inspektimit në përfundim të çdo inspektimi dhe paraqitja e tyre pranë drejtuesit të prokurorisë së rrethit gjyqësor që është inspektuar, Prokurorit të Përgjithshëm, Presidentit të Republikës dhe subjektit që ka paraqitur ankesën;
- Analiza e rezultatave dhe ndjekja e rekomandimeve të raporteve të inspektimit deri në paraqitjen e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor;
- Përgatitja e raportit vjetor të Ministrisë së Drejtësisë mbi inspektimet e ushtruara ndaj organit të akuzës;
- Hartimi i rekomandimeve vjetore në emër të Këshillit të Ministrave për Prokurorinë e Përgjithshëm për luftën kundër kriminalitetit;
- Organizimi dhe funksionimi i administratës gjyqësore, karriera dhe statusi i punonjësve të saj;
- Kontrolli i veprimtarisë së ZQRPP, Agjencise se Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe institucioneve të tjera vartëse, nëpërmjet inspektimeve të kryera nga ministria;
- Vlerësimi profesional i gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Statusi dhe trajtimi i inspektorëve të Ministrisë së Drejtësisë.
- Zhvillimi dhe permiresimi i sistemit ICMIS, per nje mirefunksionim te punes ne gjykata;
- Monitorimi i rezultateve të shortit elektronik;
- Përmirësimi i aksesit të qytetarëëve në sistemin elektronik (monitorimi dhe zyra e informimit);
- Përditësimi i vendimeve gjyqëësore në Qendrën e Dokumentimit tëë KLD-së, që mundëson publikimin e vendimeve gjyqësore;
- Vazhdimi i instalimit në sistemin ICMIS të modulit të regjistrimit audio në gjykatat që kanë mbetur pa u instaluar;
- Trajnimi i personelit administrative të gjykatave, kancelarëve, gjyqatarëve, stafit të MD-së me modulet e reja të regjistrimit audio;
- Vazhdimi i rishikimit të kurrikulave të Shkollës së Magjistraturës në lidhje me zhvillimet e e reja dhe sistemin e drejtësisë;

- Konsolidimi i Shkollës së Magjistraturës nëpërmjet trajtnimit të trajnerëve, përmirësimi i kushteve dhe rishikimi i organigramës;
- Dixhitalizimi i regjistrit te noterise dhe lidhja me ZQRPP;
- Studim projektim per ndertimin e Gjykates Administrative;
- Ndërtimi i Pallatit të Drejtësisë;
- Investimi për hartimin e projektit të implementimit për ndërtimin e ndërtesës së re / rikonstruksionin e ndërtesës aktuale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; Gjykatën e Apelit Tiranë; Gjykatën e Rrethit gjyqësor Fier; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet;
- Investimi për përmirësimin e infrastrukturës gjyqësore nëpërmjet ndërtimit të ndërtesave të reja në: Gjykatësn së Apelit Shkodër; Gjykatës së rrethit Gjyqësor Elbasan; Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe Gjykatës së Lartë;
- Investimi për përmirësimin e infrastrukturës gjyqësore për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë; Gjirokastër dhe Fier;
- Investimi për përmirësimin e infrastrukturës elektronike të gjykatave;
- Investimi për përmirësimin e infrastrukturës elektronike të gjykatave dhe të kushteve të punës dhe shërbimeve në salla dhe zyrat e gjyqtarëve si dhe instalimi i elementeve të sigurisë;
- Raportimi i punës së Komisionit Shtetëorr të Ndihmës Juridike pranë Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave dhe Dhmoës Kombetare të Avokatëve;
- Liçencimi dhe regjistrimi i ndërmjetësve në zbatim të ligjit të ri për ndërmjetësimin;
- Trajnimi i ndërmjetësve për zgjidhjen e konflikteve;
- Trajnimi dhe forcimi i kapaciteteve dhe rolit të profesioneve të lira në lidhje me standardet europiane dhe zhvillimin e legjislacionit;
- Përmirësimi i rolit të profesioneve të lira (noter, avokat, ndërmjetës, arbitra) nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të tyre dhe monitorimti të vazhdueshëm;
- Rritjes së rolit dhe kapaciteteve të Avokaturës së Shtetit nëpërmjet trajnimeve dhe përmirësimit të kushteve të punës;
- Implementimi i sistemit elektronik ALBIS;
- Gjenerimi i të dhënave statistikre dhe raporeve mbi përmirësimin e shërbimit;
- Zgjerimi i shërbimit përmbarimor privat ndaj shërbimit përbarimor shtetëror nëpërmjet ndryshimeve në ligji dhe certifikimit të përmbaruesve privatë;
- Trajnimi i vijueshëm i përmbaruesve gjyqësorë privatë në zbatim të programit të miratuar;
- Sigurimi i ndjekjes penale dhe dërgimi përpara gjykatës së autorëve të krimeve;
- Zbatimi me rigorozitet i legjislacionit për mbrojtjen e dëshmitarëve, duke u konsideruar një masë e nevojshme dhe e domosdoshme në luftën kundër krimit;
- Vizita monitoruese në vendet e kufizimit të lirisë nga Njësia kundër Torturës, Avokati i Popullit;
- Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme të prokurorëve, sipas programit vjetor të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime të tjera të organizuara në bashkëpunim me universitete dhe institucione ndërkombëtare;
- Zhvillimi i 80-90 trajnimeve për rritjen e performancës se Gjyqësorëve dhe Prokurorëve";

- Pergatitja e Programit te ri te formimit te vazhdueshem për gjyqtarët dhe prokurorët në detyre për 2012-2015";
- Zhvillimi i disa sesione trajnuese për trajnimin e trajnerëve (2012-2014);
- Përmirësimi i kapaciteteve institucionale të Shkollës, nëpërmjet:
- Zgjerimit të ambienteve të Shkollës së Magjistraturës, (ndërtimi i një godine të re). (2012- 2015).

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme per Sistemin Gjyqësor

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**2.205.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	2.205.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

1.1.6. MASAT ANTI-KORRUPSION

Objektivi strategjik

Lufta kundër korrupsionit përben një prioritet absolut te Qeverisë Shqiptare. Duke pasur si vizion themelor reduktimin progresiv dhe te qëndrueshëm te korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e vlerave në qeverisjes.
Zbatimi i përgjegjshëm i Strategjisë Antikorrupsion, nëpërmjet planeve konkrete te veprimit te miratuara, synon reduktimin progresiv e të qëndrueshëm të korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e vlerave në qeverisje nëpërmjet kultivimit e forcimit të mendësisë së shërbimit ndaj qytetarëve nga administrata publike, zbatimit të efektshëm e të barabartë të ligjit, përmirësimit të transparencës e informimit, zhvillimit të shpejtë e të qëndrueshëm ekonomik e njerëzor, cilësisë, përgjegjshmërisë e efektivitetit në qeverisje.

Situata aktuale

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Kuadri ligjor bazë në fushën e luftës kundër korrupsionit fokusohet, ndër të tjera, në aktet e mëposhtme:

- Ligjin nr. 7895 datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë";
- Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";

- Ligjin nr. 8498, datë 06.10.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale dhe protokollin e saj shtesë, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 8883, datë 18.04.2002 “Për ratifikimin e protokollit të dytë shtesë të Konventës së Këshillit të Europës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale;
- Ligjin nr. 8635, datë 07.06.2000 “Për ratifikimin e Konventës Civile për Korrupsionin”;
- Ligjin nr. 8778, datë 26.04.2001 “Për ratifikimin e Konventës Penale për Korrupsionin”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9245, datë 24.06.2004 “Për ratifikimin e Protokollit Shtesë të Konventës Penale për Korrupsionin”;
- Ligjin nr. 8646, datë 20.07.2000 “Për ratifikimin e konventës evropiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”;
- Ligjin nr. 8888, datë 25.4.2002 “Për ratifikimin e “Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”;
- Ligjin nr. 9262, datë 29.7.2004 “Për ratifikimin e protokollit shtesë të konventës për krimin kibernetik”;
- Ligjin nr. 9492, datë 13.3.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit”;
- Ligjin nr. 9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”;
- Ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”;
- Ligjin nr. 9049, date 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive te detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe te disa nëpunësve publike”, i ndryshuar (në proces);
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit te interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar me ligjet nr. 9475, datë 09/02/2006 dhe nr. 9529, datë 11/05/2006;
- Ligjin nr. 9508, date 03.04.2006 “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”;
- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;
- Ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”;
- Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”;
- Ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për policinë e shtetit”;
- Ligjin nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”;
- Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”;
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “ Për Procedurat tatimore në RSH”;
- Ligj nr. 10002, datë 6.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme”;
- Ligj nr. 10005, datë 23.10.2008 "Për një shtesë në ligjin nr. 8510, datë 15.7.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”;
- Ligji nr. 10051, datë 29.12.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”;

- Ligj nr. 10053, datë 29.12.2008 "Për një shtesë në ligjin nr. 796, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar"
- Ligjit Nr. 10081 datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 10078, datë 16.2.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistiken”.
- Ligji nr. 10119, datë 23.4.2009, “Për Planifikimin e Territorit”.
- Ligji nr. 10160, datë 15.10.2009, “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët e lartë dhe nëpunësit civilë".
- Ligji Nr. 10374 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar.
- Ligjit nr. 10093, datë 9.3.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)”.

- VKM nr. 768, datë 15.7.2009 “Për miratimin e proceduarave dhe të rregullave për kandidimin dhe përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)”.
- VKM nr. 769 dt. 15.07.2009 “Për miratimin e Statutit te Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.
- VKM nr. 161 dt. 10.03. 2010 ”Mbi Emërimin e anëtareve te Bordit Mbikëqyrës Agjencisë për mbështetjen e Shoqërisë Civile”.
- Vendimin nr. 794, datë 19.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Task Forcës Antikorrupsion”

- Vendimin nr. 94, datë 15.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores për funksionet dhe procedurat e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion të Këshillit të Ministrave”;
- Vendimin nr. 714, datë 22.10.2004 “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”;
- Vendimin nr. 517, datë 15.3.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit të reformës rregullatore në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit”;
- Vendimin nr. 1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Vendimin nr. 27, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”;
- Urdhrin nr. 172, datë 2.11.2005 të Kryeministrit “Për marrjen e masave të shpejta në zbatim të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Urdhrin nr. 202, datë 16.12.2005 të Kryeministrit “Për forcimin e transparencës nëpërmjet rritjes së përdorimit të internetit dhe përmirësimit të faqeve ekzistuese të internetit”;
- Urdhrin nr. 208, datë 29.12.2005 të Kryeministrit “Për vendosjen e numrave të telefonit falas për denoncimin e korrupsionit”;
- Urdhrin Nr. 135, datë 12.06.2006 të Kryeministrit, “Për ngritjen e Grupit Ndërministror të Punës, për thjeshtëzimin e dokumentacionit shoqërues për shërbimet e ofruara nga administrata qendrore”.

- Urdhrin nr. 170, datë 31.10.2005 të Kryeministrit, "Për Krijimin e Task-Forcës për drejtimin dhe monitorimin e reformës rregullatore ne funksion te përmirësimit të klimës së biznesit";
- VKM nr. 1, datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", ndryshuar me VKM nr. 153, datë 22.3.2007;
- VKM nr. 913, datë 26.8.2009 "Për krijimin e Qendrës Kombëtare për Aplikimet Energjetike";
- Urdhrat dhe Udhëzimet e Ministrit të Brendshëm mbi organizimin dhe funksionimin e SHKB-së, trajtimin e informacionit të klasifikuar, rregullores së kartotekës etj.

Struktura institucionale

Strukturat që janë të ngarkuara me luftën kundër korrupsionit, krahas organeve të hetimit e ndjekjes penale (policia e prokuroria) janë:
Ne nivel strategjik dhe politik:

- *Task Forca Anti Korrupsion* (TFA), e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 794, datë 19.12.2005. Kjo strukturë kryesohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga anëtarë të Këshillit të Ministrave dhe përfaqësues të institucioneve të tjera të varësisë që mbulojnë kryesisht menaxhimin e financave publike si dhe kontrollin e auditin.
  TFA ka për funksion të analizojë fenomenin, përcaktojë prioritetet, identifikojë masat dhe veprimet konkrete dhe koordinojë punën ndërmjet institucioneve. TFA ka një qasje më dinamike ndaj fenomenit të korrupsionit dhe synon të aktivizojë kapacitetet e administratës për të reaguar në mënyrë të shpejtë energjike dhe procedurale ndaj shfaqjeve të praktikave korruptive, abuzimeve, apo deformimeve të ndryshme në administratë.
- *Grupi Ndërministrorë i Punës*, ne baze te Urdhrit te Kryeministrit nr. 195, date 14.08.2006, i ndryshuar; mbështetur nga grupi teknik, është përgjegjës për hartimin e strategjisë dhe rishikimin periodik te saj, koordinimin e punës se ministrive për hartimin e Planeve te Integruara Ministeriale, qe janë plane te përvitshme veprimi ne zbatim te Strategjisë , si dhe ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit te "Strategjisë për Parandalimin, Luftën Kundër Korrupsionit dhe Qeverisjen Transparente" dhe planeve individuale te ministrive për antikorrupsionin.
- Me qellim permiresimin e kapaciteve zbatuese dhe monitoruese te Strategjise Antikorrupsion jane krijuar edhe grupet e posacme te punes ne te gjitha nivelet e kerkuara. Për përmirësimin e koordinimit të zbatimit të strategjisë antikorrupsion dhe kapaciteteve të DEKOBAN, gjatë vitit 2010 është ndryshuar Urdhri i Kryeministrit nr. 173, datë 27.09.2010 për krijimin dhe organizimin e Grupit Ndërministror të Punës për Zbatimin e Strategjisë Antikorrupsion, i cili ka përcaktuar se Sekretariati teknik për koordinimin e punës përbëhet nga përfaqësues nga DEKOBAN, DEBASKON. MITIK, Ministria e Drejtesise dhe Ministria e Integrimit. Jane miratuar nga GNP-ja dhe regulloret e brendshme te GNP, GNTP dhe Sekretariatit teknik te GNP, te cilat percaktojne ne detaje funksionet e detyrat e te gjitha grupeve te punes.
    - Më tej, me qëllim përmirësimin e çështjeve të koordinimit brenda ministrive të linjës, janë përcaktuar Sekretarët e Përgjithshëm të çdo ministrie për të bashkërenduar procesin e brendshëm të raportimit në lidhje me zbatimin e

planeve 1-vjeçare të veprimit. Kjo synon të përmirësojë bashkërendimin ndërmjet ministrive të linjës.

Në nivel operacional :

- Këshilli i Ministrave
  - Departamenti i Kontrollit te Brendshëm dhe Antikorrupsion pranë Këshillit te Ministrave (DEKOBAN)
- Ministria e Brendshme
  - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë se Shtetit (Drejtoria Kundër Krimit Financiar).
  - Shërbimi i Kontrollit te Brendshëm pranë Ministrisë se Brendshme.
- Ministria e Drejtësisë
  - Shërbimi i Kontrollit te Brendshëm ne Drejtorinë e Përgjithshme te Burgjeve.
- Ministria e Financës
  - Drejtoria e Investigimit te Brendshëm (Drejtoria e Përgjithshme e Tatime)
  - Agjencia e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara
  - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Departamenti Operativo-Hetimor)
  - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit te Parave (DPPPP).
- Prokuroria e Përgjithshme (Prokuroria për Krime te Renda) dhe Prokuroritë pranë Rretheve Gjyqësore
  - Njësitë e Përbashkët Hetimore për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit. (strukture e veçante e krijuar me qellim te bashkërendimit te punës midis institucioneve me qellim hetimin dhe ndjekjen efektive te veprave penale te krimit financiar dhe ekonomik
- Inspektorati i Larte i Deklarimit te Pasurive
- Kontrolli i Lartë i Shtetit

<u>Këshilli i Ministrave</u>

- Departamenti i Kontrollit te Brendshëm dhe Antikorrupsion pranë Këshillit te Ministrave (DEKOBAN)

Struktura përbehet nga drejtori dhe 10 inspektore (2 prej te cilëve janë koordinator dhe inspektore). DEKOBAN, në Këshillin e Ministrave, është struktura përgjegjëse për kontrollin e brendshëm administrativ dhe antikorrupsionin në të gjitha institucionet e pushtetit ekzekutiv (ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit a ministrave, administratës së prefektit, si dhe në shoqëritë tregtare, me kapital shtetëror). Misioni i Departamentit është të kryejë verifikimin (hetimin administrativ) e zbatimit të ligjshmërisë dhe/ose kallëzimeve për praktika abuzive, korruptive a arbitrare, të identifikojë punonjësit e administratës publike, të cilët, me veprime apo mosveprime kanë kryer shkelje te akteve ligjore/nënligjore në fuqi, të përgatisë rekomandime për çështjet përfshi edhe llojin e masave ndaj autorëve, si dhe të ndërgjegjësojë institucionet publike në luftë kundër korrupsionit.

Departamenti ka si funksion te tij edhe koordinimin për hartimin e politikave antikorrupsion, si dhe lehtësimin e koordinimin për ndjekjen dhe raportimin e zbatimit te programeve antikorrupsion. Ky funksion realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes dhe kryesimit të Sekretariatit teknik të Grupit Ndërministror të Punës për zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të

Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente. Departamenti luan një rol kryesor në Sekretariat për sa i përket dhenies se asistencës teknike në fushën e antikorrupsionit.

DKBAA është pike lokale për raportimin ne emër te qeverise ne institucionet / dhe organizmat ndërkombëtare si Regional Anti-corruption Initiative (RAI), GRECO (KiE) dhe UNODC për Konventën e Kombeve te Bashkuara kundër Korrupsionit, OECD (Rrjeti i Antikorrupsionit - Planin e Stambollit) etj.

Ministria e Brendshme

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë se Shtetit (Drejtoria Kundër Krimit Financiar).

Me organizimin e ri të Policisë së Shtetit, në qershor të vitit 2007 u krijua Drejtoria Kundër Krimit Financiar në Departamentin për Hetimin e Krimeve. Kjo Drejtori ka filluar të funksionojë në mënyrë të plotë nga data 1 Janar 2008dhe ka strukturat e saj në 12 Drejtori të Policisë në Qarqe, ku është e organizuar në Sektorë.

Mbi bazën e një Memorandumi Bashkëpunimi ne viti 2007, mes Prokurorisë se Përgjithshme, Ministrisë se Brendshme, Ministrisë se Financave dhe Shërbimit Informativ Shqiptar, është krijuar dhe është operacionale Njësia e Përbashkët Hetimore Kundër Krimit Financiar dhe Korrupsionit pranë Prokurorisë Tirane për procedimet penale te regjistruara për vepra penale te korrupsionit. Kjo strukture vepron si një Task Force operacionale për hetimin, zbulimin dhe vënien para drejtësisë te individëve te përfshirë ne afera korruptive. Ne vitin 2009 me një MoU të re u ngritën dhe janë funksionale dhe 6 Njësi të përbashkëta hetimore pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastër. Me anë të këtij MoU janë përfshirë dhe dy struktura të reja bashkëpunuese: Inspektorati i Përgjithshëm i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Kontrolli te larte të Shtetit.

- Shërbimi i Kontrollit te Brendshëm pranë Ministrisë se Brendshme.

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, në bazë të ligjit nr. 10002, datë 06.10.2008 "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme", në funksion të objektit të veprimtarisë së saj, "parandalimit, zbulimit, dokumentimin dhe hetimin paraprak të veprave penale të kryer nga punonjësit e policisë së shtetit, pavarësisht nga funksioni dhe grada".
SHKB-ja ka kompetenca për të ndërmarrë masa parandaluese dhe masa hetimore (operacionale) për të kontrolluar dhe luftuar korrupsionin në policinë e shtetit.

Prokuroria e Përgjithshme

Prokuroria ka krijuar brenda sistemit të saj struktura të specializuara anti-korrupsion. Këto struktura janë quajtur Njësi të Përbashkëta Hetimore dhe janë krijuar pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastër.
Në Prokurorinë e Përgjithshme është krijuar Sektori kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit, i cili ka për detyrë të koordinojë punët e të gjitha Njësive të Përbashkëta Hetimore.

Ministria e Financave

- Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është një Institucion buxhetor, nën varësinë e Ministrit të Financave. Agjencia ka për objekt kryesor të veprimtarisë Administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara me vendim të Gjykatës për Krimet e Rënda.

Struktura dhe organika e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara janë rregulluar me VKM nr. 1106, datë 30.7.2008 dhe Urdhrin e Kryeministrit nr. 103, datë 05.08.2008. Në bazë të akteve të mësipërme Agjencia ka në strukturën e saj 5 punonjës, përkatësisht, Kryeadministratori, 2 administratorë, 1 jurist dhe 1 specialist të administratës.

- Drejtoria e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) funksionon në bazë të Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", i cili ka hyrë në fuqi në datë 10.09.2008, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu, kjo drejtori funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 89, datë 23.06.2009 "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave" është miratuar struktura e re e DPPPP-së dhe është shtuar personeli nga 22 në 26 punonjës.

- Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (antikorrupsion) në Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka në misionin e saj zbulimin dhe parandalimin e sjelljeve korruptive nga punonjësit tatimore. është në proces miratimi nga ministri i financave draft-udhëzim "për funksionimin e investigimit të brendshëm në drejtorinë e përgjithshme të tatimeve".

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive është institucion i pavarur, pavarësia e të cilit përcaktohet në nenin 16 të Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.

Roli i Inspektoratit të Lartë në zbatim të dy ligjeve mbi të cilën ushtron veprimtarinë e vet, në mënyrë të përmbledhur është si vijon:

- Rol parandalues, rol të cilin e përmbush gjatë këshillimit dhe dhënies së asistencës teknike dhe ligjore për plotësimin e deklaratës së interesave private.
- Roli kontrollues. Neni 17 i Ligjit 10.4.2003, përcakton kompetencat e Inspektoratit të Lartë, i cili ushtron kontroll të drejtpërdrejtë të deklarimeve në emërtesë të tij, si dhe mbledh të dhëna, kryen hetime dhe kërkime administrative rreth deklarimeve të

personave që mbartin detyrim për deklarim në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

- Roli ndëshkues, Inspektorati i Lartë ka të drejtë të ndërmarrë sanksione në përmbushje të detyrimeve ligjore.

Kontrolli i Lartë i Shtetit

Neni 162 i Kushtetutës përcakton Kontrollin e Lartë të Shtetit si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Shqipëri, i cili i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Nenet 162, 163, 164, 165 të Kushtetutës së Shqipërisë , si dhe ligji miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë nr. 8270, datë 23.12.1997, "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit". KLSH ka për mision rritjen e rolit dhe kontributit në drejtim të miradministrimit të financave publike, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve cilësore të zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike dhe financiare dhe raportimit mbi rregullshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të të gjitha burimeve financiare shtetërore, në të mirë të shtetit dhe publikut në tërësi.

Sipas nenit 6 te ligjit organik objekti kryesor i veprimtarisë përcaktohet kontrolli i përdorimit efektiv dhe i dobishëm i fondeve publike, miradministrimi financiar dhe zbatimi i ligjshmërisë ne fushën ekonomike e financiare. Zgjedhja e Kryetarit te KLSH-së për një mandat 7 vjeçar bëhet nga Kuvendi.

Te tjera institucione mund te përmendim ato te krijuara nga amendimet e ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, te cilat kanë krijuar organe të reja administrative si Avokati i Prokurimeve i cili mbron të drejtat dhe interesat e ligjshëm të kandidatëve, ofertuesve apo furnizuesve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të autoriteteve kontraktore (neni 14) si dhe Komisionin e Prokurimit Publik (neni 19/1) i cili shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe ato të koncesioneve.

Masat legjislative afatshkurtra

Prioritetet afatshkurtra te përcaktuara ne Dokumentin e Partneritetit Evropian dhe rekomandimeve te takimeve dypalëshe BE - Shqipëri lidhur me këtë fushe, janë si më poshtë:

- Hartimi i dokumentave të rinj strategjikë (2014 e në vijim) pas përfundimit të zbatimit të Strategjisë Antikorrupsion (2008-2013);
- Harmonizimi i Kodi Civil, Kodi Tregtar dhe Kodi Administrativ me Konventën (e Këshillit të Evropës) e Ligjit Civil për Korrupsionin;

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Parandalimit, luftës kundër korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013;
- Zbatimi, ndjekja dhe vlerësimi istrategjisë dhe planeve të veprimit 2012-2013 / Planit të veprimit për zbatim të Rekomandimit nr. 8 “Të luftës kundër korrupsionit” duhet të përfshijë shoqërinë civile, më së pari OJF-të që janë aktive në fushat e anti-korrupsionit dhe qeverisjes së mirë. Për këtë qëllim, duhet te garantohet mbështetje e duhur aktorëve të shoqërisë civile;

- Zbatimi i rekomandimeve të bëra në Raportin e 3 të vlerësimit të Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit (e Këshillit të Evropës) dhe përgatitja për Raundin e 4 të vlerësimit;
- Adresimi i transparencës në financimin e partive politike duke bërë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe nënligjore;
- Marrja e masave për përmirësimin e sistemit të inspektimeve administrative, për të siguruar integritet dhe transparencë në praktikën administrative, qoftë në kuadrin ligjor ashtu dhe atë organizativ;
- Zhvillimi i metejshem i sistemit te prokurimit publik;
- Krijimin e nje sistemi te konsoliduar te dhenash ne lidhje me regjistrimin e hetimeve, ndjekjese penale dhe dënimeve;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale për hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit;
- Zbatimi i legjislacionit për parandalimin e korrupsionit, duke u mbështetur siç duhet në bashkërendimin ndër-institucional;
- Forcimi i mekanizmave e zbatimit të Ligjit për deklarimin e pasurive nëpërmjet ndryshimeve ligjore të propozuara;
- Qartësimi i rregullave për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike nëpërmjet ndryshimeve ligjore të propozuara;
- Qartësimi i rregullave për aksesin publik në informacion në linjë me standardet ndërkombëtare;
- Ulja e numrit te zyrtarëve që gëzojnë imunitet dhe të jepet imunitet vetëm atëherë kur është domosdoshmërisht e nevojshme;
- Për parandalimin e korrupsionit, të vazhdohet organizimi i programeve të trajnimit për zyrtaret përkatës për cështje të etikës, integritetit, shmangies se konfliktit të interesave etj.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Parandalimi, transparenca, gjithëpërfshirja e edukimi:
    - Forcimi i sistemit politik dhe i etikes se funksionimit publik
    - Modernizimi e konsolidimi i procedurave
    - Reformat sektoriale (kontrolli, klima e biznesit, shërbimi civil, prokurimi publik, arsimi, shëndetësia, financat, drejtësia, pushteti vendor, etj.)
    - Konsolidimi i transparencës dhe integritetit në administratën publike
    - Përafrimi i legjislacionit ne fushën e luftës kundër korrupsionit
    - Fushatat informuese dhe masa edukuese te qëndrueshme

- Hetimi dhe dënimi i korrupsionit:
    - Sigurimi i eficences se ndjekjes penale, rritja e shpejtësisë se ndjekjes penale dhe gjykimit
    - Rritja e integritetit dhe rezistencës ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë
    - Forcimi i mjeteve administrative ne luftën kundër korrupsionit
    - Pjesëmarrja e publikut ne denoncimin e korrupsionit

- Konsolidimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit te brendshëm dhe ndërkombëtar:

- Konsolidimi i mekanizmave ne bashkëpunimin ndërmjet agjencive te zbatimit te ligjit
- Konsolidimi i mekanizmave te qëndrueshëm për shkëmbimin periodik te informacionit
- Zbatimi i efektshëm i instrumenteve antikorrupsion rajonale e ndërkombëtare.

1.2. TË DREJTAT E NJERIUT

1.2.1. TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

Objektivi strategjik

Ndërmarrja e mëtejshme e reformave tërësore institucionale dhe ligjore do të synojnë garantimin në nivele gjithnjë e më të larta të të drejtave dhe lirive themelore të individit e në veçanti të të drejtave të minoriteteve. Kështu, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, Qeveria shqiptare është e angazhuar në ndërmarrjen e të gjitha reformave të nevojshme që do të shërbejnë për trajtimin në mënyrë sa më humane të personave me liri të kufizuar, zbatimin e ligjit në vendin e vuajtjes së dënimit, rehabilitimin dhe integrimin e të dënuarve në shoqëri dhe krijimin e një sistemi të sigurt dhe efikas për të gjithë shoqërinë.

Legjislacioni shqiptar në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ka përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore një sërë dispozitash që kanë të bëjnë me trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve, si dhe kompetencat dhe detyrat e organeve shtetërore kompetente, me qëllim respektimin e dinjitetit të dënuarve dhe të paraburgosurve, trajtimin e tyre pa njëanshmëri apo diskriminim për shkak te seksit, kombësisë, racës, gjendjes ekonomike dhe shoqërore, pikëpamjeve politike dhe besimit fetar, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurisë në të cilën mbahen dhe trajtohen të burgosurit dhe të paraburgosurit si dhe zhvillimin e programeve të rehabilitimit social dhe veprimtarive prodhuese për të burgosurit;

Gjithashtu, në kudër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në Shqipëri, ka filluar të funksionojë Institucioni i Shërbimit të Provës. Misioni i këtij institucioni është të mbikqyrë dhe mbështesë zbatimin e dënimeve alternative me qëllim mbrojtjen e interesave publike, parandalimin e kryerjes së veprave penale, asistimin e personit të dënuar për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dënimi alternativ, asistimin e personit të dënuar për kapërcimin e vështirësive për riintegrimin e tij shoqëror, uljen e recitivizmit si dhe rritjen e sigurisë në komunitet.

Në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të së drejtave sociale, fokusi kryesor i qeverisë në fushën e mbrojtjes shoqërore, për periudhën afatshkurtër, është implementimi i sistemit të mbrojtjes sociale dhe standardeve, duke luftuar përjashtimin social dhe diskriminimin, përmirësimin e legjislacionit në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, monitorimin e zbatimit të legjislacionit aktual si edhe fuqizimit të kapaciteteve të strukturave implementuese të legjislacionit. Ndërsa, objektivi kryesor i Qeverisë shqiptare për periudhën afatgjatë është përmirësimi i skemës aktuale të sigurimeve shoqërore, nëpërmjet reformimit të shtyllës

publike të pensioneve e forcimit të një lidhjeje më të drejtpërdrejtë midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme, futjes graduale të skemave të përfitimeve suplementare të menaxhuara nga subjekte jopublike, krijimit të llogarive personale të çdo kontribuesi dhe përfituesi, arritjen e transparencës maksimale, duke pergatitur skemen dhe sistemin per bashkepunimin e saj me vendet e BE (në perputhje me nenin 99 te Marreveshjes se Stabilizim Asocimit).

Për më tepër, qeveria shqiptare angazhohet për të zbatuar dhe arritur standardet më të larta të respektimit dhe realizimit të të drejtave të minoriteteve kombëtare, që jetojnë në Shqipëri. Të gjitha iniciativat dhe masat që do të ndërmerren do të synojnë zbatimin dhe përputhshmërinë e plotë me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës "Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare", të ratifikuara nga Shqipëria. Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e mbrojtjes së minoritetit rom, është zbatimi i Strategjisë Kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom", duke luftuar përjashtimin social dhe diskriminimin, bazuar në instrumentet ndërkombëtare në këtë fushë si dhe kuadrin ligjor të brendshëm dhe objektivat kryesore të programit te Qeverisë në fushën e mbrojtjes së minoriteteve.
Qeveria shqiptare është plotësisht e angazhuar që politikat sociale të orientohen drejt respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013), duke siguruar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

1.2.1.1. SISTEMI PENITENCIAR

Situata aktuale

Sistemi i institucioneve të vuajtjes së dënimit, është një nga organizmat ku reformat demokratike kanë sjellë një ndryshim tërësor. Gjatë viteve të komunizmit, burgjet shiheshin si institucione ndëshkimi, ku të dënuarit dhe burgosurit trajtoheshin në mënyrë ç'njerëzore. Në ditët e sotme, është punuar që institucionet penale të mos shihen vetëm si vende ndëshkimi, por si mjete për ri-integrimin e të dënuarve në shoqëri. Në vendin tonë ndodhen 19 burgje dhe paraburgime, 1 Spital Burgu dhe 1 Institut për të Miturit në qytetin e Kavajës. Kushtet e përgjithshme të burgjeve në Shqipëri, veçanërisht gjatë viteve të fundit, kanë pësuar ndryshime pozitive, duke ndikuar në përmirësimin e jetës së personave që mbahen në burgje dhe paraburgime, por në të njëjtën kohë dhe sigurinë e gjithë sistemit. Ndryshimet kanë ardhur paralelisht me ndryshimet konceptuale, logjistike, financiare dhe infrastrukturore. Të gjitha këto ndryshime, janë reflektuar dhe në konkluzionet e raportit përfundimtar të Komisionit Evropian, datë 12.10.2011, ku citohet se "*ka pasur progres në adoptimin e disa dispozitave ligjore dhe përmirësimin e kushteve në të cilat mbahen të paraburgosurit dhe të dënuarit në burgje, si dhe në zbatimin e dënimeve alternative*". Aspekt themelor në zbatimin e ligjshmërisë dhe përmirësimin e kushteve të burgjeve në Shqipëri, është monitorimi i gjithë sistemit nëpërmjet treguesve të realizimit të perfomancës, ku janë vendosur objektiva strategjikë dhe është vendosur një vizioni i qartë, ecuria e të cilave

monitorohen në mënyrë të pavarur dhe transparente nga institucione publike vendase dhe ndërkombëtare, si dhe shoqëria civile.

Sipas të dhënave statistikore të muajve të parë të vitit 2012, në 21 institucionet penale në vend, janë trajtuar mesatarisht *4696* të dënuar dhe paraburgosur, prej të cilëve *4484* burra, *85* gra dhe *127* të mitur. Shifra e mbipopullimit ka qenë *279* persona mbi kapacitetet akomoduese të burgjeve. Krahasuar me vitet e mëparshme, ky është numri më i ulët, sa i takon nivelit të mbipopullimit. Ky fenomen ka sjell pasoja pozitive në drejtim të rritjes së kohës së ajrimit, kohës së takimit me të afërmit, të trajtimit individual të paraburgosurve nga ana e punonjësve të kujdesit social, ligjor etj. Gjithashtu, element i rëndësishëm që lidhet me uljen e mbipopullimit është dhe zbatimi i parimit rajonal, që do të thotë të dënuarit dhe paraburgosurit të vendosen në institucione sa më afër vendbanimit të tyre, duke stimuluar në këtë mënyrë forcimin e kontakteve dhe lidhjeve me familjarët dhe të afërmit.

Realizimi i të gjitha objektivave të ndërmarra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, shton perspektivën për të përmirësuar zbatimin e tyre praktik në sistemin e burgjeve, sikurse të gjitha vendet evropiane. Këto objektiva synohen të shndërrohen në simbole e stimuj për përmirësimin e standardeve të përgjithshme dhe regjimeve humanitare e bashkëkohore të trajtimit të personave me liri të kufizuar, duke garantuar që dënimi me heqje lirie zbatohet në mënyrë të paanshme, pa diskriminim për arsye mendimi politik, feje, race, ngjyre, seksi, niveli ekonomik, etj.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/ nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe paraburgosurve", i ndryshuar.Një risi e këtij ligji ishte dhe krijimi i Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues dhe kompetencat e tij si një strukturë e veçantë e Avokatit të Popullit. Kjo strukture është ngritur në zbatim të "Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe dënimi tjetër çnjerëzor dhe degradues" (OPCAT) të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me anë të ligjit nr. 9094 dt. 03. 07. 2003.
- Ligji nr 10024, datë 27.11.2008 "Për Policinë e Burgjeve", i ndryshuar;
- VKM nr. 303, datë 25.03.2009, "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve", i ndryshuar;
- VKM nr. 337 dt. 06.04.2011 "Për përfshirjen e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve në skemën e sigurimeve shëndetësore".
- Rregulloret e brendshme të gjitha IEVP dhe të Qendrën Spitalore të Burgjeve të miratuara me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e ngjyrës, uniformës dhe shenjave në mjetet e Policisë se Burgjeve";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për llojet e armëve dhe mënyrën e përdorimit të tyre;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e flamurit dhe të stemës së Policisë së Burgjeve";

- Urdhri i përbashkët nr. 582, datë 24.01.2007, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme, për realizimin e plotë de facto të sistemit të paraburgimit në administrimin e Ministrisë së Drejtësisë;
- Urdhri nr. 3155, datë 28.04.2008 "Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale", i ndryshuar;
- Urdhri i përbashkët nr. 1779/15, datë 26.12.2011, midis Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit "Për caktimin e kritereve të standardizuara në ndërtimin dhe rikonstruksionin me cilësi të burgjeve dhe paraburgimit";
- Memorandumi i Bashkëpunimit, nr. 2381, datë 20.03.2012, midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë "Për Ngritjen e Institutit Mjekësor për Trajtimin e Personave me Probleme të Shëndetit Mendor që kanë Kryer Vepra Penale";
- Memorandumi i Bashkëpunimit, 05.12.2008, midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për arsimimin e të ndaluarve dhe burgosurve;

Ndryshimet e bëra në legjislacionin e lartpërmendur janë përafruar pothuajse plotësisht me Rekomandimin (2006) 2 të Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane te Burgjeve i miratuar nga Këshilli i Ministrave me 11 Janar 2006 në takimin e 952 të Zëvendës Ministrave.

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në garantimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, për respektimin e të drejtave të njeriut janë:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Mbështetur në ligjin nr. 8688, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar me ligjin nr. 9112 datë 24.07.2003, DPB është një institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë i cili menaxhon dhe organizon funksionimin e sistemit të paraburgimit, vuajtjes së dënimit, ekzekuton të gjitha vendimet penale, siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e sistemit, etj.

Ministria e Brendshme në lidhje me respektimin e të drejtave të shtetasve të ndaluar dhe të arrestuar në flagrancë (48 orë), të cilët qëndrojnë në Komisariatet e Policisë.

Prokuroria e Përgjithshme në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale dhe trajtimin e kërkesë-ankesave të dënuarve dhe paraburgosurve, rastet e kallëzimeve për keqtrajtime të burgosurve nga punonjës të policisë së burgjeve, etj.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit penitenciar shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij, përmirësimi i kushteve të strehimit dhe sigurisë së personave me liri të kufizuar, si dhe rritja e veprimtarive me karakter rehabilitues.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 8328, date 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar;
- Miratimi i disa shtesave e ndryshimeve në ligjin nr. 10032, datë 11.12.2008 për Policinë e Burgjeve;
- Miratimi i VKM "Mbi nxitjen dhe shpërblimin e punës së të dënuarve dhe paraburgosurve": Në zbatim të ndryshimeve dhe shtesave në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", i ndryshuar, u miratua Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve me VKM nr. 303 datë 25.03.2009, i ndryshuar, ku u bë rregullimi i marrëdhënieve të punësimit të burgosurve;
- Dërgimi për Shqyrtim dhe Miratim në Këshillin e Ministrave i Projektligjit "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm për sistemin e Burgjeve;
- Hartimi i draftit të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, në të cilën do të adresohen masa lidhur me:
  - administrimin e drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin,
  - të miturit nën moshën e përgjegjësisë penale,
  - të miturit viktima të krimit dhe të miturit dëshmitarë;

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Ndërtimi i paraburgimit të ri në Elbasan;
- Rekrutimi i stafit për paraburgimin e ri të Elbasanit;
- Trajnimi i stafit të sapozgjedhur civil e policor të paraburgimit të Elbasanit;
- Realizimi i projektit për bllokuesit e valëve celulare në IEVP Jordan Misja dhe Fushë-Krujë;
- Ndërtimi i Paraburgimit të ri në Berat;
- Ndërtimi i Paraburgimit të ri në Fier;
- Realizimi i një sistemi të veçantë për punësimin e të dënuarve dhe paraburgosurve;
- Projekte për përmirësimin e kushteve të përgjithshme në disa institucione penitenciare;
- Përfshirja e të burgosurve në skemën e sigurimeve shëndetësore;
- Punësimi i mjekëve psikiatër në të gjitha institucionet penale;
- Trajnimi i stafeve të edukimit që merren me trajtimin e të miturve në ambientet e vuajtjes së dënimit dhe ato të paraburgimit;
- Trajnimi i gjithanshëm të gjithë stafit civil dhe policor të burgjeve në çështjet e të drejtave të njeriut dhe nxitja dhe respektimi i të drejtave për sa i përket trajtimit të paraburgosurve dhe dënuarve;
- Zbatimi i VKM "Për përfshirjen e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë";
- Dërgimi i projektvendimit "Për miratimin e Strategjisë për Drejtësinë për të Mitur" për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave;
- Përmirësimi i ruajtjes së të dhënave mjekësore të të burgosurve.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatmesme synohet përmirësimi i infrastrukturës të burgjeve dhe paraburgimeve, ulja e mbipopullimit në sistemin e burgjeve, shtimin e numrit të shkollave në institucionet penale, forcimi i kapaciteteve të stafit të punonjësve të burgjeve, duke siguruar trajtim me dinjitet për personat e privuar nga liria, si dhe informatizimi i të dhënave.

Masat legjislative afatmesme janë si vijon;

- Hartimi i një drafti të një ligji të ri të drejtimit, menaxhimit dhe funksionimit të burgjeve dhe paraburgimeve;
- Rishikimi i legjislacionit për personat me probleme mendore në qëndrat e burgimit dhe paraburgimit.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Ndërtimi i Paraburgimit të ri në Shkodër;
- Vënia në efiçensë të plotë të paraburgimit në Berat, Fier;
- Rekrutimi i stafit për paraburgimin e ri të Berat, Fier dhe Shkodër;
- Trajnimi i stafit të sapozgjedhur civil e policor të IEVP Berat, Fier, Shkoder;
- Sisteme kamerizimi të reja dhe përmirësim i sistemeve aktuale në IEVP Peqin, Lezhë, Tepelenë, Qendra Spitalore e Burgjeve, Krujë, Lushnjë, Mine Peza, Rrogozhinë dhe Vaqarr si dhe permiresim i sistemeve aktuale;
- Ndërtimi i një institucioni të ri në ambientet e Burgut 313 dhe 325 Tiranë;
- Linja te reja elektrike ne Lezhe dhe Fushe Krujë;
- Përgatitja e projekteve për depo dhe puse uji si dhe linja ujësjellësi të reja;
- Rikonstruksion i plotë i IEVP Lushnje;
- Rikonstruksion në godinat e rregjimit të brendshëm dhe të jashtëm në IEVP Rrogozhinë;
- Rikonstruksion në godinat e 1,4,5 në IEVP Lezhë;
- Rikonstruksion në tualete në sigurinë e lartë në IEVP Peqin;
- Informatizimi i sistemit penitenciar;
- Komunikimi online (radio rele) i të gjitha IEVP dhe D.P.Burgjeve;
- Përmirësimi i sistemit të ngrohjes në IEVP Vaqarr, Sarandë dhe Peqin;
- Mbrojtje perimetrike në disa IEVP;
- Godine e re qëndër trainimi;
- Ngritja e një ambienti për stërvitje për stafin policor si dhe poligon qitje;
- Projekte për rritjen e sigurisë fizike përmes mbikëqyrjes dhe kontrollit me kamera dhe sisteme sigurie;
- Projekte për linja të reja elektrike dhe linja te reja ujësjellësi e puse uji në institucionet penitenciare;
- Projekte për përmirësimin e kushteve të punës në institucionet penitenciare;
- Hartimi i planit tematik të inspektimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;
- Ofrimi i kujdesit shëndetësor të burgosurve, veçanërisht personave të sëmurë mendorë;

- Studimi i projektit për administrimin dhe trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor;
- Krijimi i standardeve për trajtimin e personave nën masën mjekësore të "mjekimit të detyruar" dhe "mjekim të detyruar të përkohshëm";
- Bashkëpunimi për organizimin e tryezave të rrumbullakëta me OJF-të për përmirësimin e disa praktikave dhe proçedurave në sistemin e burgjeve dhe paraburgimit;
- Kryerja e inspektimeve;
- Marrja e masave në zbatim të rekomandimeve që dalin nga inspektimet;
- Identifikimi i problemeve të ngritura në Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit;
- Marrja e masave për reflektimin përkundrejt vërejtjeve të Avokatit të Popullit;
- Rritja e numrit të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve në rrugë jashtëgjyqësore nëpërmjet zbatimit me efiçencë te ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve";
- Inspektime tematike nga strukturat inspektuese të gjyqësorit dhe prokurorisë për verifikimin e zbatimit të ligjit në rastin e të miturve të paraburgosur;
- Investigimi i ankesave administrative;
- Trajnimi në lidhje me Kodin e Etikës së Policisë dhe kufirin e përdorimit të forcës nga ana e Policisë dhe e stafit të sistemit penitenciar, në përputhje me standardet evropiane (Kodi Evropian i Etikës Policore) dhe praktikën e Gjykatës Europiane;
- Trajnime në lidhje me Kodin e Etikës Mjekësore, për personelin mjekësor në sistemet penitenciare në lidhje me dinjitetin njerëzor;
- Identifikimi dhe trajtimi i ankesave administrative ndaj kushteve të trajtimit në komisariatet e policisë dhe qëndrat e paraburgimit dhe burgimit;
- Analiza e bazave të ankesave, rezultatet dhe ndjekja e rekomandimeve.

1.2.1.2. SHËRBIMI PËRMBARIMOR

Situata aktuale

Objektiv i Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor është rritja e vazhdueshme e ekzekutimeve të titujve ekzekutivë.

Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor ka organizim unik dhe të centralizuar, me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe i ushtron funksionet nëpërmjet përmbaruesve gjyqësorë, të cilët janë personat e ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor varet nga Ministri i Drejtësisë dhe organizohet në nivel qëndror dhe vendor.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Kuadri ligjor ekzistues mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore duke përfshirë edhe ligjin "Për Shërbimin Përmbarimor Privat":

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, i ndryshuar.
- Ligji nr.8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor ",
- Kodi i Procedurës Civile i R.SH. –së, (miratuar me Ligjin Nr. 8116, date 29.03.1996, ndryshuar me Ligjin Nr. 8491, date 27.05.1999, me Ligjin nr. 8812, datë 17.05.2001, me Ligjin 9953, date 14.07.2008, me Ligjin nr. 10052, datë 29.12.2008,
- Kodi Civil i RSH-së, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar me ligjin 8536, datë 18.10.1999 dhe me ligjin nr. 8781, datë 03.05.2001.
- Kodi i Familjes, miratuar me ligjin Nr. 9062, datë 08.05.2003.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, , ndryshuar me Ligjin nr. 8204, datë 10.04.1997, ndryshuar me Ligjin nr. 8279, datë 15.01.1998, ndryshuar me Ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001, ndryshuar me Ligjin nr. 9017, datë 06.03.2003, ndryshuar me Ligjin nr. 9086, datë 19.06.2003, ndryshuar me Ligjin nr. 9188, datë 12.02.2004, ndryshuar me Ligjin nr. 9275, datë 16.09.2004, ndryshuar me Ligjin nr. 9686, datë 26.02.2007, ndryshuar me Ligjin nr. 9859, datë 21.01.2008, ndryshuar me Ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008.
- Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998 "për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2009.
- Kodi i Procedurës Penale, (miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, me ligjin nr. 7905, datë 21. 03. 1995, i ndryshuar me ligjin nr. 7977, datë 26.07.1995, ligjin nr. 8460, datë 11.02.1999, ligjin nr. 9085, datë 19.06.2003, ligjin nr. 9187, datë 12.02.2004, ligjin nr. 9276, datë 16.09.2004, ligjin nr. 9911, datë 05.05.2008.
- Ligji nr. 10 192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë",
- Urdhëri i Ministrit të Drejtësisë nr. 3851, datë 08.05.2009 " Për miratimin e Kodit të Etikës të Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë dhe Privat".
- Udhëzimi nr. 1240/4, datë 15.09.2009, i Ministrit të Drejtësisë dhe Financave "Për caktimin e tarifave (çmimeve) për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat dhe shtetëror".
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 335, date 28.12.1998 "Mbi procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin Buxhetin e Shtetit".
- Ligji nr. 10031 datë 11.12.2008, "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat".

Masat legjislative afatshkurtra

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Përmirësimi i Ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor" .

Masat zbatuese afatshkurtra

- Aplikimi i sistemit të kontrollit, për një vlerësim konkret në ecurinë dhe efektivitetin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, nga zyrat përmbarimore;

- Gjenerimi on-line të statistikave, raporteve të caktuara për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror dhe Privat;
- Implementimi i sistemit qëndror elektronik për trajtimin dhe menaxhimin e çështjeve përmbarimore, së bashku me ngritjen e infrastrukturës së nevojshme në zbatim të këtij sistemi;
- Përmirësimi i infrastrukturës nëpërmjet rikonstruksionit dhe përshtatjes së ambienteve si dhe blerjes së mjeteve logjistike të nevojshme në funksion të detyrës për zyrat përmbarimore;
- Realizimi i trajnimit vazhdues, për periudhën 2012 e në vazhdim, të përmbaruesve gjyqësorë dhe trajnimi i stafit të IT-së që do të menaxhojë sistemin.

Masat legjislative afatmesme

- Aplikimi i Ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor" dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të tij .

Masat zbatuese afatmesme

- Aplikimi i sistemit të kontrollit, për një vlerësim konkret në ecurinë dhe efektivitetin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, nga zyrat përmbarimore;
- Përmirësimi i infrastrukturës nëpërmjet rikonstruksionit dhe përshtatjes së ambienteve si dhe blerjes së mjeteve logjistike të nevojshme në funksion të detyrës për zyrat përmbarimore;
- Realizimi i trajnimit vazhdues (2013-2015), për përmbaruesit gjyqësorë.

1.2.1.3. SHËRBIMI I PROVËS

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Shërbimi i Provës është organ shtetëror në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i krijuar në bazë të Ligjit nr.8331, datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar me ligjin Nr.10 024, datë 27.11.2008.

Institucioni i Shërbimit të Provës në Shqipëri ka filluar të funksionojë në muajin Qershor 2009, ku në bazë të Urdhrit të Kryeministrit Nr.67, datë 06.05.2009, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës", ky shërbim kishte vetëm 4 zyra vendore pranë gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë, Shkodër, Durrës dhe Fier, të cilat e shtrinin juridiksionin e tyre në të gjithë territorin e RSH-së. Numri i specialisteve për këto 4 zyra ishte 30.

Ndërkohë që në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 01.07.2010 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës", u bë i mundur krijimi i 4 (katër) zyrave të reja vendore të Shërbimit të Provës, me vendndodhje pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore

Lezhë, Elbasan, Korçë dhe Gjirokastër, me qëllim uljen e ngarkesës së punës së zyrave ekzistuese dhe rritjen e efikasitetit të tyre, por edhe me hapjen e këtyre zyrave të reja vendore, nuk u rrit numri i specialisteve (pasi u krye vetëm një ristrukturim i zyrave pa shtuar numrin e specialisteve në to). Tashmë funksionojnë tetë zyra vendore me qendër në Tiranë, Shkodër, Durrës, Fier, Lezhe, Gjirokastër, Korçë, dhe Elbasan me të njëjtin numër të pandryshueshëm specialistësh.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin Nr.10 023, datë 27.11.2008;
- Ligjit nr.8331, datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar me ligjin Nr.10 024, datë 27.11.2008;
- Rregullorja "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe proçedurave për mbikqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative" të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 25.03.2009,;
- Urdhër i Kryeministrit Nr. 2, datë 11.01.2012 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës";
- Urdhëri nr. 7746/1, datë 24/09/2010 i Ministrit të Drejtësisë "Për përcaktimin e vendndodhjes dhe kompetencave tokësore të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës", si dhe akteve të tjera nënligjore.

Masat legjislative afatshkurtra

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Ndryshimi i Urdhërit të Kryeministrit nr. 2, datë 11.01.2012 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës", për krijimin e 10 Zyrave të reja Vendore të Shërbimit të Provës pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore ku ende nuk ka të tilla;
- Hartimi i Projektvendimit të Këshillit të Ministrave "Për kriteret, të drejtat dhe detyrimet që duhet të plotësojë organi që realizon ME-në, si dhe rregullat për përzgjedhjen e tij";
- Hartimi i Urdherit të Ministrit të Drejtësië "Për metodologjinë dhe rregullat e ushtrimit të kontrolleve të Shërbimit të Provës mbi mënyrën e realizimit të ME-së, periodicitetit dhe përmbajtja e informacionit të përcjellë Ministrisë së Drejtësisë, si dhe rregullat për paraqitjen e të dhënave të përditësuara pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit";
- Hartimi i Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për kriteret e dhënies së autorizimeve nga Shërbimi i Provës";

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Hapja e 4 zyrave të reja të Shërbimit të Provës;
- Krijimi i Regjistrit Elektronik;

- Mbledhja, sistemimi, kategorizimi dhe përpunimi i të dhënave të dënuarve me dënime alternative të Zyrave Vendore të Shërbimit te Provës;
- Hedhja e informacionit të nevojshëm në regjistër;
- Trajnimi i specialistëve të Zyrave Vendore mbi mënyrën e përdorimit të këtij regjistri;
- Përditësimi i të dhënave nga specialistët përgjegjës;
- Aplikimi i dënimeve alternative nëpërmjet Mbiqyrjes Elektronike si projekt pilot në Tiranë;
- Analizimi dhe identifikimi i masave konkrete që duhen ndërmarrë në bazë të dokumentit teknik për nevojën e rritjes së numrit të specialistëve të Shërbimit të Provës, të propozuar nga projekti i binjakëzimit, me qëllim forcimin e kapaciteteve të Shërbimit të Provës për të menaxhuar ngarkesën e punës (Buxheti dhe burimet njerëzore).

Masat legjislative afatmesme

- Nuk është parashikuar.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Ndërrmarja e masave organizative për krijimin e 10 Zyrave të reja Vendore të Shërbimit të Provës;
- Sigurimi i ambienteve të përshtatshme për Zyrat Vendore egzistuese të Shërbimit të Provës dhe sidomos të Zyrave të reja Vendore që do të krijohen në të ardhmen;
- Pajisja e Zyrave të reja Vendore të Shërbimit të Provës me infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme (kompjutera, fotokopje, printera etj.) për të ushtruar funksionet e tyre normalisht;
- Krijimi i strukturave të reja organike të zyrave të reja vendore, si dhe ndryshimi i strukturave organike të zyrave vendore aktuale;
- Në bashkëpunim me Këshillin e Europës, Misionin e OSBE-së në Tiranë dhe Misionin Euralius, do të kryhen një seri trajnimesh, të cilët do të synojnë trajnimin e vazhdueshëm i stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe atij të zyrave vendore, me qëllim kryerjen me efikasitet dhe profesionalizëm të detyrave funksionale. Projekti i binjakëzimit IPA 2009, nr. i projektit AL 09 IB JH 01 – nr. i kontratës 2010/259-265;
- Krijimi i database-it që do të përmbajë informacionin e nevojshëm mbi trajnimet e kryera deri me sot nga të gjithë punonjësit e Shërbimit të Provës.
- Rikonstruksioni i godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës;
- Zbatim në vijimësi i Projektit të Binjakëzimit me Mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar për Shërbimin e Provës dhe alternativat ndaj dënimit me burg (me fonde të akorduara nga BE);
- Rritja e aplikimit të dënimeve alternative ndaj burgimit për të miturit;
- Zgjerimi i rangut të shërbimeve që ofron Shërbimi i Provës në lidhje me zbatimin e sanksioneve alternative ndaj burgimit dhe masave në komunitet për të miturit, duke nënshkruar memorandume bashkëpunimi me OJF-të dhe njësitë e Pushtetit Vendor;
- Forcimi i zbatimit të masave alternative të dënimit për të miturit që kanë shkelur ligjin.

1.2.2. TË DREJTAT EKONOMIKE DHE SOCIALE

1.2.2.1. MBROJTA SOCIALE

Situata aktuale

Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale 2008-2013 u hartua në harmoni të plotë me objektivat e strategjive të tjera ndërsektoriale si strategjia për të drejtat e fëmijëve, strategjia për personat me aftësi të kufizuara, strategjia e romëve, strategjia për barazine gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje, strategjia për moshën e tretë, etj., dencentralizimin dhe rritjen e kompetencave të qeverisjes vendore, për të përafruar sistemin shqiptar të mbrojtjes sociale me standardet e Kartës Sociale Evropiane të Rishikuar, legjislacionit social dhe dokumentave të tjerë të BE-së.

Me ndryshimet që iu bënë ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore", i ndryshuar u zgjerua kategoria e përfituesve të ndihmës ekonomike (viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës në familje, jetimët), mbështetje ekonomike për rastet kur fëmijët nuk kanë prindër apo njërin prej tyre, rastet kur kryefamiljare është gruaja, gjithashtu zgjerohet gama e shërbimeve për fëmijët duke garantuar shërbimin e kujdestarisë.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me mbështetjen e UNDP është duke punuar për përshtatjen e legjislacionit me detyrimet që burojnë nga Konventa.
Në kuadër të plotësimit të procesit të decentralizimit të institucioneve të përkujdesit shoqëror në vartësi të qeverisjes vendore, janë marrë masat për delegimin e fondeve si grante të kushtëzuara që në fillim të vitit në 2012 bashkitë përkatëse me destinacion institucionet e përkujdesit shoqëror për kategoritë në nevojë.

Aktualisht rezultojnë të licensuara rreth 130 subjekte që ofrojnë shërbime sociale. Licencimi shoqërohet me një vlerësim nga Inspektoriati i Shërbimeve Shoqërore, i cili zhvillohet në terren dhe ka si komponentë elemente të standardeve për grupe të veçanta përfituesish, si: numri i përfituesve, lloji i shërbimeve, kushtet e përgjithshme të institucionit, siguria e përfituesve dhe mbrojtja nga dhuna dhe abuzimi, ushqimi, veshja, numri i punonjësve, sa prej tyre profesionistë, etj. Ky dokument është shumë i rëndësishëm për vendim-marrjen.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar Fletorja Zyrtare: Viti 2005, Nr 22, Faqe 829; Data e botimit: 13-04-2005;
- Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbrit" Fletorja Zyrtare: Viti 1996, Nr 13, Faqe 569; Data e botimit: 07-05-1996;
- Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" Fletorja Zyrtare: Viti 2000, Nr 20, Faqe 939; Data e botimit: 18-07-2000;
- Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit të punës" , i ndryshuar Fletorja Zyrtare: Viti 1994, Nr 19, Faqe 882; Data e botimit: 10-01-1995;
- Ligj nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit", i ndryshuar Fletorja Zyrtare: Viti 1996, Nr 27, Faqe 923; Data e botimit: 12-12-1996.

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në garantimin e sigurisë sociale janë Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe institucionet e varësisë së saj.

Funksionet politikëbërëse realizohen nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale përbëhet nga 3 sektorë: Sektori i planifikimit të Ndihmës Ekonomike, Sektori i Politikave të Mbrojtjes Shoqërore dhe Sektori i Politikave të Sigurimeve Shoqërore.

Kjo drejtori është përgjegjëse për formulimin dhe zhvillimin e politikave, legjislacionit dhe strategjive për mbështetjen e inidividëve, familjeve, grupeve dhe komuniteteve në nevojë me pagesa në kesh dhe shërbime shoqërore në nivel komunitar me qëllim parandalimin e diskriminimit dhe përjashtimit social, duke nxitur rehabilitimin, integrimin dhe përfshirjen e tyre në jetën shoqërore, si edhe mbrojtjen nga skema e sigurimeve shoqërore.

Shërbimi Social Shtetëror është institucion në varësi të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i cili ka si mision ekzekutimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin. Drejtori i Përgjithshëm i këtij institucioni, propozohet nga Ministri i Punës dhe emërohet nga Kryeministri. Organi më i lartë drejtues për këtë institucion është Këshilli Administrativ.

Në nivel rajonal funksionojnë 12 zyra rajonale në nivel qarku. Zyrat rajonale e zhvillojnë aktivitetin e tyre në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore që veprojnë në nivel rajonal, me institucionet e qeverisjes vendore, sektorin privat, OJF-të dhe operatorë të tjerë.
Zyrat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në përputhje me legjislacionin në fuqi, koordinojnë, kontrollojnë zbatimin e legjislacionit për ndihmën dhe shërbimet shoqërore në: 64 Bashki, 11 minibashki (në Tiranë) dhe 308 komuna të vendit.

Masat legjislative afatshkurtra

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Projektligj ”Për disa ndryshime në ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 ‘Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”i ndryshuar.
- Projektligj “Për ndërmarrjet Sociale”
- Projektligj “Për statusin e punonjësit social”
- Projektligj “Për moshimin”.
- Projekt VKM “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot”.
- Projekt VKM “Për reformimin e shërbimeve sociale”. Dokument analitik për reformimin e shërbimeve sociale. Projekt VKM “Për përcaktimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror”.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Tryeza të rrumbullakta për diskutimin e projekakteve me antarët e grupit të punës dhe shoqërinë civile;
- Konferenca dhe workshope për ditën ndërkombëtare të moshës së tretë, personave me aftësi të kufizuar, fëmijëve, etj.
- Implementimi i standardeve të fëmijëve, standardeve për PAK, për të moshuarit në institucionet publike dhe jopublike dhe për personat e trafikuar dhe viktimat e trafikimit, si edhe viktimat e dhunës në familje;
- Licencimin e te gjitha shoqatave që ofrojnë shërbime sociale në përputhje me kriteret e reja të miratuara nga qeveria të cilat garantojnë identifikimin e OJF-ve dhe operatoreve të tjerë që ofrojnë shërbime sociale, vlerësimin e kapaciteteve te tyre.
- Organizimin e tavolinave të rrumbullakëta dhe trajnimeve.

Masat legjislative afatmesme

Masat legjislative afatmesme janë si vijon:

- Projekt VKM "Përberja, procedurat e përzgjedhjes së anetarëve të Komisionit të Vlerësimit të Aftësisë së kufizuar dhe Komisionit Epror.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Uljen e varfërisë, nëpërmjet rritjes së efektivitetit të përdorimit të fondeve të ndihmës ekonomike;
- Ndjekja e objektivave të Planit të Veprimit për detyrimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Rritja e kompetencave të pushtetit vendor dhe shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve shoqërore në komunitet;
- De-institucionalizimi dhe rritja e përgjegjësive të pushtetit vendor për ndihmën ekonomike, aftësinë e kufizuar dhe realizimin e shërbimeve shoqërore, rritjen e llojshmërisë dhe zgjerimin e gjeografisë së shërbimeve;
- Licencimi i ofruesve të shërbimeve;
- Inspektimi i shërbimeve të ofruara;
- Rritja e kapaciteteve të operatorëve që ofrojnë shërbime;
- Institucionalizimin e marrëdhënieve me OJF-të, përfshirjen e shoqërisë civile dhe operatorëve privat për ofrimin e shërbimeve shoqërore në komunitet.

1.2.3. TË DREJTAT E MINORITETEVE DHE MBROJTJA E MINORITETEVE

Situata aktuale

Shqipëria ka pasur dhe vazhdon të ketë një angazhim të përhershëm, përsa i përket përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pjesë përbërëse e të cilave janë dhe të drejtat e minoriteteve. Këtë fakt e ka dëshmuar gjithashtu anëtarësimi i vendit tonë në organizatat ndërkombëtare, si Organizata e Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Evropës, OSBE, etj, si dhe

ratifikimi apo aderimi në një sërë konventash ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe në mënyrë të veçantë, në ratifikimin pa asnjë rezervë të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës "Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare".

Në kuadër të OKB-së, Republika e Shqipërisë është palë në instrumentet më të rëndësishme për të drejtat e njeriut si vijon:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, (aderuar më 1955);
- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike ICCPR, (aderuar me ligjin nr. 7510, datë 8.8.1991);
  - Protokolli Opsional i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (aderuar me ligjin nr. 9725, datë 7.05.2007);
  - Protokolli i Dytë Shtesë i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike mbi heqjen e dënimit me vdekje (aderuar me ligjin nr. 9726, datë 7.5.2007);
- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (aderuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial-ICERD, (aderuar më 1994);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave- CEDAË (aderuar me ligjin nr. 7767, datë, 09.11.1993);
- Protokolli Shtesë i Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (ratifikuar me ligjin nr. 9052 datë 17.4.2003);
- Konventa kundër Torturës, Trajtimeve të Egra Çnjerëzore dhe Degraduese (aderuar me ligjin nr. 7727, datë 30.06.1993);
- Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës, Trajtimeve të Egra Çnjerëzore dhe Degraduese –OPCAT (ratifikuar 2003);
- Konventa mbi të drejtat e fëmijëve (ratifikuar me ligjin nr. 7531 datë 11.12.1991).
- Protokolli Opsional "Mbi shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin me Fëmijët dhe Pornografinë" (aderuar me ligjin nr. 9834, datë 22.11.2007);
- Protokolli Opsional "Mbi Përfshirjen e Fëmijëve në Konfliktet e Armatosura (aderuar me ligjin nr. 9833, datë 21.12.2007;
- Konventa, "Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre" (aderuar me ligjin nr. 9703, datë 02.07.2007);
- Nënshkrimi i Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar. (Shqipëria e ka nënshkruar këtë Konventë në datën 22 dhjetor dhe aktualisht po ndiqen procedurat e brendshme për ratifikimin dhe hyrjen në fuqi të saj);
- Në kuadër të Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Evropian, janë nënshkruar të gjitha dokumentet e saj, si:
- Akti Final i Konferencës së Helsinkit, 1975.
- Deklarata e Kopenhagenit, 1990.
- Karta e Parisit për një Evropë të re, 1990.
- Dokumenti i Konferencës së Moskës, 1991.

Në kuadër të Këshillit të Evropës, janë nënshkruar dhe ratifikuar një numër të konsiderueshëm dokumentesh të rëndësishme:

- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, (nënshkruar nga Republika e Shqipërisë më ratifikuar me Ligjin 8137, datë 31.07.1996 dhe hyrë në fuqi më 1996) dhe Protokollet 1, 2, 4, 6, 7, 11, 13,14;
- Konventa Kuadër "Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare" është nënshkruar nga Republika e Shqipërisë më 29.06.1995, ratifikuar me Ligjin 8496, datë 3.06.1999, dhe ka hyrë në fuqi me 01.01 2000;
- Konventa Evropiane për Televizionin Ndërkufitar 1999 (ratifikuar me Ligjin Nr. 8525, datë 9.9.1999).
- "Marrëveshja e Pjesshme e Zgjeruar e Qendrës Evropiane të Gjuhëve Moderne" në Grac të Austrisë (ratifikuar me Ligjin Nr. 8706, datë 01.12.2000);
- Karta Evropiane Sociale të Rishikuar, (nënshkruar nga Shqipëria në 1998, ratifikuar më 2002, hyrë në fuqi më 1 Janar 2003);
- Konventa mbi Shtetësinë (nënshkruar nga Shqipëria në vitin 1999, ratifikuar më 11.2.2004 dhe ka hyrë në fuqi 1.06 2004);
- Konventa Evropiane "Për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në nivel Lokal (nënshkruar 9.6.2004, ratifikuar më 19.7.2005 dhe hyrë në fuqi 1.11 2005);
- Protokolli shtesë i Konventës mbi krimin kibernetik, lidhur me penalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobe nëpërmjet sistemeve kompjuterike" (nënshkruar nga Shqipëria më 26.5.2003, ratifikuar më 26.11.2004 dhe ka hyrë në fuqi më 1.3.2006).

Në kuadër të UNESCO-s:

- Konventa "Për Mbrojtjen dhe Nxitjen e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore", ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në Shtator 2006.

Gjithashtu, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të minoriteve, Sektori i Kulturës së Minoriteteve dhe Diasporës i ngritur tashmë prej më se dy vjetësh në Ministrinë e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, ka si objektiv të ndikojë në krijimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të hapësirave ligjore dhe strategjive sektoriale në fushën e kulturës së diasporës dhe minoriteteve dhe përafrimin e tyre në përputhje me standardet i BE. Një ndër objektivat bazë të këtij sektori përgjatë viteve 2010- 2011, ishte dhe u kurorëzua me sukses krijimi i një databaze me të dhëna mbi forumet, shoqatat dhe individët më të spikatur në komunitetet e diasporës dhe minoriteteve dhe përvijimi i një klime të përshtatshme për lulëzimin e nismave individuale dhe grupimeve të ndryshme të diasporës dhe minoriteteve për jetësimin e ideve dhe projekteve kulturore që ndikojnë në evidentimin e vlerave kulturore dhe kombëtare të shqiptarëve që jetojnë në vendet e huaja dhe pakicave të kombësive të huaja që jetojnë në vendin tonë.

Zbatimi dhe respektimi i parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare, filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë ose me çdo shkak tjetër, që nga viti 2010 garantohet nga Komisioneri për Mrojtjen nga Diskriminimi, i cili është konsideruar si një arritje për Shqipërinë në aspektin e politikave anti-diskriminim.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të minoriteteve garantohet nga Kushtetuta dhe legjislacioni aktual. Në këtë kuadër vlerësojmë se Konventa Kuadër "Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare", e cila pas ratifikimit është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe ka forcën e ligjit, është një garanci për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri.

Kuadri ligjor aktual i cili garanton respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 8417, datë 28.10.1998, ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007, ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008,
- "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"(miratuar me Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999), në të cilin theksohet se në marrëdhëniet me personat privatë, administrata publike drejtohet nga parimi i barazisë në kuptimin që askush nuk duhet të privilegjohet apo diskriminohet për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore;
- "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" (miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995) me ndryshimet përkatëse. Në këtë Kod një vend të rëndësishëm zë eliminimi i çdo lloj forme paragjykimi apo diskriminimi ndaj minoriteteve dhe mbrojtja e pjesëtarëve të minoriteteve që jetojnë në Shqipëri, si dhe denoncimi i akteve diskriminuese ndaj tyre (një sërë dispozitash që dënojnë "shkeljen e barazisë së shtetasve", "nxitjen e urrejtjes dhe e grindjeve raciale, nacionale ose fetare, "krimin e gjenocidit" etj.
  Gjithashtu në ligjin nr. 9686 datë 26.02.2007 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995 "Kodi Penal i RSH-së të ndryshuar", (neni 6) është përcaktuar "Parashikimi si figurë krimi të veçantë në Kodin Penal i krimeve për motive racore apo për motive të tjera diskriminuese dhe konsiderimi si rrethanë rënduese i motivit të diskriminimit si motiv për kryerjen e krimit";
- Me ligjin nr. 10023/2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.*7895/1995"Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar"*, janë parashikuar disa vepra të reja penale në lidhje me racizimin dhe diskriminimin në sistemet komjuterike: në nenet 11, 12 dhe 13 të ligjit të sipërcituar, janë trajtuar si vepra penale ato sjellje si : *shpërndarjes së materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik* dhe *fyerjes për motive raciste dhe ksenofobike* që i referohen shpërndarjes kompjuterike të materialeve që kanë të bëjnë me genocidin, krimeve kundër njerëzimit, racizmin dhe ksenofobinë;
- "Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë", (miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996-me ndryshimet përkatëse), i cili parashikon përdorimin e gjuhës amtare për personat që nuk dinë shqip gjatë gjithë fazave të gjykimit dhe marrjen dijeni për provat dhe për gjithë zhvillimin e gjykimit me anë të përkthyesit;
- Ligji nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", ndryshuar me Ligjin Nr. 8387, datë 30.07.1998, "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar". Mbështetur në këtë ligj, personat që u përkasin minoriteteve kombëtare u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen

në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre brenda kuadrit të planeve dhe programeve mësimore;

- Ligji nr. 8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH-së". Ky ligj garanton të drejtën e arsimit dhe formimit profesional pa asnjë lloj diskriminimi edhe për shkak të përkatësisë etnike;
- Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë (miratuar me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, i ndryshuar me ligjin nr. 9832, datë 12.11.2007, ligjin 10307 date 22.7.2010 dhe ligjin 10493 date 15.12.2011). Ky ligj garanton mundësitë për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë të gjithë jetës, pa asnjë lloj diskriminimi përfshirë edhe përkatësinë etnike;
- Ligji nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë", i cili garanton akses të minoriteteve në gjuhën e tyre amtare, si në median e shkruar, ashtu edhe në atë elektronike;
- Ligji nr. 8454, datë 4.02.1999,"Për Avokatin e Popullit" i plotësuar me ligjin nr. 8600 datë 10.04.2000, (Fletore Zyrtare Nr. 9, Faqe 423) ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005 Garanci për mbrojtjen e të drejtave të ligjshme të personave që u përkasin minoriteteve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj është edhe institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues dhe i pavarur;
- Ligji nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike", garanton të drejtën e tyre kushtetuese, me qëllim pjesëmarrjen e minoriteteve në jetën publike;
- Ligji nr. 8773, datë 23.04.2001 "Për tubimet". Ky ligj garanton të drejtën për tubime publike për të gjithë shtetasit, pa asnjë dallim për shkak të seksit, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit, etnisë, gjendjes ekonomike e financiare, arsimore e sociale, të bindjeve politike, përkatësisë prindërore ose të çdo lloj rrethanë tjetër vetjake;
- Ligji nr. 8291, datë 25.2.1998 "Kodi i Etikës së Policisë", parashikon edhe procedurat e ankimit për raste të diskriminimit në polici, duke parashikuar përgjegjësinë e forcave të policisë për veprime të kundërligjshme;
- Ligji nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit" Ky ligj i cili ka si qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të punonjësve të Policisë, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, parashikon se Punonjësi i Policisë duhet t'i trajtojë personat në mënyrë të barabartë dhe duhet t'i kryejë detyrat pa asnjë lloj diskriminimi përfshirë edhe përkatësinë etnike;
- Ligji nr. 9888, datë 10.03.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim" Ky ligj, i cili ka si objekt mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, përcakton se trajtimi i të dënuarve nuk duhet të ketë diskriminim edhe për shkak të përkatësisë etnike;
- Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" . Në këtë ligj në të cilin përcaktohen rregullat për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, parashikon rregulla të veçanta për të dhënat personale të personit fizik që kanë të bëjë me origjinën e tij racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimin penal, si edhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale;
- Ligji nr. 10019, datë 29.12.2009, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008. Ky Kod i cili ka si qëllim caktimin e

rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve, garanton pjesëmarrjen e të gjithë shtetasve përfshirë edhe personat që u përkasin minoriteteve në procesin zgjedhor;

- Ligji nr. 10221, datë 4.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare, filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore,shtatzëninë, përkatësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë ose me çdo shkak tjetër;
- Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi', botuar në Fletoren Zyrtare nr.15, datë 25 shkurt 2010, fq. 482, përafruar plotësisht me:

- Direktivën e Këshillit Europian 2000/43/KE e 29 qershorit 2000 për *"Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike";*
- Direktivën e Këshillit Europian 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për *"Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës";*
- Direktivën e Këshillit Europian 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për *"Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime";*
- Direktivën e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Europian 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për *"Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës";*
- Ligji nr.9616 dt 27.09.2006, për "Librin në Republiken e Shqipërisë";
- VKM 633 e datës 18/09/2003 për "Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom në Shqipëri";

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 22. 08. 1994 "Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Minoriteteve", parashikon krijimin e kushteve të nevojshme për shprehjen, ruajtjen e zhvillimin e arsimit, si dhe identitetit gjuhësor kulturor të personave që iu përkasin minoriteteve;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 5.8.1996 "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 22.08.1994 "Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Minoriteteve", përcakton rregulla mbi funksionimin e njësive të shkollimit në gjuhën amtare pranë shkollave tetëvjeçare mbi bazën e kërkesave duke respektuar, kriteret përkatëse;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.02.2010, "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore te sistemit të arsimit parauniversitar" ku parashikohet pajisja falas me tekste shkollore të fëmijëve të pakicave kombëtare;
- V.K.M nr. 404, datë 01.07.1998 mbi funksionimin e Shkollës private 9-vjeçare dhe e mesme, "Arsakeio" në Tiranë;
- V.K.M nr. 868, datë 30.09.2004 "Për funksionimin e Institucionit Arsimor Jopublik parauniversitar për shkollën 9-vjeçare "Omiros";
- V.K.M nr. 266, datë 05.05.2006, Për hapjen e Institucionit arsimor privat parauniversitar, shkolla 9 vjeçare "Omiros", në qytetin e Himarës e cila zhvillon mësim edhe në gjuhën greke;

- V.K.M nr. 633, datë 18.09.2003 për miratimin e Strategjisë Kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom";
- V.K.M nr. 127, datë 11.03.2004 "Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet".
- VKM nr. 508, datë 8.08.2007 "Për një ndryshim dhe shtesë në VKM nr. 632, datë 18.09.2003 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, femra", ku punësimi i personave që i përkasin minoritetit rom, përbën një ndër objektivat e Strategjisë Kombëtare për Minoritetin rom;
- VKM nr. 437, datë 8.04.2008 "Për anëtarësimin e Këshillit të Ministrave të RSH-së në Deklaratën "Dekada e Romëve";
- VKM nr. 366, datë 15.04.2009 Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë. Në bazë të këtij Vendimi, personat që i përkasin minoritetit rom, kompensohen për çmimin e letërnjoftimit (kartës së identitetit) duke përfituar falas këtë dokument;
- VKM nr. 1087 datë 28 .10.2009 "Për miratimin e Planit Kombëtar të veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2005-2015";
- Vendim nr 33, datë 22.04.2010 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi";
- Vendim nr. 34, datë 20.05.2010 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi", botuar në Fletoren Zyrtare nr.68, datë 1 qershor 2010; fq. 2581;
- Udhëzimi nr. 14, datë 03.09.1994 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përcakton kriteret e hapjes dhe të funksionimit të njësive të shkollimit të personave të minoriteteve Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004 – 2015, të miratuar me V.K.M nr. 538, datë 12.08.2004 dhe Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë (2008-2013), garantojnë arsimimi i të gjitha shtresave të shoqërisë shqiptare;
- Urdhri nr. 10 datë 21.12.2010, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së KMD";
- Urdhri nr. 11 datë 21.12.2010, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi " Për miratimin e Kodit të Etikës së Institucionit".

Struktura institucionale

Në hartimin dhe zbatimin e politikave për minoritetet Shqipëria mbështetet në detyrimet që dalin nga Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare e Këshillit të Evropës. Strukturat që janë të angazhuara me mbrojtjen e minoriteteve dhe zbatimin e strategjisë kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës të minoritetit Rom" janë:

Komiteti Shteteror i Minoriteteve:
Komiteti Shtetëror i Minoriteteve është krijuar si institucion qendror në varësi të Kryeministrit me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 127 dt. 11.03.2004 "Për krijimin e Komitetit Shtetëror per Minoritetet", i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 28.12.2005.

Komiteti Shtetëror i Minoriteteve ushtron kompetencat e tij nëpërmjet vendimmarrjes me shumicën e votave të anëtarëve të tij. Komiteti perbehet nga kryetari dhe pese anetare nje per cdo minoritet te njohur zyrtarisht nga shteti shqiptar.

Në bazë të vendimit të krijimit, Komiteti ka të drejtë t'i propozojë organeve shtetërore të kenë parasysh çështje të rëndësisë së veçantë për minoritetet, veçanërisht përsa i takon zbatimit të detyrimeve kushtetuese, si dhe të akteve të tjera të veçanta që rregullojnë të drejtat dhe liritë e personave që u përkasin këtyre minoriteteve, gjithashtu ka te drejte t'i propozojë organeve të pushtetit, qendror dhe vendor masat e mundshme dhe konkrete për përmirësimin e gjendjes së personave që u përkasin minoriteteve kudo që janë. Komiteti ka të drejte të japë mendime dhe të propozojë masa për zhvillimin ekonomik, shoqëror, kulturor e arsimor, si dhe të nxisë transmetimin e programeve për minoritetet në median publike. Ka të drejtë të kërkojë ose të marrë prej organeve qendrore dhe të qeverisjes vendore të dhëna dhe raporte, që kanë të bëjnë me çështjet për minoritetet, gjithashtu mund të thërasë dhe të kërkojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organeve qendrore ose të atyre të qeverisjes vendore për çështje që janë në përgjegjësinë e Komitetit Shtetëror të Minoriteteve.

Sektori i të Drejtave të Njeriut, **Minoriteteve dhe Raportimeve në Drejtorinë e Organizatave Ndërkombëtare**, Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Sigurisë dhe Organizatave Ndërkombëtare, në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Sektori i të Drejtave të Njeriut, Minoriteteve dhe Raportimeve ndjek përmbushjen e angazhimeve dhe detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e të drejtave të minoriteteve, si dhe në bashkëpunim me institucionet e linjës do të ndjekë në vazhdimësi çështjet e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve dhe koordinimin dhe zbatimin e politikave mbi minoritetet. Gjithashtu ky sektor ka si objektiv të mbajë dhe të zhvillojë dialogun zyrtar me përfaqësuesit e shoqatave të minoriteteve, të nxisë dhe të mbështesë veprimtarinë dhe aktivitetet e shoqatave të tyre, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre gjuhësor, kulturor, fetar dhe kombëtar.

Sekretariati Teknik për Romët, në Drejtorinë e Monitorimit të Strategjive Ndërsektoriale, në Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i cili ka për detyrë:

- Monitorimin e zbatimit të objektivave dhe masave prioritare të përcaktuara në këtë strategji, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, Ministrinë e Financave dhe donatorë të ndryshëm për sigurimin e fondeve të nevojshme për realizimin e objektivave të kësaj strategjie.
- Nxitjen dhe ndërgjegjësimin e institucioneve, strukturave rajonale dhe pushtetit vendor për t'u përfshirë në zbatimin e strategjisë së komunitetit rom.
- Vendosjen dhe mbajtjen e kontakteve me ministritë e linjës dhe institucionet përgjegjëse të përfshira në zbatimin e strategjisë.
- Vendosjen e bashkëpunimit me shoqatat e komunitetit rom dhe OJF-të e ndryshme që veprojnë në fushën e minoriteteve për zbatimin e strategjisë.
- Bashkëpunimi me donatorë dhe OJF-të për fuqizimin e kapaciteteve të sektorit dhe të institucioneve në nivel qendror, rajonal dhe lokal për zbatimin e strategjisë.

Sektori i Kulturës së Diasporës dhe Minoriteteve pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Sektori i Diasporës dhe Minoriteteve i krijuar për mëse dy vjetësh pranë

Drejtorisë së Librit dhe Bibliotekave në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve së bashku me Sektorin e Kulturës së Shkruar, koordinojnë punën dhe programet e përbashkëta me strukturat përgjegjëse të ministrive të linjës si edhe me strukturat homologe te vendeve të Rajonit, BE dhe ato Euroatlantike, për një përkujdesje më të veçantë dhe organizmit të shumë evenimenteve dhe projekteve të përbashkëta kulturore në ato vende ku ka edhe përqendrim të numrit të më të madh të shqiptarëve dhe njëkohësisht mbështet projekte specifike për promovimin e identitetit kulturor të individëve, grupimeve të ndryshme dhe shoqatat kulturore dhe artistike që përfaqësojnë kulturën e minoriteteve që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Drejtoria e Arsimit Fillor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës e cila mbulon edhe problemet e arsimimit të minoriteteve.
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, lidhur me çështjet e regjistrimit ne gjendjen civile.

INSTAT - Drejtoria e Statistikave Sociale, është përgjegjëse për prodhimin e statistikave të profilit social e demografik dhe veçanërisht për punën përgatitore dhe zbatimin e regjistrimit/censusit të përgjithshëm të popullsisë.

Drejtoria e Librit dhe e Bibliotekave me sektorin e kulturës së diasporës dhe minoriteteve pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Qëllimi i sektorit është përmirësimi i vazhdueshëm i hapësirave ligjore në fushën e diasporës dhe minoriteteve dhe përafrimi i tyre në përputhje me standardet e BE, ndërtimi i politikave të zhvillimit në fushën e diasporës dhe minoriteteve për të ruajtur dhe promovuar edhe më tej identitetin kombëtar të shqiptarëve që jetojnë e punojnë në vendet e huaja, si edhe në mbrojtjen e karakteristikave thelbësore që përbëjnë gjuhën dhe kulturën e komuniteteve të kombësive të huaja që jetojnë në Shqipëri

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili është i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ky autoritet është i krijuar me ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010, *"Për mbrojtjen nga diskriminimi"*. Bazuar në këtë ligj, Komisioneri është një një institucion publik qendror, i pavarur dhe në ushtrim të kompetencave ligjore i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit. Komisioneri zgjidhet për një mandat 5 vjecar me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.

Komisioneri, shqyrton ankesat për diskriminim të individëve apo organizatave që kanë interes të ligjshëm si dhe të kryen hetime administrative kur merr informacion të besueshëm. Komisioneri gjithashtu, monitoron zbatimin e ligjit, nxit parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe informimit duke pasur në vëmendje që të përdoret gjuha e pakicave të caktuara, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuar. Kompetencë e rëndësishme e Komisionerit, është kryerja e sondazheve në lidhje me diskriminimin. Roli këshillimor i Komisionerit është një tjetër kompetencë e rëndësishme që ky i fundit e ushtron nëpërmjet hartimit dhe publikimit të rekomandimeve/raporteve me qëllim përmirësimin/plotësimin e legjislacionit ekzistues apo për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin. Komisioneri gjithashtu, mund t'i drejtohet drejtpërdrejt opinionit

publik si dhe të zhvillojë dialogun e rregullt në lidhje me çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat jo qeveritare.

Komisioneri mund të japë mendimin e tij në lidhje me çdo çështje diskriminimi në gjykatë, kur i kërkohet nga kjo e fundit. Ai mund të përfaqësojë gjithashtu ankuesit që kanë paraqitur kërkesëpadi në gjykatë kur pretendojnë se janë diskriminuar. Komisioneri apo çdo oganizatë legjitime mund të paraqesin padi në gjykatë me kushtin që të jenë pajisur më parë me prokurë të posaçme në emër të një individi apo një grupi ose me anë të një deklarate para gjykatës.

Masat legjislative afatshkurtra

- Propozimi per disa shtesa dhe ndryshime e VKM nr 127 dt. 11.03.2004 ''Për Krijimin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet";
- Propozimi për ndryshimin e Vendimit nr. 34 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi".
- VKM për pagesën prej 20 mijë Eurosh të kootizacionit të përvitshëm që duhet të paguajë qeveria shqiptare si pjesë e iniciativës "Dekada e Përfshirjes së Romve"
- VKM për rezervimin e kuotave për studentët romë në institucionet e arsimit të lartë, në kuadër të Planit të Veprimit të "Dekadës së Përfshirjes së Romve".

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Fuqizimi i kapaciteteve administrative te Komitetit me specialiste dhe juriste te fushes perkatese, pergatitja e infrastruktures teknike dhe ligjore;
- Tryeza te rrumbullakta informuese per diskutimin me aktoret e interesuar ne lidhje me propozimet e masave ligjore afatshkurtra;
- Organizimi i eventit artistiko kulturor Ditet e Kultures se Minoriteteve;
- Organizimi i nje tavoline te rrumbullaket mbi zbatimin e Strategjise Kombetare per Romet;
- Realizimi i takimeve me organizatat minoritare me qellim konsultimin ne lidhje me problematikat e tyre;
- Organizimi i Konferences Kombetare per pjesemarrjen e minoriteteve ne jeten publike;
- Tavoline e rrumbullaket mbi nevojshmerine e nenshkrimit dhe ratifikimit te Kartes per gjuhet rajonale ose minoritare;
- Organizimi i tryezave te rrumbullaketa per ceshtjet e minoriteteve ne Shkoder, Korce dhe Sarande.
- Realizimi i një një studimi për të evidentuar nevojat për ndryshime në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimit";
- Rishikimi dhe ndërmarrja e ndryshimeve të nevojshme në strukturën organizative dhe organogramën e KMD;
- Zbatimi dhe monitotimi i Planit të Veprimit të Planit Strategjik 2012-2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Botimi i broshurave dhe katalogëve e manualeve per grupe specifike dhe sipas formave të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara;

- Zhvillimi i një spoti publicitar dhe transmetimi në TV;
- Pjesmarrje në emisione dhe debate televizive;
- Organizimi i ditëve të hapura dhe në rajone të ndryshme;
- Përmirësimi i infrastrukturës së institucionit me pajisjet e nevojshme kompjuterike dhe informatike;
- Trajnimi i stafit të zyrës me qëllim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të punonjësve;
- Trajtim efektiv, me profesionalizëm dhe në respektim të afateve ligjore të ankesave për diskriminim;
- Organizimi dhe pjesmarrja në konferenca, tryeza të rrumbullakta, seminare me institucione të tjera publike, OJF dhe organizma ndërkombëtarë;
- Organizimi i trainimeve me grupe të ndryshme profesionale si forcat e rendit, punonjësit e shëndetësisë, punonjësit e arsimit etj;
- Monitorim në fushën e arsimit parauniversitar i përqendruar tek diskriminimi për shkak të racës, gjendjes ekonomike dhe aftësisë së kufizuar;
- Monitorim në fushën e punësimit, në sektorin publik dhe privat, me fokus të veçantë tek aksesi i grupeve vulnerabël tek mundësitë e punësimit;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me INSTAT, Departamentin e Administratës Publike, Ministrinë e Brndshme, Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Avokatin e Popullit, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Ministrinë e Shëndetësisë;
- Nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me OJF;
- Vendosja e bashkepunimit me pushtetin vendor;
- Në bashkëpunim me Ministrinë Arsimit dhe Shkencës dhe me përfshirjen e aktorëve të tjerë nga bota akademike dhe shoqëria civile, KMD do të angazhohet në hartimine e një plani masash për ndërhyrjen në kurrikulat shkollore në kuadër të parashikimeve të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi";
- Në bashkëpunim me institucionet perkatese do të ndërmerren hapat e nevojshme për përfshirjen e KMD-së në rrjetin europian të institucioneve të barazisë EQUINET;
- Organizimi i tryezave të përbashkëta në 12 qarqet e vendit për ti njohur me përditësimin e strategjisë dhe Planin të Veprimit të "Dekadës së Përfshirjes së Romëve"e Strategjisë;
- Realizimi i ciklit të dytë të trainimeve në 10 Qarqet ku ka komunitet Rom për të bërë të mundur informatizimin për hedhjen e të dhënave në nivel lokal në fusha si arsimi, shëndetësia, strehimi dhe punësimi dhe më pas këto të dhëna do të përcillen në zyrën e Sekretariatit Teknik nëpërmjet një programi kompjuterik dhe një rrjeti të ngritur për këtë qëllim;
- Realizimin e projektit të UNDP-së në bashkëpunim me strukturat shtetërore në nivel qendror dhe lokal për realizimin e projektit tre vjeçar që përfundon në 2013 dhe partner kryesor është Sekretariati Teknik për Romët;
- Takimet dy herë në vit të Grupit Ndërministror për organizimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të Strategjisë Kombëtare për Romët dhe Planit të Veprimit të "Dekadës së Përfshirjes së Romve";
- "Dita e Kulturës së Minoriteteve"(një bashkëpunim i Komitetit Shtetëror të Minoriteteve, Ministrisë së Turizmit, Kulturës,Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrisë së

Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës Çështjeve sociale dhe Shanseve të Barabarta);

- "Dita e Minoritetit Rom", (një bashkëpunim i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta) i organizuar në funksion të evidentimit të vlerave kulturore të Minoritetit Rom në vendin tonë;
- "Dita e Tolerancës së Minoritetit Rom Herdelezi". Një aktivitet që ka për qëllim dhënien e shembujve pozitivë të tolerancës në radhët e minoritetit Rom në vendin tonë;
- Zbatimi i planit kombëtar të MASH për Braktisjen Zero 2010 – 2014;
- Zbatimi sistematik dhe i financuar i Projektit "Shansi i dytë" për fëmijët e grupeve etnike në nevojë dhe grupeve të margjinalizuara;
- Identifikimi i të gjithë fëmijëve romë, egjiptian dhe fëmijëve me aftësi të kufizuar në sistemin arsimor dhe jashtë tij dhe integrimi i tyre në sistem;
- Realizimi i veprimtarive edukative individuale për zhvillimin gjuhësor të fëmijëve romë, që hasin vështirësi në komunikimin në gjuhën shqipe, në kuadër të programit edukativ të kopshtit për të ndihmuar integrimin e tyre në sistemin e detyruar arsimor;
- Përfshirja me prioritet e fëmijëve 5-6 vjeçar të minoritetit Rom në kopshte dhe klasa përgatitore për mësimin e gjuhës shqipe për t'i përgatitur për klasën e parë;
- Sigurimi nga autoritetet lokale i shërbimit të transportit shkollor për nxënësit romë, që e kanë shkollën larg qendrës së banimit;
- Organizimi në nivel DAR/ZA dhe shkolle i aktiviteteve ndërkulturore me prindër dhe nxënës Rom dhe nxënës që vijnë nga popullsia maxhoritare , me qëllim rritjen e njohurive dhe mirëkuptimit midis fëmijëve;
- Përgatitja e dokumentacionit të standardizuar për mbështetjen e nxënësve me përparim të dobët dhe të nxënësve në rrezik braktisjeje;
- Përmbushja e angazhimeve që rrjedhin nga Konventa Kuadër për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të minoriteteve;
- Zbatimi i Strategjisë kombëtare për Romët, si pjesë e strategjisë së qeverisë për të luftuar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror;
- Zbatimi i angazhimeve të ndërmarra në kuadër të Iniciativës " Dekada e Përfshirjes së Romve" dhe monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit të "Dekadës së Përfshirjes së e Romve".

Masat legjislative afatmesme

- Nisma për ndryshime në ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Propozim i projekt marrëveshjeve bilaterale me shtetet e rajonit per mbrojtjen e ndersjellte te pakicave kombetare;

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Organizimi i Konferences Kombetare per ruajtjen dhe kultivimin e kultures dhe gjuhes se minoriteteve;
- Tryeze e rrumbullaket mbi rezultatet e monitorimit te Strategjise per Romet;

- Takim nderkombetar me institucionet homologe te rajonit per minoritetet me teme " Minoritetet dhe integrimi euro-atlantik";
- Organizimi i Konferences Kombetare per arsimimin ne gjuhen e minoriteteve;
- Projekte te perbashketa zhvillimi me organizatat minoritare dhe aktore te tjere
- Zbatimi dhe monitotimi i Planit Strategjik 2012-2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe promovimi i parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit;
- Botimi i broshurave dhe katalogëve e manualeve per grupe specifike, në gjuhën e minoriteteve dhe sipas formave të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.
- Pjesmarrje në emisione dhe debate televizive;
- Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe krijimi i një programi elektronik (softëare), për menaxhimin e ankesave dhe gjenerimin e dhenave statistikore dhe trajnimi i stafit të KMD për përdorimin e sistemit;
- Trajnimi i stafit të zyrës me qëllim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të punonjësve;
- Trajtim efektiv, me profesionalizëm dhe në respektim të afateve ligjore të ankesave për diskriminim;
- Organizimi dhe pjesmarrja në konferenca, tryeza të rrumbullakta, seminare me institucione të tjera publike, OJF dhe organizma ndërkombëtarë;
- Realizimi i sondazheve/anketave me tematika të ndryshme, në mënyrë periodike, për të evidentuar grupet me të prekura nga diskriminimi;
- Realizimi i monitorimeve në fusha dhe grupe të ngryshme të mbrojtura nga ligji, të identifikuara si më të prekura nga diskriminimi, për të adresuar më pas rekomandimet dhe rregullimet e nevojshme për eleminimin e situatave diskriminuese;
- Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional;
- Zhvillimi i rregullt i dialogut me shoqërinë civile;
- Zbatimi dhe monitotimi i Planit të Veprimit të Planit Strategjik 2012-2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Botimi i broshurave dhe katalogëve e manualeve per grupe specifike dhe sipas formave të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara;
- Pjesmarrje në emisione dhe debate televizive;
- Përmirësimi i infrastrukturës së institucionit me pajisjet e nevojshme kompjuterike dhe informatike;
- Trajnimi i stafit të zyrës me qëllim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të punonjësve;
- Trajtim efektiv, me profesionalizëm dhe në respektim të afateve ligjore të ankesave për diskriminim;
- Organizimi dhe pjesmarrja në konferenca, tryeza të rrumbullakta, seminare me institucione të tjera publike, OJF dhe organizma ndërkombëtarë;
- Në bashkëpunim me institucionet përkatëse do të ndërmerren hapat e nevojshme për përfshirjen e KMD-së në rrjetin europian të institucioneve të barazisë EQUINET;
- Organizim i takimeve me shoqatat që përfaqësojnë minoritetin Rom, si dhe institucionet shtetërore, lidhur me respektimin, mbrojtjen e të drejtave të këtij Minoriteti dhe problematikën e tyre.

- Ndjekja dhe përmbushja e detyrimeve periodike që rrjedhin nga Konventa Kuadër për mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, pas paraqitjes së Opinionit të Komitetit Këshillues, të Konventës Kuadër lidhur me raportin mbi minoritetet të paraqitur nga Shqipëria.
- Përgatitja e komenteve të qeverisë shqiptare lidhur me raportin periodik mbi minoritetet, të paraqitur nga Shqipëria.
- Realizimi i Strategjisë Kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së Minoritetit Rom" dhe i Planit të Veprimit të :Dekadës së Përfshirjes së Romëve" e cila ka një afat 2005-2015.
- Organizimin e Konferencës Kombëtare me rastin e 8 Prillit , ditës Ndërkombëtare të Romve.
- Realizimin e projektit IPA të Komisionit Evropian dhe projketit të OSBE-së të cilat mbeshtesin Minoritetin Rom dhe do të kenë një kohezgjatje 2 vjeçare.
- Ngritja e grupit të gjuhës dhe të kulturës rome në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës, ku prej vitesh funksionojnë katedra e gjuhëve ballkanike, në kuadrin e Dekadës Rome.
- Përgatitja e programeve të kualifikimit dhe të trajnimit sistematik (fillestar dhe në vazhdimësi) të mësuesve të gjuhës Rome.
- Përfshirja në kurrikulat e fakulteteve, në degët e mësuesisë, të programit të gjuhës Rome si lëndë me zgjedhje.
- Përfundimi i reformimit të kurrikulës së arsimit bazë dhe vijimi i punës në arsimin e mesëm, në fushën e arsimimit të minoriteteve.
- Hartimi i planit të ri mësimor 9-vjeçar për minoritetet, si dhe i programeve të reja për klasat I, II, III, IV,V dhe VI, VII, VIII, IX të minoriteteve, nga specialistë dhe mësues të minoritetit.
- Pajisja me libra dhe mjete mësimore të të gjithë fëmijëve romë, mbështetur në VKM Nr. 107, datë 10.02.2010 "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të Sistemit të Arsimit Parauniversitar".
- Krijimi i një fondi të veçantë për bursa studimi për nxënësit që ndjekin shkollën e mesme dhe për studentët romë;
- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom";
- Zbatimi dhe monitorimi i angazhimeve të ndërmarra në kuadër të Iniciativës "Dekada e Romëve", (2005-2015);
- Kremtimi i Ditëve Ndërkombëtare të Minoriteteve në Shqipëri. Këto veprimtari organizohen dhe kanë një shtrirje gjithëvjetore;
- Organizimi i ceremonive dhe takimeve jubilare për festimin e përvjetorëve të krijimit të Shoqatave dhe organizmave të ndryshme që përfaqësojnë kulturën e minoriteteve në Shqipëri;
- Veprimtari në bashkëpunim me Shoqatën e Arumunëve të Shqipërisë pranë shkollës së gjuhës arumune në Divjakë;
- Pjesëmarrje në nivel të lartë në Konferencën Ndërkombëtare në Gjenevë mbi të drejtat e minoriteteve.

Efektet financiare

Përmbledhje e efekteve financiare për të gjitha masat kombëtare për nënkapitullin 1.2

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**27.308.000**	**17.933.000**	**16.864.000**	**16.500.000**
Mbulohen nga buxheti i	25.588.000	17.933.000	16.864.000	16.500.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	1.720.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

1.3. TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME

1.3.1. REGJISTRIMI FILLESTAR

Situata aktuale

Politika e ZRPP konsiston në ofrimin e një shërbimi të shpejtë ndaj qytetarëve dhe institucioneve shqiptare në lidhje me regjistrimin e të drejtave mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në të gjithë territorin e Shqipërisë, si dhe për dhënien e informacionit mbi këto pasuri, nëpërmjet një sistemi regjistrimi të pasurive të paluajtshme efikas, bashkëkohor, që siguron informacion të qartë, të saktë, të përditësuar, të sigurt, transparent mbi te gjitha pasuritë e paluajtshme në Shqipëri. Qëllimi kryesor i Politikës së Institucionit konsiston në garantimin e titujve të pronësisë mbi të gjithë pasuritë e paluajtshme në të gjithë Shqipërinë si pjesë përbërëse e angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Regjistrimi fillestar i pasurisë së paluajtshme rregullohet nga aktet e mëposhtme ligjore:

- Ligji Nr. 7843, datë 13.07.1994, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar;
- VKM Nr. 519, 31.10.1994 “Për miratimin e Kartelës për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”
- VKM Nr. 432, datë 14.8.1995 "Për proçedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”;
- VKM Nr. 352, datë 3.05.1995, "Për miratimin e çertifikatave të pronësisë së pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 549, datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e tarifave të shërbimit të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", i ndryshuar;
- VKM Nr. 157, datë 26.2.1998 “Për fillimin e punës së zyrës së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në disa rrethe”

- VKM nr. 553, datë 28.08.1998 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shoqërive tregtare, të krijuara nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore”
- VKM Nr. 556, datë 23.10.2000 "Për dorëzimin e dokumentacionit të pronësisë në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme";
- VKM Nr. 411, datë 29.8.2002 "Për kalimin e disa mjediseve në administrimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, Korçë, Durrës;
- VKM Nr. 787, datë 26.11.2004 “Për bashkimin në një të vetme të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme “Tirana 1” dhe “Tirana 2” dhe për krijimin e zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë dhe Has…”
- VKM Nr. 3, datë 21.03.2006 “Për mbylljen e Njësisë së Menaxhimit të Projektit për Sistemin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe transferimin e funksioneve të saj Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.
- VKM nr. 24, datë 19.01.2007 “Për procedurën e lëshimit të dokumenteve nga disa zyra të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe ndryshimin e tarifave për to”
- Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 31.01.2007 ”Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.
- Urdhër i Ministrisë së Drejtësisë nr. 21 datë 14.11.1998 “Për mbylljen e zyrave të Hipotekës dhe kalimin e tyre pranë zyrave të regjistrimit të pasurive.”
- VKM nr. 1025, datë 09.07.2008 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen.”
- Vendim nr. 200, datë 19.02.2009 “Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar.”

Struktura institucionale

Në kuadër të garantimit të të drejtave të pronësisë, institucioni përgjegjës i cili drejton, organizon dhe kontrollon veprimtarinë e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Kjo e fundit përbëhet nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe 35 Zyra Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndodhura në çdo rreth të vendit. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme e ushtrojnë veprimtarinë në territorin e zonës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

ZRPP bashkëpunon ngushtë me institucionet qendrore (ministritë dhe me institucionet në varësi të tyre) dhe me organet e pushtetit lokal (bashki dhe komuna), për evidentimin e tokës shtetërore te disponueshme për kompensim, duke u bazuar ne informacionet mbi pronat e regjistruara në këtë Zyre. Gjithashtu ZRPP bashkëpunon ngushtë dhe me sektorin privat (ndërtuesit, dhoma e Avokatisë, Noterisë, Bankat etj.). Mekanizmi i bashkëpunimit konsiston në lidhjen e marrëveshjeve ndërmjet ZRPP dhe këtyre institucioneve.

Masat legjislative afatshkurtra

- Ndryshime në kuadrin ligjor rregullator, të cilat do të mundësojnë përmirësimin dhe përditësimin e të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme që administron zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- Miratimi me akt nënligjor (VKM), i rregullores së shërbimeve në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në të cilën do të përcaktohen në mënyrë të detajuar të gjitha llojet e shërbimeve që realizon zyra, dokumentet e nevojshme për çdo shërbim, elementët që verifikohen në çdo dokument dhe qëndrimi që mbajnë zyrat e regjistrimit për kryerjen e shërbimeve;
- Përgatitja e bazës ligjore mbështetëse në zbatim të ligjit të ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në funksion të kalimit të ZRPP në institucion vetë-financues.
- Miratimi me vendim të Këshillit të Ministrave i "Strategjisë për të Drejtën e Pronës";
- Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës për stafin e ZRPP-së.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Përmirësimi i dhënies së shërbimeve të ZRPP në të gjithë Shqipërinë;
- Zbatimi i Strategjisë së IT (Information Technology Strategy) nëpërmjet kompjuterizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- Zbatimi i strategjisë dhe zhvillimi i fushatës për informimin publik për funksionimin e ZRPP dhe për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme;
- Përfundimi i Regjistrimit Fillestar i 150.000 pasurive të paluajtshme në zonat urbane;
- Zhvillim i mëtejshëm i kuadrit rregullator;
- Rishikimi dhe përgatitja e Planit të Biznesit dhe e strategjive në zbatim të tij;
- Ngritja e kapaciteteve administrative. Kryerja e trajnimeve të stafit të ZRPP për procedurat dhe legjislacionin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe punën me sistemin e kompjuterizuar të regjistrimit;
- Përgatitja e projektligjit për ndryshimin e ligjit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, në funksion të kalimit të ZRPP në institucion vetë-financues si dhe përgatitja e akteve nënligjore qe do të mundësojnë zbatimin e këtyre ndryshimeve ligjore;
- Konsultimi i draft strategjisë "Për të drejtat e Pronës", si dhe reflektimi i komenteve të ardhura nga subjektet e interesuara;
- Përditësimi i legjislacionit ekzistues mbi të drejtat pronësore;
- Hartimi dhe miratimi i programeve vjetore periodike të trajnimit;
- Trajnimi i stafit për mbushjen e detyrave funksionale pas riorganizimit, të orientuara drejt shërbimit ndaj publikut;
- Rekrutimi i stafit mbi bazat e meritave profesionale dhe të integritetit;
- Dixhitalizimi i dokumentacionit arkivor ekzitues (dokumentet ligjore, kartelat dhe hartat treguese të regjistrimit) për zyrat vendore të regjistrimit Tiranë dhe Durrës;
- Zbatimi i arkitekturës së miratuar të sistemit elektronik të regjistrimit dhe ngritja e infrastrukturës hardëare, softëare, rrjet kompjuterik dhe përshtatja e ambienteve në zyrat vendore të regjistrimit Tiranë dhe Durrës;
- Adoptimi i sistemit elektronik në zyrat vendore të regjistrimit, Tiranë dhe Durrës;

- Shtrirja e sistemit të aplikimit elektronik të kërkesave të qytetarëve për shërbim në të gjitha zyrat vendore të regjistrimit;
- Aksesimi i noterëve në sistemin elektronik në zyrat vendore të regjistrimit Durrës dhe Tiranë;
- Krijimi i regjistrit kombëtar të tokës për një shërbim efektiv, cilësor dhe të shpejtë për publikun.

Masat legjislative afatmesme

- Përgatitja e bazës ligjore mbështetëse ne zbatim të ligjit të ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në funksion të kalimit të ZRPP në institucion vetë-financues.

Aktivietet zbatuese afatmesme

- Përmirësimi i dhënies së shërbimeve të ZRPP në të gjithë Shqipërinë;
- Zbatimi i Strategjisë së IT (Information Technology Strategy) nëpërmjet kompjuterizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive te paluajtshme;
- Kryerja e investimeve për rikonstruksionin, zgjerimin dhe pajisjen e ambienteve të punës së Zyrës Qendrore dhe Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- Përfundimi i Regjistrimit Fillestar i 400.000 pasurive të paluajtshme në zonat urbane.
- Zhvillim i mëtejshëm i kuadrit rregullator;
- Rishikimi, përditësimi dhe përgatitja e të akteve te nevojshme ligjore e nënligjore qe do të mundësojnë implementimin e strategjisë afatgjate të ZRPP-së, akte që do të mundësojnë rregullimin e procedurave te regjistrimit dhe lëshimit të dokumenteve të pronësie dhe të të drejtave reale mbi pasuritë, në rrugë elektronike;
- Ngritja e kapaciteteve administrative. Kryerja e trajnimeve të stafit të ZRPP për procedurat dhe legjislacionin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe punën me sistemin e kompjuterizuar të regjistrimit;
- Ngritja e kapaciteteve administrative;
- Dixhitalizimi i dokumentacionit arkivor ekzitues (dokumentet ligjore, kartelat dhe hartat treguese të regjistrimit) për zyrat e tjera vendore të regjistrimit;
- Zbatimi i arkitekturës miratuar elektronik të sistemit të regjistrimit dhe ngritjen e hardëare, softëare infrastrukturës, rrjetit kompjuterik dhe adaptimin e zonave në zyrat e regjistrimit të tjera lokale;
- Zbatimi i arkitekturës së miratuar të sistemit elektronik të regjistrimit dhe ngritja e infrastrukturës hardëare, softëare, rrjet kompjuterik dhe përshtatja e ambienteve në zyrat e tjera vendore të regjistrimit;
- Aksesimi i noterëve në sistemin elektronik në zyrate tjera vendore të regjistrimit;
- Vazhdimi i proçesit të regjistrimit fillestar;
- Identifikimi dhe krijimi i fondit fizik të tokës (tokat dhe ndërtesat nën pronësinë të shtetit).

1.3.2. KTHIMI DHE KOMPENSIMI I PRONAVE

Situata aktuale

Me qëllim realizimin e objektivit politik në fushën e kthimit dhe kompensimit të pronës, është krijuar Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Republikën e Shqipërisë, si person juridik publik, me qendër në Tiranë, në varësi të Ministrit të Drejtësisë.

AKKP-ja përmbush objektivat, kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar i cili aktualisht është në proces rishikimi në lidhje me shtyrjen e afatit për trajtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuar, për njohjen kthimin apo kompensimin e pronës. Kjo masë e nevojshme u ndërmor për shkak të mjaft kërksave të depozituara të cilat ende nuk janë trajtuar me një vendim përfundimtar.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 9235, datë 27.5.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës:, i ndryshuar.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 256, datë 13.4.2010 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 253, datë. 13.04.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 52 dt. 07.02.2007 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve të komunikimit, nëpërmjet AKKP-së dhe institucioneve shtetërore, gjatë procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës”
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 255 dt. 13.04.2010 “Për procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara gjatë procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr 254, datë 13.04.2010, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 257 dt. 11.04.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurën e kompensimit fizik me troje shtetërore, të subjekteve të shpronësuara në disa raste të veçanta”
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr 250, datë 14.04.2010, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 12 dt. 07.01.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar”
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 383, datë 19.05.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale” dhe Vendimet të Këshillit të Ministrave ku përcaktohet shpërblimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 267, datë 21.4.2010 ”Për përcaktimin e rregullave për bashkërendimin e punës së ALUIZNI-t me zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për procedurat e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 19.2.2009 ”Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar” .

Struktura institucionale

AKKP-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm dhe 2 (dy) zëvendësdrejtorë të Përgjithshëm. Organika dhe struktura e AKKP-së përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave".

AKKP-ja si institucion qendror varet nga Ministria e Drejtësisë dhe është përgjegjëse për:

- Njohjen e të drejtës së njohjes së pronësisë, e drejtë kjo themelore e parashikuar në Kushtetutën e republikës së Shqipërisë;
- Kthimin e kësaj të drejte aty ku është e mundur, si dhe aty ku nuk është e mundur kompensimin e saj në gjashte mënyrat e parashikuara në ligj;
- Ndjekjen e procedurave hap pas hapi të këtij procesi si dhe të bashkëpunimit me institucionet e treta që duhet të japin ndihmën e tyre ligjore për këtë proces;
- Me ndryshimet e kuadrit ligjor autoriteti i vetëm shtetëror, i cili merret me trajtimin e çështjeve të pronësisë, të cilat derivojnë nga shtetëzimet, shpronësimet dhe konfiskimet nga shteti totalitar komunist, do të jetë vetëm Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave me qendër në Tiranë;

Masat legjislative afatshkurtra

- Miratimi i strategjisë për të drejtat e pronësisë;
- Hartimi i akteve nënligjore për ristrukturimin e burimeve njerëzore;
- Nxjerrjen e rregullores se re “Për funksionimin e Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave”;
- Miratimi i një skeme të re definitive mbi afatet e kompensimit në përputhje me orientimet e GJEDNJ;
- Projekt Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në të holla për vitin 2012”;
- Miratimi i aktit të ri të metodikës së rishikuar.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Konsultimi i draft strategjisë “Për të drejtat e Pronës”, si dhe reflektimi i komenteve të ardhura nga subjektet e interesuara;
- Zbatimi i skemës kalimtare aktuale të kompensimit;
- Përmirësimi i organizimit strukturor dhe funksional;
- Përditësimi i informacionit mbi fondin fizik të objekteve;
- Përditësimi i fondit fizik të tokave;
- Krijimi i fondit fizik të kompensimit, realizimi i shpërndarjes se tij nga AKKP-ja sipas procedurave qe do te miratohen me Vendim të Këshillit te Ministrave duke e

bere procesin transparent korrekte dhe ne përputhje me ligjin dhe me aktet e tjera nënligjore në fuqi;

- Shpërndarjen e fondit të kompensimit në të holla për vitin 2012 për subjektet e shpronësuara prona e të cilëve është njohur për kompensim me vendim;
- Shpërndarjen e fondit në të holla për subjektet që preken nga ndërtimet informale;
- Përmbushja e rekomandimeve të analizës teknike që do të kryhen nga institucionet e eprore, përmes masave strukturore dhe institucionale;
- Trajnimi i stafit të AKKP-së për ngritjen e kapaciteteve të tyre;
- Përditësimi i legjislacionit ekzistues mbi të drejtat pronësore;
- Krijimi i bazës së të dhënave elektronike për vendimet administrative që lidhen me pronën;
- Përfundimi i shqyrtimit administrativ të kërkesave në lidhje me njohjen e pronës, për rreth 7000 dosje, për të cilat nuk është marrë një vendim ende;
- Përfundimi i proçesit për lirimin e banesave të ish - pronarëve, nëpërmjet aplikimit të kredive të buta për personat, sipas ligjit;
- Përgatitja e metodikës së rishikuar për vlerësimin e të gjithë tokës, të pasurive të paluajtshme, në bazë të vlerës së tregut dhe konsultimit me personat e interesuar;
- Identifikimi i pasurive të paluajtshme shtetërore dhe regjimit të tyre juridik, pas reformimit të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, sipas vlerës së tregut.

Masat legjislative afatmesme

- Përmirësimi i kuadrit ligjor.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Evidentimin e trojeve të lira, brenda zonave të stimuluara, për efekt të kompensimit fizik të ish-pronarëve;
- Krijimin e një baze të dhënash dixhitale për informacionin gjeografiko-hartografik GIS të të gjitha vendimeve për njohjen/kthimin apo kompensimin e pronës të dhëna në vite;
- Hartimi i një baze të dhënash arkivore dixhitale për të evidentuar të gjitha vendimet e dhëna ndër vite nga organet paraardhëse që kanë ushtruar këtë veprimtari administrative;
- Dixhitalizimin e Arkivës së Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, në bashkëpunim edhe me donatorë vendas apo të huaj;
- Dixhitalizimin dhe informatizimin e të gjithë veprimtarisë së Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, në mënyrë që ky institucion të jetë transparent dhe i hapur për publikun dhe personat e interesuar në lidhje me veprimtarinë e saj;
- Fillimi i procedurave të aplikimit dhe shpërndarjes së fondit në të holla për subjektet që preken nga ndërtimet informale;
- Fillimi i procedurave të aplikimit dhe shpërndarjes së fondit në të holla për subjektet e shpronësuara prona e të cilëve është njohur për kompensim;
- Trajnimi i stafit të AKKP-së për ngritjen e kapaciteteve të tyre.

1.4. ÇËSHTJET RAJONALE DHE DETYRIMET NDËRKOMBËTARE

Objektivi strategjik

Objektiv i rëndësishëm i politikës së jashtme të Shqipërisë ka qenë dhe mbetet politika rajonale. Shqipëria, si një aktor rajonal me një peshë dhe rol gjithnjë e më të të rëndësishëm, është e interesuar për për një rajon të stabilizuar ku të mbizotërojë paqja dhe bashkëpunimi socio-ekonomik dhe kulturor, si dhe për vendosjen e marrëdhënieve të qëndrueshme me fqinjët e saj. Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe të bashkëpunimit me vendet e rajonit dhe, veçanërisht, me ato të Ballkanit Perëndimor, vazhdojnë të jenë një nga prioritetet e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë, duke qenë njëkohësisht edhe një nga kërkesat kryesore të Marrëveshjes së Stabilizimit-Asociimit me BE.

Qeveria Shqiptare do të respektojë angazhimet e marra dhe do të jetë plotësisht e hapur për një bashkëpunim kapilar me institucionet e specializuara ndërkombëtare dhe ato të vendeve të tjera të rajonit, duke qenë mjaft aktive në zbatimin e angazhimeve që do të marrë në kuadër të këtij bashkëpunimi.

Gjithashtu, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare, Qeveria shqiptare do të jetë tërësisht e angazhuar të rrisë bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, duke iu përgjigjur me efektivitet programeve të ndërmarra nga partnerët rajonal dhe ndërkombëtarë në këtë fushë, në përputhje dhe me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (Neni 1,2,4,13 dhe 81 i MSA-së). Për më tepër, do të ndërmerren të gjitha hapat e nevojshme, si në kuadrin ligjor dhe atë institucional, për ta bërë sa më efektive dhe të plotë bashkëpunimin në këtë fushë.

1.4.1. BASHKËPUNIMI RAJONAL

Objektivi Strategjik

Objektivi strategjik i Shqipërisë është që përmes një angazhimi aktiv në të gjitha forumet dhe nismat rajonale të kontribuojë me qëndrimet parimore e të balancuara në trajtimin e çështjeve të ndryshme sensitive të rajonit. Nëpërmjet aktivitetit të saj në këto forume rajonale, Shqipëria synon që të nxisë zhvillimin ekonomik rajonal nëpërmjet projekteve të përbashkëta, në fusha të tilla si energjia dhe transporti. Shqipëria do të lobojë pa ndërprerje për përfaqësimin e Kosovës në nismat dhe organizatat rajonale duke kontribuar për paqen, stabilitetin dhe sigurinë në rajon.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Republika e Shqipërisë konsideron se bashkëpunimi dhe pronësia rajonale janë jo vetëm parakushte të integrimit evropian, por edhe domosdoshmëri e kohës për të transformuar përfundimisht imazhin e rajonit tonë. Ky orientim i politikës sonë të jashtme reflektohet në të

pjesëmarrjen tonë proaktive në të gjitha nismat dhe organizatat shumëpalëshe që veprojnë në rajonin e Evropës Juglindore e më gjerë.

Shqipëria është anëtare e nismave rajonale të mëposhtme:

- Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP)
- Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC)
- Nisma e Evropës Qendrore (CEI)
- Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ/BSEC)
- Nisma Adriatiko-Joniane (NAJ)
- MARRI (Nisma Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët)
- RACVIAC (Qendra Rajonale për Verifikimin e Kontrollit të Armëve)
- Karta e Partneritetit të Adriatikut (A-5)
- Ministeriali i Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM)

Për sa i përket kuadrit ligjor ekzistues dhe angazhimeve konkrete lutem referohuni ne kapitullin 31.

1.4.2. MARRËDHËNIET DYPALËSHE

Situata aktuale

Shqipëria është angazhuar fuqimisht për të mbështetur procesin e njohjes ndërkombëtare të Kosovës (89 vende); anëtarësimin në organizmat politiko-financiare ndërkombëtare; pjesëmarrjen me të drejta të plota në nismat shumëpalëshe rajonale. Shqipëria mbështet bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, marrëveshjet/konkluzionet e arritura gjatë këtyre bisedimeve, me ndërmjetësinë e BE, dhe shpreson që këto të implementohen sa më shpejt nën garancinë e ndërkombëtarëve. Shqipëria mbështet përpjekjet e faktorit ndërkombëtar dhe institucioneve kosovare për të normalizuar situatën në veri të Kosovës.

Shqipëria përshëndet fillimin e procesit të bisedimeve për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës dhe inkurajojmë nisjen e bisedimeve për një marrëveshje të re kontraktuale të Kosovës me BE-në, që do të përshpejtonte axhendën integruese të saj në BE dhe NATO. Njëkohësisht Shqipëria ka përshëndetur vendimin e Këshillit Evropian (2 mars 2012) për nisjen e Studimit të Fizibilitetit për MSA midis Kosovës dhe BE.

Në marrëdhëniet me **Maqedoninë**, Shqipëria do të vazhdojë të ndjekë me konsekuencë politikën e saj të fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit të ndërsjelltë, të mbështetjes për integrimin e saj të shpejtë në NATO, si dhe anëtarësimin e saj në BE. Konstatohet se midis dy vendeve ekziston një bashkëpunim politik intensiv, gjë që vihet re tek kontaktet e shpeshta të niveleve më të larta politike. Shqipëria i jep një mbështetje parimore autoriteteve maqedonase në zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit, duke shprehur besimin se zbatimi i plotë i saj përbën një kusht të rëndësishëm për sigurimin e paqes, stabilitetit dhe procesit te reformave në vend. Përveç dialogut politik, ka një angazhim në drejtim të thellimit të

bashkëpunimit ekonomik, rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe intensifikimin e bashkëpunimit në fusha me interes reciprok.

Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi dypalësh me **Kroacinë** ka shënuar progres të dukshëm pozitiv dhe cilësor, veçanërisht në kuadër të proceseve integruese në të dy vendet. Shqipëria ka përshëndetur anëtarësimin e plotë të Kroacisë në BE, si edhe rëndësinë e zhvillimit specifik të këtyre marrëdhënieve për të gjithë rajonin.

Bashkëpunimi me **Malin e Zi**, përbën një model të shkëlqyer të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, me një dialog politik tepër intensiv dhe me një bashkëpunim ekonomiko-tregtar gjithnjë e më intensiv. Shqipëria vlerëson ecurinë e procesit të integrimit të Malit të Zi në BE dhe ofron mbështetjen e saj për procesin e antarësimit të këtij vendi në NATO. Shqipëria ndjek dhe vlerëson interesin e treguar në vazhdimësi nga qeveria e Malit të Zi për pakicën shqiptare në vend. Integrimi i shqiptarëve në të gjitha nivelet e administratës qendrore e vendore dhe respektimi i të drejtave të tyre ndikon pozitivisht edhe në marrëdhëniet midis dy vendeve tona.

Zhvillimi i marrëdhënieve bilaterale me **Serbinë** është një prioritet shumë i rëndësishëm i politikës sonë rajonale. Shqipëria synon të ndërtojë me Serbinë marrëdhënie të mira dhe konstruktive, në interes të dy vendeve ç'ka do të përbënte edhe një kontribut për sigurinë dhe stabilitetin në rajon. Shqipëria është e interesuar për trajtimin e shqiptarëve në Serbinë e Jugut sipas standarteve të përparuara ndërkombëtare dhe demokratike. Ajo mbështet integrimin e plotë qytetar dhe të barabartë të shqiptarëve të kësaj zone në jetën dhe institucionet e shtetit të Serbisë.

Intensifikimi i dialogut politik dhe kontakteve në çdo nivel është qëllimi i bashkëpunimit me **Bosnjë-Hercegovinën**. Shqipëria mbështet procesin e integrimit të Bosnjë-Hercegovinës në NATO dhe BE, dhe i bashkangjitet përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar për reformat e nevojshme në vend, për një dinamikë të re në proceset integruese të Bosnjë-Hercegovinës. Qëndrimi i Shqipërisë është kundër çdo përpjekje për destabilizim dhe mbështet zbatimin e Marrëveshjes së Dejtonit. Shqipëria ka inkurajuar Bosnjë dhe Hercegovinën për të rishikuar qëndrimin e saj ndaj pavarësisë së Kosovës dhe për pjesëmarrjen e Kosovës në të gjitha nismat, projektet dhe aktivitetet rajonale.

Marrëdhëniet me **Italinë** janë në nivel të shkëlqyeshëm politik me nënshkrimin e Deklaratës së Përbashkët për Vendosjen e Partneritetit Strategjik, që cilësohet një shprehje e qartë e miqësisë dhe vullnetit politik mes dy vendeve. Italia është mbështetësja dhe avokatja kryesore e Shqipërisë në procesin e integrimit evropian dhe të lëvizjes së lirë të njerëzve. Në fushën ekonomike dhe tregtare, Italia është partneri preferencial dhe investitori më i rëndësishëm për Shqipërinë. Italia ruan një pozicion mbizotërues në investimet e huaja direkte në Shqipëri dhe renditet vendi i tretë donator, pas Bashkimit Evropian dhe Bankës Botërore, me një angazhim që arrin në 650 milionë Euro. Ekziston një angazhim të madh i biznesit italian në Shqipëri, ku janë të pranishme mbi 400 ndërmarrje italiane dhe me kapital të përbashkët.

Marrëdhëniet me **Greqinë** i konsiderojmë si marrëdhënie të një karakteri të natyrshëm, tradicional dhe strategjik, nisur nga fakti që Greqia ka dhënë një ndihmesë të çmuar në zhvillimet ekonomike dhe demokratike të vendit tonë si dhe në proceset integruese euro-atlantike. Marrëdhëniet mes dy vendeve bazohen, gjithashtu, mbi ura të forta lidhëse dhe miqësie, siç janë komuniteti shqiptar në Greqi dhe minoriteti grek në Shqipëri. Greqia ka qenë dhe mbetet partner i rëndësishëm strategjik, politik dhe ekonomik i Shqipërisë. Greqia është një nga partnerët më të rëndësishëm ekonomikë e tregtarë të Shqipërisë. Nga pikëpamja e investimeve, sipas vendit të origjinës, Greqia ruan një pozicion të rëndësishëm në investimet e huaja direkte në Shqipëri. Një numër i konsiderueshëm kompanish, kanë investuar në disa sektorë kyç të ekonomisë, përkatësisht në telefoninë celulare, sistemin bankar, ndërtim, shërbime, e industri, etj.

Marrëdhëniet me **Republikën e Turqisë** kanë në bazë të tyre miqësinë, lidhjet historike e tradicionale midis dy popujve. Bashkëpunimi politik, gjatë dy viteve të fundit është karakterizuar nga vizita reciproke zyrtare intensive të nivelit më të lartë dhe shkëmbime të rëndësishme në të gjitha fushat. Turqia mbetet një mbështetëse energjike e aspiratave integruese të Shqipërisë sidomos me ndihmën e pakursyer për anëtarësimin në NATO dhe në përpjekjet e saja për integrim të plotë në Bashkimin Evropian. Turqia mbetet një nga partnerët më të rëndësishëm ekonomikë e tregtarë për Shqipërinë. Investimet turke në Shqipëri janë të konsiderueshme dhe në sektorë strategjikë të ekonomisë shqiptare si në telekomunikacion, banka, energji, miniera, transport, etj.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

MAQEDONIA Të dyja vendet kanë nënshkruar rreth 58 marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi, ndërsa janë në proces edhe 7 marrëveshje të tjera. Baza ligjore e bashkëpunimit midis dy vendeve është pasuruar me nënshkrimin e marrëveshjeve të reja, ku mund të përmendim:

- Marrëveshje për Mbrojtjen Sociale dhe Sigurimet Shoqërore, (29 mars 2012)

KROACIA Mes dy vendeve janë nënshkruar rreth 40 marrëveshje dhe janë në proces 3 marrëveshje. Baza ligjore e bashkëpunimit midis dy vendeve është pasuruar me nënshkrimin e marrëveshjeve të reja, ku mund të përmendim

- Marrëveshja për njohjen reciproke të lejeve të drejtimit të automjeteve (u nënshkrua më 23 janar 2012) në Tiranë;

GREQIA ekziston një kuadër i gjerë ligjor, mbi të cilin mbështetet bashkëpunimi institucional, në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë.

Struktura Institucionale

Përsa i përket çështjeve të bashkëpunimit dypalësh me vendet fqinje, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, janë përgjegjëse:

- Drejtoria e Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi (në kuadrin e Drejtorisë së Përgjithshme Rajonale) është përgjegjëse për ndjekjen e të gjithë problematikës së marrëdhënieve dypalëshe me Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e Zi;
- Drejtoria e Italisë, Greqisë dhe Turqisë (në kuadrin e Drejtorisë së Përgjithshme Rajonale) është përgjegjëse për ndjekjen e të gjithë problematikës së marrëdhënieve dypalëshe me Italinë, Greqinë dhe Turqinë;
- Drejtoria e Evropës Juglindore (në kuadrin e Drejtorisë së Përgjithshme Rajonale) është përgjegjëse për ndjekjen e të gjithë problematikës së marrëdhënieve dypalëshe me Serbinë, Kroacinë dhe Bosnje-Hercegovinën.

Masat legjislative

Kosova

- Plotësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor të bashkëpunimit dypalësh përmes përfundimit të marrëveshjeve të mëposhtme:
    - Marrëveshje bashkëpunimi në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe trafikimit".
    - Marrëveshje bashkëpunimi midis Ministrisë së Drejtësisë së RSH dhe asaj të Kosovës (1) "Mbi ekstradimin"; (2) Për ndihmën e ndërsjellë në fushën penale dhe ndihmës së ndërsjellë juridike ne fushën civile e tregtare" dhe (3) "Mbi transferimin e personave të dënuar".
    - Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e postave dhe komunikimit elektronik".
    - Marrëveshje për eliminimin e taksimit të dyfishte"
    - Memorandum Bashkëpunimi në fushën e administratës civile.

Maqedonia

- Plotësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor të bashkëpunimit dypalësh përmes përfundimit të marrëveshjeve të mëposhtme:
    - Marrëveshje për bashkëpunimin në fushën e parandalimit të fatkeqësive dhe kufizimit e izolimit të pasojave të tyre [të firmoset 2012];
    - Marrëveshje për njohjen reciproke të lejeve të drejtimit të automjeteve,[2012]
    - Marrëveshjeje dypaleshe në fushën e standardeve;
    - Projekt-Marrëveshje për lidhjet hekurudhore ndërmjet dy vendeve[2013]
    - Marrëveshja për problemet ujore së bashku me Projekt-statutin e Komisionit
    - shqiptaro-maqedon për problemet ujore. [2013/2014]

Mali i Zi

- Plotësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor të bashkëpunimit dypalësh përmes përfundimit të marrëveshjeve të mëposhtme:
    - Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi në fushën e Arsimit
    - Marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit automjeteve.

- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për bashkëpunim në fushën e postave dhe komunikimeve elektronike.
- Marrëveshja bashkëpunimin në fushën e *transportit detar*.
- Memorandum për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar dhe të dhënave personale.
- Memorandum për menaxhimin e incidenteve ajrore.

Serbia

- Plotësimi i kuadrit ligjor të bashkëpunimit përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të mëposhtme:
  - Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë mbi transportin ajror;
  - Marrëveshje për bashkëpunimin në fushën e postave dhe komunikimit elektronik;
  - Marrëveshje për transportin ndërkombëtar të pasagjereve dhe mallrave;
  - Marrëveshje për ndihmën e ndërsjellë për parandalimin, hetimin dhe dënimin e shkeljeve doganore;
  - Marrëveshje për njohjen reciproke të diplomave;
  - Marreveshje per njohjen e lejeve te drejtimit;
  - Marrëveshje ndërmjet METE dhe Ministrisë së Mininerave dhe Energjetikës së Republikës së Serbisë në fushën e energjisë;
  - Marrëveshje në fushën e mbrojtjes.

Kroacia

- Plotësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor të bashkëpunimit dypalësh përmes përfundimit të marrëveshjeve të mëposhtme:
  - Marrëveshja për bashkëpunimin policor;
  - Marrëveshja shtesë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë mbi ndryshimet e "Marrëveshjes dypalëshe ekonomike ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë;
- Protokoll bashkëpunimi

Bosnje-Hercegovina

Plotësimi i kuadrit ligjor të bashkëpunimit përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të mëposhtme:
- Marrëveshje mbi trasportin detar;
- Marrëveshje për bashkëpunimin ndërmjet Ministrive të Drejtësisë;
- Marrëveshje në fushën e veterinarisë;
- Marrëveshje në fushën e bashkëpunimit ekonomik

Greqia

Plotësimi i kuadrit ligjor të bashkëpunimit përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të mëposhtme:

- Programi për Bashkëpunimin Arsimor dhe Shkencor midis Qeverisë së Republikës Greke dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë;
- Memorandumi i bashkëpunimit midis dy MPJ-ve për asistencën greke në procesin e integrimit evropian;
- Protokoll trepalësh (Shqipëri-Itali-Greqi), për bashkëpunimin në kuadër të projektit TAP (*Transadriatic Pipeline)*;
- Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës Greke dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për hapjen e Qendrës së Përbashkët për shkëmbim informacioni në Kakavijë;
- Protokolli për Zbatimin e Marrëveshjes së Ripranimit me BE-në.

Turqia

Plotësimi i kuadrit ligjor të bashkëpunimit përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të mëposhtme:

- Marrëveshja ndërqeveritare për Transportin Detar;
- Marrëveshja mbi bashkëpunimin e institucioneve të zbatimit të ligjit;
- Marrëveshja në fushën e parandalimit dhe përballimit të emergjencave civile;
- Protokolli për Bashkëpunimin në Fushën e Arsimit midis Akademive të Policive të të dy vendeve;
- Memorandum Mirëkuptimi mbi vendosjen e mekanizmit për konsultime të rregullta në fushën e shërbimeve të sipërmarrjes dhe të konsulencës teknike;
- Protokoll ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë mbi statusin e Administratës turke për Zhvillim dhe Bashkëpunim (TIKA);
- Marrëveshje për Nxitjen dhe Mbrojtjen Reciproke të Investimeve;
- Memorandumin ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Shqiptare dhe Nënsekretariatit të Kryeministrisë për Doganat Turke;
- Marrëveshje për njohjen e lejeve të drejtimit të automjetit;
- Protokolli i asistencës financiare ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së RSH-së dhe Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë.

Aktivitetet zbatuese

Kosova

- Vazhdimi i mbështetjes për rritjen e numrit të vendeve që njohin pavarësinë e Kosovës;
- Lobimi për pjesëmarrjen e Kosovës me të drejta të plota në nismat dhe forumet rajonale;

Maqedonia

- Vazhdimi i mbështetjes për antarësimin e Maqedonisë në NATO;

Mali i Zi

- Vazhdimi i mbështetjes për antarësimin e Malit të Zi në NATO;

Serbia

- Promovimi i dialogut politik në nivelin më të lartë midis dy vendeve;
- Mbështetja e integrimit të popullësisë shqiptare të Luginës së Preshevës në institucionet dhe jetën politike të Serbisë.

Kroaci

- Sigurimi i mbështetjes së Kroacisë për antarësimin në BE;
- Sigurimi mbështetës në fushën e arsimit dhe shkencës për vitet akademike 2011-2016.

Italia

- Intensifikimi i dialogut politik në nivelet më të larta;
- Sigurimi i lobimit që Italia mund të bëjë në BE për të mbështetur marrjen e statusit të vendit kandidat nga Shqipëria brënda vitit 2012.

Greqia

- Sigurimi i lobimit që Greqia mund të bëjë në BE për të mbështetur marrjen e statusit të vendit kandidat nga Shqipëria brenda vitit 2012.

Efektet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**963.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	963.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

2. KRITERI EKONOMIK

Kapitulli Kriteri Ekonomik i Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit 2012-2015 paraqet një panoramikë dhe një vlerësim mbi përpjekjet, arritjet dhe progresin e Shqipërisë në drejtim të implementimit të atyre reformave ekonomike dhe sociale të cilat janë parakushte për arritjen e kritereve ekonomike të Kopenhagenit. Përveç analizës së situatës aktuale të sektorëve të ekonomisë shqiptare, ky kapitull paraqet edhe prioritetet për vitet në vijim në këndvështrimin e sigurimit të një ekonomie tregu funksionale të aftë për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

Integrimi në Bashkimin Evropian nënkupton jo vetëm implementimin e suksesshëm të një sërë reformash politike dhe institucionale, por edhe reformimin dhe përforcimin e konkurueshmërisë së sistemit ekonomik shqiptar. Reformimi i sistemit ekonomik shqiptar mbështetet në një sërë dokumentesh strategjikë të hartuar në harmoni të plotë më rekomandimet dhe konstatimet e Komisionit Europian. Kështu, në Strategjinë Kombëtarë për Zhvillim dhe Integrim përcaktohet se përmirësimi i infrastrukturës bazë dhe krijimi i një kuadri mbështetës për biznesin janë parakushte për rritjen e konkurueshmërisë. “Strategjia”, konfirmon objektivin e qeverisë shqiptare për themelimin e një ekonomie më dinamike dhe konkurruese, të aftë të sigurojë rritje ekonomike të qëndrueshme dhe kohezion social. Një ekonomi moderne dhe rrjedhimisht edhe vetë zhvillimi ekonomik, kërkon investim në kapital njerëzor, implementim të suksesshëm të reformave në sistemin arsimor dhe shkencor, lidhje më të fortë të këtyre reformave me tregun e punës, dhe promovim të sipërmarrjes dhe inovacionit për të rritur konkurueshmërinë.

Objektivat makroekonomikë kryesorë të qeverisë shqiptare për periudhën afatmesme janë:

- Rritje dhe zhvillim ekonomik shoqëruar me rritje të standarteve të jetesës;
- Rritje të punësimit dhe kohezion social;
- Rritje të konkurueshmërisë së ekonomisë për të siguruar pjesëmarrje të barabartë të Shqipërisë në tregun Evropian.

Parakushtet kryesore për arritjen e këtyre objektivave janë vazhdimësia e rritjes ekonomike dhe përmirësimi i kushteve për një rritje të qëndrueshme në periudhën afatgjatë. Gjithashtu e rëndësishme është vazhdimi i ristrukturimit dhe reformave në ekonomi së bashku me ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe kursit të këmbimit. Këto objektiva synohet të arrihen nëpërmjet investimeve në infrastrukturë, vazhdimit të proçesit të liberalizimit dhe privatizimit, uljes së deficitit fiskal dhe të borxhit publik të brendshëm dhe të jashtëm, mbështetje për sektorët e eksportues dhe investimeve të huaja direkte, politikë fiskale favorizuese për biznesin. Gjithsesi, implementimi i reformave ekonomike duhet të shoqërohet me reforma cilësore në administratën publike dhe sistemin ligjor.

Ky kapitull është hartuar në harmoni të plotë me dokumentet strategjikë kombëtarë dhe prioritetet e identifikuara në Partnershipin Evropian dhe rekomandimet dhe konstatimet e KE të përmbajtura në Progres Raportet Vjetore dhe në Raportin Analitik që shoqëron Opinionin e KE mbi aplikimin e Shqipërisë për Anëtarësim.

2.1. ZHVILLIMET EKONOMIKE

Në fillim të viteve ‘90 Shqipëria ndërmori rrugën e vështirë të hapjes së ekonomisë së saj nga një ekonomi e mbyllur në një ekonomi të tregut të lirë. Gjatë kësaj kohe Shqipëria filloi t’i nënshtrohej një regjimi ri-strukturimi makroekonomik. Nevoja për reforma ishte shumë e madhe duke përfshirë të gjithë sektorët e ekonomisë. Procesi i tranzicionit dhe kalimi i ekonomisë tonë nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë është shoqëruar jo vetëm me transformimin e mekanizmave dhe infrastrukturës të funksionimit të tregjeve, por mbi të gjitha me nevojën e zhvillimit dhe krijimit të instrumentave dhe hapësirave të reja ligjore, institucionale, ekonomike dhe sociale me qëllim rritjen e efiçencës alokuese dhe përdoruese të burimeve publike dhe private.

Gjatë dekadës së fundit ekonomia shqiptare ka njohur një progres të qëndrueshëm dhe relativisht të kënaqshëm krahasuar me vendet e rajonit. Proçeset e transformimit ekonomik dhe ristrukturimit, si dhe politikat makroekonomike të ndjekura në dhjetë vitet e fundit kanë rezultuar në një nga ritmet e rritjes më të larta në rajonin e Evropës Qëndrore dhe Lindore (EQL). Me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.6 përqind, PBB për frymë është rritur me rreth 2.3 herë gjatë periudhës 2000 – 2010 (nga 171 mijë Lekë në vitin 2000 në 385 mijë Lekë për banor në vitin 2010). Ndërsa PBB për frymë e shprehur në dollarë amerikanë të indeksuar me Paritetin e Fuqisë Blerëse (USD-PPP) është rritur me rreth 2.5 herë gjatë kësaj periudhe (nga 3500 USD-PPP në vitin 2000 në 8900 USD-PPP në vitin 2010). Ulja e barrës tatimore dhe lehtësirat administrative, kanë ndihmuar biznesin për të rritur produktivitetin e tij. Zhvillimet pozitive në sektorin e biznesit, veçanërisht në atë industrial dhe në atë të orientuar drejt shërbimeve, kanë rezultuar në një rritje të punësimit dhe të të ardhurave familjare. Të ardhurat në rritje, të mbështetura edhe nga zgjerimi i kredisë në ekonomi, kanë kontribuar për një kërkesë të fortë të brendshme, e cila ka sjellë nxitjen e investimeve kapitale dhe zgjerimin e prodhimit.

Banka e Shqipërisë është autoriteti monetar i Republikës së Shqipërisë. Në bazë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.97, "Për Bankën e Shqipërisë", ajo është institucioni përgjegjës për hartimin, miratimin dhe zbatimin e pavarur të politikës monetare. Politika monetare është në funksion të përmbushjes së objektivit ligjor të Bankës së Shqipërisë: arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë hyri në një fazë të re interesante, në fundin e vitit 2000, kur u hoq dorë përfundimisht nga përdorimi i instrumenteve të drejtpërdrejta të kontrollit monetar. Që prej vitit 2000, për zbatimin e politikës monetare, më konkretisht për ndërhyrjet e saj në treg, Banka e Shqipërisë përdor kuadrin operacionale të instrumentave indirekt të politikës monetare. Më konkretisht ky kuadër operacional përfshin operacionet e tregut të hapur, lehtësitë e përhershme, instrumentat mbështetës dhe rezerva e detyruar, të cilat rregullohen me një bazë të plotë nënligjore. Kuadri operacionale është rishikuar në vite, me qëllim për tu përshtatur me standardet më të mira ndërkombëtare, në veçanti me ato të Bashkimit Evropian, si dhe me nevojat dhe sfidat e kohës.

2.2. EKZISTENCA E NJË EKONOMIE TREGU FUNKSIONALE

Një ekonomi tregu funksionale është kriteri i parë ekonomik i Kopenhagenit dhe përfshin:

- Arritjen e stabilitetit makroekonomik, përfshirë qëndrueshmërinë e financave publike, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe bilancit të pagesave;
- Ekuilibrin ndërmjet kërkesës dhe ofertës bazuar në konkurrencën e lirë ndërmjet forcave të tregut dhe liberalizimit të çmimeve dhe tregtisë;
- Eliminimin e barrierave për hyrjen dhe daljen nga tregu (në formën e krijimit të firmave të reja dhe të procedurës së falimentimit për ato ekzistuese);
- Ekzistencën e një sistemi ligjor, përfshirë rregullimin e titujve të pronësisë, zbatueshmërinë e ligjit dhe kontratave;
- Konsensus të gjerë mbi politikën ekonomike;
- Një sektor financiar mjaftueshmërisht të zhvilluar për të kanalizuar kursimet drejt investimeve produktive.

Ekonomia shqiptare karakterizohet nga një rritje ekonomike e lartë, inflacion i ulët, progres në implementimin e reformave strukturore, vazhdimësi të proçesit të liberalizimit dhe privatizimit, dhe rritje të investimeve të huaja direkte. Mbi bazën e këtyre rezultateve, Komisioni Evropian ka dhënë një vlerësim pozitiv për politikën ekonomike dhe stabilitetin makroekonomik[3]. Objektivat e politikës ekonomike për Shqipërinë janë:

- *në periudhën afatshkurtër:* ruajtja e disiplinës fiskale dhe ulja e cënueshmërisë të shkaktuar nga defiçiti i llogarisë korrente;
- *në periudhën afatmesme:* përmirësimi dhe modernizimi i aktiviteteve të sektorit privat për të siguruar rritjen e konkurueshmërisë.

Këto objektiva janë komplementarë pasi vetë stabiliteti makroekonomik dhe defiçiti fiskal i ulët janë kushte të domosdoshme për rritjen afatgjatë të konkurueshmërisë, rritjen ekonomike, anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe zhvillimin e vendit.

2.2.1. Bazat e politikës ekonomike

Ekonomia shqiptare i është nënshtruar ndryshimeve të thella strukturore gjatë dy dekadave të fundit dhe politika ekonomike është orientuar drejt konsolidimit makroekonomik. Përgjatë vitit 2009, politika ekonomike kryesisht u fokusua në minimizimin e efekteve negative të krizës globale, nëpërmjet investimeve kapitale. Gjithashtu, politikat për uljen e barrës tatimore dhe lehtësirat administrative vazhdojnë të japin rezultate jo vetëm në terma të normës së rritjes ekonomike por edhe në rritjen e produktivitetit të bizneseve shqiptare, në sfondin e një situate ekonomike akoma të vështirë të partnerëve tregtarë të Shqipërisë.

Për periudhën 2012-2014, ekziston një konsensus i gjerë mbi politikën ekonomike e cila do të vazhdojë të fokusohet në konsolidimin e mëtejshëm fiskal, uljen e vazhdueshme të borxhit të brendshëm, përmirësimit të balancës korrente dhe hartimit të politikës fiskale në përputhje me politikën monetare, dhe shoqëruar me konsolidim të buxhetit bazuar në shpenzime. Gjithashtu, ashtu sikurse pohuar edhe nga Komisioni Evropian në Progres Raportin e vitit

[3] Raporti Analitik 2010 dhe Progres Raporti 2011.

2011, ekziston një konsensus i gjerë mes partive politike për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

2.2.2. Stabiliteti makroekonomik

Gjatë viteve të krizës dhe pas krizës ekonomike globale (2009-2011), stabiliteti makro-ekonomik në vend ka ndjerë presionet negative të saj, megjithatë është arritur të ruhet në parametra relativisht të kënaqshëm. Gjatë secilit prej viteve 2009-2011 u arrit të evitohej recesioni ekonomik, i cili u përjetua në pjesën dërrmuese të vendeve të rajonit dhe më gjerë, dhe ekonomia shqiptare vijoi të performojë me ritme positive rritje. Rritja mesatare ekonomike e Shqipërisë gjatë viteve 2000-2008 (periudha para krizes) ishte në nivelin 6.1%, duke qenë mbi mesataren prej 5.3% të vendeve të EQL, ndërsa norma e inflacionit mesatar për këtë periudhe ishte 2.7%, ndjeshëm poshtë mesatares prej 8.5% të vendeve të EQL. Gjatë viteve 2009-2011 (periudha e krizës dhe pas saj) ekonomia e Shqipërisë ka performuar me një rritje mesatare prej rreth 3.4% , dukshëm mbi rritjen mesatare prej 0% të vendeve të EQL, ndërsa inflacioni mesatar ka qenë në nivelin 3.1%, lehtësisht poshtë inflacionit mesatar prej 3.7% të vendeve të EQL.

Një prej faktorëve përcaktues në evitimin e recesionit përgjatë goditjes së krizës globale, veçanërisht gjatë vitit 2009, ishte stimuli i fortë dhe efektiv i injektuar në ekonomi nëpërmjet një politike fiskale ekspansioniste, e cila u materializua kryesisht në një nivel të lartë investimesh publike, duke kompensuar rënien në kërkesën e jashtme dhe ngadalësimin e kërkesës së brendshme. Në vitin 2010, politika fiskale u ri-orientua përsëri në një kurs të qëndrueshëm drejt konsolidimit të financave publike, ku deficiti fiskal u reduktua në 3.1% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) nga 7% e PBB që ishte në vitin 2009, ndërsa borxhi publik ra në nivelin 58.1% të PBB nga niveli 59.3% që ishte në vitin 2009. Në rafshin relativ, mund të thuhet se politika fiskale e ndjekur gjatë viteve 2009 – 2011 (periudha e krizës globale dhe ajo post-krize) ka rezultuar relativisht mjaft efektive, pasi në njërën anë vlerësohet si një prej faktorëve kyç në evitimin e një recesioni ekonomik dhe mbajtjen e ekonomisë në terren pozitiv, ndërsa nga ana tjetër zgjerimi i borxhit publik në raport me PBB për këtë periudhë tre-vjeçare ka rezultuar relativisht i ulët krahasuar me vendet e EQL.

Megjithëse në prani të një kursi lehtësisht të nënçmuar të këmbimit dhe të pasigurisë së shtuar në ekonomi, Banka e Shqipërisë ka arritur të kontrollojë inflacionin rreth objektivit të saj prej 3%.
Po kështu, në drejtim të aktivitetit makroekonomik, ndikimi i krizës botërore u materializua në formën e ngadalësimit të ritmit të rritjes ekonomike. Furnizimi i ekonomisë me likuiditet nga Banka e Shqipërisë, lehtësimi i kujdesshëm i kushteve monetare, vazhdimi i kreditimit të ekonomisë nga sistemi bankar si dhe përdorimi i hapësirës fiskale në drejtim të nxitjes së aktivitetit ekonomik ndihmuan në përballimin e kësaj goditjeje.

Kredibiliteti i konsiderueshëm i investitorëve të huaj dhe tregjeve të huaja të kapitalit në ekonominë dhe financat publike të Shqipërisë u reflektua qartë në emetimin e eurobondit të Shqipërisë, në Tetor 2010. Megjithëse koha në të cilën u emetua eurobondi sërish karakterizohej nga një volatilitet dhe pasiguri e lartë në tregjet e kapitalit, Shqipëria arriti të dalë për herë të parë në tregjet e huaja të kapitalit duke emetuar eurobondin me vlerë

nominale prej 300 milionë Euro, në terma relativisht mjaft të kënaqshëm, respektivisht me një afat maturimi prej pesë vjetësh dhe me një normë interesi prej 7.5%

Sektori Real

Viti 2010 rezultoi sërish një vit relativisht pozitiv për ekonominë shqiptare. Rritja reale ekonomike për vitin 2010 ishte mesatarisht 3.9%, dhe ishte në përshpejtim përgjatë gjithë vitit duke arritur në 5.6% në tremujorin e fundit të vitit 2010 (në terma vjetore) nga 2.2% që ishte në tremujorin e parë të tij, ose nga rritja negative prej 0.6% e regjistruar në tremujorin e fundit të vitit 2009. Në ndryshim nga vitet e mëparshme, rritja ekonomike në 2010, u gjenerua kryesisht nga kërkesa e jashtme e udhëhequr nga eksporti i mallrave. Në ndryshim me vitin 2009, ku rritja pozitive prej 3.3% u gjenerua kryesisht nga kërkesa e brendshme e fuqizuar së tepërmi nga stimuli i fortë fiskal i "injektuar" nëpërmjet një politike fiskale ekspansioniste, rritja ekonomike në vitin 2010 u gjenerua pothuajse plotësisht nga sektori privat, duke qenë se efekti fiskal *(fiscal stance)*, gjatë vitit 2010 krahasuar me vitin 2009, ishte negativ.

Rritja e PBB tremujor *(ne terma vjetore, ne %)*



Burimi: INSTAT

Rritja ekonomike ka vijuar të jetë pozitive edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, megjithëse ajo rezultoi më e ulët krahasuar me parashikimet fillestare të Ministrisë së Financave. Ky devijim nga parashikimi ishte rrjedhoje e ndryshimit në kahun negativ të disa prej variablave ekonomikë kryesisht të jashtëm, por veçanërisht ishte rrjedhoje e ndikimit të disa faktorëve të brendshëm jo-ekonomikë. Rritja ekonomike e vlerësuar për tremujorin e parë ishte 3.8%, ndërkohë që në tremujorin e dytë të vitit produkti i brendshëm bruto u rrit me 0.5%. Kërkesa e jashtme ka vijuar të gjenerojë rritje ekonomike pozitive edhe gjatë vitit 2011, ndonëse në një masë të konsiderueshme më të ulët se rritja e gjeneruar gjatë vitit 2010. Rritja e konsumit dhe investimeve, edhe pse vlerësohet të jetë pozitive krahasuar me vitin 2010, mbetet e ngadaltë duke reflektuar kryesisht zbehjen e besimit të konsumatorëve dhe bizneseve gjatë gjysmës së parë të vitit. Aktivitetet ekonomike me performancën më të mirë gjatë gjysmës së parë të vitit ishin industria (duke përjashtuar degën e energjisë elektrike, gazit dhe ujit), transporti dhe tregtia, ndërsa sektori i ndërtimit duket se po rikthehet në terren pozitiv pasi shënoi një rritje pozitive prej 4.4% gjatë tremujorit të parë të 2011, pas pesë tremujorësh rresht me rritje të thellë negative.

Tregu i Punës

Tregu i punës gjatë vitit 2010 shënoi një përmirësim të lehtë. Numri i të punësuarve u rrit me 2% dhe norma e papunësisë ra në 13.5% në fund të vitit 2010 nga piku prej 13.8% regjistruar në tremujorin e parë të 2010. Tregu i punës ka njohur përmirësim të mëtejshëm gjatë gjysmës së parë të 2011. Punësimi regjistroi rritje vjetore me 2.2% dhe 2.7% përkatësisht në

tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2011. Norma e papunësisë vijoi të bjerë lehtësisht për të qëndruar në 13.26% në tremujorin dytë të vitit.

Sektori Monetar

Norma mesatare e inflacionit në gjysmën e parë të vitit 2011 ishte lehtësisht mbi limitin e sipërm të objektivit të Bankës së Shqipërisë, kryesisht si rrjedhoje e çmimeve më të larta të mallrave bazë (commodities) në tregjet ndërkombëtare. Inflacioni mesatar vjetor në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011 rezultoi 2.9%, duke rënë me 1.1 pikë përqindje në krahasim me vlerën e shënuar në gjashtëmujorin e parë. Tendenca rënëse e inflacionit u shfaq gjatë tremujorit të dytë, duke u forcuar më tej në gjysmën e dytë të vitit. Çmimet e mallrave ushqimorë devijuan nga sjellja e tyre sezonale në muajin dhjetor, duke shkaktuar rënien e shpejtë të inflacionit vjetor në nivelin 1.7%.

Nga këndvështrimi makroekonomik, ecuria rënëse e inflacionit është ndikuar në mënyrë të njëkohshme nga faktorë të kërkesës dhe të ofertës. Nga ana e ofertës, ngadalësimi i inflacionit të çmimeve të mallrave kryesorë në tregjet botëror dhe qëndrueshmëria relative e kursit të këmbimit, u materializuan në rënie të inflacionit të importuar. Nga ana kërkesës, rritja nën potencialin e ekonomisë shqiptare ka vijuar të mbajë kapacitete të lira në faktorët e prodhimit – të punës dhe kapitalit – duke u materializuar në presione të kahut rënës në paga, në kostot e prodhimit dhe në inflacion.

Reduktimi i presioneve inflacioniste gjatë vitit 2011 dhe pritjet për nivele të ulëta të inflacionit gjatë vitit 2012, motivuan lehtësimin e mëtejshëm të politikës monetare në tremujorin e katërt të vitit 2011. Banka e Shqipërisë kreu dy ulje të normës bazë të interesit në muajt shtator e nëntor, duke e zbritur këtë normë në nivelin më të ulët historik prej 4.75%. Banka e Shqipërisë vlerëson se i forcimi i natyrës stimuluese të politikës monetare do të ofrojë kushte më të përshtatshme financiare për respektimin e objektivit të inflacionit në horizontin afatmesëm. Në të njëjtën kohë, ky lehtësim i shërben nxitjes së kërkesës së brendshme të ekonomisë, e cila mbetet ende e brishtë në prani të pasigurisë së rritur në ekonomi. Gjithashtu, ai faktorizon një politikë fiskale të kujdesshme gjatë vitit 2012 dhe reduktimin e pritur të kontributit të shpenzimeve publike në rritjen ekonomike.
Ecuria e treguesve monetarë ka qenë në linjë me zhvillimet në sektorin real të ekonomisë. Analizat dhe vlerësimet tona sugjerojnë se rritja e ofertës monetare është në përputhje me kërkesën e agjentëve ekonomikë për para reale dhe presionet inflacioniste me natyrë monetare në ekonomi janë të përmbajtura. Rritja e agregatit M3 u shfaq më e ngadaltë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, i ndikuar nga krijimi më i ulët i parasë në monedhë të huaj. Për periudhën korrik-nëntor, rritja mesatare vjetore e mjeteve monetare në ekonomi rezultoi 10.4%. Kontributi i kërkesës së sektorit privat për financim ka ruajtur nivele të qëndrueshme. Në fund të muajit nëntor, rritja vjetore e saj shënoi 10.9%. Ecuria e kreditimit mbetet nën ndikimin e një kërkese të ulët për kredi dhe të politikave më të kujdesshme të bankave drejt kreditimit. Sjellja e agjentëve ekonomikë vijon të kushtëzohet nga pasiguria për të ardhmen, e cila kufizon kryerjen e shpenzimeve dhe investimeve në ekonomi. Nga ana tjetër, edhe oferta e kredisë paraqitet e shtrënguar, sikurse tregohet nga ecuria e standardeve të kreditimit.

Zhvillimet në tregjet financiare në gjysmën e dytë të vitit 2011 kanë qenë të qeta dhe kanë reflektuar prime relativisht të ulëta të rrezikut, të likuiditeti dhe të inflacionit. Uljet e njëpasnjëshme të normës bazë janë reflektuar shpejt në tregun ndërbankar. Në tregun primar, yield-et e letrave me vlerë të qeverisë kanë ndjekur prirje rënëse, në reflektim të uljes së normës bazë dhe të normave afatshkurtra të interesit dhe njëkohësisht të kërkesës së ulët të sektorit publik për financim. Ndërkohë, përcjellja e sinjaleve të politikës monetare pritet të shfaqet më e plotë në tregjet e depozitave dhe të kredive, në përputhje me kohëvonesat në mekanizmin e transmisionit.

Sektori i Jashtëm

Bilanci i pagesave (BP) regjistroi një sufiçit të konsiderueshëm gjatë vitit 2010 prej afërsisht 179 milionë Euro dhe stoku i rezervave valutore arriti nivelin e 1.9 miliardë Euro, i mjaftueshëm për të financuar rreth 4.8 muaj importi të mallrave dhe shërbimeve. Sufiçiti i BP erdhi si rezultat i përmirësimit të bilancit të llogarisë korrente me 3.8 pikë përqindje të PBB (nga një defiçit prej 15.5% të PBB në 2009 në rreth 11.7% të PBB në 2010). Përmirësimi i bilancit tregtar ishte më tepër se i mjaftueshëm për të kompensuar rënien prej 11% të remitancave. Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në sektorin e jashtëm gjatë vitit 2010 ishte rritja e investimeve të huaja direkte (IHD). Flukset hyrëse neto të IHD u rritën me 20.9% gjatë vitit 2010 duke financuar rreth 79.1% të defiçitit të llogarisë korrente, nga niveli historik i financimit prej rreth 53.3%. Luhatjet e kursit të këmbimit janë stabilizuar gjatë vitit 2010 pas zhvlerësimit që u regjistrua gjatë vitit 2009.

Pozicioni i jashtëm i vendit u përkeqësua disi gjatë gjysmës së parë të vitit 2011. Bilanci i pagesave regjistroi një defiçit prej 78.8 milionë Euro gjatë gjysmës së parë të vitit nga një defiçit prej 7.1 milionë Euro i regjistruar një vit më parë. Defiçiti i llogarisë korrente u rrit me 29.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke reflektuar ngadalësimin e rritjes së eksportit të mallrave në nivelin 17.8% gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 nga një rritje prej 65.8% që shënonte në vitin 2010. Ndërsa rritja e importeve u përshpejtua në 13% nga 3% regjistruar gjatë vitit 2010. Përveç përkeqësimit të tregtar, rënia e remitancave me 12% dhe rritja e flukseve dalëse për turizëm dhe udhëtime ishin kontribuesit kryesorë në përkeqësimin e llogarisë korrente dhe bilancit te pagesave gjatë gjysmës së parë të vitit 2011. Megjithatë, kursi i monedhës vendase kundrejt valutave mbeti përgjithësisht i stabilizuar, borxhi i jashtëm bruto i Shqipërisë (publik dhe privat) është rritur me vetëm 2% që nga fundi i vitit 2010 dhe rezervat valutore janë të mjaftueshme për të financuar rreth 4.3 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Gjatë periudhës Janar – Nëntor të vitit 2011 Leku është zhvlerësuar kundrejt Euros me rreth 2% duke arritur pikën maksimale të këmbimit me 142.64 lekë / euro në 7 qershor 2011, nga 138.8 lekë / euro që ishte në 31 dhjetor 2010, si dhe në të njëjtën kohë Leku është vlerësuar me rreth 3.2% kundrejt dollarit amerikan. Referuar statistikave të tregtisë së jashtme, gjatë periudhës Janar – Tetor 2011 u rregjistrua një rritje e eksporteve me rreth 20.3% dhe një rritje e importeve me 11.7%, duke thelluar defiçitin tregtar me 7.3% krahasuar me një vit më parë.

Sektori Financiar

Besimi mbi sektorin financiar dhe bankar është rikthyer plotësisht pas goditjeve negative të shkaktuara prej krizës globale gjatë vitit 2009. Depozitat bankare u rritën me 18.5% në 2010 krahasuar me vitin 2009 dhe është vënë re një përshpejtim i ritmeve të rritjes së tyre përgjatë gjithë vitit. Kredia mbi ekonominë është rritur gjithashtu, megjithëse me ritme më të moderuara se depozitat. Normat e interesit janë ulur gradualisht gjatë gjysmës së parë të vitit 2010 dhe janë stabilizuar në fund te vitit. Gjithashtu, treguesit e rentabilitetit janë përmirësuar gjatë vitit 2010 krahasuar me vitin 2009.

Dinamika pozitive e sektorit financiar ka vijuar edhe përgjatë vitit 2011. Depozitat u rriten me 13.3% deri në muajin Shtator 2011 (në terma vjetore) ndërsa kredia mbi ekonominë është rritur me 14.6% dhe ritmi i rritjes së saj është përshpejtuar gjatë vitit. Kredia ndaj biznesit udhëheq rritjen në kredinë totale, duke u rritur me 19% në terma vjetore dhe kryesisht për qëllime investimi, por gjithashtu edhe kredia ndaj konsumatorëve familjarë është përshpejtuar në muajt e fundit duke arritur nje rritje prej 5.4% në Shtator 2011 (në terma vjetore). Sektori bankar është mjaft likuid, gjë kjo e reflektuar edhe në ankandet e fundit të Bonove të Thesarit (yield-e më të ulta dhe ofertë me e lartë nga bankat), si edhe në normat e interesit të cilat përgjithësisht kanë njohur një rënie ose kanë mbetur të stabilizuara, si për kreditë ashtu edhe për depozitat. Megjithatë, niveli i kredive me probleme ende mbetet problematik në sektorin financiar. Niveli i tyre arriti në 18% në tremujorin e tretë të vitit 2011 nga niveli prej 13.6% në fundin e vitit 2010. Por në të njëjtën kohë, kjo është shoqëruar me rritje të nivelit të provigjioneve të mbajtura nga bankat në nivelin e 10.2% të totalit të kredive nga 8.2% që ishte në fundin e vitit 2010. Ndërkohë, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit mbetet në nivel mjaftueshmërisht të sigurt prej 15.1%, mbi minimumin e kërkuar nga Banka e Shqipërisë prej 12%.

2.2.3. NDËRVEPRIMI I FORCAVE TË TREGUT

Politika e përgjithshme e qeverisë në lidhje me çmimet parashikon formimin e lirë të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve nëpërmjet reflektimit të kushteve të tregut. Në Shqipëri, pas reformave të thella të ndërmarra, proçesi i liberalizimit të çmimeve në përgjithësi ka përfunduar, përveç çmimeve të administruara të vendosura nga entet rregullatore sektoriale ose organet shtetërore në fushën e energjisë elektrike, telefonisë dhe furnizimit me ujë.

Modeli i tregut të *energjisë elektrike* në Shqipëri, është konceptuar dhe hartuar në zbatim të Direktivave të Bashkimit Europian për energjinë elektrike si dhe, të kërkesave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë të vendeve të Evropës Juglindore, për krijimin e Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike. Modeli Shqiptar synon të krijojë një treg të thjesht-rregulluar, transparent dhe të balancuar të energjisë elektrike, mbi bazën e kontratave dypalëshe. Gjithashtu, me ndryshimet më të fundit të legjislacionit për sektorin e energjisë elektrike, shënohen hapa të

mëtejshëm drejt liberalizimit të tregut duke përmbushur në këtë mënyrë edhe angazhimet në kuadër të traktatit të sipërpërmendur dhe të *acquis*[4].
Çmimet për *furnizimin me ujë të pijshëm dhe çmimet për largimin e ujërave te zeza* janë të kontrolluara dhe të miratuara nga ERRU (Enti Rregullator i Ujit), i cili mbi bazën e propozimeve të Sh.a Ujësjellës Kanalizimeve dhe të organeve të pushtetit vendor studion dhe miraton këto çmime për çdo Sh.a Ujësjellës Kanalizime. Megjithëse ka përmirësime çmimet e ujit të pijshëm, përveçse nuk janë unike për të gjithë vendin, mbeten nën nivelin e kostos të shitjes. Rrjedhimisht ky shërbim përfiton ndihmë shtetërore me subvencione për të mbuluar defiçitin operacional të ndërmarrjeve. Gjithsesi, me synimin e orientimit të ndërmarrjeve të ujësjellësit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostos, me VKM nr. 643, datë14.09.2011 është miratuar Strategjia Kombëtare Sektoriale e Shërbimit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017.
Ashtu sikurse konstatuar edhe nga Komisioni Europian, në tërësi, proçesi i privatizimeve ka avancuar, pjesëmarrja e shtetit në ekonomi është ulur gradualisht ndërsa kontributi i sektorit privat në ekonomi ka arritur në një nivel të lartë. Qeveria planifikon të vazhdojë me programin e privatizimeve duke filluar me strukturimin dhe shitjen e kuotave dhe aseteve në disa sektorë strategjikë, si energjitika, hidrokarburet, sigurimet, disa shërbime portuale, disa operacione në transportin hekurudhor dhe në telekomunikacion. Qëllimi kryesor i proçesit të ristrukturimit të shoqërive shtetërore dhe privatizimit është rritja e cilësisë së menaxhimit, duke synuar rritjen e vlerës së tyre në proçesin e privatizimit.

Gjatë vitit 2011 është bërë ristrukturimi i shoqërisë strategjike "KESH" Sh.a, si rezultat i të cilit u krijuan tre shoqëri të reja[5] me kapital 100% shtetëror, për të cilat pasi u përfunduan të gjitha proçeduat e regjistrimit në QKR dhe, pasi filluan funksionimin dhe veprimtarinë e tyre si entitete më vete, është përgatitur baza ligjore përkatëse për privatizimin e tyre. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE), dhe më specifikisht Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike janë përgjegjës për ristrukturimin dhe privatizimin e këtyre shoqërive. Lidhur me sektorin e hidrokarbureve, qeveria shqiptare planifikon vazhdimin e ristrukturimit dhe privatizimit të shoqërive me kapital shtetëror dhe më konkretisht me privatizimin e shoqërisë "ALBPETROL", për të cilën është miratuar ligji për privazimin dhe janë në fazë përgatitje aktet nënligjore në zbatim të ligjit dhe do të vijojnë më pas procedurat për përzgjedhjen e investitorit strategjik që do të blejë aksionet e kësaj shoqërie, proçes i cili pritet të përfundojë brenda vitit 2012.

Gjatë vitit 2010 është kryer ristrukturimi i "Hekurudha Shqiptare sha". Kjo shoqëri anonime, brenda saj, është ndarë në katër njësi biznesi të veçanta dhe konkretisht : (i) njësia e biznesit e transportit të udhëtarëve, (ii) njësia e biznesit e transportit të mallrave, (iii) njësia e biznesit të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore dhe (iv) njësia e biznesit të mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse. Këto njësi biznesi janë në përbërje të Hekurudhës Shqiptare sha, por janë të ndara ekonomikisht dhe financiarisht.

Me hartimin ligjit të ri "Për sistemin hekurudhor në Republikën e Shqipërisë", "Hekurudha Shqiptare sha", brenda vitit 2013 do te ndahet në katër ndërmarrje krejtësisht të veçanta dhe konkretisht: (i) Ndërmarrja e Infrastrukturës Hekurudhore, (ii) Ndërmarrja e Transportit të

[4] Për më tepër informacion, konsulto Kapitullin 15 "Energjia".
[5] a) HEC Ulëz-Shkopet, sh.a,Bulqizë; b) HEC Bistrica 1, Bistrica 2, sh.a,Sarandë dhe c) HEC Lanabregas sh.a, Tiranë.

Udhëtarëve, (iii) Ndërmarrja e Transportit te Mallrave, (iv) Ndërmarrja e Riparimit të Mjeteve Lëvizëse.
Ndërmarrja e Infrastrukturës hekurudhore parashikohet të jetë një shoqëri anonime me kapital 100 për qind shtetëror, ndërsa tre ndërmarrjet e tjera, fillimisht do të jenë shoqëri anonime me kapital 100 për qind shtetëror dhe më tej mund të privatizohen. Ndërsa në shërbimet portuale gjatë vitit 2011, nuk janë realizuar privatizime.

2.2.4. HYRJA DHE DALJA NGA TREGU

Në proçesin e eliminimit të barrierave administrative për hapjen e bizneseve të reja dhe mbylljen e atyre ekzistuese, qeveria shqiptare ka ndërmarrë reforma të rëndësishme, të cilat, me ngritjen e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në 2007, Qendrës Kombëtare të Liçensimit në 2009, kanë sjellë proçedura më efektive dhe efiçente.

Me ngritjen e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, e cila funksionon sipas parimit one-stop-shop, është e mundur regjistrimi i një biznesi të ri brenda 1 dite (nga 28 ditë që duheshin para vitit 2007) dhe me një kosto minimale prej 100 lekë (0.81 Euro). Sipas statistikave, deri në fund të muajit dhjetor 2011, janë regjistruar 12,706 biznese të reja; 22,653 regjistrime të tjera (ndryshime) dhe 3,900 ç'regjistrime vullnetare. Janë vetëm dy subjekte që janë ç'regjistruar nga QKR nëpërmjet proçedurës së falimentimit nga gjykata.

Gjithashtu, me themelimin e Qendrës Kombëtare të Liçensimit, e cila operon sipas parimit one-stop-shop dhe sipas parimit të miratimit në heshtje, proçedurat në shumë sektorë u lehtësuan dhe u harmonizuan duke ulur kështu barrierat administrative për bizneset. Kështu, liçensat e grupit I dhe të grupit II jepen nga vetë QKL brenda 2-4 ditëve, ndërsa, për licensat e grupit të III, të cilat përcillen pranë ministrive të linjës, koha e dhënies se licencës është 10-30 ditë. Sipas të dhënave statistikore, gjatë vitit 2011, në total kanë aplikuar për liçensë dhe leje 5295 subjekte: 3,355 prej tyre janë aprovuar, 1,731 janë refuzuar, 186 janë në proçes dhe janë revokuar 28 prej tyre. Ndërsa sipas parimit "Silent is Consent" janë miratuar 30 aplikime.

Me miratimin e ligjit të ri për proçedurat e falimentit (2009), dhe legjislacionit për ngritjen e Agjensisë së Mbikqyrjes së Falimentimit[6], janë bërë përparime në proçedurat e daljes nga tregu dhe falimentimit. Agjensia e Mbikqyrjes së Falimentimit, është ngritur mbi bazën e VKM nr. 852, datë 21.10.2010, "Mbi organizimin dhe funksionimin e Agjensisë së Mbikqyrjes së Falimentimit". Kjo agjensi është organi kompetent shtetëror për mbikëqyrjen e veprimtarisë së administratorëve të falimentimit, e cila do të organizojë dhe zhvillojë provimin e administratorëve të falimentimit, do të mbajë regjistrin e administratorëve dhe do të mbikëqyrë veprimtarinë e tyre. Në mbështetje të pikës 3 të VKM nr. 852/2010, Ministria e Drejtësisë ka hartuar strukturën dhe organikën e cila është përcjellë për miratim pranë Këshillit të Ministrave, miratimi i së cilës pritet së shpejti. Në projekt urdhrin e përcjellë për

[6] Në mbështetje të ligjit nr. 8901, datë 23.05.2002 "Për falimentin", i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.05.2008 dhe ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë", me nismë të Ministrisë së Drejtësisë, është miratuar nga VKM nr. 852, datë 21.10.2010 "*Mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit*".

miratimin e strukturës, është parashikuar që kjo agjensi do të ketë gjithsej 8 punonjës dhe do të drejtohet nga një Drejtor i cili do të ketë në varësi 3 sektorë: a)Zyrën e Licencave, b)Sektorin e Standardeve dhe Statistikave dhe c)Sektorin e Mbikëqyrjes së Veprimtarisë së Administratorëve. *Pritet që Agjencia të fillojë funksionimin me kapacitet të plotë institucional dhe administrativ brenda nje afati te shkurter kohor.* Të dhënat statistikore lidhur me kërkesat për deklarim falimenti për vitin 2011, janë në përpunim e sipër nga Zyra e Statistikës dhe bibliografisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, por_të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2011, të përpunuara deri më tani nga ky sektor janë_si më poshtë vijon:

Tabela 1:

57 çështje të ngritura me objekt "Kërkesë për deklarim falimenti": • 33 çështje të mbartura • 24 çështje të reja	Mbi mënyrën e përfundimit të çështjeve: • 17 çështje të përfunduara • 40 çështje të papërfunduara • 3 çështje të pranuara • 4 çështje të refuzuara • 10 çështje të pushuara	Afatet e përfundimit • 3 çështje të gjykuara brenda 0-2 muajve • 5 çështje të gjykuara brenda 2-6 muajve • 9 çështje të gjykuara mbi 6 muaj • 3 çështje të apeluara

2.2.5. SISTEMI LIGJOR PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE (TË DREJTAT E PRONËSISË; ZBATIMI I LIGJIT DHE I KONTRATAVE; EFEKTSHMËRIA E GJYQËSORIT)

Një ndër objektivat madhorë dhe prioritarë të qeverisë shqiptare është reformimi i sistemit që mbron dhe garanton të drejtën e pronës. Vizioni në realizimin e reformës së të drejtave të pronës do të materializohet në Strategjinë Ndërsektoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë"[7], duke synuar në rregullimin e tregut të tokës, në funksion të zhvillimit ekonomik për ta shndërruar Shqipërinë në një vend të zhvilluar.

Dokumenti strategjik pritet të adresojë këto prioritete strategjike:

- Finalizimin nga AKKP brenda vitit 2012 të procesit të njohjes së pronësisë së subjekteve të shpronësuar dhe hartimin të një plani efektiv e realist brenda vitit 2013 për afatet e zbatimit të skemës për kthimin e kompensimin e plotë të pronës nëpërmjet konsolidimit të fondit fizik dhe financiar;
- Krijimin e regjistrit kombëtar të tokës brenda vitit 2012 për ta shndërruar shërbimin e ofruar ndaj publikut në efektiv, cilësor dhe të shpejtë, si dhe përfundimin e regjistrimit të plotë fillestar sistematik kombëtar brenda vitit 2013;
- Evidentimin e pasurive të paluajtshme dhe të regjimit juridik të tyre brenda vitit 2012 nëpërmjet reformimit të metodikës së vlerësimit të pronave të paluajtshme sipas vlerës së tregut, me qëllim përllogaritjen në vijimësi të detyrimeve financiare të shtetit, të pasurive ekzistuese shtetërore dhe në funksion të proceseve që lidhen me kalimin e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme;

[7] Projektstrategjia dhe Plani i Veprimit që e shoqëron atë, brenda muajit Mars 2012 do t'i nënshtrohen procesit të konsultimit të jashtëm

- Konsolidimin e titujve të pronësisë, rritjen e sigurisë mbi pronën e fituar me ligj dhe të investimeve mbi të si dhe dinamizmin e tregut të tokës nëpërmjet finalizimit të proceseve të tjera të përkohshme të pronës si legalizimit të ndërtimeve informale dhe shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore;
- Zbatimin efektiv dhe pa barriera, në kohë dhe cilësi të vendimeve përfundimtare, administrative apo gjyqësore, që disponojnë të drejta pronësie, sidomos për subjektet e shpronësuara, nëpërmjet forcimit të shërbimit përmbarimor privat apo agjencive të tjera private dhe parandalimit, për aq sa është e mundur të konflikteve pranë GjEDNj-së;
- Konsolidimi i qeverisjes së mirë, përmes luftës ndaj korrupsionit dhe fenomeneve të tjera negative që pengojnë zhvillimin e integrimin e vendit dhe garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës;
- Dixhitalizimi i informacionit mbi të drejtat e pronësisë për nxitjen e procedurave elektronike të aplikimit, si element thelbësor për një shërbim më të shpejtë, më të besueshëm, transparent, publik dhe pa influenca të paligjshme në përputhje me strategjinë ndërsektoriale të shoqërisë së informacionit dhe standardet e direktivës INSPIRE.

Parimet që udhëheqin strategjinë dhe planin e veprimit për të drejtat e pronësisë janë të dimensionit kushtetues dhe lidhen me "interesin publik", "shpërblimin e drejtë", parimin e drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social, duke u bazuar jo vetëm në elaborimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe nga jurisprudenca, tashmë e pasur, e Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, masat që do të ndërmerren mbajnë në konsideratë edhe parimet e sigurisë juridike dhe të qartësisë së legjislacionit, si premisa thelbësore të forcimit të të drejtave themelore paralelisht me zhvillimin e vendit dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Për më tepër informacion në lidhje me cështjet e drejtësisë, konsulto Kapitullin 1 "Kriteri Politik dhe Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore".

2.2.6. ZHVILLIMI I SEKTORIT FINANCIAR

Zhvillimet në sektorin bankar

Gjendja e sistemit financiar dhe e sektorit bankar gjatë vitit 2011[8] vlerësohet e qëndrueshme. Sektori bankar vijon të mbetet segmenti kryesor i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, aktivet e të cilit përfaqësonin rreth 94.5% të totalit të aktiveve të sistemit financiar. Sektori financiar jo- bankar vijon të zërë një peshë të vogël ndaj tërësisë së sistemit financiar.
Aktiviteti kreditues është përmirësuar gradualisht, por cilësia e portofolit të kredisë ka vijuar të bjerë. Pesha e kredisë akorduar sektorit privat, publik dhe individëve është ngjitur në rreth 42.7% të GDP-së në 2011, nga 39.9% që llogaritej një vit më parë duke treguar se kredidhënia vijon të jetë mundësia kryesore e ndërmjetësimit financiar. Pasiguritë në aktivitetin kreditues kanë sjellë shtim të nivelit të provigjioneve gjatë vitit 2011. Kështu, ato shënuan një rritje me rreth 44.7% referuar periudhës së një viti më parë. Niveli i huave me

[8] Vlerësimi i gjendjes i referohet zhvillimeve në sektorin bankar deri në muajin Nëntor 2011, sipas raportimeve më të fundit pranë Bankës së Shqipërisë.

probleme mbetet shqetësimi kryesor i sektorit bankar. Raporti i kredive me probleme ndaj totalit të kredive rezultoi në nivelin 18.7% në fund të vitit 2011 kundrejt 13.9% në fund të vitit 2010.
Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ka ardhur në rënie, ndonëse mbetet dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar nga kuadri rregullativ. Në muajin shtator 2011, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit zbriti në 15.1% nga 15.4% në muajin dhjetor 2010 dhe 15.7% vlera e të njëjtës periudhë një vit më parë.

Sektori bankar ruan ritme të qëndrueshme të rritjes së të ardhurave neto nga interesat dhe të fitimit operativ bruto. Por rritja e nevojshme e fondeve rezervë për mbulimin e rrezikut të kreditit, ka ndikuar në rënien e rezultatit financiar neto të sektorit bankar në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Megjithatë, rezultati financiar vijon të mbetet pozitiv dhe i përqendruar. Treguesit e përfitueshmërisë RoE dhe RoA, referuar të dhënave më të fundit pranë Bankës së Shqipërisë, u llogaritën në nivelet 0,76% dhe 0.07% nga 7.58% dhe 0.72% krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë[9].

Në fund të vitit 2011, portofoli i kredisë u zgjerua me 15.3% krahasuar me fundin e vitit 2010, duke kapërcyer në një farë mënyre ngercin e krijuar si kombinim i ofertës dhe kërkesës: nga ana e ofertës, bankat janë treguar më prudente në dhënien e kredive gjatë periudhës 2009-2010 si rezultat i zhvillimeve financiare ndërkombëtare; ndërsa nga ana e kërkesës, zhvillimet në ekonomi që kanë prekur direkt ose indirekt gjendjen financiare të bizneseve dhe individëve, kanë rezultuar në uljen e kërkesës për kredimarrje në sistemin bankar.
Portofoli i kredisë për sektorin privat u rrit me rreth 17.1% nga një vit më parë, ndërkohë që kjo rritje ishte më e ulët për sektorin e individëve rreth 5.6%. Në harkun kohor prej një viti, kredia akorduar biznesit të madh vijon të zërë peshën kryesore. Më konkretisht shpërndarja: biznesi i vogël përftoi rreth 20.8 miliardë lekë, ose 18.9% të tepricës së kredisë, nga 12.5% një vit më parë, duke zënë 5.3% të PBB-së së vendit; biznesi i mesëm përftoi 11.3 miliardë lekë, rreth 10.3% të tepricës së kredisë nga 14.7% një vit më parë, duke zënë 5.7% të PBB-së së vendit dhe biznesi i madh të cilit iu akordua rreth 53.1 miliardë lekë, ose 48.3% e tepricës së kredisë duke zënë 16.6% të PBB-së së vendit.

Sipas *valutës*, në harkun kohor prej një viti evidentojmë se kredia e akorduar në monedhën evropiane (euro) vijon të zërë peshën më të madhe në portofolin e kredisë me rreth 59.6%, ndjekur nga kredia e akorduar në monedhën vendase me 33.2% dhe më pak ajo në dollarë rreth 7.1%. Megjithatë, rritjen më të madhe të tepricës së kredisë (stok) e ka shënuar kredia akorduar në monedhën vendase e cila u rrit me rreth 18% referuar një viti më parë, ndjekur nga ajo në dollarë me rreth 10.9% dhe në euro me rreth 8.8%.

Për sa i përket shpërndarjes së tepricës së kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, rritjen më të madhe vjetore të kredisë e kanë pasur këta sektorë: sektori i prodhimit, sektori i shpërndarjes së energjisë elektrike, gazit dhe ujit me rreth 43%, ku pesha e kredisë së këtij sektori ra në 3.5% nga 4.7% e vitit të mëparshëm. Sektori i bujqësisë, gjuetisë dhe silvikulturës u rrit me rreth 29% dhe sektori i tregtisë, riparimit të automjeteve dhe artikujve shtëpiakë u rrit me

[9] Krahasimi i bërë në dhejtor 2011 me dhjetor 2010

17%. Sektori i ndërtimit u rrit me vetëm 5.66% në harkun kohor prej një viti. Normat e interesit të kredive për bizneset dhe konsumatorët janë udhëhequr nga ecuria e normave të bonove të thesarit.

Situata e *likuiditetit* paraqitet e mirë në kushtet kur rritja e depozitave të publikut vijon me ritme të kënaqshme, ato mbulojnë më shumë se një herë vlerën e kredive dhe huamarrja nga jorezidentët është në nivele të ulëta. Depozitat u rritën me rreth 14.7% referuar një viti më parë, tregues ky i rikthimit të besimit të publikut ndaj sektorit bankar.

Gjenerimi i pamjaftueshëm i rezultatit financiar pozitiv dhe rënia e mjaftueshmërisë së kapitalit, kanë rritur ndjeshmërinë e sektorit bankar ndaj rreziqeve të ndryshme, siç konfirmohet edhe nga ushtrimet e provës së rezistencës. Ndër këto rreziqe, sektori bankar paraqitet më i mbrojtur nga rreziqet e drejtpërdrejta të tregut, por mbetet i ekspozuar ndaj efektit mbi cilësinë e kredisë të lëvizjeve të padëshiruara në kursin e këmbimit dhe në normat e interesit. Rreziku i kreditit, përfaqëson burimin kryesor të rrezikut për sektorin bankar. Për këtë çështje, nëpërmjet funksionit të saj mbikëqyrës Banka e Shqipërisë ka kërkuar nga bankat tregtare që ato të sigurojnë paralelisht identifikimin e saktë dhe në kohën e duhur të kredive me probleme dhe krijimin e fondeve përkatëse rezervë, si edhe të realizojnë veprime të vendosura për rikuperimin e vlerave të kredive të humbura nëpërmjet ekzekutimit të kolateraleve. Këto veprime, të kombinuara me masat për uljen e mëtejshme të kostove operative, do të krijonin gradualisht kushtet për gjenerimin e një rezultati financiar të qëndrueshëm dhe pozitiv, i cili do të mbështeste më mirë nevojat afatmesme për kapital të sektorit bankar.

Zhvillimet në tregun financiar jo-bankar

Në fushën e tregut financiar jo-bankar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare edhe gjatë 2011 ka thelluar përpjekjet për përafrimin e kuadrit ligjor me legjislacionin e BE-së, në zbatim të MSA-së, rekomandimeve të Raportit Analitik 2010 dhe Progres Raportit 2011, me synim përmirësimin e mëtejshëm të këtij tregu dhe forcimin e mbikëqyrjes.

Tregu i pensioneve vullnetare ka njohur zhvillime pozitive në drejtim të licencimit. Autoriteti ka miratuar dhënien e licencës për 3 shoqëri administruese të fondeve të pensioneve vullnetare dhe licencën për tre banka si depozitar të fondeve të pensioneve.
Shoqëritë e licensuara do të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tregut të pensioneve vullnetare dhe në rritjen e besueshmërisë së individëve dhe bizneseve për të përfshirë punonjësit e tyre në skemën e pensioneve vullnetare. Skema e re e organizimit dhe funksionimit të pensioneve vullnetare, *përbën një risi për tregun financiar shqiptar*. Për më tepër, përfshirja e lehtësirave tatimore në këtë ligj, e ka bërë skemën e pensionit privat më atraktiv për kontribuuesit dhe punëdhënësit.
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare gjatë 2011 ka vazhduar forcimin e bazën rregullative me hartimin dhe miratimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të ligjit për pensionet vullnetare.
Për periudhën janar-nëntor 2011 tregu i sigurimeve ka pasur rritje me 5.27 % dhe numri i kontratave është rritur me 578,095 në krahasim me vitin 2010. Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e jo-jetës shënoi një rritje në masën 2.96 % krahasuar me janar-nëntor 2010, ndërsa për veprimtarinë e jetës shënoi një rritje në masën 30.37 % krahasuar me janar-

nëntor 2010. Struktura e tregut të sigurimeve ka një përmirësim të ndjeshëm në favor të rritjes së sigurimeve vullnetare. Kështu për periudhën janar- nëntor 2011 sigurimi i detyrueshëm zinte mbi 45% dhe ai vullnetar afro 55%.* Aktualisht 50% e tregut të sigurimeve dominohet nga kapitali i huaj.
Në dhjetor 2011 Autoriteti përfundoi hartimin e projektligjit "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" me qëllim, forcimin dhe zhvillimin e sektorit të sigurimeve në vend. Ky projektligj u hartua me synim plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e sigurimeve dhe përmbushjen e angazhimeve për përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian.
Ndër zhvillimet më të rëndësishme në fushën e sigurimeve përmendim hyrjen në fuqi të ligji nr. 10455, datë 21.07.2011 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10076, dt 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" i cili solli liberalizimin e tarifave të primeve të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, duke hequr regjimin e tarifave fikse dhe vendosjen e tarifave të primeve nga vet shoqëritë e sigurimit sipas kushteve dhe kërkesave të tregut të sigurimit, në përputhje me Direktivën 92/49/EEC të BE-së.

Në tetor 2011, Autoriteti miratoi metodologjinë e re të mbikëqyrjes në sigurime, nëpërmjet miratimit të Manualit të Mbikëqyrjes me Fokus Riskun, së bashku me planin strategjik të zbatimit. Koncepti bazë i metodologjisë së re është të identifikojë zonat me rrezik më të lartë në veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit dhe kur është e nevojshme, të punojë me menaxhimin e saj në mënyrë që ta ulë riskun në nivele të pranueshme. Objektivi i kësaj metodologjie është parandalimi problemeve financiare përpara se ato të ndodhin. Autoriteti, në nëntor 2011, dha miratimin paraprak për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit në klasat e jo-jetës për një shoqëri të re.

Tregu i letrave me vlerë edhe për vitin 2011 vazhdoi të mbetej i përqendruar në tregun me pakicë të letrave me vlerë të borxhit të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione). Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar - shtator 2011 u dominua në masën 95.14% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 4.86% nga instrumenta afatgjatë (obligacione). Për sa i takon numrit të transaksioneve, 99.02% e të gjithë transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.*

Arritjet legjislative për vitin 2011 në fushën e titujve u konkretizuan me miratimin e rregullave të reja për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të hartuara në zbatim të ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Gjatë vitit 2011 ky treg njohu zhvillime pozitive në drejtim të licencimit. Autoriteti licensoi shoqërinë e parë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive si dhe miratoi emetimin e parë të obligacionit me ofertë private.
Listimi i shoqërive dhe tregtimi i aksioneve në Bursë mbetet një përpjekje potenciale. Pavarësisht nga përpjekjet e vazhdueshme të Bursës së Tiranës për të afruar biznesin vendas, faktorë të shumtë si: madhësia e bizneseve (kryesisht biznes i vogël dhe i mesëm), mënyra e funksionimit të biznesit, trashëgimia kulturore dhe mentaliteti, kriza financiare ndërkombëtare kanë ndikuar në mos-zhvillimin e tregut të kapitalit.

Për më tepër informacion në lidhje me këtë fushë, konsultoni Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”.

2.3. KAPACITETET PËR TË PËRBALLUAR PRESIONET KONKURRUESE DHE FORCAT E TREGUT BRENDA BASHKIMIT

Aftësia për të përballur presionet konkuruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian përfaqëson kriterin e dytë ekonomik të Kopenhagenit, dhe përfshin:

- ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale ku stabiliteti makroekonomik lejon vendimmarrjen në një klimë stabiliteti dhe parashikueshmërie;
- ekzistencën e kapitalit të nevojshëm njerëzor dhe fizik, me kosto të përballueshme, përfshirë infrastrukturën (energjinë, telekomunikacionet, transportin, etj.), sistemin arsimor dhe kërkimor-shkencor;
- ndikimin e shtetit në konkurueshmëri nëpërmjet politikave tregtare, konkurencës, ndihmës shtetërore, mbështetjeve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- rritjen e proporcionit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në marrëdhënie tregtie me BE; dhe
- nivelin e integrimit tregtar me Bashkimin Evropian përpara anëtarësimit (volumi dhe struktura e produkteve të tregtuara).

Me qëllim rritjen e aftësisë për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda BE, dhe në pritje të marrjes së statusit të vendit kandidat për anëtarësim në BE, forcimi i konkurueshmërisë së ekonomisë shqiptare, përbën një nga objektivat strategjikë kryesorë të politikës ekonomike. Prioritetet e Shqipërisë në këtë kuadër janë:

- harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me *acquis*;
- vazhdimi i konsolidimit makroekonomik dhe fiskal
- zhvillimi i mëtejshëm i sektorit financiar
- promovimi i konkurencës së lirë dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit të sipërmarrësve, konsumatorëve, organeve qeveritare dhe autoriteteve të tjera publike, sistemit gjyqësor dhe publikut në përgjithësi;
- zhvillim i njëtrajtshëm dhe i harmonizuar të territorit të Republikës së Shqipërisë, rritjes së numrit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe të shkallës së ndikimit të tyre në PBB;
- harmonizimi i mëtejshëm i politikave dhe programeve të ndihmës shtetërore me legjislacionin Evropian në këtë fushë;
- përdorimi i avantazheve krahasuese të Shqipërisë në fushën e turizmit;
- përmirësimi i infrastrukturës së energjisë, transportit dhe kanalizimeve;
- stimulimi i aplikimit efiçent të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit me qëllim rritjen e konkurueshmërisë së ekonomisë shqiptare;
- ndërmarrja e reformave tepër të rëndësishme në sistemin gjyqësor
- reformimi i sistemit ligjor për çështjet ekonomike (të drejtat e pronësisë; zbatimi i ligjit dhe i kontratave; efektshmëria e gjyqësorit)

2.3.1. EKZISTENCA E NJË EKONOMIE TREGU FUNKSIONALE

Një ekonomi tregu funksionale është kriteri i parë ekonomik i Kopenhagenit dhe përfshin:

- Arritjen e stabilitetit makroekonomik, përfshirë qëndrueshmërinë e financave publike, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe bilancit të pagesave;
- Ekuilibrin ndërmjet kërkesës dhe ofertës bazuar në konkurrencën e lirë ndërmjet forcave të tregut dhe liberalizimit të çmimeve dhe tregtisë;
- Eliminimin e barrierave për hyrjen dhe daljen nga tregu (në formën e krijimit të firmave të reja dhe të proçedurës së falimentimit për ato ekzistuese);
- Ekzistencën e një sistemi ligjor, përfshirë rregullimin e titujve të pronësisë, zbatueshmërinë e ligjit dhe kontratave;
- Konsensus të gjerë për politikën ekonomike;
- Një sektor financiar mjaftueshmërisht të zhvilluar për të kanalizuar kursimet drejt investimeve produktive.

Ekonomia shqiptare karakterizohet nga një rritje ekonomike e lartë, inflacion i ulët, progres në implementimin e reformave strukturore, vazhdimësi të procesit të liberalizimit dhe privatizimit, dhe rritje të investimeve të huaja direkte. Për vitet në vijim objektivat e politikës ekonomike për Shqipërinë janë:

- *në periudhën afatshkurtër:* ruajtja e disiplinës fiskale dhe ulja e cënueshmërisë së lartë të shkaktuar nga defiçiti i llogarisë korrente;
- *në periudhën afatmesme:* përmirësimi dhe modernizimi i aktiviteteve të sektorit privat për të siguruar rritjen e konkurueshmërisë.

2.3.2. KAPITALI NJERËZOR DHE KAPITALI FIZIK

Kapitali Njerëzor

Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe tregu funksional i punës janë ndër faktorët kryesorë që kontribuojnë në rritjen e ekonomike te vendit, rritjen e konkurueshmërisë dhe pozicionimin e sistemit ekonomik shqiptar si pjesëmarrës në tregjet europiane dhe globale. Problematikat kryesore me të cilat përballet Shqipëria dhe që pengojnë realizimin e plotë të kapitalit njerëzor janë: ndryshimet e sistemit të ekonomisë, rrjedhja e trurit në vitet e fundit, informaliteti, si dhe mungesat në sistemin e arsimit dhe formimit. Si rezultat shpesh ndodh që bizneset të përballen me një mungesë të aftësive gjë që kufizon rritjen e tyre. Gjithsesi, kohët e fundit janë ndërmarrë disa reforma për të modernizuar sistemin e arsimit dhe formimit profesional (AFP) dhe për të rritur shkallën e përgjegjshmërisë dhe përputhshmërisë me ndryshimet në tregun e punës.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit zbaton programet aktive të tregut të punës, duke siguruar këshillim, trajnim profesional, ndërmjetësim për punë, dhe programe të nxitjes së punësimit për të sapo diplomuarit grupet vulnerabe, femrat dhe punëkërkuesit pa profesion. Megjithëse fondet për këto programe janë të limituara ato kanë qenë periodike dhe sistematike dhe kanë mbuluar pjesën më vulnerabe të punëkërkuesve të papunë. Këto ndërhyrje janë planifikuar në programin e qeverisë dhe strategjitë kombëtare dhe sektoriale. Politikat e qeverisë në lidhje

me punësimin dhe zhvillimin social janë miratuar me anë të kornizës legjislative, programet aktive të tregut të punës dhe projekteve, formimit profesional dhe ritrajnimin, si dhe në vazhdim proçesin e harmonizimit me politikat e Bashkimit Evropian.

Strategjia Sektoriale e Punësimit dhe Formimit Profesional 2007-2013, e hartuar në harmoni me Strategjinë Evropiane të Punësimit dhe linjat udhëzuese, synon hedhjen e bazave kryesore strategjike për MPÇSSHB për zhvillimin e sistemit të shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve ndaj punëkërkuesve dhe punëdhënësve duke rritur cilësinë e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional dhe zbatimit sa më efikas të programeve aktive dhe pasive duke synuar uljen e nivelit të papunësisë.

Më konkretisht, Strategjia parashikon përmirësimin e sistemit të shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional që synohet të realizohet nëpërmjet krijimit të një sistemi modern dhe unik të shërbimeve të punësimit në të gjithë vendin, ndërtimit dhe zhvillimit të marrëdhënieve të partneritetit me aktorë të tjerë në tregun e punës, zhvillimit të teknologjisë së informacionit (IT) në shërbimet e punësimit, zhvillimit të burimeve njerëzore, krijimit të një sistemi unik dhe cilësor të AFP, i aftë për të kontribuar në zhvillimin vazhdueshëm të aftësive profesionale dhe qytetarisë aktive të të rinjve dhe të rriturve si dhe ofrimit të kualifikimeve profesionale në përputhje me kërkesat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit, në kuadrin e integrimit rajonal dhe Evropian.

Në strategji është trajtuar edhe një pjesë në lidhje me krijimin e një klime pozitive për zhvillimin e biznesit dhe investimeve, rritjen e konkurueshmërise së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në tregun rajonal dhe atë global nëpërmjet zhvillimit të teknologjisë së informacionit, reduktimit te barrierave administrative dhe krijimit te lehtësirave për biznesin.

Aktivitete zbatuese afatshkurtra

- Informatizimi i shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional si një prioritet i qeverisë do të shtrihet në të gjitha zyrat e punësimit rajonale dhe lokale dhe qendrat publike të formimit profesional. Informatizimi i zyrave rajonale do të realizohet në vitin 2012.
- Përgatitja e Planit Kombëtar të Veprimit të mundshme të Punësimit (PKV), për të cilën qeveria (institucionet e tregut të punës) dhe të partnerëve socialë do të shpërndajnë burimet dhe të përkushtuar.
- Shpërndarja në të gjithë vendin e qasjes së klubeve të punësimit duke shtrirë këtë proçes për vitin 2012 në Tiranë dhe Durrës.
- Krijimi i një partneriteti lokal për punësimin dhe partneritetit publik privat për të mbështetur grupet e synuara që të integrohen në tregun e punës**.**
- Zhvillimi i partneriteteve të qëndrueshme dhe iniciative me partnerët social, SME dhe shoqërisë civile të cilat do të inkurajohen, nëpërmjet skemave të reja për të stimuluar të rinjtë e gratë dhe punëkërkuesit e papunë afatgjatë të promovohen dhe masave për lehtësuar futjen dhe mbajtjen sa më gjatë në tregut të punës te. Skemat e reja do zbatohen për herë të parë në vitin 2012 pasi u miratuan nga Këshilli i Ministrave në janar 2012.

- Plotësimi i kuadrit ligjor-normativ të AFP në mbështetje të të gjitha ndryshimeve reformuese në këtë sektor dhe në mbështetje të ligjit te ri te AFP-së.
    - Ndryshimi i strukturës së AFP në një strukturë të re, (2 +1 +1, 2 +2, 4 vjet) për të krijuar më shumë fleksibilitet dhe më tepër hyrje dhe dalje nga sistemi.
    - Krijimin e mundësive për të siguruar arsimin pas te mesem si një domosdoshmëri që kërkon tregu i punës sot.
    - Pjesëmarrjen e përfaqësuesve të biznesit në bordet e shkollave dhe qendrave për aftësime profesionale, zhvillimi i përshkrimeve profesionale dhe programeve për të përcaktuar kompetencat e duhura dhe aftësitë që nxënësit dhe kursantet duhet të kenë në mënyrë që të jenë më konkurrues në tregun e punës.
    - Hapja e profileve të reja dhe modernizimi i modelit kurrikular, për të rritur shkallën e fleksibilitetit dhe përputhshmërinë me tregun e punës

Masat zbatuese afatmesme

- Përfundimi i proçesit të informatizimit të të gjithë sistemit të shërbimeve të punësimit dhe krijimi i bankës së të dhënave të punëkërkuesve dhe punëdhënësve on line;
- Krijimi Fondit Kombëtar të Punësimit sipas ligjit nr. 7995 datë 20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit";
- Hartimi i strategjisë së re sektoriale të punësimit dhe formimit profesional në mbështetje të strategjisë evropiane të punësimit dhe linjave udhëzuese të BE-së;
- Hartimi në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës i strategjisë së të mësuarit gjatë gjithë jetës si një element shumë i rëndësishëm për zhvillimin e burimeve njerëzore nër të ardhmen;
- Rritja e fleksibilitetit të ofertës, mundësive të pranimit, përparimit dhe mobilitetit vertikal e horizontal në AFP, nëpermjet zbatimit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
- Zhvillimi sasior dhe cilësor i objekteve, mjediseve dhe mjeteve mësimore në mbështetje të rritjes së parashikuar cilësore dhe sasiore të ofertës së AFP nëpërmjet rinovimit të mjediseve ekzistuese për mësimin teorik e praktik në shkolla/qendra, duke treguar kujdes për personat me aftësi të kufizuar, pajisjes me bazën e nevojshme materiale/didaktike për mësimin teorik e praktik, institucionalizimit të bashkëpunimit midis AFP dhe biznesit lokal për të shfrytëzuar me efektivitet infrastrukturën e këtyre aktorëve në funksion të përgatitjes profesionale të të rinjve dhe të rriturve.

Gjithashtu në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe në bashkërendim me institucionet e tjera qëndrore si Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit po punohet për hartimin e dokumentave strategjike në fushën e të mësuarit për sipërmarrjen. Nga Analiza e Nevojave për Trajnim, të realizuar në vitin 2010 me mbështetjen e Projektit IPA 2007 “Mbështetje për SME-të për t’u bërë më konkurruese në BE”, nga intervistimi i 250 SME-ve, rezultoi se ndërmarrjet shqiptare kanë nevoja për trajnime kryesisht në fushën e 1) Planifikimit të biznesit dhe menaxhimit strategjik, 2) Menaxhimit të prodhimit, 3) Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, 4)

Menaxhimin e shitjeve/marketingut/eksportit, 5) Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, 6) Kontrollin financiar dhe sistemet për llogaritjen e kostos[10].

Kapitali Fizik

Investimet në infrastrukturën bazë dhe rritja e kapitalit prodhues, si parakushte për zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe rritjen e konkurueshmërisë së sistemit ekonomik shqiptar në tërësi, janë ndër faktorët kryesorë ndikojnë në sigurimin e rritjes ekonomike afatgjatë. Në këtë kuadër, për të siguruar rritjen e konkurueshmërisë, objektivi i politikës ekonomikë në periudhën afatmesme është nxitja e përmirësimit dhe modernizimit të aktiviteteve të sektorit privat.

Shqipëria ka ndërmarrë një sërë masash për të nxitur zhvillimin dhe modernizimin e sektorit privat dhe zgjerimin e bizneseve të reja. Duke kontribuar me 80% në PBB dhe rreth 82% në punësim, sektori privat përbën forcën kryesore lëvizëse të rritjes ekonomike. Duke marrë në konsideratë strukturën industriale dhe përbërjen e sistemit ekonomik shqiptar me përparësi është parashikuar zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, kryesisht në nxitjen dhe zhvillimin e industrive nxjerrëse dhe përpunuese, industrive jo-ushqimore duke u mbështetur në një shfrytëzim sa më racional të burimeve lokale.

Në funksion të zhvillimit të këtyre sektorëve edhe politika fiskale e ndjekur nga qeveria shqiptare duke u bazuar në uljen e barrierave administrative dhe barrës fiskale ka synuar zhvillimin e sektorit privat dhe stimulimin e punësimit dhe kohezionit social.
Në Progres Raportin e vitit 2011, Komisioni Europian shprehet se "*në tërësi, shpenzimet për kapitalin njerëzor dhe fizik janë rritur, megjithatë, duhen investime të mëtejshme për të përmirësuar konkurrueshmërinë e ekonomisë*".

Infrastruktura energjitike

Sektori i energjetikës mbetet një sektor prioritar në politikat e Qeverisë. Sfidat në këtë fushë janë shfrytëzimi i potencialit hidroenergjitik të vendit, diversifikimi i burimeve gjeneruese, integrimi fizik i rrjetit nëpërmjet zhvillimit të linjave të interkoneksionit për energjinë, dhe rrjeteve Rajonale dhe Europiane të naftësjellësve dhe gazsjellësve për furnizimin e vendit me burime energjitike hidrokarbure.
Strategjia e Qeverisë Shqiptare për rritjen e sigurisë së furnizimit të vendit me energji elektrike udhëhiqet së pari nga shfrytëzimi në maksimum i potencialit të madh hidroenergjetik të vendit kryesisht nëpërmjet investimeve private. Pasiguria në furnizimin me energji elektrikë është një nga pengesat e zhvillimit të kapitalit prodhues në vend. Për të nxitur nismën private për investime në ndërtimin e HEC-eve të rinj me konçension, me fuqi deri në 15 MË, qeveria ka autorizuar KESH-in që të blejë të gjithë energjinë elektrike të prodhuar prej tyre, me çmim të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë, sipas një formule nxitëse e cila i referohet çmimeve mesatare të importit të energjisë elektrike plus një bonus 10%. Diferencimi në çmim ndërmjet HEC-eve privat ekzistues dhe atyre që ndërtohen të rinj

[10] Për më tepër informacion, konsultoni Kapitullin 19 "Politika Sociale dhe Punësimi".

është arsyetuar me ndryshimin e madh në vlerën e investimeve ndërmjet këtyre dy kategori objektesh.

Gjithsesi, gjatë viteve të fundit, është shënuar një shkallë e lartë pjesëmarrjeje të investitorëve privatë në sektorin e energjisë. Gjatë vitit 2010, janë vënë në funksionim 17 HEC-e të reja, me kapacitet rreth 65 MW, ndërsa gjatë vitit 2011 janë vënë në funksionim HEC-e të tjerë të rinj me kapacitet prej 34 MW. Gjatë vitit 2012, me mjaft rëndësi është vënia në funksionim të HEC-it "ASHTA" me kapacitet prej 48 MW, dhe kaskadës së lumit Devoll për të cilën kanë filluar punimet.

Projekti i rehabilitimit të veprës hidroteknike në HEC-et kryesore të vendit, do të rrisë në një shkalle të konsiderueshme sigurinë në punë të këtyre objekteve me rëndësi të veçantë duke kontribuar gjithashtu edhe në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike.

Një drejtim i rëndësishëm në funksion të rritjes së sigurisë së furnizimit dhe rritjes së investimeve green field, është diversifikimi i burimeve gjeneruese. Në këtë kuadër përveç TEC-it të Vlorës, janë në proçes realizimi një sërë investimesh private për të ndërtuar parqe eolike në territorin e Shqipërisë, me një fuqi të përgjithshme të instaluar rreth 1,350 MW dhe prodhim të pritshëm vjetor rreth 4.1 TWh, që parashikon një investim rreth 2 miliard Euro.

Lidhur me *integrimin fizik të rrjetit*, zhvillimi i linjave ndërshtetërore të interkoneksionit shënon një hap shumë të rëndësishëm në drejtim të rritjes së sigurisë së furnizimit të vendit me energji elektrike. Gjatë vitit 2011, përfunduan dhe u vendosën nën tension linjat elektrike ajrore të interkoneksionit me Malin e Zi dhe përfundoi vlerësimi i ofertave për linjën Tiranë-Prishtinë, ndërtimi i të cilës pritet të përfundojë brenda vitit 2013. Gjithashtu në vijim, pritet të ndërtohet edhe linja e interkoneksionit me Maqedoninë duke ju shtuar këtyre edhe dy linjat kabllore nënujore të interkoneksionit me Italinë.

Në këtë kuadër, vlerësohet që në periudhën afatmesme, Shqipëria të pozicionohet në mënyrë shumë efektive dhe të sigurte, nga pikpamja e konfiguracionit të sistemeve të transmetimit, në rajonin e tetë energjetik të Europes, duke zgjidhur një sërë problemesh teknike lidhur me sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe kapacitetet e import-eksportit të energjisë[11].

Infrastruktura e Transportit dhe Kanalizimeve

Zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës në tërësi, është një nga objektivat strategjikë të qeverisë shqiptare. Zhvillimi i infrastrukturës do të ndihmojë në rritjen e lëvizshmërisë së njerëzve dhe mallrave, do të afrojë tregjet e për pasojë do të ndihmojë në nxitjen e biznesit, do të rrisë aksesin e njerëzve ndaj shërbimeve elementare por shumë të rëndësishme, si arsimi e shëndetësia duke ndikuar drejtpërdrejt në nivelin e tyre të jetesës, ndërkohë që zhvillimi i rrjetit kryesor kombëtar dhe i rrugëve kufitare, i porteve dhe aeroporteve do të ndihmojnë në integrimin me tregun rajonal dhe me atë Evropian.

Infrastruktura e Transportit

[11] Për më tepër informacion mbi këtë fushë, konsultoni Kapitullin 15 "Energjia".

Ndër reformat kryesore që janë ndërmarrë vitet e fundit nga Qeveria Shqiptare, dhe që aktualisht po vijon, është ndërtimi i një rrjeti rrugor të përshtashëm për një zhvillim më të balancuar në të gjithë vendin. Në përmbushje të detyrimeve që rrjellin nga MSA, të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), P.K.T (të rishikuar) dhe të Strategjisë Sektoriale, synohet krijimi i një rrjeti transporti pa bllokime e ndërprerje, zvogëlimi i hendekut midis tendencës gjithmonë në rritje të mjeteve motorrike dhe ritmeve të zhvillimit të rrjetit rrugor, si dhe zhvillimi i transportit të qëndrueshëm.

Në përmirësimin e infrastrukturës rrugore është synuar integrimi i rrjetit kombëtar të rrugëve në rrjetin e transportit evropian i shoqëruar me rezultate të prekshme në plotësim të politikës për kompletimin e korridoreve rrugore, ndërtimit të rrugëve të reja në territorin shqiptar dhe të realizimit të rrugëve në drejtim të qendrave turistike dhe kufitare si: Ndërtimi i autostradës e konsideruar si "Rruga e Kombit" (Milot-Rrëshen-Kalimash-Rexhepaj-Kukës-Morinë), pjesë e Korridorit Durrës-Kukës-Prishtinë-Nish ose arteria 7 në Rrjetin Kryesor të Transportit të Europës Jug-Lindore; Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve pjesë të rrjetit kryesor rajonal (Core Network/Comprehensive SEETO network) të Korridorit VIII (Korçë-Qafë Plloçë-Qukës, Qafë Thanë-Pogradec, Levan-Vlorë, dublimi By Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë); Korridorit Veri-Jug Shkodër-Hani Hotit, Milot-F.Krujë (Thumanë), Fier (Levan)-Tepelenë, Sarandë-Konispol, Urës së re të Bunës) etj. Ndërsa në mirëmbajtjen e rrjetit rrugor kombëtar është synuar përmirësimi rrënjësor për zhvillimin e sistemit të menaxhimit të aseteve rrugore dhe kryerjen e shërbimit të plotë të mirëmbajtjes me kontraktorë privat mbi bazë performance.

Në zbatim të prioriteteve për zhvillimin e rrjetit rrugor kombëtar, në vijim do të ndërtohen disa arterie të rëndësishme rrugore. Përparësi do të ketë ndërtimi i autostradës Tiranë-Elbasan me tunel, pjesë e rëndësishme e Boshtit Jugor dhe e Korridorit VIII; rrugës së Arbërit (Tiranë-Bulqizë), kompletimi i Korridorit VIII, Veri-Jug dhe ndërtimit të Boshtit Jugor (Elbasan-Berat-Tepelenë), si dhe përmirësimi rrënjësor i sistemit të mirëmbajtjes së rrjetit rrugor kombëtar, përmes dhënies me koncension të shërbimit të mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të autostradës Milot-Morinë.

Në programet e zhvillimit të MPPT krahas Investimeve në Infrastrukturën Portuale ekzistuese, është vlerësuar si domosdoshmëri, ndërtimi me koncesion (duke thithur kapitalin vendas dhe të huaj) i Porteve Private të specializuara, si dhe përfshirja e teknologjive bashkëkohore, si kontejnerët, siloset etj., të cilat rrisin ndjeshëm nivelin e shërbimit dhe efektivitetin e portit. Në Portin e Durrësit është në proces ndërtimi i Terminalit te Pasagjereve ne sheshin e trageteve dhe rehabilitimin e kalatave nr.7 dhe nr. 8. Në Portin e Vlorës është ne procesin ndërtimi i kalatës së re të përpunimit te anijeve traget dhe të kalatës. Në Portin Detar të Sarandës ka filluar ndërtimi i kalatës për anijet turistike Kruiz, e cila parashikohet të përfundojë brenda vitit 2012. Me ketë investim rritet ndjeshëm kapaciteti akostuse dhe përpunues i Portit të Qytetit të Sarandës si një port pasagjeresh dhe turistik. Në Portin Detar Shëngjin ka filluar ndërtimi i kalaten së re të përpunimit te mallrave i cili parashikohet të përfundojë brenda vitit 2012, projekt i cili synon rritjen e kapacitetit të këtij porti

Për më tepër informacion lidhur me prioritetet në fushën e transportit rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror, konsultoni Kapitullin 14 " Politikat e Transportit" dhe Kapitullin 21 "Rrjetet Trans-Europiane".

Ujësjelles-Kanalizime

Shërbimi i ujësjellës kanalizimeve ka qënë organizuar në 55 shoqëri aksionere me pronar Qeverinë Qëndrore të përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe me status të shoqërive anonime. Sot të gjitha këto shoqëri, të vetmet që operojnë në zonat ku shërbejnë, janë transferuar pranë Njësive të Qeverisjes Vendore, dhe janë transformuar në shoqëri tregtare. Meqënëse çmimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe për largimin e ujërave të zeza, të miratuara dhe kontrolluara nga ERRU, janë nën nivelin e kostos së shitjes, me miratimin me VKM nr. 643, datë 14.09.2011, të Strategjisë Kombëtare Sektoriale të Shërbimit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017, janë ndërmarrë disa hapa për përmirësimin e këtij sektori.

Duke synuar orientimin e ndërmarrjeve të ujësjellësit drejt parimeve të kontrollit dhe rekuperimit të plotë të kostos, përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me Acquis, kjo strategji inkurajon bashkimin e ndërmarrjeve të ujësjellsësit, për reduktimin e tyre deri në vitin 2017. Rajonalizimi i shoqërive të ujësjellës kanalizimeve në përputhje me Direktivën e Parlamentit dhe Këshillit të Europës nr. 2000/60/EC, datë 23 korrik 2000 (WFD)[12] për ujin orienton që, numri i shoqërive të ujësjellës kanalizimeve të jetë i njëjtë me numrin e baseneve ujore, pra nga 55 shoqëri në 6 shoqëri në nivel vendor. Për të arritur këtë objektiv, hapi i parë do të jetë me fillimin e zbatimit të një programi që inkurajon bashkimin e ndërmarrjeve të ujësjellsësit, për realizimin e objektivit që deri në vitin 2017 nga 57 sh.a. të kemi 26 ndërmarrje rajonale.

Qeveria ka marrë vendim të nxitë bashkimin e zonave të shërbimit me ujësjellës kanalizime për të arritur ekonominë e shkallës në këtë sektor. Në këtë drejtim, bëhet e detyrueshme hartimi i një ligji organik për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve, që të përcaktojë: statutet dhe pronësinë e ndërmarrjeve rajonale të ujësjellësit si dhe të ndërmarrjeve rajonale të trajtimit të ujërave të ndotur, parimet për inventarin dhe vlerësimin e aseteve, ndarjen e titujve të përdorimit nga e drejta e përdorimit, të drejtat dhe detyrimet e secilit aktor kryesor, pronësinë e përzier publik-privat, strukturat e shërbimeve të bashkuara të shitjes me pakicë, si edhe hyrjen dhe daljen nga tregu.

2.3.3. Struktura e sektorit të ndërmarrjeve

Referuar të dhënave të INSTAT, numri i subjekteve aktive deri në fund të vitit 2010 arriti në 100,687 gjë që tregon një ulje të lehtë krahasuar me vitin 2009. Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta aktive në Shqipëri përbëjnë 2.9% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive në vend. Krahasuar me vitin 2009 shohim një rritje prej 7%.

[12] The Water Framework Directive

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur ndërmarrjet aktive sipas vitit të krijimit. Nga viti 2005 në vitin 2010 ndërmarrjet në Shqipëri janë rritur me rreth 65%.

Tabela 2: Ndërmarrjet aktive sipas vitit të krijimit

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Nr. ndërmarrjeve aktive	**64,710**	**77,814**	**87,484**	**104,750**	**106,477**	**100,687**

Referuar strukturës së tyre, ndërmarrjet aktive për vitin 2010: mikro ndërmarrjet me 1 deri në 9 të punësuar përbëjnë 95.7% të numrit total të ndërmarrjeve aktive, ndërmarrjet e vogla me 10 deri në 49 të punësuar përbëjnë 3.5%, ndërmarrjet e mesme me 50 deri në 249 punonjës zënë 0.7%, dhe ndërmarrjet e mëdha me mbi 250 punonjës zënë vetëm 0.1% të ndërmarrjeve aktive në vend. Nga të dhënat e mësipërme shohim një rënie të lehtë të mikro ndërmarrjeve krahasuar me vitin 2009 si dhe një rritje me 5% të ndërmarrjeve të vogla. Ndërmarrjet e mëdha ngelin të pa ndryshuara krahasuar me vitin 2009. (Graf 1)

Graf.1 Struktura e ndërmarrjeve, 2010



Graf.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas aktivitetit, 2010



Shpërndarja e ndërmarrjeve aktive sipas sektorit ekonomik është: Tregtia 44.4%, hotele, kafe, restorante 15.6%, shërbime të tjera 13.9%, transporti & komunikacioni 10.3%, industria 9.9%, ndërtimi 4.2%, bujqësia dhe peshkimi 1.7%. Krahasuar me vitin 2009 rënie më të madhe ka pësuar sektori i tregtisë me rreth 2.9 %, ndërsa rritjen më të madhe sektori i sektori i transportit me 0.7% dhe sektori i hotele, kafe, restorante me 0.5%. (Graf 2)Në qarkun e Tiranës dhe të Durrësit operojnë mbi 50% të ndërmarrjeve aktive në Shqipëri.Grafiku i mëposhtëm shfaq vendin që zënë ndërmarrjet aktive sipas qarqeve ku vihet re që vetëm në Tiranë janë përqëndruar 38.1% e tyre, ndjekur nga qarku i Durrësit me 12.1%, qarku i Fierit me 9.3% dhe qarku i Vlorës me 8.4%. Krahasuar me vitin 2009 shohim që ka pasur rritje të

numrit të ndërmarrjeve në qarkun e Fierit, Beratit dhe Durrësit, ndërsa qarku i Korçës ka pësuar rënie. (graf.3)

Graf 3. Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta aktive në Shqipëri janë 2924 dhe përbëjnë 2.9% të numrit te përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive në vend. Nga grafiku 4 vihet re se ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta dominojnë në tregti me 31.4%, industria me 24.6% dhe shërbime të tjera me rreth 24%.

Graf 3: Shpërndarja e ndermarrjeve aktive sipas prefekturave, 2010



Graf 4. Shpërndarja e ndërmarrjeve të huaja e të përbashketa sipas sektorëve, 2010



Në funksion të rritjes së konkurueshmërisë, dhe për të përmirësuar klimën e financimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, janë ndërmarrë disa masa për skemat e garantimit të kredive:

Implementimi i skemës së kredive për NVM-të nga programi Italian.

Në kuadër të këtij programi deri në 17 janar të vitit 2012 janë kredituar 64 kompani me një vlerë prej 14,3 milionë euro. Sektorët që financohen janë bujqësia, përpunimi i mermerit granit, prodhimi i këpucëve, përpunimi i mishit, ndërtimet nëntokësore, produktet e aluminit, etj dhe me veprimtari në zonat e Lushnjës, Shkodrës, Korçës, Tiranë, Fierit, Krujës.

Ngritja e skemës së garantimit të kredive për NMV-të.

Në prill 2011 është nënshkruar një marrëveshje me një grup të përbërë nga 6 banka të nivelit të dytë për të lehtësuar hyrjen e bizneseve në skemën e garantimit e kredive prej 2.500.000 Euro, dhe aktualisht është në fazë implementimi pjesa e parë pilot prej 500,000 Euro.

Rritja e Konkurrueshmërisë së kompanive eksportuese nëpërmjet zbatimit të "Skemës së Grantit për Ndarjen e Kostove".

Duke u bazuar në ecurinë dhe rezultatet pozitive të kësaj skeme si dhe për t'i ardhur në ndihmë biznesit eksportues me VKM Nr. 112 datë 17.02.2010, është vendosur Krijimi i Fondit të Konkurueshmërisë edhe për periudhën 2010 - 2012 me një vlerë prej 28,000,000 lekësh për çdo vit. Objektivi kryesor i kësaj skeme është të mbështesë biznesin eksportues shqiptar në përpjekjet e tij për të nxitur dhe rritur eksportet dhe më konkretisht:

- Të ofrojë mbështetje financiare (fonde) për eksportuesit, duke ndarë me ta në masën 50% kostot e projekteve që lidhen me inisiativa për futjen në tregje të rinj ose konsolidimin e tregjeve ekzistuese, plotësimin e standardeve të cilësisë së proceseve të prodhimit dhe të produktit, realizimin e misioneve të biznesit, promovimit të aktiviteteve, etj;
- Të mbështesë dhe intensifikoje atë që kompania është në gjendje të bëjë me kapacitetet e veta, por duke i shtuar "fonde grant" burimeve të kompanisë.

Krijimi dhe implementimi i Fondit të Inovacionit

Në bazë të VKM-së nr. Nr.667, dt 28.09.2011, është miratuar krijimi i fondit të inovacionit, për periudhën 2011-2014 me një vlerë prej 40 milion lekë për 3 vite. Ky fond do të menaxhohet nga BRIC/AIDA dhe do të mbështesë me grante auditimin dhe ndërkombëtarizimin e teknologjisë së kompanive. Granti për një kompani është deri në 400,000 lekë dhe mbulon deri në 50% të projektit. Është hartuar rregullorja e funksionimit të skemës së inovacionit, i cili pritet të miratohet nga bordi i AIDAs.

Fondi i Garantimit të Kredive për Eksport

Me VKM Nr.540, datë 07.27.2011 për ndryshimin e VKM nr.489 datë 25.07.2007 për "Fondin e Garantimit te Kredive për Eksport", e cila i jep të drejtë AIDA-s të jetë institucioni që do të menaxhojë këtë fond. Ky fond lidhet me dhënien e garancive për ndërmarrjet eksportuese, kur ata kanë nevojë për financim afat-shkurtër për të finalizuar marrëveshje me blerësit e huaj.

2.3.4. Ndikimi i Shtetit në konkurueshmëri

Në Shqipëri, pavarësisht skemave të sipërpërmendura për rritjen e konkurueshmërisë dhe për të përmirësuar klimën e financimit të NVM, nuk jepet asistencë financiare specifike për shoqëritë tregtare, ndërkohë që subvencionet aplikohen në një numër të kufizuar sektorësh. Rreth tri të pestat e ndihmës shtetërore janë dhënë në mbështetje të sektorëve të veçantë që ofrojnë shërbime publike dhe më konkretisht sektorit të energjisë, ujit dhe hekurudhave.

Pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, strukturat e ndihmës shtetërore do të përgatisin Raportet për Ndihmat Shtetërore, të cilat pasi të shqyrtohen nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, do të vijojnë proçedurat e miratimit nga Këshilli i Ministrave dhe më pas do të përcillen pranë shërbimeve të Komisionit Evropian. Mbi bazën e këtyre Raporteve vjetore do të jepet një pasqyrë e qartë e subvencioneve, garancive shtetërore dhe instrumenteve të tjera të ndihmës shtetërore për çdo vit.

2.3.5. Integrimi ekonomik dhe konvergjenca me BE-në

Fluksi i *Investimeve të Huaja Direkte (IHD)* të Shqipërisë është rritur ndjeshëm në vitet e fundit duke reflektuar një preferencë në rritje të investitorëve të huaj ndaj faktorëve të prodhimit të Shqipërisë dhe reduktimit të riskut të primeve. Fluksi i IHD është rritur ndjeshëm gjatë pesë viteve të fundit, nga 259 milionë € në 2006 në 832 milionë € gjatë vitit 2010 ose 19,30% me shume krahasuar me vitin 2009. Ndërsa nga të dhënat paraprake të BSH, për 11 mujorin fluksi i IHD arriti shifrën 440 milionë euro, ose 24,7 % më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Pjesa dërmuese e fluksit të IHD gjate vitit 2010 është në formën e kapitalit aksionar 79%, pjesa tjetër është në formën e fitimit të ri investuar, i cili është një tregues i përfitueshmërisë së IHD dhe vendimin e investitorëve të huaj për të investuar fitimet e aktivitetit të tyre në vend.

Sektori i industrisë paraqet sektorin kryesor në tërheqjen e investimeve të huaja për vitin 2010 me 40 %, i ndjekur nga sektori i ndërtimit me 16%, në vend të tretë telekomunikacioni dhe sektorit bankar respektivisht me 15% dhe në fund sektori i shërbimeve me 13% (tabela3).

Tabela 3:Fluksi IHD sipas aktivitet ekonomik viti 2010

Aktiviteti Ekonomik	**2010**	**%**
Agrikultura, gjuetia dhe peshkimi	-	
Ndërtimi	135	16
Industria	332	40
Elektriciteti dhe gazi	7	1
Sektori i shërbimeve	111	13
Telekomunikimet	121	15
Ndërmjetësimi Financiar	125	15
TOTAL	**831**	**100**

Burimi: Banka e Shqipëris

Të dhënat për ndarjen e stokut të IHD sipas sektorëve për vitin 2009 tregojnë se 31 % e këtij stoku është i përqendruar në sektorin financiar, 19 % në sektorin e manifakturës dhe të transportit e telekomunikacionit, 10 % në sektorin e ndërtimit dhe në vend të katërt tregtia me shumicë dhe pakicë me 8% të tij (tabela 4).

Tabela 4 : Stoku IHD sipas aktiviteti ekonomik 2008-2009

Stoku në fund të vitit	**2008**	**2009**	
1. Përshkrimi	2. Mln/Euro	3. Mln/Euro	**4. %**
Agrikultura, gjuetia dhe Pemëtaria	2.6	2.3	0.1
Peshkimi	2.2	3.4	0.1
Minierat	44.4	62.6	2.7
Prodhimi	469.3	440.0	19
Elektriciteti dhe Gazi	(45.7)	61.6	2.7
Ndërtimi	217.3	239.2	10.3
Tregti me shumicë dhe pakicë	184.4	189.9	8.2
Hotele dhe Restorante	94.7	80.7	3.5
5. Transport, magazinim dhe komunikim	6. 461.9	7. 447.2	8. 19.3
9. Ndërmjetësim financiar	10. 663.2	11. 712.0	12. 30.8
13. Pasuri e Paluajteshme, qera dhe aktivitete biznesi	14. 76.8	15. 53.2	16. 2.3
17. Edukim	18. 0.9	19. 0.9	20. 0
21. Shëndetesia dhe Puna Sociale	22. 0.4	23. 1.0	24. 0
25. Shërbime të tjera të komunitetit, sociale dhe personale	26. 2.5	27. 7.8	28. 0.3
29. Ente dhe organizata ekstraterritorriale	30.	31. 15.1	32. 0.7
33. TOTAL	34. 2169.7	35. 2312.3	36. 100

Burimi: Banka e Shqipëris

Numri i ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta sipas të dhënave të INSTAT është rritur vit pas viti. Kështu në vitin 2010 ato janë rritur me 25 % më shumë se një vit më parë.
Sipas vendeve të origjinës së IHD në Shqipëri, vendet fqinje zënë pjesën më të madhe të IHD, ku Greqia zë vendin e parë me 30% të tij, Italia vendin e dytë me 14 %, SHBA vendin e tretë me 11%, Turqia vendin e katërt, 10%, të pestin Austria 9% si dhe Zvicra dhe Qipro me 5 % te stokut IHD deri në fund të vitit 2009.

Tabela 5: Stoku IHD sipas vendeve te origjines 2008-2009

		2008	2009	
Nr.	Vendi	Mln Euro	Mln Euro	Ne %
9	Greqia	693.8	687.8	30
10	Italia	289.4	311.6	14
15	SHBA	243.1	249.6	11
14	Turqia	203.7	219.1	10
2	Austria	185.4	201.2	9
4	Zvicra	118.7	101.8	5
6	Qipro	104.1	113.9	5
5	Republika Çeke	0	95.4	4
7	Gjermania	63.2	71.6	3
1	Emiratet e Bashkuara Arabe	83	70.4	3
12	Hollanda	30	36.1	2
11	Libani	31.5	24.9	1
17	Të tjera			1
8	France	21.3	22.8	1
16	Organizata Ndërkombëtare	25.4	21	1
3	Bullgaria	15.1	15.9	1
13	Sllovenia	9.3	15.2	1
	TOTALI			100

Burimi: Banka e Shqipëris

Shqipëria renditet relativisht lart në renditjen globale të bazuar në Indeksin e Performancës së Fluksit Hyrës të IHD të UNCTAD. Renditja më e fundit në këtë tregues (për vitin 2010) e vendos Shqipërinë në vendin e 18 mes 141 vendeve (tabela 4). Kjo paraqet një përmirësim të shpejtë nga pozita e 80-të e vendit në 2006. Pozita e përmirësuar është pjesërisht rezultat i rritjes së shpejtë të fluksit të IHD në vend, në përgjigje të përmirësimit në mjedisin e biznesit dhe mundësive nga privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore. Ndërsa referuar Indeksit të Potencialit të IHD Hyrëse, Shqipëria renditet në vendin 81 (viti 2009), Indeksi i Potencialit

IHD është i bazuar në 12 tregues, duke përfshirë ndër të tjera nivelin e zhvillimit në përgjithësi dhe të infrastrukturës në veçanti.

Tabela : Renditja e Shqipërisë në Indeksin e Performancës së Fluksit Hyrës të IHD

Viti	2000	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Indeksi i Performancës së Fluksit Hyrës të IHD	58	67	80	53	35	25	18
Indeksi i Potencialit të IHD Hyrëse	101	82	83	82	79	81	

Burimi: UNCTAD WIR 2011

Sipas Raportit të Bankës Botërore, Doing Business 2012, Shqipëria është ndër 16 vendet e para në renditjen botërore për mbrojtjen e investitorëve.

3. AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

3.1. LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

3.1.1. ÇËSHTJET HORIZONTALE

Objektivi strategjik

Levizja e lirë e mallrave është një nga fushat me të rëndësishme për zbatimin e parimeve të ekonomisë së lirë të tregut, ku ndër objektivat strategjik përmendim vendosjen e parimeve të përgjithshme për levizjen e lirë të produkteve, eliminimin e barrierave të panevojshme teknike në tregti, nëpërmjet krijimit të kuadrit të përshtatshem ligjor dhe institucional për tregtimin dhe vendsojen në treg të produkteve të sigurta për konsumatoret.
Në zbatim te nenit 75 të MSA-së Shqipëria është angazhuar në drejtim të harmonizimit të legjislacionit shqiptare me atë evropian në fushat e vleresimit të konformitetit, standardizimit, akreditimit, metrologjise dhe mbikqyrjes së tregut me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe mbajtjes së standarteve të duhura të sigurisë. Ky objektiv do te realizohet nepërmjet:

- përafrimit të legjislacionit në fushën e standardizimit, akreditimit, metrologjise, vleresimit të konformitetit dhe mbikqyrjes se tregut;
- forcimit të sistemit institucional për Infrastrukturen e Cilesise dhe mbikqyrjes se tregut;

Situata aktuale

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) është organi kombëtar në Republikën e Shqipërisë përgjegjes për hartimin, adoptimin, përshtatjen dhe publikimin e standardeve për gjithë sektorët. Stafi është relativisht i trajnuar, pa perfshire fushen e re te adoptimit te standardeve ETSI, per te cilen ka nevoja per forcimin e kapaciteteve.
Aktualisht jane adoptuar mbi 95.5 % e totalit të standardeve europiane (CEN dhe CENELEC) si standarde shqiptare (S SH) dhe 100% standardet e harmonizuara europiane, listat e të cilave botohen në Fletoret Zyrtare. DPS-së eshte e angazhuar ne plotësimin e kushteve për anëtarësim në CEN&CENELEC per te cilin do te aplikoj ne fund te vitit 2012.

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) është organi kombetar përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të akreditimit në Shqipëri, i cili ka akredituar 20 organizma të vleresimit të konformitetit. DPA ka përmirësuar në mënyrë të qendrueshme kapacitetet institucionale të brendshme dhe të jashtme. Vetëm gjatë vitit 2011 janë trainuar 60 persona nga stafi i DPA dhe vleresues të jashtëm.

DPA është anëtare e asociuar pranë Organizates Europiane të Akreditimit (EA) që nga Nentori i vitit 2011. Ajo ka nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe të saj në Greqi, Turqi, Rumani, Kosove, Mal të Zi dhe Maqedoni. DPA ka aplikuar pranë EA për nënshkrimin e Marrëveshjes së njohjes dy-paleshe në fushën e laboratoreve testues dhe pritet te merret opinioni përfundimtar nga grupi i eksperteve vleresues. Dy laboratore kalibrues për masën dhe forcen ne Drejtorine e Pergjithshme të Metrologjise (DPM) kanë

marrë certifikaten e akreditimit nga DPA. Në lidhje me laboratorin e mases, DPM është drejt njohjes nderkombetare te aftesive te tij matese dhe kalibruese.

Me propozim të METE është miratuar një paketë e re ligjore, që shfuqizon ligjin nr. 9779 datë 16.7.2007 "Per sigurine e pergjithshme, kerkesat thelbesore dhe vleresimin e konformitetit per produktet jo ushqimore". Kjo pakete permban 2 ligje me karakter horizontal; ligjin nr.10 480, datë 17.11.2011 "Per sigurine e pergjithshme te produkteve joushqimore", si dhe ligjin nr.10 489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore". Ligji i fundit parashikon parime të përgjithshme, përgjegjesitë e operatoreve ekonomik, prezumimin e konformitetit kundrejt standardeve të harmonizuara shqiptare, parimet për vendosjen e markimit të konformitetit, vlerësimin e konformitetit, deklaratën EC të konformitetit, procedurat e miratimit, parimet e pergjithshme të mbikqyrjes së tregut, etj. Gjithashtu, ky ligj do te sherbeje si baze ligjore per hartimin e rregullave teknike te cilat perafrojne direktivat e Perafrimit te Ri dhe te Vjeter nepermjet Vendimeve te Keshillit te Ministrave.

Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise (DPM) eshte i vetmi institucion publik qe ofron sherbime metrologjike ne Shqiperi dhe pergjegjese per metrologjine shkencore, industrial dhe ligjore. DPM ruan njesite e matjes ne 8 fusha matje dhe siguron gjurmueshmerine e matjeve ne nivelin me te larte nderkombetar.
DPM është anëtarësuar me të drejta të plota në EURAMET, OIML dhe IMEKO, si dhe është anëtare e asociuar e WELMEC dhe BIPM-CGPM.

Baza ligjore dhe perafrimi i legjislacionit

- Ligji 10489, date 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i cili përafron pjeserisht Rregulloren nr. 765/2008/EC e Parlamentit Europian dhe Keshillit date 9 Korrik 2008 "Per vendosjen e kerkesave per akreditimin dhe mbikqyrjen e tregut ne lidhje me tregtimin e produkteve" si dhe Vendimin 768/2008/EC e Parlamentit Europian dhe Keshillit date 9 Korrik 2008 "Nje veshtrim i pergjithshem per tregtimin e produkteve";
- Ligji nr.10480, date 17.11.2011 "Per sigurine e pergjithshme te produkteve joushqimore", i cili perafron pjeserisht direktiven nr. 2001/95/EC e Parlamentit Europian dhe Keshillit date 31 dhjetor 2001 " Mbi sigurine e pergjithshme te Produkteve";
- Ligji nr.9870, datë 04.02.2008 "Për Standardizimin", i cili eshte ne perputhje me parimet dhe rekomandimet e botuara nga KE "Strukturat kryesore administrative te nevojshme per implementimin e acquis – pika 1 – Levizja e Lire e mallrave - Masat Horizontale, germa a) Standardizimi;
- Ligji nr.10384, datë 24.02.2011 "Për disa ndryshime nr ligjin nr.9870, datë 04.02.2008 "Për Standardizimin", i cili i jep kompetencë DPS-së për adoptimin dhe publikimin edhe të standardeve të fushës së telekomunikacionit të publikuara nga Instituti Europian i Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI);
- Ligji nr. 9824 dt 1.11.2007 "Mbi akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë";

- Ligji nr. 9875 datë 14.02.2008 “Për metrologjinë”, i ndryshuar, përafron pjesërisht Direktivën e Keshillit nr.71/316 EEC date 26 korrik 1971 “Per perafrimin e legjislacionit ne lidhje me dispozitat e pergjithshme per instrumentet mates dhe metodat e kontrollit metrologjik” amenduar nga 72/427/EEC; 83/575/EEC; 87/354/EEC; 87/355/EEC; 88/665/EEC (tekst i konsoliduar), si dhe dokumenti D1 i Organizates Nderkombetare te Metrologjise Ligjore (OIML);
- VKM nr.789, datë 22.07.2009 “Për notifikimet në zbatim të Marrëveshjeve për Barrierat Teknike në Tregti dhe të Masave Sanitare dhe Fitosanitare, të Organizatës Botërore të Tregtisë”, i cili eshte ne perputhje te plote me Marrëveshjen e OBT-se mbi “Barrierat Teknike në Tregti”;
- VKM nr.433, datë 05.05.2010 “Për krijimin, përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Bordit Drejtues të DPS-së”;
- VKM nr. 1716 dt 3.10.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”;
- VKM nr. 1160 datë 13.08.2008 “Për miratimin e rregullores për etalonet kombëtare të matjeve” që përafron plotësisht Marreveshja e Njohjes së Ndërsjelltë te Komitetit Nderkombetar i Peshave dhe Masave (e Byrose Nderkombetare te Peshave dhe Masave BIPM) (CIPM MRA) dhe Dokumentin D 8 - Standardet e Matjes. Zgjedhja, njohja, perdorimi, ruajtja dhe dokumentimi te Organizates Nderkombetare te Metrologjise Ligjore (OIML);
- VKM nr. 1162 date 13.08.2008 “Për njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SI”, e cila përafron plotësisht Direktivën 80/181/EEC (32009L0003) “Mbi përafrimin e legjislacionit mbi njësitë e matjeve dhe shfuqizimi i Direktives 71/354/EEC” e ndryshuar me 85/1/EEC, 89/617/EEC dhe 1999/103/EC.(teksti i konsoliduar);
- VKM nr. 1161 datë 13.08.2008 “Rregullore për shishet si enë matesë”, përafron plotësisht Direktiven nr. 75/107/EEC (31975L0107) “Shishet që përdoren si kontenierë mates”;
- VKM nr. 1351, datë 03.10.2008 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike, për instrumentet matëse, ligjerisht të kontrolluara” i cila përafron plotësisht Direktivat e Keshillit: 71/317/EEC “Mbi perfarimin e legjislacionit mbi gramaret drejtkendore 5-50 kg me saktesi mesatare dhe gramaret cilindrike 1-10 kg me saktesi mesatare”, 74/148/EEC “Mbi perafrimin e legjislacionit mbi gramaret nga 1 mg deri ne 50 kg me saktesi mbi mesataren”, 76/765 EEC Mbi perarfimin e legjislacionit mbi alkoolmatesit dhe hidrometerat, 76/766 EEC Perafrimimi i legjislacionit mbi tabelat e alkoolit; 86/217 EEC Perafrimi i legjislacionit mbi presionin e gomave te automjeteve dhe direktiven 71/347 EEC. Perafrimi i legjislacionit mbi matjen e standardit te mases per njesine volumore te grurit;
- VKM nr. 1352 datë 03.10.2008 “Për miratimin e rregullores për parapaketimet”, përafron plotësisht të Direktivës 76/211/EEC për vëllimin ose peshën e disa produkteve të para-ambalazhuara dhe Direktivës 2007/45/EC “Për sasitë nominale të produkteve të para-ambalazhuara”;
- VKM nr. 1576 date 17.10.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”;
- Rregullorja e Brendshme të DPS-së “Për funksionimin e Bordit Drejtues të DPS-së” miratuar nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës datë 12.11.2010;

- Urdhri i Kryeministrit nr. 124 dt. 03.07.2007 "Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Drejtorisë së Akreditimit" si dhe standardeve ndërkombëtarë që përcaktojnë kërkesat e organizmave akreditues";
- Urdhër i Kryeministrit nr. 7 datë 24.01.2012 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë";
- Urdhër i Ministrit METE nr. 195, datë 09.03.2009 "Për verifikimin fillestar dhe pasardhës të instrumentëve matëse ligjërisht të kontrolluara", përafron pjesërisht direktivën kuadër 71/316/EEC për verifikimin fillestar dhe të mëpasshëm të instrumentave matësi;
- Urdhër i Ministrit METE nr. 196, datë 09.03.2009 "Për miratimin e tipit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara", përafron pjesërisht Direktivën kuader 71/316/EEC "Për Miratimin e Llojeve";
- Urdhër i Ministrit METE nr. 538, datë 11.07.2008 "Për përcaktimin e territorit të Qendrave Rajonale";
- Urdhër i Ministrit METE "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Metrologjisë;
- Urdhër i Ministrit METE nr. 192, datë 09.03.2009 "Për përcaktimin e kritereve të përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati për t'u kualifikuar si metrolog i autorizuar";
- Urdhër i Ministrit METE nr. 193, datë 09.03.2009 "Për përcaktimin e procedurave dhe kërkësave për regjistrimin e prodhuesve dhe importuesve të parapaketimeve dhe shisheve enë matese";
- Urdhër i Ministrit METE nr. 194, datë 09.03.2009 "Për miratimin e rregullores për autorizimin e personave juridike për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe për autorizimin e personave juridikë dhe fizike për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumentave matëse";
- Udhëzimi i përbashkët i METE Nr. 7643/3 Prot. Datë 08.12.2009, me Ministrin e Financave Nr. 11965/3 Prot. Datë 11.12.2009 "Për tarifat dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë".

Struktura Institucionale

DPS është institucion publik, jo-fitimprurës, i financuar nga buxheti i shtetit nën varësi të METE me 16 punonjes dhe i drejtuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Bordi Drejtues.
Proçesi i hartimit, adoptimit, miratimit dhe shfuqizimit të standardeve kryhet nëpërmjet 60 Komiteteve Teknike të DPS. Numërohen rreth 150 ekspertë të grupuar në Komitete Teknike dhe Grupe Pune të caktuara, të cilët adoptojnë standarde të të gjitha fushave që publikojnë organizmat europiane të standardeve.
DPA eshte institucion publik, jo-fitimprures ne varesi te METE, i financuar 100% nga buxheti i shtetit me 14 punonjes, i mbeshtetur nga Bordi Keshillimor. Prane DPA operojne 4 Komitete Teknike per fusha te ndryshme te akreditimit. Kjo drejtori mbeshtetet ne ofrimin e sherbimeve te akreditimit nga 6 kryevleresues, 39 vleresues dhe 11 eksperte.
Drejtoria e Mekanizmave te Tregut dhe Ndihmes Shteterore, eshte struktura administrative ne METE ku sektori me 4 punonjes eshte pergjegjes per hartimin e legjislacionit horizontal ne fushen e vleresimit te konformitetit dhe mbikqyrjen e tregut.

Në kuadër të Reformës së Inspektimit dhe konkluzioneve përfundimtare të saj, pritet riorganizimi dhe reduktimi i numrit të inspektoriateve ekzistuese, nga e cila do të përfitohen burime për krijimin e një strukture eficente të mbikëqyrjes së tregut. Deri në krijimin e struktures mbikeqyrese të tregut, Inspektorati Qendror Teknik do të jetë përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve te mbikëqyrjes se tregut për produktet industriale nën përgjegjësinë e METE-s.
DPM është një person juridik, publik, me qendër në Tiranë nen varesi te METE me 120 punonjes dhe e organizuar në 4 (katër) Qendra Rajonale. DPM perbehet nga Drejtoria e Metrologjsë Shkencore dhe Industriale, Drejtoria e Metrologjisë Ligjore, Drejtoria e Inspektimit Metrologjik dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

Masat legjislative afatshkurtra

Ne nje perspektive afatshkurter prioritet ne fushen e vleresimit te konformitetit, standardizimit, akreditimit, metrologjise dhe mbikqyrjes se tregut eshte harmonizmi i legjislacionit kombetar me ate evropian, forcimi i kapaciteteve institucionale, progres i metejshem ne adoptimin e standardeve evropiane, si dhe rritja e ndergjegjesimit te operatoreve ekonomik.

Iniciativat ligjore afatshkurtra

- Projektvendimi "Kodi i përgatitjes, adoptimit, miratimit dhe zbatimit të standardeve".
- Projektvendimi *"Rregull teknik mbi kërkesat thelbesore dhe vlerësimin e konformitetit të instrumenteve jo-automatikë të peshimit"*, që transpozon Direktivën 2009/23 /NAWI.
- Projektvendimi *"Rregull teknik mbi kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të instrumenteve matës"*, që transpozon Direktivën 2004/22/ MID, janë në proces miratimi nga Këshilli i Ministrave.
- Projektvendim mbi amendimin "Për miratimin e rregullores për etalonet kombëtare të matjeve" duke adoptuar kërkesat e Guidave 10 dhe 11 të EURAMET;
- Projektvendimi "Për radarët e shpejtësisë dhe matësit e alkolit në frymëmarrje", në zbatim të Rekomandimeve R 126 dhe R 91 të Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore OIML.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Adoptimi i 97,2 % standardeve Evropiane te CEN, CENELEC ;
- Adoptimi i 10% te standardeve europiane ETSI;
- Adoptimi i 100% te standardeve te harmonizuara europiane;
- Adoptimi i 12.6% i standardeve ISO;
- Adoptimi i 9.5% standardeve IEC;
- Shfuqizimi i standardeve kombëtare që bien ndesh me standardet EN dhe ndjekja e ritmit të shfuqizimeve nga organizmat europiane e ndërkombëtare;
- Organizimi i 3 seminareve ne lidhje me standardet ne fushen prioritare te ekonomise;
- Takimi i pervitshem i Dites Boterore te Standardeve ;
- Përkthimi i standardeve, kryesisht te atyre evropiane, ne shqip;

- Informimi, promovimi, dhe shitja e standardeve;
- Përgatitje materialesh, artikuj, botime e publikime promovuese;
- Takime te drejtpërdrejta me biznesin dhe kompanitë private;
- Trajnime te stafit teknik dhe anëtareve te KT te DPS;
- Pjesëmarrje në punën europiane të standardizimit;
- Ndërtimi i qendrës së re kombëtare të metrologjis;
- Sigurimi i pajisjeve laboratorike për drejtorinë qendrore dhe qendrat rajonale;
- Prezantimi i Sistemit të Cilësisë në TC-Q të EURAMET;
- Sigurimi i transmetueshmerise se matjeve ne nivelet me të larta;
- Përfaqësimi aktiv në strukturat ndërkombëtare e rajonale të metrologjisë, OIML, EURAMET, WELMEC, BIPM, IMEKO;
- Sigurimi i konsulencës metrologjike dhe trainimi i stafit teknik;
- Mbrojta e konsumatorëve dhe rritja e ndërgjegjësimit publik;
- Trainimi dhe kualifikimi i stafit teknik

Iniciativat ligjore afatmesme

- Projektvendimi "Per percaktimin e strukturave përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të mbikëqyrjes së tregut, procedurat standarde të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, si dhe produktet që do të mbikëqyrë secila strukture";
- Rishikim i Ligjit 9875, datë 14.02.2008 "Për metrologjinë";
- Rishikim i paketës se akteve nënligjore në zbatim të Ligjit "Për metrologjinë" me qellim arritjen e perputhshmerise se plotë me acquis communautaire.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Adoptimi i 99% standardeve Evropiane te CEN, CENELEC;
- Adoptimi i 60% te standardeve europiane ETSI;
- Adoptimi i 100% te standardeve te harmonizuara europiane;
- Adoptimi i 19% i standardeve ISO;
- Adoptimi i 16% standardeve IEC;
- Shfuqizimi i standardeve kombëtare që bien ndesh me standardet EN dhe ndjekja e ritmit të shfuqizimeve nga organizmat europiane e ndërkombëtare;
- Organizimi i 5 seminareve ne lidhje me standardet e fushë se ndertimit dhe bujqesise dhe fushave te tjera prioritare te ekonomise;
- Takimi i pervitshem i Dites Boterore te Standardeve
- Përkthimi i standardeve, kryesisht te atyre evropiane, ne shqip;
- Informimi, promovimi, dhe shitja e standardeve;
- Shperndarje materialesh dhe publikime promovuese;
- Tavoline e rrumbullaket me biznesin dhe kompanitë private;
- Trajnime te stafit teknik dhe anëtareve te KT te DPS;
- Pjesëmarrje në punën europiane dhe nderkombetare të standardizimit.
- Venia ne efiçiencë e Qëndrës Kombëtare të Metrologjisë
- Ngritja e fushave të reja të matjes
- Sigurimi i transmetueshmërisë së matjes në nivelet më të larta
- Ngritja dhe funksionimi i Qendrës Rajonale Tiranë

- Pergatitje dhe deklarimi i aftësive matëse dhe kalibruese (CMC)
- Anetaresimi në BIPM dhe pjesëmarrje aktive ne EURAMET, WELMEC, si dhe në Komitetet teknike të OIML-së.
- Trainimi dhe kualifikimi i stafit teknik

Implikimet Financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.1.1 "Ceshtjet horizontale"

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**398.355.000**	**85.300.000**	**85.470.000**	**64.440.000**
Mbulohen nga buxheti i	66.975.000	79.100.000	81.270.000	60.240.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	331.380.000	6.200.000	4.200.000	4.200.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.1.2. DIREKTIVAT E PERQASJES SE VJETER

Objektivi strategjik

Një ndër objektivat më të rëndësishem është eliminimi i barrierave të panevojshme teknike në levizjen e lire të produkteve të Përqasjes së Vjetër, duke përcaktuar kërkesa të njëjta me ato europiane për vendosjen në treg të ketyre produkteve si dhe duke siguruar në këtë mënyre të njëjtin nivel mbrojtje dhe sigurie me ate evropian.
Në zbatim te nenit 70 dhe 75 të MSA-së Shqiperia eshte angazhuar ne drejtim te harmonizimit te legjislacionit shqiptare me direktivat e Perqasjes se Vjeter, nepërmjet:

- përafrimit te legjislacionit shqiptar me ate evropian;
- forcimit te kapaciteteve administrative per permbushjen e kerkesave te MSA-se.

Situata aktuale

Institutucionet pergjegjese per perafrimin e legjislacionit per produktet e Perqasjes se Vjeter jane: METE, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK), Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Mbrojtjes (MM), Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU).
METE luan rol koordinues gjatë adoptimit të rregullave teknike nga ministrite e linjës me qëllim përafrimin e tyre në linjë me parimet e përgjithshme të këtij ligji horizontal. Me propozim të METE është miratuar një kuadër ligjor për detergjentet i cili do të plotesohet plotesisht gjatë vitit 2012.

Me propozim të MBUMK është miratuar një kuader ligjor "Për plehrat e përdorimit për bimësinë", i cili do të plotesohet gjithashtu ne fund te vitit 2012. Perafrimi i plote i kesaj rregulloreje do te realizohet me miratimin e dy vendimeve.

Ministria e Shëndetësisë është institucioni përgjegjës për hartimin e legjislacionit në fushën e kozmetikës dhe barnave per perdorim njerezor.Nuk ka ende një kuadër ligjor ekzistues në fushen e produkteve kozmetike. Në e fushën e produkteve mjekesore per perdorim njerezor (barnave), ekziston nje kuader ligjor qe synojne mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorit në çështjet e sigurisë, zgjedhjes, cilësisë, çmimit, llojshmërisë si dhe transparencen e tregut.

Ministria e Shëndetësisë është ne fazen përgatitore të projekt-VKM –së "Për organizimin, funksionimin dhe statusin e Qendrës së Farmakovigjilencës Shqiptare", e cila po hartohet bazuar ne Direktivën 2001/83/EC e Parlamentit Europian dhe Keshillit e 6 Nëntor 2001 "Mbi Kodin Komunitar lidhur me produktet mjekesore për përdorim njerëzor".

Baza ligjore dhe perafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 10489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i cili përafron pjesërisht Rregulloren nr.765/2008/EC e Parlamentit Europian dhe Keshillit date 9 Korrik 2008 "Per vendosjen e kerkesave per akreditimin dhe mbikqyrjen e tregut ne lidhje me tregtimin e produkteve" si dhe Vendimin 768/2008/EC e Parlamentit Europian dhe Keshillit date 9 Korrik 2008 "Nje veshtrim i pergjithshem per tregtimin e produkteve";
- Ligji nr. 10216 dt 21.01.2010 "Për detergjentët", i cili përafron pjesërisht Rregulloren (EC) 648/2004 për detergjentet dhe amendimet e saj me nr. 907/2006;
- Vendimi nr. 669 dt. 28.09.2011 "Për etiketimin dhe te dhënat e përbërësve për detergjentet", i cili perafron plotesisht Aneksin VII të Rregullores Europiane 648\2004 "Per detergjentet";
- Ligji nr.10390, datë 03.03.2011 "Për plehrat e përdorimit për bimësinë".
- VKM nr. 234 datë 11.05.2000 "Për kriteret dhe rregullat e marrjes së mostrave dhe vlerësimit të plehrave kimike".
- VKM nr. 253 datë 18.05.2000 "Për organizimin e shërbimit të kontrollit të plehrave kimike".
- VKM nr. 233 datë 11.05.2000 "Për mbështetjen e shërbimit të kontrollit të plehrave kimike nga organet e ruajtjes së rendit".
- Rregullore "Për funksionimin e shërbimit të kontrollit të plehrave kimike dhe për kushtet e ruajtjes dhe magazinimit të plehrave kimike.
- Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Marrëveshja Evropiane në lidhje me Adoptimin e kushteve uniforme për inspektimet teknike periodike të mjeteve motorike dhe njohja reciproke e inspektimeve të tilla e 13 Nëntorit 1997, ratifikuar me ligjin nr. 9273, datë 16.09.2004;
- Ligji Nr. 10 432, dt. 16.6.2011, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e rishikuar të Kombeve të Bashkuara, në lidhje me miratimin e parashikimeve teknike uniforme për automjetet, pajisjet dhe pjesët që mund të instalohen dhe/ose përdoren tek automjetet me rrota dhe kushtet për njohjen reciproke

të aprovimeve të dhëna mbi bazën e këtyre parashikimeve". (Marrëveshja e Kombeve të Bashkuara 1958, mbi rregulloret e mjeteve motorike)

- Rregullorja në zbatim të Kodit Rrugor VKM nr. 153, datë 4.7.2000, i ndryshuar;
- Udhëzim i MPPT Nr. 10, dt. 30.5.2011 "Për miratimin e tipit të traktorëve bujqësorë ose të pylltarisë, rimorkiove dhe rimorkiatorëve të tyre të ndërkëmbyeshëm, së bashku me sistemet, pjesët përbërëse dhe njësitë e tyre të ndara teknike perafron plotesisht Direktiven 2003/37/EC te Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 maj 2003 mbi miratimin e tipit të traktorëve bujqësorë ose të pylltarisë, rimorkiove dhe rimorkiatorëve të tyre të ndërkëmbyeshëm, së bashku me sistemet, pjesët përbërëse dhe njësitë e tyre të ndara teknike dhe që shfuqizon Direktivën 74/150/EEC.
- Udhëzim i MPPT nr.11, datë 6.6.2011 "Për miratimin e tipit të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre, të sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësive të veçanta teknike të destinuara për këto mjete", përafron plotesisht Direktiven 2007/46/EC te Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 5 shtator 2007 që vendos një kuadër për aprovimin e mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre, dhe të sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësive të veçanta teknike të destinuara për këto mjete (Direktivë Kuadër)"
- Udhëzim i MPPT nr.12, datë 6.6.2011 "Për miratimin e tipit të mjeteve motorike me dy ose tri rrota" përafron plotesisht Direktiven 2002/24/EC te Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 18 marsit 2002 në lidhje me miratimin e tipit të mjeteve motorike me dy ose tre rrota dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 92/61/EEC.
- Ligji Nr. 9644, datë 20.11.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar i perputhur pjeserisht me Direktivën 89/105/EEC e Këshillit e 21 dhjetorit 1998 ne lidhje me transparencën e masave rregulluese të çmimeve të produkteve mjekësore për përdorim njerëzor dhe përfshirjen e tyre ne kufijtë e sistemeve kombëtare të sigurimeve shëndetësore;
- Ligj nr. 10008 datë 27.10.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar;
- Ligj nr. 10350 datë 11.11.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, i përputhur pjesërisht me Direktivën 2001/83/EC të Parlamentit Europian dhe Keshillit e 6 nentor 2001 "Mbi Kodin Komunitar lidhur me produktet mjekesore per perdorim njerezor", lidhur me Farmakovigjilenën;
- Ligj nr. 10 410, datë 31.03.2011 "Për një ndryshim në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar;
- VKM nr. 543 date 27.07.2011 "Per percaktimin e marzheve te fabrikimit dhe tregtimit te barnave";
- VKM nr. 544 date 27.07.2011 "Per miratimin e Listes se Barnave qe rimbursohen nga Instituti i Sigurimve te Kujdesit Shendetesor dhe masen e mbulimit te cmimit te tyre", e cila shfuqizon VKM nr. 401 date 1.06.2011.
- VKM nr. 62 datë 01.02.2012 "Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Çmimit të Barnave"

Struktura Institucionale

Drejtoria e Mekanizmave te Tregut dhe Ndihmes Shteterore eshte struktura administrative ne METE me nje sektor prej 4 punonjesish përgjegjës për hartimin e rregullave teknike të cilat përafrojne direktivat e Përqasjes së Vjetër në lidhje me detergjentet, qelqin kristal, tekstilet dhe kepucet, me qellim reduktimin e barrierave teknike ne tregti dhe vendosjen ne treg vetem te produkteve te sigurta.

Për mjetet motorike përgjegjës është Drejtoria e Shërbimeve të Transportit Rrugor në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit. Misioni dhe detyrat funksionale të Drejtorisë burojnë nga legjislacioni bazë në fushën e sigurisë së transportit rrugor dhe ndotjes së ambjentit nga mjetet.
Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatoreve eshte pergjegjese per hartimin e legjislacionit ne lidhje me plehrat kimike. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ne varesi te MBUMK kryen kontrolle për vlerësimin e cilësisë së plehrave, përpara vendosjes së tyre në treg dhe gjatë tregtimit, për të garantuar mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe mjedisit si dhe interesave ekonomike të fermerëve. Laboratori Analitik, në varësi të Qendrës së Transferimit të Teknologjisë (QTTB), Fushë-Krujë, kryen analizat e mostrave të marra prej inspektoreve. Ky laborator kryen analiza për tokat, ujërat dhe plehrat kimike. Komisioni i Vlerësimit dhe Regjistrimit të Plehrave bën Vlerësimin dhe Regjistrimin e Plehrave që nuk kanë emertimin EC Fertilizer dhe që përdoren për bimësinë.

Ministria e Shëndetësisë është përgjegjës per fushën e kozmetikës dhe barnave per perdorim njerezor. Sot nuk ka struktura të specializuara për zbatimin e legjislacionit në fushën e kozmetikës.

Në fushën e produkteve farmaceutike, strukturat bazë për zbatimin e legjislacionit janë Drejtoria Farmaceutike e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Shëndetësore dhe Planifikimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave (QKKB), si institucion i specializuar. për analizën regjistrimin, kontrollin e barnave dhe inspektimin farmaceutik. Kapacitetet e dy strukturave janë 69 vetë (5 persona në Drejtorinë Farmaceutike + 64 persona ne QKKB).

Masat legjislative afatshkurtra

Ne drejtim te direktivave te Perafrimit te Vjeter prioritetet do të jenë:

- Te sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së;
- Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të vjeter.

Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativa ligjore e mëposhtme:

- Hartimin e Projektvendimit “Për Standartet, Metodat e testimit lidhur me biodegradueshmërine e detergjentëve dhe vleresimi i rrezikut për lëndet tensioaktive

në detergjentë" i cili perafron Anekset I, II, III, IV dhe VIII te Rregullores Europiane 648/2004 "Për detergjentet" amenduar me Rregulloren e Komisionit Nr.907/2006 date 20 qershor 2006 qe amendon Anekset III dhe VII te Rregullores Nr. 648/2004 te Parlamentit Europian dhe Keshillit "Per detergjentet", ne baze te ligjit nr. 10216 date 21.01.2010 " Për detergjentet" nga METE;

- Hartimin e projektvendimit "Për miratimin e rregullit teknik "Për etiketimin e produkteve te qelqit kristal" i cili përafron plotesisht Direktivën Evropiane 69/493 EEC "Per produktet e qelqit", ne baze te ligjit nr.10489 dt.15.12.2011 "Per tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut te produkteve joushqimore" nga METE;
- Hartimin e projektvendimi "Për miratimin e rregullit teknik "Per etiketimin e materialeve që përdoren në përbërësit kryesor të veshjeve të këmbës në shitje për konsumatorët", i cili përafron plotesisht Direktivën Evropiane 94/11/EC "Per etiketimin e materialeve që përdoren në përbërësit kryesor të veshjeve të këmbës në shitje për konsumatorët", ne baze te ligjit nr.10489 dt.15.12.2011 "Per tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut te produkteve joushqimore" nga METE.
- Hartimin e projektligjit "Mbi aderimin në Marrëveshjen mbi themelimin e rregulloreve globale teknike të mjeteve me rrota, pajisjeve dhe pjesëve te tyre, 1998, nga MPPT.
- Hartimin e projektvendimit "Për rregullat për kërkesat e prodhimit, të etiketimit e të paketimit për vendosjen në treg si dhe tolerancat, lista e tipeve të plehrave me emërtimin "EC Fertilizers" nga MBUMK.
- VKM "Për rregullat për kontrollin, marrjen e mostrave, analizat e procedurat, dhënia e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimi i analizave të plehrave nga MBUMK.
- Projekt ligji "Per produktet kozmetike" i cili do te perafroje Rregulloren Europiane 1223/2009 "Per produktet kozmetike".
- Projekt VKM "Per importimin e barnave te paregjistruara dhe barnave te dhuruara e cila do te perafroje pjeserisht Direktiven Europiane 2001/83/EC dhe Rregullore 141/200/EC.
- Projekt VKM "Per strukturen dhe organizimin e kontrollit te barnave e cila do te perafroje pjeserisht Direktiven Europiane 2001/83/EC .
- Projekt urdher i MSH "Per klasifikimin e barnave" e cila do te perafroje pjeserisht Direktiven Europiane 2001/83/EC.
- Projekt rregullore e MSH "Per reklamën e barnave" e cila do te perafroje pjeserisht Direktiven Europiane 2001/83/EC .

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

MPPT parashikon si aktivitet zbatues afatshkurtër forcimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e legjislacionit në lidhje me mjetet motorike. MSH parashikon si aktivitete zbatuese afatshkurter :

- Përcaktimin e procedurave për importimin e barnave të paregjistruara dhe të dhuruara;
- Riorganizimin e struktures së kontrollit të barnave;
- Njoftimin e palës së inetesit për klasifikimin e miratuar;

- Njoftimin e palës së interesit mbi rregullat e reklames dhe miratim e formulareve-tip të aplikimit për reklame;
- Fuqizim i kapaciteteve administrative nepermjet trajnimit mbi legjislacionin mbi produktet kozmetike;
- Ngritja e strukturave per kontrollin e produkteve kozmetike

Iniciativat ligjore afatmesme

- Hartimin e projektvendimit "Për emërtimin e fibrave textile, etiketimin dhe markimin e fibrave përbërëse te produkteve te tekstilit" e cila do të përafrojë Rregulloren e re evropiane 1007/2011 te dates 27.09.2011 "Për emërtimin e fibrave textile, etiketimin dhe markimin e fibrave përbërëse te produkteve te tekstilit, ne baze te ligjit nr.10489 dt.15.12.2011 "Per tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut te produkteve joushqimore" nga METE;
- Projekt VKM "Per etiketimin e barnave" e cila do te perafroje pjeserisht Direktiven Europiane 2001/83/EC;
- Projekt VKM "Per organizimin e Komiteteve te Etikes" e cila do te perafroje pjeserisht Direktiven Europiane 2001/20/EC.
- Projekt rregullore "Për Praktiken e Mire Klinike" e cila do te perafroje pjeserisht Direktiven Europiane 2001/83/EC dhe Direktiven Europiane 2001/20/EC .
- Projekt VKM "Per listen e lendeve te ndaluara per prodhimin e produkteve kozmetike"
- Hartimi i akteve nenligjore ne zbatim qe ligjit "Per produktet kozmetike"

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatoreve ka parashikuar si aktivitete zbatuese afatmesme:

- Takimet e grupit të punës për hartimin e akteve nenligjore që rrjedhin nga ligji nr. 10390, datë 03.03.2011 "Për plehrat e përdorimit për bimësinë".
- Forcimi i sistemit të monitoimit për kërkesat e prodhimit, etiketimit dhe paketimit të plehrave.
- Zbatimi i masave për vendosjen në treg të plehrave bazuar në levizjen e lirë të plehrave me emërtimin e EC Fertilizer dhe Vlerësimin e Regjistrimin te atyre që nuk kanë emërtimin EC Fertilizer.
- Zbatimi i masave për marrjen e mostrave, analizimin dhe vlerësimin e rezultateve të tyre.

MSH parashikon si aktivitete afatmesme do te nderrmerren aktivitetet e meposhtme zbatuese:

- Organizim i komiteteve te etikes mjekesore;
- Fuqizim i kapaciteteve administrative nepermjet trajnimit mbi legjislacionin dhe zbatimin e Praktikes se Mire Klinike;
- Ngritja e strukturave per kontrollin e produkteve kozmetike;
- Ngritja e laboratoreve perkates ne perputhje me ligjin

Implikimet Financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.1.1 "Direktiva e Perqasjes se Vjeter"

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**195.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	195.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.1.3. DIREKTIVAT E PERQASJES SE RE

Objektivi Strategjik

Objektivi strategjik është eliminimi i barrierave të panëvojshme teknike në lëvizjen e lire të produkteve të Përqasjes së Re, duke përcaktuar kërkesa të njëjta me ato europiane për vendosjen në treg të këtyre produkteve si dhe duke siguruar ne kete menyre te njejtin nivel mbrojtje dhe sigurie me ate evropian.

Në zbatim te nenit 70 dhe 75 të MSA-së Shqiperia eshte angazhuar ne drejtim te harmonizimit te legjislacionit shqiptare me direktivat e Perqasjes se Re, nepërmjet:

- përafrimit te legjislacionit shqiptar me ate evropian;
- forcimit te kapaciteteve administrative per permbushjen e kerkesave te MSA-se.

Situata aktuale

Institucionet pergjegjese per perafrimin e legjislacionit per produktet e Perqasjes se Re jane: METE, MPPT, MSH, MM, MMPAU.

Ligji nr. 10489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joshqimore", krijon bazen ligjore per transpozimin e direktivave te Perqasjes se Re dhe percakton METE, si kordinatore per hartimin e rregullave teknike me qellim harmonizimin e tyre me parimet e pergjithshme te ketij ligji horizontal.

Me propozim të METE janë miratuar nga Keshilli i Ministrave rregulla teknike që transpozojnë plotësisht direktivat e Përqasjes së Re për paisjet elektrike të tensionit të ulet, paisjet e thjeshta nën presion, lodrat, makinerite, paisjet mbrojtese personale, paisjet dhe sistemet mbrojtese ne atmosfera potencialisht shperthyese, ashensoret, paisjet nen presion, boileret me uje te nxehte, paisjet e gazit, frigoriferet, perputhshmerine elektromagnetike, emetimin e zhurmave ne mjedis si dhe instalimet teleferike me shina te ndertuara per te mbajtur njerez.

Me propozim të MITIK është miratuar rregulli teknik për paisjet radio dhe fundore dhe telekomunikacioneve

Baza ligjore dhe perafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 10489, date 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i cili përafron pjesërisht Rregulloren nr.765/2008/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit date 9 Korrik 2008 "Për vendosjen e kërkesave për akreditimin dhe mbikqyrjen e tregut në lidhje me tregtimin e produkteve" si dhe Vendimin 768/2008/EC e Parlamentit Europian dhe Keshillit date 9 Korrik 2008" Nje veshtrim i pergjithshem per tregtimin e produkteve";
- Ligji nr. 8402, date 10.09.1998 "Per kontrrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" i ndryshuar me ligjin nr.9200, date 26.02.2004, ligjin Nr.9794, date 23.07.2007, ligjin, nr.9826, date 01.11.2007, ligjin nr.10137, date 11.05.2009.
- Ligj, Nr.9290, date 07.10.2004 "Per produktet e ndertimit" i ndryshuar me ligjin nr.9825, date 01.11.2007, ligjin nr.10327, date 30.09.2010.
- Ligji nr. 9780 date 16.07.2007 "Per Inspektimin e ndertimit" i ndryshuar me ligjin nr.10240, date 25.02.2010, ligj nr.10323 date 23.09.2010.
- Ligji nr. 9689, datë 05.03.2007 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Marrëveshjen Evropiane për Linjat Hekurudhore Ndërkombëtare Kryesore";
- Ligji nr. 9620, datë 16.10.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes shumëpalëshe "Për ngritjen e një rrjeti hekurudhor, të performancës së lartë, në Evropën Juglindore";
- Ligji nr. 9317, datë 18.11. 2004, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë";
- Ligji Nr. 9126, datë 29.7.2003 "Për përdorimin Civil të Lëndëve Plasëse në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar;
- VKM-ja nr.888 i datës 19.12.2007 "Për miratimin e rregullit teknike "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të lodrave", i cili perafron plotesisht Direktiven nr. 88/378/EEC date 3 maj 1988 "Per perafrimin e legjislacionit ne lidhje me sigurine e lodrave";
- VKM-ja nr. 889 i datës.19.12.2007 "Për miratimin e rregullit teknike "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të enëve të thjeshta nën presion" i cili perafron plotesisht direktiven nr.87/404/EEC te Parlamentit Europian dhe Keshillit date 25 qershor 1987 "Per perafrimin e legjislacionit ne lidhje me enet e thjeshta nen presion";
- VKM-ja nr.73 i datës 28.01.2008 "Për miratimin e rregullit teknike "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve nën presion" i cili perafron direktiven nr. 97/23/EC te Parlamentit Europian dhe Keshillit date 29 maj 1997 "Per perafrimin e legjislacionit ne lidhje me enet nen presion";
- VKM-ja nr. 369 i datës 27.3.2008 "Për miratimin e rregullit teknike "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve te tensionit", i cili perafron plotesisht direktivën e Këshillit 2006/95 EC të datës 12 dhjetor 2006 "Për harmonizimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me pajisjet elektrike për përdorim brenda disa kufijve të caktuar të tensionit";
- VKM-ja nr. 864 i datës 18.06.2008 "Për miratimin e rregullit teknike "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të përputhshmërisë elektromagnetike" i cili

perafron plotesisht direktivën 2004/108/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 dhjetor 2004 "Për përafrimin e legjislacionit të vendeve anëtare në lidhje me Përputhshmërinë elektromagetike";

- VKM-ja nr.1216 i dates 03.09.2008 "Për miratimin e rregullit teknike "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të makinerive" i cili perafron direktiven 2006/42/EC e Parlamentit evropian dhe Këshillit e datës 17 maj 2006 "Për makineritë";
- VKM-ja nr.152 i datës 11.02.2009 "Për miratimin e rregullit teknike "Për kërkesat e eficiencës se energjisë për paisjet e vogla elektronike (drosela) dhe ndricim fluoreshent" i cili perafron plotesisht direktiven 2000/55/EEC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e dates 18 shtator 2000 "Per kerkesat e eficences se energjise per balastrat ";
- VKM-ja nr.141 i datës 11.02.2009 "Për miratimin e rregullit teknike "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisje shtëpiake frigoriferike, ngrirësit dhe kombinimet e tyre në lidhje me kërkesat e eficiencës së energjisë" i cili perafron plotesisht direktiven 96/57/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e dates 18 shtator 2000 "Per kerkesat e eficences se energjise per të pajisje shtëpiake frigoriferike, ngrirësit dhe kombinimet e tyre"
- VKM-ja nr.142 i datës 11.02.2009 "Për miratimin e rregullit teknike "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit mbi pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente (atmosferë) potencialisht shpërthyese" i cili perafron plotesisht direktiven 94/9/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 23 mars 1994 "Për përafrimin e legjislacionit të vendeve anëtare në lidhje me pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyese";
- VKM-ja nr.91 i datës 27.01.2009 "Për miratimin e rregullit teknike "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të ashensorëve" i cili perafron plotesisht direktiven e Parlamentit Evropian dhe Këshillit 95/16/EC e datës 29 qershor 1995 "Për përafrimin e legjislacionit të vendeve anëtare në lidhje me ashensorët;
- VKM-ja nr. 1096 i datës 04.11.2009 "Për miratimin e rregullit teknike "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve mbrojtëse personale" i cili perafron plotesisht direktivën e Këshillit 93/95/EEC të datës 29 tetor 1993, 96/58/EC te dates 3 shtator 1996, qe amendon Direktiven 89/686/EEC "Për përafrimin e legjislacionit të vende anëtare në lidhje me pajisjet për mbrojtje personale (PMP);
- VKM-ja nr.1097 i datës 04.11.2009 "Për miratimin e rregullit teknike "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të boilerëve me ujë të nxehtë që përdoren me gaz" i cili perafron plotesisht direktiven nr. 92/42/EEC "Per boileret e rinj me uje te nxehte";
- VKM nr. 137, dt. 24.02.2010 "Per miratimin e rregullit teknik " Për kerkesat thelbësore dhe vleresimin e konformitetit te pajisjeve te gazit", i cili perafron plotesisht direktivën e këshillit 90/396/EEC të datës 29 qershor 1990 "Për përafrimin e legjislacionit e vendeve anëtare në lidhje me pajisjet që djegin lëndë gazi";
- VKM nr. 1039, dt. 22.12.2010 "Per miratimin e rregullit teknik "Për kerkesat thelbësore dhe vleresimin e konformitetit te instalimeve kabllore per transpost personash", i cili perafron plotesisht direktiven e Keshillit nr.2000/9/ EC date 20 mars 2000 ne lidhje me instalimet kabllore per transpost njerezish;

- VKM nr. 613, datë 7.9.2011 Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve në mjedise të hapura në lidhje me emetimin e zhurmave", i cili përafron plotesisht direktiven nr. 2000/14/EC te Parlamentit Europian dhe Keshillit date 8 maj 2000 "Për harmonizimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me emetimin e zhurmave te pajisjeve në mjedise të hapura;
- VKM nr.331, date 14. 04.2011 "Per miratimin e rregullit teknik "Per kerkesat thelbesore dhe vleresimin e konformitetit te paisjeve radio dhe fundore dhe telekomunikacioneve" i cili përfron plotesisht direktiven 1995/5/EC te Parlamentit Europian dhe Keshillit date 9 mars 1999 "Për paisjet radio dhe fundore dhe telekomunikacioneve";
- VKM Nr.862, date 05.12.2007 "Per unifikimin e proçedurave te kontrollit te territorit nga Inspektorati Ndertimor e Urbanistik Kombetar e ai Vendor"
- VKM nr.58 datë 1.2.2006 Për miratimin e rregullores "Për procedurat e kontrollit të produktit në fabrikë dhe në qendrën e shpërndarjes, për marrjen e certificates së vlerësimit të konformitetit për çimentot, për të cilat ka rëndësi parësore rezistenca dhe qëndrueshmëria" e cila perafron pjeserisht direktivën e Keshillit nr. 89/106/EEC date 21 dhjetor 1988 në lidhje me produktet e ndertimit;
- VKM Nr.279 datë 18.4.2007 Për miratimin e listës së produkteve të ndërtimit, për të cilat kërkohet vlerësimi i detyruar i konformitetit" i ndryshuar e cila perafron pjeserisht direktivën e Keshillit nr. 89/106/EEC date 21 dhjetor 1988 në lidhje me produktet e ndertimit;
- VKM Nr. 525, datë 30.7.2004 "Për procedurën e aplikimit për regjistrimin e lëndëve plasëse në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse për përdorim civil";
- VKM Nr. 469, datë 29.6.2011 "Për procedurën për dhënien e licencave të importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil";
- Urdhër i përbashkët i Ministrit të Mbrojtjes Nr. 107, datë 23.02.2005 dhe Ministrit të Financave Nr.423, datë 21.03.2005 "Për tarifat financiare për dhënien e lejeve të importimit eksportimit dhe prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil",i ndryshuar;
- Urdhër i Ministrit të Mbrojtjes Nr. 315, datë 15.03.2007 "Për miratimin e Rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejeve të importimit eksportimit dhe prodhimit të lëndëve plasëse lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil dhe funksionimit të Komisionit të Dhënies së Lejeve";
- Urdhër i Ministrit të Mbrojtjes Nr. 872, datë 19.06.2009 "Për ndryshimin e përbërjes së Komisionit të Dhënies së Lejëve për lëndët plasëse lëndët piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil";
- Urdhër i Ministrit të Mbrojtjes Nr. 954, datë 06.07.2009 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejeve të importimit eksportimit dhe prodhimit të lëndëve plasëse lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil dhe funksionimit të Komisionit të Dhënies së Lejeve";
- Urdhër i Ministrit të Mbrojtjes Nr. 1106, datë 20.08.2009 "Për regjistrimin e lëndëve plasëse për përdorim civil në Regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse nga AKSHE";
- Ligji Nr. 9126, datë 29.7.2003 "Për përdorimin Civil të Lëndëve Plasëse në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar;

- VKM Nr. 853, datë 17.12.2004 "Për procedurën e dhënies së lejes së importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil";
- Urdhër i Ministrit të Mbrojtjes Nr. 155, datë 21.03.2005 "Për tarifat financiare për dhënien e lejeve të importimit eksportimit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil", i ndryshuar;
- Urdhër i Ministrit të Mbrojtjes Nr. 315, datë 15.03.2007 "Për miratimin e Rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejeve të importimit eksportimit dhe prodhimit të lëndëve plasëse lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil dhe funksionimit të Komisionit të Dhënies së Lejeve";
- Urdhër i Ministrit të Mbrojtjes Nr. 872, datë 19.06.2009 "Për ndryshimin e përbërjes së Komisionit të Dhënies së Lejëve për lëndët plasëse lëndët piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil";
- Urdhër i Ministrit të Mbrojtjes Nr. 954, datë 06.07.2009 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejeve të importimit eksportimit dhe prodhimit të lëndëve plasëse lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil dhe funksionimit të Komisionit të Dhënies së Lejeve".

Struktura Institucionale

Drejtoria e Mekanizmave të Tregut dhe Ndihmes Shteterore, është struktura administrative në METE përgjegjëse për hartimin e rregullave teknike të cilat përafrojne direktivat e Përqasjes së Re për grup produktet nën fushën e veprimtarise se se saj.

Drejtoria e Politikave të Ndërtimit në MPPT është përgjegjës për hartimin e politikave në fushën e ndërtimit në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptarë me atë evropian. Inspektoriati Ndertimor Urbanistik e Kombetar eshte pergjegjes per zbatimin e legjislacionit ne fushen e materialeve të ndertimit.

Sektori i Politikave të Transportit Hekurudhor, në MPPT është njësia rregullatore e përgjithshme e aktivitetit tërësor të transportit hekurudhor. Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor ne varësi te MPPT eshte pergjegjese per kontrollin e zbatimit e legjislacionit ne kete fushe.

Ministria e Shëndetësisë është institucioni përgjegjës në lidhje me hartimin e legjislacionit per pajisjet mjekësore. Në Ministrinë e Shëndetësisë janë përgjegjese për kontrollin e pajisjeve mjekësore: Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet, Sektori i Standarteve dhe Menaxhimit të Teknologjise Mjekësore, i përbërë nga tre specialiste te pajisjeve mjekësore, Agjencia Shtetërore e Pajisjeve Mjekësore funksionet e se ciles pjesërisht i kryen Qendra Bio-mjekësore ekzistuese, si dhe Njësitë e Inxhinierisë Klinike në nivel spitali rajonal.

Ministria e Mbrojtjes është institucioni përgjegjës për hartimin e legjislacionit, dhënien e lejes së prodhimit, importimit dhe eksportimit të lëndëve pirotknike dhe fishekzjarre për përdorim civil në Republikën e Shqipërisë. Ministria e Brendshme është institucioni përgjegjës për transferimin, magazinimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse për përdorim ci lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë për përdorim civil vil;

Masat legjislative afatshkurtra

Në drejtim të direktivave të Perafrimit te Vjeter prioritetet do të jenë:

- Te sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së.
- Të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri.

Iniciativat ligjore afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat ligjore të mëposhtme:

- Hartimin e projekt VKM se re "Per miratimin e e rregullit teknik "Per kerkesat thelbesore dhe vleresimin e konformitetit te lodrave" i cili do te perafrohet plotesisht me Direktiven 2009/48/EC te Keshillit dhe Parlamentit Europian te 18 Qershor 2009 per sigurine e lodrave, ne baze te ligjit nr. 10489 dt.15.12.2011 "Per tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut te produkteve joushqimore" nga METE.
- Hartimin e VKM-se "Per vleresimin e konformitetit te pajisjeve mjekesor"i cili do te perputhet plotesisht me Direktiven e Keshillit 93/42/EEC per Pajisjet Mjekesore (MDD) ne baze te ligjit nr. 10489 dt.15.12.2011 "Per tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut te produkteve joushqimore" nga Ministria e Shendetesise.
- Hartimin e VKM-se "Kerkesat kryesore dhe vleresimin e konformitetit te pajijseve mjekesore active te implantueshme" i cili do te perputhet plotesisht me Direktiven e Keshillit 90/385/EEC per Pajisjet Mjekesore te implantueshme ne baze te ligjit nr. 10489 dt.15.12.2011 "Per tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut te produkteve joushqimore" nga Ministria e Shendetesise.
- Hartimin e VKM-se "Kerkesat kryesore dhe vleresimin e konformitetit te pajisjeve mjekesore diagnostifikuese in vitro" i cili do te perputhet me Direktiven e Keshillit 98/79/EC per Pajisjet Mjekesore Diagnostikuese In Vitro (IVDMD) ne baze te ligjit nr. 10489 dt.15.12.2011 "Per tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut te produkteve joushqimore" nga Ministria e Shendetesise.
- Hartimi VKM "Për miratimin e Rregullit teknik mbi kërkesat thelbesore dhe vlerësimin e konformitetit të instrumenteve jo-automatikë të peshimit", që do transpozoje plotesisht Direktivën 2009/23 /NAWI, ne baze te ligjit nr. 10489 dt.15.12.2011 "Per tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut te produkteve joushqimore" nga METE.
- Hartimi i VKM "Per miratimin e rregullit teknik per kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të instrumenteve matës", që do transpozoje plotesisht Direktivën 2004/22/ MID, në bazë të ligjit nr. 10489 dt. 15.12.2011 "Per tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut te produkteve joushqimore" nga METE.
- Hartimi i amendimit të VKM-se "Për miratimin e rregullores për etalonet kombëtare të matjeve" duke adoptuar kërkesat e Guidave 10 dhe 11 të EURAMET, nga DPM ne METE.
- Hartimi i projektvendimit "Për radarët e shpejtësisë dhe matësit e alkolit në frymëmarrje", në zbatim të Rekomandimeve R 126 dhe R 91 të Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore OIML nga DPM ne METE.

- Hartimi i project rregullores"Per produktet e ndertimit", e cila do te perafroje Regulloren e Parlamentit Europian dhe e Keshillit nr. 305/2011, date 9 mars 2011 "Per parashtrimin e kushteve te harmonizuara per tregtimin e produkteve te ndertimit"nga MPPT.
- Hartimi i Projektvendimit i cili do të transpozojë Direktivën e BE-së 2008/43/EC e 4 Prillit 2008, "Për ndërtimin e një sistemi gjurmimi dhe identifikimi të lëndëve plasëse me përdorim civil" nga MPPT .
- Hartimi i Projektvendimit qe do transpozoje direktivën 2007/23/EC "Mbi vendosjen në treg të Materialeve Piroteknike" nga MPPT.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Nga Ministria e Shendetesise eshte parashikuar si aktivitet zbatues afatshkurter:

- Trajnime të vazhdueshme të personelit teknik dhe mjekesor si dhe përdoruesve të tjere të pajisjeve mjekesore për një përdorim sa me të sigurtë dhe eficent.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Nga Ministria e Shëndetësisë është parashikuar si aktivitet zbatues afatmesem:

- Trajnime te vazhdueshme te personelit teknik dhe mjekesor si dhe perdoruesve te tjere te pajisjeve mjekesore per nje perdorim sa me te sigurte dhe eficent
- Forcimi i rolit te Njesive te Inxhinierise Clinike ne Spitalet Rajonale for nje permiresim te vazhdueshem te menaxhimit te pajiajeve mjekesor
- Krijimi i sistemit kombetar te incidenteve per raportimin e incidenteve qe ndodhin gjate perdorimit te pajisjeve mjekesore

Efektet Financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.1.1 "Direktiva e Perqasjes se Re"

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**2.260.000**	**500.000**	**500.000**	**500.000**
Mbulohen nga buxheti i	2.260.000	500.000	500.000	500.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.1.4. TRASHEGIMIA KULTURORE

Objektivi strategjik

Trashëgimia kulturore është pasuri e brezave, vijimësia materiale dhe shpirtërore e një kombi. Si e tillë, trashëgimia kulturore është një sfidë e pareshtur për të ruajtur gjurmët e gjeniut krijues mbarëshekullor dhe për ta përcjellë atë drejt ardhmërisë. Ajo përbëhet nga vlera materiale (momunente kulture, site arkeologjike, qendra historike etj) si dhe nga vlera

shpirtërore sic janë gjuha, folklori gojor dhe muzikor traditat dhe besimet e të gjitha llojeve, dhe zejet.

Situata aktuale

Aktualisht, cështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore, rregullohen me ligjin nr. 9048 dt. 7.4. 2003, "Për trashëgiminë kulturore", si dhe nga ligji nr. 9386 dt. 04.05.2005, "Për muzetë". Çështja e kthimit të një objekti të marrë ilegalisht nga një shtet anëtar i BE, në vendin e origjinës, nuk rregullohet shprehimisht nga dy ligjet e mësipërme. Ligji nr. 9048 dt. 7.4. 2003 "Për trashëgiminë kulturore", objekti i të cilit janë vlerat e trashëgimisë kulturore, nuk është i përafruar me Direktivën 93/7/EEC të 15 Marsit 1993 (31993L0007) mbi kthimin e objekteve të zhvendosura ilegalisht nga territori i një Shteti Anëtar.

Aktualisht në ligjin "Për trashëgiminë kulturore", janë përfshirë detyrimet që burojnë nga Direktivat e mësipërme. Projektligji është në proces konsultimi me gjithë institucionet përkatëse si publike dhe private. Krahas kësaj, me VKM nr. 917 dt. 28.12.2011 është miratuar nga Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me MTKRS një Plan Veprimi Kombëtar "Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të veprave të artit të kulturës" plan në të cilin parashikohen aktivitete të ndryshme në lidhje me ndërgjegjësimin, trajnimin dhe luftën në tërësi të zhvendosjes së paligjshme të pasurive kulturore.

Gjithashtu, në Strategjinë Kombëtare të Kulturës që do të miratohet brenda vitit 2012, një kapitull i vecantë i dedikohet ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

Struktura institucionale

Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore (DTK) në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, është strukturë politikëbërëse që përcakton prioritetet e zhvillimit dhe ruajtjes në këtë fushë, prioriete të cilat i zbaton përmes institucioneve teknike në varësi të saj.

Gjithashtu, kjo drejtori orienton investimet e ndryshme të buxhetit të shtetit për monumentet e kulturës, sitet arkeologjike e muzetë, si dhe financon një sërë aktivitetesh që synojnë të promovojnë vlerat e kësaj trashëgimie përmes festivaleve, botimeve, panaireve, ekspozitave etj.

Masat legjislative afatshkurtra

Amendimi i projektligjit "Për trashëgiminë kulturore" i cili do te transpozoje plotesisht :

- Direktiven nr. 93/7/EEC date 15 mars 1993 "Për kthimin e objekteve kulturore larguar në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar" ;
- Direktiven nr.96/100/EC te Parlamentit Europian dhe Keshillit e cila amendon aneksin e Direktives 93/7/EEC "Për kthimin e objekteve kulturore larguar në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar";

- Rregulloren e komisionit nr.752/93 date 30 mars1993 parashtrimi I dispozitave për zbatimin e Rregullores së Këshillit nr. 3911/92 " Për eksportin e mallrave kulturore";
- Rregulloren së Këshillit nr. 3911/92 "Për eksportin e mallrave kulturore";

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Fuqizimi institucional dhe përmirësimi i kapaciteteve të stafit të Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.
- Organizimi i një trajnimi me punjonjës të kësaj qendre pranë Policisë së Trashëgimisë Kulturore Italiane e parashikuar brenda vitit 2012.

Masat legjislative afatmesme

Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore për eksportin e pasurive kulturore.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Hartimi dhe vënia në funksion e regjimit te liçencave te eksportit te pasurive kulturore.

3.2. LIRIA E LËVIZJES SË PUNËTORËVE

3.2.1. AKSESI NË TREGUN E PUNËS

Objektivi strategjik

a. **Hyrja e shtetasve të huaj në tregun shqiptar të punës**

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në Strategjinë e saj për punësimin e të huajve në Shqipëri, ka për qëllim zbatimin e një strategjie ku të përcaktohet ushtrimi efektiv i së drejtës së punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre për lëvizje të lirë, punësim, dhe sigurimin e mbrojtjes dhe asistencës në kuadrin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së dhe të detyrave, që i dalin Qeverisë shqiptare për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Ky qëllim po realizohet nëpërmjet:

- Përmirësimit të legjislacionit Për të huajt në Shqipëri
- Forcimit institucional dhe zhvillimit të kapaciteteve institucionale të zyrave të punësimit

b. **Hyrja e shtetasve shqiptarë në tregun e punës të shteteve anëtare**

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) është institucioni i cili harton dhe ndjek zbatimin e politikave të nevojshme në fushën e emigracionit për motive punësimi. Në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme ajo menaxhon dhe mbikëqyr të gjitha aspektet e emigrimit për motive punësimi[13]. MPÇSSHB ushtron funksionet e veta për të ngritur shërbime për përkujdesjen ndaj emigrantëve shqiptarë para largimit nga vendi dhe gjatë rikthimit të tyre në Republikën e Shqipërisë. MPÇSSHB është institucioni që propozon nënshkrimin e marrëveshjeve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të vendeve të tjera në fushën migratore, në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore të fushës.

MPÇSSHB ka koordinuar punën për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe planit të saj të veprimit 2005-2010, miratuar përkatësisht, me Vendim të Këshillit të Ministrave, me numër 760, më 19 Nëntor 2004 dhe VKM Nr. 296, datë 06.05.2005. Kjo strategji ndërsektoriale afatmesme synonte të siguronte një politikë më të plotë për migracionin, nga një politikë që kryesisht ka reaguar në luftën ndaj flukseve të parregullta në një politikë më të plotë bazuar në menaxhimin e migracionit, dhe në mënyrë të veçantë të flukseve të emigracionit. Strategjia Kombëtare për Migracionin ka përfunduar dhe në dhjetor 2010-s u hartua raporti përfundimtar i monitorimit të saj. Një vend të rëndësishëm në këtë strategji zinin edhe marrëveshjet dypalëshe të punësimit ndërmjet vendit tonë dhe shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për sigurimet shoqërore me vendet me një numër të madh emigrantësh shqiptarë.

MPÇSSHB me qëllim nxitjen e bashkëpunimit të ndërsjellë me shtetet anëtare, në zbatim edhe të detyrimeve të MSA, ka nënshkruar me shtetin Italian në 2 dhjetor 2008,

[13] Ligji Nr. 9668, datë 18.12.2006 "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi", (i ndryshuar)

"Marrëveshjen e bashkëpunimit në fushën e punës si dhe protokollin e saj të zbatimit"[14]. Me synim lehtësimin e hyrjes dhe qëndrimit për motive punësimi Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta së bashku me institucione të tjera si Ministria e Brendshme (MB), Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), Ministria e Punëve te Jashtme (MPJ) etj, kanë negociuar dhe kanë finalizuar me palën franceze tekstin e një Marrëveshjeje që ka në fokus lehtësimin e qarkullimit të të rinjve të dy vendeve tona. Kjo marrëveshje është miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendim Nr. 157, datë 2.3.2011 "Për miratimin në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze, për qarkullimin e të rinjve". Aktualisht, jemi ende në pritje të nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje. Ka filluar puna për hartimin e Strategjisë së re Kombëtare për Migracionin 2013-2018. Për këtë ka dalë Urdhri i Kryeministrit Nr. 103, datë 20.12.2011 "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2013-2018". MPÇSSHB është institucioni i cili koordinon punën për hartimin e kësaj strategjie. Grupi ndërinstitucional i punës për hartimin e strategjisë së re do të kryesohet nga zëvendësministri i MPÇSSHB, por në varësi të problematikës edhe nga përfaqësuesit e MPJ dhe MB. Për hartimin e kësaj strategjie do të bashkëpunohet ngushtë me organizatat ndërkombëtare që punojnë në këtë fushë si dhe akademikë e shoqërinë civile. Strategjia e re, ndër të tjera, do të synojë të plotësojë realizimin e disa masave të paplotësuara të strategjisë së mëparshme si dhe do të ketë në vëmendje edhe çështje të cilat lidhen me marrëveshjet dypalëshe për sigurimet shoqërore si dhe marrëveshjet e punësimit

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

a. **Hyrja e shtetasve të huaj në tregun shqiptar të punës**

Përsa i përket përputhjes së legjislacionit tonë me atë të BE-së, (për punësimin e shtetasve të BE-së në vendin tonë pa aplikuar për leje pune), kuadri ligjor do të amendohet me qëllim adresimin e rekomandimit për dhënien prioritet qytetarëve të BE-së në tregun e punës, që nënkupton punësimin e tyre pa aplikuar për leje pune dhe trajtimin e tyre pa asnjë dallim nga qytetarët shqiptarë.

Zhvillimet e fundit për këtë çështje lidhen me daljen e një urdhri të përbashkët me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Jashtme, (të iniciuar nga MB), Nr. 1848, datë 15.12.2011 "Për ngritjen e grupit ndërministror të punës për përgatitjen e ndryshimeve në Ligjin Nr. 9959, datë 17.7.2008 "Për të Huajt" si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, në përputhje me rekomandimet e BE-së në kuadër të vlerësimeve për anëtarësim të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Një nga përmirësimet që rekomandohet të bëhet në Ligjin për të Huajt, është ai për dhënien prioritet të huajve qytetarë të BE-së që të mos aplikojnë për leje pune, sepse përafrimi është i

[14] Miratuar me VKM Nr. 876, datë 12.12.2007 "Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë në fushën e punës dhe të Protokollit Ekzekutiv të Marrëveshjes"(E ndryshuar).

pjesshëm lidhur me punësimin e tyre, mbasi janë të detyruar të aplikojnë për leje pune për t'u punësuar në Republikën e Shqipërisë.

Pas vlerësimit të nevojave, Sporteleve të Migracionit i është ofruar mbështetje me pajisje për zyrat si dhe me materiale informative. Për të fuqizuar më tej kapacitetet, 36 Sportelet e Migracionit si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit janë pajisur me kompjuterë dhe akses interneti.

Janë organizuar trajnime për punonjësit e 36 Sporteleve të Migracionit. Objektivi kryesor i këtyre trajnimeve ka qenë rritja dhe forcimi i profesionalizmit të punonjësve të Sporteleve të Migracionit në ushtrimin e detyrave të tyre për intervistimin, identifikimin e nevojave, dhënien e informacionit dhe referimit për migrantët që paraqiten pranë Sporteleve të Migracionit.

b. **Hyrja e shtetasve shqiptarë në tregun e punës të shteteve anëtare**

Ka filluar puna për zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me Italinë. Është ngritur në Tiranë, Zyra Italiane Vendore e Koordinimit, strukturë e parashikuar në Memorandum. Edhe pse është miratuar me VKM Nr. 157, datë 2.3.2011 "Për miratimin në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze, për qarkullimin e të rinjve", ende nuk është bërë nënshkrimi i saj. Aktualisht jemi duke ndjekur procedurat me strukturat përgjegjëse për nënshkrimin sa më shpejt të saj.

Në dhjetor 2010, është hartuar Raporti përfundimtar monitorues për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionin 2005-2010. Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit Nr. 103, datë 20.12.2011 "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2013-2018" për hartimin e Strategjisë së re Kombëtare për Migracionin ka filluar puna me institucionet e përfshira për organizimin e takimeve dhe fillimin e procesit të hartimit të këtij dokumenti.

Gjatë vitit 2010 është punuar për përditësimin e paketave informative të 36 shteteve, 27 shtetet anëtare dhe shtete të tjera që përbëjnë interes për hyrje dhe qëndrim për punësim për shtetasit shqiptarë. Të 36 Sportelet e Migracionit në Zyrat Rajonale dhe Vendore të Punësimit janë pajisur me paketa informative. Punonjësit e sporteleve janë trajnuar për shpërndarjen e këtij informacioni shtetasve shqiptarë të interesuar. Kjo punë është bërë në bashkëpunim me IOM në kuadër të një projekti i cili ka në fokus forcimin e kapaciteteve të sporteleve.

Gjatë periudhës 2010 – 2011, është punuar dhe janë arritur edhe:

- Nënshkrimi në 19 Korrik 2011, i "Memorandumit të Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale të Republikës Italiane dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të Republikës së Shqipërisë në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për Migracionin e Punës të nënshkruar në 2 dhjetor 2008";
- Miratimi i Urdhrit të Kryeministrit Nr. 103, datë 20.12.2011, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2013-2018";

- Miratimi i marrëveshjes dypalëshe me shtetin francez me VKM Nr. 157, datë 2.3.2011 "Për miratimin në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze, për qarkullimin e të rinjve".

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

a. **Hyrja e shtetasve të huaj në tregun shqiptar të punës**

Në Ligjin aktual "Për të Huajt", Nr. 9959, datë 17.7.2008, në nene të veçanta synohet përfshirja dhe zbatimi i angazhimeve të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në kuadrin e Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit dhe të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Gjithashtu në këtë ligj, janë pasqyruar edhe dispozita të *acquis*-së së Bashkimit Evropian, në fushën e migrimit, rekomandime të fundit të BE-së, sidomos të Direktivës të Komisionit Evropian (CCOM/2001/386final-CNS 2001/0154, Brussels, 11 July 2001) "Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve nga një vend i tretë me qëllim ushtrimin e aktiviteteve ekonomike, si punëmarrës, apo të vetëpunësuar". Përafrimi është i pjesshëm lidhur me punësimin e të huajve shtetas të BE-së, të cilët janë të detyruar të aplikojnë për leje pune për t'u punësuar në Republikën e Shqipërisë.

Procedurat dhe dokumentacioni për përcaktimin e kritereve, për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës për të gjitha tipat e lejeve të punës janë përcaktuar me Vendime të Këshillit të Ministrave. Janë gjithsej 15 VKM të cilave ju referohen zyrat e punësimit rajonale dhe vendore si dhe DPSHKP, për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejeve të punës për të gjitha tipat e lejeve të punës.

Më poshtë jepet lista e plotë e 15 VKM-ve, në fuqi në zbatim të Ligjit për të Huajt:

- VKM nr. 348, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për A/NK (Punëtorë ndërkufitarë);
- VKM nr. 349, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për A/PS (Punëtorë stinorë)";
- VKM nr. 350, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për A/SH (Shërbime vullnetare)";
- VKM nr. 351, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për B/VP Veprimtari të pavarur ekonomike si i vetëpunësuar";
- VKM nr. 352, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për A/AF (Anëtarë të familjes)";
- VKM nr. 353, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për A/S (Studente)";

- VKM nr. 354, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për raste të veçanta- Tipi C";
- VKM nr. 355, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për B/I (Veprimtari të pavarur ekonomike si investitor)";
- VKM nr. 356, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për A/TN (Të transferuarit brenda ndërmarrjes)";
- VKM nr. 357, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për leje pune të vazhdueshme Tipi D";
- VKM nr. 358, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për A/FP (Arsimin profesional)";
- VKM nr. 359, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për punëmarrës A/P";
- VKM nr. 360, datë 6.3.2009 "Për dokumentacionin dhe procedurën për përjashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune";
- VKM Nr. 467, datë 29.6.2011 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurave për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës së tipit C/SP (për sportistët);
- VKM Nr. 518, datë 6.7.2011 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurave për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës së tipit C/SHP (për punëtorët shtëpiakë).

Struktura institucionale

a. Hyrja e shtetasve të huaj në tregun shqiptar të punës

Sipas Ligjit për të Huajt, Autoriteti shtetëror qendror, përgjegjës për trajtimin e marrëdhënieve të punësimit të të huajve në Shqipëri, është Drejtoria e Politikave të Migracionit në MPCSSHB dhe autoriteti shtetëror përgjegjës, në nivel qendror është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe në nivel rajonal dhe vendor, për punësimin e të huajve, është zyra rajonale dhe vendore e punësimit.

Është konkretisht përgjegjësia e zyrave përkatëse të punësimit që sipas Ligjit "Për të Huajt" dhe VKM-ve në zbatim të tij, për pajisjen me leje pune të të huajve, të kryejnë me përgjegjësi detyrat si më poshtë:

- të presin personat e interesuar për pajisje me leje pune për të huajin;
- të japin informacionin e duhur për çdo paqartësi rreth procedurave për pajisje me leje pune;
- të shqyrtojnë dokumentacionin përkatës dhe të pranojnë, ose të bëjnë vërejtjet e duhura bazuar në ligj dhe VKM, për ta pranuar brenda afatit të lejuar në VKM;

- të respektojnë afatet sipas VKM-së përkatëse për pajisjen me leje pune të të huajit;
- të evidentojnë në kohë lejet e punës duke i regjistruar në regjistrin elektronik;
- një kriter i rëndësishëm që duhet të zbatohet nga zyrat e punësimit është ai i vlerësimit të tregut të punës sipas Nenit 40 "Nevojat e tregut të punës për punëmarrësit" të Ligjit "Për të Huajt".

b. **Hyrja e shtetasve shqiptarë në tregun e punës të shteteve anëtare**

MPÇSSHB është institucioni i cili harton dhe ndjek zbatimin e politikave të nevojshme në fushën e emigracionit për motive punësimi. Në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme ajo menaxhon dhe mbikëqyr të gjitha aspektet e emigrimit për motive punësimi[15]. MPÇSSHB ushtron funksionet e veta për të ngritur shërbime për përkujdesjen ndaj emigrantëve shqiptarë para largimit nga vendi dhe gjatë rikthimit të tyre në Republikën e Shqipërisë. MPÇSSHB është institucioni që propozon nënshkrimin e marrëveshjeve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të vendeve të tjera në fushën migratore, në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore të fushës.

Masat legjislative afatshkurtra

a. **Hyrja e shtetasve të huaj në tregun shqiptar të punës**
- Përmirësimi i legjislacionit për të huajt konform rekomandimit të KE-së , për dhënien akses të huajve shtetas të BE-së në tregun e punës , për t'u punësuar në Republikën e Shqipërisë pa aplikuar për leje pune, është masa ligjore që parashikohet të diskutohet në grupin e punës së ngritur për përmirësimin e Ligjit "Për të Huajt" brenda tremujorit të parë të këtij viti.
- Përmirësime të tjera ligjore, si rrjedhim i ndryshimit të legjislacionit për të huajt nga ministritë e tjera.

b. **Hyrja e shtetasve shqiptarë në tregun e punës të shteteve anëtare**
- Nënshkrimi i marrëveshjes për lehtësimin e qarkullimit të të rinjve me shtetin francez.

Aktivitetet zbatuese

a. **Hyrja e shtetasve të huaj në tregun shqiptar të punës**
- Vazhdimi i aktiviteteve të trajnimit për forcimin e kapaciteteve të personelit për ofrimin e shërbimeve ndaj migrantëve, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM Tirana).
- Vazhdimësi e forcimit të kapaciteteve me pajisje dhe mjete pune për Shërbimin Kombëtar të Punësimit, Zyrat Rajonale të Punësimit dhe Zyrat Vendore të Punësimit sipas nevojave, mbështetur gjithashtu nga Organizata Ndërkombëtare e Migracionit në Tiranë (IOM).

b. **Hyrja e shtetasve shqiptarë në tregun e punës të shteteve anëtare**
- Zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale të Republikës Italiane dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të Republikës së Shqipërisë në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për Migracionin e Punës, i nënshkruar më 19 korrik 2012.

[15] Ligji Nr. 9668, datë 18.12.2006, "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi", (i ndryshuar)

- Ndjekja e procesit të nënshkrimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze, për qarkullimin e të rinjve.
- Krijimi i një database eficente për mbledhje të dhënash për shtetasit shqiptarë që duan të punojnë jashtë vendit, në shërbim të qasjes kërkesë - ofertë. Jemi duke punuar aktualisht për këtë në kuadër të zbatimit të marrëveshjes me shtetin Italian.
- Organizimi i takimeve dhe tryezave të rrumbullakëta për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2013-1018.

Masat legjislative afatmesme

a. **Hyrja e shtetasve të huaj në tregun shqiptar të punës**

- Në vazhdimësi do të synohet për përditësimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me atë evropian dhe zbatimin e plotë të tij, lidhur me çështjet e punësimit që mbulon MPCSSHB.

b. **Hyrja e shtetasve shqiptarë në tregun e punës të shteteve anëtare**

- Miratimi i P/VKM "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2013 – 2018".

Aktivitetet zbatuese

a. **Hyrja e shtetasve të huaj në tregun shqiptar të punës**

- Aktivitetet për forcim kapacitetesh dhe koordinim ndërinstitucional do të realizohen në vazhdimësi në përputhje me ndryshimet që mund të realizohen në legjislacion dhe kërkesat për forcim kapacitetesh nga zyrat përkatëse të punësimit.

b. **Hyrja e shtetasve shqiptarë në tregun e punës të shteteve anëtare**

- Zbatimi i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze, për qarkullimin e të rinjve;
- Zbatimi i Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë në fushën e punës dhe të Protokollit Ekzekutiv të Marrëveshjes;
- Analiza e situatës së tregut të punës në shtetet anëtare të BE –së dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të reja dypalëshe të punësimit, menaxhimit të flukseve migratore, etj.
- Organizimi i takimeve dhe tryezave të rrumbullakëta për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2013-1018.
- Fillimi i zbatimit të Strategjisë së re Kombëtare për Migracionin 2013-2018.

Implikimet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**70.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	70.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.2.2. BASHKËRENDIMI I SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Objektivi strategjik

Parë në aspektin e integrimit në instrumentet bi dhe multilaterale ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes shoqërore, konkludimi i marrëveshjeve bilaterale dhe aderimi në marrëveshjet evropiane e më gjerë, në fushën e sigurimeve shoqërore, janë midis objektivave të rëndësishme të parashikuara në Programin e Qeverisë për sigurimet shoqërore.

Koordinimi i sistemit të mbrojtjes shoqërore për punonjësit nga shtetet anëtare të BE-së të punësuar në territorin shqiptar, si dhe adaptimi i sistemit të sigurimeve shoqërore me kërkesat e reja ekonomike e sociale, nëpërmjet bashkëpunimit me palët. (Nenet 46, 47, 48, 80 dhe 99 të MSA-s). Nga ky këndvështrim, janë ndërmarrë hapa konkrete për realizimin e marrëveshjeve bilaterale, kryesisht me shtetet fqinje ku është edhe numri më i madh i emigrantëve shqiptarë.

Gjithashtu miratimi i ligjit "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor", përpunimi dhe zhvillimi i strategjisë përkatëse kanë për qëllim përmirësimin dhe forcimin e skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor, për të realizuar një shërbim shëndetësor sa më efikas.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Gjatë periudhës 2010-2011 vihet re një zhvillim në procesin e bashkërendimit të skemave të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me vendet e tjera në përputhje me standardet dhe kriteret që përcaktohen në Rregulloret 883/2004 dhe 987/2009 të KE.

Do të vazhdojë puna për të rifilluar bisedimet për marrëveshje dypalëshe me Italinë dhe Greqinë, për mbrojtjen shoqërore. Zbatimi i marrëveshjeve përfshin eksportin e pensioneve si dhe kompensimin e shpenzimeve shëndetësore për shtetasit shqiptarë që trajtohen në një shtet tjetër dhe anasjelltas, duke krijuar probleme financiare, të cilat bëhen edhe më të vështira në kushtet e krizës globale. Ky ka qenë një ndër arsyet që negociatat nuk kanë filluar ende me këto shtete.

Në rastet e lëvizjes së punëtorëve drejt vendeve me të cilat Shqipëria ka marrëveshje bilaterale, rregullimi dhe administrimi bëhet sipas kushteve dhe strukturave të parashikuara në marrëveshje. Shqipëria ka marrëveshje të mbrojtjes shoqërore me Turqinë. Marrëveshja bilaterale për mbrojtjen sociale midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, e cila është ratifikuar më datë 15.05.2003 dhe ka hyrë në fuqi në 1.2.2005, ka parashikuar rregullat për punonjësit e dërguar me punë në të dy vendet. Institucionet kompetente për zbatimin e kësaj marrëveshje janë Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetësor. Kjo Marrëveshje ka hyrë në një fazë të re të zbatimit të saj me rritjen e numrit të punonjësve turq në Shqipëri. Kërkesat nga institucionet homologe turke dhe nga ISSH tashmë kanë si subjekt shtetas shqiptarë dhe turq, që punojnë në Shqipëri apo

Turqi. Janë ndjekur rreth 350 procedura në zbatim të Marrëveshjes dhe në përputhje me rregullat e vendosura në Marrëveshjen Administrative.

Për bashkërendimin e skemave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ka vazhduar puna për rishikimin e marrëveshjeve bilaterale me Hungarinë dhe Rumaninë pasi kanë qenë marrëveshje të abroguara që nga vitet 60. Me Hungarinë janë zhvilluar negociatat gjatë vitit 2011 dhe janë në proces për përfundimin dhe ratifikimin e marrëveshjes. Gjithashtu ka filluar bashkëpunimi me Maqedoninë për marrëveshjen në fushën e mbrojtjes shoqërore, për të cilën do të punohet në grupe ekspertësh për konkludimin e saj. Me Mbretërinë e Belgjikës kanë filluar negociatat gjatë vitit 2010 për marrëveshje dypalëshe për mbrojtjen shoqërore. Ka përfunduar diskutimi i marrëveshjes dypalëshe, pritet të miratohet nga pala belge dhe të vazhdojnë negociatat për Marrëveshjen Administrative. Bashkëpunimi me Maqedoninë për marrëveshjen në fushën e mbrojtjes shoqërore kanë filluar me negociatat e zhvilluara në Shkup në maj 2011. Në takimet e ardhshme pritet të përfundojë diskutimi dhe miratimi i projektmarrëveshjes dhe të vazhdojë puna me marrëveshjen administrative.

Në këtë aspekt po punohet për të pasur marrëveshje në fushën e mbrojtjes sociale dhe me vende të tjera, të cilat janë të interesuara, sidomos me vendet fqinje Italinë dhe Greqinë ku dhe emigracioni i shqiptarëve është i konsiderueshëm.

Për realizimin e kartës së sigurimit shëndetësor, ISKSH bashkë me institucione të tjera do të realizojë projektin përkatës. Për realizimin e këtyre angazhimeve në skemën e sigurimeve shëndetësore do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- Zbatimi i legjislacionit të sigurimeve të detyrueshme shëndetësore;
- Organizimi i grupeve të punës për hartimin e Projektvendime të Këshillit të Ministrave në zbatim të Ligjit Nr. 10383, datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor".
- Në lidhje me përgatitjet për të përdorur kartën e identitetit si kartë shëndeti, ISKSH-ja po punon për të përfunduar procesin e identifikimit të të siguruarve me anën e numrit personal kombëtar të identifikimit (Kartës së Identitetit). Për këtë qëllim aktualisht ISKSH po punon që të bëjë transferimin e të dhënave të identifikimit të të siguruarve që përdoret vetëm nga ISKSH, dhe personave në ngarkim të mjekut të familjes në Numrin Kombëtar të Identifikimit. Në këtë mënyrë, krijohen kushtet për të përdorur Kartën e Identitetit si Kartë e Sigurimit Shëndetësor.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimin Shoqëror në RSH", i ndryshuar", Fletorja Zyrtare: Viti 1993, Nr 7. Ligji përafron pjesërisht Kartën Sociale Evropiane (E rishikuar), Rregulloren (EC) 32004R0883, Rregulloren (EC) 32009R0987, Direktivën 31986L0613, Direktivën 32007L0079 EEC.
- Ligji Nr. 8960, datë 24.10.2002 "Për ratifikimin e Kartës Sociale Evropiane, të rishikuar";
- Ligji Nr. 9442, datë 16.11.2005 "Për ratifikimin e Konventës se ILO-s, nr. 102 "Për standardet minimale të mbrojtjes shoqërore";

- Ligji Nr. 9066, datë 15.5.2003 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverise se RSH dhe Republikës se Turqisë Për Mbrojtjen Shoqërore”;
- Marrëveshja me Italinë dhe Protokollet e saj të Zbatimit që u nënshkruan në Tiranë, më 2 dhjetor 2008.
- Ligji Nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” (i cili hyn në fuqi në mars të vitit 2013).

Struktura institucionale

Për hartimin e marrëveshjeve dypalëshe në fushën e mbrojtjes shoqërore funksionon grupi i punës i kryesuar nga Zëvendësministri i Punës me përfaqësues nga Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, ISSH, ISKSSH, Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale (Sektori i Sigurimeve Shoqërore).

Institucionet kompetente për zbatimin e kësaj marrëveshje janë Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetësor.
Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale në MPCSSHB, Sektori i Sigurimeve Shoqërore, organizon dhe koordinon proceset e negociatave me palët e interesuara për hartimin e projektmarrëveshjeve në fushën e mbrojtëse sociale; Bashkërendon gjithashtu punën me Ministrinë e Jashtme, e cila krijon bashkëpunimin dhe merr miratimin e palës për fillimin e negociatave në rrugë diplomatike; Ndjek të gjitha procedurat që nga hartimi i projektmarrëveshjes deri në ratifikimin e nënshkrimin e tyre nga Kuvendi i Shqipërisë.

Masat legjislative afatshkurtra

- Bashkërendimi i sistemit të mbrojtjes shoqërore për punonjësit nga shtetet anëtare të BE-së të punësuar në territorin shqiptar.
- Adaptimi i sistemit të sigurimeve shoqërore me kërkesat e reja ekonomike e sociale nëpërmjet bashkëpunimit me palët, nëpërmjet përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me atë evropian.
- Rregullore për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave personale në sistemin informatik.
- Marrëveshjeve me Institucionet Homologe dhe Bankat për transferimin e pensioneve dhe kontributeve nga jashtë brenda vendit dhe anasjelltas.

Aktivitete zbatuese

- Zbatimi i Marrëveshjes me Turqinë;
- Ndjekja e procesit të përfundimit të marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore dhe marrëveshjes administrative midis Republikës të Shqipërisë dhe Mbretërisë të Belgjikës;
- Zhvillimi i raundit të fundit të negociatave për marrëveshjen për mbrojtjen shoqërore midis Republikës të Shqipërisë dhe Republikës të Hungarisë;

- Vazhdimi i negociatave me Maqedoninë për përfundimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore.
- Përmirësimi i menaxhimit të sistemit elektronik të sigurimeve shoqërore, në fushën e kontabilitetit dhe të lëvizjes së parave, do të mundësojë shkëmbimin e shpejtë të informacionit të saktë me sistemet e tjera lokale e kombëtare si dhe me institucionet qendrore.
- Do të vazhdojë të plotësohet baza e të dhënave të pensioneve dhe një bazë të dhënash e kontributeve për personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe të personave të siguruar vullnetarisht. Administrimi elektronik i listëpagesave (pay-roll) mujore e kontributeve dhe llogaritë personale të kontribuuesve, i bazës së të dhënave të kontribuuesve urbane dhe të bazës së të dhënave për periudhat e sigurimit të personave që kanë punuar në ish-kooperativa bujqësore, do të mundësojnë shkëmbimin e shpejtë të informacionit të saktë me sistemet e tjera lokale dhe kombëtare në fjalë, si dhe me institucionet qendrore.
- Për sa i përket koordinimit të sistemeve të sigurimeve shoqërore, për të marrë pjesë në sistemin e EESSI (mbi shkëmbimin elektronik të informacioneve të sigurimeve shoqërore në Bashkimin Evropian) do të realizohen këto aktivitete:
    - Hartimi i programeve, softeve për sistemin financiar, llogaritjen automatike të përfitimeve, krijimin e llogarive personale të kontribuuesve.
    - Zhvillimi i programeve kompjuterike për llogaritjen në mënyrë automatike të përfitimeve.
    - Implementimi i këtij softi (programet kompjuterike për llogaritjen në mënyrë automatike të përfitimeve), sipas një kalendari të përcaktuar nga ISSH.
    - Ndërtimi i sistemit informatik të menaxhimit të kontributeve.
    - Hedhja në vazhdimësi në 12 DRSSH e regjistrave urbane në regjistrin elektronik.
    - Përmirësimi i infrastrukturës së sistemit të sigurimeve shoqërore, në mënyrë që t'i përshtatet ndryshimeve aktuale.
- Rehabilitimi i DRSSH-ve Fier, Vlorë, Lezhë dhe Durrës.
- Rehabilitimi i godinës të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH dhe DRSSH Tiranë.
- Procedurat e tenderimit dhe rikonstruksionit të DRSSH Kukës, Dibër, Gjirokastër.
- Rritja më tej e bashkëpunimit me Institucionet e Postës Shqiptare sha, Tatimeve, Bankave të nivelit të dytë dhe Zyrave të Gjendjes Civile.
- Funksionimi i Arkivës së Centralizuar të ISSH, në godinën e rikonstruktuar dhe strukturën e re administrative.
- Krijimi i sistemit informatik të Arkivës së Centralizuar të ISSH.
- Trajnime dhe workshop për sistemet e reja të Teknologjisë së Komunikimit.
- Trajnime për funksionimin e Arkivave të Centralizuara të Institucioneve të Sigurimeve Shoqërore.

Masat legjislative afatshkurtra

- Fillimi dhe ndjekja e procedurave legjislative për ratifikimin dhe nënshkrimin në Kuvendin e Shqipërisë të:
    - Marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore midis Republikës të Shqipërisë dhe Mbretërisë të Belgjikës.

- Marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore midis Republikës të Shqipërisë dhe Hungarisë.
- Marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore midis Republikës të Shqipërisë dhe Maqedonisë.

- Bashkërendimi i sistemit të mbrojtjes shoqërore për punonjësit nga shtetet anëtare të BE-së të punësuar në territorin shqiptar.
- Modernizimi i sistemit të sigurimeve shoqërore me kërkesat e reja ekonomike e sociale nëpërmjet bashkëpunimit me palët.
- Me miratimin e Ligjit Nr. 10383 datë 24.02.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", Fletore zyrtare nr 25 datë 25.03.2011, i cili hyn në fuqi në mars të vitit 2013, do të përgatiten aktet nënligjore si më poshtë:
  - VKM për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor.
  - VKM për përcaktimin e kategorive të individëve të siguruar që përjashtohen nga pagesat e drejtpërdrejta të shërbimeve shëndetësore.
  - VKM për miratimin e statutit të fondit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.
  - VKM për krijimin dhe përdorimin e buxhetit të fondit rezerve të fondit të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor.
  - VKM për rregullat mbi regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe mënyrën e paraqitjes së informacionit nga institucionet përgjegjëse për informim.
  - VKM për përcaktimin e institucioneve publike dhe private që japin të dhëna fondit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

Aktivitete zbatuese

- Organizimi i takimeve të grupit ndërinstitucional të punës;
- Zhvillimi i takimeve të radhës për përfundimin dhe miratimin e marrëveshjeve dypalëshe me Hungarinë, Belgjikën, Maqedoninë;
- Komunikimi i vazhdueshëm me palët dhe Ministrinë e Jashtme, për mbarëvajtjen e këtij procesi;
- Ndërtimi i një Sistemi të ri *on line* të Informimit të klientëve, në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, si pjesë e Sistemit EESSI (shkëmbim elektronike të informacionit të sigurimeve shoqërore në BE);
- Realizimi i kartës së sigurimit shëndetësor.

Implikimet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**91.339.000.000**	**95.987.010.000**	**101.832.880.000**	**107.929.500.000**
Mbulohen nga buxheti i	91.339.000.000	95.987.010.000	101.832.880.000	107.929.500.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.3. E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME

3.3.1 & 2: E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME NDËRKUFITARE

Objektivi strategjik

Objektivi kryesor lidhur me të drejtën e vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime është përafrimi i plotë i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ky objektiv lidhet drejtpërdrejt me përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në nenet 49-59 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe me detyrimet afatshkurtra dhe afatmesme të parashikuara nga Partneriteti Evropian i nënshkruar ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në shkurt 2008.

Në këtë kuadër, janë përcaktuar edhe objektivat kryesore si më poshtë:

- Përcaktimi i kuadrit institucional, përcaktimi i personave përgjegjës dhe ngritja e kapaciteteve administrative në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime, hartimi i metodologjisë, kritereve dhe pikave kryesore që do të përdoren për rishikimin e legjislacionit horizontal dhe sektorial me qëllim përcaktimin e shkallës së përputhshmërisë me Direktivën e Shërbimeve.
- Identifikimi dhe inventarizimi i acquis-së në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime dhe analizimi i të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë të drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime në Republikën e Shqipërisë sipas fushave dhe përcaktimin e shkallës së përputhshmërisë të tyre me acquis-në e BE-së.
- Krijimi dhe vënia në funksionim e Pikave të Vetme të Kontaktit (Single Points of Contact) sipas kuptimit të dhënë nga Direktiva e Shërbimeve.
- Transpozimi i plotë i Direktivës së Shërbimeve në sistemin ligjor shqiptar duke përcaktuar një periudhë tranzitore për disa prej dispozitave të kësaj direktive të cilat nuk mund të hyjnë në fuqi menjëherë.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Kapitulli 3, e drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime mbështetet në detyrimet e Shqipërisë të parashikuara në nenet 49-59 të MSA-së. Në përputhje me këto detyrime dhe konstatimet ne raportin e Komisionit Evropian të nëntorit 2010 Shqipëria garanton të drejtën e vendosjes për kompanitë e themeluara në BE duke iu ofruar atyre të njëjtin trajtim si edhe kompanive shqiptare.

Sa i përket lirisë për të ofruar shërbime, përfshirë shërbimet ndërkufitare, legjislacioni shqiptar nuk është në përputhje me *acquis*. Në përputhje me nenin 56 të Traktatit për

Funksionimin e Bashkimit Evropian liria për të ofruar shërbime ndërkufitare është detyrim për Shqipërinë vetëm ne momentin e anëtarësimit me të drejta të plota në BE.
Me qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime si edhe transpozimin e Direktivës së Shërbimeve METE ka hartuar tashmë një plan veprimi, i cili përcakton objektivat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për këtë qëllim, plan i cili është konsultuar gjerësisht me të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore të përfshira në proces dhe ka marrë miratimin e tyre në parim.

Gjithashtu, me mbështetjen e GIZ është përgatitur tashmë analiza e mospërputhjeve (boshllëkut) legjislative i cili paraqet mospërputhshmëritë e legjislacionit shqiptar me acquis-në në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime. Kjo analize do të plotësohet më tej gjatë vitit 2012.

Po kështu në bashkëpunim me GIZ është punuar në përgatitjen e një liste të direktivave dhe rregulloreve të BE-së, përveç Direktivës së Shërbimeve, të cilat lidhen me ushtrimin e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime si edhe është bërë përkthimi në shqip i Direktivës së Shërbimeve me qëllim që të jetë më e thjeshtë për t'u kuptuar nga punonjësit e administratës publike që do të përfshihen në proces. Kjo listë do të shërbejë si bazë për rishikimin e legjislacionit shqiptar dhe përcaktimin e sektorëve më të ndjeshëm dhe prioritarë në këtë drejtim.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktualisht nuk ka asnjë akt ligjor specifik që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me direktivën e shërbimet në tregun e brendshëm duke qenë se ajo nuk është transpozuar akoma. Duke qenë se e drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime është një fushë shumë e gjerë, të gjitha ligjet sektoriale që aktualisht rregullojnë ofrimin e shërbimeve në fusha të caktuara prekin në mënyrë indirekte këtë direktivë.

Aktet ligjore kryesore që lidhen indirekt me të drejtën e vendosjes janë:

- Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (botuar në GZ 60/2007) i cili transpozon në mënyrë të pjesshme këto akte: (i) Direktiva e parë (1) e Këshillit 68/151/EEC (Celex 31968L0151), (ii) Direktiva 2003/58/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Celex 32003L0058) që ndryshon Direktivën 68/151, (iii) Direktiva e dytë (2) e Këshillit 77/91/EEC (Celex 31977L0091), (iv) Direktiva njëmbëdhjetë e Këshillit 89/666/EEC (Celex 31989L0666)
- Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë" (botuar në GZ 31/2009).

Struktura institucionale

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës po harton një VKM që do të përcaktojë strukturat institucionale dhe detyrat përkatëse të tyre.

Në bazë të kësaj darft-VKM-je strukturat kryesore për përafrimin e legjislacionit në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime do të jenë:

- Grupi ndërinstitucional i punës;
- Grupet e punës për rishikimin e legjislacionit sipas fushave.

Në këtë proces do të përfshihen institucionet e mëposhtme:

(i) Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (e cila do të udhëheqë kapitullin 3), (ii) Ministria e Integrimit (si institucioni përgjegjës për politikat e integrimit evropian të Shqipërisë), (iii) Ministria e Arsimit dhe Shkencës, (iv) Ministri për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, (v) Ministria e Drejtësisë, (vi) Ministria e Financave, (vii) Ministria e Mbrojtjes, (viii) Ministria e Brendshme, (ix)Ministria e Shëndetësisë, (x) Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, (xi) Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, (xii) Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, (xiii) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, (xiv) Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, (xv) Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, (xvi) Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, (xvii) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, (xviii) Banka e Shqipërisë, (xix) Qendra Kombëtare e Regjistrimit, (xx) Qendra Kombëtare e Licencimit, (xxi) Enti Rregullator i Energjisë, (xxii) Agjencia e Prokurimit Publik, (xxiii)Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, (xxiv) Autoritetet e Pushtetit Vendor (Qarqe, Bashki, Komuna)

Institucionet e sipërpërmendura do të përfshihen në procesin e rishikimit të legjislacionit për fushat që mbulojnë dhe hartimin e ndryshimeve apo akteve të reja ligjore në përputhje me Direktivën shërbimet në tregun e brendshëm 2006.123.EC dhe do të kenë këto detyra:

- Rishikimi i legjislacionit të tyre sektorial dhe përcaktimi i mospërputhshmërive të tij me Direktivën për shërbimet në tregun e brendshëm 2006\123\EC;
- Përgatitja e informacionit përfundimtar për çdo shërbim të identifikuar brenda fushave të tyre;
- Përcaktimi i akteve ligjore dhe nënligjore që duhet të ndryshohen me qëllim përputhjen e tyre me parimet e Direktivës për shërbimet në tregun e brendshëm 2006\123\EC;
- Hartimi i ndryshimeve apo akteve ligjore dhe nënligjore të reja në fushat e tyre në përputhje me dispozitat e Direktivës për shërbimet në tregun e brendshëm 2006\123\EC.

Masat legjislative afatshkurtra

Në përputhje edhe me objektivat të përcaktuara në planin e veprimit të hartuar nga METE gjatë vitit 2012 puna do të përqendrohet në ngritjen e kuadrit të nevojshëm institucional për rishikimin e legjislacionit shqiptar në këtë fushë dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme administrative për këtë qëllim.

- Hartimi dhe miratimi i VKM “Për përafrimin e legjislacionit në fushën e të drejtës së

vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime", e cila do të përcaktojë kuadrin institucional, strukturat dhe personat përgjegjës për përafrimin e legjislacionit në këtë fushë, përfshirë këtu edhe grupet sektoriale të punës për rishikimin e legjislacionit si dhe parimet kryesore dhe metodologjinë e rishikimit të legjislacionit'

- Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (botuar në GZ 60/2007);
- Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", (botuar në GZ 60/2008);
- Projektligji "Për veprimtarinë e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike".

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Ngritja e kapaciteteve administrative në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime. Në përputhje me objektivat e parashikuara në planin e veprimit do të hartohet plani i trajnimit për nëpunësit e administratës publike që do të përfshihen në procesin e rishikimit të legjislacionit me qëllim njohjen e specifikave dhe kërkesave teknike te procesit.
- Amendimi i Analizës e Mospërputhjeve Legjislative (Legislative Gap Analysis) me qëllim identifikimin sa më të plotë dhe të saktë të mospërputhshmërive të legjislacionit shqiptar me atë evropian në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime.
- Miratimi i planit të detajuar të veprimit për rishikimin i legjislacionit (screening) për të gjithë sektorët që preken nga zbatimi i Direktivës shërbimet në tregun e brendshëm 2006\123\EC (Celex 32006L0123).

Masat legjislative afatshkurtra

Nuk janë parashikuar masa legjislative afatmesem.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Në përputhje me objektivat të përmendura më sipër[16] dhe me planin e veprimit për përafrimin e legjislacionit të fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime aktivitetet e parashikuara për vitet 2013-2015 janë si më poshtë:

- Rishikimi i legjislacionit shqiptar sipas sektorëve me qëllim identifikimin e mospërputhshmërive me legjislacionin të BE-së dhe Direktivën e Shërbimeve 2006\123\EC (Celex 32006L0123) dhe përcaktimin e akteve ligjore dhe nënligjore që duhet të ndryshohen apo të shfuqizohen për këtë arsye.
- Vlerësimi i hartimit dhe miratimit të kuadrit ligjor apo nënligjor të nevojshëm për transpozimin e Direktivës mbi shërbimet në tregun e brendshëm 2006\123\EC (Celex 32006L0123).
- Ngritja e Pikave të Vetme të Kontaktit (Single Points of Contacts)-Krijimi i programit përkatës dhe lidhja me bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian.

[16] Shih objektivat tek Objektivi Strategjik.

Efektet Financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.3.1"E drejta e Vendosjes"

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**9.233.000**	**0**	**0**	**0**
Mbuluar nga ndihma e huaj	**9.233.000**	**0**	**0**	**0**
Ndryshim	**0**	**0**	**0**	**0**

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.3.2"E liria per te ofruar sherbime "

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**6.175.000**	**0**	**0**	**0**
Mbuluar nga ndihma e huaj	**6.175.000**	**0**	**0**	**0**
Ndryshim	**0**	**0**	**0**	**0**

3.3.3. SHËRBIMET POSTARE

Objektivi strategjik

Në mbështetje me nenet 50, 57, 70, 71, 72 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Dokumentin mbi Politikat e zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, Shqipëria është e angazhuar në liberalizimin gradual të tregut të shërbimeve postare me qëllim ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë dhe tarifa të përballueshme nga konsumatorët.

Objektivi kryesor është që të gjitha shërbimet postare të arrihen të ofrohen dhe nga sektori privat, kjo në përputhje me legjislacionin evropian. Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Liberalizimit gradual të tregut të shërbimeve postare me qëllim ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë dhe tarifa të përballueshme nga konsumatorët;
- Hartimit dhe miratimit të VKM: "Politika e Zhvillimit të Shërbimeve Postare në Republikën e Shqipërisë";
- Hartimit dhe miratimit të një ligji të ri: "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë" i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivat e shërbimit postar, Direktiva 97/67/EC, e ndryshuar me Direktivën 2002/39/EC dhe me Direktivën 2008/06/EC.

Situata Aktuale

Analiza e situatës aktuale

Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë rregullohen me ligjin nr. 8530, datë 23.09.1999 "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 9223, datë 29.04.2004, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8530, datë 23.9.1999, "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 10132, datë 11.05.2009, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8530, datë 23.09. 1999, "Për Shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 10361, datë 16.12.2010 "Për një shtesë ne ligjin nr. 8530, date 23.09.1999 "Për shërbimin postar ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Ky ligj është harmonizuar pjesërisht me direktivat për shërbimin postar[17].

Në Republikën e Shqipërisë, tregu i shërbimeve postare, jo të rezervuara, është i liberalizuar. Në tregun e shërbimeve postare operojnë 11 kompani të pajisura me "Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare", përfshirë Posta Shqiptare sh.a. si operator publik postar dhe 10 ofrues privat të shërbimeve postare.

Operatori publik postar në tregun shqiptar të postave është "Posta Shqiptare" sh.a. e cila ka detyrimin për përmbushjen e shërbimeve bazë postare. Kompania siguron një gamë të gjerë shërbimesh tradicionale postare (postën e letrave, kolipostën dhe shërbime të urdhërpagesave), shërbimin e shpejtë Express Mail Services (EMS), shërbime biznesi si dhe shërbime financiare (transferta të shpejta të parave, pagesat e tatim–taksave, shpërndarje të pensioneve të pleqërisë, arkëtimi i faturave të telefonisë dhe energjisë, ujit e pagesa të tjera). Ajo ka rrjetin më të madh që mbulon gjithë territorin e vendit nëpërmjet 550 zyrave të saj në qytete, komuna e fshatra fundorë.

Struktura institucionale

Kuadri institucional për shërbimet postare përbëhet nga Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit si politikë-bërës, dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare si organi rregullator i pavarur. Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit është Ministri përgjegjës në lidhje me shërbimet postare i cili i propozon Këshillit të Ministrave strategjinë e zhvillimit të postave, aktet ligjore dhe nënligjore si dhe veprimet e nevojshme për përmbushjen e objektivave të politikës së zhvillimit të postave.

Roli i Ministrit është i përcaktuar në nenin 6 të ligjit nr. 8530, datë 23.09.1999 "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ministri, nëpërmjet drejtorisë përgjegjëse për shërbimin postar, ndjek zbatimin e politikës së Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në sektorin e shërbimeve postare. Bazuar në VKM nr. 248, datë 27.4.2007 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", të ndryshuar, në ushtrimin e

[17] Direktiva 97/67/EC, e ndryshuar me Direktivën 2002/39/EC dhe me Direktivën 2008/06/EC

kompetencave të tij Ministri mbështetet nga Drejtoria e Komunikimeve Elektronike dhe Postare që funksionon brenda AKSHI-t.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ushtron aktivitetin në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9918 dt. 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit 8530, datë 23.09.1999 "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

AKEP, bazuar në dokumentin mbi Politikat e zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet dokumenteve rregullatore është angazhuar për krijimin e një mjedisi konkurrent, me qëllim rritjen e llojshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve postare me tarifa të përballueshme nga konsumatorët.

AKEP, bazuar në ligjin nr. 8530, datë 23.09.1999 "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me të cilin rregullohen shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet aplikimit të procedurave të thjeshtëzuara për licencim, është angazhuar për nxitjen e interesit të sektorit privat për të konkurruar në tregun postar të brendshëm edhe në atë të jashtëm.

Masat legjislative afatshkurtra

Prioritet i përcaktuar për Shqipërinë për periudhën afatshkurtër është liberalizimi gradual i tregut të shërbimeve postare me qëllim ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë dhe tarifa të përballueshme nga konsumatorët. Gjatë vitit 2012 do të punohet për:

- Hartimin dhe miratimin i VKM "Politika e Zhvillimit të Shërbimeve Postare në Republikën e Shqipërisë". Ky dokument i ri politikash do të hartohet në përputhje te plote me Direktivat Postare. Direktivat e shërbimit postar, Direktiva 97/67/EC të ndryshuar me Direktivën 2002/39/EC dhe me Direktivën 2008/06/EC, për liberalizimin e plotë të tregut postar.
- Hartimi dhe miratimi i ligjit "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë" i cili do të përafrohet plotësisht me Direktivat e shërbimit postar, Direktiva 97/67/EC të ndryshuar me Direktivën 2002/39/EC dhe me Direktivën 2008/06/EC.
- Miratimi i VKM për "Ratifikimin e Dokumentit të Kongresit të 24 të Bashkimit Postar te Përbotshëm UPU-së, Gjenevë, 2008".

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Organizimi i seminareve me grupe të ndryshme të interesit për të diskutuar mbi dokumentin e ri të politikave të sektorit postar;
- Organizimi i seminareve me grupe të ndryshme të interesit për të diskutuar mbi projektligjin e ri te sektorit postar;
- Fuqizimi i sektorit postar në Drejtorinë e Komunikimeve Elektronike dhe Postare përmes kualifikimit të stafit dhe njohjes se acquis communaitare, implementimit të këtyre direktivave në vendet e tjera te BE-së;
- Krijimi i Njësisë Rregullatore për sektorin postar në Autoritetin e Komunikimeve

Elektronike dhe Postare. Për këtë, AKEP ka propozuar për miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë strukturën e ndryshuar, pjesë e të cilës është dhe njësia që do të merret me mbikëqyrjen e kuadrit rregullator në shërbimet postare;

- Ngritja e Postbankës si një element për përmirësimin e shërbimeve postare dhe financiare të Postës Shqiptare sh.a.

Masat legjislative afatshkurtra

Nuk janë parashikuar masa legjislative afatmesme

Masat legjislative afatmesme

Plotësimi i kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit të ri postar dhe dokumentit të politikës së re.
Ne zbatim te ligjit te ri postar, AKEP do te hartoje dhe miratoje dokumentet rregullatore përkatëse.

Efektet Financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.3.3"Sherbimet postare"

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**5.500.000**	**0**	**0**	**0**
Mbuluar nga ndihma e huaj	**5.500.000**	**0**	**0**	**0**
Ndryshim	**0**	**0**	**0**	**0**

3.3.4. NJOHJA E NDËRSJELLË E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

Objektivi strategjik

Objektivat prioritarë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në fushën e kualifikimeve profesionale janë:

- trajnimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i mësuesve për zhvillimin dhe konsolidimin e arsimit,
- krijimi i standardeve kombëtare të njohurive, aftësive dhe kompetencave të gjera,
- ofrimi i një sistemi koordinimi për krahasimin e kualifikimeve duke i lidhur ato me njëra-tjetrën.

Në këtë kontekst, MASH zhvillon politikat dhe reformat në fushën e arsimit me qëllim rritjen e cilësisë në gjitha nivelet e arsimit.

Situata Aktuale

Analiza e situatës aktuale

Në fushën e trajnimit dhe kualifikimit të mësuesve dhe drejtuesve të arsimit parauniversitar është plotësuar kuadri ligjor me akte të tjera nënligjore, të cilat përcaktojnë standarde dhe kritere bashkëkohorë të kualifikimit dhe vlerësimit të punonjësve arsimorë. Aktualisht vijon procesi i akreditimit te programeve të trajnimit i cili do të përfundojë me hartimin e katalogut të të gjitha programeve të akredituara.

Në zbatim të Rregullores nr. 7170/1, datë 22.11.2010 "Për Kualifikimin e drejtuesve të institucioneve arsimore" janë miratuar standardet e drejtorit dhe programi kombëtar i zhvillimit profesional të drejtuesve të institucioneve arsimore parauniversitarë. Me vendimin Nr. 321, datë 21.04.2011 të Këshillit të Ministrave u krijua Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve si dhe njësia e sekretarit në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Gjithashtu me vendimin nr. 351, datë 21.04.2011 të Këshillit të Ministrave u përcaktua mënyra e ushtrimit të funksioneve dhe të kompetencave të Këshillit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Gjatë këtij viti në zbatim të KSHK u hartua lista e kualifikimeve të nivelit të parë dhe të dytë, duke pasqyruar në të sugjerimet e marra nga tregu shqiptar i punës dhe donatorët.

Pas miratimit të ligjit të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP), Nr. 10434, datë 23.06.2011, është përcaktuar struktura e re e sistemit AFP, rritja e profileve dhe përmirësimi i menaxhimit të shkollave të AFP. Trajnimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i mësuesve mbetet një nga prioritetet për zhvillimin dhe konsolidimin e AFP. Në vitin akademik 2011-2012 është ofruar për herë të parë programi Master Profesional në fushën Pedagogji për mësuesit e arsimit profesional pranë Universitetit të Korçës.

Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.1013 dt. 10.12.2010, është përgjegjëse për vlerësimin e nxënësve me anë të provimeve kombëtare, pranimet në IAL publike dhe organizimin e provimeve të shtetit. Në përputhje me ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", një profesionist e fiton të drejtën e ushtrimit të profesionit, vetëm pasi ai kalon provimin e shtetit. Aktualisht, me VKM nr. 649, datë 14.09.2011 është përcaktuar një listë e plotë (në total 38) e specialiteteve, nënspecialiteteve dhe specialiteteve plotësuese për 10 profesionet e rregulluara.

Në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 10 171, datë 22.10.2009 "Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është miratuar rregullorja e provimeve të shtetit dhe paketa e akteve nënligjore, që rregullon procesin e ngritjes së komisioneve për hartimin e katalogut të pyetjeve, komisioneve të provimeve të shtetit, tarifat (VKM nr. 812, dt. 10.11.2011) dhe gjithë elementët përbërës të dhënies së provimit. Kandidatët regjistrohen pranë ministrive dhe urdhrave përkatës, që janë përgjegjës për profesionet respektive (VKM

Nr. 649, datë 14. 09.2011 "Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve, apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara").

Në përmbushje të detyrimit të përcaktuar nga ligji nr. 10171, datë 22.10.2010 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" MPPT ka hartuar projektligjin "Për krijimin e urdhrit profesional të inxhinierit dhe arkitektit" i cili është dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave. Ministria e Punëve Publike, dhe Transportit është duke diskutuar me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës dhe Ministrinë për Inovacion dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për të vlerësuar përfshirjen e qasjes së këtij projekti të propozuar në një projektligj horizontal "Për urdhrat profesionalë për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë". Ndërkohë MPPT është duke marrë asistencë teknike nga TAIEX mbi përmbajtjen dhe funksionimin e Urdhrit Profesional të Inxhinierit dhe Arkitektit.

Gjatë periudhës janar-shkurt 2012, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) organizoi Provimin e Shtetit për degët Mjekësi dhe Farmaci, nëpërmjet teknologjisë dixhitale dhe në përputhje me standardet evropiane. Është miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës Rregullorja mbi "Organizimin dhe Zhvillimin e Praktikave Profesionale për Profesionin e Rregulluar të Mësuesit" Nr. 3874, datë 14.07.2011 si dhe programi i praktikës profesionale për mësuesit e rinj, të cilët do t'i nënshtrohen provimit të shtetit, në mënyrë që të kualifikohen si mësues të licencuar.
Sektori i Njohjes së Diplomave në Drejtorinë e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit është përgjegjës për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë si dhe është përgjegjës për të siguruar vërtetësinë dhe krahasueshmërinë e kualifikimeve të huaja te arsimit të lartë me nivelet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Në vitin 2011 filloi funksionimi i data bazës së diplomave të njohura dhe modulit të njohjes së diplomave i cili do të mundësojë aplikimin on-line për njohjen e diplomës së studentëve që kanë përfunduar studimet jashtë shtetit. Moduli do të informatizojë të gjithë procedurën e aplikimit të njohjes së diplomës dhe do të përshpejtojë kohën e kësaj procedure administrative. Gjithashtu vetë aplikuesi do të jetë në gjendje të gjurmojë procedurën e njohjes së diplomës dhe do të njoftohet automatikisht kur ajo të ketë përfunduar.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Përsa i përket njohjes së ndërsjelltë të kualifikimeve profesionale (profesioneve të rregulluara) midis shteteve të Evropës është Direktiva 2005/36/EC e cila përbën direktivën bazë të Bashkimit Europian. Njohja, trajtimi dhe diferencimi i kualifikimeve akademike dhe profesionale, është i rregulluar nga aktet ligjore të mëposhtme:

- Ligji nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10247, datë 04.03.2010 "Korniza Shqiptare e Kualifikimeve";
- Ligji nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)"

- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, nr. 41, datë 08.12.2009 "Për procedurat dhe kriteret për njohjen e diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 812, datë 10.11.2011 "Për caktimin e tarifave për provimin e shtetit" Fletore Zyrtare nr. 162, date 16.12.2011
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 649, datë 14. 09. 2011 "Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara" Fletore Zyrtare nr. 141, date 17. 10. 2011
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 321, datë 21.04.2011 krijimi i Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 351, datë 21.04.2011 "Funksionet dhe kompetencat e Këshillit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projektvendim për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe e sekretariatit teknik
- Projektvendim "Për mënyrën e ushtrimit të funksioneve dhe të kompetencave të Këshillit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit dhe të njësisë.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Hartimi i programeve për praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.

Masat legjislative afatmesme

- VKM për miratimin e listës kombëtare të kualifikimeve profesionale.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Monitorimi i procesit të praktikave profesionale të mësuesve të rinj.

Efektet Financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.3.3"Sherbimet postare"

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**206.573.000**	**209.070.000**	**210.670.000**	**212.230.000**
Mbulohen nga buxheti i	**206.573.000**	**209.070.000**	**210.670.000**	**212.230.000**
Ndryshim	**0**	**0**	**0**	**0**

3.4. LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT

3.4.1. REGJIMI I LËVIZJEVE TË KAPITALIT DHE PAGESAVE AKTUALE

Objektivi Strategjik

Neni 60 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton që palët angazhohen të autorizojnë, në monedha të këmbyeshme lirshëm, çdo pagesë apo transfertë në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e Nenit VIII të Neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Detyrimet për Republikën e Shqipërisë në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit rrjedhin nga nenet 61 dhe 62 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Dokumenti i Partneritetit Evropian dhe Raport Progreset e Komisionit Evropian për Shqipërinë. Sipas nenit 61 dhe 62 të MSA-së, Shqipëria ka marrë përsipër detyrimin për të liberalizuar lëvizjen e kapitalit dhe të pagesave rrjedhëse në marrëdhëniet me Komunitetin Evropian.

Situata aktuale

Në Republikën e Shqipërisë toka bujqësore rezulton në pronësi private në rreth 80% dhe pronësi shtetërore në rreth 20% të sipërfaqes së përgjithshme të saj. E drejta e pronësisë private mbi tokën garantohet nga legjislacioni ekzistues në fuqi dhe shprehet nëpërmjet të drejtës së trashëgimisë mbi të, të shitblerjes si dhe të dhënies me qira. Toka në pronësi shtetërore përdoret nga shteti për kthim dhe kompensim prone të subjekteve të shpronësuara nga regjimi komunist, për qiradhënie etj. Përsa i përket kalimit të drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore për shtetas të huaj si për tokën bujqësore në pronësi private, ashtu dhe për tokën në pronësi shtetërore ekzistojnë disa kufizime ne lidhje me kalimin e së drejtës së pronësisë për personat fizike dhe juridike te huaj. Sipas nenit 4 te ligjit 8337, datë 30.04.1998 "Për kalimin ne pronësi te tokës bujqësore, pyjore, livadhe dhe kullotave kalimi i se drejtës se pronësisë nuk iu njihet personave fizike dhe juridike te huaj. Ndërkohe, po sipas këtij ligji shtetasit e huaj kane te drejte te marrin toke bujqësore me qira ne afate deri ne 99 vjet.

Me ndryshimet e kuadrit ligjor, i cili rregullonte veprimtarinë ligjore të AKKP-së, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij në rang kombëtar, rezulton se këtij të fundit ju suprimuan të gjitha institucionet në varësi të saj, sikundër ishin Zyrat Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave në 12 qarqe. Tashmë autoriteti i vetëm shtetëror, i cili do të merret me trajtimin e çështjeve të pronësisë, të cilat rrjedhin nga shtetëzimet, shpronësimet dhe konfiskimet nga shteti totalitar komunist, do të jetë vetëm Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave me qendër në Tiranë.

Të gjitha çështjet e pronësisë që kanë qenë të regjistruara pranë ish-Zyrave Rajonale të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave në 12 Qarqe, që kanë qenë në proces trajtimi apo rishqyrtimi pranë tyre, do të përthithen për tu trajtuar më vendim përfundimtar nga Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave me seli në Tiranë. Në kuadër të rritjes së kapaciteteve administrative të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në Urdhrin e Kryeministrit, nr. 58, datë 23.04.2009 "Për miratimin e strukturës dhe të organikes

së sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar me VKM nr. 240, datë 31/03/2011, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontrate të përkohshme për vitin 2011 në njësitë e qeverisjes vendore", gjatë vitit 2011, janë punësuar 10 punonjës të rinj me kontratë të përkohshme.

Toka Bujqësore administrohet nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorëve dhe nga Departamenti i Tokës dhe administrimit te Ujërave. Gjithashtu, për administrimin e tokës janë përgjegjëse:

- Drejtoritë për Mbrojtjen dhe Administrimin e Tokës (DMAT) te cilat operojnë në 12 Këshillat e Rajonal, një funksion i deleguar nga Këshilli i Ministrave për Këshillat Rajonal. DMAT kanë në total një staf prej 112 personash.
- Zyrat për Mbrojtjen dhe Administrimin të cilat veprojnë në çdo njësi të qeverisjes vendore dhe kanë minimalisht 1 punonjës.

Të dy këto struktura kryejnë funksionet e tyre në përputhje me ligjin 26.03.2001 "Për ngritjen dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës" i ndryshuar me ligjin 10257, datë 25.03.2010 dhe ligjin 9244, datë 17.06.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore". Kapacitet teknike dhe profesionale të Drejtorisë për Mbrojtjen dhe Administrimin e Tokës forcohen përmes programeve të veçanta te hartuara çdo vit nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/ nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji nr. 7764, datë 02.11.1993 "Për investimet e huaja"[18] i ndryshuar me ligjin 10316, datë 22.10.2010 ;
- Ligji nr. 7980, datë 27.07.1995 "Për trojet"[19] i ndryshuar me ligjin nr. 8260 datë 26.11.1997 ;
- Ligji 8312, datë 26.03.1998 "Për administrimin e tokave bujqësore të pandara"[20]
- Ligji nr. 8337, datë 30.04.1998 "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjeve, livadheve dhe kullotave"[21]
- Ligji nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës"[22], i ndryshuar, ligj i cili është akti bazë i rregullimit dhe funksionimit të këtij procesi
- Ligji nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet"[23]
- VKM nr. 200, datë 19.2.2009 "Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar"[24] ;
- VKM nr 250, datë 14.04.2010, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 12 dt. 07.01.2009 të Këshillit të Ministrave "Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të

[18] Fletore Zyrtare nr. 13, datë 14.12.1993, faqe 803
[19] Fletore Zyrtare nr. 18, date 08.08.1995, faqe 797
[20] Fletore Zyrtare nr. 9, datë 21.04.1998, faqe 321;
[21] Fletore Zyrtare nr. 12, datë 8 maj 1998 faqe 442.
[22] Fletore Zyrtare nr. 61, datë 31.08.2004, faqe 3934).
[23] Fletore Zyrtare nr. 150, datë 18.01.2007, faqe 6075)
[24] Fletore Zyrtare nr. 21, datë 06.03.2009, faqe 1374).

tokës me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar"[25]

- VKM nr. 253, datë. 13.04.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 52 dt. 07.02.2007 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve të komunikimit, nëpërmjet AKKP-së dhe institucioneve shtetërore, gjatë procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës"[26];
- VKM nr. 254, datë 13.04.2010, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 257 date 11.04.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret dhe procedurën e kompensimit fizik me troje shtetërore, të subjekteve të shpronësuara në disa raste të veçanta"[27] ;
- VKM nr. 255 datë. 13.04.2010 "Për procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara gjatë procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës", vendim mbi bazën e të cilit përcaktohen kriteret ligjore në mënyrë të detajuar, për pranimin e kërkesave të subjekteve (trashëgimtarëve të tyre ligjor), për njohjen e të drejtës së pronësisë[28];
- VKM nr. 256, datë 13.4.2010 "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave" [29];
- VKM nr. 267, datë 21.4.2010 "Për përcaktimin e rregullave për bashkërendimin e punës së ALUIZNI-t me zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për procedurat e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin"[30];
- VKM nr. 383, datë 19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale"[31]

Struktura institucionale

AKKP-ja si institucion qendror varet nga Ministria e Drejtësisë dhe është përgjegjëse për:

- Njohjen e të drejtës së njohjes së pronësisë, e drejtë kjo themelore e parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Kthimin e kësaj të drejte aty ku është e mundur, si dhe aty ku nuk është e mundur kompensimin e saj në gjashtë mënyrat e parashikuara në ligj;
- Ndjekjen e procedurave hap pas hapi të këtij procesi si dhe të bashkëpunimit me institucionet e treta që duhet të japin ndihmën e tyre ligjore për këtë proces.

Me ndryshimet e kuadrit ligjor, i cili rregullonte veprimtarinë ligjore të AKKP-së, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij në rang kombëtar, rezulton se këtij të fundit ju suprimuan të gjitha institucionet në varësi të saj, sikundër ishin Zyrat Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave në 12 qarqe. Tashmë autoriteti i vetëm shtetëror, i cili do të merret me trajtimin e çështjeve të pronësisë, të cilat derivojnë nga shtetëzimet, shpronësimet dhe konfiskimet nga shteti totalitar komunist, do të jetë vetëm Agjencia e Kthimit dhe e

[25] Fletore Zyrtare nr. 49, datë 28.04.2010, faqe 1828).
[26] Fletore Zyrtare nr. 56, datë 13.05.2010, faqe 2111).
[27] Fletore Zyrtare nr. 56, datë 13.05.2010, faqe 2112
[28] Fletore Zyrtare nr. 56, datë 13.05.2010, faqe 2113
[29] Fletore Zyrtare nr. 56, datë 13.05.2010, faqe 2116
[30] Fletore Zyrtare nr. 56, datë 13.05.2010, faqe 2127
[31] Fletore Zyrtare nr. 75, datë 30.06.2010, faqe 3977

Kompensimit të Pronave me qendër në Tiranë.

Të gjitha çështjet e pronësisë që kanë qenë të regjistruara pranë ish-Zyrave Rajonale të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave në 12 Qarqe, që kanë qenë në proces trajtimi apo rishqyrtimi pranë tyre, kanë kaluar tashmë për tu trajtuar me vendim përfundimtar nga Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave me seli në Tiranë.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projekt-ligj nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar;
- Projekt-Vendim i Këshillit të Ministrave mbi miratimin e "Strategjisë për të drejtat e pronësisë"
- Projekt-Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në të holla për vitin 2012".
- Ndryshimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 256, datë 13.04.2010 "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave" dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 76, datë 5.4.2011 me qëllim ristrukturimin e burimeve njerëzore;
- Miratimi i rregullores se re "Për funksionimin e Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave";
- Miratimi i një skeme të re definitive mbi afatet e kompensimit në përputhje me orientimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Zbatimi i skemës kalimtare aktuale të kompensimit;
- Përmirësimi i organizimit strukturor dhe funksional;
- Përditësimi i informacionit mbi fondin fizik të objekteve;
- Përditësimi i fondit fizik të tokave;
- Krijimi i fondit fizik të kompensimit, realizimi i shpërndarjes se tij nga AKKP-ja sipas procedurave që do të miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave duke e bërë procesin transparent korrekte dhe në përputhje me ligjin dhe me aktet e tjera nënligjore në fuqi;
- Shpërndarjen e fondit të kompensimit në të holla për vitin 2012 për subjektet e shpronësuara prona e të cilëve është njohur për kompensim me vendim;
- Shpërndarjen e fondit në të holla për subjektet që preken nga ndërtimet informale;
- Përmbushja e rekomandimeve të analizës teknike që do të kryhen nga institucionet e eprore, përmes masave strukturore dhe institucionale;
- Trajnimi i stafit të AKKP-së për ngritjen e kapaciteteve të tyre.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Evidentimi e trojeve të lira, brenda zonave të stimuluara, për efekt të kompensimit fizik të ish-pronarëve.
- Krijimi e një baze të dhënash digjitale për informacionin gjeografiko-hartografik GIS

të të gjitha vendimeve për njohjen/kthimin apo kompensimin e pronës të dhëna në vite.

- Hartimi i një baze të dhënash arkivore digjitale për të evidentuar të gjitha vendimet e dhëna ndër vite nga organet paraardhëse që kanë ushtruar këtë veprimtari administrative.
- Digjitalizimin e Arkivit së Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, në bashkëpunim edhe me donatorë vendas apo të huaj.
- Digjitalizimin dhe informatizimin e të gjithë veprimtarisë së Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, në mënyrë që ky institucion të jetë transparent dhe i hapur për publikun dhe personat e interesuar në lidhje me veprimtarinë e saj.
- Fillimi i procedurave të aplikimit dhe shpërndarjes së fondit në të holla për subjektet që preken nga ndërtimet informale
- Fillimi i procedurave të aplikimit dhe shpërndarjes së fondit në të holla për subjektet e shpronësuara prona e të cilëve është njohur për kompensim.
- Trajnimi i stafit të AKKP-së për ngritjen e kapaciteteve të tyre.

Efektet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**334.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	334.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.4.2. SISTEMI I PAGESAVE

Objektivi strategjik

Neni 61 i MSA-së parashikon detyrimet që rrjedhin në lidhje me transaksionet e kapitalit dhe llogarinë financiare të bilancit të pagesave. Nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, Palët sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit për sa u përket kredive që lidhen me transaksionet tregtare ose me sigurimin e shërbimeve ku merr pjesë një rezident i një prej Palëve, dhe të huave financiare e kredive, me afat maturimi më të gjatë se një vit.

Situata aktuale

Banka e Shqipërisë për të realizuar objektivin e saj kryesor, atë të "arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve", përdor instrumentet e politikës monetare, efikasiteti i të cilave varet nga funksionimi normal i sistemit të pagesave. Për këtë arsye, nxitja dhe mbështetja për mirëfunksionimin e sistemit të brendshëm të pagesave në Shqipëri është një nga objektivat dytësorë dhe njëkohësisht një nga detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë.

Roli i Bankës së Shqipërisë, në drejtim të nxitjes dhe funksionimit normal të sistemit të pagesave, konsiston në tre drejtime kryesore; roli i operatorit në ofrimin e sistemeve dhe infrastrukturave të nevojshme për klerimin dhe shlyerjen e pagesave dhe të titujve, kur shlyerja e këtyre të fundit mund të vlerësohet me risk për funksionimin normal të sistemit të

pagesave; roli i mbikëqyrësit në hartimin dhe zbatimin e parimeve dhe standardeve për zhvillimin e sigurt dhe eficient të sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes, si dhe në sigurimin e përputhshmërisë me parimet dhe standardet e vendosura, si për sistemet e administruara nga vetë Banka ashtu edhe për ato të administruara nga operatorë të tjerë; dhe roli i katalizatorit në nxitjen e ndryshimeve për funksionimin e sigurt dhe efiçient të sistemit të pagesave, duke influencuar në zhvillimin dhe integrimin e sistemit të pagesave në mënyra të ndryshme, si diskutime me pjesëmarrësit në sistem, publikime të materialeve të ndryshme, zbatimit të marrëveshjeve apo kontratave për pjesëmarrje në sisteme, bashkëpunimit me autoritete të tjera, etj.

Në Republikën e Shqipërisë, klerimi dhe shlyerja e pagesave ndërmjet bankave, në monedhën kombëtare Lek, realizohet nëpërmjet dy sistemeve të pagesave: "Sistemi i shlyerjes së pagesave ndër - bankare me vlerë të madhe - AIPS" dhe "Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH", në përputhje me rregullat dhe procedurat e funksionimit të sistemeve.

Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të MSA-së në lidhje me lëvizjen e lirë të kapitalit dhe të pagesave rrjedhëse si dhe mbi sistemin e pagesave. Struktura e Bankës së Shqipërisë, e cila është përgjegjëse për mirëfunksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të pagesave, është Departamenti i Sistemeve të Pagesave. Ky departament përbëhet nga 19 punonjës, organizuar në 3 Sektorë: Sektori i Politikave dhe Mbikëqyrjes së Sistemeve të Pagesave, Sektori i Sistemeve të Pagesave dhe Sektori "Back Office".

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Ligji 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"[32], i ndryshuar me ligjin 10481, datë 17.11.2011. Ligji përafron pjesërisht Direktivën 2006/48/KE[33] të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 14.06.2006 'Për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit te veprimtarisë nga ana e institucioneve te kreditit" (e riformuluar), Direktivën 2007/64/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 13.11.2007 "Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm" dhe Direktivën 2009/110/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 16.09.2009 "Për sipërmarrjen, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të sipërmarrjes së institucioneve te parasë elektronike".

Rregullore:

Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 148, datë 20.11.1998 "Për sistemin dhe instrumentet e pagesave";[34]

Rregullore miratuar me Vendimin nr. 83 datë 15.01.2006 "Mbi organizimin e Kleringut të Çeqeve në Bankën e Shqipërisë"[35].

Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 55, datë 26.09.2007 "Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël- AECH"[36] .

[32] Fletore Zyrtare nr. 149, datë 18.01.2007, faqe 6013.
[33] CELEX: 32006L0048, OJL 177 datë 30.06.2006 p. 1-200.
[34] Buletini zyrtar vëllimi 1, numër 1, datë nëntor 1998
[35] Fletore Zyrtare nr. 125, datë 04.12.2006, faqe 5008

Rregullorja përafron pjesërisht Direktivën 98/26/KE[37], datë 19.05.1998 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit "Për finalitetin e shlyerjeve në sistemet e pagesave dhe të shlyerjes së letrave me vlerë";

Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 53, datë 26.09.2007 "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe- AIPS"[38]. Rregullorja përafron pjesërisht Direktivën 98/26/KE, datë 19.05.1998 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit "Për finalitetin e shlyerjeve në sistemet e pagesave dhe të shlyerjes së letrave me vlerë" dhe Direktivën 2002/47/KE[39], datë 06.06.2002 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit "Mbi marrëveshjet financiare të kolateralit";

Rregullore miratuar me Vendimin nr. 11, datë 06.02.2008 'Për instrumentet e pagesave elektronike"[40]. Rregullorja përafron pjesërisht Direktivën 2007/64/KE[41], datë 13.10.2007 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit "Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm" dhe Direktivën 2009/110/KE[42], datë 16.09.2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit "Për fillimin, vazhdimin dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të sipërmarrjes së institucioneve të parasë elektronike";

Rregullore miratuar me Vendimin nr. 42, datë 16.07.2008 'Për strukturën dhe përdorimin e numrit ndërkombëtar të llogarisë bankare (IBAN)[43].). Rregullorja përafron pjesërisht Direktivën 2007/64/KE" Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm";

Rregullore miratuar me Vendimin nr. 12, datë 23.02.2011 për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloret 'Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërkombëtare me vlerë të madhe - AIPS" dhe "Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH)".[44]

Struktura institucionale

Përgjegjësia e Bankës së Shqipërisë në lidhje me zhvillimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes përcaktohet në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar (më poshtë ligji për Bankën), dhe në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me ligjin10481, datë 17.11.2011. (ligji për bankat): neni 3 i ligjit për Bankën, përbën burimin e përgjegjësisë së Bankës së Shqipërisë në raport me mbarëvajtjen e sistemeve të pagesave në Republikën e Shqipërisë, si dhe njëkohësisht shpreh një nga funksionet kryesore të saj. Në këtë nen përcaktohet se: "Banka e Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor dhe mbi bazën e tregut të brendshëm bankar, nxit dhe mbështet zhvillimin e regjimit dhe të sistemit të këmbimeve valutore, tregun e brendshëm financiar, sistemin e pagesave si dhe ndihmon në përmirësimin e kushteve monetare e krediituese, në mbështetje të stabilitetit dhe të zhvillimeve ekonomike të vendit."; ndërkohë neni 3 pika 4 shkronja "dh" parashikon "të nxisë funksionimin normal të sistemit të pagesave".

---

[36] Buletini Zyrtar vëllimi 9, numër 9, datë 15.10.2007
[37] CELEX: 31998L 0026; OJL 166, datë 11.06.1998, p. 45-50.
[38] Buletini Zyrtar vëllimi 9, nr. 9, datë 15.10.2007
[39] CELEX: 32002L 0047; OJL 168, datë 27.06.2002, p. 43-50.
[40] Fletore Zyrtare nr. 15, datë 17.02.2008, faqe 528
[41] CELEX: 32007L 0064; OJL 319, date 05.12.2007, p. 01-X6.
[42] CELEX: 32009L 0110; OJL 267, date 10.10.2009, p. 07-17.
[43] Fletore Zyrtare nr. 133, datë 13.08.2008, faqe 5941
[44] Buletini Zyrtar vëllimi 13, nr. 2, datë 07.03.2011

Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të MSA-së në lidhje me lëvizjen e lirë të kapitalit dhe të pagesave rrjedhëse si dhe mbi sistemin e pagesave. Struktura e Bankës së Shqipërisë, e cila është përgjegjëse për mirëfunksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të pagesave, është Departamenti i Sistemeve të Pagesave. Ky departament përbëhet nga 19 punonjës, organizuar në 3 Sektorë: Sektori i Politikave dhe Mbikëqyrjes së Sistemeve të Pagesave, Sektori i Sistemeve të Pagesave dhe Sektori "Back Office".

Masat legjislative afatshkurtra

- Projektligji "Për sistemet e pagesave", i cili do të ketë përafrim të pjesshëm me Direktivën 98/26/KE, datë 19.05.1998 "Për finalitetin e shlyerjeve në sistemet e shlyerjes së pagesave dhe të letrave me vlerë", Direktivën 2002/47/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 6 qershor 2002 mbi marrëveshjet financiare të kolateralit , Protokollin (Nr. 4) mbi statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane dhe Parimet Themelore të Bankës për Rregullimet Ndërkombëtare për Sistemet e Pagesës me Rëndësi Sistemike.
- Rregullore "Mbi disa ndryshime ne Rregulloren nr. 11, datë 06.02.2008 "Për instrumentet e pagesave elektronike" me qëllim harmonizimin me Direktivën 2007/64/KE "Për shërbimet e pagesave në Komunitet"[45].
- Miratimi i rregullores së re "Për licencimin e veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike". Hartimi i rregullores ka për qellim përafrimin e dispozitave te saj me Direktivën 2009/110/KE "Për paranë elektronike".Miratimi i rregullores së re "Për mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike". Hartimi i rregullores ka për qellim përafrimin e dispozitave te saj me Direktivën 2009/110/EC "Për paranë elektronike".

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Trajnimi i stafit të Departamentit të Sistemit të Pagesave me qëllim përdorimin e instrumenteve dhe metodologjisë për realizimin e aktiviteteve mbikëqyrëse, hartimin dhe zbatimin e rregullave të reja për aktivitetin e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave dhe shlyerjes dhe hartimin dhe zbatimin e Direktivës së shërbimeve të pagesës;
- Hartimi i planit për zbatimin e rregullave të reja me qëllim mbikëqyrjen e aktivitetit të sistemeve të pagesave dhe shlyerjes;
- Ndryshimi i legjislacionit që rregullon fushën e shërbimeve të pagesave me qëllim përafrimin e mëtejshëm të tij me Direktivën 2007/64/KE "Për shërbimet e pagesave në Komunitet" dhe Direktivën 2009/110/KE "Për paranë elektronike";
- Hartimi i një plani të detajuar për zbatimin e direktivës së shërbimeve të pagesës së BE-së. Ky aktivitet ka për qëllim përgatitjen për zbatimin e Direktivës së shërbimeve të pagesës (2007/64/KE) dhe rregullores "Për paranë elektronike" (2009/924/KE).

[45] Kjo rregullore përbën një nga aktet nënligjore të cilat do të rishikohen në sajë të transpozimit të Direktivën 2007/64/KE "Për shërbimet e pagesave në Komunitet.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Hartimi i manualeve me qëllim administrimin e sistemeve të pagesave në përputhje me praktikat Evropiane.
- Trajnimi dhe kualifikimi i stafit të Departamentit të Sistemit të Pagesave mbi funksionimin e sistemeve të pagesave. Aktiviteti do të përfshij trajnime lidhur me dërgimin dhe marrjen e pagesave me vlerë të vogël në përputhje me projektin Evropian të Zonës Unike të Pagesave në Euro (SEPA – Zona Unike e Pagesave në Euro), me objektiv integrimin Evropian në pagesat elektronike me vlerë të vogël në Euro.
- Zbatimi i procedurave të bankave qendrore për administrimin e kolateralit, të sistemeve të pagesës me vlerë të madhe dhe vlerë të vogël me qëllim arritjen e sinkronizimit të proceseve dhe infrastrukturës së pagesave në përputhje me zhvillimet e sistemeve të pagesës dhe standardeve.
- Rishikimi i legjislacionit që rregullon fushën e shërbimeve të pagesave me qëllim përafrimin e mëtejshëm të tij me Rregulloren 2009/924/KE[46] "Për pagesat ndër-kufitare në Komunitet";
- Rishikimi i legjislacionit që rregullon fushën e shërbimeve të pagesës me qëllim transpozimin e dispozitave të Direktivës 2007/64/KE[47] "Për shërbimet e pagesave në Komunitet" të cilat rregullojnë institucionin e ankimimit për zgjidhjen e konflikteve midis klientëve dhe ofruesve të shërbimit të pagesave.

Efektet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**1.455.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	1.455.000	0	0	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	0	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.4.3. PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE

Objektivi strategjik

Në zbatim të detyrimeve të parashikuara në nenin 4 dhe 82 "Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit", të MSA-së, Qeveria Shqiptare është plotësisht e angazhuar për të forcuar më tej luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit si dhe për formalizimin e ekonomisë në vend. Në këtë mënyrë, synohet rritja e besueshmërisë në vend dhe në sistemin e tij ekonomik e ligjor. Fuqizimi i kapaciteteve në këtë drejtim do të ketë vëmendjen kryesore me qëllim arritjen e rezultateve të dukshme dhe konkrete. Në përmbushje të këtyre detyrimeve, Qeveria Shqiptare do të nxisë bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e

[46] CELEX: 32009R 0924; OJL 266, date 09.10.2009, p. 11-18.
[47] CELEX: 32007L 0064; OJL 319, date 05.12.2007, p. 01-36.

fqinjësisë së mirë për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, për çështje që kanë të bëjnë veçanërisht me parandalimin e pastrimit të parave. Gjithashtu, Qeveria Shqiptare do të bashkëpunojë me vendet e tjera me qëllim parandalimin e përdorimit të sistemeve financiare për pastrimin e produkteve nga aktivitete kriminale në përgjithësi, si dhe përdorimin e tyre për qëllime të financimit të terrorizmit.

Situata aktuale

Legjislacioni në fushën e parandalimit te pastrimit te parave synon të luftojë në mënyrë aktive dhe të pandërprerë krimin ekonomiko-financiar, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit të cilat dëmtojnë rëndë stabilitetin politik dhe ekonomik të vendit, sigurinë kombëtare e në tërësi demokracinë dhe shtetin e të drejtës.

Zbatimi dokumentit strategjik kombëtar 'Për hetimin e krimit financiar" kërkon angazhimin e një sërë institucionesh shtetërore si Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Shërbimit Informativ Shtetëror, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Agjencisë së Administrimit të Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara si dhe bashkëpunimi me institucione Mbikëqyrëse si Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Dhoma Kombëtare e Noterëve, Avokatëve, Dhoma e Tregtisë etj. Institucionet e përfshira në zbatimin e këtij dokumenti do të identifikojnë dhe përcaktojnë burimet përkatëse për zbatim. Në 13 prill të vitit 2011 Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit te Parave dhe Financimit të Terrorizmit[48] i KE publikoi raportin e raundit të katërt të vlerësimit të Shqipërisë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ky raport, ndër të tjera, përmban rekomandime të detajuara për të gjitha institucionet e vendit që janë përfshirë në procesin e vlerësimit. Këto rekomandime janë marrë në konsideratë gjatë marrjes së masave përkatëse për përmbushjen e mangësive të konstatuara. Në raportin përmbledhës të sipërcituar, përsa i përket rekomandimit 26 që ka të bëjë drejtpërdrejt me aktivitetin e Njësisë së Inteligjencës Financiare – DPPPP, vlerësimi u rrit në "LC" (Largely Compliant). Duke qenë se sipas raportit të Komitetit MONEYVAL pjesa më e madhe e rekomandimeve për raundin e IV të vlerësimit kanë një nivel të pamjaftueshëm (Non Compliant/Partially Compliant), DPPPP si kryesuese e delegacionit, ka adresuar menjëherë problematikat tek institucionet përgjegjëse për marrjen e masave të nevojshme.

Në mbështetje edhe të rekomandimeve të sipërcituara, DPPPP është përfshirë drejtpërdrejtë në hartimin e ndryshimeve të Ligjit nr. 9917 (të sipërcituar) dhe të akteve nënligjore të fushës.
DPPPP ka bashkëpunuar ngushtësisht me ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë në funksion të përgatitjeve për raportin e vlerësimit të Shqipërisë si dhe ka marrë pjesë në Konferencën e Palëve për Konventën e Këshillit të Evropës (CET 198) "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit", të zhvilluar në datat 7-8 mars 2011, në Strasburg të Francës.

[48] Komiteti i MONEYVAL

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacion

Ligje:

- Ligji nr. 9258 datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"[49] . Ligji përafron pjesërisht Direktivën 91/308/KE, datë 10.06.1991 "Për parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për pastrimin e parave" dhe Direktivën 2001/97/KE e datës 04.12.2001 e cila ndryshon Direktivën 91/308/KE.
- Ligjin nr. 9917 datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" i ndryshuar[50] . Ligji përafron pjesërisht Direktivën 91/308/KE[51], datë 10.06.1991 "Për parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për pastrimin e parave" dhe Direktivën 2001/97/KE[52] të datës 04.12.2001 e cila ndryshon Direktivën 91/308/KE si dhe Direktivën 2005/60/KE[53]. Ligji përafron pjesërisht Direktivën 2005/60 EC, datë 26 tetor 2006 "Mbi parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", Direktivën 2006/70 /KE[54], datë 1 gusht 2006, e cila parashikon masat për zbatimin e Direktivës 2005/60 KE si dhe Rregulloren 1781/2006 KE[55], datë 15 nëntor 2006 "Mbi informacionin e paguesit, i cili bën transferimin e fondeve";
- Ligji Nr. 10391, datë 03.03.2011, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" ka hyrë në fuqi më date 15.04.2011[56].
- Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 343, datë 8.4.2009, "Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse".
- VKM nr. 1077 datë 27.10.2009, "Për miratimin e Dokumentit Strategjik Kombëtar për Hetimin e Krimit Financiar"[57] ;
- VKM Nr. 871, datë 14.12.2011 " Për përcaktimin e procedurave të konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes së masave administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)";
- VKM Nr. 922, datë 21.12.2011 " Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave". Aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit te terrorizmit" janë:

Udhëzime:

- Udhëzim i Ministrit të Financave nr. 15, datë 16.02.2009, " Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës për financimin e terrorizmit në sistemin doganor".
- Udhëzim i Ministrit të Financave nr. 16, datë 16.02.2009, " Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës për financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave".

---

[49] Fletore zyrtare nr. 54, datë 11.08.2004, faqe 3538
[50] Fletore zyrtare nr. 83, datë 10.06.2008, faqe 3645
[51] CELEX: 31991L 0308; OJL 166, date 28.06.1991, p. 0077-0083
[52] CELEX: 32001L 0097; OJL 344, date 28.12.2001, p. 7682
[53] CELEX: 32005L 0060; OJL 309, date 25.11.2005, p. 15-36
[54] CELEX: 32006L 0070; OJL 214, date 4.8.2006, p. 29-34
[55] CELEX: 32006R 1781; OJL 345, date 8.12.2006, p. 01-09
[56] Përgjithësisht, gjatë hartimit të këtij ligji, janë marrë në konsideratë kriteret esenciale të Rekomandimeve 5[56] dhe 6[56] të FATF. Gjithashtu u cilësua më tej pavarësia e DPPPP duke përcaktuar një mandat për Drejtorin e Përgjithshëm.
[57] Fletorja Zyrtare nr.164, datë 03.12.2009, faqe 7247

- Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 01.04.2009 "Për formën, mënyrat e procedurat e raportimit të të dhënave të subjekteve, Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në kuadrin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".
- Udhëzim i Ministri të Financave Nr. 21, datë 08.09.2011 "Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare";
- Udhëzim i Ministri të Financave nr. 20, datë 08.09.2011 "Për metodat dhe procedurat e raportimit të subjekteve raportuese të ligjit nr.9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar".
- Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 93, datë 25.02.2009 "Për menaxhimin e punonjësve të policisë nën mbulim apo të infiltruar ".
- Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 23, datë 15.01.2009 "Për vëzhgimin e fshehtë të personave dhe mjediseve dhe procedurat standarde gjatë aplikimit të tyre".

Struktura institucionale

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), e cila është në rolin e Njësisë së Inteligjencës Financiare. Misioni i kësaj Drejtorie konsiston në: Parandalimin e "pastrimit të parave" dhe në luftën kundër financimit të terrorizmit, nëpërmjet grumbullimit, verifikimit, vlerësimit, kontrollit, ruajtjes së informacioneve nga subjektet e ligjit, pezullimit, bllokimit dhe ngrirjes të çdo veprimi me qëllim parandalimin e transferimit, tjetërsimit ose kalimit të pasurisë dhe produkteve që rrjedhin nga veprimtaria kriminale; Bashkërendimin me struktura të tjera të zbatimit të ligjit të tilla si Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, Shërbimi Informativ Shtetëror, me Organizma homologe dhe Institucione ndërkombëtare; Hartimin e programeve të bashkëpunimit dhe asistencave të ndërsjella në drejtim të parandalimit të "pastrimit të parave" me vende të ndryshme, në bazë të konventave ndërkombëtare të nënshkruara dhe ratifikuara.

Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP) i cili funksionon në bazë të Rregullores të Re për Komitetin e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave të miratuar në datë 16.12.2008. Ky komitet drejtohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje të tij Prokurorin e Përgjithshëm, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Ministrin e Punëve të Jashtme, Ministrin e Mbrojtjes, Ministrin e Brendshëm, Ministrin e Financave, Ministrin e Drejtësisë, Drejtorin e SHISH-it dhe Inspektorin e Përgjithshëm të ILDKP-së.

Komiteti është përgjegjës për përcaktimin e drejtimeve të politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave e financimit të terrorizmit. Komiteti ka për detyrë shqyrtimin dhe analizimin e raporteve për veprimtaritë e kryera nga "Autoriteti Përgjegjës", nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, si dhe raportet për dokumentet e përgatitura nga institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë, të cilat ushtrojnë veprimtaritë e tyre në fushën e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Banka e Shqipërisë (Departamenti i Mbikëqyrjes), ka detyrimin të njoftojë DPPPP në rast se vëren se ka elemente të pastrimit të parave, sipas së njëjtës formë dhe mënyrë, sikurse

parashikohet për të gjithë subjektet e përcaktuara nga ligji.
Drejtoria Kundër Krimit Financiar në përbërje të Departamentit të Hetimit të Krimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendshme, e përbërë nga tre sektorë:

- Sektori Kundër Korrupsionit;
- Sektori Kundër Pastrimit të Parave;
- Sektori Kundër Krimit Ekonomik dhe Financiar;
- Sektori Kundër Krimeve Kompjuterike;
- Sektori për Hetimin e Aseteve Kriminale.

Kjo drejtori ka në vartësi vendore në 12 drejtoritë e policisë së qarqeve Seksionet e luftës kundër korrupsionit, kundër pastrimit të parave dhe kundër krimit ekonomik dhe financiar. Përgjegjësitë e Drejtorisë Kundër Krimit Financiar, janë të parandalojë, të zbulojë dhe hetojë, në përputhje me ligjin penal dhe me ligjin procedural penal, veprat penale të korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimet ekonomike dhe financiare.

- Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore sipas juridiksionit territorial, për hetimin e krimeve financiare, veçanërisht me Njësinë e Përbashkëta Hetimore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Shërbimi Informativ Shtetëror për shkëmbimin e informacioneve dhe realizimit të operacioneve të përbashkëta.

Sektori i Luftës Kundër Pastrimit të Parave në Drejtorinë e Luftës Kundër Krimit Ekonomiko-Financiar në Ministrinë e Brendshme. Detyra e këtij sektori është drejtimi, bashkërendimi, kontrolli dhe ushtrimi i veprimtarisë për zbulimin, dokumentimin dhe ndërprerjen e aktivitetit kriminal në fushën e pastrimit të parave.

Masat legjislative afatshkurtra

- Miratimin e VKM-ve në lidhje me listat e individëve që figurojnë si financues të terrorizmit në Listën e personave të shpallur të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në zbatim te ligjit nr. 9258 datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.
- Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit me njësinë homologe të Spanjës.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Krijimi dhe funksionimi i një grupi pune për hartimin e VKM shtesë ne lidhje me listat e individëve që figurojnë si financues të terrorizmit në Listën e personave të shpallur të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në zbatim të Ligjit nr. 9258 datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”;
- Trajnimi i specialistëve të strukturave të luftës kundër pastrimit të parave dhe krimeve ekonomiko-financiare për teknikat e hetimit të veprave penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Trajnimi i subjekteve të ligjit mbi zbatueshmërinë dhe përputhshmërinë me kërkesat e ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit

te terrorizmit" i ndryshuar;

- Inspektimi i subjekteve te ligjit 9917, date 19.05.2008, për një zbatim sa më të mirë të ligjit 9917, datë 19.05.2008, i ndryshuar;
- Zhvillimi i tryezave të rrumbullakëta me Grupin e Kontaktit (teknik ndërinstitucional), dhe strukturat e tjera lidhur me: direktivat e BE-së, 40+9 rekomandimet e Grupi i Aksionit Financiar[58] FATF –së si dhe strategjitë e nevojshme ndërinstitucionale e kombëtare për përafrimin me standardet ndërkombëtare te luftës kundër PP/FT;
- Përdorimi me efektivitet i pajisjeve hardëare dhe softëare në dispozicion të Njësisë së Inteligjencës Financiare FIU-t Shqiptare, sidomos atyre të akorduara me fonde të BE-se si dhe trajnimi i mëtejshëm i stafit të analizës për përdorimin me efektivitet të softëareve analitik;
- Identifikimi i subjekteve me rrezik të lartë për pastrim parash;
- Rishikimi dhe përditësimi i listës së indikatorëve në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;Zbatimi i objektivave të përcaktuar në Dokumentin Strategjik "Për hetimin e krimit financiar" dhe të Strategjisë së Luftës kundër krimit të organizuar.

Masat legjislative afatmesme

Nënshkrimi i memorandumeve të Bashkëpunimit me partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim rritjen e bashkëpunimit dy dhe shumëpalësh në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit;

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Trajnimi i subjekteve raportuese mbi legjislacionin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional kombëtar në kuadër të aktiviteteve të parashikuara sipas Planit të Zbatimit të Strategjisë Kombëtare "Për Hetimin e Krimit Financiar".

[58] Financial Action Task Force - FATF

3.5. PROKURIMI PUBLIK

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik në fushën e prokurimit publik është garantimi dhe respektimi i procedurave të prokurimit publik. Në përputhje edhe me angazhimet e marra nga Shqipëria në këtë fushë, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, përkatësisht Neni 70 dhe 74 i saj, ky objektiv do të realizohet nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të legjislacionit të prokurimit publik sipas standardeve evropiane dhe zbatimit të drejtë të tij, forcimit të kapaciteteve institucionale të përfshirë në procedurat e prokurimit publik, si dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të prokurimit elektronik në funksion të sigurimit të transparencës, nxitjes së pjesëmarrjes dhe rritjes së konkurrencës.

Statusi aktual

Kuadri aktual legjislativ në fushën e prokurimit publik siguron një proces transparent dhe lehtësisht të aksesueshëm për aktorët e përfshirë në procedurat prokuruese. Që prej vitit 2009, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 45, datë 21.01.2009 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik me mjete elektronike", të ndryshuar, të gjitha procedurat e prokurimit publik kryhen elektronikisht (me përjashtim të procedurës së prokurimit negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës). Ky është një faktor i rëndësishëm në drejtim të rritjes së konkurrencës dhe cilësisë së komunikimit, pasi sistemi i prokurimit elektronik mundëson transaksione të sigurta ndërmjet institucioneve publike shqiptare dhe komunitetit kombëtar e ndërkombëtar të biznesit.

Gjithashtu, dhënia e asistencës në arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian për fushën e prokurimit publik, sikurse janë kërkuar në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, ka qenë qëllimi i zbatimit të projektit të Binjakëzimit IPA 2008 "Mbështetje për forcimin e sistemit Shqiptar për prokurimin publik, koncesioneve dhe ankandit publik". Konkretisht, disa nga aktivitetet e realizuara gjatë zbatimit të projektit IPA, me kohëzgjatje Nëntor 2010 – Janar 2012, konsistojnë në vlerësimin e kuadrit aktual ligjor dhe institucional për prokurimin publik dhe koncesionet dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim të mëtejshëm të tyre; ekzaminimi i praktikave më të mira të prokurimit në disa prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe krahasimi i tyre me legjislacionin Shqiptar të prokurimit publik; përgatitja e draft-it për amendime në ligjin e prokurimit publik, dhe një draft-ligji për koncesionet; vlerësimi i dokumenteve standarde të tenderit dhe propozime për përmirësim të mëtejshëm të tyre.

Në drejtim të forcimit institucional, disa nga aktivitetet e kryera në kuadër të projektit të lartpërmendur i përkasin hartimit të një Plani Kombëtar Trajnimi në fushën e prokurimit publik; ngritjes së 12 Njësive Trajnuese Rajonale në secilën Prefekturë të Qarkut dhe trajnimit të tyre nga ekspertët e projektit dhe stafi i Agjencisë së Prokurimit Publik; hartimi i manualeve dhe udhëzimeve mbi procedurat e rishikimit; organizimi i trajnimeve mbi prokurimin publik me përfaqësues të autoriteteve kontraktore në gjithë vendin, në nivel qendror dhe vendor; përgatitja e moduleve dhe manualeve të trajnimit për përdorim gjatë trajnimeve nga APP.

Për më tepër, në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit në fushën e prokurimit publik, në kuadër të projektit u përgatitën materiale informuese, si broshurë dhe fletëpalosje mbi sistemin e prokurimit publik dhe institucionet e lidhura me të; hartimi i pyetësorëve për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë dhe publikimi i tyre në faqen zyrtare të Internetit të APP-së, përgjigjet e dhëna gjatë plotësimit të të cilëve do të shërbejnë për adresimin e tematikave të adresuara përkatësisht nga AK-të dhe OE-të.

Zbatimi i legjislacionit për prokurimin publik ushtrohet nëpërmjet Agjencisë së Prokurimit Publik, Institucionit të Avokatit të Prokurimeve, Komisionit te Prokurimit Publik dhe Autoriteteve Kontraktore. Në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative, APP, në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit IPA, kanë zhvilluar trajnime me përfaqësues të institucioneve të lartpërmendura, si dhe me punonjës të autoriteteve kontraktore, në nivel qendror dhe vendor, të përfshirë në procedurat e prokurimit publik. Në këto trajnime u trajtuan çështje që i përkasin legjislacionit të prokurimit publik dhe zbatimit të tij në praktikë, si dhe sistemit të prokurimit elektronik.

Prioritetet në vazhdim, në këtë fushë, i përkasin kryesisht përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit me direktivat respektive të Bashkimit Evropian, zbatimit të drejtë të tij, dhe ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve institucionale, të përfshirë në procesin e prokurimeve publike.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/nënligjore në fushën e prokurimit publik janë:

- Ligj nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, (botuar në Fletoren Zyrtare të RSH nr. 133, datë 22 Dhjetor 2006). Ky ligj përafron pjesërisht Direktivën 2004/18/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit datë 31 Mars 2004, për koordinimin e procedurave për shpalljen fituese të kontratave për punë publike, furnizime dhe shërbime publike; pjesërisht Direktivën 2004/17/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 31 mars 2004, për koordinimin e procedurave të prokurimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektorët ujor, energjetik, të transportit dhe postar; pjesërisht Direktivën 89/665/EEC e Këshillit datë 21 Dhjetor 1989, mbi koordinimin e ligjeve, rregullave dhe dispozitave administrative në lidhje me aplikimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave publike të furnizimit dhe të punëve publike.
- Ligj nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", i ndryshuar, (botuar në Fletoren Zyrtare të RSH nr. 150, datë 18 Janar 2007). Ky ligj përafron pjesërisht Direktivën 2004/18/EC.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", të ndryshuar (botuar në Fletoren Zyrtare të RSH nr. 1, datë 10 Janar 2007).
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19.01.2007 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", i ndryshuar (botuar në Fletoren Zyrtare të RSH nr. 10, datë 12 Shkurt 2007).
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 03.10.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik me mjete elektronike", të ndryshuar botuar në Fletoren Zyrtare të RSH nr. 141, datë 24 Tetor 2007).

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 45, datë 21.01.2009 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike", i ndryshuar (botuar në Fletoren Zyrtare të RSH nr. 8, datë 9 Shkurt 2009).
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 53, datë 21.01.2009 "Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime", i ndryshuar (botuar në Fletoren Zyrtare të RSH nr. 8, datë 9 Shkurt 2009).

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në zbatimin e legjislacionit në fuqi të prokurimit publik janë Agjencia e Prokurimit Publik (APP), Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), Avokati i Prokurimeve (AvP) dhe Autoritetet Kontraktore (AK).

Agjencia e Prokurimit Publik (APP) është organi qendror për mbikëqyrjen dhe koordinimin e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri. Mbi këtë bazë, APP-ja është organi kompetent për monitorimin e mbarëvajtjes së sistemit të prokurimit publik nëpërmjet informacioneve të marra nga raportet periodike të autoriteteve kontraktore, si dhe nga raportet e organit qendror blerës apo Avokatit të Prokurimeve. Krahas ekzistencës si organ kontrolli, kjo Agjenci nxit dhe ndihmon në kualifikimin e punonjësve të Organeve Qendrore e Lokale, që merren me prokurimin publik, si dhe jep udhëzime dhe, sipas kërkesës, këshilla e ndihmë Autoriteteve Kontraktore që kryejnë një procedurë prokurimi. APP-ja gjithashtu ka një sërë kompetencash në fushën e koncesioneve dhe ankandeve. Konkretisht në bazë të 3 ligjeve përkatëse APP ka këto kompetenca:

Në bazë të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, disa nga detyrat kryesore të APP-së janë:

- paraqet në Këshillin e Ministrave propozime për rregullat e prokurimit;
- harton dhe nxjerr Buletinin e Njoftimeve Publike, siç është përshkruar në rregullat e prokurimit;
- harton dokumentet standarde të tenderit, që do të përdoren në procedurat e prokurimit, sipas rregullave të prokurimit publik;
- paraqet një raport vjetor në Këshillin e Ministrave për funksionimin e përgjithshëm të sistemit të prokurimit publik;
- planifikon dhe bashkërendon ndihmën teknike të huaj për Shqipërinë në fushën e prokurimit publik;
- nxit dhe mbështet përdorimin e standardeve teknike ndërkombëtare për përgatitjen e specifikimeve teknike kombëtare, si dhe mban lidhje të vazhdueshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimeve;
- Monitoron mbarëvajtjen e sistemit të prokurimit publik nëpërmjet informacioneve të marra nga raportet periodike të autoriteteve kontraktore, si dhe nga raportet e organit qendror blerës apo Avokatit të Prokurimeve. Procedurat e monitorimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- në rast shkeljesh të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, vendos gjoba ose i propozon drejtuesit të autoritetit kontraktor apo organeve më të

larta masa disiplinore për personat e autoriteteve kontraktore, që i kanë kryer këto shkelje;
- kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me ligj;
- Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, pavarësisht nga çështja penale, që mund të ketë filluar, për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet në rast se përmbushen kushtet e parashikuara në nenin 13 pika 3/a/b/c/ç të ligjit të prokurimit publik.

Në bazë të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", i ndryshuar, APP ka disa kompetenca në drejtim të koncesioneve:
- u kërkon autoriteteve kontraktuese raportime periodike, një herë në 6 muaj, për gjendjen e koncesioneve;
- verifikon zbatimin e procedurave koncesionare, në mënyrë periodike, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së koncesionit, në përputhje me këtë ligj e aktet e tjera të dala në zbatim të tij, duke u kërkuar autoriteteve koncesionare të gjithë informacionin e nevojshëm;
- propozon, në përfundim të verifikimeve, masa disiplinore dhe vendos gjoba, në rastet kur vëren shkelje të procedurave të këtij ligji;
- shpall përjashtimin nga procedurat koncesionare të ofertuesve, të cilët, gjatë një procedure koncesionare, kanë depozituar dokumente false apo kanë deklaruar informacion të rremë, në bazë të propozimit të autoritetit kontraktues ose në rastin kur i konstaton këto shkelje në përfundim të verifikimit si më sipër, dhe kur është rasti, bën kallëzim penal;
- mban dhe administron regjistrin e koncesioneve, si dhe dokumentacionin origjinal që dërgohet nga autoritetet kontraktuese brenda 3 (tre) muajve nga data e miratimit të kontratës së koncesionit;
- i paraqet Këshillit të Ministrave rekomandime të përgjithshme për gjendjen dhe kuadrin ligjor të koncesioneve.

Gjithashtu, në bazë të ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik", të ndryshuar, Agjencia e Prokurimit Publik ka këto kompetenca:
- u kërkon autoriteteve shitëse raportime periodike, një herë në 6 muaj, për procedurat e realizuara nëpërmjet shitjes me ankand publik;
- verifikon zbatimin e procedurave të ankandeve publike në përputhje me këtë ligj dhe akte të tjera të dala në zbatim të tij, duke u kërkuar autoriteteve shitëse të gjithë informacionin e nevojshëm;
- i propozon autoritetit shitës marrjen e masave disiplinore dhe vendos gjoba nga 50 mijë në 100 mijë lekë, në rastet kur vëren shkelje të procedurave të këtij ligji;
- vendos dhe shpall përjashtimin e 1 deri në 3 vjet nga procedurat e ankandit publik, të ofertuesve të cilët gjatë një procedure shitje kanë depozituar dokumente false apo kanë deklaruar informacion të rremë;
- raporton një herë në 6 muaj pranë Këshillit të Ministrave për kontratat e shitjes, të realizuara me ankand publik.

Agjencia e Prokurimit Publik ka në total 18 punonjës.

Komisioni i Prokurimit Publik ushtron kompetencat e tij në bazë të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", i ndryshuar; dhe ligjit nr. 9874, date 14.02.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik ka për detyrë shqyrtimin administrativ të ankesave në fushën e prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandit publik. Vendimet e tij janë përfundimtare nga ana administrative. Struktura e Komisionit të Prokurimit Publik ka një numër total prej 18 punonjësish.

Avokati i Prokurimeve ushtron kompetencat e tij në bazë të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", i ndryshuar; dhe ligjit nr. 9874, date 14.02.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar. AvP mbron të drejtat dhe interesat e ligjshëm të kandidatëve, ofertuesve apo furnizuesve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të autoriteteve kontraktore, nëpërmjet monitorimit dhe hetimit të procedurave administrative të prokurimeve publike, koncesioneve dhe ankandit publik. Mbështetur në legjislacionin e lartpërmendur, Avokati i Prokurimeve ka këto kompetenca:

- të monitorojë procedurat administrative në prokurimin publik, në dhënien me koncesion, dhe ankandeve publik;
- të hetojë në bazë të ankesave të marra apo me iniciativën e tij veprimet apo mosveprimet e kundraligjshme ose të parregullta të autoriteteve kontraktore;
- të rekomandojë masa korrigjuese;
- të raportojë direkt në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për aktivitetin dhe problematikat që trajton, nëpërmjet analizës vjetore, me kërkesë të Kuvendit ose me kërkesën e tij.

Struktura e Avokatit te Prokurimeve ka një numër total prej 14 punonjësish.
Gjithashtu legjislacioni i prokurimit publik zbatohet nga të gjitha Autoritetet Kontraktore që prokurojnë fonde publike.

Masat ligjore afatshkurta

- Miratimi i draft ndryshimeve në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar. Ky projektligj do të përafrojë më tej Direktivën 2004/18/EC.
- APP do të hartojë dhe dërgojë për miratim disa amendime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", të ndryshuar. Këto amendime kanë për qëllim reflektimin e ndryshimeve të bëra në Ligjin e prokurimeve.

Masat zbatuese

- Implementimi në formë elektronike i marrëveshjeve kuadër;
- APP do të hartojë manuale shpjeguese për zbatimin elektronikisht të marrëveshjeve kuadër;
- Trajnimi i autoriteteve kontraktore në nivel qendror dhe vendor mbi zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik dhe përmirësimet në sistemin e prokurimit elektronik.

Masat ligjore afatmesme

- Hartimi i një draft-ligji për koncesionet. Ky projektligj do të përafrojë më tej direktivën 2004/18/EC;
- APP do të hartojë dhe dërgojë për miratim disa ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Ky projektligj do të përafrojë më tej direktivën 2004/18/EC.

Masat zbatuese

- Forcimi i kapaciteteve institucionale në fushën e prokurimit publik, me qëllim zbatimin efektiv të legjislacionit në këtë fushë.

Efektet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**34.250.000**	**650.000**	**650.000**	**650.000**
Mbulohen nga buxheti i	650.000	650.000	650.000	650.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	33.600.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.6. E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE

3.6.1. E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE

Objektivi strategjik

Objektivi kryesor i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) është përmirësimi i vazhdueshëm dhe harmonizimi i legjislacionit tregtar vendas me atë të Bashkimit Europian. Legjislacioni tregtar është një nga fushat prioritare në kuadër të procesit të integrimit në përputhje me detyrimet e përcaktuara në nenet 70 (3), 6, 49, 50 (1), 51 (1), 55 (1) dhe 56 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA).

Në grupet ndërinstitucionale të punës është rënë dakord që, hartimi dhe zbatimi i një kuadri ligjor tregtar në përputhje me standartet e BE-së për:

- krijimin e shoqërive tregtare, mbrojtjen e aksionarëve dhe të kreditorëve në kontekstin e bashkimit dhe ndarjes së shoqërive aksionare,
- të mundësuar bashkimin ndërkufitar të shoqërive aksionare dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar,
- të mundësuar marrjet ndërkufitare në kontroll të shoqërive tregtare,
- trajtimin e parimeve të qeverisjes së korporatave për shpërblimin e drejtorëve dhe shpërblimin në institucionet financiare dhe
- pavarësinë e drejtorëve joekzekutivë dhe komiteteve të këshillit për reduktimin e barrierave të hapjes së biznesit, thjeshtimin dhe standartizimin e praktikave të biznesit në përputhje me praktikat ndërkombëtare, por edhe
- përmirësimin e mëtejshëm të standarteve të auditimit dhe kontabilitetit, do të bënin që legjislacioni tregtar shqiptar të ishte në përputhje të plotë me *acquis*.

Sa i takon Raport Progresit të Komisionit Europian për vitin 2011, raporti vë në dukje problematikën në lidhje me përafrimin e legjislacionit shqiptar të shoqërive tregtare me acquis-në përsa i përket bashkimit ndërkufitar të shoqërive (Direktivën 2005/56/EC), raportimin dhe dokumentimin e bashkimeve dhe ndarjeve (Direktivën 2009/109/EC), kërkesat për kapitalin minimal të regjistruar për shoqëritë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, mungesën e një Kodi të Qeverisjes së Korporatave, si dhe një progres të kufizuar sa i përket zbatimit të nënshkrimit elektronik nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Objektivat e përcaktuara në SKZHI, MSA, por edhe rekomandimet e Komisionit Europian dhe Komitetit të Stabilizim Asociimit do të realizohent nëpërmjet:

- Përforcimit të kapaciteteve administrative;
- Trajnimit të zyrtarëve përgjegjegjës dhe gjyqtarëve të seksionit tregtar;
- Përmirësimit dhe përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit për shoqëritë tregtare me acquis-në e BE-së, si dhe zbatimit të tij.

Situata Aktuale

Analiza e situatës aktuale

Përsa i takon përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit të shoqërive tregtare janë marrë masat si me poshtë vijon:

- Ligji nr. 10236, datë 18.2.2010 "Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike" i cili është në përputhje të plotë me Direktivën 2004/25/EC për marrjen në kontroll të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar. Ky ligj përcakton rregullat që lidhen me kushtet dhe procedurat për ofertat publike të blerjes së titujve të emetuar nga një shoqëri aksionare. Ai do të zbatohet për ofertat publike për blerjen e titujve të emetuar nga një shoqëri aksionare me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe të pranuar për tregtim në tregun e organizuar të titujve të Republikës së Shqipërisë, sipas Ligjit Nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt". Ky ligj nuk do të zbatohet vetëm për titujt e emetuar nga Banka e Shqipërisë.
- Ligji nr. 10475, datë 27.10.2011, "Për një ndryshim në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", sipas të cilit kapitali minimal i shoqërive aksionare bëhet 3.500.000 lekë (=25.000 Euro) dhe kjo, në përputhje të plotë me nenin 6 (1) të Direktivës së Dytë 77/91/EEC për koordinimin e masave, të cilat për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, kërkohen nga shoqëritë e Shteteve Anëtare, brenda kuptimit të Nenit 58 të Traktatit, në përputhje me formimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe ruajtjen dhe alterimin e kapitalit, me synimin për ti bërë këto masa ekuivalente.
- Kodi i Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Tregtare u miratua nga Këshilli Konsultativ i Biznesit në Dhjetor 2011 dhe është i disponueshëm për të gjithë bizneset në faqen web të Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës. Kodi do të jetë i zbatueshëm në mënyrë vullnetare nga shoqëritë tregtare. Me mbështetjen e ekspertëve ndërkombëtarë të International Finance Corporation (IFC) dhe asistencën e Gesellschaft fur Internationalischen Zusammenarbeit (GIZ) është hartuar Kodi i Qeverisjes së Korporatave (Corporate Governance Code).

Përsa i përket kapacitetit administrativ vlen të theksohet që Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) ka shtrirë aktivitetin e saj në 32 zyra sporteli në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

QKR funksionon në bazë të një sistemi elektronik të integruar të dhënash që realizon lidhjen ndërmjet të gjitha sporteleve të shërbimit me selinë qëndrore të QKR-së në Tiranë. Ai është ndërtuar në përputhje me standardet dhe praktikat me të mira për regjistrimin elektronik të biznesit. Nëpërmjet sistemit të ri të regjistrimit pranë QKR-së, çdo subjekt regjistrohet në regjistrin tregtar brenda 24 orëve dhe vetëm për 100 lekë.
Ky sistem arrin të koordinojë të dhënat në mënyrë të saktë, duke ju dhënë mundësi subjekteve të interesuara të informohen në kohë reale për sa i përket statusit të aplikimit të tyre.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e shoqërive tregtare janë:

- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i hyrë në fuqi më 21 maj 2008 përafron plotësisht këto direktiva: Celex 31968L0151 - Direktiva e Parë 68/151/EEC, datë 9 mars 1968 (Direktiva për Dhënien e Informacionit - FZ L 65, 14.3.1968, f. 8), me ndryshime dhe shtesa; Celex 31978L0885 - Direktiva e Tretë 78/885/EEC, datë 9 tetor 1978 (Direktiva për Bashkimin e Kompanive - FZ L 295 , 20/10/1978 f. 36); Celex 31982L0891 - Direktiva e Gjashtë 82/891/EEC, datë 17 dhjetor 1982 (Direktiva për Ndarjen e Kompanive - FZ L 378 , 31/12/1982 f. 47); Celex 31994L0045 Direktiva 94/45/EC, datë 22 shtator 1994 "Për krijimin e një Këshilli Evropian për Punën" (FZ L 254 , 30/09/1994 f. 64); Celex 31989L0667 - Direktiva e Dymbëdhjetë e Këshillit 89/667/EEC, datë 21 dhjetor 1989 (Direktiva për Kompanitë me një Ortak - FZ L 395, 30.12.1989, f. 40); Celex 32001L0023 - Direktiva 2001/23/EC, datë 12 mars 2001 "Për ruajtjen e të drejtave të punëmarrësve në rast të transferimit të ndërmarrjeve ose aktiviteteve tregtare ose të pjesëve të tyre" (FZ L 82, 22.03.2001, f. 16; Celex 32007L0036 - Direktiva 2007/36/EC, datë 11 korrik 2007 "Për ushtrimin e disa të drejtave të aksionarëve të shoqërive të regjistruara në bursë" (FZ L 184, 11.07.2007, f 17); Pjesërisht Direktivën e Dytë 77/91/EEC, datë 13 dhjetor 1976 me ndryshime dhe shtesa me Celex 31977L0091.
- Ligji nr. 9723, date 3.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit", i ndryshuar përafron pjeserisht këto direktiva: Direktiva e pare 68/151/EEC, nenet 2,3,4,5,6,10, "Direktiva e Hapjes"; Amendimin e direktivës se pare 2003/58/EC, neni 3,4,6; Direktiva e dytë 77/91/EEC, nenet 2,3,4,6,7,10 "Direktiva e kapitalit"; Direktiva e katërt e këshillit "Direktiva e bilancit vjetor"; Direktiva e njëmbëdhjetë 89/666/EEC, nenet 1,2,9 "Direktiva e degëve".

  Ligji nr. 10236, dt.18.2.2010 "Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike", i hyrë në fuqi më 2 prill 2010, ka përafruar plotësisht Direktivën e BE 2004/25/EC (Celex 32004L0025) për marrjen në kontroll të shoqërive.
- Ligji nr. 10475, datë 27.10.2011 "Për një ndryshim në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ka përafruar plotësisht Direktivën 77/91/EEC me celex 31977L0091 për koordinimin e masave, të cilat për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, kërkohen nga shoqëritë e Shteteve Anëtare, brenda kuptimit të Nenit 58 të Traktatit, në përputhje me formimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe ruajtjen dhe alterimin e kapitalit, me synimin për ti bërë këto masa ekuivalente.

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në zbatimin dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit tregtar vendas me *acquis* të BE-së në këtë fushë janë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), Ministria e Financave, Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, Prokuroria.

METE është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave për përmirësimin e klimës së biznesit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Drejtoria e Politikave të Mbështetjes së

Konkurrueshmërisë së Ekonomisë, është e përbërë nga tetë punonjës, të ndarë në dy sektorë (Sektori i Zhvillimit te Biznesit & SME-ve, Sektori i Politikave për Nxitjen e Punësimit dhe Teknologjive). Kjo drejtori është përgjegjëse për:

- Studimin e gjendjes dhe përpunimin e politikave të zhvillimit të biznesit për sektorin privat, për nxitjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), investimeve të huaja direkt (IHD) dhe të eksporteve;
- Hartimin e masave me karakter ligjor, institucional dhe administrativ në interes të zhvillimit të biznesit;
- Hartimin e programeve dhe projekteve të financimit, në bashkëpunim me institucionet publike shtetërore e private dhe donatorët, në interes të zhvillimit të sektorit privat, veçanërisht të SME-ve, investimeve dhe eksporteve;
- Organizimin e dialogut të vazhdueshëm me grupet e interesit të komunitetit të biznesit;
- Hartimin e legjislacionit tregtar në përputhje me acquis.
- Ministria e Financave - për çështje që lidhen me përcaktimin e pragut për tatimin e tregtarëve dhe shoqërive, por edhe me miratimin e standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit, të hartuara / përkthyera nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK) dhe Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA).
- Sektori Sektori i Udhëheqjes Metodologjike pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) -. Ky sektor përbëhet nga nje përgjegjës sektori dhe nga dy specialist. Detyrat konkrete të këtij sektori janë:
    - Sqaron nga ana ligjore qytetarët dhe punonjësit e QKR-së për paqartësitë që kanë lidhje me legjislacionin që lidhet me veprimtarinë e QKR-së.
    - Ndjek dhe mbikqyr procedurën për marrjen dhe dhënien e mendimeve për aktet ligjore dhe nënligjore.
    - Ndihmon në dhënien e konsulencës për procedurat gjyqësore, në të cilat QKR është palë.
    - Përfaqësojnë QKR në procese gjyqësore.
    - Kryen hetime administrative në emër të titullarit të QKR-së, mbi bazën e ankimeve administrative për procesin e regjistrimit.
    - Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë në qarqe bashkëpunojnë me administratën shtetërore duke kontribuar me mendime ose propozime për çështje që lidhen me mbarëvajtjen e tregtisë e të industrisë.
    - Këshilli Konsultativ i Biznesit – është strukturë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për përmirësimin e klimës së Biznesit dhe të kuadrit ligjor për shoqëritë tregtare dhe biznesin në përgjithësi.
    - Organet e Prokurorisë – Prokuroria ushtron ndjekjen penale për krimet e kundravajtjet penale të kryera në shoqëritë tregtare.

Masat legjislative afatshkurtra

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Projektligji “Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”. Ky ligj do të përafrojë plotësisht Direktivën 2005/56/EC për bashkimin ndërkufitar të shoqërive me

përgjegjësi të kufizuar, si dhe pjesërisht Direktivën 2001/86/EC që amendon Statutin për Shoqëritë europiane duke pasur parasysh përfshirjen e punëtorëve dhe Direktivën 2009/109/EC për kërkesat e raportimit dhe dokumentimit në rastin e ndarjeve dhe bashkimeve.

- Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, i cili përafron plotësisht Direktivën 2009/109/EC për kërkesat e raportimit dhe dokumentimit në rastin e ndarjeve dhe bashkimeve.
- Projektligji "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar, në lidhje me pamjaftueshmërinë kohore të afateve ligjore (15 ditë dhe 30 ditë) për t'u respektuar nga subjektet e huaja për regjistrimin fillestar, regjistrime të tjera dhe për plotësimin ose ndreqjen e elementeve që pengojnë regjistrimin. Kërkohet një zgjatje e këtyre afateve. Gjithashtu, me këtë ligj synohet të hiqen edhe funksionet e liçensimit nga tërësia e funksioneve të QKR, etj.
- Projekturdhër i përbashkët i Ministrit të Ekonomisë dhe Financave "Për përcaktimin e pragut të vëllimit të veprimtarisë, në bazë të të cilave lind detyrimi i regjistrimit si tregtar", në përputhje me pikën 4, të nenit 2, të ligjit 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Aktivitete zbatuese afatshkurter

- Përkthimi i Direktivës 2005/56/EC për bashkimin ndërkufitar të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe rishikimi ligjor i saj.
- Organizimi i takimeve për konsultimin me aktorët kryesorë dhe grupet e interesit, të draftit të parë të projektligjit "Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare".
- Hedhja e projektligjit "Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare" në portalin e Regjistrit të Ligjeve të Biznesit për konsultim të gjerë me publikun.
- Organizimi i takimeve për konsultimin me aktorët kryesorë dhe grupet e interesit, për problematikat e zbatimit të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, si dhe për hartimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, i cili përafron plotësisht Direktivën 2009/109/EC dhe pr/ligjin "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
- Organizimi i takimeve për konsultime me grupet e interesit për draftin e parë të projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.
- Përditësimi i Analizës së Mangësive Ligjore (Legislative Gap Analyses) për Kapitullin 6 – E Drejta e Shoqërive Tregtare .
- Përditësimi i komentarit të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar; përkthimi dhe rishikimi gjuhësor e ligjor i Komentarit.
- Kurrikula trajnuese për zbatimin e drejtë të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar; Analiza e nevojave për trajnim.

- Trajnimi i zyrtarëve, juristëve, avokatëve, gjyqtarëve dhe përfaqësuesve të biznesit për zbatimin e drejtë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

Masat legjislative afatmesme

Masat legjislative afatmesme janë si vijon:

- Projektligj për përafrimin e plotë të Direktivës 2009/101/EC për koordinimin e masave, të cilat për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe palëve të treta, kërkohen nga shoqëritë e Shteteve Anëtare, brenda kuptimit të paragrafit të dytë të Nenit 48 të Traktatit, me synimin për t'i bërë këto masa ekuivalente.

Aktivitete zbatuese afatmesme

Për adresimin e masave afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- Trajnim për prezantimin me Direktivën 2009/101/EC për koordinimin e masave, të cilat për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe palëve të treta, kërkohen nga shoqëritë e Shteteve Anëtare, brenda kuptimit të paragrafit të dytë të Nenit 48 të Traktatit, me synimin për t'i bërë këto masa ekuivalente.
- Fuqizimi i kapaciteteve administrative në METE për zbatimin dhe monitorimin e reformës në fushën e legjislacionit tregtar;
- Trajnime në fushën e legjislacionit tregtar.

Efektet Financiare

Urdhër i përbashkët i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrit të Financave "Për përcaktimin e pragut të vëllimit të veprimtarisë, në bazë të të cilave lind detyrimi i regjistrimit si tregtar".
Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.6.1 "E drejta e shoqerive tregtare"

(në /000 lekë)

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**14.175.000**	**2.975.000**	**0**	**0**
Mbuluar nga ndihma e huaj	**14.175.000**	**2.975.000**	**0**	**0**
Ndryshim	**0**	**0**	**0**	**0**

3.6.2. KONTABILITETI DHE AUDITIMI

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK) është përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar. Raportimi financiar është kushti garant i besueshmërisë së investitorëve dhe palëve të tjera të interesuara gjatë vendimmarrjes në raport me njësinë ekonomike.

Hartimi dhe zbatimi i një kuadri ligjor tregtar, në përputhje me standardet e BE-së, në drejtim të raportimit financiar, nevojitet:

- përditësimi në kohë reale istandardeve ndërkombëtare të kontabilitetit,
- hartimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit,
- monitorimin e zbatimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit nga njësitë ekonomike.

Realizimi i detyrave të mësipërme kërkon rritjen e kapaciteteve të KKK-së për:

- Hartim e manualeve dhe udhëzuesve në zbatim të standardeve kombëtare të kontabilitetit.
- Mbikqyrjen e zbatimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Fillimin e fushatave lidhur me ndërgjegjësimin e publikut për detyrimin e zbatimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit.
- Drejtimin dhe evidentimin eproblemeve që dalin nga praktika e biznesit të të gjithë sektorëve.

Objektivi strategjik është përmirësimi i raportimit financiar përmes rritjes së cilësisë së auditimeve dhe përgatitjen e auditorëve ligjor, i cili është bërë me kombinimin më të mirë të regjimit vetë rregullator dhe të mbikëqyrjes së pavarur publike për kontabilistët dhe auditorët.

Statusi Aktual

Shqipëria është një pjesëmarrës aktiv i Programit "Rruga drejt Europës: Program për Reformën në kontabilitet dhe Fuqizimin Institucional (REPARIS) program". Pjesë e këtij programi është edhe projekti "Zgjerimi i Raportimit Financiar të Shoqërive" (CFREP), projekt i cili financohet nga qeveria zviceriane, administrohet nga Banka Botërore dhe ekzekutohet nga Ministria e Financave të Shqipërisë. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit është pjesë e komponentit dytë të këtij projekti.

Gjithashtu KKK është angazhuar në fushata për ndërgjegjësimin e publikut lidhur me detyrimin për zbatimin e standardeve të kontabilitetit në hartimin e pasqyrave financiare.
Gjatë vitit 2010 - 2011 janë organizuar takime me përfaqësues të profesionit dhe të biznesit, me qëllim evidentimin dhe zgjidhjen e problemeve të dala nga praktika e zbatimit të standardeve përmes udhëzimeve kontabël, përgjigjeve shkresore apo përgjigjeve online në faqen e saj të internetit.

Komiteti i Rishikimit të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit / Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ka përkthyer dhe rishikuar materialet e dërguara nga Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Bilanceve (IASB), te cilat të përkthyera në gjuhën shqipe, publikohen në faqen zyrtare të KKK-së si në vijim www.kkk.al
Gjithashtu gjatë vitit 2011 janë ndërmarrë inisiativën për të rishikuar ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" me qëllim ndryshimin në pjesë të caktuara të tij.

Instituti i Eksperteve Kontabël të Autorizuar (IEKA) është përgjegjës jo vetëm për grupimin e anëtarëve të profesionit por për kualifikimin, çertifikimin, liçensimin, etj, Parlamenti shqiptar miratoi një ligj të veçantë për auditimin dhe audituesit. Ligji Nr. 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i cili është në përputhje me direktivën e auditimit (e njohur si Direktiva e 8-te e BE e vitit 2006) që mbulon audituesit dhe auditimin në vendet anëtare të BE-së.
Ky ligj përcakton dispozitat për audituesit ligjore të pasqyrave financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara, organizimin e profesionit të auditimit ligjor, firmat audituese, të profesionit te ekspertit kontabël te regjistruar, si dhe rregullimin e organeve të eksperteve kontabël te regjistruar. Qëllimi kryesor i këtij ligji është për të rritur dhe forcuar mbikëqyrjen publike të profesionit të auditimit ligjor, dhe për rregullimin e profesionit te ekspertit kontabël.

Në vitin 2011 Bordi miratoi Kodin e Etikës për profesionistët e auditimit, dhe gjithashtu ka aprovuar rregullore dhe udhëzime të tjera që janë të detyrueshme në zbatim të kërkesave të ligjit të auditimit, të tilla si rregullorja për hetimin dhe disiplinën, si dhe rregullorja për cilësinë e kontrollit te auditorëve te ligjshëm.
Bordi ka miratuar gjithashtu rregulloren e vet për cilësinë e kontrollit për auditimin e subjekteve me interes për publikun (subjekte të listuara, bankat e nivelit të dytë, kompanitë e sigurimeve dhe kompanitë e ri sigurimit, etj), dhe në vitin 2011 ajo filloi aktivitetin e saj për cilësinë e kontrollit për disa subjekte me interes publik. Rezultatet publikohen në fillim të vitit 2012. Në këtë mënyrë, përgjegjësia përfundimtare, në cilësinë e kontrollit dhe hetimit do t'i mbeten bordit dhe kjo mund të arrihet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet mbikëqyrjes se aktiviteteve te organeve profesionale.
Stafi i IEKA lehtëson komunikimin e Bordit me anëtarët dhe palët e tjera të interesuara. Stafi administrativ i dhënë nga IEKA nuk ka rol apo ndikim në vendimet e Bordit, të cilat janë plotësisht të pavarura.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar me Ligjin nr 9477, datë 09.02.2006, i ndryshuar me Ligjin nr 10110, datë 02.04.2009. Ky ligj përafron pjesërisht Direktivën e katërt të Këshillit 78/660/EEC me Celex 31978L0660 për llogaritë vjetore të disa tipe shoqërish, si dhe pjesërisht Direktivën e shtatë të tij 83/349/EEC me Celex 31983L0349 për llogaritë e konsoliduara.
- Ligji nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar" ka përafruar plotësisht Direktiva 2006/43/EC i Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 17 maj 2006 me Celex 32006L0043 për audituesit ligjore te llogarive vjetore dhe te konsoliduara, qe amendon Direktivën e Këshillit 7/660/EEC dhe 83/349/EEC dhe shfuqizimin e Direktivës se Këshillit 84/253/EEC.

Aktet e mëposhtme nuk kanë transpozuar legjislacion europian:

- Ligji nr. 10297, date 8.7.2010 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar"
- Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
- Ligj nr. 9477, datë 9.2.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
- Ligj nr. 10110, datë 2.4.2009 “Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar”.
- Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.
- Ligji nr. 10318, date 16.9.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- VKM nr.672, datë 26.10.2005 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të KKK-së”.
- VKM nr.742, datë 07.11.2007 “Mbi kriteret e përzgjedhjes së njësive ekonomike që duhet të aplikojnë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit”.
- VKM nr. 388, datë 12.06.2003 “Për ngritjen e Komisionit Shtetëror për kualifikimin e auditëve të brendshëm në sektorin publik” dhe VKM nr. 389, datë 12.06.2003 “Për përcaktimin e vjetërsisë në punë, për marrjen e titullit të përkohshëm “Audit i brendshëm në sektorin publik”.
- VKM nr. 833, datë 11.12.2003 “Për funksionimin e Komitetit të Auditimit të brendshëm”.
- VKM nr. 345, datë 01.06.2004 “Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm, të kodit etik për auditët e brendshëm dhe të kartës së auditimit të brendshëm politik.
- VKM nr. 874, datë 12.08.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Bordit të Mbikqyrjes Publike të Ekspertëve Kontabël të Regjistruar”.
- Urdhër nr.42, datë 15.06.2006 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”.
- Urdhër nr.65, datë 05.05.2008 “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar, të përkthyera në gjuhën shqipe”.
- Urdhër nr.79, datë 19.10.2009 “Për shpalljen e ndryshimeve të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar, të përkthyera në gjuhën shqipe”.
- Urdhër nr.94, datë 10.11.2009 “Për shpalljen standardit kombëtar të kontabilitetit nr.15”.
- Urdhër nr.24, datë 28.02.2011 “Për shpalljen e ndryshimeve të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar, të përkthyera në gjuhën shqipe”.
- Urdhër nr.3, datë 10.01.2012 “Për shpalljen e ndryshimeve të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar, të përkthyera në gjuhën shqipe, të ndodhura gjatë viteve 2010-2011””.

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në zbatimin dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit tregtar vendas me *acquis* të BE-së në këtë fushë janë Këshilli Konsultativ i Biznesit (KKB), Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK), si dhe Bordi i Mbikqyrjes Publike (BMP).

IEKA: Instituti i Ekspertëve Kontabë të Autorizuar ka këtë strukturë institucionale:

- Mbledhja e përgjithshme e anëtarëve
- Këshilli drejtues – 1 kryetar, 1 zv/kryetar dhe 5 anëtarë
- Komiteti i kontrollit te brendshem – 2 anëtarë.
- Drejtori ekzekutiv

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) ka për mision të sigurojë mirëushtrimin e profesionit, mbrojtjen e nderit dhe të pavarësisisë të ekspertëve kontabël të regjistruar, anëtarë të tij, si edhe të garantojë mbikëqyrjen e formimit të tyre profesional.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit është një organizëm profesional publik i pavarur dhe gëzon personalitet juridik. Struktura institucionale e tij përbëhet nga 9 anëtarët e Këshillit dhe struktura administrative me personel të punësuar e përbërë prej 5 personash. Stafi përbëhet nga 3 inspektorë të standardeve të kontabilitetit dhe 2 personel mbështetës. Anëtarët e Këshillit janë, sipas detyrimit të përcaktuar në Ligjin nr 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", nga këto fusha:

- dy anëtarë të propozuar nga organizatat e profesioneve të lira kontabël, të krijuara sipas legjislacionit në fuqi;
- dy anëtarë të propozuar nga Fakultetet e Ekonomisë;
- dy anëtarë të propozuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë;
- tre anëtarë të propozuar nga Ministri i Financave.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka për detyrë:

- të hartojë standardet kontabël kombëtare, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe në koherencë me Standardet Kontabël Ndërkombëtare.
- të përpunojë një sistem kontabël, ku përveç standardeve kontabël kombëtare, të përcaktojë rregullat për mbajtjen e kontabilitetit, listat e llogarive dhe përdorimin e tyre, si dhe formatet për pasqyrat financiare;
- të evidentojë nevojat dhe të propozojë zgjidhjet për përmirësimin e metodave kontabël për mbajtjen e kontabilitetit dhe për kualifikimet;
- të interpretojë dhe të përgjithësojë problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël, të cilat i paraqet në formën e udhëzimeve kontabël;
- të shqyrtojë dhe të japë mendime për të gjitha projektligjet dhe projektaktet nënligjore, rregulluese, të cilat përmbajnë dispozita për kontabilitetin, për përgatitjen e llogarive, që lidhen me njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, si dhe me profesionet me bazë kontabilitetin;

Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) është një organ kolegjial, i pavarur, i përbërë nga shtatë anëtarë, të emëruar nga Ministri i Financave, me nje mandat 4 vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje, por jo më shumë se dy mandate radhazi. BMP kryen mbikëqyrjen publike të profesionit të auditimit dhe firmave audituese në mënyrë direkte, si dhe nëpërmjet mbikëqyrjes së veprimtarisë së organit profesional të auditorëve ligjorë. Qëllimi i mbikëqyrjes publike të auditorëve ligjorë dhe firmave audituese është që të rrisë sigurinë që auditimet ligjore të kryhen në mënyrë transparente, të kontrolluar dhe me kujdesin e duhur për t'i shërbyer interesit publik.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projektligj "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar, ndryshime të cilat synojnë përmirësimin e zbatimit të tij.
- Projekturdhër i Ministrit të Financave për të gjitha ndryshimet e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar të ndodhura gjatë vitit 2011, të ardhura nga Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Bilanceve (IASB) dhe të përkthyera në gjuhën shqipe nga KKK.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Përfundimi i procesit të rishikimit dhe përkthimit të ndryshimeve të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar të ndodhura gjatë vitit 2011.
- Shtimi i stafit me 1 punonjës.
- Ndjekja e zbatimi i projekti "Zgjerimi i Raportimit Financiar të Shoqërive" (CFREP).

Masat legjislative afatmesme

Nuk ka masa legjislative të parashikuara.

Masat Zbatuese afatmesme

- Përcaktimi nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, nëse në të ardhmen do të zbatohen standardet kombëtare të kontabilitetit apo Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme në hartimin e pasqyrave financiare të njësive ekonomike.
- Me përfundimin e rishikimit të Direktivës 4 dhe 7 të Shoqërive Tregtare nga Komisioni Europian, KKK do të rishikoje ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" në këndvështrimin e përputhjes së tij me këto direktiva.
- Në kuadër të projektit CFREP do të hartohen pyetësorë me një tematikë që synon evidentimin e problematikave që dalin nga zbatimi i Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit me qëllim përmirësimin e kuadrit të raportimit financiar në Shqipëri,
- Paralelisht me pyetësorin KKK-ja do të angazhohet në një punë shumë teknike, në atë të krahasimit të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit me Standartet

Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme dhe në fund KKK do të arrijë në përfundimet përkatëse.

- Analizë e mirëfilltë krahasuese në drejtim të avantazheve që do të sillte transpozimi i Direktivës së 4 dhe 7 të Shoqërive Tregtare për të marrë një vendim lidhur me këtë.

Efektet Financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.6.2 "Kontabiliteti dhe Auditimi"

(në /000 lekë)

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**14.175.000**	**2.975.000**	**0**	**0**
Mbuluar nga ndihma e huaj	**14.175.000**	**2.975.000**	**0**	**0**
Ndryshim	**0**	**0**	**0**	**0**

3.7. TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE

3.7.1. TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA TË LIDHURA

Objektivi politik

Qëllimi kryesor i politikave të mbrojtjes së pronësisë intelektuale sa i takon të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me të në Republikën e Shqipërisë është garantimi i mbrojtjes dhe respektimit të këtyre të drejtave si dhe zbatimi i tyre me efektivitet.

Detyrimet për këtë fushë rrjedhin nga Neni 73 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit i cili kërkon garantimin e respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në të njëjtin nivel që ato garantohen në vendet e BE-së.

Ky objektiv do të zbatohet nëpërmjet:

- Përmirësimit të legjislacionit dhe harmonizimit të tij të plotë me legjislacionin evropian dhe implementimin në të të praktikave më të mira evropiane.
- Rritjes, forcimit dhe përmirësimit të nivelit të njohurive të të gjitha institucioneve shtetërore zbatuese të ligjit, si dhe të gjyqësorit.
- Rritjes dhe sensibilizimit të institucioneve shtetërore për rëndësinë e kësaj fushe si dhe ndërgjegjësimit të komunitetit të gjerë dhe kategorive të ndryshme të përdoruesve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera që lidhen me të.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Zyra Shqiptare për te Drejtat e Autorit ka si objekt të veprimtarisë së saj mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera, të lidhura me të, nga subjektet, persona fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike, shkencore. Ky mision duhet te realizohet nëpërmjet ZSHDA-së dhe Zyrave Rajonale për të Drejtën e Autorit (ZRDA) ne bashkëpunim me institucionet e tjera zbatuese.

Një ndër detyrat funksionale më të rëndësishme që ZSHDA kryen, është ajo e inspektimit të tregut të produktit intelektual (produkt artistik, letrar e shkencor). Ky funksion kryhet nëpërmjet 3 inspektorëve të saj ne zyrën qendrore dhe 2 inspektoreve të qarqeve Elbasan dhe Durrës.

Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit në përputhje me detyrimet dhe obligimet e Planit Kombëtar të Zbatimit të MSA-së, ka hartuar një projekt-ligj të ri (pritet të miratohet dhe të hyjë në fuqi në shtator 2012). Ky ligj i ri do të transpozojë plotësisht Direktivat e Bashkimit Evropian për këtë fushe si dhe praktikat me te mira te vendeve Evropiane.

Amendimi i Kodit Penal dhe i Kodit të Procedurës Penale sa i takon shkeljeve në fushën e pronësisë intelektuale/te drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura, është i domosdoshëm me qëllim forcimin e mekanizmave shtrëngues në këtë fushë. Propozimet e Zyrës Shqiptare te te

Drejtave te Autorit janë dërguar në të gjitha institucionet përgjegjëse për prezantimin e nismave ligjore. Amendimi i Kodit Penal dhe i Kodit të Procedurës Penale, rrjedh nga Marrëveshja TRIPS, dhe është parashikuar si domosdoshmëri si në Strategjinë Kombëtare të Zbatimit të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale ashtu edhe si rekomandim në Raportin analitik të 2011 të KE për Shqipërinë.

Siç është sugjeruar dhe në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale, me miratimin e ligjit të ri mbi të Drejtën e Autorit dhe të Drejtave të tjera të lidhura me të, struktura dhe kompetencat e ZSHDA- do të rishikohen në kushtet e krijimit të një inspektorati të vetëm të mbikëqyrjes së tregut, i cili do të ngrihet së shpejti.

Sa i takon ankimeve administrative të depozituara në ZSHDA gjatë kësaj periudhe, ZSHDA në përmbushje të detyrave të saj funksionale ka vazhduar me shqyrtimin e këtyre ankesave, duke përgatitur për çdo rast aktet administrative përfundimtare.

Agjenci te Administrimit Kolektiv qe funksionojnë ne Shqipëri janë:

ALBAUTOR: Agjenci e Administrimit Kolektiv për Autoret e Muzikës dhe Regjistrimin mekanik te saj
FMAA: Agjenci e Administrimit Kolektiv për Autoret e Audiovizualit dhe Filmit (Regji dhe Skenar)
AKDIE: Agjenci e Administrimit Kolektiv për artistet interpretues dhe ekzekutues.
AMP: Agjenci e Administrimit Kolektiv për prodhues/producentë te fono/videogramit ne te gjitha format e njohura nga teknologjia

Në përgjigje të një situate problematike të zbatimit të ligjit "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera që lidhen me të" është hartuar dhe miratuar me VKM nr. 760, datë 1.9.2010 "Strategjia Kombëtare e Zbatimit të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale". Qëllimi i SKPI është të sigurojë një nivel të njëjtë mbrojtjeje të të drejtave të Pronësisë Intelektuale me atë të vendeve të Bashkimit Evropian.

Ky dokument strategjik adreson si elementët kryesorë të domosdoshëm për të përmirësuar situatën si më poshtë:

- Përmirësimit të legjislacionit dhe harmonizimit të tij të plotë me legjislacionin Evropian dhe implementimin në të, të praktikave më të mira Evropiane.
- Rritjes, forcimit dhe përmirësimit të nivelit të njohurive të të gjitha institucioneve shtetërore zbatuese të ligjit, si dhe të gjyqësorit.
- Rritje e sensibilizimit të institucioneve shtetërore për rëndësinë e kësaj fushe si dhe ndërgjegjësimit të komunitetit të gjerë dhe kategorive të ndryshme të përdoruesve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera që lidhen me të.

Në funksion të sa më sipër ZSHDA në kuadër të projektit "Për forcimin e kapaciteteve zbatuese të ZSHDA" të mbështetur me fondet e BE në kuadër të IPA 2008, ka zhvilluar një sërë aktivitetesh të rëndësishme të fokusuara kryesisht në tre shtyllat e sipërme:

- Është hartuar projekt-ligji i ri ‘Për të Drejtën e Autorit dhe të drejtat e lidhura”, I cili është i përputhur plotësisht me legjislacionin e BE si dhe implementon në të praktikat më të mira evropiane.
- Është bërë analizë e hollësishme dhe në përputhje dhe me SKZPI janë sugjeruar pjesë të legjislacionit që duhen amenduar si Kodi Penal dhe Kodi I Procedurës Penale.
- Janë trajnuar stafet e ZSHDA-s si dhe të strukturave të tjera shtetërore zbatuese siç janë Doganat, Tatime, KKRT, Policia etj
- Janë trajnuar gjyqtarë e prokurorë
- Janë zhvilluar seminare ndërgjegjësuese me përdorues të pronësisë intelektuale/e drejta e autorit e të drejtat e lidhura nëpër të 12 qarqet e vendit.

Pavarësisht aktiviteteve të shumta dhe përpjekjeve maksimale të bëra nga ZSHDA sa i takon përmirësimit të nivelit të zbatimit dhe respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me të mbetet problematikë zbatueshmëria e ligjit nga operatorët ekonomikë, qoftë ata primarë si radio, televizione, operatorë kabllorë etj ashtu edhe nga ata më dytësorë si hotele, restorante, bare, klube nate, operatorë të telefonisë celulare etj.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Ligji Nr. 9380, date 28.04.2005 Mbi të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të (publikuar në fletoren Zyrtare nr. 42, datë 13.06.2006 fq-1493-1528) është pjesërisht i përputhur me Acquis e Bashkimit Evropian.

- Direktiva 2001/29/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 22 Majit 2001 mbi “Harmonizimin e disa aspekteve te te drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të ne Shoqërinë e Informacionit, FZ 2001 L 167/10. (Pjesërisht i përputhur)
- Direktiva 2001/84 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 Shtatorit 2001 mbi të drejtën e rishitjes për përfitimin e autorit të një vepre origjinale arti, FZ 2001 L 272/32 (Pjesërisht i përputhur)
- Direktiva 2006/115 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 mbi të drejtën e rishitjes dhe të drejtën e hua-qerasë mbi disa aspekte të caktuara të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në fushën e pronësisë intelektuale (versioni i kodifikuar i 92/100/EEC) FZ 2006 L 376/28. (Pjesërisht i përputhur)
- Direktiva 2006/116/ EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 mbi kohëzgjatjen e mbrojtjes të së drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të (versioni i kodifikuar i 93/98/EEC) FZ 2006 L372/12. (Pjesërisht i përputhur)
- Direktiva 96/9/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 Marsit 1996 mbi mbrojtjen ligjore të bazës së të dhënave, FZ 1996 L 77/20. (Pjesërisht i përputhur)
- Direktiva 2009/24/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 23 Prillit 2009 mbi mbrojtjen ligjore te programeve kompjuterike, FZ 2009/L 111/16. (Pjesërisht i përputhur)
- Direktiva 93/83/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 Shtatorit 1993 “Mbi koordinimin e rregullave te caktuara lidhur me te drejtën e autorit dhe te drejtat e lidhura e zbatueshme për transmetimet satelitore dhe kabllore”. (Celex nr. 31993L0083/ OJ 1993L248/15.) (Pjesërisht i përputhur)

Pjesë e kuadrit ligjor të për funksionim e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit janë dhe:

- Vendimi i Këshillit te Ministrave Nr. 232, datë 19.4.2006 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit",
- VKM 343 date 06.06.2007 "Për Miratimin e Tarifave qe Ofron Zyra Shqiptare për te Drejtën e Autorit".

Struktura institucionale

Institucioni shtetëror përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në Shqipëri është Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit. ZSHDA është institucion qendror në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Struktura e ZSHDA-së është 13 punonjës nga të cilët 3 janë inspektorë. Gjithashtu në dhjetor të vitit 2009 me Urdhër të Kryeministrit të Shqipërisë Nr. 136,date 23.10.2008 është miratuar ngritja e Zyrave Rajonale të të Drejtës së Autorit në qarqet Elbasan dhe Durrës, me nga 1 inspektor për secilin qark.

Në kuadër të reformës rregullatore të inspektimit të tregut në Republikën e Shqipërisë dhe të ri-organizimit të inspektorateve do të rishikohet dhe inspektorati i ZSHDA-së dhe rrjedhimisht dhe ky funksion zbatues i Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit. .

Me miratimin e LDA i ri, në kushtet dhe nivelet e reja të zhvillimeve që kjo fushë pëson në mënyrë të vrullshme, struktura e propozuar e ZSHDA duhet reflektojë kërkesat në kuadër të MSA (neni 73 dhe Aneksi V) dhe të Dokumentit të Partneritetit Evropian dhe të reflektojë të njëjtën fizionomi me zyrat e ngjashme në BE.

Në kuadër të projektit "Për forcimin e kapaciteteve zbatuese të ZSHDA" të mbështetur me fondet e BE në kuadër të IPA 2008, një grup ekspertësh bënë një vlerësim krahasues të ZSHDA-s me strukturat homologe të saj në vende të ndryshme të BE dhe hartuan një Plan Zhvillimi Afatgjatë të ZSHDA-s. Kjo strukturë duhet të rritet.

Institucione të tjera që lidhen me zbatimin e të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të tjera të lidhura me të janë:

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve – ka detyrimin ligjor në bazë të nenit 133 të ligjit nr. 9380/2005 "Për te Drejtën e Autorit dhe te Drejtat e tjera te lidhura me te" , të ndryshuar, ekzekutimin (vjeljen) e gjobave të vendosura nga Inspektorët e ZSHDA, të cilat kanë kaluar në titull ekzekutiv.
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave– Ka detyrimin ligjor në bazë të VKM nr. 584/2007, përpara çlirimit të mallrave dhe hyrjes në qarkullim në tregun e brendshëm, të kërkojë nga importuesi i kopjeve të veprave të mbrojtura me të drejta autori dhe të drejta të lidhura, të vërtetojë se gëzon titullin e ligjshëm nga mbajtësit e të drejtave, të regjistruar në institucionin kompetent për të lejuar hyrjen në territor të mallrave/produktit intelektual të mbrojtur me ©.
Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit– në bazë të nenit 3 të ligjit 8410/1998, të ndryshuar, parashikon se veprimtaria radiotelevizive në territorin e RSH bazohet në dispozitat

e këtij ligji dhe në dispozitat për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të. Neni 99, i Ligjit nr. 9380/2005, "Për te Drejtën e Autorit dhe te Drejtat e tjera te lidhura me te" të ndryshuar, parashikon se të drejtat e organizatave radiotransmetuese si prodhues të programeve/transmetimeve të veta, nuk mund të kalohen në mënyrë ekskluzive /joekskluzive pa respektuar të drejtat e autorëve krijues, interpretues/ekzekutues.

Autoritetet lokale (Prefekturat e qarqeve) –Neni 119 i LDA nr. 9380/2005, të ndryshuar, parashikon kompetencën e prefektit të ndalojë shfaqjen publike nëse me kërkesë të titullarit të të Drejtës në territor, dhe vërtetim të ZSHDA-së, se organizatori i shfaqjes publike nuk është pajisur me Autorizim/kontratë nga Titullari i të drejtave ose Agjencia e Administrimit Kolektiv.

Prokuroritë dhe gjykatat – Neni 59 i KPr.P, legjitimon kërkesën-të drejtën e ngritjes së akuzës, së palës së dëmtuar nga vepra penale e parashikuar në nenin 148 dhe 149 i K.P, kundër çdo subjekti përdorues. Prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve si pale per te vertetuar akuzen se bashku me te demtuarin akuzues, duke u shprehur ne fund per fajesine apo pafajesine e te pandehurit si dhe nuk merr pjese ne debatin gjyqesor duke bere qe gjykata te jete orhani procedues i vetem i cili zgjidh te pengesat per mbarevajtjen e procesit gjyqesor , duke hetuar dhe gjykuar njekohesisht per veprat penale te parashikuara nga neni 148 dhe 149 i Kodit Penal.

Shkolla e Magjistraturës – Ne formimin dhe ngritjen profesionale te gjyqtareve dhe prokuroreve për çështjet qe lidhen me respektimin, mbrojtjen dhe zbatimin e te drejtave te autorit dhe te drejtave te tjera te lidhura me te.

Agjencitë e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit- AAK janë Organizata Jofitimprurëse te licencuara nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinise dhe Sporteve për te ushtruar administrim kolektiv te te drejtave te autorit dhe te drejtave te lidhura me te, sipas degëve te artit, te cilat kane një rol aktiv ne mbrojtjen, respektimin e te drejtave te anëtareve te degëve përkatëse ne garantimin e përfitimit te shpërblimit përkatës për çdo rast dhe mënyre shfrytëzimi te produktit intelektual pa autorizimin e mbajtësve te ligjshëm te te drejtave.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përcaktimi më i qartë i kompetencave të institucioneve të përfshira në zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me të, përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar:

- Miratimi i Ligjit të ri për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e tjera që lidhen me të dhe hartimi dhe miratimi i akteve nen-ligjore në zbatim të tij. Ky ligj do te transpozoje ne mënyrë te plote Direktivat e BE-se.
- Miratimi i Amendimeve të Kodit Penal dhe Kodin e Procedurave Penale të RSH.
- Miratimi i akteve ligjore dhe nën-ligjore që do të merren me strukturat inspektuese të tregut për sa i takon të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të.

Masa afatshkurtra zbatuese

- Miratimi i strukturës së re të ZSHDA-se pas miratimit të Ligjit të ri për te Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me të.

- Trajnimet të stafit të ZSHDA me qëllim përshtatjen e tyre me funksionet e reja të saj pas miratimit të projekt-ligjit të ri.
- Trajnimi i kapaciteteve institucionale zbatuese të ligjit
- Trajnime të gjyqtarëve dhe prokurorëve
- Ndërgjegjësim i komunitetit të përdoruesve për detyrimet e tyre në bazë të ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatmesme synohet forcimi i funksionimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar:

- Amendimi i ligjit për te Drejtat e Autorit dhe te Drejtat e tjera qe lidhen me te për te harmonizuar me ndryshimet qe mund te përfshihen ne legjislacionin ndërkombëtar

Masa zbatuese afatmesme

- Forcimi dhe rritja i kapaciteteve institucionale te ZSHDA-se.
- Trajnimin e Kapaciteteve institucionale te strukturave qe merren me zbatimin e ligjit për te drejtën e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhur me te
- Rritjen e njohurive ne funksion te një gjyqësori te specializuar për çështje te te drejtave te autorit dhe te drejtave te tjera te lidhura me te.
- Rritje e ndërgjegjësimit te komunitetit te përdoruesve
- Rritje e sensibilitetit te komunitetit te gjere mbi rëndësinë e respektimit dhe mbrojtjes se te drejtave te autorit dhe te drejtave te tjera qe lidhen me te.

Implikimet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**139.000**	**42.000**	**40.000**	**38.000**
Mbulohen nga buxheti i	134.000	42.000	40.000	38.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	5.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.7.2. PRONËSIA INDUSTRIALE

Objektivi strategjik

Objektivat kryesore strategjike në fushën e Pronësisë Industriale, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2010-2015 me qëllim zbatimin e angazhimeve të ndërmarra në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, si dhe në zbatim të prioriteteve të Partneritetit Evropian, janë:

- Sigurimi i një niveli të njëjtë mbrojtjeje të të drejtave të Pronësisë Industriale, me atë të vendeve të Bashkimit Evropian brenda një periudhe katër vjeçare nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA – neni 73).
- Harmonizimi i plotë i legjislacionit në fushën e Pronësisë Industriale me acquis communautaire.
- Forcimi i institucioneve të përfshira në zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale si dogana, policia, strukturat inspektuese të tregut dhe gjykata me qëllim forcimin e mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave në fushën e PI.
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale.

Këto objektiva do të realizohen nëpërmjet:

- harmonizimit të plotë të legjislacionit kombëtar aktual në fushën e Pronësisë Industriale, me legjislacionin e BE në këtë fushë dhe me marrëveshjen e TRIPS-it,
- anëtarësimit në traktate, konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare në fushën e Pronësisë Industriale si Marrëveshja e Londrës për Patentat Evropiane,
- forcimit të kapaciteteve administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave nëpërmjet rritjes së numrit të stafit të DPPM, trajnimit të tyre për zbatimin e legjislacionit të harmonizuar me acquis dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale dhe përmirësimit të infrastrukturës së TI, me qëllim përmirësimin e shërbimeve on-line,
- forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave të përfshira në sistemin e mbrojtjes së Pronësisë Industriale si dhe forcimin e kapaciteteve administrative të institucioneve zbatuese si doganat, policia, gjykata, strukturat e inspektimit të tregut etj,
- krijimit të qendrave të informacionit teknik dhe shkencor dhe zhvillimit të aktiviteteve promovuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë dhe rretheve të interesuara në këtë fushë, si dhe trajnimin e tyre lidhur me rëndësinë e të drejtave të Pronësisë Industriale.

Situata aktuale

Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale dhe sigurimi i një niveli mbrojtje të tyre në Shqipëri, të njëjtë me atë të vendeve të BE, ka qenë një nga angazhimet e marra përsipër nga qeveria shqiptare në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, neni 73 i saj. Në zbatim të këtij angazhimi, janë ndërmarrë masa legjislative dhe aktivitete zbatuese, si në drejtim të përafrimit të legjislacionit kombëtar në fushën e pronësisë industriale me acquis, ashtu edhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative të institucioneve përgjegjëse në këtë fushë.

Masat legjislative të ndërmarra deri tani në fushën e përmirësimit të legjislacionit shqiptar dhe përafrimit të tij me legjislacionin e BE në fushën e pronësisë industriale janë:

- Miratimi dhe hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 9947 datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale" i cili është gjerësisht i përafruar me *acquis* si dhe adoptimi i akteve nënligjore në zbatim të tij.
- Anëtarësimi i Shqipërisë në 5 marrëveshje ndërkombëtare të fushës konkretisht:
    - Marrëveshja e Strasburgut për klasifikimin ndërkombëtar të patentave;
    - Marrëveshja e Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove industriale;
    - Akti i Gjenevës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove industriale;
    - Konventa Evropiane e Patentave;
    - Marrëveshja për të drejtën e patentave të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale.
- Miratimi dhe hyrja në fuqi e VKM Nr. 760 datë 08.12.2010 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2010-2015.
- Projektligji për disa ndryshime në Kodin Penal, i cili parashikon sanksione penale për shkeljen e të drejtave të Pronësisë Industriale në përputhje me parashikimet e marrëveshjes së TRIPS-it është hartuar nga Ministria e Drejtësisë, miratuar në Komisionet Parlamentare dhe pritet miratimi i tij në seancë plenare nga parlamenti gjatë vitit 2012.

Miratimi dhe hyrja në fuqi e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2010-2015 në Dhjetor të vitit 2010 është një nga masat legjislative më të rëndësishme të ndërmarra në drejtim të forcimit të sistemit të mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Intelektuale.

Strategjia përmban një plan veprimi të ndarë në planin afatshkurtër (2010-2012) dhe planin afatgjatë (2010-2015) dhe propozon masa konkrete për zgjidhjen e çështjeve ligjore dhe institucionale, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe rolin e secilit institucion në forcimin e mbrojtjes së të drejtave të PI në Shqipëri, me qëllim përmbushjen e angazhimeve të marra në nenin 73 të MSA

Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2010-2015 ka si objektiva strategjikë:

- Përfundimin e harmonizimit të kuadrit ligjor dhe rregullator me acquis, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të PI.
- Zhvillimin dhe konsolidimin e institucioneve të përfshira në mbrojtjen e të drejtave të PI duke përfshirë marrjen e masave për përmirësimin e teknologjisë së informacionit, trajnimet profesionale si dhe zhvillimi i shërbimeve specifike për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe edukimin, të cilat të ofruara nga institucionet përgjegjëse, do të kenë si target partnerët lokalë dhe grupet e interesit.
- Rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në fushën e mbrojtjes së të drejtave të PI.
- Forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit mes institucioneve kombëtare, rajonale dhe më tej, me qëllim përmirësimin e praktikave në fushën e mbrojtjes së të drejtave të PI.

Për sa i takon forcimit të kapaciteteve administrative të DPPM, janë realizuar këto aktivitete zbatuese: shtimi i stafit me 5 specialistë gjatë periudhës 2006-2009, instalimi i programit IPAS me anë të të cilit u mundësua procesimi automatik i të gjitha aplikimeve për

regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale; krijimi i bazës së të dhënave elektronike për patentat, markat, disenjot industriale; përkthimi në shqip i Klasifikatorëve ndërkombëtare si: Klasifikimi Ndërkombëtar i Patentave, Klasifikimi i Locarnos për disenjot industriale dhe Klasifikimi i Nicës për mallrat dhe shërbimet lidhur me markat tregtare.

Në drejtim të forcimit të bashkëpunimit me institucione të tjera të zbatimit të të drejtave të Pronësisë Industriale, DPPM ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione kombëtare si Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe me zyra analoge të rajonit si Turqia dhe Kosova.

Për sa i përket marrjes së masave ligjore dhe institucionale për forcimin e zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, është krijuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtoria e Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale (DMPI). Kjo strukturë funksionon në bazë të VKM Nr. 547 datë 01.05.2008 dhe VKM Nr. 274 datë 13.04.2010 "Për disa ndryshime në dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", të cilat janë gjerësisht të përafruara me Rregulloren e KE Nr. 1383/2003 datë 13.07.2003.

Me iniciativën e DMPI janë përfunduar dhe miratuar:

- Manuali për depozitimin e kërkesave për veprim doganor dhe
- Udhëzime për pranimin dhe përpunimin e kërkesave për veprim doganor.

Këto materiale janë publikuar dhe në faqen e internetit të DPD në rubrikën me titull "Pronësia Intelektuale".

Gjithashtu, në proces e sipër është hartimi nga DMPI, i profileve përkatëse të riskut për kategoritë e mallrave të përfshira në kërkesat për veprim të mbajtësve të së drejtave.

DPPM është përfituesi kryesor i projektit "Zhvillimi i Sistemit të të Drejtave të Pronësisë Industriale në Shqipëri (IPA Kombëtare 2009) financuar nga BE (1 milion Euro) dhe Zyra Evropiane e Patentave (100.000 Euro). Projekti që do të implementohet nga Zyra Evropiane e Patentave ka filluar në muajin maj 2011 dhe do të ketë një kohëzgjatje 2 vjeçare.

Objektivi kryesor i projektit IPA Kombëtare 2009 "Zhvillimi i Sistemit të të Drejtave të Pronësisë Industriale në Shqipëri" është të harmonizojë sistemin rregullator të Shqipërisë me acquis communautaire për Tregun e Brendshëm, të forcojë kapacitetet administrative të institucioneve të përfshira në zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Industriale, dhe t'i mbështesë ato në zbatimin e aktiviteteve të parashikuara nga Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale.
Përfitues të tjerë nga IPA Kombëtare 2009 janë institucionet e përfshira në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të PI si: Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, Doganat, Policia, Strukturat e Mbikëqyrjes së Tregut, Gjykatat si dhe institucionet arsimore dhe publiku i gjerë.

Trajnimi i stafit të institucioneve të mbrojtjes së të drejtave të PI dhe zhvillimi i aktiviteteve promovuese për publikun e gjerë, të mbështetura nga krijimi dhe instalimi i shërbimeve on-

line janë disa nga aktivitetet kryesore të parashikuara për t'u realizuar në kuadër të projektit IPA Kombëtare 2009.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Regjistrimi, njohja dhe mbrojtja e të drejtave të Pronësisë industriale në Shqipëri rregullohen me aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

- Ligji Nr. 9947 dt. 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale" i cili përafron gjerësisht legjislacionin kombëtar në fushën e PI me aktet e mëposhtme komunitare: Direktiva 98/44/EC "Për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike; Direktiva 98/71/EC "Për mbrojtjen ligjore të dizenjove industriale"; Direktiva 89/104/EEC "Mbi markat tregtare dhe të shërbimit";Direktiva 2004/48/EC "Mbi mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë
  Industriale"; Rregullorja (EEC) Nr. 1768/92 "Për lëshimin e certifikatave të mbrojtjes shtesë për produktet mjekësore"; Rregullorja (EC) Nr. 1610/96 "Për lëshimin e certifikatave të mbrojtjes shtesë për produktet për mbrojtjen e bimëve"; Rregullorja Nr. 6/2002 "Për Dizenjot Komunitare"; Rregullorja Nr. 40/94 "Për Markat Komunitare"; Rregullorja Nr. 2081/92 "Për mbrojtjen e Treguesve Gjeografikë" Shkalla e Përafrimit: Gjerësisht i përafruar
- Ligji Nr. 8488, datë 13.5.1999 "Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara", ndryshuar me Ligjin Nr. 9957, datë 17.7.2008 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8488, datë 13.5.1999 "Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara", i cili përafron legjislacionin kombëtar me aktin e mëposhtëm komunitar;_Direktivën Nr. 87/54 "Për mbrojtjen ligjore të topografisë së qarqeve të integruara".

Aktet e mëposhtme nënligjore dalë në zbatim të ligjit nr. 9947 datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale" rregullojnë procedurat që ndjek DPPM për ushtrimin e funksionit të saj kryesor që është njohja dhe regjistrimi i të drejtave të Pronësisë Industriale:

- VKM Nr. 1707, datë 29.12.2008, "Për Miratimin e Rregullores për Lëshimin e Patentave për Shpikjet dhe Modelet e Përdorimit" ndryshuar me VKM Nr. 618 datë 07.09.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 1707 datë 29.12.2008 "Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit";
- VKM Nr. 1706, datë 29.12.2008, "Për Miratimin e Rregullores për Regjistrimin e Markave Tregtare dhe të Shërbimit.
- VKM Nr. 1705 dt. 29.12.2008, "Për miratimin e Rregullores për regjistrimin e Treguesve Gjeografikë.
- VKM Nr. 381 datë 08.04.2009, "Për miratimin e Rregullores për regjistrimin e disenjove industriale";
- VKM Nr. 883 datë 13.05.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale" ndryshuar me VKM Nr. 433 datë 16.06.2011 "Për një ndryshim në VKM Nr. 883 datë 13.05.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale";

- Urdhri Nr. 406 datë 06.05.2009 i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë, dhe Energjetikës Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DPPM ndryshuar me Urdhrin Nr. 788 datë 15.11.2010 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Struktura dhe organika e DPPM janë përcaktuar me aktin e mëposhtëm nënligjor:

- Urdhri i Kryeministrit Nr. 126, datë 3.8.2007 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Patentave dhe Markave"

Shqipëria është anëtare e këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare dhe konventave në fushën e Pronësisë Industriale:

- Konventa për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin Nr. 8993, datë 30.1.2003, hyrë në fuqi më 30.06.1992.
- Konventa e Parisit për mbrojtjen e Pronësisë Industriale, hyrë në fuqi më 04.10. 1995.
- Marrëveshja e Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave hyrë në fuqi më 04.10. 1995.
- Protokolli i Marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin Nr. 8992, datë 30.1.2003, hyrë në fuqi më 30.07.2003.
- Traktati i bashkëpunimit në fushën e patentave. (PCT)
- Marrëveshja e Nice-s për klasifikimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve për efekt të regjistrimit të markave, ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin Nr. 9033, datë 20.3.2003, hyrë në fuqi më 19.09.2003.
- Marrëveshja e Budapestit për njohjen ndërkombëtare të depozitimit të mikroorganizmave për qëllime të procedurave të patentave, ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin Nr. 9031, datë 20.3.2003 hyrë në fuqi më 19 Shtator 2003.
- Konventa Ndërkombëtare "Për mbrojtjen e varieteteve të reja të bimëve" ratifikuar nga parlamenti shqiptar me Ligjin Nr. 9395, datë 12.5.2005, hyrë në fuqi më 15 Tetor 2005.
- Marrëveshja e Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove industriale ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin Nr. 9647, datë. 27.11.2006, hyrë në fuqi me datë 19.03.2007.
- Akti Gjenevë-s për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove industriale ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin Nr. 9648, datë 27.11.2006, hyrë në fuqi me datë 19.03.2007.
- Marrëveshja e Strasburgut për Klasifikimin Ndërkombëtar të Patentave, ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin Nr. 9532, datë 15.05.2006, hyrë në fuqi me datë 24.07.2007.
- Konventa Evropiane e Patentave" (EPC 2000) miratuar nga parlamenti shqiptar me ligjin Nr. 10179 datë 29.10.2009, hyrë në fuqi më datë 01.05. 2010.
- Marrëveshja e Ligjit mbi Patentat" (PLT) miratuar nga parlamenti shqiptar me ligjin Nr. 10180 , datë 29.10.2009 hyrë në fuqi më datë 17.05. 2010.
- Marrëveshja e TRIPS-it "Për disa aspekte të Pronësisë Intelektuale të lidhura me tregun" e cila është aneks i Marrëveshjes së Marrakesh-it për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, hyrë në fuqi më 08.09.2000 si dhe një ndryshim i Marrëveshjes së TRIPS-it hyrë në fuqi më datë 28.01.2009.

Struktura institucionale

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve në fushën e Pronësisë Industriale janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave është institucioni qendror publik i vetëm nëpërmjet të cilit shteti shqiptar jep të drejtën e pronësisë mbi shpikjet dhe modelet e përdorimit (patentat), topografinë e qarqeve të integruara, markat tregtare e të shërbimit, dizenjot industriale dhe treguesit gjeografik, duke iu njohur pronarëve të tyre këto të drejta nëpërmjet regjistrimit të tyre.
  Misioni i Drejtorisë është sigurimi i një sistemi efektiv të mbrojtjes së Pronësisë Industriale, sistem, i cili do të inkurajojë progresin teknologjik nëpërmjet transferimit të teknologjisë duke bërë të mundur zhvillimin e industrive lokale dhe nxitjen e Institucioneve të Kërkimit dhe Zhvillimit për krijimin e një mjedisi inovativ.
  Ky mision realizohet nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave të objekteve të Pronësisë Industriale, (patentave për shpikje dhe modele përdorimi, markave tregtare, dizenjove industriale dhe treguesve gjeografike) si dhe përhapjen e informacionit në lidhje me këto aktivitete.

Institucionet drejtpërdrejt përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si pjesë e sistemit të mbrojtjes së Pronësisë Industriale, është e detyruar që me kërkesë të personit të interesuar, të verifikojnë dhe të kontrollojnë mallrat e falsifikuara.
- Prokuroria është organi i procedimit penal pranë të cilit depozitohen kërkesat për rastet e falsifikimit ose piratimit të objekteve të Pronësisë Industriale, nga subjektet private kundër njeri tjetrit, bazuar në dispozitat e Kodit Penal.
- Policia e Krimit Ekonomik është një hallke tjetër e sistemit të mbrojtjes së Pronësisë Industriale. Ajo heton mbi bazën e denoncimeve të marra nga subjektet, pronarë të të drejtave të Pronësisë Industriale.
- Gjykata. Sistemi Gjyqësor ka të bëjë kryesisht me Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka juridiksionin e përcaktuar nga Kodi i Procedurës Civile dhe ligji "Për Pronësinë Industriale", për të vepruar si instancë e parë e specializuar për gjykimin e konflikteve që burojnë nga shkelja e të drejtave të Pronësisë Industriale. Pranë kësaj gjykate është seksioni i gjykimit të çështjeve tregtare ku përfshihet edhe gjykimi i çështjeve të mësipërme.

Masat legjislative afatshkurtra

Në përputhje me prioritetet afatshkurtra për harmonizimin e plotë të legjislacionit kombëtar në fushën e Pronësisë Industriale me acquis, gjatë vitit 2012, do të ndërmerren këto masa ligjore:

- Hartimi dhe miratimi i projektligjit për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9947 datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale" i cili synon harmonizimin e plotë të legjislacionit në fushën e pronësisë industriale me këto akte të acquis: Direktiva 98/44/EC "Për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike; Direktiva 98/71/EC "Për mbrojtjen ligjore të dizenjove industriale"; Direktiva 2008/95/EC "Mbi përafrimin e legjislacionit të vendeve anëtare për markat tregtare dhe të shërbimit";

Direktiva 2004/48/EC "Mbi mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Industriale". Institucioni përgjegjës për përgatitjen e projektligjit është DPPM me asistencën e Projektit IPA Kombëtare 2009. Afati i miratimit të projektligjit është muaji Dhjetor 2012.

- Hartimi dhe miratimi i projektligjit për aderimin e Shqipërisë në Marrëveshjen e Londrës për Patentat Evropiane. Miratimi i këtij akti nuk synon harmonizim të legjislacionit kombëtar me acquis. Institucioni përgjegjës për përgatitjen e projektligjit është DPPM me asistencën e Projektit IPA Kombëtare 2009. Afati i miratimit të projektligjit është muaji Dhjetor 2012.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet zbatuese të mëposhtme:

- Hartimi i manualeve për ekzaminimin e patentave, markave dhe disenjove industriale.
- Përmirësimi dhe rritja e sigurisë së infrastrukturës së TI të DPPM, përmirësimi i faqes së internetit dhe vendosja e sistemit te hetimit on-line duke krijuar akses në bazën e të dhënave për publikun.
- Trajnimi i stafit të DPPM dhe i stafit të autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të Pronësisë Industriale si doganat, policia, gjykata.
- Krijimi i Qendrës së Informacionit Teknik dhe Shkencor.
- Përgatitja e një programi edukimi dhe ndërgjegjësimi për biznesin dhe e materialeve mbështetëse promovuese.

Masat ligjore afatmesme

Masat ligjore afatmesme që do të ndërmerren në kuadër të harmonizimit të plotë të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE janë:

- Hartimi dhe miratimi i projektligjit për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8488 datë 13.05.1999 “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara”.i cili synon harmonizimin e plotë të legjislacionit kombëtar me këto akte të acquis: Direktivën Nr. 87/54 “Për mbrojtjen ligjore të topografisë së qarqeve të integruara” Institucioni përgjegjës për përgatitjen e projektligjit është DPPM me asistencën e Projektit IPA Kombëtare 2009. Afati i miratimit të projektligjit është muaji Mars 2013.

Aktivitete zbatuese afatmesme

- Trajnimi i stafit të DPPM, përfaqësuesve të autorizuar dhe grupeve të interesit.
- Promovimi dhe rritja e sensibilizimit për çështjet e Pronësisë Industriale mes bashkësisë së biznesit dhe institucioneve në zbatim të ligjit duke përfshirë institucionet dhe operatorët ekonomik.
- Instalimi i programit kompjuterik që do të mundësojë aplikimin on-line (e-filing) për regjistrimin e objekteve të PI.

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.7.2 Pronësia Industriale

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**75.888.000**	**44.640.000**	**21.000.000**	**24.000.000**
Mbulohen nga buxheti i	20.000.000	20.000.000	21.000.000	24.000.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	55.888.000	24.640.000	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.8. POLITIKA E KONKURRENCËS

3.8.1. POLITIKAT E KONKURRENCËS

Objektivi strategjik

Mbrojtja e konkurrencës është një fushë e rëndësishme për zbatimin e parimeve të ekonomisë së lirë të tregut. Për të vendosur një konkurrencë të lirë dhe efektive në tregun shqiptar, Autoriteti i Konkurrencës është i angazhuar të zbatojë detyrimet e përcaktuara në nenet 70 dhe 71 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, në zbatim të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), të dokumenteve strategjikë, të Politikës Kombëtare të Konkurrencës, si dhe të gjithë kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e një institucioni publik.

Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është promovimi dhe mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive nëpërmjet ruajtjes së mjedisit konkurrues dhe nxitjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Ruajtja apo nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat, apo ai shtetëror mund t'i bëjnë konkurrencës, prandaj ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet për fiksimin e çmimit, ndarjen e tregut, kufizimin apo kontrollin e prodhimit, të zhvillimit teknik, zbatimin e kushteve të ndryshme për transaksione të njëjta etj, abuzimin me pozitën dominuese si dhe kontrollin e përqendrimeve që rrezikojnë të krijojnë ose forcojnë një pozitë dominuese në treg. Promovimi i konkurrencës realizohet nëpërmjet forcimit të advokacisë dhe kulturës, një aspekt tjetër i rëndësishëm i aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës.

Zbatimit të Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës i nënshtrohen të gjitha ndërmarrjet private dhe publike që ushtrojnë veprimtarinë të drejtpërdrejt në tregun shqiptar apo që pasojat e veprimtarisë së tyre ndihen në tregun shqiptar. Forcimi i pavarësisë dhe rolit të enteve rregullatorë për tregjet specifikë është i rëndësishëm me qëllim, që të rrisë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Gjithashtu, në respektim të kuadrit ligjor respektiv, duhet të sigurohet transparenca në shkëmbimin e informacioneve.

Situata aktuale

Në Shtator të 2010, pranë Kuvendit të Shqipërisë, u diskutuan dhe miratuan amendimet e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës". Në 16.09.2010 u miratua Ligji Nr. 10317, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i cili hyri në fuqi me datë 23.10.2010, shpallur me dekretin Nr. 6696, datë 04.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Amendimet e fundit e kanë sjelle një përafrim thuajse të plotë të legjislacionit shqiptar në fushën e konkurrencës me acqui communitaire.

Autoriteti i Konkurrencës i ka dhënë përparësi krijimit të legjislacionit dytësor në fushën e konkurrencës. Ai ka hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore, të cilat janë ne përputhje te plote me aktet e BE-së.

Në vijim të aktivitetit të tij Autoriteti i Konkurrencës i ka dhënë një rëndësi të veçantë advokacisë së konkurrencës. Puna e Autoritetit te konkurrencës për rritjen e kulturës së konkurrencës u përqendrua kryesisht ne transparencën e plotë të procedurave të ndjekura nga Autoriteti. Kjo transparencë është respektuar dhe nëpërmjet publikimit të vendimeve të Komisionit, në kohë reale, si dhe dëgjimi i aktorëve të tjerë (institucione shtetërore) përpara dhënies së rekomandimeve. Gjithashtu kjo transparencë është realizuar edhe nëpërmjet pjesëmarrjes publike në media, e cila ka shërbyer dhe për rritjen e kulturës së konkurrencës në Shqipëri. Me asistencën e projektit të IPA 2008 janë kryer një sërë publikimesh të tilla si:

- Konkurrenca në prokurimet publike, Udhëzim si të parandalohen dhe zbulohen marrëveshjet e ndaluara në ofertat publike;
- Konkurrenca në prokurimet publike: Një leflet /Red flag
- Përmbledhje e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e Konkurrencës;
- Konkurrenca në Shqipëri;
- Vlerësimi i Ndikimit Rregullator dhe Konkurrenca në Tregjet e Rregulluara;
- Koncesionet, Konkurrenca dhe Rregullat e Ndihmës Shtetërore.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar); i përafruar nga: a). Nenet e Traktatit të Lisbonës (neni 101-102-106 i Traktatit të Funksionit të BE-së); b) 32003R0001 Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003, e datës 16 Dhjetor 2002 "Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit"; c). 32004R0773 Rregullorja e Komisionit Evropian (EC) nr. 773/2004, e datës 7 Prill 2004 mbi kryerjen e procedurave nga ana e Komisionit në mbështetje të neneve 81 dhe 82 të Traktatit të KE; ç). 52004XC0427(04) Njoftimi i Komisionit për shqyrtimin e ankesave nga Komisioni sipas neneve 81 dhe 82 i Traktatit të KE; d). 32004R0139 Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) nr. 139/2004, të datës 20 janar 2004 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve (Rregullorja e përqendrimeve të KE); e). 31997Y1209(01) Njoftimi i Komisionit mbi përcaktimin e tregut përkatës për qëllimet e ligjit komunitar të konkurrencës; dh). 52006XC1208(04) Njoftimi i Komisionit mbi imunitetin nga gjobat dhe uljen e gjobave në rastet e karteleve dhe 52006XC0901(01) Udhëzime për metodën e përcaktimit të gjobave të vendosura në përputhje me nenin 23 (2) (a) të Rregullores nr. 1/2003; g). 52001XC1222(03) Njoftimi i Komisionit për marrëveshjet me rëndësi të vogël të cilat nuk e kufizojnë ndjeshëm konkurrencën sipas nenit 81 (1) të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian (de minimis), etj.
- Rregullorja "Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës";
- Rregullorja "Për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të specializimit"; e përafruar nga: 32010R1218 Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1218/2010, e datës 14 dhjetor 2010 "Për zbatimin e nenit 101 (3) të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian për kategori të caktuara të marrëveshjeve të specializimit";
- Rregullorja "Për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit"; 32010R1217 Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1217/2010, e datës 14

dhjetor 2010 “Për zbatimin e nenit 101 (3) të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian për kategori të caktuara të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit”;

- Rregullorja “Për Kategoritë e Marrëveshjeve të Transfertave Teknologjike”; 32004R0772 Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 772/2004, e datës 27 prill 2004 “Për zbatimin e nenit 81 (3) të Traktatit për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike”;
- Rregullorja “Për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”; përfaruar nga: 32003R0001 Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003, të datës 16 Dhjetor 2002 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit”;
- Udhëzim “Mbi vlerësimin e marrëveshjeve vertikale”; përafruar nga: 32000Y1013(01) Njoftimi i Komisionit - Udhëzues mbi kufizimet vertikale;
- Udhëzim “Mbi vlerësimin e marrëveshjeve Horizontale”; përafruar nga: 32001Y0106(01) Njoftimi i Komisionit - Udhëzime për zbatimin e Nenit 81 të Traktatit të KE-së për marrëveshjet horizontale të bashkëpunimit;
- Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; përafruar nga: 32004R0139 Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) Nr. 139/2004, të datës 20 janar 2004 “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” (Rregullorja e Përqendrimit të KE);
- Udhëzim “Mbi formën e Njoftimit të përqendrimit” si dhe Anekset përkatëse I dhe II; përafruar nga: 32004R0802 Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 802/2004, e datës 7 Prill 2004, mbi zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 139/2004 “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”;
- Udhëzuesi “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale ndërmjet ndërmarrjeve”; përafruar nga: 52004XC0205(02) Udhëzime Mbi vlerësimin e përqendrimeve horizontale sipas Rregullores së Këshillit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”;
- Udhëzim “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglometare ndërmjet ndërmarrjeve”; përafruar nga: 52008XC1018(03) Udhëzime mbi vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale sipas Rregullores së Këshillit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”;
- Rregullorja “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël”; përafruar nga: 52001XC1222(03) Njoftimi i Komisionit për marrëveshjet me rëndësi të vogël të cilat nuk e kufizojnë ndjeshëm konkurrencën sipas nenit 81 (1) të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian (de minimis);
- Rregullorja “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”; përafruar nga: 52006XC1208(04) Njoftimi i Komisionit mbi imunitetin nga gjobat dhe uljen e gjobave në rastet e karteleve dhe 52006XC0901(01) Udhëzime për metodën e përcaktimit të gjobave të vendosura në përputhje me nenin 23 (2) (a) të Rregullores nr. 1/2003;
- Udhëzimi”Për përcaktimin e tregut”; përafruar nga: 31997Y1209(01) Njoftimi i Komisionit mbi përcaktimin e tregut përkatës për qëllimet e ligjit komunitar të konkurrencës;
- Udhëzimi” Për Vlerësimin e Pasojave të Legjislacionit mbi Konkurrencën”;
- Kodi i Etikës së Autoritetit të Konkurrencës;
- Rregullore “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Konkurrencës”;

- Rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”;
- Udhëzim “Për Formën e Njoftimit të marrëveshjeve” si dhe Formulari i Njoftimit të marrëveshjeve.

Struktura institucionale

Autoriteti i Konkurrencës e ushtron veprimtarinë e tij si një institucion publik, i pavarur, me mision mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive për një treg sa më funksional, me synimin final realizimin e përfitimeve sa më të mëdha të mundshme për konsumatorët , duke vlerësuar në mënyrë sa më objektive sjelljen e operatorëve në treg dhe të efekteve të akteve normative në funksionimin e tregut. Gjithashtu realizimi i këtij misioni mbështetet ne praktikat më të mira të eksperiencës evropiane e më gjerë, si dhe ne specifikat e ekonomisë shqiptare si: madhësia e tregut, masa e informalitetit, etj.

Autoriteti i Konkurrencës, si një institucion publik i pavarur, është ngritur në zbatim të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Autoriteti përbëhet nga Komisioni i Konkurrencës, si organi vendimmarrës dhe Sekretariati, si organi ekzekutiv i tij.

Komisioni përbëhet prej pesë anëtarësh të zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë, për një periudhë pesëvjeçare dhe vepron si një organ kolegjial i përhershëm. Bazuar në nenin 20 dhe 21 të Ligjit janë përcaktuar kushtet që duhen të plotësojnë anëtarët e Komisionit për tu zgjedhur si dhe mënyrën e zgjedhjes së tyre. Komisioni i Konkurrencës vepron si një strukturë kolegjiale e përhershme dhe ka të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimeve me nismën e tij, lidhur me çështjet që kufizojnë, pengojnë apo deformojnë konkurrencën në treg për ndërmarrjet private ashtu dhe në dhënien e rekomandimeve për institucionet publike. Ligji i ka dhënë kompetenca Komisionit të Konkurrencës që nëpërmjet vendimeve të tij të propozojë mjetet e nevojshme për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive nëpërmjet dhënies së rekomandimeve institucioneve publike dhe enteve rregullatorë në sektorë të ekonomisë. Komisioni i Konkurrencës paraqet në Kuvend raportin vjetor të punës së Autoritetit të Konkurrencës.

Sekretariati është struktura administrative dhe ekzekutive e Autoritetit të Konkurrencës që vepron në bazë të ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”(i ndryshuar) si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji. Sekretariati drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe përbëhet nga tre Drejtori dhe një Sektor : Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Hetimit te Tregjeve (10 persona), Drejtoria Juridike, Hetimit dhe e Procedurave (5 persona), Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Integrimit Evropian (8 persona) si dhe Sektori i Analizës dhe Studimeve (3 persona). Struktura e Autoritetit të Konkurrencës në bazë të nenit 10 të ligjit 9584, datë 17.07.2006, “Struktura dhe organika e institucioneve kushtetuese dhe të pavarura” miratohet me vendim të Kuvendit në bazë të numrit të miratuar në zbatim të buxhetit të shtetit për çdo institucion. Në bazë të ligjit, për kryerjen e veprimtarisë se tij, Autoriteti i Konkurrencës bashkëpunon me Administratën qendrore dhe vendore, Entet Rregullatorë, Gjykatat, komunitetin e biznesit, studiot ligjore, etj.

Masat legjislative afatshkurtra

- Rregullorja "Për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara" duke përafruar Rregulloren e Komisionit nr. 330/2010 e datës 20 Prill 2010 mbi zbatimin e nenit 101/3 të traktatit të Funksionimit të BE-së për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikat e bashkërenduara (qershor 2012);
- Rregullorja "Për kategoritë e marrëveshjeve në sektorin e mjeteve motorike" në përputhje me Rregulloren e Komisionit Nr. 461/2010 e datës 27 Maj 2010 Mbi zbatimin e nenit 101/3 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e mjeteve motorike; (mars 2012);
- Rregullorja "Për kategoritë e marrëveshjeve në sektorin e sigurimeve" në përputhje me rregulloren e Komisionit të BE-së Nr. 267/2010, të datës 24 Mars 2010 "Mbi zbatimin e nenit 101 (3) të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian për kategori të caktuara të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve" (Dhjetor 2012).
- Udhëzimi "Për kontrollin e përqendrimeve në përputhje me Njoftimin juridik të konsoliduar të Komisionit sipas Rregullores së Këshillit Evropian (EC) Nr. 139/2004 "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" (2008/C 95/01); (Shkurt 1012).

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Në funksion të arritjes së objektivit të Ligjit dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës, aktivitetet zbatuese të Autoritetit të Konkurrencës do të shtrihet në këto fusha kryesore:

- Zbatimi i ligjit antitrust (abuzimi me pozitën dominuese dhe marrëveshjet e ndaluara) si dhe kontrolli i përqendrimeve;
- Avokatia e konkurrencës nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për rritjen e konkurrencës në sektorët/tregjet ku ka të drejta ekskluzive/të veçanta, barriera të hyrjes në treg, monopolet natyrore etj.
- Realizimi i një studimi mbi barrierat e hyrjes sipas tregjeve, të drejtat ekskluzive/të veçanta me qëllimin kryesor rekomandimin e ndërhyrjeve për liberalizimin e tregjeve në funksion të rritjes së konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve private dhe/ose publike sipas tregjeve përkatëse. Sektori i energjisë, telekomunikacionit dhe transportit do të jenë në qendër të këtij studimi.
- Rritja dhe forcimi i kapaciteteve administrative;
  a) Organizimi i trajnimeve ne lidhje me:
    - Zbatimin e ligjit të konkurrencës në sektorin e telekomunikacioneve (2012);
    - Politika dhe Advokacia e Konkurrencës (2012);
    - Nocione të abuzimit me dominancën (rastet e BE-së, refuzimi për të shitur, doktrina e lehtësive esenciale, Rabatet 2012)
    - Ligji i Konkurrencës dhe mbrojtja e pronësisë industriale në sektorin farmaceutik (2012);
    - Diskutimi i karteleve: krahasimi i eksperiencës italiane me atë shqiptare, si të zbulosh një kartel dhe si të përgatisësh inspektime të befasishme (2012);

- Zbatimi i programit të lehtësimit– Mock case (2012);
- Rishikimi ligjor i gjobave, rastet e BE dhe vendeve anëtare, vendimet e Gjykatave(2012)
- Metodikat e llogaritjes së dëmit konsumator, abuzimi me praktika përjashtuese, eksperienca e Italisë (2012);
- Njohuritë teorike për konkurrencën në Vlerësimin e Impaktit të reformës Rregullatore (RIA) (2012);
- Produktet ushqimore dhe sektori i shpërndarjes (rastet e kartelit të miellit dhe nënprodukteve) (2012);
- Workshope rajonale me biznesin për njohjen e ligjit dhe politikës së konkurrencës, Shkodër (maj 2012) e Tiranë;
- Realizimi i eventeve publike (seminare, workshop dhe konferenca) si:
  - Seminar me Shkollën e Magjistraturës;
  - Konference ndërkombëtare në kuadër të ditës kombëtare të konkurrencës.

b) Shtimi i numrit të punonjësve mesatarisht me një post ne vit.

Masat legjislative afatmesme

- Rregullorja "Për Kategoritë e Marrëveshjeve në sektorin e transportit ajror" në përputhje me Rregulloren e BE-së Nr. 487/2009, e datës 25 Maj 2009 "Mbi zbatimin e nenit 81 (3) të Traktatit për kategori të caktuara të marrëveshjeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror" (Mars 2013)
- Rregullorja "Për kategoritë e marrëveshjeve për shoqëritë e linjave të transportit të mallrave" në përputhje me Rregulloren e BE-së 32009R0246; Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 246/2009, e datës 26 Shkurt 2009 "Mbi zbatimin e nenit 81 (3) të Traktatit për kategori të caktuara të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara ndërmjet shoqërive të linjave të transportit të mallrave" (Dhjetor 2013);
- Udhëzuesi "Për marrëveshjet horizontale" rishikim dhe përputhje me Njoftimin e ri të Be-së 52011XC0114(04): "Udhëzime mbi zbatimin e nenit 101 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian për marrëveshjet horizontale të bashkëpunimit" (Shtator 2013);
- Udhëzimi "Për marrëveshjet vertikale" rishikim dhe përputhje me Njoftimin e BE-së 52010SC0411: "Udhëzime mbi kufizimet vertikale" SEC/2010/0411 (nëntor 2014);
- Udhëzimi/Rregullorja "Për sektorin e transportit detar" në përputhje me udhëzimin e BE-së 52008XC0926(01): "Udhëzime mbi zbatimin e nenit 81 të Traktatit të KE për shërbimet e transportit detar" (mars 2014);
- Udhëzimi për kufizimet e "varura" në përputhje me 52005XC0305(02): "Njoftim i Komisionit mbi kufizimet drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme për përqendrimet"; (2015);
- Udhëzimi ne lidhje me masat e komisionit në përputhje me Njoftim i Komisionit mbi angazhimet e pranuara sipas Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 139/2004 dhe sipas Rregullores së Komisionit (EC) Nr. 802/2004 (2008/C 267/01) (2015);

- Vlerësim i projekt akteve ligjore dhe nënligjore në kuadër të respektimit të dispozitave ligjore (neni 69 i Ligjit) (2012-2015);
- Riamendim i Ligjit 9121 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" me 2015

Aktivitete zbatuese afatmesme

- monitorimi i tregut,
- hetimi i përgjithshëm në një sektor,
- hetimi paraprak dhe hetimi i thelluar me synim rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.
- organizimi i seminareve dhe workshopeve për rritjen e kapaciteteve administrative, duke kërkuar edhe asistencën e programit TAIEX
- seminaret trajnuese nëpër qarqet e vendit, si dhe të mundësohet futja e njohurive të konkurrencës në shkolla me bashkëpunimin e MASH
- pjesëmarrja në seminaret trajnuese të organizuara nga ICN, RCC (OECD) etj, për trajtimin e çështjeve të konkurrencës
- Organizimi i seminareve dhe workshopeve lidhur me:
    - Shqyrtimi i praktikave të "margin squeeze" (shtypjes së tregut) (viti 2013)
    - Masat strukturore në rastet e abuzimit me pozitën dominuese (2013)
    - Autorizimi i përqendrimeve me kushte dhe detyrime/masat strukturore dhe të sjelljes në rastet e përqendrimeve (2013)
    - Seminar mbi praktikat më të mira të investigimit në ambientet private me miratimin e Gjykatës (2013)
    - Road-shows për aplikimin e ligjit dhe politikës së konkurrencës (rrethet kryesore Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër) (2014)
    - Aplikimi i "Çmimeve Grabitqare" (2014)
    - Workshop "Praktikat Gjyqësore ne GJED dhe Gj.Luxemburg 2014
    - Workshop Mbi masat e sjelljes (Remedies) 2015
    - Kartelet rajonale dhe impakti në ekonomitë lokale (2015)
    - Road-shows për aplikimin e ligjit dhe politikës së konkurrencës (rrethet Korcë, Elbasan, Fier) (2015)
- Konferenca ndërkombëtare
- Konferenca Ndërkombëtare mbi Investigimin e Karteleve Ndërkombëtare 2013
- Konferencë rajonale mbi "Përvojat për Identifikimin e Marrëveshjeve të ndaluara" 2015

Efektet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**60.133.312**	**61.999.312**	**63.999.104**	**66.000.000**
Mbulohen nga buxheti i	60.134.000	62.000.000	64.000.000	66.000.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	0	0	0	0
Ndryshim	688	688	896	0

3.8.2. NDIHMA SHTETËRORE

Objektivi Strategjik

Fusha e ndihmës shtetërore është një nga fushat prioritare në kuadër të procesit të integrimit, detyrimet e së cilës përcaktohen në nenet 70 dhe 71 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe në nenin 38 të Marrëveshjes së Ndërmjetme. Këto nene parashikojnë domosdoshmërinë e përafrimit të legjislacionit vendas me "acquis" e Bashkimit Evropian, si dhe ngritjen e strukturës së pavarur nga ana funksionale, e ngarkuar me kontrollin e skemave financiare të ndihmës shtetërore dhe ndihmave individuale që zbatohen në Shqipëri, me kompetencat e mjaftueshme ligjore mbi kthimin e ndihmave shtetërore të paligjshme. Qeveria shqiptare është e angazhuar në zbatimin e parimit të transparencës për të gjitha masat e ndërmarra nga organet e administratës qendrore dhe vendore, si dhe institucionet e tjera që veprojnë në emër të shtetit, të cilat lidhen me përdorimin e burimeve shtetërore. Për këtë do të përgatitet një inventar gjithëpërfshirës i skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore dhe vlerësimi i tyre sipas standardeve evropiane, si dhe do të përgatiten raportet vjetore për ndihmat shtetërore në Shqipëri, të cilat duhet t'i paraqiten Komisionit Evropian. Bazuar në llogaritjen e treguesve të GDP-së sipas nivelit të NUTS-II, do të përgatitet edhe harta rajonale që do të bëjë klasifikimin e zonave dhe rajoneve të vendit dhe, mbi bazën e treguesve të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, do të përcaktohen vlerat e intensitetit maksimal të lejuar për kategori të veçanta të ndihmës shtetërore në këto rajone.

Analiza e situatës aktuale

Në Shqipëri, që nga janari i vitit 2006, është në fuqi një kuadër i plotë ligjor në fushën e ndihmës shtetërore, periudhë prej së cilës vepron dhe sistemi kombëtar i ndihmës shtetërore për mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin. Kuadri ligjor në këtë fushë përfshin Ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore", tri rregulloret në zbatim të tij, të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave, si dhe një sërë udhëzimesh për aspekte apo kategori të caktuara të ndihmës shtetërore, të miratuara me vendime të Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

Strukturat përgjegjëse për kontrollin e ndihmave shtetërore në Shqipëri janë; Komisioni i Ndihmës Shtetërore, si strukturë vendimmarrëse dhe Drejtoria si strukturë tekniko-organizative në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH) përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli i Ministrave me një mandat 4 vjeçar. Kryetar i Komisionit të Ndihmës Shtetërore është ministri që mbulon çështjet e ekonomisë. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vepron në zbatim të procedurave të ligjit si dhe rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore".

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Kuadri ligjor për ndihmën shtetërore reflekton rregullat e legjislacionit parësor dhe dytësor evropian dhe përbëhet nga:

- Ligji Nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën Shtetërore" i cili është në përputhje me nenet 87, 88 të Traktatit mbi Komunitetin Evropian dhe i harmonizuar plotësisht me Rregulloret Nr. 69/2001, (KE) e datës 12 Janar 2001 "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën "de minimis", 70/2001 "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së lidhur me ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", nenet 4 dhe 5, Rregullore e Komisionit Evropian Nr 2204/2002 "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE-së për ndihmën shtetërore për punësimin", Rregullore e Komisionit Evropian Nr. 68/2001, "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën për trajnim", Rregullore e Këshillit nr. 659/1999 "Për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të KE-së.
- Ligjin nr. 10183, datë 29.10.2009: "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore", përafruar pjesërisht me Rregulloren e Komisionit (EC) 800/2008 e datës 06 Gusht 2008 "Për deklarimin e disa kategorive të ndihmës shtetërore në përputhje me tregun e përbashkët (GBER)"; Udhëzim e Komunitetit 2008/C 82/1, datë 01.04.2008 "Për ndihmën shtetërore për mbrojtjen e mjedisit"; Udhëzim i Komunitetit 2006/C 194/2, datë 18.08.2006 "Për ndihmën shtetërore për riskun e kapitalit".
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 28.12.2005: "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale", përfaruar pjesërisht me Udhëzimi "Për ndihmën rajonale" Nr (98/C 74/06) e datës 10.03.1998.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 28.12.2005: "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës për shpëtim dhe ristrukturim", përafruar pjesërisht me Udhëzimin e Komisionit "Për ndihmën për shpëtim dhe ristrukturim" (1999/C 288/02) , Gazeta Zyrtare Seria C, datë 9.10.1999.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005: "Për miratimin e rregullores për procedurat dhe formën e njoftimit", përafruar pjesërisht me Rregullore e Komisionit (EC) Nr. 659/1999 e datës 22 Mars 1999; Rregullore e Komisionit (EC) Nr. 794/2004 e datës 21 Prill 2004, neni 2 dhe Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 659/1999 e datës 22 Mars 1999, neni 2.2. Rregullore "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore", miratuar me Vendimin e Komisionit te Ndihmës Shtetërore nr. 1, datë 31.05.2006.
- Udhëzim "Për paraqitjen e ankesave për ndihmat e paligjshme dhe vlerësimin e ndihmave të paligjshme, miratuar me Vendimin e KNSH nr. 7, datë 20.10.2006.
- Udhëzim "Për disa kategori të ndihmave horizontale", miratuar me Vendimin e KNSH nr. 23, datë 12.12.2007, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172, faqe 5291. përafruar pjesërisht me Rregullore e Komisionit Evropian Nr. 68/2001, "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën për trajnim"; Rregullore Nr. 363/2004 "Për disa ndryshime në rregulloren Nr. 68/2001, "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE-së për ndihmën për trajnim"; Rregullore e Komisionit Nr. 70/2001 "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE-së për ndihmën shtetërore për ndërmarrjet e vogla të mesme"; Rregullore Nr. 364/2004 "Për disa ndryshime në rregulloren Nr 70/2001 Rregullore e Komisionit Evropian Nr 2204/2002 "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE-së për ndihmën shtetërore për punësimin".
- Udhëzim "Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik", miratuar me Vendimin e KNSH nr. 26, datë 17.06.2008,

botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, faqe 4613. Përafruar plotësisht me Komunikatën e Komisionit, volumi 48, gazeta zyrtare nr. 297, datë 29.11.2005, f. 4-7.).

- Udhëzim "Për metodologjinë e analizës së kostove të ndihmës shtetërore në formën e sigurimit afatshkurtër të kredive të eksportit", miratuar me Vendimin e KNSH nr. 28, datë 25.09.2008, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 156, faqe 7700 përafruar pjesërisht me Komunikatën e Komisionit OJ C 281, 17.09.1997, f. 4-10)
- Udhëzimi "Për ndihmën shtetërore për mbrojtjen e mjedisit" në përputhje me Udhëzimet e Komunitetit nr. 2008/C 82/1, datë 01.04.2008, botuar ne fletoren zyrtare Nr. 25, date 19.03.2010, përafruar pjesërisht me Udhëzim e Komunitetit 2008/C 82/1, datë 01.04.2008 "Për ndihmën shtetërore për mbrojtjen e mjedisit", Vendimin nr. 29, datë 08.04.2009: "Për përcaktimin e normës së interesit për kthimin e ndihmës shtetërore, për vitin 2009".
- Vendimin nr. 30, datë 08.04.2009 "Për miratimin e hartës së ndihmës shtetërore",
- Udhëzimin "Për ndihmën shtetërore për kërkim dhe zhvillim", i cili është përafruar pjesërisht me Rregulloren e Komisionit nr. 800/2008 "Për deklarimin e disa kategori të caktuara të ndihmës në përputhje me tregun e përbashkët, në zbatim të neneve 87 dhe 88 të Traktatit të Përgjithshëm "(Blloku i përjashtimit"), Vendim i KNSH, Nr. 34, Dt. 02.04.2010, Flet. Zyrtare Nr. 46, Faqe:1746.
- Udhëzim "Për ndihmën shtetërore në sektorin postar", përfaruar pjesërisht me Komunikatën e Komisionit "Mbi zbatimin e rregullave të konkurrencës në sektorin postar dhe vlerësimin e disa masave shtetërore për shërbimet postare" (98/C 39/02).

Struktura institucionale

Bazuar në legjislacionin në fuqi janë krijuar dhe funksionojnë dy strukturat e kontrollit të ndihmës shtetërore:

Drejtoria e Ndihmës Shtetërore (1) në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Komisioni i Ndihmës Shtetërore (2):

- Struktura e Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është e ngarkuar me detyrat tekniko - administrative për kontrollin e ndihmave shtetërore në Shqipëri. Misioni i saj është zbatimi i legjislacionit në fushën e ndihmës shtetërore, nëpërmjet analizës, vlerësimit dhe kontrollit të skemave të ndihmës shtetërore dhe të ndihmave individuale, për të siguruar vendosjen e disiplinës së ndihmës shtetërore në vend, transparencën në përdorimin e fondeve publike, si dhe balancimin e politikave për realizimin e objektivave horizontale, sektoriale e rajonale.
- Komisioni i Ndihmës Shtetërore është organi vendim-marrës, i cili ka kompetencë të autorizojë planet për dhënien e ndihmës shtetërore, apo të urdhërojë kthimin e ndihmave të paligjshme. Në bazë të dispozitave të ligjit, Komisioni është një organ kolegjial i përbërë nga pesë anëtarë, i cili gëzon pavarësi në ushtrimin e funksioneve të tij.

Në kuadër të programit IPA 2008 "Mbështetje për Autoritetin e Konkurrencës dhe Drejtorinë e Ndihmës Shtetërore", struktura e ndihmës shtetërore është asistuar nga ekspertët e projektit

për forcimin e kapaciteteve institucionale, për diskutimin e rasteve konkrete të ndihmës shtetërore si dhe organizimin e disa aktiviteteve.

Masat legjislative afatshkurtra

- VKM për përgatitjen e raportit vjetor për ndihmat shtetërore të vitit 2011;
- Vendimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore "Për miratimin e hartës rajonale të ndihmës shtetërore".

Masat zbatuese

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- Fuqizimi i kapaciteteve institucionale të strukturave të ndihmës shtetërore, në veçanti, për trajnimin.
- Ndërgjegjësimi i dhënësve të ndihmës për zbatimin e detyrimeve të tyre ligjore në fushën e ndihmës shtetërore.

Masat Legjislative afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

- Ndryshimi i ligjit Nr. 9374, datë 24.05.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar; përafruar me Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) Rregullore Nr. 70/2001 "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së lidhur me ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", nenet 4 dhe 5. Rregullore e Komisionit Nr. 69/2001 (KE) e datës 12 Janar 2001 "Për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së për ndihmën "de minimis". Rregullore e Procedurave nr. 659/1999, neni 2; Rregullore e procedurave nr 794/2004, neni 10;
- Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin "Për disa kategori të ndihmave horizontale", në mënyrë që të përshtatet me Rregulloren e re të Bllokut të Përjashtimeve, Udhëzim "Për ndihmën shtetërore në sektorin e transmetimeve publike", harmonizuar me Komunikatën e Komisionit (2009/C 257/01);
- Udhëzim "Për ndihmën shtetërore në sektorin rrjetit broadband", harmonizuar me Komunikatën e Komisionit (2009/C 235/04);
- Udhëzim "Për ndihmën shtetërore rajonale për projektet e investimeve të mëdha", harmonizuar me kuadrin multisektorial publikuar me dokumentin nr C(2002) 315) (2002/C 70/04);
- VKM për përgatitjen e raporteve vjetore për ndihmat shtetërore;
- Udhëzim "Për ndihmën shtetërore në formën e garancive", harmonizuar me komunikatën (2008/C 155/02);
- Udhëzim "Për disa elementë të ndihmës shtetërore në shitjen trualli dhe ndërtesave nga autoritetet publike", harmonizuar me komunikatën e Komisionit Evropian (97/C 209/03);
- Udhëzim "Për zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore në lidhje me taksimin direkt të biznesit, harmonizuar me njoftimin e Komisionit (98/C 384/03);
- Udhëzim "Për financimin e aeroporteve dhe krijimin e linjave ajrore që operojnë në aeroportet rajonale", harmonizuar me udhëzimin e KE (2005/C 312/01);

- Udhëzim "Për ndihmën shtetërore për shërbimet ndaj pasagjerëve të transportit publik hekurudhor dhe rrugor", harmonizuar me Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian Nr 1370/2007;
- Udhëzim "Për ndihmën shtetërore në transportin detar", harmonizuar me komunikatën e komisionit Evropian (2004/C 13/03).

Masat zbatuese

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- Fuqizimi i kapaciteteve institucionale të dhënësve të ndihmës për zbatimin e detyrimeve të tyre ligjore në fushën e ndihmës shtetërore.

Efektet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**23.400.000**	**9.750.000**	**4.875.000**	**5.850.000**
Mbulohen nga buxheti i	3.900.000	9.750.000	4.875.000	5.850.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	19.500.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.9. SHËRBIMET FINANCIARE

3.9.1. BANKAT

Objektivi strategjik

Banka e Shqipërisë synon përafrimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me legjislacionin e Bashkimit Evropian, statutin e Bankës Qendrore Evropiane dhe Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, detyrimet që rrjedhin për Bankën në fushën e shërbimeve financiare i referohen dispozitave në lidhje me të drejtën e vendosjes dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve në fushën financiare; parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; përafrimit dhe zbatimit të kuadrit rregullator (nenet 50, 57, 70 të MSA-së).

Banka e Shqipërisë, si bankë qendrore ushtron funksionin e mbikëqyrjes bankare bazuar në ligjin nr. 8269, dt. 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 9662, dt. 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Departamenti i Mbikëqyrjes, krahas realizimit të një mbikëqyrje të kujdesshme, të vazhdueshme dhe të pavarur ndaj të gjitha institucioneve të licencuara nga Banka e Shqipërisë, ka për qëllim zhvillimin e sigurt të veprimtarisë bankare në vend, realizimin në mënyrë të shëndetshme të procesit të ndërmjetësimit bankar nga sektori bankar, me përfitime për industrinë bankare dhe për publikun që përfiton shërbimet e saj.

Në zbatim të dokumentit të Strategjisë së zhvillimit të mbikëqyrjes bankare për periudhën afatmesme 2009-2014, ndër objektivat e saj, Departamenti i Mbikëqyrjes synon:

- orientimin e veprimtarisë se tij mbikëqyrëse me pranë standardeve që kërkon mbikëqyrja mbi baza rreziku;
- përafrimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës me direktivat e BE-së në fushën e rregullimit dhe të mbikëqyrjes bankare;
- riorganizimin e kapacitetit institucional;
- bashkëpunimin me autoritetin mbikëqyrës vendas dhe të huaja, dhe
- forcimin e vetë-rregullimit të sektorit bankar dhe të mbrojtjes së klientit.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Edhe gjatë vitit 2011, Departamenti i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë konsolidoi punën për rishikimin e kuadrit rregullativ mbikëqyrës duke synuar përafrimin e mëtejshëm të tij me *acquis* e Bashkimit Evropian, përshtatjen me standardet e Komitetit të Bazelit dhe me praktikat më të mira në fushën e rregullimit të bankingu-t.

Kështu, viti 2011 shënoi finalizimin e disa rregulloreve të reja të mbikëqyrjes bankare, si rishikim tërësor i atyre ekzistuese dhe të disa ndryshimeve e shtesave në rregullore të tjera. Kuadri rregullativ u përafrua më tej me *acquis*-në e BE-së në fushën e administrimit të

rrezikut të kredisë, të administrimit të likuiditetit dhe përmirësimit të metodës për llogaritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit si më poshtë:

Me vendimin nr. 62, datë 14.09.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë". Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për administrimin e rrezikut të kredisë në veprimtarinë e bankave dhe degëve të bankave të huaja; dhe përcaktimi i kritereve për vlerësimin e rrezikut dhe klasifikimin e kredive dhe aktiveve të tjera, si dhe llogaritjen e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga zhvlerësimi i tyre. Rishikimi i rregullores "Për administrimin e rrezikut të kredisë" kishte për qëllim harmonizimin e mëtejshëm të dispozitave me Direktivën 2006/48/EC "Për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit të veprimtarisë nga ana e institucioneve të kreditit" (e riformuluar). Rregullorja "Për administrimin e rrezikut të kredisë është përafruar pjesërisht me Direktivën 2006/48/EC.

Nëpërmjet vendimit nr. 63, datë 14.09.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi disa ndryshime në rregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit" miratuar me vendimin nr. 58, datë 05.05.1999 e ndryshuar. Qëllimi kryesor i këtyre ndryshimeve ishte adresimi i çështjeve që lidhen me kredinë ndërkombëtare dhe përcaktimi i detyrimeve për bankat për kërkesa më të larta kapitale, në rastin kur banka jep kredi jashtë territorit në të cilin ushtron aktivitetin pa prezencën e një filiali, dege ose agjencie. Objektiv tjetër i ndryshimeve në rregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit" ishte gjithashtu harmonizimi i mëtejshëm i saj me dispozitat e Direktivës 2006/48/EC "Për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit të veprimtarisë nga ana e institucioneve të kreditit" (e riformuluar). Dispozitat e rregullores janë pjesërisht në përputhje me Direktivën 2006/48/EC.

Nëpërmjet vendimit nr. 75, datë 26.10.2010, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut te likuiditetit" të miratuar me vendimin nr. 71, datë 14.10.2009. Qëllimi i ndryshimeve në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit" ishte përcaktimi i qartë i detyrimeve të subjekteve të kësaj rregullore (bankat dhe degët e bankave të huaja) në lidhje me vendosjen e disa raporteve më të shtrënguara të likuiditetit si dhe vendosjen e një raporti të ri të likuiditetit në monedhë të huaj. Njëkohësisht, nëpërmjet ndryshimeve u arrit të realizohej rishikimi i përkufizimit në rregulloren ekzistuese në lidhje me aktivet likuide, zbatimi i disa marzheve reduktuese në disa lloje investimesh duke marrë në konsideratë vlerësimin e kundërpartisë si dhe disa kërkesa mbi raportimin më të shpeshtë në lidhje me treguesit e likuiditetit.

Në bashkëpunim me Bankën e Italisë, në kuadër të zbatimit të (Projektit të Binjakëzimit) të Bankës së Shqipërisë, projekt ky i financuar nga fondet IPA të BE-së me një shumë prej 1 milionë euro, është punuar në drejtim të rishikimit tërësor të rregullores "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" nën dritën e përafrimit me direktivën 2006/48/EC "Për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit te veprimtarisë nga ana e institucioneve te kreditit" (e riformuluar) dhe 2006/49/EC "Për mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërive të investimit dhe institucioneve të kreditimit", e ndryshuar. Kjo rregullore është rishikuar disa herë gjatë vitit 2011 me ndryshime të pjesshme, ndërkohë që projekti i rishikimit të plotë të rregullores është përfunduar nga grupi i punës dhe ka marrë vlerësimet dhe komentet e para nga ekspertët e Bankës së Italisë. Pas rishikimit të parë do të mundësohet dhe një vlerësim i dytë gjatë muajit

janar-shkurt dhe për një periudhë 6 mujore parashikohet diskutimi me përfaqësuesit e industrisë bankare, fillimisht me grupin ad-hoc të krijuar nëpërmjet Shoqatës Shqiptare të Bankave, me qëllim ndarjen e çështjeve më të rëndësishme duke marrë në konsideratë eksperiencën që sjellin bankat me mëmat në BE të cilat kanë përshtatur modelet e tyre, ashtu dhe kostot që mund të rrjedhin për bankat e vogla.

Në kuadër të menaxhimit të efekteve të krizës financiare ndërkombëtare, për t'i dhënë Bankës së Shqipërisë kompetenca më të plota në administrimin e situatave që paraqesin rrezik sistemik, Banka e Shqipërisë propozoi disa ndryshime ligjore në ligjin nr. 8365 datë 2.7.1998 "Per bankat ne Republiken e Shqiperise" propozime të cilat u miratuan në Kuvendin e Shqipërisë në nëntor 2011.

Kështu, në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis*-në e BE-së në veçanti me Direktivën 2006/48/EC "Për krijimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së institucioneve të kreditit", ndryshimet e ligjit konsistuan në rikonceptimin e termit "veprimtari bankare", në përputhje me përcaktimet e direktivës dhe me praktikat e vendeve anëtare të BE-së. Ndryshimi ligjor qëndron në heqjen e eskluzivitetit të ushtrimit të veprimtarisë së emetimit të parasë elektronike nga banka, dhe përfshirjen e saj në gamën e shumëllojshmërisë së veprimtarive financiare, që parashikohen në këtë ligj.

Në kuadër të rritjes së konkurrencës, tashmë jo vetëm bankat por dhe institucionet e parasë elektronike (institucione të reja për tregun shqiptar) mund të emetojnë para elektronike sipas kërkesave të tregut. Në këtë nismë janë marrë në konsideratë, duke u përafruar në këtë ligj, disa nga përcaktimet e direktivës së dytë të Bashkimit Evropian mbi paranë elektronike, Direktiva 2009/110/EC "Mbi krijimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen prudenciale të veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronik.

Departamenti i Mbikëqyrjes, ka zhvilluar një punë intensive për të përmirësuar cilësinë analitike të procesit të mbikëqyrjes së bankave si nëpërmjet ekzaminimeve në vend ashtu edhe gjatë analizës nga jashtë duke konsideruar përafrimin me standardet më të mira për praktikat mbikëqyrëse. Gjithashtu, është duke u riparë i gjithë procesit i vlerësimit të bankave duke tentuar drejt një zhvendosjeje nga sistemi i vlerësimit CAMELS[59] drejt sistemit të vlerësimit që përdoret nga bankat qendrore evropiane. Vlerësimi mbi të cilin është duke u bazuar Departamenti i Mbikëqyrjes është ai i përdorur nga Banka e Italisë. Ky sistem quhet RAS (Risk Assessment System) dhe është gjerësisht në përputhje me ato të përdorura nga bankat e tjera të Evropës pjesë e Eurosistemit. Kjo përputhje lidhet si në elementët përbërë të matricës së vlerësimit ashtu edhe në numrin e niveleve të përdorura, numër çift (1 deri në 6). Këto ndryshime janë duke u ndërmarrë në bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Italisë në kuadrin e projektit të binjakëzimit.

[59] CAMELS (Capital, Asset, Management, Earnings, Liquidity. Sensitivity) është metodologjia e përdorur për vlerësimin e rrezikut të bankave, elementet e së cilës janë mjaftueshmëria e kapitalit, cilësia e aktivit, menaxhimit, të ardhurat, likuiditeti dhe administrimi i fondeve dhe ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. (Fletore Zyrtare nr. 149, date 18.01.2007, faqe 6013). Ligji përafron pjesërisht Direktivën 2006/48/EC, datë 14.06.2006 'Për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit te veprimtarisë nga ana e institucioneve te kreditit" (e riformuluar). (Nr. CELEX 32006L0048 OJ L 177**,** 30.6.2006; OJ L 239M , 10.9.2010);
- Rregullore nr. 11, datë 25.02.2009 "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jo-banka", e ndryshuar. (Fletore Zyrtare nr.30, datë 19.03.2009, faqe 1714). Rregullorja përafron pjesërisht Direktivën 2006/48/EC, datë 14.06.2006 'Për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit te veprimtarisë nga ana e institucioneve te kreditit" (e riformuluar). (Nr CELEX 32006L0048 OJ L 177**,** 30.6.2006; OJ L 239M , 10.9.2010);
- Rregullore nr. 5 datë 11.02.2009 "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individët", e ndryshuar. (Fletore Zyrtare nr. 30, datë 19.03.2009, faqe 1706). Rregullorja përafron pjesërisht Direktivën 2008/48/EC, datë 29 prill 2008 "Mbi marrëveshjen e kredisë për konsumatorët". (Nr. CELEX 32008L0048, OJ L 133, 22.5.2008);
- Rregullore nr. 44, datë 10.06.2009 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit". (Fletore Zyrtare nr. 110, datë 18.07.2009, faqe 5338). Rregullorja përafron pjesërisht Direktivën 2005/60/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit dt. 26 tetor 2005 "Mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar me qëllim pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit" dhe (40 + 9) rekomandimet e FAFT- it. (Nr. CELEX 32005L0060, OJ L 309, 25.11.2005);
- Rregullore nr. 14, datë 11.03.2009 "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", e ndryshuar. (Fletore Zyrtare nr. 47, datë 23.04.2009, faqe 2321). Rregullorja përafron pjesërisht Direktivën 2006/48/EC, datë 14.06.2006 'Për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit te veprimtarisë nga ana e institucioneve te kreditit" (e riformuluar) dhe Parimet bazë të Komitetit të Bazelit për një mbikëqyrje efektive. (Nr. CELEX 32006L0048 OJ L 177**,** 30.6.2006; OJ L 239M , 10.9.2010);
- Rregullore nr. 70, datë 14.10.2009 "Për veprimtarinë valutore". (Fletore Zyrtare nr. 158, datë 22.11.2009, faqe 7051). Rregullorja përafron pjesërisht direktivën 88/361EEC, datë 24.06.1988 "Për zbatimin e nenit 67 të Traktatit të BE-së". (Nr. CELEX 31988L0361, OJ L 178, 8.7.1988);
- Rregullore nr. 31, datë 10.06.2009 "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave", e ndryshuar. (Fletore Zyrtare nr. 69, datë 21.05.2009, faqe 3037). Rregullorja përafron pjesërisht direktivën 2006/48/EC, datë 14.06.2006 'Për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit te veprimtarisë nga ana e institucioneve te kreditit" (e riformuluar) (Nr. CELEX 32006L0048 OJ L 177**,** 30.6.2006; OJ L 239M , 10.9.2010);
- Rregullore nr. 06, datë 15.06.2011 "Për ekspertët kontabël të autorizuar". (Fletore Zyrtare nr. 91, datë 08.07.2011, faqe 3736). Rregullorja përafron pjesërisht Direktivat: 2006/48/EC, datë 14.06.2006 'Për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit te veprimtarisë nga ana e institucioneve te kreditit" (e riformuluar) (Nr. CELEX 32006L0048 OJ L 177**,** 30.6.2006; OJ L 239M , 10.9.2010); Direktivën 78/660/EEC,

datë 25.07.1978 "Direktiva e Katërt e Këshillit bazuar në nenin 54 (3) të Traktatit për llogaritë vjetore të disa kategorive të shoqërive" e ndryshuar (Nr. CELEX 31978L0660, OJ L 222, 14.8.1978); Direktivën 85/611/EEC, datë 20.12.1985 "Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me sipërmarrjen e investimeve kolektive në titujt e transferueshëm"(UCIT) e ndryshuar. (Nr. CELEX 31985R0661 OJ L 74, 15.3.1985);

- Rregullore nr. 03, datë 19.01.2011 "Për administrimin e rrezikut operacional". (Fletore Zyrtare nr. 142, datë 21.10.2011, faqe 6417). Rregullorja përafron pjesërisht Direktivën 2006/48/EC, datë 14.06.2006 'Për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit te veprimtarisë nga ana e institucioneve te kreditit" (e riformuluar) (Nr. CELEX 32006L0048 OJ L 177**,** 30.6.2006; OJ L 239M , 10.9.2010);
- Rregullore nr. 48, datë 14.07.2010 "Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore". (Fletore Zyrtare nr. 103, datë 06.08.2010, faqe 5217). Rregullorja përafron pjesërisht Direktivën 2006/49/EC, datë 14.06.2006 "Për mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërive të investimit dhe institucioneve te kreditimit", e ndryshuar (Nr. CELEX 32006L0049**,** OJ L 177, 30.6.2006, OJ L 239M , 10.9.2010);
- Rregullore nr. 58, datë 05.05.1999 "Për mjaftueshmërinë e kapitalit", e ndryshuar. (Buletini Zyrtar Vëllimi 1, nr. 11, maj 1999). Rregullorja përafron pjesërisht Direktivën 2006/48/EC, datë 14.06.2006 'Për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit te veprimtarisë nga ana e institucioneve te kreditit" (e riformuluar) (Nr. CELEX 32006L0048 OJ L 177**,** 30.6.2006; OJ L 239M , 10.9.2010) dhe Direktivën 2006/49/EC, datë 14.06.2006 "Për mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërive të investimit dhe institucioneve të kreditimit", e ndryshuar (Nr. CELEX 32006L0049**,** OJ L 177, 30.6.2006, OJ L 239M , 10.9.2010);
- Rregullore nr. 62, datë 14.09.2011 "Për administrimin e rrezikut të kredisë" (Fletore Zyrtare nr.142, datë 21.10.2011, faqe 6417). Rregullorja përafron pjesërisht Direktivën 2006/48/EC, datë 14.06.2006 'Për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit te veprimtarisë nga ana e institucioneve te kreditit" (e riformuluar) (Nr. CELEX 32006L0048 OJ L 177**,** 30.6.2006; OJ L 239M , 10.9.2010)

Rregullore:

- Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.67, datë 13.10.2010 "Mbi përmbajtjen e informacionit dhe funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë" (Fletore Zyrtare nr.146, datë 04.11.2010, faqe 7842);
- Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.25, datë 24.03.2011 "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jo-bankar" (Fletore Zyrtare nr.61, datë 26.05.2010, faqe 2303);
- Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 40, datë 27.05.2009 "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre" (Fletore Zyrtare nr.94, datë 25.06.2009, faqe 4175);
- Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 71, datë 14.10.2009 "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit" (Fletore Zyrtare nr. 158, date 22.11.2009, faqe 7062);

- Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 14.09.2011 “Për administrimin e rrezikut të kredisë” (Fletore Zyrtare nr.142, datë 21.10.2011, faqe 6417);
- Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 27.02.2002 “Për licencimin e shoqërive te kursim-kreditit dhe të unioneve te tyre” Buletini Zyrtar Vëllimi 4, Nunër. 2, datë 27.02.2002);
- Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 38, datë 24.06.2009 “Për funksionimin e regjistrit të kredive në Bankën e Shqipërisë” (Fletore Zyrtare nr.116, datë 06.07.2009, faqe 5602);
- Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 60, datë 29.08.2008 “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja” (Fletore Zyrtare nr.142, datë 16.09.2008, faqe 6328);
- Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 29.08.2008 “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”, e ndryshuar (Fletore Zyrtare nr.142, datë 16.09.2008, faqe 6317);
- Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 57, datë 15.10.2007 “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e degëve te bankave te huaja”, e ndryshuar (Fletore Zyrtare nr. 140, datë 24.10.2007, faqe 389);
- Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 68, datë 28.07.2005 “Për mbikëqyrjen e konsoliduar” (Buletini Zyrtar Vëllimi VII, Numër. 11, datë 03.08.2005);
- Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr 11, datë 08.03.2002 “Për mbikëqyrjen e shoqërive te kursim-kreditit dhe te unioneve te tyre”, e ndryshuar (Buletini Zyrtar Vëllimi VII,Nr. 8, datë 15.06.2002);
- Rregullore miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 72, datë 02.06.1999 “Mbi rreziqet e tregut”. (Buletini Zyrtar Vëllimi 1, Numër. 12, qershor 1999);
- Rregullore miratuar me Vendimin nr. 28, datë 30.03.2005 "Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike" (Fletore Zyrtare nr.22, datë 30.03.2005, faqe 584).

Struktura Institucionale

Veprimtaria e tregut financiar në Shqipëri mbikëqyret nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të cilët rregullojnë respektivisht sektorin financiar bankar dhe jo-bankar. Funksioni i mbikëqyrjes bankare ushtrohet nga Banka e Shqipërisë, si bankë qendrore, në bazë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Banka e Shqipërisë është ekskluzivisht përgjegjëse për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave, subjekteve financiare jo-banka, shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre dhe zyrave të këmbimit valutor në Republikën e Shqipërisë. Për këtë qëllim Banka e Shqipërisë:

- nxjerr akte normative dhe jonormative për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit bankar bazuar në ligj dhe për zbatim të tij;

- kontrollon çdo zyrë bankare dhe këmbimi valutor, llogari bankare dhe dokumente të bankave, si dhe të subjekteve të tjerë që kryejnë veprimtari bankare me licencë.

Misioni i mbikëqyrjes bankare është ushtrimi i një mbikëqyrjeje të kujdesshme, të vazhdueshme dhe në mënyrë të pavarur, ndaj të gjitha institucioneve financiare të licencuara prej Bankës së Shqipërisë, në mënyrë që të garantohet mbarëvajtja e biznesit të tyre. Mbikëqyrja bankare ka një rol identifikues dhe parandalues të problemeve që mund të shfaqen në institucionet që licencohen nga Banka e Shqipërisë, në mënyrë që, në varësi të institucioneve që preken, këto probleme të mos shndërrohen në një kërcënim potencial për qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe veçanërisht të atij bankar. Nëse kjo do të ndodhte, përveç të tjerash, do të cenohej imazhi dhe reputacioni publik i këtyre institucioneve dhe i Bankës së Shqipërisë, me pasoja negative për shëndetin dhe rritjen në tërësi të ekonomisë shqiptare. Banka e Shqipërisë në funksion të rritjes dhe forcimit të aktivitetit mbikëqyrës si në përputhje me strukturën e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka parashikuar rritjen e numrit të punonjësve të Departamentit të Mbikëqyrjes me 3 punonjës të rinj për vitin 2012. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Departamentit të Mbikëqyrjes do të arrijë në 50 nga 47 punonjës që janë aktualisht.
Roli i mbikëqyrjes bankare është:

- të sigurojë nëpërmjet procesit të licencimit hyrjen në tregun bankar, vetëm të subjekteve të kualifikuara (aksionarë dhe administratorë) që plotësojnë kërkesat përkatëse ligjore, profesionale dhe etike, që kanë kapital të mjaftueshëm për ndërmarrjen e rrezikut, si dhe politika dhe procedura për kontrollin e rrezikut;
- të sigurojë që bankat të veprojnë në mënyrë të shëndoshë duke zbatuar kërkesat ligjore dhe rregullative, që ato të kenë kapitalin e mjaftueshëm, likuiditetin e nevojshëm, cilësi të kënaqshme të aktiveve, rezerva të mjaftueshme për të përballuar rreziqet që kanë ndërmarrë, administrim sipas standardeve ndërkombëtare "të praktikave më të mira", në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen e klientit dhe të evitojë praktikat abuzive;
- të sigurojë që bankat me probleme të trajtohen shpejt dhe me efektivitet në mënyrë që të mbrohen depozituesit, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë ekzistuese, minimizimin e kostos së qeverisë dhe të publikut.

Për të përmbushur këtë rol mbikëqyrja bankare:

- harton dhe rishikon rregulloret lidhur me: hyrjet e reja në sistemin bankar, kryerjen e një veprimtarie të kujdesshme bankare, monitorimin e rezultateve të arritura, kujdestarinë dhe likuidimin e bankave, dhe imponon zbatimin e akteve ligjore dhe rregullative;
- harton politika aktive dhe strategji për mbikëqyrjen e bankave të veçanta dhe të sistemit bankar në tërësi, që janë të bazuara në vlerësimin e drejtimit të rrezikut;
- zhvillon procedura mbikëqyrëse sipas udhëzimeve dhe standardeve ndërkombëtare;
- zbaton këto procedura, standarde dhe udhëzime në vazhdimësi;
- siguron mjaftueshmërinë e personelit në numër dhe në cilësi, për të realizuar mbikëqyrjen e industrisë bankare;

- financon dhe merr pjesë në takime të rregullta me industrinë bankare dhe me autoritete të tjera mbikëqyrëse, për probleme me interes të përbashkët.

Masat ligjore afatshkurtra

- Ndryshimi i rregullores nr. 58, datë 05.05.1999 "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" e ndryshuar. Rregullorja do të përafrohet më tej me dispozitat e Direktivës 2006/48/EC "Për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit te veprimtarisë nga ana e institucioneve te kreditit" (e riformuluar) (Nr. CELEX 32006L0048 OJ L 177**,** 30.6.2006; OJ L 239M , 10.9.2010). Ndryshimet janë parashikuar të miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012.
- Hartimi i rregullores "Për licencimin e veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike". Rregullorja do të përafrojë Direktivën 2009/110/EC, datë 16 shtator 2009 "Për fillimin, vazhdimin e ushtrimit të veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të sipërmarrjes së institucioneve të parasë elektronike" (Nr. CELEX 32006L0048 OJ L 177**,** 30.6.2006; OJ L 239M , 10.9.2010). Ndryshimet janë parashikuar të miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012.
- Rishikimi i kuadrit rregullativ për qeverisjen e përgjegjshme të bankave dhe degëve të bankave të huaja. Rishikimet janë parashikuar të miratohen gjatë tremujorit të dytë të vitit 2012.
- Rregullore "Për administrimin e rrezikut nga norma e interesit ne librat e bankës" Rregullorja parashikohet të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2012.
- Ndryshime në rregulloren "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare". Ndryshimet parashikohen të miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2012.
- Hartimi i rregullores "Për mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike". Rregullorja do të përafrojë Direktivën 2009/110/EC, datë 16 shtator 2009 "Për fillimin, vazhdimin e ushtrimit të veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të sipërmarrjes së institucioneve të parasë elektronike" (Nr. CELEX 32006L0048 OJ L 177**,** 30.6.2006; OJ L 239M , 10.9.2010). Ndryshimet janë parashikuar të miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Trajnimi dhe kualifikimi i stafit të Departamentit të Mbikëqyrjes në vlerësimin e rrezikut të tregut, produkteve të reja bankare, rrezikut të kreditit si dhe standardeve të Bazel II dhe IFRS;
- Trajnimi dhe kualifikimi i Departamentit të Mbikëqyrjes për transpozimin e Direktivës 2006/48 EC "Për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit të veprimtarisë nga ana e institucioneve të kreditit" në lidhje me format e raportimit dhe standarde të tjera raportuese.
- Trajnim për hartimin dhe zhvillimin e një projekti mbi administrimin e bazës së të dhënave/sistem i Teknologjisë së Informacionit me qellim mbikëqyrjen të fokusuar në rrezikun.

- Auditi i teknologjisë së informacionit, Modelimi i Riskut Operacional dhe Teknikat e matjes dhe menaxhimit të tij.
- Përftimi i asistencës për zbatimin e një programi periodik të provës së qëndrueshmërisë (*stress testing)* dhe sistemit të paralajmërimit paraprak.
- Konsultime për zbatimin e sistemit të integruar të mbikëqyrjes bankare "në vend dhe jo në vend"(*"on-site dhe off site")* fokusuar te rreziku.
- Implementimi i "Procesit të Brendshëm të Vlerësimit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit" (ICAAP) në kuadrin e punës për plotësimin e kërkesave të shtyllës së dytë të Bazelit, i cili do të zhvillohet në përputhje me kërkesat e direktivës 2006/48/EC dhe me asistencën e Bankës së Italisë.
- Përafrimi i metodologjive dhe manualeve të ekzaminimit të rreziqeve përkatëse në linjë me modelin "Procesi i Vlerësimit dhe Rishikimit të Mbikëqyrjes" (SREP model) SREP të parashikuar nga direktivat 2006/48/EC dhe 2006/49/EC.

Masat ligjore afatmesme

- Hartimi i rregullores "Për konglomeratët financiarë". Rregullorja do të përafrojë pjesërisht direktivën 2002/87/EC, datë 16 dhjetor 2002 "Për mbikëqyrjen suplementare të institucioneve të kreditit, sipërmarrjeve të sigurimit dhe shoqërive të investimit në konglomeratët financiare" (Nr. CELEX 32002L0087).

Masat zbatuese afatmesme

- Trajnimi dhe kualifikimi i stafit të Departamentit të Mbikëqyrjes në vlerësimin e rrezikut të tregut, produkteve të reja bankare, rrezikut të kreditit si dhe standardeve të Bazel II dhe standardeve ndërkombëtar të raportimit financiar (IFRS);
- Trajnimi i stafit të Departamentit të Mbikëqyrjes në drejtim të mbikëqyrjes së konsoliduar;
- Administrimi i rrezikut të likuiditetit në vështrimin e kuadrit të ri ndërkombëtar për këtë qellim;
- Hartimi i politikave dhe praktikave të licencimit të bankave/institucioneve financiare në zbatim të legjislacionit Evropian/Komitetit të Bazelit;
- Ristrukturimi i bankave / institucioneve financiare nëpërmjet ndryshimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, metodat e analizës dhe vlerësimit të aksionarëve të rinj dhe të efekteve të këtij ristrukturimi në sistem;
- Praktika ndërkombëtare nga autoritete mbikëqyrëse të huaja në raportimin e transaksioneve të dyshimta dhe krimin financiar;
- Pjesëmarrja aktive e Bankës së Shqipërisë në kolegjet mbikëqyrëse të grupeve bankare evropiane që operojnë edhe në Shqipëri dhe forcimi i bashkëpunimit home-host;
- Analiza e praktikave më të mira ndërkombëtare, sidomos atyre të BE, lidhur me mbrojtjen e konsumatorit dhe plotësimi i hendekut midis kuadrit tonë mbikëqyrës dhe atij të BE;
- Forcimi i kapaciteteve të Bankës së Shqipërisë për administrimin e situatave të krizave dhe zgjidhjes së bankave me probleme duke reflektuar parimet më të mira të zbatuara nga BE në këtë drejtim;

- Shqyrtimi dhe përgatitja e kushteve për implementimin e metodave të avancuara (IRB) në kuadrin e Bazel II.

Implikimet dhe burimet financiare

- Kostot për punonjës shtesë do të mbulohen nga buxheti i Bankës se Shqipërisë.
- Ndryshimi, hartimi dhe miratimi i akteve juridike nuk parashikon kosto për shpenzime në infrastrukturë.
- Kostot për trajnimet do të mbulohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë nëpërmjet instrumentit të Para-Aderimit (IPA 2008) në kuadër të Projektit të Binjakëzimit të Bankës së Shqipërisë me Bankën e Italisë dhe Bankën e Francës.
- Kostot për konsulentë do të mbulohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë nëpërmjet instrumentit të Para-Aderimit (IPA 2008) në kuadër të Projektit të Binjakëzimit të Bankës së Shqipërisë me Bankën e Italisë dhe Bankën e Francës.
- Përkthimi i akteve komunitare nuk do të ketë efekte financiare pasi do të realizohet nga punonjësit e Bankës së Shqipërisë.

Efektet Financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.9.1"Bankat"

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**2.325.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	2.325.000	0	0	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	0	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.9.2. SIGURIMI DHE PENSIONET PROFESIONALE

Objektivi strategjik

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u krijua si një institucion i pavarur rregullator dhe mbikëqyrës i tregjeve financiare jo-bankare dhe filloi veprimtarinë e tij në tetor të viti 2006. Krijimi i AMF pasqyroi angazhimin politik për rritjen dhe forcimin e rolit të tregut financiar jo-bankar në sistemin financiar në Shqipëri dhe në ekonominë e vendit në tërësi. Synimi i shtetit shqiptar ka qenë në vazhdimësi forcimi i AMF-së si institucion rregullator dhe mbikëqyrës i veprimtarisë financiare jo-bankare, me qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, nxitjen e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregut financiar jo-bankar si dhe respektimi rigoroz i ligjit.

Angazhimet e marra nga Autoriteti në kuadër të neneve 50, 57, 70, dhe 89 të Marrëveshjes të Stabilizim Asociimit do të realizohen nëpërmjet:

- Forcimit të kapaciteteve institucionale të Autoritetit; dhe
- Përmirësimit të legjislacionit në fushën financiare jo-bankare.

Autoriteti gjatë gjithë veprimtarisë së tij 5-vjeçare ka synuar forcimin e mbikëqyrjes së tregjeve financiare jo-bankare që është konkretizuar me rishikimin dhe përforcimin e kuadrit ligjor në fushën e sektorit financiar jo-bankar me synim rritjen e shkallës së përafrimit të legjislacionit të fushës me atë të Bashkimit Evropian në kuadër të angazhimeve të institucionit dhe të vendit për zbatimin e MSA-së. Fokusi i Autoritetit vazhdon të mbetet forcimi i kapaciteteve institucionale me qëllim ushtrimin e aktivitetit të një institucioni mbikëqyrës financiar në përputhje me standardet evropiane.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Në fushën e tregut financiar jo-bankar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare edhe gjatë 2011 ka thelluar përpjekjet për përafrimin e kuadrit ligjor me legjislacionin e BE-së, në zbatim të MSA-së, rekomandimeve të Raportit Analitik 2010 dhe Progres Raportit 2011, me synim përmirësimin e mëtejshëm të këtij tregu dhe forcimin e mbikëqyrjes.

Tregu i pensioneve vullnetare. Që nga hyrja në fuqi e ligjit të ri nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", tregu i pensioneve vullnetare njohu zhvillime pozitive në drejtim të licencimit. Autoriteti ka miratuar dhënien e licencës për 3 shoqëri administruese të fondeve të pensioneve vullnetare dhe licencën për tre banka si depozitar të fondeve të pensioneve. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare në fund të vitit 2011, tregon një total të ardhurash nga kontributet prej 177 mln lekë prej të cilëve rreth 44% paguhet nga anëtarët, ndërsa pjesa tjetër nga punëdhënësit. Vlera mesatare e kontributit mujor të derdhur në fondet e pensioneve private vullnetare gjatë këtij viti ka variuar nga 2,000 lekë deri në 13,600 lekë në varësi të fondit. Gjatë vitit 2011, numri i anëtarëve aktivë, ose anëtarëve, që kanë kryer të paktën një derdhje kontributi, është 5,275 nga 6,295 anëtarë gjithsej që janë të regjistruar deri më 31 dhjetor 2011 në këto fonde.

Shoqëritë e licensuara do të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tregut të pensioneve vullnetare dhe në rritjen e besueshmërisë së individëve dhe bizneseve për të përfshirë punonjësit e tyre në skemën e pensioneve vullnetare. Skema e re e organizimit dhe funksionimit të pensioneve vullnetare, përbën një risi për tregun financiar shqiptar. Për më tepër, përfshirja e lehtësirave tatimore në këtë ligj, e ka bërë skemën e pensionit privat më atraktiv për kontribuuesit dhe punëdhënësit, zbatimi i të cilave akoma nuk ka gjetur hapësirë si rezultat i politikave kufizuese të Ministrisë së Financave.
Autoriteti gjatë 2011 ka vazhduar forcimin e bazës rregullative me hartimin dhe miratimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të ligjit për pensionet vullnetare.

Tregu i sigurimeve. Të ardhurat nga primet e sigurimit, në vitin 2011, arritën rreth 8,356 milionë lekë, ose 1.81% më shumë se viti i kaluar. Gjatë vitit 2011, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 77.46% më shumë se një vit më parë. Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, te cilat sollën 87.03% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë sigurimet e Jetës me 12.75% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.22%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe

vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 55.30% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm motorik zënë 44.70% të totalit të tregut. Aktualisht në treg veprojnë 10 shoqëri sigurimi dhe 50% e tregut të sigurimeve dominohet nga kapitali i huaj.
Në dhjetor 2011 Autoriteti përfundoi hartimin e projektligjit "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" me qëllim, forcimin dhe zhvillimin e sektorit të sigurimeve në vend. Ky projektligj u hartua me synim plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e sigurimeve dhe përmbushjen e angazhimeve për përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian.

Ndër zhvillimet më të rëndësishme në fushën e sigurimeve përmendim hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10455, datë 21.07.2011 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10076, dt 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" i cili ka sjell liberalizimin e tarifave të primeve të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, duke hequr regjimin e tarifave fikse dhe vendosjen e tarifave të primeve nga shoqëritë e sigurimit sipas kushteve dhe kërkesave të tregut të sigurimit, në përputhje me (31992L0049) Direktivë 92/49/EEC e 18 qershorit 1992 mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me sigurimin e të drejtpërdrejtë, përveç sigurimit të jetës dhe ndryshimin e direktivave 73/239/EEC dhe 88/357/EEC (Direktiva e tretë të sigurimit të jo-jetës) Fletore Zyrtare L 228, 11/08/1992 P. 0001 – 0023
Në tetor 2011, Autoriteti miratoi metodologjinë e re të mbikëqyrjes në sigurime, nëpërmjet miratimit të Manualit të Mbikëqyrjes me Fokus Riskun, së bashku me planin strategjik të zbatimit. Koncepti bazë i metodologjisë së re është të identifikojë zonat me rrezik më të lartë në veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit dhe kur është e nevojshme, të punojë me menaxhimin e saj në mënyrë që ta ulë riskun në nivele të pranueshme. Objektivi i kësaj metodologjie është parandalimi problemeve financiare përpara se ato të ndodhin.
Autoriteti, në nëntor 2011, dha miratimin paraprak për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit në klasat e jo-jetës për një shoqëri të re.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Sigurimet dhe pensionet profesionale
Autoriteti ka thelluar në vazhdimësi përpjekjet për përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e bazës rregullative të nevojshme për një zhvillim sa më normal dhe të qëndrueshëm të tregjeve financiare jo-bankare. Një nga objektivat kryesore të Autoritetit ka qenë hartimi dhe miratimi i legjislacionit rregullator dhe mbikëqyrës në fushën e shërbimeve financiare jo-bankare duke mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit. Në kuadër të përmirësimit të kuadrit ligjor ekzistuese dhe përafrimit me direktivat e BE-së ka hartuar dhe miratuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore me qëllim ngritjen dhe përforcimin e proceseve rregullatore dhe mbikëqyrëse të qarta, transparente dhe të qëndrueshme.

- Ligji nr. 10 197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar" (Fletore Zyrtare e R.Shqipërisë nr. 185, datë 31.12.2009, faqe 8185). Përafruar pjesërisht me (Sipas Raportit Analitik 2010 dhe Progres Raportit 2011) Direktivën 2003/41/EC "Mbi aktivitetin dhe mbikëqyrjes e institucioneve të pensioneve profesionale" (Nr Celex 32003L0041); FZ L 235 , 23/09/2003 P. 0010 – 0021.
- Ligji nr. 10 076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" (Fletore Zyrtare e R. Shqipërisë nr 20, datë 4.3.2009, faqe 1302). Përafruar pjesërisht me Direktivën 72/166/EEC, për sigurimin e përgjegjësisë ndaj

palëve të treta nga përdorimi i mjeteve motorike, (Nr Celex 31972L0430); FZ 103 , 02/05/1972 p. 0001 - 0004; Përafruar pjesërisht me Direktivën 72/430/EEC për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta nga përdorimi i mjeteve motorike që amendon 72/166EEC, FZ L 291, 28.12.1972, p. 162–162; Përafruar pjesërisht me Direktivën 84/5/EEC, direktiva e dytë e sigurimit motorik, për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta nga përdorimi i mjeteve motorike, (Nr Celex 31984L0005); FZ L 8, 11.1.1984, p. 17–20; Përafruar pjesërisht me Direktivën 90/232/EEC, Direktiva e tretë të sigurimit motorik, për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta nga përdorimi i mjeteve motorike, (Nr Celex 31990L0232); FZ L 129, 19.5.1990, p. 33–35; Përafruar pjesërisht me Direktivën e pestë të sigurimit motorik (Nr Celex 32005L0014) që amendon Direktivat 72/166/EEC, 84/5/EEC, 88/357/EEC dhe 90/232/EEC, dhe Direktiva 2000/26/EC, FZ L 149 , 11/06/2005 P. 0014 – 0021;

- Ligji nr. 10 455, datë 21.07.2011 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 076, datë 12.2.2009 "për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" (Fletore Zyrtare e R. Shqipërisë nr 107, datë 09.08.2011, faqe 4264); Përafruar plotësisht me Direktiva 92/49/EEC "Mbi koordinimin e ligjeve, rregullave dhe dispozitave administrative në lidhje me ofrimin e drejtpërdrejtë të sigurimeve të ndryshme nga sigurimi i jetës dhe amendimi i Direktivave 73/239/EEC dhe 88/357/EEC", (Nr Celex 31992L0049); FZ L 228 , 11/08/1992 P. 0001 – 0023;
- Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" (Fletore Zyrtare Nr 78, datë 26.07.2006, faqe 2252).
- Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" (Fletore Zyrtare Nr 60, date 28.08.2004, faqe 3861; Fletore Zyrtare Nr 96, datë 17.12.2004, faqe 6597; Fletore Zyrtare Nr 27, datë 16.03.2007, faqe 487).
- VKM nr. 5, datë 07.01.2009 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 96, datë 03.08.2008 të Këshillit të Ministrave "Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimeve" (Fletore Zyrtare e R. Shqipërisë nr 2, datë 15.1.2009, faqe 10).
- VKM nr. 79, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës" (Fletore Zyrtare: Nr 15, Faqe 524; Datë 17.2.2008).
- VKM nr. 96, datë 03.02.2008 "Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimeve" i ndryshuar, (Fletore Zyrtare e R.Shqipërisë Nr, 19 datë, 22.2.2008, faqe 673, Fletore Zyrtare e R. Shqipërisë nr 2, datë 15.1.2009, faqe 10).
- VKM nr. 164, datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime" (Fletore Zyrtare e R. Shqipërisë nr 29, datë 03.3.2008, faqe 1360).
- VKM nr. 191, datë 25.03.2005 "Për miratimin e metodikës mbi mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit si dhe elementet që e përbëjnë atë" (Fletore Zyrtare e R.Shqipërisë Nr 23, datë 15.4.2005, faqe 876).
- Udhëzim nr. 15, datë 22.02.2008 "Për përmbajtjen e raportit të auditit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar".

- Udhëzim nr. 2, datë 21.11.2007 “Për procedurat e inspektimit në subjektet financiare jo-bankare”.
- Udhëzim nr. 4, datë 03.10.2007 “Mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit”.
- Udhëzim nr. 6, datë 30.08.2007 “Mbi administrimin e mirë të dëmeve në sigurime”.
- Udhëzim nr. 11, datë 08.02.2007 “Mbi rregullat e publikimit të të dhënave të shoqërive të sigurimit, shoqërive të brokerimit në kuadrin e transparencës ndaj publikut dhe mbrojtjes konsumatore”.
- Udhëzim nr. 10, datë 08.02.2007 “Për listën e dokumenteve të llogaridhënies së detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit e risigurimit”.
- Rregullore nr. 110, datë 28.07.2011 “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.
- Rregullore nr. 26, datë 23.02.2011 “Mbi funksionimin e sistemit të raportimit AMF In-Reg”
- Rregullore nr. 22, datë 19.03.2010 “Krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”.
- Rregullore nr. 21, datë 19.03.2010 “Mbi administrimin e fondit të garancisë dhe rregullat e trajtimit të dëmeve të kartonit jeshil”.
- Rregullore nr. 2, datë 28.01.2010 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”.
- Rregullore nr. 75, datë 28.08.2009 “Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.
- Rregullore nr. 67, datë 27.07.2009 “Mbi licencimin e aktuarëve të autorizuar të shoqërive të sigurimit”.
- Rregullore nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.
- Rregullore nr. 36, datë 30.04.2009 “Për regjistrin elektronik të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike”.
- Rregullore nr. 61, datë 22.05.2008 “Për procedurat e trajtimit të ankesave të të siguruarve”.
- Rregullore nr. 18, datë 27.03.2008 “Për organizimin e testimit për vlerësuesit e dëmeve në sigurime”.
- Rregullore nr. 10, datë 03.10.2007 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm motorik”.
- Rregullore nr. 2, datë 18.06.2007 “Për kriteret e risigurimit”.
- Rregullore nr. 8, datë 08.02.2007 “Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike”.
- Rregullore nr. 7, datë 08.02.2007 “Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit”.
- Rregullore nr. 6, datë 08.02.2007 “Për rregullat, mënyrat dhe kushtet e raportimit të shoqërive të sigurimit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.
- Rregullore nr. 5, datë 08.02.2007 “Mbi përmbajtjen e programit të risigurimit të shoqërive të sigurimit dhe afatet kohore të paraqitjes pranë Autoritetit”.
- Rregullore nr. 4, datë 08.02.2007 “Për kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit”.

- Rregullore nr. 16, datë 08.02.2007 "Për procedurat e licensimit dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënien e lejes për ushtrim veprimtarie si institut privat i pensioneve suplementare".
- Rregullore nr. 14, datë 08.02.2007 "Për disa kritere që duhet të plotësojnë personat e zgjedhur ose të emëruar në organet drejtuese të shoqërive të sigurimit ose risigurimit".
- Rregullore nr. 13, datë 08.02.2007 "Për procedurat e pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi ose risigurimi në Republikën e Shqipërisë".
- Rregullore nr. 25, datë 23.02.2011 "Për raportimin në AMF të veprimtarisë së shoqërisë administruese të fondeve të pensionit".
- Rregullore nr. 24, datë 23.02.2011 "Mbi ndarjen e veprimtarive të shoqërisë administruese të fondit të pensionit vullnetar;
- Rregullore nr. 2, datë 13.01.2011 "Për përmbajtjen e kontratës dhe të prospektit të fondit të pensionit".
- Rregullore nr. 1, datë 13.01.2011 "Për delegimin e funksioneve të shoqërisë administruese të fondeve të pensioneve".
- Rregullore nr. 126, datë 07.12.2010 "Mbi mënyrat, kushtet dhe procedurat e pagesave të pensionit vullnetar".
- Rregullore nr. 125, datë 07.12.2010 "Për penalitetet e zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohshme nga fondi i pensionit vullnetar".
- Rregullore nr. 113, datë 18.11.2010 "Për testimin e administratorëve të shoqërisë administruese të fondeve te pensioneve".
- Rregullore nr. 1, datë 28.01.2010 "Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondit të pensionit".
- Rregullore nr. 18/1, datë 25.02.2010 "Tarifat e licencimit dhe funksionimit të shoqërisë administruese, depozitarit dhe agjentit të fondeve të pensionit vullnetar"
  32003L0041 Direktiva 2003/41/EC "Mbi aktivitetin dhe mbikëqyrjes e institucioneve të pensioneve profesionale" FZ L 235 , 23/09/2003 P. 0010 – 0021;

Struktura Institucionale

Funksioni i mbikëqyrjes jo-bankare ushtrohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), i cili u krijua në bazë të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", si një ent rregullator i konsoliduar për të mbikëqyrur tregjet financiare jo-bankare (sigurimet, titujt, pensionet vullnetare në Shqipëri).
Bordi i AMF-së është organi drejtues dhe vendimmarrës i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Bordi i AMF-së është organ kolegjial, që përbëhet nga 7 anëtarë, 3 prej të cilëve janë anëtarë ekzekutivë me kohë të plotë dhe kryejnë përkatësisht funksionet e kryetarit dhe dy nënkryetarëve. Në bazë të nenit 6 të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", anëtarët e Bordit Anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi. Kryetari, dy nënkryetarët dhe 2 prej anëtarëve të Bordit emërohen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave. Një anëtar i Bordit emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Një anëtar i Bordit emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat. Ministri i Financave, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, si dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit kanë të drejtë t'i propozojnë

Këshillit të Ministrave nga një kandidat për anëtar të Bordit të Autoritetit. Në propozim përcaktohet edhe funksioni që kandidatët do të kenë në Bordin e Autoritetit. Në rastin e nënkryetarëve, në propozim përcaktohet edhe departamenti që do të drejtojë secili prej tyre. Kuvendi, me vendimin e emërimit të secilit prej nënkryetarëve, përcakton edhe departamentin, që do të drejtojë secili prej tyre. Mandati i Kryetarit, i dy nënkryetarëve dhe i anëtarëve të bordit është 5 vjet.
Struktura e Autoritetit miratohet nga i Kuvendi i Shqipërisë me propozimin e Bordit të AMF-së. Autoriteti vazhdon të funksionojë sipas strukturës dhe organikës së miratuar në bazë të Vendimit të Kuvendit, nr. 98, datë 30.04. 2007 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare". Organika e AMF-së, e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, është 58 punonjës. Aktualisht numri i punonjësve është 47.
Struktura aktuale e organizimit të Autoritetit mundëson një hierarki të përshtatshme për stafin e AMF-së dhe lejon mbulimin e të gjitha funksioneve që AMF kryen. Organizimi në katër departamente kryesore dhe disa drejtori krijon një ndarje të drejtë të përgjegjësive dhe lehtëson komunikimin midis njësive përbërëse.

Masat legjislative afatshkurtra

- Hartimi i ndryshimeve në ligjin e AMF-së, për të siguruar të gjitha elementet e nevojshme të pavarësisë, për ushtrimin e aktivitetit të një institucioni mbikëqyrës financiar.
- Hartimi i disa ndryshime në ligjin "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", për tu përafruar me Direktivën e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian 2009/103/EC e datës 16 shtator 2009 në lidhje me sigurimin kundër përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike (Nr. Celex 32009L0103), si dhe zbatimi i detyrimit për të siguruar kundër detyrimit të tillë, FZ L 263, 7.10.2009, p. 11–31.
- Hartimi i akteve nënligjore të tjera në zbatim të ligjeve që rregullojnë fushën financiare jo-bankare.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Ndjekja e procesit të miratimit të projektligjit "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" të hartuar nga Autoriteti në përputhje me Direktivat e BE-së. Hartimi i këtij projektligji përfundoi në dhjetor 2011 me qëllim forcimin dhe zhvillimin e sektorit të sigurimeve në vend, si dhe është rezultat i punës 2 vjeçare të AMF-së në kuadrin plotësimit të kuadrit ligjor dhe angazhimeve për përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian. Hartimi i këtij projektligji është bërë nga AMF-ja në bashkëpunim me ekspertë të Bankës Botërore.
- Kalimi gradual në një mbikëqyrje më efektive të tregut të sigurimeve, në fokus të së cilit do të jetë risku në kuadër të miratimit në mbledhjen e Bordit të AMF të datës 6.10.2011 të metodologjisë së re të mbikëqyrjes në sigurime nëpërmjet Manualit të Mbikëqyrjes me Fokus Riskun.
- Ngritja e kapaciteteve institucionale si kusht i domosdoshëm për zbatimin e metodologjisë së re të mbikëqyrjes me bazë risku. Trajnimi dhe përgatitja e stafit të

AMF dhe kryesisht të atij të mbikëqyrjes me qëllim rritjen e kapaciteteve në drejtim të zbatimit të metodologjisë së re të mbikëqyrjes me bazë risku.

- Licencimi i fondeve dhe shoqërive të administrimit të fondeve si rrjedhojë e miratimit të ligjit të fondeve të pensioneve.
- Mbarëvajtja e Sistemit AMF In-Reg.

Masat legjislative afatmesme

- Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të projektligjit "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", që do të përafrohen me: Direktivën 2002/83/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 nëntorit 2002 në lidhje me sigurimin e jetës; Direktivën e parë të Këshillit 73/239/EEC të datës 24 korrik 1973 mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me krijimin dhe kryerjen e veprimtarisë të sigurimit të drejtpërdrejtë, përveç sigurimit të jetës; Direktivën e Këshillit 73/240/EEC datë 24 korrikut 1973 për heqjen e kufizimeve në lirinë e vendosjes në veprimtarinë e sigurimit të drejtpërdrejtë, përveç sigurimit të jetës; Direktivën e Këshillit 73/240/EEC e 24 korrikut 1973 për heqjen e kufizimeve në lirinë e vendosjes në biznesin e sigurimit të drejtpërdrejtë, përveç sigurimit të jetës; Direktiven e Këshillit 84/641/EEC e 10 dhjetorit 1984 e cila ndryshon, veçanërisht për sa i përket asistencës turistike, Direktivën e parë (73/239/EEC) në koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me krijimin dhe kryerjen e veprimtarisë së sigurimit të drejtpërdrejtë, përveç sigurimit të jetës; Direktivën e Këshillit 87/344/EEC të datës 22 qershor 1987 mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me sigurimin e shpenzimeve ligjore; Direktivën e dytë të Këshillit 88/357/EEC të datës 22 qershor 1988 mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me sigurimin e të drejtpërdrejtë, përveç sigurimit të jetës dhe që përcakton dispozitat për të lehtësuar ushtrimin efektiv të lirisë për të ofruar shërbime, dhe që amendon Direktivën 73/239 / EEC; Direktivën e Këshillit 92/49/EEC e 18 qershor 1992 mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me sigurimin e të drejtpërdrejtë, përveç sigurimit të jetës (Nr. Celex 31992L0049),ndryshuar me Direktivat 73/239/EEC dhe 88/357/EEC (Direktiva e tretë e sigurimit të jo-jetës); Direktivën 2000/64/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Nr. Celex 32000L006) e 7 nëntorit 2000 që amendon Direktivat 85/611/EEC të Këshillit, të 92/49/EEC 92/96/EEC dhe 93/22/EEC, për sa i përket shkëmbimit të informacionit me vendet e treta; Direktivën 2002/13/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 marsit 2002 (Nr. Celex 32002L0013) që amendon Direktivën e Këshillit 73/239/EEC për sa i përket kërkesave të aftësisë paguese për shoqëritë e sigurimit të jo-jetës; Direktivën 2002/92/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian (Nr. Celex 32002L0092) e datës 9 dhjetor 2002 për ndërmjetësimin në sigurime; Direktivën 98/78/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 27 tetor 1998 për mbikëqyrjen shtesë të shoqërive të sigurimit në një grup sigurimi (Nr. Celex 31998L0078); Direktivën 2005/68/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 16 nëntor 2005 për risigurim (Nr. Celex 32005L0068) dhe që amendon Direktivat e Këshillit 73/239/EEC, 92/49/EEC si dhe Direktivat 98/78/EC dhe 2002/83/EC; Direktivën 2001/17/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 19 mars të vitit

2001 mbi riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive të sigurimit, (Nr. Celex 32001L0017).

- Përafrimin e plotë të legjislacionit të pensioneve vullnetare me acquis, që do të përafrohet me: Direktivën 2003/41/EC e Parlamentit Evropian dhe e Direktivat e Këshillit e datës 3 qershor 2003 për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve që ofrojnë pensione profesionale, (Nr. Celex 32003L0041);

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Ngritja e një kuadri të mbikëqyrjes me bazë riskun në tregun e pensioneve private vullnetare për të qenë më afër zhvillimeve dhe tendencave botërore të rregullimit në këtë fushë.
- Monitorimi i procesit të liberalizimit të tarifimit të produkteve të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe konsolidimi i strukturave përkatëse. Autoriteti po bashkëpunon me Bankën Botërore, në kuadër të projektit të përbashkët nga First Initiative, mbi "Liberalizimin e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri".
- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit në fushën e sigurimit, të pensioneve.
- Rritja e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave në kuadër të lehtësirave tatimore në fushën e pensioneve vullnetare.
- Informim i vazhdueshëm i publikut në lidhje me tregun financiar jo-bankar me materiale edukuese dhe nxitëse me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për përfitimet nga produktet dhe shërbimet financiare.
- Bashkëpunimi me institucionet brenda dhe jashtë vendit në kudër të një rregullimi dhe mbikëqyrje sa më efikase të tregut.
- Hartimi i një plan veprimi për implementimin e 32009L0138 Direktivës 2009/138/EC të 25 Nëntorit 2009 mbi krijimin dhe kryerjen e veprimtarisë së sigurimit dhe risigurimit.

Implikimet Financiare

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare siguron të ardhura për funksionimin normal të aktivitetit të tij në mbështetje të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare". Financimi i aktivitetit të Autoritetit që nga viti 2009 është realizuar me fonde tërësisht të krijuara nga të ardhurat e aktivitetit të tij.
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në funksion të rritjes dhe forcimit të aktivitetit mbikëqyrës të tregjeve financiare jo-bankare, ka paraqitur pranë Kuvendit të Shqipërisë nëpërmjet kërkesës nr.1488 prot. datë 24.08.2011 rritjen e numrit të punonjësve nga 58 (numri aktual i miratuar nga Kuvendi nëpërmjet Vendimit nr. 98 datë 30.047.2007) në 64 punonjës. Shtimi i numrit të punonjësve konsiston në rritjen e kapaciteteve institucionale kryesisht në njësitë që lidhen me mbikëqyrjen dhe disiplinimin e tregut.

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.9.2 "Sigurimi dhe Pensionet profesionale"

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**7.138.000**	**28.141.104**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	2.954.000	5.290.000	0	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	4.184.000	22.851.000	0	0
Ndryshim	0	-104	0	0

3.9.3. TREGU I KAPITALEVE

Objektivi strategjik

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u krijua si një institucion i pavarur rregullator dhe mbikëqyrës i tregjeve financiare jo-bankare dhe filloi veprimtarinë e tij në tetor të viti 2006. Krijimi i AMF pasqyroi angazhimin politik për rritjen dhe forcimin e rolit të tregut financiar jo-bankar në sistemin financiar në Shqipëri dhe në ekonominë e vendit në tërësi. Synimi i shtetit shqiptar ka qenë në vazhdimësi forcimi i AMF-së si institucion rregullator dhe mbikëqyrës i veprimtarisë financiare jo-bankare, me qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, nxitjen e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregut financiar jo-bankar si dhe respektimi rigoroz i ligjit.

Angazhimet e marra nga Autoriteti në kuadër të neneve 50, 57, 70, dhe 89 të Marrëveshjes të Stabilizim Asociimit do të realizohen nëpërmjet:

- Forcimit të kapaciteteve institucionale të Autoritetit; dhe
- Përmirësimit të legjislacionit në fushën financiare jo-bankare.

Autoriteti gjatë gjithë veprimtarisë së tij 5-vjeçare ka synuar forcimin e mbikëqyrjes së tregjeve financiare jo-bankare që është konkretizuar me rishikimin dhe përforcimin e kuadrit ligjor në fushën e sektorit financiar jo-bankar me synim rritjen e shkallës së përafrimit të legjislacionit të fushës me atë të Bashkimit Evropian në kuadër të angazhimeve të institucionit dhe të vendit për zbatimin e MSA-së. Fokusi i Autoritetit vazhdon të mbetet forcimi i kapaciteteve institucionale me qëllim ushtrimin e aktivitetit të një institucioni mbikëqyrës financiar në përputhje me standardet evropiane.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Në fushën e tregut financiar jo-bankar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare edhe gjatë 2011 ka thelluar përpjekjet për përafrimin e kuadrit ligjor me legjislacionin e BE-së, në zbatim të MSA-së, rekomandimeve të Raportit Analitik 2010 dhe Progres Raportit 2011, me synim përmirësimin e mëtejshëm të këtij tregu dhe forcimin e mbikëqyrjes.

Tregu i letrave me vlerë

Tregu i letrave me vlerë edhe për vitin 2011 vazhdoi të mbetej i përqendruar në tregun me pakicë të letrave me vlerë të borxhit të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione). Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2011 u dominua në masën 94.41% nga

transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 5.59% nga instrumenta afatgjatë (obligacione). Për sa i takon numrit të transaksioneve, 98.72% e të gjithë transaksioneve të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Arritjet legjislative për vitin 2011 në fushën e titujve u konkretizuan me miratimin e rregullave të reja për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të hartuara në zbatim të ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Gjatë vitit 2011 ky treg njohu zhvillime pozitive në drejtim të licencimit. Autoriteti licensoi shoqërinë e parë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive si dhe miratoi emetimin e parë të obligacionit me ofertë private.

Listimi i shoqërive dhe tregtimi i aksioneve në Bursë mbetet një përpjekje potenciale. Pavarësisht nga përpjekjet e vazhdueshme të Bursës së Tiranës për të afruar biznesin vendas, faktorë të shumtë si: madhësia e bizneseve (kryesisht biznes i vogël dhe i mesëm), mënyra e funksionimit të biznesit, trashëgimia kulturore dhe mentaliteti, kriza financiare ndërkombëtare kanë ndikuar në mos-zhvillimin e tregut të kapitalit.
Reformat ligjore, përmirësimi i standardeve dhe rritja e cilësisë së mbikëqyrjes pritet të kenë ndikim pozitiv në rritjen e interesit të investitorëve të huaj prestigjiozë për tregjet financiare jo-bankare në Shqipëri.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Autoriteti ka thelluar në vazhdimësi përpjekjet për përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e bazës rregullative të nevojshme për një zhvillim sa më normal dhe të qëndrueshëm të tregjeve financiare jo-bankare. Një nga objektivat kryesore të Autoritetit ka qenë hartimi dhe miratimi i legjislacionit rregullator dhe mbikëqyrës në fushën e shërbimeve financiare jo-bankare duke mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit. Në kuadër të përmirësimit të kuadrit ligjor ekzistuese dhe përafrimit me direktivat e BE-së ka hartuar dhe miratuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore me qëllim ngritjen dhe përforcimin e proceseve rregullatore dhe mbikëqyrëse të qarta, transparente dhe të qëndrueshme.

- Ligji nr. 10 198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" (Fletore Zyrtare nr.186, datë 31/12/2009, faqe 8225); Përafruar pjesërisht (Sipas Raportit Analitik 2010 dhe Progres Raportit 2011), me Direktivën 85/611/EEC "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me shoqëritë e investimeve kolektive për titujt e transferueshëm" (Nr Celex 31985L0611) e amenduar nga Direktivat 88/220/EEC dhe 95/26/EC, FZ L 375, 31.12.1985.
- Ligji nr. 10 236, datë 18.2.2010 "Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike" (Fletore Zyrtare e R. Shqipërisë nr 23, datë 18.03.2010, faqe 711); Përafruar plotësisht me Direktivën 2004/25/EC "Për ofertat e marrjes në kontroll të shoqërive tregtare" (Nr Celex 32004L0025); FZ L 142.
- Ligji nr. 10 158, datë 15.10.2009 "Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore" (Fletore Zyrtare nr. 149, datë 5.11.2009, faqe 6650); Përafruar

pjesërisht me Direktivën 2004/109/EC "Mbi harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth lëshuesve të letrave, të cilat janë pranuar për t'u tregtuar në tregjet e rregullta" (Nr Celex 32004L0109); e cila amendon Direktivën 2001/34/ECFZ L 390 , 31/12/2004 P. 0038 – 0057; Përafruar pjesërisht me Direktivën 2003/71/EC "Mbi publikimin e prospektusit, kur letrat me vlerë i janë ofruar publikut ose janë pranuar për t'u tregtuar" që amendon Direktivën 2001/34/EC (Nr Celex 32003L0071); FZ L 345 , 31/12/2003 P. 0064 – 0089; Përafruar pjesërisht me Direktivën 2004/39/EC (MiFID) "Mbi tregjet e instrumenteve financiarë" (Nr Celex 32004L0039); FZ L 145 , 30/04/2004 P. 0001 – 0044.

- Ligji nr.9879, datë21.02.2008 "Për titujt" (Fletore Zyrtare Nr. 36, datë 12.03.2008, faqe 1629); Përafruar pjesërisht me Direktivën 2004/109/EC "Mbi harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth lëshuesve të letrave, të cilat janë pranuar për t'u tregtuar në tregjet e rregullta" (Nr Celex 32004L0109) e cila amendon Direktivën 2001/34/EC, FZ L 390; Përafruar pjesërisht me Direktivën 2003/71/EC "Mbi publikimin e prospektusit, kur letrat me vlerë i janë ofruar publikut ose janë pranuar për t'u tregtuar" (Nr Celex 32003L0071) që amendon Direktivën 2001/34/EC FZ L 345 , 31/12/2003; Përafruar pjesërisht me Direktivën 2004/39/EC (MiFID) "Mbi tregjet e instrumenteve financiarë", (Nr Celex 32004L0039) FZ L 145; Përafruar pjesërisht me Direktivën 2003/6/EC "Për trajtimin e informacionit të brendshëm dhe manipulimin e tregut" (Nr Celex 32003L0006) implementuar nga Direktiva 2003/124/EC, FZ L 096 , 12/04/2003 P. 0016 - 0025;
- Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" (Fletore Zyrtare Nr 78, datë 26.07.2006, faqe 2252).
- Rregullore nr. 124, datë 7.12.2010 "Mbi afatet, kushtet dhe procedurat për autorizim të bankave si kujdestarë të obligacioneve".
- Rregullore nr. 74, datë 28.08.2009 "Mbi përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të veprimtarisë tregtare të shoqërive komisionere në letrat me vlerë".
- Rregullore nr. 68, datë 27.07.2009 "Mbi përgatitjen dhe publikimin e analizave financiare në fushën e letrave me vlerë".
- Rregullore nr. 42, datë 28.05.2009 "Mbi detyrimin e emetuesit për informimin e publikut mbi faktet me rëndësi materiale".
- Rregullore nr. 41, datë 28.05.2009 "Mbi likuiditetin minimal të shoqërive të brokerimit të letrave me vlerë".
- Rregullore nr. 22, datë 26.03.2009 "Për tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë së RSH-së".
- Rregullore nr. 21, datë 26.03.2009 "Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë".
- Rregullore nr. 165, datë 23.12.2008 "Për licencimin e shoqërive të brokerimit/ këshillimit, brokerit dhe këshilltarit të investimeve".
- Rregullore nr. 120, datë 02.10.2008 "Mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e bursës së titujve".
- Rregullore nr. 115, datë 11.09.2008 "Mbi përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes të librit të porosive dhe të librit të transaksioneve".
- Rregullore nr. 131, datë 06.10.2011"Mbi kodin e sjelljes të shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive".

- Rregullore nr. 130, datë 06.10.2011 “Për regjistrin e investitorëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”;
- Rregullore nr. 129, datë 06.10.2011 “Mbi procedurat, kostot dhe afatet kohore për mbylljen e fondeve të investimeve”.
- Rregullore nr. 128, datë 06.10.2011 “Mbi procedurat dhe kërkesat shtesë për licencimin e depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
- Rregullore nr. 127, datë 06.10.2011 “Mbi përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve”.
- Rregullore nr. 78, datë 29.06.2011 “Mbi përmbajtjen e regjistrit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive”.
- Rregullore nr. 77, datë 29.06.2011 “Mbi përcaktimin e vlerës së aseteve të sipërmarrjeve të investimit kolektiv dhe llogaritjen e vlerës neto të aseteve të tyre për kuotë ose për aksion”.
- Rregullore nr. 69, datë 26.05.2011 “Për autorizimin e individëve për shitjen e kuotave/aksioneve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike”.
- Rregullore nr. 68, datë 26.05.2011 “Për dhënien e licencës, veprimtarinë tregtare, ofertën publike dhe kërkesat e raportimit për sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike të krijuar nga një shoqëri e huaj administruese”.
  Përafruar plotësisht me Direktivën 85/611/EEC “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me shoqëritë e investimeve kolektive për titujt e transferueshëm” (Nr Celex 31985L0611) e amenduar nga Direktivat 88/220/EEC dhe 95/26/EC, FZ L 375, 31.12.1985, p. 3–18.

Struktura Institucionale

Funksioni i mbikëqyrjes jo-bankare ushtrohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), i cili u krijua në bazë të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si një ent rregullator i konsoliduar për të mbikëqyrur tregjet financiare jo-bankare (sigurimet, titujt, pensionet vullnetare në Shqipëri).
Bordi i AMF-së është organi drejtues dhe vendimmarrës i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Bordi i AMF-së është organ kolegjial, që përbëhet nga 7 anëtarë, 3 prej të cilëve janë anëtarë ekzekutivë me kohë të plotë dhe kryejnë përkatësisht funksionet e kryetarit dhe dy nënkryetarëve. Në bazë të nenit 6 të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, anëtarët e Bordit Anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi. Kryetari, dy nënkryetarët dhe 2 prej anëtarëve të Bordit emërohen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave. Një anëtar i Bordit emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Një anëtar i Bordit emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat. Ministri i Financave, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, si dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit kanë të drejtë t’i propozojnë Këshillit të Ministrave nga një kandidat për anëtar të Bordit të Autoritetit. Në propozim përcaktohet edhe funksioni që kandidatët do të kenë në Bordin e Autoritetit. Në rastin e nënkryetarëve, në propozim përcaktohet edhe departamenti që do të drejtojë secili prej tyre. Kuvendi, me vendimin e emërimit të secilit prej nënkryetarëve, përcakton edhe

departamentin, që do të drejtojë secili prej tyre. Mandati i Kryetarit, i dy nënkryetarëve dhe i anëtarëve të bordit është 5 vjet.
Struktura e Autoritetit miratohet nga i Kuvendi i Shqipërisë me propozimin e Bordit të AMF-së. Autoriteti vazhdon të funksionojë sipas strukturës dhe organikës së miratuar në bazë të Vendimit të Kuvendit, nr. 98, datë 30.04. 2007 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare". Organika e AMF-së, e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, është 58 punonjës. Aktualisht numri i punonjësve është 47.
Struktura aktuale e organizimit të Autoritetit mundëson një hierarki të përshtatshme për stafin e AMF-së dhe lejon mbulimin e të gjitha funksioneve që AMF kryen. Organizimi në katër departamente kryesore dhe disa drejtori krijon një ndarje të drejtë të përgjegjësive dhe lehtëson komunikimin midis njësive përbërëse.

Masat legjislative afatshkurtra

- Hartimi i ndryshimeve në ligjin e AMF-së, për të siguruar të gjitha elementet e nevojshme të pavarësisë, për ushtrimin e aktivitetit të një institucioni mbikëqyrës financiar.
- Hartimi i rregullores për tregjet MTF, për tu përafruar me Direktivën 2004/39/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datë 21 prill 2004 në tregjet në instrumente financiare (Nr. Celex 32004L0039) duke ndryshuar direktivat e Këshillit 85/611/EEC dhe 93/6/EEC dhe Direktivën 2000/12/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe duke shfuqizuar Direktivën e Këshillit 93/22/EEC, FZ L 145, 30.4.2004.
- Hartimi i rregullores "Për emetimin, transferimin dhe ruajtjen si të dhëna elektronike të titujve në regjistrarët e titujve" në zbatim të ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për Titujt", për tu përafruar me Direktivën 2004/39/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datës 21 prill 2004 në tregjet në instrumente financiare (Nr. Celex 32004L0039)duke ndryshuar direktivat e Këshillit 85/611/EEC dhe 93/6/EEC dhe Direktivën 2000/12/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit.
- Hartimi i akteve nënligjore të tjera në zbatim të ligjeve që rregullojnë fushën financiare jo-bankare.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Ngritja e kapaciteteve institucionale si kusht i domosdoshëm për zbatimin e metodologjisë së re të mbikëqyrjes me bazë risku. Trajnimi dhe përgatitja e stafit të AMF dhe kryesisht të atij të mbikëqyrjes me qëllim rritjen e kapaciteteve në drejtim të zbatimit të metodologjisë së re të mbikëqyrjes me bazë risku.
- Licencimi i fondeve dhe shoqërive të administrimit të fondeve si rrjedhojë e miratimit të ligjit të fondeve të investimit.

Masat legjislative afatmesme

- Përafrimin e plotë të legjislacionit të investimeve kolektive dhe titujve me acquis, që do të përafrohet me: Direktivën 2004/109/EC "Mbi harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth lëshuesve të letrave, të cilat janë pranuar për t'u tregtuar në tregjet e rregullta" , (Nr. Celex 32004L0039), e cila

amendon Direktivën 2001/34/EC, FZ L 390 , 31/12/2004 P. 0038 – 0057; Direktivën2003/6/EC "Për trajtimin e informacionit të brendshëm dhe manipulimin e tregut" , (Nr. Celex 32003L0006), implementuar nga Direktiva 2003/124/EC, FZ L 096 , 12/04/2003 P. 0016 – 0025; Direktivën 2010/73/EU e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 24 nëntor 2010 që amendon 2003/71/EC për prospektusin që do publikohet, kur letrat me vlerë ofrohen për publikun (Nr. Celex 32010L0073), ose që pranohen për tregtim dhe Direktivën 2004/109/EC për harmonizimin e kërkesave të transparencës në lidhje me informacionin për emetuesin letrat me vlerë e të cilit pranohen për tregti në një treg të rregulluar, FZ L 327, 11.12.2010, p. 1–12; Direktivën 2004/109/EC e Parlamentit dhe Direktivën e Këshillit Evropian e datës 15 dhjetor 2004 për harmonizimin e kërkesave të transparencës në lidhje me informacionin për emetuesit e letrave me vlerë të cilëve janë të lejuara për tregti në një treg të rregulluar (Nr. Celex 32004L0109),dhe Direktivën që amendon Direktivën 2001/34/EC, FZ L 390 , 31/12/2004 P. 0038 – 0057; Direktivën 2009/65/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 13 korrik 2009 për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur me sipërmarrjet për investimet kolektive në letrat me vlerë të transferueshme, (Nr. Celex 32009L0065), FZ L 302, 17.11.2009, p. 32–96.

- Hartimi i projektligjit për skemat e kompensimit të investitorit që do të përafrohet me Direktivën 97/9/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 3 mars 1997 për skemat e kompensimit të investitorëve, (Nr. Celex 31997L0009), FZ L 084 , 26/03/1997 P. 0022 – 0031.

Masat zbatuese afatmesme

- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit në fushën e titujve.
- Informim i vazhdueshëm i publikut në lidhje me tregun financiar jo-bankar me materiale edukuese dhe nxitëse me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për përfitimet nga produktet dhe shërbimet financiare.
- Bashkëpunimi me institucionet brenda dhe jashtë vendit në kudër të një rregullimi dhe mbikëqyrje sa më efikase të tregut.

Implikimet Financiare

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare siguron të ardhura për funksionimin normal të aktivitetit të tij në mbështetje të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare". Financimi i aktivitetit të Autoritetit që nga viti 2009 është realizuar me fonde tërësisht të krijuara nga të ardhurat e aktivitetit të tij.
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në funksion të rritjes dhe forcimit të aktivitetit mbikëqyrës të tregjeve financiare jo-bankare, ka paraqitur pranë Kuvendit të Shqipërisë nëpërmjet kërkesës nr.1488 prot. datë 24.08.2011 rritjen e numrit të punonjësve nga 58 (numri aktual i miratuar nga Kuvendi nëpërmjet Vendimit nr. 98 datë 30.047.2007) në 64 punonjës. Shtimi i numrit të punonjësve konsiston në rritjen e kapaciteteve institucionale kryesisht në njësitë që lidhen me mbikëqyrjen dhe disiplinimin e tregut.

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**7.138.000**	**8.460.000**	**7.557.104**	**8.427.104**
Mbulohen nga buxheti i	2.954.000	5.290.000	7.557.000	8.427.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	4.184.000	3.170.000	0	0
Ndryshim	0	0	-104	-104

3.10. SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA

3.10.1. TELEKOMUNIKACIONET DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Objektivi strategjik

Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë rregullohen me Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë".

Komunikimet elektronike apo telekomunikacionet përbëjnë një sektor shumë të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. Liberalizimi i plotë i tregut, sigurimi i konkurrencës efektive përmes një rregullimi efiçent janë në qendër të objektivave politike për këtë sektor. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 322, datë 05.05.2010, "Për miratimin e dokumentit të politikave për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", është miratuar dokumenti i politikës sektoriale, i cili përcakton vizionin e Shqipërisë për shtatë vitet e ardhshme në fushën e komunikimeve elektronike.

Qeveria Shqiptare bazuar në direktivat e Bashkimit Evropian (BE): nenet 49, 50, 70, 92, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) për zhvillimin e sektorit të komunikimeve elektronike, licencimin në tregun shqiptar të operatorëve vendas dhe të huaj që operojnë në fushën e komunikimeve elektronike duke garantuar trajtim jodiskriminues; nenet 50, 58 dhe 70, për sigurimin e lehtësive të nevojshme dhe tërësisht të barabarta ndërmjet operatorëve vendas dhe të huaj që do të operojnë në tregun e telekomunikacioneve në Shqipëri; Nenet 102, 104 të MSA për zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit ka përmirësuar legjislacionin e komunikimeve elektronike që ti përgjigjen politikës për liberalizimin e tregut të komunikimeve elektronike.

Prioritetet e përcaktuara për Qeverinë Shqiptare për sektorin e komunikimeve elektronike janë:

- Përmirësimi/plotësimi i kuadrit ligjor për komunikimet elektronike.
- Zhvillimi i infrastrukturës së komunikimeve elektronike në veçanti asaj me brez të gjerë.
- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të drejtën e kalimit në infrastrukturën e komunikimeve elektronike me brez të gjerë.

Iniciativa ligjore e qeverisë për plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullues për të drejtën e kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike është miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendim nr. 946, datë 01.12.2010, "Për Propozimin e projekt-ligjit "Për të drejtën e kalimit në pronë të shtetit dhe private për ndërtimin e rrjetit të komunikimeve elektronike" dhe pritet të miratohet nga Kuvendi.

Situata aktuale

Në tregun e komunikimeve elektronike operojnë sot katër operatorë të telefonisë celulare. Aktualisht ka rreth 79 operatorë alternativë të telefonisë fikse dhe 130 ofrues të shërbimit internet, ISP. Ka dy operatorë që ofrojnë shërbime të lëvizshme me brez te gjerë bazuar në 3G. Konkurrenca në tregun e komunikimeve elektronike është rritur si rezultat i politikave të

ndërmarra nga qeveria dhe masat rregullatore të zbatuara përmes rregullimit të tarifave të terminimit, implementimit të portimit të numrit në telefoninë e lëvizshme etj.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Sektori i komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë rregullohet nëpërmjet Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe ka si qëllim që, nëpërmjet parimit të asnjanësisë teknologjike, të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturën efiçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 është në përputhje me paketën Rregullatore të Bashkimit Evropian në fushën e komunikimeve elektronike sipas Direktivës 2002/19/KE për "Aksesin dhe interkonjeksionin e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese" (Direktiva e Aksesit), CELEX 32002L0019; Direktivës 2002/20/KE për "Autorizimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike" (Direktiva e Autorizimit) CELEX 32002L0020; Direktivës 2002/21/KE për "Kuadrin e përbashkët rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike" (Direktiva Kuadër) CELEX 32002L0021; Direktivës 2002/22/KE për "Shërbimin Universal dhe te drejtat e përdoruesve ne lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike" (Direktiva e Shërbimit Universal), CELEX 32002L0022; Direktivës 2002/58 për "Privatësinë dhe komunikimet elektronike"CELEX 32002L0058; Direktivës 2002/77/KE për "Konkurrencën ne tregjet për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike"CELEX 32002L0077.
- VKM nr. 322, datë 05.05.2010,"Për miratimin e dokumentit të politikave për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë". Ky dokument është në harmoni me kuadrin e përgjithshëm rregullator të BE-së për liberalizimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe masat rregulluese përkatëse të cituara më sipër.
- VKM nr. 331, datë 14.04.2011 "Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve", i cili transpozon Direktivën 1999/5/KE për "Pajisjet radio dhe pajisjet fundore te telekomunikacioneve dhe njohjen e ndërsjellët të konformitetit të tyre", CELEX 31999L0005.
- VKM nr. 479, datë 06.05.2009 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave". Ky dokument nuk përafron ndonjë akt komunitar.

Struktura institucionale

Kuadri institucional për komunikimet elektronike përbëhet nga Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit si politikë-bërës, dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) si organi rregullator i pavarur.

Roli i Ministrit është i përcaktuar në nenin 5 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", si institucion politik bërës në fushën e komunikimeve elektronike. Bazuar në VKM nr. 248, datë 27.04.2007 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", të ndryshuar, në ushtrimin e

kompetencave të tij Ministri mbështetet nga Drejtoria e Komunikimeve Elektronike dhe Postare që funksionon brenda AKSHI-t.

Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (MITIK) është Ministri përgjegjës për komunikimet elektronike, i cili i propozon Këshillit të Ministrave strategjitë e zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike, aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në dokumentin e politikave të komunikimeve elektronike.

AKEP, si organi rregullator i pavarur është një person juridik, publik, jobuxhetor, i cili e zhvillon veprimtarinë në përputhje me Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë". Kompetencat e AKEP dhe objektivat rregullatore janë përcaktuar në nenet 7 dhe 8 të këtij ligji.

AKEP drejtohet nga një Këshill Drejtues me pesë anëtarë të emëruar nga Kuvendi. AKEP kryen funksionet rregullatore si: procedurat e autorizimit individual dhe të autorizimit të përgjithshëm në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, përcaktimin e operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg, mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, cilësisë së shërbimeve dhe ndërmarrjen e masave rregulluese për garantimin e konkurrencës së ndershme në treg, etj.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë". Ky projekt-ligj synon të përafrojë plotësisht Direktivën 2009/136/KE me nr. CELEX 32006L0136 (e cila amendon Direktivën 2002/22/KE për shërbimin universal dhe Direktivën 2002/58/KE për "Privatësinë dhe komunikimet elektronike"), Direktivën 2009/140/KE, CELEX 32009L0140 (e cila amendon Direktivat 2002/19/KE, 2002/20/KE, 2002/21/KE), dhe Direktivën nr. 2006/24/KE me nr. CELEX 32006L0024.
- Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9157, datë 04.12.2003 "Për përgjimin e telekomunikimeve. Ky ligj nuk përafron ndonjë akt komunitar.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e Politikës për zhvillimin e rrjeteve me brez të gjerë në Shqipëri (National Broadband Policy). Ky projekt-vendim është në përputhje të pjesshme me kuadrin e përgjithshëm të Axhendes Dixhitale Evropiane me nr. CELEX 52010DC0245.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave". Me këtë projektvendim synohet të reflektohen aktet finale të Konferencës Botërore të Radiokomunikacionit WRC-12, por nuk përafron ndonjë acquis të BE-së specifike.
- Projektligj "Për ratifikimin e akteve finale të Konferencës fuqiplote të ITU-së, Guadalajara, Meksikë 2010". Ky projektligj nuk bën përafrimin me ndonjë acquis të BE-së.
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për regjistrimin e të drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjetit të komunikimeve elektronike, në regjistrat e zyrës së regjistrimit të

pasurive të paluajtshme". Ky projekt-vendim do të plotësojë legjislacionin për të drejtën e kalimit sikurse parashikohet ne ligjin për të drejtën e kalimit.

- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e Rregullave më të detajuara mbi formën dhe përmbajtjen e regjistrit elektronik për të drejtën e kalimit dhe subjektet e autorizuara për të pasur akses". Ky projektvendim do të plotësojë legjislacionin për të drejtën e kalimit sikurse parashikohet në ligjin për të drejtën e kalimit.

Aktivitetet zbatuese

- Fuqizimi i kapaciteteve të administratës për komunikimet elektronike që punojnë për MITIK:
- Trajnime, seminare, (kualifikim të stafit dhe njohjes së acquis të BE-së, implementimit të këtyre direktivave në vendet e tjera te BE-së.
- Organizimi i takimeve me grupe të ndryshme të interesit për të diskutuar mbi iniciativat e ndryshme ligjore.
- Organizimi i seminareve për implementimin e ndryshimeve ligjore lidhur me Konceptet e net-neutrality; Digital dividend-in dhe Politikat spektrale.

Masat legjislative afatmesme

- Hartimi i strategjisë "Shqipëria Dixhitale 2013-2020". Kjo strategji do të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Ajo do të jetë në të njëjtën linjë me programin Axhenda Dixhitale e Evropës 2020.
- Hartimin e Dokumenteve për politikat spektrale për digital dividend, zhvillimet e telefonisë celulare me brez të gjerë, 4G/LTE me VKM, në përputhje të plotë me Vendimin nr. 676/2002 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për spektrin radio me nr. CELEX 32002D0676.

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.10.1.: Telekomunikacionet dhe Teknologjia e Informacionit

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**0**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	0	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.10.2. SHOQËRIA E INFORMACIONIT

Objektivi strategjik

Mbështetja e zhvillimit të shoqërisë së informacionit është e përcaktuar dhe në dokumentin planifikues indikativ shumëvjeçar (MIPD) në pjesën**:** Programet që do të zbatohen.

Zhvillimi i shoqërisë së informacionit është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë shqiptare. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim përcaktoi disa objektiva të rëndësishëm për zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, të cilat u pasuruan dhe u detajuan me Strategjinë Ndërsektoriale për Shoqërinë e informacionit të miratuar me VKM nr. 59, datë 21.01.2009.

Objektivat kryesore të Strategjisë Ndërsektoriale të Shoqërisë së Informacionit janë:

- Zhvillimi i infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit.
- Nxitja e qeverisjes së mirë përmes shërbimeve moderne online.
- Politikat në fushën e edukimit dhe njohurive.
- Politikat në drejtim të biznesit elektronik (E-Biznes).
- Kuadri ligjor dhe institucional për zhvillimin e shoqërisë së informacionit.
- Legjislacioni për shoqërinë e Informacionit.
- Një shoqëri informacioni e sigurt.

Për periudhën afatshkurtër, prioritetet në fushën e shoqërisë së informacionit do të jenë:

- Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor për shoqërinë e informacionit
- Forcimi i kapaciteteve administrative
- Rritja e ndërgjegjësimit për shoqërinë e informacionit
- Te miratohen aktet nënligjore për zbatimin të ligjeve për dokumentin elektronik dhe ligjit për bazat e të dhënave shtetërore.

Situata Aktuale

Në përmbushje të nenit 70 dhe 103 të MSA-së i është kushtuar vëmendje plotësimit të kuadrit ligjor për shoqërinë e informacionit në përputhje me standardet evropiane.

E ndërgjegjshme për rolin e TIK në zhvillimin e shoqërisë dhe rritjen ekonomike, por dhe në përmbushjen e objektivave për një qeverisje më të mirë përmes rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetareve dhe biznesit në vendimmarrje, Qeveria ka ndërmarrë një sërë aktivitetesh dhe ka kryer një sërë hapash për zhvillimin e shoqërisë së informacionit, si në drejtim të qeverisjes elektronike, biznesit elektronik dhe të edukimit elektronik, etj.

Është bërë një përparim i mirë në procesin e miratimit të legjislacionit të shoqërisë së informacionit, në përputhje me standardet e BE-së, ku mund të përmendim miratimin e ligjeve:

- “Për Komunikimet Elektronike”
- “Për Nënshkrimin Elektronik”
- “Për Dokumentin Elektronik”
- “Për Tregtinë Elektronike”
- “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”
- “Për Krimin Kibernetik”
- “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”.

Është bërë progres në zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe ofrimit të shërbimeve publike përmes Internetit, në veçanti shërbimet për biznesin, si: regjistrimi i biznesit, lëshimi i licencave, taksat elektronike, si dhe në sistemin e doganave. Është dixhitalizuar Regjistri Kombëtar Civil. Sistemi i prokurimit elektronik është zbatuar që nga fundi i vitit 2007 dhe aktualisht të gjitha prokurimet publike realizohen në mënyrë elektronike.

Është realizuar projekti për ngritjen e pikave të aksesit për publikun në të gjitha Zyrat e Postës Shqiptare, duke ofruar shërbimin Internet falas në zyrat postare në të gjithë vendin.

Gjatë vitit 2011, u punua për hartimin e planit të ri të veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Shoqërisë së Informacionit. Ky plan veprimi u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 586, datë 03.08.2011 "Për një ndryshim në vendimin nr. 59, datë 21.01.2009 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Shoqërisë së Informacionit".

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji për Tregtinë Elektronike nr. 10128, datë 11.05.2009, u hartua në përputhje me direktivën 2000/31/KE. Shkalla e përafrimit e pjesshme.
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Referenca përkatëse në legjislacionin evropian Direktiva 95/46/KE. Shkalla e përafrimit e plotë.
- Ligji për Nënshkrimin elektronik Ligji nr. 9880, datë 25.02.2008. Referenca Përkatëse në legjislacionin evropian Direktiva 1999/93/KE. Shkalla e përafrimit e plotë.
- Ligji për dokumentin elektronik Ligji nr. 10273, datë 29.04.2010. Ky ligj nuk synon përafrim me ndonjë acquis specifik.
- Legjislacioni për krimin kibernetik Ligji nr. 9859, datë 21.01.2008 dhe Ligji nr. 10123, datë 27.11.2008 duke plotësuar kërkesat e Konventës për Krimin Kibernetik. Referenca përkatëse në legjislacionin evropian, Konventa nr. 185 e Këshillit të Europës për krimin kibernetik. Shkalla e përafrimit e plotë.
- VKM nr. 59, datë 21.01.2009 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit" Referenca përkatëse në legjislacionin evropian, eEurope Action, i2010 Initiative.
- VKM nr. 586, datë 03.08.2011 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 59, datë 21.01.2009 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit. Referenca përkatëse në legjislacionin evropian, eEurope Action, i2010 Initiative.
- VKM nr. 248, datë 27.04.2007 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit".
- VKM nr. 837, datë 29.07.2009 "Për disa Ndryshime dhe Shtesa në VKM nr. 248, datë 27.04.2007 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit".
- VKM nr. 28, datë 20.01.2010 Për disa Ndryshime dhe Shtesa në VKM nr. 248, datë 27.04.2007 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" të ndryshuar.
- VKM nr. 723, datë 01.09.2010 "Për projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemeve të informacionit".
- VKM nr. 961, datë 24.11.2010 "Për përcaktimin e autoritetit rregullator koordinues të bazave të dhënave shtetërore".

- VKM nr. 26, datë 11.01.2012, Për disa Ndryshime dhe Shtesa në VKM nr. 248, datë 27.04.2007 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", të ndryshuar.

Struktura institucionale

Për të shpejtuar më tej ritmet e progresit drejt moshës/epokës dixhitale, është krijuar institucioni i Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit. Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit është ministri përgjegjës për komunikimet elektronike dhe postare dhe është ngarkuar të drejtojë procesin e dixhitalizimit të shoqërisë, reformat në fushën e shoqërisë së informacionit dhe udhëheqjen e procesit të implementimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit. Në lidhje me fushën e shoqërisë së informacionit Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit ka këto detyra kryesore:

- Zhvillimin dhe implementimin e një strategjie të integruar për të mundësuar një përdorim të gjerë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, në mënyrë që të stimulohet ndërtimi i një shoqërie të bazuar mbi këto njohuri.
- Nxitja e zhvillimit të shërbimeve të reja elektronike për biznesin dhe qytetarin.
- Zhvillimi i një kuadri të plotë ligjor dhe harmonizimi i kuadrit ligjor përkatës të fushës me standardet e BE për shërbimet postare dhe TIK dhe sigurimin e implementimit efektiv të tyre.
- Ndërmarrja e projekteve të qeverisë elektronike (e-government) dhe promovimi i integrimit të TIK dhe shërbimeve më të mira në të gjitha fushat e zhvillimit ekonomik për të plotësuar nevojat e një ekonomie të bazuar mbi këto njohuri.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është agjenci në varësi të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit. Roli dhe funksionimi i AKSHI-it përcaktohen në VKM nr. 248, datë 27.04.2007 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" i ndryshuar. AKSHI ka objekt të veprimtarisë:

- Zbatimin e politikave e të strategjive, për zhvillimin e sektorit të Shoqërisë së Informacionit (SHI) dhe në veçanti të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).
- Bashkërendimin e programeve në fushën e SHI-së dhe në veçanti të TIK-ut;
- Nxitjen e investimeve në fushën e SHI-së.
- Hartimin e praktikave për ushtrimin e kompetencave që i jepen ministrit nga legjislacioni në fushën e komunikimeve elektronike.
- Promovimin e teknologjive të reja në fushën e SHI-së.
- Dhënien e kontributit në edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-ut nga publiku.

Autoriteti Kombëtar i Certifikimit Elektronik (AKCE) është ngritur dhe funksionon bazuar në Ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008 "Për nënshkrimin elektronik", i ndryshuar. Ky autoritet është në varësi të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit. AKCE mbikëqyr zbatimin e ligjit për Nënshkrimin Elektronik. Disa nga

parimet bazë që duhen respektuar në fushën e nënshkrimeve elektronike janë: akreditimi vullnetar; jo-autorizimi paraprak; jo-diskriminimi; mbrojtja e të dhënave personale; njohja e produkteve te huaja; standardet e mirënjohura ndërkombëtare në siguri dhe besueshmëri. Nënshkrimet Elektronike që njihen nga ligji janë ato të kualifikuara që bazohen në një certificatë të kualifikuar, të lëshuara nga një Ofrues i Shërbimit Certifikimit i regjistruar pranë AKCE.

Institucione të tjera të lidhura

AKEP-i është organi rregullator përgjegjës për sektorin e komunikimeve elektronike dhe postare dhe vepron mbi bazën e Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

Komisioneri i Mbrojtjes së të Dhënave Personale u krijua pas miratimit të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Komisioneri i Mbrojtjes së të Dhënave Personale është autoriteti mbikqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale.

KKRT është organi rregullator përgjegjës në fushën e transmetimeve radio televizive. Aktiviteti i saj rregullohet me Ligjin nr. 8410 datë 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin "Për tregtinë elektronike" nr. 10128, datë 11.05.2009". Ky projekt-ligj synon përafrimin e plotë me Direktivën 2000/31/KE.
- Projektvendim i Këshillimit të Ministrave, në zbatim të Ligji nr. 10273, datë 29.04.2010 "Për Dokumentin Elektronik". Këto akte nuk bëjnë përafrim me ndonjë akt specifik të BE-së.
- Projektudhëzim Ministri, në zbatim të Ligji nr. 10273, datë 29.04.2010 "Për Dokumentin Elektronik". Ky akt nuk bën përafrim me ndonjë akt specifik të BE-së.
- Projektvendim i Këshillimit të Ministrave për miratimin e strategjisë së re "Shqipëria Dixhitale", e cila do të jetë një strategji gjithëpërfshirëse për periudhën 2013-2020.
- Projektvendim i Këshillimit të Ministrave për miratimin e Dokumentit të Politikave për "Krijimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapsinore", e cila përfshin shërbimin Gjeodezik, Kadastral, Hartografik & GIS, në përputhje të pjesshme me Direktivën 2007/2/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës të 14 marsit 2007, INSPIRE, e cila përmban rregullat dhe orientimet kryesore mbi të cilat duhet të mbështetet ndërtimi i infrastrukturës së të dhënave gjeohapësinore.
- Projektligj për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë, i cili në përputhje me Direktivën INSPIRE synon përcaktimin e rregullave të detyrueshme për krijimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë; organizimin dhe funksionimin e Autoriteteve Kombëtare të Dhënave Gjeohapësinore; kushtet që lidhen me krijimin, përditësimin, shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin e grupeve të të dhënave gjeohapësinore, shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore dhe metadatave; detyrimet dhe

kompetencat e autoriteteve publike në lidhje me krijimin, aksesin dhe përdorimin e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore.

- Projektlligji për krijimin e fondit Shqipëria Dixhitale ose Projekti "Një nxënës një kompjuter", i cili synon nxitjen e përdorimit të teknologjive më të fundit nga rinia shqiptare. Nëpërmjet kësaj iniciative, Qeveria Shqiptare kërkon të krijojë stimuj social duke e bërë rininë shqiptare të ndihet e barabartë me atë të vendeve të rajonit dhe më tej. Gjithashtu, me anë të këtij projekti synohet zvogëlimi i hendekut dixhital (digital divide) që ekziston sot në Shqipëri.

Aktivitetet zbatuese

- Përgatitja e një Plani Veprimi për Internet më të sigurt. Lançimi i javës për Internet më të sigurt në bashkëpunim me MASH dhe me aktorë të tjerë.
- Organizimi i trajnim-eve për ngritjen e ndërgjegjësimit të një internet të sigurt në administratë dhe shkolla, në bashkëpunim me MASH.
- Tavolina të rrumbullakëta me përfaqësim të gjerë për konsultimin për miratimin e kodeve të etikës të miratuara nga Këshilli i Evropës në kuadër të luftës ndaj krimit kibernetik.
- Organizim i trajnimeve të stafit të AKSHI-t dhe MITIK –ës si dhe të institucioneve të tjera në fushën e shoqërisë së informacionit nëpërmjet seminareve, trajnim-eve të organizuara nga AKSHI në bashkëpunim me institucione të tjera.
- Kooperim me shoqatat dhe forumin e ICT.

Masat legjislative afatmesme

- Plotësimi i kuadrit ligjor për Interoperabilitetin në përputhje me praktikën e Bashkimit Europian për interoperabilitetin të zhvilluar sipas eEurope Action Plan dhe programit IDABC. MITIK ka ngritur grupin e punës.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Organizimi i aktiviteteve në zbatim të Planit të Veprimit për një Internet të sigurt, si: seminare me pjesëmarrje të grupeve të ndryshme të interesit, tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues të biznesit, shoqatave të IT-së, ministrive të ndryshme të lidhura, AKEP-in etj.
- Trajnim mbi çështje të ndryshme të shoqërisë së informacionit.
- Organizim i trajnimeve të stafit të AKSHI dhe institucioneve të tjera në fushën e shoqërisë së informacionit nëpërmjet seminareve, trajnimeve të organizuara nga AKSHI në bashkëpunim me institucione të tjera.
- Tryeza të rrumbullakëta me përfaqësim të gjerë për konsultimin e akteve ligjore-nënligjore të sipërpërmendura.

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.10.2.: Shoqeria e Informacionit

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015

Kostot totale e vlerësuar	5.400.000	8.400.000	4.400.000	8.400.000
Mbulohen nga buxheti i	5.400.000	8.400.000	4.400.000	8.400.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.10.3. POLITIKA AUDIO-VIZUALE

Objektivi strategjik

Liria e shprehjes me anë të mjeteve audiovizuale përfshin lirinë për ndërmarrje audiovizive, lirinë në përzgjedhjen e programeve në bazë të parimit të pavarësisë editoriale, si dhe lirinë në përzgjedhjen nga ana e individëve e programeve të dëshiruara.

Fusha e politikave audio-vizuale ka një rëndësi të veçantë në procesin e integrimit të vendit tonë në BE, për shkak të detyrimeve të rëndësishme që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Neni 102 Bashkëpunimi në fushën Audio-vizive" i MSA-së "përcakton ndërmjet të tjerash detyrimin për harmonizimin e legjislacionit audio-vizual me *Acquis*, si dhe përafrimin me politikat e BE-së, në lidhje me rregullimin e përmbajtjes së transmetimeve ndërkufitare. Gjithashtu, kërkohet që një kujdes i veçantë t'i kushtohet respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, në transmetimin e programeve nga operatorë të ndryshëm, tokësor, satelitorë, dhe kabllorë, si dhe hartimit të një strategjie kombëtare në fushën e medias audio-vizuale.

Ndryshimet e vrullshme të teknologjisë në fushën e medias, realiteti aktual i televizionit numerik në Shqipëri dhe nevoja për të përditësuar legjislacionin në fuqi në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane në këtë fushë, shërbejnë si një nxitje e fuqishme për të ndërmarrë hapat e duhur në krijimin e një ambienti dhe vizioni afatgjatë të qasjeve rregulluese në lidhje me procesin e rëndësishëm të kalimit në sistemin numerik.

Ky objektiv për fushën e medias elektronike do të realizohet nëpërmjet:

- Miratimin e një strategjie kombëtare në fushën e medias audiovizuale, fokusuar në rrugët dhe mënyrat e kalimit në sistemin numerik.
- Miratimi e një kuadri të ri ligjor, në përputhje të plotë me rregullat dhe praktikat më të mira evropiane dhe zbatimit të plotë të tij.
- Forcimit të kapaciteteve administrative dhe teknike të autoritetit rregullator në fushën e medias elektronike.

Situata aktuale

Mjedisi audiovizual aktual në Shqipëri është mjaft i pasur (numërohen rreth 56 radio, 90 televizione analoge, 64 kabllore, 5 rrjete satelitore). Kjo është bërë e mundur nëpërmjet procedurave e kritereve ligjore të licencimit relativisht jo kufizuese, por edhe politikës liberalizuese që ka ndjekur autoriteti rregullator. Nga ana tjetër, edhe kufizimet e pronësisë në radio dhe televizione që parashikon legjislacioni në fuqi janë një tjetër faktor që garantojnë këtë lloj pluralizmi. Veçantia shqiptare qëndron në faktin se ekzistojnë më shumë televizione

lokale se sa radio lokale çka tregon kështu një interes të theksuar të qytetarëve shqiptarë për televizionin.
Aktualisht, janë dy stacione private televizive kombëtare (TV Klan dhe Top Channel), të cilat mbulojnë afërsisht rreth 65% të territorit të Shqipërisë si dhe dy stacione private radio kombëtare të radios, të cilat mbulojnë rreth 80% të territorit të Shqipërisë. Ndërkohë, që radio televizioni publik mbulon pjesën më të madhe të territorit: Radio Tirana (RT) mbulon 80,5 % të territorit, ndërsa Televizioni Shqiptar (TVSH), i cili transmeton në dy kanale, mbulon 73% dhe në këtë kuptim është i vetmi televizion kombëtar.

Transmetimet numerike në Shqipëri, zënë fill që në korrik 2004. Edhe pse kjo situatë është zhvilluar jashtë çdo kuadri ligjor, televizioni numerik tokësor përbën tashmë një realitet në Shqipëri. Operatorët e transmetimeve numerike tokësore, përfshirë operatorët me shtrirje të konsiderueshme në territorin e Shqipërisë, realisht janë faktorë përcaktues për transmetimin numerik në Shqipëri, ndaj për nga aktivitetet dhe njohuritë, zënë një pozicion të pamohueshëm në procesin e kalimit në numerik në Shqipëri.

Ligji bazë ku mbështetet veprimtaria e radios dhe televizionit publik e privat është Ligji nr. 8410, "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili megjithë ndryshimet e shumta që ka pësuar, nuk i përgjigjet mjaftueshëm zhvillimeve të shpejta teknologjike që ndodhin në fushën e medias audiovizive si dhe konvergjencës së shërbimeve të ofruara në rrjetet e komunikimeve elektronike. Një sërë çështjesh shumë të rëndësishme nuk kanë gjetur rregullim në këtë ligj, ku një ndër çështjet më të rëndësishme është transmetimi numerik.

Deri në vitin 2007, Shqipëria nuk ka pasur të parashikuar në asnjë akt ligjor funksionimin e transmetimeve numerike. Ndërkohë që në vend ishte ngritur dhe funksiononte një transmetues që operonte në fushën e transmetimeve numerike (DIGITALB), i cili vepronte pa asnjë bazë ligjore dhe i palicencuar nga KKRT. Në maj 2007, miratohet Ligji nr. 9742, datë 28.05.2007, "Për Transmetimet Numerike në Republikën e Shqipërisë", i cili kishte si qëllim për të rregulluar funksionimin e transmetimeve numerike në Republikën e Shqipërisë.

Me gjithë risitë që sjell, ky ligj është konsideruar i pamjaftueshëm për të rregulluar sektorin e mediave audiovizive dhe për të garantuar suksesin e kalimit në numerik në Shqipëri. Procesi i dixhitalizimit në Shqipëri, i cili duhet të realizohet ashtu sikundër edhe vendet e tjera të rajonit, jo vetëm si përmbushje e detyrimeve ndërkombëtare por edhe si nevojë e zhvillimeve të medias, është një nga arsyet kryesore që ka sjellë nevojën për një kuadër të ri ligjor mbi shërbimet audiovizive.

Kalimi në procesin e dixhitalizmit kërkon një kuadër të ri ligjor që t'i përshtatet ndryshimeve teknologjike dhe, në të njëjtën kohë, të jetë i harmonizuar me legjislacionin Evropian, veçanërisht, me detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja. Për këtë arsye, janë duke u hartuar dy dokumente bazë: (1) Strategjia e kalimit nga transmetimet analoge në dixhitale, dhe (2) Projektligji "Për mediat me zë dhe figurë në Republikën e Shqipërisë".

Strategjia e kalimit nga transmetimet analoge në dixhitale, qëllimi i të cilit është përcaktimi i masave politiko-ekonomike dhe tekniko–organizative për realizimin e kalimit nga

transmetimet analoge në dixhitale. Ajo synon zbatimin e kalimit në transmetimet dixhitale në mënyrë të plotë dhe efektive, si dhe arritjen e rezultateve sa më pozitive nga ky kalim.
Dokumenti është përgatitur nga Komiteti *ad hoc* për strategjinë e kalimit nga transmetimet analoge në dixhitale, ngritur me Urdhër të Kryeministrit nr. 77, datë 02.06.2009 (i ndryshuar), dhe pritet të miratohet së shpejti. Ky dokument është hartuar pas një këshillimi të gjerë publik dhe bashkëpunimi me një numër sa më të gjerë të mundshëm të aktorëve të interesuar.

Projektligji "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", ndodhet në përfundim të procesit, hartimit dhe miratimit të tij nga Kuvendi i Shqipërisë. Ky projektligj ka për qëllim rregullimin e fushës nëpërmjet një ligji të vetëm, në përputhje me standardet europiane dhe ato ndërkombëtare, si dhe, në krahasim me legjislacionin ekzistues, sjell ndryshime, plotësime dhe përmirësime në fushën e rregullimit të transmetimeve të medias elektronike. Projektligji synon të ketë përafrim të plotë me rekomandimet e Këshillit të Europës dhe me aktet komunitare në lidhje me këtë fushë, duke përgatitur kalimin e Shqipërisë në transmetimet numerike. Ai vendos parimin e rregullimit mbi bazën e asnjanësisë teknologjike. Fusha e zbatimit të projektligjit përfshin transmetimet lineare dhe ato jolineare në përputhje me direktivën AVMSD dhe në frymën e direktivave të rrjeteve elektronike të komunikimeve. Ai përfshin, gjithashtu, edhe shërbimet e reja dhe të mbrojtura të programeve etj.

Kalimi në sistemin numerik kërkon kapacitete të mjaftueshme institucionale për të menaxhuar dhe zgjidhur problemet dhe çështjet që hasen si pasojë e zhvillimeve teknologjike në fushën e medias, si dhe për përballimin e sfidave që mbart ky proces. Aktualisht, që burimet njerëzore, teknike dhe financiare të autoritetit rregullator mbeten të kufizuara.

Nevoja e pasjes së një administrate efiçente, si dhe forcimi i kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), është pjesë e dialogut BE-Shqipëri, në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në funksion të saj, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit miratoi vendimin nr. 199, datë 30.06.2011 "Për miratimin e projekt-strukturës, organikës dhe numrit të punonjësve të administratës së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit", e cila është dërguar për miratim, pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Vlen të theksohet se, ndryshimet e paraqitura në propozim, synojnë të adresojnë problematikat të cilat janë hasur gjatë veprimtarisë së përditshme të institucionit, dhe nuk kanë për qëllim një adresim të thellë dhe afat-gjatë të forcimit të kapaciteteve administrative të institucionit. Ndryshimet e thella strukturore, në një linjë me filozofinë rregullatore të vendeve të Bashkimit Evropian, do të realizohen pas miratimit të kuadrit të ri ligjor në fushën e medias elektronike. Kompetencat dhe detyrat e KKRT-së, sipas një ligji të ri, do të kërkojnë edhe nevojën e përcaktimit të një strukture të re të institucionit, që do të mund t'i përshtatej atyre.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë" (Fletorja Zyrtare: Viti 1998, nr 24; Data e botimit: 20-10-1998), i cili është ndryshuar me Ligjin nr. 8655 datë, 31.07.2000, "Për disa Ndryshime në Ligjin nr. 8410, datë, 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë" (Fletore zyrtare: nr 24, datë 07.08. 2000,); Ligjin nr. 8794, datë 10.05.2001, "Për disa Ndryshime në Ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar" (Fletore zyrtare: nr 34, datë 15.06.2001); Ligjin nr. 9016, datë 20.02.2003, "Për disa Ndryshime në Ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar", (Fletore zyrtare: nr 18, datë 21.03. 2003); Ligjin nr. 9124 datë 29.07.2003, "Për disa shtesa në Ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar", (Fletore zyrtare: nr 71, datë 19.08.2003); Ligjin nr. 9531, datë 11.05.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar", (Fletore zyrtare: nr. 65, datë 28.06.2006); Ligjin nr. 9677, datë 13.01.2007, "Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar", (Fletore zyrtare: nr. 2, datë 14.01.2007); Ligjin nr. 9962, datë 21.07.2008, "Për një shtesë në Ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar" (Fletore zyrtare: nr. 125, datë 01.08.2008), si dhe ka përafrim të pjesshëm me aktet kryesore të *BE-së*, që rregullojnë fushën e medias dhe shërbimeve me zë dhe pamore, si Direktiva 2002/19/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 7 Mars 2002, mbi aksesin në, dhe ndërlidhjen (interkoneksionin) e, rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe faciliteteve që lidhen me to (Direktiva e Aksesit), 32002L0019, Gazeta Zyrtare nr. 108, seria L e datës 24.04.2002, fq. 7–20; Direktiva 2002/20/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 7 Mars 2002, mbi autorizimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (Direktiva e Autorizimit), 32002L0020, Gazeta Zyrtare nr. 108, seria L e datës 24.04.2002, fq. 21–32; Direktiva 2002/21/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë. 7 Mars 2002, mbi një kuadër të përbashkët rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva e Kuadrit), 32002L0021, Gazeta Zyrtare nr. 108, seria L e datës 24.04.2002, fq. 33–50; Direktiva 2002/22/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë. 7 Mars 2002, mbi shërbimin universal dhe të drejtave të përdoruesit lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva e Shërbimit Universal), 32002L0022, Gazeta Zyrtare nr. 108, seria L e datës 24.04.2002, fq. 51–77; Direktiva e Komisionit 2002/77/KE, datë. 16 Shtator 2002, mbi konkurrencën në tregjet e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, 32002L0077, Gazeta Zyrtare nr. 249, seria L e datës 17.09.2002, fq. 21-26.
- Ligji nr. 9742, datë 28.05.2007 "Për Transmetimet Numerike në Republikën e Shqipërisë". (Fletorja Zyrtare: Viti 2007, nr. 74, DATE 20.06.2007). Ky ligj ka përafrim të pjesshëm me aktet komunitare të *aqcuis*, të përmendura më sipër për Ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, të ndryshuar, si dhe me Direktivën 97/36/KE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 30 Qershor 1997, e cila ndryshon Direktivën e Këshillit 89/552/KEE "Mbi koordinimin e disa dispozitave të rregulluara me ligj, rregullore apo veprim administrativ në Shtetet Anëtare në lidhje me ndjekjen e aktiviteteve të transmetimit televiziv ("Direktiva e Televizionit pa Kufij), 31997L0036, Gazeta Zyrtare nr. 202, seria L e datës 30.07.1997, fq. 60–70)
- Ligjin nr. 8525, datë 09.09.1999 "Për Ratifikimin e Konventës Evropiane për Televizionin Ndërkufitar**" (**Fletore zyrtare: Viti 1999, nr 26, datë 18.10.1999)

- Ligji nr. 9335, datë 16.02.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin ndryshues të Konventës Europiane për Televizionin Ndërkufitar" **(**Fletore zyrtare: Viti 2004, nr. 109, datë 12.01.2005)
- Ligjin nr. 9851, datë 26.12.2007, "Për ratifikimin e Akteve finale të konferencës rajonale të radiokomunikacioneve për planifikimin e shërbimit të transmetimit numerik tokësor në pjesë të rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekuencës 174-230 mhz dhe 470-862 mhz (rrc-06) dhe të akteve finale të konferencës rajonale të radiokomunikacioneve për rishikimin e marrëveshjes së Stokholmit, 1961 (rrc-06 rev. st 61). (Fletore zyrtare: nr 187, datë 24.01.2008).

Struktura Institucionale

Organi rregullator për rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë radiotelevizive në Republikën e Shqipërisë është Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i krijuar në vitin 1999, si organizëm i pavarur që vepron në bazë e për zbatim të Ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

KKRT-ja përveç shtatë anëtarëve të saj, ka një administratë, e cila realizon gjithë veprimtarinë e nevojshme përgatitore e administrative në shërbim të Këshillit. Struktura e institucionit propozohet nga KKRT-ja dhe miratohet nga Kuvendi. Funksionimi i brendshëm i KKRT-së, procedurat e vendimmarrjes dhe zbatimi i tyre, hartuar sipas dispozitave në fuqi, propozohen nga Kryetari dhe miratohen nga Këshilli.

Me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 184, datë 19.05.2008 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të punës të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit" është miratuar struktura ekzistuese e KKRT-së. Në bazë të kësaj strukture, numri i përgjithshëm i punonjësve është 49 (dyzet e nëntë), ndërkohë që KKRT-ja përbëhet nga: Drejtoria e Programeve, Drejtoria Teknike, Drejtoria Juridike dhe Licencave, Drejtoria e Financës, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.

KKRT gëzon një sërë kompetencash që mundësojnë ushtrimin e rolit rregullator në fushën e transmetimeve radio e televizive (Ligji nr. 8410, neni 7, dhe Ligji nr. 9742). Detyra e KKRT-së është aplikimi korrekt, proporcional e jodiskriminues i këtyre kompetencave, që kanë të bëjnë kryesisht me administrimin e spektrit të frekuencave; miratimin e akteve nënligjore në këtë fushë; dhënien dhe heqjen e licencave; zbatimin e sanksioneve përkatëse ndaj shkelësve të dispozitave të legjislacionit në fuqi, etj.

Pranë KKRT-së funksion edhe Këshilli i Etikës, si organ këshillimor, anëtarët e të cilit emërohen nga KKRT-ja për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë riemërimi jo më shumë se një herë. Objekti i punës së Këshillit të Etikës është sensibilizimi i opinionit publik për të përgjegjësuar entet radiotelevizive publike dhe private që të realizojnë normat morale dhe etike në programet e tyre, nëpërmjet mbikëqyrjes së programeve radiotelevizive publike e private që kanë të bëjnë sidomos me shfaqjet e keqpërdorimit të dhunës, seksit dhe të dinjitetit.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet, hartimi dhe miratimi i një strategjie kombëtare për kalimin në sistemin numerik si dhe të një kuadri të ri ligjor me qëllim rregullimin e veprimtarisë së transmetimeve me zë dhe figurë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me standardet demokratike të funksionimit të medias elektronike.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Projektvendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e Strategjisë "Për kalimin nga transmetime analoge në atë numerike". Ky projektakt lidhet me ratifikimin e akteve finale të Konferencës Rajonale të Radio Komunikacioneve (RCC 06), e cila është miratuar me Ligjin nr. 9851, datë 26.02.2007.
- Miratimi i projektligjit "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", ku do të përfshihet edhe rregullimi i transmetimeve numerike. Projektligji synon të arrijë një përafrim të plotë me Direktivën AVMSD (Shërbimet për mediat audiovizive) 2010/13/KE. Në të njëjtën kohë, projekt-ligji bën përafrim të plotë me kërkesat e paketës së Direktivave për komunikimet elektronike në lidhje me transmetimet radio televizive në veçanti me kërkesat e Direktivës kuadër, 2002/21/KE e amenduar me Direktivën 2009/140/KE; Direktivës së autorizimit, 2002/20/KE e amenduar me Direktivën 2009/140/KE Direktivës së aksesit 2002/19/KE e amenduar me Direktivën 2009/140/KE, dhe Direktivës së shërbimit universal 2002/22/KE e amenduar me Direktivën 2009/136/KE. Projektligji bën përafrim të plotë të Direktivës së Aksesit të Kushtëzuar 98/84/KE.

Aktivitetet zbatuese

- Forcimi i kapaciteteve administrative të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, nëpërmjet propozimit të një strukture të re pranë Kuvendit të Shqipërisë.
- Pjesëmarrja në strukturën që do të ngrihet për organizimin dhe mbikëqyrjen e procesit të kalimit në sistemin numerik.
- Organizimi i fushatës sensibilizuese për informimin e publikut në kuadër të kalimit në transmetimet numerike.
- Përgatitja e Planeve të frekuencave për fazën e parë për krijimin e rrjetit numerik të RTSH-së dhe rrjeteve numerike të operatorëve privatë kombëtarë.
- Përgatitja e Planeve të frekuencave për rrjetet e tjera pas lirimit të frekuencave nga transmetimet analoge dhe riplanifikimit të frekuencave për lirimin e spektrit të dividendit numerik.
- Organizmi i takimeve dhe konferencave për mënyrat e detajuara të kalimit në transmetimet numerike për secilin operator analog ekzistues, afatet e zbatimit të "ishujve numerikë" dhe penalitetet për moszbatimin e tyre.
- Zbatimi i projektit "Televizioni Dixhital i Evropës Juglindore *(SEE Digi TV)*", brenda Programit të Bashkëpunimit Ndër-nacional të Evropës Jug-lindore, të financuar nga Bashkimi Evropian.

Aktivitetet zbatuese

- Propozimi i masave për mbulimin e abonentëve të largët që merrnin më para sinjal analog dhe që mund të mbeten jashtë shërbimit gjatë kalimit në transmetimet numerike. (Kompozimi i buketave satelitore me programet ekzistuese analogë) .
- Fillimi i zbatimit të "ishullit të parë numerik" (Allotmenti Tiranë-Durrës).
- Implementimi i "ishujve numerikë" pasues duke zbatuar hap pas hapi metodologjinë e aplikuar në implementimin e "ishullit" të parë.
- Zbatimi i plotë i angazhimeve që rrjedhin nga Strategjia e kalimit në sistemin numerik.
- Përmirësimi i sistemit të monitorimit të mediave elektronike në të gjithë territorin e vendit.

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.10.3.: Politika Audio-Vizuale

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**0**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i shtetit	0	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.11. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

3.11.1. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

Zhvillimi rural

Objektivi Strategjik

Qëllimi kryesor i politikave të zhvillimit rural në Republikën e Shqipërisë është të kontribuojë për një zhvillim të barabartë të të gjitha rajoneve rurale në Shqipëri, të përmiresojë cilesinë e jetës në zonat rurale, të reduktojë varferinë si dhe nxitjen e zhvillimit të integruar e të qëndrueshëm rural dhe diversifikimin (zhvillimin e aktiviteteve ekonomike jo bujqësore).

Ky qëllim synohet të arrihet nëpërmjet:

Bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së duke u fokusuar në zona prioritare lidhur me Acquis Communautaire në fushën e bujqësisë. Bashkëpunimi duhet veçanërisht të synojë modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë shqiptare dhe të sektorit të agro-industrisë duke u mbështetur në përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me atë të praktikave, rregullave dhe standardeve Komunitare. (Neni 95 të MSA-së)
Forcimit të kooperimit për një zhvillim rajonal dhe lokal, me objektiv kryesor, kontribuimin në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazisë rajonale. Vëmendje e veçantë do t'i jepet ngritjes së mjeteve implementuese të Planit të Veprimit te Zhvillimit Rural në përputhshmëri me BE- në.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në bashkëpunim me Ministritë e Linjës ka përgatitur Strategjinë e Zhvillimit Rural, e cila është aprovuar nga Keshilli i Ministrave me Vedim Nr. 774 datë 14.11.2007. Është aprovuar dhe Ligji nr. 9817 datë 22.10.2007 "Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural". Nëpërmjet Strategjisë së Zhvillimit Rural, do të synohet qe politikat sociale, ekonomike e mjedisore të implementimit të saj të kenë karakter zonal, rajonal e global.

Ngritja e Strukturave Operative të IPARD në MBUMK: Autoriteti Menaxhues (Drejtoria e Zhvillimit Rural) është ngritur me Urdher të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit , Nr. 15 datë 21.01.2010 "Për një ndryshim në urdhërin e ministrit Nr. 207, datë 23.06.2009, Për miratimin e strukturave përgjegjëse për zbatimin e Instrumentit të Para-zgjerimit të Zhvillimit Rural (IPARD)". Agjensia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) është ngritur me VKM nr. 1443, datë, 31.10.2008 "Për ngritjen e agjensisë së pagesave".

Strategjia Ndersektoriale e Zhvillimit Rural ka si prioritet nxitjen e zhvillimit të integruar e të qëndrueshem rural dhe diversifikimi (zhvillimi i aktiviteteve ekonomike jo bujqësore).

MBUMK-ja ka përgatitur Strategjinë Nder-sektoriale të Zhvillimit Rural të vëndit, si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, e cila do të shërbejë si udhërrëfyes për Proçesin e Integrimit të vëndit drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian.
Një sërë aktivitetesh në kuadër të Zhvillimit Rural janë praktikisht duke u implementuar nga Qeveria, shpeshherë si projekte të veçanta dhe të pavarura, nga dikaster apo aktor të tjetër.

Nëpërmjet dy dokumentave të Strategjive të përmendura me lart është siguruar baza ligjore për mbështetjen publike të bujqësisë dhe zhvillimit rural për herë të parë në vëndin tonë si nga buxheti i shtetit ashtu dhe nga donatorë të tjerë. Nëpërmjet këtyre dokumentave është përafruar 75 % e legjislacionit të Bashkimit Europian. Janë ngritur strukturat e programit IPARD, Autoriteti Menaxhues dhe Agjensia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) në përputhje me rregulloret e Bashkimit Europian për implementimin e komponentit të V të programit IPA (IPARD).

Dy janë strukturat kyçe për zbatimin e Legjislacionit të Bashkimit Europian:

- Autoriteti Menaxhues, i cili është përgjegjës për programimin e masave mbështetëse të zhvillimit rural si dhe drejtimin e proçesit të monitorimit dhe raportimi sipas rregullave të përcaktuara.
- Ngritja e Agjensisë për kryerjen e funksionit të pagesave si instrument financiar për IPARD, i cili do të zbatojë programin kombëtar të mbështetjes së zhvillimit rural dhe programin IPARD për zhvillimin rural.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 9817, datë 22 /10/ 2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural, Ky ligj si në mekanizmin dhe në drejtimet e tij, mbështet implementimin e tre Rregulloreve bazë të Këshillit të Europës për Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP): Rregullore e Keshillit (EC) nr. 1234/2007 22 Tetor 2007 mbi krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve bujqësore dhe mbi dispozita për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve bujqësore dhe mbi dispozita të veçanta për disa produkte bujqësore; Rregullore e Keshillit (EC) nr. 1782/2003 e 29 shtatorit 2003 që vendos rregullat për skemat e mbështetjes direkte nën politikën bujqësore dhe që vendos skema mbështetje të caktuara për fermerët; Rregullore e Keshillit (EC) nr. 1290/2005 e 21 Qeshorit 2005 mbi financimin e Politikës së Përbashkët Bujqësore.

Struktura institucionale

Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucioni vartës Agjencia e Pagesave, është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e Politikave të Zhvillimit Rural Kombëtar dhe atë Evropian (IPARD). Aktualisht me ndryshimin e strukturave të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit Drejtoria e Politikave Rurale përbehet dhe kryen funksionet si me poshtë :

- Sektori i Programimit të Zhvillimit Rural, kryen funksionin e hartimit të programeve kombetare dhe atë IPARD;

- Sektori i Analizës, Monitorimit dhe Vlerësimit të Politikave, realizon funksionet e monitorimit dhe atë të vlerësimit dhe;
- Sektori i Publikimit dhe Koordinimit, kryen funksionin e koordinimit dhe të publikimit të programit.

Aktivitete zbatuese afatshkurter

- Ngritja e kapaciteteve në Ministrinë e Bujqësisë dhe Agjensinë e Pagesave për zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit Rural me mbështetje të Projektit IPA 2008 "Ngritja e kapaciteteve për implementimin e Strategjisë së Zhvillimit Rural".
- Përfundimi i paketave akredituese për Autoritetin Menaxhues dhe Agjensinë IPARD, kryerja e vetëvlerësimeve dhe dorëzimi pranë Zyres së NAOs.
- Kryerja e aktivitetit te përputhshmërisë së paketës së akreditimit nga një kompani e jashtme si edhe përfshirja e rekomandimeve të tyre.
- Marrja e besimit (Conferral of Management), nga Komisioni Europian për implementimin e programit IPARD.
- Ndjekja e monitorimit të programit IPARD like dhe IPARD.
- Ngritja e Komitetit Kombëtar të Monitorimit për IPARD.
- Pregatitja e Raporteve vjetore të raportimit.

Aktivitet zbatuese afatmesme

Harmonizim me i madh i aktiviteteve në zonat rurale, për të zbutur nivelet e varferisë rurale nëpërmjet :

- Rritjes së punësimit dhe rritjes së të ardhurave nëpërmjet aktiviteteve bujqësore dhe jobujqësore;
- Përmiresimi i infrastruktures rurale, si rruget, tregjet rurale, uji i pijshem etj.
- Ulja e migrimit rural dhe krijimi i marredhenieve me të ngushta të komunitetit rural
- Zhvillimi i strategjive për zhvillim rural, diversifikimit të aktiviteteve të fermës dhe rritjes së konkurrueshmerisë në bujqësi.
- Ngritja e kapaciteteve të stafit teknik të Shërbimit Ekstensiv (agronome, veterinere, zooteknik) për të asistuar në hartimin e projekteve për mbështetjen e fermerëve nëpërmjet pagesave direkte.
- Angazhimi i trupave teknik për çertifikimin e aktiviteteve të kërkuara sipas legjislacionit Shqiptar në filimin e investimit dhe Standarteve Europiane në fundin e investimeve.
- Pregatitja e Programit post 2013 IPARD, sipas udhëzimeve të Komisionit Europian ku mund të përfshihen edhe masa të tjera, bazuar në argumentat reale si edhe në negocimet me BE-në.

3.11.2. TOKA BUJQËSORE, ADMINISTRIMI DHE MBROJTJA E SAJ

Objektivi Strategjik

Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore si komponenti bazë i zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor është përcaktuar si një nga qëllimet strategjike të Strategjisë Sektoriale të Bujqësisë dhe Ushqimit (SSBU), të miratuar për periudhën 2007-2013.

Në përmbushje të këtij qëllimi, objektivat strategjikë më kryesor janë:

- Konsolidimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nëpërmjet verifikimit të bazueshmërisë të titujve të pronësisë të lëshuara në të gjithë periudhën e privatizimit të tokës.
- Përmirësimi i politikave të administrimit të tokës në përshtatje me tipet e pronësisë, nëpërmjet përgatitjes së një kuadri ligjor adeguat, monitorimit të politikave të përdorimit të tokës në pronësi private dhe shtetërore, qëndrueshmërisë së kategorive të resurseve të tokës dhe ndryshimit të tyre vetëm me proçedura ligjore.
- Përcaktimi i rrugëve dhe modeleve më efektive për konsolidimin e tokës dhe zgjerimin e madhësisë së fermave, nëpërmjet zbatimit të një projekti-pilot të konsolidimit, të mbështetur nga FAO-si dhe hartimit të një srategjie kombëtare për këtë qëllim.
- Krijimi i një Sistemi Informacioni mbi Tokën (LIS), në përshtatje me dy tipat e pronësisë dhe, integrimin e tij në GSI, nëpërmjet zbatimit të një program të veçantë. Monitorimi i zhvillimit të tregut të tokës dhe adaptimi i një legjislacioni që stimulon dinamizmin e tij.
- Mbrojtja e fondit të tokës bujqësore nga dëmtime të shkaktuara nga faktorë natyrorë dhe njerëzorë, nëpërmjet rritjes së angazhimit të strukturave të ngarkuara nga ligji për këtë qëllim.

Situata Aktuale

Analiza e situatës aktuale

Shqipëria aktualisht disponon 695 000 ha tokë bujqësore, që zë rreth 24% të territorit të saj. Nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore 561 000 ha ose 80% janë në pronësi private, ndërsa 134 000 ha ose 20% janë në pronësi shtetërore. Transformimi i së drejtës së pronësisë, nga tokë në pronësi shtetërore në tokë në pronësi private, shënon një ndër arritjet më të mëdha në kuptim të madhësisë së objektit mbi të cilën është vepruar ashtu dhe të subjekteve pjesmarrës në këtë reformë.
Nga privatizimi i tokës bujqësore kanë përfituar 445 mijë familje bujqësore, me një mesatare prej 1.2-1.3 ha/familje. Të gjitha këto familje (subjekte) që kanë marrë tokë janë pajisur me dokumentin e pronësisë (titullin e pronësisë) të emërtuar "Akti i marrjes së tokës në pronësi". Për regjistrimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, ashtu si dhe të drejta të tjera reale për pasuritë e paluajtshme të bazuara në dokumentet ligjore, me një ligj të veçantë (nr.7843, datë 13.7.1994), në çdo rreth të vendit janë krijuar zyrat Vendore të Regjistimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP). Sistemi i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (SRPP), për regjistrimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore bazohet tek parcela e pasurisë. SRPP-

deri në vitin 2006 ka funksionuar në kuadër të një projekti të veçantë dhe është menaxhuar nga Njësia e Menaxhimit të Projektit të Sistemit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (NMP-SRPP). Veprimtaria kryesore e kësaj njësie ka konsistuar në kryerjen e Regjistrimit Fillestar të Pasurive të Paluajtshme . Territori i vendit, për efekt të organizimit të punës për Regjistrimin Fillestar, është ndarë në 2920 zona kadastrale rurale (bujqësore). Aktualisht rezulton që Regjistrimi Fillestar të jetë kryer në 2392 zona kadastrale rurale ose 82% e totalit të tyre. Në vitin 2006, me një vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave (nr.159, datë 21.3.2006), veprimtaria e Regjistrimit Fillestar të Pasurive të Paluajtshme ka kaluar në varësi të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP).

Ndryshimi i karakterit të pronësisë dhe së drejtës së pronësisë mbi tokën, e kanë bërë të domosdoshme edhe ndryshimin e mënyrave të administrimit të saj, që konsistojnë në këto drejtime kryesore:

- Monitorimin e politikave të përdorimit të tokës;
- në pronësi private, e lidhur kjo veçanërisht me përdorimin dhe shfrytëzimin e fondit të tokës.

Shfrytëzimi i tokës bujqësore nëpërmjet kultivimit të bimëve në ‘to si dhe shtimi i sipërfaqeve të mbjella ka rezultuar me rritje progressive. Megjithatë, sipërfaqja e tokës bujqësore, në pronësi private, që nuk kultivohet, ende është e madhe. Për këtë qëllim është miratuar dhe ka hyrë në fuqi ligji nr. 10 263, datë 8.4.2010, “Për përdorimn dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara” si dhe disa akte nënligjore në zbatim të tij, që synojnë vënien në qarkullim ekonomik të tokave që nuk shfrytëzohen nga pronarët e tyre, privatë, nëpërmjet dhënie së tyre me qira nga komunat ose bashkitë për subjekte të interesuara, pa cënuar të drejtën e pronësisë mbi tokën. Toka bujqësore, si në pronësi private ashtu dhe në pronësi shtetërore, nuk lejohet të kalojë në pronësi për persona fizikë dhe juridikë të huaj.

Monitorimi i qëndrueshmërisë së kategorive të resurseve të tokës dhe të ndryshimit të tyre sipas proçedurave ligjore.

Nisur nga fakti se vendi ynë ka një normë toke të ulët për çdo banorë, me qëllim të ruajtjes së fondit të tokës bujqësore, është miratuar ligji nr. 10 257, datë 25.3.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8752, datë 26.3.2001“Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, si një instrument me rëndësi për administrimin e tokës. Në zbatim të ndryshimit ligjor të sipërcituar, janë miratuar dy VKM të rëndësishme: nr.655, datë 28.7.2010 dhe nr. 121, datë 17.2.2011.

Konsolidimi i tokës dhe zgjerimi i madhësisë së tokës në fermën bujqësore.

Privatizimi i tokës bujqësore si dhe kriteret që u përdorën për këtë qëllim, kanë sjellë për pasojë një fragmentarizim të madh të saj. Aktualisht toka bujqësore në pronësi private disponohet nga rreth 445 000 pronarë. Çdo pronar e disponon këtë sipërfaqe në 4-5 parcela (ngastra) pronësie. Në shkallë vendi numërohen rreth 2.2 milion ngastra toke bujqësore. Ky fragmentarizim i madh i tokës në pronësi private përbën një pengesë serioze për një zhvillim intensiv të bujqësisë. Për të përcaktuar rrugët dhe modelet më efektive për kosolidimin e

tokës dhe të zgjerimit të madhësisë së tokës për çdo fermë në kushtet e vendit tonë, në vitin 2010 MBUMK në bashkëpunim me FAO-n dhe mbështetjen e saj ka nisur një projekt- pilot për konsolidimin e tokës në Komunën Tërbuf të Lushnjes.

- Krijimin e Sistemit të Informacionit mbi tokën (LIS) në përshtatje me dy tipe të pronësisë,
  dhe integrimin e tij në Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS). Në vitet 2009-2011 ky sistem është realizuar në rreth 60 000 ha, në kuadër të Programit "Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore", me mbështetje nga buxheti i shtetit.
- Zhvillimin e tregut të tokës, i cili në dy vitet e fundit (2010-2011) ka qenë më dinamik. Kështu gjatë vitit 2010 janë regjistruar mbi 3600 transaksione, që kanë pasur për objekt një sipërfaqe toke mbi 830 ha. Vlera e përgjithshme e transaksioneve të realizuara në këtë vit është 37.8 milon €. Amendimet e kryera në ligjin nr. 8752/2001, e kanë përmirësuar mënyrën e evidentimit dhe cilësinë e informimit për transaksionet e tokës bujqësore.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, "për tokën", i ndryshuar (fz nr.5,1991, fq.224).
- Ligji nr.8312, datë 26.3.1998 "për tokat bujqësore të pandara" (fz nr.9, prill 1998, fq.321).
- Udhëzim i këshillit të ministarave nr.3, datë 16.5.2007 "për proçedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara" (fz.nr.65, qershor 2007, fq.1755).
- Ligji nr. 8053, datë 21.12.1995, "për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", të ndryshuar (fz.nr.27, dhjetor 1995, fq 1179).
- Ligj nr.8318, datë 1.4.1998 "për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore" ,(fz. nr.10, prill 1998,fq 341).
- Ligji nr. 10263, datë 8.4.2010,"për përdorimn dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara" dhe disa akte nënligjore në zbatim të tij (fz.nr.51, 2010).
- Ligj nr.8337, datë 30.4.1998 "për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave" (fz. nr.12, maj 1998, fq.442).
- Ligji nr.8752, datë 26.3.2001 "për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar, (fz.nr.14, 2001, fq.400).
- VKM nr.655, datë 28.7.2010 "për rregullat dhe proçedurat e ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës" (fz. nr.124, shtator 2010).
- VKM nr.121,datë 17.2.2011 "për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki" (fz.nr.23, mars 2011, fq 839).
- Ligj nr.9244, datë 17.6.2004 "për mbrojtjen e tokës bujqësore" (fz.nr.49, korrik 2004, fq.3375).
- VKM nr.80, datë 28.1.2005 "për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore" (fz. nr.8, 2005).
- Ligj nr.9948, datë 7.7.2008 "për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar (fz nr.122, korrik 2008, fq.5387).

Struktura institucionale

Institucionet dhe sektorët e angazhuar në administrimin dhe mbrojtjen e tokës janë si më poshtë:

- Sektori i Administrimit të Tokës në MBUMK që funksionon në përbërje të Drejtorisë së Tokave dhe Ujrave (DTU) në MBUMK;
- Inspektoriati Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës (ISHMT), që funksionon në përbërje të DTU-së;- Drejtoritë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) në varësi administrative të qarqeve dhe në varësi teknike të MBUMK-së. Pranë tyre funksionojnë sektorët e administrimit të tokës dhe inspektoriatet e Mbrojtjes së Tokës (IMT), me 112 punonjës gjithsej.
- Zyrat e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZMMT) në komuna (bashki).

Këto struktura ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbi bazën e dispozitave ligjore të përcaktuara në ligjin nr.8752/2001 dhe nr.9244/2004 si dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre. Mbrojtja e tokës ka në objekt harmonizimin e së drejtës së pronësisë mbi tokën me detyrimin për mbrojtjen e saj dhe të funksioneve natyrore që ajo përmbush.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përcaktimi më i qartë i kompetencave të institucioneve të përfshira në realizimin e fushes se menaxhimit te tokes bujqesore, përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë te BE-se dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Amendimi i ligjit nr.8752, datë 26.3.2001 " për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar,
- Amendimi i VKM vkm nr.655,datë 28.7.2010, "për rregullat dhe proçedurat e ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës".
- Amendimi i udhëzimit të këshillit të ministarave nr.3, datë 16.5.2007, "për proçedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara".

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat legjislative afatmesme janë si vijon:

- Përgatitja dhe miratimi i ligjit "Për konsolidimin e tokës. (Viti 2014)

Aktivitetet zbatuese

Për adresimin e prioriteteve do të ndërmerren aktivitetet zbatuese të mëposhtme:

Administrimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore, duke:

- azhornuar informacionin për gjendjen e fondit të tokës ;
- ndjekur kalimet dhe ndryshimet e kategorive të resurseve ;
- monitorimi i proçedurave të vlerësimit të kategorive të tokës;
- vijimi i krijimit i dokumentacionit të LIS, me rreth 20 000 në çdo vit.
- vijimi i verifikimit të bazueshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën.

Zhvillimi i tregut të tokës, duke:

- konsoliduar dokumentacionin e pronësisë;
- duke kontrolluar zbatimin e ligjshmërisë.

Mbrojtja e tokës, duke:

- siguruar funksionimin e ISHMT-së në MBUMK;
- siguruar funksionimin e IMT-ve në qarqe.
- Evidentimi e përpunimi i të dhënave dhe rezultateve të projektit pilot për konsolidimin e tokës, në Komunën e Tërbufit (2012).
- Hartimi i strategjisë Kombëtare për konsolidimin e tokës (2013).
- Forcimi i kapaciteteve institucionale të strukturave të administrimit të tokave në qarqe, me programe të veçanta trajnimi.

3.11.3. PRODHIMI BIMOR

Objektivi Strategjik

Qëllimi kryesor i politikave në fushën e prodhimit bimor është orientimi dhe sigurimi i një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të integruar të bimëve bujqësore, me qëllim rritjen e prodhimit sipas standardeve të Be-së për plotësimin e: i.) nevojave të tregut të brendshëm nëpërmjet rritjes së gamës së produkteve, rendimentit të tyre dhe reduktimit të sezonalitetit të prodhimit; ii). Rritjes së konkurrueshmërisë në treg, çka do të reduktojë importin dhe do të mundësojë eksportin e produkteve shqiptare në Rajon dhe më gjerë; iii.) rritjes së kapaciteteve përpunuese të produkteve bujqësore me synim përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat urbane dhe rurale të vendit.

Bazuar në nene t 71, 76 dhe 95 të MSA-së për fushën e prodhimit bimor, objektivi kryesor është përafrimi gradual i legjislacionit Shqiptar me atë Komunitar si edhe zhvillimi i strategjive për përdorimin e tokës, për tregun e tokës, zhvillimin rural, diversifkimin e aktiviteteve fermere dhe rritjen e konkurrueshmërisë në bujqësi. Neni 95 në veçanti përcakton se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian do të ketë si synim modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë shqiptare dhe sektorit agro-industrial, si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave me rregullat dhe standardet komunitare.
Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Forcimit të sistemit institucional të strukturave të prodhimit bimor dhe sistemeve të kontrollit që kanë lidhje me të;
- Përforcimit të kapaciteteve laboratorike dhe të kontrollit në sigurinë e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- Forcimit të kapaciteteve të kërkimit shkencor lidhur me krijimin dhe regjistrimin e varieteteve të reja në fushën e prodhimit bimor;
- Përmirësimit të legjislacionit për fushën e prodhimit bimor dhe zbatimit të tij.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Ligji Nr. 8880, datë 15.04.2002 "Për të drejtat e seleksionerit të bimëve", përafron pjeserisht acquis e Bashkimit Evropian per fushen. Për këtë ligj ka punuar grupi i punës si dhe është shfrytëzuar ardhja e një eksperti të fushës në kuadrin e Programit shumë-përfitues 2a nën komponentin e parë – ndihma për tranzicionin dhe zhvillimin institucional, Instrumenti i Asistencës së Para-Pranimit (IPA) 2008, program i cili adresohet për Shqipërinë, Kroacinë, Bosnje-Hercegovinën, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi, Serbinë, Kosoven dhe Turqinë dhe është i vlefshëm për vitet 2009 dhe 2010. (Sistemi i Komunitetit mbi të Drejtën e Varietetit të Bimëve (CPVR) është forma ekskluzive e të drejtave të pronësisë industriale të Komunitetit ose varietetet e bimëve). Afati i këtij programi është vazhduar dhe për vitet 2011-2012 dhe në këtë kuadër, është mundësuar ardhja e një eksperti të fushës. Ky amendim i ligjit do të realizohet brenda vitit 2012, pasi grupi i punës ka menduar për një asistencë teknike të avancuar për vetë rëndësinë që mbart ky Ligj në fushën e Sektorit të Prodhimit Bimor. Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e të drejtave të personave që seleksionojnë, zbulojnë dhe zhvillojnë varietete të reja bimore. **Ligji "Për shoqëritë kooperativiste Bujqësore",** është Ligj i ri, bazuar në Rregulloren e Këshillit, No 1435/2003(EC), datë 22 Korrik 2003 mbi "Statutin e Shoqërive Kooperativiste Europiane". Aktualisht është hartuar projektligji dhe është në procedura miratimi.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- P/L "Për disa ndryshime në ligjin nr 8880, datë 15.04.2002, "Për të drejtat e seleksionerit të bimëve" bazuar në Rregulloren nr. 2100/94 EC, datë 27.7.1994 "Për mbrojtjen e varieteteve bimore në KE", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 15, datë 13.05.2002, faqe 454. Shkalla e përafrimit : e pjesshme
- Ligji i ri "për shoqëritë kooperativiste bujqësore", bazuar në Rregulloren No 1435/2003(EC), datë 22 Korrik 2003 mbi "Statutin e Shoqërive Kooperativiste Europiane". Shkalla e përafrimit : e pjesshme

Ligjet dhe aktet e tjera që nuk transpozuan acquis te BE-se:

- Ligji nr. 7929, datë 11.5.1995 " Për mbrojtjen e drufrutoreve";
- Ligji nr. 9395, datë 12.5.2005 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për mbrojtjen e varieteteve të reja të bimëve".

Struktura institucionale

Institucionet përgjegjëse për Sektorin e Prodhimi Bimor janë Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucionet e varësisë së saj si Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Institucionet të tjera të përfshira në prodhimin bimor janë Ministria e Mjedisit, Ministria e Arsimit dhe institucionet e varësisë së tyre. Funksionet politikëbërëse realizohen nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK). Si pjesë e MBUMK funksionon Drejtoria e Politikave të Prodhimit Bujqësor (DPPB). DPPB është përgjegjëse për përcaktimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit të nevojshëm sektorin e prodhimi bimor sidomos për: i.) rritjen e prodhimit bujqësor; ii.) rritjen e nivelit të konkurrueshmërisë së prodhimeve bujqësore në treg brenda dhe jashtë vendit me qëllim minimizimin e importit dhe rritjes së eksportit; iii.) dhe në mbrojtje të interesave të fermerëve, duke krijuar kushte bashkëpunimi nëpërmjet nxitjes së kooperimit midis tyre.

Sektori i Prodhimit Bimor varet nga Drejtoria e Politikave të Prodhimit Bujqësor dhe kjo e fundit nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Sektori i Prodhimit Bimor, përbëhet nga tre specialistë dhe një përgjegjës sektori. Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve (ESHFF), sipas ligjit nr. 10416, 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor” që është pjesë substanciale e punës për të drejtat e seleksionerit të bimëve, pasi në përbërje të tij ka Sektorin e Testimit të Varieteteve, i cili provon në kushtet agroklimatike të vendit, të gjitha materialet mbjellëse që kërkohet të tregëtohen në Shqipëri konform skemave dhe standarteve të OECD. Organizimi dhe funksionimi i ESHFF-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) funksionon në varësi të Ministrit, sipas përcaktimit të bërë në legjislacionin në fuqi për ushqimin. QTTB-të janë strukturat përgjegjëse për kërkimin, krijimin dhe regjistrimin e varieteteve të reja të bimëve; Universiteti Bujqësor i Tiranës (Banka Gjenetike), është gjithashtu pjesë ne kërkimit në këtë fushë.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij. Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Përmirësim i ligjit nr. 8880,datë 15.4.2002 "Për të drejtat e seleksionerit të bimëve", bazuar në Rregulloren nr. 2100/94 EC, datë 27.7.1994 “Për mbrojtjen e varieteteve bimore në KE”
- Ligji i ri për Shoqëritë Kooperativiste Bujqësore”, bazuar në Rregulloren nr. 1435/2003(EC), datë 22 Korrik 2003 mbi “Statutin e Shoqërive Kooperativiste Europiane”.

Aktivitetet zbatuese

- Trajnimi i ekspertëve të fushës lidhur me legjislacionin te BE-se, për mbrojtjen e varieteteve;
- Asistencë teknike lidhur me rregullat e regjistrimit të varieteteve të reja;

- Organizimi i seminareve dhe workshop-eve për diskutimin e draftligjit të ri (të amenduar);
- Miratimi i Ligjit të amenduar brenda vitit 2012;
- Ngritja e strukturës për mbrojtjen e varieteteve;

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatmesme synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij. Masat legjislative afatmesme janë si vijon:

- VKM ne zbatim te ligjit të ri "Për shoqëritë kooperativiste bujqësore" dhe të Ligjit të amenduar "për të drejtat e seleksionerit"

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Trajnimi i mëtejshëm lidhur përditësimin e rregullave komunitare për të drejtat e varietetit;
- Funksionimi i institucioneve përgjegjëse për regjistrimin e varieteteve të reja;
- Promovimi i vazhdueshëm i kooperativave bujqësore;
- Nxitjen e organizimit të tregjeve nga vetë shoqëritë kooperativiste për të realizuar komunikimin konsumatorëve direkt me fermerët dhe të fermerëve midis tyre;

3.11.4. BLEGTORIA

Objektivi Strategjik

Sektori i Prodhimit Blegtoral në funksion të detyrimeve në zbatim të nenit 95 të MSA-së si dhe në mbështetje të realizimit të programit të Qeverisë ka si qëllim kryesor të analizojë identifikojë dhe hartojë politika, strategji sektoriale në funksion të zhvillimit të blegtorisë, të drejtojë dhe mbështesë në shkallë vendi e lokale rritjen dhe plotësimin gjithnjë e më mirë të kërkesave dhe nevojave të tregut me produkte blegtorale nëpërmjet përdorimit racional të burimeve dhe futjes së teknikave dhe teknologjive të reja në prodhim.

Ky qëllim synohet të realizohet nëpërmjet:

- Hartimit dhe përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së, në kuadër të politikave të zhvillimit dhe integrimit nëpërmjet propozimit, hartimit dhe zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore që veprojnë në fushën e blegtorisë.
- Hartimi i politikave dhe programeve për zhvillimin e blegtorisë në aspektet e mbarështimit të kafshëve e përmirësimit racor të tyre, si dhe të prodhimit.
- Përgatitjes së kuadrit ligjor të përshtatshëm për zbatimin e politikave të zhvillimit në sektorin e blegtorisë.
- Forcimit të sistemit të monitorimit dhe zbatimit të masave në lidhje me standardet zooteknike të mbarështimit të kafshëve.

- Nxitja dhe konsolidimi i sistemeve të qëndrueshme të prodhimit blegtoral me ferma të specializuara, komplekse industriale të prodhimit të vezëve dhe të mishit, si dhe të prodhimit të ushqimeve.
- Miradministrimi i burimeve gjenetike shtazore të kultivuara dhe autoktone në blegtori.
- Përmirësimit të sistemit të kontrollit, të cilësisë dhe të tregtimit të materialeve racore, në përputhje me standardet.
- Vlerësimi i tendencave në zhvillimin e blegtorisë nëpërmjet studimeve, analizave mbi strukturën dhe përcaktimi i prioriteteve në zhvillimin e prodhimit blegtoral.

Situata Aktuale

Sektori i Prodhimit Blegtoral e ushtron veprimtarinë e tij në bazë Ligjit Nr. 9426, datë 06. 10. 2005 "Për Mbarështimin e Blegtorisë" (i ndryshuar me ligjin Nr. 9864, datë 28. 01. 2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9426, datë 06. 10. 2005 "Për Mbarështimin e Blegtorisë", si dhe me ligjin Nr. 10137, datë 11. 05. 2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë". Ligji Nr. 8702, datë 1. 12. 2000 "Mbi identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe fermave blegtorale", Ligjit Nr. 8411, datë 01. 10. 1998 "Për Ushqimet e Blegtorisë" (i ndryshuar dhe me ligjin Nr. 10137, datë 11. 05. 200 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë) si dhe një sërë aktesh nënligjore. Strukturat që merren me zbatimin e legjislacionit janë Sektori i Prodhimit Blegtoral në Drejtorinë e Politikave të Prodhimit Bujqësor në MBUMK, Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë si dhe Departamentet e Blegtorisë në Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Fushë - Krujë dhe Korçë. Personat e angazhuar në zbatimin e legjislacionit janë 15 persona. Politikat aktuale të Sektorit të Prodhimit Blegtoral janë fokusuar kryesisht në rritjen e numrit të kafshëve (gjedhë dhe të imta) brenda fermës blegtorale me synim konsolidimin e fermave dhe orientimin e këtyre fermave drejt tregut. Gjithashtu, mbështetja e prodhimit të mëshqerrave të racës duke synuar krijimin dhe nxitjen e shoqatave racore si dhe krijimin e tregut vendas për kafshët me vlera racore të identifikuara.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji Nr. 9426, datë 06. 10. 2005 "Për mbarështimin e Blegtorisë" i ndryshuar me Ligjin Nr. 9864, datë 28. 01. 2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9426, datë 06. 10. 2005 "Për Mbarështimin e Blegtorisë", dhe me ligjin Nr. 10137, datë 11. 05. 2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 8702, datë 1. 12. 2000 "Mbi identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe fermave blegtorale" Direktiva 92/102/EEC, datë 27 Nëntor 1992 "Mbi identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve"- Përafrim i pjesshëm. (Nr. celex 31992L0102) Fletore zyrtare Nr. 47 datë 01. 12. 2000.
- Ligji Nr. 8411, datë 1. 10. 1998 " Mbi Ushqimin e Blegtorisë" (i ndryshuar me ligjin Nr. 10137, datë 11. 05. 2009) Direktivën 82/471/EEC, datë 30 Qershor 1982, "Lidhur me disa produkte që përdoren në të ushqyerit e kafshëve" (Nr. celex 31982L0471), Direktiva

93/74EEC, datë 13 Shtator 1993 "Mbi ushqimet e kafshëve për qëllime specifike të të ushqyerit (Nr. celex 31993L0074)". Përafrim i pjesshëm.

- Urdhër Ministri Nr. 1, datë 10. 03. 2000, për miratim e rregullores "Për ushqimin e kafshëve". Direktiva Nr. 93/74/EEC, datë 13 Shtator 1993 "Mbi ushqimet e kafshëve për qëllime specifike të ushqyeri"; (Nr. celex 31993L0074) Direktiva Nr. 70/524/EEC 23 Nëntor 1970 "Mbi adititivët ushqimor" (Nr. celex 31970L0524). Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër Ministri Nr. 12, datë 12. 11. 2002, për miratim Rregullores "Për disa ndryshime dhe shtesa ne Rregulloren Nr. 1, datë 10.03.2000 "Për ushqimin e kafshëve". (referimi sipas pikës 4).
- Urdhër Ministri Nr. 4, datë 10. 03. 2000, për miratim Rregullores "Për marrjen dhe konservimin e mostrës për kontrollin zyrtar të ushqimit të kafshëve". Direktiva Nr. 70/373/EEC 20 Korrik 1970 " Mbi futjen e metodave komunitare për kampionet dhe analizat në kontrollet zyrtare të ushqimit për kafshë (Nr. celex 31970L0373) "Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër Ministri Nr. 5, datë 10. 03. 2000 për miratim Rregullores "Për përcaktimin e nivelit maksimal të lejuar për substancat e dëmshme, mbetjet e pesticideve dhe substancave të tjera shtesa në ushqimin për blegtorinë", Direktiva Nr. 70/524/EEC datë 23 Nëntor 1970) "Mbi aditivët në ushqimet për kafshë" (Nr. celex 31970L0524; Direktiva Nr. 82/471/EEC datë 30 Qershor 1982 "Mbi disa produkte të përdorur në të ushqyerit e kafshëve" (Nr. celex 31982L0471). Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër Ministri Nr. 6, datë 10. 03. 2000 për miratim Rregullores "Për tregtimin e ushqimit të përzier blegtoral" Direktiva Nr. 77/101/EEC23 datë 23 Nëntor 1976 "Mbi marketimin e ushqimeve për kafshë" (Nr. celex 31977L0101); Direktiva Nr. 92/87/EEC datë 26 Tetor 1992 "Që vendos një listë jo përjashtuese ingredientësh kryesore të përdorur dhe tregtuar për përgatitjen e ushqimeve të përdorura për kafshët dhe kafshët e shoqërimit" (Nr. celex 31992L0087). Direktiva Nr. 82/471/EEC datë 30 Qershor 1982 "Mbi disa produkte të përdorura në të ushqyerit e kafshëve". (Nr. celex 31982L0471). Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër i Ministrit Nr. 614, datë 12. 12. 2002, " Për kryerjen e analizave te ushqimit blegtoral". Direktiva Nr. 82/471/EEC datë 30 Qershor 1982 "Mbi disa produkte të përdorura në të ushqyerit e kafshëve" (Nr. celex 31982L0471). Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër i Ministrit Nr. 373, datë 23. 08. 2002, "Për të parandaluar importin e miellit, mishit, kockave dhe gjakut për ushqimin e kafshëve". Direktivën 82/471/EEC e datës 30 Qershor 1982 "Mbi disa produkte të përdorura në të ushqyerit e kafshëve". (Nr. celex 31982L0471). Përafrim i pjesshëm.
- VKM Nr. 143, datë 11. 3. 2004, "Për anëtarësimin e MBUMK në Komisionin Ndërkombëtar për regjistrimin e kafshëve (ICAR). (fletore zyrtare Nr. 18 faqe 916) Direktiva 92/102/EEC e datës 27. Nëntor 1992 "Mbi identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve" dhe rregulloren 820/97/EEC e datës 21 prill 199721 "Që vendos një sistem identifikimi dhe regjistrimi për kafshët gjedhë dhe në lidhje me etiketimin e mishit dhe produkteve të mishit" (Nr. celex 31997R0820). Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër i Ministrit Nr. 4, datë 9. 09. 2008 për miratim e rregullores mbi "Standardet minimum të mbarështimit të kafshëve shtëpiake (Standardet minimum të mbarështimit të gjedhit- viçave)", Direktiva 91/629/EEC, (Nr. celex 31991L06290) datë 19 Nëntor 1991 mbi standardet minimale të mbrojtjes së viçave. Përafrim i pjesshëm.

- VKM Nr. 1708 datë 29.12.2008 “Për zbatimin e programeve për ruajtjen in-situ të racave autoktone të bagëtive të imta” (fletore zyrtare Nr. 208 faqe 11176) Vendimi i referohet Rregullores së komisionit (KE) Nr. 1974/2006 (Nr. celex. 32006R1974) të 15 Dhjetorit 2006 që përcakton me hollësi rregullat për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1698/2005 mbi mbështetjen për zhvillimin rural nga Fondi Bujqësor Evropian për zhvillimin rural (EAFRD). Përafrim i pjesshëm.
- VKM Nr. 436, datë 2. 06. 2010 “Për disa ndryshime në vendimin Nr. 1634, datë 17. 12. 2008, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të mënyrës së mbështetjes financiare, për ruajtjen e rezervës gjenetike të racës autoktone të buajve” (fletore zyrtare Nr. 85 faqe 4453) Vendimi i referohet Rregullores së komisionit (KE) Nr. 1974/2006 të 15 Dhjetorit 2006 (Nr. celex. 32006R1974) që përcakton me hollësi rregullat për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1698/2005 mbi mbështetjen për zhvillimin rural nga Fondi Bujqësor Evropian për zhvillimin rural (EAFRD). Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër i Ministrit Nr. 3, datë 5. 08. 2008, për miratim e rregullores “Mbi Certifikimin e kafshëve Racë Pastër të Specieve të Gjedhit, Dhenve, Dhive, Kuajve, Derrave Racë Pastër dhe Hibride, Spermës, Ovulave dhe Embrioneve të tyre” - të miratuar nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (Fletore zyrtare Nr. 162, datë 22. 10. 2008) përafron keto direktiva: Direktiva 2005/379/EC e 17 Maj 2005 (Nr. Celex 31986D0404) “Mbi certifikatën e prejardhjes dhe veçanërisht për racat e pastra të llojit gjedhë, spermën e tyre, vezët dhe embrionet”; Direktiva 90/258/EC, datë 10 Maj 1990 “Për certifikatën zooteknike për racat e pastra të llojit dhen e dhi, spermën e tyre, ovulat dhe embrionet”. (Nr. Celex 31990D0258); Direktiva 89/503/EEC datë 18 Korrik 1989 “Për certifikatën zooteknike për racat e pastra të llojit derr, spermën e tyre, ovulat dhe embrionet”. (Nr. Celex 31989D0503); Direktiva 89/506/EEC, datë 18 Korrik 1989 “Për certifikatat e derrave hibrid” (Nr. Celex 31989D0506); Vendim 96/79, datë 16 Dhjetor 1996, “Për certifikatën zooteknike për kuajt e regjistruar spermën e tyre, ovulat dhe embrionet”- Nr. celex. 31996D0079). Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër i Ministrit Nr. 1, datë 4.03.2009 per miratim e rregullores “Mbi Standardet për Mbarështimin e Derrave e Pulave Pjellëse” përafron pjesërisht keto direktiva: Direktiva 1999/74/EC, e 19 Korrik 1999 “Mbi standardet minimale të mbrojtjes së pulave pjellëse”.(Nr. celex. 31999L0074); Direktiva 91/630/EEC, e 19 Nëntorit 1991 “Mbi standardet minimale të mbrojtjes së derrave”- Nr. celex. 31991L0630); Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër i Ministrit Nr. 2 datë 22. 07. 2008 për miratim rregullores “Për riprodhimin e kafshëve të fermës, prodhimin dhe tregtimin e materialeve racore" perfron keto direktiva: Direktiva 77/504/EEC datë 25 Korrik 1997 mbi mbarështimin e kafshëve racë pastra të llojit gjedhë. (Nr. celex 31997L0504); Vendim 96/509/EC, datë 18 Korrik 1996 që përcakton kërkesat zooteknike edhe prejardhjen për importin e spermës së kafshëve. (Nr. celex 31996D0509);Vendim 96/510/EC: datë 18 Korrik 1996 që përcakton certifikatën zooteknike e të prejardhjes për importin e kafshëve racë pastër, spermës, vezëve dhe embrioneve.(Nr. celex. 31996D0510); Direktiva 89/361/EEC, datë 30 Maj 1989 lidhur me mbarështimin e racave të pastra të llojit dele e dhi-Nr. celex. 31989L0361); Direktiva 91/174/ EEC datë 25 mars 1991, që përcakton kërkesat zooteknike dhe të prejardhjes për marketimin e kafshëve racë pastra. (Nr. celex. 31991L0174). Përafrim i pjesshëm.

- Urdhër i Ministrit Nr. 422, datë 17. 12. 2009 për miratim e rregullores "Mbi kushtet për regjistrimin e riprodhuesve racë - pastër të specieve të gjedhit, dhenve, dhive, kuajve, derrave racë- pastër dhe hibridë në librin gjenealogjik" perfron: Vendim 84/419/EEC: datë 19 Korrik 1984 që përcakton kriteret për futjen e kafshëve në regjistrin e tufës- (Nr. celex. 31984D0419); Vendim 89/502/EEC datë 18 korrik 1989 që përcakton kriteret për futjen e kafshëve në regjistrin e tufës për derrat racë pastër. Vendim 89/505/EEC datë 18 Korrik 1989 që përcakton kriteret për futjen e derrave hibridë në regjistër - (Nr. celex. 31989D0502, 31989D0505); Vendim 90/255/EEC:datë 10 Maj 1990 që përcakton kriteret për futjen e kafshëve racë pastër të llojeve dele e dhi në regjistrin e tufës (Nr. celex 31990D0255); Direktiva 96/78/EC, datë 10 Janar 1996, që përcakton kriteret për futjen e kuajve në regjistrin e tufës për qëllime racore. 90/255/EEC, Direktiva 96/78/EC3. (Nr. celex 31996D0078, 31990D0255) - Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër i Ministrit Nr. 83, datë 16. 03. 2010, për miratim e rregullores "Për organizatat e mbarështimit të kafshëve"perafron: 84/247/EEC,Vendim i Komisionit 27 prill 1984 që përcakton kriteret për njohjen e organizatave të mbarështuesve dhe shoqata që mbajë apo krijojnë librat gjenealogjik për riprodhuesit racë-pastër të specieve të gjedhit (Nr. celex. 31984D0247); 90/254/EEC: Vendim i Komisionit i 10 maj 1990 që përcakton kriteret për miratimin e organizatave të mbarështuesve dhe shoqata të cilat mbajnë dhe krijojnë librat gjenealogjik për riprodhuesit racë-pastër të specieve të deleve dhe dhive. (Nr. celex. 31990D0254); 89/501/EEC Vendim i Komisionit i 18 korrik 1989 që përcakton kriteret për miratimin dhe mbikëqyrjen e shoqatave të mbarështuesve dhe organizatat e mbarështimit të cilat krijojnë dhe mbajnë librat gjenealogjik për derrat racë-pastër. (Nr. celex. 31989D0501); 89/504/EEC: Vendim i Komisionit i 18 korrik 1989 që përcakton kriteret për miratimin dhe mbikëqyrjen e shoqatave të mbarështuesve, organizatave, dhe ndërmarrjeve private që krijojnë dhe mbajnë regjistrin për derrat hibride. (Nr. celex. 31989D05047); 92/353/EEC:Vendim i komisionit i 11 qershor 1992 që përcakton kriteret për miratimin ose njohjen e organizatave dhe shoqatave që mbajnë ose krijojnë regjistrin e prejardhjes për kuajt e regjistruar. (Nr. celex. 31992D0353); 92/354/EEC: Vendim i Komisionit i 11 qershor 1992 që përcakton rregulla të caktuara për të siguruar koordinimin ndërmjet organizatave dhe shoqatave që mbajnë ose të krijojë regjistrin e prejardhjes për kuajt e regjistruar (Nr. celex. 31992D0354). Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër i Ministrit Nr. 300, datë 8. 10. 2010 për miratimin e rregullores "Për metodat e matjes dhe vlerësimit të prodhimit dhe tipareve të tjera si dhe metodat për vlerësimin e vlerave gjenetike të riprodhuesve racë-pastër të species së gjedhit" 2006/427/EC Vendim i komisionit i 20 qershorit 2006 që përcakto metodat e monitorimit të performancës dhe metodat për vlerësimin e vlerës gjenetike të riprodhuesve racë-pastër të species së gjedhit". (Nr. celex. 32006D0427)- Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër i Ministrit Nr. 333, datë 17. 11. 2010 për miratim e rregullores "Për metodat e matjes dhe vlerësimit të prodhimit dhe tipareve te tjera si dhe metodat për vlerësimin e vlerave gjenetike të riprodhuesve racë-pastër të dhenve dhe dhive". Vendim i komisionit 90/256/EEC i 10 majit 1990 që përcakto metodat e monitorimit te performancës dhe metodat për vlerësimin e vlerës gjenetike të riprodhuesve racë-pastër të species së dhenve dhe dhive". (Nr. celex. 31990D0256). Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër i Ministrit Nr. 332, datë 17. 11. 2010 për miratim e rregullores "Për metodat e matjes dhe vlerësimit të prodhimit dhe tipareve te tjera si dhe metodat për vlerësimin e vlerave gjenetike të riprodhuesve racë-pastër të derrave dhe derrave hibridë". 89/507/EEC

Vendim i komisionit i 18 korrikut 1989 që përcakto metodat e monitorimit te performancës dhe metodat për vlerësimin e vlerës gjenetike të riprodhuesve racë-pastër të derrave dhe derrave hibridë.” (Nr. celex. 31989D0507) - Përafrim i pjesshëm.

- Urdhër i Ministrit Nr. 303, datë 04. 11. 2011 për miratim e rregullores “Mbi standardet zooteknike të kafshëve riprodhuese racë- pastër të species së gjedhit”2009/157/EC Vendim i komisionit i 30 nëntorit 2009 ne lidhje “Mbi kafshët racë-pastër të species gjedh”.
- Urdhër i Ministrit Nr. 318 datë 14. 11. 2011 për miratim e rregullores “Mbi standardet zooteknike të kafshëve riprodhuese racë- pastër të species dhen dhe dhi” 89/361/EEC ” Vendim i komisionit i 30 majit 1989 ne lidhje me riprodhuesit racë- pastër te species dhen dhe dhi. (Nr. celex. 31989D0361). Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër i Ministrit Nr. 6, datë 09. 01. 2012 për miratim e rregullores “Mbi përcaktimin e kritereve për përdorimin e kafshëve racë-pastër të llojit gjedh për qëllime riprodhimi” 87/328/EEC Vendim i komisionit i18 qershorit 1987 mbi pranimin e kafshëve racë-pastër të llojit gjedh për qëllime riprodhimi. (Nr. celex. 31987L00328). Përafrim i pjesshëm.
- Urdhër i Ministrit Nr. 360, datë 27. 12. 2011 për miratim e rregullores “Mbi përcaktimin e kritereve për përdorimin e kafshëve racë-pastër të llojit dhen dhe dhi për qëllime riprodhimi”. 90/257/EEC Vendim i komisionit i10 majit 1990 Mbi përcaktimin e kritereve për përdorimin e kafshëve racë-pastër të llojit dhen dhe dhi spermës, ovulave dhe embrioneve të tyre [për qëllime riprodhim për qëllime riprodhimi. Përafrim i pjesshëm. (Nr. celex. 31990D0257).

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira ne realizimin e objektiva të blegtorisë janë:

Drejtoria e Politikave të Prodhimit Bujqësor në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit është autoriteti kompetent për ushtrimin e veprimtarive në fushën e blegtorisë nëpërmjet:

- Sektorit të prodhimit blegtoral
- Specialisteve të blegtorisë në drejtoritë Rajonale të Bujqësisë.
- Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore
- Shërbimit këshillimor publik dhe/ose privat

Sektori i Prodhimit Blegtoral është përgjegjës për zhvillimin e qëndrueshëm të Prodhimit Blegtoral në vend nëpërmjet hartimit të legjislacionit, strategjive, si dhe të politikave të zhvillimit dhe programeve të mbrojtjes, përmirësimit dhe ruajtjes së cilësive të burimeve gjenetike shtazore për të nxitur rritjen e prodhimeve blegtorale, krijimin dhe përhapjen e vlerave racore dhe ruajtjen e ndryshueshmërisë gjenetike të kafshëve të fermës. Sektori i Prodhimit Blegtoral, i përberë nga përgjegjësi i sektorit dhe 2 specialistë është përgjegjës për:

- Zhvillimin e strategjive dhe politikave për sektorin e blegtorisë
- Monitorimin, vlerësimin dhe rinovimin sistematik të politikave dhe strategjive të prodhimit blegtoral.

- Analizat e nevojshme për zhvillimin e politikave, hartimin e programeve për zbatimin e politikave të zhvillimit të blegtorisë, për mbarështimin e mirë të kafshëve,
- Hartimin dhe përafrimin e legjislacionit në fushën e blegtorisë
- Vlerësimin e progresit gjenetik për caktimin e rentabilitetit të racave, përcaktimin e prioriteteve për strategjinë e punës racore
- Identifikimin e resurseve gjenetike autoktone e të kultivuara dhe propozimin e masave mbrojtëse për to.
- Monitorimin dhe zbatimin e legjislacionit në drejtim të mbarështimit të kafshëve dhe të përmirësimit racor si dhe të mbrojtjes dhe zhvillimit të fondit gjenetik autokton si dhe zbatimit të masave në lidhje me standardet zooteknike të mbarështimit të kafshëve.

Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë (DRB) ushtrojnë aktivitetin e tyre 12 specialistë blegtorie (zooteknikë). Ky rrjet specialistësh blegtorie kontrollon dhe siguron:

- zbatimin e legjislacionit në fushën e blegtorisë.
- plotësimin e kushteve për mbarështimin e qëndrueshëm të kafshëve të fermës.
- përmirësimin racor.
- ushqimet dhe të ushqyerit e kafshëve.
- tregtimin e materialeve racore.

Shërbimi zooteknik privat funksionon në fushën e riprodhimit të kafshëve, ku ushtrojnë aktivitetin 480 teknikë (inseminatorë) të kualifikuar nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (shërbimi publik) dhe shërbimi privat (programi i të cilit miratohet nga MBUMK-ja).
Shërbimi Zooteknik Privat, që operon në ferma dhe stabilimente blegtorale dhe Organizata të mbarështimit të kafshëve, përfshin 14 zooteknikë.

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë - Krujë dhe Korçë janë struktura të transferimit të teknologjive në blegtori, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit QTTB Fushë-Krujë është Qendër e Referencës Kombëtare (QRK) për:

- Kontrollin e ushqimeve që përdoren në blegtori.
- Kontrollin e materialeve racore (spermë, vezë, embrione).
- QTTB-të realizojnë veprimtarinë e tyre në zbatim të politikave të zhvillimit të prodhimit blegtoral.

Shërbimi këshillimor është i përfshirë në strukturat e Drejtorive Rajonale të Bujqësisë ku operojnë 30 zooteknikë, të cilët veprojnë deri në nivel Komune.

Këshilli i Blegtorisë është organ që miratohet nga ministri për një periudhë 4 vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje në zbatim të nenit 73 të ligjit Nr. 9864, datë 28. 01. 2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9426, datë 06.10.2005 "Për Mbarështimin e Blegtorisë". Detyrat për funksionin e Këshillit të Blegtorisë janë:

1. Këshilli i Blegtorisë është organ këshillues i ministrit që mbulon fushën e blegtorisë

2. Këshilli i Blegtorisë jep mendime:
   - për politikat bujqësore , që rregullojnë fushën e blegtorisë;
   - për programet e zhvillimit afatgjatë;
   - për programet racore të paraqitura për miratim;
   - për raportet vjetore mbi veprimtaritë e kryera në kuadër të programeve racore;
   - për rregulloret e rëndësishme në fushën e blegtorisë;
   - për njohjen e racave autoktone;
   - për të ushqyerit dhe ushqimet e blegtorisë
   - për ndryshimet në/ose futjen e metodave të reja për parashikimet e vlerës racore dhe vlerësimin e kafshëve të racës

Masat legjislative afatshkurtra

Sektori i Prodhimit Blegtoral duke ju referuar angazhimeve që rrjedhin në zbatim të MSA, ka synuar të zbatojë një sërë politikash që kanë të bëjnë me ndërmarrjen e një sërë iniciativash ligjore në fushën e përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE-së.

Në masat legjislative afatshkurtër

- në hartimin pakets ligjore lidhur me standardet zooteknike të kafshëve riprodhuese racë-pastër si dhe në lidhje me përcaktimin e kritereve për përdorimin e kafshëve racë-pastër për qëllime riprodhimi që parashikon standardet zooteknike dhe kushtet për tregtimin e materialit racor si dhe kërkesat për përdorimin e kafshëve racë-pastër për qëllime riprodhimi, për çiftëzim natyror dhe/ose inseminim artificial si dhe përdorimin e spermës së tyre.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat legjislative afatmesme janë si vijon;

- Rregullore mbi përcaktimin e kritereve për përdorimin e derrave racë-pastër për qëllime riprodhimi përafron direktivën 90/118/EEC e 5 Marsit 1990 (celex 31990L0118).
- Rregullore mbi përcaktimin e kritereve për përdorimin e derrave hibride për qëllime riprodhimi përafron direktivën 90/119/EEC. e 5 Marsit 1990 (celex 31990L0119)
- Rregullore mbi standardet zooteknike të kafshëve riprodhuese racë – pastër të species derr; përafron direktivën 88/661/EEC, 19 Dhjetorit 1988 (celex 31988L0661)

Aktivitete zbatuese afatshkurtër

- Trajnim i stafit të specialistëve në qarqe, trajnim dhe asistencë teknike për stafin e sektorit të prodhimit blegtoral dhe të specialistëve të QTTB-ve në lidhje me legjislacionin zooteknik (2012).

- Takime dhe trajnime me fermerë, grupe të ndryshme interesi, shoqata racore me qëllim nxitjen dhe mbështetjen për krijimin e programeve racore në fushën e blegtorisë. Kërkesat për miratimin e programeve racore. (2012)
- Trajnime dhe takime të ndryshme me grupe interesi dhe fermerë me qëllim nxitjen dhe zbatimin e masave në lidhje me standardet zooteknike të mbarështimit të kafshëve të llojit Gjedhe dhe dhen (2012)
- Procedurat dhe metodat e mbajtjes së regjistrave dhe librave të racës (2012)
- Kushtet për tregtimin e materialeve racore (2012).

Iniciativat ligjore afatmesme

Masat legjislative afatmesme synojnë në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar në fushën e blegtorisë me atë komunitar si dhe përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional për zbatimin e tij.

Masat legjislative afatmesme janë:

- Rregullore mbi kushtet zooteknike e gjenealogjike që administrojnë tregtinë e kuajve që përafron direktivën 90/427/EEC 26 Qershorit 1990 (celex 31990L0427).
- Rregullore mbi kërkesat zooteknike dhe të prejardhjes për importin e kafshëve racë-pastër spermës, ovulave dhe embrioneve të tyre përafron vendim komisioni 96/509/EC e 18 Korrikut 1996 (celex 31996D0509).
- Rregullore Mbi certifikatën zooteknike dhe prejardhjen për importin e kafshëve racë pastër spermës, ovulave dhe embrioneve të tyre. Përafron vendim komisioni 96/510/EC amenduar 2004/186/EC e 18 Korrikut 1996 (celex 31996D0510).
- Rregullore Në lidhje me metodat për identifikimin e kuajve përafron rregullore e komisionit 504/2008/EEC e 6 Qershorit 2008 (celex 32008R0504).

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet zbatuese të mëposhtme:

- Trajnime dhe takime të ndryshme me grupe interesi dhe fermerë me qëllim nxitjen dhe zbatimin e masave në lidhje me standardet zooteknike të mbarështimit të kafshëve të llojit gjedhë dhe dhen (2013).
- Kërkesat për pranimin e kafshëve për qëllime racor (2013)
- Metodat për monitorimin e tipareve dhe vlerësimin e vlerave gjenetike (2013).
- Trajnime dhe takime të ndryshme me grupe interesi dhe fermerë me qëllim forcimin e sistemit të monitorimit dhe zbatimit të masave në lidhje me standardet zooteknike të mbarështimit të derrave dhe derrave hibridë (2013-2014).
- Procedurat dhe metodat e mbajtjes së regjistrave dhe librave të racës (2013).
- Kushtet për tregtimin e materialeve racore (2013).

- Kërkesat për pranimin e kafshëve për qëllime racore (2014).
- Metodat për monitorimin e tipareve dhe vlerësimin e vlerave gjenetike (2014).
- Organizimi i takimeve në qarqe me fermerë dhe përfaqësues të shoqatave me qëllim nxitjen dhe mbështetjen e fermerëve për ruajtjen in-situ të racave autoktone të bagëtive të imta me synim sigurinë e diversitetit gjenetik në mbarështimin e racave autoktone për mish dhe qumësht prej të cilave prodhohen produkte tipike shqiptare.(2013-2014).
- Forcimi i monitorimit në lidhje me zbatimin e legjislacionit për mbajtjen e dokumentacionit zooteknik nga shoqatat (2014-2015).

3.11.5. PRODHIMI ORGANIK BUJQËSOR

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucioneve të tjera me detyra në këtë fushë, është garantimi i rritjes së sasisë dhe cilësisë së prodhimit organik. Kjo jo vetëm për faktin e gjenerimit të eficencës ekonomike (rritje e të ardhurave) por edhe garantimit të rritjes së cilësisë së jetesës për konsumatorët. Nga ana tjetër prodhimi organik konsiderohet si avantazh i rritjes së mundësisë së eksportit në Rajon dhe me gjerë, duke mundësuar kështu rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare si dhe ndikuar në reduktimin e importit dhe rritjen e eksportit.

Po ashtu, neni 95 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian do të ketë si synim modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë shqiptare dhe sektorit agro-industrial, si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave me rregullat dhe standardet komunitare.

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Forcimit të sistemit institucional të sektorit të prodhimit organik (prodhim, tregtim, konsum) dhe sistemeve të kontrollit që kanë lidhje me të;
- Përforcimit të kapaciteteve në prodhimin organik për minimizimin e mbetjeve në mjedis;
- Përmirësimit të legjislacionit të prodhimit organik dhe zbatimit të tij.

Situata aktuale

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit në Strategjinë Sektoriale të Bujqësisë dhe Ushqimit 2007-2013, e ka konsideruar bujqësinë organike në fokus të veçantë të politikave bujqësore, bazuar kjo dhe në kuadrin e Planit të Veprimit të Bujqësisë Organike të hartuar po nga MBUMK (2006) ku janë identifikuar pesë fusha prioritare si bazë e zhvillimit të strategjisë së këtij sektori: i.) hartimi, konsolidimi dhe zbatimi i një politike kombëtare për bujqësinë organike, e cila të lejojë sinergji me institucionet përkatëse dhe politikat e tjera zhvillimore përkatëse; ii.) zbatimi i legjislacionit kombëtar për bujqësinë

organike dhe strukturimi i sistemit organik kombëtar; iii). strukturimi i zinxhirit të ofertës organike duke lehtësuar konvertimin në bujqësinë organike (midis fermerëve dhe përpunuesve) dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër, inkurajimin e zhvillimit të tregut për inputet dhe produktet organike; iv) mbështetjen e kërkimit shkencor, arsimit dhe shërbimit këshillimor në bujqësinë organike me qëllim që të zhvillohet dhe konsolidohet një sistem kombëtar njohurish për bujqësinë organike; v.) inkurajimi i integrimit të Shqipërisë në komunitetin organik ndërkombëtar dhe nxitja e rrjetëzimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Bazuar në faktin që Bujqësia Organike në Shqipëri funksionon prej mbi një dekade, duke u bërë një sektor me rëndësi të veçantë për ekonominë dhe eksportet bujqësore shqiptare, MBUMK, në mbështetje të saj, në vitin 2004, ka hartuar Ligjin. Nr. 9199, datë 26/02/2004 "Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve "Bio", ligj i cili është miratuar dhe zbatohet që nga ky vit (2004): botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 20/2004, datë 05/04/2004, Faqe:1045;

Ligji shqiptar Nr. 9199, datë 26/02/2004 "Për prodhimin, përpunimin, çertifikimin dhe tregtimin e produkteve "Bio", synon nxitjen e prodhimit organik në Shqipëri, krijimin e kuadrit ligjor të nevojshëm dhe përcaktimin e kushteve të prodhimit, përpunimit, transportit, çertifikimit dhe kontrollit të produkteve bujqësore dhe atyre ushqimore me prejardhje bimore ose shtazore, që prodhohen, përpunohen ose/dhe importohen e tregtohen si produkte "Bio".
Ky ligj rregullon ngritjen e Komisionit Shtetëror të Prodhimit Organik (KSHPO), përcakton kushtet specifike të prodhimit organik, jep leje të përkohshme për përdorimin e materialeve të palistuara në Anekse, përcakton kushtet për etiketimin e produkteve "Bio", procedurat e kundërvajtjeve administrative si dhe sanksionet që ndërmerren për to.

Në Strategjinë Sektoriale të Bujqësisë dhe Ushqimit (SSBU) 2007 – 2013), Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) synon që në vitin 2013, sipërfaqja organike në Shqipëri të arrijë 5%. Për këtë vlen të përmendet që prej vitit 2008 e në vazhdim, MBUMK nëpërmjet skemave mbështetëse në bujqësi, mbështet çertifikimin e produkteve bujqësore "Bio" nga bimët e kultivuara, duke bërë të mundur kështu rritjen e sipërfaqes bujqësorë të çertifikuar si dhe organizimin grupfermerëve të çertifikuar në grup. Numri i operatorëve organikë (fermat organike) aktualisht është 116 nga 61 që ishte në vitin 2009. Sipërfaqja totale e çertifikuar sipas të dhënave të agreguara (MBUMK dhe trupat private të çertifikimit) ka arritur në rreth 19 000 ha. Duke filluar nga viti 2010 të dhëna për produkte organike janë regjistruar për herë të parë dhe në Vjetarin Statistikor të MBUMK. Bazuar në rregulloret dhe direktivat e BE-së për vitin 2011 është plotësuar pyetësori për të dhënat lidhur me bujqësinë organike në statistikat zyrtare me të dhënat për fermat organike si për sipërfaqen ashtu dhe sipas kulturave (drejtimi i fermës);

Pyetësorët e Bujqësisë Organike janë futur në sistemin e regjistrimit të fermës, të dhënat e të cilit mblidhen dhe përpunohen dhe nga INSTAT.

Duke filluar nga viti 2001, projekte të ndryshme kanë ndihmuar në ngritjen dhe promovimin e bujqësisë organike në Shqipëri, ku më të rëndësishmit kanë qenë projekti Sustainable Agriculture Support in Albania (SASA) (2001 – 2011), zbatuar nga FiBL Zvicër; projekti

PAB-Interreg IIIA (2004 – 2007) (Projekt i Integruar për përhapje dhe asistencë teknike në zbatimin e metodave të prodhimit organik) zbatuar nga IAM-Bari; si dhe Bio-84/01 (Balkans provision for the Italian Partecipation in Stabilization, Reconstruction and Development of the countries of the Balkan area) për trajnimin e ekspertëve teknikë në bujqësinë organike, në mbështetje të zhvillimit rural dhe emergjencave të ushqimit në rajonin e Ballkanit. Bujqësia organike po përfiton nga aktivitete të financuara nga agjencitë dhe donatorë të huaj si Oxfam, GTZ, SNV, FAO, etj.

Projektet kanë ndihmuar në ngritjen dhe forcimin e shoqatave të prodhuesve dhe organizmit çertifikues, njohjen e metodave të prodhimit organik, përmirësimin e shërbimeve dhe strukturave teknike në mbështetje të zhvillimit të bujqësisë organike dhe promovimin e produkteve organike shqiptare në tregjet dhe panairet më të njohur lokalë dhe Europian.

Rezultat i kësaj ndihme është rritja e kapaciteteve prodhuese dhe tregtuese e produkteve organike brenda dhe jashtë vendit sidomos në prodhimin e vajit të ullirit organik ku "Shkalla" sh.p.k ka eksportuar në Zvicër, Kroaci, etj si dhe është renditur në vendin e 6-të ndër 100 vajrat më të mirë të listuar në Katalogun Botëror (2006). Po ashtu "Gjikondi" sh.p.k dhe "Musaj" sh.p.k janë vlerësuar me çmime kombëtare dhe ndërkombëtare për cilësinë e vajit të tyre organik. USAID ka qenë dhe është aktiv në promovimin e produkteve organike Shqiptare në panairet si 'BioFach" apo dhe atyre të organizuara në USA e vende të tjera Evropiane.

Ndër produktet që vijnë nga kultivimi, mund të renditim si më të rëndësishëm, ullirin, kryesisht për prodhim vaji, vreshtat për tavolinë dhe verë, perimet dhe frutat. Madhësia e fermave organike është më e lartë sesa mesatarja e Shqipërisë, përkatësisht 2,24 ha ndaj 1,2 ha që është mesatarja e fermës konvencionale.

Mbi 99% e produkteve që vijnë nga mbledhja spontane eksportohen në SHBA, Gjermani, Zvicër, Francë, Belgjikë, Lihtenshtein, Austri, Itali dhe vende të tjera si Bullgaria dhe Turqia. Megjithatë, tregu lokal për produkte organike është duke u zgjeruar sidomos në drejtim të përpunimit të tyre si "Xherdo" sh.p.k. gjithashtu është rritur intersi i grumbulluesve të këtyre bimëve spontane për certifikimin e terreneve ku rriten e kultivohen këto bimë.

Në Shqipëri operojnë disa shoqata, ku ndër më aktivet janë: BioAdria dhe SHBO, të cilat janë anëtare të IFOAM, për sektorin e fruta-perimeve, shoqata EPCA e bimëve mjekësore shqiptare dhe shoqata e prodhuesve të vajit të ullirit, (AOA).

Në bazë të nenit 4 të Ligjit 9199/2004 për bujqësinë organike, organizma çertifikues vendas dhe të huaj lejohen të ushtrojnë aktivitet çertifikues për fermat dhe operatorët që veprojnë në bujqësinë organike. Këta organizma duhet që më parë të jenë akredituar. Akreditimi i organizmave çertifikues kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), e cila është një organizëm kombëtar i akreditimit, i njohur nga qeveria për të vlerësuar në përputhje me standardet ndërkombëtare kompetencën teknike të organizmave të vlerësimit të konformitetit.

DPA operon në përputhje me Ligjin Nr. 9824, datë 01/11/2007, "Për Akreditimin e oganizmave të vlerësimit të konformitetit në RSH" dhe akreditimi nga DPA kryhet në

përputhje me standardet ndërkombëtare të vendosura nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO).

KSHPO, i ngritur pranë MBUMK, është organi shtetëror përgjegjës për zbatimin dhe administrimin e legjislacionit dhe sistemit të bujqësisë organike në Shqipëri. KSHPO kryen: njohjen së organizmave çertifikues dhe inspektorëve të prodhimit organik; regjistrimin të kërkesave të fermerëve për aplikim për tu futur në sistemin e prodhimit organik; mbikëqyrjen të aktivitetit vjetor të organizmave çertifikues; regjistrimit të njësive të prodhimit organik pas miratimit nga organizmi çertifikues i zgjedhur nga vetë ferma; publikimin e përditësuar të listës së emrave dhe adresave të njësive të prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve "Bio"; regjistrimin e subjekteve vendase dhe të huaja që eksportojnë dhe importojnë produkte "Bio"; pajisjen e këtyre subjekteve me çertifikatë që vlen vetëm për rastin e shqyrtuar; publikon logon e organizmave çertifikues; organizon kualifikimin dhe testimin e përvitshëm të inspektorëve; propozon modelet e formularëve që njësitë prodhuese, organizmat çertifikues dhe subjektet import/eksport duhet të plotësojnë; paraqet vendimet e marra për pranimin e veprimtarisë apo ndërprerjen e kontratave të bashkëpunimit për organizmat çertifikues dhe inspektorët si vendas dhe të huaj.

Ky Komision është krijuar si organ ndërinstitucional, dhe përbëhet nga 9 anëtarë, si dhe sekretariati i përbëhet nga 3 anëtarë. Sektori përgjegjës për veprimtarinë e bujqësisë organike në MBUMK është Sektori i Prodhimit Bimor me dy persona. Për më tepër, pesë Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), në varësi të MBUMK, dhe që mbulojnë gjithë territorin e Shqipërisë, kanë secila një person që punon direkt me bujqësinë organike, pra, në total 17 persona.

Në Ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009 " Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për liçensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë leja e përkohshme zëvëndësohet me autorizim i përkohshëm.
Bazuar në sa më sipër, sipas ligjit nr. 9199, datë 26.2.2004 " Për prodhimin, përpunimin, çertifikimin dhe tregtimin e produkteve bio ", neni 7, Komisioni Shtetëror i Prodhimit Organik (KSHPO) jep autorizim të përkohshëm për:

- përdorimin e materialeve të palistuara në anekset II e III të këtij ligji,
- përdorimin e materialeve me origjinë jobujqësore (ndihmesat teknologjike dhe shtesat) ose me origjinë bujqësore joorganike për përpunim, të palistuara në shkronjën "D" dhe "E" të aneksit II.

Organizmi i inspektim/çertifikimit Albinspekt, është operatori i parë dhe i vetëm, që siguron një shërbim inspektimi dhe çertifikimi të produkteve organike sipas Standardeve kombëtare, private dhe Evropiane (Ligji shqiptar 9199/2004, standardi privat BioAdria si dhe Rregullorja e BE Nr. 834/2007).

Albinspekt është një shoqëri aksionere private, e njohur nga KSHPO, si organizëm çertifikues në bazë të Ligjit shqiptar Nr. 9199/2004 për produktet "Bio" si dhe VKM Nr. 639, datë 14/05/2008 për regjistrimin e organizmave çertifikues si dhe nga DPA në Shqipëri. Albinspekt, gjithashtu, është akredituar gjatë vitit 2009 nga DGA (Deutsche Gesellshaft fur Akkreditierung GmbH) sipas normës Evropiane EN 45011/1998, për kryerjen e shërbimit të

çertifikimit të produkteve organike në fushat e prodhimit bimor dhe shtazor dhe të përpunimit. Roli kryesor i Albinspekt është sigurimi i shërbimit të inspektim/çertifikimit si dhe informacion lidhur me parimet dhe metodat e prodhimit organik.

Në Shqipëri, operojnë dhe 7 organizma të huaj çertifikimi si janë: ICEA, BCS Öko-GarantieGmbH, BioInspecta AG, CERES GmbH, Control Union Certifications B.V., IMO CH, IMC srl. Këto organizma çertifikues të huaj janë të njohur dhe akredituar për çertifikim të produkteve "bio" në vendet e tyre të origjinës. Organizmat çertifikues të huaj kryejnë çertifikim në bazë të Rregullores Nr. 834/2007 të BE, për prodhimin dhe etiketimin e produkteve organikë si dhe standardit amerikan për produktet organike (NOP).

MBUMK bashkëpunon me organizmin e çertifikimit "Albinspekt" dhe që nga viti 2010 është filluar regjistrimi i të dhënave për operatorët organikë on-line dhe ky bashkëpunim do të jetë në vazhdim;
Për vitin 2009-2011 është firmosur marrëveshje e bashkëpunimit (për fazën e tretë) midis MBUMK dhe projektit SASA (Sustainable Agriculture Support in Albania):" A bilateral project of Co-operation and development" lidhur me bujqësinë organike dhe përafrimin e legjislacionit në këtë fushë;
MBUMK po bashkëpunon me Ministritë e linjës dhe organizma të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare si Ministria e Mjedisit, IBB, ICI, CIHEAM, etj., lidhur me menaxhimin e mbetjeve dhe monitorimin e nitrateve në tokë si dhe për ngritjen e kapaciteteve institucionale për përafrimin e legjislacionit të BE-së;
Me zhvillimet e Sektorit të prodhimit organik, ka dalë si detyrë e domosdoshme amendimi i Ligjit Nr. 9199, datë 26/02/2004 "Për prodhimin, përpunimin, çertifikimin dhe tregtimin e produkteve "Bio", pasi ky Ligj është bazuar në Rregulloren e Këshillit (EC) Nr. 2092/91 e cila është amenduar sipas rregulloreve të mëposhtme:

- Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 834/2007, datë 28 Qershor 2007 "për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike si dhe shfuqizimin e Rregullores (EEC) Nr. 2092/91;
- Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 889/2008, datë 5 Shtator 2008 përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 834/2007 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike lidhur me prodhimin organik, etiketimin dhe kontrollin;
- Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 967/2008, datë 29 Shtator 2008 , Rregullorja e amenduar (EC) Nr. 834/2007 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike;
- Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1254/2008 , datë 15 Dhjetor 2008, për amendimin e Rregullores (EC) Nr. 889/2008, përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e Rregulores së Këshillit (EC) Nr. 834/2007 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike në lidhje me prodhimin organik, etiketimin dhe kontrollin;
- Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 537/2009 , datën 19 Qershor 2009 për amendimin e Rregullores (EC) Nr. 1235/2008, lidhur me listen e vendeve të treta nga të cilat produktet bujqësore të fituara nga prodhimi organik duhet të fillojnë të tregtohen brenda Komunitetit;
- Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 710/2009, datë 5 Gusht 2009 për amendimin e Rregullores (EC) Nr. 889/2008 përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e

Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 834/2007, lidhur me përcaktimin e rregullave të detajuara për të akuakulturës organike dhe prodhimit të algave të detit;

- Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 271/2010, datë 24 Mars 2010 për ndryshimin e Rregullores (EC) Nr. 889/2008 përcakton rrgullat e detajuara për zbatimin e e Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 834/2007, lidhur me logon e prodhimit organik të Bashkimit Evropian;
- Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 471/2010, datë 31 Maj 2010 për amendimin e Rregullores (EC) Nr. 1235/2008, lidhur me listën e vendeve të treta nga të cila produktete bujqësore të siguruara nga prodhimi organik duhet fillojnë të tregtohen brenda Komunitetit;

Rregulloret e reja përfshijnë:

- Rregullat e reja të prodhimit, çertifikimit, etiketimit, të produkteve organike përfshirë transportin dhe shpërndarjen. Kanë fushë të gjerë veprimi në produktet e përpunuara duke përfshirë zinxhirin e plotë nga përpunimi tek shpërndarja e produktit organik: "produktet e përpunuara organike duhet të prodhohen duke përdorur metodat e përpunimit që garantojnë që cilësitë integrale dhe jetësore të produktit janë ruajtur në të gjitha hallkat e prodhimit" neni 19 i Rregullores 834/2007. Për herë të parë trajtohen produktet që përmbajnë OMGJ, të akuakulturës dhe tekstilet si dhe garantohen rregulla të reja për fermat në konvertim dhe per logon e produktit (në këto rregulla parashikohen edhe rastet e etiketimit per vendet jashtë BE-së siç është dhe rasti i Shqipërisë);
- Prodhimi organik, bazohet në 4 shtylla kryesore të parashikuara në rregulloret që kërkohen të përafrohen;
- Përafrimi i legjislacionit do të mbështesë trupat e çertifikimit për çertifikimin e produkteve organike mbi baza ligjore kombëtare (trupat e huaj të çertifikimit do të veprojnë jasht kuadrit tërësor privat, siç dhe veprojne deri më tani);
- Kompanitë përpunuese do të gjejnë bazën ligjore të prodhimit, përpunimit, çertifikimit, etiketimit të produktit organik, rregullat për sigurinë ushqimore dhe përpunimin e mbetjeve deri në tregtim dhe shpërndarje, çka do të rregullojë standarded e produktit deri në arritjen e standardeve ndërkombëtare si ISO, HCPP, etj., si domosdoshmëri të eksportimit të produkteve organike në tregun rajonal dhe më gjerë;

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/ nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligjin. Nr. 9199, datë 26/02/2004 "Për prodhimin, përpunimin, çertifikimin dhe tregtimin e produkteve "Bio", ligj i cili është miratuar dhe zbatohet që nga ky vit (2004): botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 20/2004, datë 05/04/2004, Faqe: 1045, bazuar në rregulloren e BE-së 2092/91 "Për prodhimin organik të produkteve bujqësore dhe treguesit që i referohen produkteve bujqësore dhe ushqimore" dhe shkalla e përafrimit është e pjesshme,
- Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM), Nr. 388, datë 31/05/2005 "Për përbërjen, funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Komisionit Shtetëror të Prodhimit Organik" (Fletorja Zyrtare, Nr.41/2005, datë 13/06/2005);

- VKM Nr. 145/2006, datë 08/03/2006 "Për disa ndryshime në vendimin Nr. 388, datë 31/05/2005 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen, funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Komisionit Shtetëror të Prodhimit Organik" (Fletorja Zyrtare, Nr.20/2006, datë 17/03/2006);
- VKM Nr. 639, datë 14/05/2008 "Për strukturën, funksionimin, kriteret e pranimit të dokumentacionit të nevojshëm dhe të detyrimeve të organizmave Çertifikues" (Fletorja Zyrtare, Nr.82/2008, datë 06/06/2008);
- Urdhëri i Ministrit të MBUMK Nr. 306, datë 21/06/2006 "Për ngritjen e Komisionit Shtetëror të Prodhimit Organik si dhe ngritjen e funksionimin e Sekretariatit të këtij Komisioni";
- Urdhëri i Ministrit të MBUMK Nr. 131, datë 17/04/2009 "Për ngritjen e Komisionit Shtetëror të Prodhimit Organik si dhe ngritjen e funksionimin e Sekretariatit të këtij Komisioni" (ky Urdhër ka ndryshuar Urdhërin Nr. 306, datë 21/06/2006);
- Urdhëri Nr. 173, datë 21/05/2009 "Për tarifat e pagesave për regjistrimin e organizmave të çertifikimit dhe trupave inspektuese".

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në prodhimin organik janë Ministria e Bujqësisë dhe institucionet e varësisë së saj Ministria e Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe institucionet e varësisë së tyre. Në lidhje me Ministrinë e Bujqësisë dhe institucioneve të saj të varësisë, me krijimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit i cili filloi nga aktiviteti me datë 1 shtator 2010, garantohet dhe ndarja e funksioneve politikëbërëse/ ligjbërëse nga ato zbatuese. Funksionet politikëbërëse realizohen nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, pjesë e së cilës është Sektori i Prodhimit Bimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Bujqësore. Kjo Drejtori është përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit për prodhimin bimor në përshirë atë organik, funksionet kryesore të prodhimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore/organike brenda standardeve si dhe sigurimit të një konkurrueshmërie të produkteve në treg ku produkti organik të plotësojë të gjitha rregullat dhe kërkesat e prodhimit dhe tregtimit sipas normave të BE-së dhe legjislasionit të fushës në fuqi, nxit rritjen e gamës së produkteve produkteve bujqësore/organike në tregun lokal, rajonal e më gjerë. Ajo gjithashtu, ndihmon në zhvillimin dhe implementimin e politikave të sigurisë së prodhimit bujqësor/organik të integruar nga "ferma tek tavolina".

Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF), institucion në vartësi të MBUMK, siguron pastërinë e rregullat e prodhimit, çertifikimit, regjistrimit dhe tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, përfshirë dhe atë organik Në ESHFF është dhe laboratori i referencës për këtë qëllim.

AKU menaxhon kontrollin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, përfshirë dhe atë organik, në treg, dogana, pika grumbullimi/ruajtje, etj., për sigurimin e respektimit të rregullave të tregtimit dhe pastërtisë fitosanitare të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor/organik. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) është Qendër Reference në kontrollin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimeve, përfshirë atë organik.

AKU gjithashtu kryen kontrolle për vlerësimin e cilësisë së plehrave, përpara hedhjes së tyre në treg dhe gjatë tregtimit, për të garantuar mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe mjedisit si dhe interesat ekonomike të fermerëve, si rregulla thelbësore të prodhimit organik.

Në QTTB-Fushë Krujë është laboratori i referencës për analizën e tokave (mbetjet toksike apo të lëndëve të tjera të papranueshme për prodhimin organik). Ky laborator përveç sa më sipër kryen analiza për ujërat dhe plehrat që përdoren në bimësi.

Universiteti Bujqësor Tiranë (UBT), nëpërmjet Deparatmentit të Mbrojtes së Bimëve ndihmon në analizimin e dëmtuesve dhe sëmundjeve për realizimin me sukses të luftës së integruar në këtë drejtim (IPM), aq e rëndësishme në prodhimin organik.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Ligj i ri "Për bujqësinë organike" për amendimin e Ligjit Nr. 9199, datë 26/02/2004 "Për prodhimin, përpunimin, çertifikimin dhe tregtimin e produkteve "Bio" me Rregulloren e Këshillit (EC) Nr. 834/2007, datë 28 Qershor 2007 "për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike si dhe shfuqizimin e Rregullores (EEC) Nr. 2092/91 dhe Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 889/2008, datë 5 Shtator 2008 përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 834/2007 "për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike lidhur me prodhimin organik, etiketimin dhe kontrollin";

Aktivitetet zbatuese

- Ngritja e grupit ndërministror të punës për draftimin e ligjit të ri;
- Trajnimi i ekspertëve të fushës lidhur me legjislacionin komunitar të prodhimit organik;
- Organizimi i seminareve dhe workshop-eve për diskutimin e draftligjit të ri;
- Miratimi i Ligjit të ri brenda vitit 2012;

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatmesme synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat legjislative afatmesme janë si vijon:

- Ministria e Bujqësisë do të hartojë dhe dërgojë për miratim projektvendimet e Këshillit të Ministrave që lidhen me implementimin e ligjit të ri "Për bujqësinë organike"

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Hartimi i Manuali të njësuar të Prodhimit Organik për disa nga produktet kryesore;
- Trajnimi i mëtejshëm lidhur me prodhimin dhe tregtimin e produkteve organike, sidomos të punonjësve të ekstensionit;
- Fillimi i regjistrimit të operatorëve organike on-line;
- Nxitjen e organizimit të tregjeve të produkteve organike për të realizuar komunikimin konsumatorëve direkt me fermerët dhe të fermerëve midis tyre;
- Fushata sensibilizuese dhe promovuese për konsumatorët e produkteve organike;
- Fillimet e databases të prodhimit organik (sistemi i informacionit);
- Regjistri i fermës organike;
- AKU për kontrollin e produkteve të importuara në termat e cilësisë;
- AKU për kontrollin e produkteve lokale të shitura si organike;

11.3.6. PRODUKTET SUBJEKT I ORGANIZIMIT TË TREGUT

Objektivi strategjik

Objektivi kryesor, siç është shprehur dhe në nenin 95 të MSA, është bashkepunimi me BE-në për modernizimin dhe rikonstruktimin e Sektorit të Bujqesisë dhe Agroindustrisë, duke e mbështetur përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me rregullat dhe politikat e komunitetit, rritja e cilësisë së produkteve agroushqimore në drejtim të rritjes së konkurrueshmërisë së produkteve të përpunuara përmes: përmirësimit teknologjik, metodave dhe teknikave të reja të menaxhimit të integruar të sistemeve të prodhimit dhe reduktimit të kimikateve, përafrimit të legjislacionit vendas me acquis communautaire, përmbushja e standardeve të BE-së.

Sektori bujqësor dhe ai i agropërpunimit duhet të arrijnë një nivel më të lartë prodhueshmërie dhe konkurrueshmërie, si në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar, mbi bazën e përmirësimit të kushteve për veprimin e iniciativës private, por dhe të një mbështetje zhvilluese më të plotë, në një mënyrë të qëndrueshme dhe që të garantohet nga institucione efiçente. Prodhueshmëria dhe konkurrueshmëria më e lartë janë themelet e rritjes së prodhimit, të përmirësimit të daljes në treg për fermerët dhe biznesin agropërpunues, të rritjes së të ardhurave dhe të përmirësimit të nivelit të jetesës së femerëve dhe familjeve të tyre.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Lidhur me situatën aktuale mund të themi se ka pasur progres në drejtim të përmirësimit të kapaciteteve administrative. Përsa i përket Ligjit Nr. 8443, datë 21.01.1999 “Për vreshtarinë, verën dhe produktet e tjera që rrjedhin nga rrushi”, u vendos hartimi i një ligji të ri për vreshtarinë dhe verën, ligj i cili ka për qëllim të percaktojë dhe të vendosë rregulla bazë për mbarështimin e vreshtarisë, për prodhimin e rrushit, të verërave dhe produkteve të tjera që

rrjedhin prej tij. Aktualisht është hartuar draft-ligji i ri "Për Vreshtarinë dhe Verën", i cili është planifikuar të miratohet brenda vitit 2012.

Nëpërmjet financimit të Programit CARDS dhe BE është mundësuar projekti për Krijimin e Kadastrës së Verës Shqiptare. Kohëzgjatja e këtij projekti është parashikuar për periudhën 2008-2012. Objektivi i projektit është lidhja e projektit me zbatimin e MSA-së, lidhja e projektit me përmbushjen e rekomandimeve të Partneritetit Europian si edhe lidhja e projektit me Strategjinë Sektoriale/Kombëtare. Po ecet paralelisht me projektin për mbylljen dhe përfundimin e ligjit.

Në lidhje me amendimin e ligjit nr. 8944 dt.19.09.2002 "Për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit", meqenëse gjatë punës për amendimin e këtij ligji rezultoi se ai ndryshonte me mbi 50%, u vendos hartimi i një projekt-ligji të ri. Aktualisht projekt-ligji "Për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit" është dërguar për mendim në ministritë e linjës. Parashikohet që të dërgohet për miratim brenda muajit prill 2012.

Me miratimin e ligjit të ri "Për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit", në zbatim të tij do të fillojë puna edhe për hartimin e miratimin e rregullores për karakteristikat e vajit të ullirit, si dhe hartimi dhe miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave "Mbi përbërjen, organizimin dhe detyrat e komisionit të ekspertëve të vlerësimit organo-shqisore të vajrave të ullirit". Këto akte do të mbështeten në parimin se për vlerësimin cilësor të vajrave të ullirit, përcaktimi i treguesve shijorë i tyre ka rëndësi të veçantë si për të gjitha produktet ushqimore.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligj Nr. 8443, datë 21.01.1999, "Për Vreshtarinë Verën dhe Produktet e tjera që Rrjedhin nga Rrushi", që përafron pjesërisht: Rregulloren e Këshillit (EC) Nr 1493/99, e Maj 1999, "Mbi organizimin e tregut të përbashkët të verërave {e zëvendësuar me (EC) Nr. 1234/2007 "Për ngritjen e një tregu të përbashkët bujqësor, dhe masat specifike për disa produkte bujqësore"}; Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 1623/2000 dhe Rregullore e Komisionit (EC) Nr 1622/2000, e 24-25 Korrik 2000, mbështetur në rregulloren nr. 1493/99 "Mbi organizimin e tregut te verës, dhe vendosjen e kodeve praktike dhe përpunuese të komunitetit e zëvendësuar me (EC) No. 1234/2007 "Për ngritjen e një tregu të përbashkët bujqësor, dhe masat specifike për disa produkte bujqësore."; Rregulloren e Komisionit (EEC) Nr 2392/86, e Korrik 1986, "Mbi mbajtjen e rregjistrit të vreshtarisë"; Rregulloren e Komisionit (EEC) Nr 649/87, e Mars 1987, "Mbi vendosjen e disa kritereve në ngritjen e regjistrit të vreshtarisë".
- VKM, Nr. 505, datë 01.08.2000, "Për miratimin e rregullores për Vreshtarinë, Verën dhe Produktet e tjera që rrjedhin nga Rrushi", që përafron pjesërisht: Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 1238/92, e Maj 1992, "Mbi metodat që zbatohen në sektorin e verës për analizën e akoolit neutral"; Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 2676/90, e Shtator 1990, "Mbi metodat kryesore të analizimit të verës".
- Rregullore Nr. 2, datë 06.01.2003, "Për përkufizimin, emërtimin dhe paraqitjen e pijeve alkoolike", që përafron pjesërisht: Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 753/2002, e Prill

2002, “Mbi përshkrimin, emërtimin, paraqitjen dhe mbrojtjen e sigurtë të produkteve në sektorin e verës.

- Ligj Nr. 8944, datë 19.09.2002, “Mbi prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit”, që përafron pjesërisht: Rregulloren e Këshillit (EC) Nr 865/2004, “Mbi organizimin e një tregu të përbashkët të vajit të ullirit dhe ullinjëve të tavolines, që amendon Regulloren (EEC) Nr. 827/68, duke u përfshirë në Regulloren nr 1234/2007 “Për ngritjen e një tregu të përbashkët bujqësor, dhe masat specifike për disa produkte bujqësore”; Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 702/2007 e datës 21 Qershor 2007 që amendon Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 2568/91 “Për karakteristikat e vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit, dhe metodat e duhura të analizave”; Rregulloren e Komisionit Nr. 1044/2006 që amendon Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 1019/2002, e datës 13 Qershor 2002 “Për standardet e tregtimit të vajit të ullirit”
- Rregullore Nr. 475, datë 12.07.2003, “Për karakteristikat e Vajrave të Ullirit”, që përafron pjesërisht: Rregulloren e Komisionit (EEC) Nr 2568/91 e datës 11 Korrik 1991 “Mbi përcaktimin e karakteristikave fiziko-kimike të vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit dhe metodat e analizave të këtyre karakteristikave”.

Struktura institucionale

Funksionet politikbërëse realizohen nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Si pjesë e Ministrisë së Bujqësisë funksionon Drejtoria e Tregjeve dhe Marketingut, pjesë e së cilës është Sektori i Marketingut. Këto struktura janë përgjegjëse për për hartimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit për nxitjen dhe mbështetjen e prodhimit bujqësor vendas, duke marrë pjesë aktive në zbatimin e politikave të qeverisë, në drejtim të përmirësimit dhe nxitjes së konkurueshmërise së produkteve, marketingun, menaxhimin dhe mirëfunksionimin e tregjeve, si dhe agroindustrinë.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Projekt ligj “Për Prodhimin, Emërtimin dhe Tregtimin e Vajit të Ullirit dhe Vajit të Bërsive të Ullirit”. Ky ligj do të përafrojë pjesërisht Rregulloren e Komisioinit (EC) nr.1019/2002 të 13 qershor 2002 “Mbi standardet e marketingut për vajin e ullirit” dhe Rregulloren e Komisioinit (EC) Nr.1234/2007 1234/2007 “Për ngritjen e një tregu të përbashkët bujqësor, dhe masat specifike për disa produkte bujqësore”.
- Projekt VKM “Për miratimin e rregullores “Për karakteristikat e vajrave të ullirit”, e cila përafron Rregulloren e Komisionit (EEC) Nr 2568/91 e datës 11 Korrik 1991 “Mbi përcaktimin e karakteristikave fiziko-kimike të vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit dhe metodat e analizave të këtyre karakteristikave” .
- Hartimi i projekt VKM “Për përbërjen, organizimin dhe detyrat e komisionit të ekspertëve të vlerësimit organo-shqisor të vajrave të ullirit”.

- Projekt ligj "Për vreshtarinë dhe verën", i cili do të përafrojë pjesërisht: Rregulloren e Këshillit (EC) Nr 479/2008, e 29 Prill 2008, "Për organizimin e përbashkët të tregut të verës"; Rregulloren e Komisionit (EC) Nr.423/2008 e 8 maj 2008 që vendos rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr 1493/99 dhe për krijimin e një kodi Komuniteti për proçeset dhe praktikat enologjike; Rregulloren e Komisionit (EC) Nr.555/2008 e 27 qershor 2008.
- Rregullore "Për funksionimin e Komitetit Rregullator të përcaktimit të origjinës së verërave".
- Projekt VKM "Për përcaktimin e kategorive të produkteve në sektorin e verës, praktikave enologjike dhe kufizimeve të zbatueshme", që do të përafrojë Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 606/2009, e 10 korrikut 2009, që vendos rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) nr.479/2008 e 29 prill 2008.
- Projekt VKM "Për emërtimet e origjinës dhe treguesve gjeografikë të mbrojtur, termave tradicionalë, etiketimet dhe paraqitjes së informacionit për konsumatorin të disa produkteve të sektorit të verës", që do të përafrojë Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 607/2009, e 14 korrikut 2009, që vendos rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) nr.479/2008 e 29 prill 2008.

Aktivitetet zbatuese

- Ngritja e grupit të punës për hartimin e Projekt VKM "Për miratimin e rregullores "Për karakteristikat e vajrave të ullirit".
- Ngritja e grupit të punës për hartimin e projekt VKM për "Për përbërjen, organizimin dhe detyrat e komisionit të ekspertëve të vlerësimit organo-shqisor të vajrave të ullirit".
- Ngritja e grupit të punës për hartimin e rregullores "Për funksionimin e Komitetit Rregullator të përcaktimit të origjinës së verërave".
- Ngritja e grupit të punës për hartimin e projekt VKM "Për përcaktimin e kategorive të produkteve në sektorin e verës, praktikave enologjike dhe kufizimeve të zbatueshme".
- Ngritja e grupit të punës për hartimin e projekt "Për emërtimet e origjinës dhe treguesve gjeografikë të mbrojtur, termave tradicionalë, etiketimet dhe paraqitjes së informacionit për konsumatorin të disa produkteve të sektorit të verës".

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatmesem synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat legjislative afatmesme janë si vijon:

- Hartimi dhe dërgimi për miratim i projektligjit "Për ngritjen e një tregu të përbashkët bujqësor dhe masat specifike për disa produkte bujqësore", i cili do të përafrojë pjesërisht Rregulloren e Komisioinit (EC) Nr.1234/2007, e 22 tetorit 2007, "Për ngritjen e një tregu të përbashkët bujqësor, dhe masat specifike për disa produkte bujqësore".
- Hartimi dhe dërgimi për miratim i projektvendimit "Për përcaktimin e standardeve të marketingut për frutat dhe perimet", i cili do të përafrojë pjesërisht Rregulloren e Komisioinit (EC) Nr.1234/2007, e 22 tetorit 2007, "Për ngritjen e një tregu të përbashkët

bujqësor, dhe masat specifike për disa produkte bujqësore" dhe Rregulloren e Komisioinit (EC) Nr.1580/2007, të 21 dhjetorit 2007 që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr.2200/96, (EC) Nr.2201/96 dhe (EC) Nr.1182/2007 në sektorin e frutave dhe perimeve.

- Hartimi i Rregullores "Për regjistrin e vreshtave, deklarimet e detyrueshme dhe grumbullimin e informacionit për të monitoruar tregun e verës, dokumentat shoqëruese për ngarkesat e produkteve të verës dhe regjistrave që mbahen për sektorin e verës", që do të përafrojë Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 436/2009, e 26 majit 2009, që vendos rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) nr.479/2008 e 29 prill 2008.
- Hartimi i Rregullore "Për Regjistrin e tregtarëve të fruta – perimeve".

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Ngritja e grupit të punës për hartimin e projektligjit "Për ngritjen e një tregu të përbashkët bujqësor dhe masat specifike për disa produkte bujqësore".
- Ngritja e grupit të punës për hartimin e projekt VKM "Për përcaktimin e standardeve të marketingut për frutat dhe perimet".
- Ngritja e grupit të punës për hartimin e rregullores "Për regjistrin e vreshtave, deklarimet e detyrueshme dhe grumbullimin e informacionit për të monitoruar tregun e verës, dokumentat shoqëruese për ngarkesat e produkteve të verës dhe regjistrave që mbahen për sektorin e verës".
- Ngritja e grupit të punës për hartimin e rregullores "Për Regjistrin e tregtarëve të fruta – perimeve".

3.11.7. POLITIKAT E CILËSISË

Objektivi strategjik

Aktualisht në Shqipëri treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës në bazë të legjislacionit vlerësohen si një lloj pronësie industriale. Një politikë e tillë, në përputhje me politikat evropiane në këtë sektor, synon që nëpërmjet regjistrimit të mund të mbrohet pronësia intelektuale që lidhet me kulturën tradicionale, diversitetin gjeografik dhe metodat e prodhimit të një zonë ose rajon të caktuar. Në këtë mënyrë këto tregues gjeografik dhe emërtime origjine do të shërbejnë si një mjet marketingu për diversifikimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore në treg, duke forcuar në këtë mënyrë pozicionin e tyre konkurrues në treg e cila përkthehet në të ardhura më të larta për prodhuesit e këtyre produkteve, por edhe në mjet për mbrojtjen e konsumatorëve, rritjen e cilësisë së produkteve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Gjithsesi, deri në këto momente, në Shqipëri nuk ka ndonjë produkt bujqësor ose edhe ushqimor me origjinë të mbrojtur. Në progres raportin për vitin 2011, Komisioni Europian, konstaton se nga ana e Shqipërisë janë bërë disa përparime në fushën e politikës së cilësisë, sidomos me përgatitjet e autoriteteve për futjen dhe promovimin e treguesve gjeografikë. Duke pasur parasysh këto baza të hedhura, synimi i qeverisë shqiptare në afatin e mesëm

është ndërmarrja e të gjitha hapave të nevojshëm për të pasur një listë produktesh tradicionale shqiptare me origjinë të mbrojtur si brenda vendit ashtu edhe në tregjet ndërkombëtare.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Kuadri ligjor ekzistues për mbrojtjen e të drejtave mbi treguesit gjeografikë në Shqipëri përbëhet nga:

- Ligji Nr. 9947 datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale".
  Dispozitat e këtij ligji lidhur me mbrojtjen e treguesve gjeografikë janë pothuajse plotësisht të përafruara me parashikimet e Marrëveshjes së TRIPS-it dhe Direktivën 2004/48/EC "Mbi mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale" si dhe transpozojnë pjesërisht parashikimet e Rregullores së KE Nr. 510/2006 të datës 20 Mars 2006 "Për mbrojtjen e treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës për produktet ushqimore dhe të agrikulturës".
- VKM Nr. 1705 datë 29.12.2008 "Për miratimin e rregullores për regjistrimin e treguesve gjeografikë" dalë në zbatim të ligjit Nr. 9947 datë 07.07.2008.

Gjithsesi këto akte ligjore përmbajnë vetëm dispozita për proçedurën e regjistrimit dhe mbrojtën e këtyre treguesve gjeografik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, por nuk përmbajnë asnjë dispozitë për proçedurat para regjistrimit, kryesisht për specifikimin e produkteve, përcaktimin e zonës gjeografike objekt i zonës, mënyrën e kontrollit të produkteve të mbrojtura etj.

Në këto kushte Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, ka parashikuar plotësimin e këtij kuadri ligjor për treguesit gjeografik me synimin përafrimin sa më të plotë të kuadrit ligjor vendas me *acquis communautaire*. Për këtë qëllim është parashikuar hartimi i një projekt ligji "Për emërtimin dhe mbrojtjen e origjinës së produkteve bujqësore dhe ushqimore", i cili mendohet të përfundojë dhe të jetë i gatshëm për t'u dërguar për miratim brenda muajit dhjetor 2012.

Masa administrative të ndërmarra:

MBUMK ka ngritur një grup pune i cili ka punuar për hartimin e një liste paraprake me të gjitha produktet bujqësore dhe ushqimore si dhe të produkteve tradicionale shqiptare të cilat kanë potencial për tu regjistruar si produkte me origjinë të mbrojtur si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Ndërkohe DPPM në zbatim të nenit 8 të Shtojcës II të Protokollit III të MSA për mbrojtjen dhe kontrollin e emrave të verërave, pijeve alkoolike dhe verërave të aromatizuara ekzaminon me iniciativën e vet, nëse aplikimet për regjistrimin e markave tregtare për verë dhe pije alkoolike cenojnë emrat e këtyre pijeve të mbrojtura në BE, sipas listës së tyre të përfshirë në Protokoll, dhe refuzon regjistrimin e markës nëse ajo është cenuese.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji Nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale";

- VKM Nr.1705, datë 29.12.2008 “Për miratimin e rregullores “për regjistrimin e treguesve gjeografikë” që përafron pjesërisht Rregulloren e Këshillit (EC) Nr. 510/2006 e datës 20 Mars 2006 “Për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografik në produktet bujqësore dhe ushqimore”.

Struktura institucionale

Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit kryen funksionet e politikbërjes në kuadër të politikave të cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore (treguesve gjeografik dhe emërtimeve të origjinës). Ndërsa proçedurat administrative për regjistrimin dhe mbrojtjen e këtyre treguesve gjeografik dhe emërtimeve të origjinës realizohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave. Në strukturën e MBUMK funksionin Drejtoria e Tregjeve dhe Marketingut Bujqësor, e cila ka si pjesë përbërëse të saj edhe Sektorin e Marketingut. Ky sektor është përgjegjës për hartimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit për treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës.

Masat legjislative afatshkurtra

Në afatin e shkurtër synohet plotësimi i legjislacionit ekzistues edhe për proçedurat para regjistrimit, kryesisht për specifikimin e produkteve, përcaktimin e zonës gjeografike objekt i zonës, mënyrën e kontrollit të produkteve të mbrojtura etj.

- Projekt ligj “Për emërtimin dhe mbrojtjen e origjinës se produkteve bujqësore dhe ushqimore”.
- Projektligji “Për disa ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë” Ky projektligj përmban parashikime lidhur me vendosjen e sanksioneve penale për shkeljen e të drejtave mbi treguesit gjeografikë, në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes së TRIPS-it. Projektligji është në pritje për shqyrtim nga parlamenti në seancë plenare. Projektligji është në pritje për shqyrtim nga parlamenti në seancë plenare sipas *acquis communautaire*.

Aktivitetet zbatuese

Për periudhën afatshkurtër, prioritetet në fushën e treguesve gjeografikë do të jetë:

- Plotësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave mbi treguesit gjeografikë nëpërmjet vendosjes së sanksioneve penale për shkeljen e të drejtave.
- Plotësimi i kuadrit ligjor për specifikimin e produkteve, përcaktimin e kufijve të zonës që do të jetë objekt i mbrojtjes, proçedurat e kontrollit të produkteve bujqësore dhe ushqimore të mbrojtura.
- Identifikimi i plotë i të gjitha produkteve potenciale që mund të regjistrohen si produkte me origjinë të mbrojtur, nëpërmjet ngritjes së një task force në MBUMK e cila do të identifikojë të gjithë produktet potenciale që mund të jenë subjekt i mbrojtjes së origjinës.

Masat zbatuese afatmesme

- Vlerësimi i produkteve potenciale dhe përzgjedhja e disa prej produkteve që nga vlerësimi duket se paraqesin kushte të favorshme për sukses si produkte me origjinë të mbrojtur.
- Specifikimi i produkteve që do të përzgjidhen, përcaktimi i zonës së mbrojtur dhe të gjitha kërkesave të tjera ligjore për mbrojtjen e këtyre produkteve brenda territorit të Shqipërisë.
- Regjistrimi i këtyre produkteve të përzgjedhura fillimisht në nivel kombëtar pranë Drejtorisë së Patentave dhe Markave.
- Përgatitja e proçedurave për regjistrimin e këtyre produkteve për mbrojtje në nivel ndërkombëtar.
- Reflektimi në kuadrin ligjor vendas i ndryshimeve të mundshme në *acquis communautaire*.

3.12. SIGURIA USHQIMORE, VETERINARIA DHE FITOSANITETI

3.12.1. SIGURIA USHQIMORE

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Qeverisë shqiptare (ose Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit) është garantimi në shkallën më të lartë i shëndetit të qytetarëve shqiptar dhe perfeksionimi i sistemit të mbikëqyrjes dhe garantimit të sigurisë ushqimore. Ky sistem do të shërbejë për mbrojtjen sa më të mirë të shëndetit të popullatës nga sëmundjet/ dëmtimet si pasojë e konsumimit të produkteve ushqimore me origjinë bimore ose shtazore.

Vizioni, prioritetet dhe qëllimet strategjike synojnë krijimin e një sistemi me funksionim të plotë të sigurisë ushqimore dhe te mbrojtjes se konsumatorit, nga ferma ne tavolinë, qe mbulon te gjithë vendin si dhe monitorim dhe kontroll modern në përputhje me standardet e BE-së.
Përafrimi i standardeve aktuale me ato të BE-së, të sigurisë së produkteve ushqimore, të shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve, mbrojtjes se mjedisit, sistemit të kontrollit dhe inspektimeve, zhvillimi i infrastrukturës administrative me qëllim zbatimin e legjislacionit, janë pjese e politikës se sigurisë ushqimore që rrjedh nga Neni 76, MSA-së si më poshtë:

- Forcimi i sistemit te sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit dhe sistemeve të kontrollit që kanë lidhje me të.
- Të arrihen përmirësime thelbësore për sa i takon sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit dhe kushteve fitosanitare dhe veterinare, në përputhje me standardet e KE-së.

Po ashtu, neni 95 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian do të ketë si synim modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë shqiptare dhe sektorit agro-industrial, si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave me rregullat dhe standardet komunitare.

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Forcimit të sistemit institucional të sigurisë së ushqimit dhe sistemeve të kontrollit që kanë lidhje me të,
- Përforcimit të kapaciteteve laboratorike në sigurinë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitetit,
- Përmirësimit të legjislacionit për sigurinë ushqimore, fitosanitetin dhe veterinarinë dhe zbatimit të tij.

Situata aktuale

Institucionet e përfshira në garantimin e sigurisë ushqimore në tërësi dhe të situatës epidemiologjike, veçanërisht ndaj sëmundjeve zoonotike, janë Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucionet e varësisë së saj.

Per shkak te nje zinxhiri te paqarte te komandes nga ndarja e pergjegjesive nen 4 agjensi dhe per qellim te vendosjes se kopetencave te qarta te kontrollit te sigurise ushqimore nen nje autoritet te vetem ndryshimet institucionale ne strukturen e sigurise ushqimore kane bere te mundur ndarjen e politik-berjes nga zbatimi i tij. Per kete qellim Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit eshte pergjegjes per realizimin e politik-berjes ne fushen e sigurise ushqimore. Ndersa Autoriteti Kombetar i Ushqimit eshte pergjegjes per implementimin e ketyre politikave.

Drejtoria e Sigurise Ushqimore është përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit në fushën e sigurise ushqimore me qëllim integrimin e kontrollit të ushqimeve si një nga funksionet kryesore në mbrojtje të interesave dhe shëndetit të konsumatorit si dhe futjen e produkteve ushqimore në tregun ndërkombëtar. Ajo ndihmon në zhvillimin dhe implementimin e politikave te sigurise ushqimore në zinxhirin ushqimor nga "ferma tek tavolina".

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Baza ligjore mbi te cilen mbeshtetet veprimtaria ne fushen e sigurise ushqimore eshte e pergatitur nga perafrimi i pjesshem ose i plote i legjislaciot te BE-se ne kete fushe. Ajo eshte si me poshte:

- Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, "Mbi ushqimin", i ndryshuar, (botuar në GZ 17/2008). Ligji përafron rregulloret 32002R0178, 32004R0852, 32004R0853, 32004R854 dhe 32004R0882.
- Ligji nr. 9441, date 11. 11. 2005 "Per grumbullimin, perpunimin dhe tregtimin e qumeshtit dhe produkteve me baze qumeshti", (botuar ne GZ 93/2005). Ky Ligj perafron direktiven 31992L0046.
- Ligji nr. 8443, date 21. 01. 1999 "Mbi vreshtarine, veren dhe produkte te tjera qe rrjedhin nga rrushit" (botuar ne GZ 3/1999).
- Ligji nr. 8944 date 19. 9. 2002 "Per prodhimin, emertimin dhe tregtimin e vajit te ullirit" (botuar ne GZ 67/2002).
- VKM Nr. 609, date 17.11.2000 "Per Industrializimin dhe Tregtimin e Ujrave minerale natyrale", percakton kriteret per shfrytezimin dhe tregtimin e ujrave minerale natyrale, i cili eshte perafrim i plote i direktives 31980L0777.
- Vendim i Keshillit te Ministrave nr. 1132 date 05. 08. 2008 "Per miratimin e normave per grumbullimin e qumeshtit te paperpunuar", i cili eshte pergatitur nga perafrimi i pjesshem i direktives 31992L0046.
- Vendim i Keshillit te Ministrave nr. 1131 date 05. 08. 2008 "Per miratimin e rregullores "Kerkesat teknike dhe normat qe duhet te permbush qumeshti i destinuar per prodhimin e qumeshtit per konsum dhe produkte me baze qumesht", i cili eshte pergatitur nga perafrimi i pjesshem i direktives 31992L0046.

- Vendim i Keshillit te Ministrave nr. 1344 date 10. 10. 2008 “Per etiketimin e produkteve ushqimore”. Ky vendim eshte pergatitur nga perafrimi i direktivës 31989L0396, direktivës 31990L0496, direktivën 31994L0054, direktivën 31996L0021, Vendimin e Komisionit 31999D0010, direktivën 32000L0013, direktivën 32001L0101, direktivën 32002L0067, direktivën 32003L0089, direktivën 32003L0120, direktivën 32004L0077, direktivën 32004R0608, direktivën 32006L0142, direktiven 32007L0068, direktivën 32008L0005.
- Urdher i perbashket i Ministrit te Bujqesise dhe Ushqimit dhe Ministrit te Shendetesise nr.698 date 16.12.2003 “Mbi perdorimin e disa embelsuesve ushqimor ne produktet ushqimor, i cili eshte perafrim i plote i anekseve ku percaktohen embelsuesit qe perdoren ne produktet ushqimore i direktives 94/35/EC amenduar nga direktivat 96/83/EC, 2003/115/EC dhe rregullores 1882/2003/EC.
- Urdher i perbashket i Ministrit te Bujqesise dhe Ushqimit dhe Ministrit te Shendetesise nr.699 date 16.12.2003 “Mbi perdorimin e disa ngjyruesve ushqimor ne produktet ushqimore”, i cili eshte perafrim i plote i anekseve ku percaktohen ngjyruesit ushqimor te lejuar ne ushqime te direktives 94/36/EC.
- Urdher nr.209 date 27.04.2006 “Mbi perdorimin e aromatizuesve ne produktet ushqimore”, i cili eshte perafrim i plote i listes se aromatizuesve te perdorur ne produktet ushqimore ne Direktiven 2002/113/EC.
- Urdher nr.346 date 14.07.2006 “Mbi miratimin e rregullores “Aromatizuesit qe perdoren ne produktet ushqimore dhe ne lendet e para per prodhimin e tyre”, i cili eshte perafrim i plote i direktives 88/388/EEC.
- Urdher nr. 5 date 09.01.2007 “Per miratimin e rregullores “Mbi kontrollin e kriterit te pastertise per disa aditive te autorizuar, i cili eshte perafrim i pjesshem i Direktives 95/45/EC.
- Urdher nr. 4 date 09.01.2007 “Per miratimin e rregullores “Mbi kriterin e pastertise se aditiveve ushqimore te tjere nga ngjyruesit dhe embelsuesit”, i cili eshte perafrim i plote i direktives 2003/95/EC.
- Udhezim nr.10 date 4.09.2007 “Per materialet ne kontakt me ushqimet”, i cili eshte perafrim i plote i direktives 2004/1935/EC .
- Udhezim nr.361 date 23.10.2007 “Per miratimin e rregullores “Mbi materialet dhe artikujt qe permbajne monomer klorur vinili dhe jane percaktuar te jene ne kontakt me ushqimet”, i cili eshte perafrim i plote i Direktives 80/766/EC.
- Rregullore Nr.1 date 17.3.2000 “Mbi masat per monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve ne kafshet e gjalla dhe produktet shtazore”, i cili eshte perafrim i plote i direktives 96/23/EEC.
- Rregullore Nr. 2 date 1.11.2002 “ Per Mbrojtjen e Kafsheve gjate therjes si dhe kerkesat e aplikueshme per thertoret”, qe percakton kriteret qe duhet te plotesojne thertoret per te mbrojtur kafshet gjate therjes, i cili eshte perafrim i plote i direktives 93/119/CEE.
- Urdhër nr.313 datë 26.06.2006 “Per miratimin e rregullores Për nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve në produktet ushqimore dhe ushqimet me origjinë bimore”, i cili eshte perafrim i plote i rregullores 396/2005/EC.
- Urdher nr.257 date 24.5.2006 ”Per miratimin e rregullores ”Per kryerjen e kontrollit shteteror te produkteve ushqimore”, i cili eshte perafrim i plote i direktives 89/397/EEC.

- Urdher Nr. 195 date 15.01.2007 per miratimin e rregullores “Mbi kerkesat e prodhimit dhe vendosjes ne treg te mishit te grire dhe mishit te pergatitur”, i cili eshte perafrim i plote i direktives 94/65/CEE.
- Urdher nr.462 date 18.12.2007 “Per miratimin e rregullores ”Mbi organizimin e kontrolleve veterinare te produkteve me origjine shtazore qe hyjne ne territorin e Republikes se Shqiperise”, i cili eshte perafrim i pjesshem i direktives 97/78/EEC.
- Urdher nr.463 date 18.12.2007 “Per miratimin e rregullores ”Mbi percaktimin e shkalles per klasifikimin e karkases se gjedhit te rritur”, i cili eshte perafrim i pjesshem i direktives 1208/81/EEC.
- Urdher nr.456 date 17.12.2007 “Mbi miratimin e rregullores “Mbi formulat e ushqimeve per bebe”, i cili eshte perafrim i pjesshem i direktives 2006/141/EC.
- Urdher nr.482 date 31.12.2007 “Mbi miratimin e rregullores “Mbi produktet ushqimore me ngrirje te shpejte”, i cili eshte perafrim i pjesshem i direktives 89/108/EEC.
- Urdher nr.444 date 07.12.2007 “Mbi miratimin e rregullores “Mbi lengjet e frutave dhe produktet e ngjashme me to”, i cili eshte perafrim i pjesshem i Direktives 2001/112/EC.
- Urdher nr.3 date 10.03.2008 “Mbi çlirimin e substancave N-nitrosamines dhe N-nitrosable nga materiale elastomere ose goma”, i cili eshte perafrim i pjesshem i direktives 93/11/EEC.
- Urdher nr.167 date 09.04.2008 “Mbi miratimin e rregullores “Mbi rregullat baze per testimin e migrimit te perberesve te materialeve dhe artikujve plastike ne kontakt me ushqimet”, i cili eshte perafrim i pjesshem i direktives 82/711/EEC.
- Urdher nr.216 date 23.05.2008 “Mbi miratimin e rregullores “Per ushqimet shtese”, i cili eshte perafrim i pjesshem i rregullores 2002/46/EC.
- Udhezim nr.7 date 01.07.2008 “Per materialet dhe artikujt e prodhuar nga filma celuloze te rigjeneruar te percaktuar te jene ne kontakt me produktet ushqimore”, i cili eshte perafrim i pjesshem i rregullores 1935/2004/EEC.
- Udhezim nr.9 date 21.07.2008 “Per kufizimin e perdorimit te derivateve te caktuara epoksi ne materialet dhe artikujt e percaktuar te jene ne kontakt me produktet ushqimore”, i cili eshte perafrim i pjesshem i rregullores 1895/2005/EEC.
- Urdher nr.290 date 01.07.2008 “Per miratimin e rregullores ”Mbi percaktimin e metodave te marrjes se mostrave dhe analizave per kontrollet zyrtare per nivelet e dioksinave dhe dioksines si PCB ne artikujt ushqimor”, i cili eshte perafrim i pjesshem i rregullores 1883/2006/EC.
- Udhezim nr.8 date 21.07.2008 “Materialet dhe artikujt qeramik te percaktuar te jene ne kontakt me produktet ushqimore”, i cili eshte perafrim i pjesshem i rregullores 84/500/EEC.
- Urdher nr.427 date 01.10.2008 “Per miratimin e rregullores ”Mbi rregullat specifike per kontrollin zyrtar te trichinela-s ne mish”, i cili eshte perafrim i pjesshem i rregullores 2075/2005/EC.
- Urdher nr.438 date 01.10.2008 “Per miratimin e rregullores ” Mbi kerkesat e shendetit publik dhe certifikata veterinare per futjen ne Komunitet te qumeshtit te trajtuar termikisht, produkteve me baze qumeshti dhe qumeshtit te patrajtuar per konsum njerezor”, i cili eshte perafrim i pjesshem i rregullores 2004/438/EC.

- Urdher nr.439 date 01.10.2008 “Per miratimin e rregullores ”Mbi kerkesat e shendetit publik dhe modeli i certifikates per importin e produkteve te caktuara te mishit dhe stomakut te trajtuar dhe zorreve per konsum njerezor nga vendet e treta”, i cili eshte perafrim i pjesshem i rregullores 2007/777/EC.
- Urdher nr.1 date 26.01.2009 “Per miratimin e rregullores ”Mbi aromatizuesit tymues”, i cili eshte perafrim i pjesshem i rregullores 2065/2003/EC.
- Urdher nr.33 date 26.01.2009 “Per miratimin e rregullores ”Mbi inventarizimin e burimit te materialeve dhe substancave te perdorura ne pergatitjen e aromatizuesve”, i cili eshte perafrim i pjesshem i direktives 88/389/EC.
- Urdher nr.82 date 27.02.2009 “Per miratimin e rregullores “Mbi percaktimin e nivelit maksimal dhe metodat e analizave per percaktimin e permbajtjes se acidit erucik ne vajra dhe yndyrna te percaktuara per konsum njerezor dhe si perberese te produkteve ushqimore tek te cilat vajrat ose yndyrat jane shtuar”, i cili eshte perafrim i pjesshem i direktives 76/7621/EEC, 80/891/EEC, rregullores 807/2003/EC.
- Urdher nr. 3 date 30.04.2009 “Per miratimin e rregullores “Mbi rregullat shëndetësore që mbulojnë prodhimin, përpunimin, shpërndarjen dhe importin e produkteve me origjinë shtazore për konsum njerëzor”, i cili eshte perafrim i pjesshem i direktives 2002/99/EC.
- Urdher nr. 4 date 30.04.2009 “Per miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike, i cili eshte perafrim i pjesshem i Rregullores 2073/2005/EC.
- Urdher nr. 223 date 08.07.2009 “Per miratimin e rregullores “Mbi rregullat e pergjithshme, per percaktimin, pershkrimin dhe prezantimin e pijeve alkoolike”, i cili perafron rregulloret 1576/89/EEC, 3280/92/EEC, 3378/94/EC, 1882/2003/EC.
- Urdher nr. 253 date 27.08.2009 “Per miratimin e rregullores “Mbi metodat e marrjes së mostrës për kontrollin zyrtar të mbetjeve të pesticideve në produktet me origjinë bimore dhe shtazore, i cili perafron direktiven 2002/63/EC.
- Udhezim nr.5 date 7.09.2009 “Mbi nivelet maksimale te mbetjeve te pesticideve ne produktet ushqimore me origjine nga kafshet”, i cili perafron direktiven 86/363/EEC.
- Urdher nr.291 date 29.09.2009 “Per miratimin e rregullores “Per shtimin e vitaminave, mineraleve dhe disa substancave te tjera te caktuara ne produktet ushqimore”, i cili perafron rregulloret 108/2008/EC, 1925/2006/EC.
- VKM nr.1081 date 21.10.2009 “Mbi organizimin dhe funksionimin e AKU-se”.
- Urdher nr.146 date 02.12.2009 “Per miratimin e rregullores “Per ushqimet per perdorim ne dieta me energji te kufizuar per ulje ne peshe”, i cili perafron direktivat 96/8/EEC, 2007/29/EC.
- Urdher nr.392 date 29.02.2009 “Per miratimin e rregullores “Mbi perkufizimin, pershkrimin, dhe paraqitjen e vererave te aromatizuara, pijeve me baze vere te aromatizuar dhe produkte kokteile te vererave te aromatizuara”, i cili perafron regulloret 1601/91EEC, 3279/92/EEC, 3378/94/EEC, 2061/96/EC, 1882/2003/EC, 1334/2008/EC.
- Urdher nr. 10 date 13.01.2010 “Mbi vleresimin dhe kategorizimin e stabilimenteve te produkteve ushqimore me origjine shtazore”, i cili eshte perafrim i pjesshem i rregulloreve 852/2004/EC, 853/2004/EC dhe 854/2004/EC.
- Udhezim nr. 2 date 17.2.2010 “Mbi miratimin e rregullores per etiketimin e mishit te viçit”, i cili eshte perafrim i pjesshem i regullores 1760/2000/EC.

- Urdher nr.94, date 28.03.2010 per miratimin e rregullores “Mbi ushqimet e perpunuara me baze dritherat dhe ushqimet per foshnje dhe per femije te vegjel”, i cili perafron direktiven 2006/125/EC.
- Urdher nr.176, date 28.05.2010 per miratimin e rregullores i “Mbi ushqimet dietike per qellime te vecanta mjeksore”, i cili perafron direktiven 1999/21/EC.
- Udhezim nr.12, date 29/092010 "Mbi metodat e marrjes së mostrave dhe analizave për kontrollin zyrtar të nivelit të mykotoksinave në ushqime, i cili perafron rregulloren 401/2006/EC.
- Udhezim nr.13, date 29.09.2010 “Per vendosjen e niveleve maksimale per kontaminues te caktuar ne ushqime”, i cili perafron rregulloren 1881/2006/EC.
- Udhezim nr.15, date 05/10/2010 "Mbi limitet maksimal të mbetjeve të medikamenteve veterinare në ushqimet me origjinë shtazore, i cili perafron rregulloren 2377/90/EEC.
- Urdher nr.314, date 27.10.2010 per miratimin e rregullores “Per krijimin e listes, limitet e perqendrimit dhe kerkesat e etiketimit per perberesit e ujrave mineral natyral dhe kushtet per perdorimin e ajrit te pasuruar me ozon per trajtimin e ujrave mineral natyral”, i cili perafron direktiven 2003/40/EC.
- Urdher nr. 320, date 2.11.2010 per miratimin e rregullores “Per substancat qe mund te shtohen per qellime te vecanta ushqimore ne ushqimet per perdorim te veçant ushqimor, perafron rregulloren 953/2009 /EC.
- Urdhër nr.331, datë 17.11.2010 PPer miratimin e listës së vendeve jo anëtare te BE-së dhe territoreve, nga të cilët janë të lejuara importet e molusqeve bivalve, ekinodermëve, tunikatëve, gastropodëve detarë si dhe produkteve të peshkimit”, i cili perafron Vendimet e Komisionit 2006/766/EC dhe 2008/156/EC.
- Udhezim nr.18, date 17.11.2010 “Per aditivet ushqimore te perdorur ne produktet ushqimore”, i cili perafron rregulloren 1333/2008/EC.
- Udhezim nr.19, date 17.11.2010 “Per metodat e marrjes se mostrave dhe kontrolit zyrtar te nivelit te nitrateve ne produkte te caktuara ushqimore”, i cili perafron rregulloren 1882/2006/EC.
- Udhezim nr.20, date 25.11.2010 “Per zbatimin e programeve paraprake, te praktikave te mira te higjenes, praktikave te mira te prodhimit dhe procedurat e bazuara ne HACCP ne stabilimentet ushqimore”.
- Udhezim nr.21, date 25.11.2010 “Mbi kerkesat specifike te higjenes dhe kontrollet zyrtare per produktet me origjine shtazore”, i cili perafron rregulloren 853/2004/EC dhe 854/2004/EC.
- Udhezim nr.22, date 25.11.2010 “Per kushtet e pergjithshme dhe te veçanta te higjenes per stabilimentet e ushqimit dhe operatoret e biznesit ushqimor”, i cili perafron rregulloren 852/2004/EC.
- Udhezim nr.23, date 25.11.2010 “Per kerkesat specifike te higjenes per mishin dhe produktet e mishit, duke perfshire produktet e mishit, mishin e grire dhe mishin e ndare ne menyre mekanike”, i cili perafron rregulloren 853/2004/EC dhe 854/2004/EC.
- Udhezim nr.5 date 25.03.2011 “Per kerkesat specifike te higjenes per stabilimentet e prodhimit, grumbullimit dhe perpunimit te qumeshtit dhe produkteve me baze qumeshti”, i cili perafron rregulloren 853/2004/EC dhe 854/2004/EC.

- Udhezim nr.25 date 25.11.2010 “Per kushtet higjenike dhe kontrollet per molusqet e gjalla bivalore, peshkun dhe produktet e peshkimit”, i cili perafron rregulloren 853/2004/EC dhe 854/2004/EC.
- Urdhër nr.3 datë 18.01.2011 “Mbi kërkesat shëndetësore të kafshëve të akuakulturës dhe produkteve të tyre, parandalimin dhe kontrollin e disa sëmundjeve në kafshët ujore, i cili perafron direktiven 2006/88/EC.
- Urdhër nr.194, date 06.06.2011 “Për miratimin e rregullores “Mbi kushtet speciale që mbulojnë ushqime të caktuara të importuara nga vendet e treta në lidhje me kontaminimin e tyre nga aflatoksina”, i cili perafron rregulloren 2009/669/EC.
- Udhezim nr. 12 date 15.06.2011 “Për miratimin e rregullores “Mbi kërkesat e shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve mbi tregtinë dhe importin nga vendet e BE-së”, i cili perafron direktivën 2004/41/EC.
- Udhezim nr.6 date 27.5.2011 “Mbi percaktimin e kriterit të pastërtisë në lidhje me ëmbëlsuesit e perdorur në ushqime”, i cili perafron direktivën 2008/60/EC.
- Udhezim nr.14 date 30.06.2011 “Mbi percaktimin e nivelit dhe frekuences së marrjes së mostrave për monitorimin e substancave të caktuara dhe mbetjeve në produkte të caktuara me origjine shtazore”, i cili perafron Vendimin e Komisionit 97/747/EC.
- Urdher Nr.211 date 29.06.2011 “Mbi miratimin e rregullores “Mbi produktet ushqimore per perdorime te vecanta ushqimore”, i cili perafron direktiven 2009/39/EC.
- Urdher, Nr.266, date 29.08.2011, “Per miratimin e rregullores “Mbi shfrytëzimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale”, i cili perafron direktiven 2009/54/EC.
- Udhezim Nr. 04.datë 21.03. 2011 “Për përbërjen dhe etiketimin e produkteve ushqimore të përshtatshme për personat intolerant ndaj glutenit”, i cili perafron rregulloren 41/2009/EC.
- Urdher nr.3 date 04.01.2012 “Per miratimin e rregullores “Mbi rregullat e detajuara në marrjen e mostrave zyrtare për monitorimin e substancave të caktuara dhe mbetjeve në produktet me origjinë shtazore”, i cili perafron direktiven 179/1998/EC.
- Urdhër nr.3 datë 18.01.2011 “Mbi kërkesat shëndetësore të kafshëve të akuakulturës dhe produkteve të tyre, parandalimin dhe kontrollin e disa sëmundjeve në kafshët ujore, i cili perafron direktiven 2006/88/EC.
- Urdher nr.81 datë 21.03.2011 per “Miratimin e modeleve te çertifikatave per eksportin e produkteve te peshkimit, molusqeve bivalve te gjalle, ekinodermeve, tunikateve dhe gastropodeve detare te destinuar per konsum njerezor per ne vendet anetare te BE-se”, i cili perafron Rregulloren 1250/2008/EC.
- Urdher nr.315 datë 14.11.2011 per miratimin e rregullores “Mbi kushtet dhe kërkesat e çertifikimit për vendosjen në treg dhe të importit të kafshëve të akuakultures dhe produkteve te tyre si dhe perpilimi i listes se specieve vektore”, i cili perafron rregulloren 1251/2008/CE.
- Udhezim nr.316 date 14/11/2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 25, date 25.11.2010 “Për kushtet higjenike dhe kontrollet për molusqet e gjalla bivalvore, peshkun dhe produktet e peshkimit”, i cili perafron rregulloren 1021/2008 EC.
- Udhëzim, nr.16, date 29.08.2011, “Për aditivët ushqimorë të tjerë nga ngjyruesit dhe ëmbëlsuesit”, i cili perafron perafron direktiven 98/72/EC.

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në garantimin e sigurisë ushqimore janë Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit dhe institucionet e varësisë së saj.

Në lidhje me Ministrinë e Bujqësisë dhe institucioneve të saj të varësisë, ndryshimet në strukturën institucionale të sigurisë ushqimore të kryera gjatë periudhës 2010 – 2011 garantojnë ndarjen e funksioneve politikëbërëse/ ligjbërëse nga ato zbatuese.

Funksionet politikëbërëse realizohen nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Si pjesë e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit funksionon ***Drejtoria e Sigurise Ushqimore (DSU).***

Mbrojtja e konsumatorit dhe parandalimi i sëmundjeve me origjinë ushqimore janë dy elementet bazë mbi te cilat Drejtoria e Sigurisë Ushqimore ka ndertuar politikat dhe strategjine e saj per arritjen e qellimit të vendosjes se bazave për sigurimin e nivelit me të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesave te konsumatorit.

Kjo Drejtori është përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit për sigurinë dhe cilësinë e produkteve ushqimore me qëllim integrimin e kontrollit të ushqimeve si një nga funksionet kryesore në mbrojtje të interesave dhe shëndetit të konsumatorit, sigurimit të një konkurrence të ndershme në treg si dhe futjen e produkteve ushqimore në tregun ndërkombëtar. Ajo ndihmon në zhvillimin dhe implementimin e politikave të sigurisë ushqimore në të gjithë zinxhirin ushqimor nga “ferma tek tavolina”.

Kjo drejtori përbëhet nga 9 punonjes dhe eshte e organizuar ne 2 sektorë: Sektori i Cilesise, Sigurisë Ushqimore Mbrojtjes se Konsumatorit dhe Sektori i Produkteve Ujore. Ne DSU punojne specialiste te profesioneve te ndryshme, si kimiste, veterinere, agronome, mercelog dhe juriste, te cilet kane kryer nje sere trainimesh ne fushen e legjislacionit dhe analizes e menaxhimit te riskut, si dhe kane hartuar nje plan te qarte per vazhdimin e kualifikimit te tyre.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) është organi publik, ne varesi te Ministrit te Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatoirit, i ngarkuar me funksionet zbatuese të garantimit të sigurisë ushqimore. Autoriteti Kombetar i Ushqimit filloi nga aktiviteti me datë 1 Shtator 2010. AKU përbëhet nga 3 drejtori qendrore: Drejtoria e Menaxhimit te Riskut dhe Koordinimit te Inspektimeve, Drejtoria e Vleresimit dhe Komunikimit te Riskut, Drejtoria e Sherbimeve te Brendeshme, të cilat mbulojnë fusha të veçanta të kontrollit të ushqimeve për konsum njerëzor dhe 12 drejtori rajonale të vendosura në 12 qarqet e vendit. AKU ka gjithsej 423 punonjës.

AKU në aktivitetin e tij mbështetet në Ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “Per Ushqimin” (GZ 17/2008) dhe Ligjin nr.10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë" (GZ 143/2011) dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

AKU është përgjegjës për kontrollin e sigurisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore të importuara, të prodhuara dhe të tregtuara në vend si dhe të lendeve të para të përdorura në industrinë ushqimore. Inspektorët e Sigurisë Ushqimore janë të atashuar pranë çdo pike të kalimit kufitar dhe pikave doganore.

AKU menaxhon laboratorët e kontrollit të sigurisë ushqimore dhe dymbëdhjetë laboratorët rajonalë të cilët realizojnë analizat e sigurisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore. ISUV është Qendër Reference në kontrollin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimeve.

Në nivel rajonal funksionojnë dymbëdhjetë laboratorë, katër nga të cilët, Durrësi, Vlora, Shkodra dhe Gjirokastra, janë të pajisur shumë mirë. Në këta laboratorë kryhen analizat për përcaktimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore si dhe të lëndëve të para të përdorura në industrinë ushqimore. Laboratorët janë pajisur nga projekte të Bankës Botërore, Qeverisë italiane dhe BE (IPA).

MBUMK, bazuar ne Ligjin "Per Ushqimin" 9863 date 28. 01. 2008, neni 46, ka percaktuar laboratoret e ***Institutit te Sigurise Ushqimore dhe Veterinarise*** (ISUV) si laboratore reference per cdo analize te kryer, per kontrollin zyrtar te sigurise se ushqimeve si dhe laboratore pergjegjes per:

- Kontrollin mikrobiologjik, kimik, toksikologjik, te produkteve dhe nenprodukteve me origjine shtazore te prodhuara ne vend ose te importuara si dhe ato per export;
- Kontrollin e mbetjeve te substancave me efekt anabolik dhe te pa autorizuara, te biopreparateve dhe medikamenteve veterinare ne produktet me origjine shtazore;
- Kontrollin mikrobiologjik dhe kimik per produktet e peshkimit (histamine, TVB-N);
- Kontrollin per biotoksinat detare tek molusqet bivalve te gjalle;
- Survejancen e fitoplanktonit potencialisht toksik (identifikim-kuantifikim) ne ujin e detit.

MBUMK ka perzgjedhur laboratoret e ISUV per kryerjen e analizave per kontrollin zyrtar, si te vetmit laboratore qe kane eksperiencen, kapacitetet dhe infrastrukturen e nevojshme per garantimin e cilesise se analizes.

Laboratoret jane duke implemetuar sistemin e sigurimit te cilesise ne perputhje me kerkesat e ISO 17025/2005.

ISUV ka perzgjedhur 8 prova si me prioritare per procesin e akreditimit ne perputhje me kreun 12 te rregullores CE Nr. 882/2004 date 14 prill 2004 dhe ISO/IEC 17025/2005.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përcaktimi më i qartë i kompetencave të institucioneve të përfshira në realizimin e sigurisë ushqimore, përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Rregullore “ Mbi monitorimin e zonozave dhe agjenteve zoonotike”, i cili perafron Direktiven 2003/99/EC.
- Rregullore mbi materialet dhe artikujt e percaktuar te jene ne kontakt me ushqimet, i cili perafron Regulloren 1935/2004/EC.
- Rregullore mbi performancen e metodave analitike dhe interpretimin e rezultatetve, i cili perafron Vendimin e Komisionit 2002/657/EC.
- Udhezim mbi limitet e mbetjeve te substancave active farmakologjike ne produktet me origjine shtazore, i cili perafron Regulloren 470/2009/EC.
- Rregullore “ Per percaktimin e kushteve te perdorimit te aluminit aktiv per largimin e florureve nga uji mineral natyral”, i cili perafron Regulloren 115/2010/EC.
- Rregullore mbi percaktimin e kriterit specific te pastertise per embelsuesit e perdorur ne produktet ushqimore, i cili perafron Direktiven 2008/60/EC.
- Rregullore mbi metodat e mostrimit, analizave për kontrollin zyrtar të niveleve të plumbit,kadmiumit, merkurit, kallajit inorganik, 3-MCPD dhe Benzo (a) pyrene në ushqime, i cili perafron Regulloren 333/2007/EC.
- Rregullore mbi krijimin e një faqe interneti për marrjen e informacionit për bizneset e prodhimit te akuakultures dhe stabilimentet e përpunimit të peshqve te miratuar, i cili perafron Vendimin e Komisionit 2008/392/EC.
- Rregullore mbi krijimin e listes se zonave dhe fermave te miratuara në lidhje me një ose më shumë nga sëmundjet virale, septicemise hemorragjike te peshkut (VHS) dhe necroses haematopoietice infective, i cili perafron Vendimin e Komisionit 2002/308/EC.

Aktivitetet zbatuese

- Do te blihen pajisje dhe mjete per inspektoret me qellim kryrjen e kontrolleve zyrtare.
- Do te kryhet plan monitorimi per qumeshtin e paperpunuar.
- Do te kryhet plan monitorimi per peshkun.
- Do te kryhet kontrolle zyrtare mbi operatore biznesi prodhues e perpunues ne zbatim te ligjit per ushqimin ne pergjithesi dhe zbatimin e sistemit te vetkontrollit.
- trajnim i stafit per perdorimin e AKU-Net.
- trajnim i stafit inspektues te AKU per " Trajnim ne Programet paraprake dhe HACCP".
- trajnim i stafit inspektues per vleresimin e Riskut.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat legjislative afatmesme janë si vijon;

- Rregullore lidhur me programet mbikqyrrese dhe crrenjosese te semundjeve , për marrjen e statusit te zonave dhe fermave pa sëmundje (e lire) cili perfarohet me Vendimin e Komisionit 2009/177/ EC.

- Rregullore mbi krijimin e listës së zonave të miratuara në lidhje me ostreae Bonamia dhe/ose Marteilia refringens cili perfarohet me Vendimin e Komisionit 2002/300/ EC.
- Rregullore "Mbi vendosjen e masave transitore per implementimin e rregulloreve 853/2004/KE, 854/2004/KE dhe 882/2004/KE te Parlamentit dhe e Këshillit Evropian", e cila perafrohet me Rregulloren e Komisionit 1666/2006/ EC.
- Rregullore "Mbi vendosjen e masave transitore per implementimin e rregulloreve 853/2004/KE, 854/2004/KE dhe 882/2004/KE te Parlamentit dhe e Këshillit Evropian" e cila perafrohet me Rregulloren e Komisionit 479/2007/ EC.
- Rregullore mbi materialet dhe artikujt plastic te percaktuar te jene ne kontakt me ushqimin, e cila perafrohet me Rregulloren 10/2011/ EC.
- Rregullore mbi enzimat ne produktet ushqimore, e cila perafrohet me Rregulloren 1332/2008/ EC.
- Rregullore mbi kerkesat e gjurmueshmerise per ushqimet me origjine shtazore, e cila perafrohet me Rregulloren 931/2011/ EC.
- Rregullore mbi listen e produkteve me origjine shtazore subjekt per kontroll veterinar ne PIK, e cila perafrohet me Direktiven 2007/275/ EC.
- Rregullore në lidhje me zgjatjen e periudhës së tranzicionit dhënë operatorëve të biznesit të ushqimit qe importojne vaj peshku te destinuar për konsum njerëzor, e cila perafrohet me Rregulloren e Komisionit 1246/2007/ EC.
- Rregullore Mbi shenjat e identifikimit, qumështit të papërpunuar dhe produkteve te qumështit, vezët dhe produktet e vezëve dhe prodhimeve të caktuara te peshkimit, e cila perafrohet me Rregulloren e Komisionit 1020/2008/ EC.
- Rregullorja në lidhje me zgjatjen e periudhës së tranzicionit dhënë operatorëve të biznesit të ushqimit importuar vaj peshku destinuar për konsum njerëzor, e cila perafrohet me Rregulloren e Komisionit 1023/2008/ EC.
- Rregullat e shendetit te kafsheve me qellim prodhimin, perpunimin dhe perdorimin e produkteve me origjine shtazore per konsum human, e cila perafrohet me Direktiven 2002/99/ EC.
- Rregullore mbi tretesat ekstraktues te perdorur ne prodhimin e produkteve ushqimore dhe ingredienteve ushqimore, e cila perafrohet me Direktiven 2009/32/ EC.
- Rregullore mbi percaktimin e kriterit te pastertise per ngjyruesit e perdorur ne produktet ushqimore, e cila perafrohet me Direktiven 2008/128/ EC.
- Pranimi i ngarkesave personale me produkte me origjine shtazore, e cila perafrohet me Rregulloren 206/2009/ EC.
- Percaktimi i masave zbatuese per disa produkte te perktuara ne pakten higjenike dhe organizimi i kontrolleve zyrtare, e cila perafrohet me Rregulloren 2074/2005/ EC.
- Per deklaratat ushqimore dhe shendetsore te bera ne produktet ushqimore, e cila perafrohet me Rregulloren 1924/2006/KE.
- Rregullore mbi udhëzuesit për qëllimin e skemave mbikqyrese te shëndetit te kafshëve të bazuara në risk, të parashikuara në Direktivën e Këshillit 2006/88/KE, e cila perafrohet me Vendimin e Komisionit 2008/896/ EC.
- Rregullore mbi hartimin e planeve të kampionimit dhe metodat diagnostike për zbulimin dhe konfirmimin e pranisë së sëmundjeve ne molusqe Bonamiosis (Bonamia ostreae) dhe Marteiliosis (Marteilia refringens), e cila perafrohet me Vendimin e Komisionit 2002/878/ EC.

- Rregullore per zbatimin e Direktivës së Këshillit 2006/88/KE persa i përket kërkesave për karantinë te kafsheve te akuakultures, e cila perafrohet me Vendimin 2008/946/ EC.
- Rregullore produktet ushqimore dhe ingredientet ushqimore te trajtuar me rrezatim jonizues, , e cila perafrohet me Direktiven 1999/2/EC.
- Rregullore mbi reduktimin e pranise se dioksinave, furaneve dhe PCB-ve ne produkte ushqimore, e cila perafrohet me Rekomandimin e Komisionit 2011/516/ EC.
- Rregullore mbi kontributet financiare ne drejtim te koordinimit te programeve e monitorimit ne *Listeria monocytogenes te perh* ne disa ushqime te gateshme per tu ngrene, , e cila perafrohet me Vendimin e Komisionit 2010/75/ EC.
- Rregullore mbi percaktimin e certifikatave te reja per importimin e produkteve me origjine shtazore, e cila perafrohet me Vendimin e Komisionit 2007/240/ EC.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Plan monitorimi per qumeshtin e paperpunuar
- Plan monitorimi per peshkun.
- Plan monitorimi per mishin.
- Kontrolle zyrtare mbi operatore biznesi prodhues perpunues ne zbatim te ligjit per ushqimit ne pergjithesi dhe zbatimin e sistemit te vetkontrollit.
- Trajnim i stafit te AKU.
- Trajnim mbi procedurat e inspektimit per inspektoret e AKU.
- Trajnim ne Programet paraprake dhe HACCP".

3.12.2. POLITIKAT VETERINARE

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Qeverisë Shqiptare (ose Ministrisë së Bujqësisë dhe institucioneve të tjera me detyra në këtë fushë/ministrive dhe institucioneve publike të shtetit shqiptar) është garantimi në shkallën më të lartë i shëndetit të qytetarëve shqiptar dhe perfeksionimi i sistemit të mbikëqyrjes dhe garantimit të sigurisë ushqimore. Ky sistem do të shërbejë për mbrojtjen sa më të mirë të shëndetit të popullatës nga sëmundjet/ dëmtimet si pasojë e konsumimit të produkteve ushqimore me origjinë bimore ose shtazore.
Vizioni, prioritetet dhe qëllimet strategjike synojnë krijimin e një sistemi me funksionim të plotë të sigurisë ushqimore dhe te mbrojtjes se konsumatorit, nga ferma ne tavolinë, qe mbulon te gjithë vendin si dhe monitorim dhe kontroll modern në përputhje me standardet e BE-së.
Përafrimi i standardeve aktuale me ato të BE-së, të sigurisë së produkteve ushqimore, të shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve, mbrojtjes se mjedisit, sistemit të kontrollit dhe inspektimeve, zhvillimi i infrastrukturës administrative me qëllim zbatimin e legjislacionit, janë pjese e politikës se sigurisë ushqimore që rrjedh nga Neni 76, MSA-së si më poshtë:

- Forcimi i sistemit te sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit dhe sistemeve të kontrollit që kanë lidhje me të.

- Të arrihen përmirësime thelbësore për sa i takon sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit dhe kushteve fitosanitare dhe veterinare, në përputhje me standardet e KE-së.

Po ashtu, neni 95 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian do të ketë si synim modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë shqiptare dhe sektorit agro-industrial, si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave me rregullat dhe standardet komunitare.

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Forcimit të sistemit institucional të sigurisë së ushqimit dhe sistemeve të kontrollit që kanë lidhje me të,
- Përforcimit të kapaciteteve laboratorike në sigurinë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitetit,
- Përmirësimit të legjislacionit për sigurinë ushqimore, fitosanitetin dhe veterinarinë dhe zbatimit të tij.

Situata aktuale

Institucionet e përfshira në garantimin e sigurisë ushqimore në tërësi dhe të situatës epidemiologjike, veçanërisht ndaj sëmundjeve zoonotike janë Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucionet e varësisë së saj.
Funksionet politikë-bërëse realizohen nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Drejtoria e Shëndetit të Kafshëve është përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit në fushën e veterinarisë me qëllim integrimin e kontrollit të ushqimeve si një nga funksionet kryesore në mbrojtje të interesave dhe shëndetit të konsumatorit si dhe futjen e produkteve ushqimore në tregun ndërkombëtar. Ajo ndihmon në zhvillimin dhe implementimin e politikave veterinare në zinxhirin ushqimor nga "ferma tek tavolina".

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligjit nr. 10465, dt. 29.09.2011 "Mbi Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë"; (fletore zyrtare nr.143, datë 23/10/2011). Përafron pjesërisht: Direktivën 82/894/KEE të Këshillit, datë 21 Dhjetor 1982. Numri CELEX:31982L0894, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 378, datë 31. 12. 1982, faqe 58 – 62; Direktivën e Këshillit 86/609/KEE, datë 24 Nëntor 1986 "Mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare në lidhje me mbrojtjen e kafshëve që përdoren për qëllime eksperimentale dhe për qëllime të tjera shkencore", CELEX 31986L069, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 358, datë 18. 12. 1986, faqe 1 – 28; Direktivën 90/425/KEE të Këshillit, datë 26 Qershor 1990 "Mbi kontrollet veterinare dhe zooteknike që zbatohen në tregëtinë brenda komunitetit të disa lloje kafshësh të gjalla dhe produktet e tyre me qëllim plotësimin e tregut të brendëshëm". Numri CELEX: 31990L0425, Fletorja Zyrtare e

Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 224, datë 18. 8. 1990, faqe 29 – 41; Direktivën 91/496/KEE të Këshillit, datë 15 Korrik 1991 "Mbi vendosjen e parimeve që rregullojnë organizimin e kontrolleve veterinare për kafshët që hyjnë në Komunitet nga vendet e treta". Numri CELEX: 31991L0496, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 268, datë 24. 9. 1991, faqe 56 – 68; Direktivën 92/119/KEE të Këshillit, datë 17 Dhjetor 1992 "Mbi masat e përgjithëshme të Komunitetit për kontrollin e disa sëmundjeve të kafshëve dhe masat specifike lidhur me sëmundjen vezikulare të derrit". Numri CELEX: 31992L0119, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 62, datë 15. 3. 1993, faqe 69 - 85.; Direktivën 93/119/KE të Këshillit, datë 22 Dhjetor 1993 "Për mbrojtjen e kafshëve në kohën e therjes apo eliminimit". Numri CELEX: 31993L0119, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 340, datë 31. 12. 1993, faqe 21 – 34; Direktiva 96/23/KE e Keshillit, date 29 Prill 1996, "Mbi masat per monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve te tyre ne kafshet e gjalla dhe produktet shtazore", Numri CELEX: 31996L023, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 125, datë 23. 5. 1996, faqe 10 – 32; Direktivën 97/78/KE të Këshillit, datë 18 Dhjetor 1997 "Mbi parimet e organizimit të kontrollit veterinar mbi produktet që hyjnë në Komunitet nga vendet e treta". Numri CELEX: 31997L0078, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 24, datë 30. 1. 1998, faqe 9 – 30; Direktivën 98/58/KE të Këshillit, datë 20 Korrik 1998 "Mbi Mbrojtjen e Kafshëve të mbajtura për qëllime blegtorale". Numri CELEX: 31998L0058, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 221, datë 8. 8. 1998, faqe 23 – 27; Direktivën 2001/82/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 6 Nëntor 2001 "Mbi Kodin e Komunitetit për Produktet Mjekësore Veterinare". Numri CELEX: 32001L0082, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 311, datë 28. 11. 2001, faqe 1 – 66; Direktivën 2002/32/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 7 Maj 2002 "Mbi substancat e padëshiruara në ushqimin e kafshëve". Numri CELEX: 32002L0032, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 140, datë 30. 5. 2002, faqe 10 - 22.)

- Ligjit nr. 8702, 01.12.2000 " Mbi sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve"; Fletore zyrtare nr 47 datë .01.12.2000, Përafron pjesërisht dir. 92/102 EEC, Nr CELEX. 31992L0102) Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L 355 datë 5.12.1992, faqe. 32-36
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 19.03.2008 " Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale"
  (Fletore zyrtare nr. 49, datë 11/04/2008)
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 198. date, 19.02.2009 " Për një ndryshim në VKM nr.320, datë 19.03.2008, Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale "
  (Fletore zyrtare nr. 40, datë 04.04.2009)
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 831. date, 29.07.2009 " Për një shtesë në VKM nr.320, datë 19.03.2008, Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale "(Fletore zyrtare nr. 130, datë 5 Shtator 2009)

Aktet nën/ligjore që transpozojnë akte te Bashkimit Evropian

- Rregullore Nr 432, 09/11/06 ” Për kontrollin e sëmudjes së brucelozës në të imta”. Direktivat nr.77/391/ EEC e datës 17 Maj1977; 78/52/EEC e datës 13 Dhjetor 1977; 82/400/EEC e datës 14 Qershor 1982, 91/68/EEC e datës 28 Janar 1991. Shkalla e përafrimit i pjesshëm. (Celex. 31978L0052, 31982L0400, 31991L0068)
- Rregullore Nr. 4, dt. 30.12.1999, Nr. 5, dt. 30.12.1999, Nr. 6, dt. 30.12.1999 “Mbi hapjen, ndërtimin dhe funksionimin e farmacive veterinare”. direktiva nr. 91/412/EEC e datës 23 korrik 1991. Shkalla e përafrimit i pjesshëm. (Celex. 31991L0412)
- Rregullore Nr 2, 01/11/02,Për mbrojtjen e kafshëve gjatë therjes si dhe kërkesat e aplikuara për thertoret. Direktiva nr. 93/119/EC e datës 22 dhjetor 1993. Shkalla e përafrimit i pjesshëm. (Celex. 31993L0119)
- Urdhër Ministri, Nr 381 02/08/06, Për disa masa mbi zbatimin e rregullores nr. 3 datë 26.07.1999 mbi kushtet e tregtimit të kafshëve dhe produkteve të akuakulturës. Vendim nr. 453/2004/EC e dates 29 prill 2004. Shkalla e përafrimit pjesshëm. (Celex. 32004D0453)
- Urdhër Ministri Nr.366, 28/07/06, Për përcaktimin e listës së zonave dhe fermave të miratuara si të lira nga sëmundjet e septicemisë hemoragjike virale dhe nekrozës hematopoietike infektive në peshq, të cilat lejohet importin. Vendim i komisionit bazuar në rregulloren 308/2002/EC e dates 22 prill 2002. Shkalla e përafrimit i pjesshëm. (Celex 32002D0308).
- Rregullore Nr.3, 26.07.1999, “Mbi kushtet e tregtimit të kafshëve dhe produkteve të akuakulturës”, direktiva nr. 91/67/EEC e dates 28 janar 1991 "Mbi kushtet e tregtimit të kafshëve dhe produkteve të akuakulturës." Shkalla e përafrimit i pjesshëm. (Celex 31991L0067).
- Rregullore Nr.2, 26.07.1999, “Mbi rregullat sanitare veterinare që administrojnë prodhimin dhe vendosjen në treg të molusqeve bivalve. Direktiva nr. 91/492/EEC e datës 15 korrik 1991 Mbi rregullat sanitare veterinare që administrojnë prodhimin dhe vendosjen në treg të molusqeve bivalve. Shkalla e përafrimit i pjesshëm. (Celex. 31991L0492).
- Rregullore nr. 370, 28/07/06, “Për mbajtjen e regjistrit të fermës së akuakulturës mbi lëvizjet, karantinën, mortalitetin dhe sëmundjet detyrimisht të lajmërueshme në peshq dhe molusqe”. Direktiva nr. 93/53/EC e dates 24 Qershor 1993 "Masat e kontrollit ne sumundjet e peshqve". Shkalla e përafrimit i pjesshëm. (Celex. 31993L0053).
- Urdhër Ministri nr.1294, date 13/03/06, mbi organizimin e kontrolleve zyrtare në molusqet bivalve të gjallë dhe produktet e peshkimit. Rregullore nr. 854/2004/EC e dates 29 prill 2004. Shkalla e përafrimit i pjesshëm. (Celex. 32004R0854)
- Rregullore Nr.2, datë 17/03/06, “Mbi normat specifike të higjienës për molusqet bivalvë të gjallë”. Rregullore nr. 853/2004/EC e dates 29 prill 2004. Shkalla e përafrimit i pjesshëm. (Celex. 32004R0853)
- Rregullore Nr. 1, datë 15/03/06, “Mbi përcaktimin e kushteve shëndetësore të kafshëve dhe kërkesat e certifikimit për eksport të molusqeve bivalve të gjallë, vezëve dhe gametave të tyre për rritje të mëtejshme të tyre, majmëri apo konsum human” Vendim nr. 2003/804/EC e dates 14 Nëntor 2003, Rregulore nr. 853/2004/EC e dates 29 Prill 2004. Shkalla e përafrimit i pjesshëm. (Celex. 32003D0804)

- Rregullore, NR. 1 datë 17.3.2000, “Mbi masat për monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve në kafshë të gjalla dhe produkte shtazore”. Direktiva nr. 96/23/EEC e datës 29 prill 1996 " Masat kontrolluese për parandalimin e përdorimit". Shkalla e përafrimit i pjesshëm. (Celex. 31996L0023).
- Rregullore, Nr.4 datë 11.6.2004,” Mbi kontrollin e sëmundjes së pseudopestit. Direktiva nr. 92/66/EEC e datës 14 korrik 1992 “Masat kontrolluese të sëmundjes së pseudopest”. Shkalla e përafrimit i pjesshëm. (Celex. 31992L0066).
- Rregullore Nr.1 datë 4.12.2003, “Mbi kontrollin e sëmundjes Lopa e Çmendur”. Rregullore nr. 999/2001/EC e datës 22 maj 2001. Shkalla e përafrimit i pjesshëm. (Celex. 32001R0999).
- Urdhër Ministri Nr.405, datë 15.11.2007 mbi miratimin e “Rregullore që vendos masat minimale të kontrollit të Murtajës Klasike në Derra”, përcakton kriteret kontrollin e Murtajës Klasike në Derra. Direktive nr 2001/89/EC, e datës 23.10.2001 “Mbi masat minimale për kontrollin e Murtajës Klasike në Derra”. Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32001L0089).
- Urdhër Ministri Nr.404, datë 15.11.2007 mbi miratimin e “Manual i procedurave diagnostike, metodat e kampionimit dhe kriteret e vlerësimit të provave laboratorike për konfirmimin e MKD”, Vendim Nr. 2002/106/EC datës 1.02.2002 “Manual i procedurave diagnostike, metodat e kampionimit dhe kriteret e vlerësimit të provave laboratorike për konfirmimin e MKD”. Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32002D0106).
- Urdhër Ministri Nr.406, datë 15.11.2007 “Mbi miratimin e “Regullore mbi përcaktimin e kërkesave të shëndetit të kafshëve që zbatohen në tregëtimin e importin e spermës së kafshëve shtëpiake të llojit gjedhë”. Dir.88/407/EEC e datës 14 Qershor 1988 “Mbi përcaktimin e kërkesave të shëndetit të kafshëve që zbatohen në tregëtimin e importin e spërmes së kafshëve shtëpiake të llojit gjedhë”. Përafrim i pjesshëm. (Celex. 31988L0407).
- Urdhër Ministri Nr. 365, datë 28/07/06 “Mbi miratimin e “Rregullore që vendos kushtet e shëndetit të kafshëve dhe kërkesat e certifikimit për import të peshkut të gjallë, vezëve, gametave të caktuara për mbarështim dhe peshkut të gjallë me origjinë aquakulture”. Vendim 2003/858/EC e datës 21 Nëntor 2003 “Mbi kushtet e shëndetit të kafshëve dhe kërkesat e çertifikimit për import të peshkut të gjallë , vezëve, gametave të caktuara për mbarështim dhe peshkut të gjallë me origjinë aquakulture”. Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32003D0858).
- Urdhër Ministri Nr. 407, datë 15/11/07 mbi miratimin e “Rregullore lidhur me listën e disa territoreve nga të cilat importimi i disa llojeve të peshqeve, gametave dhe vezëve të tyre është i lejuar në Shqipëri”. Vendim 2005/0742 /EC e dates 1 Shkurt 2002 “Mbi listën e disa territoreve nga të cilat importimi i disa llojeve të peshqeve, gametave dhe vezëve të tyre është i lejuar në KE. Perafrim i pjesshëm. (Celex. 32005D0742).
- Urdhër Ministri Nr. 403, datë 15/11/07 mbi miratimin e “Rregullore mbi përfshirjen e disa sëmundjeve në kuaj e në bletë në listën e sëmundjeve të lajmërueshme”. Vendim 2004/216/EC e dates 1 Mars 2004 “Mbi përfshirjen e disa sëmundjeve në kuaj e në bletë në listën e sëmundjeve të lajmërueshme”. Perafrim i pjesshëm. (Celex.32004D0216).
- Urdhër Ministri Nr.1, datë 08.01.2007 mbi miratimin e rregullores “Mbi përcaktimin e rregullave specifike zyrtare në kontrollet zyrtare në produktet me origjinë shtazore për konsum human”. Rreg. 2004/854/EC e dates 29 Prill 2004“Mbi përcaktimin e

rregullave specifike zyrtare në kontrollet zyrtare në produktet me origjinë shtazore për konsum human". Perafrim i pjesshëm. (Celex.32004R0854).

- Urdhër Ministri Nr. 184, date 25.05,2007 Mbi miratimin e rregullores "Mbi shfuqizimin e direktivava në lidhje me higjenën e produkteve me origjinë shtazore". Dir. 2004/41/EC e datës 21 Prill 2004 "Mbi shfuqizimin e direktivava në lidhje me higjenën e produkteve me origjinë shtazore". Përafrim i pjesshëm. (Celex 32004L0041).
- Urdhër Ministri Nr.185/1, datë 25.05.2007 mbi miratimin e rregullores "Mbi zbatimin e direktivës 96/23 në lidhje me performancën e metodave analitike dhe interpretimit të rezultateve". Vendim 2002/657 /EC e datës 15 Korrik 2002 "Mbi zbatimin e direktivës 96/23 në lidhje me performancën e metodave analitike dhe interpretimit të rezultateve". Përafrim i pjesshëm. (Celex.32002D0657).
- Urdhër Ministri Nr. 8, Dt. 12.01.2007 mbi miratimin e rregullores " Mbi monitorimin e zoonozave dhe shkaktarëve të tjerë zoonotikë". Direktiva nr 2003/99 EC e datës 17 Nëntor 2003 "Mbi monitorimin e zoonozave dhe shkaktarëve të tjerë zoonotikë". Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32003L0099).
- Urdhër Ministri Nr. 185, datë 25.05.2007, mbi miratimin e rregullores " Mbi metodat analitike për kontrollin e PB,CD,MR". Dir. 2001/22/EC e dates 8 Mars 2001 "Mbi metodat analitike për kontrollin e PB,CD,MR". Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32001L0022).
- Urdhër Ministri Nr. 182, datë 25.05.2007, mbi miratimin e rregullores " Mbi vendosjen e niveleve maksimale për kontaminuesit ushqimor". Rreg. 2006/1881/EC e dates 19 Dhjetor 2006 "Mbi vendosjen e niveleve maksimale për kontaminuesit ushqimor". Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32006R1881).
- Urdhër Ministri Nr. 183, datë 25.05.2007, mbi miratimin e rregullores " Mbi rregullat specifike të higjenës për ushqimet me origjinë shtazore". Rreg. 2004/853/EC e dates 29 Prill 2004 "Mbi rregullat specifike të higjenës për ushqimet me origjinë shtazore". Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32004R0853).
- Urdhër ministri, Nr. 184/1, datë 25.05.2007, mbi miratimin e rregullores, Amendim i Rregullores "Mbi kriteret mikrobiollogjike për produktet ushqimore" ne kuadrin e kerkesave minimale per permbushjen e limiteve (MRPLs) per disa mbetje ne ushqime. Vendim 2004/25/EC e dates 20 Dhjetor 2003. Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32004D0025).
- Urdhër Ministri Nr. 142, datë 26.03.08 për ndryshimin e rregullores 185/1, date 25.05.2007 "Mbi zbatimin e dir. 96/23 në lidhje me performancen e metodave analitike dhe interpretimin e rezultateve. Vendim 2004/025/EC e dates 22.12.2004. Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32004D0025).
- Urdhër Ministri Nr. 255, date 10.06.2008 mbi Rregulloren "Per problemet e shëndetit të kafshëve që veprojnë në tregëtine e brendëshme në llojet gjedh e derr", Reg. 64/432/EEC e dates 26 Qershor 1964, Përafrim i pjesshëm. (Celex. 31964L0432).
- Urdher Ministri, Nr. 298, date 02.07.2008 për rregulloren "Mbi masat e çrrënjosjes së brucelozës, tbc dhe leukozës në gjedhë". Reg. 78/52/EEC e datës 13 Dhjetor 1977. Përafrim i pjesshëm. (Celex. 31978L0052).
- Urdher Ministri Nr. 307, dated 4.07.08 për Rregulloren "Mbi përcaktimin e standarteve minimale për mbrojtjen e pulave pjellëse". Dir. 1999/74/CE e datës 19 Koriik 1999. Përafrim i pjesshëm. (Celex. 31999L0074).

- Urdhër Ministri Nr. 223, date 26/05/08 mbi "Rregulloren që vendos rregulla te detajuara lidhur me nivelin minimal për kontrollin e kryer për sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të gjedhit". Rreg.2003/1082/CE e datës 23 Qershor 2003. Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32003R1082).
- Urdhër Ministri Nr. 274, datë 18/06/08 për Rregulloren "Mbi regjistrimin e stabilimenteve të pulave të prodhimit". Dir. 2002/4/EC e datës 30 Janar 2002. Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32002L0004).
- Urdhër Ministri Nr. 214, datë 22/05/08 për Rregulloren "Mbi zgjatjen e periudhës maksimale për aplikimin e matrikujve në disa kafshë gjedhë". Vendim 2006/28/EC e datës 18 Janar 2006. Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32006D0028).
- Urdhër Ministri Nr. 273, date 18/06/08 mbi Rregulloren "Për miratimin e listës së territoreve nga të cilat është i autorizuar importi i disa llojeve peshqish të gjallë, vezëve dhe gametave të destinuara për mbarështim në Shqiperi". Vendim 2006/680/CE e dates 6 Tetor 2006. Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32006D0680).
- Urdhër Ministri Nr. 406, dated 19/09/08 për Rregulloren "Mbi masat veterinare për kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në Shqipëri". Rreg. 2005/94/CE e dates 20 Dhjetor 2005. Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32005L0094).
- Urdhër Ministri Nr. 407, date19/09/08 për Rregulloren "Mbi implementimin e rregullores mbi vendosjen e matrikujve, pasaporten dhe regjistrin e fermes". Rreg.2004/911/EC e dates 29 Prill 2004; Dec.2006/28/EC e dates 18 Janar 2006. Përafrim i pjesshëm. (Celex. 32004R0911).
- Urdhër Ministri Nr. 469, datë 28/10/08), Rregullore "Mbi zbatimin e masave minimale administrative në kuadër të sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve gjedhë". Rregullore 494/98 EC datë 24 Shkurt 1998. Përafrim pjesërisht. (Celex. 31998R0494).
- Urdhër Ministri Nr. 4, datë 12.01.2009 mbi, "Rregullore qe perfshin nje dokument deklarimi dhe kontrollin veterinar mbi kafshet qe hyne ne KE nga vendet e treta". Rre.2004/282 CE date 18 Shkurt 2004. Përafrim pjesërisht. . (Celex. 32004R0282).
- Urdhër Ministri Nr.196, datë 11.06.2009 "Për miratimin e manualit diagnostik për influencën aviare". Dec. 2006/437 EC datë 4 Gusht 2006. Përafrim pjesërisht. (Celex. 32006D0437).
- Urdhër Ministri Nr.187, datë 11.06.2009 "Mbi rregullat e shendetit të kafshëve në tregtinë e të imtave". Dir.91/68 CE date 28 Janar 1981, dec. 2005/932 CE datë 21 Dhjjetor 2005. Përafrim pjesërisht. (Celex. 31991L0068).
- Urdhër Ministri Nr.196, datë 11.06.2009 "Mbi planet e marrjes së kampioneve dhe metodat diagnostike për zbulimin dhe konfirmimin e disa sëmundjeve në peshq" që shfuqizon Vendimin 92/532/BE". (Urdhr Ministri Nr.362/1, datë 28.07.2006). Dec. 2001/183 datë 22 Shkurt 2001. Përafrim pjesërisht. (Celex. 31992D0532).
- Urdhër Ministri Nr.235, date 27.07.2009 "Mbi masat e biosigurisë për reduktimin e rrezikut të transmetimit të Influencës Aviare me patogjenicitet të lartë". Dec. 2005/745 CE datë 21 Tetor 2005, 2005/734 CE datë 19 Nëntor 2005, 2005/855 CE datë 30 Nëntor 2005, 2006/574 CE datë 18 Gusht 2006. Përafrim pjesërisht. (Celex. 32005D0745, 32005D0734, 32005D0855, 32006D0574).
- Urdhër Ministri Nr. 236, datë 27.07.2009 "Mbi disa masa mbrojtese ne lidhje me HPAI tipi H5N1 në shpendet e egër". Dec.2006/563 CE datë 11 Gusht 2006, dec. 2006/521 datë 25 Korrik 2006. Përafrim pjesërisht. (Celex. 32006D0563).

- Urdhër Ministri Nr.420, date 17.12.2009, “Mbi kerkesat e ujit te molusqeve bivalve”. Dir. 2006/113 date 12 Dhjetor 2006. Përafrim pjesërisht. (Celex.32006L0113).
- Urdhër Ministri Nr.391, datë 26.11.2009 “Mbi përcaktimin e kritereve që duhet të zbatohen me rastin e hartimit të planeve të kontingjenës për kontrollin e Aftës Epizootike.” Dec. 91/42 CE date 11 Dhjetor 1990. Përafrim pjesërisht. (Celex. 31991D0042).
- Urdhër Ministri Nr.431, date 28.12.2009 “Mbi kushtet sanitaro-veterinare të tregtimit dhe exportit të pulave dhe vezëve për inkubim në vendet e BE-së”, Dir. 90/539 EC date 15 Tetor 1990 cfuqizuar me dir.2009/158 date 30 Nentor 2009 . Përafrim pjesërisht. (Celex. 31990L0539, 32009L0158).
- Urdhër Ministri Nr.430, datë 28.12.2009 “Mbi gjurmimin dhe luftimin e salmonelozës, zoonozave të tjera që merren me anë të ushqimit si dhe hartimin e programeve të kontrollit të zoonozave në përgjithësi”, Rreg 2160/2003 EC datë 17 Nëntor 2003. Përafrim pjesërisht. (Celex. 32003R2160),
- Urdhër Ministri Nr.3, datë 13.01. 2010 “Mbi programet e kontrollit të IA në zogj të egër”. Dec. 2006/101/ EC, datë 6 shkurt 2006. Përafrim pjesërisht. (Celex. 32006D0101)
- Urdhër Ministri Nr.8, datë 13.01. 2010 “Mbi masat kalimtare në lidhje me influencën aviare në shpendë dhe zogj të tjerë kafazi”, Dec. 2006/416. Përafrim pjesërisht. (Celex. 32006D0416).
- Urdhër Ministri Nr. 9, datë 13.01.2010 “Mbi kriteret e klasifikimit të vendeve të treta për gripin e shpendëve dhe pseudopestin përsa i përket importeve të pulave të gjalla dhe vezëve për celje”, Dec. 12 maj 1993, nr 93/342/ EEC. Përafrim pjesërisht. (Celex. 31993D0342).
- Urdhër Ministri Nr. 193 datë 06.06.2011 “Për vendosjen e kritereve për përjashtimin nga detyrimi i recetës veterinare në shpërndarjen për publikun për produkte të caktuara mjekësore veterinare për përdorim në kafshët që prodhojnë ushqim”, Dir. 2006/130 EC, datë 11 Dhjetor 2006. (Celex. 32006L0130).
- Urdhër Ministri Nr. 7 datë 26.01.2011 “Për ndalimin e qarkullimit apo përdorimit me qëllim të ushqyerit e kafshëve të disa materialeve”, dir.nr. 2004/217, datë 1 Mars 2004. Përafrim pjesërisht. (Celex. 32004D0217).
- Urdhër Ministri Nr. 192 datë 06.06.2011 Për miratimin e rregullores “Mbi substancat e padëshiruara në ushqimin e kafshëve”. Janë përafruar dir. Nr. 2002/32 EC, datë 7 Maj 2002; dir. Nr. 2005/86 EC, datë5 Dhjetor 2005; dir. 2005/87, datë 5 Dhjetor 2005 dhe dir. 2006/13, datë 3 Shkurt 2006. (Janë bashkuar 4 rregullore të parashikuara në PKZMSA në një të vetme), Përafrim pjesërish. (Celex. 32005L0086, 32005L0087, 32006L0013).
- Udhëzim Ministri Nr. 7, datë 03.06.2011 “Për reduktimin e prevalencës së seriotipeve të salmonelës në tufat e rritura të llojit gallus gallus”, Rregullore e komisionit nr. 200/2010 EC datë 10 Mars 2010. Përafrim pjesërisht. (Celex. 32010R0200).
- Urdhër Ministri Nr 264, datë 24/08/2011 “Mbi disa masa mbrojtese lidhur me tregetine e pulave për mbarështim (shpendë të egër gjahu). (Vendim 2006/605 CE, 6 Shtator 2006). Përafrim pjesërisht. (Celex. 32006D0605).
- Urdhër Ministri Nr 265, datë 24.08.2011 “Mbi përcaktimin e vendeve të treta ose pjesë të tyre si dhe kushtete e çertifikatës veterinare, nga te cilat mund te importohen

disa kafshë të gjalla dhe mish të freskët prej tyre". Rregullore 206/2010 EC e 12 Marsit 2010. Përafrim pjesërisht. (Celex.32010R0206).

- Urdhër Ministri Nr. 358, date 23. 12. 2011. "Mbi masat e përgjithëshme veterinare për kontrollin e disa sëmundjeve në kafshe dhe masat specifike lidhur me sëmundjen vezikulare të derrave", Dir.92/119 EC e 17 Dhjetorit 1992. Përafrim pjesërisht. (Celex. 31992L0119).
- Urdhër Ministri Nr. 354, datë 21.12.2011, "Mbi mbrojtjen e kafsheve gjatë transportit. Regullore Nr 1/2005 EC e 22 Dhjetorit 2004. (Celex. 32005R0001).
- Urdhër Ministri Nr. 355, datë 21.12.2011 që miraton "Rregullore që përcakton territoret e lira nga murtaja klasike e derrave", Directive 80/1095/EEC e datës 11 Nëntor 1980. Përafrim pjesërisht. (Celex. 31980L1095).
- Urdher Ministri, Nr 353, date 21.12.2011, që miraton "Rregullore mbi garancite shtese ne tregetine e derrave lidhur me semundjen e Aujeskit, kriteret e parashikimit te kesaj semundje". Vendim 2008/155 e 23 Shkurtit 2008. Përafrim pjesërisht. (Celex. 32008D0185).
- Urdhër Ministri nr. 357, date 22.12.2011, per miratimin e rregullores, "Mbi kushtet e tregtimit dhe perdorimit ne kafshe te disa lëndëv me veprim hormonal ose tirostatik dhe të beta-agonistëve", Dir. 96/22/EC e dates 29 Prill 1996. Përafrim pjesërisht. (Celex. 31996L0022).

Struktura institucionale

Drejtoria e Shëndetit të Kafshëve (DSHK) në MBUMK, e përbërë nga 8 punonjës, është autoriteti përgjegjës për rregullimin e përgjithshëm të çështjeve veterinare lidhur me shëndetin e kafshëve. Drejtoria është e përbërë nga dy sektorë, specialistët e të cilëve punojnë sipas termave të referencës të gjithë për transpozimin e aquis communitaire, dhe:

Sektori i shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve është përgjegjës për përafrimin e legjislacionit veterinar me atë të BE, hartimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të programeve të profilaksisë veterinare në shkallë kombëtare, mbikqyrjen e realizimit të programeve kombëtare të monitroimit të mbetjeve në kafshë e produkte prej tyre, mbikqyrjen e programit kombëtar te monitorimit te ujrave dhe molusqeve bivalve, mbikqyrjen e aktivitetit të veterinerëve zyrtarë të shëndetit të kafshëve në qarqe për diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve parazitare dhe infektive në zonat publike dhe rurale (*vëzhgimin, lajmërimin, parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve ngjitëse t*ë *kafshëve),* kontrollin në vazhdimësi të kushteve sanitaro veterinare të stabilimenteve të rritjes e mbarështimit të kafshëve të gjalla te llojeve të ndryshme, të aquakultures e molusqeve bivalve si dhe mbikqyrjen e zbatimit të legjislacionit veterinar kombëtar në tërësi.

Sektori i identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale është përgjegjës për funksionimin e sitemit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale, hartimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të programit të identifikimit të kafshëve e regjistrimit të fermave blegtorale.

Shërbimi veterinar rajonal i shëndetit të kafshëve është një sistem kontrolli i organizuar në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, si " Sektor Veterinar" i cili është në vartësi

administrative të DRB dhe përgjigjet teknikisht për të gjithë aktivitetin e tij në Drejtorinë e Shëndetit të Kafshëve në MBUMK.

Në vartësi të 12 Sektorëve Veterinarë në DRB –së janë :

- 157 Veterinerë zyrtarë në Drejtorite Rajonale të Bujqësisë në Qarqe, rrethe, komuna;
- 500 Inspektorë Veterinerë në rrjetin e shërbimit veterinar privat me kontratë.

Ky rrjet kontrolli, garanton zbatimin e Ligji Nr. 10465, dt. 4.11.2004 "Për shërbimin veterinar në Rebublikën e Shqipërisë" dhe Ligjit nr. 8702, 01.12.2000 " Mbi sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve", VKM–të e aktet nënligjore në zbatim të tyre, dhe është përgjegjës për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve

Ai kryen kontroll në qarqet, bashkitë dhe komunat me qëllim:

- parandalimin e sëmundjeve;
- garantimin e kushteve sanitaro-veterinare në tregjet e kafshëve të gjalla e stabilimentet e rritjes e mbarështimit të kafshëve;
- kontrollin e ushqimit të kafshëve;
- Identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale;
- Monitorimin e mbetjeve në kafshët e gjalla e produktet shtazore;

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV) varet nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe është përgjegjës për hartimin në bashkëpunim me DSHK të strategjive të gjurmimit dhe luftimit të sëmundjeve infektive, parazitare në kafshet e tokës, të ujit dhe shpendëvë. Ky Institut ka në varësi te tij 11 Laboratore Rajonale, të cilët janë përgjegjës për gjurmimin, analizimin dhe diagnostikimin e sëmundjeve infektive, parazitare në kafshët e tokës, të ujit dhe në shpendë.
Instituti kryen diagnozat veterinare dhe testimin e profilaksisë së shëndetit të kafshëve në përputhje me programin kombëtar. Ai kryen programe testuese për kontrollin e sëmundjeve epizotike, ilaçeve veterinare dhe diagnozat e sëmundjeve të përgjitshme, është përgjegjës për zbatimin e programeve kombëtare të monitorimit të mbetjeve, ujrave e molusqeve bivalve. Ai është përgjegjës gjithashtu për kryerjen e testimeve të produkteve ushqimore me origjinë shtazore në bashkepunim me Institutin e Shëndetit Publik. ISUV bashkëpunon me FAO, WHO, OIE dhe laboratorë të tjere reference për konfirmimin e sëmundjeve të ndryshme infektive.

Masat legjislative afatshkurtra

- Ligj "Për Urdhërin e mjekut veteriner"
- VKM "Për dëmshpërblimin e kafshëve të eliminuara apo dëmtuara"
- VKM "Për Standardet e shërbimit veterinar të qeverisjes vendore"
- Rregullore mbi kushtet e shendetit te kafsheve ne importin e njëthundrakëve. (Dir.2004/68EC) CELEX. 32004L0068

- Rregullore mbi kërkesat e certifikatave veterinare dhe listën e shteteve prej të cilave mund të importohen shpendë ose produkte të shpendeve. (Rreg. Komisionit 2008/798/EC) CELEX. 32008R0798
- Rreg. mbi kërkesat e shëndetit të kafshëve në importin e kafshëve, spermës, ovulave dhe embrioneve të tyre". (Dir.1992/65/EC) CELEX. 31992L0065
- Rreg.mbi listen e vendeve të treta të autorizuara për importin e spermës, ovulave, embrioneve me origjinë nga derrat. (Dec.2008/636/EC CELEX. 32008D0636.
- Rregullore mbi mbrojtjen e kafshëve që mbarështohen në ferma. (Dir. Këshillit 98/58/EC) CELEX.31998L0058.
- Rregullore për mbrojtjen e kafshëve gjatë eleminimit të tyre. (Rregullore 1099/2009/EC) CELEX. 32009R1099.
- Rregullore mbi kërkesat shëndetësore të kafshëve për lëvizjen jotregtare të kafshëve të shoqërimit. (Rregullore 998/2003/EC) CELEX. 32003R0998.
- Rregullore mbi masat e kontrollit të Aftës Epizootike (Dir.2003/85CE) CELEX. 32003L0085.
- Rregullore mbi kodin komunitar në lidhje me produktet medicinale veterinare. (Dir.2001/82) CELEX 32001L0082.
- Rregullore që përcakton kushtet specifike per kontrollin e murtajes afrikane të derrave. (Dir.2002/60 CE). Heqje nga 2005/624/EC CELEX 32002L0060
- Rregullore mbi manualin diagnostik të murtajës afrikane të derrave. (Dec.2003/422 EC) CELEX 32003D0422.
- Rregullore mbi masat e luftimit të sëmundjes së influencës në shpendë të tjere veç pulave (shoqërimit). (Dec 2007/25/EC of 22 December 2006) CELEX. 32007D0025.
- Rregullore mbi vendosjen dhe administrimin në treg të somatotropines bovinë. (Dec.1999/879 EC of 17 Dec 1999) CELEX.31999D0879
- Rregullore mbi masat administrative lidhur me mbrojtjen e kafshëve të laboratorit. (Directive 86/609/EEC) CELEX. 31986L0609.

Aktivitetet zbatuese

- Realizimi i programit kombëtar të profilaksisë veterinare.
- Identifikimi i gjedhit dhe të imtave në të gjithë territorin e vendit.
- Realizimi sipas programit kombëtar i monitorimi të mbetjeve, monitorimit të ujrave dhe molusqeve bivalve.
- Monitorimi i sëmundjeve në kafshë sipas programit të hartuar nga DSHK në bashkëpunim me ISUV.
- Realizimi i të gjitha aktivitetet mbështetëse të Projektit PAZA " Fuqizimi i mbrojtjes të shëndetit human kundër sëmundjeve zoonotike" (identifikimi i të imtave, brenda vitit 2012, vaksinimi i të imtave k/brucelozës)
- Trajnimi i mëtejshëm i veterinerëve zyrtarë në fushën e identifikimit të kafshëve, regjistrimit të fermave blegtorale, kontrollit të sëmundjeve në kafshë.
- Trajnim i stafit në fushën e legjislacionit të BE si dhe standardeve të BE –së në kontrollin kontrollin sanitaro-veterinar.
- Zbatimi i projektit IPA 2008 "Fuqizimi i mbrojtjes të shëndetit human kundër sëmundjeve zoonotike".

Masat legjislative afatmesme

- Rregullore mbi garancitë shtesë në tregtinë e kafshëve të llojit gjedhe lidhur me infeksionin e rinotrakeitit infektiv të gjedhit dhe miratimin e programit të çrrenjosjes. Dec.04/0558 EC. CELEX 32004D0558.
- Rregullore që përcakton kërkesat e shëndetit të kafshëve dhe çertifikimit veterinar të importimin të zogjve, përveç pulave dhe kushtet e karantinës. Rreg. 318/2007 EC. CELEX. 32007R0318.
- Rregullore mbi mbikqyrjen epidemiollogjike dhe testet për encefalopatitë sfungjerore të transmetueshme Rreg.1248/2001 EC. CELEX. 32001R1248.
- Rregullore që përcakton masat e përkohshme për parandalimin, kontrollin dhe zhdukjen e disa encephalopathive spongiform të transmetueshme. Reg. 01/1326 EC. CELEX. 32001R1326.
- Rregullore përcakton rregullat e shëndetit në lidhje me nënproduktet shtazore jo per qëllim konsum human. Rreg.1069/2009 EC FAQE) CELEX. 32009R1069.
- Rregullorja mbi kërkesat e shëndetit të kafshëve të zbatueshme ne lëvizjen jo-tregtare të kafshëve të shoqerimit. Rreg. 03/998, Dec. 04/0301 EC.Faqe 20 CELEX 32003R0998 .
- Rregullore lidhur masat për çrrënjosjen e encephalopathive spongiforme të transmetueshme në, kafshët gjedh, dele dhe dhi, e tregtine dhe importimin e spermës dhe embrioneve të kafshëve dhen e dhi. Reg.2004/1492 EC. CELEX. 32004R1492. 20 faqe.
- Rregullore mbi shpenzimet në fushën e veterinaries. Dec.2009/470/EC CELEX 32009D0470
- Rregullore qe vendos modelin e një pasaporte për lëvizjet e qenve e maceve. Dec.2003/803/EC. CELEX. 32003D0803
- Rregullore që përcakton standardet minimale për mbrojtjen e viçave. Dir.2008/119/EC CELEX 32008L0119
- Rregullore që përcakton standardet minimale për mbrojtjen e derrave. Dir. 2008/120/EC CELEX 32008L0120
- Rregullore qe vendos modelin e certificates se shendetit per importin e qenve, maceve. Dec. 04/595/ EC CELEX 32004D0595
- Rregullore mbi nivelin minimal të kontrolleve lidhur me identifikimin dhe regjistrimin e dhenve dhe dhive. Reg. (EC) No 1505/2006. CELEX. 32006R1505
- Rregullore mbi masat për luftimin e sëmundjes afrikane në kuaj. Directive 92/35/EEC of 29 April .CELEX. 31992L0035.
- Rregullore Mbi rregullat për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e disa encefalopative të trasmetueshme. Regullore (EC) Nr 999/2001 ". CELEX. 32001R0999.
- Rregullore mbi perdorimin të mikroorganizmave gjenetikisht te modifikuar. Dir. 2009/41/EC. CELEX. 32009L0041.
- Rregullore "Mbi kushtet e shëndetit të kafshëve në tregëtinë e kafshëve të llojit gjedhe derr .Rregullore ECnr 64/432. CELEX. 31964L0432
- Rregullore "Mbi kushtet e shëndetit të kafshëve që rregullorojnë tregëtinë e kafshëve të llojit dhen e dhi" Directiva 91/68/EEC e 28 Janarit 1991.CELEX 31991L0068.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Realizimi i programit kombëtar të profilaksisë veterinare.
- Identifikimi i gjedhit dhe të imtave në të gjithë territorin e vendit.
- Realizimi sipas programit kombëtar i monitorimi të mbetjeve, monitorimit të ujrave dhe molusqeve bivalve.
- Monitorimi i sëmundjeve në kafshë sipas programit të hartuar nga DSHK në bashkëpunim me ISUV.
- Realizimi i të gjitha aktivitetet mbështetëse të Projektit PAZA " Fuqizimi i mbrojtjes të shëndetit human kundër sëmundjeve zoonotike" (vaksinimi i të imtave k/brucelozës)
- Trajnimi i mëtejshëm i veterinerëve zyrtarë në fushën e identifikimit të kafshëve, regjistrimit të fermave blegtorale, kontrollit të sëmundjeve në kafshë.
- Trajnim i stafit në fushën e legjislacionit të BE si dhe standardeve të BE –së në kontrollin kontrollin sanitaro-veterinar.
- Zbatimi i projektit IPA 2008 "Fuqizimi i mbrojtjes të shëndetit human kundër sëmundjeve zoonotike".

3.12.3. POLITIKAT FITOSANITARE (MBROJTJA E BIMËVE)

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Qeverisë shqiptare (ose Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucioneve të tjera me detyra në këtë fushë/ministrive dhe institucioneve publike të shtetit shqiptar) është garantimi në shkallën më të lartë i shëndetit të qytetarëve shqiptar dhe perfeksionimi i sistemit të mbikëqyrjes dhe garantimit të sigurisë ushqimore. Ky sistem do të shërbejë për mbrojtjen sa më të mirë të shëndetit të popullatës nga sëmundjet/ dëmtimet si pasojë e konsumimit të produkteve ushqimore me origjinë bimore. Vizioni, prioritetet dhe qëllimet strategjike synojnë krijimin e një sistemi me funksionim të plotë të sigurisë ushqimore dhe të mbrojtjes së konsumatorit, nga ferma ne tavolinë, që mbulon të gjithë vendin si dhe monitorim dhe kontroll modern në përputhje me standardet e BE-së.

Përafrimi i standardeve aktuale me ato të BE-së, të sigurisë së produkteve ushqimore, të shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve, mbrojtjes së mjedisit, sistemit të kontrollit dhe inspektimeve, zhvillimi i infrastrukturës administrative me qëllim zbatimin e legjislacionit, janë pjesë e politikës së sigurisë ushqimore që rrjedh nga Neni 76, MSA-së si më poshtë:

- Forcimi i sistemit të sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit dhe sistemeve të kontrollit që kane lidhje me të.
- Të arrihen permiresime thelbesore per sa i takon sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit dhe kushteve fitosanitare, ne perputhje me standardet e KE-së.

Po ashtu, neni 95 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian do të ketë si synim modernizimin dhe

ristrukturimin e bujqësisë shqiptare dhe sektorit agro-industrial, si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave me rregullat dhe standardet komunitare.

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Forcimit të sistemit institucional të sigurisë së ushqimit dhe sistemeve të kontrollit që kanë lidhje me të,
- Përforcimit të kapaciteteve laboratorike në sigurinë ushqimore dhe fitosanitetare
- Përmirësimit të legjislacionit për sigurinë ushqimore, fitosanitare dhe zbatimit të tij.

Situata aktuale

Institucionet e përfshira në garantimin e sigurisë ushqimore në tërësi dhe të situatës fitosanitare, vçanërisht ndaj paraziteve të bimeve dhe perdorimit dhe mirë-administrimit të produkteve të mbrojtjes së bimeve janë Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucionet e varësisë së saj dhe Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e varësisë së saj. Funksionet politikë-bërëse realizohen nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Si pjesë e Ministrisë së Bujqësisë funksionon Drejtoria e Pergjithshme e Politikave bujqësore (Sektori i mbrojtjes së bimeve). Kjo drejtori është përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit në fushën e mbnrojtjes së bimeve me qëllim integrimin e kontrollit të ushqimeve si një nga funksionet kryesore në mbrojtje të interesave dhe shëndetit të konsumatorit si dhe futjen e produkteve ushqimore me origjine bimore në tregun ndërkombëtar. Ajo ndihmon në zhvillimin dhe implementimin e politikave fitosanitare në zinxhirin ushqimor nga "ferma tek tavolina".

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Shërbimi i Mbrojtjes së Bimeve bazohet në Ligjin nr.9362. datë 24.03.2005 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve" (i ndryshuar), Ligji nr.9908, datë 24.04.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9362. datë 24.03.2005 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve". Ky Ligj lejon hartimin dhe miratimin e rregulloreve dhe udhëzimeve në përputhje me Directivat e BE-së të fushës së mbrojtjes së bimëve (kryesisht të dy directivave bazë si 2000/29 dhe 91/414, etj)
Në zbatim të tij dalin rregullore dhe udhëzime në përputhje sa më të plotë me acquis communitare, për këtë është paraparë rishikimi i këtij Ligji deri në fund të këtij viti me qëllim krijimin e hapsirave të tjera për plotësimin e kuadrit ligjor në përputhje me atë të BE-së.
Nga Sektori i mbrojtjes së Bimeve në kuadër të MSA-së, për vitin 2011 janë hartuar dhe miratuar 3 rregullore Udhëzime të Ministrit si më poshtë vijon:

- Udhëzim i ministrit të MBUMK Nr.8 Datë 9.6.2011; " Për Regullat për njohjen e zonave të pa prekura dhe për lëvizjen e bimeve, të produkteve bimore e të objekteve të tjera brenda një zone të pa prekur" në përafrim të Dir. 92/70/EEC, e 30 korrik 1992; Dir.2001/32/EC, e 8 maj 2001; dhe të Dir. 93/51/EC, e 24 korrik 1993.Shkalla e Përafrimit e pjesshme

- Udhëzim i ministrit të MBUMK Nr. 10 Datë 14.6.2011; “ Për Miratimin e proçedurave të zbulimit, ndalimit dhe të njoftimit të një ngarkese ose të një paraziti nga vëndet e tjera, që paraqet rrezik fitosanitar të mundshëm” në përafrim të Dir. 94/3/EC, e 21 janar 1994. Shkalla e Përafrimit rreth 80%
- Udhëzim i ministrit të MBUMK Nr. 9 Datë 14.6.2011; “ Për Vendosjen e një sistemi detyrues të regjistrimit të prodhuesve dhe tregëtuesve të bimëve dhe produkteve bimore.” Në përshtatje të Dir. 92/90/EC, e 3 Nëntor 1992. Shkalla e Përafrimit rreth 80%

Masat legjislative afat shkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përcaktimi më i qartë i kompetencave të institucioneve të përfshira në realizimin e mbrojtjes së bimeve, përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Ligj mbi ndryshimin e ligjit Nr.9362, datë 24.03.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve” (i ndryshuar) (*Fletore Zyrtare e RSH nr. 29 datë 3 maj 2005*). Ky projektligj do të lejojë perafrimin e Rregulloreve të tjera të EC.
- -Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 1188, datë 20.8.2008 “Për miratimin e rregullave për importimin, tregetimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e Produkteve të Mbrojtjes së bimëve (PMB-ve*)”.(Fletore Zyrtare RSH 141 datë11 Shtator 2008*) i cili përafron plotësisht këto akte komunitare: Direktivën 91/414/EC.

Aktivitetet zbatuese

- trajnim i mëtejshëm i personelit të Mbrojtjes së Bimeve dhe të specialisteve të mbrojtjes së bimëve pranë DRB-ve.
- Tenderim i teknikës laboratorike për analizat e mbetjeve të PMB-ve në bimë dhe produktet me origjine bimore.
- Zbatimi i projektit IPA 2010 “Mbështetje për Ministrinë e Bujqësisë”.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat legjislative afatmesme janë si vijon:

- Udhëzim i Ministrit të MBUMK-së "Për miratimin e rregullave mbi kerkesat që duhen rrespektuar per materialet shumëzues të bimeve zbukuruese. (Viti 2013).Dir. 93/49/EEC e 23 tetor 1993, me amendimet e saj. Celex 31993L0049.
- Udhëzim i Ministrit të MBUMK-së "Për miratimin e rregullave për vendosjen e pasaportës bimore, e cila përdoret për lëvizjen e bimeve e të produkteve bimore. (Viti 2013). Dir. 92/105/EEC e 3 dhjetor 1992, me amendimet esaj. Celex 31992L0105.

- Rregullore për regjistrimin e PMB-ve, Miratim me vendim të Keshillit të Ministrave. (Viti 2012). Rregullore (EC) Nr. 1107/2009 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, Datë 21 Tetor 2009, Celex 32009R1107.
- Rregullore për hedhjen në treg të PMB-ve. Miratim me vendim të Këshillit të Ministrave. (Viti 2013). Rregullore (EC) Nr 107/2009 e Parlamentit Europian dhe e Keshillit, e 21 tetor 2009, Celex 32009R1107.
- Rregullore për përdorimin e qëndrueshëm ë PMB-ve. Miratim me Vendim të Këshillit të Ministrave. (Viti 2014). Direktiva 2009/128/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, Datë 21 Tetor 2009.
- Udhezim i Ministrit të MBUMK-së për Statistikat e PMB-ve. (Viti 2015). Rregullore (EC) Nr 1185/2009 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, Datë 25 Nëntor 2009, Celex 32009R1185.
- Udhëzim i Ministrit të MBUMK për përdorimin e mjeteve për trajtimet kimike. (Viti 2015), Regullore 2009/127.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Zbatimi i masave të vecanta në zonat e mbrojtura për të garantuar një prodhim të pastër nga parazitet karantinor me qëllim mundësinë e eksportit në vendet e BE-së (Divjake për patatën për eksport).
- Monitorimi dhe evidentimi i bimëve të prekura nga zjarri bakterial, eleminimi i tyre. Minimizimi i përhapjes së infeksioneve të reja. (2013)
- Forcimi i sistemit të monitorimit dhe zbatimit të masave fitosanitare për parazitë të vecantë (Vazhdim i atyre të vitit 2011, si dhe për rrënjëngrënësin e misrit dhe parazitët karantinore të patatës).(2013)
- Monitorimi dhe luftimi i paraziteve të veçantë në bujqësi (Karkalecave, Miut të arave, Mizës së Ullirit) nëpërmjet trajtimit kimik në zonat më të prekura për të eleminuar demet në kulturat bujqësore nga këta parazite.
- Krijimi i një database per prodhuesit e bimëve dhe prodhimeve bimore (viti 2013).
- Futja në sistemin e të dhënave statistikore e importeve dhe përdorimin e Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve (Viti 2015).

3.12.4. FARAT DHE MATERIALET FIDANORE

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucioneve të tjera me detyra në këtë fushë është rritja e qëndrueshme e prodhimit bujqësor e cila krahas faktorëve të tjerë do arrihet nëpërmjet rritjes së vazhdueshme të cilësisë së farërave e fidanëve që përdoren në prodhimin bujqësor duke perfeksionuar sistemin e mbikëqyrjes dhe kontrollit të cilësisë. Po ashtu, në nenin 95 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcaktohet se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian do të ketë si synim modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë shqiptare dhe sektorit agro-industrial, si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave me rregullat dhe standardet komunitare.

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Forcimit të sistemit institucional të mbikqyrjes dhe kontrollit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- Përmirësimit të legjislacionit për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor.

Situata aktuale

Është miratuar Ligji Nr. 10416, datë 07. 04. 2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor" (shkalla e përafrimit e pjesshme). Për hartimin e këtij ligji ka punuar grupi i punës së ngritur për këtë qëllim, është marë asistencë teknike nga ana e ish GTZ, e cila bëri të mundur ardhjen e një eksperti të fushës për një periudhë dy ditore, i cili pati takime me anëtarët e grupit të punës. Nga TAIEX është bërë e mundur ardhja e dy ekspertëve të fushës në një takim dy ditor me anëtarët e grupit të punës si dhe organizimit të një seminari lidhur me direktivat në funksion të këtij ligji. Për hartimin e këtij ligji, grupi i punës është mbështetur në Direktivat e BE – së që vijojnë:

- 32002L0054- Direktivë e Këshillit 2002/54/EC, 13 qershor 2002 për tregtimin e farës së panxharit. OJ L 193, 20.7.2002, p. 12-32, Version i Konsoliduar 25.1.2005;
- 32002L0053 - Direktivë e Këshillit 2002/53/EC, 13 qershor 2002 për katalogun e përbashkët të varieteteve të specieve të bimëve bujqësore. OJ L 193, 20.7.2002, p. 1-11, Version i Konsoliduar 18.4.2004;
- 32002L0055 - Direktivë e Këshillit 2002/55/EC, 13 qershor 2002 për tregtimin e farave të perimeve. OJ L 193, 20.7.2002, p. 33-59, Version i Konsoliduar 4.7.2009;
- 32002L0056 - Direktivë e Këshillit 2002/56/EC, 13 qershor 2002 për tregtimin e farës së patates. OJ L 193, 20.7.2002, p. 60-73, Version i Konsoliduar 23.12.2008;
- 31966L0401 - Direktivë e Këshillit 66/401/EEC, 14 qershor 1966 për tregtimin e farës së bimëve foragjere. OJ 125, 11.7.1966, p. 2298-2308, Version i Konsoliduar 4.7.2009;
- 31966L0402 - Direktivë e Këshillit 66/402/EEC, 14 qershor 1966 për marketingun e farave të drithërave. OJ 125, 11.7.1966, Version i Konsoliduar 4.7.2009;
- 31992L0090 - Direktivë e Këshillit 92/90/EEC, 3 nëntor 1992, vendosjen e detyrimeve ndaj të cilave prodhuesit dhe importuesit e bimëve, produkteve bimore ose objekteve të tjera, janë objekt dhe rregullimin e detajeve për regjistrimin e tyre. OJ L 344, 26.11.1992, p. 38-39;
- 31968L0193 Direktivë e Këshillit 68/193/EEC, 9 prill 1968 për tregtimin e materialit për shtimin vegjetativ të hardhisë; OJ L 93, 17.4.1968, p. 15-23, Version i Konsoliduar 14.7.2005;
- 31992L0033 - Direktivë e Këshillit 92/33/EEC, 28 prill 1992 për tregtimin e materialit të shtimit vegjetativ dhe mbjellës të perimeve, të ndryshëm nga fara. OJ L 157, 10.6.1992, p. 1-9 , Version i Konsoliduar 30.10.2007;
- 31992L0034 - Direktivë e Këshillit 92/34/EEC, 28 prill 1992 për tregtimin e materialit të shtimit vegjetativ të bimëve frutore dhe bimëve frutore të destinuara

për prodhimin e frutave. OJ L 157, 10.6.1992, p. 10-18, Version i Konsoliduar 30.11.2007;

- 31998L0056 - Direktivë e Këshillit 98/56/EC, 20 korrik 1998 për tregtimin e materialit të shtimit të bimëve zbukuruese. OJ L 226, 13.8.1998, p. 16-23 , Version i Konsoliduar 10.7.2003.

Ligji përcakton autoritetet përgjegjëse për mbikqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të ligjit të cilat janë Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Ligjin do e plotësojnë aktet nënligjore që do dalin në zbatim të tij dhe duke u mbështetur në direktivat e sipërpërmendura.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji Nr. 10416, datë 07. 04. 2011 " Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor" Dt.Miratimit: 07.04.2011, Flet.Zyrtare Nr.46, Faqe:1959 ;

Aktualisht, derisa të hartohen e miratohen aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", janë në fuqi për aq sa nuk bien në kundërshtim me ligjin, aktet që vijojnë:

- Vendim i KM, Nr.155, datë 25.04.2002 "Për funksionimin, të drejtat dhe detyrat e entit shtetëror të farërave dhe fidanëve"., Flet.Zyrtare Nr.17, Faqe:534;
- Vendim i KM, Nr.156, datë 25.04.2002 "Për organizimin dhe proçedurat e kryerjes së çertifikimit të materialit mbjellës, bimor. Flet.Zyrtare Nr.17, Faqe:535;
- Vendim i KM, Nr.157, datë 25.04.2002 "Për kriteret dhe rregullat e përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes, etiketimit dhe përmbajtjes së etiketës për materialin mbjellës,bimor. Dt.Miratimit:25.04.2002, Flet.Zyrtare Nr.17, Faqe:536;
- Udhëzim, Nr.107, datë 02.12.2002 ". Flet.Zyrtare Nr.78, Faqe:2186;

Struktura institucionale

Institucionet përgjegjëse për rritjen e vazhdueshme të cilësisë së farërave e fidanëve që përdoren në prodhimin bujqësor janë Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucionet e varësisë së saj si Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Funksionet politikëbërëse realizohen nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK). Si pjesë e MBUMK funksionon Drejtoria e Politikave të Prodhimit Bujqësor (DPPB). DPPB është përgjegjëse për përcaktimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit të nevojshëm për farat dhe materialet fidanore si një nga funksionet kryesore për rritjen e prodhimit bujqësor, rritjen e nivelit të konkurrueshmërisë së prodhimeve bujqësore në treg brenda dhe jashtë vendit dhe në mbrojtje të interesave të fermerëve. Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve (ESHFF), sipas ligjit nr. 10416, 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", është person juridik publik, që funksionon në varësi të ministrit, me financim nga Buxheti i Shtetit.

Detyrat e këtij enti për realizimin e qëllimit të këtij ligji janë si më poshtë:

- të kryejë proçedurat për regjistrimin dhe çregjistrimin e varieteteve nga KK-ja;
- të organizojë dhe të drejtojë sistemin e informacionit në fushën e prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- të organizojë dhe të kryejë testimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të ri, të krijuar ose/dhe të importuar;
- të organizojë dhe të drejtojë proçedurat e certifikimit zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, përgatitjen e etiketës zyrtare dhe administrimin e saj;
- të lidhë kontrata publike të shërbimeve me subjektet, publike e private, për realizimin e proçedurave të certifikimit zyrtar, të testimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, si dhe kryerjen e mbikëqyrjes për realizimin e detyrave të tyre;
- të bashkëpunojë me struktura dhe organizata të tjera, brenda dhe jashtë vendit, për të marrë pjesë në veprimtari që kanë të bëjnë me materialin mbjellës dhe shumëzues bimor;
- të verifikojë dhe të analizojë mostrat e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar, të sjella nga inspektori i AKU-së.

Organizimi dhe funksionimi i ESHFF-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) funksionon në varësi të ministrit, sipas përcaktimit të bërë në legjislacionin në fuqi për ushqimin. Në lidhje me ligjin nr. 10416, 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", AKU është autoritet inspektues dhe kontrollues. Sipas ligjit detyrat e AKU-së për realizimin e qëllimit të këtij ligji janë si më poshtë:

- të kontrollojë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të furnizuesit, në çdo kohë dhe në çdo vend ku ai prodhohet, magazinohet, përpunohet, përgatitet për treg e tregtohet;
- të kontrollojë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor nëse plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj;
- të kontrollojë në magazinat e furnizuesve ose në treg materialin mbjellës shumëzues bimor të importuar, për plotësimin e kërkesave për tregtim, të përcaktuara në këtë ligj;
- të kontrollojë përfituesit e kontratave publike të shërbimeve, sipas këtij ligji.

AKU-ja, për zbatimin e masave administrative dhe kryerjen e detyrës, bashkëpunon me Policinë e Shtetit, me strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përcaktimi më i qartë i rregullave për tregtimin e farave dhe fidanëve dhe i funksioneve të institucioneve të përfshira në realizimin e cilësisë së farave dhe fidanëve. Gjithashtu, kërkohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i tij.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Projektvendim "Mbi kërkesat për tregtimin e farave të drithrave"; (në zbatim të neneve 4, 5, 7, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 33 të ligjit 10416)

- Projektvendim “Mbi kërkesat për tregtimin e farave të bimëve foragjere”;
- Projektvendim “Mbi kërkesat për tregtimin e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të pemëve frutore, ullirit dhe agrumeve”;
- Projektvendim “Mbi kërkesat për tregtimin e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të hardhisë” ;
- Projektvendim “Mbi kërkesat për tregtimin e materialeve të shumëzimit dhe mbjellës të perimeve, të ndryshme nga farat”;
- Projektvendim “Mbi kërkesat për tregtimin e farave të perimeve”;
- Projektvendim “Mbi kërkesat për tregtimin e farës së patates”;
- Urdhër “Për listën e specieve varietetet ei të cilave duhet të regjistrohen në Katalogun Kombëtar”. (në zbatim të pikës 1 të nenit 6 të ligjit 10416).
- Udhëzim “Për sasitë e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të varieteteve në proçes pranimi për regjistrim në Katalogun Kombëtar, të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor që importohet i çertifikuar jo përfundimisht, për sasitë e mostrave të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për prova testimi varietor, për qëllime shkencore dhe për ruajtjen e materialit gjenetik dhe për sasitë e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor që lejohet të importohet për përdorim vetjak”. (Në zbatim të neneve 6, 10, 25 dhe 26 të ligjit 10416)

Aktivitetet zbatuese afatshkurtëra

- Vlerësimi i ngarkesës në punë të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve;
- Njohje e stafit të çertifikimit dhe të testimit të varieteteve me aktet ligjislative përkatëse të EU;
- Pjesëmarrja e punonjësve të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në grupet e punës për hartimin e akteve nënligjore për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat legjislative afatmesme janë si vijon;

- Projektvendim “Për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar”; (Sipas nenit 40 të ligjit 10416)
- Projektvendim Për organizimin dhe funksionimin e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve”. (Sipas nenit 41 të ligjit 10416)
- Projektvendim “ Për kriteret që duhet të plotësojnë laboratori i referencës dhe laboratorët e akredituar për t’u miratuar nga ministri dhe analizat që do kryejnë këta laboratorë”. (sipas pikës 4 të nenit 44 të ligjit 10416)
- Projektvendim “Për kushtet që duhet të plotësojnë subjektet publike e private për kryerjen e shërbimit publik që lidhet me materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”. (sipas pikës 2 të nenit 49 të ligjit 10416)
- Projektvendim “Mbi kërkesat për tregtimin e farës së panxharit”;

- Projektvendim “Mbi kërkesat për tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues të bimëve zbukuruese”;
- Projektvendim “Mbi kërkesat për tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues të bimëve pyjore”;
- Udhëzim “Për kriteret dhe rregullat e përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes, etiketimit dhe përmbajtja e etiketës për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të bimëve bujqësore, të prodhuar dhe për tregtim brenda vendit”. (në zbatim të neneve 4, 8, 9 dhe 20 të ligjit nr 10416, 07. 04. 2011 “ Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”)
- Udhëzim “Për kriteret dhe rregullat e prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, formën dhe përmbajtjen e regjistrit të të dhënave që mban dhe zbaton prodhuesi si dhe për deklarimin e prodhimit”. (sipas neneve 11 e 12 të ligjit 10416)
- Udhëzim “Për metodën e inspektimit, mënyrën e mbajtjes së të dhënave të inspektimit, metoda e marjes së mostrave për analizat laboratorike që kryhen”. (në zbatim të nenit 13 pika 6) nga AKU
- Urdhër “Për formën, përmbajtjen dhe afatin e botimit të Katalogut Kombëtar të specieve dhe varieteteve të bimëve të kultivuara”. (në zbatim të nenit 29 pika 3)
- Udhëzim “Për proçedurat dhe formën e përmbajtjen së kërkesës për regjistrimin, çregjistrimin, për rinovimin e regjistrimit të varietetit, për përshtatjen e emrit të varietetit për regjistrim në Katalogun Kombëtar”. (në zbatim të neneve 30, 34, 35, 36 dhe 37 të ligjit 10416)
- Udhëzim i përbashkët me ministrin përgjegjës për pyjet dhe bimët dekorative “Për kriteret dhe rregullat e përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes, etiketimit dhe përmbajtja e etiketës për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të bimëve pyjore e dekorative, të prodhuar dhe për tregtim brenda vendit”. (në zbatim të nenit 4 pika 10 të ligjit 10416)
- Udhëzim i përbashkët me ministrin përgjegjës për financat “ Për tarifat për çertifikimin zyrtar, për etiketimin e rietiketimin zyrtar, marjen e mostrave të kontrollit e kryerjen e analizave laboratorike dhe për testimin varietor për regjistrim në Katalogun Kombëtar”. (në zbatim të neneve 16, 18, 21`, 24, 28 dhe 33 të ligjit 10416)

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Riorganizimi i Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve;
- Për stafin e Trupës së Çertifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor pranë ESHFF do të fillojnë proçedurat e akreditimit.
- Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit do të vazhdojnë informimin dhe ndërgjegjësimin i furnizuesëve mbi kërkesat ligjore/ nënligjore që lidhen me prodhimin, importin dhe tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

Efektet Financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**47.000.000**	**22.000.000**	**22.000.000**	**22.000.000**
Mbulohen nga buxheti i	25.000.000	22.000.000	22.000.000	22.000.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	22.000.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.13. PESHKIMI

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave është rregullimi i aktivitetit te peshkimit dhe akuakultures ne Shqiperi, nepermjet shfrytezimit racional dhe te qendrueshem te burimeve biologjike ujore, ne funksion te zhvillimit te qendrueshem, permiresimit te cilesise se jetes dhe te integrimit te vendit ne Bashkimin Europian

Po ashtu, neni 96 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian do të ketë si synim identifikimit e fushave me përfitim të ndërsjellë dhe interes të përbashkët në sektorin e peshkimit. Bashkëpunimi do të fokusohet vecanerisht ne mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave me rregullat dhe standardet e Bashkimit Evropian.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Aktualisht, Shqipëria është në fazën e përafrimit të sektorit me BE, ne politika dhe ne zhvillimin ekonomik, dhe është e nevojshme që edhe politikat që kanë filluar të zbatohen të jenë në përputhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit aktuale dhe atë ne proces rishikimi. Me asistencën e BE është hartuar ligji i ri "Për peshkimin" i cili është miratuar nga qeveria shqiptare dhe është ne fazën e miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë. Është ne procesin final miratimi i ligjit te ri "Për akuakulturën"edhe ky me mbështetjen e BE. Ligji i ri për peshkimin është përgatitur me asistencën e Projektit IPA, bazuar ne Kornizën Ligjore te përgatitur ne kuadër te TAIEX.
Aktualisht është ne fuqi ligji nr. 7908, date 5.4.1995 "Për Peshkimin dhe Akuakulturën" i ndryshuar. Gjithashtu, ne kuadër te ristrukturimit te Ministrisë ne vartësi te Drejtorisë se Kontrollit për Mjedisin është ngritur sektori i kontrollit te peshkimit me një përgjegjës dhe dy specialiste si dhe ne vartësi 23 inspektore lokale peshkimi.

Për përmirësimin e kontrollit në det është ngritur Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD). Në këtë Qendër janë të angazhuar 6 persona (një Koordinator i Lartë i Ministrisë dhe 5 oficerë civilë shërbimi), të cilët kanë për detyrë të monitorojnë aktivitetin e anijeve të peshkimit në det, për zonat e peshkimit dhe respektimin e legjislacionit të peshkimit sikurse mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu është ne proces përzgjedhja e operatoreve te sistemit MCS prej 5 personash ne QNOD. Është instaluar sistemi blue – box ne anijet e peshkimit mbi 12 metra si dhe është ngritur sistemi i monitorimit pranë QNOD.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji Nr. 7908, Datë 5.4.1995 "Për Peshkimin dhe Akuakulturën", i ndryshuar nga Ligji Nr. 8763, datë 2.4.2001, si dhe nga Ligji Nr. 8870, Datë 21.3.2002 dhe Ligji Nr.10001, Datë 6.10.2008 "Per disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7908, Date

5.4.1995 “Per Peshkimin dhe Akuakulturën”” i ndryshuar. Ky ligj bazohet mbi parimet e Politikes se Përbashkët te Peshkimit (PPP)

- Ligji Nr. 7908, Datë 5.4.1995 “Për Peshkimin dhe Akuakulturën", i ndryshuar bazohet mbi parimet e PPP me konkretisht:
  a. Procedura për ekzekutimin dhe regjistrimin e inspektimeve e formuluar në Rregulloret ((EEC) Nr 3561/85, Nr 1382/87 dhe Nr 2740/1999) ((ne Nenet 34 -44 te ligjit)
  b. Në lidhje me shfrytëzimin e burimeve të peshkimit dhe masat teknike të peshkimit (EEC) Nr 954/87, (EEC) Nr 3440/84,
  c. Kërkesat për plotësimin e ditareve të udhëtimit, deklaratat e zbarkimit, shënimet e lundrimit dhe mbledhja dhe transmetimi i statistikave në lidhje me shfrytëzimin e burimeve të peshkimit (EEC) Nr 2807/83,E EC Nr 2018/93, (EC) Nr 2597/95)
- Ligji Nr. 9093, Date 3.7.2003 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes për Krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun” Fletorja Zyrtare nr. 63, datë 4.8.2003, faqe 2816. Ky ligj eshte ne perputhje te pjesshme me Vendimin e Këshillit *98/416/EC* e dt. 16 Qeshor 1998 mbi aksesin e Komunitetit Europian në Komisionin e Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun *OJ L 190 4.7.1998, P. 34-35* dhe Vendimi i Këshillit *2000/487/EC* I dt. 17 Korrik 2000 mbi miratimin nga Komuniteti Europian për amendimin e marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përbashkët të Peshkimit për Mesdheun me synim për të krijuar një buxhet autonom të kësaj organizate OJ L 197 3.8.2000, P. 35-47
- Ligji Nr. 9401, Datë 19.05.2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen për nxitjen e respektimit të masave ndërkombetare të menaxhimit dhe të ruajtjes së burimeve nga anijet e peshkimit në det të hapur". Ky ligj eshte i perafruar pjeserisht me Direktiven *98/416/EC* mbi marrëveshjen për nxitjen e respektimit të masave ndërkombëtare të menaxhimit dhe të ruajtjes së burimeve nga anijet e peshkimit në det të hapur OJ L 177, 16.7.1996, p. 26–32
- Ligji Nr. 9822, Datë 29.10.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për ruajtjen e peshkut ton të Atlantikut (ICCAT)” i cili perafron plotesisht Direktiven *98/416/EC , Directiva 86/237/EEC Mbi aderimin e EE ne ICCAT (14 shtator 1997).*
- VKM Nr. 1062, Datë 16.7.2008 “Për përcaktimin e kompetencave të inspektoratit të peshkimit dhe ngritjen e sistemit të kontrollit, për zbatimin e politikave menaxhuese në peshkim” i cili perafron plotesisht rregullore e Këshillit (EEC) Nr 2847/93 e 12 tetorit 1993 “Që krijon një sistem kontrolli të aplikueshëm në politikën e përbashkët në peshkim”.
- VKM Nr. 1050, Datë 21.7.2008 “Per furnizimin e anijeve te peshkimit me nafte pa akcize” Fletorja Zyrtare: Viti 2008, Nr 128, Faqe 5661; data e botimit: 04.08.2008 i cili perafron plotesisht Direktiven e Keshillit 92/81/EEC e 19 tetorit 1992 mbi harmonizimin e struktures se akcizes mbi vajrat minerale, Neni 8 germa “c
- Rregullore Nr 1, Datë 29.3.2005 ”Për zbatimin e Ligjshmërisë në peshkim dhe Akuakulturë”; Kjo rregullore, bazohet pjesërisht në parimet kryesore të Politikës së Përbashkët të Peshkimit dhe dispozitat e Rregullores së Këshillit Nr. 2847/93 EEC që krijojnë një sistem kontrolli të zbatueshem ndaj Politikës së Përbashkët të Peshkimit dhe Rregulloren e Këshillit Nr. 3670/92 EEC që krijon një sistem Komunitar për

peshkimin dhe akuakulturën si dhe me regulloren 26/2004 EC e dt. 30 Dhjetor 2003 'Mbi rregjistrin e flotave të peshkimit të Komunitetit".

- Rregullore Nr. 4, Datë 24.10. 2008 "Për pajisjet që mund ti vendosen tratave tërheqëse, tratave të zallit dhe tratave të ngjashme me to" e cila perafron plotesisht Rregulloren e Komisionit (EEC) no. 3440/1984 of 6 December 1984. (Commission Regulation (EEC) No 3440/84 of 6 December 1984 "Mbi vendosjen e pajisjeve në tratat tërheqëse, tratave të zallit dhe rrjetave të ngjashme me të"CELEX No. 31984R3440; (OJ L 318, 7.12.1984, p. 23).
- Regullore Nr. 5, Datë 24.10.2008 "Per detajimin e rregullave në lidhje me përcaktimin e madhësisë së syzes dhe vlerësimin e trashësisë së fijes në rrjetat e peshkimit", e cila perafron pjeserisht Rregulloren e Komisionit (EC) nr. 517/2008 date 10 Qershor 2008 "Detajimi i rregullave për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 850/98 në lidhje me përcaktimin e madhësisë së syzes dhe vlerësimit të trashësisë së fijes në rrjetat e Peshkimit".
- Rregullore Nr 6, Datë 13.2.2009 "Për përcaktimin e mënyrës së regjistrimit të informacioneve të nevojshme në lidhje me zëniet e peshkut", e cila perafron plotesisht Rregulloren e Komisionit (EEC) no. 2807/83 e 22 shtator 1983 "Për detajimin e rregullave per regjistrimin e informacionit të Shteteve Anëtare në lidhje me zëniet e peshkut.
- Rregullore Nr. 8, Datë 11.11.2009 "Për masat menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det" (Fletorja Zyrtare nr. 173, data e botimit 16.12.2009, faqe 7690) qe perafron pjeserisht rregulloren (EC) no. 1967/2006 date 21 Dhjetor 2006 "Për masat menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm rë resureseve peshkore në detin Mesdhe, duke amenduar Rregulloren, (EEC) No 2847/93 dhe shfuqizuar Rregulloren (EC) No 1626/94" CELEX No. 32006R1967; OJ L 409/11, 30.12.2006).
- Regullore Nr. 9, Datë 25.1.2010 "Për ngritjen e një sistemi për parandalimin, dekurajimin dhe eliminimin e peshkimit ilegal të parregulluar dhe të paraportuar" (Fletorja Zyrtare: Nr 14, Faqe 461; data e botimit: 25-02-2010) qe perafron pjeserisht Rregulloren e Këshillit 1005/2008 e 29 shtator Për ngritjen e një sistemi komunitar për parandalimin, dekurajimin dhe eleminimin e peshkimit ilegal, të parregulluar e të paraportuar dhe Rregullores Nr. 1010 të datës 22 tetor 2009 për hartimin e rregullave të detajuara për zbatimin e Rregullores (EC) nr. 1005/2008 Për ngritjen e një sistemi komunitar për parandalimin, dekurajimin dhe eleminimin e peshkimit ilegal, të parregulluar e të paraportuar.

Ligjet dhe aktet e tjera që nuk transpozojnë akte te Bashkimit Evropian:

- Ligj Nr. 8875, datë 04.04.2002 "Për Rojën Bregdetare Shqiptare", Fletorja Zyrtare: Viti 2002, Nr. 15, data e botimit: 13.05.2002, Faqe 435;
- VKM Nr. 547, Datë 13.5.2009 "Për proçedurat dhe çmimet për dhenien me qera të sipërfaqeve ujore për qëllime të akuakulturës intensive", Fletorja Zyrtare: Viti 2009, Nr 97, data e botimit: 03.07.2009, Faqe 4251.
- VKM Nr. 622, Datë 11.06.2009 "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Mbrojtjes, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, të sipërfaqes 6467.31 m2, pjesë e pronës Nr.974 "Baza ndihmuese, Shëngjin, Lezhë" dhe për një ndryshim në vendimin Nr.515, Datë 18.7.2003 të

Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar", (Fletorja Zyrtare: Viti 2009, Nr 104, Faqe 4989; data e botimit: 16.07.2009);

- VKM Nr. 954, datë 30.09.2009 "Për organizimin, strukturën, funksionimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore, që kanë interesa në det" (Fletorja Zyrtare: Viti 2009, Nr 155, Faqe 6951; data e botimit: 20.11.2009);
- Rregullore Nr. 10, datë 18.6.2010 "Për përcaktimin e procedurave për pajisjen me leje dhe të konkurimit publik për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit në det, në ujërat e brendshme dhe akuakulturën tokësore dhe ujore".

Instrumentët e mëposhtëm janë të lidhura në veçanti me menaxhimin e peshkimit në Shqipëri:

- Ligji Nr. 9055 datë 24.4.2003 "Per aderimin e Republikes se Shqiperisë në "Konventën mbi te drejtën e detit të OKB-se" Fletorja Zyrtare: Viti 2003, Nr 40, Faqe 1351; data e botimit: 27.05.2003
- Kodi i FAO-s, 31 10.1995, Kodi i Sjelljes për Peshkim të Përgjegjshëm (implementuar si një kod vullnetar në 27.11.1997, ku parimet e këtij Kodi janë bazë për legjislacionin e peshkimit).
- Ligji Nr. 9093 datë 03.7.2003 "Për ratifikimin e marreveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM - KPPM)" Fletorja Zyrtare nr. 63, datë 4.8.2003, faqe 2816
- Ligji Nr. 9401 date 19.5.2005 "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne "Marreveshjen per nxitjen e respektimit te masave nderkombetare te menaxhimit dhe te ruajtjes se burimeve nga anijet e peshkimit ne det te hapur". Fletorja Zyrtare nr. 49, data e botimit 23.6.2005, faqe 1753.
- Ligji Nr. 9822 date 29.10.2007 "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Konventen Nderkombetare per ruajtjen e peshkut ton te Atlantikut (ICCAT - *International Convention for the Conservation of Atlantic Tuna*)" Fletorja Zyrtare nr. 153, data e botimit 16.11.2007, faqe 4464.
- Komisioni Këshillmor Europian i Peshkimit të Ujerave të Brendshëm (EIFAC). Themeluar në vitin 1957 dhe ndihmon në shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin, këshillimin me organizmat qeveritare për ujrat e brendshme dhe akuakulturën.

Struktura institucionale

Bazuar në legjislacionin në fuqi institucioni përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e resurseve peshkore është:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit te Ujerave;
Drejtoria e Peshkimit është institucioni përgjegjës për menaxhimin e sektorit te peshkimit dhe akuakultures. Kjo drejtori harton politika ne drejtim te menaxhimit dhe mbrojtjes se

resurseve peshkore ne det dhe ujera te brendshëm me qellim zhvillimin e qëndrueshëm te sektorit, menaxhon infrastrukturën ne peshkim, grumbullon dhe përpunon te dhënat. Organizimi i Drejtorisë se Peshkimit është ne dy sektorë: sektori i Menaxhimit te Peshkimit dhe Akuakultures me dy specialiste dhe sektori i Monitorimit dhe Planifikimit me një përgjegjës dhe dy specialiste**.**

Drejtoria e Kontrollit për Mjedisin, pjesë e së cilës është Sektori për Kontrollin e Peshkimit, me këtë përbërje: 1 përgjegjës sektori, dy specialistë në qendër dhe 23 inspektorë në qarqe dhe rrethe të vendit.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera:

Drejtoria e Peshkimit si pjesë e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave bashkëpunon me Drejtoritë përkatëse të Ministrisë dhe Inspektoratin e Mjedisit.

- Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve;
- Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

Drejtoria e Kontrollit për Mjedisin bashkëpunon me:

- Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë se Shtetit, Departamentin i Migracionit dhe Kufirit nga e cila siguron mbështetjen për kontrollet dhe penalizimet e shkeljeve ligjore që rezultojnë gjatë kontroll/inspektimet e inspektoratit.
- Ministrinë e Mbrojtjes me të cilën, në kuadër të Ligjit Nr 8875 datë 04.04.2002 "Për Rojën Bregdetare Shqiptare", dhe Manualin e Rojës Bregdetare siguron operacione të veçanta për kontrollin e hapësirës detare në bashkëpunim me strukturën e Inspektoratit, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në peshkim dhe akuakulturë. Marrëveshjet specifike të bashkëpunimit të hartuara me Rojën Bregdetare specifikojnë modalitetet e këtij bashkëpunimi.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përcaktimi më i qartë i kompetencave të institucioneve të përfshira në realizimin e fushes se peshkimit, përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë te BE-se dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- VKM "Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim" si përafrim te Rregullores se Këshillit (EEC) Nr 1224/2009 e 20 nëntorit 2009 që krijon një sistem kontrolli komunitar për të garantuar respektimin e rregullave te politikës se përbashkët në peshkim, qe modifikon rregulloret (CE) nr. 847/96, (CE) nr. 2371/2002, (CE) nr. 811/2004, (CE) 768/2005, (CE) nr. 2115/2005, (CE) nr. 2166/2005, (CE) nr. 509/2007, (CE) 676/2007, (CE) 1098/2007, (CE) 1300/2008, (CE) nr. 1342/2008 dhe qe shfuqizon rregulloret (CEE) 2847/93, (CE) 1627/94 dhe 1966/2006, dhe Rregullores se zbatimit (BE) Nr. 404/2011 e Komisionit e 8 prill 2011 qe përmban

modalitetet e zbatimit te rregullores se Këshillit (EEC) Nr 1224/2009 e 20 nëntorit 2009 që krijon një sistem kontrolli komunitar për të garantuar respektimin e rregullave te Politikës se Përbashkët në Peshkim.

- VKM "Për krijimin e një kuadri kombëtar për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor lidhur me politikën shqiptare të peshkimit" si përafrim i Rregullores se Këshillit (EC) Nr 199/2008 e 25 shkurtit 2008 ne lidhje me krijimin e një kuadri komunitar për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e te dhënave ne sektorin e peshkimit dhe mbështetjen e këshillimit shkencor ne lidhje me Politiken e Përbashkët te Peshkimit dhe Vendimit te Komisionit te 18 dhjetorit 2009 qe adopton një program komunitar shumëvjeçar për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e te dhënave te sektorit te peshkimit për periudhën 2011-2013.
- VKM "Për masat menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore ne det" si përafrim i Rregullores se Këshillit (CE) 1967/2006 e 21 dhjetorit 2006 ne lidhje me masat menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm te burimeve peshkore te Detit Mesdhe dhe qe modifikon Rregulloren (CEE) n. 2847/93 dhe shfuqizon Rregulloren (CE) n. 1626/94
- VKM "Për krijimin e një sistemi kombëtar për te parandaluar, shkurajuar dhe eliminuar peshkimin ilegal, te paraportuar dhe te parregulluar" përafrim i Rregullores se Këshillit (CE) 1005/2008 e 29 shtatorit 2008 qe krijon një regjim komunitar për te parandaluar, shkurajuar dhe eliminuar peshkimin ilegal, te pa deklaruar dhe pa rregulluar, qe modifikon rregulloret (CEE) nr. 2847/93, (CE) n. 1936/2001 e (CE) nr. 601/2004 dhe shfuqizon Rregulloret (CE) nr. 1093/94 e (CE) nr. 1447/1999.
- Rregullore teknike ne zbatim te ligjit te ri te Peshkimit.
- Ligj "Për akuakulturën". Ligji i ri "Për Akuakulturën" do të bazohet mbi parimet e Komitetit te Akuakultures te Komisionit te Përgjithshëm te Peshkimit për Mesdheun ne lidhje me Alokimin e Zonave te Akuakultures si dhe ne transpozimin e parimeve të legjislacionit të mëposhtëm të BE: Rregullore e Këshillit Nr. 1198/2006 në lidhje me Fondin Evropian të Peshkimit; Rregullore e Këshillit (EEC) Nr. 1224/2009 e 20 nëntorit 2009 që krijon një sistem kontrolli komunitar për të garantuar respektimin e rregullave te politikës se përbashkët në peshkim, qe modifikon rregulloret (CE) nr. 847/96, (CE) nr. 2371/2002, (CE) nr. 811/2004, (CE) 768/2005, (CE) nr. 2115/2005, (CE) nr. 2166/2005, (CE) nr. 509/2007, (CE) 676/2007, (CE) 1098/2007, (CE) 1300/2008, (CE) nr. 1342/2008 dhe qe shfuqizon rregulloret (CEE) 2847/93, (CE) 1627/94 dhe 1966/2006; Rregullore (EC) Nr 762/2008 e Parlamenti dhe Këshillit e 9 korrikut 2008 mbi dërgimin nga vendet anëtare te statistikave te akuakultures dhe qe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EC) Nr. 788/96

Aktivitetet zbatuese

- Rekrutimi i monitorëve lokale dhe trajnimi i tyre;
- Zbatimi i VKM "Për krijimin e një kuadri kombëtar për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor lidhur me politikën shqiptare të peshkimit"
- Bashkëpunim me Rojën Bregdetare dhe Policinë Kufitare;
- Funksionim i plotë i QNOD dhe rekrutimi i operatoreve te sistemit;

- Trajnime për strukturën e QNOD-se dhe inspektoratin e peshkimit;
- Plotësimi i rregullt dhe i saktë i log book-eve nga të gjithë subjektet e peshkimit që u është dhënë në përdorim;
- Përmirësimi i regjistrit të anijeve të peshkimit.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat legjislative afatmesme janë si vijon;

- VKM "Për ndalimin e përkohshëm te aktivitetit te peshkimit" ne zbatim te germës "b" te pikës 1 te nenit 20 te ligjit "Për peshkimin" si përafrim i nenit 24 te Rregullores se Këshillit (CE) 1198/2006 te 27 korrikut 2006 ne lidhje me Fondin Evropian te Peshkimit,
- VKM "Për rinovimin e flotës dhe modernizimin e anijeve te peshkimit me qellim përmirësimin e standardeve te sigurisë ne bordin e anijes se peshkimit dhe standardeve te sigurisë ushqimore" ne zbatim te germës "c" te pikës 1 te nenit 20 te ligjit "Për peshkimin" si përafrim i nenit 25 te Rregullores se Këshillit (CE) 1198/2006 te 27 korrikut 2006 ne lidhje me Fondin Evropian te Peshkimit,
- Rregullore ministri për të përcaktuar kushte shtese për njohjen e organizatave të peshkimit ne zbatim te pikës 2 te nenit 80 te Ligjit për peshkimin dhe si përafrim i Titullit II dhe III te Rregullores se Këshillit (EC) Nr 104/2000 e 17 Dhjetorit 1999 mbi organizimin e përbashkët te tregjeve ne produktet e peshkimit dhe akuakultures.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Grumbullim të dhënash në peshkim (social ekonomike, mbi zbarkimet, biologjike etj);
- Përmirësime strukturore të Inspektoratit të Peshkimit dhe trajnime;
- Bashkëpunim me Rojën Bregdetare në kuadër të funksionimit të Qendrës së Përbashkët Operacionale Detare;
- Trajnime të stafit dhe inspektoratit për standardet në fushën e peshkimit dhe akuakultures në vendet komunitare;
- Zbatim masash për tregtimin e produkteve peshkore.

Efektet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**44.042.080**	**70.501.536**	**149.101.536**	**154.501.536**
Mbulohen nga buxheti i	38.441.000	38.941.000	117.541.000	122.941.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	5.600.000	31.559.000	31.559.000	31.559.000
Ndryshim	-1.080	-1.536	-1.536	-1.536

Peshkimi dhe akuakultura Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**300.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	0	0	0	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	300.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.14. POLITIKA E TRANSPORTIT

Objektivi Strategjik

Qeveria Shqiptare ka shpallur si objektiv strategjik të saj zhvillimin dhe modernizimin e transportit. Në këtë kuadër Ministria e Punëve Publike dhe Transportit ka hartuar politikat strategjike në përmbushje të programit të qeverisë. Këto objektiva janë bazuar në Marrëveshjen e Stabilizim – Asociimit (MSA) dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Strategjia Sektoriale e Transportit, është një dokument i rëndësishëm ku janë paraqitur të detajuara objektivat për Transportin Rrugor, Ajror, Detar dhe Hekurudhor.

Në kuadër të procesit të Integrimit Evropian, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT) ka shndërruar në objektiva kryesorë, rekomandimet e palës komunitare që janë adresuar si në progres raportet vjetore, ashtu edhe në takimet e ndërsjella Shqipëri –Bashkimi Evropian. Objektivat kryesorë në këtë drejtim janë fokusuar në përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian (BE), reformimin e institucioneve të vartësisë sipas rekomandimeve dhe në trajnimin e burimeve njerëzore. Reformimi i institucioneve të vartësisë, ka për qëllim standardizimin e tyre me analoget evropian. Reforma në fjalë, si për përafrimin e legjislacionit, reforma strukturore e institucioneve, si dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore, janë pjesë e objektivave strategjikë për Transportin Rrugor, Transportin Ajror, Transportin Detar dhe atë Hekurudhor.

Në të ardhmen synohet që strukturat e transportit rrugor të mundësojnë krijimin e një hapësire unike ekonomike, fillimisht brenda territorit shtetëror, më pas në rrafsh rajonal e panevropian. Në sektorin e Transportit Ajror po punohet intensivisht, për përafrimin e legjislacionit në zbatim të MSA-së dhe në përputhje me Marrëveshjen Shumëpalëshe për Krijimin e Zonës së Përbashkët të Aviacionit Evropian. Në përmbushje të këtyre objektivave dhe sfidave të tjera, si dhe për t'iu përgjigjur sa më mirë reformave për të gjithë sektorët e transportit është miratuar së fundmi edhe Plani Kombëtar i Transportit (rishikimi i parë pesëvjeçar).

3.14.1. TRANSPORT TOKËSOR

3.14.1.1. TRANSPORTI RRUGOR

Objektivat kryesore

- Krijimi i një sistemi rregullator dhe ligjor sipas kërkesave dhe standardeve evropiane, i cili do të garantojë lehtësimin e hyrjes në treg të transportuesve, për operime optimale të shërbimeve të transportit në bazë të një konkurrimi të nivelit të lartë, si dhe uljen e barrierave jo-fizike;
- Forcimi i legjislacionit për shmangien e konkurrencës së paligjshme, si dhe zbatimin e marrëveshjeve dy dhe shumëpalëshe në Transportin Rrugor, duke i amenduar këto marrëveshjeve në zbatim të nenit 11 të Protokollit 5;

- Hartimi i politikave në lidhje me transportin tokësor të mallrave të rrezikshme si Palë Kontraktuese e Marrëveshjes Evropiane në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme në transportin rrugor (pika 2, neni 18, Protokolli 5);
- Harmonizimi i legjislacionit mbi trajnimin e personelit të transportit rrugor, veçanërisht në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme sipas standardeve të KE-së (pika 1, neni 16, protokolli 5);
- Dhënien e të drejtës së pakufizuar të trafikut transit për transportuesit e shteteve të BE-së, përmes territorit të Shqipërisë dhe transportit transit të transportuesve Shqiptare përmes Komunitetit (pika 2, nenin 11, Protokolli 5);
- Zbatimi i legjislacionit në lidhje me punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor sipas marrëveshjes AETR dhe politikat e BE-së në lidhje me kohën e drejtimit të mjetit, periudhat e ndërprerjes dhe pushimit për drejtuesit e mjeteve, dhe stafit të tyre, legjislacionit social në fushën e transportit rrugor (pika 2, neni 16, protokolli 5).
- Zhvillimi i një transporti të qëndrueshëm, të sigurt e sipas standardeve mjedisore, me synim të veçante minimizimin e aksidenteve rrugore.

Situata aktuale

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes se Përkohshme mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, pala shqiptare ka liberalizuar transportin transit me vendet e BE-së, i cili siguron akses të pakufizuar në operacionet e transitit të transportuesve rrugore të vendosur në Shtetet Anëtare të BE-së përmes territorit te Shqipërisë. Autoritetet e pikave të kalimit kufitar në bazë të nenit 51 të Ligjit "Për transportet rrugore", lejojnë kalimin e mjeteve të transportuesve të vendosur në Shtetet Anëtare të BE-së përmes Shqipërisë për në një vend tjetër anëtar të BE-së pa qenë të pajisur me leje të kalimit transit.

Integrimi në BE në fushën e transportit rrugor nënkupton përshtatjen e kornizës ligjore të transportit me Standardet dhe Rregulloret Ndërkombëtare. Në këtë kuadër kanë përfunduar iniciativat ligjore që lidhen me përcaktimin e kritereve cilësore që duhet të plotësohen për pranimin në veprimtarinë e transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve; rregullat në organizimin e kohës së punës së personave, që kryejnë transport rrugor, orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjen e regjistrimit. Procesi i implementimit të tahografit dixhital ka filluar me përfundimin e akteve që lidhen me shpërndarjen e kartave të tahografit dixhital, funksionimin e ofiçinave të tahografit, programin e trajnimit të drejtuesve të mjeteve dhe lëshimin e kartave të memories për drejtuesit e mjeteve.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPShTRr) në varësi të MPPT-së, organizon kurse trajnimi për drejtuesit e mjeteve të transportit të mallrave të rrezikshme, për drejtuesit e ndërmarrjeve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave si dhe lëshon dëshminë e aftësisë profesionale ADR, certifikatën e kompetencës profesionale ÇKP dhe kartat e tahografit dixhital.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar që përafron pjesërisht Direktivën nr. 96/53/KE e 25 Qershorit 1996, "Që përcakton ... përmasat e lejuara maksimale dhe peshat e autorizuara maksimale të automjeteve..." (nr. celex 31996L0053, Fletore Zyrtare e KE, L235/1996, f. 59); ndryshuar me Ligjin nr. 10488, datë 05.12.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" (F.Z. e RSH 166/2011), ndryshimi i nenit 177 të tij përafron pjesërisht Rregulloren 3821/85/KE, datë 20 dhjetor 1985 e Këshillit "Mbi pajisjet e regjistrimit" (nr. Celex 1985R3821, Fletore Zyrtare e KE L370/1985).
- Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar që përafron Direktivën nr. 96/26/KE të 29 Prill 1996 e Këshillit "Për pranimin në aktivitetin e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe operatorin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe njohjen reciproke të diplomave, certifikatave, si dhe evidencën e kualifikimeve zyrtare me qëllim lehtësimin për këta operatorë të së drejtës në lirinë e vendosjes në operatorët e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar" (nr. celex 31996L0026, Fletore Zyrtare e KE, L124/1996, f. 1), e shfuqizuar nga Rregullorja (KE) nr. 1071/2009.
- Ligji nr. 10211, datë 23.12.2009 "Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e funksionimit dhe burimet e financimit të sistemit të tahografit dixhital në Shqipëri" (F.Z. e RSH 194/2009), për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të tahografit dixhital, në zbatim të Rregullores nr. 3821/85/KE, datë 20 dhjetor 1985 e Këshillit "Mbi pajisjet e regjistrimit" (nr. Celex 1985R3821, Fletore Zyrtare e KE L370/1985).
- Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 325, datë 19.03.2008 "Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë" (F.Z. e RSH 49/2008), që përafron Direktivën nr. 96/26/KE të 29 Prill 1996; e ndryshuar me VKM nr. 194, datë 09. 03. 2011 "Për disa shtesa e ndryshime ne vendimin nr. 325, datë 19.02.2008 "Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatore" (F. Z. e RSH 40/2011), përafron pjesërisht Rregulloren (KE) nr. 1071/ 2009 (nr. Celex 32009R1071, Fletore Zyrtare e KE L300/2009, f.51).
- VKM nr. 1243, datë 10.09.2008 "Për miratimin e rregullores për organizimin e kohës së punës së personave, që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit" (F.Z. e RSH 147/2008), përafron Rregulloren (KE) nr. 561/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit e 15 Mars 2006 "Mbi harmonizimin e disa ligjeve në lidhje me transportin rrugor që amendon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 3821/85 dhe (KE) nr. 2135/98 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 3820/85", (nr. celex 32006R561, Fletore Zyrtare e KE, L 102/2006), dhe Direktiva 2002/15/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 marsit 2002 "Në organizimin e kohës së punës të personave që kryejnë veprimtari transporti të lëvizshëm" (nr. celex 32002L0015, Fletore Zyrtare e KE, L 80/2002, f.35).
- VKM nr. 207, datë 25.02.2009 "Për miratimin e rregullores për kontrollin në anë të rrugës dhe në zyrat e ndërmarrjeve, përsa i përket zbatimit të rregullave të kohës së punës, për personat, që kryejnë transport rrugor, dhe për orët e drejtuesve të mjeteve", e cila përafron

pjesërisht Direktivën nr. 2006/22/KE, datë 15 Mars 2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit "Mbi kushtet minimale për implementimin Rregullores së Këshillit nr. 3820/85/KEE dhe 3821/85/KEE në lidhje me legjislacionin social për sa i përket veprimtarive të transportit rrugor dhe shfuqizimit të Direktivës së Këshillit 88/599/KEE" (nr. celex 32006L0022, Fletore Zyrtare e KE L102/2006, f. 35), e ndryshuar.

- VKM nr. 1054, datë 22.12.2010 "Për miratimin e Rregullores për pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor" (F. Z e RSH nr. 186, v. 2010), në përputhje me Rregulloren nr. 3821/85 "Mbi pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor" (nr. celex. 1985R3821, Fletore Zyrtare e KE L370/1985).
- VKM nr. 101, datë 9. 02. 2011 "Për miratimin e rregullave për lejet e transportit dhe kryerjen e operacioneve të transportit nga transportuesit e hua, që nuk kanë selinë në Shqipëri (jorezidente), për mallra dhe udhëtarë" (F. Z e RSH nr. 14, v. 2011), përafron pjesërisht Rregulloren nr. 3118/1993 dhe Rregulloren (KE) 107/2/2009 në lidhje me kabotazhin nga transportues të huaj në Shqipëri, si dhe përafron pjesërisht Rregulloren (KE) 1073/2009, në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve.

Konventat dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare për Transportin Rrugor në të cilat vendi ynë ka aderuar dhe ratifikuar, ndër më kryesoret janë:

- Marrëveshja Evropiane qe lidhet me Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR), aderuar me Ligjin nr. 9272, datë 16.09.2004, dhe Marrëveshja është bërë e vlefshme me 26 Janar 2005 (Fletore Zyrtare e RSH nr. 71/04)
- Marrëveshja Evropiane mbi Transportin Ndërkombëtar të Mallrave Ushqimore Delikate dhe Pajisjet Speciale që përdoren në të tilla Transporte (ATP), aderuar me Ligjin nr. 9289, datë 07.10.2004, dhe Marrëveshja është bërë e vlefshme me 26 Janar 2005 (Fletore Zyrtare e RSH nr. 80/04)
- Marrëveshja Evropiane, që lidhet me Punën e Ekuipazheve të Mjeteve në Transportin Ndërkombëtar Rrugor (AETR), aderuar me Ligjin nr. 9514, datë 18.04.2006, dhe Marrëveshja është bërë e vlefshme më 20 korrik 2006 (Fletore Zyrtare e RSH nr. 49/06)
- Marrëveshja mbi Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Rastit të Udhëtarëve me Autobus (Marrëveshja Interbus), Republika e Shqipërisë ka miratuar aderimin në këtë Marrëveshje me Ligjin nr. 9305, datë 04.11.2004, dhe Marrëveshja është bërë e vlefshme më 1 korrik 2005 (Fletore Zyrtare e RSH nr. 92/04).

Struktura institucionale

Politika e transportit rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar lidhur me transportin e mallrave dhe udhëtarëve është nën përgjegjësinë e Sektorit të Politikave të Transportit Rrugor, i cili është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Politikave të Transportit në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT). Roli i Sektorit të Politikave të Transportit Rrugor ka të bëjë me hartimin e politikave në lidhje me pranimin në veprimtari dhe hyrjen në treg të transportuesve, mënjanimin e konkurrencës së paligjshme në këtë fushë, hartimin dhe monitorimin e marrëveshjeve bilaterale e multilaterale në transportin rrugor, propozimin dhe hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

Për realizimin e objektivave të saj, ky sektor bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila kryen shërbimet e transportit rrugor ndaj subjekteve

shtetërore dhe private, kryen monitorimin e tregut të transportit rrugor dhe ushtron kontroll për zbatimin e kuadrit ligjor. Për kryerjen e kontrolleve rrugore dhe inspektimeve të operimeve të transportit, dokumentacionin, përdorimin ekonomik të automjeteve etj, DPShTRr bashkëpunon me Drejtorinë e Policisë së Qarkullimit Rrugor në Ministrinë e Brendshme, Njësitë e Qeverisjes Vendore si dhe me Shoqatën e Transportuesve Ndërkombëtar Shqiptar (ANALTIR).

Masat legjislative afatshkurtra

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Projektligj "Për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme", në përputhje me Marrëveshjen Evropiane në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Rrugë (ADR). Projektligji përafron pjesërisht Direktivën 2008/68/KE (nr. celex 32008L0068, Fletore Zyrtare e KE L260/2008, f.13) dhe Direktivën e Këshillit 95/50/KE (nr. celex 31995L0050, Fletore Zyrtare e KE L249/1995, f.35). (3 mujori dytë 2012)
- Projektudhëzim "Mbi procedurat për lëshimin e certifikatës së konformitetit të mjeteve që mbartin mallra të rrezikshme", në përputhje me Marrëveshjen Evropiane në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Rrugë (ADR), njëkohësisht projektudhëzimi përafron pjesërisht Direktivën 2008/68/KE, (3 mujori parë 2012)
- Projektudhëzim "Mbi programin, trajnimin dhe testimin e këshilltarëve të sigurisë në transportin e mallrave të rrezikshme", në përputhje të pjesshme me Direktivën 96/35/KE (nr. celex 31996L0035, Fletore Zyrtare e KE L145/1996, f.10) dhe Marrëveshjen Evropiane, në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Rrugë (ADR), (3 mujori i katërt 2012).

Aktivitetet zbatuese

- Trajnimi i inspektoreve të kontrollit të mallrave të rrezikshme.

Masat legjislative afatmesme

Masat kombëtare për periudhën afatmesme do të jenë:

- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Mbi kushtet e rregullat për dhënien dhe heqjen e autorizimit për ambalazhet e mallrave të rrezikshme", në përputhje me Marrëveshjen Evropiane në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Rrugë (ADR), si dhe përafron pjesërisht Direktivën 2008/68/KE, (3 mujori parë 2013)
- Projektudhëzim "Mbi procedurat uniforme në kontrollin e transportit rrugor të mallrave të rrezikshme", i cili do të përafrohet pjesërisht me Direktivën e Këshillit 95/50/KE, (3 mujori dytë 2013)
- Projektudhëzim "Mbi përcaktimin e rregullave për pranimin në treg në shërbimet e transportit të udhëtarëve me autobus", në përputhje të pjesshme me Rregulloren (KE) 1073/2009 (nr. celex 32009R1073, Fletore Zyrtare e KE L300/2009, f. 88). (viti 2014).

- Projektudhëzim "Mbi modelet e dokumentacionit në transportin e udhëtarëve me autobus", në përputhje të pjesshme me Rregulloren e Komisionit 2121/98 (nr. celex 31998R2121, Fletore Zyrtare e KE L268/, f.10). (viti 2014).

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Nuk ka aktivitete zbatuese afatmesme.

Efektet financiare

Në lidhje me masat ligjore afatshkurtra dhe afatmesme nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit. Këto iniciativa ligjore do hartohen me grupe pune ndërministrore, me punonjësit e Sektorit të Politikave të Transportit Rrugor, si dhe nga trajnimet që do sigurohen nga TAIEX.

Në lidhje me aktivitetet zbatuese të masave afatshkurtra është parashikuar që këto të mbulohen me të ardhurat që krijohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPShTRr).

Në tabelën e kostove është bërë një llogaritje e përafërt e orëve të punës që ju duhen punonjësve të MPPT-së, për përgatitjen e akteve ligjore.

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.14.1.: Transport Tokësor

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**1.783.000**	**1.154.000**	**886.000**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	1.783.000	1.154.000	886.000	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.14.1.1.1 Siguria rrugore

Situata aktuale

Në funksion të angazhimeve që rrjedhin nga zbatimi i MSA-së, për fushën qarkullimit dhe sigurisë rrugore, fokusi i qeverisë shqiptare është përqendruar në: përafrimin e legjislacionit në fushën e transportit tokësor, me drejtim kryesor sigurinë rrugore dhe ndotjen e mjedisit nga mjetet rrugore.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë veprimtarin në këtë fushë janë:

- Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nuk ka përafrim me legjislacionin evropian të fushës.

- VKM nr. 153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e Rregullores së Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", nuk përafron ndonjë direktivë evropiane të fushë.
- VKM nr. 1214, datë 03.09.2008 "Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit", nuk ka përafrim me legjislacionin evropian të fushës.
- VKM nr. 817 , datë 23.11.2011, "Për miratimin, në parim, të Planit Kombëtar të Transportit (rishikimi i parë pesëvjeçar)", vendimi i përshtatet nevojave kombëtare, nuk ka përafrim me legjislacionin evropian të fushës.
- VKM nr. 125, datë 23.02.2011, "Për zbatimin e objektivave për përmirësimin e sigurisë rrugore", nuk përafron ndonjë direktive të fushës.
- Udhëzimi i Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 994, datë 12.03.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e autoshkollave", i ndryshuar, nuk ka përafrim me legjislacionin evropian të fushës.
- Udhëzimi i Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 5, datë 26.10.2006, "Mbi përgatitjen e testeve të njohurive teorike të kandidatit për drejtues të mjetit rrugor". nuk ka përafrim me legjislacionin evropian të fushës.
- Udhëzimi nr. 2, datë 11.02.2010, "Mbi inspektimin teknik të mjeteve rrugore", i cili përafron pjesërisht Direktivën 2009/40, "Mbi inspektimin teknik të mjeteve rrugore"
- Udhëzimi nr. 6527, datë 24.12.2004, "Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre". Udhëzimi nuk ka përafruar pjesërisht Direktivën 2009/40/KE "Mbi inspektimin teknik të mjeteve rrugore"
- Udhëzimi nr. 1, datë 18.01.2012 "Për dokumentet e qarkullimit dhe regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre", Udhëzimi nuk ka përafruar ndonjë prej direktivave evropiane të fushës.

Republika e Shqipërisë është palë në disa Konventa dhe Marrëveshje Evropiane më konkretisht:

- Konventa e Trafikut Rrugor, Vjenë me 8 Nëntor 1968. Republika e Shqipërisë ka miratuar aderimin në këtë Konventë me Ligjin nr. 8613, datë 25.05.2000, dhe Konventa është e vlefshme nga 29 Qershor 2000 (Fletore Zyrtare e RSH nr. 15.1/2000, fq.1).
- Marrëveshja Evropiane plotësuese e Konventës së Trafikut Rrugor Vjenë e 8 Nëntor 1968 e hapur për nënshkrim në Gjeneve 1 Maj 1971. Republika e Shqipërisë ka miratuar aderimin në këtë Marrëveshje me Ligjin nr. 9360, datë 24.03.2005, dhe Marrëveshja është e vlefshme nga 27 Tetor 2005. (Fletore Zyrtare e RSH nr. 28/05, 1073).
- Konventa e shenjave dhe sinjaleve rrugore Vjenë, 8 Nëntor 1968. Republika e Shqipërisë ka miratuar aderimin në këtë Konvente me Ligjin nr. 9142, datë 16.10.2003, dhe Konventa është e vlefshme nga 6 shkurt 2004. (Fletore Zyrtare e RSH nr. 92/03, fq. 3973).
- Marrëveshja Evropiane që plotëson Konventën e shenjave dhe sinjaleve rrugore, Gjeneve, 1 Maj 1971. Republika e Shqipërisë ka miratuar aderimin në këtë Marrëveshje me Ligjin nr. 9190, datë 19.02.2004, dhe Marrëveshja është e vlefshme nga 6 Qershor 2005. (Fletore Zyrtare e RSH nr. 16/04, fq. 763).
- Marrëveshja Evropiane për arteriet kryesore të trafikut ndërkombëtar (AGR). Republika e Shqipërisë ka miratuar aderimin në këtë Marrëveshje me Ligjin nr. 9511, datë 10.04.2006. (Fletore Zyrtare e RSH nr. 41, 2006).
- Marrëveshjen e rishikuar të kombeve të bashkuara në lidhje me miratimin e parashikimeve teknike uniforme për automjetet me rrota, pajisjet dhe pjesët që mund të

instalohen dhe/ose përdoren tek automjetet me rrota dhe kushtet për njohjen reciproke të aprovimeve të dhëna mbi bazën e këtyre parashikimeve. Republika e Shqipërisë ka miratuar aderimin në këtë Marrëveshje me Ligjin nr. 10432, datë 16.06.2011. (Fletore Zyrtare e RSH nr. 90, 5 korrik 2011, fq. 3707).

- Marrëveshja Evropiane "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme" (ADR) dhe Protokolli i saj, ratifikuar me Ligjin nr. 9272, datë 16.09.2004. Fl. Z. nr. 71, 4635.
- Marrëveshja Evropiane në lidhje me "Adoptimin e kushteve uniforme për inspektimet teknike periodike të mjeteve motorike dhe njohja reciproke e inspektimeve të tilla" e 13 Nëntorit 1997, ratifikuar me Ligjin nr. 9273, datë 16.09.2004, Fl. Zyrt. 69, dt. 4580.

Struktura institucionale

Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore, pjesë e strukturës së Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit është organi kryesor përgjegjës për veprimtarinë në këtë fushë. Mision i saj është të analizojë, identifikojë dhe hartojë politikat e zhvillimit në fushën e qarkullimit dhe sigurisë rrugore si pjesë integrale e strategjisë sektoriale në funksion të zhvillimit të sektorit të transportit rrugor të konkretizuara në programet afatshkurtra dhe afatmesme të objektivave të Ministrisë. Detyrë tjetër e rëndësishme është hartimi i legjislacionit dhe kuadrit rregullator për nxitjen, zhvillimin e përmirësimin e komponentëve të qarkullimit dhe sigurisë rrugore në veçanti, që mundësojnë parandalimin dhe minimizimin e aksidenteve rrugore, nëpërmjet zbatimit të normave dhe standardeve ndërkombëtare e evropiane, të pasqyruara në legjislacionin bazë të transportit rrugor, për të gjithë komponentët me karakter institucional dhe legjislativ, në shërbim të sigurisë së lëvizjes të përdoruesve të rrugës.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është institucioni shtetëror që kryen regjistrimin e mjeteve dhe pajisjen e kandidatëve me leje drejtimi për mjetet rrugore.

Njëkohësisht Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore në MPPT, kryen edhe detyrat e sekretarisë teknike të Komitetit Ndërministror të Sigurisë Rrugore, ku për realizimin e detyrave të saj bashkëpunon me: Komitetin Ndërministror të Sigurisë Rrugore, Autoritetin Rrugor Shqiptar, Institutin e Transportit, Drejtorinë e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor si dhe me Policinë Rrugore pranë Ministrisë së Brendshme.

Masat Legjislative afatshkurtra

Gjatë vitit 2012, është përgatitur një plan pune për përafrimin e legjislacionit shqiptar të fushës me atë komunitar dhe më konkretisht:

- Projektligj "Për sigurinë në tunelet rrugore", për miratim brenda 3 mujorit të parë 2012. Ky projektligj ka për qëllim të përputhë plotësisht legjislacionin tonë me Direktivën 2004/54/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 Prill 2004, "Mbi kërkesat minimale të sigurisë për tunelet në rrjetin rrugor Trans – Evropian".
- Projektvendim "Për disa ndryshime në VKM nr. 153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e Rregullores së Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar", për miratim

brenda 3 mujorit të tretë 2012. Ky projektvendim ka për qëllim përditësimin e Direktivës së Këshillit nr. 93/704/KE të 30 Nëntorit 1993 "Mbi krijimin e databazës së Komunitetit për aksidentet rrugore. (OJ L 329, 30.12.1993, p.63).

- Projektudhëzim "Mbi ndryshimin e lejes së qarkullimit" për miratim brenda 3 mujorit të katërt 2012. Ky projektakt synon përditësimin dhe përputhjen e plotë me Direktivën 1999/37/KE "Mbi dokumentet e regjistrimit të mjeteve" .
- Projektudhëzim "Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore" dhe "Udhëzuesi i Auditimit të sigurisë rrugore", për miratim brenda 3 mujorit të parë 2012. Ky projektakt përafron plotësisht Direktivën 2008/96/KE "Mbi menaxhimin e sigurisë në infrastrukturën rrugore".

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Përditësimi dhe modernizimi i sistemit të aksidenteve rrugore;
- Realizimi i investimeve, për përmirësimin e komponentëve të sigurisë rrugore, të sinjalizimit rrugor dhe përmirësimin e pikave të rrezikut;
- Krijimi i hartës së përditësuar të pikave të rrezikut të aksidenteve;
- Monitorimi i planit të veprimit për zbatimin e strategjisë së sigurisë rrugore VKM Nr. 125, datë 23.2.2011

Masat legjislative afatmesme

- Projektligj "Për disa ndryshime në Kodin Rrugor së bashku me aktet nënligjore "Mbi lejet e drejtimit", në 3 mujorin e katërt të 2013. Kjo synon të arrijë përputhshmërinë e plotë me Direktivat 91/439/KE dhe 2006/126/KE.
- Projektligj, "Mbi disponimin e informacionit për konsumatorin mbi kursimin karburantit dhe gazrave CO_2, për autoveturat e reja", i cili synon përputhjen e plotë me Direktivën 1999/94/KE, ky akt përfundon në 3 mujorin e katërt të 2014.
- Projektligj, "Monitorimi i gazrave CO_2 nga mjetet e reja të pasagjereve", shkalla e përputhshmërisë do të jetë e plotë me Direktivën 1753/2000/KE. Puna me këtë akt përfundon në 3 mujorin e katërt të 2015.
- Projektligj, "Mbi vendosjen e standardeve të performancës së gazrave, për mjetet e reja si pjesë e qasjes komunitare për të reduktuar gazrat CO_2 nga mjetet e lehta", akti do të përputhet plotësisht me Rregulloren nr. 443/2009, në 3 mujorin e katërt të 2015

Aktet në fjalë kanë për qëllim përmbushjen e detyrime në fushën e ndryshimeve klimaterike, ato do të përafrojnë legjislacionit shqiptar me atë evropian. Këto akte do të hartohen në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave si dhe Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Monitorimi i planit të veprimit për zbatimin e strategjisë së sigurisë rrugore në zbatim të VKM nr. 125, datë 23.02.2011" Për zbatimin e objektivave për përmirësimin e sigurisë rrugore"[60].

[60] Drejtoria përkatëse është shprehur se iniciativat dhe masat e parashikuar, nuk kanë kosto financiare.

3.14.1.2. TRANSPORTI HEKURUDHOR

Objektivi Strategjik

- Përafrimin e kuadrit ligjor me legjislacionin evropian.
- Përmirësimin gradual dhe të vazhdueshëm të infrastrukturës hekurudhore kombëtare, sidomos trungut kryesor hekurudhor dhe rritjes së nivelit te mekanizimit me qëllim rritjen e treguesve teknike e shfrytëzues.
- Ristrukturimin e mëtejshëm të sistemit hekurudhor, krijimin e Autoritetit Hekurudhor Shqiptar, riorganizimin e Hekurudhave Shqiptare sha, nëpërmjet ndarjes totale të aktiviteteve të operimit nga aktivitetet e administrimit dhe të mirëmbajtjes së infrastrukturës.
- Përmirësimin dhe rinovimin e shpejtë të mjeteve lëvizëse me qëllim që ti përgjigjen cilësisht më mirë nevojave të udhëtarëve dhe kërkesave në rritje të ekonomisë kombëtare, për transportin e mallrave.

Situata aktuale

Transporti hekurudhor bazohet në direktivat kryesore të KE-së (paketa e parë) për zhvillimin e sektorit hekurudhor si: hapja e tregut për transportues të tjerë përveç Hekurudhave Shqiptare Sha, liberalizimi, transparenca, mos diskriminimi i operatorëve, ndarja e operatorëve të transportit nga administruesit e infrastrukturës, etj. Në mbështetje të Kodit Hekurudhor në fuqi, janë miratuar edhe një sërë aktesh nënligjore.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligjin nr. 9317, datë 18.11.2004, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" (Fletorja zyrtare nr. 95/2004, faqe 6566), i cili përafron pjesërisht Direktivën 91/440/KEE, 95/18/KE, 2001/12/KE, 2001/13/KE, 2001/14/KE dhe Rregulloren 1191/69.
- Rregullorja e MPPT nr. 2638, datë 10.06.2011, "Mbi pajisjen me leje veprimtarie të transportuesve hekurudhore" (Fletorja Zyrtare nr. 96, datë 20.7.2011, fq. 3922). Kjo rregullore përafron plotësisht Direktivën 1995/18/KE të legjislacionin të BE-së.
- Rregullorja e MPPT nr. 3602, datë 18.08.2011, "Mbi mënyrën e ngarkimit të mallrave në vagonët hekurudhore (fletorja zyrtare nr. 126, datë 04 shtator 2011, fq. 5467). Kjo rregullore mbështetet plotësisht në rregulloret përkatëse të Bashkimit Ndërkombëtar të Hekurudhave (UIC).

Aktualisht Republika e Shqipërisë ka nënshkruar disa marrëveshje dhe është pjesë e organizatave shumëpalëshe në fushën e transportit ndërkombëtar hekurudhor:

- Konventa Ndërkombëtare për transportin e mallrave me hekurudhë (CIM) dhe konventa për transportin ndërkombëtar (COTIF)" e 9 maj 1980, aderuar me Dekretin e Presidentit nr. 6845, datë 06.12.1983, është bere e vlefshme me 1 qershor 1984. Gjithashtu Shqipëria është anëtare e Organizatës Ndërqeveritare të Transportit Ndërkombëtar Hekurudhor, që nga viti 1984 (OTIF).
- "Protokolli i Vilniusit e 3 qershorit 1999, që përmban modifikimin e Konventës për transportet ndërkombëtare hekurudhore (COTIF), e 9 maj 1980", aderuar me Ligjin nr.

8638, datë 13.07.2000 (botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 22, datë 19.07.2000, faqe 1073, hyrë në fuqi me 04.08.2000).

- Konventa e OKB-së (UNCE) "Për lehtësimin e kalimeve kufitare për mallrat e transportuara me hekurudhë", aderuar me Ligjin nr. 9167, datë 22.1.2004 (botuar ne Fletoren zyrtare nr. 6, datë 24 shkurt 2004, faqe 176).
- Konventa e OKB-së (UNCE) "Për lehtësimin e kalimeve kufitare për udhëtarët dhe bagazhet e transportuara me hekurudhë", aderuar me Ligjin nr. 9168, datë 22.01.2004 (botuar ne Fletoren zyrtare nr. 6, datë 24 shkurt 2004, faqe 184).
- Shtojca "A" e Konventës për transportin ndërkombëtar hekurudhor (COTIF) "Për rregullat uniforme për kontratën e transportit ndërkombëtar hekurudhor të udhëtarëve (CIV), aderuar me Ligjin nr. 9300, datë 28.10.2004 botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 90, datë 09.12.2004, faqe 6388. Hyrë në fuqi më 24.12.2004.
- Marrëveshja shumëpalëshe "Për ngritjen e një rrjeti hekurudhor, të performancës së lartë, në Evropën Juglindore", miratuar me Ligjin nr. 9620, datë 16.10.2006 (Fletoren zyrtare nr. 188, datë 17.11.2006, faqe 4731).
- "Marrëveshja Evropiane për Linjat Hekurudhore Ndërkombëtare Kryesore", miratuar me Ligjin nr. 9689, datë 05.03.2007 (Fletoren zyrtare nr. 28, datë 22.3.2007, faqe 508).

Në tërësi këto akte ligjore janë implementim i pjesshëm i akteve ligjore të paketës së parë hekurudhore të BE-së. Njëkohësisht aktet ligjore të Organizatës Ndërqeveritare për Transportet Ndërkombëtare Hekurudhore (OTIF), zbatohen plotësisht gjatë transportit hekurudhor ndërkombëtar.

Struktura institucionale

Organizimi aktual strukturor institucional, mbështetet në tre nivele kryesore dhe konkretisht:

Sektori i Politikave të Transportit Hekurudhor, në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit është përgjegjës për hartimin e politikave të zhvillimit, në përputhje me zhvillimin aktual të ekonomisë kombëtare dhe të nevojave për transportin e mallrave e të udhëtarëve, si për transportin e brendshëm ashtu dhe për transportin ndërkombëtar. Detyrë kryesore e këtij sektori është përafrimi i legjislacionin hekurudhor në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian, ndjekja e hartimi i studimeve të fizibilitetit dhe master–planeve për zhvillimin e transportit hekurudhor. Ky sektor mbështet zhvillimin e trafikut transit duke i dhënë përparësi zhvillimit të transporteve multimodale në korridoret Lindje–Perëndim, Veri–Jug si dhe ato në drejtim të Kosovës. Një tjetër detyrë e rëndësishme është mënjanimi i konkurrencës diskriminuese si dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese të transportit hekurudhor. Njëkohësisht Sektori i Politikave të Transportit Hekurudhor monitoron problemet e përputhshmërisë teknike dhe konformitetit të transportit hekurudhor që lidhen me gjendjen aktuale të inventarit të mjeteve lëvizëse, të sistemeve të komunikimit, të sinjalizimit e të operimit.

Niveli i ofrimit të shërbimeve të transportit hekurudhor, përbëhet nga transportuesit e ndryshëm hekurudhorë që ofrojnë shërbimet hekurudhore të transportit kombëtar dhe ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të mallrave. Aktualisht, në rrjetin hekurudhor shqiptar operon vetëm një transportues hekurudhor, që është Hekurudha Shqiptare sha.

Niveli i administrimit, mirëmbajtjes dhe zgjerimit të infrastrukturës hekurudhore, që është pjesë integrale e Hekurudhës Shqiptare, por është ndarë administrativisht dhe financiarisht nga aktiviteti i transportit. Hekurudha Shqiptare sha, ka statusin juridik të një shoqërie anonime. Struktura e saj përbehet nga katër njësi biznesi të ndara administrativisht dhe financiarisht në përputhje me direktivat e BE-së:

- Njësia e biznesit e transportit hekurudhor të udhëtarëve.
- Njësia e biznesit e transportit hekurudhor të mallrave.
- Njësia e biznesit e administrimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore.
- Njësia e biznesit për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse.

Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor është në vartësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe ka për detyrë kontrollin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore dhe garantimin e zbatimit të rregullave për: (i) mbrojtjen, mirëmbajtjen, remontin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës hekurudhore, (ii) lëvizjen e sigurt të trenave, (iii) kontrollin teknik të mjeteve lëvizëse gjatë shfrytëzimit të tyre, (iv) të gjitha procedurat e ndjekura gjatë pranimit teknik për shfrytëzim të mjeteve hekurudhore.

Masat legjislative afatshkurtra

Me qëllim përafrimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor me aktet komunitare, do të ndërmerren nismat e mëposhtme:

- Hartimi me konsulentë të huaj i projektligjit "Mbi sistemin hekurudhor në Republikën e Shqipërisë". Në të do të përfshihen të gjitha direktivat dhe rregulloret e BE-së, Dhjetor 2012, si direktivat e paketës së dytë dhe të tretë hekurudhore: Direktiva 2001/14/KE, 2001/16/KE, 2004/49/KE, 2004/50/KE, 2004/51/KE, 2007/58/KE, 2007/59/KE, 2008/57/KE, 2008/110/KE, dhe Rregulloret 1370/2007 dhe 1371/2007.

Hartimi i akteve nënligjore të Kodit Hekurudhor në fuqi:

- Udhëzim i Ministrit të PPT "Mbi kushtet teknike të ndërtimit, të funksionimit dhe të mirëmbajtjes së kalesave hekurudhore, të mbikalimeve dhe të nënkalimeve hekurudhore" (dhjetor 2012). Akti synon një përafrim të pjesshëm të Vendimit të Komisionit 2002/732/KE, datë 30 Maj 2002, lidhur me specifikimet teknike të ndërveprimit të nënsistemit të infrastrukturës të sistemit hekurudhor të shpejtësisë së lartë, që i referohet nenit 6(1) të Direktivës 96/48, fletorja zyrtare L 245, datë 12/09/2002, fq 0143 – 0279.
- Udhëzim për Standardet teknike të vijave hekurudhore, (nëntor 2012); do të përafrojë pjesërisht Vendimin e Komisionit 2008/217/KE, datë 20.12.2007, lidhur me një specifikim teknik të ndërveprimit të nënsistemit te infrastrukturës të sistemit hekurudhor të shpejtësisë së lartë, fletorja zyrtare L 77, datë 19.03.2008, fq. 0001 – 0105.
- Rregullore e MPPT-së, "Për kontrollin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e infrastrukturës hekurudhore", (nëntor 2012); Synon përafrim të pjesshëm të Vendimit të Komisionit 2008/217/KE, datë 20.12.2007 lidhur me një specifikim teknik të ndërveprimit të nënsistemit të infrastrukturës të sistemit hekurudhor të shpejtësisë së lartë, fletorja zyrtare L 77, datë 19.03.2008, fq 0001 – 0105.

- Udhëzim i Ministrit të PPT "Mbi kriteret e bashkimit të vijave hekurudhore në perigon", (tetor 2012); Synon përafrim të pjesshëm të Vendimit të Komisionit 2008/217/KE, datë 20.12.2007 lidhur me një specifikim teknik te ndërveprimit te nënsistemit te infrastrukturës te sistemit hekurudhor të shpejtësisë së lartë, fletorja zyrtare L 77, datë 19.03.2008, faqe 0001 – 0105.
- Rregullore e MPPT-së, "Për transportin hekurudhor të udhëtarëve dhe të bagazheve". Implementimi i Rregulloreve të BE-së 1370/2007 dhe 1371/2007 (dhjetor 2013). Ka për qëllim implementimin e pjesshëm të Rregullores 1371/2007 të BE-së.
- Rregullore "Mbi kriteret e lëshimit të certifikatave, autorizimeve të formimit profesional të drejtuesve të mjeteve tërheqëse, të personelit të lëvizjes së trenave, të personelit të instalimit dhe të mirëmbajtjes së sistemeve të sinjalizimit e të ndërlidhjes, të kontrollit teknik të mjeteve dhe të materialeve hekurudhore", në përputhje të pjesshme me Direktivën 2007/59);
- Miratimi i Rregullores "Për shfrytëzimin teknik të hekurudhave", në përputhje të pjesshme me Standardet Teknike të Ndërveprimit, për operimin në sistemin hekurudhor); Përafrim i pjesshëm i Vendimit të Komisionit 2008/231/KE, datë 01.02.2008 lidhur me specifikimin teknik të ndërveprimit të nënsistemit "operimi" të sistemit hekurudhor trans-evropian të cituar në nenin 6§1 të Direktivës 96/48/KE, fletorja zyrtare L 84, datë 26.03.2008, faqe 1-131.

Aktivitet zbatuese

- Krijimin e kushteve optimale, për hapjen e tregut në sektorin hekurudhor.

Masat ligjore afatmesme

Këto masa synojnë në transpozimin gradual të direktivave të përthyera te BE-së në legjislacionin kombëtar dhe konkretisht:

- Hartimi i VKM-së, "Për krijimin e autoritetit Hekurudhor Shqiptar", i cili përafron pjesërisht direktivat 95/18, 2001/14, 2001/16, 2004/49, 2007/59 (Dhjetor 2013).

Hartimi i akteve nënligjore:
- Rregullorja "Për kushtet teknike të ndërtimit, mirëmbajtjes dhe të shfrytëzimit të sistemit të ndërlidhjes" (2013).
- Rregullorja "Për kushtet teknike të sistemit të sinjalizimit dhe të shenjëzimit në vijat hekurudhore" (2014).
- Rregullore "Për përdorimin e vijës hekurudhore nga transportuesit hekurudhore", që përafron Direktivën 2001/14/KE (trem 3 –të i 2013).
- Rregullorja "Për transportin hekurudhor të mallrave të rrezikshme" (2014).
- Rregullorja "Për kushtet e pranimit teknik dhe të pranimit për shfrytëzim të mjeteve hekurudhore" (2013) (Përputhje e pjesshme me Standardet Teknike të Ndërveprimit të përcaktuara në direktivat 96/48/KE dhe 2001/16/KE).

Të gjitha këto iniciativa ligjore do të jenë pjesërisht të përputhura me direktivat, rregulloret dhe Standardet Teknike të Ndërveprimit të BE-së.

Aktivitet zbatuese afatmesme

- Krijimi i Autoritetit Hekurudhor Shqiptar. (trem IV i vitit 2013 – trem I-rë, i vitit 2014), i cili do të ketë strukturën, si Sektori i Rregullimit të Tregut (2 specialistë); Sektori i sigurisë ne trafikun hekurudhor (3 specialistë); Sektori i notifikimit dhe regjistrit të mjeteve hekurudhore (2 specialistë); Sektori i përgatitjes së akteve ligjore dhe nënligjore, rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për fushën e hekurudhave(4 specialistë).
- Ndarja e Hekurudhës Shqiptare sha, në katër ndërmarrje të veçanta, si Ndërmarrja për transportin hekurudhor të udhëtarëve; Ndërmarrja për transportin hekurudhor të mallrave; Ndërmarrja për administrimin dhe mirëmbajtën e infrastrukturës hekurudhore; Ndërmarrja për mirëmbajtjen e mjeteve hekurudhore.

Ndërmarrja për Administrimin e Infrastrukturës Hekurudhore do të jetë një ndërmarrje publike. Dy ndërmarrjet e transportit (e transportit të udhëtarëve dhe e transportit të mallrave) dhe baza e riparimit të mjeteve lëvizëse fillimisht do të jenë shoqëri anonime, pronë shtetërore e më tej mund të privatizohen.

Krijimi i ndërmarrjeve të reja do te realizohet pas miratimit te ligjit "Për sistemin hekurudhor në Republikën e Shqipërisë", dhe parashikohet të realizohet në periudhën janar – prill 2014;

Efektet financiare

Kostot e akteve ligjore dhe nënligjore që do të hartohen si dhe masat zbatuese do të përballohen me fondi i pagave të punonjësve të parashikuara në buxhet.

Sa i përket Asistencës së huaj **"**LOUIS BERGER SAS", do të asistojë Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit me financim të BE-së – EuropeAid/128432/C/SERIAL edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2012. Konsulenca në fushën e transportit hekurudhor ka për objektiv përfundimin e draftit të ri të ligjit "Mbi sistemin hekurudhor ne Republikën e Shqipërisë", i cili po konsolidohet më tej pas draftit paraprak të përgatitur gjatë vitit 2011.

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.14.1.2.: Transporti hekurudhor

Në Lekë

	2012	**2013**	**2014**	**2015**
Kostot totale e vlerësuar	**7.000.000**	**0**	**0**	**0**
Mbuluar nga ndihma e huaj	7.000.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.14.1.3. TRANSPORTI I KOMBINUAR

Situata aktuale

Transporti i kombinuar në Shqipëri aktualisht paraqitet në formën e një transporti multimodal, i cili zhvillohet vetëm përmes ndërrimit të llojit të transporteve nga transporti

detar në transportin rrugor. Ky lloj transporti gjen zbatim për transportin e kontejnerëve të magazinuar në portin e Durrësit në drejtim të Kosovës.

Transporti i kombinuar parashikohet të gjej një zhvillim më të madh në vitet në vijim, pasi do të përfshihet edhe transporti hekurudhor. Për transportin e kombinuar me hekurudhë është parashikuar rehabilitimi i segmentit hekurudhor Tiranë – Durrës, termat e referencës së projektit për këtë qëllim kanë përfunduar dhe tani po kryhet "hartimi i detajuar". Gjithashtu, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka akorduar një fond, për ndërtimin e një terminali kontejnerësh në Tiranë, i cili do të shërbejë për këtë lloj transporti.

Objektivi është zhvillimi gradual i transportit të kombinuar, që lidh portet shqiptare me vendet fqinje sidomos në akset: (i) Korridori i VIII (duke kompletuar ndërtimin e linjës hekurudhore me Republikën e Maqedonisë, me qëllim lidhjen e saj me Detin Adriatik dhe detin Jon) (ii) Tiranë Shkodër – Podgoricë dhe (iii) portet Durrës – Vlore – Shëngjin, në drejtim të Kosovës dhe më tej.

Komuniteti Evropian, i përfaqësuar nga Delegacioni i Komisionit Evropian për Shqipërinë, në kuadrin e IPA 2007 "Programi i bashkëpunimit kufitar" ka financuar studimin "Rrjeti Transnacional, për nxitjen e transportit multimodal ujë – tokë", me pjesëmarrës nga Shqipëria, Austria, Bullgaria, Greqia, Italia, Rumania, Sllovenia, Mali i Zi dhe Serbia.

Studimi ka për objektiva kryesore përcaktimin e një sërë indikatorëve të përgjithshëm për matjen dhe regjistrimin e shërbimeve të platformave të logjistikës multimodale ujë/tokë, duke orientuar, në këtë mënyrë, operatorët logjistik publik ose privat në vlerësimin e situatës, orientimin e investimeve, etj.; implementimin e lidhjeve ndërmjet infrastrukturës det-/transport ujor-port dhe zonës në brendësi të territorit tokësor të vendit, etj.

Kuadri ligjor ekzistues në fushën e transportin të kombinuar bazohet në:

- Konventa "Marrëveshja Evropiane mbi linjat e rëndësishme ndërkombëtare të transportit të kombinuar dhe instalimet përkatëse" (AGTC), ratifikuar nga Kuvendi me Ligjin nr. 9873, datë 14.02.2008 (Fletore Zyrtare e RSH nr. 28 /08, f. 1305);
- Zhvillimi i transportit të kombinuar të mallrave në Republikën e Shqipërisë është parashikuar në Strategjinë Sektoriale të Transportit, të miratuar me VKM nr. 1214, datë 03.09.2008, "Për miratimin e strategjisë sektoriale të transportit" (Fletore zyrtare e RSH nr. 145/08).
- Marrëveshja bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë "Për transportin ndërkombëtar të kombinuar të mallrave", ratifikuar nga Kuvendi me Ligjin nr. 9132, datë 11.09.2003 (Fletore Zyrtare e RSH nr. 83/03, fq. 3665);
- Marrëveshja bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë "Mbi transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave" miratuar në parim me VKM nr. 468, datë 23.06.2005, e cila nxit transportin e kombinuar te operatorët e transportit rrugor.
- Në dy marrëveshjet bilaterale të mësipërme nuk është identifikuar asnjë linjë e transportit ndërkombëtar të kombinuar dhe për pasojë këto marrëveshje ende nuk kanë gjetur zbatim.

3.14.2. TRANSPORTI DETAR (UJOR)

Objektivi Strategjik

- Përafrimi i legjislacionit kombëtar të fushës së transportit detar me legjislacion evropian, përfshi edhe aktet ligjore për sigurinë e jetës në det, mbrojtjen e mjedisit detar, trajnimi dhe certifikimi i detarëve sipas standardeve të IMO-s. etj.
- Konsolidimi i strukturave të Administratës Detare; Sektorit të Regjistrimit të Anijeve dhe Detarëve; Kontrollin Shtetëror të Flamurit; Kapitaneritë e Porteve
- Përmirësimi i kushteve të sigurisë detare, veçanërisht shkalla e ndalimit të anijeve shqiptare sipas Memorandumit të Mirëkuptimit të Parisit.
- Krijimi i Kontrollit Shtetëror Portual, në zbatim të Memorandumit të Parisit
- Kontrolli dhe përmirësimi i kushteve të punës së detarëve në anije sipas standardeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Situata aktuale

Politikat e zhvillimit të Transportin Detar burojnë nga Plani Kombëtar i Transportit, Strategjia e Sektorit të Transportit, VKM nr. 1214, datë 03.09.2008), si dhe Master-Planet e secilit port. Përafrimi i legjislacionit kombëtar me atë ndërkombëtar dhe ratifikimi i Konventave Ndërkombëtare në fushën e detarisë, ka qenë dhe është në qendër të vëmendjes, si rezultat i së cilës janë hartuar dhe miratuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, në zbatim të kërkesave të Kodit Detar dhe Konventave Ndërkombëtare. Është ndryshuar Kodi Detar, në zbatim të rekomandimeve të KE, është miratuar VKM-ja, Për miratimin e Rregullores mbi Formalitetet e Anijeve që Operojnë në Portet Detare të Republikës së Shqipërisë, si dhe Urdhri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, në zbatim të detyrimeve që dalin nga aderimi në Konventën STCW.

Gjithashtu, janë përgatitur e miratuar në Parlament dhe ratifikuar Konventa të Kombeve të Bashkuara dhe Organizatës Ndërkombëtare Detare, të cilat lidhen dhe me zbatimin e direktivave përkatëse të Komunitetit Evropian si: Konventat Ndërkombëtare, Për barrët dhe hipotekat, Për Përgjegjësinë Civile për Dëmet e Shkaktuara nga Ndotja, nga Karburanti i Depozitave, 2001, Për heqjen e anijeve të mbytura, Për aderimin e Konventës HNS, etj.

Reformat Institucionale, janë një objektiv i rëndësishëm i programit të qeverise, për të cilën, po punohet me programe konkrete si nga ana MPPT-së dhe e porteve, për riorganizimin e strukturave ekzistuese dhe krimin e strukturave të reja të specializuara dhe efektive për t'ju përgjigjur në kohë kërkesave të ligjshmërisë kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e detarisë.

Në këtë drejtim, Autoriteti Portual Durrës, në zbatim të Ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003, është në procesin e ristrukturimit të tij, për tu transformuar ne fazën finale në "Land - Lord Port".

Mbi bazën e Ligjit nr. 10109, datë 02.04.2009 "Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë" dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 131, datë 14.06.2010, "Për miratimin e strukturës

dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare", vazhdon puna për plotësimin e strukturave përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, të cilat janë në procesin e organizimit dhe të hartimit të rregulloreve përkatëse, mbi bazën e kërkesave të Memorandumit të Parisit, Konventave SOLAS 1974, MARPOL dhe Direktivave përkatëse.

Aktualisht është bërë riorganizimi i Kapitanerisë së Porteve dhe krijimi i strukturave të Regjistrit të Anijeve dhe Detareve, Autoritetit të Sigurisë, Kontrolli Shtetëror Portual, me struktura sipas standardit me personel të trajnuar dhe efektiv për plotësimin e kërkesave të ligjshmërisë detare kombëtare dhe ndërkombëtare dhe në veçanti, të Memorandumin e Parisit, Konventave SOLAS 1976, Marpol 1974/78, STCW 1976, për të garantuar standardin teknik të anijeve, për sigurinë e jetës në det dhe të mjedisit detar.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 8569, datë 20.01.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për standardet e kualifikimit, atestimit dhe të shërbimit për detarët".
- Ligj nr. 8663, datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me tonazh nën 20NT".
- Ligji nr. 8690, datë 16.12.2000, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të detit Mesdhe, (Konventa e Barcelonës)".
- Ligji nr. 8989, datë 23.01.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për Tonazhin e Anijeve".
- Ligji nr. 9032, datë 20.03.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për Vijën e Ngarkesës".
- Ligji nr. 9055, datë 24.04.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për të Drejtën e Detit", Montego Bay, Xhamajka.
- Ligji nr. 9056, datë 24.04.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për Kërkim Shpëtimin në Det"
- Ligji nr. 9130, datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual"
- Ligji nr. 9166, datë 22.01.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për rregullat për parandalimin e përplasjeve në det".
- Ligji nr. 9212, datë 25.03.2004, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për kufizimin e përgjegjësive te pronareve për kleimet"
- Ligji nr. 9213, datë 01.04.2004, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për Shpëtimin e Jetës në Det" (SOLAS 1974), së bashku me amendamentet që pasojnë atë deri në Dhjetor të vitit 2000.
- Ligji nr. 9251, datë 8.7.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë".
- Ligji nr. 9254, datë 15.07.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara, "Mbi Kushtet e Regjistrimit".
- Ligji nr. 9277, datë 23.09.2004, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Athinës "Për transportin e pasagjereve dhe bagazheve të tyre me det".
- Ligji nr. 9281, datë 23.09.2004, "Për sigurinë në anije dhe porte".
- Ligji nr. 9292, date 21.10.2004, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për Krijimin e Fondit".

- Ligji nr. 9293, datë 21.10.2004, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për Përgjegjësitë Civile për Ndotjen nga karburantet".
- Ligji nr. 9428, datë 13.10.2005, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për krijimin e lehtësive për trafikun ndërkombëtar detar, (FAL), London 1965".
- Ligji nr. 9495, datë 20.03.2006, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për shpëtimin, 1989, London".
- Ligji nr. 9504, datë 03.04.2006, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për transportin e mallrave në rrugë detare (Rregullat e Hamburgut)".
- Ligji nr. 9594, datë 27.07.2006 "Për aderimin në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973 të ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78).".
- Ligji nr. 9852, datë 26.12.2007, Për Aderimin ne Memorandumin e Parisit, "Për Kontrollin Shtetëror Portal"
- Ligji nr. 9912, datë 05.05.2008, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për Ujërat e Balastit"
- Ligji nr. 10 085, datë 26.02.2009 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për barrët dhe hipotekat"
- Ligji nr. 10109, datë 02.04.2009, "Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë"
- Ligji nr. 10 224, datë 4.2.2010 Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për Përgjegjësinë Civile për Dëmet e Shkaktuara nga Ndotja nga Karburanti i Depozitave, 2001"
- Ligji nr. 10260, datë 01.04.2010 Për aderimin në konventën ndërkombëtare "Për heqjen e anijeve të mbytura"
- Ligji nr. 10290, datë 24.06.2010 "Për aderimin në konventën ndërkombëtare të HNS"
- Ligji nr. 10396, datë 17.03.2011 "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale te Gjermanisë, për Transportin Detar"
- Ligji nr. 10 483, datë 17.11.2011 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9251, datë 08.07.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë".
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 892, datë 21.12.2011 "Për miratimin e Rregullores mbi Formalitetet e Anijeve që Operojnë në Portet Detare të Republikës së Shqipërisë", përfarim i plotë me Direktivën nr. 2002/6/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 18 Shkurt 2002. "Mbi formalitetet e raportimit për anijet që mbërrijnë dhe/ose nisen nga portet e Shteteve Anëtare të Komunitetit".
- Urdhër i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr. 111, datë 13.12.2011 Për miratimin e Rregullores për "Ekuipazhimin në Mënyrë të Sigurt të Anijeve që Lundrojnë me Flamurin Shqiptar".
- Urdhër i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr. 112, datë 13.12.2011 Për miratimin e Rregullores për "Trajnimin, Edukimin, Ekzaminimin, Certifikimin dhe Inspektimin e Aktivitetit të Detarëve".
- Urdhër i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr. 113, datë 13.12.2011 Për miratimin e Rregullores për "Për Trajnimin dhe Certifikimin e Detarëve". Përafrim i pjesshëm i Direktivës 2008/106/KE, e datës 19 Nëntor 2008. "Mbi nivelin minimal të trajnimit të detarëve"

Struktura institucionale

Sektori i Politikave të Transportit Detar, është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Politikave të Transportit dhe ka për qëllim zbatimin e programit të Qeverisë dhe Ministrisë në fushën e zhvillimit të transportit detar, nëpërmjet studimit, identifikimit, zhvillimit dhe koordinimit të politikave dhe ndërhyrjeve për zhvillimin e integruar të transportit detar. Misioni i këtij Sektori përfshin të gjitha çështjet administrative, juridike, ekonomike, financiare, teknike, sociale etj, brenda kuadrit ligjor të kompetencave të kësaj Ministrie, si:

- Përcaktimi i strategjisë së zhvillimit të Transportit Detar, Ujor, dhe Porteve,
- Përcaktimi i rregullave të administrimit të pronës brenda territoreve të porteve,
- Përgatitja e legjislacionit për rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimin normal të aktiviteteve në fushën e transportit detar, ujor dhe porteve.
- Përcaktimi i rregullave për parandalimin dhe mbrojtjen nga ndotja të mjedisit në bashkëpunim me Ministritë e interesuara në zbatim të Konventave Ndërkombëtare Detare si dhe mënyrën e zbatimit dhe kontrollit të këtyre rregullave etj.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Detare, Drejtorinë e Shërbimeve Juridike, Drejtorinë e Integrimit dhe Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë, në MPPT, ky sektor përgatit:

- Marrëveshjet detare me shtetet e tjera që burojnë nga zbatimi i Ligjit të Detit, Konventave Ndërkombëtare Detare, Direktivave etj.
- Të gjithë dokumentacionin për ratifikimin, bashkimin ose pranimin e Konventave Ndërkombëtare Detare, si dhe Rregullat kombëtare në zbatim të tyre.
- Ndjek në procesin e zhvillimit të përgjithshëm të gjitha problemet që dalin për detin duke i zgjidhur ato sipas kompetencave që i jep ligji.
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës harton Planin Buxhetor Afatmesëm, në lidhje me kryerjen e investimeve në sektorin e transportit detar, ujor dhe porteve.
- Bashkëpunon me institucionet e tjera në fushën e detarisë si: Drejtoria e Përgjithshme Detare, Autoriteti Portual Durrës, Portet Detare Sh.A, Regjistri Detar Sh.A,, për çështjet që lidhen me funksionimin e këtyre institucioneve.

Drejtoria e Përgjithshme Detare e krijuar mbi bazën e Ligjit nr. 10109, datë 02.04.2009 "Për Administratën Detare Republikës së Shqipërisë" dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 131, datë 14.06.2010 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme", është autoriteti përgjegjës për funksionimin e Administratës Detare, për Politikat e zhvillimit të transportit Detar dhe monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit, për fushën e detarisë në varësi të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit. DPD drejton dhe organizon veprimtarinë e strukturave përbërëse të administratës detare, në zbatim të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për fushën e detarisë të cilat janë: Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale, Kapiteneria e Porteve, Kontrolli Shtetëror Portual, Kontrolli Shtetëror i Flamurit, Regjistri i mjeteve lundruese dhe regjistri i detarëve të Republikës së Shqipërisë. Drejtoria ka këto detyra kryesore:

- Drejton e bashkërendon veprimtarinë e strukturave përbërëse të administratës detare.
- Kontrollon zbatimin e rregullave të përgjithshme, kombëtare dhe ndërkombëtare, të detarisë nga të gjitha subjektet private dhe shtetërore, të regjistruara si të tilla, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e detarisë dhe janë të lejuara, sipas ligjit, nga ministria.
- Jep asistencë teknike në hartimin dhe përafrimin e legjislacionit kombëtar detar me legjislacionin ndërkombëtar. Bën plotësimin e kuadrit ligjor kombëtar për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, që lidhen me të drejtën e detit dhe transportin detar, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.
- Bashkëpunon me të gjitha institucionet e tjera, si me Rojën Bregdetare, me strukturat e Policisë Kufitare me agjencitë doganore, me agjencitë mjedisore, me Shërbimin Hidrografik dhe me shoqatat e operatorëve privatë që kanë lidhje me veprimtarinë e fushës së detarisë,
- Bashkëpunon me institucionet rajonale homologe me qëllim monitorimin dhe rregullimin e trafikut detar në rajon e më gjerë.
- Organizon dhe kontrollon trajnimet e specialistëve në fushën e detarisë.

Masat legjislative afatshkurtra

- Hartimi dhe miratimi me VKM të "Planit Kombëtar të Kontigjencës në rastet e ndotjes aksidentale detare dhe anekset përkatëse", në zbatim të detyrimeve që i dalin Republikës së Shqipërisë nga Konventat Ndërkombëtare MARPOL dhe "Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të detit Mesdhe, (Konventa e Barcelonës)", (3 mujori i tretë i vitit 2012).
- Hartimin e Rregullores "Për Sigurinë në Portet Detare të Republikës së Shqipërisë", e cila përafron pjesërisht Rregulloren (KE) nr. 725/2004, datë 31 Mars 2004 "Mbi rritjen e sigurisë në anije dhe në porte", (3 mujori i katërt i vitit 2013).
- Hartimin e Ligjit "Për aderimin e Protokollit mbi Përgatitjen, Kundërveprimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve me ndotje nga Lëndët e Rrezikshme dhe Helmuese, 2000 (Protokolli OPRC-HNS 2000)", (3 mujori i katërt).
- Hartimi i Rregullores "Për Monitorimin e Trafikut të Anijeve dhe Sistemit të Informacionit", e cila përafron pjesërisht Direktivën 2002/59/KE, datë 27 Qershor 2002, "Mbi vendosjen e sistemit të monitorimit dhe informimit të trafikut të anijeve të Komunitetit dhe shfuqizimin e Direktivës 93/75/KEE", (3 mujori i parë 2013).
- Hartimin e Rregullores "Për Regjistrimin e Anijeve". e cila përafron pjesërisht Rregulloren (KE) nr. 789/2004, datë 21 Prill 2004 "Mbi transferimin e anijeve të mallrave dhe pasagjerëve midis regjistrave brenda Komunitetit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit nr. 613/91", (3 mujori i katërt i vitit 2013).

Masat legjislative afatmesme

- Hartimi i Projektligjit "Për Aderimin në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Transportin Ndërkombëtar të Mallrave plotësisht apo pjesërisht nëpërmjet Detit 2009 (Rregullat e Roterdamit)", (3 mujori i tretë i vitit 2015).
- Hartimi i Projektligjit "Për Aderimin në Konventën Ndërkombëtare Detare të Punës 2006 (MLC, 2006)", (3 mujori i katërt i vitit 2015)

- Hartimi i Rregullores "Për Rregullat e Inspektimit te Anijeve", e cila përafron pjesërisht Direktivën 2009/15/KE, datë 23 Prill 2009 "Mbi rregullat dhe standardet e përbashkëta për organizmat e inspektimit dhe kontrollit të anijeve dhe për aktivitete të administratës detare". (3 mujori i katërt i vitit 2015)
- Hartimin e Rregullores "Për Inspektimin e Kontrollit Shtetëror Portual", e cila përafron pjesërisht Direktivën 2009/16/KE, datë 23 Prill 2009 "Mbi Kontrollin Shtetëror Portual", (3 mujori i katërt i vitit 2015).
- Hartimin e Rregullores "Për Matjen e Tonazhit të Anijeve", e cila përafron pjesërisht Rregulloren (KE) nr. 391/2009, 23 Prill 2009. Mbi rregullat dhe standardet e përbashkëta për organizmat e inspektimit dhe kontrollit të anijeve" Hartimin e Rregullores "Për Rregullat e Vijës së Ngarkesës", (3 mujori i katërt i vitit 2015)
- Hartimi i Rregullores "Për Parandalimin e Përplasjeve në Det", (3 mujori i katërt i vitit 2015)
- Hartimin e Rregullores "Për Investigimin e Aksidenteve Detare", i cili përafron pjesërisht Direktivën 2009/18/KE, datë 23 Prill 2009 "Mbi vendosjen e parimeve kryesore që drejtojnë investigimin e incidenteve në sektorin e transportit detar dhe ndryshimin e Direktivës së Këshillit 1999/35/KE të Parlamentit Evropian, (3 mujori i katërt i vitit 2015).
- Hartimin e Rregullores së Pilotimit, e cila përafron pjesërisht Direktivën e KE-së " Për certifikatën e përjashtimit të pilotit adoptuar në Direktivën për formalitetet e raportimit për anijet që preken dhe nisen nga portet e shteteve anëtare të BE-së " (2010/65/EU). (3 mujori i katërt i vitit 2015.)

Aktivitet zbatuese afatmesme

- Kompletimi i Administratës Detare me strukturat sipas standardeve të IMO-s dhe me staf të trajnuara dhe me kapacitetet e nevojshme për zbatimin e ligjshmërisë detare kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Hartimi i rregulloreve përkatëse për zbatimin e kërkesave të konventave ndërkombëtare detare të IMO-s dhe Direktivave përkatëse.

3.14.3. TRANSPORTI AJROR

Objektivi strategjik

- Ngritja e një sistemi legjislativ të qëndrueshëm në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar nëpërmjet përshtatjes së infrastrukturës ligjore dhe operuese në këtë fushë në zbatim të dispozitave të marrëveshjeve së Shqipërisë me KE (Marrëveshja Horizontale dhe Marrëveshja ECAA), me qëllim rritjen e efiçencës së Transportit Ajror në lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave.
- Krijimin gradualisht të një infrastrukture ligjore dhe operative unike e të lidhur qarkullimi, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel rajonal nëpërmjet zbatimit me efiçencë të legjislacionit e të projekteve aeroportuale, për rritjen e kapaciteteve të qarkullimit dhe të metodave më efektive të tërheqjes së kapitaleve private në këto shërbime.

- Forcimi i kapaciteteve të Organit Kombëtar të Investigimit të Incidenteve/Aksidenteve ajrore, në zbatim të VKM-së nr. 686, datë 02.06.2010 "Për krijimin e OKIIA-s", ndjekja e procedurave ligjore, për certifikimin e investiguesve sipas standardeve ndërkombëtare me qëllim njohjen e tyre nga organizmat ndërkombëtare"
- Rritjes e performancës dhe plotësimit të rekomandimeve, për forcimin e kapaciteteve të administratës teknike të Autoritetit të Aviacionit Civil, sipas standardeve evropiane.
- Forcimi i rolit të Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC) si Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës në aviacion, me qëllim plotësimin e rekomandimeve përkatëse.
- Krijimin e një tregu konkurrues, jo diskriminues, të liberalizuar të shërbimeve të operimit të Transportit Ajror, me synim rritjen e lëvizjes së pasagjereve dhe mallrave.
- Njehsim me standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe parrezikshmërisë, zbatimi praktik të dokumenteve që normojnë këto procedura të sigurisë në aviacion, si dhe vendosja e standardeve të informacionit, te raportimit të shërbimeve në aviacion.

Situata aktuale

Puna në fushën e sektorit ajror është përqendruar në përmbushjen e detyrimeve të Fazës së I-rë, Tranzitore të Marrëveshjes Shumëpalëshe, Plotësimin e detyrimeve të Konventës së Çikagos (ICAO--s), si dhe përfundimin e akteve nënligjore përfundimtare në zbatim të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008, i ndryshuar Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë.

Ka përfunduar projekti i modernizimit të Trafikut Ajror i cili përfshinte ndërtimin e Kullës dhe Qendrës së Kontrollit të Trafikut Ajror, si dhe ngritjen e sistemit të menaxhimit të trafikut ajror tashmë i certifikuar dhe i integruar në sistemin unik të hapësirës ajrore evropiane të përcaktuar nga EUROKONTROLLI .

Aktualisht po ndiqet zbatimi i Kontratës së Koncesionit të Aeroportit dhe ecurisë së fazave të zbatimit në përputhje të plotë me kushtet e kontratës, duke patur parasysh suksesin e ecurisë së kësaj kontrate, e cila është e reflektuar dhe në rritjen e shifrave përkatëse të pasagjerëve që kanë përdorur aeroportin "Nenë Tereza".

Në vijim të angazhimeve të marra në Komitetin e Sigurisë Ajrore në Komisionin Evropian, mbikëqyrja e sigurisë ajrore në AAC, kryhet nga ekspertë të huaj të certifikuar nga EASA dhe është siguruar vazhdueshmëria e këtij procesi. Autoriteti i Aviacionit Civil tashmë është i gatshëm për kryerjen e ricertifikimit të avionëve dhe kryerjen e inspektimeve përkatëse në lidhje me standardet e sigurisë ajrore.

Ndërkohë, vazhdon implementimi i projektit të binjakëzimit (Twining), ndërmjet AAC-së dhe ENAC, nëpërmjet të cilit është ndjekur një plan veprimi eficent në lidhje me hartimin e manualeve dhe procedurave teknike, si dhe trajnime të vazhdueshme, me stafin teknik të AAC-së.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 9658, datë 18.12.2006 "Marrëveshja Shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjë - Hercegovinës,

Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për Krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian".

- Ligji nr. 10 040, datë 22.12.2008, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, që përafron pjesërisht Rregulloren nr. 1008/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 24 Shtator 2008 "Mbi rregullat e përbashkëta për operimin e shërbimeve ajrore" (nr. celex 32008R1008 *Fletore Zyrtare e KE L 293, 31.10.2008, p. 3–20*), ndryshuar me Ligjin nr. 10 484, datë 24.11.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" (F.Z. e RSH Nr. 164, Dhjetor 2011).
- Ligji nr. 10 233, datë 11.02.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", i ndryshuar me Ligjin nr. 10 479, datë 10.11.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10 233, datë 11.02.2010 " Për Autoritetin e Aviacionit Civil" (F.Z. e R.SH nr. 157, datë 1 dhjetor 2011), i cili është një ligj organik dhe nuk ka shkallë përputhshmërie.
- VKM nr. 686, datë 02.06.2010 "Për krijimin e Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil" (*F.Z. e RSH nr. 127, datë 10.09.2010*), që përafron plotësisht Direktivën nr. 94/56/KE e 21 Nëntorit 1994 "Që vendos parimet themelore në hetimin mbi aksidentet dhe incidentet e aviacionit civil"(nr. celex 31994L0056 Fletore Zyrtare e KE L 319, 12/12/1994 p. 14-19)
- VKM nr. 74, datë 02.02.2011 "Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil".
- VKM nr. 575, datë 10.08.2011. "Për Miratimin e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil", që përafron pjesërisht Rregulloren nr. 2320/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 16 Dhjetorit 2002 "Që përcakton rregullat e përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil" (nr. celex 32002R2320 Fletore Zyrtare e KE L 355, 30.12.2002 p. 1- 22).
- Udhëzim i MPPT nr. 17, datë 02.09.2010 "Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", që përafron plotësisht Rregulloren nr. 1008/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 24 Shtator 2008 "Mbi rregullat e përbashkëta për operimin e shërbimeve ajrore" (nr. celex 32008R1008 Fletore Zyrtare e KE L 293, 31.10.2008, p. 3–20).
- Udhëzim i MPPT-së, nr. 3, datë 07.02.2011, "Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil", që përafron pjesërisht Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit nr. 216/2008, datë 20.02.2008 "Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe për krijimin e Agjencisë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit" (nr. celex 32008R0216 Fletore Zyrtare e KE L 079, 19/03/2008 p. 1 – 49).
- Udhëzim i Përbashkët i MPPT dhe MPAU nr. 1037/1, datë 12.04.2011"Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore"(F.Z. e R.SH nr. 55, datë 10 Maj 2011), që përafron pjesërisht Direktivën 2002/49 KE, datë 25 Qershor 2002. "Në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës së mjedisit" (nr. celex 32002L0049 Fletore Zyrtare e KE L 189, 18.7.2002, p. 12–25).
- Urdhër i MPPT-së, nr. 68, datë 10.06.2011 "Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil", që përafron plotësisht Direktivën 2003/42/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 13 qershor 2003 "Mbi raportimin e

ngjarjeve në aviacionin civil" (nr. celex 32003L0042 Fletore Zyrtare e KE L 167 , 04/07/2003 p. 23 – 36).

- Urdhër i MPPT-së, nr. 84, datë 09.09.2011 "Për miratimin e rregullores së organizimit të procesit të alokimit të sloteve në aeroporte" që përafron pjesërisht Rregulloren e Këshillit nr. 95/93/KE, e datës 18 Janar 1993 "Mbi rregullat e përbashkëta për caktimin e sloteve në aeroporte" (nr. celex 31993R0095 Fletore Zyrtare e KE L 14, 22.1.1993, p. 1–6).
- Urdhër MPPT-së, nr. 85, datë 09.09.2011 "Për miratimin e rregullores për përgjegjësinë e transportuesit ajror në lidhje me transportin ajror të pasagjerëve dhe bagazheve të tyre" që përafron pjesërisht Rregulloren e Këshillit nr. 2027/97, e 9 Tetorit 1997, "Për përgjegjësinë e transportuesit ajror në rast aksidenti"(nr. celex 31997R2027**,** Gazeta Zyrtare e KE L 285, 17.10.1997, f. 0001-0003).
- Udhëzim i MPPT-së, nr. 17, datë 28.09.2011 "Për organizimin e kohës së punës të punëtorëve të lëvizshëm në aviacionin civil", që përafron pjesërisht Direktivën e Këshillit nr. 2000/79/KE e 27 Nëntorit 2000 "Lidhur me Marrëveshjen Evropiane mbi organizimin e kohës së punës së punëtorëve të lëvizshëm në aviacionin civil"(nr. celex 32000L007, Gazeta Zyrtare e KE L 302, 1.12.2000, p. 57–60).
- Urdhri i MPPT-së nr. 92, datë 28.09.2011 "Për miratimin e rregullores mbi harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në fushën e aviacionit civil", që përafron plotësisht me tekstin e konsoliduar Rregulloren e Këshillit 3922/91, e datës 16 Dhjetor 1991 "Për harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në fushën e aviacionit civil" (nr. celex 31991R3922, Gazeta Zyrtare e KE L 373, 31/12/1991 P. 0004 – 0008).

Struktura institucionale

Sektori i Politikave të Transportit Ajror, është pjesë e strukturës së Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, i cili ushtron funksionet e tij si pjesë e Drejtorisë së Politikave të Transportit .

Roli i Sektorit të Politikave të Transportit Ajror qëndron në hartimin e politikave të transportit ajror, për zhvillimin e transportit ajror dhe aviacionit civil në veçanti në përputhje me objektivat politike të Qeverisë, sipas standardeve ndërkombëtare dhe në zbatim të dispozitave të marrëveshjes Shumëpalëshe "Për krijimin e ZPAE-së (Marrëveshja ECAA).

Gjithashtu, Sektori i Politikave të Transportit Ajror, është veçanërisht përgjegjës për hartimin dhe negocimin e marrëveshjeve bilaterale e multilaterale në fushën e transportit ajror, planifikimin, propozimin dhe hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore të kësaj fushe si pjesë integrale e Programit Analitik të Akteve të Këshillit të Ministrave dhe Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Për realizimin e objektivave të tij, ky Sektor bashkëpunon me:

- Autoritetin e Aviacionit Civil, i cili është një institucion shtetëror publik, jobuxhetor me statusin e personit juridik, në varësi të ministrit që mbulon çështjet e transportit. AAC kryen veprimtarinë e tij si organi rregullator në fushën e aviacionit civil dhe objekti i veprimtarisë së tij është rregullimi dhe mbikëqyrja e të gjitha veprimtarive në fushën e

transportit ajror civil në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

- Organin Kombëtar të Investigimit të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore, si një institucion juridik publik, në varësi të ministrit përgjegjës për transportet. Objekti i veprimtarisë së Organit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore është investigimi i plotë i çdo aksidenti/incidenti ajror, në zbatim të Ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nëpërmjet kryerjes së shpejtë të procesit të investigimit dhe nxjerrjes së shkaqeve të aksidenteve/incidenteve ajrore.
- Operatoret në fushën e Transportit Ajror si Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës e Operatorët Ajrorë.

Masat legjislative afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat ligjore të mëposhtme:

- Projektvendim, "Për përcaktimin e kritereve për Licencimin e Aeroporteve, në përputhje të plotë të Aneksit 14 të Konventës së Çikagos (ICAO) dhe në zbatim të Ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 i ndryshuar. Akti vendos standardet ndërkombëtare, pasi gjithë aktet komunitare janë në përputhje me këtë Konvente. Nuk përafron ndonjë akt komunitar.
- Projekturdhër i MPPT-së, për miratimin e Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat për hyrjen në tregun e shërbimeve në tokë dhe në aeroporte", i cili synon të përafrojë pjesërisht Rregulloren e BE 96/97 "Për aksesin në tregun e shërbimeve në tokë dhe në aeroporte"
- Projekturdhër i MPPT-së, "Për miratimin e Rregullores, mbi kriteret dhe procedurat për regjistrimin e avionëve", në përputhje të plotë të Aneksit 7 të Konventës së Çikagos (ICAO) "Mbi kombësinë e avionëve, procedurat dhe shenjat e regjistrimit", si dhe në zbatim të Ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008, i ndryshuar. Nuk ka shkallë përputhshmërie, por vendos standardet ndërkombëtare, në përputhje me konventën e sipërpërmendur.
- Projektudhëzim i Përbashkët i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, "Për aspekte të caktuara të organizimit të kohës së punës", i cili përafron pjesërisht Direktivën nr. 2003/88 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 4 nëntor 2003 (nr. celex: 32003L0088; Fletore Zyrtare e KE-së L. 299, 18.11.2003, p. 9–19)

Aktivitet zbatuese

- Konsultime në kuadër të grupeve të punës, mbi hartimin e akteve ligjore që kanë nevojë për konsultim ndërinstitucionale dhe me grupet e interesit si, METE, MPÇSSHB, Aeroportin Nënë Tereza, dhe operatorët ajrorë,

Masat legjislative afatmesme

- Projektudhëzim i Përbashkët i MPPT dhe MPÇSSHB "Për përcaktimin e masave që nxisin përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në punë", i cili përafron pjesërisht Direktivën e Këshillit nr. 89/391/KEE, të datës 12 Qershor 1989 (nr. celex 31989L0391, Fletore Zyrtare e KE L 183, 29.6.1989, p. 1–8).

- Projekturdhër i MPPT “Mbi mbrojtjen e individit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”, që përafron pjesërisht Direktivën 95/46/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 tetor 1995.
- Projekturdhër i MPPT “Për miratimin e Rregullores mbi kodin e sjelljes për sistemin kompjuterik të rezervimit”, që përafron pjesërisht Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 2299/1989, datë 24 korrik 1989, e amenduar nga Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 3089/93, datë 29 tetor 1993.
- Projekturdhër i MPPT “Për miratimin e rregullores mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara gjatë përdorimit të transportit ajror, që përafron pjesërisht Rregulloren e Komisionit Evropian nr. 1107/2006

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Takime konsultative me grupet e interesit, shoqërinë civile, si dhe institucione që kanë kontributin e tyre, në hartimin e akteve ligjore të iniciativave ligjore afatmesme.

3.15. ENERGJIA

Objektivi strategjik

Në programet e saj strategjike Qeveria Shqiptare ka përcaktuar si objektiv parësor zhvillimin e sistemit energjetik shqiptar për të garantuar një zhvillim të qëndrushëm social ekonomik të vendit. Për këtë qëllim po punohet për krijimin e një sektori energjetik të besueshëm dhe të qëndrueshëm, zhvillimi i të cilit do të jetë i bazuar në shfrytëzimin e të gjitha opsioneve të energjisë në mënyrë që të plotësojmë nevojat tona për energji dhe për të krijuar vlerë të shtuar për qytetarët e Shqipërisë, në përputhje me parimet e përgjegjësisë mjedisore, ekonomike dhe sociale.

Në mënyrë që të arrihet një zhvillim i vazhdueshëm i një sistemi të energjisë, nevojiten investime në kohë dhe efikase. Në këtë kuptim, Qeveria e Republikës së Shqipërisë luan një rol kyç në krijimin e një ambienti stimulues për investime në strukturën e energjisë, veçanërisht për kapacitetet e reja të prodhimit dhe në uljen e rrezikut për investitorët me anë të aktiviteteve dhe kuadrit transparent, të qartë dhe të qëndrueshëm të politikave strategjike.

Bazuar në Nenin 70 (për Përafrim Ligjor) dhe Nenin 107 (Energjia) të MSA-së "Bashkëpunimi do të përqëndrohet në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e energjisë, duke përfshirë, sipas rastit, aspektet e sigurisë bërthamore. Ky bashkëpunim do të pasqyrojë parimet e ekonomisë së tregut dhe bazohet në Traktatin ,të nënshkruar, rajonal të Komunitetit për Energjinë me synim integrimin gradual të Shqipërisë në tregjet Evropiane të energjisë".

3.15.1. SIGURIA E FURNIZIMIT

Situata aktuale

Në strategjinë e sektorit të energjisë, Qeveria Shqiptare ka përcaktuar si përparësi, shfrytëzimin e potencialit të madh hidroenergjetik të vendit ende të pashfrytëzuar. Për të nxitur nismën private për investime në ndërtimin e HEC-eve të rinj me koncension, me fuqi deri në 15 MW, Qeveria ka autorizuar KESH-in që të blejë të gjithë energjinë elektrike të prodhuar prej tyre, me çmim të miratuar nga ERE.

Në përputhje me detyrimet e Traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë, Shqipëria përgatiti Deklaratën e Sigurisë së Furnizimit, e cila është miratuar nga Keshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë më 29 Qershor 2007 dhe është rinovuar nga vendi ynë në Maj 2009. Ky traktat merr në konsideratë sektorin ekzistues të prodhimit të energjisë elektrike të Shqipërisë të bazuar në 100% hidro.

Dispozitat bazë të Sigurisë së Furnizimit me energji elektrike janë përgjithësisht të vendosura në legjislacion primar dhe sekondar. Çështja e Sigurisë së Furnizimit adresohet nga ligji i sektorit elektroenergjetik në kontekstin e përgjegjësisë për furnizimin me energji elektrike, sherbime publike dhe mbrojtje konsumatori, standarteve teknike dhe të sigurisë së energjisë

(Nenet 8, 25, 32, 41, 43 dhe 46) si dhe Modeli i Ri i Tregut (Pika 3) dhe Strategjia Kombëtare e Energjisë, në lidhje me investimet dhe përforcimin e rrjetit energjetik.

Siguria e Furnizimit, sikurse dihet, përfaqëson një koncept të gjerë dhe mjaft kompleks, pasi është funksion i shumë variableve, si i skenarit të zhvillimit të burimeve energjetike në vend, i rezervës së tyre, i strukturës së interkonjeksioneve ndërshtetërore, i shkalles së efiçencës së prodhimit dhe konsumit të energjisë, i shkallës së sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes, i shkallës së automatizimit të tyre, i cilësisë së manaxhimit të këtyre sistemeve, i dinamikës së zhvillimit të kërkesës për energji etj. Strategjia e Qeverisë Shqiptare për rritjen e sigurisë së furnizimit të vendit me energji udhëhiqet së pari nga shfrytëzimi në maksimum i potencialit energjetik të vendit i cili ende ka rezerva.

Sektori i Energjisë Elektrike

Gjatë dekadës së fundit Shqipëria ka miratuar ligje dhe rregullore për energjinë elektrike, dhe ka krijuar një rregullator të pavarur për energjinë elektrike i cili ka kompetenca të gjera. Ajo ka bërë gjithashtu përparime drejt çmimeve reflektues-kostosh për energjinë elektrike dhe në një model-BE për sistemin e taksave. Ristrukturimi i ndërmarrjeve shtetërore të energjisë elektrike ka përmirësuar punën teknike, ekonomike dhe të korporatës.

Sistemi i Gjenerimit

Hidrocentralet dominojnë sektorin e prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri. Prej kapacitetit total të instaluar prej 1.541 MW, një total prej 1.444 MW është i bazuar në hidro-energji. Tre hidrocentralët kryesorë përfshijnë Komanin, Fierzë dhe Vaun e Dejës me kapacitet respektivisht 600 MW, 500 MW dhe 250 MW. Në shifrën e mësipërme është përfshirë gjithashtu edhe termocentrali i ri i Vlorës i cili është vënë në punë në vitin 2011. Prodhimi mesatar i kapaciteteve ekzistuese është 4,162 GWh. Kapacitetet ekzistuese prodhuese të bazuara në HEC-e bën prodhimin e energjisë elektrike të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të kushteve hidrologjike.

Objektivi themelor i veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike është pa dyshim furnizimi në mënyrë të pandërprerë dhe me cilësi i konsumatorëve me energji elektrike. Viti 2011 demonstroi një furnizim të pandërprerë të konsumatorëve me energji elektrike dhe për pasojë konsumi prej 6.773 TWh përfaqëson edhe kërkesën reale për energji elektrike, e cila shërben si pikë mbështetje për skenaret e parashikimit të kërkesës për energji elektrike për periudhat afatshkurtër dhe afatgjata.

Shfrytëzimi i tij parashikohet të realizohet kryesisht nëpërmjet investimeve private. Viti 2011 shënoi një shkallë të lartë pjesëmarrjeje të investitorëve privat që u kurorëzua me futjen në punë të 5 HEC-eve të rinj të dhënë me konçension, me fuqi të përgjithshme të instaluar 16 MW dhe një prodhim vjetor me shkallë sigurije 70% prej rreth 50 Milion kWh. Një drejtim i rëndësishëm është diversifikimi i burimeve gjeneruese. Në këtë kuader përveç futjes në punë dhe fillimit të prodhimit gjatë vitit 2011 të TEC-it të Vlorës, janë në proces ndërtimi në shkallë të avancuar rreth 30 HEC-e të rinj të dhënë me konçension.

Nga ana tjetër liçencimi i një numri të rëndësishëm investitorësh privatë për të ndërtuar parqe eolike në teritorin e Shqipërisë, me një fuqi të përgjithshme të instaluar rreth 1,350 MW dhe prodhim të pritshëm vjetor rreth 4.1 TWh, që parashikon një investim rreth 2 miliard Euro, përbën një drejtim tjetër të diversifikimit të burimeve gjeneruese ambjentalisht miqësorë. Në strategjinë e vetë Qeveria Shqiptare e vlerëson një opsion real edhe ndërtimin e një centrali nuklear me karakter rajonal nëpërmjet sipërmarrjes private për të siguruar një furnizim të sigurtë e të qëndrueshëm afatgjatë, me energji elektrike ambjentalisht miqesorë, të Shqipërisë dhe vendeve fqinjë në rajon.

Hapa shumë të rëndësishëm në rritjen e sigurisë së furnizimit të vendit me energji elektrike janë edhe zhvillimi i linjave ndërshtetërore të interkonjeksionit. Në vitin 2011 përfunduan dhe u vendosën nën tension linjat elektrike ajrore të interkonjeksionit me tension 400kV dhe kapacitet transmetues 1,000 MW, Elbasan – Tiranë dhe Tiranë – Podgoricë, si dhe nënstacioni elektrik 400/220/110 kV Tirana 2. Gjatë vitit 2011 është punuar për komisionimin, me financime të Qeverisë Gjermane, në linjën e interkonjeksionit Tiranë-Prizren-Prishtinë gjithashtu me tension 400 kV dhe kapacitet 1,000 MW. Në vijim parashikohet të ndërtohet edhe linja e interkonjeksionit me Maqedoninë, duke ju shtuar ketyre dhe dy linjat kabllore nënujore të interkonjeksionit me Italine. Në këtë mënyrë Shqipëria brenda një periudhe afatmesme do të pozicionohet në mënyrë shumë efektive dhe të sigurtë, nga pikpamja e konfiguracionit të sistemeve të transmetimit, në rajonin e tetë energjetik të Evropës.

Projekti i rehabilitimit të veprave hidroteknike në HEC-et kryesore të vendit, do të rrisë në një shkallë të rëndësishme sigurinë në punë të këtyre objekteve me rëndësi të veçantë, çka nga ana tjetër i shërben rritjes së sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Në vitin 2010, sikurse vërehet është arritur konsumi më i madh historik në vendin tonë me 6.773 TWh. Tendencë e përgjithshme e konsumit të energjisë elektrike është rritja vjetore e kërkesës për energji elektrike mesatarisht me rreth 3%.

Sistemi i Transmetimit

Sistemi i Transmetimit në Shqipëri është i përbërë nga rrjetet e nivelit 400, 220 dhe 110 kV, 120 km linja janë 400 kV, 1,103 km linja janë 220 kV, 34 km linja janë 150 kV dhe 1,202 km linja janë 110 kV. Rrjeti 220 kV është plotësisht i lidhur në unazë dhe lidh impiantet kryesore në veri të Shqipërisë me qendrat e ngarkesës në rajonet e Tiranës, Elbasanit dhe Fierit. Rrjeti 110 kV përdoret për furnizimin e Sistemit të Shpërndarjes. Pjesë të këtij rrjeti janë lidhur në rrjet dhe pjesa tjetër është radiale. 12 nënstacionet 220 kV dhe 400 kV janë ndërtuar në përgjithësi me zbara të dyfishta në anën 220 kV dhe 400 kV. Ana 110 kV në këto nënstacione ka përgjithësisht një zbare.

Sistemi Shqiptar i Energjisë Elektrike është i përbërë në atë mënyrë që impiantet elektrikë kryesorë janë të përqendruara në veri të Shqipërisë dhe ngarkesat kryesore janë në qendër (zonat Tiranë - Elbasan) dhe në jug (zona e Fierit). Meqënëse gjenerimi është i vendosur kryesisht në veri të vendit, profili i tensionit ka tendencën për të qenë pak më i ulët në pjesën jugore të vendit. Profili i tensionit në rrjetin kryesor 400 dhe 220 kV është pothuajse në përputhje me kërkesat e ENTSO (European Netëork of Transmission System Operators for

Electricity). Profili i tensionit në rrjetin 110 kV është një problem lokal dhe ndryshon sipas zonave në Shqipëri.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.
- Ligji nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për Konçesionet", i ndryshuar.
- Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për Shpronësimet dhe Marrjen në Përdorim të Përkohshëm të Pasurisë Pronë Private për Interes Publik".
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19.01.2007 "Për Miratimin e Rregullave për Dhënien e Konçensioneve", i ndryshuar.
- VKM nr. 424, datë 26.06.2003 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2015".
- VKM nr. 553, datë 12.08.2004 "Për proçedurat dhe kushtet për lejet konçesionare për ndërtimin dhe përdorimin e rafinerive, naftësjellësve dhe gazsjellësve".
- VKM nr. 529, datë 15.08.2007 "Për miratimin e kritereve dhe të proçedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit".
- VKM nr. 1701, datë 18.12.2008 "Për miratimin e rregullave për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e objekteve të prodhimit të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni.
- VKM nr. 338, datë 19.03.2008 për "Modelin e Tregut të Energjisë elektrike".
- Kodi i Transmetimit miratuar me Vendim të bordit të Komisionerëve të ERE.
- Kodi i Shpërndarjes miratuar me Vendim të bordit të Komisionerëve të ERE.
- Kodi i Matjes miratuar me Vendim të bordit të Komisionerëve të ERE.

Struktura institucionale

Kuadri institucional dhe kapacitetet e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e energjisë, përfshirë specifikisht edhe infrastrukturën energjetike, si pjesë e rrjeteve rajonale dhe Trans-Evropiane energjetike, janë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) është autoriteti më i lartë shtetëror në hartimin e politikave dhe strategjive në sektorin e energjisë. Misioni i METE-es, në sektorin e energjisë është zhvillimi i politikave për të siguruar një furnizim normal me burime energjie për konsumatorët, për të garantuar një rritje të qëndrueshme të ekonomisë së vendit dhe një zhvillim social dhe kulturor të popullsisë, përfshirë edhe diversifikimin e burimeve të furnizimit nëpërmjet lidhjes së Shqipërisë me rrjetet rajonale dhe Trans-Evropiane të energjisë elektrike dhe të gazit natyror e të naftës.

Drejtoria Energjetike, pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit të Burimeve Natyrore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), ka për mision hartimin e politikave të zhvillimit të rrjetit energjetik kombëtar dhe përfshirjen e tij në rrjetet rajonale dhe Trans-Evropiane energjetike, të konkretizuara në objektivat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, zbatimin dhe monitorimin e tyre në kuadrin e sistemit ligjor rregullues dhe të angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e energjisë, hartimin e

Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe bashkëpunimin për një progres të mëtejshëm në përcaktimin e përparësive rajonale dhe koordinimin e investimeve, hartimin e PKZMSA-së për rrjetin energjetik shtetërorë etj. Në zbatim të Ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", nga Ministria në bashkëpunim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), në zbatim të politikave dhe përparësive, përcaktohen detyrimet lidhur me fondet, planifikimin, monitorimin e performancës së rrjeteve energjetike kombëtare dhe Trans-Evropiane.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është një institucion i pavarur, bazuar në Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe në Ligjin nr. 9946, datë 30.06.2008 "Për sektorin e gazit natyror", me përgjegjësitë që lidhen ngushtë me rrjetet dhe tregjet e energjisë, përfshirë edhe rrjetet rajonale dhe ato Trans-Evropiane. Mandati i saj përfshin liçencimin e kompanive të energjisë elektrike dhe të gazit, përcaktimin e tarifave me shumicë dhe me pakicë, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të liçencuarve dhe konsumatorëve, nxitjen e konkurencës, dhe miratimin e rregullave të tregut dhe të kodeve të rrjetit.

Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST sha) është përgjegjës për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit 400-220-110 kV, përfshirë nënstacionet e tensionit të lartë, si dhe për funksionimin e Sistemit Elektroenergjetik në Shqipëri dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

Masat legjislative afatshkurtra

- Hartimi dhe miratimi i ligjit të ri "Për sektorin e energjisë elektrike".
- Hartimi i kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit të mësipërm.
- Hartimi i kuadrit rregullator për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe miratimi nga Keshilli i Ministrave dhe Bordi i ERE.
- Hartimi i akteve nënligjore për privatizimin e hidrocentraleve Ulez, Shkopet, Bistrica 1, Bistrica 2 dhe Lanabregas.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Privatizimi i hidrocentraleve Ulez Shkopet.
- Privatizimi i hidrocentraleve Bistrica 1 Bistrica 2.
- Privatizimi i hidrocentralit Lanabregas.

Masat legjislative afatmesme

- Hartimi i draftit të ri të Strategjisë Kombëtare të Energjisë.
- Hartimi i Planit të Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Energjisë.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Rekomandime konkrete për burime energjetike në zbatim të Strategjisë Kombëtare të energjisë.
- Studimi mbi fuqizimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike.

- Studimi i projekteve të linjave të reja të interkonjeksionit.

3.15.1.1. SEKTORI HIDROKARBUR

Objektivi strategjik

Objektivi kryesor i Qeverisë për Sektorin Energjetik Hidrokarbur është zhvillimi i qëndrueshëm dhe i besueshëm i tregut në këtë sektor për të garantuar furnizimin e ekonomisë me burime energjetike hidrokarbure në mënyrë që të mundësohet zhvillimi i shpejtë dhe i qëndrueshëm ekonomik e njerëzor i vendit si dhe për të siguruar integrimin e vendit në BE.

Realizimi i këtij objektivi do të bëhet nëpërmjet:

- Diversifikimit (shumëllojshmërisë, shtimit dhe zgjerimit) të burimeve furnizuese të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.
- Rritjes së prodhimit vendas të naftës bruto deri në 10% në vit.
- Krijimit të kushteve të përshtatshme për nxitjen e zhvillimit të tregut të gazit natyror nëpërmjet lidhjes së Shqipërisë me rrjetin e naftësjellësve dhe gazsjellësve rajonalë.
- Regjimit të mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre, mbrojtjes së mjedisit për të patur një qëndrim miqësor ndaj tij për aq sa është e mundur, si dhe përdorimit të qëndrueshëm dhe më efiçent të burimeve natyrore tokësore dhe nëntokësore.
- Ristrukturimit dhe privatizimit të shoqërive në sektorin e hidrokarbureve, ku shteti është pronar.

Situata aktuale

Furnizimi me naftë, gaz dhe nënprodukte i ekonomisë është bërë nga importi dhe prodhimi vendas. Aktualisht prodhimi vendas i nënprodukteve të naftës dhe gazit plotëson 15% të nevojave të ekonomisë. Për vitin 2011 prodhimi vendas arriti një nivel të lartë prodhimi rreth 890 mije ton naftë bruto, shifër nga me të lartat në 20 vitet e fundit. Kjo rritje prodhimi ka ardhur si rezultat i zbatimit të marrëveshjes hidrokarbure me disa kompani të huaja, të tilla si Bankers Petroleum Albania Ltd dhe Oil & Gas Steam, IEC Visoka dhe Sherëood international për vendburimet ekzistuese të naftës dhe të gazit. Duhet të theksohet se, për një përdorim më të mirë të rezervave tona në vendburimet naftëmbajtëse ekzistuese është rritur koefiçenti i nxjerrjes së naftës përmes përdorimit të teknologjive të ndryshme të reja për nxjerrjen e naftës dhe janë zbuluar rezerva të reja të naftës dhe të gazit nga këto kompani.

Pavarësisht nga angazhimet dhe studimet e shumta, vendi ynë ende nuk është lidhur me rrjetin ndërkombëtar të gazit, kjo sepse vendimmarrja për ndërtimin e gazsjellsave dhe naftësjellsave i takon faktorit ndërkombëtar dhe kërkohen angazhimet e këtij faktori, si dhe angazhimet e investitorëve potencialë startegjik. Në kuadër të diversifikimit të burimeve të energjisë, si dhe të zhvillimit të sektorit energjetik, Qeveria ka si objektiv zhvillimin e infrastrukturës rajonale të gazit, dhe para së gjithash për futjen e Gazit Natyror në Shqipëri dhe lidhjen e vendit me rrjetet e gazit Rajonale dhe Ndërkombëtare.

Aktualisht vendi ynë është përfshirë në projekte të lidhjeve rajonale të sistemeve të gazit, që kanë marrë një vlerësim konkret nga strukturat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, , sikurse është projekti i Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë, që parashikohet të lidh pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu Shqipëria është pjesë e projektit të Gazesjellsit Jonian Adriatik (projekti IAP), projekt i cili do të lidhë vendet e rajonit si Kroacia, Mali i Zi dhe Shqipëria, si dhe Bosnja&Hercegovina, si dhe e projektit të gazsjellesit lindje-perëndim Trans Adriatic Pipeline (projekti TAP – Greqi – Shqiperi – Itali), që parashikohet të sjellë gazin e rajoneve të Lindjes së Mesme, Kaspikut dhe Rusisë drejt Evropës Perëndimore. Një projekt tjetër për lidhjet rajonale me gazsjellësat është projekti i ndërtimit të një terminali të Gazit Natyror të Lëngëzuar në bregdetin e Qarkut të Fierit dhe lidhja me rrjetin Italian te gazit (dhe rrjetin Evropian) me një gazsjellës nëndetar Shqipëri - Itali.

Sektori i rafinerisë është privatizuar në 85% të aksioneve që nga viti 2008. Kompania Albania Refinery Marketing Oil (ARMO Sh.a.) nëpërmjet një programi ambicioz të investimeve do të përmirësojë teknologjinë e përpunimit dhe prodhimit të nënprodukteve të naftës si në aspektin e përmirësimit të pajisjeve ekzistuese të cilat janë amortizuar deri në rinovimin me një teknologji moderne të re. Në përputhje me programin e investimeve të përcaktuar në kontratën e shitjes, ARMO sh.a ka përmirësuar ndjeshëm produktet dhe veçanërisht gazoilin(diezel) duke kaluar nga prodhimi i gazoilit sipas standardit SSH: 31:1997 në gazoil sipas standard SSH EN 590, siç është përcaktuar me Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 147, datë 21.03.2007 ”Për cilësinë e lëndëve djegëse, Benzinë dhe Diezel”.

Përdorimi i Gazit natyror të lëngët (GNL) është rritur ndjeshëm në vendin tonë dhe po luan një rol gjithnjë e më të madh në tregun e brendshëm, si një burim alternativ i energjisë, me më shumë gjasa për të zëvendësuar energjinë elektrike në sektorin e banesave dhe shërbimet që konsumohen kryesisht për ngrohje dhe gatim, duke arritur një konsumim të përgjithshëm për vitin 2011, në 85 mije ton. Gjithmonë e më tepër kjo energji po gjen përdorim më të gjerë në industrinë ushqimore dhe ndërtim.

Rezervat e Sigurisë: Legjislacioni aktual në Shqipëri, mbi detyrimin e mbajtjes së rezervës së sigurisë, llogaritjes, mënyrës së mbajtjes, përdorimit dhe menaxhimit të tij, është pjesërisht në përputhje me Direktivën nr. 2009/119/KE, datë 14.09.2009 “Për vendosjen e detyrimit për shtetet anëtare për mbajtjen e rezervës minimale të naftës bruto dhe/ose nënprodukteve të naftës”. Bazuar në Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, rafineritë e naftës dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë të naftës, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre janë të detyruara të mbajnë rezerva sigurie. Sipas Ligjit nr. 9218, datë 08.04.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, aktualisht rezerva e sigurisë llogaritet me 90 ditë mesatare shitjeje.

Infrastruktura e tregut të karburantit në vendin tonë paraqitet me një numër shumë të madh të pikave të tregtimit me pakicë të karburantit. Në të ardhmen parashikohet që të kryhet optimizimi i tyre në të gjithë territorin e Shqipërisë, bazuar në normat dhe standardet evropiane.

Një kontribut të ndjeshëm në sigurinë e furnizimit përsa i përket diversifikimit ashtu edhe standartit të operacioneve të importit dhe eksportit përmes depozitave bregdetare ka dhënë vënia në funksionin i porteve specifike për karburantet që janë përqëndruar në dy zona, në portin "Vlora-1", në gjirin e Vlorës dhe në portin "Porto Romano", në zonën e Porto Romano, pranë qytetit të Durrësit.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993, i ndryshuar me Ligjin nr. 7853, datë 29.07.1994 "Për kushtet për dhënien dhe përdorimin e autorizimeve për zbulimin, eksplorimin dhe prodhimin e hidrokarbureve", përafruar plotësisht me Direktivën 94/22/KE.
- Ligji nr. 7811, datë 12.04.1994 "Për aprovimin e Dekretit nr. 782, datë 22.02.1994 "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (Kërkim – Prodhim)", amenduar me Ligjin nr. 10 049, datë 24.12.2008.
- Ligji nr. 9946, datë 30.06.2008 "Për sektorin e Gazit Natyror". Ligji shqiptar për gazin natyror është në përputhje të plotë me Direktivën 2003/55/KE. Kjo Direktivë është shfuqizuar me miratimin e Direktivës së re 2009/73/KE e datës 13 Korrik 2009 mbi rregullat e përbashkëta për tregjet e brendshme të gazit natyror. Ligji ekzistues shqiptar do të rishikohet dhe ndryshoje me synimin që të jetë në përputhje me direktivën e re.
- Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve", amenduar nga Ligji nr. 9218, datë 08.04.2004 dhe Ligji nr. 9574, datë 3.7.2006, pjesërisht në përputhje me Direktivën 2009/119/KE, "Për vendosjen e detyrimit për shtetet anëtare për mbajtjen e rezervës minimale të naftës bruto dhe/ose nënprodukteve të naftës".
- Ligji nr. 9876, datë 14.02.2008 "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport". Ky ligj përafron plotësisht Direktivën 2003/30/KE, amenduar nga Direktiva e re 2009/28/KE.
- Ligji nr. 9501, datë 03.04.2006 "Për ratifikimin e traktatit të krijimit të komunitetit të energjisë".
- Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i amenduar.

Struktura institucionale

Institucionet përgjegjëse në METE për zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për fushën e hidrokarbureve janë:

- Sektori i Politikave Energjetike pranë Drejtorisë së Energjisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit të Burimeve Natyrore;
- Sektori i Administrimit të partneriteteve Publike – Private në Drejtorinë e Menaxhimit të Projekteve;
- Sektori i Menaxhimit të Shoqërive dhe Ndërmarrjeve Publike në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike.

Këto struktura janë pjesë e METE dhe kanë përgjegjësinë kryesore në zbatimin e

legjislacionit për fushën e hidrokarbureve. Funksionet e tyre janë:

- Hartimi i politikave për një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjetik hidrokarbur në përputhje me kërkesat në rritje të tregut për burime energjetike me bazë hidrokarbure, si dhe realizimi i rolit rregullator të shtetit në këtë treg;
- Formulimi dhe zbatimi i politikave për ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm duke minimizuar efektin e aktivitetit hidrokarbur në të dhe caktimi i masave për eliminimin e këtyre efekteve nga operatorët e sektorit;
- Nxitja e diversifikimit të burimeve të furnizimit me naftë, gaz dhe nënproduktet e tyre, duke:
    - rritur prodhimin vendas;
    - nxitur konkurrencën e operatorëve vendas në tregun e hidrokarbureve;
    - rritur efiçencën e përdorimit të burimeve natyrore vendase;
    - promovuar përdorimin e burimeve energjetike alternative dhe të rinovueshme;
    - u përfshirë në tregun rajonal të naftës dhe gazit;
- Përpunimi i të dhënave për aktivitetin e subjekteve dhe institucioneve të sektorit hidrokarbur, duke përcaktuar përparësitë e shprehura në programe dhe projekte konkrete zhvilluese;
- Ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të kontratave dhe marrëveshjeve që operojnë në sektorin hidrokarbur;
- Bashkëpunimi me QKL për dhënien e liçensave, sipas fushave të veprimtarisë së operatorëve dhe produkteve në fjalë;
- Koordinimi i punës me organizma të ndryshëm shkencorë për kërkim dhe zhvillim, përpunimin dhe marketingun në sektorin energjetik hidrokarbur;
- Ndjekjen e aktivitetit të shoqërive me pronë publike që veprojnë në sektorin hidrokarbur duke përfaqësuar pronarin shtet.

Ndërkohë në vartësi të METE janë institucionet e mëposhtme:

- Inspektorati Qendror Teknik (IQK) që kryesisht ka si funksion kontrollim e respektimit të kushteve dhe normave teknike të instalimeve dhe paisjeve të nevojshme për transportimin, depozitimin dhe tregetimin e naftës gazit dhe nënprodukteve të tyre si dhe kontrollin e cilësisë se nënprodukteve që tregtohen.
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) ka si funksion për sektorin e naftës dhe gazit pronovimin, negocimin dhe ndjekjen e Marrëveshjeve Hidrokarbure për kërkimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit.
- Qendra Kombëtare e Liçencimit ka si funksion liçencimin e shoqërive për tregtimin e naftës, gazit dhe nënproduktet e tyre.
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) ka si funksion kryerjen e studimeve gjeologjike të karakterit rajonal, të cilat në bashkëpunim me strukturat përkatëse të METE janë të angazhuara me realizimin e rolit nxitës, rregullator dhe kontrollues në tregun e burimeve energjetike me bazë hidrokarbure në Shqipëri.

Zhvillimet perspektive të sektorit energjetik shqiptar, pjesë e të cilit është edhe sektori energjetik hidrokarbur diktojnë edhe rishikimin e mundshëm të kuadrit institucional, duke e harmonizuar atë me ato rajonale dhe evropiane për ketë sektor.

Masat legjislative afatshkurtra

- Hartimi i akteve nënligjore për forcimin e rolit rregullator të shtetit në tregun e nënprodukteve të naftës dhe të gazit dhe kontrollit të cilësisë së karburanteve.
- Rishikimi i kuadrit ligjor për privatizimin e shoqërive publike që operojnë në sektorin hidrokarbur.
- Hartimi i kuadrit bazë nënligjore për tregun e brendshëm të gazit.
- Hartimi i kuadrit bazë nënligjorë për prodhimin dhe tregtimin e Biokarburanteve.
- Hartimi i akteve nënligjorë për miratimin e rregullave teknike për tregun e brendshëm të gazit.
- Rishikimi i kuadrit ligjor dhe institucional për regjimin e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë të naftës, gazit dhe nënproduktet e tyre.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Studimi mbi fuqizimin e infrastrukturës së furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure.
- Ushtrimi i rolit rregullator të shtetit në mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën gazin dhe nënproduktet e tyre nëpërmjet llogaritjes së sasisë së rezervës së sigurisë, përpilimin e urdhrave përkatëse dhe realizimit të inspektimeve.
- Ndjekja e procesit të privatizimit të ALBPETROL sh.a. nëpërmjet realizimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure për nxjerrjen e naftës dhe të gazit dhe formave të tjera të privatizimit.
- Ndjekja e praktikave për trajtimin e projekteve që kanë të bëjnë me zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri.

Masat legjislative afatmesme

- Amendimi i kuadrit ligjor dhe institucional ekzistues për regjimin e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë të naftës, gazit dhe nënproduktet e tyre, në përputhje me Direktivën e Këshillit Europian 2009/119, 14 shtator 2009 "Për vendosjen e detyrimit për shtetet anëtare për mbajtjen e rezervës minimale të naftës bruto dhe/ose nënprodukteve të naftës".
- Amendimi i Ligjit nr. 9946, datë 30.06.2008 "Për sektorin e Gazit Natyror" për të reflektuar në të Direktivën e re të BE 2009/73/KE mbi rregullat e përbashkëta për tregjet e brendshme të gazit natyror.
- Amendimi i Ligjit nr. 9876, datë 14-02-2008 "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport", i cili do të përafrojë direktivën 2009/28/KE.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Rekomandime konkrete për burime energjetike me bazë hidrokarbure nëpërmjet studimeve konkrete gjeolog-gjeofizike dhe shfrytëzimit racional të tyre.
- Studimi i ndikimit në mjedis të aktiviteteve të sektorit Hidrokarbur.

- Vlerësimi i kapaciteteve nafte-gaz-mbajtëse nëpërmjet kryerjes së studimit në kushtet e zbatimit të teknologjive të reja të nxjerrjes duke rivlerësuar po ashtu edhe rezervat sipas standardeve të BE-së.
- Trajtimi institucional dhe ligjor i projekteve për integrimin e vendit në rrjetet rajonale të naftës dhe gazit, nëpërmjet diversifikimit të burimeve furnizuese të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.
- Studimi mbi fuqizimin e infrastrukturës së furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.15.1: Siguria e furnizimit

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**3.000.000**	**3.000.000**	**9.000.000**	**2.000.000**
Mbulohen nga buxheti i	3.000.000	3.000.000	9.000.000	2.000.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.15.2. TREGU I ENERGJISË

Objektivi strategjik

Strategjia për zhvillimin e sektorit energjetik është pjesë e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Objektivi themelor lidhet me ndryshimet e nevojshme për të siguruar një treg të hapur dhe konkurrent në vetvete dhe me atë rajonal si pjesë e detyrimeve që Shqipëria ka pas nënshkrimit të Traktatit të Themelimit të Komunitetit të Energjisë më 25 Tetor 2005, në Athinë, dhe pas ratifikimit nga Kuvendi, më 3 Prill 2006, kur dhe u bë anëtare me të drejta të plota (Palë Kontraktuese) e Komunitetit të Energjisë.

Strategjia përfshin disa objektiva specifike, si më poshtë:

- Rritja e besueshmerisë për furnizim me energji në përgjithësi dhe me energji elektrike në veçanti, në nivel kombëtar dhe rajonal.
- Krijimi i një sektori energjetik efektiv në aspektet financiare dhe teknike.
- Krijimi i një kuadri efektiv institucional dhe regulator.
- Optimizimi i sistemit të furnizmit me burime energjetike bazuar në parimin e planifikimit me koston më të ulët dhe ndotjen mjedisore minimale.
- Përfundimi i procesit të ristrukturimit të kompanive të energjisë.
- Rritja e investimeve në sektorin e energjisë me anë të rritjes së kapitalit të institucioneve financiare ndërkombëtare dhe te kapitalit privat.
- Krijimi i një tregu konkurues të energjisë elektrike në përputhje me kërkesat e BE-së për reformat dhe detyrimet e Shqipërisë në kuadrin e Traktatit të Energjisë të Evropës Juglindore për të mbështetur integrimin e sektorit të energjisë në Tregun Rajonal të Energjisë Elektrike të Evropës Juglindore dhe interkonjeksionin me rrjetin UCTE.

Situata aktuale

Veprimtaria e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre regullohet me anë të një Ligji të veçantë nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre". Ky ligj aplikohet pa dallim për të gjithë personat juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj. Ligji parashikon liberalizimin e plotë të veprimtarive nga këndvështrimi i eksport-importit dhe çmimet me shumicë ose pakicë të nënprodukteve të naftës, përveç situatave specifike të tregut kur Këshilli i Ministrave mund të vendosë kufizime të përkohshme për çmimet me shumicë dhe pakicë.

Ky ligj klasifikon personat që i nënshtrohen këtij ligji në: a) rafineri nafte që ushtrojnë aktivitetin e tyre në përpunimin e naftës bruto; b) naftëslellsa dhe gazsjellsa; c) kompani të tregtimit me shumicë; d) stacione pompimi me pakicë, të cilët tregtojnë karburante; e) njësi pakice që shesin karburante për qëllime ngrohjeje. Në lidhje me lejet, ligji parashikon tre llojë lejesh: a) leje koncesionare që jepet për rafineritë, naftësjellsat dhe gazsjellsat; b) leje tregtare që jepet për tregtimin me shumicë; dhe c) leje të dhëna për stacione pompimi karburanti. Në këtë kuadër tregu i naftës gazit dhe nënprodukteve është totalisht i liberalizuar dhe jo i regulluar.

Aktualisht në treg operojnë rreth 60 shoqëri të tregtimit me shumicë te gazoilit, benzinës, solarit dhe naftës bruto si dhe rreth 30 shoqëri për tregtimin me shumicë të gazit të lëngshëm natyror, ndëkohë që ka rreth 900 stacione të shitjes së karburanteve të shpërndara në të gjithë territorin e Shqipërisë, ku përqëndrimi me i madh vërehet në zonat urbane.

Në kuadrin e përafrimit të legjislacionit në sektorin e hidrokarbureve me direktivat e BE-së, në vitin 2008, është miratuar një ligj i veçantë për prodhimin dhe tregtimin e biokarburanteve. Ligji nr. 9876, datë 14.02.2008 "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djesëse të rinovueshme, për transport", harmonizohet plotësisht me Direktivën 2003/30/KE për nxitjen e përdorimit të biokarburanteve ose lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport.

Ka gjithashtu një sërë aktesh nënligjore, të cilat rregullojnë procedurat dhe kushtet për ndërtim dhe përdorim të naftësjellsave dhe rafinerive (VKM nr. 553, datë 12.08.2004 "Për procedurat dhe kushtet për lejet konçesionare për ndërtimin dhe përdorimin e rafinerive, naftësjellsave dhe gazsjellsave), për tregtimin e produkteve të naftës (VKM nr. 170, datë 14.05.2002, "Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për licensat dhe autorizimin e tregtimit të naftës, gazit dhe produkteve të tyre").

Shqipëria ka zhvilluar dhe miratuar një ligj për gazin, Ligji nr. 9946, datë 30.06.2008 "Për sektorin e gazit natyror". Ligji përmban dispozita në lidhje me politikat në sektorin e gazit, ku përfshihen dispozitat për sigurinë e furnizimit me gaz. Ministria përgjegjëse për energjinë do të luajë rolin kryesor në fushën e politikëbërjes. Nga ana tjetër, Ligji përmban gjithashtu një numër dispozitash për rregullimin e veprimtarive në sektorin e gazit. Ligji i jep Entit Rregullator të Energjisë të drejtat dhe përgjegjësitë për rregullimin e këtij sektori, ku përfshihen kompetencat për lëshimin, modifikimet, transferimin dhe tërheqjen e liçencave,

përcaktimin dhe miratimin e metodologjive dhe tarifave përkatëse, monitorimin e sigurisë së furnizimit të klientëve, rregullimin dhe garantimin e futjes në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes, mbrojtjen e konsumatorëve, përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, vendosjen e kushteve të përgjithshme të furnizimit, vendosjen e një hapjeje të tregut me faza , etj.

Sektori elektrik

Tregu i energjisë elektrike në Shqipëri rregullohet nëpërmjet Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me VKM nr. 338, datë 19.03.2008 "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike". Gjatë proceseve teknike dhe zbatuese të Modelit të Tregut është evidentuar nevoja për rishikim, në kuadër të zhvillimeve të mëtejshme dhe reformave e Sektorit Energjetik në përputhje me detyrimet e Traktatit të Energjisë Komunitare.

Bazuar në propozimin e ERE, Qeveria e Shqipërisë miratoi me Vendimin nr. 338, datë 19.03.2008, Modelin e Ri të Tregut. Ky vendim nënvizon përgjegjësitë dhe marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve në treg dhe ERE. Modeli i Ri i Tregut karakterizohet nga kontrata bilaterale ndërmjet dhe me pjesëmarrësit në treg, ku përvec gjenerimit, transmetimit, shpërndarjes, funskionit të tregtimit dhe furnizimit ka krijuar dhe funskionin e Furnizuesit Publik me shumicë dhe Furnizuesit Publik me pakicë. Liçenca e furnizimit publik me shumicë i mbetet KESH dhe liçensa e furnizimit publik me pakicë i është dhënë OSSH-së. Sipas Modelit të Ri të Tregut, Furnizuesi Publik me shumicë është përgjegjës për blerjen e energjisë elektrike për tregje të rregulluara dhe të lira, bazuar në parashikimin e kërkesës së konsumatorëve, të përgatitur dhe dorëzuar nga Furnizuesi Publik me pakicë dhe për ta shitur atë tek OSSH-ja, me një çmim të rregulluar. Çmimet dhe tarifat ne sektorin e energjise elektrike përcaktohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), që është në vartësi të Kuvendit të Shqipërisë.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.
- Ligji nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për Konçesionet", i ndryshuar.
- Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për Shpronësimet dhe Marrjen në Përdorim të Përkohshëm të Pasurisë Pronë Private për Interes Publik".
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19.01.2007 "Për Miratimin e Rregullave për Dhënien e Konçensioneve", i ndryshuar.
- VKM nr. 424, datë 26.06.2003 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2015".
- VKM nr. 553, datë 12.08.2004 "Për proçedurat dhe kushtet për lejet konçesionare për ndërtimin dhe përdorimin e rafinerive, naftësjellësve dhe gazsjellësve".
- VKM nr. 529, datë 15.08.2007 "Për miratimin e kritereve dhe të proçedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit".
- VKM nr. 1701, datë 18.12.2008 "Për miratimin e rregullave për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e objekteve të prodhimit të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni.

- VKM nr. 338, datë 19.03.2008 për "Modelin e Tregut të Energjisë elektrike".
- Kodi i Transmetimit miratuar me Vendim të bordit të Komisionerëve të ERE.
- Kodi i Shpërndarjes miratuar me Vendim të bordit të Komisionerëve të ERE.
- Kodi i Matjes miratuar me Vendim të bordit të Komisionerëve të ERE.

Struktura institucionale

Kuadri institucional dhe kapacitetet e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e energjisë, përfshirë specifikisht edhe infrastrukturën energjetike, si pjesë e rrjeteve rajonale dhe Trans-Evropiane energjetike, janë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) është autoriteti më i lartë shtetëror në hartimin e politikave dhe strategjive në sektorin e energjisë. Misioni i METE-es, në sektorin e energjisë është zhvillimi i politikave për të siguruar një furnizim normal me burime energjie për konsumatorët, për të garantuar një rritje të qëndrueshme të ekonomisë së vendit dhe një zhvillim social dhe kulturor të popullsisë, përfshirë edhe diversifikimin e burimeve të furnizimit nëpërmjet lidhjes së Shqipërisë me rrjetet rajonale dhe Trans-Evropiane të energjisë elektrike dhe të gazit natyror e të naftës.

Drejtoria Energjetike, pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit të Burimeve Natyrore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), ka për mision hartimin e politikave të zhvillimit të rrjetit energjetik kombëtar dhe përfshirjen e tij në rrjetet rajonale dhe Trans-Evropiane energjetike, të konkretizuara në objektivat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, zbatimin dhe monitorimin e tyre në kuadrin e sistemit ligjor rregullues dhe të angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e energjisë, hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe bashkëpunimin për një progres të mëtejshëm në përcaktimin e përparësive rajonale dhe koordinimin e investimeve, hartimin e PKZMSA-së për rrjetin energjetik shtetërorë etj. Në zbatim të Ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", nga Ministria në bashkëpunim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), në zbatim të politikave dhe përparësive, përcaktohen detyrimet lidhur me fondet, planifikimin, monitorimin e performancës së rrjeteve energjetike kombëtare dhe Trans-Evropiane.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është një institucion i pavarur, bazuar në Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe në Ligjin nr. 9946, datë 30.06.2008 "Për sektorin e gazit natyror", me përgjegjësitë që lidhen ngushtë me rrjetet dhe tregjet e energjisë, përfshirë edhe rrjetet rajonale dhe ato Trans-Evropiane. Mandati i saj përfshin liçencimin e kompanive të energjisë elektrike dhe të gazit, përcaktimin e tarifave me shumicë dhe me pakicë, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të liçencuarve dhe konsumatorëve, nxitjen e konkurencës, dhe miratimin e rregullave të tregut dhe të kodeve të rrjetit.

Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST sha) është përgjegjës për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit 400-220-110 kV, përfshirë nënstacionet e tensionit të lartë, si dhe për funksionimin e Sistemit Elektroenergjetik në Shqipëri dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

Masat legjislative afatshkurtra

- Hartimi i akteve nënligjore për forcimin e rolit rregullator të shtetit në tregun e nënprodukteve të naftës dhe të gazit dhe kontrollit të cilësisë së karburanteve.
- Hartimi i kuadrit bazë nënligjore për tregun e brendshëm të gazit.
- Hartimi i kuadrit bazë nënligjorë për prodhimin dhe tregtimin e Biokarburanteve.
- Hartimi i akteve nënligjorë për miratimin e rregullave teknik për tregun e brendshëm të gazit.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Studimi mbi fuqizimin e infrastrukturës së furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure.
- Ushtrimi i rolit rregullator dhe kontrollues i shtetit për cilësine dhe standartet e tregetimit të naftës, gazit dhe nënproduktet e tyre.
- Ndjekja e praktikave për trajtimin e projekteve që kanë të bëjnë me zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri.
- Ushtrimi i kompetencave të METE sa i përket nxitjes së investimeve në parqet energjetike hidrokarbure.

Masat legjislative afatmesme

- Amendimi i Ligjit nr. 9946, datë 30.06.2008 "Për sektorin e Gazit Natyror" për të reflektuar në të Direktivën e re të BE mbi Gazin 2009/73/KE.
- Amendimi i Ligjit nr. 9876, datë 14-02-2008 "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport", i cili do të përafrojë direktivën 2009/28/KE.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Studimi i ndikimit në mjedis të aktiviteteve të sektorit Hidrokarbur.
- Trajtimi institucional dhe ligjor i projekteve për integrimin e vendit në rrjetet rajonale të naftës dhe gazit, nëpërmjet diversifikimit të burimeve furnizuese të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.
- Studimi mbi fuqizimin e infrastrukturës së furnizimit me burime energjetike me bazë hidrokarbure

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.15.2 Tregu i Energjisë

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**4.000.000**	**4.000.000**	**0**	**0**
Mbuluar nga ndihma e huaj	4.000.000	4.000.000	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.15.3. EFIÇENCA E ENERGJISË DHE BURIMET E RINOVUESHME TË ENERGJISË

Objektivi strategjik

Shqipëria po punon për të kombinuar politikat për efiçencën e energjisë dhe atë të energjive të rinovueshme, duke i bërë ato pjesë të një strategjie të tërë për energjinë. Një politikë e tillë do të mbështetet tek nisma 20-20-20 e BE-së, si dhe në direktivat përkatëse të BE-së.

Situata aktuale

Aktualisht është hartuar draft ligji "Për Efiçencën e Energjisë" dhe është dërguar pranë Bankës Botërore për komente. Ligji i ri implementon parimet e politikave të BE-së dhe kuadrin ligjor mbi efiçencën e energjisë në përputhje me Direktivat 2006/32/KE, 2009/125/KE, 2010/30/KE dhe 2010/31/KE.

Burimet e rinovushme në Shqipëri kanë një përdorim tradicional të konsiderueshëm, kryesisht ato hidrike dhe të biomasës (drutë e zjarrit). Përsa i përket energjisë hidrike, Shqipëria ka një potencial të madh hidroenergjie, nga i cili vetëm rreth 35.4% është shfrytëzuar deri tani. Kapaciteti hidroenergjetik i instaluar aktualisht është 1466MW. Prodhimi mesatar nga hidroenergjia është 5283GWh. Rezervat totale të hidro-energjisë mundësojnë instalimin e një fuqie afro 4500 MW dhe potenciali vjetor i prodhimit të energjisë hidro mund të arrijë 16 TWh. Deri tani janë nënshkruar rreth 112 kontrata konçesionare të cilat kanë kapacitet total prej reth 1400 MW.

Energjia diellore është një formë tjetër e energjive të rinovueshme, e cila mund të shfrytëzohet me sukses në Shqipëri, sepse vendi shtrihet në një gjerësi gjeografike të përshtatshme dhe me sipërfaqe horizontale të konsiderueshme të tokës, sidomos në zonat me popullsi më të madhe. Ka filluar interesimi i shoqërive të ndryshme për ndërtimin e këtyre impjanteve dhe deri tani janë paraqitur vetëm 4 propozime.

Energjia e Erës, si një burim i rinovueshem për prodhimin e energjisë elektrike, është përdorur pak në Shqipëri. Me financim të qeverisë italiane është kryer një studim, sipas të cilit potenciali energjetik i erës në Shqipëri vlerësohet në rreth 11 GWh/vit. Deri tani janë dhënë autorizime për ndërtimin e 14 parqeve me erë, me një fuqi të instaluar prej rreth 1600 MW.

Energjia e biomasës përfitohet si energji e pastër nga përpunimi i nënprodukteve të drurit ose të agrikulturës nëpërmjet teknologjive të ndryshme. Eshtë dhënë autorizimi për ndërtimin e një centrali elektrik me fuqi 140 MW, që do të përdorë lëndë djegëse bio.

Aktualisht është hartuar draft ligji "Për Energjitë e Rinovueshme", i cili ka si qëllim transpozimin e Direktivës 2001/77/EU dhe 2003/30/KE, si dhe parimet kryesore të Direktivës së re 2009/28/KE dhe është dërguar pranë Bankës Botërore për komente.

Baza Ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 8937, datë 12.09.2002 "Në ruajtjen e ngrohjes termike në ndërtesa".
- VKM nr. 38, datë 16.1.2003 "Normat Teknike të Kursimit të Ngrohtësisë në Ndërtesa".
- Ligji nr. 9379, datë 28.04.2005 "Për efiçencën e energjisë".
- VKM nr. 619, datë 7.9.2011 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficencën e Energjisë.

Struktura institucionale

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) është pjesë e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe ka përgjegjësinë kryesore në zbatimin e legjislacionit për fushën e efiçencës së energjisë dhe energjive të rinovueshme.

AKBN-ja, nëpërmjet Drejtorisë së Energjive të rinovueshme, është i vetmi institucion përgjegjës për promovimin dhe monitorimin e efiçencës së energjisë dhe energjive të rinovueshme, si dhe për implementimin e projekteve të ndryshme.

Objektivi kryesor i AKBN-së është zbatimi i një sistemi energjetik të qëndrueshëm dhe njëkohësisht miqësor ndaj mjedisit. Ky sistem synon të jetë plotësisht i varur nga burimet e energjive të rinovueshme. Masat për të nxitur ose për të mbështetur ruajtjen e energjisë, si dhe për përdorimin e burimeve të energjive të rinovueshme luajnë një rol kyc në politikat energjetike në Shqipëri.

Masat legjislative afatshkurtra

- Miratimi i ligjit "Për Efiçencën e Energjisë".
- Miratimi i ligjit "Për Energjitë e Rinovushme".
- Hartimi i planit kombëtar të veprimit për energjitë e rinovushme.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Organizimi i seminareve dhe i fushatave sensibizuese për zbatimin e këtyre ligjeve pas miratimit të tyre.
- Zbatimi i planit kombëtar të veprimit për efiçencën e energjisë.

Masat legjislative afatmesme

- Hartimi dhe miratimi i Vendimeve të Këshillit të Ministrave në zbatim të Ligjit "Për efiçencën e Energjisë".
- Hartimi dhe miratimi i Vendimeve të Këshillit të Ministrave në zbatim të Ligjit "Për Energjitë e Rinovushme".

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Organizimi i seminareve dhe i fushatave sensibizuese për zbatimin e VKM pas miratimit të tyre.
- Zbatimi i detyrave afatmesme të parashikuara në planin kombëtar të veprimit për energjitë e rinovushme.
- Zbatimi i detyrave afatmesme të parashikuara në planin kombëtar të veprimit për efiçencën e energjisë.

3.15.4. SIGURIA BËRTHAMORE DHE MBROJTJA NGA RREZATIMET

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, si Autoritet Kombetar i pavarur prane Ministrisë së Shëndetësisë është mbrojtja e shëndetit të punonjësve dhe publikut ndaj rreziqeve dhe riskut të rrezatimit jonizues dhe jojonizues. Një nga angazhimet e Shqipërisë që rrjedhin në kuadër të MSA-së, konkretisht nenit 70/3 të saj, është edhe përafrimi i legjislacionit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese.

Situata aktuale

Ligji bazë për mbrojtjen nga rrezatimet në Republikën e Shqipërisë është Ligji nr. 8025, datë 09.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet Jonizuese" dhe Ligji nr. 9973, datë 28.07.2008 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8025, datë 09.11.1995 "Për Mbrojtjen nga Rrezatimet", përafron Direktivën e Këshillit 96/29/Euratom, datë 13 Maj 1996, që përcakton standardet bazë të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve dhe publikut në përgjithësi ndaj rreziqeve që paraqet rrezatimi jonizues. Ligji është një ligj kuadër bazë i tillë që t'i hapë rrugë implementimit të të gjithë elementëve që përmban kjo direktivë në lidhje me sigurinë sigurimin dhe mbrojtjen nga rrezatimet. Është miratuar në parlament Ligji nr. 10469, datë 13.10.2011 "Per mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese", pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e Këshillit, datë 12 Korrik 1999, mbi kufizimin e ekspozimit të publikut ndaj fushave elektromagnetike (1999/519/EC) dhe atë të 29 Prillit 2004 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit lidhur me ekspozimin e punonjësve ndaj rrezikut që vjen nga agjentët fizikë (fushat elektromagnetike (2004/40/EC).

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktualisht, për shkak të mungesës së prodhimeve radioaktive në vend dhe përdorimit të kufizuar të burimeve radioaktive për qëllime shëndetësore dhe industriale, mbrojtja nga radioaktiviteti nuk ka qenë prioritare në Shqipëri dhe legjislacioni i miratuar në këtë fushë ka qenë nën këndvështrimin e dokumenteve të IAEA dhe EU:

- Konventa për Sigurinë Bërthamore.
- Konventa e bashkuar për Sigurinë e Administrimit të Karburanteve (Lëndëve Djegëse) të shpenzuara dhe "Për trajtimin e mbetjeve radioactive", kanë hyrë në fuqi më 27 Shtator 2011.

Këto konventa janë miratuar në parlament me:

- Ligjin nr. 10 379, datë 24.2.2011 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në

konventën e bashkuar "Për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive". Për këtë konventë janë paraqitur dhe raporti bazë në lidhje me menaxhimin e mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë;

- Ligjin nr. 10 380, datë 24.02.2011 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për sigurinë bërthamore".

Baza ligjore përfshin gjithashtu:

- Ligji nr. 10469, datë 13.10.2011 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese", pjesërisht në përputhje me rekomandimet e organizatës botërore të shëndetësisë dhe Rekomandimin e Këshillit, datë 12 Korrik 1999, mbi kufizimin e ekspozimit të publikut ndaj fushave elektromagnetike (1999/519/EC) dhe ate të 29 Prillit të 2004 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit lidhur me ekspozimin e punonjësve ndaj rrezikut që vjen nga agjentët fizikë (fushat elektromagnetike (2004/40/EC).
- Urdhrin nr. 415, datë 11.10.2011 të Ministrit të Shëndetësisë mbi liçencimin e kabineteve të radiologjisë dhe qendrave që përdorin burime të rrezatimit jonizues.
- VKM nr. 591, datë 18.08.2011 "Për miratimin e Rregullores "Për nivelet e lejuara të përqëndrimit të radonit në ndërtesa dhe ujë, nivelet udhëzuese të radiobërthamave në materialet e ndërtimit, si dhe nivelet e lejuara të radiobërthamave në ushqime dhe produktet kozmetike", pjesërisht në përputhje me Direktivën 96/29/Euratom "Mbi standartet bazë të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe popullatës ndaj rrezikut nga rrezatimi jonizues" dhe dokumente të IAEA.
- VKM nr. 590, datë 18.08.2011 "Për miratimin e Rregullores për mbrojtjen e punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve jonizuese", pjesërisht në përputhje me Direktivën 96/29/Euratom "Mbi standartet bazë të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe popullatës ndaj rrezikut nga rrezatimi jonizues" dhe dokumente të IAEA.
- VKM nr. 344, datë 29.04.2011 "Për miratimin e Rregullores "Për mbrojtjen fizike të materialeve radioaktive në RSH", pjesërisht në përputhje me dokument të IAEA dhe Direktivën 2003/122/Euratom "Mbi kontrollin e burimeve radioaktive me aktivitet të lartë dhe burimeve jetime".
- Udhëzim nr. 134, datë 12.04.2011 "Për import-eksportin dhe tranzitin e burimeve radioaktive të kategorive 1 dhe 2 në Republikën e Shqipërisë".
- Vendim i Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimet nr. 1438/4, datë 12.04.2011 "Terminologjia e përdorur dhe përcaktimet e termave në mbrojtjen nga rrezatimet, sigurinë dhe sigurimin e materialeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë".
- Vendim i Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimet nr. 1438/6, datë 12.04.2011 "Programi i trajnimit në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese".
- Vendim i Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimet nr. 1438/7, datë 12.04.2011 mbi "Procedurat e vlerësimit të aplikimit për njohjen nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet si ekspert i kualifikuar".
- Vendim i KMR nr. 5027/2 datë 02.12.2010 "Kodi i Praktikës në Mjekësinë Bërthamore, radiodiagnostike dhe radioterapi".
- VKM nr. 543, datë 07.07.2010 "Për miratimin e Rregullores "Për punë të sigurtë me burimet e rrezatimit jonizues", pjesërisht në përputhje me Direktivën 96/29/Euratom, "Mbi standartet bazë të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe popullatës ndaj rrezikut nga rrezatimi jonizues".

- VKM nr. 488, datë 23.06.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për transportin e sigurt të lëndëve radioaktive”, pjesërisht në përputhje me dokumentin ST-1 të IAEA-së.
- VKM nr. 10, datë 07.01.2010 për miratimin e Rregullores “Për Liçencimin dhe Inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizuese”, pjesërisht në përputhje me Direktivën 96/29/Euratom, “Mbi standartet bazë të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe popullatës ndaj rrezikut nga rrezatimi jonizues”.
- VKM nr. 9, datë 07.01.2010 për miratimin e Rregullores “Për kategorizimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë në funksion të mbrojtjes nga rrezatimet, për sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues”, në përputhje me dokumentin e IAEA-së.
- VKM nr. 8, datë 07.01.2010 “Për trajtimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me dokumentin e IAEA-së.
- VKM nr. 510, datë 13.05.2009 “Për ngritjen, përbërjen, organizimin, funksionimin dhe mënyrën e shpërblimit të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet.”
- Rregullore e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet nr . 3072/2, datë 10.08.2009 për funksionimin e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet.
- Udhëzuesi nr. 675, datë 05.12.2008 “Për tarifat e liçencimit të aktiviteteve me burime të rrezatimit jonizues”
- Udhëzuesi nr. 676, datë 05.12.2008 “Për shkallën e penalizimit për shkeljet adminstrative të parashikuara në Ligjin 8025, datë 09.11.1995 dhe 9973, datë 28.07.2008.
- Ligji nr. 9973, datë 28.07.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8025, datë 09.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, pjesërisht në përputhje me Direktivën 96/29/Euratom, “Mbi standartet bazë të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe popullatës ndaj rrezikut nga rrezatimi jonizues”.
- VKM nr. 158, datë 13.02.2008 “Mbi import-eksportin e burimeve të rrezatimit jonizues në RSH”, në përputhje me Udhëzuesi i import-eksporteve të IAEA, IAEA/CODEOC/IMP-EXP/2005.
- Rregullore nr. 865, datë 28.02.2008 “Për administrimin dhe manaxhimin e Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet”
- Vendimin i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet nr. 3896/2, datë 24.10.2007 për miratimin e Planit të përgatitjes dhe reagimit ndaj Emergjencave Radiologjike, KMR, IFB, ZMR.
- Rregullore nr. 2269/1, datë 19.06.2007 “Mbi sigurinë ndaj ekspozimeve mjekësore me burime të rrezatimeve jonizuese”, pjesërisht në përputhje me Direktivën 97/43/Euratom, “Mbi mbrojtjen e individëve ndaj rreziqeve te rrezatimit jonizues në lidhje me ekspozimet mjekësore dhe dokumentin e IAEA-së”.
- Rregullore nr. 2269/3, datë 19.06.2007 “Mbi sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve me burime të rrezatimeve jonizuese”, pjesërisht në përputhje me Direktivën 96/29/Euratom, “Mbi standartet bazë të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe popullatës ndaj rrezikut nga rrezatimi jonizues”.
- Ligjin nr. 8025, datë 09.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, mbështetur në Konventën e Mbrojtjes nga Rrezatimet.

Struktura institucionale

Institucionet përgjegjëse në lidhje me fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, sigurise dhe sigurimit janë:

- Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR) pranë Ministrisë së Shëndetësisë;
- Instituti i Shëndetit publik.
- Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Mbrojtja nga rrezatimet dhe strukturat administrative janë të përcaktuara me Ligjin nr. 8025, datë 09.11.1995, i amenduar si Ligji nr. 9973, datë 28.7.2008 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese". Neni 6 i këtij Ligji përcakton organizimin e strukturave të mbrojtjes nga rrezatimet. Struktura kyçe në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, sigurisë dhe sigurimit janë Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR) dhe Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR), përkatësisht si organizma rregullues vendimarrës dhe ekzekutivë për sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues dhe jo energjinë berthamore.

Autoriteti Kombëtar Rregullator në Shqipëri është Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR), që përbëhet nga 9 anëtarë jo të përhershëm, pranë Ministrisë së Shëndetësisë. Në varësi të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet është Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, si organ ekzekutiv i saj. Kryetari i kësaj zyre është edhe sekretar i komisionit. Aktualisht KMR është ngritur dhe funksionon mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 13.05.2009 "Për ngritjen, përbërjen, organizimin, funksionimin dhe mënyrën e shpërblimit të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet". Neni 8 i Ligjit përcakton detyrat dhe të drejtat për Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet përbëhet nga 5 persona dhe funksionon pranë Institutit të Shëndetit Publik me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë nr. 43, datë 26.02.1996 dhe Urdhërit nr. 284, datë 31.8.1998.

KMR dhe ZMR bashkëpunojnë dhe me Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projektvendim për rregulloren "Mbi sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve me burime të rrezatimeve jonizuese", në përputhje të pjesshme me Direktivën 96/29/Euratom e datës 13 Maj 1996 mbi "Kërkesat bazë të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe publikut ndaj rrezikut që vjen nga rrezatimet jonizuese".
- Projektvendim për rregulloren "Mbi sigurinë në ekspozimet mjekesore me burime të rrezatimeve jonizuese", që do të përputhet pjesërisht me Direktivën 97/43/EURATOM e 30 Qershorit 1997 "Mbi mbrojtjen e shëndetit të personave ndaj rreziqeve nga rrezatimi jonizues në lidhje me ekspozimet mjekësore".
- Projektvendim për rregulloren "Mbi sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve të rrezatimeve jojonizuese", që do të përputhet pjesërisht me Rekomandimin e Këshillit Europian të datës 12 korrik 1999 "Mbi kufizimin e ekspozimit të publikut të përgjithshëm ndaj fushave elektromagnetike (0 Hz deri në 300 GHz) (1999/519EC) dhe në INCIRP.

- Projektvendim për rregulloren "Për monitorimin e radioaktivitetit të mjedisit", që do të përputhet pjesërisht me Rekomandimin e Këshillit Europian të datës 8 Qershor 2000 "Mbi zbatimin e nenit 36 të Traktatit Euratom lidhur me monitorimin e niveleve të radioaktivitetit në mjedis me qëllim vlerësimin e ekspozimit të publikut si një i tërë.
- Projektvendim i KMR për miratimin e dokumentit "Politika dhe Strategjia kombëtare për menaxhimin e mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqiperisë".

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Riorganizimi i strukturave të kontrollit për mbrojtjen nga rrezatimet.
- Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet shtimit të personelit me 4 persona dhe organizimi i një sërë trajnimesh në fushën e mbrojtjes së rrezatimeve.

Masat legjislative afatmesme

- Projektvendim për rregullore për materialet NORM (Naturally Occurring Radioactive Materials).
- Rishikimi i planit të emergjencave radiologjike "Mbi informimin e publikut në rast emergjence radiologjike", me qëllim përafrim të pjesshëm me Direktivën 89/618/Euratom, datë 27 Nëntor 1989 "Mbi informimin e popullatës për masat mbrojtjëse për shëndetin që duhen zbatuar dhe hapat që duhen marrë në rast emergjence radiologjike.
- Rishikim i rregullores "Për mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve jonizuese", me qëllim përafrim të pjesshëm me Direktivën 90/641/Euratom "Mbi mbrojtjen funksionale të punonjësve të jashtëm të ekspozuar ndaj riskut të rrezatimit jonizues gjatë punës në zonat e kontrolluara."
- Projektvendim për rregulloren "Mbi sigurinë e punonjësve ndaj ekspozimeve të rrezatimeve jojonizuese", që do të përputhet pjesërisht me Direktivën 2004/40/KE, datë 29 Prill 2004 "Mbi kërkesat minimale të shendetit dhe sigurisë lidhur me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që vijnë nga agjentët fizikë (fushat elektromagnetike)", e amenduar si Direktiva 2008/46/KE, datë 18 Prill 2008.
- Projektvendim për "Rregulloren e Standarteve bazë për kontrollin teknik të pajisjeve mjekësore".

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar.
- Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet shtimit të personelit (3) dhe organizimi i një sërë trajnimesh në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.15.4: Siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimet

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**7.588.416**	**1.897.104**	**1.897.104**	**1.897.104**
Mbulohen nga buxheti i	7.588.000	1.897.000	1.897.000	1.897.000
Ndryshim	-416	-104	-104	-104

3.16. TATIMET

3.16.1. POLITIKAT TATIMORE

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesor lidhur me të politikat tatimore është përafrimi i plotë i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Angazhimet në fushën e tatimore janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe më konkretisht, neni 98 i saj si dhe me detyrimet afatshkurtra dhe afatmesme të parashikuara nga Partneriteti Evropian.Ky objektiv strategjik do të realizohen nëpërmjet:

- zgjerimit të bazës së taksueshme;
- harmonizimit i politikave tatimore me acquis
- krijimit të klimës së biznesit të favorshme për zhvillimin dinamik të sipërmarrjes private dhe tërheqjen e investimeve të huaja;
- formulimit të politikave tatimore që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri dhe nxisin formalizimin e ekonomisë;
- përmirësimit të menaxhimit të administratës tatimore duke u bazuar në realizimin e të ardhurave me profesionalizëm, integritet dhe ndershmëri, me një standard që krijon besueshmëri tek qytetarët dhe kredibilitet me partnerët ndërkombëtarë dhe komunitetin e biznesit, vendas dhe të huaj.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Ne fokus të politikes fiskale, përfshirë vitin 2011, ka qënë formalizimi i transaksioneve midis biznesve, rritja e bazës së taksueshme si dhe shmangien e nënraportimeve. Në këtë kuadër, në shkurt të vitit 2011 u prezantuar Deklarata Personale e të Ardhurave. Synimi i kësaj reforme është formalizimi i të ardhurave të individëve si dhe rritja e nivelit të vetdeklarimit për këto të ardhura në nivelin dhe normën e vetdeklarimit e cila aplikohet sot në pothuajse të gjitha vendet. Që nga Shkurt 2011, pragu i TVSH-së është hequr për taksapaguesit të cilët ushtrojnë profesione të lirë si dhe për ata qe ushtrojnë aktivitete në fushën e hotelerisë, pavarësihst nga niveli i tyre i qarkullimit. Synimi i kësaj inisiative ishte rritja e bazës së taksueshme si dhe formalizmi i transaksioneve midis biznesve. Sipas të dhenave të administratës tatimore, kjo reforme ka filluar të japë rezultate pozitive. Ndryshimet e bëra në ligjin e procedurave tatimore (ligj nr.10 415, datë 7.4.2011 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar synoj prezantimin/rritjen e penaliteteve dhe gjobave në rastin e ekonomise informale.

Në mesin e vitit 2011, ndryshime te rendesishme jane bere ne kuadrin ligjor fiskal, si më poshtë vijon:

- Ligji nr. 10 456, datë 29.07.2011 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8976 date 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (fletore zyrtare

nr.107 date 09.08.2011,) i cili konsiston në rishikimin e niveleve të akcizës së disa produkteve.

- Ligji nr. 10 459, datë 29.07.2011 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9981 datë 8.9.2008 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", (fletore zyrtare nr.107 date 09.08.2011) i ndryshuar beri (0%) tarifat doganore të lëndeve të para të industrisë së konfeksioneve dhe produkteve të gatshme të veshjeve si dhe adresojne propozimet e industrisë së konfeksioneve dhe shitjes me pakicë të veshjeve të gatshme. Eliminimi i tarifës doganore të lendëve të para do të ndikojë ndjeshëm në uljen e kostos së prodhimit të kësaj industrie në mënyrë që të jenë me të konkurues ne tregjet boterore.
- Ligji nr. 10 458, datë 29. 07. 2011 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar ristrukturoi taksimin e mjeteve të perdoruara dhe rishikoj masaën e taksës së karbonit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në kuadër të përmbushjes të angazhimeve që burojnë nga neni 89 "Tatimet" i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe me asistencën e Projektit IPA 2007 "Support for the General Tax Directorate (GTD) of Albania". Projekt i cili ka filluar që në vitin 2010 dhe viti 2012 shënon finalizimin e një pune të rëndësishme në këtë proces.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligj nr. 7928, datë 27.04.1995, "Për Tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar (botuar në fletoren zyrtare me nr 12 datë 16.06.1994, faqe 469), shpallur me dekretin nr. 1096 datë 12.05.1995. Ligji përafron pjesërisht Direktivën 2006/112/KEE datë 28.11.2006 "Sistemi i përbashkët i TVSH-së", e konsoliduar.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1058, datë 21.10.2009 "Për përcaktimin e kufirit minimal të tatimit mbi vlerën e shtuar" i ndryshuar (botuar ne në fletoren zyrtare nr 163, datë 03.12.2009").
- Udhëzimi "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" nr 17, datë 13.05.2008 (botuar ne fletoren zyrtare nr. 62, datë 16.05.2008)
- Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar. Ky ligji aktualisht nuk transpozon legjislacion europian.

Masat legjislative afatshkutër

- Ministria e Financave do të hartojë dhe dërgojë për miratim projektligjin e ri "Për tatimin mbi vlerën e shtuar". Ky projektligj do të përafroje pjesërisht Direktivën 2006/112/KEE për sistemin e përbashkët të TVSH-së, të konsoliduar.
- Ministria e Financave do të hartojë dhe dërgojë për miratim projektvendim në zbatim te ligjit te ri të TVSH-së. Ky projketvendim do te përafroje pjesërisht me Direktivën 2006/112/EC për sistemin e përbashkët të TVSH-së, të konsoliduar.
- Ministria e Financave do të hartojë Udhëzimin "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" i cili do të dalë në zbatim të ligjit dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave të TVSH-së.
- Ministria e Financave do të hartojë dhe dërgojë për miratim projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar", i cili përafron pjesërisht Direktivën 90/434/KEE në lidhje me

sistemin e taksimit te aplikuar ne shkrirjet, ndarjet, transferimet e aseteve dhe shkëmbimit të aksioneve; Direktivën 90/435/KEE ne lidhje me sistemin e taksimit te aplikuar ne rastet e kompanive meme dhe filialet ne shtete te ndryshme anetare te BE-se; Direktivën 2003/49/KE ne lidhje me sistemin e aplikuar per interesat dhe pagesat e honorareve te bera midis shoqerive te lidhura ne shtete te ndryshme anetare te BE-se dhe Direktivën 2003/48/KE ne fushen e te ardhurave nga kursimet ne formen e pagesave te interesit.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Hartimi i dokumentacionit të nevojshëm për blerjen e një sistemi të ri tatimor (të centralizuar) për TI.
- Implementimi i sistemit të pagesave on-line.
- Krijimi dhe përmiresimi i infrastruktures për deklarimin e të ardhurave personale (DIVA).
- Përfshirja e të dhënave të tjera në analizën e riskut si: të dhënat e kasave fiskale, librave të blerje-shitjeve etj.
- Përmiresimi i kapaciteteve të analizës së riskut dhe implementimi i saj.
- Përgatitja e një strategjie trajnimi për inspektoret e hetimit tatimor.
- Përditesimi i regjistrit kombetar tatimor.
- Hartimi i një modeli informativ elastik dhe efikas i tatimpaguesve.
- Përmiresimi i kushteve akomoduese të Drejtorive Rajonale Tatimore.
- Implementimi i manualit të vlerësimit i përshtatur sipas ndryshimeve ligjore dhe reformave te deklarimeve elektronike.
- Përmiresimi i teknikave dhe metodave të marrjes së informacionit për evazionin tatimor.
- Përmiresimi i procedurave dhe i teknikave të hetimit tatimor.
- Përditesimi i shënimeve të industrisë për disa dege të industrisë si dhe vazhdimi i bashkëpunimit për hartimin e shënimeve në fusha si: telekomunikacioni, bankat dhe sigurimet.
- Saktësimi dhe përditësimi në kohe i regjistrit elektronik të borxhit duke siguruar përputhjen e tëe dhënave me kontabilitetin.
- Zbatimi i manualit të mbledhjes.

Masat legjislative afatmesme

- Ministria e Financave do të hartojë dhe dërgojë për miratim projektligjin e ri "Për tatimin mbi vlerën e shtuar". Ky projektligj do të përafroje plotësisht Direktivën 2006/112/KEE për sistemin e përbashkët të TVSH-së, të konsoliduar.
- Ministria e Financave do të hartojë dhe dërgojë për miratim projektvendim në zbatim te ligjit te ri të TVSH-së. Ky projketvendim do te përafroje plotësisht Direktivën 2006/112/EC për sistemin e përbashkët të TVSH-së, të konsoliduar.
- Ministria e Financave do të hartojë Udhëzimin "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" i cili do të dalë në zbatim të ligjit të ri të TVSH-së dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave të TVSH-së.

- Ministria e Financave do të hartojë dhe dërgojë për miratim projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, i cili përafron plotësisht Direktivën 90/434/KEE në lidhje me sistemin e taksimit te aplikuar ne shkrirjet, ndarjet, transferimet e aseteve dhe shkëmbimit të aksioneve; Direktivën 90/435/KEE ne lidhje me sistemin e taksimit te aplikuar ne rastet e kompanive meme dhe filialet ne shtete te ndryshme anetare te BE-se; Direktivën 2003/49/KE ne lidhje me sistemin e aplikuar per interesat dhe pagesat e honorareve te bera midis shoqerive te lidhura ne shtete te ndryshme anetare te BE-se dhe Direktivën 2003/48/KE ne fushen e te ardhurave nga kursimet ne formen e pagesave te interesit.

Masat zbatuese afatmesme

- Plani strategjik dhe operacional për edukimin e studenteve të universiteteve për sistemin fiskal.
- Realizimi dhe implementimi i sistemit të ri tatimor të TI-së.
- Krijimi dhe vënia në funksion e regjistrit kombëtar të inteligjencës tatimore.
- Krijimi i një berthame të analizës për evazionin tatimor brenda Drejtorisë së Hetimit Tatimor.
- Trajnimi i stafit tatimor.
- Përmirësohen procedurat e inspektimit (‘auditimit’) tatimor për të ulur cenueshmërinë e tyre nga korrupsioni dhe per te bere sistemin tatimor me pak te ndjeshem te tatimpaguesi.

3.16.2. TATIMI DIREKT

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesore i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve eshte krijimi i nje kuadri konkret ligjor dhe administrativ i cili do te siguroje qe sistemet tatimore jane ne perputhje me standartet nderkombetare dhe ato te BE-se, duke u bazuar në tre shtylla:

- ulja e barrës fiskale si për individin dhe për biznesin, krahas reduktimit të informalitetit dhe administrimin e mire të sistemit fiskal;
- harmonizimi i politikës së taksave me situatën ekonomike dhe sociale të zhvillimit të vendit;
- krijimi i klimës së favorshme të biznesit për zhvillimin dinamik të sipërmarrjes private dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Statusi Aktual

Analiza e situatës aktuale

Ne fokus të politikes fiskale, përfshirë vitin 2011, ka qënë formalizimi i transaksioneve midis biznesve, rritja e bazës së taksueshme si dhe shmangien e nënraportimeve. Në këtë kuadër, në shkurt të vitit 2011 u prezantuar Deklarata Personale e të Ardhurave. Synimi i kësaj reforme

është formalizimi i të ardhurave të individëve si dhe rritja e nivelit të vetdeklarimit për këto të ardhura në nivelin dhe normën e vetdeklarimit e cila aplikohet sot në pothuajse të gjitha vendet.

Lidhur me bazën ligjore, përafrimin e legjislacionit, masat afatshkurtra dhe afatmesme, referohuni te nënkapitulli 3.16.1.

Lidhur me strukturen institucionale referohuni tek nenkapitulli 3.16.5.

3.16.3. TATIMI INDIREKT

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesore i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve eshte krijimi i nje kuadri konkret ligjor dhe administrativ i cili do te siguroje qe sistemet tatimore jane ne perputhje me standartet nderkombetare dhe ato te BE-se, duke u bazuar në tre shtylla:

- ulja e barrës fiskale si për individin dhe për biznesin, krahas reduktimit të informalitetit dhe administrimin e mire të sistemit fiskal;
- harmonizimi i politikës së taksave me situatën ekonomike dhe sociale të zhvillimit të vendit;
- krijimi i klimës së favorshme të biznesit për zhvillimin dinamik të sipërmarrjes private dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Statusi aktual

Analiza e situatës aktuale

Për një administrim më të mirë tatimor si dhe rritje të bazës së tatimpaguesve të tatueshem me TVSH, me qellim funksionimin normal dhe sigurimin e neutralitetit të TVSH-së sipas skemes normale në zinxhirin e funksionimit të saj për një bazë më të gjerë tatimpaguesish, ne vitin 2009 u ul pragu i TVSH nga 8 milion lek të qarkullimit vjetor në 5 milion lek. Ndërsa ne vitin 2011 u hap pragu i TVSH për të gjitha profesionet e rregulluara.Nga Shkurti 2011, pragu i TVSH-së është hequr për taksapaguesit të cilët ushtrojnë profesione të lirë si dhe për ata qe ushtrojnë aktivitete në fushën e hotelerisë, pavarësihst nga niveli i tyre i qarkullimit. Synimi i kësaj inisiative ishte rritja e bazës së taksueshme si dhe formalizmi i transaksioneve midis biznesve. Sipas të dhenave të administratës tatimore, kjo reforme ka filluar të japë rezultate pozitive.

Lidhur me bazën ligjore, përafrimin e legjislacionit, masat afatshkurtra dhe afatmesme, referohuni tek nënkapitulli 3.16.1.

Lidhur me strukturen institucionale referohuni tek nenkapitulli 3.16.5.

3.16.4. NDIHMA E NDËRSJELLË

Objektivat strategjik e

Bashkepunimi bilateral nepermjet nje programi kooperimi me administratat e vendeve te tjera, duke siguruar shkembimin e eksperiences me to, me qellim pershtatjen e procedurave dhe praktikave me te mira te sistemit tatimor.

Statusi aktual

Analiza e situatës aktuale

Që nga viti 2009, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Financave Publike (DGFiP) të Francës. Gjatë kësaj kohe janë zhvilluar një sërë vizitash bilaterale, sipas një programi kooperimi, ku ka patur shkembime eksperiencas mes dy administratave për çeshtje të ndryshme tatimore si kontrolli i Tatimpaguesve te Medhenj, kontrolli në industrinë e turizmit, kontrolli tatimor i telefonisë mobile, kontrolli i Shoqërive të Sigurimeve, kontrolli bankar etj.

Në vijim te ketij bashkëpunimi bilateral, në datën 21 Mars 2011, pranë DGFiP, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit mes dy administratave. Kjo marrëveshje është një pasqyrim i objektivave te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, me synim ndërtimin dhe funksionimin e një administrate tatimore sipas standarteve të BE-se. Ky bashkëpunim do të zhvillohet në formën e shkëmbimeve të eksperiencës me anë të vizitave studimore dhe misioneve, të cilat do të mundësojnë takime ekspertësh të të dy palëve si dhe me anë të organizimit të seminareve, trajnimeve ose konferencave të ndryshme në interes dhe sipas nevojave të dy palëve.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe administrata tatimore e Maqedonisë kanë intensifikuar bashkëpunimin e tyre përgjatë viteve 2009-2011. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar disa vizita bilaterale të ndërsjellta, të cilat i kanë shërbyer punonjesve te administrates tatimore Shqiptare si dhe asaj të Maqedonisë, në venien ne zbatim te praktikave me te mira ne punën e tyre të përditshme. Gjithashtu, ne vijim te bashkepunimit bilateral eshte arritur binjakezimi i Drejtorise Rajonale te Elbasanit me Drejtorine Rajonale te Manastirit (Bitoles). Ne kuader te ketij binjakezimi jane zhvilluar vizita te ndersjellta dhe jane shkembyer eksperienca ne ceshtje te ndryshme tatimore si ne: procedurat e vleresimit, kontrollit, mbledhjes, sherbimit te tatimaguesve etj.

Gjithashtu, vlen te theksohet bashkepunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Administates Tatimore te Kosovës në sferën e përafrimit te legjislacionit të dy vendeve: kontrolli i Lojrave të Fatit, në aspektin e tatimeve, pra mënyrën e vjeljes së tatim-fitimit, sqarime në lidhje me deklarimin elektronit, shërbimi ndaj tatimpaguesve si dhe implementimi i arkave fiskale.
Në këte nënkapitull nuk janë parashikuar masa legjislative afatshkurtra/afatmesme dhe aktivitete zbatuese afatshkurtra/afatmesme.

3.16.5. ZYRA E TË ARDHURAVE PUBLIKE

Objektivat strategjik e

Kontributi i Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve ne mbulimin e shpenzimeve publike të qeverisë, përmes mbledhjes efektive dhe efikase të të ardhurave tatimore, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe taksave ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Statusi aktual

Analiza e situatës aktuale

Gjatë vitit 2011 ka patur përmiresime të sistemit informatik duke përmirsuar menyrat e funksionimit të sistemit në vetvete. Gjatë këtij viti jane zhvilluar programe shtese per të mbeshtetur dhe zbatuar ligjin nr.10 418, datë 21.4.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor" i ndryshuar, si dhe ndryshimet e tjera ligjore. Struktura e administrates tatimore funksionon mbi sisteme të informatizuara për menaxhimin dhe mbledhjen e tatimeve ne Shqiperi. Me teknologjine ekzistuese dhe me planin e investimeve, Sistemet TI dhe infrastuktura janë të afta për të perballuar zhvillimet e pritshme. Janë bërë zhvillimet përkatese për përmirësimin e sistemeve të Raportimit, Analizës së Riskut, Sistemit të menaxhimit të Pajisjeve Fiskale, Sistemit të Integruar Tatimor (SIT), Deklarimit Elektronik, Menaxhimit të Borxhit, etj.

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve operacionale, rekrutimit dhe trajnimit të stafit të aftë dhe kompetent në strukturat e hetimit tatimor, Drejtoria e Hetimit Tatimor është mbështetur nga projektet e ndryshme të institucioneve ndërkombetare krahas trajnimeve të planifikuara nga institucioni. Aktualisht projekti "IPA 2007" ka nje projekt të veçantë "Mbeshtjetje për Drejtorinë e Hetimit Tatimor" e cila ka kryer trajnime per sektoret e Informacionit dhe Hetimit për fushat specifike që mbulojnë keto sektore. Nga ana tjetër atributet e policisë gjyqesore dhe kryerja e veprimeve procedurale hetimore nga ana e inspektoreve të hetimit tatimor ben të nevojshem trajnimin special të tyre për menyrat e kryerjes së veprimeve hetimore si marrja në pyetje, kqyrja e vendeve e sendeve, vëzhgimi etj për të cilat ligji nr. 8677, datë 2.11.2000 "Per Policine Gjyqesore", i ndyshuar, adreson nevojën e trajnimeve te vazhdueshem specifik.

Me qëllim përmiresimin e shërbimit ndaj tatimpaguesve, në lufte kunder korrupsionit dhe informalitetit, në bashkepunim dhe me ndihmën e Programit të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë II (MCCA2), i administruar nga USAID, u realizua ngritja e Qendrës se Shërbimit ndaj Tatimpaguesve për Rajonin e Tiranës. Ne kete Qender, ofrohet shërbim rreth 50.000 tatimpaguesve të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, biznes i madh apo i vogel, individeve, personave fizik apo juridik si dhe opinionit publik për informim për legjislacionin tatimor dhe ndryshimet e tij, për të ofruar asistencë dhe ndihmë në realizimin vullnetar te deklarimit dhe pagesave të detyrimeve tatimore brenda afateve ligjore që janë të percaktuara në legjislacion etj.

Në administraten tatimore është krijuar edhe Call Center-i, i cili do te sherbeje për menaxhimin e Borxhit Tatimor dhe ndihmesën e tatimpaguesve për të shlyer sa më shpejt detyrimet e tyre tatimore të prapambetura.

Vazhdimësia e reformave ne Administraten Tatimore, kane per qellim ofrimin e shërbimeve elektronike dhe lehtesimin e barrës administrative për tatimpaguesit. Pjesë e rëndesishme e këtyre reformave janë deklarimet elektronike tatimore të cilat kanë arritur në shifra të konsiderueshme, ku vetem gjate vitit te fundit kemi patur rreth 540 000 deklarata në total, me një mesatare prej 45 000 deklarata në muaj

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Lidhur me bazën ligjore dhe përafrimin e legjislacionit referohuni te nënkapitulli 3.16.1.

Stuktura institucionale

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve eshtë institucioni i cili ka autoritetin për të ekzekutuar legjislacionin tatimor në Republikën e Shqipërisë, si dhe per te për te zbatuar dhe administruar tatimet, taksat e tarifat kombëtare. Ky institucion përbehet nga Drejtoria Qendrore dhe nga 14 Drejtori Rajonale. Qëllimi kryesor i DPT është të ndihmoje tatimpaguesit për të paguar detyrimet e tyre tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi dhe të siguroje që të ardhurat nga këto detyrime të shkojnë për llogari të buxhetit të shtetit, duke i ofruar tatimpaguesve një sistem pagese efektiv. Administrata tatimore ka një personel prej 1.606 nëpunësish. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Drejtoria Qendrore) përbehet nga Drejtori i Përgjithshëm, tre Departamente ose Zv/drejtore, përkatësisht Departamenti i Procedurave dhe Teknologjisë së Informacionit, Departamenti Operacional, Departamenti i Shërbimeve Mbeshtetëse, dy Zv. Drejtor të Mbikqyrjes Territoriale dhe 14 drejtori brenda drejtorisë qendrore.

Lidhur me shkëmbimin e informacionit DPT bashkëpunon me Drejtorin e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Thesarit, Drejtoritë Rajonale të Transportit, Ministrinë e Brendshme, Bankat, Dhomën e Tregtisë, Shoqatat e Bizneseve si dhe me administratat analoge jashtë vendit etj.Përsa i përket fushës së politikave tatimore dhe legjislacionit tatimor bashkëpunon me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Integrimit Evropian dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes.

Në këte nënkapitull nuk janë parashikuar masa legjislative afatshkurtra/afatmesme dhe aktivitete zbatuese afatshkurtra/afatmesme.

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.16 “Tatimet”
në mijë Lekë

3.17. POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE

3.17.1. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

Ky kapitull trajton ne tërësinë e tij aspektet kryesore te politikes monetare te ndjekur ne vend si dhe politikat e ekonomike. Në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, Banka e Shqipërisë synon arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, nëpërmjet hartimit, miratimit dhe zbatimit të një politike monetare të kujdesshme, të besueshme dhe të efektshme dhe në të njëjtën kohë, ndjek një politikë të kujdesshme të kursit të këmbimit, duke kontribuar kështu në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik në vend. Ne kapitull parashtrohen edhe informacione të tjera të cilat ndihmojnë në analizimin e synimit të institucioneve në vend që është realizimi me sukses i vendosjes të një regjimi asociimi me Bashkimin Evropian dhe vendet anëtare, ku një ndër prioritetet është edhe sigurimi i stabilitetit makroekonomik.

3.17.2. POLITIKA MONETARE

Objektivi strategjik

Strategia e Politikës monetare për vitet 2012-2014 ilustrohet në dokumentin e Politikës Monetare për periudhën 2012-2014, i cili bashkërendohet me programin e përgjithshëm afatmesëm të zhvillimit të vendit si dhe me Strategjinë Afatmesme të Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë është autoriteti monetar i Republikës së Shqipërisë. Në bazë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar", Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës për hartimin, miratimin dhe zbatimin e pavarur të politikës monetare. Politika monetare hartohet, miratohet dhe zbatohet në funksion të përmbushjes së objektivit ligjor të Bankës së Shqipërisë, arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Për zbatimin e politikës monetare, Banka e Shqipërisë përdor kuadrin operacional të instrumenteve të politikës monetare. Më konkretisht kuadri operacional përfshin operacionet e tregut të hapur, lehtësitë e përhershme dhe rezervën e detyruar, të cilat rregullohen me një bazë të plotë nënligjore (rregullore e akte).

Objektivi kryesor i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve, duke kontribuar direkt në ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë të vendit, në uljen e primeve të rrezikut, në rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe në përmirësimin afatgjatë të mirëqenies, si dhe në mbështetjen e stabilitetit të sistemit financiar.
Arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve nënkupton arritjen e normave të ulëta por pozitive të inflacionit dhe ruajtjen e tyre për periudha relativisht të gjata kohe. Në terma sasiorë, objektivi i inflacionit për periudhën 2012-2014 do të vazhdojë të jetë në formën e një vlere pikësore prej 3.0%, me një interval luhatjeje ± 1 pikë përqindjeje rreth kësaj vlere qendrore. Objektivi sasior prej 3% i inflacionit mbështet procesin e integrimit në Bashkimin Evropian, duke mundësuar një horizont të arsyeshëm kohor për konvergjencën reale e nominale të ekonomisë shqiptare me të.

Situata Aktuale

Politika monetare e ndjekur gjatë vitit 2011, ka qenë në funksion të përmbushjes së objektivit për ruajtjen e inflacionit vjetor pranë nivelit prej 3%. Në tremujorin e parë të vitit, presionet e shtuara inflacioniste nga jashtë u materializuan në rritje të shpejtë të normës së inflacionit, përtej kufirit të sipërm të intervalit të tolerancës së objektivit të Bankës së Shqipërisë. Për të kontrolluar presionet inflacioniste në vend, nëpërmjet parandalimit të shfaqjes së efekteve të raundit të dytë në ekonomi, si dhe për të administruar dhe ankoruar pritjeve inflacioniste rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë, në muajin mars u ndërmor rritja e normës bazë së interesit me 0.25 pikë përqindjeje, në 5.25%. Reduktimi i presioneve inflacioniste, mbas gjashtëmujorit të parë të vitit 2011 dhe pritjet për nivele të ulëta të inflacionit gjatë vitit 2012, motivuan lehtësimin e politikës monetare në tremujorin e katërt të vitit 2011. Banka e Shqipërisë kreu dy ulje (me nga 0.25 pikë përqindje) të normës bazë të interesit në muajt shtator e nëntor, duke e zbritur këtë normë në nivelin më të ulët historik prej 4.75%. Banka e Shqipërisë vlerëson se natyra stimuluese e politikës monetare do të ofrojë kushte më të përshtatshme financiare për respektimin e objektivit të inflacionit në horizontin afatmesëm. Në të njëjtën kohë, ky lehtësim i shërben nxitjes së kërkesës së brendshme të ekonomisë, e cila mbetet ende e brishtë në prani të pasigurisë së rritur në ekonomi. Gjithashtu, natyra aktuale e politikës monetare i shërben dhe bashkërendimit më të mirë me politikën e kujdesshme fiskale që është ndjekur dhe pritet të ndiqet edhe gjatë vitit 2012.

Ndryshimet në kuadrin rregullator te instrumenteve për vitin 2011.

Në kuadër të përmirësimit të kuadrit operacional të Bankës së Shqipërisë, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2011, nëpërmjet Vendimit nr. 29, datë 27.04.2011 u ndërmor ndryshimi në rregulloren ”Mbi minimumin e rezervës së detyruar të mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”[61]. Ky ndryshim konsistonte në heqjen e remunerimit për rezervën e detyruar në valutë. Nëpërmjet këtij ndryshime në rregullore, Banka e Shqipërisë synon të dekurajojë aktivitetin në valutë të ndërmjetësve financiar duke synuar rritjen e eficiencës së zbatimit të politikës monetare në të ardhmen.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/ nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”[62] i ndryshuar. Ligji përafron pjesërisht nenet 2, 3, 7 dhe 14 te Statutit te Sistemit Evropian të Bankave Qëndrore Bankës Qendrore Evropiane dhe nenet 123,124,127/2 dhe 130 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian;
- Ligji nr. 9974, datë 28.7.2008 “Për marrëveshjen e riblerjes dhe te anasjelltë te riblerjes”[63]. Ligji përafron pjesërisht Direktivën 2006/49/EC te Parlamentit dhe Këshillit “Mbi përshtatshmërinë e kapitalit të firmave të investimit dhe institucioneve

[61] Fletore Zyrtare, nr. 66, datë 28.05.2011, faqe 2676
[62] Fletore Zyrtare, nr. 20, datë 07.01.1998, faqe 479.
[63] Fletore Zyrtare nr. 128, datë 04.08.2008, faqe 5637.

të kreditit”[64] dhe Direktivën 2002/47/EC të Parlamentit dhe Këshillit “Mbi marrëveshjet për kolateralin financiar”[65];

- Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 57, datë 13.07.2005 për miratimin e rregullores “Mbi kredinë Lombard”[66].Objekti i kësaj rregullore është rregullimi i kredisë;
- Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 13.07.2005 për miratimin e rregullores “Mbi kredinë njëditore”, e ndryshuar[67]. Objekti i kësaj rregullore është rregullimi i kredisë njëditore;
- Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 92, datë 30.11. 2005 për miratimin e rregullores “Mbi kredinë brenda ditës për bankat e nivelit të dytë”[68]. Objekti i kësaj rregullore është lejimi i dhënies së kredisë brenda ditës nga Banka e Shqipërisë për bankat e nivelit të dytë me qëllim plotësimin e nevojave të bankave për likuiditet brenda ditës dhe garantimin e vijueshmërisë normale të funksionimit të sistemit ndërbankar të pagesave AIPS;
- Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 58, datë 13.07.2005 për miratimin e rregullores “Mbi depozitën njëditore”, e ndryshuar[69]. Objekti kësaj rregullore është rregullimi i depozitës njëditore;
- Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 75, datë 11.10.2006 për miratimin e rregullores ”Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore”[70].Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i procedurave të ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore
- Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 93, date 13.12.2006 për miratimin e rregullores “Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes” e ndryshuar[71]. Objekti i rregullores është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave të ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes; "
- Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 99, datë 27.12.2006 për miratimin e rregullores “Mbi llogaritjen e normave fikse të interesit në tregun ndërbankar të parasë”[72].Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i mënyrës së llogaritjes së normave fikse të interesit të vendosjes dhe të pranimit të depozitave në tregun ndërbankar të parasë, të cilat përdoren nga Banka e Shqipërisë dhe nga të interesuarit për qëllime referuese, statistikore, vlerësuese dhe kontabilizuese
- Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 43, datë 16.07.2008 për miratimin e rregullores “Mbi minimumin e rezervës së detyruar të mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”[73].Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave për llogaritjen, raportimin, mbajtjen, përdorimin dhe remunerimin e rezervës së detyruar në Bankën e Shqipërisë
- Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 61, datë 29.07.2009 për miratimin e rregullores

[64] CELEX: 32006L0049; OJL 177, datë 30.06.2006, p. 0201-0255.
[65] CELEX: 32002L0047; OJL 168, datë 27.06.2002, p. 0043-0050.
[66] Buletini Zyrtar vëllimi 7, nr. 10, korrik 2005.
[67] Buletini Zyrtar vëllimi 7, nr. 10, korrik 2005.
[68] Buletini Zyrtar vëllimi 7, nr 16, nëntor 2005.
[69] Buletini Zyrtar vëllimi 7, nr. 10, korrik 2005.
[70] Buletini Zyrtar vëllimi 8, nr 11, tetor 2006.
[71] Buletini Zyrtar vëllimi 8, numër 15, dhjetor 2006.
[72] Buletini Zyrtar vëllimi 8, nr 15, dhjetor 2006.
[73] Fletore Zyrtare nr. 133, datë 13.08.2008, faqe 5952.

”Për transaksionet me titujt nëpërmjet bankave dhe funksionimin e sistemit të regjistrimit të titujve”[74].Objekti i kësaj rregullore është nxitja dhe mbështetja e veprimtarisë ndërmjet bankave për transaksionet me titujt dhe e funksionimit të sistemit të regjistrimit të titujve;

- Vendim i Këshillit Mbikqyrës nr 47 datë 30.06.2010 për miratimin e rregullores “ Mbi transkaksionet e shitblerjev me të drejta të plota”[75] Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave dhe i mënyrave të ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun ndërbankar të parasë, nëpërmjet transaksioneve të shitblerjes me të drejta të plota të titujve.

Struktura institucionale

Bashkërendimi i punës për hartimin, miratimin dhe zbatimin e politikës monetare në Bankën e Shqipërisë kryhet nëpërmjet strukturave të mëposhtme:

- Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e udhëzimeve për zbatimin e politikës monetare të Republikës së Shqipërisë. Ai përcakton normën bazë të interesit të operacioneve të Bankës së Shqipërisë në treg të hapur, përqindjen e interesave për depozitat në Bankën e Shqipërisë dhe për skontimet dhe kreditë e Bankës së Shqipërisë, si dhe nivelin e rezervave të detyruara, që bankat e nivelit të dytë duhet të mbajnë në Bankën e Shqipërisë”;
- Departamenti i Politikave Monetare, i cili përbëhet nga 24 punonjës, mbështet Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e efektivitetit të politikës monetare në funksion të përmbushjes së objektivit kryesor ligjor të Bankës;
- Departamenti i Operacioneve Monetare, i cili përbëhet nga 25 punonjës, zbaton politikën monetare të Bankës së Shqipërisë, administron rezervën valutore, llogarinë qendrore të Ministrisë së Financave dhe të tregut primar e të regjistrit të letrave me vlerë, të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë;
- Departamenti i Kërkimeve, i cili përbëhet nga 14 punonjës, kontribuon me punën e tij kërkimore në zgjerimin e njohurive për fenomenet ekonomike dhe ndihmojnë në marrjen e vendimeve sa më të shëndosha në lidhje me politikën monetare dhe mbikëqyrjen bankare;
- Komiteti i Zbatimit të Politikës Monetare, si organ ndër-departamental në Bankën e Shqipërisë merr vendime në lidhje me ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore, si dhe mund të marrë rolin e këshilltarit për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në lidhje me qëndrimin e politikës monetare për normën bazë të interesit.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Trajnim për thellimin e njohurive në politikat makroekonomike dhe në veçanti

[74] Fletore Zyrtare nr. 127, datë 29.08.2009, faqe 5969.
[75] Buletini Zyrtar Vëllimi 12, numër 5, qershor 2010.

shkëmbimi i eksperiencave me praktikat më të mira ndërkombëtare;
- Trajnim i stafit mbi kanalet e transmisionit të politikës monetare;
- Trajnime mbi modelimin dhe parashikimin e variablave kryesor makroekonomik;
- Trajnime te stafit te Departamentit te Politikës Monetare për treguesit e sektorit monetar dhe financiar, sektorit të jashtëm dhe fiskal;
- Pjesëmarrjen në trajnime të organizuara nga institucionet akademike/ ndërkombëtare të tilla si: Qendra për studime të Bankave Qëndrore, Instituti i Budapestit për Studime të Bankës Qëndrore.

Masat legjislative Afatmesme

- Hartimi i projekt-ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", që do të shfuqizojë ligjin ekzistues për Bankën e Shqipërisë. Ky projektligj do të ketë harmonizim të pjesshëm me acquis në këtë fushë duke synuar adoptimin e neneve 123,124,127/2 dhe 130 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe nenet 14 dhe 28 të Statutit të Bankës Qendrore Evropiane dhe të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore

Aktivitetet zbatuese

- Trajnim për thellimin e njohurive në politikat makroekonomike dhe në veçanti shkëmbimi i eksperiencave me praktikat më të mira ndërkombëtare;
- Trajnim i stafit mbi kanalet e transmisionit të politikës monetare;
- Trajnime mbi modelimin dhe parashikimin e variablave kryesor makroekonomik;
- Trajnime te stafit te Departamentit te Politikës Monetare për treguesit e sektorit monetar dhe financiar, sektorit të jashtëm dhe fiskal;
- Pjesëmarrjen në trajnime të organizuara nga institucionet akademike/ ndërkombëtare të tilla si: Qendra për studime të Bankave Qëndrore, Instituti i Budapestit për Studime të Bankës Qëndrore.

Efektet Financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	433.000	0	0	0
Mbulohen nga buxheti i	433.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.17.3. POLITIKA EKONOMIKE

Objektivi Strategjik

Vizioni i Qeverisë për vitet në vijim është një rritje e shpejtë, e qëndrueshme dhe

gjithëpërfshirëse e ekonomisë shqiptare, dhe integrim të suksesshëm Evropian dhe euroatlantik. Në këtë vizion përfshihen:

- Mbajtja e një ritmi rritjeje ekonomike mesatare më të lartë se 6% në vit dhe me tendencë rritëse duke arritur në 7 % ;
- Ruajtja e stabilitetit makroekonomik nëpërmjet konsolidimit të mëtejshëm fiskal, uljes së vazhdueshme të borxhit të brendshëm, përmirësimit të balancës korrente dhe hartimit të politikës fiskale në përputhje me politikën monetare;
- Ulja e nivelit të taksave dhe ruajtja e nivelit 27-28 % të PBB-së të të ardhurave publike, krahas reduktimit të informalitetit dhe miradministrimit të sistemit fiskal;
- Krijimi i klimës së biznesit të favorshme për zhvillimin dinamik të sipërmarrjes private dhe tërheqjen e investimeve të huaja;
- Rritja e nivelit të decentralizimit fiskal, me decentralizimin e mëtejshëm të funksioneve të përbashkëta.

Për arritjen e këtij vizioni, Qeveria është angazhuar:

- Të reformojë thellësisht planifikimin e financave publike, duke zbatuar Sistemin e Integruar të Planifikimit, i cili do të sigurojë harmonizimin e hartimit të buxhetit vjetor me kuadrin e Planifikimit të Buxhetit Afatmesëm, me Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrim dhe me Procesin e Stabilizim Asociimit në BE, si edhe me politika dhe strategji të tjera prioritare.

Katër shtyllat e kësaj strategjie janë:

- Përmirësimi i menaxhimit të financave publike sipas standardeve ndërkombëtare;
- Zgjerimi i bazës së taksueshme dhe harmonizimi i politikave fiskale me përparësitë kombëtare;
- Modernizimi i menaxhimit të borxhit publik.
- Rritja e performancës dhe besueshmërisë të administratave tatimore dhe doganore.

Kjo strategji sektoriale përfshin gjithashtu një plan strategjik të brendshëm për ngritjen e kompetencave organizative të nevojshme për arritjen e objektivave strategjike.

Sfidat kryesore për sektorin e financave publike do të jenë:

- Ruajtja e stabilitetit makroekonomik;
- Përmirësimi i menaxhimit të financave publike sipas standardeve ndërkombëtare;
- Përmirësimi i planifikimit dhe i cilësisë së shpenzimeve publike;
- Formulimi i politikave tatimore dhe doganore që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri dhe nxisin formalizimin e ekonomisë;
- Ulja e nivelit të borxhit publik në përqindje të PBB-së dhe e kostos së shërbimit të tij;
- Thellimi i reformës në politikën e burimeve njerëzore në të gjithë administratën e financave publike, dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative;
- Përmirësimi i menaxhimit të administratës tatimore dhe doganore duke u bazuar në realizimin e të ardhurave me profesionalizëm, integritet dhe ndershmëri, me një

standard që krijon besueshmëri tek qytetarët, dhe kredibilitet me partneret ndërkombëtar dhe komunitetin e biznesit, vendas dhe të huaj.

- Përmirësimi i vlerësimit të performancës të administratës tatimore dhe doganore, duke u bazuar kryesisht në aftësitë profesionale dhe në cilësinë e shërbimit ndaj taksapaguesve, me fokus të veçantë inkurajimin e vetë-deklarimit vullnetar të detyrimeve tatimore;
- Përmirësimi i sistemit të administrimit financiar, të auditit të brendshëm, të raportimit financiar dhe të llogaridhënies;
- Lufta ndaj transaksioneve jo-ligjore.

Programi Ekonomik 2012-2014 do të jetë në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI).

Objektivi kryesor i politikës ekonomike në terma afatmesëm, objektiv ky i hartuar në përputhje të plotë me përfundimet e Raportin Analitik 2010 të Komisionit Evropian për Shqipërinë bazuar në Kriteret e Kopenhagenit, është ruajtja e stabilitetit makroekonomik dhe vazhdimi i reformave strukturore të cilat kanë për qëllim krijimin e kushteve të nevojshme që ekonomia të operoj në kushtet e rritjes së saj potenciale. Politika fiskale dhe monetare mbeten të angazhuara për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, si një parakusht i domosdoshëm për arritjen e një rritje ekonomike të lartë dhe të qëndrueshme në të ardhmen me synim arritjen e niveleve mesatare të mirëqenies të Bashkimit Evropian. Bashkërendimi i të dy politikave bazohet në shkëmbimin e informacionit, strategjinë e politikës së qeverisë dhe masave fiskale të cilat ndikojnë ekonominë në përgjithësi dhe çmimet në veçanti.
Objektivat e politikës fiskale për periudhën afatmesme në vijim 2012 – 2015 janë të përcaktuara në Ligjin nr. 10487, datë 05.12.2011"Për buxhetin e vitit 2012[76] të miratuar nga Parlamenti më datë 5.12.2011, nr. 10487, në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2013 – 2015 të miratuar nga Këshilli i Ministrave më datë 18.1.2012, si dhe janë në përputhje të plotë me Kuadrin afatgjatë 2013 – 2020 të miratuar nga Komiteti i Planifikimit

Strategjik, në takimin e datës 21 dhjetor 2011, konkretisht si më poshtë:

- Borxhi publik total në fund të çdo viti fiskal nuk do të jetë më i lartë se 60% e Produktit të Brendshëm Bruto;
- Huamarrja totale neto për vitin fiskal 2012 dhe 2013 nuk do të jetë më e lartë se 3% e Produktit të Brendshëm Bruto;
- Huamarrja totale neto për vitet fiskale 2014-2015 nuk do të jetë më e lartë se 2.5% e Produktit të Brendshëm Bruto;
- Shpenzimet kapitale të buxhetit gjatë çdo viti fiskal do të jenë të paktën sa huamarrja totale neto e atij viti.

[76] Fletore zyrtare nr.161, datë 10.12.2011, faqe 7683.

Situata aktuale

Politika fiskale e ndjekur gjatë vitit 2011 vazhdoi të udhëhiqej nga synimi kryesor për të siguruar qëndrueshmërinë e financave publike si një prej fondamenteve kryesore të stabilitetit makroekonomik të vendit. Gjithashtu, përtej këtij synimi kryesor, politika fiskale ka patur në konsideratë edhe sigurimin e një balance optimale sa i takon ndikimit në kërkesën e brendshme dhe stimulit të rritjes ekonomike.
Politika fiskale e materializuar në buxhetin e vitit 2011 ishte në përputhje të plotë me objektivat e kësaj politike të shpallura si në Kuadrin Makro-Fiskal afatmesëm ashtu edhe në Buxhetin e vitit 2011. Bazuar në performancën e treguesve fiskal dhe veçanërisht të të ardhurave përgjatë gjysmës së parë të vitit 2011, në Korrik të vitit 2011 u rishikua buxheti fillestar i miratuar për vitin 2011, ku shpenzimet u reduktuan në linjë me mos-realizimin e të ardhurave duke e ri-orientuar buxhetin në përputhje me objektivat e përcaktuara të politikës fiskale. Në mbyllje të vitit 2011 deficiti fiskal rezultoi në nivelin e 3.5% të PBB, ekzaktësisht sa targeti limit i vendosur për këtë indikator të politikës fiskale. Gjithashtu, borxhi total publik (përfshirë edhe borxhin e garantuar publikisht) rezultoi në nivelin 58.9% të PBB, poshtë targetit limit të përcaktuar prej 60%, ndërsa shpenzimet kapitale rezultuan në nivelin prej 5.3% të PBB duke përmbushur edhe objektivin tjetër të politikës fiskale lidhur me tepricën në balancën korrente të buxhetit të shtetit.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/ nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji nr.10 456 datë 21.7.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat"[77];
- Ligji nr. 9844, datë 17.12.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat"[78] i ndryshuar;
- Ligji nr 7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar"[79] i ndryshuar
- Ligji nr. 9965, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë"[80];
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008"Për huamarrjen e qeverisë vendore"[81];
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"[82];
- Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010 'Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"[83];
- Ligji nr. 10487, datë 05.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012"[84].
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 69, datë 02.02.2011 "Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2012-2014"[85];

[77] Fletore zyrtare nr. 107, date 09.08.2011, faqe 4265.
[78] Fletore zyrtare nr.180, dhjetor 2007, faqe 5608.
[79] Fletore Zyrtare nr. 12, date 16.06.1995, faqe 469
[80] Fletore Zyrtare nr. 150, dhjetor 2006, faqe 6088
[81] Fletore zyrtare nr.18, datë 19.02.2008, faqe 644.
[82] Fletore zyrtare nr.112, datë 21.07.2008, faqe 4933.
[83] Fletore zyrtare nr.97, datë 26.07.2010, faqe 5152.
[84] Fletore zyrtare nr.164, datë 19.12.2011, faqe 8256.
[85] Fletore zyrtare nr.10, datë 17.02.2011, faqe 242

- VKM nr. 521, datë 20.07.2011 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 147, datë 02.03.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve buxhetore të programit buxhetor afatmesëm 2012-2014"[86];
- VKM nr. 522, datë 20.07.2011 "Për miratimin e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2012-2014"[87];
- VKM nr. 528, datë 20.07.2011" Për një ndryshim në Vendimin nr. 69, datë 02.02.2011 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2012-2014"[88];
- VKM nr. 915, datë 28.12.2011 "Për miratimin e kalendarit të vitit 2012 për menaxhimin e shpenzimeve publike"[89].

Struktura institucionale

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Fiskale (DPPMF) në Ministrinë e Financave, është struktura përgjegjëse për zbatimin e politikës fiskale për stabilitetin makroekonomik, në aspektin e politikave fiskale është përgjegjëse për analizën dhe parashikimet makroekonomike dhe fiskale në përputhje me programet e zhvillimit ekonomik te vendit". DPPMF-ja ka në përbërjen e saj dy drejtori: Drejtorinë e Makroekonomisë, e cila është përgjegjëse për analizimin në vijimësi të zhvillimeve ekonomike në rrafshin makroekonomik, parashikimin afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afatgjatë të ecurisë së ekonomisë dhe parashikimin e burimeve financiare të buxheteve afatshkurtër, afatmesëm e afatgjatë, si dhe rekomandon objektivat kryesorë afatshkurtër dhe afatmesëm të politikës fiskale duke synuar një kurs optimal të politikës fiskale në harmonizim të plotë me zhvillimet dhe perspektivën makroekonomike të vendit. Dokumenti kryesor me anë të të cilit materializohen dhe formalizohen përgjegjësitë e mësipërme të kësaj drejtorie është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.60, datë 18.01.2012 mbi Kuadrin Makroekonomik e Fiskal afatmesëm dhe atë afatgjatë, dhe rishikimet periodike të tij. Drejtoria e Makroekonomike ka në përbërjen e saj shtatë punonjës dhe është e organizuar në dy sektorë: Sektori i analizave dhe Sektori i parashikimeve makroekonomike. Drejtoria e Politikave Fiskale (DPF) e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave tatimore dhe kuadrit ligjor tatimor në vend, zhvillimin e një modeli të plotë fiskal, parashikimin e të ardhurave, përgatitjen e parashikimeve dhe analizave të situatës fiskale të qeverise. DPF ka në përbërjen e saj shtatë punonjës dhe është e organizuar në dy sektorë: Sektori i analizave dhe hartimit te politikave dhe Sektori i analizave dhe parashikimit të të ardhurave.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projekt ligji mbi disa ndryshime në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat" i ndryshuar;
- Projekt ligji mbi disa ndryshime në ligjin nr. 9844, datë 17.12.2002 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar;

[86] Fletore zyrtare nr.121, datë 25.08.2011, faqe 4799.
[87] Fletore zyrtare nr.124, datë 31.08.2011, faqe 4883.
[88] Fletore zyrtare nr.114, datë 17.08.2011, faqe 4506.
[89] Fletore zyrtare nr.181, dhjetor 2011, faqe 10160.

- Projekt ligji mbi disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 05.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012.
- Projekt VKM mbi disa dryshime në Vendimine Këshillit të Ministrave nr. 528, datë 20.07.2011" Për një ndryshim në Vendimin nr. 69, datë 02.02.2011 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2012-2014";

Efektet Financiare

Në Lekë

	2012	**2013**	**2014**	**2015**
Kostot totale e vlerësuar	4.707.000	62.534.000	121.934.000	121.934.000
Mbulohen nga buxheti i	4.707.000	7.334.000	11.534.000	11.534.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	0	55.200.000	110.400.000	110.400.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.18. STATISTIKAT

Objektivi strategjik

Detyrimet kryesore të zhvillimit strategjik të statistikave në Shqipëri derivojnë nga neni 88 "*Bashkëpunimi Statistikor*" i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, i cili parashikon se bashkëpunimi mes palëve përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* në fushën e statistikave. Ai synon veçanërisht zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm, të aftë për të siguruar të dhëna të krahasueshme, të besueshme, objektive dhe të sakta, që nevojiten për të planifikuar dhe monitoruar procesin e reformave në Shqipëri. Ky sistem duhet gjithashtu të aftësojë Institutin e Statistikave Shqiptare për të përmbushur më mirë nevojat e klientëve vendas dhe ndërkombëtarë (si të administratës publike ashtu dhe sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të respektojë parimet themelore të statistikave të nxjerra nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe Kodi Statistikor Evropian i Praktikës dhe parashikimet e se drejtës Statistikore Evropiane dhe duhet të zhvillohet drejt *acquis* së BE-së.

Bazuar në sa më sipër, drejtimet kryesore të zhvillimit strategjik të statistikave zyrtare në Shqipëri janë:

- Forcimi i identitetit të sistemit dhe të imazhit të statistikës zyrtare, zhvillimi i kulturës statistikore në vend dhe shtimi i përdorimit të metodave statistikore në bazë të të dhënave që vijnë nga administrata publike;
- Stimulimi i kërkesës për informacion statistikor, integrimi dhe harmonizimi i metodave të prodhimit të informacionit statistikor në funksion të kërkesave dhe rekomandimeve evropiane e ndërkombëtare si dhe sigurimi i një bashkëpunimi statistikor ndërmjet të gjitha agjencive statistikore operuese në vend.

Situata aktuale

INSTAT-i, si dhe agjencitë e tjera prodhuese të statistikave zyrtare, janë në përballje me një numër në rritje të kërkesave të reja nga përdoruesit kombëtar dhe ndërkombëtar. Duke patur parasysh synimet për anëtarësim në BE, sistemi ka nevojë për zhvillimin sistematik dhe të planifikuar në një numër fushash, kryesisht për treguesit makroekonomikë dhe socialë.

INSTAT-i, si institucioni i ngarkuar me ligj për koordinimin dhe monitorimin e veprimtarisë së Sistemit Statistikor Shqiptar, siguron zbatimin e Programit Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare, nëpërmjet raportimeve periodike mbi ecurinë e tij para Këshillit të Statistikave si dhe nënshkruan Memorandume Mirëkuptimi me Agjencitë Statistikore dhe institucionet e tjera të ngarkuara për prodhimin të dhënave statistikore.

INSTAT krijon, mirëmban dhe është përgjegjës për krijimin e regjistrave statistikorë, të cilët përdoren vetëm për qëllime statistikore. Duke respektuar parimet e konfidencialitetit, regjistrat ndihmojnë marrjen dhe përditësimin e informacionit nëpërmjet burimeve të ndryshme, administrative ose vrojtime statistikore. Gjithashtu, regjistrat bëjnë të mundur përgatitjen e mostrave, koordinimin e anketave dhe grupimin e rezultateve, analizën

demografike të popullsisë, njësive ekonomike dhe njësive të lidhura me to, si dhe prodhimin e statistikave të nevojshme për treguesit periodikë. Në këtë kuadër, pas përfundimit të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike 2010, INSTAT disponon një regjistër më të plotë e të përditësuar të ndërmarrjeve që operojnë në Shqipëri, statusin e tyre, adresat, et.

Gjithashtu, pas përfundimit të procesit të skanimit të pyetësorëve të plotësuar nga intervistuesit e Censusit të Popullsisë e Banesave, i cili është parashikuar të përfundojë brenda gjashtë-mujorit të parë të vitit 2012, INSTAT do të disponojë gjithashtu një bazë të hollësishme të të dhënave që kanë të bëjnë me popullsinë e vendit, lëvizjet demografike, numrin e banesave etj.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Veprimtaria në fushën e statistikave zyrtare në Shqipëri rregullohet në bazë të akteve të mëposhtme ligjore dhe nënligjore:

- Ligji nr. 9180, date 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare";
- Ligji nr. 8669, datë 26.10.2000 "Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave", ndryshuar me ligjin nr. 10084, datë 23.02.2009 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8669, datë 26.10.2000 "Për Regjistrimin e Përgjithshëm të Popullsisë dhe Banesave" dhe Aktin Normativ nr. 6, datë 30.09.2009 "Për një ndryshim në ligjin nr. 8669, datë 26.10.2000 "Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë e banesave, të ndryshuar";
- Ligji nr. 10201, datë 17.12.2009 "Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore", përafruar pjesërisht me Rregulloren (KE) nr. 223/2009 E Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 mars 2009, "Për statistikat Evropiane" dhe që shfuqizon Rregulloren (KE, Euratom) nr. 1101/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për transmetimin e të dhënave që përbëjnë objekt të sekretit statistikor Zyrës Statistikore të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 322/97 "Për Statistikat e Komunitetit", si edhe Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom "Për krijimin e Komitetit për Programet Statistikore të Komuniteteve Evropiane"[90] dhe Rregulloren (KE) Nr. 1893/2006 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 20 dhjetor 2006, "Për krijimin e klasifikimit statistikor të veprimtarive ekonomike *NACE Revision 2*" (që ndryshon Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 3037/90 si edhe disa Rregullore KE për fusha të caktuara statistikore.[91];
- Ligji nr. 10202, datë 17.12.2009 "Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore", përafruar pjesërisht me Rregulloren (KE) nr. 223/2009 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 mars 2009, "Për Statistikat e Komunitetit" dhe që shfuqizon Rregulloren (KE, Euratom) nr. 1101/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për transmetimin e të dhënave që përbëjnë objekt të sekretit statistikor Zyrës Statistikore të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 322/97 për Statistikat e Komunitetit, si edhe Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom për krijimin e Komitetit për Programet Statistikore të

[90] FZ L 87, 31.3.2009, fq. 164
[91] FZ L393, 30.12.2006, fq.1

Komuniteteve Evropiane[92];

- Ligji nr 8957 datë 17.10.2002 "Për Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme, SME", ndryshuar me Ligjin nr 10042 datë 22.12.2008;
- Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë";
- VKM nr. 704, datë 16.11.2005 "Për miratimin e kritereve të përfaqësimit, të përzgjedhjes, emërimit e shkarkimit të anëtarëve dhe rregullat e funksionimit të këshillit të statistikave", ndryshuar me VKM nr. 314, datë 24.05.2006;
- VKM nr. 399, datë 22.04.2009 "Për organizimin, funksionimin dhe përbërjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit", të ndryshuar;
- VKM nr. 1013, datë 17.03.2010 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit dhe për përbërjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore";
- VKM nr. 327 datë18.07.1994 "Mbi Nomenklaturën e Aktiviteteve".

Me qëllim rregullimin e kuadrit ligjor të kësaj fushe janë nënshkruar këto Memorandume Mirëkuptimi ndërmjet INSTAT dhe Institucioneve të tjera:

- Memorandumi i Bashkëpunimit nr.342 prot., datë 6.6.2005 mes INSTAT dhe Ministrisë së Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave);
- Memorandumi i Bashkëpunimit nr.343 prot., datë 6.6.2005 mes INSTAT dhe Ministrisë së Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Taksave);
- Memorandumi i Bashkëpunimit nr. 418 prot datë 12.05.2008 mes INSTAT dhe Bankës së Shqipërisë
- Memorandumi i Bashkëpunimit nr.141 prot datë 11.02.2009 mes INSTAT dhe Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Memorandumi i Bashkëpunimit nr. 604 prot datë 29.07.2009 mes INSTAT dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës
- Memorandumi i Bashkëpunimit nr.246 prot datë 13.03.20085 mes INSTAT dhe Inspektoriatit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive

Këto memorandume të nënshkruara me mbajtësit kryesorë të të dhënave administrative, synojnë sigurimin dhe transmetimin në vazhdimësi të të dhënave bazë nga burimet administrative në drejtim të INSTAT - it.

Struktura institucionale

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacionit në fuqi në fushën e statistikave është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve, të cilët janë pjesë përbërëse e Sistemit Kombëtar Statistikor:

Instituti i Statistikave (INSTAT) i cili ka për detyrë të prodhojë statistika transparente, të pa aneshme dhe në kohë që ndihmojnë përdoruesit të gjykojnë mbi ecurinë e proceseve transformuese të zhvillimit në vend. Këtë mision INSTAT - i e ushtron në përputhje me

[92]FZ L 87, 31.3.2009, fq. 164

mandatin e tij publik dhe institucional duke synuar ngritjen e organizuar të një sistemi statistikor kombëtar, duke maksimizuar përdorimin e të gjitha burimeve ekzistuese të informacionit. Instituti i Statistikave në Shqipëri (INSTAT) është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare dhe është përgjegjës për koordinimin e sistemit statistikor shqiptar.

Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr.67, datë 8.7.2011 "*Për miratimin e organikës dhe strukturës organizative të Institutit të Statistikave*", INSTAT ka një strukturë të re organizative e cila është e ndërtuar nga një Drejtori i Përgjithshëm dhe gjashtë drejtori si më poshtë:

- Drejtoria e Statistikave Sociale;
- Drejtoria e Statistikave Ekonomike;
- Drejtoria e Anketave Pranë Familjeve
- Drejtoria e Llogarive Kombëtare;
- Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit;
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Numri aktual i personave që punojnë pranë institucionit është 200 punonjë, nga të cilët 127 specialistë punojnë në qendrën e institucionit, ndërsa 72 të tjerë në drejtoritë rajonale.
Zbatimi i aktiviteteve statistikore mbulohet edhe nga punonjësit mbështetës të rekrutuar me kohë të pjesshme. Gjatë vitit 2010 dhe 2011 u kryen dy Regjistrime të Përgjithshme (Censusi i Biznesit 2010 dhe Censusi i Popullsisë e Banesave 2011). Këto dy projekte madhore angazhuan një numër relativisht të madh punonjësish prej rreth 15 mijë vetë, të angazhuar kryesisht për kryerjen e intervistimeve, kontrolleve dhe hedhjen e të dhënave.
Agjencitë Statistikore, të cilat prodhojnë statistikat zyrtare sipas detyrimeve të parashikuara në Programin Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare si dhe i sigurojnë INSTAT-it të gjitha dokumentet dhe të dhënat e nevojshme, për t'i mundësuar atij përpunimin e statistikave në çdo sektor. Aktualisht, agjencitë statistikore janë:

- Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Ministria e Mjedisi Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave;
- Banka e Shqipërisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Veprimtaria këtyre institucioneve monitorohet nga *Këshilli i Statistikave*, i cili përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë të emëruar me VKM nr. 704, datë 16.11.2005 "Për miratimin e kritereve të përfaqësimit, të përzgjedhjes, emërimit e shkarkimit të anëtarëve dhe rregullat e funksionimit të këshillit të statistikave", ndryshuar me VKM nr. 314, datë 24.05.2006. Ky bord miraton programin statistikor, planin strategjik pesëvjeçar dhe Plan-Veprimin njëvjeçar të INSTAT-it, projekt-buxhetin vjetor dhe projekt-strukturën organizative të INSTAT-it.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Në kuadër të hartimit të projekt-programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare, në mënyrë që sistemi statistikor të prodhojë një gamë sa më të gjerë treguesish do të zhvillohen takime me grupet e interesit, do të merren opinione si dhe do të hartohen parashikimet buxhetore përkatëse për kryerjen e aktiviteteve**.**

- Hartimi i memorandumeve të bashkëpunimit mes institucioneve të përfshira në programin pesëvjeçar të statistikave zyrtare për format dhe afatet e shkëmbimit të të dhënave statistikore;
- Zhvillimi i trajnimeve të personelit të INSTAT-it si dhe agjencive të tjera statistikore.
- Regjistrimi i Përgjithshëm i Bujqësisë;
- Sigurimi i të dhënave mjedisore për cilësinë e ajrit, ujërave sipërfaqësorë, zonave të mbrojtura, sektorin pyjor, biodiversitetin, mbetjet urbane dhe inerte.

3.18.1. STATISTIKAT DEMOGRAFIKE-SOCIALE

3.18.1.1. STATISTIKAT DEMOGRAFIKE

Analiza e Situates Aktuale

Statistikat e Popullsisë studiojnë popullsinë sipas dimensioneve hapsinore të shpërndarjes dhe strukturës së saj, duke iu referuar karakteristikave demografike, sociale dhe ekonomike. Merret parasysh evolucioni i këtyre ndryshimeve në mënyrë që të nxirren ligjshmëritë që kanë prodhuar këto fenomene demografike dhe gjithashtu këto njohuri të vihen në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Nga 1950 deri në 1990, popullsia e Shqipërisë ka përjetuar dekada të rritjes së shpejtë të popullsisë, edhe pse ritmi i kësaj lëvizje ra në mënyre progresive. Fertiliteti ishte shumë më i lartë se kudo tjetër në Europe, ndërkohë që mortaliteti ishte relativisht i favorshëm, që ndjek modelin e vendeve Mesdhetare, shkëmbimet me vendet e huaja përmes migrimit ishin pothuajse inekzistente dhe lëvizjet nga rajoni në rajon në vend ishin shumë të kufizuara.

Popullsia e Shqipërisë ka përjetuar dekada të rritjes së shpejtë të popullsisë, edhe pse ritmi i kësaj lëvizje ra në mënyre progresive. Fertiliteti ishte shumë më i lartë se kudo tjetër në Europe, ndërkohë që mortaliteti ishte relativisht i favorshëm, që ndjek modelin e vendeve Mesdhetare. Shkëmbimet me vendet e huaja përmes migrimit ishin pothuajse inekzistente dhe lëvizjet nga rajoni në rajon në vend ishin shumë të kufizuara.

Vitet 90-të e ndryshuan në mënyrë të konsiderueshme këtë pamje. Rënia e lindshmërisë ka shkuar drejt niveleve që janë më afër standarteve evropiane, emigracioni ishte në shkallë të gjerë, dhe ka lënë gjurmë të forta në piramidën e moshës, migracioni i brendshëm e ka ndryshuar shumë ekuilibrin midis rajoneve të vendit. Vitet që pasuan pas regjistrimit të fundit të popullsisë 2001, theksuan rënien e lindshmërise në nivele akoma më të ulta dhe nje vdekshmëri puthuaj stacionare. Kjo ka sjellë që në Shqipëri ritmi i rritjes se popullsisë të jetë akoma pozitiv, por riprodhimi i saj të jetë i pamundur. Studimet demografike të thelluara do të mund të sillnin në vëmendje të politikë bërësve masat që duhen marrë në të ardhmen, nëse këta tregues do të vazhdojnë të ulen, pra popullsia do të fillojë të plaket.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 8669, datë 26.10.2000 ”Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave”, ndryshuar me Ligjin nr. 10084, datë 23.02.2009 “Për disa ndryshime dhe

shtesa në Ligjin nr. 8669, datë 26.10.2000 "Për Regjistrimin e Përgjithshëm të Popullsisë dhe Banesave" dhe Aktin Normativ nr. 6, datë 30.09.2009 "Për një ndryshim në Ligjin nr. 8669, datë 26.10.2000 "Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë e banesave, të ndryshuar";

- Ligji nr. 9180, date 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare";
- Ligji Nr. 10442, datë 7.7.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8669, datë 26.10.2000 "Për censusin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave";
- VKM nr. 520 dhe nr. 533 të datës 20.7.2011 "Për ngritjen dhe funksionimin ekomisioneve vendore të censusit",

Struktura Institucionale

Për prodhimin e statistikave demografike, brenda strukturës organizative të INSTAT-it operon Drejtoria e Statistikave Sociale, e përbërë nga 1 drejtor, 3 shefa sektorësh dhe 8 specialistë. Ky numër punonjësish shikohet si i mjaftueshëm për të mbuluar aktivitetet statistikore që do të zbatohen gjatë viteve 2012-2015.

Drejtoria e Statistikave Sociale përbëhet nga 3 sektorë:
Sektori i Demografisë dhe Statistikat Juridike. Statistikat e demografisë shërbejnë për të studiuar popullsinë në aspektin e dimensionit të shpërndarjes hapësinore dhe të strukturës së saj, sipas karakteristikave të ndryshme demografike, sociale dhe ekonomike. Ato ndjekin evolucionin e këtyre ndryshimeve me qëllim që të nxirren në pah ligjshmëritë sipas të cilave prodhohen dukuritë demografike dhe i vë këto njohuri në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Në statistikat juridike përfshihen statistikat e krimeve dhe divorcet.

Sektori Shëndetësi-Arsim. Ky sektor është përgjegjes për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave të arsimit, kulturës dhe sporteve si dhe të dhënave mbi shëndetësinë.
Statistikat e arsimit kanë për qëllim të evidentojnë zhvillimet e arsimit në vend, nëpërmjet treguesve statistikorë. Treguesit statistikorë të arsimit llogariten: për fëmijë, nxënës e studentë të regjistruar; nxënës e studentë të diplomuar; edukatorë, mësues e staf akademik,si raporte të ndryshme të të regjistruarve dhe të diplomuarve me popullsinë, si dhe për stafin mësimdhënës. Gjithashtu llogariten tregues ekonomikë lidhur me shpenzimet e kryera për arsimin. Treguesit statistikorë të *kulturës e sporteve* evidentojnë institucionet më të rëndësishme të artit dhe kulturës në vend, aktivitetet e tyre, aktivitetet e operatorëve radio televizive, si edhe të sporteve . Statistikat në lidhje me *shëndetin publik* përfshijnë të dhëna mbi statistikat e sëmundshmërisë, vdekshmërisë, aktivitete të institucioneve shëndetësore (spitalore dhe shërbimit parësot) të cilat vazhdojnë të zhvillohen, si dhe analizojmë dhe shpërndajnë një grup të qëndrueshëm të statistikave mbi shëndetin publik si element statistikor i informacionit shëndetësor të kërkuar për mbështetjen e Strategjisë Shëndetësore.

Sektori i Analizave Socio-Demografike dhe Gjinore. Ky sektor pëqendrohet në hartimin dhe përditësimin e projeksioneve të popullsisë si dhe në përllogaritjen e tabelave të jetës. Gjithashtu ky sektor do të përdorë të gjitha burimet e INSTAT por sidomos anketat pranë familjeve, duke hulumtuar dhe analizuar ato për të rritur gamën e treguesve të rinj. Përsa i takon statistikave *Gender*, ky sektor do të grumbullojë, analizojë dhe përgatisë publikimin e

veçantë "Femrat dhe meshkujt në Shqipëri", duke e përmirësuar atë me të gjithë treguesit e mundshëm si sociale ashtu edhe ekonomikë, përsa i takon statistikave gjinore.

Masat legjislative afatshkurtra

Projekt Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë "Për miratimin e programit të statistikave zyrtare për periudhën 2012-2016". Ky projekt-vendim do të përafrojë pjesërisht: Rregulloren nr. 223/2009/EP dhe KE "Për statistikat Evropiane dhe shfuqizimin e Rregullores Nr. 1101/2008 të Parlamentit të Evropës dhe Këshillit për transmetimin e të dhënave konfidenciale nga Zyrat e Statistikave të Komuniteteve të Evropës, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr.322/97 për Statistikat Komunitare, dhe Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom për ngritjen e një Komiteti për Programet e Statistikave të Komuniteteve të Evropës"93; Direktivën 95/46/KE dt. 24 Tetor 1995 "Për mbrojtjen e individëve për shkak të përpunimit të të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave"; Rregulloren (KE) 45/2001 dt. 18 Dhjetor 2000;

Aktivitetet zbatuese

- Përmiresimi i treguesve të popullsisë me rezultatet e Censusit 2011.

Aktivitet zbatuese afatmesme

- Përmirësimi i burimeve statistikore apo administrative të informacionit si bazë e nevojshme për analizën e sektorëve Institucional;
- Bazuar në rezultatet e arritura nga ndërtimi i një baze të plotë të dhënash, do të përgatitet një publikim i cili do të përmbajë rezultatet, metodologjine dhe disa analiza për sektorët institucional;
- Përmirësim i vazhdueshëm i metodologjisë së llogaritjeve, publikimit të të dhënave;
- Rritja e bashkëpunimit me agjencitë e tjera statistikore për përmirësimin e treguesve duke shfrytëzuar sa më më mirë burimet administrative të tyre;
- Studime të vazhdueshme mbi praktikat e ndjekura nga vendet e tjera.

3.18.1.2. STATISTIKAT E TREGUT TË PUNËS

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesor i statistikave të tregut të punës është sigurimi i përshkrimeve të sakta mbi madhësinë, strukturën dhe karakteristikat e pjesëmarrësve të ndryshëm në tregun e punës.
Statistikat e tregut të punës mbulojnë aspekte afatshkurtra dhe strukturore të tregut të punës, si për anën e ofertës ashtu dhe për anën e kërkesës së tregut të punës, në terma monetarë dhe jomonetarë. Këto aspekte përfshijnë: Punësimin dhe papunësinë – Anketa e Forcave të Punës dhe burimet administrative.

[93] Celex nr 32009R0223, *FZ L 87, 31.3.2009, fq. 164–173*

Objektivi strategjik do të sigurohet nëpërmjet harmonizimit të metodologjisë të anketës së vazhdueshme të forcave të punës me rekomandimet dhe rregulloret e Eurostat-it lidhur me saktësinë e të dhënave të mbledhura dhe me përpunimin në kohë reale të tyre, si dhe lidhur me madhësinë e zgjedhjes dhe llogaritjen e treguesve të cilësisë së anketës.

Situata aktuale

Për prodhimin e statistikave të tregut të punës në Shqipëri, INSTAT-i përdor dy burime informacioni: Burimet administrative dhe Anketën e Forcave të Punës që kryhet nga INSTAT-i që nga viti 2007.

Burimet administrative: Të dhënat e mbledhura nga burimet administrative publikohen në INSTAT me periodicitet tremujor. Këto të dhëna mbulojnë punësimin në sektorin shtetëror, punësimin në sektorin privat jo-bujqësor dhe papunësinë e regjistruar. Të dhënat mbi punësimin në sektorin shtetëror mblidhen mbi bazën e programit statistikor kombëtar nga Instituti i Statistikës. Të dhënat administrative mbi punësimin në sektorin privat jo-bujqësor dhe të papunët e regjistruar mblidhen nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Për punësimin në sektorin privat bujqësor janë përdorur estimimet e marra nëpërmjet anketave pranë familjeve (deri në vitin 2007 është përdorur vlerësimi i marrë nga LSMS 2005).

Anketa e Forcëse së Punës: Burimi i dytë i informacionit që përdor INSTAT për punësimin në Shqipëri është Anketa e Forcave të Punës (AFP). Kjo Anketë ka si bazë familjen dhe të dhënat mblidhen nëpërmjet intervistimit të drejtpërdrejtë të të gjithë individëve 15 vjeç e lart në familjet të cilave u ka rënë shorti për t'u intervistuar. Anketa për forcën e punës është një anketë që kryhet në nivel kombëtar, dhe mbulon gjithë territorin e Shqipërisë. Anketa është kryer në katër vitet e kaluara, respektivisht në 2007, 2008, 2009 dhe 2010 me periodicitet vjetor. Nevojat në rritje për tregues më të përditësuar për tregun e punës, dhe informacion sa më real mbi shkallën e kërkimit aktiv të punës, mënyrat e kërkimit dhe shkallën e inaktivitetit në tregun e punës (të cilat kushtëzojnë direkt hartimin e politikave të duhura mbi punësimin dhe trainimin e të papunëve apo riintegrimin në tregun e punës të personave ekonomikisht jo aktivë), bëri që INSTAT në vitin 2011 të fillojë anketën e vazhdueshme të forcave të punës, rezultatet e së cilës do të publikohen me periodicitet tremujor.

Anketa e vazhdueshme e forcave të punës është anketë panel ku një familje intervistohet në pesë tremujorë të njëpasnjëshëm. Anketimi kryhet me intervistë të drejtpërdrejtë dhe në vend të pyetësorëve letër që u përdorën në 4 anketat e para vjetore, po përdoren Asistenti Personal Dixhital (PDA). Hedhja e të dhënave bëhet direkt në PDA gjatë intervistimit, ndërsa përpunimi i të dhënave bëhet në SPSS.
Nëpërmjet kryerjes në vijimësi të Anketës për Forcën e Punës synohet ngritja e një sistemi statistikor të qëndrueshëm të statistikave të tregut të punës sipas standarteve të Eurostat.

Anketa mbledh të dhëna bazë mbi karakteristikat demografike të anëtarëve të familjeve dhe të dhëna të detajuara mbi të punësuarit dhe të papunët. Mbi bazën e të dhënave të mbledhura arrihet të bëhet një vlerësim sasior dhe dinamik i zhvillimeve të tregut të punës, përcaktohet pjesëmarrja në tregun e punës e personave në moshë 15 vjeç e lart, niveli i punësimit,

punësimi sipas aktiviteteve ekonomike, punësimi sipas gjinisë dhe grupmoshave, shkalla e papunësisë, pjesëmarrja e grave në tregun e punës etj. Anketa për Forcën e Punës kryhet në përputhje me rekomandimet metodologjike të Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO), të adoptuara në Konferencën e 13-të Ndërkombëtare të Statisticienëve të Punës dhe me rekomandimet e EUROSTAT-it.

Anketa e forcave të punës kryhet mbi një kampion prej 5040 familjesh gjithsej. Eshtë një kampion dy-hapësh, me stratifikim. Stratifikimi bazohet në dy grupe studimi kryesore: qytet/fshat dhe 12 prefektura me një total prej 24 stratash. Në hapin e parë zgjidhen PSU-të me metodën PPS-sistematike, ku si madhësi matjeje përdoret numri total i familjeve. Në hapin e dytë, një numër i njëjtë familjesh zgjidhet brenda çdo PSU-je.

Gjatë përpunimit të të dhënave, aplikohen klasifikimet ndërkombëtare ISCO-88 deri në vitin 2009, NACE Rev.1 deri në vitin 2010. Në vitin 2012 do të përdoren për profesionet nomenklatura ISCO-08 dhe për aktivitetet ekonomike NACE Rev2.

Baza ligjore dhe përafrim i legjislacionit

Referohu bazës ligjore të Kapitullit 18

Struktura institucionale

Për prodhimin e statistikave të Tregut të Punës, brenda strukturës organizative të INSTAT-it operon Drejtoria e Anketave pranë Familjeve, e përbërë nga 1 drejtor, 3 përgjegjës sektorësh dhe 10 specialistë. Ky numër punonjësish shikohet si i mjaftueshëm për të mbuluar aktivitetet statistikore që do të zbatohen gjatë viteve 2012-2015.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Në kuadër të hartimit të projekt-programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare, në mënyrë që sistemi statistikor të prodhojë një gamë sa më të gjerë treguesish për të kënaqur interesat e sa më shumë përdoruesve, do të zhvillohen takime me grupet e interesit, do të merren opinione si dhe do të hartohen parashikimet buxhetore përkatëse për kryerjen e aktiviteteve.
- Hartimi i memorandumeve të bashkëpunimit mes institucioneve të përfshira në programin pesëvjeçar të statistikave zyrtare për format dhe afatet e shkëmbimit të të dhënave statistikore;
- Zhvillimi i trajnimeve të personelit të INSTAT-it si dhe agjencive të tjera statistikore.
- Përmirësimi i përllogaritjes së treguesve të tregut të punës që masin punësimin informal dhe punësimin në sektorët informalë të ekonomisë.
- Kryerja e një studimi të plotë për dinamikën e zhvillimeve të tregut të punës në Shqipëri bazuar në rezultatet e Anketave (vjetore) të Forcave të Punës 2007-2011 dhe në të dhënat e Census 2011.
- Analiza e të gjitha burimeve të të dhënave statistikore për punësimin dhe hartimi i pasqyrave statisikore të detajuara në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet publike dhe private që mbledhin të dhëna për punësimin

Aktivitet zbatuese afatmesme

- Konsolidimi i anketës tremujore të forcave të punës lidhur me cilësinë e të dhënave të mbledhura dhe publikimin e rezultateve kryesore për papunësinë dhe punësimin;
- Zhvillimi i analizave longitudinale dhe cross-section i të dhënave të anketës së forcave të punës;
- Përditësimi i samplit të anketës tremujore të forcave të punës me bazën e re të të dhënave nga Censusi 2011 dhe rritja e samplit për të marrë statistika për tregun e punës sa më të besueshme dhe sa më përfaqësuese në nivel NUT 2 dhe 3;
- Përshtatja-me-qëllimin e statistikave të tregut të punës, që ndryshe do të thotë një cilësi e lartë statistikore e të dhënave (aksesin dhe afatet kohore të shpërndarjes së të dhënave, saktësinë, koherencën, krahasueshmërinë dhe përkatësinë);
- Kryerja e Anketës së Kostos së Punës 2013.

3.18.1.3. SHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE DHE NIVELI I JETESËS

Analiza e Situates Aktuale

Statistikat mbi shpërndarjen e të ardhurave, shpenzimeve dhe kushteve të jetesës në Shqipëri bazohen në dy burime: Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) dhe Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF).

Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) është një anketë shumëqëllimëshe, e cila kryhet në familje dhe është një nga burimet kryesore të informacionit për të matur kushtet e jetesës, gjendjen e varfërisë si dhe për të siguruar një instrument të nevojshëm për të ndihmuar hartuesit e politikave në monitorimin dhe zhvillimin e programeve sociale.Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) është kryer në kontekstin e monitorimit të vazhdueshëm të varfërisë dhe krijimin e një sistemi të vlerësimit të politikave të parashikuar nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Statistikat mbi të ardhurat, përfshirjen sociale dhe kushtet e jetesës janë bazuar në: Anketën e Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS). Objektivi kryesor i LSMS-së është të mbledhë informacion për ndërtimin dhe matjen e mirëqënies dhe për të identifikuar faktorët që përcaktojnë atë. Mirëqënia totale matet zakonisht nga konsumatorët, duke siguruar informacion për nivelin dhe shpërndarjen e varfërisë në vend. LSMS është gjithashtu një mjet i fuqishëm për vlerësimin dhe përcaktimin e kostove sociale.Ky vrojtim mbulon të gjithë vendin dhe ofron të dhëna në nivel rajoni dhe ndarje urbane/rurale. Për qëllime statistikore bazuar në metodologjinë e Bankës Botërore, Shqipëria u nda në 4 rajone: Rajoni Bregdetar, Qëndror, Malor dhe Tirana urbane. Bazuar në shifrat e LSMS, INSTAT llogarit linjën absolute të varfërisë, bazuar në metodën e shpenzimeve.Kostoja e metodologjisë së nevojave bazë (Ravallion dhe Bidani, 1994) është përdorur për llogaritjen e kufirit të varfërisë.Kjo metodologji llogarit së pari një linjë të varfërisë ushqimore, ose koston e marrjes së një shume të caktuar minimale kalorish, dhe pastaj duke e shtuar atë me një pagesë për nevojat bazë jo-ushqimore.

Pyetësori i LSMS-së, përmban edhe një modul mbi varfërinë subjektive. Varfëria subjektive është interpretuar si një mendim subjektiv në përputhje me mendimet e të gjithë popullatës

për nivelin e të ardhurave të nevojshme për të shmangur varfërisë.

Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF) është një vrojtim statistikor i cili siguron të dhëna mbi shpenzimet dhe të ardhurat e familjeve, shpenzimet për vetë-konsum, si dhe të dhëna për situatën socio-demografike në të cilën familjet jetojnë.Kjo anketë është plotësisht e harmonizuar me studimet ABF në vendet e tjera Europiane. Për të përcaktuar strukturën e konsumit është përdorur klasifikimi COICOP/ABF i rekomanduar nga Eurostat për vendet Europiane; *"Anketa e Buxhetit të Familjes në BE, Metodologji dhe Rekomandime për harmonizim, 2003".*

Anketa e Buxhetit të Familjes kryhet për të të marrë të dhëna mbi shpenzimet familjare për konsum, vetë-konsum, të ardhurat dhe treguesit socio-ekonomike në të cilat jetojnë familjet. Ky vrojtim dhe të dhënat e mbledhura japin gjithashtu informacion mbi përbërjen e shpenzimeve të konsumit total të familjeve.Objektivi kryesor i këtij vrojtimi është, përcaktimi i strukturës së Buxhetit të Familjeve, për t'a përdorur atë në përditësimin e shportës dhe peshave të Indeksit të Çmimeve të Konsumit si dhe në përllogaritjen e konsumit final të familjeve të përdorura nga Llogaritë Kombëtare.

Anketa e Buxhetit të Familjes ka një shtrirje 1-vjeçare në terren. ABF është kryer për herë të parë në 1999-2000, përfaqësuese vetëm për zonën urbane të Shqipërisë, në krahasim me përfshirjen totale të territorit të vendit në 2006-2007 dhe një përfaqësim në nivel prefekture dhe ndarje urbane-rurale. Është planifikuar që kjo anketë të kryhet me baza tre-mujore duke filluar nga viti 2013.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Referohu bazës ligjore të Kapitullit 18

Struktura Institucionale

Për prodhimin e statistikave të Nivelit të Jetesës, brenda strukturës organizative të INSTAT-it operon Drejtoria e Anketave pranë Familjeve, e përbërë nga 1 drejtor, 3 përgjegjës sektorësh dhe 10 specialistë. Ky numër punonjësish shikohet si i mjaftueshëm për të mbuluar aktivitetet statistikore që do të zbatohen gjatë viteve 2012-2015.

Sektori i Nivelit të Jetesës ka për objektiv kryesor që në mbështetetje të kërkesave të Programit Kombëtar Statistikor, të organizojë punën për kontrollin, analizën dhe prodhimin e treguesve statistikore të familjeve dhe individëve. Sektori i Nivelit të Jetesës implementon dhe organizon punën për realizimin e anketave pranë familjeve lidhur me nivelin e jetesës, shpenzimet për konsum dhe të ardhurat e tyre. Realizimi i këtyre anketave presupozon punën për të gjithe fazat që nga pergatitja e pyetsorit, testimi në terren, përgatitja e manualit të anketuesve, trajnimi i tyre, organizimi dhe supervizimi i punës ne terren, trajnimi dhe supervizimi i kontrollorëve dhe operatorëve për hedhjen e të dhënave, editimi i file-it për t'a sjellë ne formën finale, të gatshme për përpunim, nxjerrja e rezultateve të parashikuara nga PSZ dhe përgatitja e materialeve bazuar në këto të dhëna për botimet e përgjithshme, periodike të INSTAT-it si dhe analiza nëpërmjet botimeve specifike të vetë sektorit për

publikun e gjerë. Gjithashtu, sektori përpunon informacion sipas kërkesave të përdoruesve lidhur me të dhënat që disponon për aspekte të ndryshme të nivelit të jetesës të familjeve sipas kërkesave të bëra në INSTAT. Gjithashtu ky sektor bashkëpunon ngushtësisht me *Sektorin e Menaxhimit të Anketave pranë Familjeve* i cili ka për detyrë të koordinimin dhe kontrollin e punës për intervistat e kryera në terren. Në bashkëpunim të ngushtë me sektorët përgjegjës të anketave ndihmon që në nisjen e fazës përgatitore të anketës me organizimin e punës në terren, kujdeset për aspektet logjistike siç janë printimi i pyetësorëve, shpërndarja e punës mes anketuesve. Gjithashtu, sektori kujdeset për sigurimin dhe plotësimin në mënyrë të saktë të dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e anketës, si konfirmimin e buxhetit, rregullshmërinë dhe zbatueshmërinë e kontratave të lidhura me anketuesit, përgatitjen e raporteve periodike për ecurinë e intervistimeve. Në bashkëpunim me specialistët, kontrollorët brenda këtij sektori do të kryejnë kontrollin fizik të zbatimit të anketës duke takuar intervistuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ballafaquar plotësimin e pyetësorëve.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Hartimi i projekt-programit të ri të Statistikave Zyrtare për periudhën 2012-2016.
- Në kuadër të hartimit të projekt-programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare, në mënyrë që sistemi statistikor të prodhojë një gamë sa më të gjerë treguesish socialë në Shtator të vitit 2012 do të realizohet Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës e cila do të na furnizojë me të dhëna jo vetëm në nivel 4 Rajonesh por edhe në nivel Prefekture.
- Modifikim dhe përshtatja e pyetësorit duke ruajtur krahasueshmërinë ndër vite dhe duke na mundësuar dhënien e një panorame reale të karakteristika të ndryshme socio-ekonomike të familjeve shqiptare.
- Hartimi i memorandumeve të bashkëpunimit mes institucioneve asistuese si dhe të përfshira në programin pesëvjeçar të statistikave zyrtare për format dhe afatet e shkëmbimit të të dhënave pranë familjeve;
- Zhvillimi i trajnimeve të personelit të INSTAT-it si dhe agjencive të tjera statistikore.
- Përmiresimi i treguesve mbi të ardhurat, konsumit, kushteve të banimit, shëndetësisë, arsimit etj.
- Përfshirja e një moduli të ri në anketën e Matjes së nivelit të Jetesës me treguesit kryesorë të Anketës së Nivelit të Jetesës dhe Përfshirjes Sociale (EU-SILC).

Aktivitet zbatuese afatmesme

- Në kuadër të hartimit të projekt-programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare duke filluar nga viti 2013, INSTAT ka parashikuar kryerjen e Anketës së Buxhetit të Familjes me baza tre mujore.
- Bazuar në rezultatet e arritura nga ndërtimi i një baze të plotë të dhënash, do të përgatitet një publikim i cili do të përmbajë rezultatet, metodologjine dhe disa analiza referuar anketave në vite të Matjes së Nivelit të Jetesës.
- ABF do të vazhdojë të përmirësohet sipas rekomandimeve dhe udhëzimeve të EUROSTAT-it.
- Përmirësim i vazhdueshëm i metodologjisë së llogaritjeve, publikimit të të dhënave;
- Rritja e bashkëpunimit me agjencitë e tjera statistikore për përmirësimin e

treguesve.

- Studime të vazhdueshme mbi praktikat e ndjekura nga vendet e tjera.

Efektet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**2.060.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	1.350.000	0	0	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	710.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.18.2. STATISTIKAT E MJEDISIT

Objektivi Stratetgjik

Objektivi kryesor i statistikave të mjedisit është të ndërtojë statistika krahasuese, të besueshme dhe të përshtatshme. Statistikat e mjedisit sigurojnë informacion të përgjithshëm dhe specifik mbi mjedisin, në periudha vjetore në nivel kombëtar. Ky informacion sigurohet nëpërmjet burimeve administrative institucionale (Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave si dhe nga Ministria Puneve Publike dhe Transportit). Puna për grumbullimin, miratimin dhe diseminimin e të dhënave mbi mjedisin si dhe përcaktimi dhe zhvillimi i indikatorëve do të organizohen në kuadër të Programit të Ri te Statistikve Zyrtare 2012-2016.

Ky objektiv do të sigurohet nëpërmjet:

- Pasqyrimit të drejtë dhe të saktë në programin statistikor të variablave të kërkuar, të treguesve të prodhuar, kostos dhe burimeve të sigurimit;
- Forcimi i marrëdhënieve institucionale me ministritë dhe institucionet prodhuese të këtyre statistikave;
- Forcimit të kapaciteteve administrative në INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e statistikave ekzistuese;

Situata aktuale

INSTAT publikon të dhëna të cilat mblidhen në rrugë administrative nga MMPAU mbi mjedisin, cilësinë e ujrave të ëmbla dhe të kripura në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe mbi pyjet. Nga MPPT të dhënat që mblidhen janë mbi mbetjet dhe substancat e rrezikshme. Për mbetjet e ngurta urbane dhe inerte, të dhënat që grumbullohen janë për Mbetjet Urbane (në 000 ton/vit), Mbetjet Urbane për banor (në ton/vit) dhe Mbetjet Inerte (në 000 ton/vit).

Baza ligjore dhe përafrim i legjislacionit

Referohu bazës ligjore të Kapitullit 18

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në sigurimin e informacionit statistikor mbi statistikat e mjedist janë: Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave dhe Ministria e Puneve Publike dhe Telekomunikacionit. Ministria e mjedist është përgjegjëse për të dhënat administrative të mjedisit, të listuara më lartë dhe të cilat dërgohen në INSTAT, keto të dhëna merren me baza vjetore. Ministria e Transportit është përgjegjëse për të dhënat mbi mbetjet dhe substancat e rrezikshme ë cilat dërgohen në INSTAt me baza vjetore.

Masat legjislative Afatshkurtra

- Projektligji mbi disa ndryshime në ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për statistikat zyrtare". Ky projektligj do të përafrojë pjesërisht Direktivën 95/46/KE dt. 24 Tetor 1995, Rregulloren nr.223/2009/PE dhe KE "Për statistikat Evropiane" dhe shfuqizimin e Rregullores (KE, Euratom) nr.1101/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për transpetimin e të dhënave konfidenciale statistikore që i sigurohen Zyrave Statistikore të vendeve të Komuniteteve Evropiane, rregulloren e Këshillit Nr.322/97 "Për Statistikat komunitare"', Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom "Për krijimin e Komitetit për Programet statistikore të Komuniteteve Evropiane", Rregulloren nr 45/2001 datë 18 Dhjetor 2000 "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga ana e institucioneve dhe organeve komunitare dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave";
- Projektligji "Për menaxhimin e integruar të rezervave ujore", i cili do të përafrojë direktivën kuadër 2000/60/KE të Parlamentit dhe Keshillit të Europes nëfushën e politikave te ujit;[94]
- Projekt Vendimet e Këshillit të Ministrave "Mbi sistemin e integruar të monitorimit mjedisor" dhe "Për miratimin e rregullores mbi zonat bio-gjeografike, zonat e monitorimit dhe treguesit mjedisorë". Këto dy akte do të transpozojnë direktivat 86/278/KEE, direktiva për mbrojtjen e mjedisit dhe në veçanti të tokës nga llumrat e ujërave të zeza kur ato përdoren në bujqësi 91/271/KEE[95], direktiva për trajtimin e ujërave urbane dhe direktivën 98/15/KE e datës 27 shkurt 1998 që amendon direktivën 91/271/KEE[96]. Direktiva e trajtimit të mbetjeve nga ujërat 91/414/KEE.[97] Direktiva mbi produktet biologjike të hedhura në treg 98/8/KE e datës 24 prill 1998,[98] Direktivën kuadër të ujit 2000/60/KE të Parlamentit dhe Këshillit të Evropës në fushën e politikave të ujit[99]. Direktiva për trajtimin e ujërave për larje 2006/7/KE e datës 15 shkurt 2006,[100] direktiva për ndotjen e shkaktuar nga disa substanca të rrezikshme të shkarkuara në mjedisin ujor të komunitetit 2006/11/KE e datës 15 shkurt 2006,[101] direktiva për cilësinë e ujërave të freskët e nevojshme për mbrojtjen

[94] Celex nr 32000L0060, FZ L 327, 22.12.2000, fq. 1–73
[95] Celex nr 31986L0278, FZ L 181, 4.7.1986, fq. 6–12
[96] Celex nr 31998L0015; FZ L 67, 7.3.1998, fq. 29–30
[97] Celex nr 1991L0414
[98] Celex nr 31998L008, FZ L 175, 10.7.1999, fq. 83
[99] Celex nr 32000L0060, *FZ* L 327, 22.12.2000, fq. 1–73
[100] Celex nr 32006L0007, FZ L 64, 4.3.2006, fq. 37–51
[101] Celex nr 32006L0011, FZ L 64, 4.3.2006, fq. 52–59

dhe përmirësim për të zhvilluar jetën e peshkut 2006/44/KE të datës 6 shtator 2006.[102] Direktiva për ujërat nëntokësore 2006/118/KE e datës 12 dhjetor 2006,[103]direktiva për standartet e cilësisë së mjedisit në ujë 2008/105/KE e datës 16 dhjetor 2008.[104] Direktiva për kontrollin dhe parandalimin e ndotjes industriale 2008/1/KE e datës 15 janar 2008.[105]Direktiva për kontrollin e shkarkimeve industriale 2010/75/EU e datës 24 nentor 2010.[106]Direktiva kuadër për mbrojtjen e tokës 2006/232 e datës 22 shtator 2006; COM(2006) 232; Rregullorja (KE), 166/2006 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 18 janar 2006 në lidhje me krijimin e një regjistri për shkarkimet dhe transferimet e ndotësve.[107] Direktiva për mbrojtjen dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti 87/217/KE e datës 19 mars 1987. [108] Vendimi 97/101/KE e datës 27 janar 1997 për shkëmbim informacioni dhe të dhënash për cilësinë e ajrit.[109] Direktiva për metodat kampionime dhe metodat e analizave për kontrollin zyrtar të niveleve të patulineve në ushqimore 2003/87/KE e datës 11 gusht 2003.[110] Direktiva 2008/50/EC e datës 21 maj 2008, direktiva kuadër "Për cilësinë e ajrit".[111] Direktiva "Për mbrojtjen e punonjësve nga asbesti' 2009/148/KE e datës 30 nëntor 2009 [112];

- Projekt Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë "Për miratimin e programit të statistikave zyrtare për periudhën 2012-2016". Ky projekt-vendim do të përafrojë pjesërisht: Rregulloren nr. 223/2009/EP dhe KE "Për statistikat Evropiane dhe shfuqizimin e Rregullores Nr. 1101/2008 të Parlamentit të Evropës dhe Këshillit për transmetimin e të dhënave konfidenciale nga Zyrat e Statistikave të Komuniteteve të Evropës, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr.322/97 për Statistikat Komunitare, dhe Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom për ngritjen e një Komiteti për Programet e Statistikave të Komuniteteve të Evropës"[113]; Direktivën 95/46/KE dt. 24 Tetor 1995 "Për mbrojtjen e individëve për shkak të përpunimit të të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave"; Rregulloren (KE) 45/2001 dt. 18 Dhjetor 2000;
- Projekt VKM "Për normat e cilësisë së mjedisit për ujrat sipërfaqësorë"

Aktivitetet zbatuese

- Hartimi i një memorandumi bashkëpunimi midis MMPAU mbi të dhënat administrative që INSTAT mbledh nga ky institucion dhe nga institucionet e tjera në varësi të saj;
- Hartimit i një memorandumi bashkepunimi me Bashkinë e Tiranës[114] për të bërë të mundur mbledhjen e informacionit në nivel bashkie si dhe realizimin e anketave të reja për të prodhuar statistika të mjedisit të cilat nuk janë prodhuar ndonjëherë në

[102] Celex nr 32006L0044, FZ L 264, 25.9.2006, fq. 20–31
[103] Celex nr 32006L0118, FZ L 372, 27.12.2006, fq. 19–31
[104] Celex nr 32008L0105, FZ L 348, 24.12.2008, fq. 84–97
[105] Celex nr 32008L0001, FZ L 24, 29.1.2008, fq. 8–29
[106] Celex nr 32010L0075, FZ L 334, 17.12.2010, fq. 17–119
[107] Celex nr 32006R016; *FZ* L 26, 31.1.2006, fq. 7–8
[108] Celex nr 31987L0217, FZ L 85, 28.3.1987, fq. 40–45
[109] Celex nr 31997D0101, FZ L 35, 5.2.1997, fq. 14–22
[110] Celex nr 32003L0078, FZ L 203, 12.8.2003, fq. 40–44
[111] Celex nr 32008L0050, FZ L 152, 11.6.2008, fq. 1–44
[112] Celex nr 32009L0148, FZ L 330, 16.12.2009, fq. 28–36
[113] Celex nr 32009R0223, *FZ L 87, 31.3.2009, fq. 164–173*
[114] Në fillim do të hartohet memorandumi me Bashkinë e Tiranë dhe më vonë do të hartohet me bashkitë e tjera ne vend.

Shqipëri.

- Në kuadër të hartimit të projekt-programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare, në mënyrë që sistemi statistikor të prodhojë një gamë sa më të gjerë treguesish për të kënaqur interesat e sa më shumë përdoruesve, do të zhvillohen takime me grupet e interesit, do të merren opinione si dhe do të hartohen parashikimet buxhetore përkatëse për kryerjen e aktiviteteve.
- Hartimi i memorandumeve të bashkëpunimit mes institucioneve të përfshira në programin pesëvjeçar të statistikave zyrtare për format dhe afatet e shkëmbimit të të dhënave statistikore;
- Zhvillimi i trajnimeve të personelit të INSTAT-it si dhe agjencive të tjera statistikore.
- Regjistrimi i Përgjithshëm i Bujqësisë;
- Sigurimi i të dhënave mjedisore për cilësinë e ajrit, ujërave sipërfaqësorë, zonave të mbrojtura, sektorin pyjor, biodiversitetin, mbetjet urbane dhe inerte.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), bazuar në ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, do të hartojë Manualin e njësuar të Kontrollit të Produkteve Ushqimore.
- Trajnimi i personelit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në lidhje me aktet e reja ligjore/ nënligjore në fushën e sigurisë ushqimore.
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit do të zhvillojë një dokument procedurash për vlerësimin e impaktit të inspektimeve dhe kontrolleve në rritjen e sigurisë ushqimore.
- Zbatimi i projektit "Zhvillimi i sistemit të sigurisë ushqimore" financuar nga SNV (Agjencia e Ndihmës e Holandës), për periudhën 2013 – 2014.
- informimi dhe ndërgjegjësimi i prodhuesve dhe tregtuesve mbi kërkesat ligjore/ nënligjore mbi cilësinë dhe sigurinë ushqimore nga AKU.

Efektet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**2.060.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	1.350.000	0	0	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	710.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.18.3. STATISTIKAT MAKROEKONOMIKE

3.18.3.1. LLOGARITË KOMBËTARE VJETORE: VLERËSIMI I PBB-SË ME METODËN E PRODHIMIT

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesor i statistikave të llogarive kombëtare vjetore është vlerësimi në nivel kombëtar i treguesve të Llogarive Kombëtare, sipas metodës së Prodhimit, me çmime

korrente e konstante, shtimi i treguesve të tjerë si dhe përmirësimi i burimeve dhe metodologjisë për konsolidimin e mëtejshëm të llogarive kombëtare vjetore dhe përafrimin gjithnjë e më tepër të tyre me standardet e BE-s (SNA 1993/ESA 1995), për të siguruar cilësinë e tyre e sidomos dy nga karakteristikat kryesore të cilësisë siç janë, saktësia dhe koha sa më e shkurtër e vlerësimit te tyre.
Burimet kryesore të marrjes së informacionit u referohen regjistrimeve të përgjithshme, vrojtimeve statistikore mbi ndërmarrjet, familjet, arkivave statistikore e administrative, me qëllim të gjithëpërfshirjes dhe integrimit të të gjitha burimeve ekzistuese në dispozicion.

Ky objektiv do të sigurohet nëpërmjet:

- Pasqyrimit të drejtë dhe të saktë në programin e ri statistikor të treguesve të prodhuar;
- Implementimit të vazhdueshem të metodologjive të rishikuara të llogaritjes së agregatëve të Llogarive Kombëtare mbeshtetur në manualet dhe rregulloret e vazhdueshme që miraton Eurostat në këtë fushë statistikore;
- Publikimi në nivel më të detajuar në vitet në vazhdim duke kaluar nga klasifikimi A7 në A31 dhe më pas në A60;
- Llogaritja e treguesve të rinj si Inputet e punës dhe Produktiviteti, tregues të cilët janë të lidhur ngushtë me vlerësimin e llogarive vjetore kombëtare;
- Implementimi i NACE Rev.2 në llogaritë kombëtare vjetore. Programi i ri statistikor duhet të ketë parasysh implementimin e klasifikimit të ri të aktiviteteve ekonomike NACE Rev.2, i cili do të çojë në revizionimin e të gjithë burimeve të informacionit;
- Forcimit të kapaciteteve në INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e statistikave ekzistuese të Llogarive Kombëtare.

Situata aktuale

Llogaritë Kombëtare Vjetore luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave ekonomike dhe janë baza e informacionit për të treguar zhvillimin dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë së një vendi. INSTAT, publikon vlerësimet e Produktit të Brendshëm Bruto sipas metodës së Prodhimit, me çmime korrente dhe konstante. Kjo metodë realizohet në mënyrë të pavarur dhe është konsideruar si më e mira për vlerësimin e PBB-së pasi bazohet në një numër të madh burimesh informacioni, gjë që lejon aplikimin e metodave direkte të llogaritjes së treguesve.

Në vitet e fundit është bërë një punë intensive në fushën e statistikave të llogarive kombëtare për përmirësimin dhe shtimin e treguesve makroekonomike në përputhje me kërkesat dhe standartet evropiane. Që prej Marsit 2010, Llogaritë Kombëtare Shqiptare asistohen nga projekti IPA 2007 Kombëtar. Një prej objektivave të këtij projekti konsiston në përmirësimin e burimeve të të dhënave dhe metodologjisë së vlerësimit të Llogarive Kombëtare Vjetore, në përputhje sa më të të plotë me parimet e aplikuara në Sistemin Evropian të Llogarive (ESA 95) dhe SNA 93, konkretisht vlerësimi i Produktit të Brendshëm Bruto.

Baza ligjore dhe përafrim i legjislacionit

Referohu bazës ligjore të Kapitullit 18

Struktura institucionale

Llogaritë vjetore bazohen kryesisht në shfrytëzimin e të dhënave të dala nga vrojtimet statistikore dhe burimet administrative si psh Llogaritë Vjetorë të njësive ekonomike jo-bujqesore, statistikat e bujqësisë, të punësimit dhe në statistikat e njësive ekonomike familjare. Kryesisht, INSTAT, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë janë furnizuesit kryesorë të informacionit për përpilimin e llogarive vjetore. Për fusha të pambuluara me informacion është e nevojshme të mbështetemi në vlerësime të ndryshme.

Masa legjislative afatshkurtra

- Projektligji mbi disa ndryshime në ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për statistikat zyrtare". Ky projektligj do të përafrojë pjesërisht Direktivën 95/46/KE dt. 24 Tetor 1995, Rregulloren nr.223/2009/PE dhe KE "Për statistikat Evropiane" dhe shfuqizimin e Rregullores (KE, Euratom) nr.1101/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për transpetimin e të dhënave konfidenciale statistikore që i sigurohen Zyrave Statistikore të vendeve të Komuniteteve Evropiane, rregulloren e Këshillit Nr.322/97 "Për Statistikat komunitare"', Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom "Për krijimin e Komitetit për Programet statistikore të Komuniteteve Evropiane", Rregulloren nr 45/2001 datë 18 Dhjetor 2000 "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga ana e institucioneve dhe organeve komunitare dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave";
- Projekt Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë "Për miratimin e programit të statistikave zyrtare për periudhën 2012-2016". Ky projekt-vendim do të përafrojë pjesërisht: Rregulloren nr. 223/2009/EP dhe KE "Për statistikat Evropiane dhe shfuqizimin e Rregullores Nr. 1101/2008 të Parlamentit të Evropës dhe Këshillit për transmetimin e të dhënave konfidenciale nga Zyrat e Statistikave të Komuniteteve të Evropës, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr.322/97 për Statistikat Komunitare, dhe Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom për ngritjen e një Komiteti për Programet e Statistikave të Komuniteteve të Evropës"[115]; Direktivën 95/46/KE dt. 24 Tetor 1995 "Për mbrojtjen e individëve për shkak të përpunimit të të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave"; Rregulloren (KE) 45/2001 dt. 18 Dhjetor 2000;

Aktivitetet zbatuese

- Hartimi i projekt-Programit të ri të Statistikave Zyrtare për periudhën 2012 – 2016;
- Vlerësimi dhe publikimi i treguesve ekzistues me çmime korrente dhe konstante, duke përmirësuar cilësinë e llogaritjes së tyre mbështetur në rekomandimet e eksperteve në kuadrin e projektit IPA 2007 Kombëtar;
- Përmirësim i vazhdueshëm i burimeve të informacionit dhe metodologjisë së llogaritjeve te ekonomise se pavrojtuar;
- Rritja e bashkëpunimit me Institucione të tjera për shfrytëzim sa më më mirë të burimeve administrative;
- Vazhdimi i vlerësimeve të komponentëve të PBB-së me metodën e Prodhimit, duke

[115] Celex nr 32009R0223, *FZ L 87, 31.3.2009, fq. 164–173*

shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme të informacionit, përfshirë këtu edhe Regjistrimin e Përgjithshëm i Njësive ekonomike Jo-bujqësore 2010, Censusit te Popullsise dhe Banesave 2011 dhe Regjistrimit te Njesive ekonomike Bujqesore 2012;
- Studime të vazhdueshme mbi praktikat e ndjekura nga vendet e tjera.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Ngritja e një Grupi Pune për të studiuar mundësinë e ndërtimit të një baze të dhënash unike me përmbajtjen e treguesve të pasqyrave financiare të subjekteve që veprojnë në vëndin tonë;
- Përmirësimi i metodologjisë mbështetur në konceptet dhe SNA 1993/ESA 1995, për të pasur statistika të dobishme dhe të krahasueshme me vendet europiane;
- Vlerësimi i PBB-së me çmime konstante me anë të deflatimit të dyfishtë duke përmirësuar matjet në volum dhe në çmim të llogarive kombëtare.
- Publikimi në nivel më të detajuar në vitet në vazhdim duke kaluar nga klasifikimi A7 në A31 dhe më pas në A60 si dhe prodhimin i të dhënave të llogarive kombëtare në kohë më të shkurtër;
- Implementimi i nomenklaturës së aktiviteteve NACE Rev.2 në llogaritë kombëtare vjetore dhe hartimi i treguesve të rinj si të inputit të punës sipas aktivitetit ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal sipas tipit të punësimit dhe matjes së produktivitetit në përputhje me metodologjinë dhe legjislacionin e BE-së.

3.18.3.2. VLERËSIMI I PBB-SË ME METODËN E SHPENZIMEVE

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesor është vlerësimi në nivel kombëtar i treguesve të statistikave të Llogarive Kombëtare, sipas metodës së Shpenzimeve, me çmime korrente e konstante duke synuar koherencën me konceptet e Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA-93) dhe Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare (ESA-95) si dhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna për zhvillime të mëtejshme të Llogarive Kombëtare.
Nëpërmjet integrimit të informacionit statistikor ekzistues mbi sistemin ekonomik e social të vendit, aplikimit të kombinuar me metodat bilancuese, realizohen vlerësime mbi komponentë të veçantë të përdorimeve finale të PBB-së konkretisht, formimin bruto të kapitalit, konsumin final (të popullatës, administratës publike e IJFP) si dhe shkëmbimet neto të produkteve e shërbimeve me botën e jashtme. Me anë të këtyre vlerësimeve, synohet llogaritja e pavarur, me rrugë statistikore e PBB, sipas kësaj metode.
Ky objektiv do të sigurohet nëpërmjet:
- Pasqyrimit të drejtë dhe të saktë në programin e ri statistikor të treguesve të prodhuar.
- Forcimit të kapaciteteve në INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e stastikave ekzistuese të Llogarive Kombëtare;
- Implementimit në mënyrë të vazhdueshme të metodologjive të rishikuara të llogaritjes së agregatëve të Llogarive Kombëtare mbështetur në manualet dhe rregulloret e vazhdueshme që miraton Eurostat në këtë fushë statistikore.

Situata aktuale

INSTAT, publikon vlerësimet e Produktit të Brendshëm Bruto sipas metodës së Shpenzimeve, me çmime korrente dhe me çmimet e vitit të kaluar. Këto vlerësime nuk realizohen në mënyrë të pavarur për të gjithë komponentët përbërës. Disa prej komponentëve vlerësohen në mënyrë direkte, si Eksportet Neto, Konsumi Final i Administratës Publike dhe Konsumi Final i Institucioneve Jo-Fitimprurëse që i shërbejnë Familjeve (shkurt IJFPSF). Konsumi Final i Popullatës vlerësohet duke përdorur një sërë treguesish të integruar që rezultojnë nga metoda e prodhimit. Vlerësimi i Produktit të Brendshëm Bruto sipas metodës së Shpenzimeve në mënyrë të pavarur është gjithashtu një nga objektivat kryesore të projektit IPA-2007 (Komponenti Llogaritë Vjetore) për të cilën janë kryer një seri punimesh që do të finalizohen me përfundimin e projektit.

Baza ligjore dhe përafrim i legjislacionit

Referohu bazes ligjore të Kapitullit 18

Struktura institucionale

Kryesisht INSTAT, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë janë furnizuesit kryesor të informacionit për vlerësimin e Produktit të Brendshëm Bruto sipas metodës së Shpenzimeve. Për fusha të pambuluara me informacion është e nevojshme të mbështetemi në vlerësime të ndryshme. Për vlerësimin e PBB-së me metodën e shpenzimeve, pranë INSTAT funksionojnë në bashkëpunim Sektori i Llogarive Kombëtare Vjetore dhe Sektori i Llogarive të Sektorëve Institucionalë. Këta sektorë operojnë brenda Drejtorisë së llogarive Kombëtare dhe janë të përbërë përkatësisht me 4 dhe 3 punonjës.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Në kuadër të përmirësimit të metodologjisë së Llogarive Kombëtare vjetore, metoda e shpenzimeve, do të zhvillohen këto aktivitete kryesore:

- Analiza e komponentëve kryesorë të llogarites së PBB me metodën e Shpenzimeve. Në këtë kuadër, do të analizohen rezultatet ekonomike të Rregjistrimit të Përgjithshëm të Njësive ekonomike Jo-bujqësore, të cilat do të lejojnë realizimin e aktiviteteve të mëposhtme:
    - Vlerësimi i Investimeve dhe Ndryshimeve në Inventar bazuar në të dhëna komplete dhe direkte nga njësitë ekonomike;
    - Vlerësimi i konsumit final të Institucioneve Jo-Fitimprurëse në shërbim të familjeve (shkurt IJFPSF) për vitin 2009 dhe ndërtimi i një metode vlerësimi për vitet në vazhdim.
- Përmirësimi metodologjik i vlerësimeve aktuale. Aktiviteti do të fokusohet kryesisht në përmirësimet metodologjike të gjithë komponentëve të Produktit të Brendshëm Bruto me metodën e Shpenzimeve, konkretisht:
    - Vlerësimi i Formimit Bruto të Kapitalit Fiks, me çmime korrente dhe

konstante;
  - Ballafaqimi i burimeve ekzistuese për llogaritjen e Konsumit të Familjeve;
  - Vlerësimi i Konsumit të Administratës Publike me çmimet e vitit bazë dhe me çmimet e vitit paraardhës;
  - Vlerësimi i Ndryshimeve në Inventar.
- Plotësimi i informacionit të nevojshëm për llogaritjen e komponentit të Eksporteve Neto 2009;
- Rritja e bashkëpunimit me institucione të tjera për shfrytëzim sa më të mirë të burimeve administrative;
- Studime të vazhdueshme mbi praktikat e ndjekura nga vendet e tjera.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Përmirësimi i burimeve statistikore apo administrative të informacionit si bazë e nevojshme për analizën e komponentëve kryesorë të llogaritjes së PBB-së me metodën e Shpenzimeve;
- Shfrytëzimi i rezultateve nga Rregjistrimi i njësive Bujqesore;
- Përmirësim i vazhdueshëm i metodologjisë së llogaritjeve, publikimit të të dhënave.

3.18.3.3. LLOGARITË VJETORE TË SEKTORËVE INSTITUCIONAL

Objektivi Stratetgjik

Objektivi kryesor i llogarive vjetore sipas sektorëve institucionalë është vlerësimi dhe analiza në nivel kombëtar i llogarive vjetore, duke dhënë një paraqitje të plotë të transaksioneve jo-financiare për çdo sektor institucional të ekonomisë, kryesisht për Familjet, Qeverinë, Ndërmarrjet (Financiare dhe jo-Financiare) dhe pjesën tjetër të Botës, realizuar kjo nëpërmjet integrimit të informacionit statistikor ekzistues mbi sistemin ekonomik e social të vendit dhe aplikimit të kombinuar të metodave balancuese, duke synuar koherencën e plotë me konceptet e SNA-93 (ESA-95). Burimi kryesor i marrjes së informacionit i referohet regjistrimeve të përgjithshme, vrojtimeve statistikore mbi familjet, ndërmarrjet, arkivave statistikore e administrative, me qëllim të përfshirjes dhe integrimit të të gjitha burimeve ekzistuese në dispozicion.

Ky objektiv do të sigurohet nëpërmjet:
- Pasqyrimit të drejtë dhe të saktë në programin e ri statistikor të treguesve të prodhuar.
- Forcimit të kapaciteteve në INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e stastikave ekzistuese të Llogarive Kombëtare;
- Implementimit të vazhdueshem të metodologjive të rishikuara të llogaritjes së agregatëve të Llogarive Kombëtare mbeshtetur ne manualet dhe rregulloret e vazhdueshme që miraton Eurostat në këtë fushë statistikore.

Situata aktuale

Një prej objektivave të projektit IPA-2007, konsiston në zhvillimin për herë të parë të

Llogarive Vjetore sipas sektorëve institucionalë, duke zhvilluar një sistem të thjeshtuar, i cili do të realizojë kalimin e treguesve ekonomik ekzistues nga burime të ndryshme, në koncepte të Llogarive Kombëtare për sektorët institucionalë. Synohet të arrihet ndërtimi i dy prej llogarive kryesore, llogaria e Prodhimit dhe llogaria e të Ardhurave, në përputhje të plotë me parimet e balancimit të aplikuara në Sistemin europian të Llogarive (ESA 95) dhe SNA 93.

Baza ligjore dhe përafrim i legjislacionit

Referohu bazës ligjore të Kapitullit 18

Struktura institucionale

Llogaritë e sektorëve Institucionalë bazohen kryesisht në Llogaritë vjetorë të njësive institucionale ekonomike (Jo-financiare, Financiare, Qeveria, Familjet, institucionet jo-fitimprurëse në shërbim të familjeve, Familjet), statistikat e pagave, statistikat e Bilancit të Pagesave, etj. Aktivitetet statistikore të këtyre fushave mbulohen nga Sektori i Llogarive të Sektorëve Institucionalë (3 specialistë). Kryesisht, INSTAT, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë janë furnizuesit kryesorë të informacionit për përpilimin e llogarive sektoriale. Për fusha të pambuluara me informacion është e nevojshme të mbështetemi në vlerësime të ndryshme, me origjinë burime administrative, vrojtime statistikore, studime, etj.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Në kuadër të vlerësimit të llogarive vjetore sipas sektorëve institucionalë, do të zhvillohen këto aktivitete kryesore:

- Hartimi i projekt-Programit të ri të Statistikave Zyrtare për periudhën 2012 – 2016;
- Klasifikimi i njësive institucionale në sektorë institucionalë;Të gjitha njësitë ekonomike që operojnë në aktivitetin ekonomik do të analizohen dhe klasifikohen në sektorë institucional, duke u grupuar në:
    - Njësitë Jo-financiare
    - Njësitë Financiare
    - Qeveria
    - Familjet
    - Institucionet Jo-fitimprurëse në shërbim të familjeve
    - Bota e Jashtme
- Përpilimi i llogarisë së Prodhimit sipas sektorëve Institucionalë.

Treguesit e nevojshëm për llogarinë e prodhimit janë: Prodhimi (tregëtar, për përdorim vetjak, prodhim jo-tregëtar), Konsumi Ndërmjetës, Taksat mbi produktet, Subvencionet mbi produktet dhe Vlera e Shtuar. Këta tregues do të paraqiten sipas sektorëve institucional.

Vlerësimet do të behen me çmime korrente.

- Përpilimi,i llogarisë së të ardhurave sipas sektorëve Institucionalë.

Treguesit kryesorë të kësaj llogarie (Kompensimi i punonjësve, taksat mbi prodhimin dhe importet, subvencionet dhe teprica bruto operative) do të paraqiten sipas sektorëve institucionalë. Vlerësimet do të bëhen më çmime korrente.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Rishikimi i përmbajtjes aktuale të Memorandumeve të Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe institucioneve të saj vartëse (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, etj), pas vlerësimit të të dhënave që disponojnë institucionet, në mënyrë që t'i përshtaten metodologjisë së kohës si dhe të formalizojnë shkëmbimin e këtyre të dhënave.
- Hartimi i një Memorandumi Bashkëpunimi me Autoritetin e Mbikëqyrjes financiare;
- Përmirësimi i burimeve statistikore apo administrative të informacionit si bazë e nevojshme për analizën e sektorëve Institucional;
- Përmirësim i vazhdueshëm i metodologjisë së llogaritjeve, publikimit të të dhënave;
- Përgatitja e një publikimi ku do të përmbahen rezultatet, metodologjia dhe disa analiza për sektorët institucionalë.
- Rritja e bashkëpunimit me institucionet e ndryshme për shfrytëzim sa më të mirë të burimeve administrative;
- Studime të vazhdueshme mbi praktikat e ndjekura nga vendet e tjera.

3.18.3.4. STATISTIKAT MBI TABELAT BURIM-PËRDORIM DHE INPUT-OUTPUT

Objektivi Strategjik

Objektivi parësor është që të mbledhë, të verifikojë dhe të analizojë një grup të madh treguesish ekonomik me qëllim ndërtimin e tabelave burime-përdorime (shkurt SUT-Termi Angl.) dhe input-output (shkurt IOT-Termi Angl.), për të bërë të mundur sintezën e plotë të sistemit të llogarive kombëtare. Këto tabela japin portretin më të detajuar të ekonomisë, pasi paraqesin hap pas hapi një analizë të detajuar të procesit të prodhimit dhe përdorimit të mallrave dhe shërbimeve dhe të ardhurave të krijuara.

Situata aktuale

Aktualisht INSTAT po punon për vlerësimin dhe ndërtimin e tabelave sintezë të ekonomisë, siç janë tabela e burim-përdorimeve (SUT) dhe tabela input-output (IOT). Aktualisht këto vlerësime janë vetëm në hapat e para të tyre në trajtë eksperimentale për vitet 2008 dhe 2009. Objektivi është që në kuadër të projektit IPA 2007 të arrihet një vlerësim i mirë për vitin 2009, i cili është konsideruar dhe si një vit që do të sigurojë një informacion më të plotë me të dhëna ekonomike. Deri tani janë përpiluar dhe ndërtuar SUT[116] me çmime korente në nivel detajimi 25degë x 25degë për vitet 2008 dhe 2009 të pa balancuara, mbështetur mbi informacionin ekzistues. Janë ndërtuar SUT me çmime konstante në nivel 25 degë x 25 degë

[116] Tabela e burim-përdorimeve

të pa balancuara për vitin 2009. Për këto vlerësime objektivi kryesor ishte gjetja dhe mbledhja e indekseve përkatëse për secilin agregat të SUT si dhe analiza e tyre për të vlerësuar mundësinë e përdorimit të tyre.

Struktura institucionale

Duke qenë se ndërtimi i tabelave burim-përdorim dhe input-output kërkon një informacion mjaft të gjerë dhe të hollësishëm është shumë e nevojshme që edhe institucionet e tjera prodhuese të të dhënave, apo sektorët e INSTAT, jashtë dhe brenda Drejtorisë së Llogarive Kombëtare, të përfshihen në kuadër të këtyre kërkesave. Ndër institucionet më kryesore duhet të përmendim Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
Përgjegjës për ecurinë e përmbushjes së aktiviteteve të veprimtarive për prodhimin e statististikave sipas tabelave burim-përdorim dhe input-output, është Sektori Sintezë i Llogarive Kombëtare, i përbërë nga 3 specialistë. Ky sektor funksionon brenda strukturës së Drejtorisë së llogarive Kombëtare INSTAT.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit mbi marrjen e të dhënave në nivel të detajuar lidhur me librat e shitjeve dhe të blerjeve ndërmjet INSTAT dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Vlerësime eksperimentale në nivele 25 degë x 25 degë të tabelave të burim-përdorim me çmime korente për vitet 2008 dhe 2009 dhe me çmime konstante për vitin 2009;
- Vlerësime eksperimentale në nivele 60 degë x 60 degë të tabelave të burim-përdorim me çmime korente për vitet 2008 dhe 2009;
- Propozime për ndryshimin e strukturës së mbledhjes së informacionit për përbërjen e kostos nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve (ASN). Është e nevojshme që informacioni të merret sipas Nomenklaturës së Produkteve sipas Aktiviteteve Ekonomike Clasification of Product by Activities CPA 2008 ;
- Përpunimi i të dhënave mbi importet dhe eksportet e mallrave në nivel nomenklature të kombinuar të mallrave Combined Nomenclature (CN) dhe kalimi i tyre në nivel nomenklature CPA 2008, Nomenklature të Veprimtarive Ekonomike (Statistical Classification of Economic Activities in the European Community (NACE rev 1.1) në 4 shifror, 2 shifror si dhe në nivel alfabetik 2 shifror;
- Mbledhje më të detajuar të të dhënave mbi importet dhe eksportet e shërbimeve të vlerësuara nga Banka e Shqipërisë dhe grupimi i tyre sipas klasifikimeve ekonomike;
- Grupimi i të dhënave të dala nga Vrojtimi Statistikor mbi Buxhetin e Familjeve (Household Budget Survey HBS) nga niveli i detajuar i nomenklaturës COICOP (Classification of Individual Consumption According to Purpose në klasifikimin ekonomik NACE rev1.1.
- Mbledhje informacioni nga Vrojtimi Strukturor pranë Ndërmarrjeve (Vjetor ose Tremujore për shpërndarjen e marzhit të tregtisë me pakicë dhe shumicë si dhe të marzhit të transportit.
- Marrja e të dhënave vjetore në nivel të detajuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve lidhur me librat e shitjeve dhe të blerjeve të bëra nga çdo ndërmarrje.

- Përdorim i informacionit të marrë nga anekset e pasqyrave financiare për ndërmarrjet që operojnë në sektor të veçantë të ekonomisë, si atë financiar, shëndetësi dhe arsimi privat etj.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Vlerësime përfundimtare në nivele 25 degë x 25 degë të tabelave të burim-përdorim me çmime korente për vitet 2008 dhe 2009 dhe me çmime konstante për vitin 2009;
- Vlerësime eksperimentale në nivele 60 degë x 60 degë të tabelave të burim-përdorim me çmime konstante për vitin 2009, si dhe të tabelave input-output në nivelet 25 degë x 25 degë dhe 60 degë x 60 degë.

3.18.3.5. STATISTIKAT RAJONALE

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesor i statistikave rajonale eshte vlerësimi në përputhje me metodologjine e EUROSTAT, të treguesit të PBB për frymë sipas Nomenklaturës të Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS II) të Bashkimit Europian. Sigurimi i vlerësimit të këtij treguesi vjen si përmbushje e detyrimeve të Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit si dhe në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian si dhe në përputhje me detyrimet e sanksionuara në nenin 37 të Marrëveshjes së Përkohshme (Neni 71 i MSA)[117]. Statistikat Rajonale sigurojnë informacion statistikor, në periudhë vjetore në nivel rajonal sipas rajoneve statistikore niveli 2 dhe 3.

Ky objektiv do të sigurohet nëpërmjet:

- Pasqyrimit të drejtë dhe të saktë në programin statistikor të variablave të kërkuar, të treguesve të prodhuar, kostos së vrojtimeve statistikore;
- Forcimit të marrëdhënieve institucionale me ministritë dhe agjensitë e tjera statistikore;
- Forcimit të kapaciteteve në INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e statistikave ekzistuese.

Situata aktuale

Aktualisht INSTAT llogarit PBB për frymë sipas Nomenklaturës të Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS II dhe NUTS III) si dhe në termat e Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPS) i cili merr në konsideratë diferencat e çmimeve në Bashkimin Europian.

Në 28 Prill 2011 EUROSTAT konfirmoi propozimin e Institutit të Statistikave të aprovuar nga Këshilli i Ministrave për ndarjen e Shqipërisë në 3 rajone statistikore niveli 2 dhe 12 rajone statistikore niveli 3, që i korrespondojnë prefekturave ekzistuese. Ndarja territoriale

[117] Shqipëria duhet t'i paraqesë Komisionit Evropian shifrat e PBB-së së saj për frymë të harmonizuar në nivelin NUTS II.

statistikore e Republikës së Shqipërisë kryhet në zbatim të VKM-së nr.1037 datë 15.12.2010, "Mbi Implementimin e Nomenklaturës "Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II" sipas nomenklaturës mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Europian", akt i cili është në përputhje të plotë me rregulloren e Komisionit Europian nr 1059/2003 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit Europian më datë 26 maj 2003 mbi vendosjen e klasifikimit të përbashkët të njësive territoriale për statistikat (NUTS).
Prodhimi i statistikave rajonale ekonomike ka rëndësi të madhe për vendimmarrjen në nivel kombëtar, si dhe për politikën rajonale të BE – së në funksion të alokimit të fondeve strukturore për zhvillim.
Vlerësimi i Llogarive Rajonale bazohet në burimet e disponueshme të të dhënave ku përfshihen: burime statistikore dhe burime administrative. Llogaritë Rajonale në Republikën e Shqipërisë bazohen në të njëjtat koncepte të ESA '95 si dhe me klasifikimet e NACE Rev 1.1 respektivisht.

Baza ligjore dhe përafrim i legjislacionit

- VKM nr.1037 datë 15.12.2010, "Mbi Implementimin e Nomenklaturës "Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II" sipas nomenklaturës mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Europian", përafruar plotësisht me rregulloren e Komisionit Europian nr 1059/2003 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit Europian më datë 26 maj 2003 mbi vendosjen e klasifikimit të përbashkët të njësive territoriale për statistikat (NUTS).

Struktura institucionale

Procesi i prodhimit të statistikave të llogarive kombëtare në nivel rajoni (NUTS) kryhet nga Sektori i Llogarive Kombëtare të Administratës Publike Qendrore dhe Rajonale, i përbërë nga 3 specialistë të fushës. Ky sektor është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Llogarive Kombëtare INSTAT.

Institucionet e përfshira në sigurimin e informacionit statistikor janë: Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, Ministria e Financës, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare të përfshira në mbledhjen e të dhënave administrative dhe statistikore për treguesit rajonale.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Përgatitja mbi rishikimin e serive kohore me të dhëna të dala, nga regjistrimi i pergjithshëm i ndërmarrjeve;
- Zgjerimi i Anketës Strukturore të Ndërrmarrjeve për informacione të detajuara për njesitë lokale, pagat, punësimin, aktivitetin ndërtimor.
- Ngritja e një grupi pune me institucionet e ndërmjetësimit financiar, Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare, për marrjen e të dhënave më të detajuara rajonale për vlerësimin e sektorit financiar, alokimin e treguesit të Shërbimeve të ndërmjetësimit Financiar matur Indirekt FISIM (Financial Intermediation Services Indirectly Measured)

- Konsolidimi dhe detajimi i të dhënave rajonale të marra nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit mbi detajimin e të dhënave sipas prefekturave.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Financave mbi detajimin e taksave dhe subvencioneve mbi produktet sipas rajoneve statistikore.
- Bashkëpunimi me zyrat rajonale statistikore në rrethe mbi përpunimin e informacionit statistikor.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Vlerësimi i treguesve rajonale duke përdorur të dhënat e Censusit të Popullsisë dhe Banesave 2011, ku do të sigurohen të dhëna të punësimit sipas sektorëve si dhe do të shërbejë si një bazë krahasuese me të dhënat aktuale;
- Alokimi i Vlerës së Shtuar Bruto sipas rajoneve statistikore për sektorin e Bujqësisë dhe Peshkimit me të dhënat e marra nga Censusi i ardhshëm i Bujqësisë;
- Alokim i Vlerës së Shtuar Bruto për ekonominë e pavrojtuar sipas rajoneve statistikore;
- Alokimi i Vlerës së Shtuar Bruto të punonjësve në rajonin ku ata janë residentë;
- Hartimi i një pyetësori për kompanitë multirajonale për identifikimin e njësive lokale, të dhëna mbi pagat, punësimin veçanërisht në degë si energjia, ndërtimi etj.
- Ndërtimi i një database gjithëpërfshirëse për integrimin e të dhënave për nevojat e statistikave rajonale.

Zgjerimet e mëtejshme të treguesve të Llogarive Rajonale do të konsistojnë në:

- Vlerësimin e Formimit Bruto të Kapitalit Fiks sipas rajoneve statistikore niveli 2,3;
- Shpenzimet Rajonale të Qeverisë;
- Ndërtimin e Llogarive të familjeve sipas rajoneve territoriale statistikore;
- Vlerësimin e Vlerës së Shtuar Bruto duke përdorur metodën e të ardhurave sipas rajoneve.

3.18.3.6. ADMINISTRATA PUBLIKE

Objektivi Stratetgjik

Objektivi kryesor i statistikave të Administratës Publike është të ndërtojë statistika krahasuese, të besueshme dhe të përshtatshme duke prodhuar informacione mbi treguesit ekonomikë të sektorit të Administratës Publike në periudha vjetore si dhe periudha tremujore. Ato japin një panoramë të plotë të treguesve makroekonomikë të sektorit të administratës publike. Gjithashtu pjesë e përmirësimeve të sektorit të administratës publike, në kuadrin e projektit IPA 2007 është ndërtimi i të gjitha llogarive të Administratës Publike. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një strukture më të plotë të informacionit makroekonomik të Administratës Publike. Puna për grumbullimin, miratimin dhe diseminimin e të dhënave administratën Publike si dhe përcaktimi dhe zhvillimi i indikatorëve do të organizohen sipas Programit të Ri të Statistikave Zyrtare 2012-2016.

Ky objektiv do të sigurohet nëpërmjet:

- Pasqyrimit të drejtë dhe të saktë në programin statistikor të variablave të kërkuar, të treguesve të prodhuar, kostos dhe kalendarit të publikimit të rezultateve;
- Forcimi i marrëdhënieve institucionale me ministritë dhe institucionet e tjera prodhuese të burimeve administrative (Ministria e Financave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Instituti i Sigurimeve Shëndetsore, Ministritë e linjës);
- Forcimit i kapaciteteve në INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e statistikave ekzistuese.

Situata aktuale

INSTAT përpunon të dhëna të cilat mblidhen në rrugë administrative nga Ministria e Financave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Instituti i Sigurimeve Shëndetsore mbi informacionet kryesore të strukturës së shpenzimeve dhe të ardhurave të sektorit të Administratës Publike. Këto të dhëna përdoren për vlerësimin e PBB sipas metodave të prodhimit e shpenzimeve, nëpërmjet vlerësimit të treguesve të mëposhtëm:

- Prodhimi, Konsumi Ndërmjetës dhe Vlera e shtuar e Administratës Publike, Institucioneve Jo Fitim Prurëse, aktivitetit të arsimit, shëndetësisë (pjesa buxhetore) me çmime korrente e konstante;
- Konsumi final i administratës publike, me çmime korrente e konstante i ndarë në konsum individual dhe kolektiv;
- Llogaritja e taksave mbi produktet, me çmime korrente dhe konstante;
- Llogaritja e subvencioneve mbi produktet me çmime korrente dhe konstante.

Nomenklaturat e përdorura për prodhimin e statistikave të Administratës Publike janë Klasifikimi i Funksioneve të Qeverisë COFOG (Classification of the Functions of Government), Klasifikimi i Veprimtarive Ekonomike Rev1.1 (NACE Rev1.1), Nomenklatura e Llogarive të Planit Kontabël.

Baza ligjore dhe përafrim i legjislacionit

Referohu bazes ligjore te Kapitullit 18

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në sigurimin e informacionit statistikor për hartimin e Statistikave Financiare të Qeverisë (Administratës Publike) janë Ministria e Fimnancave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Instituti i Sigurimeve Shëndetësore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Përmirësimi i bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh me institucionet e mësipërme nëpërmjet përfshirjes në memorandumet e bashkpunimit të nevojave për informacion.

- Ngritja e një grupi pune nga INSTAT në bashkëpunim me Ministrinë e Financave për përcaktimin e sektorëve dhe nën-sektorëve të Administratës Publike, listës nominative të insitucioneve përbërëse përkatëse në administratën publike qëndrore dhe lokale, kodifikimin e klasifikimit ekonomik kontabël drejt kodifikimeve bazuar në kërkesat e Sistemit Evropian të Llogarive (ESA).
- Klasifikimi i sektorëve dhe nën-sektorëve të Administratës Publike sipas standarteve të ESA 95;
- Implementimi dhe përmirësimi i Nomeklaturave të nevojshme midis INSTAT dhe Ministrisë së Financave;
- Informacione të detajuara për strukturën e Klasifikimit Ekonomik Kontabël të përdorur nga Ministria e Financave;
- Ristrukturim i artikujve të Klasifikimit Ekonomik Kontabël sipas Sektorëve Institucionalë me të cilat janë krijuar këto transaksione;
- Ndërtimi i një seri kohore me të dhënat e punësimit në Administratën Publike tremujore dhe vjetore;
- Ndërtimi i një kalendari për transmetimit e të dhënave nga Ministria e Financave drejt INSTAT;
- Ndërtimi i treguesve të Llogarive Kombëtare tremujore të Administratës Publikë;
- Vlerësimi i Taksave dhe Subvencioneve mbi produktet në nivel tremujore.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Ndërtimi i një strukture eksperimentale vjetore të serisë së plotë të llogarive jo-financiare të qeverisë;
- Ngritja e një grupi pune mes INSTAT, Ministrisë së Financave, Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Institutit të Sigurimeve Shëndetësore për përmirësimin e të dhënave aktuale me burime administrative shtesë.
- Ndërtimi i treguesve të Llogarive Kombëtare vjetore të Administratës Publikë;
- Vlerësimi i Taksave dhe Subvencioneve mbi produktet në nivel vjetor;
- Ndërtimi i serisë së plotë të llogarive të sektorit institucional të Administratës Publike;
- Konsolidimi i treguesve të sektorit të Administratës Publike me sektorët e tjerë Institucionalë;
- Vlerësimi i informacioneve të disponueshme me anë të burimeve administrative dhe evidentimi i burimeve shtesë të informacionit për sektorët nën-buxhetorë.
- Mbledhja e të dhënave eksperimentale të konsumit fiks të kapitalit nga struktura e të dhënave të Administratës Publike;
- Përmirësimi i metodave të vlerësimit të Formimit Bruto të Kapitalit Fiks për sektorin e Administratës Publike, bazuar në burimet e reja të të dhënave që do të sigurohen nga Ministria e Financave;
- Trajnim stafi specialist per hartimin e metodologjive bashkekohore
- Përmirësim i sasior dhe cilësor i treguesve statistikorë të Administratës Publike, në kuadër të zbatimit të projektit IPA 2007, i cili ka siguruar asistencën e nevojshme për këtë qëllim.

3.18.3.7. STATISTIKAT E LLOGARIVE KOMBËTARE TREMUJORE

Objektivi Stratetgjik

Sektori i llogarive kombëtare tremujore ka si objektiv kryesor vlerësimin dhe publikimin e PBB-së tremujore me mënyrën e shpenzimeve sipas komponentëve përkatës si dhe vazhdimin e publikimit të treguesve ekzistues duke përmirësuar cilësine e llogaritjes së tyre si dhe shtimin e disa treguesve të tjere në përputhje të plot me konceptet e ESA95 dhe Sistemin e llogarive Kombëtare (System of National Account SNA93) si dhe legjislacionin e BE-së.

Ky objektiv do të sigurohet nëpërmjet:

- Pasqyrimit të drejtë dhe të saktë në Programin Statistikor Zyrtar 2012-2016, të variablave të kërkuar, të treguesve të prodhuar, kostos së vrojtimeve statistikore;
- Forcimit të kapaciteteve në INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e stastikave makroekonomike;
- Forcimit të marrëdhënieve institucionale me Ministritë e linjës, Bankën e Shqipërisë, KESH, ISKSH, për sigurimin në kohë dhe me cilësi të informacionit;
- Implementimin e vazhdueshëm të metodologjive të rishikuara të llogaritjes së PBB-së tremujore, mbështetur në manualet dhe rregulloret e vazhdueshme që miraton Eurostat si dhe rekomandimeve të ekspertëve që asistojnë në kuadër të misioneve të projektit IPA 2007 dhe FMN;
- Implementimin e mënyrave më të avancuara të grumbullimit dhe kontrollit të informacionit për të qënë koherent dhe të saktë në llogaritjen e treguesve duke bërë të mundur të qenit sa më afër plotesimit të kërkesave të përdoruesve të ndryshëm.

Situata aktuale

Sektori i Llogarive Kombëtare Tremujore aktualisht kryen vlerësimin sipas metodës Indirekte dhe publikimin periodik në nivel kombëtar të Produktit të Brendshëm Bruto me çmime bazë (nuk përfshihen taksat dhe subvencionet), sipas metodës së prodhimit, me çmime konstante, viti bazë 2005=100, dhe me çmimet e vitit të mëparshëm, duke përdorur metodën Chain-link (Annual overlap technique). Produkti i Brendshëm Bruto Tremujore publikohet në seri kohore sipas 7 degëve kryesore të ekonomisë të përshtatura dhe jo sezonalisht.
Në kuadër të projektit IPA 2007, komponenti A5, e cila lidhet drejtpërdrejtë me sektorin e llogarive kombëtare tremujore, janë realizuar dy misione që kanë patur si qëllim përmirësimin e cilësisë së treguesve aktualë si dhe vlerësimin e PBB-së tremujore me metodën e shpenzimeve. Një sërë studimesh dhe punimesh eksperimentale janë kryer për vlerësimin dhe përcaktimin e burimeve si dhe aplikimin e metodikave të rekomanduara nga eksperti për vlerësimin e këtij treguesi me metodën e shpenzimeve.
Vlerësimet e këtyre treguesve bëhen duke synuar përmirësimin e metodave ekzistuese dhe potenciale, për vlerësimin sa më të mirë në përputhje me kërkesat e manualëve të ndryshëm ku bazohen këto vlerësime si; (i) EUROSTAT, European System of Accounts (ESA 1995); (ii) International Monetary Fund (IMF), System of National Account (SNA 1993); (iii) EUROSTAT, Handbook on Quarterly National Accounts, 1999; (iv) International Monetary Fund (IMF), Quarterly National Accounts Manual.

Baza ligjore dhe përafrim i legjislacionit

Referohu bazës ligjore të Kapitullit 18

Struktura institucionale

Statistikat e llogarive kombëtare tremujore mbulohen nga një sektor i veçantë brenda strukturës së Drejtorisë së Llogarive Kombëtare INSTAT, i përbërë nga 3 specialistë.
Institucionet e përfshira në sigurimin e informacionit statistikor për vlerësimin e këtyre treguesve janë:

- Ministria e Financave (të dhëna mbi buxhetin e shtetit);
- Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit (të dhëna për sektorin Bujqësor);
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), (të dhënat që deklarojnë subjektet ne formularin e pagesës së TVSH);
- Banka e Shqipërisë, (të dhëna për aktivitetin financiar dhe FISIM);
- Enti Rregullator i Energjitikes dhe KESH, (të dhëna për sektorin energjitik);
- Sektorë të ndryshëm në INSTAT.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Përmirësim i vazhdueshëm i ecurise së punës në drejtimin e mbledhjes dhe kontrrolit të të dhënave, vlerësimit dhe publikimit të serise kohore të PBB-së vlerësuar me mënyrën e prodhimit, me cmime konstante vit bazë 2005 (2005=100) dhe të vitit të mëparshëm duke përdorur metodat statistikore mbështetur në metodologjin përkatëse. Analiza e deflatorëve të përdorur për llogaritjen e PBB-së tremujore me çmime konstante me metodën e prodhimit;
- Analiza, vleresimi dhe përzgjedhja e burimeve të të dhënave që do përdoren për llogaritjen e PBB-së tremujore me metodën e shpenzimeve si dhe përcaktimi i metodologjisë bazuar në këto të dhëna. Vlerësimi i disa komponentëve me metodën e shpenzimeve si; Formimi Bruto i Kapitalit Fiks GFCF(Gross Fixed Capital Formation), Eksportet neto, Konsumi i Administratës Publike i ndarë në konsum individual dhe kolektiv.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Hartimi i memorandumit të bashkëpunimit me Institutin e Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor për përmirësimin e treguesve tremujorë për degën e shëndetësisë;
- Vlerësimi dhe publikimi i komponentëve me metodën e shpenzimeve si: Konsumi individual i popullsisë, Konsumi i Administratës Publike i ndarë në konsum individual dhe kolektiv, Konsumi i Institucioneve Jofitimprurëse, Formimi Bruto i Kapitalit Fiks, Eksportet neto, Ndryshimi i gjendjeve;
- Përmirësimi i procesit të përshtatjeve sezonale të serive kohore duke trajnuar stafin dhe përdorur programin Demetra +;

- Publikimi i serisë së PBB-së tremujore me çmime korrente sipas mënyrës së prodhimit si dhe publikimi i PBB-së tremujore me çmimet e tregut, duke përfshirë Taksat dhe Subvencionet.

3.18.3.8. STATISTIKAT E ÇMIMEVE

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesor i statistikave të Çmimeve është llogaritja e saktë dhe në përputhje të plotë me metodologjinë e Eurostatit të indekseve të çmimeve të konsumit, të prodhimit, të ndërtimit dhe punimeve inxhinierike si dhe përpirësimin e vazhdueshëm të metodollogjisë egzistuese duke iu referuar përdorimit të metodave dhe analizave statistikore më të avancuara që përdoren në llogaritjen dhe publikimin e statistikave evropiane, si dhe shtimin e numrit të treguesve të tjerë sipas kërkesave të EU-së. Burimi kryesor i marrjes së informacionit janë vrojtimet statistikore mujore dhe tremujore. Të dhënat publikohen në nivel vendi.

Ky objektiv do të sigurohet nëpërmjet:

- Pasqyrimit të drejtë dhe të saktë në programin statistikor të variablave të kërkuar, të treguesve të prodhuar, kostos së vrojtimeve statistikore;
- Forcimit të kapaciteteve në INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e stastikave ekzistuese të çmimeve;
- Implementimit të vazhdueshëm të metodologjive të rishikuara të llogaritjes së indekseve të çmimeve, duke u mbështetur në manualet dhe rregulloret e vazhdueshme që miraton Eurostat në këtë fushë statistikore;
- Implementimit të mënyrave më të avancuara të grumbullimit dhe kontrollit të informacionit për të qenë koherent dhe të saktë në llogaritjen e treguesve. Në këtë mënyrë do të bëhet e e mundur të qenit sa më afër plotësimit të kërkesave të përdoruesve të ndryshëm.
- Llogaritjes së treguesve të rinj si: Indeksi i Çmimet e Importit, Indeksi i Punimeve Inxhinierike si pjese përbërëse e treguesve të Indekseve të Çmimeve.

Situata aktuale

INSTAT aktualisht llogarit Indeksin e Çmimeve të Konsumit, Indeksin e Çmimeve të Prodhimit, Indeksin e Kushtimit në Ndërtim (për banesa), ku secili nga këta tregues ka rëndësinë e vet dhe shërben në vetevete jo vetëm për te treguar tendencën e çmimeve në tregun vendas, por dhe si tregues ndihmës në llogaritjen e PBB vjetore, tremujore, statistikave tremujore.
Indeksi i Çmimeve të Konsumit, përbën një nga treguesit më të rëndësishëm për përdoruesit e ndryshëm dhe përdoret aktualisht nga Qeveria dhe BSH si matës i inflacionit në vend.
Në kuadër të matjes së Barazisë së Fuqisë Blerëse (PPP), INSTAT do të vazhdoj realizimin e aktiviteteteve të vrojtimit të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve të ciklit të Programit Europian të Krahasimit për vitin 2012. Çmimet e produkteve dhe shërbimeve do të mblidhen vazhdimisht në harmonizim të plotë me listën e produkteve dhe specifikimeve të përcaktuara nga programi. Gjithashtu, INSTAT do të ndjekë të gjitha hapat e punës dhe afatet

respektive të përcaktuar nga Eurostat për dërgimin e të dhënave sipas afateve të paracaktuara.

Aktivitetet statistikore që do të kryhen dhe variablat që do të grumbullohen nga vrojtimet statistikore apo burimet administrative, indikatorët që do të llogariten dhe publikohen, kosto etj për periudhën në vazhdim do të përcaktohen në PSZ 2012-2016.

Baza ligjore dhe përafrim i legjislacionit

Referohu bazës ligjore të Kapitullit 18

Struktura institucionale

Për prodhimin e statistikave të çmimeve, brenda Drejtorisë së Statistikave Ekonomike INSTAT, janë krijuar dy sektorë: Sektori i Indekseve të Cmimeve dhe Sektori i Cmimeve të Prodhimit, të cilët janë të përbërë përkatësisht me nga 3 specialistë.
Institucionet e përfshira në sigurimin e informacionit statistikor mbi statistikat e çmimeve janë njësitë tregtare, ndërmarrjet prodhuese të fushës së industrisë, ndërmarrjet e import – eksportit, ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e ndërtimit dhe punimeve inxhinierike.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- organizimit të vrojtimeve pranë njësive statistikore;
- kontrollit të vazhdueshëm të punës në terren;
- kontrollit të cilësisë së informacionit të mbledhur;
- cilësisë së llogaritjes të indikatorëve duke përdorur metodat statistikore si dhe duke u mbështetur në metodologjitë përkatëse të secilit tregues.
- Organizimi i vrojtimit pilot për të testuar dhe analizuar të gjitha hapat e punës dhe problemet.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Vrojtimi mbi çmimet e importit do të realizohet pranë ndërmarrjeve që kanë aktivitet e tyre kryesore si importi i mallrave në Shqipëri. Në bazë të informacionit të mbledhur nga kjo ankete do të llogaritet dhe publikohet Indeksi i Çmimeve të Importit si pjesë përbërese e indikatoreve të rëndësishem të Indekseve të çmimeve dhe njëkohësisht si plotësues i nevojave të Drejtorisë së Llogarive Kombëtare për deflatimin e treguesve përkatës të lidhur me këtë tregues;
- Publikimi i indekseve të çmimeve të importit;
- Vrojtimi për llogaritjen e Indeksit të punimeve inxhinierike, i cili do të realizohet pranë njësive statistikore që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë sektor. Llogaritja e këtij treguesi do të plotësojë kuadrin e Indekseve të Çmimeve të Ndërtimit;
- Trajnim i stafit, i cili do të përfshijë si trajnimin e anketuesve, ashtu dhe të spcialistëve.

3.18.3.9. TREGTIA E JASHTME

Objektivi Strategjik

INSTAT publikon statistikat e Tregtisë së mallrave të cilat kanë për qëllim të japin të dhëna mbi tregtinë e mallrave, eksport-importin e mallrave. Informacioni bazë sigurohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në periudha mujore.

Ky objektiv do të sigurohet nëpërmjet:

- Pasqyrimit të drejtë dhe të saktë në programin statistikor të variablave të kërkuar, të treguesve të prodhuar, kostos së vrojtimeve statistikore;
- Forcimit të marrëdhënieve institucionale me ministritë e linjës, institucionet për sigurimin në kohë dhe me cilësi të informacionit;
- Forcimit të kapaciteteve të INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e statistikave ekzistuese të tregtisë së jashtme.

Situata aktuale

Statistikat e tregtisë së mallrave kanë qëllim të japin të dhëna mbi tregtinë e mallrave, eksport-importin, e mallrave në Shqipëri. Statistikat e tregtisë së mallrave llogarisin treguesit e eksportit FOB (Free On Board) dhe importit CIF (Cost, Insurance, Freight) në total si dhe disa tregues të tjerë më të detajuar si psh. eksport/importi sipas vendeve, grupvendeve, grupmallrave, etj. Të dhënat e tregtisë së jashtme të mallrave përpunohen duke u mbeshtetur në parimet e sistemit të tregtisë speciale.

Nomenklaturat e përdorura për llogaritjen e statistikave të tregtisë së mallrave janë:

- Nomenlatura e Kombinuar e Mallrave, (CN),
- Klasifikimi Standart i Tregtisë Ndërkombëtare SITC, rev.4,
- Klasifikimi i vendeve dhe teritoreve ISO (International Standard Organization) – 3166 alpha-2code

Baza ligjore dhe përafrim i legjislacionit

Referohu bazës ligjore të Kapitullit 18

Efektet Financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**2.060.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	1.350.000	0	0	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	710.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.18.4. STATISTIKAT PËR BIZNESIN

Objektivi Stratetgjik

Objektivi kryesor i statistikave të Ndërmarrjeve është të ndërtojë statistika krahasuese, të besueshme dhe Statistika të përshtatshme në fushën e prodhimit të treguesve ekonomikë financiare. Informacioni statistikor sigurohet nëpërmjet vrojtimeve statistikore tremujore dhe vjetore. Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve (jo bujqësore), ASN përmbajnë të dhëna të detajuara ekonomike-financiare të cilat mbulojnë aktivitetet ekonomike sipas degëve të ekonomisë dhe sipas madhësisë së ndërmarrjeve. Të dhënat publikohen në nivel vendi.
Statistikat afatshkurtra sigurohen nëpërmjet vrojtimeve statistikore tremujore si edhe burimeve administrative.
INSTAT publikon statistikat e Tregtisë së mallrave të cilat kanë për qëllim të japin të dhëna mbi tregtinë e mallrave, eksport-importin e mallrave. Informacioni bazë sigurohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ne periudha mujore.
INSTAT mbledh dhe publikon të dhëna mbi Bilancin e Energjisë Elektrike. Dhe Bilancin e Pergjithshem të Energjisë. Informacioni sigurohet me burime administrative nga Ministria e Ekonomisë Tregtise dhe Energjitikës dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.
Statistikat e Transportit përfshijnë një sistem të gjerë informacioni mbi transportin Hekurudhor, Detar, Ajror të pasagjerëve, të mallrave, si dhe inventarin e mjeteve. Të dhënat janë në nivel kombëtar dhe rajonal.
Informacioni mbi statistikat e turizmit është administrativ, të dhënat vijnë nga Ministria e Brendëshme, Drejtoria e Përgjithëshme e Policisë. Aktivitetet statistikore që do të kryhen dhe variablat që do të grumbullohen nga vrojtimet statistikore apo burimet administrative, indikatorët që do të llogariten dhe publikohen, kosto për periudhën në vazhdim do të përcaktohen në PSZ 2012-2016.
Ky objektiv do të sigurohet nëpërmjet:

- Pasqyrimit të drejtë dhe të saktë në programin statistikor të variablave të kërkuar, të treguesve të prodhuar, kostos së vrojtimeve statistikore;
- Forcimit të marrëdhënieve institucionale me ministritë e linjës dhe institucionet e tjera publike e private, për sigurimin në kohë dhe me cilësi të informacionit;
- Forcimit të kapaciteteve të INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e statistikave ekzistuese të ndërmarrjeve dhe të tregtisë së jashtme.

Situata aktuale

Statistikat Strukturore të ndërmarrjeve

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon statistikat vjetore strukturore të ndërmarrjeve ekonomike jo bujqësor. Të dhënat grumbullohen me vrojtim vjetor me intervistë të drejtpërdrejtë me anketues. Fusha e mbulimit e këtij vrojtimi janë aktivitetet që u përkasin seksioneve nga B-Peshkimi deri P-Shërbime shtëpiake pranë familjeve dhe mjediseve të përbashkëta. Nuk përshihen në vrojtim aktivitetet e seksioneve J- Ndërmjetësim Financiar, L-Administrim Publik, dhe Q-Organizma Ndërkombëtare. Seksionet M-Arsimi dhe N-Shëndetësi u perfshinë në vrojtimin ASN 2010 viti i referencës. Të dhënat që publikohen janë të dhënat bazë numri i ndërmarrjeve dhe Punësimi, të ardhurat, shpenzimet, investimet

sipas aktiviteteve ekonomike, madhësisë së ndërmarrje, llojit të pronësisë. Të dhëna makroekonomike si prodhimi, konsumi ndërmjetës, Vlera e shtuar sipas aktiviteteve ekonomike, madhësisë së ndërmarrjes dhe llojit të pronësisë.

Statistikat Afatshkurtra të ndërmarrjeve

INSTAT gjithashtu nëpërmjet vrojtimeve tremujore mbledh, përpunon dhe publikon të dhëna statistikore afatshkurtra për aktivitetet Industri, Ndërtim, Transport, Komunikacion, Tregti, Hotele dhe disa Shërbime. Të dhënat e publikuara janë në formë indeksi për tregues si prodhimi, shifra e afarizmit, numri mesatar i të punësuarve, paga Regjistri statistikor i ndërmarrjeve është mjeti bazë për përcaktimin e popullatës dhe zgjedhjes për vrojtim. Klasifikimi i aktiviteteve ekonomike bëhet sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike NACE Rev 1.1.

Energjia

INSTAT mbledh dhe publikon të dhëna mbi Bilancin e Energjisë Elektrikedhe bilancin e përgjithshëm të energjisë. Informacioni sigurohet me burime administrative nga Ministria e Ekonomisë Tregtise dhe Energjitikës dhe nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.
Statistikat e Transportit

INSTAT gjithashtu mbledh, përpunon dhe publikon informacion mbi statistikat e transportit të mallrave dhe pasagjerëve, inventarin e mjeteve të transportit dhe aksidentet e transportit rrugor dhe postë-telekomunikacionin. Burimi i këtyre të dhënave është administrativ. Të dhënat vijnë nga Ministria e Brendëshme, Drejtoria e Përgjithëshme e Policisë, Ministria e Punëve Publike, Transporteve dhe Komunikacioneve.

Turizmi

INSTAT gjithashtu mbledh, përpunon dhe publikon informacion mbi statistikat e turizmit. Burimi i këtyre të dhënave është administrativ. Të dhënat vijnë nga Ministria e Brendëshme, Drejtoria e Përgjithëshme e Policisë.

Baza ligjore dhe përafrim i legjislacionit

Referohu bazës ligjore të Kapitullit 18

Struktura institucionale

Për kryerjen e aktiviteteve që mbulojnë prodhimin e statistikave të ndërmarrjeve, pranë Drejtorisë së Statistikave Ekonomike funksionon Sektori i Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve dhe ai i Statistikave Afatshkurtra. Këta dy sektorë janë të përbërë përkatësisht me nga 4 dhe 5 specialistë. Institucionet e përfshira në sigurimin e informacionit statistikor mbi statistikat e ndërmarrjeve janë:

- Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, e cila është përgjegjëse për:

- Të dhënat mbi Transportin hekurudhor;
- Të dhenat mbi Transportin detar;
- Të dhenat mbi Transportin ajror;
- Inventari i mjeteve të transportit rrugor;

- Ministria e Ekonomise, Tregtisë dhe Energjetikës është përgjegjës për të siguruar:
  - Të dhënat për Prodhimin e gazit dhe nënproduktet e naftës,
- Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme Policisë së Shtetit), është përgjegjëse për të siguruar:
  - Të dhëna mbi hyrje daljet në kufi;
  - Aksidentet rrugore.

- Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave), e cila është përgjegjëse për:
  - Të dhënat e tregtisë së Jashtme të Mallrave Export –Import
- KRT pranë zyrave të urbanistikës së Komunës, Bashkisë, Qarkut, të cilët sigurojnë:
  - Lejet e ndertimit (tremujore) ,
- AKBN (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore) siguron:
  - Bilancin e Përgjithshëm të Energjisë.
- ERE (Enti Regullator i Energjisë) siguron:
  - Të dhëna shtesë për Bilancet e Energjise Elektrike.
- KESH, CEZ, OST janë përgjegjës për:
  - Bilancet përkatëse të Energjisë Elektrike.
- Posta Shqiptare është përgjegjëse per të siguruar të dhënat e:
  - Shërbimit Postar.
- "Albtelekom" sh.a. është përgjegjës për:
  - Pajtimtaret telefonikë;
  - Impulset telefonike.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projekt Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë "Për miratimin e programit të statistikave zyrtare për periudhën 2012-2016". Ky projekt-vendim do të përafrojë pjesërisht: Rregulloren nr. 223/2009/EP dhe KE "Për statistikat Evropiane dhe shfuqizimin e Rregullores Nr. 1101/2008 të Parlamentit të Evropës dhe Këshillit për transmetimin e të dhënave konfidenciale nga Zyrat e Statistikave të Komuniteteve të Evropës, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr.322/97 për Statistikat Komunitare, dhe Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom për ngritjen e një Komiteti për Programet e Statistikave të Komuniteteve të Evropës"[118]; Direktivën 95/46/KE dt. 24 Tetor 1995 "Për mbrojtjen e individëve për shkak të përpunimit të të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave"; Rregulloren (KE) 45/2001 dt. 18 Dhjetor 2000;

Aktivitetet zbatuese

- Hartimi dhe nënshkrimi i Memorandumit të bashkepunimit me Autoritetitn e

[118] Celex nr 32009R0223, *FZ L 87, 31.3.2009, fq. 164–173*

Komunikimit Elektronik Postar (AKEP) për përmirësimin e treguesve të telekomunikacionit;

- Bashkëpunimi me AKEP për përditësimin dhe përfshirjen e të gjithë treguesve mbi Telekomunikacionin;
- Përmirësimi sasior dhe cilësor i statistikave të ndërmarrjeve;
- Ndjekja e ecurisë së ndërmarrjeve të mëdha;
- Përdorimi metodologjisë bashkëkohore për trajtimet e mospërgjigjeve;
- Rritja e bashkëpunimit me institucionet publike për të shfrytëzuar sa më mirë burimet administrative, nëpërmjet:
- marrjes së informacioneve shtesë për variablat që ata prodhojnë;
- përditesimit të informacionit statistikor.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Implemnetimi i Nomenklatures NVE Rev.2 në vrojtimet ekonomike;
- Analiza e konvertimit në klasifikimin e ri dhe llogaritja pas e serisë kohore të treguesve të publikuar;Organizimi i vrojtimeve mbi treguesit e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit:
    - Bashkëpunimi me institucionet e tjera mbështetëse;
    - Trajnim i specialistëve, kontrollorëve, anketues;
    - Analizimi i rezultateve paraprake;
    - Publikim i rezultateve.
- Përmiresim i rubrikes mbi produktet industriale pjese perberese e ASN, në përputhje me kerkesat e brendshme të institucionit dhe standartet e EU, duke përdorur kombinim të klasifikimit të produkteve (CPA) me Listën e produkteve të Komunitetit (Prodcom)
    - Trajnim i specialistëve, kontrollorëve dhe anketuesit;
    - Përgatitja e listës së produkteve industriale shqiptare;
    - Analizimi i rezultateve.

Efektet Financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**2.060.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	1.350.000	0	0	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	710.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.18.5 STATISTIKAT MONETARE, FINANCIARE, TË TREGTISË DHE STATISTIKAT E BILANCIT TË PAGESAVE

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Bankës së Shqipërisë në fushën e prodhimit të statistikave është prodhimi i të dhënave të krahasueshme, të besueshme, objektive dhe të sakta, që nevojiten

për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformës në Shqipëri. Në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare, Banka e Shqipërisë, synon përafrimin gradual të legjislacionit dhe metodologjisë statistikore me kërkesat e Bashkimit Evropian të shprehura në aktet rregullative, vendime dhe rregullore të Parlamentit Evropian, të Këshillit dhe të Komisionit, manuale metodologjike dhe vademekume, që rregullojnë prodhimin dhe raportimin statistikor. Nëpërmjet prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave të një cilësie të lartë dhe sipas një baze metodologjike në linjë me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare, synohet të mbështetet analiza, vendimmarrja, krahasimi dhe vlerësimi i ecurisë së Shqipërisë në raport me objektivat strategjikë dhe kërkesat e Komunitetit në fushën e ekonomisë dhe financave. Në linjë me rekomandimet e Raportit të Progresit (2010) Banka e Shqipërisë do të punojë në drejtim të përmirësimit të statistikave monetare dhe financiare, statistikave të investimeve të huaja direkte dhe matjes së dërgesave nga emigrantët. Në Programin e Statistikave Zyrtare për vitet 2012-2016, do të parashikohet një ndarje më e qartë e detyrimeve midis Institutit të Statistikave (INSTAT), Bankës së Shqipërisë dhe autoriteteve doganore, për raportimin dhe prodhimin e të dhënave të tregtisë së jashtme të mallrave.

Në përputhje me Nenin 88 të MSA mbi 'Bashkëpunimin statistikor', Banka e Shqipërisë do të mbështesë Institutin e Statistikave (INSTAT) për të përmbushur më mirë nevojat e klientëve vendas dhe ndërkombëtarë. Gjithashtu Banka e Shqipërisë do të vijojë të punojë për të përfshirë në bazën legjislative dhe në praktikat e punës parimet themelore të statistikave të nxjerra nga OKB-ja dhe Kodi Statistikor Evropian i Praktikës dhe parashikimet e Të Drejtës Statistikore Evropiane, si edhe të zhvillojë sistemin e saj statistikor drejt *Acquis* të Komunitetit.

Këto objektiva do të realizohen nëpërmjet:

- Përmirësimit të legjislacionit dhe akteve rregullative mbi raportimin për nevoja statistikore. Në bazën rregullative bëjnë pjesë Ligji për Statistikat, Programi Pesëvjeçar i Statistikave Zyrtare, Ligji për Bankën e Shqipërisë, manualet metodologjike dhe formatet e raportimit të të dhënave për nevoja statistikore.
- Përforcimit të kapaciteteve njerëzore dhe teknologjike nëpërmjet investimit në trajnime dhe në programe bashkëkohore për menaxhimin e të dhënave statistikore.
- Forcimit të bashkëpunimit midis agjencive statistikore dhe përdoruesve të statistikave zyrtare nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale të bashkëpunimit, aktiviteteve dhe projekteve të fokusuara në sektorë të veçantë të statistikave.

Situata aktuale

Banka e Shqipërisë prodhon statistika monetare dhe statistika të sektorit të jashtëm. Të dyja këto blloqe statistikore prodhohen në bazë të manualeve metodologjikë të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) mbi statistikat monetare, statistikat e bilancit të pagesave, statistikat e borxhit të jashtëm dhe statistikat e pozicionit të investimeve ndërkombëtare. Deri në fund të vitit 2011 Banka e Shqipërisë ka plotësuar të gjitha kërkesat e Standardeve për Shpërndarjen e të Dhënave të Veçanta për statistikat e sektorit monetar dhe sektorit të jashtëm, në drejtim të mbulimit, periodicitetit dhe kohëvonesës me përjashtim të kohëvonesës së statistikave të pozicionit të investimeve ndërkombëtare. Statistikat monetare prodhohen në frekuencë mujore, me një kohëvonesë mujore dhe mbulojnë korporatat depozituese. Statistikat e bilancit

të pagesave prodhohen në frekuencë tremujore, me një kohëvonesë prej 70 ditësh dhe paraqesin transaksionet dhe pozicionet e Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës. Gjatë pesë viteve të fundit, duke shfrytëzuar të dhënat e vrojtimit vjetor pranë ndërmarrjeve të huaja, Banka e Shqipërisë ka prodhuar statistika të pozicionit të investimeve të huaja direkte sipas shteteve dhe sektorëve ekonomikë.

Objektivi afatshkurtër i Bankës së Shqipërisë është zgjerimi i mbulimit për të përfshirë institucionet financiare jo-banka në prodhimin e rregullt statistikor. Sfida afatgjatë në drejtim të prodhimit të statistikave monetare dhe financiare është ngritja e strukturës, hartimi i metodologjisë, identifikimi i burimeve, dhe prodhimi i statistikave të Llogarive Financiare, të cilat aktualisht nuk mbulohen nga asnjë agjenci statistikore në vend (Moduli 2.03.01 dhe 2.03.02 në "Compendiumin 2009").
Sfida afatshkurtër në drejtim të statistikave të bilancit të pagesave lidhet me përmirësimin cilësor të statistikave të investimeve të huaja direkte dhe investimeve të portofolit. Në horizontin afatmesëm sfida për statistikat e bilancit të pagesave dhe shërbimeve ndërkombëtare është plotësimi i kërkesave të Manualit të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, Edicioni i gjashtë, Fondi Monetar Ndërkombëtar 2010 (BPM6) si edhe plotësimi i kërkesave të Eurostat dhe Banka Qëndore Evropiane (BQE) mbi detajimin e statistikave të bilancit të pagesave sipas shteteve dhe sektorëve ekonomikë.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligjin nr. 8269, dt. 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"[119], i ndryshuar. Ligji përafron pjesërisht Statutin e Sistemit Evropian te Bankave Qëndore dhe Bankës Qendrore Evropiane[120].
- Ligjin nr. 9180, dt. 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare"[121].
- Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 153, date 31.01.2008 "Për miratimin e programit të statistikave zyrtare për periudhën 2007-2011".

Struktura institucionale

Banka e Shqipërisë e realizon prodhimin statistikor nëpërmjet Departamentit të Statistikave, i cili ka një personel prej 26 personash dhe është i ndarë në Sektorin e Statistikave Monetare dhe Financiare dhe Sektorin e Bilancit të Pagesave. Drejtori i Departamentit të Statistikave të Bankës së Shqipërisë është njëkohësisht anëtar i Këshillit të Statistikave. Departamenti i Statistikave të Bankës së Shqipërisë është përgjegjës për mbledhjen e informacionit nga subjektet raportuese, hartimin dhe miratimin e metodologjisë përkatëse, hartimin dhe vënien në përdorim të formave të raportimit, përpunimin e informacionit dhe shpërndarjen e statistikave monetare dhe statistikave të sektorit të jashtëm. Departamenti i Statistikave gjithashtu prodhon statistika të detajuara të mbikëqyrjes bankare në shërbim të funksionit të Bankës së Shqipërisë për mbikëqyrjen e sistemit bankar dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

Objektivat dhe produktet e Bankës së Shqipërisë si agjenci statistikore parashikohen në planet

[119] Fletore Zyrtare nr. 20, datë 07.01.1998, faqe 479
[120] Fletore Zyrtare nr.115, date 09.05.2008, faqe 230-250
[121] Fletore Zyrtare nr. 12, date 12.03.2004, faqe 489

vjetore të punës, në strategjitë afatmesme (3-vjeçare) të Bankës së Shqipërisë dhe në Programin Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare. Për prodhimin e statistikave zyrtare Banka e Shqipërisë mbledh informacion nëpërmjet raportimit direkt nga institucionet financiare; raportimit direkt nga burime administrative si: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Ministria e Brendshme, Qendra Kombëtare e Regjistrimit; si edhe vrojtimeve të realizuara me kompani private dhe individë. Për vrojtimet statistikore, çdo vit Banka e Shqipërisë nënshkruan një kontratë me INSTAT, i cili realizon kundrejt pagesës intervistimin në terren të ndërmarrjeve dhe individëve ose familjeve. Marrëdhëniet midis Bankës së Shqipërisë dhe agjencive të tjera statistikore për dhënien dhe marrjen e të dhënave të përpunuara, parashikohen në Programin e Statistikave Zyrtare. Asistenca teknike e përfituar deri në fund të vitit 2011 është ofruar kryesisht nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, ndërsa trajnimi i burimeve njerëzore është realizuar nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese nga FMN, Banka Qendrore Evropiane (BQE), Eurostat dhe banka të tjera qendrore.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projekt Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë "Për miratimin e programit të statistikave zyrtare për periudhën 2012-2016". Ky projekt-vendim do të përafrojë pjesërisht: Rregulloren nr. 223/2009/EP dhe KE "Për statistikat Evropiane dhe shfuqizimin e Rregullores Nr. 1101/2008 të Parlamentit të Evropës dhe Këshillit për transmetimin e të dhënave konfidenciale nga Zyrat e Statistikave të Komuniteteve të Evropës, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr.322/97 për Statistikat Komunitare, dhe Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom për ngritjen e një Komiteti për Programet e Statistikave të Komuniteteve të Evropës"[122]; Direktivën 95/46/KE dt. 24 Tetor 1995 "Për mbrojtjen e individëve për shkak të përpunimit të të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave"; Rregulloren (KE) 45/2001 dt. 18 Dhjetor 2000;

Aktivitetet zbatuese

- Përgatitja e Programit të Statistikave Zyrtare për vitet 2012-2016 për prodhimin e statistikave të sektorit të jashtëm dhe statistikave monetare dhe financiare.
- Projekti i Binjakëzimit për Forcimin e Kapaciteteve Institucionale të Bankës së Shqipërisë, përfshirë prodhimin statistikor: moduli 'Statistikat Financiare' dhe moduli 'Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe të Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare'.

Statistikat e sektorit të jashtëm:

- Vrojtim statistikor tremujor për të dhënat e fluksit dhe stokut për investimet e huaja direkte në përputhje me kërkesat e Eurostat.
- Projekti i Eurostat IPA 2009 në nivelin rajonal për vendet e Ballkanit për vlerësimin e statistikave të bilancit të pagesave dhe mundësinë e prodhimit të statistikave për filialet e huaja (OFATS).

Statistikat monetare dhe financiare

- Ngritja e modelit pilot dhe dokumenteve metodologjike për ndërtimin e llogarisë financiare të sektorit bankar.

[122] Celex nr 32009R0223, *FZ L 87, 31.3.2009, fq. 164–173*

Masat legjislative afatmesme

- Projekt ligji mbi disa ndryshime në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"[123], i ndryshuar me qëllim përafrimin e mëtejshëm të tij me Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qëndore dhe Bankës Qëndrore Evropiane.

Aktivitetet zbatuese

- Zbatimi i Programit të Statistikave Zyrtare për vitet 2012-2016 për prodhimin e statistikave të sektorit të jashtëm dhe statistikave monetare dhe financiare;
- Asistencë teknike nga Banka Qendrore e Gjermanisë (për t'u konfirmuar gjatë vitit 2012);
- Pjesëmarrje në aktivitetet trajnuese dhe takimeve e grupeve të punës të organizuara nga EUROSTAT;
  Pjesëmarrje në programet e trajnimit.

Statistikat e sektorit të jashtëm

- Vrojtim statistikor vjetor për investimet direkte të kompanive shqiptare jashtë për statistikat e fluksit dhe të stokut.
- Vrojtim i përbashkët me INSTAT për ngritjen e sistemit të statistikave OFATS.

Statistikat monetare dhe financiare

- Ndërtimi i llogarisë financiare për sistemin bankar.
- Në Projekt-programin e Statistikave Zyrtare për vitet 2012-2016, Banka e Shqipërisë ka propozuar që Banka e Shqipërisë, INSTAT dhe Ministria e Financave të bashkëpunojnë për kryerjen e një studimi, me qëllim ngritjen ose ristrukturimin e proceseve statistikore, ngritjen e sistemeve të informacionit, përcaktimin e metodave statistikore dhe sigurimin e mjeteve të nevojshme për hartimin e llogarive financiare si pjesë të sistemit të llogarive kombëtare.

Efektet Financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**2.493.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	1.783.000	0	0	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	710.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.18.6.STATISTIKAT BUJQËSORE

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesor i statistikave të Bujqësisë është të ndërtojë statistika krahasuese, të besueshme dhe të përshtatshme. Statistikat e bujqësisë dhe blegtorisë sigurojnë informacion

[123] Fletore Zyrtare nr. 20, datë 07.01.1998, faqe 479

të përgjithshëm dhe specifik mbi bujqësinë dhe blegtorinë, në periudha tremujore, vjetore në nivel kombëtar dhe rajonal

Ky informacion sigurohet nëpërmjet burimeve statistikore dhe administrative nga institucionet mbajtes të dhënave si nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrotjes së Konsumatorit, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe nga Ministria e Brendeshme. Realizimi i regjistrimit të përgjithshëm të bujqësisëne në vitin 2012 do të krijojë mundësinë e ndërtimit të Rregjistrit të fermave bujqësore mbi bazë e të cilit do të ndërmerren vrojtime statistikore. Variablat që do të grumbullohen nga vrojtimet statistikore, indikatorët që do të llogariten dhe publikohen, si dhe kostot që do të përcaktohen në PSZ 2012-2016.
Ky objektiv do të sigurohet nëpërmjet:

- Pasqyrimit të drejtë dhe të saktë në programin statistikor të variablave të kërkuar, të treguesve të prodhuar, kostos së vrojtimeve statistikore;
- Forcimi i marrëdhënieve institucionale me ministrite dhe axhecite e tjera statistikore ;
- Forcimit të kapaciteteve në INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e statsitikave ekzistuese;
- Riorganizim të sistemit te statistikave te bujqesise dhe mjedisit ne shkall vendi.

Situata aktuale

INSTAT publikon të dhëna të cilat mblidhen nga MBUMK mbi produktet bimore të cilat përfshijnë përdorimin e tokës, bimët e arave dhe kulturat drufrutore, prodhimet bimore, llogaritë ekonomike, strukturën e blegtorisë, prodhimet blegtorale dhe llogaritë ekonomike të blegtorisë. Statistika për strukturën e fermave, për mjedisin, pylltarinë dhe peshkimin. Aktualisht të dhenat mbilidhen sipas klasifikimit kombëtare aktiviteteve NACE Rev.l.1 .

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Referohuni bazës ligjore të parashikuar në pjesën e përgjithshme të Kapitullit 18

Struktura institucionale

Prodhimi i statistikave të bujqësisë sigurohet nga INSTAT dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. Brenda strukturës së Drejtorisë së Statistikave Ekonomike funksionin Sektori i statistikave të Bujqësisë, është i përbërë nga 4 specialistë. Institucionet e përfshira në sigurimin e informacionit statistikor mbi statistikat e bujqësisë janë:

Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumtorit, e cila është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave statistikore dhe administrative mbi bujqësinë e blegtorinë bazuar në dokumentacionin administrativ si dhe vrojtimet statistikore sipas planit.

Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, e cila është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave administrative për treguesit lidhur me Statistikat e Mjdisit pylltarine dhe Peshkimin.

Masa legjislative afatshkurtra

- Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave mbi "Për Riorganizimin e sistemit të statistikave zyrtare për Bujqësinë";
- Projekt Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë "Për miratimin e programit të statistikave zyrtare për periudhën 2012-2016". Ky projekt-vendim do të përafrojë pjesërisht: Rregulloren nr. 223/2009/EP dhe KE "Për statistikat Evropiane dhe shfuqizimin e Rregullores Nr. 1101/2008 të Parlamentit të Evropës dhe Këshillit për transmetimin e të dhënave konfidenciale nga Zyrat e Statistikave të Komuniteteve të Evropës, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr.322/97 për Statistikat Komunitare, dhe Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom për ngritjen e një Komiteti për Programet e Statistikave të Komuniteteve të Evropës"[124]; Direktivën 95/46/KE dt. 24 Tetor 1995 "Për mbrojtjen e individëve për shkak të përpunimit të të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave"; Rregulloren (KE) 45/2001 dt. 18 Dhjetor 2000;
- Udhëzimi i Komisionit Qëndror të Regjistrimit për zbatimin e proçesit të rregjistrimit të bujqësisë.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Kryerja e Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Bujqësore (Nj.E.B), nëpërmjet:

- Finalizimt të pyetësorit dhe instruksionet e anketuesve, kontrollorëve dhe mbikqyrësve;
- Sistemit të skanimit të pyetësoreve, i cili do të realizohet me këtë metodologji të re;
- Printimit të materialeve, të cilat do të përdoren gjatë fazes së trajnimit si dhe gjatë fazës së terrenit;
- Përcaktimit të zonave të regjistrimit ku ndodhen Nj.E.B dhe printimi i hartave të cilat do të përdoren për identifikimin e njësive të cilat duhet të intervistohen;
- Trajnimit të Supervizorëve, kontrollorëve dhe anketuesve;

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Rishikim i Memorandumit të bashkëpunimit me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Hartim i Memorandumit me Ministrinë Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave;
- Kryerja e vrojtimeve të reja në funksionim të përmirësimit të statistikave të bujqësisë;
- Trajnim i stafit për ngritjen e njohurive dhe forcimin e kapaciteteve;
- Prodhimi i statistikave të reja mbi Bujqësinë dhe Blegtorinë në nivel rajonal;
- Përmirësim i statistikave të Mjedisit me të dhënat e klimes në nivel kombëtar dhe rajonal;
- Përmirësim i llogarive ekonomike të bujqësisë me statistikat e çmimeve dhe indekset përkatëse;
- Mbledhja e të dhënave në nivel vendi dhe raportimi vjetor i variablave të Joint

[124] Celex nr 32009R0223, *FZ L 87, 31.3.2009, fq. 164–173*

Forestry Questionarie në EUROSTAT.

Efektet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**2.060.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	1.350.000	0	0	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	710.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.18.7. REGJISTRAT

Objektivi strategjik

Objektivi Strategjik për këtë pikë është

- Përditësimi dhe përmirësimi i cilësisë së regjistrave statistikor të njësive ekonomike sipas kërkesave të BE-së.
- Përmirësimi i cilësisë së informacionit mbi vendodhjen gjeografike të ndërmarrjeve nëpërmjet standartizimit të adresave dhe sistemit GIS (Geografical Information System) nga përdorimit i GPS (Global Position System) në çdo aktivitet statistikor.
- Përgatitja e regjistrave statistikor të njësive ekonomike, ndërmarrjeve dhe njësive lokale, me kodifikim të dyfishtë te aktivitetit, NVE Rev 1.1 dhe NVE Rev.2.
- Përdorimi i anketave specifike për përditësimin e regjistrave statistikor të njësive ekonomike, Anketa e Ndërmarrjeve të Reja dhe Anketa e Njësive Lokale.
- Lidhja e Regjistrit të Ndërmarrjeve me Regjistrin e Fermave, sipas kërkesave të BE.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

INSTAT krijon, mirëmban dhe është përgjegjës për regjistrat statistikor të njësive ekonomike, Ndërmarrjet dhe Njësitë Lokale.
Këto regjistrat shërbejnë vetëm për qëllime statistikore dhe identifikojnë qartësisht njësitë, në mënyrë që të lejojë, marrjen e informacionit për to nëpërmjet burimeve administrative e statistikore, përgatitjen e mostrave, koordinimin e anketave dhe grupimin e rezultateve, analizën demografike të popullsisë së ndërmarrjeve dhe njësive lidhur me to si dhe prodhimin e statistikave të nevojshme për treguesit afat-shkurtër dhe të zhvillimeve strukturore ekonomike.
Treguesit që prodhohen nga Regjistrat e Njësive Ekonomike, Ndërmarrjet dhe Njësitë lokale, si më poshtë vijon:
Regjistri i Ndërmarrjeve

- Tregues identifikues, Forma ligjore, Pronësia, Emri, Adresa, Komunikimi (Tel, Faks etj.);
- Tregues shtresore, aktiviteti ekonomik kryesor, madhësia sipas të punësuarve, madhësia sipas xhiros, vendodhja gjeografike;

- Ndryshimet demografike, Data e krijimit, Data e mbarimit.

Regjistri i Njësive Lokale

- Tregues identifikues, Emri, Adresa, Komunikimi (Tel, cel);
- Tregues shtresore, aktiviteti ekonomik kryesor, madhësia sipas të punësuarve, vendodhja gjeografike;
- Ndryshimet demografike, Data e krijimit, Data e mbarimit.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Referohuni pjesës së bazës së përgjithshme ligjore në Kapitullin 18

Struktura institucionale

INSTAT ka në strukturë një sektor të veçantë, Sektori i Menaxhimit të Bazave të të Dhënave dhe Metadatave, i cili ka për detyrë edhe ndërtimin e mirëmbajtjen e regjistrave të njësive ekonomike. Sektorët e tjerë e mbështesin këtë aktivitet me informacion nga anketat e ndryshme statistikore. QKR është burimi kryesor i informacionit për ndërmarrjet e reja të krijuara si dhe ndryshimet përkatëse.

INSTAT ka nënshkruar memorandume të veçanta bashkëpunimi sipas të cilit DPT transferon periodikisht informacione të ndryshme për përmirësimin e cilësisë së regjistrit të ndërmarrjeve si ndërmarrjet aktive që operojnë në vend, të punësuarit, xhiro etj. Ministria e Financave është burimi kryesor për ndërmarrjet e institutcionet buxhetore.
Banka e Shqipërisë informon INSTAT për situatën e ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave mbi "Nomenklaturën e Aktiviteteve Rev 2", në zbatim të ligjit nr.9180, datë 05.02.2004 "Për statistikat zyrtare";
- Projekt Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë "Për miratimin e programit të statistikave zyrtare për periudhën 2012-2016". Ky projekt-vendim do të përafrojë pjesërisht: Rregulloren nr. 223/2009/EP dhe KE "Për statistikat Evropiane dhe shfuqizimin e Rregullores Nr. 1101/2008 të Parlamentit të Evropës dhe Këshillit për transmetimin e të dhënave konfidenciale nga Zyrat e Statistikave të Komuniteteve të Evropës, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr.322/97 për Statistikat Komunitare, dhe Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom për ngritjen e një Komiteti për Programet e Statistikave të Komuniteteve të Evropës"[125]; Direktivën 95/46/KE dt. 24 Tetor 1995 "Për mbrojtjen e individëve për shkak të përpunimit të të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave"; Rregulloren (KE) 45/2001 dt. 18 Dhjetor 2000;

Aktivitetet zbatuese

- Përgatitja e regjistrave statistikor të njësive ekonomike, ndërmarrjeve dhe njësive lokale, me kodfikim të dyfishtë te aktivitetit, NVE Rev 1.1 dhe NVE Rev.2;

[125] Celex nr 32009R0223, *FZ L 87, 31.3.2009, fq. 164–173*

- Rishikimi i anketës së ndërmarrjeve të reja në përputhje me treguesit e klasifikimet e reja të Regjistrit të Ndërmarrjeve;
- Përgatitja dhe vënia në zbatim e anketës së njësive lokale;
- Standartizimi i rubrikës për treguesit si pjesë e anketave të ndryshme , i cili shërben për përditësimin e regjistrave statistikor të njësive ekonomike.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Lidhja e Regjistrit të Ndërmarrjeve me Regjistrin e Fermave, sipas kërkesave të BE-së.

Efektet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**2.060.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	1.350.000	0	0	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	710.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.18.8. KLASIFIKIMET

Objektivi Strategjik

Për koordinimin e statistikave në një gjuhë të përbashkët, për të lehtësuar prodhimin e këtyre statistikave dhe bërjen e tyre sa më eficente, INSTAT zbaton klasifikimet europiane dhe ndërkombëtare për kodifikimin e aktiviteteve ekonomike dhe produkteve dhe shërbimeve që derivojnë nga këto aktivitete. Objektivi kryesor është implementimi, zbatimi dhe rishikimi i harmonizuar brenda INSTAT dhe me agjensitë e tjera statistikore.

Ky objektiv do të sigurohet nëpërmjet:

- Përditësimit të sistemit të unifikimit të klasifikimeve te zbatuar në INSTAT për fusha të ndryshme;
- Implementimit të klasifikimeve të aktiviteteve dhe produkteve, të rishikuara;
- Forcimit të marrëdhënieve institucionale me ministritë dhe agjensitë e tjera statistikore përdorimin në mënyrë të unifikuar të këtyre klasifikimeve;
- Forcimit të kapaciteteve në INSTAT për prodhimin dhe përmirësimin e statistikave ekzistuese;

Situata aktuale

Për koordinimin të gjitha klasifikimeve të përdorura në sektorë të ndryshëm, INSTAT ka ndërtuar një sistem të integruar të klasifikimeve sipas nivelit të përputhshmërisë me klasifikimet Europiane dhe ndërkombëtare. Klasifikimi i aktiviteteve ekonomike është përdorur për kodifikimin e njësive ekonomike, prej vitit 1994. Për kodifikimin e produkteve

dhe shërbimeve sipas aktiviteteve ekonomike përdoret Klasifikimi i Produkteve, prej vitit 1996. Të dy këto klasifikime janë identike me versionin e paraqitur nga Eurostat. Për kodifikimin e profesioneve në vend INSTAT përdor klasifikimin e profesioneve, ISCO 88, qysh prej vitit 1996.

Klasifikimet për Tregtinë e mallrave (Dogana)

Për të pasur një instrument të vetëm, që do të mundësonte administrimin në të njëjtën kohë të tarifës doganore, të statistikave të tregtisë së jashtme dhe të politikave të tjera, që lidhen me mallrat dhe lëvizjen e tyre, Këshilli i Ministrave ka miratuar Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave" (NK), Ligji Nr.9461, datë 21.12.2005 "Per Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave dhe Tarifën e Integruar Doganore". Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave bazohet plotësisht në Nomenklaturën e Kombinuar të Bashkimit Europian (CN). Përditësimet e kësaj nomenklature behen zakonisht cdo vit sipas perditesimeve te Nomenklaturës së Kombinuar të BE-së dhe duke u mbeshtetur në vendimin e Këshillit të ministrave.

Nomenklatura e shteteve bazohet në Rekomandimin nr.3 tëUNECE dhe në kodin e vendeve, të paraqitur në elementet e Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) 3166-1-alfa-2code, dhe të përditësuara çdo vit në bazë të rejat nga ISO (dogana)

Baza ligjore dhe përafrim i legjislacionit

Referohuni pjesës së bazës së përgjithshme ligjore në Kapitullin 18

Struktura institucionale

Ministritë dhe institucionet për klasifikimin e aktiviteteve të tyre dhe të atyre njësive që ato kanë në varësi.

- Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve për kodifikimin subjekteve të regjistruara, si objekt tatimor;
- Qendra Kombëtare e Regjistrimit për kodifikimin e njësive të cilat regjistrohen për hapje aktiviteti dhe / ose ndryshime;

Masat legjislative afatshkurtra

- Projekt Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë "Për miratimin e programit të statistikave zyrtare për periudhën 2012-2016". Ky projekt-vendim do të përafrojë pjesërisht: Rregulloren nr. 223/2009/EP dhe KE "Për statistikat Evropiane dhe shfuqizimin e Rregullores Nr. 1101/2008 të Parlamentit të Evropës dhe Këshillit për transmetimin e të dhënave konfidenciale nga Zyrat e Statistikave të Komuniteteve të Evropës, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr.322/97 për Statistikat Komunitare, dhe Vendimin e Këshillit 89/382/KEE, Euratom për ngritjen e një Komiteti për Programet e Statistikave të Komuniteteve të Evropës"[126]; Direktivën 95/46/KE dt. 24 Tetor 1995 "Për mbrojtjen e individëve për shkak të përpunimit të të dhënave personale dhe për

[126] Celex nr 32009R0223, *FZ L 87, 31.3.2009, fq. 164–173*

lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave"; Rregulloren (KE) 45/2001 dt. 18 Dhjetor 2000;

Aktivitetet zbatuese

- Hartimi i projekt-VKM-së për zbatimin e Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike të Revizionuar NACE Rev 2;
- Përfundimi i përshtatjes në shqip të NACE Rev 2, në 2012;
- Publikimi i NVE Rev.2;
- Implementimi në Regjistrin Statistikor të ndërmarrjeve i klasifikimit të rishikuar të aktiviteteve;
- Implementimi nga burimet e tjera administrative, Ministritë përgjegjëse, DPT, QKR; ;
- Zbatimi në vrojtimet ekonomike apo sociale që INSTAT do të ndërmarrë në vazhdimësi;

Masa legjislative afatmesme

- Projekt Vendimi mbi miratimin e VKM-së "Për implementimin e nomenkalutrës së produkteve", në zbatim të ligjit nr.9180, datë 05.02.2004 "Për statistikat zyrtare".

Aktivitetet zbatuese

- Hartimi i projekt-VKM-së "Për implemntimin e nomenkalutrës së produkteve".

3.19. POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI

3.19.1. LEGJISLACIONI I PUNËS

Objektivi strategjik

Përafrimi i legjislacionit të punës me direktivat e BE dhe standardet ndërkombëtare të punës, me qëllim vendosjen e balancave të drejta midis punëmarrësve dhe punëdhënësve, midis eficencës ekonomike dhe mirëqenies së popullsisë.

Statusi aktual

Në kuadrin e Projektit SMEI –II, është bërë, nga ekspertët e huaj, krahasimi i Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë me direktivat e BE. Gjithashtu, ekspertë të ILO-s kanë bërë krahasimin e tij me standardet ndërkombëtare të punës.

Në këto analiza janë evidentuar mospërputhjet dhe janë përcaktuar ndërhyrjet për përafrimin e Kodit të Punës me direktivat dhe standardet e përmendura më sipër.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), nenet 124,138,139, 148, 159-196 dhe 200-202;
- VKM Nr. 730, datë 6.11.2003 "Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë Këshill";
- VKM Nr. 16, datë 13.1.2006 "Për disa ndryshime e shtesa në Vendimin Nr. 730, datë 6.11.2003, të Këshillit të Ministrave "Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë Këshill";
- VKM Nr. 741, datë 6.11.2003 "Për procedurën e pajtimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Zyrave Shtetërore të Pajtimit";
- VKM Nr. 740, datë 6.11.2003 "Për mënyrën e organizimit dhe procedurën e votimit, për përcaktimin e përfaqësueshmërisë së organizatave të punëmarrësve";
- VKM. Nr. 132, datë 24.2.2010 "Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të Organizatave të Punëmarrësve dhe të Punëdhënësve në KKP";
- Urdhri i Ministrit Nr. 549/1, datë 17.3.2010 "Për emërimin e anëtarëve dhe kandidateve të KKP, përfaqësues të Organizatave të Punëmarrësve dhe Punëdhënësve";
- Urdhri i Ministrit Nr. 1026, datë 6.5.2010 "Për caktimin e Kryetarëve të komisioneve të specializuara, trepalëshe, të përhershme të Këshillit Kombëtar të Punës;
- Urdhri i Ministrit Nr. 960/1, datë 12.05.2010 "Për ngritjen dhe vënien në lëvizje të Zyrave Shtetërore të Pajtimit";
- Urdhri i Kryeministrit Nr. 246, datë 18.10.2006 "Për caktimin e Përfaqësuesve të Ministrive, për bashkëpunimin me Partnerët Sociale";
- Urdhri i Ministrit Nr. 2082, datë 10.10.2006 "Për krijimin e Rrjetit Shtetëror të Ndërmjetësimit";

- Udhëzimi i Ministrit Nr. 2083, datë 10.10.2006 "Për organizimin dhe funksionimin e Rrjetit Shtetëror të Ndërmjetësimit";
- Urdhri i Ministrit Nr. 25, datë 22.2.2011 "Për formularin tip të votimit që përdoret në procedurën e votimit për përcaktimin e përfaqësueshmërisë së organizatave t punëmarrësve".

Struktura institucionale

Në procesin e rishikimit të Kodit të Punës, palët e përfshira janë: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Organizatat e Punëmarrësve dhe Organizatat e Punëdhënësve, që janë të përfaqësuara në Këshillin Kombëtar të Punës.

Ministria e Punës ka zhvilluar konsultime me partneret sociale dhe në bashkëpunim me ata ka hartuar projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë".

Masat legjislative afatshkurtra

Në perspektivë afatshkurtër synohet:

- Rishikimi i Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe dërgimi i projektligjit përkatës për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e ministrave, brenda vitit 2012;
- VKM "Për shtrirjen e efekteve të kontratës kolektive të punës;
- VKM " Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi" për vitin 2012;
- VKM "Për ndryshimin e VKM nr. 730, datë 6.11.2003 "Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe për caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë Këshill";
- VKM "Për funksionimin e Këshillit Konsultativ Trepalësh rajonal";
- VKM "Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të Organizatave të Punëmarrësve dhe të Punëdhënësve në KKP";
- VKM "Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi" për vitin 2012, 2013, 2014, 2015;
- VKM "Për caktimin e pagës në natyrë";
- Urdhri i Ministrit "Për emërimin e anëtarëve dhe kandidateve të KKP, përfaqësues të Organizatave të Punëmarrësve dhe Punëdhënësve";
- Urdhri i Ministrit "Për caktimin e Kryetarëve të komisioneve të specializuara, trepalëshe, të përhershme të Këshillit Kombëtar të Punës";

Kodi i Punës do të përafrohet me: Direktivën 2003/88/EC "Mbi disa aspekte të organizmit të kohës së punës, 2002/14/EC "Mbi informimin dhe konsultimin e punëmarrësve, 97/80/EC "Barra e provës në rastet e diskriminimit bazuar në seks, 2006/54/EC "Mbi shanset e barabarta dhe trajtimin e barabartë", 98/59/EC "Mbi pushimet kolektive". Gjithashtu, do të bashkëpunohet me eksperte të kontraktuar nga ILO për hartimin e projektligjit mbi rishikimin e Kodit të Punës.

Masat zbatuese

- Aktivitete zbatuese janë konsultimet me përfaqësuesit e partnerëve sociale në komisionet e specializuara trepalëshe të KKP dhe miratimi paraprak në KKP para dërgimit të projektligjit përkatës në Këshillin e Ministrave;
- Konsultime në Komisionet Trepalëshe të Këshillit Kombëtar të Punës (KKP) dhe më pas edhe në KKP, për miratimin paraprak, para dërgimit në Këshillin e Ministrave për shqyrtim dhe miratim;
- Zhvillimi i seminareve trepalëshe për njohjen dhe rritjen e aftësive lidhur me Kodin e Punës (të rishikuar);
- Krijimi i Këshillave Trepalëshe Rajonale dhe Komisioneve Trepalëshe të tyre.

Masat legjislative afatmesme

- VKM "Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi" për vitin 2013;
- VKM "Për caktimin e pagës minimale në shkalle vendi" për vitin 2014.

Masat zbatuese

- Konsultime në Komisionet Trepalëshe të KKP dhe më pas edhe në KKP, për miratimin paraprak të VKM "Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi, para dërgimit në Këshillin e Ministrave për shqyrtim dhe miratim.

Implikimet financiare

Shpenzimet e përgjithshme[127] Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**2.379.000**	**470.000**	**85.000**	**90.000**
Mbulohen nga buxheti i	2.379.000	470.000	85.000	90.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.19.2. KËRKESAT E SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË

Objektivi strategjik

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e sigurisë dhe shëndeti në punë për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme është nxitja e zbatueshmërisë së legjislacionit të punës, lidhur me sigurimin dhe mbrojtjen e integruar fizike, mendore dhe sociale të punonjësve, nëpërmjet përmirësimit dhe harmonizimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian.

127 Për më shumë informacion në lidhje me shpenzimet për çdo aktivitet ose institucion të veçantë, ju lutemi konsultoni Shtojcën 3 Vlerësimi financiar i zbatimit të PKZMSA.

Për periudhën afatgjatë objektivi strategjik është zhvillimi i vetëdijes sociale, motivimit dhe qëndrimeve pozitive karshi sigurisë dhe shëndetit në punë, zbatimi i kushteve që krijojnë mirëqënie dhe prosperitet në punë, të tilla si: reduktimi i stresit, arrogancës, ngacmimeve dhe diskriminimit, bazuar këto në gjini, besim fetar, moshë, apo paaftësi fizike dhe mendore.

Po ashtu, neni 77 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit "Kushtet e punës dhe mundësitë të barabarta" përcakton se Shqipëria do të harmonizojë në mënyrë progresive legjislacionin e saj me atë të BE-së në fushën e kushteve të punës, veçanërisht të shëndetit dhe sigurisë në punë, dhe mundësive të barabarta.

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Sigurimi sa më i efektshëm i zbatimit të Legjislacionit të Punës në praktikën e përditshme, nëpërmjet ushtrimit te inspektimeve dhe kontrolleve administrative në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.
- Zhvillimi i një kulture parandalimi të rreziqeve në punë. Fushatat informuese evropiane dhe kombëtare përfaqësojnë një mjet të rëndësishëm në arritjen e ndryshimeve pozitive përsa i përket kulturës së parandalimit të rreziqeve në punë.
- Rritja e bashkëpunimit institucional midis institucioneve të ndryshme në nivel qendror dhe rajonal, me qëllim shkëmbim informacioni dhe realizim inspektimesh të përbashkëta.
- Realizimin e një bashkëpunimi efektiv me partnerët socialë.

Statusi aktual

Në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë, ligji shqiptar i miratuar rishtazi zbaton Direktivën kuadër dhe në këtë mënyrë vendos bazën për përafrimin e mëtejshëm të direktivave të veçanta. Amendimi i Kodit të Punës mund të jetë një hap i parë në këtë drejtim, i cili do të vinte vlerat kufi për ekspozimin ndaj zhurmës dhe dridhjes, në vendin e punës dhe për të futur një nen të ri i cili përcakton rrezikun e atmosferës shpërthyese.

I pjesshëm harmonizimi është bërë tashmë në rastin e:

- Direktiva e Këshillit 89/656/EEC të 30 nëntorit 1989 mbi shëndetin minimale dhe kërkesat e sigurisë për përdorimin nga punëtorët e pajisjeve mbrojtëse personale në vendin e punës;
- Direktiva e Këshillit 92/58/EEC e 24 qershor 1992 në kërkesat minimale për ofrimin e sigurisë dhe / ose shenjat e shëndetit në punë;
- Direktiva 92/85/EEC mbi paraqitjen e masave për të inkurajuar përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtoreve shtatzëna dhe punëtoreve të cilat kanë lindur ose janë me fëmijë në gji;
- Direktiva 94/33/EC për mbrojtjen e të rinjve në punë;
- Direktiva 91/383/EEC plotësimin e masave për të inkurajuar përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtorëve me një marrëdhënie të caktuar kohëzgjatjen e

punësimit apo një marrëdhënie të përkohshme pune (vetëm përsa i përket punësimit të caktuar gjatë, sepse puna e agjencisë nuk është e rregulluar në Shqipëri).

Janë në proces miratimi aktet e mëposhtme nënligjore:

- Projekt VKM "Për listën e sëmundjeve profesionale", në zbatim të pikës 4, neni 25 të Ligjit;
- Projekt VKM "Për mënyrën e funksionimit të shërbimit mjekësor në punë, përfshirë normat, rregullat dhe procedurat për të siguruar kontrollin mjekësor të pranimit në punë dhe ato periodike të punëmarrësit", në zbatim të pikës 3, neni 23 të Ligjit;
- Projekt VKM "Mbi rregullat, detyrat, pajisjet dhe medikamentet me të cilat duhet të pajiset një strukturë e shërbimit mjekësor shëndetësor në ndërmarrje", zbatim të pikës 2, të nenit 39 të Ligjit;
- Projekt VKM "Mbi përcaktimin e rregullave, procedurave dhe llojet e testeve ekzaminuese mjekësore, që duhet të kryhen në varësi të punës që kryejnë punëmarrësi", në zbatim të pikës 2, të nenit 11 të Ligjit;
- Ratifikimi i Konventës 167 ILO "Siguria dhe shëndeti në punë në ndërtim" dhe C 187 "Kuadri promocional i sigurisë dhe shëndetit në punë". (VKM Nr. 28, datë 11.1.2012 "Për miratimin në parim, të Konventës C. 187, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) "Kuadri promocional i sigurisë dhe shëndetit në punë");

Me mbështetjen e qeverisë franceze, po hartohet një metodologji inspektimi në fushën e bujqësisë. Gjithashtu, në kuadrin e programit TAIEX, është rishikuar metodologjia e përpunimit të të dhënave statistikore, dhe të përmbajtjes së formularit inspektimi, në përputhje me ligjin e ri të sigurisë dhe shëndetit në punë. Së fundmi, ka filluar puna, me asistencën e ILO-s për rishikimin e Kodit të Punës, përfshirë këtu dhe Kapitullin VIII "Sigurimi dhe mbrojtja e shëndetit", në përputhje të plotë me direktivat evropiane dhe konventat e ILO-s.

Është rritur cilësia e inspektimeve sidomos në subjektet që përdorin substanca të rrezikshme dhe kanë risk për sëmundje profesionale. Për t'ju ardhur në ndihmë inspektorëve të punës, është përgatitur dhe shpërndarë një Udhëzues për subjektet që përdorin substanca të rrezikshme, si dhe janë futur disa materiale për Ueb-site, mbi ekspozimin e punëmarrësve ndaj substancave të rrezikshme.

Për t'ju ardhur në ndihmë inspektorëve të punës gjatë inspektimeve në subjektet ku punëmarrësit janë të ekspozuar ndaj agjentëve biologjikë, është përgatitur guida praktike "Vlerësimi i rrezikut ndaj ambienteve biologjikë".
Gjithashtu për rritjen e cilësisë së inspektimit dhe njohjen e standardeve, inspektorëve të punës ju janë vënë në dispozicion VKM Nr. 1012, datë 10.12.2010 "Miratimi i rregullores për sinjalistikën në kantier dhe vendin e punës" dhe VKM Nr. 1022, datë 15.12.2010 "Për miratimin e listës së standardeve të harmonizuara Shqiptare, që kanë karakter referues për prezumimin e konformitetit të pajisjeve mbrojtëse personale".

Janë hartuar fishat e reja të inspektimit, në përputhje me konventat e ratifikuara dhe kërkesat e Ligjit të Sigurisë e Shëndetit në Punë dhe është bërë përmirësim cilësor ne plotësimin e tyre.

Janë hartuar një varg materialesh që ndihmojnë inspektorët e punës në procesin e inspektimit dhe janë vendosur në faqen e internetit të ISHP-së, gjithashtu janë prezantuar në këtë faqe edhe gjithë aktivitetet që zhvillon Inspektorati i Punës dhe Drejtoria e Sigurisë e Shëndetit në Punë.

Në zbatim të MSA-së janë ngritur në çdo Drejtori Rajonale të ISHP-së, grupet e ekspertëve për hetimin e aksidenteve të rënda në punë dhe po trajnohen nga grupi i ekspertëve i ngritur pranë Drejtorisë të Sigurisë e Shëndetit në Punë.

ISHP punon sistematikisht për promovimin e një kulture parandaluese për bërjen e vendeve të punës të sigurt të shëndetshëm e produktive. Për këtë janë zhvilluar konferenca kombëtare dhe rajonale, fushata sensibilizuese etj.

Gjithashtu, në mbështetje të nenit 12, të Ligjit Nr. 9634, datë 30.10.2006 "Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës", Fletorja Zyrtare: Viti 2006, Nr. 124, Faqe 4955; Data e botimit: 27.11.2006, janë miratuar aktet nënligjore, ku parashikohet bashkëpunimi ndërinstitucional midis ISHP-së dhe institucioneve ekzekutive të këtyre ministrive në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, me qëllim parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji Nr. 10237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" ka për objekt përcaktimin e masave, që synojnë garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë të punëmarrësve. Ky ligj transpozon plotësisht Direktivën Kuadër të Komisionit Evropian 89/391/KKE, datë 12 qershor 1989 "Lidhur me zbatimin e masave që synojnë të nxisin përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë", 31989L0391, Gazeta Zyrtare 183, seria L, datë 29 qershor 1989, faqe 0001-0008;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier". Ky akt përcakton kërkesat minimale si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes për promovimin dhe përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë për kantieret e përkohshme ose të lëvizshme, ku janë transpozuar dispozitat e një sërë aktesh ligjore të acquis të BE-së, dhe kryesisht Direktiva 92/57/EC për "Kantieret e përkohshme dhe të lëvizshme" (përputhshmëri e plotë).
- VKM "Për miratimin e rregullores për mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve jonizuese", (e cila nuk është zbardhur akoma në Fletoren Zyrtare) në zbatim të nenit 42, pika 3, e Ligjit "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", ku transpozohet pjesërisht Direktiva 2004/40/EC mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë për punonjësit e ekspozuar ndaj rrezikut të lartë të agjentëve fizikë (fushat elektromagnetike).

- VKM Nr. 1012 datë 10.12.2010 "Rregullorja për sinjalistikën në çdo vend pune dhe në kantieret e ndërtimit", ku gjen përputhshmëri të plotë Direktiva 92/58 "Mbi kërkesat minimale për sinjalistikën e sigurisë dhe shëndetit në punë".
- VKM. Nr. 499, datë 6.5.2009 "Për një shtesë në Vendimin Nr. 384, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave "Për mbrojtjen e të miturve në punë", të ndryshuar (Fletorja Zyrtare: Viti 2009 Nr. 90, Faqe 3946, Data e botimit 18.6.2009). Ky vendim synon përcaktimin e rregullit të kontrollit mjekësor periodik të të miturve, duke bërë një përputhshmëri të plotë me Direktivën e Këshillit 94/33/KKE, e identifikuar si instrumenti evropian referues për të bërë këtë ndryshim. Kjo direktive respekton dhe reflekton në nenet e saj parimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për mbrojtjen e të miturve në punë dhe të Konventës të saj Nr. 38 të vitit 1973 "Mbi moshën minimale të pranimit në punë". Shkalla e Përputhshmërisë - E plotë
- VKM Nr. 409, datë 22.4.2009 "Për një shtesë në VKM Nr. 207, datë 9.5.2002 "Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme" (Fletorja Zyrtare: Viti 2009, Nr. 78, Faqe 3430, Data e botimit 29.5.2009), ku përafrohet neni 6 i Direktivës Nr. 2003/88/KKE "Mbi disa aspekte të rregullit të kohës të punës, 32003L0088, Gazeta Zyrtare 299, seria L e datës 18 nëntor 2003, faqe 0009-0019. Shkalla e Përputhshmërisë - E pjesshme
- VKM Nr. 500, datë 6.5.2009 "Për disa shtesa në VKM nr. 751, datë 7.11.2007 "Për miratimin e strategjisë sektoriale të punësimit dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj". Në Strategjinë Sektoriale të Punësimit, pas kapitullit 5 shtohet një kapitull i ri 6, me titull, "Dokumenti i politikave për sigurinë dhe shëndetin në punë". Për hartimin e këtij dokumenti janë mbajtur në konsideratë kërkesat e strategjisë së BE-së 2007-2012 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", aktet e tjera ndërkombëtare të cilat RSh-së i ka ratifikuar në Kuvend. Shkalla e Përputhshmërisë - E pjesshme
- Udhëzimin Nr. 17, datë 28.9.2011 "Për organizimin e kohës së punës të punëtorëve të lëvizshëm në aviacionin civil" që përafron Direktivën Nr. 2000/79/EC e 27 Nëntorit 2000 "Për organizimin e kohës së punës të punëtorëve të lëvizshëm në aviacionin civil".

Ligje dhe akte që nuk transpozojnë akte evropiane[128]

- Kodi i Punës (nenet 39-75)
- Shqipëria ka ratifikuar, në fushën e sigurisë dhe shëndetit Konventat e ILO-s si më poshtë:
    - Ligji Nr. 9772, datë 12.7.2007 "Për ratifikimin e Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) "Për kontrollin e punës në bujqësi C 129 1969, Fletorja Zyrtare: Viti 2007, Nr 93, Faqe 2655, data e botimit: 26.07.2007;
    - Ligji Nr. 9148 datë 30.10.2003 "Për ratifikimin e protokollit të vitit 2002 të Konventës Nr. 155 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës, 1981 "Fletorja zyrtare: Viti 2003, Nr. 97, Faqe 4206, data e botimit: 3.12.2003;

Shënim: Shkalla e përafrimit, e pjesshme i referohet vetëm konventave të ILO.

- Ligji Nr. 8181, datë 23.1.1997 "Për ratifikimin e Konventës Nr. 81 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës", Fletorja Zyrtare, Nr. 1, Viti 1997, Faqe 4, data e botimit 11.2.1997.
- Ligji Nr. 9634, datë 30.10.2006 "Për inspektimin e Punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës". Fletorja Zyrtare: Viti 2006, Nr. 124, Faqe 4955, data e botimit: 27.11.2006.

Në zbatim të Ligjit "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", janë miratuar:

- VKM Nr. 107, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë". VKM përcakton qartësisht detyrat e personave të ngarkuar përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë (brenda ndërmarrjes), të parashikuar sipas nenit 7, pika 1, të Ligjit "Për sigurinë dhe shëndetin në punë".
- VKM Nr. 108, datë 9.2.2011 "Për përbërjen, rregullat e organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe përfaqësuesit e punëmarrësve". VKM përcakton përbërjen dhe mënyrat e zgjedhjes së përfaqësuesve të punëmarrësve në këshillat e sigurisë dhe shëndetit në punë në nivel ndërmarrje, si dhe dispozita lidhur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave të sigurisë dhe shëndetit në punë në të tre nivelet.
- VKM Nr. 1139, datë 16.7.2008 "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës" (Fletorja Zyrtare: Viti 2008, Nr 135, Faqe 6009; Data e botimit: 26.8.2008)
- VKM Nr. 594 datë 22.12.1997 "Për regjistrin që mban punëdhënësi për punëmarrësit e tij"
- VKM Nr. 384, datë 20.5.1996 "Për mbrojtjen e të miturve në punë", Fletorja Zyrtare Nr. 18, Faqe: 665, datë 24.6.1996
- VKM Nr. 788, datë 14.12.2005 "Për përcaktimin e aksidentit në punë ose për shkak të punës" (Fletorja Zyrtare: Viti 2005, Nr. 98, Faqe 3153; Data e botimit: 23.12.2005)
- VKM Nr. 461, datë 22.7.1998 "Për regjistrin që mban punëdhënësi për aksidentin në punë dhe sëmundjet profesionale" (Fletorja Zyrtare: Viti 2001, Nr. 61, Faqe 1907; Data e botimit: 31.12.2004)
- VKM Nr. 248, datë 13.4.2010 "Për një shtesë në vendimin nr. 207, datë 9.5.2002 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme".
- VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 "Për masa të veçanta të sigurisë dhe higjienës në punë" (Fletorja Zyrtare: Viti 2002, Nr. 21, Faqe 681; Data e botimit: 2.6.2002)
- VKM Nr. 207, datë 9.5.2002 "Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme"; (Fletorja Zyrtare: Viti 2002, Nr. 21, Faqe 681; Data e botimit: 2.6.2002)
- VKM Nr. 205, datë 9.5.2002 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 384, datë 20.5.1996 "Për mbrojtjen e të miturve në punë" (Fletore zyrtare viti 2002, Nr. 18, faqe 587, Data e botimit: 9.5.2002)
- VKM Nr. 742, datë 6.11.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 "Për masa të veçanta të sigurisë dhe higjienës në punë para vënies në punë të ndërmarrjes" (Fletorja Zyrtare: Viti 2003, Nr 94, Faqe 4151; Data e botimit: 18.11.2003)

- VKM Nr. 513, datë 30.7.2004 "Për klasifikimin e veprimtarisë dhe dokumentacionin e procedurën për dhënien e lejes nga inspektori i punës, para vënies në punë të ndërmarrjes". (Fletorja Zyrtare: Viti 2004, Nr 58, Faqe 3787; Data e botimit: 18.08.2004)
- VKM Nr. 164, datë 22.3.2007 "Për bashkëpunimin midis ISHP-së dhe Ministrisë së Brendshme" (Fletore zyrtare viti 2007 Nr 43 faqe 1124, datë e aprovimit 22.3.2007, data e botimit 19.04.2007)
- VKM Nr. 169, datë 28.3.2007 "Për procedurën e lënies së aktit të inspektimit dhe elementet përbërës së tij" (Fletore zyrtare Nr. 43, faqe 1127, data e botimit 19.4.2007)
- VKM Nr. 396, datë 28.6.2007 "Për përcaktimin e sëmundjeve profesionale" (Fletore Zyrtare: Viti 2007, Nr 83, Faqe 2440; Data e botimit: 6.7.2007)
- VKM Nr. 100, datë 2.3.2008 "Për substancat e rrezikshme" (Fletore zyrtare 19 datë 22.2.2008, faqe 679)
- VKM Nr. 696, datë 18.8.2010 "Për bashkëpunimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës me Institucionet e Varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë".
- VKM Nr. 704, datë 25.8.2010 "Për bashkëpunimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës me Institucionet e Varësisë të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës"
- VKM Nr. 708, datë 25.8.2010 "Për bashkëpunimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës me Ministrinë e Mbrojtjes"
- VKM Nr. 709, datë 25.8.2010 "Për bashkëpunimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës me Institucionet e Varësisë së Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit"
- VKM Nr. 710, datë 25.8.2010 "Për bashkëpunimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës me Institucionet e Varësisë së Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 726, datë 1.9.2010 "Për bashkëpunimin e ISHP-së me Ministrinë e Drejtësisë"
- Urdhri i Kryeministrit Nr. 160, datë 29.7.2010 "Për ngritjen e Këshillit Ndërministror për Çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në punë"
- Urdhri i Kryeministrit Nr. 161, datë 29.7.2010 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Ndërministror për Çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në punë"

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë e Energjisë

- Ligji Nr. 7796, datë 17.2.1994 "Ligji Minerar i Shqipërisë", Fletorja Zyrtare: Viti 1994, Nr. 2, Faqe 54; Data e botimit: 18.3.1994.
- Ligji Nr. 9595, datë 27.7.2006 "Për Krijimin e Inspektoratit Qendror Teknik" (Fletorja Zyrtare: Viti 2006, Nr. 84, Faqe: 2871, Data e botimit 27.7.2006)
- Ligji Nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre" (Fletorja Zyrtare: Viti 1999, Nr. 9, Faqe: 262, Data e botimit 3.3.1999)
- VKM Nr. 130, datë 18.3.1999 "Për Inspektoratin Shtetëror të Naftës, Gazit dhe nënprodukteve të tyre", Fletorja Zyrtare: Viti 1999, Nr. 14, Faqe 433; Data e botimit: 4.5.1999;
- Ligji Nr. 8734, datë 1.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve e instalimeve elektrike", Fletore Zyrtare Nr. 4, Faqe:117

- VKM Nr. 494, datë 14.8.2001 "Për organizimin e funksionimin e inspektoratit të pajisjeve e instalimeve elektrike", Fletorja Zyrtare: Viti 2001, Nr. 44, Faqe 1384; Data e botimit: 29.08.2001
- Ligji Nr. 8739, datë 12.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve nën presion", Fletore Zyrtare Nr. 7, Faqe:169
- VKM Nr. 497, datë 14.8.2001 "Për organizimin e funksionimin e IQT në përdorimin e pajisjeve nën presion" Fletorja Zyrtare: Viti 2001, Nr. 44, Faqe 1387; Data e botimit: 29.08.2001;
- Ligji Nr. 8741, datë 15.2.2001 "Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare", Fletore Zyrtare Nr. 7, Faqe:190;
- VKM Nr. 37, datë 28.1.2002 "Për organizimin e funksionimin e Repartit të inspektim e shpëtim në miniera" Fletorja Zyrtare: Viti 2002, Nr 3, Faqe 65; Data e botimit: 15.02.2002
- VKM Nr. 760, datë 8.7.2009, Data e Miratimit: 08.07.2009, Fletore Zyrtare Nr. 118, Faqe:5658;
- Ligjin Nr. 9126, datë 29.7.2003 "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në RSH" (Fletorja Zyrtare: Viti 2003, Nr. 72, Faqe: 3245, Data e botimit 29.07.2003);
- VKM Nr. 533, datë 8.7.2005 "Për rregulloren e teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në RSH". Fletorja Zyrtare: Viti 2005, Nr. 58, Faqe 2073; Data e botimit: 19.07.2005;
- VKM Nr. 1109, datë 30.7.2008 "Për sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë" (Fletorja Zyrtare: Viti 2008, Nr. 130, Faqe 5749; Data e botimit: 8.8.2008).

Ministria e Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit

- Ligji Nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", Fletore Zyrtare Nr. 22, Faqe: 881
- Ligji Nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për Urbanistikën", Fletore Zyrtare Nr. 23, Faqe: 897
- Ligji Nr. 8408, datë 25.9.1998 "Për Policinë e Ndërtimit", Fletore Zyrtare Nr. 23, Faqe: 931
- Ligji Nr. 9251, datë 8.7.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin Nr. 10483, datë 17.11.2011 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9251 datë 8.7.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë" - Pjesa e Katërt "Veprimtaritë në Mjetet Lundruese" Kreu I-II-III, Nenet 99-147)
- Ligji Nr. 9317, datë 18.11.2004 "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" Fletore Zyrtare nr. 95, faqe 6566, Data e botimit 17.12.2004
- Ligji Nr. 9658, datë 18.12.2006 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes Shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, "Për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian"
- VKM Nr. 207, datë 25.2.2009 "Për miratimin e rregullores mbi kontrollin në anë të rrugës e në zyrat e ndërmarrjeve për sa i përket zbatimit të rregullave, të kohës së

punës për personat, që kryejnë transport rrugor dhe për orët e drejtuesve të mjeteve" (nuk është botuar në Fletoren zyrtare)

- Udhëzimin Nr. 17, datë 28.9.2011 "Për organizimin e kohës së punës të punëtorëve të lëvizshëm në aviacionin civil" që përafron Direktivën Nr. 2000/79/EC e 27 Nëntorit 2000 "Për organizimin e kohës së punës të punëtorëve të lëvizshëm në aviacionin civil".

Ministria e Shëndetësisë

- Urdhëresë e hartuar nga Drejtoria e Higjienës Nr. 473/6 Protokolli me 21.8.1982 "Normat sanitare mbi nivelet e lejueshme të zhurmave në mjediset e punës";
- VKM Nr. 447, datë 19.9.1994 "Për ndalimin e përdorimit të asbestit si material termoizolues në të gjitha llojet e ndërtimit" (Fletorja Zyrtare: Viti 1994, Nr 17, Faqe 791; Data e botimit: 20.12.1994);
- Ligji Nr. 7643, datë 2.12.1992 "Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror" (Fletorja Zyrtare: Viti 1992, Nr. 9, Faqe 464, Data e botimit 9.12.1992)
- Ligji Nr. 9635, datë 6.11.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7643/1992 "Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror" (Fletorja Zyrtare: Viti 1992, Nr. 124, Faqe: 4966, Data e botimit 6.11.2006);
- "Rregullore Nr. 80/1998 e Shërbimit të Higjienës dhe ISSH".

Struktura institucionale

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Transportit dhe Ministria e Ekonomisë dhe institucionet e varësisë së tyre.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

- Drejtoria e Politikave të Inspektimit dhe Marrëdhënieve të Punës;
- Inspektorati Shtetëror i MPCS.

Drejtoria e politikave të inspektimit ka si mision hartimin e politikave të inspektimit, duke kontribuar në përmirësimin e marrëdhënieve, kushteve të punës, si dhe të legjislacionit që i rregullon këto marrëdhënie.

Përcakton rregullat e mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe politikat shtetërore në këtë fushë. Ajo transpozon të drejtën komunitare dhe siguron zbatueshmërinë e legjislacionit në këtë fushë, me ndihmën e partnerëve socialë. Ajo ka një rol kryesor në evidentimin dhe parandalimin e rreziqeve profesionale të reja që mund të kenë efekt negativ në shëndetin e punëmarrësve për një kohë të gjatë.

Roli i saj, është gjithashtu, në sigurimin korrekt të zbatueshmërisë së teksteve ligjore në fuqi dhe rregulloreve të sigurisë dhe shëndetit në punë. Për këtë të fundit, DPI mbështetet në punën e punonjësve të Inspektoratit Shtetëror të Punës.

Inspektorati Shtetëror i Punës është autoriteti më i lartë ekzekutiv i politikave të inspektimit dhe përgjigjet para Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, përgjegjës në fushën e inspektimit.

Me Urdhër të Kryeministrit Nr. 87, datë 25.10.2011, në kuadër të reformimit të inspektorateve, është përmirësuar struktura e Inspektoratit Shtetëror të Punës. Aktualisht Drejtoria e Përgjithshme ka 35 punonjës dhe Drejtoritë Rajonale kanë 135 punonjës. Pra, ISHP ka gjithsej 170 punonjës, 12 Drejtori Rajonale dhe 1 Zyrë Vendore në Sarandë. Në Drejtorinë e Përgjithshme është krijuar një drejtori e re, Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore, në kuadër të reformës në inspektim. Misioni i saj është të sigurojë që Legjislacioni i Punës të zbatohet nga punëdhënësit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

ISHP-ja në ushtrimin e veprimtarisë së saj mbështetet në aktet ligjore dhe nënligjore si më poshtë vijon:

- Ligji Nr. 9634, datë 30.10.2006 "Për inspektimin në punë dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës"
- VKM Nr. 1139, datë 16.7.2008 "Për organizimin dhe funksionimin e ISHP-së'
- Rregullores së ISHP-së të miratuar me Urdhër Ministri Nr. 1269, datë 28.7.2010

Ministria e Shëndetësisë

- Drejtoria e Shëndetit Publik, organizon, drejton dhe kontrollon hartimin dhe zbatimin e politikave shëndetësore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe programit të qeverisë në fushën e shëndetit publik dhe kujdesit shëndetësor parësor, përmes sigurimit të zbatimit të masave parandaluese, higjienike, antiepidemike, informuese, edukuese dhe mjekuese, mbështetur në legjislacionin në fuqi.
- Misioni i Institutit të Shëndetit Publik, si qendra Kombëtare në fushën e shëndetit publik, konsiston në zhvillimin dhe aplikimin e parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve, dëmtimeve, paaftësive, e faktorëve dëmtues shëndetësorë të mjedisit, dhe zhvillimin dhe aplikimin e promocionit të shëndetit, në bashkëpunim të ngushtë me agjenci/organizma/organizata kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ministria e Transportit

Drejtoria e Politikave të Ndërtimit ka si mision: Hartimi i politikave në fushën e ndërtimit në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptarë me atë evropian dhe në përgjigje të ritmit të zhvillimit e arritjeve të teknologjisë në këtë fushë, si dhe unifikimi i metodologjisë së llogaritjes së kostos dhe hartimi i manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit, për të bërë të mundur një administrim cilësor dhe efektiv të përdorimit të fondeve publike.

Drejtoria e Politikave të Transportit Ajror është strukturë e administratës shtetërore të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe kryen funksionet e saj administrative e operacionale brenda juridiksionit te saj, në përputhje me legjislacionin në

fuqi dhe aktet normative që rregullojnë procedurat dhe marrëdhëniet në administratën shtetërore.

Misioni i Drejtorisë së Transportit Ajror është përpilimi i politikave të infrastrukturës dhe të investimeve në fushën e transportit ajror në përputhje me strategjitë qeveritare.

Masat legjislative afatshkurtra

Bazuar në angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, prioritete afatshkurtra për fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, janë:

- Plotësimi në mënyrë progresive i legjislacionit shqiptar në përputhje me atë të Bashkimit Evropian, për kushtet e punës si dhe mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- Hartimi i VKM-së "Për një ndryshim në VKM Nr. 500, datë 6.5.2009 "Për disa shtesa në VKM Nr. 751, datë 7.11.2007 "Për miratimin e strategjisë sektoriale të punësimit dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj". Në Strategjinë Sektoriale të Punësimit, pas kapitullit 5 shtohet një kapitull i ri 6, me titull "Dokumenti i politikave për sigurinë dhe shëndetin në punë";
- Projektligj "Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9634, datë 30.10.2006 "Për inspektimin e Punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës";
- Projektligj "Mbi disa ndryshime në Ligjin Nr. 10237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë";
- Projekt VKM "Për rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të MPCSSHB";
- Projekt VKM "Për vlerat limit profesionale nga ndotja e ajrit, lëndëve kimike, zhurmave dhe dridhjeve." Ky akt do të përafrojë plotësisht:
    - Direktiva 2002/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 qershor 2002 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që lindin prej agjentëve fizikë (vibrimi) (Direktiva e gjashtëmbëdhjetë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC);
    - Direktiva 2003/10/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 6 shkurt 2003 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që lindin prej agjentëve fizikë (zhurma) (Direktiva e shtatëmbëdhjetë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC);
    - Direktiva e Këshillit 98/24/EC të 7 Prill1998 mbi mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve prej rreziqeve të lidhura me agjentët kimikë në punë (Direktiva e katërmbëdhjetë brenda kornizës së Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC);
    - Direktiva e Komisionit 91/322/EEC, 29 Maj 1991, mbi përcaktimin e vlerave limit mbi mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve prej rreziqeve të lidhura me agjentët kimikë në punë;

- Direktivave 2000/39/EC; 8 Qershor 2000, mbi përcaktimin e listës së parë të vlerave limit mbi mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve prej rreziqeve të lidhura me agjentët kimikë në punë;
- Direktiva 2066/15/EC; 7 Shkurt 2006, mbi përcaktimin e listës së dytë të vlerave limit mbi mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve prej rreziqeve të lidhura me agjentët kimikë në punë, në zbatim të Direktivës 98/24/EC dhe amendimit të Direktivës 2000/39/EC;
- Direktiva 2009/161/EU; 17 Dhjetor 2009, mbi përcaktimin e listës së tretë të vlerave limit mbi mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve prej rreziqeve të lidhura me agjentët kimikë në punë, në zbatim të Direktivës 98/24/EC dhe amendimit të Direktivës 2000/39/EC;

- Projekt VKM "Për përcaktimin e listës së punëve të vështira që dëmtojnë shëndetin e gruas";
- Projekt VKM "Për rregullat e veçanta që përcaktojnë punën e natës te gratë";
- Projekt Udhëzim i Përbashkët i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta "Për aspekte të caktuara të organizimit të kohës së punës" që përafron Direktivën Nr. 2003/88 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 4 nëntor 2003 (Nr. celex: 32003L0088; Fletore Zyrtare e KE-se L 299, 18.11.2003, p. 9–19);
- Projekt Udhëzim i Përbashkët i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta "Për përcaktimin e masave që nxisin përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në punë" që përafron Direktivën e Këshillit Nr 89/391/EEC të datës 12 qershor 1989 (Nr. celex 31989L0391, Fletore Zyrtare e KE L 183, 29.6.1989, p. 1–8);
- Projekt VKM që përcakton kërkesat minimale për kushtet e sigurisë në vendin e punës, që përafron Direktivën e Këshillit 89/654/EEC datë 30 nëntor 1989 mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës (Direktiva e parë brenda kornizës së Nenit 16(1) të Direktivës 89/391/EEC);
- Projekt VKM që përcakton kërkesat minimale të mbrojtjes së punëtorëve nga rreziku i ambienteve shpërthyese, që përafron Direktivën 1999/92/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 dhjetor 1999 mbi kërkesat minimale për përmirësimin e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së punonjësve që janë nën rrezikun e ajrit të presuar (atmosferëve) eksplozivë (Direktiva e pesëmbëdhjetë brenda kornizës së Nenit 16(1) të Direktivës 89/391/EEC);
- Projekt VKM për përcaktimin e kërkesave minimale të përdorimit të mjeteve mbrojtëse individuale në vendin e punës, që përafron Direktivën e Këshillit 89/656/EEC datë 30 nëntor 1989 mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin nga ana e punonjësve të pajisjeve të punës, në vendin e punës (Direktiva e tretë brenda kornizës së Nenit 16(1) të Direktivës 89/391/EEC)

Ministria e Shëndetësisë

Në zbatim të Ligjit Nr. 10237 datë 18.2.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", janë përcjellë për mendim në Ministritë e linjës projekt aktet e mëposhtme:

- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e funksionimit të shërbimit mjekësor në punë përfshirë normat rregullat dhe procedurat për të siguruar kontrollin mjekësor të pranimit në punë dhe ato periodike për punëmarrësin".

Projekt VKM u hartua nga MSH dhe MPCSSHB. Parashikohet miratimi i tij brenda tremujorit të parë të vitit 2012. Projekt VKM nuk transpozon ndonjë Direktivë të BE, apo Vendim të Këshillit të Evropës.

- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave, procedurat, dhe llojet e testeve ekzaminuese mjekësore që do të kryhen në varësi të punës që kryejnë punëmarrësit". Projektvendimi u hartua nga MSH dhe MPCSSHB, Parashikohet miratimi i tij brenda tremujorit të parë të vitit 2012. Projektvendimi nuk transpozon ndonjë Direktivë të BE, apo Vendim të Këshillit të Evropës.
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e listës së sëmundjeve profesionale". Projektvendimi u hartua nga MSH dhe MPCSSHB. Parashikohet miratimi i tij brenda tremujorit të parë të vitit 2012. Projektvendimi nuk transpozon ndonjë Direktivë të BE, apo Vendim të Këshillit të Evropës. (lista e sëmundjeve profesionale bazohet në deklaratën ILO 2010).
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për mbrojtjen e Shëndetit në lidhje me mjedisin e punës dhe për nxitjen e shëndetit në vendin e punës ,si dhe të mjekësisë së punës dhe për sëmundjet profesionale". Projektvendimi u hartua nga MSH dhe MPCSSHB. Parashikohet miratimi i tij brenda tremujorit të katërt të vitit 2012.

Masat zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e angazhimeve gjatë periudhës afatshkurtër, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- Blerje zyrash për Drejtoritë Rajonale të Inspektoratit të Punës Berat, Lezhë, Kukës, Gjirokastër;
- Organizimi i 13000 kontrolleve nëpër subjektet private me qëllim sigurimin e zbatueshmërisë së legjislacionit të punës; inspektime të planifikuara dhe të specializuara;
- Krijimi i kushteve të përshtatshme me infrastrukturë të Zyrave Rajonale të Inspektoratit të Punës Berat, Lezhë, Kukës nëpërmjet implementimit të sistemit të informimit dhe komunikimit të inspektimit të punës, nëpërmjet kompjuterizimit të gjerë të ISHP-së; trajnimi i 122 inspektorëve për përdorimin e këtij sistemi;
- Krijimi i një bërthame ekspertesh të kualifikuar dhe me përvojë, për inspektimet e specializuara dhe hetimet e aksidenteve të rënda në punë, që do të funksionojë si strukturë brenda Drejtorisë së Përgjithshme të ISHP-së;
- Përfshirja në kurrikulat e niveleve të ndryshme të sistemit arsimor të koncepteve që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë;
- Botimi i fletëpalosjeve, afisheve, broshurave;
- Organizimi i takimeve dhe tryezave të rrumbullakëta me përfaqësues të biznesit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, aty ku hasen vështirësitë më të mëdha për zbatueshmërinë e ligjit të sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Organizimi i fushatave sensibilizuese për inkurajimin e qytetarëve në bashkëpunim me median e shkruar dhe vizive;
- Vënia në dispozicion për publikun e një linje telefoni për të regjistruar të gjitha ankesat dhe sugjerimet e punëdhënësve dhe të punëmarrësve;
- Organizimi i trajnimeve për njohjen e legjislacionit në fuqi në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë;

- Kualifikimi dhe trajnimi i mjekëve të punës, të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme në kuadër të Javës Evropiane për sigurinë dhe shëndetin në punë nën sloganin "Vend pune i shëndetshëm, mirë për ne, mirë për biznesin";
- Bashkëpunimi me Institutin e Shëndetit Publik për monitorimin e situatës të sëmundjeve profesionale të shkaktuara nga ndotja e ambienteve të punës.

Ministria e Shëndetësisë

- Zbatimi i planit të veprimit të përcaktuara nga dokumenti politik strategjik i sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Fuqizimi i organeve të ISHP-së, përmes krijimit të kushteve të kënaqshme të punës, trajnimit të duhur, sistemit të informimit, strukturave organizative dhe bashkëpunimit me trupat e tjera të inspektimit;
- Krijimi i "Regjistrit kombëtar të Mjekëve të Punës" (MSH);
- Trajnime teorike dhe praktike për punëmarrësit në vendin e punës nga (mjeku i punës dhe ISSH, ISSHP);
- Përcaktimi i elementeve standard që duhet të përmbajë paketa e ndihmës së parë në ndërmarrje, kushtet e ruajtjes, aksesi, kontrolli dhe rifreskimi i elementëve të saj. (MSH, OBSH);
- Hartimi i Modulit të raportimit nga Strukturat e Shëndetit Publik dhe ISHP mbi gjendjen dhe vlerësimin e shëndetit të punëmarrësve (ISHP, MSH);
- Hartimi i modelit të fletës së deklarimit të sëmundjeve profesionale dhe procesverbalit të sëmundjeve profesionale (MSH);
- Forcim i mëtejshëm i kapaciteteve inspektuese: trajnim i inspektoreve, përmirësim i instrumenteve të inspektimit;
- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative në nivel rajonal dhe lokal edukim dhe promocion shëndetësor, marrëdhënie me publikun, monitorim-vlerësim, etj.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatmesëm synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

- Përgatitja e rregulloreve, në zbatim të pikës 3, neni 42 të Ligjit Nr. 10237 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" nga Ministritë e linjës me qëllim përputhjen e plotë të akteve ligjore e nënligjore me *acquis* e BE-së.

Masat zbatuese afatmesme

- Organizimi i 13500 kontrolleve nëpër subjektet private me qëllim sigurimin e zbatueshmërisë së legjislacionit të punës; inspektime të planifikuara dhe të specializuara;
- Krijimi i kushteve të përshtatshme me infrastrukturë në të 12 zyrat rajonale nëpërmjet implementimit të sistemit të informimit dhe komunikimit të inspektimit të punës,

nëpërmjet kompjuterizimit të gjerë të ISHP-së; trajnimi i 130 inspektorëve për përdorimin e këtij sistemi;

- Botimi i fletëpalosjeve, afisheve, broshurave;
- Organizimi i takimeve dhe tryezave të rrumbullakëta me përfaqësues të biznesit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, aty ku hasen vështirësitë më të mëdha për zbatueshmërinë e ligjit të sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Organizimi i fushatave sensibilizuese për inkurajimin e qytetarëve në bashkëpunim me median e shkruar dhe vizive;
- Vënia në dispozicion për publikun e një linje telefoni për të regjistruar të gjitha ankesat dhe sugjerimet e punëdhënësve dhe të punëmarrësve;
- Organizimi i trajnimeve për njohjen e legjislacionit në fuqi në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Kualifikimi dhe trajnimi i mjekëve të punës, të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme në kuadër të Javës Evropiane për sigurinë dhe shëndetin në punë nën sloganin "Vend pune i shëndetshëm, mirë për ne, mirë për biznesin";
- Bashkëpunimi me Institutin e Shëndetit Publik për monitorimin e situatës të sëmundjeve profesionale të shkaktuara nga ndotja e ambienteve të punës.

Ministria e Shëndetësisë

- Ngritja e laboratorëve të sëmundjeve profesionale. Fondi i investimit 175,000,000 Lek, për pilotimin e laboratorëve të mirëfilltë të mjekësisë së punës, në Drejtoritë Rajonale të Shëndetësisë;
- Riorganizim i trupave inspektuese në rrethe, etj;
- Trajnimi i inspektorëve sanitarë shtetërorë që do të mbulojnë fushën e sëmundjeve profesionale;
- Evidentimi dhe regjistrimi në regjistër të veçantë i të gjitha strukturave private (kabinete, laboratorë) që do të mbulojnë ekzaminimet shëndetësore për sëmundjet profesionale;
- Ngritja dhe forcimi i rolit të mjekut të punës dhe mjekut të sëmundjeve profesionale (programe trajnuese). Fond investimit 450,000,000 (kualifikime për mjekët e punës dhe të sëmundjeve profesionale të paktën për një periudhë njëvjeçare);
- Negocimi për hapjen e kurseve të Specializimit për mjekësinë e punës dhe mjekësinë e sëmundjeve profesionale.

Implikimet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**1.782.000**	**478.000**	**154.000**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	1.782.000	478.000	154.000	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.19.3. DIALOGU SOCIAL

Objektivi strategjik

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e dialogut social është inkurajimi i tij për të kontribuar në përmirësimin e qeverisjes dhe në performancën ekonomike, forcimi i Organizatave të Punëdhënësve dhe Sindikatave si dhe harmonizimi në mënyre progresive i legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, sikurse është parashikuar në Nenin 70 të MSA.

Situata aktuale

Në Shqipëri janë krijuar dhe ushtrojnë aktivitetin 83 sindikata, ku një pjesë e tyre e ushtrojnë aktivitetin nën ombrellën e konfederatave, ndërkohë që pjesa tjetër vepron në mënyrë të pavarur. Dy Konfederatat më të mëdha dhe me influencë tepër të ndjeshme janë: Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH), dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH), të cilat përfaqësohen me nga 3 anëtarë në Këshillin Kombëtarë të Punës. Dy konfederatat e mëdha përfaqësojnë rreth 90 për qind të anëtarëve të sindikatave në Shqipëri. KSSH-së dhe BSPSH janë të përfaqësuar në 12 qarqe të Shqipërisë dhe veprojnë kryesisht në sektorët e arsimit dhe shkencës, punonjësve të administratës dhe pensionistët, industri, bujqësi dhe në industrinë ushqimore, në sektorin e shëndetit publik, transportit, naftës, ndërtimit, tekstileve dhe zejtarisë, tregti, metalurgji dhe kimi, telekom. Vihet re se Sindikatat shtrihen në sektorin publik dhe në ndërmarrjet private (ish shtetërore) ndërsa në sektorin privat të sapokrijuar ky përfaqësim është i dobët.

Përsa i përket punëdhënësve ekzistojnë një sërë organizatash punëdhënësish si: Këshilli i Organizatave Punëdhënëse të Shqipërisë (KOPSH), Konfindustria shqiptare, Konfederata KOP, Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve dhe Këpucëve, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, Bashkimi i Investitorëve dhe Industrialistëve të Shqipërisë të cilat përfaqësohen edhe në KKP dhe marrin pjesë aktivisht në diskutimin e çështjeve të ndryshme që lidhen me biznesin si në KKP ashtu dhe në borde të tjera. Vihet re se Organizatat e punëdhënësve në krahasim me sindikatat janë më të dobëta nga pikëpamja organizative dhe shkrirja territoriale. Pavarësisht nga këto dobësi ato kanë arritur të influencojnë nëpërmjet KKP në ngritjen dhe zgjidhjen e disa problemeve të tyre.

Kohët e fundit janë bërë përpjekje nga organizatat e punëdhënësve dhe kompani të ndryshme të biznesit për t'u bashkuar në një organizate ombrelle që është "Biznes Albania" me qëllim që të rrisin rolin dhe influencën e tyre në jetën sociale dhe ekonomike të vendit.

Përsa i përket situatës së kontratave kolektive janë lidhur 27 kontrata kolektive në nivel qendror por nuk ka "kontratë kolektive" kombëtare për të gjitha degët pasi deri më sot nuk ekziston një organizim i tillë i punëdhënësve që të ketë autoritetin për të nënshkruar kontratën kolektive të nivelit kombëtar me sindikatat.

Në sektorin publik janë të mbuluar me marrëveshje kolektive 85% e të punësuarve, ndërsa në sektorin privat mbulimi nga kontratat kolektive të punës është 14%. Nivel i ulet i kontraktimit në sektorin privat shpjegohet jo vetëm me organizimin e dobët të sindikatave në këtë sektorë

por edhe me mungesën e kulturës së dialogut dhe skepticizmi nga ana e punëdhënësve ndaj sindikatave. Gjithashtu, vihet re se kontraktimi kolektiv është më i zhvilluar në zonat urbane, sidomos në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë dhe kjo për arsye të përqendrimit të ndërmarrjeve më të mëdha në këto zona.

Nxitja dhe zhvillimit i dialogut social si dhe forcimi i marrëdhënieve të partneritetit social përbën një nga objektivat prioritare të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Gjatë viteve të fundit vihet re një përmirësim i dukshëm në veprimtarinë dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe të komisioneve të tij të specializuara trepalëshe. Tregues i këtij përmirësimi është diskutimet dhe trajtimet e problemeve të ndryshme me interes të veçantë për punëdhënësit dhe sindikatat (kryesisht në sektorin e energjetikës, ndërtimit dhe industrinë fasoniste) si dhe marrja në konsideratë dhe zgjidhja e tyre nga Këshilli i Ministrave. Në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së KKP, në bashkëpunim me partnerët socialë dhe me mbështetjen e Zyrës së ILO-së në Budapest, u rishikua dhe me konsensus u miratuan ndryshimet përkatëse të Rregullores së Këshillit Kombëtar të Punës. Një tregues tjetër i përmirësimit të dialogut social është arritja e mirëkuptimit dhe konsensusit për rritjen e pagës minimale në shkallë vendi në vitin 2011, e cila synonte mbrojtjen e punëmarrësve nëpërmjet përcaktimit të standardit dinjitoz të shpërblimit të punës së punëmarrësit, në përputhje me kushtet dhe rrethanat dhe stadin e zhvillimit social-ekonomik të vendit.

Në muajin shkurt 2011, me qëllim nxitjen dhe forcimin e dialogut social trepalësh dhe të marrëdhënieve të partneritetit social u realizua nënshkrimi i një Pakti Trepalësh të Mirëkuptimit Social midis Qeverisë, Organizatave të Punëdhënësve dhe Organizatave të Punëmarrësve. Nënshkrimi i këtij pakti mirëkuptimi është kurorëzimi i përpjekjeve të përbashkëta i cili do të kontribuojë gjithashtu, për sigurimin e stabilitetit dhe paqes sociale në vend.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), nenet 124,138,139, 148, 159-196 dhe 200-202;
- VKM Nr. 730, datë 6.11.2003 "Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë Këshill";
- VKM Nr. 16, datë 13.1.2006 "Për disa ndryshime e shtesa në vendimin nr 730, datë 6.11.2003, të Këshillit të Ministrave "Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë Këshill";
- VKM Nr. 741, datë 6.11.2003 "Për procedurën e pajtimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Zyrave Shtetërore të Pajtimit";
- VKM Nr. 740, datë 6.11.2003 "Për mënyrën e organizimit dhe procedurën e votimit, për përcaktimin e përfaqësueshmërisë së organizatave të punëmarrësve";
- VKM Nr. 132, datë 24.2.2010 "Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të Organizatave të Punëmarrësve dhe të Punëdhënësve në KKP";
- Urdhri i Ministrit Nr. 549/1, datë 17.3.2010 "Për emërimin e anëtarëve dhe kandidateve të KKP, përfaqësues të Organizatave të Punëmarrësve dhe Punëdhënësve";

- Urdhri i Ministrit Nr. 1026, datë 6.5.2010 "Për caktimin e Kryetarëve të komisioneve të specializuara, trepalëshe, të përhershme të Këshillit Kombëtar të Punës;
- Urdhri i Ministrit Nr. 960/1, datë 12.5.2010 "Për ngritjen dhe vënien në lëvizje të Zyrave Shtetërore të Pajtimit"
- Urdhri i Kryeministrit Nr. 246, datë 18.10.2006 "Për caktimin e Përfaqësuesve të Ministrive, për bashkëpunimin me Partnerët Sociale";
- Urdhri i Ministrit Nr. 2082, datë 10.10.2006 "Për krijimin e Rrjetit Shtetëror të Ndërmjetësimit";
- Udhëzimi i Ministrit Nr. 2083, datë 10.10.2006 "Për organizimin dhe funksionimin e Rrjetit Shtetëror të Ndërmjetësimit";
- Urdhri i Ministrit Nr. 25, datë 22.2.2011 "Për formularin tip të votimit që përdoret në procedurën e votimit për përcaktimin e përfaqësueshmërisë së organizatave të punëmarrësve";
- Rregullorja e Funksionimit të Këshillit Kombëtar të Punës.

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në nxitjen dhe zhvillimin e dialogut social janë Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe institucionet e varësisë së saj, Këshilli Kombëtar i Punës, Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional, Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Funksionet politikëbërëse realizohen nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nëpërmjet Drejtorisë së Politikave të Inspektimit dhe Marrëdhënieve të Punës. Kjo drejtori përbëhet nga 2 sektorë: Sektori i Politikave të Inspektimit, Sektori i Marrëdhënieve të Punës dhe Pagave. Kjo Drejtori është përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit në fushën e inspektimit në punë, duke krijuar bazën për kushtet e punës dhe të punësimit, parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale, mbrojtjes social-juridike të punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, nxitja dhe zhvillimi i dialogut social ne kuadrin e partneritetit social, me synim harmonizimin e interesave të palëve.

Këshilli Kombëtar i Punës është institucioni më i lartë trepalësh i dialogut social në shkallë vendi, i cili e ushtron veprimtarinë e tij, në bazë të nenit 200 të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë", (ndryshuar), VKM Nr. 730, datë 6.11.2003 "Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe për caktimin e Përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë Këshill" dhe rregullores së funksionimit të tij.

Këshilli Kombëtar i Punës përbëhet nga 27 anëtarë, ku Qeveria përfaqësohet me 7 anëtarë (Ministra) dhe organizatat e punëmarrësve dhe punëdhënësve përfaqësohen me nga 10 anëtarë. Misioni i KKP është ruajtja e ekuilibrave sociale nëpërmjet harmonizimit të interesave të palëve, arritja e mirëkuptimit social nëpërmjet zhvillimit të dialogut Qeveri-Partnerë Socialë, minimizimi i konflikteve sociale dhe arritja e marrëveshjeve të pranuara nga palët nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe shqyrtimit të propozimeve e alternativave të propozuara.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë"; rishikimi dhe harmonizimi i tij me standardet ndërkombëtare të punës dhe direktivat e Bashkimit Evropian;
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillave Konsultative Trepalëshe në nivel rajonal";
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për procedurat e shtrirjes së efekteve të kontratës kolektive të punës";
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të Organizatave të Punëmarrësve dhe të Punëdhënësve në KKP";
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave " Për një ndryshim në VKM-në Nr. 730, datë 6.11.2003 "Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë Këshill", për përcaktimin e treguesve të përfaqësueshmërisë;
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi";
- Urdhri i Ministrit "Për emërimin e anëtarëve dhe kandidatëve të KKP, përfaqësues të Organizatave të Punëmarrësve dhe Punëdhënësve";
- Urdhri i Ministrit "Për caktimin e Kryetarëve të komisioneve të specializuara, trepalëshe, të përhershme të Këshillit Kombëtar të Punës".

Masat zbatuese afatshkurtra

- Seminare kualifikuese trepalëshe, në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për parandalimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kolektive të punës nëpërmjet ndërmjetësimit dhe pajtimit;
- Seminare kualifikuese trepalëshe për funksionimin e Këshillave Konsultative Trepalëshe Rajonal në 3 prefektura (në varësi të ndryshimeve në Kodin e Punës);
- Seminare kualifikuese trepalëshe për njohjen me shtesat dhe ndryshimet e bëra në Kodin e Punës, organizuar me Zyrat e Punësimit, Organizatat e Punëdhënësve dhe Organizatat e Punëmarrësve.

Masat legjislative afatmesme

- Hartimi dhe dërgimi për miratim i projektvendimit "Për caktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

Masat zbatuese afatmesme

- Organizmi i Seminareve kualifikuese trepalëshe "Zbatimi i të Drejtës së Punës në Shqipëri";
- Organizmi i Seminareve kualifikuese trepalëshe, për parandalimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kolektive të punës nëpërmjet ndërmjetësimit dhe pajtimit në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimit;
- Organizmi i Konferencës Trepalëshe Vjetore e Punës.

Implikimet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**2.379.000**	**520.000**	**85.000**	**90.000**
Mbulohen nga buxheti i	2.379.000	520.000	85.000	90.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.19.4. PUNËSIMI DHE FONDI SOCIAL EVROPIAN

Objektivi strategjik

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e punësimit, për periudhën afatgjatë është realizimi i pajtueshmërisë me instrumentet komunitare për Shtetet Anëtare në fushën e lëvizjes së punonjësve, duke pasur parasysh situatën në tregun e punës në Shtetet Anëtare si dhe në varësi të legjislacionit që ato kanë; krijimi i lehtësirave ekzistuese për akses në punësim për shtetasit shqiptarë, të akorduara nga Shtetet Anëtare me anë të marrëveshjeve dypalëshe; bashkëpunimi për lehtësimin e reformave dhe politikave shqiptare të punësimit, në kontekstin e forcimit të reformave ekonomike dhe të integrimit; përshtatja e legjislacionit shqiptar për sa u përket kushteve të punës dhe mundësive të barabarta për gratë si dhe ngritja e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe trajnimit profesional në Shqipëri.

Po ashtu, nenet 46, 47, 48, 77, 99 të MSA-së përcaktojnë se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, do të ketë si synim modernizimin dhe ristrukturimin e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional, zbatimit të programeve aktive dhe pasive të punësimit si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave në fushën e tregut të punës dhe formimit profesional me rregullat dhe standardet komunitare.

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet zbatimit të Strategjisë sektoriale të punësimit dhe formimit profesional dhe konkretisht duke:

- Ulur nivelin e papunësisë me 0.3% - 0.4% çdo vit;
- Rritur numrin e të punësuarve me 1.9% - 2.2% në vit;
- Hartuar programe për hapjen e vendeve të reja të punës dhe mbajtjen e atyre ekzistuese;
- Nxitur formimin profesional gjatë gjithë jetës;
- Rritur investimet në kapitalin njerëzor;
- Siguruar mbështetje shtetërore për të papunë dhe grupet në nevojë;
- Përmirësuar performancën e rrjetit të shërbimeve të punësimit brenda kapaciteteve ekzistuese;
- Krijuar një klimë pozitive për zhvillimin e biznesit dhe investimeve, rritur konkurueshmërinë e SME-ve në tregun rajonal dhe atë global, nëpërmjet zhvillimit të

teknologjisë dhe informacionit, reduktimit të barrierave administrative dhe krijimit të lehtësirave për biznesin;
- Ngushtuar gradualisht peshën e sektorit informal.

Situata aktuale

Forca e punës për vitin 2011 (Tremujori i III-Burimi INSTAT) rezulton 1,071,948 persona, numri i të punësuarve gjithsej në shkalle vendi është 929,866 persona, në sektorin bujqësor privat 506,664 persona, në sektorin shtetëror 165,000 persona dhe në sektorin privat jo bujqësor 258,202 persona. Niveli i punësimit është më i lartë për meshkujt. Ky tregues është më i lartë për meshkujt e të gjitha grup moshave. Analiza e nivelit të punësimit sipas gjinisë në vite, tregon se niveli i punësimit të femrave ka qenë dukshëm më i ulët se ai i meshkujve. Femrat e punësuara kanë një pjesëmarrje më të madhe në sektorin privat bujqësor, ndërkohë që meshkujt janë më të angazhuar në sektorin privat jo-bujqësor.

Shkalla e papunësisë për vitin 2011 (Tremujori i III-Burimi INSTAT) është 13.25% dhe në vlerë absolute janë 142,082 persona të regjistruar si të papunë pranë zyrave rajonale dhe vendore të punësimit. Shkalla e papunësisë është më e lartë në grup moshat e reja deri 30 vjeç. Vlerat krahasuese të papunësisë, tregojnë se niveli i papunësisë është më i lartë tek femrat sesa tek meshkujt.

Për të përmirësuar situatën e tregut të punës nga ana e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ofrohen shërbimet e punësimit si dhe hartohen programet e nxitjes së punësimit, të cilat zbatohen nga ana e Shërbimit Kombëtar të Punësimit nëpërmjet rrjetit të zyrave rajonale dhe vendore të punësimit. Gjatë vitit 2011 janë realizuar 11,555 punësime nëpërmjet ndërmjetësimit të ofruar nga ana e zyrave të punësimit.

Programet e nxitjes së punësimit janë programe aktive shtetërore të cilat veprojnë drejtpërsëdrejti në grupin e punëkërkuesve të papunë për t'i nxitur ata në gjetjen e një punësimi afatgjatë. Këto programe së bashku me programin e ndërmjetësimit në punë ndikojnë realisht në uljen e numrit të të papunëve të regjistruar si dhe largimin e tyre nga skemat pasive të mbështetjes me të ardhura (pagesa e papunësisë dhe ndihma ekonomike).

Aplikimi i programeve të nxitjes së punësimit bazohet në një kuadër ligjor që u krijua prej vitit 1999 e në vazhdim me daljen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 7995 "Për nxitjen e punësimit" datë 20.9.1995 (i ndryshuar). Përfitues të programeve të nxitjes së punësimit janë klientët e zyrave të punësimit, punëkërkues dhe punëdhënës.

Aktualisht zbatohen:

- Programi sipas VKM Nr. 873 datë 27.12.2006 "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit";
- Programi sipas VKM Nr. 47, datë 16.1.2008 (i ndryshuar) "Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, nëpërmjet formimit në punë";

- Programi sipas VKM nr. 48, datë 16.1.2008 (i ndryshuar) "Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, në vështirësi".

Gjatë vitit 2011 janë hartuar edhe dy programe të reja të cilat do të zbatohen gjatë vitit 2012, dhe konkretisht: "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë" dhe "Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta".

Një politikë tjetër që zbatohet në tregun e punës është formimi profesional, me synimin e integrimit dhe riintegrimit në tregun e punës, kryesisht të punëkërkuesve të papunë të regjistruar në zyrat rajonale dhe vendore të punësimit por edhe të personave të tjerë që kërkojnë të rrisin nivelin e tyre të aftësive profesionale për t'iu përshtatur ndryshimeve që ndodhin në tregun e punës. Gjatë vitit 2011 në qendrat publike të formimit profesional në vendin tonë (sqarojmë se janë 10 të shtrira në qytetet kryesore të vendit) janë regjistruar 10,450 persona. Pjesëmarrës në kurset e përfunduara kanë qenë 8,949 persona nga të cilët janë certifikuar 8,531 persona. Nga këto 4,751 persona kanë qenë femra dhe 4,159 persona kanë qenë të papunë.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji Nr. 7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- VKM Nr. 751, datë 7.11.2007 "Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të punësimit dhe formimit profesional 2007 – 2013";
- VKM Nr. 42, datë 17.1.1998 "Për miratimin e statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit", i ndryshuar;
- VKM Nr. 873, datë 27.12.2006 "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papune që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit";
- VKM Nr. 47, datë 16.1.2008 "Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë" (i ndryshuar);
- VKM Nr. 48, datë 16.1.2008 "Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, në vështirësi" (i ndryshuar);
- VKM Nr. 27, datë 11.1.1012 "Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta";
- VKM Nr. 199, datë 11.1.2012 "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë";
- VKM Nr. 616, datë 4.12.2002 "Për përcaktimin e kategorive te tjera te grupeve te veçanta qe përfitojnë nga Ligji Nr. 8872, datë 29.03.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë";
- VKM Nr. 196, datë 20.3.2003 "Për standardet e zhvillimit të kurrikulave të arsimit dhe formimit profesional";
- VKM Nr. 675, datë 25.9.2003 "Për përcaktimin e procedurave të krijimit, organizimit dhe mbylljes së institucioneve të formimit profesional, në varësi të MPÇSSHB";

- VKM Nr. 543, datë 31.10.2002 “Për akreditimin e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional (AFP)”;
- VKM Nr. 321, datë 21.4.2011 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”.

Struktura institucionale

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e tregut të punës dhe formimit profesional është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta- Drejtoria e Politikave të Punësimit; është përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive, legjislacionit (në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Juridike) për fushën e punësimit dhe formimit profesional
- Shërbimi Kombëtar i Punësimit- SHKP është institucioni përgjegjës për zbatimin e masave dhe programeve aktive dhe pasive në tregun e punës.

Zyrat rajonale dhe vendore të punësimit janë institucione në varësi të SHP-së të cilat luajnë një rol aktiv në zbatimin e politikave të tregut të punës për të luftuar papunësinë strukturore duke kryer aktivitete të ndryshme të lidhura këto me analizën e situatës së tregut të punës, ndërmjetësim për punë (përputhjen e kërkesës me ofertën për punë), orientim dhe këshillim për punëkërkuesit, përgatitjen e dokumentacionit të përfitimeve të papunësisë, orientim dhe vendosje në kurset e formimit profesional, si dhe zbatimin e programeve për nxitjen e punësimit.

Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik janë institucione në varësi të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nëpërmjet të cilave realizohet ofrimi i shërbimit të formimit profesional, si një politikë aktive e tregut të punës e fokusuar për punëkërkuesit e papunë por edhe personave të tjerë me synimin integrimin dhe riintegrimin e tyre në tregun e punës.

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit dhe Kualifikimeve Profesionale; është institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës por që ofron shërbimet e saj edhe për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në drejtime dhe funksione të rëndësishme si hartimi dhe përmirësimi i kurrikulave, trajnimi i trajnerëve, vlerësimi, certifikimi, në sistemin e formimit profesional etj.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional”.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për modalitetet e kryerjes së praktikave profesionale në ndërmarrje nga nxënësit dhe kursantët e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional dhe teknik, si dhe format e mbështetjes, kriteret dhe kushtet e mbështetjes shtetërore”.

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për rishikimin e Vendimit Nr. 675, datë 25.9.2003, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave të krijimit, organizimit dhe mbylljes së institucioneve të formimit profesional, në varësi të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta".

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Realizimi i studimeve periodike afatshkurtra të tregut të punës;
- Pajisja me bazën e nevojshme materiale/didaktike për mësimin teorik dhe praktik të qendrave publike të formimit profesional;
- Vazhdimi i decentralizimit të menaxhimit të sistemit të AFP-ve në drejtim të shkollave apo qendrave të AFP;
- Vijimi i punës për institucionalizimin e metodologjisë së hartimit të kurrikulave të AFP;
- Kompletimi i procesit të informatizimit të tregut të punës në gjithë sistemin e shërbimit publik të punësimit duke shfrytëzuar investimet e donatorëve të huaj dhe Qeverisë Shqiptare;
- Monitorimi dhe vlerësimi i programeve të nxitjes së punësimit.
- Institucionalizimi i bashkëpunimit midis AFP dhe biznesit lokal.
- Mbështetje e kurrikulit të AFP-ve me "tekste integrale".
- Krijimi i shërbimit për orientimin profesional dhe këshillimin për karrierë në bashkëpunim me partnerët socialë.

Aktivitete zbatuese afatmesme

- Fillimi i punës për hartimin e strategjisë së ardhshme sektoriale në fushën e punësimit dhe formimit profesional;
- Hartimi i kritereve të vlerësimit dhe certifikimit në fushën e AFP;
- Vijimi i punës për krijimin e shërbimit për orientimin profesional dhe këshillimin për karrierë në bashkëpunim me partnerët socialë;
- Vijimi i punës për institucionalizimin e bashkëpunimit midis AFP dhe biznesit lokal.
- Vijimi i monitorimit dhe vlerësimi të programeve të nxitjes së punësimit.
- Vijimi i pajisjes me bazën e nevojshme materiale/didaktike për mësimin teorik dhe praktik të qendrave publike të formimit profesional.

POLITIKAT PËR PUNËSIMIN E TË RINJVE

Statusi aktual

MTKRS udhëheq Strategjinë Kombëtare të Rinisë dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë 2007-2013, miratuar me VKM Nr. 782, datë 16.11.2006. Kjo strategji është ndërsektoriale, afatgjatë dhe përfshin politika të gjithanshme në fushën e rinisë si dhe thekson bashkëpunimin me partnerët dh organizatat rinore.

Një nga drejtimet kryesore të strategjisë është dhe Punësimi i të rinjve ku forcimi i statusit social-ekonomik të rinise luan një roj mjaft të rëndësishëm në zhvillimin e vendit.

Masat e marra gjatë vitit 2010-2011

- Dokumenti për Ri-shikimin e Politikave Rinore në Shqipëri realizuar nga Këshilli i Evropës, i cili përbën një dokument të rëndësishëm udhërrëfyes në lidhje problematikën, prioritetet dhe alternativat e implementimit të strategjisë, planit të veprimit dhe politikave rinore në nivel kombëtar;
- Në kuadër të Programit të Kombeve të Bashkuara (UN) "Youth Employment and Migration" është hartuar Plani Kombëtar i Aksionit për Punësimin e të Rinjve për vitet 2010-2013, si rezultat i punës së politikëbërësve në ministritë e linjës. Plani përvijohet në katër objektiva strategjikë si dhe në një sërë çështjesh të rëndësishme që duhet të ndiqen për të mbështetur punësimin e plotë, të frytshëm dhe në përputhje me zgjedhjet e vetë të rinjve;
- Mbështetja dhe zhvillimi i vazhdueshëm i programeve të intership-it me qëllim krijimin e mundësive për studentët që studiojnë jashtë vendit, për t'u integruar në tregun e punës dhe zhvillimin e karrierës në Shqipëri;
- Programi Rinia, ka realizuar mbështetjen e Projekteve Rinore duke pasur si qëllim kryesor forcimin e kapaciteteve të organizatave rinore, promovimin e nismave rinore dhe zhvillimin i një sektori të qëndrueshëm të OJF-ve rinore;
- Zhvillimi i Panaireve te punësimit rinor, të cilat ndihmojnë në lançimin e vendeve të reja të punës nga administrata publike dhe biznesi duke bërë të mundur rritjen e aksesit të informacionit tek të rinjtë;
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me organizata të ndryshme të cilat përfaqësojnë interesat e të rinjve që studiojnë jashtë vendit për të lehtësuar komunikimin dhe bashkëpunimin e tyre të drejtpërdrejtë me institucionet publike;
- Programe trajnuese për rininë "Si të nisësh një biznes ose si të hartosh një plan biznesi", për të rritur kapacitetin e tyre në këtë drejtim;
- Studimi i nevojave të tregut për mundësi punësimi.

Masat afatshkurtra

- Realizimi i Programe trajnuese "për orientimin e të rinjve drejt kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimin e aftësive të tyre" me qëllim aftësimin e të rinjve në këtë drejtim dhe në forcimin e kapaciteteve të tyre;
- Nxitja e iniciativave dhe partneritetit ndërmjet institucioneve publike dhe atyre private me qëllim përfshirjen e sektorit privat për zhvillimin e programeve aktive për punësimin. Sektori privat si siguruesi kryesor i vendeve të punës, luan një rol të qenësishëm në kërkimin e zgjidhjeve të efektshme për problemet e punësimit të të rinjve;
- Krijimi i zyrave të karrierës në Universitete me qëllim informimin dhe aftësimin e të rinjve për mundësitë e punësimit dhe shkollimit;
- Organizimi i Panaireve të Punës do të ndihmojë në lancimin e vendeve të reja të punës nga administrata publike dhe nga sektori privat, duke krijuar mundësinë në integrimin e tregut të punës.

Masat afatmesme

- Miratimi i ligjit për Rininë, i cili do të ketë si qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimit të statusit të tyre përmes mbështetjes së iniciativave rinore, rritjen e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën publike dhe në proceset e vendimmarrjes;
- Analizën e situatës së tregut të punës në përgjithësi dhe të rinjve në veçanti. Rishikimin e politikave dhe programeve ekzistuese që prekin punësimin e të rinjve, kuadri institucional dhe koordinimi i punësimit të rinjve; Bashkëpunimi për zhvillim në punësimin e të rinjve;
- Ofrimi i informacioneve të dobishme për të rinjtë shqiptar që kthehen nga studimet jashtë Shqipërisë, në kuadër të programit "Brain Gain";
- Realizimi i programeve të punësimit sezonal;
- Ngritja e zyrave të karrierës në shërbim të të rinjve;
- Rritja e fondit të të rinjve për të mbështetur programet në fushën e rinisë por edhe veprimtarinë e tyre.

Implikimet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**14.352.000**	**10.000.000**	**10.000.000**	**10.000.000**
Mbulohen nga buxheti i	14.352.000	10.000.000	10.000.000	10.000.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.19.5. PËRJASHTIMI SOCIAL

Romët

Objektivi strategjik

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e mbrojtjes së minoritetit Rom, është zbatimi i Strategjisë Kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom", duke luftuar përjashtimin social dhe diskriminimin, bazuar në instrumentet ndërkombëtare në këtë fushë si dhe kuadrin ligjor të brendshëm dhe objektivat kryesore të programit të Qeverisë në fushën e mbrojtjes së minoriteteve. Qeveria Shqiptare duke u anëtarësuar në Prill 2008 në iniciativën "Dekada e Romëve angazhohet për realizimin e objektivave të kësaj iniciative në fushat e punësimit, arsimimit, strehimit dhe shëndetit, si dhe për të nxitur dhe mbështetur pjesëmarrjen dhe përfshirjen e minoritetit Rom në këtë proces.

Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të minoritetit Rom garantohet nga Kushtetuta dhe legjislacioni aktual, i cili po përmirësohet dhe plotësohet me të njëjtin ritëm të përmirësimit të legjislacionit shqiptar në përgjithësi.

Në këtë kuadër Konventa Kuadër "Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare", e cila pas ratifikimit është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe ka forcën e ligjit, është një garanci për mbrojtjen e të drejtave të minoritetit Rom në Shqipëri.

- VKM Nr. 633, datë 18.9.2003 për miratimin e Strategjisë Kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom";
- VKM Nr. 437, datë 8.4.2008 "Për anëtarësimin e Këshillit të Ministrave të RSH-së në Deklaratën "Dekada e Përfshirjes së Romëve";
- VKM Nr. 1087, datë 28.10.2009 "Për miratimin e Planit Kombëtar të veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2005-2015".

Statusi aktual

Analiza e situatës aktuale

Minoriteti Rom jeton në Shqipëri përkrah minoriteteve të tjera dhe konsiderohet si minoritet gjuhësor. Popullsia rome përbëhet nga disa fise dhe është vendosur në territorin e vendit tonë rreth fundit të shekullit të XIII. Lidhur me numrin e minoritetit rom në Shqipëri nuk ka statistika të plota dhe të sakta, por sipas përfaqësuesve të organizatave të këtij minoriteti apo studimeve të realizuara nga institute të pavarura ky numër varion nga 30,000 - 120,000 persona gjithsej. Përgjithësisht minoriteti rom banon në zonat periferikë urbane dhe në zonat rurale. Përqendrimet më të mëdha të kësaj popullsie janë në Tiranë, Fier, Elbasan, Durrës, Berat, Korçë, Vlorë dhe Fushë Krujë.

Mungesa e statistikave të sakta ka qenë një pengesë e madhe për analizimin e gjendjes social-ekonomike të këtij komuniteti. Megjithatë duke u mbështetur në vlerësimin e situatës së këtij komuniteti dhe duke marrë në konsideratë analizat, studimet, vëzhgimet dhe raportet e realizuara nga institucionet shtetërore dhe organizatat jo qeveritare, Qeveria Shqiptare miratoi në shtator të vitit 2003 Strategjinë Kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom". Strategjia ishte iniciativa e parë e ndërmarrë nga qeveria shqiptare për të adresuar problemet me të cilat përballej komuniteti rom në Shqipëri. Hartimi dhe zbatimi i saj kishte qëllim të dyfishtë. Së pari, synonte plotësimin e detyrimeve që rridhnin nga ratifikimi i Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Së dyti, duke synuar procesin e integrimit me BE po përpiqej të përmbushte kriteret politike të vendosura nga Deklarata e Kopenhagen-it. Me VKM Nr. 437, datë 8.4.2008, i ndryshuar me VKM Nr. 455, datë 16.6.2011, Republika e Shqipërisë u anëtarësua ne Deklaratën Dekada e Romëve.

Shqipëria ka pasur dhe vazhdon të ketë një angazhim të përhershëm, përsa i përket përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pjesë përbërëse e të cilave janë dhe të drejtat e minoritetit Rom. Këtë fakt e ka dëshmuar gjithashtu anëtarësimi i vendit tonë në organizatat ndërkombëtare, si Organizata e Kombeve të Bashkuara Këshilli i Evropës, OSBE, etj, si dhe ratifikimi apo aderimi në një sërë konventash ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe në mënyrë të veçantë, në ratifikimin pa asnjë rezervë të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës "Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare".

Në kuadër të OKB-së, Republika e Shqipërisë është palë në instrumentet më të rëndësishme për të drejtat e njeriut si vijon:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, (aderuar më 1955);
- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike ICCPR, (aderuar me Ligjin Nr. 7510, datë 8.8.1991);
- Protokolli Opsional i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (aderuar me Ligjin Nr. 9725, datë 7.5.2007);
- Protokolli i Dytë Shtesë i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike mbi heqjen e dënimit me vdekje (aderuar me Ligjin Nr. 9726, datë 7.5.2007);
- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (aderuar me Ligjin Nr. 7511, datë 8.8.1991);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial-ICERD, (aderuar më 1994);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave- CEDAW (aderuar me Ligjin Nr. 7767, datë, 9.11.1993);
- Protokolli Shtesë i Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (ratifikuar me Ligjin Nr. 9052, datë 17.4.2003);
- Konventa kundër Torturës, Trajtimeve të Egra Çnjerëzore dhe Degraduese (aderuar me Ligjin Nr. 7727, datë 30.6.1993);
- Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës, Trajtimeve të Egra Çnjerëzore dhe Degraduese –OPCAT (ratifikuar 2003);
- Konventa mbi të drejtat e fëmijëve (ratifikuar me Ligjin Nr. 7531, datë 11.12.1991);
- Protokolli Opsional "Mbi shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin me Fëmijët dhe Pornografinë" (aderuar me Ligjin Nr. 9834, datë 22.11.2007);
- Protokolli Opsional "Mbi Përfshirjen e Fëmijëve në Konfliktet e Armatosura (aderuar me Ligjin Nr. 9833, datë 21.12.2007;
- Konventa "Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre" (aderuar me Ligjin Nr. 9703, datë 2.7.2007);
- Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. (Shqipëria e ka nënshkruar këtë Konventë në datën 22 dhjetor dhe aktualisht po ndiqen procedurat e brendshme për ratifikimin dhe hyrjen në fuqi të saj);

Në kuadër të Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Evropian, janë nënshkruar të gjitha dokumentet e saj, si:

- Akti Final i Konferencës së Helsinkit, 1975;
- Deklarata e Kopenhagenit, 1990;
- Karta e Parisit për një Evropë të re, 1990;
- Dokumenti i Konferencës së Moskës, 1991.

Në kuadër të Këshillit të Evropës, janë nënshkruar dhe ratifikuar një numër të konsiderueshëm dokumentesh të rëndësishme:

- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, (nënshkruar nga Republika e Shqipërisë më ratifikuar me Ligjin Nr. 8137, datë 31.7.1996 dhe hyrë në fuqi më 1996) dhe Protokollet 1, 2, 4, 6, 7, 11, 13,14;
- Konventa Kuadër "Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare" është nënshkruar nga Republika e Shqipërisë më 29.6.1995, ratifikuar me Ligjin Nr. 8496, datë 3.6.1999, dhe ka hyrë në fuqi me 1.1.2000;
- Konventa Evropiane për Televizionin Ndërkufitar 1999 (ratifikuar me Ligjin Nr. 8525, datë 9.9.1999);
- Marrëveshja e Pjesshme e Zgjeruar e Qendrës Evropiane të Gjuhëve Moderne, (ratifikuar me Ligjin Nr. 8706, datë 1.12.2000);
- Karta Evropiane Sociale të Rishikuar, (nënshkruar nga Shqipëria në 1998, ratifikuar më 2002, hyrë në fuqi më 1 Janar 2003);
- Konventa mbi Shtetësinë (nënshkruar nga Shqipëria në vitin 1999, ratifikuar me 11.2.2004 dhe ka hyrë në fuqi 1.6 2004);
- Konventa Evropiane "Për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në nivel Lokal (nënshkruar 9.6.2004, ratifikuar më 19.7.2005 dhe hyrë në fuqi 1.11 2005);
- Protokolli shtesë i Konventës mbi krimin kibernetik, lidhur me penalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobe nëpërmjet sistemeve kompjuterike" (nënshkruar nga Shqipëria më 26.5.2003, ratifikuar më 26.11.2004 dhe ka hyrë në fuqi më 1.3.2006).

Në kuadër të UNESCO-s:

- Konventa "Për Mbrojtjen dhe Nxitjen e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore", ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në Shtator 2006.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të minoritetit Rom garantohet nga Kushtetuta dhe legjislacioni aktual, i cili po përmirësohet dhe plotësohet me të njëjtin ritëm të përmirësimit të legjislacionit shqiptar në përgjithësi.

Në këtë kuadër Konventa Kuadër "Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare", e cila pas ratifikimit është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe ka forcën e ligjit, është një garanci për mbrojtjen e të drejtave të minoritetit Rom në Shqipëri.

Kuadri ligjor aktual i cili garanton respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoritetit Rom:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë miratuar me Ligjin Nr. 8417, datë 28.10.1998, ndryshuar me Ligjin Nr. 9675, datë 13.1.2007, ndryshuar me Ligjin Nr. 9904, datë 21.4.2008;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 396, datë 22.8.1994 "Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Minoriteteve";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 502, datë 5.8.1996 "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 396, datë 22.08.1994 "Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Minoriteteve";

- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004 – 2015, të miratuar me VKM Nr. 538, datë 12.8.2004 dhe Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë (2008-2013);
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 14, datë 3.9.1994, përcakton kriteret e hapjes dhe të funksionimit të njësive të shkollimit të personave të minoriteteve;
- Ligji Nr. 8239, datë 3.9.1997 "Për një ndryshim në Ligjin Nr. 7756, datë 11.10.1993 "Për Shtypin";
- Ligji Nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji Nr. 8454, datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i plotësuar me Ligjin Nr. 8600, datë 10.4.2000, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9398, datë 12.05.2005;
- Ligji Nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike";
- Ligji Nr. 8773, datë 23.4.2001 "Për tubimet";
- Ligji Nr. 8291, datë 25.2.1998 "Kodi i Etikës së Policisë";
- Ligji Nr. 9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit";
- Ligji Nr. 9888, datë 10.3.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim";
- Ligji Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile";
- Ligji Nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi";
- VKM Nr. 127, datë 11.3.2004 "Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet";
- VKM Nr. 633, datë 18.9.2003 për miratimin e Strategjisë Kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom";
- VKM Nr. 508, datë 8.8.2007 "Për një ndryshim dhe shtesë në VKM Nr. 632, datë 18.9.2003 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, femra";
- VKM Nr. 437, datë 8.4.2008 "Për anëtarësimin e Këshillit të Ministrave të RSH-së në Deklaratën "Dekada e Përfshirjes së Romëve";
- VKM Nr. 366, datë 15.4.2009 "Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë";
- VKM Nr. 1087, datë 28.10.2009 "Për miratimin e Planit Kombëtar të veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2005-2015".

Struktura institucionale

Në hartimin dhe zbatimin e politikave për minoritetet në përgjithësi dhe Minoritetit Rom në veçanti , Shqipëria mbështetet në detyrimet që dalin nga Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare e Këshillit të Evropës. Strukturat që janë të angazhuara me mbrojtjen e minoriteteve dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës të minoritetit Rom" dhe Planit të Veprimit të "Dekadës së Përfshirjes së Romëve" janë:

Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, i cili bashkëpunon me organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, me organizata e shoqata që kryejnë veprimtari për ushtrimin e të drejtave dhe lirive të minoriteteve, për përmirësimin e standardeve në respektimin e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri. Komiteti gjithashtu propozon masa konkrete për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe arsimor të pakicave. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve ka në përbërjen e tij përfaqësues të

minoriteteve kombëtare dhe etnogjuhësore në Shqipëri. Në këtë komitet romët kanë një përfaqësues nga komuniteti i tyre.

Sektori i të Drejtave të Njeriut, Minoriteteve dhe Raportimeve në Drejtorinë e Organizatave Ndërkombëtare, Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Sigurisë dhe Organizatave Ndërkombëtare, në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Sektori i të Drejtave të Njeriut, Minoriteteve dhe Raportimeve ndjek përmbushjen e angazhimeve dhe detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e të drejtave të minoriteteve, si dhe në bashkëpunim me institucionet e linjës do të ndjekë në vazhdimësi çështjet e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve dhe koordinimin dhe zbatimin e politikave mbi minoritetet. Gjithashtu ky sektor ka si objektiv të mbajë dhe të zhvillojë dialogun zyrtar me përfaqësuesit e shoqatave të minoriteteve, të nxisë dhe të mbështesë veprimtarinë dhe aktivitetet e shoqatave të tyre, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre gjuhësor, kulturor, fetar dhe kombëtar.

Sekretariati Teknik për Romët, në Drejtorinë e Monitorimit të Strategjive Ndërsektoriale, në Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i cili ka për detyrë:

- Monitorimin e zbatimit të objektivave dhe masave prioritare të përcaktuara në këtë strategji, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, Ministrinë e Financave dhe donatorë të ndryshëm për sigurimin e fondeve të nevojshme për realizimin e objektivave të kësaj strategjie;
- Nxitjen dhe ndërgjegjësimin e institucioneve, strukturave rajonale dhe pushtetit vendor për t'u përfshirë në zbatimin e strategjisë së komunitetit rom;
- Vendosjen dhe mbajtjen e kontakteve me ministritë e linjës dhe institucionet përgjegjëse të përfshira në zbatimin e strategjisë;
- Vendosjen e bashkëpunimit me shoqatat e komunitetit rom dhe OJF-të e ndryshme që veprojnë në fushën e minoriteteve për zbatimin e strategjisë;
- Bashkëpunimi me donatorë dhe OJF-të për fuqizimin e kapaciteteve të sektorit dhe të institucioneve në nivel qendror, rajonal dhe lokal për zbatimin e strategjisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, lidhur me çështjet e regjistrimit.

Drejtoria e Arsimit Fillor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, e cila mbulon edhe problemet e arsimimit të minoriteteve.

INSTAT - Drejtoria e Statistikave Sociale, është përgjegjëse për prodhimin e statistikave të profilit social e demografik dhe veçanërisht për punën përgatitore dhe zbatimin e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë.

Drejtoria e Librit dhe e Bibliotekave me sektorin e kulturës së diasporës dhe minoriteteve pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Qëllimi i sektorit është përmirësimi i vazhdueshëm i hapësirave ligjore në fushën e diasporës dhe minoriteteve dhe përafrimi i tyre në përputhje me standardet e BE, ndërtimi i politikave të zhvillimit në fushën e diasporës dhe minoriteteve për të ruajtur dhe promovuar edhe më tej identitetin kombëtar të shqiptarëve që jetojnë e punojnë në vendet e huaja, si edhe në mbrojtjen e karakteristikave

thelbësore që përbëjnë gjuhën dhe kulturën e komuniteteve të kombësive të huaja që jetojnë në Shqipëri

Masat legjislative afatshkurtra

- VKM për pagesën prej 20,000 Eurosh të kuotizacionit të përvitshëm që duhet të paguajë qeveria shqiptare si pjesë e iniciativës "Dekada e Përfshirjes së Romëve";
- VKM për rezervimin e kuotave për studentët romë në institucionet e arsimit të lartë, në kuadër të Planit të Veprimit të "Dekadës së Përfshirjes së Romëve";
- Përmbushja e angazhimeve që rrjedhin nga Konventa Kuadër për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të minoriteteve.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Zbatimi i Strategjisë kombëtare për Romët, si pjesë e strategjisë së qeverisë për të luftuar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror;
- Zbatimi i angazhimeve të ndërmarra në kuadër të Iniciativës "Dekada e Përfshirjes së Romëve" dhe monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit të "Dekadës së Përfshirjes së e Romëve";
- Organizimi i tryezave të përbashkëta në 12 qarqet e vendit për ti njohur me përditësimin e strategjisë dhe Planin të Veprimit të "Dekadës së Përfshirjes së Romëve"e Strategjisë;
- Realizimi i ciklit të dytë të trajnimeve në 10 Qarqet ku ka komunitet Rom për të bërë të mundur informatizimin për hedhjen e të dhënave në nivel lokal në fusha si arsimi, shëndetësia, strehimi dhe punësimi dhe më pas këto të dhëna do të përcillen në zyrën e Sekretariatit Teknik nëpërmjet një programi kompjuterik dhe një rrjeti të ngritur për këtë qëllim;
- Realizimin e projektit të UNDP-së në bashkëpunim me strukturat shtetërore në nivel qendror dhe lokal për realizimin e projektit tre vjeçar që përfundon në 2013 dhe partner kryesor është Sekretariati Teknik për Romët;
- Takimet dy herë në vit të Grupit Ndërministror për organizimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të Strategjisë Kombëtare për Romët dhe Planit të Veprimit të "Dekadës së Përfshirjes së Romëve";
- "Dita e Kulturës së Minoriteteve" (një bashkëpunim i Komitetit Shtetëror të Minoriteteve, Ministrisë së Turizmit, Kulturës,Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës Çështjeve sociale dhe Shanseve të Barabarta);
- "Dita e Minoritetit Rom" (një bashkëpunim i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta) i organizuar në funksion të evidentimit të vlerave kulturore të Minoritetit Rom në vendin tonë;
- "Dita e Tolerancës së Minoritetit Rom Herdelezi". Një aktivitet që ka për qëllim dhënien e shembujve pozitivë të tolerancës në radhët e minoritetit Rom në vendin tonë;
- Zbatimi i planit kombëtar të MASH për Braktisjen Zero 2010 – 2014;

- Zbatimi sistematik dhe i financuar i Projektit "Shansi i dytë" për fëmijët e grupeve etnike në nevojë dhe grupeve të margjinalizuara;
- Identifikimi i të gjithë fëmijëve romë, egjiptian dhe fëmijëve me aftësi të kufizuar në sistemin arsimor dhe jashtë tij dhe integrimi i tyre në sistem;
- Realizimi i veprimtarive edukative individuale për zhvillimin gjuhësor të fëmijëve romë, që hasin vështirësi në komunikimin në gjuhën shqipe, në kuadër të programit edukativ të kopshtit për të ndihmuar integrimin e tyre në sistemin e detyruar arsimor;
- Përfshirja me prioritet e fëmijëve 5-6 vjeçar të minoritetit Rom në kopshte dhe klasa përgatitore për mësimin e gjuhës shqipe për t'i përgatitur për klasën e parë;
- Sigurimi nga autoritetet lokale i shërbimit të transportit shkollor për nxënësit romë, që e kanë shkollën larg qendrës së banimit;
- Organizimi në nivel DAR/ZA dhe shkolle i aktiviteteve ndërkulturore me prindër dhe nxënës Rom dhe nxënës që vijnë nga popullsia maxhoritare, me qëllim rritjen e njohurive dhe mirëkuptimit midis fëmijëve;
- Përgatitja e dokumentacionit të standardizuar për mbështetjen e nxënësve me përparim të dobët dhe të nxënësve në rrezik braktisjeje.

Masat legjislative afatmesme

- Përmbushja e angazhimeve të ndërmarra në fushën e respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të minoriteteve, për arritjen e standardeve më të larta në këtë fushë.

Masat zbatuese

- Organizimi i takimeve me shoqatat që përfaqësojnë minoritetin Rom, si dhe institucionet shtetërore, lidhur me respektimin, mbrojtjen e të drejtave të këtij Minoriteti dhe problematikën e tyre;
- Ndjekja dhe përmbushja e detyrimeve periodike që rrjedhin nga Konventa Kuadër për mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, pas paraqitjes së Opinionit të Komitetit Këshillues, të Konventës Kuadër lidhur me raportin mbi minoritetet të paraqitur nga Shqipëria;
- Përgatitja e komenteve të qeverisë shqiptare lidhur me raportin periodik mbi minoritetet, të paraqitur nga Shqipëria;
- Realizimi i Strategjisë Kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së Minoritetit Rom" dhe i Planit të Veprimit të Dekadës së Përfshirjes së Romëve" e cila ka një afat 2005-2015;
- Organizimin e Konferencës Kombëtare me rastin e 8 Prillit, ditës Ndërkombëtare të Romëve;
- Realizimin e projektit IPA të Komisionit Evropian dhe projektit të OSBE-së të cilat mbështesin Minoritetin Rom dhe do të kenë një kohëzgjatje 2 vjeçare;
- Ngritja e grupit të gjuhës dhe të kulturës rome në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës, ku prej vitesh funksionojnë katedra e gjuhëve ballkanike, në kuadrin e Dekadës Rome;
- Përgatitja e programeve të kualifikimit dhe të trajnimit sistematik (fillestar dhe në vazhdimësi) të mësuesve të gjuhës Rome;

- Përfshirja në kurrikulat e fakulteteve, në degët e mësuesisë, të programit të gjuhës Rome si lëndë me zgjedhje;
- Përfundimi i reformimit të kurrikulës së arsimit bazë dhe vijimi i punës në arsimin e mesëm, në fushën e arsimimit të minoriteteve;
- Hartimi i planit të ri mësimor 9-vjeçar për minoritetet, si dhe i programeve të reja për klasat I, II, III, IV,V dhe VI, VII, VIII, IX të minoriteteve, nga specialistë dhe mësues të minoritetit;
- Pajisja me libra dhe mjete mësimore të të gjithë fëmijëve romë, mbështetur në VKM Nr. 107, datë 10.2.2010 "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të Sistemit të Arsimit Parauniversitar";
- Krijimi i një fondi të veçantë për bursa studimi për nxënësit që ndjekin shkollën e mesme dhe për studentët romë.

Përfshirja Sociale

Objektivi strategjik

Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale (SNPS) e miratuar me VKM Nr. 218, datë 3.2.2008 është një pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Ajo synon të përqendrohet në rritjen e mundësive të punësimit, përmirësimin e arsimit dhe trajnimit për shanse më të mëdha punësimi për grupet dhe individët në rrezik për përjashtim social, siç kategorizohen në strategjinë për përfshirje sociale.

Me vizionin e SNPS dhe realizimin e objektivave të saj synohet reduktimi i varfërisë , më shumë mirëqenie dhe një zhvillim i qëndrueshëm që të krijojë mundësi për përfshirjen sociale të çdo individi dhe garantimin e kohezionit social të gjithë shoqërisë.

Statusi aktual

Analiza e situatës aktuale

Reformat ekonomike dhe sociale të ndërmarra vitet e fundit, kanë sjellë rezultate të prekshme në reduktimin e varfërisë. Në tërësi, treguesit socialë, sasiore dhe cilësore tregojnë një përmirësim të situatës por edhe fushat ku duhet të ketë intensifikim të ndërhyrjeve për grupet në nevojë.

Objektivat e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta lidhur me SNPS synojnë përfshirjen e grupeve dhe individëve dhe mbulimin e nevojave të tyre nëpërmjet programeve që synojnë rritjen e të ardhurave apo atë të shërbimeve alternative. Në këtë proces, është parë me përparësi fuqizimi i strukturave sektoriale për grupet në nevojë, nevoja për përmirësimin e kuadrit ligjor që synojnë mbrojtjen e të drejtave për PAK, sigurimin e përfshirjes së komunitetit Rom në jetën socio-ekonomike të vendit, etj. Ndryshimet legjislative, institucionale dhe zbatimi i programeve të reja për grupet në nevojë si gratë, fëmijët, PAK, romë, të moshuar si dhe ndryshime cilësore të standardeve të shërbimeve janë pjesë e realizimit të objektivave të Strategjisë.

Në përputhje me situatën sociale, ekonomike dhe demografike si dhe duke marrë parasysh objektivat makroekonomikë e socialë dhe zhvillimet në kuadrin e integrimit evropian është e arsyeshme që realizimet si dhe fushat që identifikohen për ndërhyrje duhet të shikohen në një kontekst të gjerë. Politikat aktive të punësimit po implementohen si mjet për reduktimin e papunësisë dhe përjashtimit social me programe të veçanta për grupet në nevojë dhe bazë ligjore përkatëse. Rritja e aksesit në arsim dhe kualifikim profesional për grupet e veçanta në tërësi janë në funksion të zhvillimeve të tregut të punës dhe përqasjet e reja synojnë që t'i zgjerojnë këto ndërhyrje në kuadrin e integrimit dhe zhvillimeve evropiane.

Progresi i deritanishëm drejt mbrojtjes dhe përfshirjes për grupet e përjashtuara, krijimi i modeleve të reja vlerësuese si dhe numri i shërbimeve në rritje flasin për mbështetjen për PAK, të moshuar, të rinjtë në nevojë, gratë në nevojë dhe fëmijët si dhe parashtrojnë sfida të tjera për të ardhmen.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë miratuar me Ligjin Nr. 8417, datë 28.10.1998, ndryshuar me Ligjin Nr. 9675, datë 13.1.2007, ndryshuar me Ligjin Nr. 9904, datë 21.4.2008, sanksionon parimet universale të të drejtave të njeriut;
- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004 – 2015, e miratuar me VKM Nr. 538, datë 12.08.2004 dhe Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë (2008-2013), garantojnë arsimimi i të gjitha shtresave të shoqërisë shqiptare;
- Ligji Nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Përgatitja e këtij ligji është kontribut i shoqërisë civile me asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë në këtë fushë, si dhe ky ligj është përafruar plotësisht me direktivat e BE-së;
- VKM Nr. 508, datë 8.8.2007 "Për një ndryshim dhe shtesë në VKM Nr. 632, datë 18.09.2003 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, femra";
- VKM Nr. 366, datë 15.4.2009 "Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë".

Struktura institucionale

Institucionet e qeverisë shqiptare që janë të përfshira në politikat e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale janë: MPÇSSHB, SHSSH, SHKP, ISSH, si dhe ministritë e tjera sipas fushave respektive që mbulojnë (shëndeti, arsimi, strehimi, transporti, drejtësia, kultura).

Në MPÇSSHB është ngritur Drejtoria e Monitorimit të Strategjive Ndërsektoriale e cila nëpërmjet sektorëve përkatës monitoron zbatimin e Strategjisë Përfshirjes Sociale, Strategjisë për Komunitetin Rom, Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar. Po në këtë ministri, Drejtoria e Politikave të Mbrojtjes Sociale harton politikat kundër varfërisë dhe përjashtimit social.

Shërbimi Social Shtetëror është institucion qendror që ndjek zbatimin e këtyre politikave në të gjithë vendin nëpërmjet 12 Zyrave Rajonale të Mbrojtjes Sociale. Në nivel vendor, të gjitha

bashkitë kanë zyrat e tyre të mbrojtjes sociale të cilat janë përgjegjëse për përcaktimin e familjeve të varfra dhe atyre në nevojë si dhe të grupeve vulnerabile e atyre në rrezik të përjashtimit social.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit është institucion qendror që ndjek zbatimin e politikave aktive dhe pasive të punësimit, ku përfshihen edhe programe specifike për të mundësuar punësimin e grupeve në nevojë. Në vartësi të këtij institucioni janë 36 Zyra Lokale të Punësimit në të gjithë vendin, ku ofrohen shërbime këshillimi dhe ndërmjetësimi për punësimin e personave punëkërkues të papunë.

Janë rreth 30 institucione publike të përkujdesit social në të gjithë vendin që ofrojnë shërbime sociale për grupe të ndryshme vulnerabile si: shtëpitë e foshnjës, shtëpitë e fëmijëve jetime, shtëpitë e të moshuarve, qendra zhvillimi për fëmijë me aftësi të kufizuar, qendra për rehabilitimin e personave të trafikuar. Këto institucione janë rezidenciale ose ditore dhe mbulohen financiarisht nga buxheti i shtetit ose në forma të përbashkëta me ndonjë donator tjetër (përgjithësisht të huaj).

Shoqëria civile në Republikën e Shqipërisë ka pësuar një zhvillim të konsiderueshëm. Kështu në Shqipëri funksionojnë shumë NGO vendase dhe të huaja që ushtrojnë aktivitetin e tyre në ofrimin e shërbimeve sociale për grupet vulnerabile.

Përsa i përket koordinimit ndërmjet institucioneve, që nga fillimi i procesit të hartimit të Strategjisë Përfshirjes Sociale, bazuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 168, datë 27.7.2006 "Për ngritjen e Grupit Ndërministror të Punës për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Përfshirjes Sociale", funksionojnë:

- Grupi Ndërministror i Punës i përbërë nga 7 zëvendësministra dhe i kryesuar nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- Grupi Teknik i Punës i përbërë nga ekspertë të të gjitha ministrive pjesëmarrëse dhe i kryesuar nga Zëvendësministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- Sekretariati Teknik për hartimin e SNPS.

Të gjitha këto struktura funksionojnë mbi bazën e Rregulloreve të miratuara nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Gjithashtu kuadri monitorues i ngritur për monitorimin e politikave të Përfshirjes Sociale përcakton në mënyrë të qartë bashkëpunimin dhe koordinimin e punës ndërinstitucionale. Funksionin e koordinimit dhe mbikëqyrjes së bashkëpunimit ndërministror e luan Drejtoria e Monitorimit të Strategjive Ndërsektoriale në MPÇSSHB.

Masat legjislative afatshkurtra

- Hartimi dhe miratimi i Ligjit Kuadër për mbrojtjen e të drejtave të PAK;
- Ratifikimi i Konventës së OKB-së për të drejtat e PAK, nga Parlamenti shqiptar.

Masat zbatuese

- Kryerja e studimit për vlerësimin afatmesëm të dokumentit strategjik të Përfshirjes Sociale;
- Rishikimi i objektivave të Përfshirjes Sociale, duke parë përputhjen me strategjinë 2020 të BE-së;
- Identifikimi i nevojave për kapacitetet e duhura të strukturave qeveritare, pushtetit lokal, strukturave gjyqësore, mediave, biznesit dhe shoqërisë civile për të drejtat e PAK;
- Organizimi i trajnimeve të ndryshme në fushën e të drejtave të PAK;
- Organizimi i sesioneve konsultative me shoqërinë civile për diskutimin e projektligjit për PAK;
- Lobimi me deputetët e Parlamentit Shqiptar për ratifikimin e Konventës për të drejtat e PAK.

Masat legjislative afatmesme

- Rishikimi i gjithë legjislacionit shqiptar, që prek çështjet e aftësisë së kufizuar dhe përmirësimi i tyre në funksion të përputhshmërisë me parimet e Konventës ndërkombëtare;
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e dokumentit strategjik për Përfshirjen Sociale".

Masat zbatuese

- Ngritja dhe funksionimi i Grupit Ndërministror për hartimin e Strategjisë së Përfshirjes Sociale;
- Studimi i legjislacionit shqiptar për të identifikuar boshllëqet ekzistuese që nuk përputhen me parimet e Konventës për të drejtat e PAK.

Fëmijët

Objektivi strategjik

Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të fëmijëve, nëpërmjet koordinimit dhe harmonizimit të politikave ndërsektoriale, reformës legjislative dhe institucionale, për të krijuar një mjedis mbrojtës dhe gjithëpërfshirës për fëmijët. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet:

- Forcimit të strukturave institucionale të krijuara për të monitoruar dhe raportuar mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar e rajonal;
- Nxitjes për hartimin e politikave gjithëpërfshirëse, të koordinuara e harmonizuara të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale të fëmijëve.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Një nga zhvillimet më të rëndësishme në fushën e të drejtave të fëmijëve është miratimi i Ligjit Nr. 10347, datë 4.11.2010 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve". Ligji përcakton të drejtat e fëmijëve në koherencë me Konventën e OKB për të Drejtat e Fëmijës si dhe mekanizmat zbatues e monitorues. Ligji përcakton në mënyrë të qartë përgjegjësitë e pushtetit qendror e vendor, kërkon ngritjen e institucioneve përgjegjëse, dhe synon të përçojë frymën e bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve në nivel qendror dhe vendor.

Aktualisht ka përfunduar ngritja e mekanizmave në nivel qendror (Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtat e Fëmijëve). Në nivel vendor janë ngritur 49 Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel bashki/komuna (23 bashki dhe 26 komuna) dhe 10 Njësi për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në nivel qarku. Eksperienca në këto vite ka treguar se këto modele kane pasur një impakt pozitiv në jetën e fëmijëve në nevojë.

Është duke vazhduar puna për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit. Zhvillimet e reja ligjore dhe institucionale janë promovuar fillimisht tek të gjithë aktorët, megjithatë do të vazhdojnë fushatat e ndërgjegjësimit në çdo qark të vendit, për promovimin e ligjit, përgjegjësisë së qeverisjes vendore për ngritjen e njësive për fëmijët, nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet të gjithë institucioneve shtetërore përgjegjëse dhe shoqërisë civile.

Ndryshimet e reja në kuadrin legjislativ do të pasqyrohen dhe mbështeten edhe në Planin e ri të Veprimit për Fëmijët 2012 – 2015, një dokument strategjik ndërinstitucional i cili është hartuar dhe do të miratohet brenda muajit shkurt 2012. Në këtë Plan Veprimi për Fëmijët, janë përshkruar objektivat dhe masat që do të ndërmerren për të realizuar: të drejtën e fëmijëve për mbrojtje dhe përfshirje sociale; të drejtën për arsim cilësor; të drejtën për kujdes shëndetësor; të drejtën për mbrojtje nga dhuna dhe shfrytëzimi ekonomik; të drejtën për mbrojtje ligjore.

Të gjitha këto ndryshime në fushën e të drejtave të fëmijëve kanë siguruar që:

- Të drejtat e fëmijëve të jenë pjesë e një programi politik kompleks, në të cilin ndërthuren komponentët ligjorë, institucionalë, financiarë dhe vlerësues të ecurisë;
- Politikat për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe ndikimi i tyre në përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve të jenë pjesë e çdo raportimi kombëtar;
- Çështjet e të drejtave të fëmijëve të jenë pjesë e bashkëpunimit ndër-institucional në nivel qendror e vendor.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/ nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji Nr. 10347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës". Shkalla e përputhshmërisë së Ligjit "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" është e plotë me Konventën e OKB-së "Për të drejtat e fëmijës".

Në bazë dhe për zbatim të Ligjit të lartpërmendur janë miratuar aktet nënligjore si më poshtë vijon:

- Urdhër i Kryeministrit Nr. 73, datë 3.8.2011 "Për ngritjen e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës";
- Urdhër i Kryeministrit Nr. 30, datë 18.3.2011 "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës";
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 201, datë 16.3.2011 "Për miratimin e rregullores të funksionimit të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës";
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 346, datë 29.4.2011 "Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës".

Struktura institucionale

Ligji Nr. 10347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" parashikon qartë mekanizmat institucionalë, të cilat do të jenë përgjegjëse për zbatimin e tij dhe garantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Konkretisht, në dispozita specifike të këtij ligji janë listuar mekanizmat në nivel qendror dhe në nivel vendor si dhe funksionet e detyrat konkrete të tyre. Në nivel qendror janë Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Ministri që bashkërendon punën për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Këshilli është organ këshillimor i cili drejton, përcakton dhe zhvillon politikat shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Ai kryesohet nga ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe në funksion të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në ligjin e sipërcituar ka në përbërje dhe parashikon detyrime për 9 përfaqësues në nivel ministri konkretisht për Ministrin e Brendshëm, Ministrin e Arsimit dhe Shkencës, Ministrin e Drejtësisë, Ministrin e Shëndetësisë, Ministrin e Integrimit, Ministrin e Financave, Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Përveç përfaqësuesve në nivel ministri ai ka në përbërje edhe Avokatin e Popullit,një përfaqësues nga Shoqata e Kombëtare e Bashkive dhe 2 përfaqësues nga shoqëria civile.

Pranë Këshillit do të ngrihen komitete teknike, të cilat do të kenë funksion ndihmës për Këshillin, kryesisht, në lidhje me vendimet që do të duhet të ndërmarrë ky organ.

Ministri që do të koordinojë punën për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës është autoriteti shtetëror përgjegjës i cili në referim të fushës së veprimtarisë që ushtrohet aktualisht nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, do të jetë pikërisht Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta që do të mbulojë përmbushjen e detyrave të parashikuara në ligj. Detyrat e tij konsistojnë në: Hartimin e politikave dhe programe shtetërore në fushën e mbrojtjes së fëmijës; mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, të strategjisë kombëtare, si dhe të gjithë dokumenteve të tjerë strategjikë dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, ndërmarrjen e iniciativave legjislative në këtë fushë; nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në këtë fushë, nxjerrjen e udhëzimeve metodologjike për njësitë e te drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijëve në organet e qeverisjes vendore si dhe bashkërendimin e punës me autoritetet shtetërore përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor në hartimin e politikave dhe programeve të përbashkëta në këtë fushë.

Një tjetër mekanizëm në nivel qendror është Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHMDF), institucion nën varësinë e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. ASHMDF ka për detyrë:

- të monitorojë zbatimin e Ligjit Nr. 10347, datë 4.11.2010 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës" dhe legjislacionin në fuqi, si dhe të koordinojë autoritetet shtetërore përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të strategjive dhe politikave në fushën e të drejtave të fëmijëve;
- të propozojë në ministrinë që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për ndërhyrje në politika dhe legjislacion, bazuar në problematikat që kane dalë gjatë monitorimit të zbatimit të ligjit, strategjive dhe politikave në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- të propozojë udhëzime metodologjike për njësitë e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës në organet e qeverisjes vendore;
- të mbështesë teknikisht strukturat e organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- të koordinojë punën me të gjitha strukturat e qeverisjes qendrore dhe vendore për përgatitjen e raporteve, informacioneve dhe statistikave për gjendjen e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri;
- të ndëshkojë subjektet të cilat shkelin dispozitat e Ligjit Nr. 10347, datë 4.11.2010 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës";

Në nivel vendor parashikohen njësitë për të drejtat e fëmijës në nivel qarku dhe njësitë për mbrojtjen e fëmijëve në nivel komune dhe bashkie. Ngritja dhe funksionimi i këtyre njësive do të bëjë të mundur zbatimin dhe monitorimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, duke filluar që në terren, pra nga baza e duke vazhduar vertikalisht drejt ekzekutivit. Në respektim të parimit të autonomisë lokale, parashikohet funksionimi i këtyre njësive brenda organizimit administrativ të strukturave përkatëse të pushtetit lokal, me detyrat e parashikuara në këtë ligj.

Masat legjislative afatshkurtra

Miratimi i aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 10347, datë 4.11.2010 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës".

- VKM "Për krijimin dhe funksionimin e Mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyra e procedimit të tij";
- VKM "Për Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksionit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve";
- VKM "Për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga ASHMDF-ja e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor";
- VKM "Për Bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve";

- VKM "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme ndërmjet mekanizmave institucionalë dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës".

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Promovimi i Ligjit Nr. 10347 datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" dhe Planit të Veprimit për Fëmijët 2012-2015;
- Takime periodike të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve për të analizuar zbatimin e politikave, situatën e realizimit të të drejtave të fëmijëve në vend dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes;
- Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të stafit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve;
- Promovimi i rolit të ASHMDF dhe vendosja e bashkëpunimit me njësitë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në institucionet e qeverisjes vendore;
- Monitorimi i zbatimit të ligjit dhe hartimi i raporteve periodike mbi situatën e realizimit të të drejtave të fëmijëve në vend;
- Vendosja e marrëdhënieve të formalizuara të bashkëpunimit në marrëveshje konkrete midis institucioneve shtetërore në nivel qendror dhe vendor dhe OJF-ve;
- Trajnime/workshope në nivel qendror/vendor lidhur me çështje të mbrojtjes/ respektimit së të drejtave të fëmijëve.

Masat legjislative afatmesme

Masat legjislative afatmesme janë si vijon:

- Hartimi dhe miratimi i Projekturdhrit të Ministrit të Punës "Për metodologjinë e veprimit të njësive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për trajtimin e rasteve të fëmijëve në rrezik".

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore për ngritjen e njësive të reja për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në kuadër të zbatimit të Ligjit Nr. 10347, datë 4.11.2010;
- Ngritjen e kapaciteteve të njësive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel qarku/bashkie/komune;
- Rritja e numrit të stafit të ASHMDF;
- Implementimi i metodologjisë veprimit të njësive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për trajtimin e rasteve të fëmijëve në rrezik;
- Trajnime/workshope në nivel qendror/vendor lidhur me çështje të mbrojtjes/ respektimit së të drejtave të fëmijëve;
- Ngritja e një sistemi të unifikuar treguesish statistikor për vlerësimin e realizimit të te drejtave të fëmijëve.

Implikimet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**16.055.000**	**10.300.000**	**2.800.000**	**2.800.000**
Mbulohen nga buxheti i	7.255.000	4.800.000	2.800.000	2.800.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	8.800.000	5.500.000	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.19.6. SIGURIA SOCIALE

Mbrojtja Sociale

Objektivi strategjik

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e mbrojtjes shoqërore, për periudhën afatshkurtër, është implementimi i sistemit të mbrojtjes sociale dhe standardeve, duke luftuar përjashtimin social dhe diskriminimin. Mbështetja dhe adaptimi i sistemit mbrojtjes shoqërore me kërkesat e reja ekonomike sociale, në përputhje me Nenin 99 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Bazuar ne Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, Kartën Sociale Evropiane (të rishikuar), Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe Integrimit, Objektivat e Mijëvjeçarit, objektivat kryesore të programit të Qeverisë në fushën e mbrojtjes sociale.

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Përmirësimit të legjislacionit në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore.
- Monitorimit të zbatimit të legjislacionit aktual si edhe fuqizimit të kapaciteteve të strukturave implementuese të legjislacionit.

Statusi aktual

Analiza e situatës aktuale

Reforma e filluar ne 2005 u riorientua në strategjinë sektoriale të mbrojtjes sociale 2008-2013 e cila u hartua dhe u diskutua me aktorët e interesit gjatë vitit 2008. Objektivat e kësaj strategjie u hartuan në harmoni të plotë me objektivat e strategjive të tjera ndërsektoriale si strategjia për të drejtat e fëmijëve, strategjia për personat me aftësi të kufizuara, strategjia e romëve, strategjia për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje, strategjia për moshën e tretë, etj, decentralizimin dhe rritjen e kompetencave të qeverisjes vendore, për të përafruar sistemin shqiptar të mbrojtjes sociale me standardet e Kartës Sociale Evropiane të Rishikuar, legjislacionit social dhe dokumenteve të tjerë të BE-së.

Me ndryshimet që iu bënë Ligjit Nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, u zgjerua kategoria e përfituesve të ndihmës ekonomike (viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës në familje, jetimët), mbështetje ekonomike për rastet kur fëmijët nuk kanë prindër apo njërin prej tyre, rastet kur kryefamiljare është gruaja, gjithashtu zgjerohet gama e shërbimeve për fëmijët duke garantuar shërbimin e kujdestarisë.

Një arritje në fushën e aftësisë së kufizuar ishte nënshkrimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e PAK në Dhjetor 2009 nga Qeveria Shqiptare. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me mbështetjen e UNDP është duke punuar për përshtatjen e legjislacionit me detyrimet që burojnë nga Konventa.

Në kuadër të plotësimit të procesit të decentralizimit të institucioneve të përkujdesit shoqëror në vartësi të qeverisjes vendore, janë marrë masat për delegimin e fondeve si grante të kushtëzuara që në fillim të vitit në bashkitë përkatëse me destinacion institucionet e përkujdesit shoqëror për kategoritë në nevojë.

Aktualisht rezultojnë të licencuara rreth 130 subjekte që ofrojnë shërbime sociale. Licencimi shoqërohet me një vlerësim nga Inspektorati i Shërbimeve Shoqërore, i cili zhvillohet në terren dhe ka si komponentë elemente të standardeve për grupe të veçanta përfituesish, si: numri i përfituesve, lloji i shërbimeve, kushtet e përgjithshme të institucionit, siguria e përfituesve dhe mbrojtja nga dhuna dhe abuzimi, ushqimi, veshja, numri i punonjësve, sa prej tyre profesionistë, etj. Ky dokument është shumë i rëndësishëm për vendim-marrjen.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji Nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar Fletorja Zyrtare: Viti 2005, Nr. 22, Faqe 829; Data e botimit: 13.4.2005;
- Ligji Nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", i ndryshuar, Fletorja Zyrtare: Viti 1996, Nr. 13, Faqe 569; Data e botimit: 7.5.1996;
- Ligji Nr. 8626, datë 22.6.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", i ndryshuar Fletorja Zyrtare: Viti 2000, Nr 20, Faqe 939; Data e botimit: 18.7.2000;
- Ligj Nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit", i ndryshuar Fletorja Zyrtare: Viti 1996, Nr. 27, Faqe 923; Data e botimit: 12.12.1996;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 7.1.2005 "Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Plani Kombëtar i Veprimit, Fletorja Zyrtare: Viti 2005, Nr. 2, Faqe 68; Data e botimit: 18.01.2005;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 80, datë 28.1.2008 "Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të mbrojtjes Sociale dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj", Fletorja Zyrtare: Viti 2008, Nr. 14, Faqe 441; Data e botimit: 17.2.2008.

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në garantimin e sigurisë sociale janë Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe institucionet e varësisë së saj.

Funksionet politikëbërëse realizohen nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale përbëhet nga 3 sektorë: Sektori i planifikimit të Ndihmës Ekonomike, Sektori i Politikave të Mbrojtjes Shoqërore dhe Sektori i Politikave të Sigurimeve Shoqërore.

Kjo drejtori është përgjegjëse për formulimin dhe zhvillimin e politikave, legjislacionit dhe strategjive për mbështetjen e individëve, familjeve, grupeve dhe komuniteteve në nevojë me pagesa në kesh dhe shërbime shoqërore në nivel komunitar me qëllim parandalimin e diskriminimit dhe përjashtimit social, duke nxitur rehabilitimin, integrimin dhe përfshirjen e tyre në jetën shoqërore, si edhe mbrojtjen nga skema e sigurimeve shoqërore.

Shërbimi Social Shtetëror është institucion në varësi të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i cili ka si mision ekzekutimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin. Drejtori i Përgjithshëm i këtij institucioni, propozohet nga Ministri i Punës dhe emërohet nga Kryeministri. Organi më i lartë drejtues për këtë institucion është Këshilli Administrativ.

Në nivel rajonal funksionojnë 12 zyra rajonale në nivel qarku. Zyrat rajonale e zhvillojnë aktivitetin e tyre në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore që veprojnë në nivel rajonal, me institucionet e qeverisjes vendore, sektorin privat, OJF-të dhe operatorë të tjerë.

Zyrat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në përputhje me legjislacionin në fuqi, koordinojnë, kontrollojnë zbatimin e legjislacionit për ndihmën dhe shërbimet shoqërore në: 64 Bashki, 11 minibashki (në Tiranë) dhe 308 komuna të vendit.

Masat legjislative afatshkurtra

Në përputhje me prioritetet afatshkurtra, për realizimin e tyre, do ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

- Projektligj "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar;
- Projektligj "Për ndërmarrjet sociale";
- Projektligj "Për statusin e punonjësit social";
- Projektligj "Për moshimin";
- Projekt VKM "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot";
- Projekt VKM "Për reformimin e shërbimeve sociale". Dokument analitik për reformimin e shërbimeve sociale;
- Projekt VKM "Për përcaktimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror".

Masat zbatuese afatshkurtra

- Tryeza të rrumbullakëta për diskutimin e projektakteve me anëtarët e grupit të punës dhe shoqërinë civile;
- Konferenca dhe workshope për ditën ndërkombëtare të moshës së tretë, personave me aftësi të kufizuar, fëmijëve, etj;
- Implementimi i standardeve të fëmijëve, standardeve për PAK, për të moshuarit në institucionet publike dhe jopublike dhe për personat e trafikuar dhe viktimat e trafikimit, si edhe viktimat e dhunës në familje;
- Licencimin e te gjitha shoqatave që ofrojnë shërbime sociale në përputhje me kriteret e reja të miratuara nga qeveria të cilat garantojnë identifikimin e OJF-ve dhe operatoreve të tjerë që ofrojnë shërbime sociale, vlerësimin e kapaciteteve te tyre;
- Organizimin e tavolinave të rrumbullakëta dhe trajnimeve.

Masat legjislative afatmesme

Në përputhje me prioritet afatmesme, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

- Projekt VKM "Përbërja, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Aftësisë së kufizuar dhe Komisionit Epror. (Ky projektvendim do të hartohet pas miratimit të ndryshimeve të Projektligjit "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar).

Masat zbatuese afatmesme

- Uljen e varfërisë, nëpërmjet rritjes së efektivitetit të përdorimit të fondeve të ndihmës ekonomike;
- Ndjekja e objektivave të Planit të Veprimit për detyrimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar;
- Rritja e kompetencave të pushtetit vendor dhe shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve shoqërore në komunitet;
- De-institucionalizimi dhe rritja e përgjegjësive të pushtetit vendor për ndihmën ekonomike, aftësinë e kufizuar dhe realizimin e shërbimeve shoqërore, rritjen e llojshmërisë dhe zgjerimin e gjeografisë së shërbimeve;
- Licencimi i ofruesve të shërbimeve;
- Inspektimi i shërbimeve të ofruara;
- Rritja e kapaciteteve të operatorëve që ofrojnë shërbime;
- Institucionalizimin e marrëdhënieve me OJF-të, përfshirjen e shoqërisë civile dhe operatorëve privat për ofrimin e shërbimeve shoqërore në komunitet.

Sigurimi shoqëror

Objektivi strategjik

Objektivi kryesor i Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore, për periudhën afatgjatë është përmirësimi i skemës aktuale nëpërmjet reformimit të shtyllës publike të pensioneve e forcimit të një lidhjeje më të drejtpërdrejtë midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme, krijimit të llogarive personale të çdo kontribuuesi dhe përfituesi, arritjen e transparencës maksimale, futjes graduale të skemave të përfitimeve suplementare të

menaxhuara nga subjekte jopublike, duke përgatitur skemën dhe sistemin për bashkëpunimin e saj me vendet e BE-së. (Në përputhje me nenin 99 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe bazuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kartën Sociale Evropiane (e rishikuar), Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe Integrimit, Objektivat e Mjëvjeçarit, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, objektivat kryesore të programit të Qeverisë në fushën e mbrojtjes sociale.

Këto objektiva do të realizohen nëpërmjet:

- Reformimit të skemës së detyrueshme të sigurimeve shoqërore;
- Implementimit dhe vënien në efiçiencë të një sistemi të automatizuar informacioni për sigurimet shoqërore;
- Zhvillimit dhe fuqizimit të kapaciteteve institucionale, përmirësimit të strukturave organizative, për të garantuar një menaxhim sa më efikas të skemës së sigurimeve shoqërore;
- Përmirësimit të raportit kontribuues-përfitues, duke bashkërenduar punën me strukturat tatimore e drejtoritë e tjera.
- Përfundimit të bazës së të dhënave elektronike të pensioneve (Regjistrit Kombëtar të Pensioneve) dhe vazhdimin e punës për përditësimin e tyre.
- Miradministrimit të fondeve të alokuara nga Buxheti i Shtetit për programe të veçanta të Qeverisë, për përfitimet suplementare e trajtimet e veçanta, sipas statuseve.
- Përmirësimit të legjislacionit të sigurimeve shoqërore dhe përafrimit me standardet e BE-së dhe zbatimi i tij.

Gjithashtu miratimi i ligjit "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor", përpunimi dhe zhvillimi i strategjisë përkatëse kanë për qëllim përmirësimin dhe forcimin e skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor, për të realizuar një shërbim shëndetësor sa më efikas.

Situata aktuale

Politikat e Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore janë fokusuar në dy drejtime kryesore:

- *Realizimit të Reformës Parametrike dhe Sistemike*

Zhvillimet e përgjithshme ekonomike dhe ato të fushës së sigurimeve shoqërore në veçanti, kanë bërë të domosdoshme përmirësimet e vazhdueshme të legjislacionit me synimin që sistemi i sigurimeve shoqërore t`u përshtatet zhvillimeve ekonomike e sociale, zhvillimeve afatshkurtra e afatgjata të të gjithë sistemit ekonomik, atij të mbrojtjes sociale të shtetasve, standardizimit të dispozitave dhe përafrimin e tyre me kuadrin ligjor të BE-së e të ILO-s si dhe të qëndrueshmërisë financiare të tij.

Për të gjykuar mbi ecurinë e skemës ekzistuese të pensioneve në perspektivën afatgjatë dhe për të dhënë vlerësime mbi qëndrueshmërinë financiare të saj janë realizuar parashikime aktuariale për skemën e pensioneve.

Ekspertët e KE-së në raportet e tyre konstatojnë se mbulimi i sistemit të pensioneve është relativisht i ulët krahasuar me standardet e BE-së dhe se ka lidhje të dobëta midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të marra, të cilat krijojnë stimuj për evazion në kontribute, sidomos për ata me të ardhura të larta.

Shmangja e deficiteve në skemën e pensioneve është një nga arsyet kryesore të reformës parametrike e sistemike në fushën e pensioneve që është planifikuar të ndërmerret. Reformat e planifikuara do të bëjnë të mundur krijimin e një sistemi pensionesh shumëkolonësh me objektiv rritjen e qëndrueshmërisë financiare të skemës së detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe rritjen e nivelit të të ardhurave për pensionistët e ardhshëm.

Ka filluar debati për reformën sistemike të pritshme në fushën e pensioneve. Parimet kryesore të reformës së pensioneve që janë në diskutim kanë të bëjnë me:

- reformimin e kolonës së parë PAYGO ekzistuese;
- krijimin e kolonës së dytë me kontribut të detyruar sipas parimit fully funded;
- forcimi i kolonës së tretë dhe krijimi i incentivave për pjesëmarrje në këtë kolonë.

Ky proces nuk ka përfunduar.

Ka filluar të zbatohet Ligji i ri Nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", i cili vendos standardet e nevojshme për rregullimin dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve vullnetare në përputhje me direktivat e BE-së dhe standardet e OECD, IOPS, duke krijuar kështu një bazë ligjore të përshtatshme për krijimin dhe zhvillimin e kolonës së tretë.

- *Rritja e vazhdueshme e pensioneve*

Angazhimi i qeverisë në fushën e pensioneve është rritja e ndjeshme e tyre e veçanërisht e pensioneve të ulëta si në qytet ashtu edhe në fshat. Në vitin 2011, të ardhurat minimale të pensionistëve në qytet arritën në 13,267 lekë në muaj dhe në fshat 8,358 leke në muaj duke realizuar një rritje mbi 59% për pensionistët në qytet dhe më shumë se dyfishim për pensionistët në fshat, krahasuar me vitin 2005. Kjo rritje në radhë të parë realizon rikuperimin total të efekteve gërryese të inflacionit, në masën e pensionit, jep një shtesë reale të pensionit të qytetit dhe realizon programin e qeverisë që pensionet e ulëta të rriten me ritme të larta. Për vitin 2011 të ardhurat minimale të pensionistëve në qytet u rriten me 4%, ndërsa në fshat me 7%, krahasuar me një vit më parë, mbi nivelin e inflacionit vjetor të çmimeve.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/ nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji Nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimin Shoqëror në RSH", i ndryshuar", Fletorja Zyrtare: Viti 1993, Nr 7. Ligji përafron pjesërisht Kartën Sociale Evropiane (E rishikuar), Rregulloren (EC) 32004R0883, Rregulloren (EC) 32009R0987, Direktivën 31986L0613, Direktivën 32007L0079 EEC;
- Ligji Nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore"; i ndryshuar;

- Ligji Nr. 8960, datë 24.10.2002 “Për ratifikimin e Kartës Sociale Evropiane, të rishikuar”;
- Ligji Nr. 9442, datë 16.11.2005 “Për ratifikimin e Konventës se ILO-s, Nr. 102 “Për standardet minimale të mbrojtjes shoqërore”;
- Ligjin Nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, në përputhje me 31985L0611, Council Directive 85/611/EEC;
- Ligjit Nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” (hyn në fuqi me 25.3.2013).

Struktura institucionale

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e sigurimeve shoqërore, është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

- Ministria e Financave: Në Ligjin Nr. 7703, datë 11.5.1993, Neni 77 përcaktohen Marrëdhëniet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me Ministrinë e Financave dhe theksohet se: Ministria e Financave “mbikëqyr zbatimin e politikave të qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore”.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, është institucioni përgjegjës për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore, është institucioni përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e skemës së sigurimeve shoqërore (pensione, pagesa në para për sëmundje, barrëlindje, aksidente në punë/sëmundje profesionale, shpërblim për lindje, pagesa për vdekje) në Republikën e Shqipërisë. ISSH raporton tek Ministri i Financave për realizimin e politikave të qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore, për realizimin e programit vjetor të zhvillimit të skemës së sigurimeve shoqërore si dhe problemeve të tjera.
- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është institucioni përgjegjës për negocimin e Marrëveshjeve Bilaterale për Mbrojtjen Shoqërore, për raportimin në kuadër të PKZMSA dhe integrimit në BE, (ku bën pjesë dhe ISSH), për raportimin e zbatimit të detyrimeve që lindin nga Konventat dhe dokumente të tjera ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes sociale.

Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale, (Sektori i politikave të sigurimeve shoqërore), është përgjegjës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave për hartimin e politikave të rritjes së pensioneve dhe përfitimeve të tjera që jepen nga kjo skemë, për bashkërendimin e skemave të mbrojtjes shoqërore dhe për raportimin e zbatimit të detyrimeve që dalin nga Konventat e dokumente të tjera ndërkombëtare në fushën e sigurimeve shoqërore.

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është institucioni përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit financiar jobankar, përfshirë këtu edhe fondet e pensionit vullnetar. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është anëtar me të drejta të plota e IOPS (organizata ndërkombëtare e mbikëqyrjes së pensioneve).

- Drejtoria e Përgjithshme e Postave. Posta Shqiptare sh.a dhe bankat e nivelit të dytë realizojnë pagesat e përfitimeve nga sigurimet shoqërore për llogari të Sigurimeve Shoqërore.

Masat legjislative afatshkurtra

Në përputhje me prioritetet afatshkurtra, për realizimin e tyre, do ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

- Projekt VKM "Për caktimin e pagës minimale dhe maksimale për efekt kontributi, dhe përcaktimin e masës së kontributit për të vetëpunësuarit në bujqësi;
- Projekt VKM "Për caktimin e pensionit bazë në qytet e fshat";
- Projekt VKM "Për rritjen e pensioneve dhe përfitimeve suplementare e trajtimeve të veçanta";
- Projekt VKM "Për indeksimin e bazës individuale për llogaritjen e pensionit vjetor fillestar";
- Marrëveshjeve me institucionet homologe dhe bankat për transferimin e pensioneve nga jashtë brenda vendit dhe anasjelltas.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Zbatimi i legjislacionit të sigurimeve shoqërore, VKM në zbatim të tij dhe rregulloreve përkatëse, për dhënien e përfitimeve;
- Hartimi i programeve, softeve për sistemin financiar, llogaritjen automatike të përfitimeve, krijimin e llogarive personale të kontribuuesve;
- Hedhja në këtë sistem i të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me vjetërsinë në punë të shtetasve shqiptarë dhe krijimi i regjistrit kombëtar të pensioneve;
- Përmirësimi i infrastrukturës së sistemit të sigurimeve shoqërore, në mënyrë që t'i përshtatet ndryshimeve aktuale;
- Rritja e bashkëpunimit me institucionet e Postës Shqiptare sha, Tatimeve, bankave të nivelit të dytë dhe Zyrave të Gjendjes Civile.
- Rritjes së koordinimit të sigurimeve shoqërore në zbatim të Marrëveshjeve Bilaterale në fuqi për Mbrojtjen Shoqërore dhe atyre në negocim.

Masat legjislative afatmesme

Në përputhje me prioritet afatmesme, për skemën e sigurimeve shoqërore do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

- Projekt VKM në zbatim të Ligjit Nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore";
- Projekt VKM "Për caktimin e pagës minimale dhe maksimale për efekt kontributi, dhe përcaktimin e masës së kontributit për të vetëpunësuarit në bujqësi;
- Projekt VKM "Për caktimin e pensionit bazë në qytet e fshat";
- Projekt VKM "Për rritjen e pensioneve dhe përfitimeve suplementare e trajtimeve të veçanta";
- Projekt VKM "Për indeksimin e bazës individuale për llogaritjen e pensionit vjetor fillestar".

Në përputhje me hartimin e projektvendimeve të Këshillit të Ministrave në zbatim të Ligjit Nr. 10383, datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

- Projektvendimi "Për hartimin e paketave të shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor";
- Projektvendim për përcaktimin e kategorive të individëve të siguruar që përjashtohen nga pagesat e drejtpërdrejta të shërbimeve shëndetësore;
- Projektvendim për miratimin e statutit të fondit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë;
- Projektvendim për rregullat mbi regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe mënyrën e paraqitjes së informacionit nga institucionet përgjegjëse për informim;
- Projektvendim për përcaktimin e institucioneve publike dhe private që japin të dhëna fondit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

Këto akte nënligjore duhet të paraqiten për miratim në Këshillit të Ministrave brenda muajit Mars 2013, duke qenë se Ligji Nr. 10383, datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor" hyn në fuqi me 25.3.2013.

Masat zbatuese afatmesme

Për realizimin e këtyre angazhimeve në skemën e sigurimeve shoqërore do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- Reforma Parametrike e sistemit të sigurimeve shoqërore për modernizimin e mëtejshëm të sistemit të sigurimeve shoqërore në raport me kërkesat e reja ekonomike e sociale, në kushtet e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
- Ndjekja e zbatimit të VKM-së "Për rritjen e përfitimeve";
- Zbatimi i VKM-së, në zbatim të Ligjit Nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë";
- Thellimi më tej i bashkëpunimit me Tatim–Taksat në luftën e informalitetit në sigurimet shoqërore;
- Përshtatja e strukturave administrative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore me dinamikën e zhvillimeve të reja;
- Rritjes së koordinimit të sigurimeve shoqërore në zbatim të Marrëveshjeve Bilaterale në fuqi për Mbrojtjen Shoqërore dhe atyre në negocim.

Për realizimin e këtyre angazhimeve në skemën e sigurimeve shëndetësore do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- Zbatimi i legjislacionit të sigurimeve të detyrueshme shëndetësore;
- Organizimi i grupeve të punës për hartimin e projekt VKM në zbatim të Ligjit Nr. 10383, datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor";
- Në lidhje me përgatitjet për të përdorur kartën e identitetit si kartë shëndeti, ISKSH-ja po punon për të përfunduar procesin e identifikimit të të siguruarve me anën e numrit

personal kombëtar të identifikimit (Kartës së Identitetit). Për këtë qëllim aktualisht ISKSH po punon që të bëjë transferimin e të dhënave të identifikimit të të siguruarve që përdoret vetëm nga ISKSH, dhe personave në ngarkim të mjekut të familjes në Numrin Kombëtar të Identifikimit. Në këtë mënyrë, krijohen kushtet për të përdorur Kartën e Identitetit si Kartë e Sigurimit Shëndetësor.

Implikimet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**91.374.930.000**	**96.056.350.000**	**101.866.004.000**	**107.964.964.000**
Mbulohen nga buxheti i	91.374.930.000	96.056.350.000	101.866.004.000	107.964.964.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	0	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.19.7. ANTIDISKRIMINIMI DHE SHANSET E BARABARTA

Trajtimi i barabartë i punëtorëve të huaj të punësuar

Objektivi strategjik

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në kuadrin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, dhe përputhja e tij me Kartën Sociale Evropiane, konventat e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e ligjshme të të punësuarve të huaj në Republikën e Shqipërisë dhe trajtimin e tyre në kushte jo më pak të favorshme se punëtorët shqiptarë.

Statusi aktual

Analiza e situatës aktuale

Pas vlerësimit të nevojave të secilit, Sporteleve të Migracionit i është ofruar mbështetje me pajisje për zyrat si dhe me materiale informative. Për të fuqizuar më tej kapacitetet, të 36 Sportelet e Migracionit si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit janë pajisur me kompjuterë dhe akses interneti.

Janë organizuar trajnime për punonjësit e 36 Sporteleve të Migracionit. Objektivi kryesor i këtyre trajnimeve ka qenë rritja dhe forcimi i profesionalizmit të punonjësve të Sporteleve të Migracionit në ushtrimin e detyrave të tyre për intervistimin, identifikimin e nevojave, dhënien e informacionit dhe referimit për migrantët që paraqiten pranë Sporteleve të Migracionit.

Në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM Tirana) është duke u zbatuar projekti për rritjen e kapaciteteve të qeverisë për të kontribuar në procese migratore më të qëndrueshme.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Për plotësimin e standardeve mbi ushtrimin efektiv të së drejtës së punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre për mbrojtje dhe asistencë shprehur në Ligjin për të Huajt Nr. 9959, datë 17.7.2008, njeh të drejtat e punëtorëve të huaj, bazuar në parimet e reciprocitetit dhe mosdiskriminimit, të cilat i ofrojnë punëtorëve të huaj një trajtim jo më pak të favorshëm se punëtorëve shqiptarë. Në këtë ligj, në Nenin 5 "Të drejtat e të huajve" njihen të drejtat e të huajve, bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë, në të cilën, sipas Nenit 16, të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë, vlejnë njëlloj edhe për të huajt. Si i tillë, legjislacioni shqiptar është në përputhje me acquis, për mosdiskriminimin e të huajve. Në kuadrin e përmirësimeve të Ligjit për të Huajt që parashikohet të bëhen së shpejti, mendohet që të drejtat e të huajve të njihen në bazë të Kushtetutës, pa u detajuar sikurse është në Ligjin aktual, në Nenin 5, sepse përmendja e disa të drejtave, konsiderohet si kufizim për të gjitha të drejtat që njeh Kushtetuta. Gjithashtu mendohet që përmirësime të pjesshme të ligjit aktual, të lehtësojnë më tej procedurat e pajisjes me leje pune të të huajve duke ruajtur të drejtat dhe barazitë e trajtimit të të huajve të punësuar në Republikën e Shqipërisë sikurse edhe punëtorët shtetas shqiptarë.

Mbas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, kanë dalë disa akte nënligjore në zbatim të tij, të cilat detajojnë dhe konkretizojnë një sërë dispozitash të rregulluara në këtë ligj mbi pajisjen me leje pune të të huajve sipas 15 kategorive të ndryshme si më poshtë vijon:

- VKM Nr. 348, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për A/NK (Punëtorë ndërkufitarë);
- VKM Nr. 349, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për A/PS (Punëtorë stinorë)";
- VKM Nr. 350, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për A/SH (Shërbime vullnetare)";
- VKM Nr. 351, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për B/VP Veprimtari të pavarur ekonomike si i vetëpunësuar";
- VKM Nr. 352, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për A/AF (Anëtarë të familjes");
- VKM Nr. 353, datë 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës" "Për A/S (Studentë);

- VKM Nr. 354, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” “Për raste të veçanta- Tipi C”;
- VKM Nr. 355, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” “Për B/I (Veprimtari të pavarur ekonomike si investitor);
- VKM Nr. 356, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” “Për A/TN (Të transferuarit brenda ndërmarrjes);
- VKM Nr. 357, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” “Për leje pune të vazhdueshme Tipi D”;
- VKM Nr. 358, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” “Për A/FP (Arsimin profesional”);
- VKM Nr. 359, datë 6.3.2009 “Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës” “Për punëmarrës A/P”;
- VKM Nr. 360, datë 6.3.2009 “Për dokumentacionin dhe procedurën për përjashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune”;
- VKM Nr. 467, datë 29.6.2011 “Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurave për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës së tipit C/SP (për sportistët);
- VKM Nr. 518, datë 6.7.2011 “Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurave për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës së tipit C/SHP (për punëtorët shtëpiakë).

Me ndryshimet në ligjin e ri, mendohet që për thjeshtësim veprimesh, të përmblidhen të gjitha VKM-të në një VKM, e cila do të shoqërohet me anekse shpjeguese për të gjitha tipet e lejeve të punës, për të cilat sipas ligjit aktual ka VKM, për çdo tip leje pune.

Struktura institucionale

Sipas Ligjit për të Huajt, Autoriteti shtetëror qendror, përgjegjës për trajtimin e marrëdhënieve të punësimit të të huajve në Shqipëri, është Drejtoria e Politikave të Migracionit në MPCSSHB dhe autoriteti shtetëror përgjegjës, në nivel qendror është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe në nivel rajonal dhe vendor, për punësimin e të huajve, është zyra rajonale dhe vendore e punësimit.

Është konkretisht përgjegjësia e zyrave përkatëse të punësimit që sipas Ligjit “Për të Huajt”, dhe VKM-ve në zbatim të tij, për punësimin e të huajve, të kryejnë me përgjegjësi detyrat si më poshtë:

- të presin personat e interesuar për pajisje me leje pune për të huajin;
- të japin informacionin e duhur për çdo paqartësi rreth procedurave për pajisje me leje pune;

- të shqyrtojnë dokumentacionin përkatës dhe të pranojnë, ose të bëjnë vërejtjet e duhura bazuar në ligj dhe VKM, për ta pranuar brenda afatit të lejuar në VKM;
- të respektojnë afatet sipas VKM-së përkatëse për pajisjen me leje pune të të huajit;
- të evidentojnë në kohë lejet e punës duke i regjistruar në regjistrin elektronik;
- një kriter i rëndësishëm që duhet të zbatohet nga zyrat e punësimit është ai i vlerësimit të tregut të punës. Sipas Nenit 40, "Nevojat e tregut të punës për punëmarrësit" të Ligjit "Për të Huajt".

Masat legjislative afatshkurtra

Ligji për të Huajt edhe sipas rekomandimeve të KE-së nuk ka ndonjë vërejtje apo rekomandim për përmirësim lidhur me çështjen e diskriminimit. Për pasojë, nuk ka ndonjë parashikim konkret për përmirësim, përveç gatishmërisë së kësaj drejtorie për përditësimin e ligjit dhe përafrimin gjithmonë e më tepër me BE-në.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Vazhdimi i aktiviteteve të trajnimit për forcimin e kapaciteteve të personelit për ofrimin e shërbimeve ndaj migrantëve, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM Tirana).
- Vazhdimësi e forcimit të kapaciteteve me pajisje dhe mjete pune për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Zyrat Rajonale të Punësimit dhe Zyrat Vendore të Punësimit, sipas nevojave, mbështetur gjithashtu nga IOM.

Masat legjislative afatmesme

- Në vazhdimësi do të synohet për përditësimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian dhe zbatimin e plotë të tij, lidhur me çështjet e punësimit që mbulon MPCSSHB.

Masat zbatuese afatmesme

- Aktivitetet për forcim kapacitetesh dhe koordinim ndërinstitucional do të realizohen në vazhdimësi në përputhje me ndryshimet që mund të realizohen në legjislacion dhe kërkesat për forcim kapacitetesh nga zyrat përkatëse të punësimit.

Shanset e Barabarta

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Qeverisë Shqiptare për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje është "angazhimi për promovimin e parimeve të barazisë gjinore, si dhe forcimin e instrumenteve ligjorë dhe institucionalë mbrojtës për të siguruar politikat gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes. Parandalimi i dhunës në familje, mbrojtja e viktimave dhe aksesi i tyre në skemat e mbrojtjes ligjore dhe psikosociale në bashkëpunim të ngushtë me median dhe

shoqërinë civile për të garantuar dhe mbrojtur dinjitetin e gruas duke i kushtuar një rendësi të veçantë fëmijëve dhe personave të moshuar".

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet zbatimit të katër drejtimeve kryesore të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimit të Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2011-2015:

- Forcimi i Mekanizmit Institucional dhe Ligjor për Barazinë Gjinore;
- Rritja e Pjesëmarrjes së Grave në Vendim-marrje;
- Fuqizimi Ekonomik i Vajzave dhe Grave;
- Zvogëlimi i Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje.

Situata aktuale

Në zbatim të Programit të Qeverisë, zbatimit të legjislacionit shqiptar dhe specifikisht të Ligjit Nr. 9970 datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" (LBGJSH) dhe Ligjit Nr. 9669 datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (LDHF), dhe të Ligjit Nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" (LMD), zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2007-2010, miratimit dhe zbatimit të Strategjisë së re Kombëtare të Barazisë Gjinore, Reduktimit të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje 2011-2015, miratuar me VKM Nr. 573, datë 16.6.2011, konstatohet se situata de facto e barazisë gjinore dhe lufta kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje ka pësuar ndryshime pozitive.

Përmbushja e objektivave të kësaj Strategjie ka bërë të mundur përfshirjen e çështjeve gjinore në të gjitha nivelet duke siguruar ngritjen e kapaciteteve, fuqizimin e gruas nëpërmjet politikave dhe programeve për nxitjen e punësimit; ndërgjegjësimin e opinionit publik mbi çështjet gjinore dhe dhunës ndaj gruas; plotësimin e kuadrit nënligjor për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje, nëpërmjet ngritjes së strukturave dhe ngritjes së shërbimeve mbështetëse dhe trajnimit të profesionistëve me çështjet e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje; rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në vendimmarrjen politike e publike; etj. Mbështetja nga programi Një OKB "Për barazinë gjinore në Shqipëri", apo organizma të tjera që veprojnë në vend për këto çështje dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile ka luajtur rol mjaft pozitiv për përmbushjen e shumë angazhimeve. Rekomandimet e dhëna nga Komiteti Për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave janë bërë pjesë e politikave dhe programeve për zbatim të cilat synojnë eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave dhe avancimin e barazisë gjinore.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Kodi i Punës, Neni 9, 10, 32, 39, 75, 76, 97, 98, 108, 109, 134, 72, 115, 55, 104 - miratuar me Ligjin Nr. 7961 datë 12.7.1995, (ndryshuar me Ligjin Nr. 8085, datë 13.03.1996, Ligjin Nr. 9125, datë 29.7.2003, Ligjin Nr 10053, datë 29.12.2008 botuar respektivisht në Fletoret Zyrtare: Nr. 16, Faqe 660, Data e botimit: 8.8.1995; Nr. 6, Faqe 253; Data e botimit: 19.2.1996; Nr. 72, Faqe 3225; Data e botimit: 19.8.2003 dhe Nr. 205, Faqe 11075, Data e botimit: 16.1.2009). Përafruar me Direktivën Nr.

92/85/KE "Mbi paraqitjen e masave për të inkurajuar përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë për punëtoret shtatzëna dhe punëtoret të cilat sapo kanë lindur fëmijë ose që janë me fëmijë në gji" dhe Direktivën Nr. 75/117/KEE, 10 shkurt 1975 "Mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me aplikimin e parimit të pagesës së barabartë për burrat dhe gratë". Shkalla e përafrimit e pjesshme.

- Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" (botuar në fletoren zyrtare Nr. 125, Data 1.8.2008, faqe 5540. Ligji është përafruar me Direktivën 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 5 Korrik 2006, "Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe të grave në fushën e punës dhe të punësimit"; Direktivën 2002/73/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 Shtatorit 2002, duke ndryshuar Direktivën 76/207/EEC e datës 9 shkurt 1976 "Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë për sa i përket aksesit në punësim, trajnim dhe promovim profesional dhe kushtet e punës dhe Rekomandimi i Këshillit 96/694/EC i 2 Dhjetorit 1996 'Mbi pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në procesin e vendimmarrjes". Shkalla e përputhshmërisë: e pjesshme.
- Ligji Nr. 9690, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Rekomandimi Nr. (2002)5 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për mbrojtjen e grave nga dhuna e adoptuar në 30 Prill 2002. Shkalla e përputhshmërisë: E pjesshme.
- Ligji Nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i përafruar plotësisht me: 32000L0043, Direktivën e Këshillit 2004/43/KE të 29 qershorit 2000 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike"; 32000L0078, Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për "Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës"; 32004L0113, Direktivën e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime"; 32006L0054, Direktivën e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për "Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës".
- Ligji Nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimin Shoqëror në RSH", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 7, Data e botimit: 12.6.1993, Faqe 401
    - Direktiva Nr. 79/7/KEE, e datës 19 dhjetor 1978 "Mbi zbatimin progresiv të parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e sigurimit shoqëror"
    - Direktiva Nr. 86/378/KEE, e datës 24 korrik 1986 "Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në skemat e sigurimit shoqëror në punë".
- Ligji Nr. 10237, datë 18.2. 2010 "Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë"

Struktura institucionale

Mekanizmat Institucionalë. Mekanizmi Shtetëror i Barazisë Gjinore, i cili përbëhet nga një sërë strukturash shtetërore është ngritur për të nxitur përparimin e barazisë gjinore dhe për të

siguruar gëzimin e të drejtave njerëzore të grave. Ky mekanizëm është ngritur në zbatim të rekomandimeve nga CEDAW, Platforma për Veprim e Pekinit (PVP) dhe në zbatim të LBGJSH. Funksioni i tij kryesor është të monitorojë dhe të sigurojë zbatimin e ligjeve, të parimit të mos-diskriminimit dhe barazisë midis burrave dhe grave.

LBGJSH përcakton si autoritet përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore Ministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Bazuar në LBGJSH si dhe LDHF, Ministri e kryen funksionin e mësipërm i ndihmuar nga struktura e specializuar brenda dikasterit të tij, Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta dhe Familjen (DPSHBF).

Në bazë të LBGJSH, propozimi i politikave mbi barazinë gjinore i ngarkohet Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore. Ky Këshill ka për detyrë të këshillojë Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për barazi gjinore dhe në përbërje ka 9 zëvendësministra të MPÇSSHB, Ministrisë së Integrimit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit si dhe tre anëtarë përfaqësues të shoqërisë civile.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" struktura të tjera përgjegjëse janë të gjitha institucionet shtetërore: në nivel qendror (Ministritë me institucionet vartëse të tyre) dhe nivel vendor (Qarqet, Bashkitë, Komunat) si dhe nëpunësit gjinorë në ministritë (Neni 13/3 të Ligjit Nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri") dhe nëpunësit vendorë për çështjet e barazisë gjinore (nenin 14/Pika 4 të Ligjit Nr. 9970)

Institucione të tjera përgjegjëse janë Ministritë e përfshira në zbatimin e Strategjisë së Barazisë Gjinore dhe ligjeve respektive për barazinë gjinore dhe dhunën në familje si: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, METE, MASH, MSH, MF.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", u krijua edhe institucioni i Komisionerit, i cili kryen funksionet e një ombudsmani për çështje të diskriminimit për çfarëdo shkaku, përfshi gjininë, por edhe identitetin gjinor, shtatzëninë, orientimin seksual, gjendjen familjare apo martesore, përgjegjësinë prindërore, të cilat tipikisht janë të lidhura ngushtë me gjininë e personit. Ky institucion ka kompetencë të shqyrtojë ankesat për diskriminim nga individët, grupet e tyre apo organizatat, të kryejë hetime, të monitorojë zbatimin e këtij ligji, të vendosë sanksione, të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

Masat legjislative afatshkurtra

- Në një perspektivë afatshkurtër synohet fuqizimi i mekanizmave institucionalë dhe ligjorë për barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje, nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve ekzistuese të barazisë gjinore dhe ngritjes së mekanizmave të reja kryesisht për dhunën në familje.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Bashkëpunim i vazhdueshëm dhe monitorim lidhur me emërimin e nëpunësve gjinorë në nivel qendror dhe vendor;
- Trajnim i mëtejshëm i nëpunësve gjinorë në ministritë dhe në bashkitë e vendit;
- Ngritja e Mekanizmit të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje dhe trajnimi i ekipeve teknike multidisiplinare;
- Bashkëpunim me shoqërinë civile për përmirësime në Kodin Zgjedhor pranë komisionit Ad Hoc për kuotën gjinore;
- Nxitja e fuqizimit ekonomik të grave sipërmarrëse nëpërmjet organizimit të panaireve të përvitshme.

Masat legjislative afatmesme

- Në një perspektivë afatmesme synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij si dhe zbatimi i programeve dhe politikave për barazinë gjinore dhe reduktimit të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Vlerësim lidhur me përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar me Konventën CEDAW, *acquis* të BE-së, LBGJSH, LDHF, LMD.
- Forcimi i kapaciteteve për të mbledhur dhe analizuar të dhëna të ndara sipas përkatësisë gjinore.
- Studim mbi situatën e dhunës në familje në Shqipëri ;
- Vazhdimi i fushatave sensibilizuese ndërgjegjësuese për barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.
- Vazhdimi i fushatave sensibilizuese ndërgjegjësuese për fuqizimin ekonomik të grave.

Antidiskriminimi

Objektivi strategjik

Miratimi i ligji nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", si një kontribut i shoqërisë civile dhe asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë në këtë fushë, përafroi plotësisht legjislacionin e brendshëm me direktivat e BE-së. Pas miratimit të Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", sfida që shtrohet është sigurimi i zbatimit efektiv të tij.

Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare, filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore,shtatzëninë, përkatësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,

vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë ose me çdo shkak tjetër.

Në Raportin Analitik 2010 miratimi i Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe emërimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është konsideruar si një arritje për Shqipërinë në aspektin e politikave anti-diskriminim.

Hartimi i këtyre masave legjislative dhe aktiviteteve zbatuese është udhëhequr nga shndërrimi i konstatimeve dhe rekomandimeve të Komisionit Evropian në Progres Raportin e vitit 2011 për Shqipërinë si dhe në përfundimet e takimeve dypalëshe për planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve kyçe të Komisionit, në masa afatshkurtra dhe afatmesme. Masat e parashikuara synojnë përmbushjen e këtyre rekomandimeve dhe konkretisht, rritjen e vizibilitetit të institucionit të Komisionerit, forcimin e rolit dhe kapaciteteve të tij, rritjen e ndërgjegjësimit për ligjin duke u fokusuar në target grupe të veçanta profesionale, si dhe forcimin e bashkëpunimit të Komisionerit me institucione të ndryshme publike, shoqërinë civile dhe organizma ndërkombëtare që veprojnë në fushën e mosdiskriminimit.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/ nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji Nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi', botuar në Fletoren Zyrtare nr. 15, datë 25 shkurt 2010, faqe 482, përafruar plotësisht me: Direktivën e Këshillit Evropian 2000/43/KE e 29 qershorit 2000 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike"; Direktivën e Këshillit Evropian 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për "Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës"; Direktivën e Këshillit Evropian 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime"; Direktivën e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për "Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës".

Akte të tjera që nuk transpozojnë legjislacionin evropian:

- Vendim Nr. 33, datë 22.04.2010 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi";
- Vendim Nr. 34, datë 20.05.2010 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 68, datë 1.6.2010, faqe 2581;
- Urdhri Nr. 10 datë 21.12.2010, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së KMD";
- Urdhri Nr. 11 datë 21.12.2010, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi "Për miratimin e Kodit të Etikës së Institucionit".

Struktura institucionale

Me miratimin e Ligjit Nr. 10221, datë 4.2.2011 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" u sanksionua krijimi i institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Bazuar në këtë ligj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Komisioneri është një institucion publik qendror, i pavarur dhe në ushtrim të kompetencave ligjore i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit. Komisioneri zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me Vendimin Nr. 33, datë 22.4.2010, zgjodhi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në ushtrim të kompetencave ligjore, Komisioneri asistohet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Zyra). Me Vendimin Nr. 34, datë 20.5.2010 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi strukturën, organikën dhe kategorizimet e punës së Zyrës, duke mundësuar kështu funksionimin dhe fillimin e punës së kësaj zyre. Sipas kësaj strukture, Zyra përbëhet nga 23 punonjës.

Kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë parashikuar në nenin 32 të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Sipas parashikimeve të këtij neni Komisioneri, shqyrton ankesat për diskriminim të individëve apo organizatave që kanë interes të ligjshëm si dhe të kryen hetime administrative kur merr informacion të besueshëm. Komisioneri gjithashtu, monitoron zbatimin e ligjit, nxit parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe informimit duke pasur në vëmendje që të përdoret gjuha e pakicave të caktuara, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuar. Kompetencë e rëndësishme e Komisionerit, është kryerja e sondazheve në lidhje me diskriminimin. Roli këshillimor i Komisionerit është një tjetër kompetencë e rëndësishme që ky i fundit e ushtron nëpërmjet hartimit dhe publikimit të rekomandimeve/raporteve me qëllim përmirësimin/ plotësimin e legjislacionit ekzistues apo për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin. Komisioneri gjithashtu, mund t'i drejtohet drejtpërdrejt opinionit publik si dhe të zhvillojë dialogun e rregullt në lidhje me çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat jo qeveritare.

Komisioneri mund të japë mendimin e tij në lidhje me çdo çështje diskriminimi në gjykatë, kur i kërkohet nga kjo e fundit. Ai mund të përfaqësojë gjithashtu ankuesit që kanë paraqitur kërkesëpadi në gjykatë kur pretendojnë të jenë diskriminuar. Komisioneri apo çdo organizatë legjitime mund të paraqesin padi në gjykatë me kushtin që të jenë pajisur më parë me prokurë të posaçme në emër të një individi apo një grupi ose me anë të një deklarate para gjykatës.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet forcimi i kapaciteteve të institucionit të Komisionerit dhe Zyrës, rritja e ndërgjegjësimit për ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe promovimi sa më i gjerë i parimit të trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, rritja dhe forcimi i

koordinimit ndërinstitucional, me qëllim sigurimin e zbatimit efikas të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Projektvendim i Kuvendit "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 34 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi"

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Rishikimi dhe ndërmarrja e ndryshimeve të nevojshme në strukturën organizative dhe organigramën e KMD.
- Zbatimi dhe monitorimi i Planit të Veprimit të Planit Strategjik 2012-2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Botimi i broshurave dhe katalogëve e manualeve për grupe specifike dhe sipas formave të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara
- Zhvillimi i një spoti publicitar dhe transmetimi në TV.
- Pjesëmarrje në emisione dhe debate televizive.
- Organizimi i ditëve të hapura dhe në rajone të ndryshme.
- Përmirësimi i infrastrukturës së institucionit me pajisjet e nevojshme kompjuterike dhe informatike.
- Trajnimi i stafit të zyrës me qëllim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të punonjësve
- Trajtim efektiv, me profesionalizëm dhe në respektim të afateve ligjore të ankesave për diskriminim.
- Organizimi dhe pjesëmarrja në konferenca, tryeza të rrumbullakëta, seminare me institucione të tjera publike, OJF dhe organizma ndërkombëtarë.
- Organizimi i trajnimeve me grupe të ndryshme profesionale si forcat e rendit, punonjësit e shëndetësisë, punonjësit e arsimit etj.
- Monitorim në fushën e arsimit parauniversitar i përqendruar tek diskriminimi për shkak të racës, gjendjes ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.
- Monitorim në fushën e punësimit, në sektorin publik dhe privat, me fokus të veçantë tek aksesi i grupeve vulnerabël tek mundësitë e punësimit.
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me INSTAT, Departamentin e Administratës Publike, Ministrinë e Brendshme, Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Avokatin e Popullit, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Ministrinë e Shëndetësisë.
- Nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me OJF .
- Vendosja e bashkëpunimit me pushtetin vendor.
- Në bashkëpunim me Ministrinë Arsimit dhe Shkencës dhe me përfshirjen e aktorëve të tjerë nga bota akademike dhe shoqëria civile, KMD do të angazhohet në hartimin e një plani masash për ndërhyrjen në kurrikulat shkollore në kuadër të parashikimeve të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi".
- Në bashkëpunim me Ministrinë e Integrimit do të ndërmerren hapat e nevojshme për përfshirjen e KMD-së në rrjetin evropian të institucioneve të barazisë EQUINET.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatmesme synohet krijimi i një sistemi efektiv dhe i besueshëm për mbrojtjen nga diskriminimi duke përmirësuar koordinimin ndërinstitucional, përafruar më tej legjislacionin shqiptar me atë evropian dhe duke siguruar zbatimin e plotë të tij.

Masat legjislative afatmesme janë si vijon:

- Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Realizimi i një studimi për të evidentuar nevojat për ndryshime në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimit".
- Zbatimi dhe monitorimi i Planit Strategjik 2012-2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe promovimi i parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.
- Botimi i broshurave dhe katalogëve e manualeve për grupe specifike, në gjuhën e minoriteteve dhe sipas formave të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.
- Pjesëmarrje në emisione dhe debate televizive.
- Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe krijimi i një programi elektronik (software), për menaxhimin e ankesave dhe gjenerimin e dhënave statistikore dhe trajnimi i stafit të KMD për përdorimin e sistemit.
- Trajnimi i stafit të zyrës me qëllim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të punonjësve.
- Trajtim efektiv, me profesionalizëm dhe në respektim të afateve ligjore të ankesave për diskriminim.
- Organizimi dhe pjesëmarrja në konferenca, tryeza të rrumbullakëta, seminare me institucione të tjera publike, OJF dhe organizma ndërkombëtarë.
- Realizimi i sondazheve/anketave me tematika të ndryshme, në mënyrë periodike, për të evidentuar grupet me të prekura nga diskriminimi.
- Realizimi i monitorimeve në fusha dhe grupe të ndryshme të mbrojtura nga ligji, të identifikuara si më të prekura nga diskriminimi, për të adresuar më pas rekomandimet dhe rregullimet e nevojshme për eliminimin e situatave diskriminuese.
- Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional.
- Zhvillimi i rregullt i dialogut me shoqërinë civile.
- Përfshirja e KMD-së në rrjetin evropian të institucioneve të barazisë EQUINET.

Implikimet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**26.990.000**	**17.920.000**	**16.850.000**	**16.500.000**
Mbulohen nga buxheti i	25.270.000	17.920.000	16.850.000	16.500.000

Mbuluar nga ndihma e huaj	1.720.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.20. NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE

3.20.1. POLITIKAT INDUSTRIALE

Objektivi strategjik

Objektivi kryesor i Qeverisë shqiptare në fushën e politikave industriale është stimulimi i programeve dhe projekteve që nxisin investimet në teknologji, në rritjen e konkurueshmërisë për modernizimin, diversifikimin dhe specializimin në tregjet e hapura. Përveç kësaj si objektiva specifike mbeten:

- Detyrimi që adresohet nga neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) për përafrimin e kuadrit ligjor Shqiptar me atë të Komunitetit Evropian (KE) si dhe të rregullave të konkurueshmërisë.
-
-
- Neni 92 i MSA-së, Bashkëpunimi Industrial, ka si synim te nxisë modernizimin dhe ristrukturimin e Industrisë shqiptare dhe sektorëve të veçantë, ashtu si edhe bashkëpunimin industrial midis operatorëve ekonomikë, me synim forcimin e sektorit privat në kushte të cilat të sigurojnë mbrojtjen e mjedisit.
- Përfundimi i privatizimit të pronës publike të mbetur dhe reformimi dhe zhvillimi i industrisë prodhuese jo-ushqimore.

Gjithashtu në përputhje me programin e qeverisë, përparësitë në sektorin e minierave janë zbatimi i objektivave të Strategjisë së Zhvillimit të Industrisë Minerare, përmirësimi i kuadrit ligjor si rezultat i përvojës së përfituar, anëtarësimi në iniciativën e Transparencës në Industrinë Nxjerrëse si dhe fillimi i zbatimit të principeve dhe kritereve të saj, monitorimi i marrëveshjeve të koncesionit në industrinë minerare, mbyllja e minierave, privatizimi i aseteve, likuidimi si dhe realizimi i studimeve me karakter kombëtar në lidhje me zhvillimin e sektorit, mbrojtja e mjedisit në zonat minerare. Sektori i minierave lidhet me nenin 70 të MSA-së i cili adreson detyrimin e përafrimit ligjor për këtë sektor.

Situata aktuale

Gjatë viteve 2010-2011 u hartua, konsultua dhe miratua “Strategjia Minerare e Republikës së Shqipërisë” 2012-2020, si dhe kuadri i ri ligjor “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i përbërë nga Ligji, 12 Vendime të Këshillit të Ministave dhe 27 Urdhëra të Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Këto dokumente të rëndësishme vendosën bazat e zhvillimit të industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të mineraleve mbështetur në planifikimin e nevojave, në planifikimin dhe efektivitetin e shfrytëzimit të burimeve minerare, në mbrojtjen dhe rehabilitimin e ambientit si edhe në transparencën e procesit të dhënies së të drejtës minerare nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 7512, datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit".
- Ligji nr. 7582, datë 13.07.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore".
- Ligji nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore".
- Ligji nr. 8306, datë 14.03.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë".
- Ligji nr. 8334, datë 23.04.1998 "Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jo strategjik".
- Ligji nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koçesionet".
- VKM nr. 269, datë 23.04.2004 "Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Industrisë jo- ushqimore".
- VKM nr. 230, datë 04.04.1998 "Për privatizimin e pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti në shoqëritë me kapital të përbashkët".
- VKM nr. 159, datë 13.03.2003 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet si dhe procedurat e shitjes".
- VKM nr. 195, datë 20.03.1998 "Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen".
- VKM nr. 169, datë 13.03.2003 "Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit të ndërmarrjeve shtetërore që nuk u nënshtrohen privatizimit apo transformimit të tyre në shoqëri tregtare".
- VKM nr. 194, datë 20.03.1998 "Për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar të shoqërive që do të krijohen nga shndërrimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare".
- VKM nr. 197, datë 20.03 1998 "Për nxjerrjen jashtë përdorimi të objekteve që nuk mund të shiten".
- VKM nr. 418, datë 09.07.1998 "Për procedurat e likuidimit të ndërmarrjeve në rrugë administrative".
- VKM nr. 162, datë 07.03.2007 "Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore".
- VKM nr. 461, datë 06.10.1999 "Për monitorimin e objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive e institucioneve shtetërore të dhëna me qira ose emfiteoze, përdorimi i të ardhurave ose emfiteoze".
- VKM nr. 398, datë 13.06.2003 "Për heqjen e licencave në industrinë prodhuese".
- VKM nr. 794, datë 21.11.2007 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet ose transformohet dhe për procedurën e shitjes".
- VKM nr. 54, datë 28.01.2005 "Për përcaktimin e kritereve për dhënien e lejeve profesionale specialistëve që kryejnë projektimin, vlerësimin, konsulencën, monitorimin dhe drejtimin teknik të veprimtarisë minerare", e ndryshuar.

Struktura institucionale

Sektori i Politikave Minerare dhe Industriale në Drejtorinë Minerare dhe Industriale, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të përbërë prej pesë punonjësish bashkëpunon me Drejtorinë e Politikave të Mbështetjes së Konkurueshmërisë së Ekonomisë

për politikat e reformimit dhe zhvillimit të industrisë prodhuese jo-ushqimore (Tekstile dhe të Veshjeve, Lëkurës dhe Këpucëve, Kimi, Dru letër,Gomës dhe Plastikes, Metalurgji dhe Punimi i Metaleve), aktivitetet e të cilave kryen në mbi 95% të subjekteve private nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Masat legjislative afatshkurtra

- Përgatitja e projektvendimit të Këshillit të Ministrave për përditësimin e Planit 3 vjecar 2012-2014 të dhënies së të drejtave për aktivitete minerare.
- Përgatitja e Urdhërit të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për miratimin e planit vjetor minerar 2012.
- Përgatitja e projektvendimit të Këshillit të Ministrave për likuidimin e aseteve të shoqërive publike në sektorin minerar në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Evidentimi i aktiviteteve të industrisë prodhuese jo-ushqimore publike dhe private, duke hartuar një database të detajuar me të gjitha të dhënat e nevojshme, sipas nomenklaturës të veprimtarive ekonomike.
- Monitorimi i zbatimit te Strategjisë së Zhvillimit të Industrisë Minerare.
- Mbikëqyrja dhe shfrytëzimi efektiv i pasurive minerare.
- Monitorimi i Fenomeneve Post Shfrytëzimit dhe uzinave metalurgjike.
- Studimi dhe përpunimi i Direktivave të BE-së për transpozimin e tyre.
- Promovimi i mineraleve të rinj dhe kërkime teknologjike dhe mjedisi.
- Digjitalizimi i të dhënave të industrisë minerare, përditësimi dhe mbajtja aktive e tyre.
- Planifikimi i zonave për të cilat parashikohet dhënia e të drejtave minerare.
- Zbatimi i principeve dhe kritereve të Iniciativës së Transparencës në Industrinë Nxjerrëse.
- Monitorimi i ujërave nëntokësore për të garantuar cilësinë e tij, për furnizimin e sigurt të popullatës.
- Vlerësimi dhe rivlerësimi i resurseve minerare sipas standardeve ndërkombëtare.
- Mirë administrimi i territorit së bashku me problemet komplekse të gjeomjedisit.
- Vlerësimi i rrezikut gjeologjik për të parashikuar efektet negative të aktiviteteve gjeologjike dhe minerare.
- Studime dhe projekte për emergjenca civile.
- Hartimi, përditësimi, mbajtjen aktive dhe transmetimi i shpejtë i gjeoinfomacionit.
- Vazhdimi i mbylljes së minierave të shfrytëzuara dhe jo efektive, si dhe privatizimi i aseteve.
- Konservimi dhe privatizimi i aseteve të industrisë prodhuese.
- Garantimi dhe kontrolli i sigurisë në punë, në miniera dhe rritja e aftësisë shpëtuese të personelit të RISHM.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Monitorimi i zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Industrisë Minerare.

- Mbikëqyrja dhe shfrytëzimit efektiv të pasurive minerare.
- Monitorimi i Fenomeneve Post Shfrytëzimit dhe uzinave metalurgjike.
- Përpunimi i Direktivave të BE-së, si dhe studimi dhe përgatitja e akteve për transpozimin e tyre.
- Promovimi i mineraleve të rinj, kërkime teknologjike dhe mjedisi.
- Dixhitalizimi i të dhënave të industrisë minerare, përditësimi dhe mbajtja aktive e tyre.
- Përcaktimi i zonave për të cilat parashikohet dhënia e të drejtave minerare.
- Zbatimi i principeve dhe kritereve të iniciativës së transparencës në industrinë nxjerrëse.
- Monitorimi i ujërave nëntokësore për të garantuar cilësinë e tij, për furnizimin e sigurt të popullatës.
- Vlerësimi dhe rivlerësimi i resurseve minerare sipas standardeve ndërkombëtare.
- Mire administrimi i territorit së bashku me problemet komplekse të gjeomjedisit.
- Vlerësimi i rrezikut gjeologjik për të parashikuar efektet negative të aktiviteteve gjeologjike dhe minerare.
- Studime dhe projekte për emergjenca civile.
- Hartimi, përditësimi, mbajtjen aktive dhe transmetimi i shpejtë i gjeoinfomacionit.
- Vazhdimi i mbylljes së minierave të shfrytëzuara dhe jo efektive, privatizimi i aseteve.
- Konservimi dhe privatizimi i aseteve të industrisë prodhuese.
- Garantimi dhe kontrolli i sigurisë në punë në miniera dhe rritja e aftësisë shpëtuese të personelit të RISHM.

3.20.1.1. POLITIKAT E TURIZMIT

Objektivi politik

Zhvillimi i turizmit duke qenë i lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, është një fushë prioritare për Qeverinë Shqiptare.

Politika e MTKRS konsiston në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, i cili ruan dhe zhvillon trashëgiminë kulturore dhe natyrore të Shqipërisë, duke siguruar rritje të shpejtë ekonomike, duke konsideruar turizmin si sektor konkurrues, të qëndrueshëm e të përgjegjshëm në ndikimin e tij në mjedis e traditën kulturore. Zhvillimi dhe përmirësimi i kushteve të produkteve turistike të vendit si turizmi i diellit dhe rërës, turizmit kulturor si dhe të turizmit të interesit të veçantë, përmirësimi i formave dhe teknikave të promocion marketingut konkurrues turistik, ofrimi i sigurisë e shërbimeve cilësore vizitorëve vendas e të huaj, krijimi i mundësisë së bërjes pushime nga të gjithë etj, janë në fokus të punës së ministrisë e institucioneve në varësi të saj. Rëndësi të veçantë në suksesin e turizmit ka harmonizimi i kuadrit ligjor e rregulloreve përkatëse me vendet anëtare të Bashkimit Evropian, përmirësimi i planifikimit urban të zonave turistike si dhe krijimi i lehtësive për investime direkte në këtë sektor duke krijuar një klimë biznesi lehtësuese për gjithë aktorët privat që operojnë me aktivitetet e tyre private në sektorin e turizmit.

Turizmi konsiderohet më shumë se një aktivitet ekonomik, i cili kontribuon direkt dhe indirekt në:

- rritjen ekonomisë në përgjithësi,
- përmirësimin e cilësisë së jetës së shqiptarëve,
- hapjen e vendeve të punës,
- planifikimin e zhvillimit e qëndrueshëm të burimeve natyrore e trashëgimisë kulturore,
- zhvillim social ekonomik në mënyrë të harmonizuar të gjithë rajoneve të vendit etj.

Suksesi i këtij sektori do të varet nga partneriteti , angazhimi i të gjithë aktorëve publik e privat dhe në kapacitetin e tyre për të punuar së bashku në zhvillimin e këtij sektori.

Statistikat turistike

Tregues i suksesit të turizmit përveç indikatorëve nga sektorë të ndryshëm që kanë lidhje me turizmin janë edhe statistikat në rritje të vizitorëve që kanë vizituar vendin tonë në vite.
Konkretisht gjatë vitit 2011 Shqipëria është vizituar prej më shumë se **4 milion vizitorë**:

- 2 milion e 734 mije vizitore jo rezidentë me nënshtetësi të huaj,
- 1 milion e 267 mijë vizitorë jo rezidentë me nënshtetësi shqiptare,

Numri i vizitorëve jo rezidentë me nënshtetësi të huaj është rritur me 18.7%, në krahasim me një vit më parë ose kanë hyrë më shumë se 500 mijë vizitorë, në krahasim me vitin 2010.
Numrin më të madh të vizitorëve e përbejnë ata kosovarë me 46%, të ndjekur nga maqedonasit me 12%, malazezët dhe grekët me 6%, italianët me 5%, anglezët dhe gjermanët me 3%.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Përsa i përket kuadrit ligjor mund të referohet se Ligji aktual Nr. 9734 datë 14.05.2007 "Për Turizmin", i ndryshuar me Ligjin Nr. 9930, datë 9.06.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9734 datë. 14.05.2007 "Për Turizmin" pasqyron të plotë: Direktivën e Këshillit 95/57 EC, e 23 nëntorit 1995 "Mbi mbledhjen e informacionit statistikor në fushën e turizmit" pikërisht në Nenin 34 të Ligjit "Për Turizmin" dhe Direktivën e Këshillit 90/314 EC e 13 qershorit 1990 "Mbi udhëtimet, pushimet dhe paketën e pushimeve", përfshirë në Nenet 9, 38, 39 të Ligjit "Për Turizmin".

Me VKM nr. 844, datë 11.06.2008 është miratuar "Strategjia Sektoriale e Turizmit 2007 – 2013". Ky dokumenti u përgatit në kuadrin e procesit të iniciuar nga Qeveria Shqiptare, për koordinimin e strategjive të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, ku ju dha prioritet nevojës për rishikimin e Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit 2002-2012 dhe ndërthurja e saj me Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Zhvillimin e Turizmit Natyror dhe Mjedisor dhe Planit të saj Veprues.

Struktura institucionale

Struktura shtetërore e sektorit të turizmit përfshin:

- **Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve**.

Në ministri funksionojnë dy Drejtori:
Drejtoria e Turizmit dhe *Drejtoria e Studimit të Tregut dhe Statistikave të Turizmit*. Detyrat kryesore të këtyre drejtorive janë:

- Sigurimi i zhvillimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor në turizëm;
- Orientimi i planifikimit të investimeve në këtë sektor;
- Menaxhimi i procesi të zbatimit të drejtimeve të Strategjisë Sektoriale të Turizmit dhe Planit të Veprimit të saj;
- Mbështetja dhe koordinimi me strukturat e turizmit në nivel ndërkombëtar, kombëtar e lokal për të siguruar zhvillimin gjithëvjetor e me shtrirje në gjithë territorin të turizmit;
- Bashkëpunimi me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare që ndërmarrin projekte dhe iniciativa të ndryshme për turizmin;
- Ndjekja dhe monitorimi i aktiviteteve të institucioneve në varësi të ministrisë;
- Garantimi i partneritetit me të gjithë aktorët publik e privat (të organizuar në shoqata) që operojnë apo kanë lidhje indirekte me sektorin e turizmit;
- Përmirësimi i sistemit të mbledhjes e përpunimit të statistikave të turizmit;
- Kryerja e studimeve të tregut për t'i paraprirë orientimit të politikave në këtë sektor etj, janë disa nga detyrat e drejtorive.

Dy drejtoritë kanë 10 punonjës.

Institucionet në varësi të ministrisë janë:

Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT) realizon Promocion - Marketing-un e turizmit nëpërmjet formave e teknikave të reja e pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit etj. Ajo operon nëpërmjet katër drejtorive kryesore: Drejtorisë së Promocion-Marketingut, Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun, Drejtorisë së Asistencës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse. AKT ka një numër prej 25 punonjësish.

*Zyrat e Shërbimit Turistik (*ZSHT), shqyrton e trajtimin e ankesave të shtetasve, vendas ose të huaj, kundrejt shërbimeve e mallrave të ofruara nga hotele, restorante, guida turistike, agjenci udhëtimi, dhe sipërmarrjeve të tjera turistike, realizimin e sinjalistikës turistike në gjithë vendin etj. Zyrat kanë degë në 9 qarqe të vendit dhe ka 20 punonjës.

Masat legjislative afatshkurtra

- Përmirësimi i kuadrit ligjor për turizmin i cili konsiston në rishikimin e ligjit aktual të turizmit. Ligji i ri do të vazhdojë të pasqyroj në mënyrë të plotë dy direktivat e mësipërme. Projektligji i ri i turizmit synon:
- Krijimin e një atmosfere të shëndoshë investimesh;
- Harmonizimin e rregulloreve të këtij sektori;
- Përmirësimin e klimës së biznesit.

Masat afatmesme

- Ngritja e grupit të punës për analizën e zbatimit të Strategjisë Sektoriale të Turizmit e planit të Veprimit që kanë shtrirje kohore deri në 2013, për të vazhduar më tej me strukturimin e një strategjie të re ose përmirësimin e strategjisë ekzistuese.

Masat ligjore afatmesme

- Përgatitja e Planit Kombëtar të Zhvillimit të Turizmit si një dokument të rëndësishëm e detyrim ligjor.

Aktivitete afatmesme

- Përdorimi i teknologjive të reja për promocion marketingun turistik si dhe përmirësimi e infrastrukturës përkatëse. Viti 2010 krahasuar vitin 2011 ka pasur një rritje prej 18.7% në numrin e vizitorëve. Objektivi ynë është rritja me 15-20% deri në vitin 2015.
- Orientimi i zhvillimit të produktit të ri turistik kurativ në rajonet që kanë burime natyrore kuruese, duke rritur e përmirësuar produktet turistike ekzistuese.
- Një ndër standardet bazë të BE për zhvillimin e turizmit është edhe krijimi i një sistemi të besueshëm statistikor mbi të dhënat e këtij sektori (TSA). Do të bëhen investime të rëndësishme për grumbullimin e të dhënave në vend dhe sistemet e menaxhimit për të monitoruar dhe analizuar vizitat turistike, shpenzimet, sjelljen, profilet e turistëve dhe karakteristika të tjera.

Implikimet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**86.751.000**	**87.729.000**	**89.385.000**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	86.751.000	87.729.000	89.385.000	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.20.2. PRIVATIZIMI DHE RISTRUKTURIMI

Objektivi strategjik

Sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim një nga objektivat kryesore strategjike në sektorin e ekonomisë është rritja e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë, nëpërmjet zhvillimit dinamik të sipërmarrjes, nxitjes së investimeve, shfrytëzimit më të mirë të burimeve natyrore, njerëzore dhe financiare.

Përmirësimi i klimës për zhvillimin e biznesit dhe investimeve përmblidhen në nenin 70, 91 dhe 93 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, duke mbështetur dhe përforcuar në këtë mënyrë politikat e qeverisë shqiptare mbi rritjen e konkurueshmërisë së SME-ve, tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri dhe nxitjen e eksporteve shqiptare në tregun rajonal dhe atë global, nëpërmjet zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit, reduktimit të barrierave administrative dhe krijimit të lehtësirave për biznesin.

Sipas politikave sektoriale të Partneritetit Europian objektivat sektoriale lidhen me:

- Ecurinë e zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël, SBA.
- Zbatimin më tej të planeve të masave/veprimeve për heqjen e barrierave administrative ndaj biznesit.
- Adresimin e problemit të ekonomisë informale, si dhe garancinë për zbatim të saktë, të hapur dhe jo-diskriminues i legjislacionit për biznesin, rregullave dhe procedurave.
- Reduktimin e rregullimeve ligjore të vjetra dhe joefikase nëpërmjet procedurave rregullatore "gijotinë".
- Zhvillimin e politikave për çështje të novacionit dhe konkurrueshmërisë për shoqëritë e vogla dhe vënien në zbatim të programeve mbështetëse.

Situata aktuale

Gjatë vitit 2011 është bërë ristrukturimi i shoqërisë strategjike KESH sh.a, si rezultat i të cilit u krijuan tre shoqëri të reja me kapital 100% shtetëror:

- HEC Ulëz-Shkopet, sh.a, Bulqizë.
- HEC Bistrica 1, Bistrica 2, sh.a,Sarandë.
- HEC Lanabregas sh.a, Tiranë.

Shoqëritë e krijuara si me sipër kanë përfunduar të gjitha procedurat e regjistrimit në QKR dhe kanë filluar funksionimin dhe veprimtarinë e tyre si entitete më vete. Krahas sa me sipër, për të tre shoqëritë e reja të krijuara në sektorin energjetik, është përgatitur baza ligjore përkatëse për privatizimin e tyre. "HEC Lanabregas" sh.a, do ti transferohen shoqërisë se "Ujësjellës-Kanalizime", sh.a, Tirane. Mbi bazën e VKM nr. 717, datë 20.10.2011 "Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërisë HEC Lanabregas Sh.a Tiranë", kanë filluar procedurat përkatëse të cilat janë në fazën përfundimtare. Po kështu kanë filluar procedurat e privatizimit të shoqërive "HEC Ulez-Shkopet" sh.a dhe "HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a.

Për shoqërinë Albpetrol sh.a, që operon në sektorin e hidrokarbureve, është miratuar ligji për privatizimin e shoqërisë. Ndërkohë po përgatiten aktet nënligjore në zbatim të ligjit dhe do të vijojnë më pas procedurat për përzgjedhjen e investitorit strategjik që do të blejë aksionet e kësaj shoqërie.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 10430, datë 09.06.2011 "Për krijimin e shoqërive "HEC Ulëz Shkopet" Sh.a, "HEC Lanabregas" Sh.a, "HEC Bistrica 1 Bistrica 2" Sh.a".
- Ligji nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare".

- Ligji nr. 10 490, datë 15.12.2011 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë “Albpetrol”, sh.a. Patos”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 717, datë 20.10.2011 “Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërisë HEC Lanabregas Sh.a Tirane”.

Struktura institucionale

Institucioni shtetëror përgjegjës për ristrukturimin dhe privatizimin e shoqërive është Drejtoria e Përgjithshme e Ofrimit të Shërbimeve, pjesë përbërëse të së cilës janë: Drejtoria e Privatizimit dhe Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike në METE. Këto drejtori kanë për detyrë zbatimin e politikave të Qeverisë për privatizimin, ndjekjen e ecurisë së procesit të privatizimit deri në mbylljen e transaksionit.

Masat legjislative afatshkurtra

- Përgatitja e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 10 490, datë 15.12.2011 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë “Albpetrol”, sh.a. Patos”.
- Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 10430, datë 09.06.2011 "Për krijimin e shoqërive “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a, “HEC Lanabregas” Sh.a dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” Sh.a dhe përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive "“HEC Ulëz-Shkopet” sh.a, “HEC Lanabregas” sh.a dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a ".
- Vendime të Këshillit të Ministrave lidhur me trajtimin e punonjësve të “HEC Bistrica 1 Bistrica 2” Sh.a”, “HEC Ulëz Shkopet” Sh.a.
- Vendime të Këshillit të Ministrave për përdorimin e të ardhurave nga privatizimi.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave për transferimin e titullit të pronësisë së aseteve nga sh.a “KESH” në favor të shoqërive të reja të krijuara, si dhe regjistrimin e tyre në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm, për llogaritjen e paketave të aksioneve për punonjësit e shoqërisë dhe për ish pronarët e truallit për shoqërinë ARMO sh.a dhe OSSH sh.a.
- Procesimi i procedurave për Albtelecom sh.a për ankandin lidhur me privatizimin e paketës së aksioneve të zotëruara nga shteti në këtë shoqëri.
- Përcaktimi i pikave te lidhjeve nga “CEZ Shperndarje” Sh.a dhe “Operatori i Sistemit të Transmetimit” Sh.a.
- Përfundimi i procedurave të privatizimit të shoqërive HEC Ulëz-Shkopet” sh.a dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2”.
- Transferimi i aksioneve të shoqërisë “HEC Lanabregas” sh.a Tiranë, tek “Ujesjellës-kanalizime” sh.a Tiranë.

3.20.3. KLIMA E BIZNESIT

Objektivi politik

Bazuar në nenin 93 të MSA-së si dhe në prioritetet afatshkurtra në lidhje me politikat sektoriale për industrinë dhe SME-të të përcaktuara në Partneritetin Europian 2007, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një sërë reformash rregullatore ku ndër më të rëndësishmet është reforma rregullatore në fushën e biznesit. Kjo reformë ka si qellim përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative ndaj nismës së lirë në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, ose përdorimin e të mirave publike, duke garantuar, njëkohësisht, mbrojtjen e interesit publik në ushtrimin e këtyre veprimtarive dhe në përdorimin e të mirave publike.

Në kuadër të kësaj reforme është reduktuar ndjeshëm numri i licencave/ lejeve/ autorizimeve nga 300 lloje e nënlloje përpara nisjes së kësaj reforme në rreth 45 syresh në Qershor 2009. Gjithashtu, janë qartësuar procedurat specifike, është ulur numri i hapave apo i zyrave të përfshira në proces si dhe janë shkurtuar ndjeshëm afatet e përpunimit të kërkesave.

Me ngritjen e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit (QKR), e cila shërben si 'one-stop-shop' për regjistrimin e biznesit, i gjithë aktiviteti për këtë fushë ndiqet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe do të monitorohet në vijim në kuadër të mekanizmave përkatës të reformës rregullatore. QKR operon nga 1 shtator 2007. Këto masa kanë reduktuar numrin e ditëve të regjistrimit në 1 ditë, dhe ofrimin e shërbimit on-line.

Situata aktuale

Një reformë tërësore është ndërmarrë për përmirësimin e klimës së biznesit, reduktimin e barrierave administrative. Sipas "Doing Business 2011-2012", në lehtësirat për të bërë biznes, Shqipëria renditet në vendin e 82 (nga 183 vende të analizuara).

Një sërë reformash për reduktimin e barrierave administrative në biznes dhanë rezultatet e tyre gjatë vitit 2011, si më poshtë vijon:
Qëndra Kombëtare e Regjistrimit, QKR si një one stop shop. Regjistrimi i biznesit brenda një dite pranë QKR e cila funksionon si një one stop shop, dhe me një kosto minimale prej 100 lekë. Kjo ka sjellë reduktimin e kohës së regjistrimit të një biznesi në një ditë nga 28 ditë që duhej një vit më parë në Gjykata. Për vitin 2011 janë regjistruar 12,706 biznese të reja; 22653 regjistrime të tjera (ndryshime) dhe 3545 c'regjistrime vullnetare. Aktualisht, ky institucion e zhvillon aktivitetin e tij në 32 zyra sporteli në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Reduktimi i kohës për hapjen e një biznesi të ri. Tashmë nevojiten pesë hapa për hapjen e një biznesi të ri nga dhjetë hapa që nevojiteshin më parë dhe vetëm pesë nga 36 ditë që nevojiteshin më parë. Reduktimi i kohës është shoqëruar edhe me reduktimin e kostos së hapjes së një biznesi të ri.

Qendra Kombëtare e Liçensave, QKL si një one-stop-shop. QKL punon sipas parimit të

miratimit në heshtje. Liçencat e grupit I dhe II jepen nga vetë QKL brenda dy-katër ditëve. Për liçencat e grupit III, të cilat përcillen pranë ministrive të linjës, koha e dhënies se liçencës është 10-30 ditë. Roli primar i Qendrës Kombëtare të Liçencimit është krijimi i një klime të përshtatshme biznesi që do të stimulojë rritjen e investimeve vendase dhe të huaja.
Për ti ardhur akoma edhe më shumë në ndihmë bizneseve, përveç tetë sporteleve në Tiranë, në bashkëpunim me QKR dhe Dhomat e Tregtisë, QKL ka hapur sportele shërbimi dhe në Korçë, Vlorë, Elbasan, Peshkopi, Durrës, Fier, Berat, Gjirokastër dhe Shkodër.

Bazuar në VKM nr. 385, datë 19.05.2010 "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.05.2009 "Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar, duke filluar nga data 9 qershor 2010, brenda QKL-së është ngritur dhe funksion sporteli i aplikimeve për projektet në fushën e energjisë. Ky sportel është asistuar me ndihmë financiare dhe teknike nga GIZ.

Për zbatimin dhe monitorimin e *Reformës Rregullatore*, me Urdhër të Kryeministrit nr. 170, datë 31.10.2005, u krijua Task-Forca për drejtimin dhe monitorimin e Reformës Rregullatore, në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit. Task-Forca për Reformën Rregullatore drejtohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje pesë Ministra të Ministrive më kryesore që lidhen me çështjet e biznesit. Plani i Veprimit për reformën rregullatore në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit është miratuar me VKM nr. 157, datë 15.03.2006, i ndryshuar.

Në përputhje me platformën e Qeverisë Shqiptare për Reformën Rregullatore, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ka patur jo vetëm rolin koordinues, implementues, monitorues dhe raportues, por edhe ka udhëhequr një sërë reformash të rëndësishme, një pjesë e të cilave janë realizuar me sukses, si reforma në sistemin e regjistrimit të biznesit dhe reforma në sistemin e liçensimit.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 "Për Liçencat, Lejet dhe Autorizimet në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji nr. 10137 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".
- VKM nr. 538, datë 26.05.2009 "Për Liçencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".
- VKM nr. 1295, datë 29.12.2009 "Për disa ndryshime në VKM nr. 538, datë 26.05.2009 "Për Liçencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".
- VKM nr. 385, datë 19.05.2010 "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 "Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar.

- Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) funksionon mbi bazën e Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", VKM nr. 505, datë 01.08.2007 dhe VKM nr. 506, datë 01.08.2007, si dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara për këtë qëllim.
- Ligji nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
- VKM nr. 157, datë 15.03.2006 "Plani i Veprimit për reformën rregullatore në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit".

Struktura institucionale

Qendra Kombëtare e Regjistrimit të biznesit, (QKR) është person juridik publik buxhetor qëndror, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës. Ajo vepron si një one-stop-shop për regjistrimin e bizneseve në një afat kohor jo më të gjatë se 24 orë. Pra regjistrimi i bizneseve është kthyer nga një veprim juridik që kryhej pranë gjykatës së rrethit Tiranë, në një veprim administrativ pranë QKR. QKR përbëhet nga një staf prej 50 punonjësish. Të gjitha llojet e shërbimeve kryhen me një tarifë minimale prej 100 Lekë ose 0,81 Euro.

Qendra Kombëtare e Licensimit, (QKL) është person juridik publik buxhetor qëndror, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës. Ajo vepron si një one-stop-shop për liçencat dhe lejet. Ajo punon sipas parimit të miratimit në heshtje. Për grupin I dhe II liçencat jepen nga vetë QKL brenda dy-katër ditëve. Për liçencat e grupit III, të cilat përcillen pranë ministrive të linjës, koha e dhënies së liçencës është 10-30 ditë. QKL-ja ka ofruar shërbimin ndaj publikut në mënyrë të drejtpërdrejtë fillimisht me 11 sportelet e saj në selinë qendrore në Tiranë si dhe në qytetet kryesore të Shqipërisë. QKL-ja përbëhet nga një staf prej 33 punonjësish.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projekt-vendim "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 538, datë 26.05.2009 "Për Liçencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", lidhur me liçencimin e projekteve energjetike".
- Projekt-amendime për dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2011 "Për QKR" dhe të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- Projekt-amendim për Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për QKR", për heqjen e funksioneve për liçencimin nga tërësia e funksioneve të QKR.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Zbatimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 385, datë 19.05.2010 "Për një shtesë në VKM nr. 538 datë 26.05.2009 "Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar, lidhur me liçencimin e projekteve energjetike".
- Testimi i sistemit të vlerësimit të impaktit rregullator / RIAs në tre fusha pilot

inspektimi, siguria ushqimore dhe mjedisi.

- Zbatimi i planit të veprimeve të rishikuar për reformën rregullatore në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit.

Masat legjislative afatmesme

- Projekt-vendim "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 538, datë 26.05.2009 "Për Liçencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", lidhur me autorizimet.
- Miratimi i Projekt-vendimit "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 538, datë 26.05.2009 "Për Liçencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", lidhur me autorizimet.
- Adoptimin e të gjithë legjislacionit përkatës për çdo Inspektoriat të ri, bazuar në:
    - Ristrukturimin.
    - Ligjin nr. 10433, datë 16.06.201 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
    - praktikat më të mira dhe orientimet më të fundit të BE-së në drejtim të Inspektimit, Sigurisë, Ambjentit etj. (RIA)

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Amendimet e mëtejshme të legjislacionit mbi bazën e të cilit operon QKR-ja do të jenë në varësi të plan-zbatimit për implementimin e direktivës për shërbimet.
- Instalimi i plotë i sistemit të vlerësimit të impaktit rregullator/RIA.
- Riorganizimi dhe ristrukturimi i të gjithë inspektoriateve dhe trupave inspektues (me fokus reduktimin e tyre, kalimin nga 33-Inspektoriate në 11-12 Inspektoriate) (RIA).

Efektet Financiare

Në lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**41.000.000**	**44.000.000**	**45.000.000**	**47.000.000**
Mbulohen nga buxheti i	41.000.000	44.000.000	45.000.000	47.000.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.20.4. POLITIKAT E SME-VE

Objektivi strategjik

Sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, një nga objektivat kryesore strategjike në sektorin e ekonomisë është rritja e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë, nëpërmjet zhvillimit dinamik të sipërmarrjes, nxitjes së investimeve, shfrytëzimit më të mirë të burimeve natyrore, njerëzore dhe financiare.

Përmirësimi i klimës për zhvillimin e biznesit dhe investimeve përmblidhen në nenin 70, 91 dhe 93 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), duke mbështetur dhe përforcuar në këtë mënyrë politikat e qeverisë shqiptare mbi rritjen e konkurueshmërisë së SME-ve, tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri dhe nxitjen e eksporteve shqiptare në tregun rajonal dhe atë global, nëpërmjet zhvillimit të teknologjisë dhe novacionit, reduktimit të barrierave administrative dhe krijimit të lehtësirave për biznesin.

Sipas politikave sektoriale të Partneritetit Evropian objektivat sektoriale lidhem me:

- Ecurinë e zbatimit të Aktit te Biznesit të Vogël, SBA.
- Zbatimin më tej të planeve të masave/veprimeve për heqjen e barrierave administrative ndaj biznesit.
- Adresimin e problemit të ekonomisë informale, si dhe garancinë për zbatimin e saktë, të hapur dhe jo-diskriminues i legjislacionit për biznesin, rregullave dhe procedurave.
- Reduktimin e rregullimeve ligjore të vjetra dhe joefikase nëpërmjet procedurave rregullatore "gijotinë".
- Zhvillimin e politikave për çështje të novacionit dhe konkurrueshmërisë për shoqëritë e vogla dhe vënien në zbatim të programeve mbështetëse.

Situata aktuale

Një reformë tërësore është ndërmarrë për përmirësimin e klimës së biznesit, reduktimin e barrierave administrative si dhe implementimin e Small Business Act.

Një nga këto reforma është edhe të mësuarit për sipërmarrjen. Është firmosur memorandumi i bashkëpunimit midis tre ministrave të Arsimit, Ekonomisë e Punës për të hartuar Planin e Veprimeve për të mësuarin për sipërmarrjen. Ka filluar funksionimin Grupi i Punës me përfaqësues nga tre ministritë me Urdhër të Ministrit të Arsimit nr. 32, datë 31.01.2012.

Kreditimi i SME-ve:

- Implementimi i skemës së kreditimit të SME-ve nga programi italian. Që prej fillimit zyrtar të Programit në Janar 2009, linja e kredisë për SME-të ka qenë mjaft e suksesshme dhe deri në fund te vitit 2011, nga pjesa e Parë dhe e Dytë e Kredisë së dhënë prej 15 milion Euro janë financuar 61 projekte të SME-ve shqiptare, me një financim prej 13,6 Milion Euro. Nga projektet e financuara dhjetë janë Biznese të reja "Start-up".
- Fondi i Garancisë me 2,5 milionë Euro është komponenti i dytë i rëndësishëm i Programit për Zhvillimin e SME-ve. Ky fond do të përdoret për të mbështetur Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SME), për të ndihmuar në uljen e nivelit të garancive të kërkuara nga Bankat për dhënien e kredive.
  Më 26 prill 2011, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shtatë përfaqësues të bankave tregtare më të rëndësishme në Shqipëri (Banka Kombëtare Tregtare (BKT); Raiffeisen Bank; Banka Ndërkombëtare Tregtare (ICB); Banka Credins; Tirana Bank; Veneto Bank dhe Banka Kombëtare Greke (NBG), nënshkruan zyrtarisht marrëveshjen për pjesëmarrjen në Fondin e Garancisë. Ky Fond do t'u mundësojë SME-ve rritjen e aksesit në kreditin bankar, në mënyrë që të zhvillohen investime sa më shumë produktive.

Për më tepër, programi merr një pjesë të garantimit të riskut të lidhur me kredin e dhënë dhe kjo do të na shërbejë me efikasitet për të mbajtur të lartë nivelin e kreditimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat kanë nevojë në këtë periudhë që të mbështeten në mënyrë më aktive, jo vetëm me linja krediti tregtar, por mbi të gjitha me linja të buta kreditimi.

- Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE). Mbështetja e EFSE për sektorin financiar shqiptar nuk përfshin vetëm investimet financiare, por edhe asistencën teknike, konsultat dhe trajnimet e ofruara për institucionet partnere të kreditimit me qëllim rritjen e informimit. EFSE ka dhënë një kredi prej 20 milion EUR për Bankën Kombëtare Tregtare (BKT). Kjo është marrëveshja e parë e kredisë midis EFSE dhe BKT dhe i referohet dhënies së kredisë afatgjatë për SME-të në Shqipëri. Në kuadër të programit EFSE, BKT deri më tani ka aprovuar dhe disbursuar pothuajse 15 Mio Euro kredi dhe rreth 200 klientë të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në fusha të ndryshme të përpunimit në industri dhe bujqësi dhe të shpërndarë në Tiranë, Durrës, Lushnje, Vlorë, Elbasan, Shkodër, Korçë, Pogradec, Sarandë, Gjirokastër, Peqin, Rrogozhinë, Vorë etj. Kreditë janë përdorur për kapital qarkullues, blerje inventari dhe investime në asete fikse si linja teknologjike apo investim në objekte/magazina. Deri tani nuk është hasur vështirësi dhe problem në implementimin e këtij fondi.

Implementimi i fondit të konkurrueshmërisë synon rritjen e konkurueshmërisë se SME-ve. Duke u bazuar në ecurinë dhe rezultatet pozitive të kësaj skeme si dhe për t'i ardhur në ndihmë biznesit eksportues me VKM nr. 112, datë 17.02.2010 u vendos Krijimi i Fondit të Konkurueshmërisë edhe për periudhën 3-vjeçare 2010, 2011, 2012 me një vlerë prej 28,000,000 lekësh për çdo vit. Me VKM nr. 539, datë 27.07.2011, u miratua që agjensia menaxhuese e ketij fondi do të jetë AIDA. Është hartuar dhe miratuar Rregullorja për funksionimin e fondit të konkurrueshmërisë, me Urdhër Ministri nr. 904, datë 21.11.2011. Gjithashtu u ngrit Komisioni i Aprovimit të Granteve me dy përfaqësues nga METE dhe tre nga AIDA. Kryetari i komisionit është drejtori i AIDAs.

Objektivi kryesor i kesaj Skeme është të mbështesë biznesin eksportues shqiptar në përpjekjet e tij për të nxitur dhe rritur eksportet**.** Konkretisht:

- Të ofrojë mbeshtetje financiare (fonde) për eksportuesit, duke ndarë me ta në masën 50% kostot e projekteve që lidhen me iniciativa për futjen në tregje të rinj ose konsolidimin e tregjeve egzistuese, plotësimin e standarteve të cilësisë së proceseve të prodhimit dhe të produktit, realizimin e misioneve të biznesit, promovimit të aktiviteteve, etj.
- Të mbështesë dhe intensifikojë atë që kompania është në gjendje të bëjë me kapacitetet e saj, por duke i shtuar "fonde grant" burimeve të kompanisë.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në programin komunitar për Konkurrueshmërinë dhe inovacionet (Competitiveness and Innovation Programme - CIP), për periudhën 2007 – 2013, u vendos me vendimin e Parlamentit Evropian nr. 1639/2006/KE. Komponenti i parë i përfshirë në këte program është komponenti EIP (Entrepreneurship Innovation Programe). Në kuadër të projektit komunitar CIP-EIP Shqipëria ka marrë pjesë suksesshëm në një sërë aktivitetesh, si në programin "Rrjeti i grave evropiane ambasadore" dhe në programin "Rrjeti evropian i

mentorëve të grave sipëmarrëse". Gjithashtu në kuadër të këtij projekti Shqipëria merr pjesë për herë të dytë në Javen Evropiane të SME-ve, si dhe në aktivitete kushtuar të mesuarit për sipërmarrjen. Gjatë zhvillimit të Panairit "Work & Study" në Pallatin e Kongreseve, me datat shtatë-nëntë tetor 2011, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit për hartimin e planit të veprimit afatmesëm për të mësuarit për sipërmarrjen.
Gjithashtu gjatë kësaj jave u organizuan aktivitete në shkollat 9-vjeçare të përzgjedhura si shkolla pilot për të futur kurikulën e të mësuarit për sipërmarrjen edhe në nivelin 9-vjeçar në kuadër të projektit rajonal të SEECEL.

Shqipëria, nëpermjet Qendres së Ndërmjetësimit të Biznesit dhe Inovacionit BRIC/AIDA dhe me asistencë të projektit IPA 2007, aplikoi në fillim të Tetorit 2011 për t'u bërë pjesë e European Enterprise Network (EEN), dhe ka ardhur përgjigja pozitive nga Komisioni Europian.

Përmirësimi i shërbimeve ndaj biznesit u përforcua me fillimin e funksionimit të Agjensisë së re të Zhvillimit të Investimeve AIDA që në Qershor 2011, si dhe me transformimin e saj në një one-stop-shop për investitorët e huaj. Stafi i ri i AIDAs është trajnuar për të kryer të gjitha veprimet dhe për të ndërmarrë të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe duke ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si dhe duke ndërmjetësuar e duke bashkëpunuar me investitorët e organet shtetërore. Gjithashtu krijimi i BRIC brënda AIDAs ka për qëllim implementimin e strategjisë së zhvillimit të inovacionit për SME-të.

Funksionimi i Këshilli Konsultativ i Biznesit (KKB). Drejtoria e Politikave të Mbështetjes së Konkurrueshmërisë dhe Ekonomisë (DPMKE), në mënyrë sistematike asiston sekretariatin e KKB për organizimin e mbledhjeve të KKB, si dhe për të mbajtur komunikim të vazhdueshëm me anëtarët e KKB per konsultimin e draftligjeve dhe vendimeve të Qeverisë që afektojnë biznesin. Gjatë vitit 2011 është koordinuar puna e KKB për të gjitha aktet ligjore e nënligjore të ardhura për mendim pranë KKB. Janë zhvilluar gjithsej katër mbledhje, në të cilat janë diskutuar mbi 10 projektligje dhe projektvendime, rekomandimet për të cilat i janë paraqitur për t'u marrë në konsideratë edhe Këshillit të Ministrave.

Krijimi i zonave ekonomike përfshin parqet industriale dhe zonat e lira. Bazuar në partneritetin midis sektorit publik dhe atij privat, vënia në funksionim e zonave ekonomike do të sjellë rritjen e fuqisë konkurruese të bizneseve, rritjen e nivelit të prodhimit, kapaciteteve teknologjike, eksporteve, punësimit, nxitjen e investimeve si dhe transferimin e teknologjive të avancuara. Deri në fund të vitit 2011 Qeveria ka shpallur dhjetë zona ekonomike dhe janë nënshkruar tre kontrata koncesionare dhe një kontratë është në negociata.

Politika fiskale përherë e më shumë po ndikon në krijimin e një mjedisi nxitës dhe mbështetës të sipërmarrjes vendase dhe të huaj. Tatim fitimi është ulur në vite, nga 30% në 1999, në 25% në 2004¸ në 23% në 2005¸ 20% në 2006-2007 dhe së fundi 10% që nga Janari i vitit 2008. Gjithashtu edhe tatimi mbi të ardhurat personale është 10%. Në vitin 2009 u sanksionua me ligj e drejta e kompensimit të detyrimeve të mëvonshme tatimore dhe

kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me shumën e TVSH-së për t'u rimbursuar.

Lidhur me shërbimin online në deklarimin dhe pagimin e tatimeve dhe taksave, gjatë vitit 2011 dhe në vazhdim, shërbimeve që sigurohen nga organet tatimore në rrugë elektronike i janë shtuar edhe deklarimi online i:

- Listë-pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi.
- pasqyrave të të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të të larguarve nga puna.
- deklarimit të pagesave e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël.

Që nga Prilli i vitit 2010 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është krijuar Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesit, e cila ka si qëllim të sigurojë një informacion efiçent dhe të prezantojë në hallkat administrative përkatëse problemet dhe shqetësimet e tatimpaguesve në përmbushjen e detyrimeve tatimore dhe procedurave përkatëse administrative. Avokati i Taimpaguesve është autorizuar që të investigojë të gjitha kërkesat nga tatimpaguesit që përmbajnë probleme të administrimit të tatimeve siç janë vonesa administrative të paarsyeshme, gabime të zyrtarëve tatimorë që nuk janë zgjidhur në mënyrën e duhur pas paraqitjes nga tatimpaguesi, mosrespektimi i procedurave tatimore apo shkelje e procedurave tatimore nga ana e zyrtarëve tatimor.
Pranë Minstrisë së Financave është krijuar Këshilli Tatimor si organ këshillimi që përfaqëson interesat e tatimpaguesve. Këshilli tatimor është propozuar si një forum teknik, këshillimi dhe bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Tatimpaguesve, i cili ka për qëllim diskutimin e problemeve dhe propozimin e masave që do të bënin të mundur zbatimin e legjislacionit tatimor me një kosto më të ulët administrative, për administratën tatimore dhe më një kosto më të ulët financiare për tatimpaguesit.

Në vazhdimësi të reformave të filluara nga Administrata Tatimore, për ofrimin e shërbimeve elektronike dhe lehtësimin e barrës administrative për tatimpaguesit, në Mars të vitit 2011 u krijua Qendra e Shërbimit të Tatimpaguesve e Drejtorisë Tatimore të Tiranës.

Qeverisja elektronike**.** Me mbështetjen e Marrëveshjes Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë (MCATA), që administrohet nga USAID, lidhur me thjeshtimin e procedurave të bërit biznes është arritur progres në veprimtarinë e administratës publike në këto katër drejtime kryesore: prokurimi publik, regjistrimi i biznesit, administrimi i tatim-taksave dhe licensimi.

Prokurimet online: Që nga fillimi i vitit 2009 të gjitha llojet e prokurimeve publike realizohen on line. Sistemi elektronik për prokurimin publik (www.app.gov.al) përmban të gjithë dokumentet për pjesëmarrjen në tender, dhe në këtë sistem të gjithë veprimtaritë, përfshirë shkarkimin e dokumenteve dhe dorëzimin në rrugë elektronike të ofertave dhe propozimeve për tender, kryhen falas.

Sherbim on line në doganat: Me informatizimin e të gjitha pikave doganore në përdorimin e programit Asycuda, është përmiresuar ndjeshëm shërbimi ndaj biznesit, duke reduktuar

kohën e plotësimit të dokumenteve si dhe të kontrollit të mallrave. Që nga viti 2010 deklaratat doganore bëhen 100% duke përdorur sistemin ACA ASYCUDA (100% DTI - Direct Trader Input) të shtrirë në të gjithe territorin doganor.

Teknologjia e informacionit. Gjatë viteve të fundit Qeveria ka ndërmarë politika nxitëse për zhvillimin e teknologjisë së informacionit, që nga nxënësit në shkolla e deri tek sipërmarrjet për të rritur konkurrueshmërinë e bizneseve shqiptar në tregun rajonal e global.

Investime të fuqishme janë bërë nga sistemi bankar, të cilat vlerësohen në rreth 200 milion Euro si dhe nga sektori i telekomunikacionit. Është rritur numri i bankave tregtare që ofrojnë shërbimet on line.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", i ndryshuar me Ligjin nr. 10 042, datë 22.12.2008, në përputhsmëri të pjesshme me Rekomandim e Komisionit të BE-së, datë 6 Maj 2003 në lidhje me përkufizimin e SME-ve.
- Ligji nr. 9880, datë 25.02.2008 "Për nënshkrimin elektronik", në përputhshmëri të plotë me Direktivën 1999/93/KE "Për kuadrin rregullator të nënshkrimit elektronik".
- Ligji nr. 10128, datë 11.05.2009 "Për tregtinë elektronike", në përputhshmëri te plotë me Direktivën 2000/31/KE "Për tregtinë elektronike".
- Ligji nr. 7764, datë 02.11.1993 "Për Investimet e Huaja".
- Ligji nr. 10316, datë 16.09.2010 për disa shtesa në Ligjin nr. 7764, datë 2.11.1993 "Për Investimet e Huaja".
- Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- Ligji nr. 10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe organizimin e Agjensisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve".
- Ligji nr. 9540, datë 09.11.2006 "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë".
- Ligji nr. 9897, datë 10.04.2008 "Për një ndryshim në ligjin nr. 9640, datë 09.11.2006 "Për Dhomat e Trëgtisë dhe Industrisë".
- Ligji Nr. 9897, datë 10.04.2008 "Për një ndryshim në Ligjin nr. 9640, datë 09.11.2006 për DHTI, është amenduar ligji për dhomat e industrisë dhe tregtisë duke hequr detyrimin e kompanive për t'u regjistruar pranë DHTI.
- Ligji nr. 9607, datë 11.09.2006 "Për Këshillin Konsultativ të Biznesit".
- Vendimi nr. 1 datë 02.12.2006 "Rregullore për funksionimin e Këshillit Konsultativ të Biznesit.
- Ligji nr. 9984, datë 11.09.2008 "Për ratifikimin e Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e komunitetit "Programi i veçantë për sipërmarrjen dhe novacionin (IEP) të programit kuadër të konkurrueshmërisë dhe novacionit, 2007-2013".
- Ligj nr. 10 045, datë 24.12.2008 "Për ratifikimin e marrëveshjes së transferimit dhe kontributit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondacionit për Financimin dhe Zhvillimin e Ndërmarrjeve (FEFAD) dhe Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE)".
- Ligji nr. 10379, datë 10.02.2011 "Për Krijimin e Shoqërisë Nxitja e Biznesit Social

Sh.a".

- Ligji nr. 9396, datë 12.05.2005 "Për qiranë Financiare" dhe në zbatim të nenit 44 të këtij ligji Udhëzimi për qiranë financiare, udhëzim i përbashkët i MF dhe METE;
- Ligj nr. 9823, datë 29.10.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9396, datë 12.05.2005, "Për qiranë financiare".
- Ligji nr. 9630, datë 30.10.2006 "Për faktoringun".
- Ligj nr. 10134, datë 11.05.2009 "Për krijimin e qendrës së panaireve dhe ekspozitave tregtare". Dekret nr. 6185, datë 25.05.2009.
- Ligjet nr. 9527 dhe 9528, datë 11.05.2006 për ratifikimin e marrëveshjeve qeveritare dhe financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e "Programit për zhvillimin e sektorit privat me anë të një kredie ndihmë për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe sigurimin e asistencës teknike për to".
- Ligj nr. 10273, datë 29.04.2010 "Për dokumentin Elektronik".
- Ligji nr. 9672, datë 29.12.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar, 1998".
- Ligji nr. 9930, datë 09.06.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9734, datë 14.05.2007 "Për Turizmin", pasqyron Direktivën 95/57/KE, e 23 Nëntorit 1995 "Mbi mbledhjen e informacionit statistikor në fushën e turizmit" pikërisht në Nenin 34 të Ligjit " Për Turizmin" dhe Direktivën 90/314/KE, 13 Qershor 1990 "Mbi udhëtimet, pushimet dhe paketën e pushimeve", përfshirë në nenet 9,38,39 të Ligjit " Për Turizmin".
- VKM nr. 844, datë 11.06.2008 është miratuar "Strategjia Sektoriale e Turizmit 2007 – 2013".
- VKM nr. 795, datë 11.07.2007, "Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2007-2013".
- VKM nr. 104, datë 09.02.2011 "Për një shtesë në vendimin nr. 795, datë 11.07.2007, të Këshillit të Ministrave "Për Miratimin e programit strategjik për zhvillimin e inovacionit për SME-të 2011-2015".
- VKM nr. 539, datë 27.07.2011 "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 21.02.2007 "Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë", të ndryshuar.
- VKM nr. 667, datë 28.09.2011, "Për krijimin e fondit të inovacionit, për periudhën 2011-2014".
- VKM nr. 540, datë 07.27.2011 për ndryshimin e VKM nr. 489, datë 25.07.2007 për "Fondin e Garatimit të Kredive për Eksport".
- "Për zhvillimin e sektorit privat me anë të një kredie ndihme për mbështetjen e SME-ve si dhe sigurimin e asistencës teknike me to", janë ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjet nr. 6527, datë 11.05.2006 dhe nr. 6528, datë 11.05.2006.
- Ligji nr. 9789 datë 19.07.2007, "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike".
- VKM nr. 860, datë 16.10.07 "Rregullore mbi krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike".
- VKM nr. 12, datë 04.01.2008, Zona ekonomike me statusin "Park Industrial" Koplik, Shkodër, me sip. 61 ha.
- VKM nr. 11, datë 04.01.2008, Zona ekonomike me statusin "Park Industrial"

Shëngjin, Lezhë, me sip. 3.2 ha.

- VKM nr. 391, datë 21.02.2008, Zona ekonomike me statusin "Park Industrial" në Spitallë Durrës, miratuar me sip. 850 ha.
- VKM nr. 771, datë 04.06.08 "Përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike, në Spitallë, Durrës".
- VKM nr. 772, datë 04.06.08 "Përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike, në Shëngjin, Lezhë, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë".
- VKM nr. 773, datë 04.06.08 "Përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike, në Koplik, Shkodër, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë".
- VKM nr. 774, datë 04.06.2008, Zonë ekonomike me statusin "Park Industrial" në Vlorë, me sip. 125 ha.
- VKM nr. 775, datë 04.06.2008, Zona ekonomike me statusin "Park Industrial" Shkodër, me sip. 130 ha.
- VKM nr. 776, datë 04.06.2008, Zona ekonomike me statusin "Park Industrial" në Elbasan, me sip. 254.7 ha.
- VKM nr. 628, datë 11.06.2009, Zona ekonomike me statusin "Zonë e Lirë", me sip. 478,14 ha në Vlore.
- VKM nr. 790, datë 22.07.2009, Zonë ekonomike me statusin "Park Industrial" me sip. 9,48 ha, në Laknas Tiranë.
- VKM nr. 713, datë 24.10.2007, "Për miratimin, në parim, të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin komunitar "Programi kuadër për Konkurrueshmëri dhe Inovacion", e cila miraton pjesëmarrjen e Shqiperisë në programin komunitar të BE, CIP.
- VKM nr. 112, datë 21.02.2007, "Për krijimin e fondit Shqiptar të konkurrueshmërisë", i ndryshuar me VKM 112, datë 24.02.2010.
- VKM nr. 438, datë 02.07.2004, "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 43, datë 17.01.1998 "Për organizimin e panaireve dhe ekspozitave tregtare".
- VKM nr. 430, datë 28.06.2006 "Për miratimin e planit të rishikuar të veprimit për reduktimin e ekonomisë informale për periudhën 2006- 2009" si dhe Urdhri i Kryeministrit nr. 145 datë 27.06.2006 "Për riorganizimin e Grupit Qendror për rishikimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit për reduktimin e ekonomisë informale".
- Urdhri nr. 192 i Kryeministrit, datë 12.12.2005, "Për riorganizimin e grupit ndërministror të punës për kompaktin e investimeve në kuadër të paktit të stabilitetit".
- VKM nr. 335, datë 02.09.1997 "Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit", të ndryshuar.
- VKM nr. 418, datë 09.07.1998 "Për procedurat e likuidimit të ndërmarrjeve në rrugë administrative".
- VKM nr. 162, datë 07.03.2007 "Për dhënien me qira të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore".
- VKM nr. 461, datë 06.10.1999 "Për monitorimin e objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive e institucioneve shtetërore të dhëna me qira ose emfiteoze, përdorimi i të ardhurave ose emfiteoze".
- VKM nr. 398, datë 13.06.2003 "Për heqjen e licencave në industrinë prodhuese".
- VKM nr. 794, datë 21.11.2007 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që

privatizohet ose transformohet dhe për procedurën e shitjes".

- VKM nr. 54, datë 28.01.2005 "Për përcaktimin e kritereve për dhënien e lejeve profesionale specialistëve që kryejnë projektimin, vlerësimin, konsulencën, monitorimin dhe drejtimin teknik të veprimtarisë minerare", e ndryshuar.

Struktura institucionale

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës**,** është institucioni kryesor që ka për detyrë hartimin e politikave për përmirësimin e klimës së biznesit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Këtë funksion ajo e kryen nëpërmjet Drejtorisë së Politikave të Mbështetjes së Konkurrueshmërisë së Ekonomisë si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe është e përbërë nga pesë punonjës.

Kjo drejtori është përgjegjëse për:

- Studimin e gjendjes dhe përpunimin e politikave të zhvillimit të biznesit për sektorin privat, për nxitjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), investimeve të huaja direkte (IHD) dhe të eksporteve.
- Hartimin e masave me karakter ligjor, institucional dhe administrativ në interes të zhvillimit të biznesit.
- Hartimin e programeve dhe projekteve të financimit, në bashkëpunim me institucionet publike shtetërore e private dhe donatorët, në interes të zhvillimit të sektorit privat, veçanërisht të SME-ve, investimeve dhe eksporteve.
- Organizimin e dialogut të vazhdueshëm me grupet e interesit të komunitetit të biznesit.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), themeluar me Ligjin nr. 10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe organizimin e Agjensisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve", përbëhet nga 29 persona. Me mbështetjen e projektit IPA "Për Rritjen e Konkurrueshmërisë së SME-ve Shqiptare", stafi i AIDA dhe Qendra e Ndërmjetësimit të Inovacionit (QNI) kanë qenë të trajnuar intensivisht për t'u bërë operacional sa më shpejt të jetë e mundur. AIDA në funksion të veprimtarisë së saj do të zhvillojë dhe të mbajë bazat e të dhënave të ndryshme që do të jenë të aksesueshme nga SME-të. Në këto baza të dhënash, në varësi të llojit të tyre do të përfshihen të dhënat që do të ndihmojnë mikrondërmarrjet, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për të vepruar. Për të realizuar këtë aktivitet AIDA është duke punuar për të zhvilluar një sistem të integruar elektronik. Ky sistem do të ketë pjesën e saj interaktive duke u përditësuar dhe duke iu përgjigjur pyetjeve nga SME-të bazuar në konceptin "asnjë derë e gabuar". AIDA është duke përgatitur bazën e të dhënave për SME-të i cili pritet të përfundojë në 2012, ndërkohë zhvillimi i aktivitetit të ofrimit të shërbimit të biznesit ofrues i AIDA-s do të përfundojë gjatë këtij viti.

Masat legjislative afatshkurtra

- Hartimi i kuadrit ligjor për instrumentat nxitës të zhvillimit të ekonomise kreative;

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Implementimi i skemës së përdorimit të fondit prej 28 milion lekë për rritjen e konkurueshmërisë së SME-ve.
- Organizimi i tryezes se Donatoreve për zbatimin e programit strategjik të SME-ve.
- Implementimi i transhit të tretë prej 10 mln Euro të programit italian për mbështetjen e SME-ve me një kredi prej 25 milion Euro dhe zbatimi i fondit të garantimit të kredive prej 2,5 milion euro.
- Forcimi i kapaciteteve të Qendrës së Ndërmjetësimit dhe Novacionit (BRIC), nëpërmjet vazhdimit të trajnimeve dhe hyrjes në rrjetin evropian të ndërmarrjeve, EEN.
- Përmirësimi i shërbimeve ndaj investitorëve nëpërmjet AIDA-s si një one-stop-shop.
- Hartimi i planit të veprimit për Përgjegjësinë Sociale të Korporatave (CSR).
- Azhornimi dhe Publikimi i Katalogut të Standardeve Shqiptare.
- Implementimi i fondit për Inovacionin për periudhen 2011-2014.

Masat legjislative afatmesme

- Hartimi i projektligjit për pagesat e vonuara, në përputhje me Direktivën 2011/7/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 16 Shkurt 2011 për luftën kundër pagesave të vonuara ne transaksionet tregtare.
- Hartimi i kuadrit nënligjor për investimet financiare private (business angels, venture capital, etc).
- Hartimi i projektligjit për transferimin e biznesit në përputhje me Rekomandimin 94/1069/KE i datës 7 Dhjetor 1994 për transferimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Mbështetje financiare mbi sipërmarrjen kreative në Shqipëri, nëpërmjet krijimit të fondit për ekonominë kreative.
- Implementimi i fondit për Inovacionin për periudhën 2011-14.
- Ngritja e inkubatorit për teknologjine e biznesit.
- Kryerja e Analizave të Nevojave për Trajnime (TNA).
- Studimi dhe krijimi i instrumentave të ndryshëm për rritjen e aksesit në financë për start-up dhe ndërmarrjet e vogla (venture capital, business angels, etj.).
- Krijimi i një sistemi të besueshëm statistikor mbi të dhënat në sektorin turistik (TSA).
- Përkthimi i standarteve në fushën e ndërtimit (eurokodeve) dhe adoptimi i tyre si standard Shqiptar (S SH).

Efektet Financiare

Në lekë

	2012	**2013**	**2014**	**2015**
Kostot totale e vlerësuar	**112.200.000**	**412.500.000**	**514.500.000**	**516.500.000**
Mbulohen nga buxheti i	112.200.000	112.500.000	114.500.000	116.500.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	0	300.000.000	400.000.000	400.000.000

Ndryshim	0	0	0	0

3.21. RRJETET TRANS-EUROPIANE

3.21.1. RRJETET TRANS-EUROPIANE TË TRANSPORTIT

Objektivi strategjik

Objektiv kryesor i Qeverisë Shqiptare për infrastrukturën rrugore është zhvillimi i përshpejtuar dhe rehabilitimi i rrjetit të përshtatshëm rrugor kombëtar, që ndihmon në realizimin e një transporti që mbështet dhe inkurajon zhvillimin e ekonomisë dhe plotësimin e kërkesave të transportit Evropian. Në mbështetje të nenit 106 të MSA-së dhe neneve 4 e 5 të Protokollit 5, të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), P.K.T (të rishikuar) dhe të Strategjisë Sektoriale, synohet krijimi i një rrjeti transporti pa bllokime e ndërprerje, zvogëlimi i hendekut midis tendencës gjithmonë në rritje të mjeteve motorike dhe ritmeve të zhvillimit të rrjetit rrugor, si dhe zhvillimi i transportit të qëndrueshëm. Qeveria Shqiptare ka përcaktuar si prioritet për zhvillimin dhe finalizimin e rrjetit bazë rrugor (SEETO Comprehensive Network), kompletimin e Korridorit Lindje–Perëndim (Korridori VIII-të) që përfshin aksin ndërkombëtar Juglindor; kompletimin e aksit Veri–Jug që lejon lidhjen nëpërmjet territorit shqiptar të Greqisë me Malin e Zi; zhvillimin e Boshtit Qendror-Jugor; të rrugës Durrës–Morinë që siguron lidhjen me Kosovën dhe Korridorin X; si dhe zhvillimin e rrugës së Arbrit si degëzim i Korridorit VIII-të dhe lidhje më e shkurtër midis Shkupit dhe Tiranës. Gjithashtu, prioritet mbetet përmirësimi i sistemit të administrimit dhe të efikasitetit të mirëmbajtjes së rrjetit rrugor me zbatimin e sistemit të menaxhimit të aseteve rrugore, aktualisht ndonëse është bëre një punë e mirë në krijimin e aseteve rrugore është bërë pak në ruajtjen e tyre. Realizimi i prioriteteve të sipërpërmendura do të ketë si qëllim përfundimtar, zhvillimin e një infrastrukture rrugore brenda territorit shtetëror që ndihmon për krijimin e një hapësire unike ekonomike, të integruar në rrjetin rajonal dhe panevropian me synim arritjen e standardeve të lejueshme të BE-së.

Rrjeti hekurudhor shqiptar është pothuaj tërësisht i përfshirë në Rrjetin kryesor rajonal të transportit. Gjatësia e përgjithshme e linjës kryesore është rreth 420 km. Krahas saj ka dhe 200 km linja të dyta dhe degëzime hekurudhore. Objektivi kryesor mbetet Integrimi i mëtejshëm i rrjetit hekurudhor shqiptar me rrjetin rajonal të Evropës juglindore, si dhe realizimi i lidhjes hekurudhore me Maqedoninë.

Për sa i përket Infrastrukturës portuale, në programet e zhvillimit të MPPT krahas Investimeve në Infrastrukturën Portuale ekzistuese, është vlerësuar si domosdoshmëri, ndërtimi me koncesion (duke thithur kapitalin vendas dhe të huaj) i Porteve Private të specializuara, si dhe përfshirja e teknologjive bashkëkohore, si kontejnerët, siloset etj., të cilat rrisin ndjeshëm nivelin e shërbimit dhe efektivitetin e portit. Në Portin e Durrësit është në proces dhe parashikohet të përfundojë brenda vitit 2013 bashkëfinacimi i BEI-t dhe BERZH-it, KE dhe Qeverisë Shqiptare prej rreth 40 Milion Euro për ndërtimin e Terminalit te Pasagjereve ne sheshin e trageteve dhe rehabilitimin e kalatave nr. 7 dhe nr. 8. Në Portin e Vlorës është ne procesin e tenderimit Projekti për rehabilitimin e infrastrukturës dhe superstrukturës portuale, ndërtimin e kalatës së re të përpunimit te anijeve traget dhe të kalatës së përpunimit të mallrave, me një financimi prej 15,3 milion euro nga Kooperacioni Italian. Në Portin Detar të Sarandës ka filluar ndërtimi i kalatës për anijet turistike Kruiz, me

financimin e Bankës Botërore prej rreth 4,7 milion USD dhe parashikohet të përfundojë brenda vitit 2012. Me ketë investim rritet ndjeshëm kapaciteti akostuse dhe përpunues i Portit të Qytetit të Sarandës si një port pasagjeresh dhe turistik. Në Portin Detar Shëngjin ka filluar ndërtimi i kalatën së re të përpunimit te mallrave me financim prej 3,6 milion Euro nga Programi IPA 2008 dhe Qeveria Shqiptare dhe parashikohet të përfundojë brenda vitit 2012, projekt i cili synon rritjen e kapacitetit të këtij porti.

Statusi aktual

Objektivat e vendosura në Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Transportit në lidhje me investimet për ndërtimin e rrugëve sipas prioriteteve, përgjithësisht janë realizuar. Në fushën e infrastrukturës rrugore, është në proces përgatitja e akteve të nevojshme nënligjore në zbatim të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009 "Për krijimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar", që është përgjegjës për zhvillimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor shtetëror. Përsa i përket rrjetit të infrastrukturës rrugore janë pranë përfundimit korridoret rrugore kryesore, duke dhënë një kontribut të madh në zhvillimin e rrjeteve infrastrukturore të Ballkanit, me synim integrimin e tyre të ardhshëm në Rrjetet e Transportit Transevropian. Në veçanti, përparimi i punimeve në Korridorin Veri-Jug (segmenti Shkodër-Hani i Hotit dhe dublimi i segmentit rrugor Fushë Krujë-Milot "Thumanë"), në pjesët e Korridorit 8-të (segmenti Levan-Vlorë dhe dublimi i rrugës By Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë), në punimet për ndërtimin e rrugës Tiranë-Elbasan, pjesë e rëndësishme e Boshtit Qëndror-Jugor (lidhje kryesore e Korridorit 8-të), si dhe hapja e Autostradës që lidh Kosovën me Korridorin Veri-Jug dhe portin e Durrësit. Shqetësim mbetet mirëmbajtja e pamjaftueshme rrugore, për të cilën ka nisur procedura parakualifikuese për dhënien me koncension të shërbimit të mirëmbajtjes, rehabilitimit dhe operimit të autostradës Milot-Morinë. MPPT ka përfaqësuar në nivel të lartë në të gjitha takimet vjetore të SEETO-s, (takime ndërministrore; të Komitetit Drejtues; Koordinatorëve Kombëtarë; etj) dhe ka shkëmbyer informacionin e nevojshëm në kuadrin e SEETO, lidhur me situatën aktuale të projekteve në zbatim të infrastrukturës rrugore dhe të atyre të parashikuara; bashkëpunim me Projektin "Bashkëpunimi për Akset e Transportit të Evropës Jug Lindore" SEETAC, etj.

Rrjeti hekurudhor shqiptar është pothuaj tërësisht i përfshirë në Rrjetin kryesor rajonal të transportit. Gjatësia e përgjithshme e linjës kryesore është rreth 420 km. Krahas saj ka dhe 100 km linja të dyta dhe degëzime hekurudhore. Si rrjedhojë e akordimit të fondeve në nivele të pamjaftueshme gjatë 20-25 viteve të fundit, nivelit të ulët të mekanizimit të punimeve të mirëmbajtjes dhe rikonstruksionit, aktualisht gjendja e linjës hekurudhore në tërësi, në të gjithë treguesit e saj, është në parametra jo optimal teknikë. Për rrjedhojë shpejtësia aktuale e lëvizjes së trenave në linjë është rreth 35 km/orë dhe në mjaft zona të veçanta është shumë më e ulët. Gjendja e traversave dhe e ballastit nuk plotëson standardet e duhura teknike. Sistemi i sinjalizimit, i instaluar para 30 viteve, nuk është në funksionim. Me përjashtime shumë të vogla, ndërlidhja e duhur me postet e kalesave hekurudhore nuk punon dhe kjo përbën një shkelje të rregulloreve teknike. Mjediset e shërbimit të stacioneve të udhëtarëve janë të papërshtatshme dhe nuk ofrojnë shërbimin e duhur ndaj udhëtarëve. Përsa me sipër transporti hekurudhor ofron një shërbim të mangët, që nuk plotëson parametrat minimale të sigurisë në lëvizjen e trenave.

Për sa i përket Infrastrukturës portale, projektet për zhvillimin e kësaj infrastrukturë, garantojnë rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetin e porteve detare në tërësi. Bazuar në Planin Kombëtare të Transportit, Strategjinë e Zhvillimit të Sektorit të Transportit, si dhe Master Planet e zhvillimit të secilit port, janë kryer një sërë investimesh të rëndësishme me financimin e Donatoreve të huaj dhe Buxhetit të Shtetit, kryesisht për rehabilitimin e kalatave të përpunimit, shesheve depozituese, blerjen e vinçave dhe pajisjeve për kontejnerë, thellimin e portit, ndërtimin e terminalit të pasagjereve etj.. Gjithashtu, janë ndërtuar me koncesion dhe kanë filluar operimin dy porte private, për karburantin dhe gazin, si Porti i Petroliferës në Vlorë dhe Porti i Porto Romanos në Durrës. Në Portin e Durrësit është realizuar Master Plani i Ri për zhvillimit e këtij portit, me financimin grand të KE prej rreth 1 milion Euro. Master Plani është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 546, datë 28.05.2009.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Legjislacioni bazë, që rregullon veprimtarinë në fushën e infrastrukturës rrugore, një pjesë e të cilave nuk përafron akte të BE-së, është si më poshtë:

- Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, përafron pjesërisht Direktivën 96/53/KE e 25 Qershorit 1996, “Që përcakton ... përmasat e lejuara maksimale dhe peshat e autorizuara maksimale të automjeteve...” (nr.celex 31996L0053, Fletore Zyrtare e KE, L235/1996, f. 59);
- Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për Shpronësimet dhe Marrjen në Përdorim të Përkohshëm të Pasurisë Pronë Private për Interes Publik”, botuar në Flet. Zyrtare 37/1999, fq. 1522, hyrë në fuqi me 1 Mars 2000.
- Ligji nr. 9511, datë 10.04.2006 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Evropiane “Për arteriet kryesore të trafikut ndërkombëtar AGR", Fletore Zyrtare 41/2006, fq. 1271, hyrë në fuqi me 21.05.2006.
- Ligji nr. 9878, datë 21.02.2008 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes “Për ngritjen dhe Veprimtarinë e Observatorit të Transportit për Evropën juglindore (SEETO)”, Flet. Zyrtare 37/2008, faqe 1673, hyrë në fuqi 27.03.2008.
- Ligji nr. 10164, datë 15.10.2009 "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar", botuar në Fletoren zyrtare 150/2009, hyrë në fuqi me 20.11.2009.
- VKM nr. 687, datë 08.11.2005 "Për Miratimin në Parim të Marrëveshjes për Ngritjen dhe Veprimtarinë e Observatorit të Transportit për Evropën Juglindore (SEETO)”.
- VKM nr. 405, datë 08.01.1996 "Për Administrimin e Rrjetit Rrugor Kombëtar dhe Rrjetit Rural të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar hyrë në fuqi me 08.01.1996.
- VKM nr. 341, datë 27.02.2008 “Për Miratimin e Planit të Veprimit, sipas Raportit Përfundimtar për Reformimin e Kapaciteteve institucionale dhe Shndërrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në Ent Publik”, Fletore zyrtare 51, datë 01.04.2008, fq. 2273, hyrë në fuqi me 27.02.2008.
- VKM nr. 1214, datë 03.09.2008 “Për Miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit”, Fletore Zyrtare nr. 145, datë 22.09.2008, faqe 7183, hyrë në fuqi 22.09.2008.
- VKM nr. 484, datë 23.06.2010 “Për Emërimin e Anëtarëve të Bordit të menaxhimit për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, Fletore Zyrtare 99, datë 28.07.2010, faqe 5206, hyrë në fuqi 23.06.2010.

- VKM nr. 817, datë 23.11.2011 "Për Miratimin në Parim të Planit Kombëtar të Transportit (Rishikimi i parë pesëvjeçar)", Fletore Zyrtare 169, datë 29.12.2011, hyrë në fuqi 23.11.2011.
- Urdhër i Ministrit të MPPT nr. 125, datë 26.12.2011 "Për Miratimin e Hartave të Azhornuara të Rrjetit Rrugor Kombëtar dhe të Distancave Kilometrike Ndërmjet Qyteteve të Shqipërisë".

Legjislacioni bazë, që rregullon veprimtarinë në fushën e infrastrukturës hekurudhore, përbëhet nga aktet e mëposhtme ligjore:

- Ligji nr. 9689, datë 05.03.2007 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Marrëveshjen Evropiane për Linjat Hekurudhore Ndërkombëtare Kryesore".
- Ligji nr. 9620, datë 16.10.2006 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes shumëpalëshe "Për ngritjen e një rrjeti hekurudhor, të performancës së lartë, në Evropën Juglindore".
- Ligji nr. 9317, datë 18.11.2004, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" (në ligj janë përafruar pjesërisht direktivat 91/440/KEE, 95/18/KE, 2001/12/KE, 2001/13/KE, 2001/14/KE).

Legjislacioni bazë, që rregullon veprimtarinë në fushën e infrastrukturës detare, është si më poshtë:

- Ligji nr. 9251, datë 08.07.2004 "Kodi Detar i Republikës se Shqipërisë".
- Plani Kombëtar i Transportit (miratuar me VKM nr. 817, datë 23.11.2011).
- Strategjia e Sektorit te Transportit (miratuara me VKM nr. 1214, datë 03.09.2008).
- Master – Plani i Portit të Durrësit (miratuar me VKM nr. 546, datë 28.05.2009).

Struktura institucionale

Autoriteti Rrugor Shqiptar "Autoriteti". Në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), Strategjinë Sektoriale të Transportit, Planin Kombëtar të Transportit (PKT), si dhe Ligjin nr. 10164, datë 15.10.2009 "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar", përveç të tjerash, përgatit programe afatmesme zhvillimi të rrjetit rrugor shtetëror, bazuar në kritere inxhinierike sa më të përparuara dhe në efektivitetin ekonomik të investimeve. Gjithashtu, përgatit programin vjetor për ndërtimin, rikonstruksionin, mirëmbajtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e rrugëve shtetërore në përputhje me përparësitë e përcaktuara në dokumentet strategjike dhe në mbështetje të burimeve të financimit bën shpërndarjen dhe kontrollon realizimin e tyre. Krijon dhe mirëmban sistemin për administrimin e rrugëve shtetërore dhe të urave; mirëmban dhe zbaton Manualin Shqiptar të Ndërtimit të Rrugëve dhe Specifikimet Teknike; merr nisma për studime, kërkime shkencore dhe eksperimente për efiçencën, trafikun, qarkullimin dhe sigurinë rrugore. Reformimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (DPRr) po aktualizon në zbatim të VKM Nr. 341, datë 27.02.2008, sipas rekomandimeve të Raportit Përfundimtar për ngritjen e kapaciteteve institucionale,që synon shndërrimin në Ent Publik "Autoritet", bazuar në vizionin e njësisë së reduktuar, të centralizuar dhe kontraktuese të shërbimeve të nevojshme, të kryera në mënyrë efektive nga sektori privat (pritet të përfundojë në fund të vitit 2012). Nga perspektiva teknike ARrSh do të menaxhojë shumicën e veprimtarive përmes kontratave bazuar në performancën duke përdorur sistemin e menaxhimit të pasurive (SMPRr), sipas planit kombëtar të transportit (PKT2).

Në punën e saj D.P.Rr/Autoriteti mbështetet nga:
Drejtoria e Politikave të Transportit (Sektori i Politikave të Transportit Rrugor), pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, mbikëqyr infrastrukturën e transportit rrugor përmes DPRr/Autoritetit. Kjo drejtori ka për mision hartimin e politikave të zhvillimit të rrjetit rrugor kombëtar, të konkretizuara në objektivat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, zbatimin dhe monitorimin e tyre në kuadrin e sistemit ligjor rregullues dhe të angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e infrastrukturës rrugore, hartimin e programit buxhetor afatmesëm (PBA) dhe bashkëpunimin për një progres të mëtejshëm në përcaktimin e përparësive rajonale dhe koordinimin e investimeve, hartimin e PKZMSA për rrjetin e rrugëve shtetërore etj. Në zbatim të ligjit për Autoritetin Rrugor Shqiptar, marrëdhënia midis "Autoritetit" dhe Ministrisë do të përcaktohet nga marrëveshja e shërbimit(aktualisht në proces hartimi), në zbatim të politikave dhe përparësive të përcaktuara për detyrimet lidhur me fondet, planifikimin, monitorimin e performancës së autostradave,progresin dhe raportimin (për zbatim në vitin 2013).

Qeveria Shqiptare, nëpërmjet MPPT, është përfaqësuar në nivel të lartë në të gjitha takimet vjetore te SEETO-s, (takime ndërministrore; te Komitetit Drejtues; Koordinatoreve Kombëtarë, etj), duke shënuar progres të dukshëm në shkëmbimin e informacionit në kuadrin e SEETO, lidhur me situatën aktuale te projekteve ne zbatim te infrastrukturës rrugore dhe te atyre te parashikuara; të dhëna trafiku; bashkëpunim me Projektin "Bashkëpunimi për Akset e Transportit të Evropës Jug Lindore" SEETAC, etj. Shqipëria po merr pjesë aktive në Observatorin e Transportit të Evropës Juglindore (SEETO) dhe duhet të vazhdojë të bashkëpunojë me fqinjët e saj me synim që të përcaktojnë së bashku, projektet me interes rajonal.

Instituti i Transportit ushtron aktivitetin e tij në zbatim të VKM nr. 861, datë 21.11.2007 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Institutit të Transportit", me objekt kryesor veprimtarie për krijimin e një database për sektorin e transportit, funksionimin si një burim qendror i informacionit, që do të përditësojë Planin Kombëtar të Transportit (PKT 2) dhe programet e investimeve, që lidhen me të.

Në fushën e Infrastrukturës hekurudhore, kuadri institucional ekzistues përbëhet nga Sektori i Politikave të Transportit Hekurudhor në MPPT dhe nga Hekurudha Shqiptare sh.a.[129]
Në kuadër të zhvillimit të Reformave Institucionale në fushën e detarisë po punohet për riorganizimin e strukturave ekzistuese dhe krijimin e strukturave te reja te specializuara dhe efektive. Autoriteti Portual Durrës, në zbatim të Ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual", është në procesin e ristrukturimit të tij me qëllim transformimin final të tij në "Land-Lord Port". Gjithashtu vazhdon procesi i ristrukturimit, privatizimit të shërbimeve në porte (përfshire dhe ngarkim-shkarkimin), duke u bazuar në eksperiencën e Autoritetit Portal Durrës, si projekt pilot, me ndryshimet logjike sipas specifikave të secilit port.

[129]Për më shumë, ju lutem shikoni në Kapitullin 14, pika 3.14.1.2. "Transporti Hekurudhor".

Masat legjislative afatshkurtra

- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Manuali shqiptar (standardet) për projektimin dhe ndërtimin e rrugëve", me qëllim respektimin e standardeve evropiane të rrugëve, normativat e KE-së (institucioni përgjegjës MPPT/Autoriteti tremujori IV/2012). Shënim: Ky akt nuk përafron akte të BE, por do të hartohet në përputhje me standardet rrugore të vendeve të BE-së, projektakt i cili ka mbetur i papërfunduar nga PKZMSA e mëparshme.
- Projekt-Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin në parim të Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për kryerjen e transportit hekurudhor kufitar në Rajonin e SEETO-s dhe me vendet fqinje të Bashkimit Evropian" (tremujori IV/2012). Drafti i Marrëveshjes është ofruar nga SEETO dhe Banka Botërore. Nuk ka direktivë specifike të BE-së për këtë problem.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Vazhdimi i ndërtimit të autostradës Tiranë-Elbasan me gjatësi 29 km dhe përfundimi i ndërtimit të tunelit, pjesë e Boshtit Qendror-Jugor dhe Korridorit VIII.
- Përfundimi i ndërtimit të autostradës Levan-Tepelenë me gjatësi 71 km, pjesë e aksit Veri-Jug.
- Përfundimi i ndërtimit të autostradës Fier-Vlorë (Levan-Vlorë me gjatësi 24 km), pjesë e Korridorit VIII.
- Fillimi i ndërtimit të By-Pass Fier me gjatësi 22 km, pjesë e Korridorit VIII.
- Përfundimi i ndërtimit të rrugës Shkodër-Hani Hotit me gjatësi 39 km, pjesë e aksit Veri-Jug.
- Përfundimi i By-Pass Shkozet (faza e parë), pjesë e Korridorit VIII.
- Përfundimi i ndërtimit (dublim) të segmentit rrugor Fushë Krujë-Milot me gjatësi 13 km, pjesë e aksit Veri-Jug.
- Vazhdimi i ndërtimit (dublim) të seksionit rrugor By Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë me gjatësi 24 km, pjesë e Korridorit VIII.
- Negocimi i "Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për kryerjen e transportit hekurudhor kufitar në Rajonin e SEETO-s dhe me vendet fqinje të Bashkimit Evropian" (tetor 2012).
- Hartimi i projekt zbatimit te rikonstruksionit te linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe vlerësimi ekonomik dhe financiar i modernizimit te gjithë rrjetit (me fonde te BERZH-it) (tremujori i VI 2012).
- Përfundimi i Terminalit të Pasagjereve në Portin e Durrësit me një financim prej rreth 22 milion Euro (BEI, BERZH);
- Përfundimi i ndërtimit të kalatës Nr. 10 në zonën lindore të Portit të Durrësit, me një financim prej rreth 8,5 milion Euro nga fondet e Autoritetit Portual Durrës;
- Përfundimi i hartimit të Projektit të detajuar për thellimin e portit të Durrësit, me fondet e Autoritetit Portual Durrës;
- Përfundimi i ndërtimit të kalatës për anijet turistike Kruiz në Portin Detar Sarandë, me financimin e Bankës Botërore prej rreth 4,7 milion USD;

- Përfundimi i ndërtimit të kalatës së re të përpunimit të mallrave në Portin Detar Shëngjin me financim prej 3,6 milion Euro nga Programi IPA 2008 dhe Qeveria Shqiptare.

Masat legjislative afatmesme

- Projekturdhër i Ministrit "Për përditësimin e hartave të rrjetit rrugor kombëtar të Republikës së Shqipërisë", me qëllim reflektimin në hartën rrugore të ndryshimeve në lidhje me rrugët kombëtare të ndërtuara (Instituti i Transportit tremujori II/2013). Ky projektakt është detyrim nga PKZMSA e mëparshme dhe nuk synon të përafrojë akt të BE-së, por do të ndihmojë për hartimin e projekt-vendimit për TEN-T.
- Projektvendim "Mbi Udhëzimet e Bashkimit Evropian për Rrjetin Transevropian TEN-T (transporti rrugor)", i cili synon përputhje të pjesshme me Vendimin e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi udhëzimet për zhvillimin e rrjetit të transportit trans-evropian, nr.celex 32010D0661/ OJ L 204 5.8.2010). Institucioni përgjegjës MPPT/3-mujori IV 2015.
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për riorganizimin e sistemit hekurudhor shqiptar", i cili synon përputhje të plote me direktivën 91/440 (pas miratimit të Ligjit "Mbi sistemin hekurudhor në Republikën e Shqipërisë").

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Përfundimi i ndërtimit të autostradës Tiranë-Elbasan me gjatësi 29 km, pjesë e Boshtit Qendror-Jugor dhe Korridorit VIII.
- Përfundimi i ndërtimit të By-Pass Fier me gjatësi 22 km, pjesë e Korridorit VIII.
- Përfundimi i By-Pass Shkozet (faza e dytë), pjesë e Korridorit VIII.
- Përfundimi i ndërtimit (dublim) të seksionit rrugor By Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë me gjatësi 24 km, pjesë e Korridorit VIII.
- Dhënie me koncension afat gjatë të rehabilitimit, mirëmbajtjes dhe operimit të autostradës Milot-Morinë me gjatësi 118 km (përfshirë tunelin e Thirës), pjesë e rrugës Durrës-Morinë-Prishtinë.
- Përfundimi i ndërtimit të rrugës së Arbrit (seksioni Tiranë-Bulqizë) me gjatësi 55 km, degëzim i Korridorit VIII.
- Përfundimi i ndërtimit Qukës-Qafë Plloçë me gjatësi 40 km, lidhje e Korridorit VIII me Greqinë.
- Përfundimi i rehabilitimit të rrugës Qafë Thanë-Pogradec me gjatësi 22 km, pjesë e Korridorit VIII.
- Vazhdimi i ndërtimit të rrugës Elbasan-Berat-Tepelenë, pjesë e Boshtit Qendror-Jugor.

Në periudhën afatmesme do të vazhdojë realizimi i projekteve të ndërtimit dhe kompletimit të infrastrukturës dhe superstrukturës portale, konkretisht si më poshtë:

Në Portin Detar Durrës

- Rikonstruksioni i Kalatës nr. 7 dhe nr. 8 me një financim prej rreth 8,5 milion Euro nga BEI dhe BERZH, parashikohet të përfundojë në fund të vitit 2013.

- Thellimi i basenit të Portit dhe kanalit hyrës me një financim prej rreth 16 milion Euro, i cili parashikohet të përfundojë brenda vitit 2013.
- Projekti për ndërtimin e Kalatës nr. 11 në zonën lindore të portit me një vlerë prej rreth 16 milion Euro, i cili parashikohet të përfundojë në vitin 2015.

Në Portin Detar Vlorë

Realizimi i projektit të ndërtimit të terminalit të operimit të trageteve dhe terminalit të përpunimit të mallrave me një financim prej rreth 15,3 milion Euro nga Kooperacioni Italian, i cili parashikohet të përfundojë brenda vitit 2014.

Efektet Financiare

Shpenzimet për nënkapitullin 3.21.1: Rrjetet Trans-Evropiane të transportit (Rrjeti Nacional i Rrugëve)

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**22.747.000.000**	**30.016.000.000**	**28.666.000.000**	**32.887.000.000**
Mbulohen nga buxheti i	5.897.000.000	1.943.000.000	2.168.000.000	6.000.000.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	16.850.000.000	28.073.000.000	26.498.000.000	26.887.000.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.21.2. RRJETET TRANS-EUROPIANE TË ENERGJISË

Objektivi strategjik

Objektivat strategjik të Qeverisë Shqiptare në fushën e rrjeteve e trans-evropiane të energjisë kanë si synim realizimin e objektivave bazë të Strategjisë Sektoriale të Energjisë, të cilat kanë për qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit të vendit me burime energjetike nëpërmjet diversifikimit të burimeve të furnizimit me energji dhe integrimit të rrjeteve të transportit të energjisë në kuadër rajonal dhe Evropian, duke respektuar dhe plotësuar njëkohësisht edhe kërkesat dhe detyrimet sipas legjislacionit dhe standardeve përkatëse Evropiane.

Prodhimi i energjisë elektrike në vendin tonë është i bazuar në prodhimin e saj nga burimet hidrike (më shumë se 98%), prandaj dhe besueshmëria e sistemit tonë elektroenergjetik është shumë e varur nga kushtet hidrike. Fuqia e instaluar e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar është rreth 1531 MW dhe prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e vendit, duke qenë se është nga burimet hidrike, ka natyrë probabilitare, që lëviz nga rreth 3 miliard kWh/vit deri në 7,7 miliard kWh/vit, në varësi të kushteve hidrike (rreth 7,7 miliardë kWh ne vitin 2010). Prodhimi mesatar vjetor është rreth 4,2 miliard kWh. Duke patur në konsideratë që kërkesa për energji elektrike në vendin tonë aktualisht është 7,342 TWh/vit dhe prodhimi vendas rreth

4,2 TWh/vit, pra është i pamjaftueshëm, bën të detyrueshëm që aktualisht, mbulimi i nevojave duhet të përballohet nëpërmjet importit të energjisë elektrike.

Nga ana tjetër, duhet të vëmë në dukje që kapacitetet importuese të vendit tonë janë të limituara. Kjo vjen si pasojë e kapaciteteve të limituara që kanë linjat tona të interkonjeksionit me vendet fqinjë. Por vështirësitë në realizimin e importit vijnë edhe për faktin se edhe kapacitetet e linjave të interkonjeksionit të vendeve të rajonit drejt vendit tonë janë të kufizuara, pasi vendi ynë është pikë fundore në rrjetin rajonal të energjisë elektrike.

Duhet theksuar gjithashtu se importi i energjisë elektrike është vështirësuar edhe për shkak të rritjes së deficitit të energjisë elektrike në rajonin e Ballkanit, ku numri më i madh i vendeve, përveç Bullgarisë, Rumanisë dhe Bosnje Hercegovinës, janë importues neto të energjisë elektrike.

Për këtë arsye, në synimet strategjike të Qeverisë Shqiptare, është përcaktuar që të punohet për realizimin e:

- Rritjes së sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit me energji, në veçanti të energjisë elektrike në nivel kombëtar dhe rajonal, përmes diversifikimit të sistemit të energjisë elektrike dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese dhe linjave te interkonjeksionit.
- Mundësimin e lidhjes së Shqipërisë me rrjetet rajonale të gazit dhe naftës, për të siguruar furnizimin e ekonomisë me burime energjetike hidrokarbure dhe specifikisht për zhvillimin e sektorit të gazit dhe tregut të gazit në Shqipëri, si dhe për shfrytëzimin e oportuniteteve që ofron pozicioni gjeostrategjik i vendit tonë në zhvillimin e rrjeteve rajonale të interkonjeksionit me gaz në rajonin e Evropës Jug-Lindore.
- Krijimin e një sektori efikas të energjisë nga aspektet financiare dhe teknike.
- Krijimin e një kuadri efektiv institucional dhe rregullator.
- Rritjes së efiçencës së energjisë në gjenerimin dhe përdorimin e energjisë.
- Përmirësimin e sistemit të furnizimit me burime energjetike, përfshirë energjitë e rinovueshme, bazuar në parimin e planifikimit me kosto të ulët dhe ndikim minimal në mjedis.
- Rritjes në mënyrë të konsiderueshme të investimeve në sektorin e energjisë me përfshirjen e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe të kapitalit privat.
- Hapjes së tregut të brendshëm konkurrues të energjisë elektrike dhe në bazë të detyrimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Prioritete për infrastrukturat që do të futen në planin e zhvillimit të rrjeteve elektrike e të gazit natyror, në kuadër të "Rrjetit Trans-Evropian të Energjisë", ashtu si dhe për rrjetin rrugor e për rrjete të tjera që lidhen me zhvillimin e tregjeve brenda këtij Komuniteti, lidhen me:

- Zhvillimin e rrjeteve që mbështesin veprimtarinë e tregjeve ekzistuese, në mënyrë të veçantë për zgjerimin e kapaciteteve të transmetimit dhe sigurinë e lidhjeve të nevojshme që mungojnë.
- Lidhja e rrjeteve energjetike të izoluara, rajonet periferike dhe ultra periferike.
- Nxitjen e diversifikimit të burimeve energjetike, përdorimin e burimeve të rinovueshme dhe efiçencën e energjisë.

Politika në kuadër të "Rrjetit Trans-Evropian të Energjisë", në një aspekt të përgjithshëm mban parasysh:

- Implementimin e Paketës së Tretë të BE-së ku duhet të futen jo vetëm vendet anëtare të BE-së por edhe vendet kontraktuese të Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë.
- Zhvillimin e një tregu evropian të energjisë mbi bazën e një rrjeti të zhvilluar energjetik (lidhjen e rajoneve të izoluara, rritjen e kapaciteteve të transmetimit, etj).
- Aftësinë e rrjetit evropian për të përballuar kërkesat e tregut evropian të energjisë.
- Sigurinë e furnizimit me energji dhe qëndrueshmërinë e sistemeve.
- Lidhja sistemore e vendeve anëtare mbështetur në kërkesat (peak) të tyre.
- Diversifikimin e burimeve të furnizimit me energji.
- Potencialin e zhvillimit të burimeve të rinovueshme të energjisë.

Në Sektorin Hidrokarbur

Politikat për zhvillimin e sektorit të naftës dhe gazit do të synojnë në diversifikimin e furnizimit me naftë dhe gaz dhe mundësimin e lidhjes së Shqipërisë me rrjetet fqinje të naftësjellësve dhe gazsjellësve, duke patur parasysh edhe mundësinë e zbulimeve të reja të burimeve energjetike hidrokarbure në vend dhe si rrjedhoje rritjen e mundshme të nivelit të brendshëm të prodhimit të naftës dhe gazit.

Shqipëria synon të jetë pjesë e Korridorit Jugor Energjetik të Evropës, duke përfshirë rrjetet e gazit që do të sjellin gazin e vendeve të Kaspikut dhe Lindjes së Mesme drejt Vendeve të Evropës Jug-Lindore dhe vendeve të Evropës Qendrore.

Vendi ynë ende nuk është lidhur me rrjetin ndërkombëtar të gazit. Në kuadër të diversifikimit të burimeve të energjisë, si dhe të zhvillimit të sektorit energjetik, Qeveria Shqiptare është tepër e interesuar dhe mbështet projekte për zhvillimin e infrastrukturës rajonale të gazit, dhe para së gjithash për futjen e Gazit Natyror në Shqipëri dhe lidhjen e vendit me rrjetet e gazit Rajonale dhe Ndërkombëtare.

Shqipëria është pjesë e Studimit Rajonal për Gazifikimin, të financuar nga Banka Botërore dhe KfW dhe në këtë kuadër si pjesë e rajonit të Evropës J-L dhe anëtare e Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë është e interesuar për lidhjen e saj me rrjetet Rajonale të gazit, në përputhje me variantin më të mirë. Vendi ynë ka mbështetur konceptin e Unazës së Gazit për Ballkanin Perëndimor (Unaza e Gazit e Komunitetit të Energjisë), e propozuar nga konkluzionet e këtij studimi.

Situata aktuale

Sistemi shqiptar elektroenergjetik deri në fund të vitit 2011 ka qenë i lidhur me vendet fqinje dhe për rrjedhojë edhe me rrjetin Trans-Evropian të Energjisë Elektrike nëpërmjet linjave të interkonjeksionit të mëposhtme:

- 400 kV mes Zemlak dhe Kardhja (Greqi) Fuqia vendosur: 1200 MVA dhe fuqia e transmetuar: 700 MVA për shkak të transformatorit 400/220 kV në Elbasan2 dhe Zemblak.
- 220 kV mes Fierzës dhe Prizrenit (Kosovë)Fuqia e transmetuar: 311 MVA.
- 220 kV mes Vaut të Dejës dhe Podgoricë 1 (Mali i Zi)Fuqia e transmetuar: 311 MVA.
- 150 kV mes Bistrica 1 dhe Igumenicë (Greqi, përdorur vetëm në operim radial). Fuqia e vendosur: 138 MVA, Fuqia e transmetuar: vetëm 40 MVA, për shkak të transformatorit të instaluar në Bistricë.
- Linja 400 kV Tiranë – Podgorice, gjatësia totale 154 km (125.5 km në anën shqiptare ku 80 km do të jenë linjë dyfishe dhe 28.5 km janë në anën Malazeze). Ka përfunduar ndërtimi i saj dhe është vënë në punë në muajin prill të vitit 2011;
- Linja 400 kV Tirana 2 – Elbasan 2, gjatësia totale 48 km. Ka përfunduar ndërtimi i saj dhe është vënë në punë në muajin Prill të vitit 2011.
- 400/220/110 kV Nënstacioni Tirana 2, kapaciteti transformues 2x300 MVA 400/220 kV dhe 2x120 MVA 220/110 kV. Ka përfunduar ndërtimi i tij dhe është vënë në punë në Nëntor të vitit 2011.
- Ndërtimi i Qendrës së Re Kombëtare Dispecer. Punimet vazhdojnë.
- Ka patur progres në ndërtimin e linjës së re 400 kV të interkonjeksionit me Kosovën (Tirana2 – Kosova B), gjatësia totale 235 km. Financimi i saj do të kryhet nga Banka gjermane KfW.

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike:

Sistemi i Transmetimit në Shqipëri është i përbërë nga rrjetat e nivelit 400, 220 dhe 110 kV dhe 120 km linja janë 400 kV, 1,103 km linja janë 220 kV, 34 km linja janë 150 kV dhe 1,202 km linja janë 110 kV. Rrjeti 220 kV është plotësisht i lidhur në unazë dhe lidh impiantet kryesore në veri të Shqipërisë me qendrat e ngarkesës në rajonet e Tiranës, Elbasanit dhe Fierit. Rrjeti 110 kV përdoret për furnizimin e Sistemit të Shpërndarjes. Pjesë të këtij rrjeti janë lidhur në rrjet dhe pjesa tjetër është radiale. 12 nënstacionet 220 kV dhe 400 kV janë ndërtuar në përgjithësi me zbara të dyfishta në anën 220 kV dhe 400 kV. Ana 110 kV në këto nënstacione ka përgjithësisht një zbarë.

Projektet për zhvillimin e rrjetit të gazit dhe integrimin e tij në rrjetet Trans-Evropiane të energjisë:

Aktualisht vendi ynë është përfshirë në projekte të lidhjeve rajonale të sistemeve të gazit, sikurse është projekti i Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë, që parashikohet të lidhë pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu Shqipëria është pjesë e:

- projektit të Gazsjellësit Ionian Adriatik (projekti IAP), projekt i cili do të lidhë vendet e rajonit si Kroacia, Mali i Zi dhe Shqipëria, si dhe Bosnja&Hercegovina.
- projektit të gazsjellësit lindje-perëndim Trans Adriatic Pipeline (projekti TAP – Greqi – Shqipëri – Itali), që parashikohet të sjellë gazin e rajoneve të Lindjes së Mesme, Kaspikut dhe Rusisë drejt Evropës Perëndimore.

- Një projekt tjetër për lidhjet rajonale me gazsjellëset është projekti i ndërtimit të një terminali të Gazit Natyror të Lëngëzuar në bregdetin e Qarkut të Fierit dhe lidhja me rrjetin Italian të gazit (dhe rrjetin Evropian) me një gazsjellës nëndetar Shqipëri - Itali.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Legjislacioni bazë, që rregullon veprimtarinë në fushën e infrastrukturës energjetike, përfshirë edhe atë që ka të bëjë me rrjetet Trans-Evropiane të Energjisë, përbëhet nga aktet e ligjore, të cilat janë miratuar apo ratifikuar nga Institucionet përkatëse të Shtetit Shqiptar, siç janë:

- Ligji nr. 8261, datë 11.12.1997, "Për ratifikimin e Traktatit të Kartës së Energjisë dhe të Protokollit të Kartës së Energjisë për eficiencën e energjisë dhe aspektet përkatëse të mjedisit".
- Ligji nr. 9560, datë 12.06.2006, "Për ratifikimin e amendamentit të dispozitave që lidhen me tregtinë, të traktatit të kartës së energjisë".
- Ligji nr. 8573, datë 03.02.2000 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes "Umbrella" për kuadrin institucional të krijimit të sistemeve ndërshtetërore të transportimit të naftës dhe të gazit", Fletorja Zyrtare: Viti 2000, Nr 4, Faqe 74; Data e botimit: 16-03-2000
- Ligji nr. 9501, datë 03.04.2006, "Për ratifikimin e Traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë".
- Ligji nr. 9778, datë 16.07.2007, "Për ratifikimin e "Konventës trepalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Maqedonisë për sistemin e naftësjellësit transballkanik".
- "Deklarata Ministeriale për Projektin e Gazsjellësit Ionian – Adriatik", ndërmjet Kroacisë, Malit të Zi dhe Shqipërisë, e nënshkruar në Zagreb (Kroaci) më 25 Shtator 2008. Kësaj Deklarate Ministeriale në datën 11 Dhjetor 2008 iu bashkua edhe Bosnja&Hercegovina, gjatë Takimit Ministerial të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, që u zhvillua në Tiranë.
- "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë në lidhje me zhvillimin dhe integrimin e sistemeve elektrike dhe të gazit natyror", e nënshkruar në Tiranë, më 10.03.2009.
- Marrëveshje Bashkëpunimi "Mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e emetimeve të gazit me efekt serë"ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë". Marrëveshja është nënshkruar më 19.12.2007.
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Greke, për bashkëpunimin në fushën e energjisë", miratuar me VKM nr. 710, datë 18.10.2006, "Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për bashkëpunimin në fushën e energjisë".
- Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Minierave të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë, për bashkëpunim në fushën e energjisë, nënshkruar në Prishtinë, më datë 09.09.2008.
- Ligji nr. 9072, datë 22.05.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, është ligji kryesor që mbulon sektorin e energjisë elektrike në Shqipëri. Ligji për sektorin e

energjisë elektrike përafron Direktivat e BE-së si: Direktivën 2003/54/KE "Lidhur me rregullat në tregun e brendshëm të energjisë elektrike" dhe Direktivën 2005/89/KE "Lidhur me masat për sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe investimet në infrastrukturë".

- Ligji nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për Koncesionet", i ndryshuar, bashkë me aktet nënligjore dhe procedurat që lidhen me koncesionet, përbën mekanizmin e Shqipërisë për të tërhequr investime private edhe në fushën e rrjeteve të energjisë.
- Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 "Për hidrokarburet" (Kërkimi dhe Prodhimi), i ndryshuar. Ligji për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve është i harmonizuar me Direktivën 94/22/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 30 Maj 1994 për kushtet e dhënies dhe përdorimit të lejeve për zbulimin, kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, Celex nr. 31994L0022.
- Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar. Dispozita e këtij ligji nuk i referohet një direktive të veçantë por bazohet në legjislacionin në fuqi në disa shtete të BE-së (p.sh. Greqia) dhe në disa direktiva si: Direktiva e Këshillit 98/93/KE e datës 14 Dhjetor 1998, Direktiva amenduese 68/414/KEE, e cila detyron Shtetet Anëtare të KEE të mbajnë rezerva minimale të naftës bruto dhe/ose produkteve hidrokarbure.
- Ligji nr. 9946, datë 30.06.2008 "Për sektorin e gazit natyror". Ligji për sektorin e gazit përafron Direktivën e BE 2003/55/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 26 qershor 2003 në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe Direktiva shfuqizuese 98/30/KE; Celex nr. 32003L0055 dhe, Rregullorja (KE) nr. 1775/2005 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 28 shtator 2005 "për kushtet në lidhje me futjen në rrjetet e transmetimit të gazit natyror"; Celex nr. 32005R1775.
- Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për Shpronësimet dhe Marrjen në Përdorim të Përkohshëm të Pasurisë Pronë Private për Interes Publik".
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë".
- VKM nr. 27, datë 19.01.2007 "Për Miratimin e Rregullave për Dhënien e Konçensioneve", i ndryshuar.
- VKM nr. 424, datë 26.6.2003, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2015".
- VKM nr. 553, datë 12.08.2004, "Për procedurat dhe kushtet për lejet konçesionare për ndërtimin e dhe përdorimin e rafinerive, naftësjellësve dhe gazsjellësve".
- VKM nr. 529, datë 15.08.2007, "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit".
- VKM nr. 713, datë 25.08.2010, "Për përcaktimin e rregullave për kushtet e procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror",
- Vendimin i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë me nr. 123, datë 24.10.2008 "Kodi i Rrjetit të Transmetimit".

Struktura institucionale

Kuadri institucional dhe kapacitetet e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e energjisë, përfshirë specifikisht edhe infrastrukturën energjetike, si pjese e rrjeteve rajonale dhe Trans-Evropiane energjetike, janë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) është autoriteti më i lartë shtetëror në hartimin e politikave dhe strategjive në sektorin e energjisë. Misioni i METE-ës, në sektorin e energjisë është zhvillimi i politikave për të siguruar një furnizim normal me burime energjie për konsumatorët, për të garantuar një rritje të qëndrueshme të ekonomisë së vendit dhe një zhvillim social dhe kulturor të popullsisë, përfshirë edhe diversifikimin e burimeve të furnizimit nëpërmjet lidhjes së Shqipërisë me rrjetet rajonale dhe Trans-Evropiane të energjisë elektrike dhe të gazit natyror e të naftës.

Drejtoria e Politikave Elektroenergjetike, pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), ka për mision hartimin e politikave të zhvillimit të rrjetit energjetik kombëtar dhe përfshirjen e tij në rrjetet rajonale dhe Trans-Evropiane energjetike, të konkretizuara në objektivat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, zbatimin dhe monitorimin e tyre në kuadrin e sistemit ligjor rregullues dhe të angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e energjisë, hartimin e programit buxhetor afatmesëm (PBA) dhe bashkëpunimin për një progres të mëtejshëm në përcaktimin e përparësive rajonale dhe koordinimin e investimeve, hartimin e PKZMSA për rrjetin energjetik shtetërore etj.

Në zbatim të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", nga Ministria në bashkëpunim me Operatorin e Sistemit te Transmetimit (OST sh.a.), në zbatim të politikave dhe përparësive, përcaktohen detyrimet lidhur me fondet, planifikimin, monitorimin e performancës së rrjeteve energjetike kombëtare dhe Trans-Evropiane.

Drejtoria e Standardeve Elektroenergjetike, si pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), në përbërje të së cilës funksionon edhe Sektori Rregullator dhe i Menaxhimit të Projekteve dhe Kontratave Hidrokarbure, i cili ka për mision trajtimin dhe menaxhimin e projekteve dhe kontratave për sektorin hidrokarbur përfshirë edhe projektet për zhvillimin e rrjeteve të transportit të naftës dhe gazit si pjesë e rrjeteve rajonale dhe Trans-Evropiane energjetike, të konkretizuara në objektivat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekjen e zbatimit dhe monitorimit të tyre në kuadrin e sistemit ligjor rregullues dhe të angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e energjisë, si dhe bashkëpunimin për një progres të mëtejshëm në përcaktimin e përparësive rajonale dhe koordinimin e investimeve në këtë drejtim.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është një institucion i pavarur, bazuar në Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe në Ligjin nr. 9946, datë 30.06.2008, "Për sektorin e gazit natyror", me përgjegjësitë që lidhen ngushtë me rrjetet dhe tregjet e energjisë, përfshirë edhe rrjetet rajonale dhe ato Trans-Evropiane. Mandati i saj përfshin licencimin e kompanive të energjisë elektrike dhe të gazit, përcaktimin e tarifave me shumicë dhe me pakicë, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve dhe konsumatorëve, nxitjen e konkurrencës, dhe miratimin e rregullave të tregut dhe të kodeve të rrjetit.

Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST sha) është përgjegjës për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit 400-220-110 kV, përfshirë nënstacionet e tensionit të lartë, si dhe për funksionimin e Sistemit të Elektroenergjetik në Shqipëri dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri;

Masat legjislative afatshkurtra

- Projektligji "Për sektorin e energjisë elektrike"
- Projektligji "Për miratimin e marrëveshjes ndërqeveritare (Itali - Shqipëri – Greqi), për projektin e gazsjellësit TAP".
- Projektligji "Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe kompanisë TAP AG për gazsjellësin TAP". (Kushtëzohet nga ecuria e implementimit te projektit TAP).

Aktivitetet zbatuese

Interkonjeksioni elektrik:
- Ndërtimi i linjës 400 kV e interkonjeksionit Tiranë –Prishtinë
- Ndërmarrja e një studimi për mundësinë e ndërtimit të linjës Shqipëri –Maqedoni.

Në sektorin e rrjeteve rajonale të gazit:
- Zhvillimi i projekteve të lidhjeve rajonale të sistemeve të gazit, (projekti i Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë), që parashikohet të lidhë pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.
- Projektit të Gazsjellësit Ionian Adriatik (projekti IAP), projekt i cili do të lidhë vendet e rajonit si Kroacia, Mali i Zi dhe Shqipëria, si dhe Bosnja&Hercegovina, projektit të gazsjellësit lindje-perëndim Trans Adriatic Pipeline (projekti TAP – Greqi – Shqipëri – Itali), që parashikohet të sjellë gazin e rajoneve të Lindjes së Mesme, Kaspikut dhe Rusisë drejt Evropës Perëndimore.

Masat legjislative afatmesme

- Projektvendime në zbatim të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike".
- Projektligji "Për sektorin e energjisë elektrike".
- Hartimi dhe miratimi i kuadrit ligjor për projektin e gazsjellësit IAP.
- Miratimi i akteve ligjore të reja, ose amendimi i mundshëm i akteve ligjore që mund të jenë miratuar lidhur me legjislacionin "Për miratimin e marrëveshjes ndërqeveritare (Itali - Shqipëri – Greqi), për projektin e gazsjellësit TAP", si dhe "Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe kompanisë TAP AG për gazsjellësin TAP". (Kushtëzohet nga ecuria e implementimit të projektit TAP)

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Në sektorin e rrjeteve të gazit natyror:
- Vazhdimi i zhvillimit të projektit të Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë, përsa ka të bëjë me lidhjen ndërmjet Shqipërisë – Maqedonisë dhe Kosovës.

- Zhvillimi i projektit të Gazsjellësit Ionian Adriatik (projekti IAP), përfundimi i studimit të fizibilitetit mbi bazën e financimit nga BE (WIBF), në shumën prej 3 (tre) milionë EURO. Nga ana e Komitetit Ndërshtetëror janë miratuar Termat e Referencës (Dhjetor 2011).(Këto investime nuk trajtohen nëpërmjet Buxhetit të Shtetit.)
- Për projektin e gazsjellësit lindje-perëndim Trans Adriatic Pipeline (projekti TAP – Greqi – Shqipëri – Itali), në rast të shpalljes fitues në tenderin e organizuar nga ana e konsorciumit të vendburimit Shah denik faza II, do të vazhdojë puna në zbatim të "Marrëveshja ndërqeveritare (Itali - Shqipëri – Greqi), për projektin e gazsjellësit TAP", si dhe "Marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe kompanisë TAP AG për gazsjellësin TAP".

Efektet Financiare

Energjia Elektrike

Fondet e nevojshme për realizimin e projekteve të interkonjecionit me vendet fqinje, për projekte publike, sigurohen nëpërmjet kredive, të cilat shoqërohen dhe me kredi të buta dhe me grante. Për financimin e projektit "Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri (Tiranë)-Kosove (Prishtinë)": Me VKM nr. 1253, datë 28.12.2009, është miratuar marrëveshja e kredisë dhe e projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave e Operatori i Sistemit të Transmetimit, si agjenci e zbatimit të projektit dhe bankës gjermane Frankfurt am Main, për shumën 42 milion Euro.

Nafta dhe Gazi

Për realizimin e investimeve për ndërtimin e tubacioneve të transportit të naftës dhe gazit dhe lidhjen e Shqipërisë me rrjetin rajonal të gazsjellësve e naftësjellësve, referuar projekteve të përmendura më sipër, fondet e nevojshme do të sigurohen nga kompanitë investuese që kanë propozuar këto projekte, përfshirë edhe kreditimin nga institucione financiare Evropiane e ndërkombëtare, si dhe banka.

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.21.2.: Rrjetet Trans-Evropiane të energjisë.

Në Lekë

	2012	**2013**	**2014**	**2015**
Kostot totale e vlerësuar	**0**	**0**	**5.000.000**	**1.000.000**
Mbulohen nga buxheti i	0	0	5.000.000	1.000.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.22. POLITIKAT RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURORE

Objektivi strategjik

Objektivi i Qeverisë Shqiptare në këtë fushë është eliminimi i çekuilabrave ekonomikë dhe socialë në zhvillimin e rajoneve dhe si rrjedhojë zhvillimin ekonomik dhe social të vendit sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

Në nenin 110 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, përcaktohet se palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit ndërkufitar, ndërkombëtar dhe ndër rajonal. Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e zhvillimit rajonal. Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Përmirësimit të kuadrit ligjor, duke synuar përafrimin e plotë të legjislacionit me atë të BE;
- Krijimin e strukturave për zbatimin e legjislacionit dhe forcimin e kapaciteteve administrative në nivel qendror dhe lokal;

Qeveria e Shqipërisë është angazhuar në krijimin e kuadrit ligjor, ngritjen institucionale dhe krijimin e një sistemi të përgjithshëm kontrolli dhe menaxhimi të IPA-s, i cili të përmbushë kriteret e përcaktuara nga BE për kalimin nga menaxhimi i centralizuar i asistencës financiare në menaxhimin e decentralizuar. Në këtë drejtim, menaxhimi i decentralizuar do te konsolidoje institucionet Shqiptare në aspekte të rëndësishme sic janë pronësia dhe përgjegjshmëria dhe si rezultat duhet te ndikoje ne rritjen e kredibilitetit te institucioneve tona në implementimin e fondeve të BE-së.

Situata aktuale

Arritjet më të fundit të Qeverisë shqiptare lidhur me *politikat rajonale* janë:

- Konsolidimi i Fondit të Zhvillimit Rajonal si instrumenti kryesor financiar kombëtar për mbështetjen e Zhvillimit Rajonal. Instrumenti i ofron grante konkurruese qeverisjes vendore për zhvillimin e projekteve në: infrastrukturën rrugore lokale, furnizimin me ujë dhe kanalizime, arsim (bazë, parauniversitar dhe universitar), shëndetësi, dhe infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit. Gjithashtu mbështetje ofrohet për investime në objekte te trashëgimisë kulturore, për ndërtimin e tregjeve agro-ushqimore, si dhe pyllëzimin.
- Dërgimi i Paketës së Akreditimit pranë Komisionin Europian per menaxhimin e decentralizuar për Komponentin e I te IPA-s (në muajin shkurt 2012).
- Përparim i konsiderueshëm në rrugën drejt menaxhimit të decentralizuar për komponentët e II-V;
- Miratimi i ndarjes territoriale sipas NUTS;

Lidhur me *instrumentet strukturore*, disa nga arritjet e Qeverisë Shqiptare janë si në vijim:

- Identifikimi/ngritja e strukturave përkatëse per Komponentin e I-re dhe te V te IPA-s. Po punohet ne kuader te finalizimit per ngritjen e strukutrave dhe per komponentët II-IV si dhe trajnimin e tyre;
- Përgatitja e një plani veprimesh për akreditimin e strukturave operacionale për menaxhimin e decentralizuar të komponentëve II-V të IPA-s;

Në tërësi, ka përparime të kufizuara në fushën e zhvillimit rajonal dhe koordinimin e fondeve strukturore dhe nevojiten ende përpjekje të mëdha për ngritjen e kapaciteteve të nevojshme institucionale dhe administrative për të zhvilluar projekte prioritare në fushën e zhvillimit rajonal. Përgatitjet në këtë fushë janë në një fazë të hershme.

Analiza e situatës aktuale

Në muajin Dhjetor 2011, Komiteti i Planifikimit Strategjik, si struktura më e lartë vendimmarrëse për Sistemin e Planifikimit të Integruar, miratoi procesin dhe metodologjinë për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020. Në vijim, ky proces u formalizua me Urdhërin nr.12 të Kryeministrit, datë 2.2.2012"Për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020 ". Sipas këtij Urdhëri, Zhvillimi Rajonal është një nga cështjet e rëndësishme që do të trajtohet me përparësi si në kapitullin e politikave prioritare ashtu edhe në sektorët e tjerë që lidhen me cështjet e zhvillimit rajonal. Nëpërmjet këtij procesi synohet që orientimet strategjike për Zhvillimin Rajonal të përfshijnë gjerësisht prioritetet e përcaktuara në dokumentet strategjike, si Kuadri i Koherencës Strategjike dhe Planet Operacionale për Komponentët 3 dhe 4 të IPA-s. Vlen të përmendet, që për politikën kombëtare të zhvillimit rajonal do të merren parasysh dhe do të përfshihen ato qëllime dhe masa që rrjedhin nga zbatimi i kapitullit përkatës në Marreveshjen e Stabilizim Asocimit.

Duke marrë parasysh rekomandimet e Misionit të KE-së, në Tiranë, në 17-19 Maj, 2011 Qeveria e Shqipërisë ka miratuar strukturën e re të Ministrinë së Integrimit, duke parashikuar ndarjen e funksioneve të programimit dhe monitorimit në Zyrën NIPAC.

Për sa i përket programimit**,** është përgatitur projekt dokumenti i Kuadrit të Koherencës Strategjike dhe Projekt Programet Operacionale për komponentët III dhe IV të IPA-s dhe i janë dërguar Komisionit Europian

Aktualisht stafi që merret me zbatimin e komponentit të I-rë IPA është përfshirë edhe në menaxhimin e Komponentëve III dhe IV të IPA-s. Megjithatë, ende duhen bërë përpjekje të mëtejshme për të forcuar kapacitetet administrative ekzistuese në ministritë e linjës dhe institucionet qëndrore.

- Janë hartuar dhe rishikuar manualet e procedurave për çdo strukturë;

- Janë përgatitur analizat e ngarkesës së punës në ministritë e linjës për të vlerësuar kërkesat për stafin që nevojitet për zbatimin e komponentëve II, III dhe IV të IPA-s;
- Janë analizuar nevojat për trajnim, dhe është përgatitur e zbatuar plani i trajnimeve. Trajnime për stafin e përfshirë në këtë proces janë marrë si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

Gjithashtu, ne baze te rekomandimeve te Misionit te KE-se, Ministria e Financave ka filluar procesin e rekrutimit per pozicionet vakante ne Drejtorine e Pergjithshme te Financimeve dhe Kontraktimeve. Ne kete aspekt, eshte rekrutuar Drejtori i Sigurimit te Cilesise dhe Monitorimit dhe Specialisti i Drejtorise se Menaxhimit Financiar. Kane filluar procedurat per rekrutimin e Pergjegjesit dhe Specialistit te Sektorit te Prokurimit te cilat do te perfundojne gjate tre-mujorit te dyte 2012. Gjithashtu:

- Eshte ngritur dhe testuar Alpha Accounting System dhe jane trajnuar perdoruesit e autorizuar (per menaxhimin e decentralizuar te fondeve te BE).
- Jane azhornuar manualet e strukturave te menaxhimit te decentralizuar te IPA I, duke perfshire paraqitjen skematike te funksioneve,
- Eshte nenshkruar Marreveshja e Mirekuptimit me date 3.10.2011, midis Zyrtarit Kombetar Autorizues (NAO) dhe Drejtorit te Inspektimit Financiar ne lidhje me AFCOS (per parandalimin, raportimin dhe investigimin e parregullsive ne procesin e menaxhimit te decentralizuar).
- Jane nenshkruar Marreveshjet Operacionale ndermjet NIPAC dhe SPO-ve te Ministrive te Linjes ne lidhje me Komponentin e I-re te IPA-s.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Qeveria miratoi ndarjen e Shqipërisë në tre rajone për qëllime statistikore në përputhje me kriteret e Nomenklaturës së BE-së për Njësitë Statistikore Territoriale (NUTS 2).

Në vitin 2010, është miratuar baza ligjore për strukturat e komponentëve III dhe IV të IPA-s, e cila aktualisht eshte ne proces rishikimi. Gjithashtu në fillim të vitit 2011 u miratua vendimi për strukturat e komponentit II të IPA-s, i cili gjithashtu po rishikohet bazuar ne rekomandimet e misionit te fundit te KE.

Gjate vitit 2011 eshte amenduar baza ligjore per Komponentin e I-re duke marre parasysh rekomandimet e Misonit te KE-se. Jane finalizuar dhe miratuar manualet, marreveshjet implementuese dhe operacionale te autoriteteve dhe strukturave per Komponentin e I-re te IPA-s si dhe po pergatiten edhe per Komponentet II, III dhe IV.

- Ligji Nr. 10 487, Datë 5.12.2011, “Për Buxhetin e Vitit 2012”, miratoi paketën financiare për vitin 2012 të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) si mjet për politikat kombëtare të zhvillimit rajonal. Çdo vit, miratimi i fondeve parashikohet nga Ligji i përvitshëm për buxhetin sipas aneksit përkatës.
- Ligji Nr. 9840, datë 10.12.2007, “Për Ratifikimin e Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve

Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)"

- VKM Nr. 23, datë 12.1.2011 "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së bashkimit europian, në kuadër të instrumentit të parazgjerimit (IPA), komponenti I: Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional";
- VKM Nr. 850, datë 14.12.2011, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.23, datë 12.1.2011 të këshillit të ministrave "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së bashkimit europian, në kuadër të instrumentit të parazgjerimit (IPA), Komponenti I, Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional";
- VKM Nr. 17, datë 07.01.2009 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 179, datë 22.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e njësive të integrimit evropian në ministritë e linjës";
- Marrëveshja e Zbatimit mes NAO dhe HOS që përcakton përgjegjësitë e NAO dhe HOS, si dhe marrëdhëniet e tyre dhe metodat e zbatimit për menaxhimin e komponentit të II të IPAs është hartuar dhe dërguar në të gjitha strukturat për shqyrtim;
- Vendimi i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve (VKZHR), nr .2, datë 11.03.2011 "Për përcaktimin e kritereve për ndarjen e fondit për zhvillimin e rajoneve", përcakton procedurat e aplikimit, afatet dhe kriteret e vlerësimit të projekteve në kuadër të financimeve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve ;
- Urdhri Nr. 127, datë 05.12.2011 i ministrit të Integrimit"Për emërimin e Koordinatorit Strategjik.
- Ligji nr. 10 332, datë 14.10.2010, për ratifikimin e "Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane "Për Programin Ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, për vitin 2009, të Komponentit të dytë të Instrumentit të Ndihmës së Paraaderimit (IPA) – Bashkëpunimi Ndërkufitar për Shqipërinë"
- VKM nr. 644 Dt. 14.09.2011 "Për miratimin në parim të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian në kuadër të Programit ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, nën Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit (IPA) Komponenti i II – Bashkëpunimi Ndërkufitar, për vitin 2010"
- Ligji nr. 10 151, datë 28.9.2009, për Ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin ndërkufitar Shqipëri-Mali i Zi, për vitin 2008, të komponentit të dytë të Instrumentit të Paraaderimit, IPA - Bashkëpunimi Ndërkufitar për Shqipërinë"
- VKM nr. 760, dt. 2.11.2011 "Për miratimin në parim të Shtesës së Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për Programin ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi, nën Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit (IPA) Komponenti i Bashkëpunimit Ndërkufitar, për vitin 2008
- Ligji nr. 10333, datë 14.10.2010, për Ratifikimin e "Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane "Për programin ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi, për vitin 2009"

- VKM nr. 759, dt. 2.11.2011 "Për miratimin në parim të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për Programin ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi, nën Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit (IPA) Komponenti i Bashkëpunimit Ndërkufitar, për vitin 2010
- Ligji nr. 10153, datë 28.09.2009, për Ratifikimin e "Marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane "Për programin e financimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet transnacionale ERDF të objektivit të bashkëpunimit territorial europian "Hapsira e Europës Juglindore" të Instrumentit të Ndihmës së Paraaderimit (IPA), komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar për vitin 2008
- Ligji nr. 10 335, datë 14.10.2010, për Ratifikimin e "Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane "Për programin e financimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet transnacionale ERDF të objektivit të bashkëpunimit territorial europian "Europa Juglindore dhe Mesdheu" të Instrumentit të Ndihmës së Paraaderimit (IPA), komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar për vitin 2009"
- VKM nr. 646. Dt. 14.09.2011 "Për miratimin në parim të Shtesës së Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për Programin e financimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në Programin ERDF të Bashkëpunimit Territorial Transnacional "Hapsira e Europës Juglindore", nën nën Instrumentin e Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA) Komponenti i II – Bashkëpunimi Ndërkufitar, për vitin 2008.
- Ligji nr. 10152, datë 28.9.2009, për ratifikimin e "Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin e bashkëpunimit ndërkufitar Adriatik, të Instrumentit të Ndihmës së Para-Aderimit, IPA, Komponenti II - bashkëpunimi ndërkufitar për Shqipërinë"
- Marrëveshja Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian mbi "Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Adriatik", në kuadër të komponentit të dytë të Instrumentit të Para-Anëtarësimit IPA - Bashkëpunimi Ndërkufitar, për vitet 2010-2011, e miratuar në parim më datë 23.03.2011.
- Ligji nr. 10 334, datë 14.10.2010, për ratifikimin e "Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane "Për Programin Ndërkufitar Shqipëri – ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, për vitin 2009, të komponentit të II të Instrumentit të Ndihmës së Paraaderimit (IPA) – Bashkëpunimi Ndërkufitar për Shqipërinë"
- VKM nr. 645, datë 14.09.2011, "Për miratimin në parim të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian në kuadër të Programit ndërkufitar ndërmjet Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë, nën Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit (IPA) Komponenti i II – Bashkëpunimi Ndërkufitar, për vitin 2010
- VKM nr. 761, datë 02.11.2011, "Për miratimin në parim të shtesës së Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian në kuadër të Programit ndërkufitar ndërmjet Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë, nën Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit (IPA) Komponenti i II – Bashkëpunimi Ndërkufitar, për vitin 2008

- VKM Nr. 517 datë 06.07.2011 "Për miratimin në parim të Marrëveshjes se Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për Programin ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, nën Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit (IPA) Komponenti i Bashkëpunimit Ndërkufitar, për vitin 2010, (e firmosur në dt. 9.09.2011)

Urdhra të brendshëm:

- Urdhër Nr. 154, datë 13.7. 2006, "Për caktimin e përfaqësuesit kombëtar në programin "Instrumenti i Ndihmës së Para-Aderimit" të Bashkimit Europian";
- Urdheri nr. 60, date 01.09.2011 i Ministrit te Financave "Per krijimin dhe funksionimin e Komitetit te Nivelit te larte per Menaxhimin e Riskut dhe krijimin e Panelit te Menaxhimit te Riskut per evidentimin, vleresimin dhe menaxhimin e riskut te Menaxhimit te Decentralizuar te fondeve te asistences se Bashkimit Evropian ne kuader te komponentit te I-re te IPA
- Urdheri nr. 84, date 30.12.2010 i Ministrit te Financave "Per ngritjen e Grupit te Punes per krijimin e Sistemit te Menaxhimit te Informacionit (MIS) ne kuader te Menaxhimit te Decentralizuar te fondeve te asistences se Bashkimit Evropian, Komponenti i I-re te IPA".
- Urdherat e Ministrive te Linjes "Per rregullimin e marredhenieve midis Zyrtarit te Larte te Programit (ZLP) dhe institucioneve te varesise ne kuader te Menaxhimit te Decentralizuar te fondeve te asistences se Bashkimit Evropian, IPA komponenti I".
- Urdheri nr. 15, date 14.02.2012 i Kryeministrit "Per miratimin e struktures dhe organizimit te Ministrise se Integrimit.
- Urdheri nr.59, date 24.04.2010 "Per caktimin e strukturave dhe personave pergjegjes ne Ministrine e Integrimit per sistemin e menaxhimit te decentralizuar te fondeve IPA, Komponenti I, Mbeshtetje Tranzitore per Ngritjen e Institucioneve"
- Urdheri nr.14, date 7.02.2012 "Per nje ndryshim ne Urdherin nr.59, date 24.04.2010 'Per caktimin e strukturave dhe personave pergjegjes ne Ministrine e Integrimit per sistemin e menaxhimit te decentralizuar te fondeve IPA, Komponenti I, Mbeshtetje Tranzitore per Ngritjen e Institucioneve'"
- Urdheri nr. 65, date 13.09.2011 "Per caktimin e autoritetit pergjegjes per fillimin e inspektimit financiar publik per fondet e Bashkimit Evropian".

Struktura institucionale

Instrumenti kryesor i konkretizimit të politikës kombëtare për zhvillimin rajonal është Fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Në aspektin institucional, janë dy struktura të rëndësishme për politikat e zhvillimit rajonal kombëtar:

Komiteti i Zhvillimeve të Rajoneve si organi më i lartë vendimmarrës për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve. Ky organ është i kryesuar nga Kryeministri, me anëtarët e mëposhtëm: Ministri i Financave, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Ministri i Brendshëm, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministri për Innovacionin dhe

Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Kryetari i Bordit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Kryetari i Konferencës së Rektorëve, Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë, Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë dhe Kryetarit i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë.

Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, pranë Këshillit të Ministrave është Sekretariati i Përgjithshëm për FZHR, luan një rol koordinues qëndror në administrimin e të gjitha materialeve që do të paraqiten për marrjen e vendimeve në mbledhjen e Komitetit. DEBASKON, në bazë të analizës mbi harmonizimin e projekteve me prioritetet strategjike kombëtare dhe me prioritetet e programit të qeverisë, propozon çështjet për marrjen e vendimeve në KZHR lidhur me përzgjedhjen e projekteve për t'u financuar.

Ministria e Integrimit Evropian e cila për zhvillimin rajonal luan një rol parësor edhe ka funksionin e Koordinatorit Strategjik për IPA 3 dhe 4, si edhe aktualisht është kryesuese e kapitullit të 22 të PKZMSA

Lidhur me programimin dhe zbatimin e asistencës së BE-së, institucionet kryesore përgjegjëse janë: Ministria e Integrimit, Ministria e Financave, ministritë e linjës dhe institucionet qendrore. DEBASKON funksionon si institucioni qendror për koordinimin e asistencës së huaj në Shqipëri.

Ministria e Integrimit është Koordinatori Kombëtar i fondeve të BE dhe është përgjegjës të koordinojë institucionet Shqiptare në procesin e programimit të Programit vjetor të IPAs, më specifikisht: i) të përgatisë udhëzimet mbi procesin e programimit për ministritë e linjës dhe institucionet qendrore, përfituesit potencialë të fondeve të IPA-s; ii) të zhvillojë trajnime të përshtatshme; iii) të organizojë konsultime me ministritë e linjës, institucionet qendrore, dhe aktorët e tjerë të interesuar; iv) të mbështesë ministritë e linjës dhe institucionet qendrore me qëllim që ato të përgatisin projekt-fishat e Programit IPA në përputhje me prioritetet e përcaktuara në dokumentet strategjikë. Projekt-fishat e IPAs janë rezultat i një pune të përbashkët mes MIE, institucioneve qendrore dhe Delegacionit të BE në Shqipëri.

Për sa i përket komponentit të II, Ministria e Integrimit në rolin e saj si Koordinatore Kombëtare e Programeve Ndërkufitare, është përgjegjëse për programimin dhe zbatimin e duhur të programeve IPA/CBC në Shqipëri. Ministria i raporton në bazë vjetore Komisionit Evropian mbi implementimin e çdo programi ndërkufitar.

(ii) Ministritë e Linjës dhe institucionet e varësisë: Drejtoritë e Integrimit Evropian

Këto struktura bashkërendojnë dhe mbështesin punën e institucioneve respektive për fushat e përqendruara në elementet kryesore të acquis communautaire, në zbatimin e MSA dhe çështje të programimit dhe zbatimit të asistencës së BE.

Ministria e Financave. CFCU eshte pjese e struktures organizative te Ministrise se Financave dhe eshte pergjegjese per sigurimin e nje menaxhim efektiv administrativ,

financiar dhe teknik te projekteve te financuara nga Komisioni Europian nen IPA. Me konkretisht, pas marrjes se akreditimit per Komponentin e I-re te IPA-s, CFCU do te jete funksionalisht pergjegjese per tenderimin, kontraktimin, monitorimin dhe implementimin e projekteve. Gjithashtu, CFCU do te jete agjencia implementuese edhe per komponentet II, III dhe IV te IPA-s.

Ministria e Transporteve. Sipas legjislacionit ne fuqi eshte drejtuese e struktures operuese per komponentin III te IPA-s, Zhvillimi Rajonal. Pjese e struktures operuese jane edhe ministrite e Mjedisit dhe METE (per konkurueshmerine)

Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale.Sipas legjislacionit ne fuqi eshte drejtuese e struktures operuese per komponentin IV te IPA-s, Zhvillimi i Burimeve Njerezore (ne rang kombëtar dhe lokal). Pjese e struktures operuese eshte edhe ministria e Arsimit dhe Shkences.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përcaktimi më i qartë i strukturave/kompetencave të institucioneve të përfshira në procesin e decentralizimit, përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020 është parashikuar të hartohet brenda një harku kohor një vjeçar janar 2012- Janar 2013, kur edhe do të konsultohet me grupet e interesit, shoqërinë civile, donatorët, partnerët socialë. Finalizimi dhe miratimi i SKZHI 2013-2020 është parashikuar të kryhet në Mars 2013.
- Marrëveshja Financiare IPA 2012, me të cilën miratohen projektet e përzgjedhura për tu financuar nga fondet e BE-së;
- Amendimi i Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 48, date 19.01.2011 “Per percaktimin e autoriteteve dhe te -pergjegjesive per menaxhimin e decentralizuar te asistences se Bashkimit Evropian ne kuadrin e IPA, komponenti II: Bashkepunimi Nderkufitar”;
- Amendimi i Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 505 date 30.06.2010 “Per percaktimin e autoriteteve dhe te pergjegjesive per menaxhimin e decentralizuar te asistences se Bashkimit Evropian ne kuader te Instrumentit të Paraaderimit (IPA), komponenti III: Zhvillimi Rajonal dhe komponenti IV: Zhvillimi i burimeve njerëzore”

Aktivitetet zbatuese

- Në kuadër të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, DEBASKON po punon për ngritjen e një sistemi IT, me qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e procedurave të shpërndarjes së fondeve, administrimit të të dhënave, sikurse zhvillimin efikas të raportimit dhe monitorimit lidhur me ecurinë e projekteve në kuadër të FZHR. Gjithashtu, sistemi synon të rrisë transparencën e procesit duke pasqyruar vendodhjen e projekteve në

hartë, si dhe të dhëna të tjera teknike. Ky sistem do të dixhitalizojë procedurat për aplikimet, vlerësimin dhe përzgjedhjen e projekteve të FZHR. Me miratimin e ngritjes së këtij sistemi nga ana e Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve në mars 2012, po vijon puna për zhvillimin e platformës së softit, si edhe manualet e përdorimit. Gjithashtu, është parashikuar të zhvillohet një proces lancimi dhe informimi me Ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore

- Do te organizohen trajnime per stafin e perfshire në menaxhimin e Komponenteve II, III dhe IV;
- Do të organizohen trjanime të mëtejshme për strukturat e Komponentit të I dhe V me mbështetjen e projektit të asistencës teknike dhe PPF;
- Plotësimi me staf (me 2 persona) për zyrën e monitorimit;
- Rekrutimi i stafit (2 persona) per vendet vakante ne CFCU.
- Kordinimi dhe bashkepunimi ne finalizimin dhe dorezimin e paketes per akreditimin per komponentet II, III dhe IV te IPA-s.
- Rritja e kapaciteteve te stafit te strukturave te perfshira ne menaxhimin e decentralizuar te fondeve IPA Komponenti I, me mbeshtetjen e asistences teknike.

Masat legjislative afatmesme

Sipas udhërrëfyesit të rishikuar, synimi i Qeverisë Shqiptare është që të paraqesë paketen e akreditimit për komponentët e II-IV gjate vitit 2013.
Gjithashtu, eficenca dhe pronesia ne drejtim te menaxhimit te decentralizuar te fondeve te Komponentit te I-re te IPA perben nje objektiv kryesor, i cili ben te mundur ne te ardhmen menaxhimin në mënyrë efiçiente te Fondeve Strukturore dhe te Kohezionit.

- Marrëveshjet Financiare për programin kombëtar IPA 2013, si dhe IPA me shumë përfitues

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Rritja e kapaciteteve te stafit te strukturave te perfshira ne menaxhimin e decentralizuar te asistences se Bashkimit Evropian, per komponentet, II, III dhe IV te IPA.
- Azhornime te mundshme te manualeve dhe marrveshjeve ndermjet autoriteteve dhe strukturave te menaxhimit te decentralizuar.
- Marrja e pronesise se menaxhimit te decentralizuar te komponentit te I-re te IPA-s.

3.23. BASHKEPUNIMI NE FUSHEN E GJYQESORIT DHE TE DREJTAVE THEMELORE

3.23.1. SISTEMI GJYQËSOR

Objektivi strategjik

Çdo veprim që do të ndërmarrë Qeveria shqiptare në kuadrin e reformës në sistemin e drejtësisë dhe forcimit të shtetit të së drejtës, ka si qëllim dhe objektiv final krijimin e një sistemi drejtësie bashkëkohor, të aftë të sigurojë garantimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë, ndershmërisë dhe efektivitetit të drejtësisë shqiptare, të respektojë parimet e proçedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, duke mbrojtur të drejtat, interesat dhe liritë e ligjshme të njeriut, të kontriboje në administrimin e drejtesisë penale, të zgjidhë mosmarrëveshjet në mënyrë efektive dhe të drejtë si dhe të implementojë acquis communautaire dhe të pasqyrojë standardet e Bashkimit Evropian në fushën e drejtësisë.

Qeveria Shqiptare është e angazhuar plotësisht në zbatimin në gjerësi dhe thellësi të reformave në sistemin e drejtësisë, të sugjeruara dhe të mbështetura nga partneret ndërkombëtare, ne bashkëpunim me institucionet e tjera kushtetuese që përfshihen në çështjet e reformave dhe performancës së sistemit të drejtësisë si dhe në përputhje me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (Neni 1, 2 , 13, 70 dhe 78 i MSA-së) .

Në kuadër të krijimit të një sistemi drejtësie bashkëkohor, Qeveria shqiptare synon rritjen e cilësisë në dhënien e drejtësisë si shërbim ndaj qytetarëve dhe forcimin e shtetit ligjor nëpërmjet formimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve me integritet, aftësi dhe cilësi të larta profesionale dhe etike. Ky objektiv përcakton si prioritet rritjen e aksesit në drejtësi, rritjen e profesionalizmit të aktorëve kryesorë të sistemit të drejtësisë përmes një programi trajnimi të niveleve bashkëkohore dhe standarteve evropiane dhe përmirësimit të sistemit të drejtësisë shqiptare duke siguruar një trajnim profesional pas universitar për gjyqtarë dhe prokurorë.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Qeveria shqiptare është e angazhuar në përmbushjen me vizion të qartë dhe ritëm të lartë të të gjitha funksioneve të saj, ku rolin më të rëndësishëm e zë Reforma në Drejtësi. Reforma në Drejtësi është konceptuar në marrjen e masave me karakter ligjor, institucional dhe administrativ, të cilat synojnë forcimin dhe konsolidimin e shtetit ligjor, rikthimin e besimit të qytetarëve te drejtësia, luftën pa kompromis kundër korrupsionit si dhe rritjen e transparencës së punës së organeve të drejtësisë.

Në kuadër të konsolidimit të sistemit gjyqësor, institucionet përgjegjëse kanë për qëllim të kërkojnë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të

ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integrimit evropian të Republikës së Shqipërisë.

Kështu, Ministria e Drejtësisë, në përputhje me ligjin, mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me organet e pushtetit gjyqësor dhe me prokurorinë, duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë.

Ministria e Drejtësisë do të vazhdojë përpjekjet dhe reformat e saj në konkretizimin me objektiva strategjikë të listuara si më poshtë:

- Konsolidimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të organeve të sistemit të drejtësisë në drejtimin strukturor, funksional dhe financiar;
- Konsolidimi i dialogut ndërisntitucional dhe bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë, gjyqësorit, prokurorisë, Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit dhe gjithë aktorëve të tjerë me kontribut në fushën e drejtësisë, me qëllim ndërtimin dhe konsolidimin e besimit dhe konsensusit të nevojshëm mes forcave politike parlamentare për reformën në drejtësi dhe përmirësimin e performancës së sistemit gjyqësor;
- Konsolidimi i përgjegjshmërisë së sistemit të drejtësisë për të qenë i pandikuar, i paanshëm dhe konsistent në sigurimin e mbrojtjes ligjore të barabartë për të gjitha palët;
- Konsolidimi i efektivitetit të pushtetit gjyqësor për të qenë efektiv, efiçent dhe i hapur;
- Fuqizimi i bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë, në përputhje edhe me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit;
- Konsolidimi i aksesit në organet e drejtësisë për të qenë i hapur për çdo person dhe për të qenë aktivisht i angazhuar në inkurajimin e formave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjve;
- Konsolidimi i besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë;
- Konsolidimi i qeverisjes së mirë, përmes luftës kundër korrupsionit dhe fenomenev të tjera negative që pengojnë zhvillimin e integrimit të vendit dhe garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës;
- Konsolidimi i shtetit demokratik bazuar në liritë dhe të drejtat themelore të individëve, duke realizuar integrimin e vendit në BE;
- Përmirësimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore;
- Përcaktimi i kompetencave të Inspektorateve të kontrollit të gjykatave;
- Konsolidimi i performancës së shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror dhe privat;
- Përmirësimi i sistemeve të burgimit dhe paraburgimit në kaudër të garantimit të të drejtave themelore të individit;
- Përmirësimi i infrastruktures se sistemit të drejtesise;
- Përmirësimi i proçesit të hartimit të legjislacionit, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve dhe konsolidimin profesional të tyre, rritjen e vëmendjes ndaj acquis communautaire me qëllim përshpejtimin e proçesit të përafrimit të legjislacionit.

Po në kuadër të përmirësimit të sistemit gjyqësor, Shkolla e Magjistraturës ka si objektiv strategjik rritjen e cilësisë në dhënien e drejtësisë si shërbim ndaj qytetarëve si dhe forcimin e shtetit ligjor nëpërmjet formimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve me integritet, aftësi dhe cilësi të larta profesionale dhe etike.

Sfida përballë së cilës gjendet Shkolla është arritja e standarteve evropiane në drejtim të dhënies së drejtësise nëpërmjet trajnimit me efikasitet të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këtë kontekst, ky objektiv përcakton si prioritet rritjen e aksesit në drejtësi, rritjen e profesionalizmit të aktorëve kryesorë të sistemit të drejtësisë përmes një programi trajnimi të niveleve bashkëkohore dhe standarteve evropiane dhe përmirësimit të sistemit të drejtësisë shqiptare duke siguruar një trajnim profesional pas universitar për gjyqtarë dhe prokurorë. Ky objektiv ka si qëllim rritjen e cilësisë në dhënien e drejtësisë, si shërbim ndaj qytetarëve dhe forcimin e shtetit ligjor, nëpërmjet formimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve me integritet, aftësi dhe cilësi të larta profesionale dhe etike.

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Formimit Fillestar Profesional i kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë brenda një programi 3 vjeçar. Ligji njeh detyrimin e emërimit si gjyqtarë dhe prokurorë të gjithë kandidatëve që përfundojnë me sukses Shkollën. Emërimi bëhet nga Këshilli I Lartë I Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme sipas detyrimit ligjor duke respektuar parimin e meritokracisë (klasifikimin e tyre në bazë të rezultateve të arritura në shkollë).
- Formimit të Vazhduar Profesional për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, përfundimi me sukses i të cilit lidhet ngushtë me kualifikimin dhe karrierën e tyre. Procesi i trajnimit organizohet në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme dhe lehtësohet nga pikat e kontaktit në gjykata dhe prokurori.
- Trajnimit të profesioneve te tjera ligjore në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë (Zyrën e Përmbarimit, Avokatin e Shtetit), Dhomën Kombëtare të Avokatisë apo Shoqata dhe Organizata ndërkombëtare, të cilat realizohen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.
- Publikimet e ndryshme shkencore dhe puna kërkimore. Shkolla boton revistën e saj "Jeta Juridike" çdo tremujor, e cila është një botim shkencor që trajton tematikë të ndryshme në lidhje me çështje të rëndësishme si: njohja me legjislacionin e ri, njohje me praktikën gjyqësore, njohje me përvojën ndërkombëtare teorike dhe praktike, shkrime nga juristë të rinj, promovime të librave të rinj juridikë, informacion për aktivitetet e zhvilluara nga shkolla, etj. Po ashtu, Shkolla publikon me sukses edhe botime te tjera profesionale në fushën e drejtësisë si libra profesional në kuadër të realizimit të programit mësimor si dhe revistën periodike çdo 6 muaj "Magjistrati" me ekstrakte nga temat e kandidatëve për magjistratë.

Në kuadrin e zbatimit të planit kombëtar të zbatimit të MSA, Shkolla e Magjistraturës ka marre angazhimet e mëposhtme:

37. Rritja e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe orientimi i sistemit gjyqësor drejt praktikave më të mira evropiane për ofrimin e shërbimeve cilësore për

qytetarët nëpërmjet një trajnimi të vazhduar dhe të përshtatshëm mbi tematika si civile, penale, tregtare, administrative, kushtetuese, familjare, etikes profesionale, çështje tregtare, të drejtës evropiane dhe çështje qe lidhen me zbatimin e MSA-se, të drejtat e njeriut, acquis communautaire, prokurimin publik, pronësinë intelektuale, krimin ekonomik dhe korrupsioni, shkrimi dhe arsyetimi ligjor, mbrojtja e të dhënave personale, drejtësia për të miturit, administrimi i gjykatave dhe të çështjeve, praktika e GJEDNJ dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, trajnime për unifikimin e kërkesave të ndihmës juridike, penale dhe civile për gjyqtarët, prokurorët, stafin e Ministrisë së Drejtësisë dhe të tjerë të interesuar, si dhe zhvillime të reja të legjislacionit etj.

38. Përmirësimi i procesit të seleksionimit të kandidatëve për magjistratë, formimit dhe vlerësimit të tyre nëpërmjet:
    - përmirësimit të kritereve dhe procedurave si dhe akteve nënligjore në lidhje me këtë proces,
    - hartimit të skemës së seleksionimit dhe vlerësimit të dijeve të kandidatëve, në bashkëpunim me Ambasadën Britanike dhe Fondacionin Slynn.

- Përmirësimi i metodologjisë se mësimdhënies në trajnimin fillestar nëpërmjet rishikimit në vijimësi të kurrikulave të shkollës për t'iu përshtatur zhvillimeve dhe nevojave të reja të sistemit, studimit dhe parashikimit të ekspertizës në përputhje me eksperiencat kombëtare dhe praktikën e Shkollës së Magjistraturës për integrimin lidhur me etikën, problemet sociale, diskriminimin gjinor, duke i përfshirë kritere të tilla në zgjedhjen, trajnimin dhe vlerësimin e procesit.
- Trajnimi i trajnerëve është tashmë një element i përhershëm i veprimtarisë akademike të Shkollës dhe ka në fokus pedagogët me kohë të plote dhe ata me kohë të pjesshme. Ai i dedikohet analizës dhe vlerësimit të metodologjisë pedagogjike dhe protokolleve që adoptohen nga trajnerët shqiptarë në lidhje me organizimin dhe koordinimin e seminareve, si dhe në lidhje me metodologjinë e përdorur gjatë zhvillimit të tyre. Njëkohësisht marrja e përvojës së vendeve të BE-së nëpërmjet seminareve të përbashkëta për trajnimin e trajnerëve është pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së Shkollës në këtë drejtim. Nëpërmjet tyre synohet të realizohet asimilimi i metodologjisë më të avancuar të trajnimit, të aplikuar nga Shkollat e vendeve të Bashkimit Evropian.
- Ngritja e nivelit të njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm me gjuhët e përdorura ne institucionet ligjore Evropiane, për të cilin lënda e gjuhës angleze ligjore është futur si lëndë mësimore në Programin e Formimit Fillestar për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë. Ky komponent po realizohet në sajë të ekspertizës së ofruar nga USAID dhe Ambasada Amerikane.

Gjithashtu, në kuadër të konsolidimit të sistemit të drejtësisë, objektivi madhor i Prokurorisë është të ushtrojë ndjekjen penale, të perfaqesoje në emer të shtetit akuzën në gjyq, duke respektuar parimet e proçedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, duke mbrojtur të drejtat, interesat dhe liritë e ligjshme të njeriut, e të kontriboje në administrimin e drejtesisë penale.

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Përmirësimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të prokurorisë në ndjekjen penale, në hetim dhe gjykim;

- Përzgjedhjes për emërimin dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve me anë të vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale të tyre;
- Përmirësimit dhe funksionimit të Inspektoratit të Prokurorisë së Përgjithshme për të vlerësuar dhe verifikuar në vazhdimësi qëndrueshmërinë në detyrë të prokurorëve;
- Rritjes se vazhdueshme e transparencës në procesin penal;
- Ruajtjes së pavarësisë dhe paanshmërisë së prokurorisë si elemente thelbësore për besimin e publikut në administrimin e drejtësisë;
- Implementimit të programeve të menaxhimit të informacionit për të rritur eficensën e ndjekjes penale;
- Përmirësimit të menaxhimit të çështjeve në prokurori me synim kontrollin në vazhdimësi të ndjekjes penale, rritjen e efektivitetit dhe parandalimin e fenomeneve korruptive;
- Përmirësimit të kapaciteteve të administratës së prokurorisë si njohje e rolit të tyre të rëndësishëm në mbështetje të punës së prokurorit;
- Bashkërendimit dhe standardizimit të bashkëpunimit të prokurorisë me policinë gjyqësore dhe organet e tjera të zbatimit të ligjit si domosdoshmëri për suksesin e ndjekjes penale;
- Garantimit dhe funksionimit efikas të Njësive të Përbashkëta Hetimore kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Prokurorisë për Krime të Rënda;
- Mbrojtjes së dëshmitarëve, personave të dëmtuar dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë si masa të domosdoshme në luftën kundër krimit të organizuar.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 "Për miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;
- Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" , i ndryshuar
- Ligji nr. 7895 datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar
- Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;
- Ligji nr. 8116, datë 29/03/1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë" , i ndryshuar;
- Lig j nr. 8136, datë 31.7.1996 "Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës të Shqipërisë";
- Ligji nr. .8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", të ndryshuar;
- Ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", të ndryshuar
- Ligji nr. 8677, datë 02.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", i ndryshuar;

- Ligji nr. 8678, date 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8888, datë 25.4.2002 “Për ratifikimin e "Konventës për krimin në fushën e kibernetikës";
- Ligji nr. 9068, date 15.5.2003 “Për ratifikimin e "Konventës Evropiane për vlefshmërinë ndërkombëtare te gjykimeve penale";
- Ligji nr. 9081, date 19.6.2003 “Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverise se Republikës te Shqipërisë dhe Qeverise se Shteteve te Bashkuara te Amerikës për dorëzimin e personave ne gjykatën ndërkombëtare penale";
- Ligj nr. 9090, datë 26.6.2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, in ndryshuar;
- Ligji nr. 9091, datë 26.6.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8502, datë 30.6.1999 "Për krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare";
- Ligji nr. 9109, datë 17.7.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 9110, date 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime te renda”;
- Ligj nr. 9245, date 24.6.2004 “Për ratifikimin e "Protokollit shtese te Konventës Penale për korrupsionin";
- Ligji nr. 9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 9284, date 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar”;
- Ligji nr 9397, date 12.05.2005 “Për shërbimin e Kontrollit te Brendshëm ne Sistemin e Burgjeve’;
- Ligji nr. 9443, date 16/11/2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Hagës “Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”;
- Ligji nr. 9446, datë 24.11.2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën, “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”;
- Ligji nr. 9492 datë 29.05.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit”;
- Ligji nr. 9614 datë 21.09.2006 “Për çertifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”;
- Ligji nr. 9639 datë 09.11.2006 “Për ratifikimin e protokollit nr. 13 të Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat”;
- Ligji nr. 9646 datë 27.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”;
- Ligji nr. 9678, date 13.01.2007, “Për amnistinë”;
- Ligji nr. 9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”;
- Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;

- Ligji 10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”;
- Ligji nr. 10 032, datë 11.12.2008 “Për policinë e burgjeve”;
- Ligji nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”;
- Ligji nr. 10071, datë 09.02.2009, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”;
- Ligji nr. 10092, datë 09.3.2009 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave”;
- Ligjin Nr.8417, datë 21.10.1998 për përbërjen dhe drejtimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Ligjin Nr.8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”;
- Ligji nr. 8136 date 31.07.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”;
- Ligj nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ligj nr. 53/2012, datë 10.05.2012 “Për marrëdhëniet juridiksionale në çështjet penale me task forcën hetimore speciale të EULEX-it”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 24, datë 19.01.2007 “Për procedurën e lëshimit të dokumenteve nga disa zyra të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe ndryshimin e tarifave për to”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1025, datë 09.07.2008 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1292, datë 24.09.2008 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, të truallit dhe të godinës së gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apeleve”, , i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave përcaktimi i procedurave për krijimin e fondit të kompensimit fizik;
- Vendimi nr. 20, datë 14.1.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të administratës gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit”;
- Vendimi nr. 101, datë 27.01.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe nivelit të pagave të Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Vendim nr. 200, datë 19.2.2009, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave “Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar”;
- Vendimi nr. 302, datë 25.03.2009 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, mbikëqyrjen e ekzekutimit te dënimeve alternative;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 303, datë 25.03.2009, “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e ngjyrës, uniformës dhe shenjave në mjetet e Policisë se Burgjeve”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për llojet e armëve dhe mënyrën e përdorimit të tyre;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e flamurit dhe të stemës së Policisë së Burgjeve”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e veçantë personale, familjare dhe të pronës së gjyqtarëve, sigurimin e jetës dhe pronës së tyre”;
- Vendimit nr 271, datë 06.04.2011 “Për veprimtarinë akademike, në zbatimin e programit të Formimit Fillestar dhe Vazhdues në Shkollën e Magjistraturës”;
- Udhëzim i Përbashkët nr.03,date 15.12.2011 "Për procedimin disiplinor të punonjësve të policisë gjyqësore";
- Udhëzim i Përbashkët nr.2, datë 07.11.2011 “Për kryerjen dhe përfundimin e hetimeve të kallëzuara drejtpërdrejt në prokurori apo të filluara kryesisht”;
- Urdher i Prokurorit te Pergjithshem nr.165, date 19.09.2011 "Per percaktimin e kritereve per dhenien e shteses se pages per veshtiresi pune per oficeret e policise gjyqesore";
- Udhëzim i Prokurorit te Pergjithshem nr. 01, datë 19.09.2011 “Për përcaktimin e kritereve për shpërblimin për merita profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore”;
- Urdhri i përbashkët nr. 582, datë 24.01.2007, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme, për realizimin e plotë de facto të sistemit të paraburgimit në administrimin e Ministrisë së Drejtësisë;
- Urdhri nr. 3155, datë 28.04.2008 “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, i ndryshuar;
- Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 4793, datë 02.07.2008 “Për miratimin e Rregullores së Agjencisë së Kompensimit dhe Kthimit të Pronave”;
- Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 5745, datë 13.08.2008 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimin dhe Funksionimin të Ministrisë së Drejtësisë;
- Urdhri nr. 275/1, datë 14.01.2009 i Ministrit të Drejtësisë “Rregullorja e Brendshme e Avokaturës së Shtetit”;
- Urdhri nr. 747, datë 28.01.2009 i Ministrit të Drejtësisë “Për procedurat që duhen ndjekur nga administrata gjyqësore për lëshimin e vërtetimeve dhe akteve të tjera, në zbatim të Vendimit nr. 1, datë 07.01.2009, të Këshillit të Ministrave “Për pajisjen për herë të parë, me letërnjoftim të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese për ata që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”;
- Urdhri nr. 1186, datë 11.02.2009 i Ministrit të Drejtësisë, ‘’Për miratimin e Rregullores së organizimit dhe strukturës së Zyrës së Gjendjes Gjyqësore’’;
- Urdhri nr. 2583, datë 01.04.2009 i Ministrit të Drejtësisë ”Për miratimin e rregullores “Për arkivat e sistemit gjyqësor dhe Manualin e Programit të Menaxhimit të Dosjeve Gjyqësore”;
- Urdhri nr. 3146, datë 16.4.2009 i Ministrit të Drejtësisë “Për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit te Apelimit te Masave Disiplinore”;

- Urdhri nr. 2438/3, datë 28.05.2009 i Ministrit të Drejtësisë "Për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit për Dhënien e Gradave për Rolin e Lartë";
- Urdhrin nr. 3851 datë 08.05.2009 të Ministrit të Drejtësisë "Kodi i Etikës së Përmbaruesve Gjyqësorë shtetërorë dhe privatë " si dhe Rregullorja "Për përbërjen e komisionit vlerësues, rregullave të funksionimit të tij, procesi i përzgjedhjes, kritereve dhe procedurave të organizimit dhe të shpalljes së rezultateve të provimit për përmbarues gjyqësor privatë;
- Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë (nr. 8311 prot,., datë 4.12.2011) dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë (nr. 1911 prot., datë 5.12.2011) "Për harmonizimin e procedurave të inspektimit gjyqësor dhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave", të nënshkruar më datë 5 dhjetor 2011;
- Urdhri i përbashkët nr. 1779/15, datë 26.12.2011, midis Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit "Për caktimin e kritereve të standardizuara në ndërtimin dhe rikonstruksionin me cilësi të burgjeve dhe paraburgimit";
- Memorandumi i Bashkëpunimit, nr. 2381, datë 20.03.2012, midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë "Për Ngritjen e Institutit Mjekësor për Trajtimin e Personave me Probleme të Shëndetit Mendor që kanë Kryer Vepra Penale";
- Memorandumi i Bashkëpunimit, 05.12.2008, midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për arsimimin e të ndaluarve dhe burgosurve;
- Marreveshja e Perbashket, Nr.2803/7, date 15.12.2011 "Per trajnimin e vazhdueshem te oficereve dhe agjenteve te Policise Gjyqesore";
- Urdhri nr. 4763, datë 08.06.2009 të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Komitetit Shqiptar të Birësimeve".

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në garantimin dhe përmirësimin të sistemit gjyqësor janë:

Presidenti i Republikës

Presidenti i Republikës është kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe autoriteti që emëron gjyqtarët, me cilësinë si President i Republikës dhe jo si kryetar i KLD- së. Gjithashtu, ai emëron dhe shkarkon prokurorët e të gjithë niveleve, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm.
Presidenti i Republikës ushtron edhe disa kompetenca rregullatore në fushën e organizimit të sistemit gjyqësor: përcakton numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve, numrin e gjykatave, qendrën e tyre të veprimtarisë dhe kompetencën territoriale, etj.
Gjyqtaret e shkalles se pare dhe apelit emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të KLD-së brenda kritereve të përcaktuara në ligj, ndërsa numri total i gjyqtareve dhe juridiksioni territorial i gjykatave caktohen nga Presidenti i Republikës me propozim te Ministrit te Drejtësisë, pasi të jetë marrë mendimi i KLD-së.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Këshilli i Lartë i Drejtësisë është organ kushtetues i rregulluar posaçërisht në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr.8417, datë 21.10.1998. Kjo normë kushtetuese ka përcaktuar përbërjen dhe drejtimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kompetencën e tij për transferimin e gjyqtarëve si edhe rastet e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit po nga ky Këshill.

Në zbatim të dispozitës kushtetuese referuar më lart, Kuvendi, ka miratuar Ligjin Nr.8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë" duke e përcaktuar Këshillin si autoritetin e vetëm shtetëror përgjegjës për të realizuar mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën dhe për kontrollin e veprimtarisë së gjykatave të shkallëve të para dhe të apeleve.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, përbëhet nga pesëmbëdhjetë anëtarë e kryesohet nga Presidenti i Republikës. Anëtarë të tij për shkak të funksionit që ushtrojnë, janë Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Ministri i Drejtësisë. Në përbërje të Këshillit janë gjithashtu nëntë gjyqtarë të të gjitha niveleve, të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare dhe tre anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi. Anëtarët e zgjedhur të tij, qëndrojnë në detyrë për 5 vjet pa të drejtë rizgjedhje të menjëhershme. Struktura e Këshillit, tre të pestat e të cilit janë të zgjedhur nga vetë gjyqtarët (në përputhje dhe me Kartën Europiane mbi Statutin për Gjyqtarët), garanton një mbikëqyrje të pavarur të sistemit gjyqësor. Veprimtaria e përditshme e tij, organizohet nga Zëvendëskryetari (i zgjedhur nga vetë anëtarët e Këshillit me propozim të Presidentit të Republikës) si dhe administrata që i është vënë në dispozicion nga ligji. Njëkohësisht, në varësi të drejtëpërdrejtë të Zëvendëskryetarit është dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë i përbërë nga Kryeinspektori dhe inspektorët.

Në mënyrë të përmbledhur, detyrat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të parashikuara në këtë ligj, janë:

- Propozimi drejtuar Presidentit të Republikës për emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të apelit;
- Vendos për transferimin e gjyqtarëve vetëm me pëlqimin e tyre duke përjashtuar rastet e riorganizimit të pushtetit gjyqësor;
- Emëron dhe shkarkon kryetarët e gjykatave të shkallëve të para dhe të apelit;
- Vendos kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve dhe kontrollon gjithë procesin e vlerësimit;
- Shkarkon gjyqtarët e gjykatave të shkallëve të para dhe të apelit kur nga ana e tyre kryehen shkelje shumë të rënda të - Merr masa disiplinore për gjyqtarët e gjykatave të shkallëve të para dhe të apelit;
- Kujdeset për kualifikimin e gjyqtarëve duke i dhënë mendim Shkollës së Magjistraturës, për programin e formimit vazhdues të organizuar prej saj.

Në raport me gjykatat, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, realizon kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të apeleve, nëpërmjet inspektimeve tematike apo të përgjithshme si të gjyqtarëve ashtu edhe të gjykatave.

Një tjetër kompetencë e Këshillit është emërimi dhe shkarkimi i inspektorëve të Inspektoratit të tij, duke respektuar si urdhërimet e Ligjit Nr.8811, datë 17.05.2001 dhe Rregulloren "Për organizimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë"

Detyra të tjera i janë ngarkuar Këshillit nga Ligji Nr.9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", ku përmendet roli konsultativ në përcaktimin e kompetencës tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së gjykatave të shkallëve të para e të apelit apo për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr.10 019, datë 29.12.2008, i ka ngarkuar Këshillit realizimin e procesit të hedhjes së shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor është një ent publik i pavarur, që administron buxhetin e sistemit gjyqësor, siç parashikohet në Kushtetutë. Zyra drejtohet nga një bord, i përbërë nga 8 gjyqtarë të tre niveleve dhe një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, dhe nga një drejtor, i emëruar nga ky bord.

Gjykata Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e sistemit gjyqësor, por ajo, në zbatim të kompetencave të saj dhe kërkesave përkatëse, ka dhënë disa vendime që kanë ndikuar mbi elementë të ndryshëm të funksionimit të sistemit gjyqësor:

- Gjykata Kushtetuese ka dhënë disa vendime, me të cilat ka detyruar KLD- në të respektojë elementë të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si p.sh: "e drejta e gjyqtarit për t'u dëgjuar paraprakisht, e drejta e mbrojtjes, etj";
- Me vendimin nr. 11, datë 27.05.2004, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën e Gjykatës së Lartë për shfuqizimin e disa neneve të ligjeve "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë" dhe "Për organizimin dhe funksionimin e KLD- së", të cilat kishin të bënin me kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë në fushën e inspektimit të gjykatave dhe gjyqtarëve.

Konferenca Gjyqësore Kombëtare

Konferenca Gjyqësore Kombëtare përmendet për herë të parë në Kushtetutë, sipas së cilës ky organizëm zgjedh 9 anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. KGjK u krijua më 3- 4 Dhjetor 1999, si bashkim vullnetar i gjyqtarëve të tre niveleve. KGjK funksionon në bazë të një statuti, megjithëse është organ i krijuar nga Kushtetuta. Nga ana tjetër, KGjK nuk është as shoqatë, sepse nuk është regjistruar si e tillë.

Prokuroria

Organizimi i prokurorisë është i ngjashëm me atë të sistemit gjyqësor, por prokuroria është organ i centralizuar dhe nuk është pjesë e këtij sistemi.

Kushtetuta parashikon se Prokurori i Përgjithshëm është i pavarur dhe kompetent për ndjekjen e çështjeve penale dhe përfaqësimin e akuzës ne gjyq në emër të shtetit. Prokuroria është organ i centralizuar dhe hierarkik; prokuroret u nënshtrohen urdhrave te prokuroreve te niveleve me te larta. Prokurori i Përgjithshëm miraton strukturën, organiken dhe rregullat e funksionimit te prokurorive pranë gjykatave dhe ne Prokurorinë e Përgjithshme, si edhe nxjerr urdhra për ushtrimin e detyrave te prokuroreve dhe delegimin e përgjegjësive te caktuara.

Çdo gjykatë ka një prokurori pranë saj dhe prokurorët ndjekin çështjet brenda juridiksionit të gjykatës pranë se cilës ndodhen. Kodi i Procedurës Penale parashikon rregullat lidhur me funksionimin e prokurorive.

Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqim të Kuvendit, ndërsa prokuror ët emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm.

Avokati i Popullit

Avokati i popullit, është krijuar me Ligjin nr. 8454, date 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", ndryshuar me Ligjin Nr. 8600, date 10.4.2000. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta te organeve te administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Shkolla e Magjistraturës

Institucioni përgjegjës për formimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve është Shkolla e Magjistraturës, e cila e realizon këtë veprimtari në bashkëpunim me KLD dhe Prokurorinë e Përgjithshme.

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë organizohet dhe funksionon në përputhje me Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë, me ligjin nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", me dispozitat ligjore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, si dhe me dispozita të tjera ligjore dhe nënligjore (deri tek Rregullorja e Brendshme e organizmit dhe funksionimit) që parashikojnë rregulla të organizimit, funksionimit dhe kompetencave për Ministrinë e Drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet dhe në zbatim të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", ushtron funksione dhe kanë kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit te vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e

tjera te drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

Masat legjislative afatshkurtra

Aktet ligjore të planifikuara për vitin 2012 janë listuar më poshtë. Përsa i përket kapaciteteve administrative, hartimi i këtij projektakti nuk implikon shpenzime shtesë pasi ato janë të parashikuara në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë. Në lidhje me zbatimin e këtij akti ai ka karakter gjithëpërfshirës.

Masat legjislative për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ky projektligj do të përafrojë pjesërisht Direktivën e Këshillit 86/653/KKE e datës 18 dhejtor 1986 për 'Koordinim e ligjeve të Shteteve Anëtare lidhur me agjentët tregëtar të vetëpunësuar', **CELEX 31986L0653,** Direktivën e Këshillit 85/374/KEE e datës 25 korrIk 1985 për 'Përafrimin e ligjeve, regullave dhe dispozitave të Shteteve Anëtare lidhur me përgjegjshmërinë për produktet e dëmtuara'; **CELEX: 01985L0374-19990604;** si dhe Direktivën 2000/35/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 29 qershor 2000 për 'Luftimin e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare'; **CELEX: 32000L0035;**
- Projektligj "Për disa shtesa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile", i ndryshuar";
- Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar";
- Projektligj "Për Kodin e Procedurave Administrative";
- Projektligj "Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Urdhrin Rajonal për Arrestimin në Shtetet e Europës Juglindore";
- Projektligj "Për aderim në Konventën e Luganos"Për juridiksionin, njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështje civile dhe tregtare";
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në çështjet tregtare dhe civile";
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale";
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Serbisë "Për ekstradimin";
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Serbisë "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën civile dhe penale";
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Serbisë "Për njohjen e vendimeve në fushën penale";
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Bosnje Hercegovinën "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën civile dhe penale";

- Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8730 datë 18.01.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarimor gjyqësor;
- Projektligj "Për disa ndryshime në ligjin nr.10186, datë 5.11.2009, "Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin";
- Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë;
- Projektligji "Për arbitrazhin";
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë mbi të Drejtat e Pronësisë";
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores se organizimit dhe funksionimit të brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore për pasuritë e paluajtshme" ;
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statusit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme";
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për caktimin e nivelit të pagave të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme";
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të ushtrimit të drejtës së aksesit të informacionit nga personat juridik/fizik, vendas apo të huaj";
- Projektvendimi Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së shërbimeve të ofruara nga ZRPP";
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen";
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar";
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për procedurën e kalimit në pronësi të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më datë 10.08.1991, dhe truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie te detyrueshme për regjistrim";
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për kryerjen e përmirësimit dhe përditësimit të të dhënave gjate afishimit publik të regjistrimit te pasurive te paluajtshme";
- Projektudhëzim i Këshillit të Ministrave "Për caktimin e kriteret dhe procedurat për regjistrimin e lejes së ndërtimit dhe akteve noteriale të lidhura për zhvillimin në cilësinë e investitorit dhe pronarëve të truallit apo blerësve/porositësve të njësive individuale, te objektit ne fazën e karabinasë dhe të objektit të përfunduar";
- Projektudhëzim i Këshillit të Ministrave "Për procedurën e regjistrimit të pasurive të fituara me vendim gjykate, akt administrativ apo noterial, në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme".

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Analiza e nevojave për ndërhyrje në projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe adresimi i rekomandimeve të evidentuara;

- Organizimi i konferencës me ekspertë shqiptarë mbi reformën në Gjykatën e Lartë lidhur me problemet e këtij institucioni, të tilla si: emërimin e anëtarëve, organizimi i brendshëm, ulja e ngarkesës dhe promovimi i funksioneve të unifikuara sipas doktrinës;
- Përgatitja nga grupi i punës i analizës mbi nevojat për ndërhyrje në Kodin e Procedurës Penale dhe adresimi i rekomandimeve të evidentuara;
- Përgatitja nga grupi i punës i analizës mbi nevojat për ndërhyrjeve në Kodin e Procedurave Administrative dhe adresimi i rekomandimeve të evidentuara;
- Përgatitja e draft manualit për inspektimet mbështetur në memorandumin e bashkëpunimit;
- Shkëmbimi i ndërsjelltë i statistikave mbi ankesat e ndaj gjyqtarëve të paraqitura në MD dhe KLD dhe analiza e tyre me qëllim evidentimin e mbivendosjeve të mundshme të tyre;
- Krijimi i formatit të standardizuar të raporteve të inspektimit të MD-së dhe KLD-së;
- Përgatitja e raportit të përbashkëta mbi implementimin e Memorandumit;
- Hartimi dhe nënshkrimi i memorandumit të përbashkët ndërmjet titullarëve të institucioneve;
- Implementimi i memorandumit nëpërmjet ushtrimit të inspektimeve sipas kompetencave të MD-së dhe KLD-së;
- Përgatitja e analizës së nevojave për ndërhyrjeve në projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2011 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar dhe adresimi i rekomandimeve të evidentuara;
- Mbledhja e dokumenteve dhe formularëve për projektaktin e vlerësimit paraprak të gjyqtarëve në 24 gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit (30 gjykata gjithsej);
- Plotësimi i vlerësimit profesional i gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Përgatitja e projektaktit final mbi vlerësimin e 24 gjykatave;
- Paraqitja e projektaktit final për vlerësimin e gjykatave në 23 gjykata dhe gjykata apeli (nga 30 gjykatat gjithsej) në KLD me propozimet për shqyrtim dhe miratim;
- Mbledhja e të dhënave dhe përgatitja e projektaktit paraprak për vlerësimin e 6 gjykatave të tjera;
- Përgatjta e projektaktit final dhe paraqitja në KLD për shqyrtim dhe miratim;
- Hartimi dhe miratimi i kritereve të qarta dhe transparente për transferimin, promovimin dhe vlerësimin e gjyqtarëve bazuar në meritë dhe raportimi i masave të ndërmarra nga Komisioni i Transferimit, Promovimit dhe Vlerësimit të Gjyqtarëve (KLD);
- Raportimi i Komisionit të Transferimit, Promovimit dhe Vlerësimit të Gjyqtarëve në KLD me qëllim paraqitjen e masave konkrete të marra për transferimin e gjyqtarëve mbi baza merite dhe të kriterere objektive (KLD);
- Ushtrimi i 3 kontrolleve mbi veprimtarinë gjyqësore në bazë të ankesave të qytetarëve dhe atyre të programuara/tematike. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet ankesave në lidhje me rregullat e etikës;
- Përgatitja e raporteve në përfundim të çdo inspektimi dhe paraqitja e tyre pranë subjekteve të inspektuara dhe të interesuara;

- Analiza e rezultatave dhe ndjekja e rekomandimeve të raporteve të inspektimit deri në paraqitjen e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor pranë KLD-së, në kuadër të përcaktimit të një praktike të qëndrushme për inspektimin gjyqësor;
- Ushtrimi i 3 kontrolleve mbi veprimtarinëe prokurorëve;
- Përgatitja e raporteve në përfundim të çdo inspektimi dhe paraqitja e tyre pranë drejtuesit të prokurorisë së rrethit gjyqësor që është inspektuar, Prokurorit të Përgjithshëm, Presidentit të Republikës dhe subjektit që ka paraqitur ankesën;
- Analiza e rezultatave dhe ndjekja e rekomandimeve të raporteve të inspektimit deri në paraqitjen e rekomandimit të Ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor;
- Përgatitja e raportit vjetor të Ministrisë së Drejtësisë mbi inspektimet e ushtruara ndaj organit të akuzës;
- Hartimi i rekomandimeve vjetore në emër të Këshillit të Minitrave për Prokurorin e Përgjithshëm për luftën kundër kriminalitetit;
- Organizimi dhe funksionimi i administratës gjyqësore, karriera dhe statusi i punonjësve të saj;
- Përgatitja nga grupi i punës i analizës mbi nevojat për ndërhyrje në ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore dhe adresimi i rekomandimeve të evidentuara;
- Implementimi i programit të trajnimeve vazhduese të administratës gjyqësore, në lidhje me: menaxhimin e gjykatës dhe marrëdhënies me kancelarë të tjerë; Çështjet e buxhetit dhe financiare; Marrëdhëniet me ministritë dhe organe të tjera; Zhvillimin e një takimi; Marrëdhëniet me palët ndërgjyqëse dhe publikun; - Marrëdhëniet me shtypin dhe median; Etikën dhe konfliktin e interesave;
- Përgatitja nga grupi i punës i analizës mbi nevojat për ndërhyrje në projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8363, datë 1.7.1998 "Për krjimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor" dhe adresimi i rekomandimeve të evidentuara;
- Kontrolli i veprimtarisë së ZQRPP, Agjencise se Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe institucioneve të tjera vartëse, nëpërmjet inspektimeve të kryera nga ministria;
- Zbatimi efektiv i rregullave për selektimin e kandidatëve për magjistratë, trajnimi dhe vlerësimi i tyre;
- Përgatitja e analizës së nevojave për ndërhyrje në projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996 "Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe adresimi i rekomandimeve të evidentuara;
- Statusi dhe trajtimi i inspektorëve të Ministrisë së Drejtësisë.
- Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit ICMIS, për një mirëfunksionim të punës në gjykata;
- Monitorimi i rezultateve të shortit elektronik;
- Përmirësimi i aksesit të qytetarëve në sistemin elektronik (monitorimi dhe zyra e informimit);
- Vendosja e modulit të inspektimit në gjykata (inspektoriati i MD-së & KLD-së) ;
- Realizimi i ndërveprimit ndërmjet bazës së të dhënave të gjykatës së shkallës së parë me gjykatat e apelit;
- Ristrukturimi dhe zhvillimi i protalit elektronik gjykata.org dhe hedhja e të dhënave në interes të qytetarëve, përfshirë edhe publikimin e vendimeve gjyqësore;

- Përditësimi i vendimeve gjyqësore në Qendrën e Dokumentimit të KLD-së, që mundëson publikimin e vendimeve gjyqësore;
- Zhvillimi i modulit të statistikave;
- Fillimi i procesit të regjistrimit audio – video të gjykatave, fillimisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë;
- Zhvillimi i 4 trajnimeve me personelin e administratës gjyqësore dhe gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe personelit të MD-së për modulin e ri të të regjistrimit audio;
- Vazhdimi i instalimit në sistemin ICMIS të modulit për regjistrimin audio, në këto gjykata: Gjykatat e Apelit Korçë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, Gjykata e Rrethit Pogradec dhe Gjykata e Apelit Korçë; Gjykatat e Apelit Durrës: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Gjykata e Apelit Durrës;
- Monitorimi video i seancave gjyqësore në Gjykatën e Tiranës (projekt pilot);
- Trajnimi vazhdues i gjyqtarëve dhe prokurorëve përfshirë Gjykatën e Lartë, me fokus të drejtat e njeriut, dhuna në familje, etika, çështjet tregatre; MSA dhe acquis; legjisalcionin europian, jurisprudenca mbi Konventën për të Drejtat e Njeriut; praktika e GJEDNJ-së; format alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve; diskriminimi, Kodi i Etikës dhe zhvillimet e reja të legjislacionit;
- Vazhdimi i rishikimit të kurrikulave të Shkollës së Magjistraturës në lidhje me zhvillimet e e reja dhe sistemin e drejtësisë;
- Konsolidimi i Shkollës së Magjistraturës nëpërmjet trajtnimit të trajnerëve, përmirësimit të kushteve dhe rishikimit të organigramës;
- Dixhitalizimi i regjistrit të noterisë dhe lidhja me ZQRPP.
- Studim projektim për ndërtimin e Gjykatës Administrative;
- Investimi për përmirësimin e infrastrukturës gjyqësore nëpërmjet ndërtimit të ndërtesave të reja në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec;
- Investimi për përmirësimin e infrastrukturës elektronike të gjykatave dhe të kushteve të punës dhe shërbimeve në salla dhe zyrat e gjyqtarëve si dhe instalimi i elementeve të sigurisë;
- Zbatimi efektiv i kuadrit ligjor për ndihmën juridike;
- Raportimi i punës së Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridke pranë Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave dhe Dhomës Kombëtare të Avokatëve;
- Liçencimi dhe regjistrimi i ndërmjetësve në zbatim të ligjit të ri për ndërmjetësimin;
- Raportimi nga Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve pranë Ministrit të Drejtësisë;
- Trajnimi i ndërmjetësve për zgjidhjen e konflikteve;
- Trajnimi dhe forcimi i kapaciteteve dhe rolit të profesioneve të lira në lidhje me standardet europiane dhe zhvillimin e legjislacionit;
- Përmirësimi i rolit të profesioneve të lira (noter, avokat, ndërmjetës, arbitra) nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të tyre dhe monitorimit të vazhdueshëm;
- Rritjes së rolit dhe kapaciteteve të Avokaturës së Shtetit nëpërmjet trajnimeve dhe përmirësimit të kushteve të punës;
- Implementimi i sistemit elektronik ALBIS;
- Gjenerimi i të dhënave statistikre dhe raporteve mbi përmirësimin e shërbimit;
- Zgjerimi i shërbimit përmbarimor privat ndaj shërbimit përbarimor shtetëror nëpërmjet ndryshimeve në ligj dhe certifikimit të përmbaruesve privatë;

- Ushtrimi i 4 inspektimeve tematike në shërbimin përmbarimor privat;
- Përgatitja e raporteve të inspektimit në përfundim të çdo inspektimi dhe paraqitja e tyre tek subjektet e kontrolluara dhe tek të interesuarit;
- Analiza e rezultateve dhe ndjekja e rekomandimeve të raporteve të inspektimit deri në paraqitjen e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor pranë Komisionit Disiplinor të Përbaruesve Gjyqësorë Privatë;
- Hartimi i programit për trajnimin vazhdues ptë përmbarauesve gjyqësorë privatë;
- Trajnimi i vijueshëm i përmbaruesve gjyqësorë privatë në zbatim të programit të miratuar;
- Hartimi i specifikimeve teknike të pajisjeve dhe programeve, lidhur me implementimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve;
- Kontraktimi me 2 ekspertë të huaj për një periudhë 2 mujore për të asistuar projektimin e CMS. Kjo është faza e fundit pas së cilës do të zhvillohet tenderi për projektin në fjalë;
- Gjenerimin e statistikave të sakta dhe të përputhshme;
- Vizita monitoruese në vendet e kufizimit të lirisë nga Njësia kundër Torturës, Avokati i Popullit;
- Vazhdimi i punës kërkimore shkencore dhe botimi i revistave shkencore "Jeta Juridike" si dhe botime të tjera profesionale për periudhen 2012 e në vazhdim;
- Vazhdimi i trajnimit të magjistratëve mbi gjuhët e përdorura në institucionet evropiane;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale të Shkollës nëpërmjet:
  - Blerjes së pajisjeve elektronike, orendi-zyrash etj . (2012-2013)
  - Pasurimi i fondit të bibliotekës; (2012-2013)

Masat legjislative afatmesme

Masat legjislative afatmesme janë si vijon:

- Përmirësimi i kuadrit ligjor.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Implementimi i memorandumit nëpërmjet ushtrimit të inspektimeve në përputhje me kompetencat përkatëse të MD-së dhe KLD-së;
- Kontrolli i veprimtarisë gjyqësore dhe veprimtarisë së administratës gjyqësore nëpërmjet inspektimeve të kryera nga ministria;
- Përgatitja e raporteve të inspektimit në përfundim të çdo inspektimi dhe paraqitja e tyre pranë subjekteve të inpektuara dhe të interesuara;
- Analiza e rezultatave dhe ndjekja e rekomandimeve të raporteve të inspektimit deri në paraqitjen e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor, në kuadër të përcaktimit të një praktike të qëndrushme për inspektimin gjyqësor;
- Kontrolli i veprimtarisë së prokurorëve ;
- Përgatitja e raporteve të inspektimit në përfundim të çdo inspektimi dhe paraqitja e tyre pranë drejtuesit të prokurorisë së rrethit gjyqësor që është inspektuar, Prokurorit të Përgjithshëm, Presidentit të Republikës dhe subjektit që ka paraqitur ankesën;

- Analiza e rezultatave dhe ndjekja e rekomandimeve të raporteve të inspektimit deri në paraqitjen e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor;
- Përgatitja e raportit vjetor të Ministrisë së Drejtësisë mbi inspektimet e ushtruara ndaj organit të akuzës;
- Hartimi i rekomandimeve vjetore në emër të Këshillit të Ministrave për Prokurorinë e Përgjithshëm për luftën kundër kriminalitetit;
- Organizimi dhe funksionimi i administratës gjyqësore, karriera dhe statusi i punonjësve të saj;
- Kontrolli i veprimtarisë së ZQRPP, Agjencise se Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe institucioneve të tjera vartëse, nëpërmjet inspektimeve të kryera nga ministria;
- Vlerësimi profesional i gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Statusi dhe trajtimi i inspektorëve të Ministrisë së Drejtësisë.
- Zhvillimi dhe permiresimi i sistemit ICMIS, per nje mirefunksionim te punes ne gjykata;
- Monitorimi i rezultateve të shortit elektronik;
- Përmirësimi i aksesit të qytetarëëve në sistemin elektronik (monitorimi dhe zyra e informimit);
- Përditësimi i vendimeve gjyqëësore në Qendrën e Dokumentimit tëë KLD-së, që mundëson publikimin e vendimeve gjyqësore;
- Vazhdimi i instalimit në sistemin ICMIS të modulit të regjistrimit audio në gjykatat që kanë mbetur pa u instaluar;
- Trajnimi i personelit administrative të gjykatave, kancelarëve, gjyqatarëve, stafit të MD-së me modulet e reja të regjistrimit audio;
- Vazhdimi i rishikimit të kurrikulave të Shkollës së Magjistraturës në lidhje me zhvillimet e e reja dhe sistemin e drejtësisë;
- Konsolidimi i Shkollës së Magjistraturës nëpërmjet trajtnimit të trajnerëve, përmirësimi i kushteve dhe rishikimi i organigramës;
- Dixhitalizimi i regjistrit te noterise dhe lidhja me ZQRPP;
- Studim projektim per ndertimin e Gjykates Administrative;
- Ndërtimi i Pallatit të Drejtësisë;
- Investimi për hartimin e projektit të implementimit për ndërtimin e ndërtesës së re / rikonstruksionin e ndërtesës aktuale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; Gjykatën e Apelit Tiranë; Gjykatën e Rrethit gjyqësor Fier; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet;
- Investimi për përmirësimin e infrastrukturës gjyqësore nëpërmjet ndërtimit të ndërtesave të reja në: Gjykatësn së Apelit Shkodër; Gjykatës së rrethit Gjyqësor Elbasan; Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe Gjykatës së Lartë;
- Investimi për përmirësimin e infrastrukturës gjyqësore për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë; Gjirokastër dhe Fier;
- Investimi për përmirësimin e infrastrukturës elektronike të gjykatave;
- Investimi për përmirësimin e infrastrukturës elektronike të gjykatave dhe të kushteve të punës dhe shërbimeve në salla dhe zyrat e gjyqtarëve si dhe instalimi i elementeve të sigurisë;

- Raportimi i punës së Komisionit Shtetëorr të Ndihmës Juridike pranë Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave dhe Dhmoës Kombetare të Avokatëve;
- Liçencimi dhe regjistrimi i ndërmjetësve në zbatim të ligjit të ri për ndërmjetësimin;
- Trajnimi i ndërmjetësve për zgjidhjen e konflikteve;
- Trajnimi dhe forcimi i kapaciteteve dhe rolit të profesioneve të lira në lidhje me standardet europiane dhe zhvillimin e legjislacionit;
- Përmirësimi i rolit të profesioneve të lira (noter, avokat, ndërmjetës, arbitra) nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të tyre dhe monitorimti të vazhdueshëm;
- Rritjes së rolit dhe kapaciteteve të Avokaturës së Shtetit nëpërmjet trajnimeve dhe përmirësimit të kushteve të punës;
- Implementimi i sistemit elektronik ALBIS;
- Gjenerimi i të dhënave statistikre dhe raporeve mbi përmirësimin e shërbimit;
- Zgjerimi i shërbimit përmbarimor privat ndaj shërbimit përbarimor shtetëror nëpërmjet ndryshimeve në ligji dhe certifikimit të përmbaruesve privatë;
- Trajnimi i vijueshëm i përmbaruesve gjyqësorë privatë në zbatim të programit të miratuar;
- Sigurimi i ndjekjes penale dhe dërgimi përpara gjykatës së autorëve të krimeve;
- Zbatimi me rigorozitet i legjislacionit për mbrojtjen e dëshmitarëve, duke u konsideruar një masë e nevojshme dhe e domosdoshme në luftën kundër krimit;
- Vizita monitoruese në vendet e kufizimit të lirisë nga Njësia kundër Torturës, Avokati i Popullit;
- Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme të prokurorëve, sipas programit vjetor të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime të tjera të organizuara në bashkëpunim me universitete dhe institucione ndërkombëtare;
- Zhvillimi i 80-90 trajnimeve për rritjen e performancës se Gjyqësorëve dhe Prokurorëve";
- Pergatitja e Programit te ri te formimit te vazhdueshem për gjyqtarët dhe prokurorët në detyre për 2012-2015";
- Zhvillimi i disa sesione trajnuese për trajnimin e trajnerëve (2012-2014);
- Përmirësimi i kapaciteteve institucionale të Shkollës, nëpërmjet:
    - Zgjerimit të ambienteve të Shkollës së Magjistraturës, (ndërtimi i një godine të re). (2012- 2015).

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.23.1 Sistemi Gjyqësor

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**2.038.000**	**0**	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	2.038.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.23.2. POLITIKAT KUNDËR KORRUPSIONIT

Objektivi strategjik

Lufta kundër korrupsionit përbën një prioritet absolut të Qeverisë Shqiptare. Duke pasur si vizion themelor reduktimin progresiv dhe të qëndrueshëm të korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e vlerave në qeverisje, drejtimet kryesore në luftën ndaj këtij fenomeni janë:

- Reformave për parandalimin e tij;
- Forcimit të integritetit të institucioneve dhe promovimit të vlerave të qeverisjes;
- Monitorimit të gjithanshëm të fenomenit të korrupsionit, luftës kundër tij nga shoqëria civile dhe forcimi i rolit të saj;
- Ndëshkimit administrativ dhe ligjor të zyrtarëve të korruptuar.

Zbatimi i përgjegjshëm i strategjisë anti-korrupsion në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim e Integrim (SKZHI), nëpërmjet planeve te veprimit te miratuara, synon reduktimin progresiv e të qëndrueshëm të korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e vlerave në qeverisje nëpërmjet kultivimit e forcimit të mendësisë së shërbimit ndaj qytetarëve nga administrata publike, zbatimit të efektshëm e të barabartë të ligjit, përmirësimit të transparencës e informimit, zhvillimit të shpejtë e të qëndrueshëm ekonomik e njerëzor, cilësisë, përgjegjshmërisë e efektivitetit në qeverisje.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Përpjekjet në këtë fushë do të përqendrohen në veprime konkrete për reduktimin e korrupsionit dhe ndryshimin rrënjësor të mendësisë qeverisëse. Reduktimi progresiv e i qëndrueshëm i korrupsionit ka nevoje për një ndërhyrje energjike që të angazhojë gjithë burimet vendase dhe mbështetjen e ndihmën e ndërkombëtarëve.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Kuadri ligjor bazë në fushën e luftës kundër korrupsionit fokusohet, ndër të tjera, në aktet e mëposhtme:

- Ligjin nr. 7895 datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë";
- Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Ligjin nr. 8498, datë 06.10.1999 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale dhe protokollin e saj shtesë, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 8883, datë 18.04.2002 "Për ratifikimin e protokollit të dytë shtesë të Konventës së Këshillit të Europës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale;
- Ligjin nr. 8635, datë 07.06.2000 "Për ratifikimin e Konventës Civile për Korrupsionin";

- Ligjin nr. 8778, datë 26.04.2001 “Për ratifikimin e Konventës Penale për Korrupsionin”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9245, datë 24.06.2004 “Për ratifikimin e Protokollit Shtesë të Konventës Penale për Korrupsionin”;
- Ligjin nr. 8646, datë 20.07.2000 “Për ratifikimin e konventës evropiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”;
- Ligjin nr. 8888, datë 25.4.2002 “Për ratifikimin e “Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”;
- Ligjin nr. 9262, datë 29.7.2004 “Për ratifikimin e protokollit shtesë të konventës për krimin kibernetik”;
- Ligjin nr. 9492, datë 13.3.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit”;
- Ligjin nr. 9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”;
- Ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”;
- Ligjin nr. 9049, date 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive te detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe te disa nëpunësve publike”, i ndryshuar (në proces);
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit te interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar me ligjet nr. 9475, datë 09/02/2006 dhe nr. 9529, datë 11/05/2006;
- Ligjin nr. 9508, date 03.04.2006 “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”;
- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;
- Ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”;
- Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”;
- Ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për policinë e shtetit”;
- Ligjin nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”;
- Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”;
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “ Për Procedurat tatimore në RSH”;
- Ligj nr. 10002, datë 6.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme”;
- Ligj nr. 10005, datë 23.10.2008 "Për një shtesë në ligjin nr. 8510, datë 15.7.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”;
- Ligji nr. 10051, datë 29.12.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”;
- Ligj nr. 10053, datë 29.12.2008 "Për një shtesë në ligjin nr. 796, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar";
- Ligjit Nr. 10081 datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 10078, datë 16.2.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistiken”;
- Ligji nr. 10119, datë 23.4.2009, “Për Planifikimin e Territorit”;

- Ligji nr. 10160, datë 15.10.2009, “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët e lartë dhe nëpunësit civilë";
- Ligji Nr. 10374 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 10093, datë 9.3.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)”;
- Ligji Nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” dhe Ligji Nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- VKM nr. 768, datë 15.7.2009 “Për miratimin e proceduarave dhe të rregullave për kandidimin dhe përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)”;
- VKM nr. 769 dt. 15.07.2009 “Për miratimin e Statutit te Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”;
- VKM nr. 161 dt. 10.03. 2010 ”Mbi Emërimin e anëtareve te Bordit Mbikëqyrës Agjencisë për mbështetjen e Shoqërisë Civile”;
- Vendimin nr. 794, datë 19.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Task Forcës Antikorrupsion”;
- Vendimin nr. 94, datë 15.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores për funksionet dhe procedurat e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion të Këshillit të Ministrave”;
- Vendimin nr. 714, datë 22.10.2004 “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”;
- Vendimin nr. 517, datë 15.3.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit të reformës rregullatore në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit”;
- Vendimin nr. 1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Vendimin nr. 27, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”;
- Urdhrin nr. 172, datë 2.11.2005 të Kryeministrit “Për marrjen e masave të shpejta në zbatim të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Urdhrin nr. 202, datë 16.12.2005 të Kryeministrit “Për forcimin e transparencës nëpërmjet rritjes së përdorimit të internetit dhe përmirësimit të faqeve ekzistuese të internetit”;
- Urdhrin nr. 208, datë 29.12.2005 të Kryeministrit “Për vendosjen e numrave të telefonit falas për denoncimin e korrupsionit”;
- Urdhrin Nr. 135, datë 12.06.2006 të Kryeministrit, “Për ngritjen e Grupit Ndërministror të Punës, për thjeshtëzimin e dokumentacionit shoqërues për shërbimet e ofruara nga administrata qendrore”.
- Urdhrin nr. 170, datë 31.10.2005 të Kryeministrit, “Për Krijimin e Task-Forcës për drejtimin dhe monitorimin e reformës rregullatore ne funksion te përmirësimit të klimës së biznesit”;
- VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 153, datë 22.3.2007;

- VKM nr. 913, datë 26.8.2009 "Për krijimin e Qendrës Kombëtare për Aplikimet Energjetike";
- V.K.M Nr. 477, datë 06.05.2009 "Për për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat e personelit hetues, në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme";
- V.K.M Nr. 478, datë 06.05.2009 "Për Klasifikimin e Niveleve, sipas funksioneve, të personelit Inspektues dhe mbështetës të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme";
- V.K.M Nr. 637, datë 11.06.2009 "Për miratimin e Rregullores së Personelit të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme";
- V.K.M Nr. 639, datë 11.06.2009 "Për përcaktimin e kushteve dhe të kritereve e të kontrollit të fondit të posaëëm, në funksion të veprimtarisë informative dhe procedurale penale, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm";
- V.K.M Nr. 646, datë 11.06.2009 "Për miratimin e Rregullores së Disiplinës së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme";
- V.K.M Nr. 718, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve të personelit të hetimit, të inspektimit dhe të shërbimeve mbështetëse, në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme";
- V.K.M Nr. 42, datë 27.01.10 "Për përcaktimin e formës e të përmasave të stemës së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme, dhe për mënyrën e përdorimit të saj";
- V.K.M. Nr. 415, date 08.06.2011 "Për disa të drejta të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme";
- Urdhri i Ministrit të Brendshëm, Nr. 588, datë 03.03.2009 "Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së SHKB-së, në Ministrinë e Brendshme";
- Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm, Nr. 114, datë 12.04.2010 "Për procedurat e Mbledhjes së të Dhënave dhe Bashkërendimin e Punës së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm me Policinë e Shtetit e Strukturat e tjera të Ministrisë së Brendshme";
- Urdhër Nr. 146, datë 04.05.2010 "Për formën, përmasat, të dhënat dhe rregullat për përdorimin e dokumentit të identifikimit të punonjësve të SHKB-së";
- Urdhër Nr. 147, datë 04.05.10 "Për përdorimin e fondit të posaçëm për shpenzime në funksion të veprimtarisë informative dhe veprimtarisë procedurale penale të SHKB-së";
- Urdhër Nr. 148, datë 04.05.2010 "Për përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin, vlerësimin dhe ruajtjen e të dhënave";
- Urdhër Nr. 402, datë 14.11.2011 i Ministrit të Brendshëm "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm".

Struktura institucionale

Strukturat që janë të ngarkuara me luftën kundër korrupsionit, krahas organeve të hetimit e ndjekjes penale (policia e prokuroria) janë:

Ne nivel strategjik dhe politik:

- Task Forca Anti Korrupsion (TFA), e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 794, datë 19.12.2005. Kjo strukturë kryesohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga

anëtarë të Këshillit të Ministrave dhe përfaqësues të institucioneve të tjera të varësisë që mbulojnë kryesisht menaxhimin e financave publike si dhe kontrollin e auditin.
TFA ka për funksion të analizojë fenomenin, përcaktojë prioritetet, identifikojë masat dhe veprimet konkrete dhe koordinojë punën ndërmjet institucioneve;

- Grupi Ndërministrorë i Punës, ne baze te Urdhrit te Kryeministrit nr. 195, date 14.08.2006, i ndryshuar; mbështetur nga grupi teknik, është përgjegjës për hartimin e strategjisë dhe rishikimin periodik te saj, koordinimin e punës se ministrive për hartimin e Planeve te Integruara Ministeriale, qe janë plane te përvitshme veprimi ne zbatim te Strategjisë , si dhe ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit te "Strategjisë për Parandalimin, Luftën Kundër Korrupsionit dhe Qeverisjen Transparente" dhe planeve individuale te ministrive për antikorrupsionin.
- Me qellim permiresimin e kapaciteve zbatuese dhe monitoruese te Strategjise Antikorrupsion jane krijuar edhe grupet e posacme te punes ne te gjitha nivelet e kerkuara. Për përmirësimin e koordinimit të zbatimit të strategjisë antikorrupsion dhe kapaciteteve të DEKOBAN, gjatë vitit 2010 është ndryshuar Urdhri i Kryeministrit nr. 173, datë 27.09.2010 për krijimin dhe organizimin e Grupit Ndërministror të Punës për Zbatimin e Strategjisë Antikorrupsion, i cili ka përcaktuar se Sekretariati teknik për koordinimin e punës përbëhet nga përfaqësues nga DEKOBAN, DEBASKON. MITIK, Ministria e Drejtesise dhe Ministria e Integrimit. Jane miratuar nga GNP-ja dhe regulloret e brendshme te GNP, GNTP dhe Sekretariatit teknik te GNP, te cilat percaktojne ne detaje funksionet e detyrat e te gjitha grupeve te punes.
Më tej, me qëllim përmirësimin e çështjeve të koordinimit brenda ministrive të linjës, janë përcaktuar Sekretarët e Përgjithshëm të çdo ministrie për të bashkërenduar procesin e brendshëm të raportimit në lidhje me zbatimin e planeve 1-vjeçare të veprimit. Kjo synon të përmirësojë bashkërendimin ndërmjet ministrive të linjës.

Në nivel operacional :

- Këshilli i Ministrave
  - Departamenti i Kontrollit te Brendshëm dhe Antikorrupsion pranë Këshillit te Ministrave (DEKOBAN)
- Ministria e Brendshme
  - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë se Shtetit (Drejtoria Kundër Krimit Financiar).
  - Shërbimi i Kontrollit te Brendshëm pranë Ministrisë se Brendshme.
- Ministria e Drejtësisë
  - Shërbimi i Kontrollit te Brendshëm ne Drejtorinë e Përgjithshme te Burgjeve.
- Ministria e Financës
  - Drejtoria e Investigimit te Brendshëm (Drejtoria e Përgjithshme e Tatime)
  - Agjencia e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara
  - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Departamenti Operativo-Hetimor)
  - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit te Parave (DPPPP).
- Prokuroria e Përgjithshme (Prokuroria për Krime te Renda) dhe Prokuroritë pranë Rretheve Gjyqësore
  - Njësitë e Përbashkët Hetimore për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit. (strukture e veçante e krijuar me qellim te bashkërendimit te punës midis institucioneve me qellim hetimin dhe ndjekjen efektive te veprave penale te krimit financiar dhe ekonomik

- Inspektorati i Larte i Deklarimit te Pasurive
- Kontrolli i Lartë i Shtetit

Këshilli i Ministrave

Departamenti i Kontrollit te Brendshëm dhe Antikorrupsion pranë Këshillit te Ministrave (DEKOBAN) përbehet nga drejtori dhe 10 inspektore (2 prej te cilëve janë koordinator dhe inspektore). DEKOBAN, në Këshillin e Ministrave, është struktura përgjegjëse për kontrollin e brendshëm administrativ dhe antikorrupsionin në të gjitha institucionet e pushtetit ekzekutiv (ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit a ministrave, administratës së prefektit, si dhe në shoqëritë tregtare, me kapital shtetëror). Misioni i Departamentit është të kryejë verifikimin (hetimin administrativ) e zbatimit të ligjshmërisë dhe/ose kallëzimeve për praktika abuzive, korruptive a arbitrare, të identifikojë punonjësit e administratës publike, të cilët, me veprime apo mosveprime kanë kryer shkelje te akteve ligjore/nënligjore në fuqi, të përgatisë rekomandime për çështjet përfshi edhe llojin e masave ndaj autorëve, si dhe të ndërgjegjësojë institucionet publike në luftë kundër korrupsionit.
Departamenti ka si funksion te tij edhe koordinimin për hartimin e politikave antikorrupsion, si dhe lehtësimin e koordinimin për ndjekjen dhe raportimin e zbatimit te programeve antikorrupsion. Ky funksion realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes dhe kryesimit të Sekretariatit teknik të Grupit Ndërministror të Punës për zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente. Departamenti luan një rol kryesor në Sekretariat për sa i përket dhenies se asistencës teknike në fushën e antikorrupsionit.
DKBAA është pike fokale për raportimin ne emër te qeverise ne institucionet / dhe organizmat ndërkombëtare si Regional Anti-corruption Initiative (RAI), GRECO (KiE) dhe UNODC për Konventën e Kombeve te Bashkuara kundër Korrupsionit, OECD (Rrjeti i Antikorrupsionit - Planin e Stambollit) etj.
Ministria e Brendshme

Me organizimin e ri të Policisë së Shtetit, në qershor të vitit 2007 u krijua **Drejtoria Kundër Krimit Financiar në Departamentin për Hetimin e Krimeve**. Kjo Drejtori ka filluar të funksionojë në mënyrë të plotë nga data 1 Janar 2008dhe ka strukturat e saj në 12 Drejtori të Policisë në Qarqe, ku është e organizuar në Sektorë.
Mbi bazën e një Memorandumi Bashkëpunimi ne viti 2007, mes Prokurorisë se Përgjithshme, Ministrisë se Brendshme, Ministrisë se Financave dhe Shërbimit Informativ Shqiptar, është krijuar dhe është operacionale Njësia e Përbashkët Hetimore Kundër Krimit Financiar dhe Korrupsionit pranë Prokurorisë Tirane për procedimet penale te regjistruara për vepra penale te korrupsionit. Kjo strukture vepron si një Task Force operacionale për hetimin, zbulimin dhe vënien para drejtësisë te individëve te përfshirë ne afera korruptive. Ne vitin 2009 me një MoU të re u ngritën dhe janë funksionale dhe 6 Njësi të përbashkëta hetimore pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastër. Me anë të këtij MoU janë përfshirë dhe dy struktura të reja bashkëpunuese: Inspektorati i Përgjithshëm i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Kontrolli te larte të Shtetit.

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, në bazë të ligjit nr. 10002, datë 06.10.2008 "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme", në funksion të objektit të veprimtarisë së saj, "parandalimit, zbulimit, dokumentimin dhe hetimin paraprak të veprave penale të kryer nga punonjësit e policisë së shtetit, pavarësisht nga funksioni dhe grada".
SHKB-ja ka kompetenca për të ndërmarrë masa parandaluese dhe masa hetimore (operacionale) për të kontrolluar dhe luftuar korrupsionin në policinë e shtetit.

Prokuroria e Përgjithshme

Prokuroria ka krijuar brenda sistemit të saj struktura të specializuara anti-korrupsion. Këto struktura janë quajtur **Njësi të Përbashkëta Hetimore** dhe janë krijuar pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastër.
Në Prokurorinë e Përgjithshme është krijuar Sektori kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit, i cili ka për detyrë të koordinojë punët e të gjitha Njësive të Përbashkëta Hetimore.

Ministria e Financave

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është një Institucion buxhetor, nën varësinë e Ministrit të Financave. Agjencia ka për objekt kryesor të veprimtarisë Administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara me vendim të Gjykatës për Krimet e Rënda. Struktura dhe organika e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara janë rregulluar me VKM nr. 1106, datë 30.7.2008 dhe Urdhrin e Kryeministrit nr. 103, datë 05.08.2008. Në bazë të akteve të mësipërme Agjencia ka në strukturën e saj 5 punonjës, përkatësisht, Kryeadministratori, 2 administratorë, 1 jurist dhe 1 specialist të administratës.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) funksionon në bazë të Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", i cili ka hyrë në fuqi në datë 10.09.2008,
Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu, kjo drejtori funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 89, datë 23.06.2009 "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave" është miratuar struktura e re e DPPPP-së dhe është shtuar personeli nga 22 në 26 punonjës.

Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (antikorrupsion) në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ka në misionin e saj zbulimin dhe parandalimin e sjelljeve korruptive nga punonjësit tatimore. është në proces miratimi nga ministri i financave draft-udhëzim "për funksionimin e investigimit të brendshëm në drejtorinë e përgjithshme të tatimeve".

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive është institucion i pavarur, pavarësia e të cilit përcaktohet në nenin 16 të Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003.
Roli i Inspektoratit të Lartë në zbatim të dy ligjeve mbi të cilën ushtron veprimtarinë e vet, në mënyrë të përmbledhur është si vijon:

- Rol parandalues, rol të cilin e përmbush gjatë këshillimit dhe dhënies së asistencës teknike dhe ligjore për plotësimin e deklaratës së interesave private.
- Roli kontrollues. Neni 17 i Ligjit 10.4.2003, përcakton kompetencat e Inspektoratit të Lartë, i cili ushtron kontroll të drejtpërdrejtë të deklarimeve në emërtesë të tij, si dhe mbledh të dhëna, kryen hetime dhe kërkime administrative rreth deklarimeve të personave që mbartin detyrim për deklarim në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.
- Roli ndëshkues, Inspektorati i Lartë ka të drejtë të ndërmarrë sanksione në përmbushje të detyrimeve ligjore.

Kontrolli i Lartë i Shtetit

Neni 162 i Kushtetutës përcakton Kontrollin e Lartë të Shtetit si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Shqipëri, i cili i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Nenet 162, 163, 164, 165 të Kushtetutës së Shqipërisë , si dhe ligji miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë nr. 8270, datë 23.12.1997, "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit". KLSH ka për mision rritjen e rolit dhe kontributit në drejtim të miradministrimit të financave publike, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve cilësore të zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike dhe financiare dhe raportimit mbi rregullshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të të gjitha burimeve financiare shtetërore, në të mirë të shtetit dhe publikut në tërësi.

Sipas nenit 6 te ligjit organik objekti kryesor i veprimtarisë përcaktohet kontrolli i përdorimit efektiv dhe i dobishëm i fondeve publike, miradministrimi financiar dhe zbatimi i ligjshmërisë ne fushën ekonomike e financiare. Zgjedhja e Kryetarit te KLSH-së për një mandat 7 vjeçar bëhet nga Kuvendi.

Te tjera institucione mund te përmendim ato te krijuara nga amendimet e ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, te cilat kanë krijuar organe të reja administrative si Avokati i Prokurimeve i cili mbron të drejtat dhe interesat e ligjshëm të kandidatëve, ofertuesve apo furnizuesve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të autoriteteve kontraktore (neni 14) si dhe Komisionin e Prokurimit Publik (neni 19/1) i cili shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe ato të koncesioneve.

Masat legjislative afatshkurtra

Prioritetet afatshkurtra te përcaktuara ne Dokumentin e Partneritetit Evropian dhe rekomandimeve te takimeve dypalëshe BE - Shqipëri lidhur me këtë fushe, janë si më poshtë:

- Hartimi i dokumentave të rinj strategjikë (2014 e në vijim) pas përfundimit të zbatimit të Strategjisë Antikorrupsion (2008-2013);
- Miratimi i Planit (shtesë) të Veprimit Antikorruspion për vitin 2012, mbi bazën e Rekomandimeve të Komisionit Evropian.

- Harmonizimi i Kodi Civil, Kodi Tregtar dhe Kodi Administrativ me Konventën (e Këshillit të Evropës) e Ligjit Civil për Korrupsionin;
- Qartësimi i rregullave për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike nëpërmjet ndryshimeve ligjore të propozuara;
- Qartësimi i rregullave për aksesin publik në informacion në linjë me standardet ndërkombëtare.
- Hartimi dhe miratimi i rregullores "Për funksionimin e strukturës operacionale të SHKB-së".
- Hartimi dhe miratimi i Udhëzimit të përbashkët me Prokurorinë e Përgjithshme "Për masat e veçanta për mbledhjen e të dhënave dhe përdorimin e teknikave të posaçme të hetimit në rastet e korrupsionit nga punonjësit e Policisë së Shtetit".
- Parashikimin e instrumenteve ligjore per goditjen e aktit të nxjerrë në kushtet e konfliktit të interesave dhe legjitimimin e ILDKP si palë në gjykim;
- Forcimi i masave ndëshkuese për situatat e konfliktit të interesave;
- Forcimin e kufizimeve të interesave private të të zgjedhurve të qeverisjes vendore;
- Forcimi i kapaciteteve dhe rritja e rolit të Autoriteteve Pergjegjese për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, etj.
- Përfshirja në rrethin e subjekteve deklarues të drejtuesve të sektorit të shëndetësisë, arsimit apo institucione të tjera të rëndësishme në nivel qarku sisubjekti "Deklarimit me kërkesë" tëpërfshihet "bashkëjetuesi";
- Vendosjen para përgjegjësisë ligjore të familjarëve të zyrtarëve për rastet e "refuzimit për deklarim" ose të "fshehjes së pasurisë";
- Forcimi i masave ndëshkuese administrative për rastet e shkeljes së procesit të deklarimit dhe afateve ligjore nga ana e subjekteve deklarues dhe personave të lidhur.
- Ngritjen e një sektori të posaçëm në ILDKP, me kompetencat e oficerit të policisë gjyqësore për kryerjen e hetimeve paraprake penale të rasteve të fshehjes së pasurisë, deklarimit të rremë, apo rasteve të konfliktit të interesave që përbëjnë elementë e një vepre penale (përfitimi i paligjshëm, shkelja e barazisë në tendera, etj).

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Parandalimit, luftës kundër korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013;
- Zbatimi, ndjekja dhe vlerësimi istrategjisë dhe planeve të veprimit 2012-2013 / Planit të veprimit për zbatim të Rekomandimit nr. 8 "Të luftës kundër korrupsionit" duhet të përfshijë shoqërinë civile, më së pari OJF-të që janë aktive në fushat e anti-korrupsionit dhe qeverisjes së mirë. Për këtë qëllim, duhet te garantohet mbështetje e duhur aktorëve të shoqërisë civile;
- Adresimi i transparencës në financimin e partive politike duke bërë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe nënligjore;
- Zbatimi i rekomandimeve të bëra në Raportin e 3 të vlerësimit të Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit (e Këshillit të Evropës) dhe përgatitja për Raundin e 4 të vlerësimit;
- Marrja e masave për përmirësimin e sistemit të inspektimeve administrative, për të siguruar integritet dhe transparencë në praktikën administrative, qoftë në kuadrin ligjor ashtu dhe atë organizativ;

- Zhvillimi i metejshem i sistemit te prokurimit publik;
- Krijimin e nje sistemi te konsoliduar te dhenash ne lidhje me regjistrimin e hetimeve, ndjekjese penale dhe dënimeve;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale për hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit;
- Zbatimi i legjislacionit për parandalimin e korrupsionit, duke u mbështetur siç duhet në bashkërendimin ndër-institucional;
- Forcimi i mekanizmave e zbatimit të Ligjit për deklarimin e pasurive nëpërmjet ndryshimeve ligjore të propozuara;
- Adresimi i çështjes se imunitetit te zyrtareve te larte;
- Për parandalimin e korrupsionit, të vazhdohet organizimi i programeve të trajnimit për zyrtaret përkatës për cështje të etikës, integritetit, shmangies se konfliktit të interesave.
- Zbatimi i detyrimeve të Planit shtesë për vitin 2012, në zbatim të Strategjisë Antikorrupsion 2008-2013.
- Rritja e numrit të regjistrimeve të procedimeve penale në Prokurori për veprat penale të korrupsionit dhe numrit të hetimeve proaktive në këtë fushë.
- Kryerja e analizave të përbashkëta me Prokurorinë për hetimin e rasteve të korrupsionit.
- Përdorimi sa më efektiv i teknikave speciale të hetimit për sigurimin e provave dhe goditjen e korrupsionit**.**
- Fuqizimi i kapaciteteve të hetimit të korrupsionit nëpërmjet trajnimeve të oficerëve të policisë nga Departamenti për Trajnimin Policor, në kuadër të projektit PACA, nga projekti i Binjakëzimit AL-2009-IB-JH-03 "Mbështetje për Strukturat e Hetimit të Pastrimit të Parave dhe Krimit Financiar në Shqipëri".
- Rritja e bashkëpunimit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit midis Policisë dhe Prokurorisë, SHISH, SHIU, ILDKP dhe DPPPP dhe transmetimi i shpejtë i informacionit, për rastet e veprave penale të korrupsionit Drejtorisë Kundër Krimit Financiar.
- Hartimi i statistikave periodike të korrupsionit së bashku me fazat e ecurisë së hetimeve për korrupsion të rakorduara me Prokurorinë**.**
- Konsolidimi i hetimit dhe efiçencës së ndjekjes penale, ndaj veprimtarisë korruptive që kryhet nga punonjësit e policisë.
- Forcimin e kapaciteteve dhe burimeve për përdorimin e teknikave të posacme të hetimit.
- Zbatimin e sistemeve të matjes së performancës dhe të vlerësimit të strukturave të Policisë së Shtetit.
- Hartimi dhe miratimi i kalendarit vjetor të inspektimeve të Drejtorisë së Inspektimeve të SHKB-së, në strukturat e Policisë së Shtetit.
- Kontrolli i zbatimit të rekomandimeve që janë lënë në raportet e inspektimeve të kryera në strukturat e Policisë së Shtetit, gjatë vitit 2011.
- Trajnimi i personelit të trupës operacionale SHKB-së.
- Trajnimi i personelit inspektues të SHKB-së mbi standartet dhe procedurat e punës gjatë inspektimeve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, trajnimi i avancuar.
- Përmirësimi i kapaciteteve operacionale të ILDKP. Amendimi i ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive."dhe ligjit nr.9367, dt.7.4.2005 "Për parandalim të konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike";

- Rritja e bashkëpunimittë ILDKP me institucionet e tjeradheagjencitë e zbatimit të ligjit në funksion në efektivitetit në verifikimet e deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave;
- Përmirësimi i shkëmbimit të të dhënave me institucionet kryesore, me qëllim marrjen e shpejtë të informacionit dhe akses të drejtpërdrejtë në të dhënat;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit midis ILDKP dhe ZQRPP, DPSHTRR, ALUIZNI.

Masat legjislative afatmesme

- Hartimi i Strategjisë së re Antikorrupsion.
- Hartimi i një Urdhri të Ministrit të Brendshëm "Për krijimin e një rrjeti të brendshëm ndërlidhjeje të agjentëve operacionalë të SHKB-së".
- Hartimi i një Urdhri të Ministrit të Brendshëm"Për lejimin e informatizimit tërësor të informacioneve që disponohen nga ky shërbim".
- Hartimi dhe miratimi i Urdhrit të Ministrit të Brendshëm "Për ngritjen e grupit të përbashkët të punës Polici e Shtetit, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm dhe misioneve partnere".
- Përgatitja dhe dërgimi për miratim i projektligjit "Kodi i Etikës së Policisë së Shtetit".

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Parandalimi, transparenca, gjithëpërfshirja dhe edukimi:
  - Forcimi i sistemit politik dhe i etikes se funksionimit publik
  - Modernizimi e konsolidimi i procedurave
  - Reformat sektoriale (kontrolli, klima e biznesit, shërbimi civil, prokurimi publik, arsimi, shëndetësia, financat, drejtësia, pushteti vendor, etj.)
  - Konsolidimi i transparencës dhe integritetit në administratën publike
  - Përafrimi i legjislacionit ne fushën e luftës kundër korrupsionit
  - Fushatat informuese dhe masa edukuese te qëndrueshme
- Hetimi dhe dënimi i korrupsionit:
  - Sigurimi i eficences se ndjekjes penale, rritja e shpejtësisë se ndjekjes penale dhe gjykimit
  - Rritja e integritetit dhe rezistencës ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë
  - Forcimi i mjeteve administrative ne luftën kundër korrupsionit
  - Pjesëmarrja e publikut ne denoncimin e korrupsionit
- Konsolidimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit te brendshëm dhe ndërkombëtar:
  - Konsolidimi i mekanizmave ne bashkëpunimin ndërmjet agjencive te zbatimit te ligjit
  - Konsolidimi i mekanizmave te qëndrueshëm për shkëmbimin periodik te informacionit
  - Zbatimi i efektshëm i instrumenteve antikorrupsion rajonale e ndërkombëtare.
- Zbatimi i Planit të Veprimit 3 vjeçar të Strategjisë Antikorrupsion 2008-2013.
- Rritja e numrit të hetimeve proaktive për veprat penale të korrupsionit.
- Kryerja e analizave të përbashkëta me Prokurorinë për hetimin e rasteve të korrupsionit.

- Përdorimi sa më efektiv i teknikave speciale të hetimit, për grumbullimin e provave dhe paraqitjen e tyre në gjykatë, për goditjen e korrupsionit.
- Fuqizimi i kapaciteteve të hetimit të korrupsionit nëpërmjet trajnimeve të oficerëve të policisë nga Departamenti për Trajnimin Policor, PAMECA, Projekti i Binjakëzimit AL-2009-IB-JH-03 "Mbështetje për Strukturat e Hetimit të Pastrimit të Parave dhe Krimit Financiar në Shqipëri".
- Rritja e bashkëpunimit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit midis Policisë dhe Prokurorisë, SHISH, SHIU, ILDKP dhe DPPPP për veprat penale të korrupsionit.
- Hartimi i statistikave periodike të korrupsionit së bashku me fazat e ecurisë së hetimeve për korrupsion të rakorduara me Prokurorinë.
- Të përmirësohet dukshëm infrastruktura logjistike e këtij shërbimi.
- Të rritet përdorimi i mjeteve speciale të hetimit, interceptimi i telekomunikimeve dhe përdorimi i informacionit të inteligjencës.
- Ndërrmarja e iniciativës për përqasjen e Kodit të Etikës së Policisë me Kodin Evropian të Etikës Policore.
- Krijimin e një rrjeti të brendshëm për ndërlidhjen e agjentëve operacionale të SHKB-së.
- Zhvillimi i kapaciteteve të grumbullimit dhe analizimit të informacionit nga njësitë e analizës së këtij shërbimi.
- Sensibilizimi i punonjësve të policisë, pasurimi i materialeve të përgjithshme arsimore, lidhur me temën e korrupsionit.
- Krijimin e temave dhe dhënie leksionesh punonjësve të policisë, në qendrat e trajnimit, për fushën e parandalimit të korrupsionit.
- Forcimi dhe përmirësimi i kapaciteteve të ILDKP;
- Kryerja e verifikimeve në terren të pasurive dhe interesave private të zyrtarëve dhe jashtë vendit npm bashkëpunimit me zyrat homologe, nëpërmjet:
  - Krijimit të praktikave të investigimit në terren të pasurive të paluajtshme, për të cilat ka të dhëna nga burime të ligjshme për fshehje pasurie apo për deklarim të rremë;
  - Forcimi i mekanizmave investigues në funksion të një kontrolli të thelluar e transparent;
  - Përfshirja e ekspeteve të pavarur vlerësues në procedurat e hetimit administrativ*;*
  - Thirrja e ekspertëve të pavarur, të liçencuar, të fushave të ndryshme, për të bërë rivlerësimin e pasurive ndihmon në mbledhjen e provave bindëse në funksion të hetimit të kryer nga ILDKP;
  - Përmirësimi i cilësisë së kontrollit duke kryer një hetim të plotë e të gjithëanshëm.
  - Trajnime të stafit të ILDKP dhe vizita studimore për marrjen e praktikave më të mira të hetimit administrativ;
  - Përqasja e legjislacionit dhe praktikës vendase me praktikën e institucioneve të tjera ndërkombëtare.
  - Organizimi i aktiviteteve, pjesëmarrjen në seminare/ëorkshop,
  - Për stafin Inspektor dheNd/Inspektor i Lartë me qëllim njohjen me praktikat e ndjekura nga institucionet homologe në hetimin pasurive të fshehura apo të padeklaruara si dhe në parandalimin e konfliktit të interesave
- Ndërgjegjësimi i shoqërisë civile dhe qytetareve mbi çështjet e denoncimit të rasteve të deklarimit të pasurive apo konfliktit të interesave, nëpërmjet:

    - Takimeve dhe tryezave rrumbullake me median dhe shoqërinë civilë, për një rol më aktiv të tyre në drejtim të goditjes së akteve korruptive;
    - Leksioneve periodike me student të universiteteve publike dhe private të drejtësisë dhe ekonomisë;
    - Konfliktit të interesave dhe korrupsionit në rradhët e administratës publike;
    - Spoteve publicitare në televizione dhe media të shkruar, ku prezantohet vazhdimisht numri free i ILDKP 0800 9999 për rastet e denoncimit dhe format e ndryshme të mundësive të komunikimit të publikut me ILDKP;
- Rritja e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë të ILDKP me institucionet qendrore dhe vendore në kuadër të parandalimit të konfliktit të interesave;
- Hartimi i Manualit Nr.5, Mbi Detyrat dhe Përgjegjësitë e Autoriteteve Përgjegjëse për Parandalimin e Konfliktit të Interesave;
- Trajnimi vazhdueshëm me të gjithë autoritetet përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, prezantimimanualit;
- Zhvillimi i projektit të konsulencës, si fazë e parë, për "Sistemin Online të Deklarimit të Interesave Private".

3.23.3. TË DREJTAT THEMELORE

Objektivi strategjik

Ndërmarrja e mëtejshme e reformave tërësore institucionale dhe ligjore do të synojnë garantimin në nivele gjithnjë e më të larta të të drejtave dhe lirive themelore të individit e në veçanti të të drejtave të minoriteteve. Kështu, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, Qeveria shqiptare është e angazhuar në ndërmarrjen e të gjitha reformave të nevojshme që do të shërbejnë për trajtimin në mënyrë sa më humane të personave me liri të kufizuar, zbatimin e ligjit në vendin e vuajtjes së dënimit, rehabilitimin dhe integrimin e të dënuarve në shoqëri dhe krijimin e një sistemi të sigurt dhe efikas për të gjithë shoqërinë.

Legjislacioni shqiptar në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ka përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore një sërë dispozitash që kanë të bëjnë me trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve, si dhe kompetencat dhe detyrat e organeve shtetërore kompetente, me qëllim respektimin e dinjitetit të dënuarve dhe të paraburgosurve, trajtimin e tyre pa njëanshmëri apo diskriminim për shkak te seksit, kombësisë, racës, gjendjes ekonomike dhe shoqërore, pikëpamjeve politike dhe besimit fetar, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurisë në të cilën mbahen dhe trajtohen të burgosurit dhe të paraburgosurit si dhe zhvillimin e programeve të rehabilitimit social dhe veprimtarive prodhuese për të burgosurit.

Gjithashtu, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në muajin qershor 2009 në Shqipëri, ka filluar të funksionojë Institucioni i Shërbimit të Provës. Misioni i këtij institucioni është të mbikqyrë dhe mbështesë zbatimin e dënimeve alternative me qëllim mbrojtjen e interesave publike, parandalimin e kryerjes së veprave penale, asistimin e personit të dënuar për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dënimi alternativ, asistimin e personit të dënuar për kapërcimin e vështirësive për riintegrimin e tij shoqëror, uljen e recitivizmit si dhe rritjen e sigurisë në komunitet.

Në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave themelore të njeriut, Qeveria shqiptare është e angazhuar në garantimin e lirisë së shprehjes, si gur themeltar në konceptimin dhe funksionimin e shoqërive demokratike. Garantimi i lirisë së shprehjes nuk mund të kuptohet e ndarë nga garantimi i një sërë lirish dhe të drejtash të tjera të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si: liria e shtypit, radios dhe televizionit (neni 22, pika 2).

Qeveria shqiptare është plotësisht e angazhuar që politikat sociale të orientohen drejt respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013), duke siguruar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet forcimit të kapaciteteve administrative të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rritjen e ndërgjegjësimit për ligjin 'Për mbrojtjen nga diskriminimi' dhe institucionin e Komisionerit, forcimin e bashkëpunimit me institucionet publike, shoqërinë civile dhe homologë ndërkombëtarë si dhe Përmirësimit të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe zbatimit efektiv të tij.

Objektivi strategjik i Qeverisë Shqiptare për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje është "a*ngazhimi për promovimin e parimeve të barazisë gjinore, si dhe forcimin e instrumentave ligjorë dhe institucionalë mbrojtës për të siguruar politikat gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes..... Parandalimi i dhunës në familje, mbrotja e viktimave dhe aksesi i tyre në skemat e mbrotjes ligjore dhe psikosociale në bashkëpunim të ngushtë me median dhe shoqërinë civile për të garantuar dhe mbrojtur dinjitetin e gruas duke i kushtuar nje rendesi te veçante fëmijëve dhe personave të moshuar".* Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet forcimit të Mekanizmit Institucional dhe Ligjor për Barazinë Gjinore, rritjes së Pjesëmarrjes së Grave në Vendim-marrje, fuqizimit ekonomik të vajzave dhe grave, zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në Familje.

Për më tepër, Qeveria shqiptare synon mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve, nëpërmjet forcimit të strukturave institucionale të krijuara për të monitoruar dhe raportuar mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar e rajonal, nxitjes për hartimin e reformës legjislative dhe politikave gjithëpërshirëse, të koordinuara e harmonizuara, mbrojtjes dhe përfshirjes sociale të fëmijëve.

Qeveria shqiptare angazhohet për të zbatuar dhe arritur standardet më të larta të respektimit dhe realizimit të të drejtave të minoriteteve kombëtare që jetojnë në Shqipëri. Të gjitha iniciativat dhe masat që do të ndërmerren do të synojnë zbatimin dhe përputhshmërinë e plotë me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës "Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare", të ratifikuara nga Shqipëria. Kështu, fokusi kryesor i qeverisë në fushën e mbrojtjes së minoritetit rom, është zbatimi i Strategjisë Kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom", duke luftuar përjashtimin social dhe diskriminimin, bazuar në instrumentet ndërkombëtare në këtë fushë si dhe kuadrin ligjor të brendshëm dhe objektivat kryesore të programit te Qeverisë në fushën e mbrojtjes së minoriteteve.

Në kuadër të respektimit dhe garantimit të të drejtave të pronës, Qeveria shqiptare është angazhuar për të plotësuar dhe konsoliduar sistemin e të drejtave të pronësisë në tërësi, të pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme në veçanti, ku toka bujqësore zë një komponente me rëndësi. Konsolidimi i së drejtës së pronësisë dhe garantimi i saj lidhet ngushte me konsolidimin e shtetit demokratik në tërësi. Reforma e tokës (transformimi i të drejtës së pronësisë), garantimi i titujve të ligjshëm të pronësisë është një premisë e zhvillimit të tregut të tokës. Dinamizmi i tregut të tokës kondicionohet jo vetëm nga transaksionet ndërmjet shtetasve shqiptare, por edhe të këtyre te fundit me shtetas të vendeve Anëtare të Bashkimit Europian. Rregullimi i legjislacionit për t'iu siguruar trajtim të njëjtë shtetasve të BE-së është parashikuar si objekt i neneve 50 dhe 61 të MSA-së. Gjithashtu, Qeveria shqiptare është e angazhuar të përshpejtojë ritmet e proçesit të regjistrimit fillestar të pasurisë së paluajtshme, në zonat rurale dhe urbane, në një kohë sa më të shpejtë.

Një objektiv tjetër kryesor i Qeverisë shqiptare në fushën e kthimit dhe kompensimit të pronës është përmbyllja me sukses dhe me shpejtësi e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave ish pronarëve të cilëve i është mohuar kjo e drejtë sipas akteve ligjore, nënligjore, vendimeve penale te gjykatave ose te marre me çdo mënyrë tjetër te padrejte nga shteti nga data 29.11.1944. Në këtë mënyrë synohet një rregullim i drejte, sipas kritereve te nenit 41 te Kushtetutës, te çështjeve te se drejtës se pronësisë qe kane lindur nga shpronësimet, shtetëzimet ose konfiskimet.
Qeveria shqiptare është e angazhuar në përmbushjen me sukses e të drejtës së kompensimit subjekteve të shpronësuara prona e të cilëve është njohur për kompensim me vendim. Kjo përmbushje do të realizohet sipas formave të përcaktuara në nenin 11, të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës, i ndryshuar.
Në të vërtetë, zgjidhja e çështjeve të pronës do të jetë një garanci për vënien në vend të padrejtësive të së kaluarës, duke respektuar këtë të drejtë për çdo individ dhe familje shqiptare.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Në kuadër të garantimit të të drejtave themelore të njeriut, Qeveria shqiptare është ë angazhuar në realizimin e të gjitha objektivave të ndërmarra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, lidhur me *përmirësimin e sistemeve të paragurgimit dhe burgimit*, përmirësimin e standardeve të përgjithshme dhe regjimeve humanitare e bashkëkohore të trajtimit të personave me liri të kufizuar, duke garantuar që dënimi me heqje lirie të zbatohet në mënyrë të paanshme, pa diskriminim për arsye mendimi politik, feje, race, ngjyre, seksi, niveli ekonomik, etj. Gjithashtu, Qeveria shqiptare është e angazhuar në përmbushjen e objektivave strategjik lidhur me parandalimin e torturave dhe keqtrajtimit, garantimin e të drejtës së shprehjes dhe lirisë së medias, antidiskriminit, barazisë ligjore, mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, mbrojtjes së minoriteteve, mbrojtjes së të dhënave personale si dhe respektimit dhe garatimit të të drejtave të pronësisë.
Kështu, lidhur me përmirësimin e standardeve të përgjithshme dhe regjimeve humanitare e bashkëkohore të trajtimit të personave me liri të kufizuar, sistemi i institucioneve të vuajtjes së dënimit, është një nga organizmat ku reformat demokratike kanë sjellë një ndryshim

tërësor. Në vendin tonë ndodhen 19 burgje dhe paraburgime, 1 Spital Burgu dhe 1 Institut për të Miturit në qytetin e Kavajës. Kushtet e përgjithshme të burgjeve në Shqipëri, veçanërisht gjatë viteve të fundit, kanë pësuar ndryshime pozitive, duke ndikuar në përmirësimin e jetës së personave që mbahen në burgje dhe paraburgime, por në të njëjtën kohë dhe sigurinë e gjithë sistemit. Ndryshimet kanë ardhur paralelisht me ndryshimet konceptuale, logjistike, financiare dhe infrastrukturore. Aspekt themelor në zbatimin e ligjshmërisë dhe përmirësimin e kushteve të burgjeve në Shqipëri, është monitorimi i gjithë sistemit nëpërmjet treguesve të realizimit të perfomancës, ku janë vendosur objektiva strategjikë dhe është vendosur një vizioni i qartë, ecuria e të cilave monitorohen në mënyrë të pavarur dhe transparente nga institucione publike vendase dhe ndërkombëtare, si dhe shoqëria civile.

Sipas të dhënave statistikore të muajve të parë të vitit 2012, në 21 institucionet penale në vend, janë trajtuar mesatarisht 4696 të dënuar dhe paraburgosur, prej të cilëve 4484 burra, 85 gra dhe 127 të mitur. Shifra e mbipopullimit ka qenë 279 persona mbi kapacitetet akomoduese të burgjeve. Krahasuar me vitet e mëparshme, ky është numri më i ulët, sa i takon nivelit të mbipopullimit. Ky fenomen ka sjell pasoja pozitive në drejtim të rritjes së kohës së ajrimit, kohës së takimit me të afërmit, të trajtimit individual të paraburgosurve nga ana e punonjësve të kujdesit social, ligjor etj. Gjithashtu, element i rëndësishëm që lidhet me uljen e mbipopullimit është dhe zbatimi i parimit rajonal, që do të thotë të dënuarit dhe paraburgosurit të vendosen në institucione sa më afër vendbanimit të tyre, duke stimuluar në këtë mënyrë forcimin e kontakteve dhe lidhjeve me familjarët dhe të afërmit.

Lidhur me *parandalimin e torturave dhe keqtrajtimit*, pranë Avokatit të Popullit është ngritur Njësia për Parandalimin e Tortures, me nje rezolute të veçantë të Kuvendit të Shqipersisë, nëpërmjet të cilës këtij institucioni i jepej atributi i Mekanizmit Kombetar te Parandalimit te Tortrures si pjese e venies ne zbatim te Protokollit Opsional te Konventes se OKB "Per Parandalimin e Tortures", ratifikuar nga Kuvendi në vitin 2003. Roli i kesaj strukture eshte të kryeje vizita te vazhdueshme ne te gjitha vendet ku liria e personit eshte e kufizuar dhe te jape rekomandime per permiresimin e trajtimit te tyre. Krahas kesaj, Njesia ka si detyrim propozimin e ndryshimeve ligjore dhe nenligjore kur veren se ka premise per torture, trajtim çnjerezor dhe degradues. Njesia kryen cdo vit rreth 150 vizita ne vendet e privimit te lirise, vizita qe perballohen nga buxheti i Avokatit te Popullit.

Lidhur me *garantimin e respektimit të parimit të pluralizmit, paanshmërisë, barazizë dhe konkurencën së ndershme për të mënjanuar monopolizimin e fushës së medias*, KKRT është përpjekur që të minimizojë vetëkontrollin dhe shtrëngimin arbitrar në proçesin e përhapjes së informacionit.
Mjedisi audiovizual në Shqipëri është mjaft i pasur (numërohen rreth 69 radio, 70 televizione analoge, 96 kabllore, 4 rrjete satelitore). Megjithatë, me gjithë ndryshimet që ka pësuar kuadri ligjor, konsiderohet i pamjaftueshëm për të rregulluar sektorin e mediave audiovizive dhe, në mënyrë të veçantë, për të garantuar suksesin e kalimit në numerik në Shqipëri. Procesi i dixhitalizimit në Shqipëri, i cili duhet të realizohet ashtu sikundër edhe vendet e tjera të rajonit, jo vetëm si përmbushje e detyrimeve ndërkombëtare por edhe si nevojë e zhvillimeve të medias, është një nga arsyet kryesore që ka sjellë nevojën për një kuadër të ri ligjor mbi shërbimet audiovizive.

Kalimi në procesin e dixhitalizmit kërkon një kuadër të ri ligjor që t'i përshtatet ndryshimeve teknologjike dhe, në të njëjtën kohë, të jetë i harmonizuar me legjislacionin Evropian, veçanërisht, me detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja. Për këtë arsye, janë duke u hartuar dy dokumente bazë: (1) Strategjia e kalimit nga transmetimet analoge në dixhitale, dhe (2) Projektligji "Për transmetimet me zë dhe figurë në Republikën e Shqipërisë".

Zbatimi dhe respektimi i parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare, filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore,shtatzëninë, përkatësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë ose me çdo shkak tjetër, që nga vitit 2010 garantohet nga Komisionerit për Mrojtjen nga Diskriminimi është konsideruar si një arritje për Shqipërinë në aspektin e politikave anti-diskriminim. Në Raportin Analitik 2010 miratimi i ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe emërimi i Komisionerit për Mrojtjen nga Diskriminimi është konsideruar si një arritje për Shqipërinë në aspektin e politikave anti-diskriminim.

Në zbatim të Programit të Qeverisë, zbatimit të legjislacionit shqiptar dhe specifikisht të Ligjit Nr. 9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" dhe Ligjit Nr. 9669 datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, dhe të Ligjit Nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2007-2010, miratimit dhe zbatimit të Strategjisë së re , konstatohet se situata de facto e barazisë gjinore dhe lufta kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje ka pësuar ndryshime pozitive.

Përmbushja e objektivave të kësaj Strategjie ka bërë të mundur përfshirjen e çështjeve gjinore në të gjitha nivelet duke siguruar ngritjen e kapaciteteve, fuqizimin e gruas nëpërmjet politikave dhe programeve për nxitjen e punësimit; ndërgjegjësimin e opinionit publik mbi çështjet gjinore dhe dhunës ndaj gruas; plotësimin e kuadrit nënligjor për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje. Rekomandimet e dhëna nga Komiteti Për Eleminimin e Diskriminimit ndaj Grave janë bërë pjesë e politikave dhe programeve për zbatim të cilat synojnë eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave dhe avancimin e barazisë gjinore.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme *në fushën e të drejtave të fëmijëve* është miratimi i ligjit Nr.10347 datë 04.11.2010, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve". Ligji përcakton të drejtat e fëmijëve në koherencë me Konventën e OKB për të Drejtat e Fëmijës si dhe mekanizmat zbatues e monitorues. Ligji përcakton në mënyrë të qartë përgjegjësitë e pushtetit qendror e vendor, kërkon ngritjen e institucioneve përgjegjëse, dhe synon të përçojë frymën e bashkëpunimit ndërmejt të gjithë aktorëve në nivel qendror dhe vendor.

Aktualisht ka përfunduar ngritja e mekanizmave në nivel qendror (Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtat e Fëmijëve). Në nivel vendor janë ngritur 28 Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel bashki/komuna (16 bashki dhe 12 komuna) dhe 9 Njësi për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në nivel qarku.

Eshtë duke vazhduar puna për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit. Ndryshimet e reja në kuadrin legjislativ do të pasqyrohen dhe mbështeten edhe në Planin e ri të Veprimit për Fëmijët 2012 – 2015, një dokument strategjik ndërinstitucional i cili është miratuar me VKM nr 39/2012. Në këtë Plan Veprimi për Fëmijët, janë përshkruar objektivat dhe masat që do të ndërmerren për të realizuar: të drejtën e fëmijëve për mbrojtje dhe përfshirje sociale; të drejtën për arsim cilësor; të drejtën për kujdes shëndetësor; të drejtën për mbrojtje nga dhuna dhe shfrytëzimi ekonomik; të drejtën për mbrojtje ligjore.

Shqipëria ka pasur dhe vazhdon të ketë një angazhim të përhershëm, përsa i përket përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pjesë përbërëse e të cilave janë dhe *të drejtat e minoriteteve*. Këtë fakt e ka dëshmuar gjithashtu anëtarësimi i vendit tonë në organizatat ndërkombëtare, si Organizata e Kombeve të Bashkuara Këshilli i Evropës, OSBE, etj, si dhe ratifikimi apo aderimi në një sërë konventash ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe në mënyrë të veçantë, në ratifikimin pa asnjë rezervë të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës "Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare".

Gjithashtu, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të minoriteve, Sektori i Kulturës së Minoriteteve dhe Diasporës i ngritur tashmë prej më se dy vjetësh në Ministrinë e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, ka si objektiv të ndikojë në krijimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të hapësirave ligjore dhe strategjive sektoriale në fushën e kulturës së diasporës dhe minoriteteve dhe përafrimin e tyre në përputhje me standardet i BE. Një ndër objektivat bazë të këtij sektori përgjatë viteve 2010- 2011, ishte dhe u kurorëzua me sukses krijimi i një databaze me të dhëna mbi forumet, shoqatat dhe individët më të spikatur në komunitetet e diasporës dhe minoriteteve dhe përvijimi i një klime të përshtatshme për lulëzimin e nismave individuale dhe grupimeve të ndryshme të diasporës dhe minoriteteve për jetësimin e ideve dhe projekteve kulturore që ndikojnë në evidentimin e vlerave kulturore dhe kombëtare të shqiptarëve që jetojnë në vendet e huaja dhe pakicave të kombësive të huaja që jetojnë në vendin tonë.

Në kuadër të garantimit të të drejtave të pronësisë, politika e ZRPP konsiston në ofrimin e një shërbimi të shpejtë ndaj qytetarëve dhe institucioneve shqiptare në lidhje me regjistrimin e të drejtave mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në të gjithë territorin e Shqipërisë, si dhe për dhënien e informacionit mbi këto pasuri, nëpërmjet një sistemi regjistrimi të pasurive të paluajtshme efikas, bashkëkohor, që siguron informacion të qartë, të saktë, të përditësuar, të sigurt, transparent mbi te gjitha pasuritë e paluajtshme në Shqipëri. Qëllimi kryesor i Politikës së Institucionit konsiston në garantimin e titujve të pronësisë mbi të gjithë pasuritë e paluajtshme në të gjithë Shqipërinë si pjesë përbërëse e angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Po kështu, me qëllim realizimin e objektivit politik në fushën e kthimit dhe kompensimit të pronës, është krijuar Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Republikën e Shqipërisë, si person juridik publik, me qendër në Tiranë, në varësi të Ministrit të Drejtësisë. **A**KKP-ja përmbush objektivat, kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar i cili aktualisht është në proces rishikimi në lidhje me shtyrjen e afatit

për trajtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuar, për njohjen kthimin apo kompensimin e pronës. Kjo masë e nevojshme u ndërmor për shkak të mjaft kërksave të depozituara të cilat ende nuk janë trajtuar me një vendim përfundimtar.

Lidhur me mbrojtën e të dhënave personale, KMDP synon minimizimin e shkeljeve, trajtimin e ankesave dhe sqarimin e subjekteve të të dhënave, nëpërmjet zbatimit të planit të kontrolleve të planifikuara sipas fushave, inspektimeve pa njoftim në raste të kufizuara më qëllim verifikimin, si dhe në rastet e disa ankesave dhe informacionit të dhënë nga Drejtoritë e brendshme të institucionit, pranë të cilëve kontrolluesit kanë detyrimin të njftojnë mbi punën e tyre lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/ nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe paraburgosurve", i ndryshuar**.** Një risi e këtij ligji ishte dhe krijimi i Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues dhe kompetencat e tij si një strukturë e veçantë e Avokatit të Popullit. Kjo strukture është ngritur në zbatim të "Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe dënimi tjetër çnjerëzor dhe degradues" (OPCAT) të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me anë të ligjit nr. 9094 dt. 03. 07. 2003;
- Ligji nr 10024, datë 27.11.2008 "Për Policinë e Burgjeve", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8410, datë, 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë" (Fletorja Zyrtare: Viti 1998, Nr 24; Data e botimit: 20-10-1998), i cili është ndryshuar me ligjet e mëposhtme:
- Ligji nr. 8655 datë, 31.07.2000, "Për disa Ndryshime në ligjin Nr. 8410, datë, 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë" (Fletore zyrtare: nr 24, datë 07.08. 2000,);
- Ligji nr. 8794, datë 10.05.2001, "Për disa Ndryshime në ligjin Nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar" (Fletore zyrtare: nr 34, datë 15.06.2001);
- Ligji nr. 9016, datë 20.02.2003, "Për disa Ndryshime në ligjin Nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar", (Fletore zyrtare: nr 18, datë 21.03. 2003);
- Ligji nr. 9124 datë 29.07.2003, "Për disa shtesa në Ligjin Nr. Nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar", (Fletore zyrtare: nr 71, datë 19.08.2003);
- Ligji nr. 9531, datë 11.5.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. Nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar", (Fletore zyrtare: nr. 65, datë 28.06.2006);
- Ligji nr. 9677, datë 13.01.2007, "Për disa Shtesa dhe Ndryshime në ligjin Nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar", (Fletore zyrtare: nr. 2, datë 14.01.2007);
- Ligji Nr. 9962, datë 21.07.2008, "Për një shtesë në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar" (Fletore zyrtare: nr. 125, datë 01.08.2008).

Ky ligj ka përafrim të pjesshëm me aktet kryesore të *acquis communautaire*, që rregullojnë fushën e medias dhe shërbimeve me zë dhe pamore, si më poshtë:

- Direktiva 2002/19/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, dt. 7 Mars 2002, mbi aksesin në, dhe ndërlidhjen (interkoneksionin) e, rrjeteve të komunikimeve elektronike

dhe faciliteteve që lidhen me to (Direktiva e Aksesit), 32002L0019, Gazeta Zyrtare nr. 108, seria L e datës 24.4.2002, fq. 7–20;

- Direktiva 2002/20/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, dt. 7 Mars 2002, mbi autorizimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (Direktiva e Autorizimit), 32002L0020,Gazeta Zyrtare nr. 108,seria L e datës 24.4.2002, fq.21–32;
- Direktiva 2002/21/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, dt. 7 Mars 2002, mbi një kuadër të përbashkët rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva e Kuadrit), 32002L0021, Gazeta Zyrtare nr. 108, seria L e datës 24.4.2002, fq. 33–50;
- Direktiva 2002/22/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, dt. 7 Mars 2002, mbi shërbimin universal dhe të drejtave të përdoruesit lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva e Shërbimit Universal), 32002L0022, Gazeta Zyrtare nr. 108, seria L e datës 24.4.2002, fq. 51–77;
- Direktiva e Komisionit 2002/77/KE, dt. 16 Shtator 2002, mbi konkurrencën në tregjet e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, 32002L0077, Gazeta Zyrtare nr. 249, seria L e datës 17.9.2002, fq. 21-26
- Ligji nr. 9742 datë, 28.05.2007 "Për Transmetimet Numerike në Republikën e Shqipërisë". (Fletorja Zyrtare: Viti 2007, Nr. 74, DATE 20.06.2007). Ky ligj ka përafrim të pjesshëm me aktet komunitare të *aqcuis,* të përmendura më sipër për ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, të ndryshuar, si dhe me Direktivën 97/36/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 30 Qershor 1997, e cila ndryshon Direktivën e Këshillit 89/552/KEE "Mbi koordinimin e disa dispozitave të rregulluara me ligj, rregullore apo veprim administrativ në Shtetet Anëtare në lidhje me ndjekjen e aktiviteteve të transmetimit televiziv ("Direktiva e Televizionit pa Kufij), 31997L0036, Gazeta Zyrtare nr. 202, seria L e datës 30.7.1997, fq. 60–70)
- Ligjin nr. 8525, datë 9.9.1999 "Për Ratifikimin e Konventës Europiane për Televizionin Ndërkufitar**" (**Fletore zyrtare: Viti 1999, Nr 26, datë 18.10.1999)
- Ligji nr. 9335, datë 16.02.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin ndryshues të Konventës Europiane për Televizionin Ndërkufitar" **(**Fletore zyrtare: Viti 2004, Nr. 109, datë 12.01.2005)
- Ligjin nr. 9851, datë 26.12.2007, "Për ratifikimin e Akteve finale të konferencës rajonale të radiokomunikacioneve për planifikimin e shërbimit të transmetimit numerik tokësor në pjesë të rajoneve 1 dhe 3, në bandat e frekuencës 174-230 mhz dhe 470-862 mhz (rrc-06) dhe të akteve finale të konferencës rajonale të radiokomunikacioneve për rishikimin e marrëveshjes së Stokholmit, 1961 (rrc-06 rev. st 61). (Fletore zyrtare: nr 187, datë 24.01.2008).
- Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi', botuar në Fletoren Zyrtare nr.15, datë 25 shkurt 2010, fq. 482, përafruar plotësisht me:
    - Direktivën e Këshillit Europian 2004/43/KE e 29 qershorit 2000 për *"Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike";*
    - Direktivën e Këshillit Europian 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për *"Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës";*

- Direktivën e Këshillit Europian 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për *"Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime";*
- Direktivën e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Europian 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për *"Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës".*

Akte të tjera që nuk transpozojnë legjislacionin komunitar:

- Vendim nr 33, datë 22.04.2010 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi";
- Vendim nr. 34, datë 20.05.2010 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi", botuar në Fletoren Zyrtare nr.68, datë 1 qershor 2010, fq. 2581;
- Urdhri nr. 10 datë 21.12.2010, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së KMD";
- Urdhri nr. 11 datë 21.12.2010, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi " Për miratimin e Kodit të Etikës së Institucionit".
- Për plotësimin e standarteve mbi ushtrimin efektiv të së drejtës së punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre për mbrojtje dhe asistencë shprehur në Ligjin për të Huajt Nr.9959, dt.17.7.2008., në përputhje me Konventën CMË dhe Rezolutën 65/212, (pika h), sanksionohen dispozita mbi të drejtat e puntorëve të huaj, bazuar ne parimet e reciprocitetit dhe mosdiskriminimit, të cilat i ofrojnë puntorëve të huaj një trajtim jo më pak të favorshëm se ç'ju afrohet puntorëve shqiptarë.

Këto të drejta, sipas Ligjit për të Huajt Nr.9959, datë 17.7.2008., konsistojnë në:

- E drejta e trajtimit të barabartë me shtetasit shqiptarë, lidhur me kushtet e punës, përfshirë dispozitat mbi largimin nga puna dhe shpërblimet; kushtet e higjienës së punës, të sigurimit teknik, pjesëmarrje në formimin profesional, (kjo e fundit me kusht që ato të kenë të drejtën e qendrimit dhe të punësimit në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë më të gjatë se një vit) ;

  Kuadri ligjor i RSh dhe konkretisht neni 2 i Ligjit 9959, datë 17.07.2008 "Për të huajt", parashikon trajtim të barabartë në hyrjen, qendrimin dhe trajtimin e të gjithë punëtoreve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Standartet e trajtimit të këtyre subjekteve janë shprehimisht "në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga RSh, duke respektuar parimin e reciprocitetit, mosdiskriminimit dhe trajtimit jo më pak të favorshëm se shtetasit shqiptarë" ;
- Liria e organizimit dhe e anëtarësimit në një organizatë sindikaliste apo profesionale, që përfaqëson punëtorët, të vetëpunësuarit dhe punëdhënësit, përfshirë edhe përfitimet që lindin nga pjesëmarrja në këto organizata, (Neni 5, Pika 4) etj ;
- Respektimi i situatës aktuale dhe të pritshme të tregut vendas të punës, duke përcaktuar qartë, kriteret bazë për punësimin e shtetasve të huaj;

- Rritja në mënyrë të vazhdueshme e të drejtave të të huajve me kohën e qëndrimit dhe të punësimit të ligjshëm të tyre në Republikën e Shqipërisë ;
- Thjeshtëzimi i procedurave administrative të dhënies dhe të ripërtëritjes së lejeve të punës në nivel qendror dhe rajonal, duke rritur operativitetin, transparencën dhe nivelin e informimit publik për këto procedura ;
- Përcaktim i qartë i kategorive të ndryshme të puntorëve të huaj, lidhur me afatin kohor të punësimit të tyre, sanksionimin e të drejtave dhe të detyrimeve te tyre , apo trajtimin me kritere lehtësuese specifike, duke mos iu nënshtruar vlerësimit të situatës së tregut të punës ;
- Gjithashtu parashikimi në ligj i programeve të Integrimit Social të të Huajve në jetën dhe shoqërinë shqiptare krijojnë mundësi për trajtim të barabartë të të gjithë shtetasve të huaj, sipas standardeve, që zbatojnë shtetet-anëtare të BE-së.
  Sipas Ligjit për të Huajt, Neni 102, autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjit duhet të sigurojnë kushtet për integrim në jetën ekonomike, kulturore dhe shoqërore të të huajve, që kanë të drejtën e qendrimit në Republikën e Shqipërisë.
- Kodi i Punës Neni 9,10,32,39,75,76,97,98,108,109,134,72,115,55,104 -miratuar me Ligjin Nr. 7961 datë 12.7.1995,(ndryshuar me Ligjin Nr. 8085 datë 13.03.1996, Ligjin Nr. 9125 datë 29.7.2003, Ligjin Nr 10053, datë 29.12.2008.
  Përafruar me Direktivën Nr. 92/85/KE, "Mbi paraqitjen e masave për të inkurajuar përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë për punëtoret shtatëzëna dhe punëtoret të cilat sapo kanë lindur fëmijë ose që janë me fëmijë në gji" dhe Direktivën Nr. 75/117/KEE, "Mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me aplikimin e parimit të pagesës së barabartë për burrat dhe gratë" . (Shkalla e përafrimit e pjesshme)
- Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"
  Ligji është përafruar me Direktivën 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 5 Korrik 2006, "Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe të grave në fushën e punës dhe të punësismit"; Direktivën 2002/73/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 Shtatorit 2002, duke ndryshuar Direktivën 76/207/EEC mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë për sa i përket aksesit në punësim, trajnim dhe promovim profesional dhe kushtet e punës dhe Rekomandimi i Këshillit 96/694/EC i 2 Dhjetorit 1996 mbi pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në procesin e vendimmarrjes.
  (Shkalla e përputhshmërisë: e pjesshme)
- Ligji Nr.9690 , datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në mardhëniet familjare"
  Rekomandimi Nr. (2002)5 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për mbrojtjen e grave nga dhuna e adoptuar në 30 Prill 2002
  (Shkalla e përputhshmerise: E pjesshme)
- Ligji Nr.10221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi" i përafruar plotësisht me:
  - 32000L0043, Direktivën e Këshillit 2004/43/KE të 29 qershorit 2000 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike".

- 32000L0078, Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për "Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës".
- 32004L0113, Direktivën e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime".
- 32006L0054, Direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për "Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës".

- Ligji Nr.7703, date 11.05.1993 "Për Sigurimin Shoqëror në RSH", botuar në Fletoren Zyrtare Nr 7, Data e botimit: 12.06.1993, Faqe 401
  - Direktiva nr. 79/7/KEE, "Mbi zbatimin progresiv të parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e sigurimit shoqëror"
  - Direktiva nr. 86/378/KEE, "Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në skemat e sigurimit shoqëror në punë"
- Ligji Nr. 10237 datë 18.2. 2010 "Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë"
- Ligji Nr. 10347, datë 04.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës"
  Shkalla e përputhshmërisë së Ligjit "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" është e plotë me acquis communitare duke realizuar kështu transpozimin e plotë të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijës". Konkretisht në nene specifike të ligjit, duke filluar që në dispozitat hyrëse të tij e në vijim, kemi referime në Konventën e OKB-së " Për të Drejtat e Fëmijëve" përsa i takon përkufizimeve që janë përdorur në ligj, parimeve kryesore që duhet të udhëheqin zbatimin e dispotizave të këtij ligji si dhe të gjitha të drejtave dhe lirive të fëmijëve të cilat ndjekin të njëjtën rradhë listimi si në këtë Konventë.

- Ligji nr. 8876 datë 4.4.2002 "Për shëndetin riprodhues";
- Ligjin nr 9952, date 14.7 2008 Për parandalimin e HIV/AIDS në Republikën e Shqipërisë;
- Ligji "Për shërbimin Shëndetësor stomatologjik", datë 9.06/2008;
- Ligji nr 9942, 26/6/2008 "Për parandalimin e çrregullimeve nga pamjaftueshmëria jodike";
- Ligjit nr. 9669 "Për masa ndaj dhunës në marrdhëniet familjare".
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"
- "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" ;
- "Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë";
- Ligji nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", ndryshuar;
- Ligji nr. 8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH-së";
- Ligji nr. 9741, datë 21.5.2007 për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë , i ndryshuar;
- Ligji nr. 8239, datë 3.9.1997, Për një ndryshim në ligjin nr. 7756, datë 11.10.1993 "Për Shtypin";
- Ligji nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë";

- Ligji nr. 8454, datë 4.02.1999,"Për Avokatin e Popullit" i plotësuar me ligjin nr. 8600 datë 10.04.2000, (Fletore Zyrtare Nr. 9, Faqe 423) ndryshuar;
- Ligji nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike";
- Ligji nr. 8773, datë 23.04.2001 "Për tubimet";
- Ligji nr. 8291, datë 25.2.1998 "Kodi i Etikës së Policisë";
- Ligji nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit";
- Ligji nr. 9888, datë 10.03.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim";
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- Ligji nr. 10019, datë 29.12.2009, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë";
- Ligjit nr.10347, datë 4.11.2010 "Për të Drejtat e Fëmijës";
- Ligji nr.10295, datë 1.7.2010 "Për faljen";
- Ligji nr. 9235, datë 27.5.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës:, i ndryshuar;
- Ligji nr.9616 dt 27.09.2006, për "Librin në Republiken e Shqipërisë";
- Ligji nr.10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve"
- Ligji nr. 10221, datë 4.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi";
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" është hartuar në harmoni dhe është në një linjë me parimet e Direktivës së Parlamentit dhe Këshillit Evropian 95/46/EC të 1995 për "Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale dhe Qarkullimin e lirë të të Dhënave të tilla", Konventën nr. 108 të Këshillit të Evropës të datës 28.01.1981 "Për mbrojtjen e individëve nga Procedimi Automatik i të Dhënave Personale" ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 9288, datë 7.10.2004, si dhe Protokollin shtesë të saj "Për Mbrojtjen e individëve nga Procedimi Automatik i të Dhënëve Personale lidhur me autoritetet mbikëqyrëse dhe lëvizjen ndërkufitare të të dhënave personale", ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 9287, datë 7.10.2004 "Për ratifikimin e protokollit shtesë të Konventës";
- Ligji Nr. 7843, datë 13.07.1994, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi', botuar në Fletoren Zyrtare nr.15, datë 25 shkurt 2010, fq. 482, përafruar plotësisht me:
    - Direktivën e Këshillit Europian 2000/43/KE e 29 qershorit 2000 për *"Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike";*
    - Direktivën e Këshillit Europian 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për *"Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës";*
    - Direktivën e Këshillit Europian 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për *"Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime";*
    - Direktivën e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Europian 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për *"Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës".*
- Kuadri ligjor për arsimimin e minoriteteve është plotësuar edhe me një sërë aktesh nënligjore dhe udhëzime të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të cilët garantojnë dhe sigurojnë mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave arsimore të minoriteteve kombëtare;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 22. 08. 1994 "Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Minoriteteve";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 5.8.1996 "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 22.08.1994 "Për Arsimin 8-Vjeçar në Gjuhën Amtare të Personave të Minoriteteve";
- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004 – 2015, të miratuar me V.K.M nr. 538, datë 12.08.2004 dhe Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë (2008-2013);
- Udhëzimi nr. 14, datë 03.09.1994 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;
- V.K.M nr. 404, datë 01.07.1998 mbi funksionimin e Shkollës private 9-vjeçare dhe e mesme, "Arsakeio" në Tiranë;
- V.K.M nr. 868, datë 30.09.2004 "Për funksionimin e Institucionit Arsimor Jopublik parauniversitar për shkollën 9-vjeçare "Omiros";
- V.K.M nr. 266, datë 05.05.2006, Për hapjen e Institucionit arsimor privat parauniversitar, shkolla 9 vjeçare "Omiros", në qytetin e Himarës;
- Në zbatim të VKM-së nr.759, datë 15.9.2010, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në kërkesat e DAR/ZA-ve, ka hartuar planin e shpërndarjes së bursave dhe brenda kuotave të miratuara, ka rekomanduar bashkitë dhe komunat për tu dhënë prioritet nxënësve dhe studentëve që i përkasin komunitetit rom;
- VKM nr. 672, datë 14.9.2011 "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i dytë i studimeve "Master profesional" për vitin akademik 2011-2012";
- V.K.M nr. 633, datë 18.09.2003 për miratimin e Strategjisë Kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom";
- V.K.M nr. 127, datë 11.03.2004 "Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet";
- Strategjinë Kombëtare Për Fëmijët, miratuar me VKM nr. 368, datë 31.05.2005;
- VKM nr. 508, datë 8.08.2007 "Për një ndryshim dhe shtesë në VKM nr. 632, datë 18.09.2003 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë, femra";
- VKM nr. 437, datë 8.04.2008 "Për anëtarësimin e Këshillit të Ministrave të RSH-së në Deklaratën "Dekada e Romëve";
- VKM nr. 366, datë 15.04.2009 Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtresave në nevojë;
- VKM nr. 1087 datë 28 .10.2009 "Për miratimin e Planit Kombëtar të veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2005-2015".
- "Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 201, dt 16.03.2011 "Për miratimin e rregullores të funksionimit të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijes";
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.346, dt 29.04.2011"Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Agjensisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës;
- Vendim nr 33, datë 22.04.2010 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi".
- Vendim nr. 34, datë 20.05.2010 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi", botuar në Fletoren Zyrtare nr.68, datë 1 qershor 2010, fq. 2581.
- VKM 633 e datës 18/09/2003 për "Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom në Shqipëri".

- VKM nr. 303, datë 25.03.2009, “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 337 dt. 06.04.2011 “Për përfshirjen e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve në skemën e sigurimeve shëndetësore”.
- Rregulloret e brendshme të gjitha IEVP dhe të Qendrën Spitalore të Burgjeve të miratuara me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.
- VKM Nr. 519, 31.10.1994 “Për miratimin e Kartelës për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”;
- VKM Nr. 432, datë 14.8.1995 "Për proçedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”;
- VKM Nr. 352, datë 3.05.1995, "Për miratimin e çertifikatave të pronësisë së pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 549, datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e tarifave të shërbimit të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", i ndryshuar;
- VKM Nr. 157, datë 26.2.1998 “Për fillimin e punës së zyrës së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në disa rrethe”;
- VKM nr. 553, datë 28.08.1998 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shoqërive tregtare, të krijuara nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore”;
- VKM Nr. 556, datë 23.10.2000 "Për dorëzimin e dokumentacionit të pronësisë në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme";
- VKM Nr. 411, datë 29.8.2002 "Për kalimin e disa mjediseve në administrimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, Korçë, Durrës;
- VKM Nr. 787, datë 26.11.2004 “Për bashkimin në një të vetme të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme “Tirana 1” dhe “Tirana 2” dhe për krijimin e zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë dhe Has”;
- VKM Nr. 3, datë 21.03.2006 “Për mbylljen e Njësisë së Menaxhimit të Projektit për Sistemin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe transferimin e funksioneve të saj Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”;
- VKM nr. 24, datë 19.01.2007 “Për procedurën e lëshimit të dokumenteve nga disa zyra të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe ndryshimin e tarifave për to”;
- Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 31.01.2007 ”Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”;
- Urdhër i Ministrisë së Drejtësisë nr. 21 datë 14.11.1998 “Për mbylljen e zyrave të Hipotekës dhe kalimin e tyre pranë zyrave të regjistrimit të pasurive” ;
- VKM nr. 1025, datë 09.07.2008 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”;
- Vendim nr. 200, datë 19.02.2009 “Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar.”
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 256, datë 13.4.2010 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 253, datë. 13.04.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 52 dt. 07.02.2007 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve të komunikimit, nëpërmjet AKKP-së dhe institucioneve shtetërore, gjatë procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës”

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 255 dt. 13.04.2010 “Për procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara gjatë procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr 254, datë 13.04.2010, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 257 dt. 11.04.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurën e kompensimit fizik me troje shtetërore, të subjekteve të shpronësuara në disa raste të veçanta”
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr 250, datë 14.04.2010, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 12 dt. 07.01.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar”
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 383, datë 19.05.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale” dhe Vendimet të Këshillit të Ministrave ku përcaktohet shpërblimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 267, datë 21.4.2010 ”Për përcaktimin e rregullave për bashkërendimin e punës së ALUIZNI-t me zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për procedurat e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 19.2.2009 ”Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar”.
- Vendimi Nr. 934, datë 02.09.2009 "Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave";
- Vendimi Nr. 1232, datë 11.12.2009, "Për përcaktimin e rasteve për përjashtimet nga detyrimi për njoftimin e të dhënave personale, që përpunohen";
- Urdhër i Kryeministrit nr 73, dt 03.08.2011 “Për ngritjen e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”;
- Urdhër i Kryeministrit Nr 30, dt 18.03.2011 “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjensisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”;
- Rregullorja e Brendshme e Zyrës së Komisionerit, e cila përcakton rregulla për organizimin dhe funksionimin e Zyrës, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve të Zyrës së Komisionerit, miratuar me Urdhërin e Komisionerit Nr. 48, datë 31.07.2009;
- Kodi i Etikës së Zyrës së Komisionerit është miratuar me Urdhërin e Komisionerit Nr. 49, datë 31.07.2009;
- Bazuar në Ligjin Nr 9367, datë 7.04.2006 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", është hartuar dhe miratuar me Urdhërin nr. 112 datë 24.12.2009 rregullorja "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Institucionin e Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale";
- Me Urdhërin 67, datë 02.10.2009 janë miratuar aktet në zbatim të veprimtarisë së punës së Drejtorisë së Hetim-Inspektimi në të cilat përfshihen: Formulari i ankimit, Urdhëri për kryerjen e hetimeve administrative, Procesverbali i hetimit administrativ si dhe Vendimi përfundimtar;

- Me Urdhërin Nr.66 datë 01.10.2009 është miratuar "Formulari i Njoftimit', si dhe "Udhëzuesi për Plotësimin e Formularit të Njoftimit", për subjektet kontrollues public dhe privat, për plotësimin e detyrimit për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit;
- Me Urdhërin Nr. 12/1, datë 12.05.2009 janë miratuar Rregullat "Për miratimin e rregullave të testimit", bazuar në ligjin "Statusi i nëpunësit civil";
- Vendimi i Komisionerit Nr. 1, datë 04.03.2010 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurinë e të dhënave";
- Vendimi i Komisionerit Nr. 2, datë 10.03.2010 "Për përcaktimin e procedurave të administrimit, të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe të nxjerrjes së tyre ";
- Udhëzimi Nr. 1, datë 19.02.2010 "Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale";
- Udhëzimi Nr. 2, datë 25.02.2010 "Për veprime të kontrolluesve përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale";
- Udhëzimi Nr. 3, datë 05.03.2010 "Për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet Sistemeve të Kamerave Monitoruese dhe Regjistruese (CCTV) në godina, ambjente dhe në mjedise të tjera";
- Udhëzimi Nr.4, datë 16/03/2010 për "Marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit";
- Udhëzimi Nr. 5, datë 26.05.2010 për "Rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e kujdesit shëndetësor";
- Udhëzimi Nr. 6, datë 28.05.2010 për "Përdorimin korrekt të SMS-ve për qëllime promocionale, reklama, informacione, shitjeve direkte, nëpërmjet telefonisë celulare";
- Udhëzimi Nr. 7, datë 09.06.2010 për "Përpunimin e të dhënave personale në sektorin e Arsimit";
- Udhëzimi Nr. 8, datë 31.08.2010 "Për veprime të kontrolluesit, Komiteti Shqiptar i Birësimit, përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale'';
- Udhëzimi Nr. 9, datë datë 15.09.2010 "Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive";
- Udhëzimi Nr. 10, datë 06.09.2011 për "Përpunimin e të dhënave personale në kuadër të shërbimeve hoteliere";
- Udhëzimi Nr. 11, datë 08.09.2011 mbi "Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat";
- Udhëzimi Nr.12, datë 21.12.2011 për "Kontrollin e identitetit në hyrje të ndërtesave";
- Udhëzimi Nr. 13, datë 22.12.2011 për ""Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 5.3.2010 "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme"";
- Udhëzimi Nr. 14, datë 22.12.2011 për "Përpunimin, mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në sektorin e komunikimit elektronik të publikut";
- Udhëzimi Nr. 15, datë 23.12.2011 për "Përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor";
- Udhëzimi nr. 16, datë 26.12.2011 për "Mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë";
- Me Urdhërin Nr. 47, datë 09.09.2011 është miratuar Strategjia "Për Trajnimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" për periudhën 2011-2012.

- Me Urdhër Nr. 76, datë 14.12.2011 është miratuar Manuali "Për Procedurën e Njoftimit";
- Me Udhërin Nr.75, datë 12.12.2011 është miratuar "Manuali për Vlerësimin e Kërkesave për Miratimin e Transferimit të të dhënave me Shtete të Huaja";
- Me Urdhrin Nr. 43, datë 09.03.2012 është miratuar "Manuali i Hetimit Administrativ i Komisionarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale';
- Me Urdhërin Nr. 3, date 24.1.2012, është miratuar "Strategjia Institucionale për Mbrojtjen e të Dhenave Personale 2012-2013";
- Udhëzimi nr.102, datë 10.2.2010, paketa informuese "Altertekst 2011";
- Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Financave dhe MASH, në zbatim të VKM-së nr.107, datë 10.2.2010, i ndryshuar me VKM nr.212, datë 16.3.2011 pika 6.1;
- Udhëzim nr.35, datë 31.08.2011, krijon kushtet dhe mundësitë për të gjithë romët, për të ndjekur arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe atë profesional me kohë të pjesshme dhe të shkurtuar;
- Urdhri nr. 10 datë 21.12.2010, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së KMD".
- Urdhri nr. 11 datë 21.12.2010, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi " Për miratimin e Kodit të Etikës së Institucionit".
- Është përgatitur dhe është dërguar në Parlament, "Raporti Vjetor 2011 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si një detyrim ligjor që rrjedh nga pika 3 e nenit 31 të ligjit Nr. 9887 datë 10.3.2008 "Për mbrotjen e të dhenave personale";
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe Ministrisë së Drejtësisë;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe AKEP;
- Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit midis Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Komisionerit dhe Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave në Republikën e Kosovës;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe Komisionerit në Mal të Zi;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Këshillit Drejtues për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Maqedonisë

Ndryshimet e bëra në legjislacionin e lartpërmendur janë përafruar pothuajse plotësisht me Rekomandimin (2006) 2 të Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane te Burgjeve i miratuar nga Këshilli i Ministrave me 11 Janar 2006 në takimin e 952 të Zëvendës Ministrave.

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në garantimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, për respektimin e të drejtave të njeriut janë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në Ministrinë e Drejtësisë, Njësia për Parandalimin e Tortures që është ngritur pranë Avoaktit të Popullit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e Politikave të Migracionit në MPÇSSHB, Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta dhe Familjen në MPÇSSHB, Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHMDF), Qëndra Kombëtare e Mirërritjes së Fëmijës, Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, Sektori i Diasporës dhe Minoriteteve në MTKRS, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe AKKP.

Institucioni përgjegjës për menaxhimin e sistemeve të burgimit dhe paraburgimit në kuadër të garantimit të të drejtave themelore të individit, është *Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve*. Mbështetur në ligjin nr. 8688, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar me ligjin nr. 9112 datë 24.07.2003, është një institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë i cili menaxhon dhe organizon funksionimin e sistemit të paraburgimit dhe burgimit, vuajtjes së dënimit, ekzekuton të gjitha vendimet penale, siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e sistemit, etj.

Në kuadër të garantimit të të drejtave themelore të njeriut kundrejt parandalimit të torturave dhe keqtrajtimit, funksionon edhe *Njësia për Parandalimin e Tortures*, e cila është ngritur pranë Avokatit të Popullit me nje rezolute të veçantë të Kuvendit të Shqipersisë, nëpërmjet të cilës këtij institucioni i jepej atributi i Mekanizmit Kombetar te Parandalimit te Tortrures si pjese e venies ne zbatim te Protokollit Opsional te Konventes se OKB "Per Parandalimin e Tortures", ratifikuar nga Kuvendi në vitin 2003. Roli i kesaj strukture eshte të kryeje vizita te vazhdueshme ne te gjitha vendet ku liria e personit eshte e kufizuar dhe te jape rekomandime per permiresimin e trajtimit te tyre. Krahas kesaj, Njesia ka si detyrim propozimin e ndryshimeve ligjore dhe nenligjore kur veren se ka premise per torture, trajtim çnjerezor dhe degradues.

Njesia perbehet nga 5 punonjes të cilet ndjekin monitorimet sipas fushave te policies burgjeve ushtrise dhe spitaleve psikiatrike. Njesia kryen cdo vit rreth 150 vizita ne vendet e privimit te lirise, vizita qe perballohen nga buxheti i Avokatit te Popullit. Njësia ka të miratuar nga Avokati i Popullit një plan vjetor vizitash dhe krahas ketyre, organizon çdo vit së bashku me shoqerinë civile një sërë tavolinash të rrumbullakta dhe konferenca për promovimin e të drejtave të njeriut në këtë fushë.

Lidhur me garatimin e shprehjes dhe lirisë së mendjes, organi rregullator për rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë radiotelevizive në Republikën e Shqipërisë është *Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit*, i krijuar në vitin 1999, si organizëm i pavarur që vepron në bazë e për zbatim të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. KKRT-ja përveç 7 anëtarëve të saj, ka një administratë, e cila realizon gjithë veprimtarinë e nevojshme përgatitore e administrative në shërbim të Këshillit. Struktura e institucionit propozohet nga KKRT-ja dhe miratohet nga

Kuvendi. KKRT-ja përbëhet nga 5 (pesë) Drejtori: Drejtoria e Programeve, Drejtoria Teknike, Drejtoria Juridike dhe Licencave, Drejtoria e Financës, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, ku numri i përgjithshëm i punonjësve është 49 (dyzet e nëntë).

Funksionimi i brendshëm i KKRT-së, procedurat e vendimmarrjes dhe zbatimi i tyre, hartuar sipas dispozitave në fuqi, propozohen nga Kryetari dhe miratohen nga Këshilli. Detyra e KKRT-së janë aplikimi korrekt, proporcional e jodiskriminues i këtyre kompetencave, që kanë të bëjnë kryesisht me administrimin e spektrit të frekuencave; miratimin e akteve nënligjore në këtë fushë; dhënien dhe heqjen e licencave; zbatimin e sanksioneve përkatëse ndaj shkelësve të dispozitave të legjislacionit në fuqi, etj.

Institucioni përgjegjës për mbrojtjen nga diskriminimi është *Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi*. Me miratimin e ligjit nr. 10221, datë 04.02.2011, *"Për mbrojtjen nga diskriminimi"* u sanksionua krijimi i institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Bazuar në këtë ligj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Komisioneri është një një institucion publik qendror, i pavarur dhe në ushtrim të kompetencave ligjore i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit. Komisioneri zgjidhet për një mandat 5 vjecar me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.

Me vendimin Nr. 34, datë 20.05.2010 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi strukturën, organikën dhe kategorizimet e punës së Zyrës, duke mundësuar kështu funksionimin dhe fillimin e punës së kësaj zyre. Sipas kësaj strukture, Zyra përbëhet nga 23 punonjës.

Një institucion tjetër përgjegjës kundra diskriminimit është *Drejtoria e Politikave të Migracionit*. Sipas Ligjit per te Huajt, Autoriteti shtetëror qendror, përgjegjës për trajtimin e marrëdhënieve të punësimit të të huajve në Shqipëri, është Drejtoria e Politikave të Migracionit në MPCSSHB dhe autoriteti shtetëror përgjegjës, në nivel qendror është *Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit* dhe në nivel rajonal dhe vendor, për punësimin e të huajve, është zyra rajonale dhe vendore e punësimit. Është konkretisht pergjegjesia e zyrave perkatese te punesimit qe sipas Ligjit "Per te Huajt", dhe VKM-ve ne zbatim te tij, për punësimin e të huajve, të kryejnë me përgjegjësi detyrat si më poshtë :

- te presin personat e interesuar per pajisje me leje pune per te huajin;
- te japin informacionin e duhur per cdo paqartesi rreth procedurave per pajisje me leje pune;
- te shqyrtojne dokumentacionin perkates dhe te pranojne, ose te bejne verejtjet e duhura bazuar ne ligj dhe VKM ,per ta pranuar brenda afatit te lejuar ne VKM
- te respektojne afatet sipas VKM-se perkatese per pajisjen me leje pune te te huajit
- te evidentojne ne kohe lejet e punes duke i regjistruar ne regjistrin elektronik
- nje kriter i rendesishem qe duhet te zbatohet nga zyrat e punesimit eshte ai i vleresimit te tregut te punes Sipas Nenit 40, "Nevojat e tregut të punës për punëmarrësit" te Ligjit "Per te Huajt".

Lidhur me garantimin e barazisë ligjore, *mekanizmi Shtetëror i Barazisë Gjinore*, i cili përbëhet nga një sërë strukturash shtetërore është ngritur për të nxitur përparimin e barazisë gjinore dhe për të siguruar gëzimin e të drejtave njerëzore të grave. Ky mekanizëm është ngritur në zbatim të rekomandimeve nga CEDAW, Platforma për Veprim e Pekinit (PVP) dhe në zbatim të LBGJ. Funksioni i tij kryesor është të monitorojë dhe të sigurojë zbatimin e ligjeve, të parimit të mos-diskriminimit dhe barazisë midis burrave dhe grave.

LBGJSH përcakton si autoritet përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore *Ministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.* Bazuar në LBGJSH si dhe LDHF, Ministri e kryen funksionin e mësipërm i ndihmuar nga struktura e specializuar brenda dikasterit të tij, Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta dhe Familjen (DPSHBF),

Në bazë të LBGJSH, propozimi i politikave mbi barazinë gjinore i ngarkohet *Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore*. Ky këshill ka për detyrë të këshillojë Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për barazi gjinore dhe në përbërje ka 9 zëvendësministra të MPÇSSHB, Ministrisë së Integrimit (MI), Ministrisë së Financave (MF), Ministrisë së Drejtësisë (MD), Ministrisë së Brendshme (MB), Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), Ministrisë së Mbrojtjes (MM), Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) si dhe tre anëtarë përfaqësues të shoqërisë civile.

Mekanizmat institucionalë, të cilat do të jenë përgjegjëse për zbatimin e tij dhe garante për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (bazuar në Ligjin nr 10 347, dt 04.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të femijës") janë: *Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës*, Ministri që bashkërendon punën për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Këshilli është organ këshillimor i cili drejton, përcakton dhe zhvillon politikat shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Ai kryesohet nga ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe në funksion të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në ligjin e sipërcituar ka në përbërje dhe parashikon detyrime për 9 përfaqësues në nivel ministri konkretisht për Ministrin e Brendshëm, Ministrin e Arsimit dhe Shkencës, Ministrin e Drejtësisë, Ministrin e Shëndetësisë,Ministrin e Integrimit, Ministrin e Financave, Ministrin e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, Ministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Përvec përfaqësuesve në nivel ministri ai ka në përbërje edhe Avokatin e Popullit,një përfaqësues nga Shoqata e Kombëtare e Bashkive dhe 2 përfaqësues nga shoqëria civile.

Pranë Këshillit do të ngrihen komitete teknike, të cilat do të kenë funksion ndihmës për Këshillin, kryesisht, në lidhje me vendimet që do të duhet të ndërmarrë ky organ. Koordinator do të jetë Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta që do të mbulojë përmbushjen e detyrave të parashikuara në ligj. Detyrat e tij konsistojnë në Hartimin e politikave dhe programe shtetërore në fushën e mbrojtjes së fëmijës; mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, të strategjisë kombëtare, si dhe të gjithë dokumentave të tjerë strategjikë dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, ndërmarrjen e inisiativave legjislative në këtë fushë; nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në këtë fushë, nxjerrjen e udhëzimeve metodologjike për njësitë e te drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijëve në organet e qeverisjes

vendore si dhe bashkërendimin e punës me autoritetet shtetërore përgjegjëse në nivel qëndror dhe vendor në hartimin e politikave dhe programeve të përbashkëta në këtë fushë.

Në nivel vendor parashikohen njësitë për të drejtat e fëmijës në nivel qarku dhe njësitë për mbrojtjen e fëmijëve në nivel komune dhe bashkie. Ngritja dhe funksionimi i këtyre njësive do të bëjë të mundur zbatimin dhe monitorimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, duke filluar që në terren, pra nga baza e duke vazhduar vertikalisht drejt ekzekutivit. Në respektim të parimit të autonomisë lokale, parashikohet funksionimi i këtyre njësive brenda organizimit administrativ të strukturave përkatëse të pushtetit lokal, me detyrat e parashikuara në këtë ligj.

Institucionet e përfshira në garantimin mbrojtjes së shëndetit të fëmijës janë; Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e varësisë së saj. Funksionet politikëbërëse realizohen nga Ministria e Shëndetësisë. Si pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë që merret më mbrojtjen e shëndetit të fëmijës funksionon Drejtoria Shëndetit Publik, Drejtoria Spitalore që janë pjesë e Drejtorisë së Përgjithëshme të Politikave dhe Planifikimit Shëndetësor.

Qëndra Kombëtare e Mirërritjes së Fëmijës e themeluar me Vendim te Keshillit te Ministrave nr 325, 23/06.2000. Kjo qëndër në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë shërben si qëndër diagnostikimi, kurimi, edukimi, trajnimi për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijës me nevoja të veçanta. Qëndra ndër të tjera ka si detyrë të diagnostikojë dhe trajtojë fëmijët 0-6 vjeç me probleme të zhvillimit; të përpunojë dhe ndjekë zbatimin e programeve trajnuese, të përsonelit mjeksor dhe atij edukativo-pedagogjik të të gjitha institucioneve shëndetësore për fëmijët në nivel vendi; në bashkëpunim me Departamentin e pediatrisë të Fakultetit të Mjeksisë të sigurojë kushtet për realizimin e praktikave mësimore të studentëve të Fakultetit të mjeksisë, psikologjisë dhe punës sociale, infermieristikës.

Strukturat që janë të angazhuara me mbrojtjen e minoriteteve dhe zbatimin e strategjisë kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës të minoritetit Rom" janë:

Komiteti Shtetëror i Minoriteteve
Bashkëpunon me organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, me organizata e shoqata që kryejnë veprimtari për ushtrimin e të drejtave dhe lirive të minoriteteve, për përmirësimin e standardeve në respektimin e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri. Komiteti gjithashtu propozon masa konkrete për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe arsimor të pakicave. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve ka në përbërjen e tij përfaqësues të minoriteteve kombëtare dhe etnogjuhësore në Shqipëri. Në këtë komitet romët kanë një përfaqësues nga komuniteti i tyre.

Sektori i të Drejtave të Njeriut, Minoriteteve dhe Raportimeve në Drejtorinë e Organizatave Ndërkombëtare, Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Sigurisë dhe Organizatave Ndërkombëtare, në Ministrinë e Punëve të Jashtme.
Sektori i të Drejtave të Njeriut, Minoriteteve dhe Raportimeve ndjek përmbushjen e angazhimeve dhe detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e të drejtave të minoriteteve, si dhe në bashkëpunim me institucionet e linjës do të ndjekë në vazhdimësi çështjet e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve dhe koordinimin dhe

zbatimin e politikave mbi minoritetet. Gjithashtu ky sektor ka si objektiv të mbajë dhe të zhvillojë dialogun zyrtar me përfaqësuesit e shoqatave të minoriteteve, të nxisë dhe të mbështesë veprimtarinë dhe aktivitetet e shoqatave të tyre, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre gjuhësor, kulturor, fetar dhe kombëtar.

Sekretariati Teknik për Romët, në Drejtorinë e Monitorimit të Strategjive Ndërsektoriale, në Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i cili ka për detyrë:

- Monitorimin e zbatimit të objektivave dhe masave prioritare të përcaktuara në këtë strategji, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, Ministrinë e Financave dhe donatorë të ndryshëm për sigurimin e fondeve të nevojshme për realizimin e objektivave të kësaj strategjie;
- Nxitjen dhe ndërgjegjësimin e institucioneve, strukturave rajonale dhe pushtetit vendor për t'u përfshirë në zbatimin e strategjisë së komunitetit rom;
- Vendosjen dhe mbajtjen e kontakteve me ministritë e linjës dhe institucionet përgjegjëse të përfshira në zbatimin e strategjisë;
- Vendosjen e bashkëpunimit me shoqatat e komunitetit rom dhe OJF-të e ndryshme që veprojnë në fushën e minoriteteve për zbatimin e strategjisë;
- Bashkëpunimi me donatorë dhe OJF-të për fuqizimin e kapaciteteve të sektorit dhe të institucioneve në nivel qendror, rajonal dhe lokal për zbatimin e strategjisë.

Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

Është një strukturë e krijuar në prill të vitit 2011, në vartësi të MPÇSSHB, e cila është përgjegjëse për zbatimin e Ligjit nr.10347, datë 4.11.2010 "Për të Drejtat e Fëmijës". ASHMDF ka për detyrë:

- të monitorojë zbatimin e ligjit nr.10 347, datë 04.11.2010 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës" dhe legjislacionin në fuqi, si dhe të koordinojë autoritetet shtetërore përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të strategjive dhe politikave në fushën e të drejtave të fëmijëve;
- të propozojë në ministrinë që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për ndërhyrje në politika dhe legjislacion, bazuar në problematikat që kane dalë gjatë monitorimit të zbatimit të ligjit, strategjive dhe politikave në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.
- të propozojë udhëzime metodologjike për njësitë e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës në organet e qeverisjes vendore;
- të mbështesë teknikikisht strukturat e organeve të qeverisjes qëndrore dhe vendore, si dhe organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- të koordinojë punën me të gjitha strukturat e qeverisjes qëndrore dhe vendore për përgatitjen e raporteve, informacioneve dhe statistikave për gjendjen e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri;
- të ndëshkojë subjektet të cilat shkelin dispozitat e ligjit nr. 10 347, datë 04.11.2010, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës"

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, lidhur me çështjet e regjistrimit.

Drejtoria e Arsimit Fillor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, e cila mbulon edhe problemet e arsimimit të minoriteteve.

INSTAT - Drejtoria e Statistikave Sociale,.
Është autoriteti përgjegjëse për prodhimin e statistikave të profilit social e demografik dhe veçanërisht për punën përgatitore dhe zbatimin e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë. INSTAT, i cili është një Institucion Qendror i specializuar, për hartimin e kritereve metodologjike sipas rekomandimeve ndërkombëtare, në muajin shkurt 2004, në Buletin e tij 3 – mujor (dhjetor 2003), ka publikuar rezultatet e vlerësimeve në nivel kombëtar mbi minoritetet në Shqipëri.

Drejtoria e Librit dhe e Bibliotekave me sektorin e kulturës së diasporës dhe minoriteteve pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
Qëllimi i sektorit është përmirësimi i vazhdueshëm i hapësirave ligjore në fushën e diasporës dhe minoriteteve dhe përafrimi i tyre në përputhje me standardet e BE, ndërtimi i politikave të zhvillimit në fushën e diasporës dhe minoriteteve për të ruajtur dhe promovuar edhe më tej identitetin kombëtar të shqiptarëve që jetojnë e punojnë në vendet e huaja, si edhe në mbrojtjen e karakteristikave thelbësore që përbëjnë gjuhën dhe kulturën e komuniteteve të kombësive të huaja që jetojnë në Shqipëri.

Autoriteti i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është organizuar në 5 drejtori në përbërje të të cilave rekrutohen, ushtrojnë kompetencat ligjore dhe gëzojnë statusin e nëpunësit civil bazuar në Ligjin Nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil". Struktura e Autoritetit të Komisionerit është pasqyruar në Vendimin e Kuvendit nr. 225, datë 13.11.2008 dhe mbështetet në Ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura" dhe përmban:

- Komisioneri;
- Këshilltare;
- Sekretare;
- Drejtoria e Çështjeve Procedurale, Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë;
- Drejtoria e Regjistrimit;
- Drejtoria e Hetim- Inspektimit;
- Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun;
- Specialistë të IT-së;
- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

Në kuadër të garantimit të të drejtave të pronësisë, institucioni përgjegjës i cili drejton, organizon dhe kontrollon veprimtarinë e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Kjo e fundit përbëhet nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe 35 Zyra Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndodhura në çdo rreth të vendit. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme e ushtrojnë veprimtarinë në territorin e zonës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

ZRPP bashkëpunon ngushtë me institucionet qendrore (ministritë dhe me institucionet në varësi të tyre) dhe me organet e pushtetit lokal (bashki dhe komuna), për evidentimin e tokës

shtetërore te disponueshme për kompensim, duke u bazuar ne informacionet mbi pronat e regjistruara në këtë Zyre. Gjithashtu ZRPP bashkëpunon ngushtë dhe me sektorin privat (ndërtuesit, dhoma e Avokatisë, Noterisë, Bankat etj.). Mekanizmi i bashkëpunimit konsiston në lidhjen e marrëveshjeve ndërmjet ZRPP dhe këtyre institucioneve.

Ndërkohë, Institucioni përgjegjëse për njohjen e të drejtës së pronësisë është *AKKP-ja*, e cila drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm dhe 2 (dy) zëvendësdrejtorë të Përgjithshëm. Organika dhe struktura e AKKP-së përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave".
AKKP-ja si institucion qendror varet nga Ministria e Drejtësisë dhe është përgjegjëse për:

- Njohjen e të drejtës së pronësisë, e drejtë kjo themelore e parashikuar në Kushtetutën e republikës së Shqipërisë;
- Kthimin e kësaj të drejte aty ku është e mundur, si dhe aty ku nuk është e mundur kompensimin e saj në gjashte mënyrat e parashikuara në ligj;
- Ndjekjen e procedurave hap pas hapi të këtij procesi si dhe të bashkëpunimit me institucionet e treta që duhet të japin ndihmën e tyre ligjore për këtë proces;
- Me ndryshimet e kuadrit ligjor autoriteti i vetëm shtetëror, i cili merret me trajtimin e çështjeve të pronësisë, të cilat derivojnë nga shtetëzimet, shpronësimet dhe konfiskimet nga shteti totalitar komunist, do të jetë vetëm Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronave me qendër në Tiranë.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit penitenciar shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij, përmirësimi i kushteve të strehimit dhe sigurisë së personave me liri të kufizuar, si dhe rritja e veprimtarive me karakter rehabilitues.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 8328, date 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar;
- Miratimi i disa shtesave e ndryshimeve në ligjin nr. 10032, datë 11.12.2008 për Policinë e Burgjeve”;
- Miratimi i VKM “Mbi nxitjen dhe shpërblimin e punës së të dënuarve dhe paraburgosurve”: Në zbatim të ndryshimeve dhe shtesave në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, u miratua Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve me VKM nr. 303 datë 25.03.2009, i ndryshuar, ku u bë rregullimi i marrëdhënieve të punësimit të burgosurve;
- Dërgimi për Shqyrtim dhe Miratim në Këshillin e Ministrave i Projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm për sistemin e Burgjeve;
- Propozimi për disa shtesave dhe ndryshimeve të VKM-së nr 127 dt. 11.03.2004 ’’Për Krijimin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet“;
- Hartimi i draftit të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, në të cilën do të adresohen masa lidhur me:
  - administrimin e drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin,
  - të miturit nën moshën e përgjegjësisë penale,

- të miturit viktima të krimit dhe të miturit dëshmitarë;
- Lidhja e marreveshjeve me Ministrinë e Shendetësisë për venien në sherbim te policisë, të mjekëve te spitaleve civile, kur kryhen pritje te ndaluarish dhe jane larg drejtorise se qarkut.
- Projekt-VKM për miratimin e Strategjisë "Për kalimin nga transmetime analoge në atë numerike". Në hartimin e këtij dokumenti janë patur parasysh orientimet strategjike të kuadrit rregullator të BE-së mbi procesin e kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike, të tilla si Komunikata e Komisioni Evropian, maj 2005, "Mbi përshpejtimin e periudhës së tranzicionit nga transmetimet televizive analoge në ato numerike", Konkluzionet e Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian, miratuar në 20 nëntor 2003, "Mbi periudhën transitore nga transmetimet analoge në ato numerike", Komunikatën e Komisionit Evropian (COM(2003)541), të datës Shtator 2003, "Mbi kalimin nga transmetimet analoge drejt atyre numerike". Gjithashtu, ky dokument është bazuar edhe në aktet që kanë lidhje me këtë sektor të tilla si Direktiva 2002/21/KE "Një Kuadër Rregullator i Përgjithshëm për Rrjetet dhe Shërbimet e Komunikimeve Elektronike" (Direktiva e kuadrit rregullator); Direktiva "Mbi autorizimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike". (Direktiva për Autorizimin); Direktiva Mbi aksesin dhe ndërlidhjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe shërbimet që kanë lidhje me to. (Direktiva për Aksesin), dhe Direktiva "Mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve në lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike. (Direktiva mbi Shërbimin Universal)
- Miratimi i projekt-ligjit "Per transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë", ku do të përfshihet edhe rregullimi i transmetimeve numerike. Projekt-ligji synon të arrijë një përafrim të plotë me Direktivën AVMSD (Audio Visual Media Service Directive) 2010/13/KE. Në të njëjtën kohë, projektligji bën përafrim të plotë me kërkesat e paketës së Direktivave për komunikimet elektronike në lidhje me transmetimet radio televizive në veçanti me kërkesat e Direktivës kuadër, 2002/21/KE e amenduar me Direktivën 2009/140/KE; Direktivës së autorizimit, 2002/20/KE e amenduar me Direktivën 2009/140/KE Direktivës së aksesit 2002/19/KE e amenduar me Direktivën 2009/140/KE, dhe Direktivës së shërbimit universal 2002/22/KE e amenduar me Direktivën 2009/136/KE. Projektligji bën transpozim të plotë të Direktivës së aksesit të kushtëzuar 98/84/KE.
- Projekt-Vendim i Këshillit të Ministrave "Për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga Agjencia dhe strukturat shtetërore përgjegjëse në nivel qëndror dhe vendor"
- Projekt-Vendim i Këshillit të Ministrave "Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksionit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve"
- Projekt- Vendim i Këshillit të Ministrave "Për Bashkërendimin e Veprimtarisë së Mekanizmave në nivel qëndror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve"
- Projekt-Vendim i Këshillit të Ministrave "Për bashkëpunimin midis mekanizmave institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe organizatave jo-fitimprurëse"

- Projekt-Vendim i Këshillit të Ministrave" Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik , si dhe mënyrën e procedimit të tij".
- Propozimi për ndryshimin e Vendimit nr. 34 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi"
- Ndryshime në kuadrin ligjor rregullator, të cilat do të mundësojnë përmirësimin dhe përditësimin e të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme që administron zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- Miratimi me akt nënligjor (VKM), i rregullores së shërbimeve në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në të cilën do të përcaktohen në mënyrë të detajuar të gjitha llojet e shërbimeve që realizon zyra, dokumentet e nevojshme për çdo shërbim, elementët që verifikohen në çdo dokument dhe qëndrimi që mbajnë zyrat e regjistrimit për kryerjen e shërbimeve;
- Përgatitja e bazës ligjore mbështetëse në zbatim të ligjit të ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në funksion të kalimit të ZQRPP në institucion vetë-financues.
- Hartimi dhe miratimi i projektligjit "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe akteve nënligjore të nevojshme (statuti, struktura dhe rregullat e brendshme) në përputhje me sugjerimet e bëra nga OSBE-ja;
- Miratimi me vendim të Këshillit të Ministrave i "Strategjisë për të Drejtën e Pronës";
- Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës për stafin e ZQRPP-së.
- Miratimi i strategjisë për të drejtat e pronësisë;
- Përmirësimi i ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar;
- Hartimi i akteve nënligjore për ristrukturimin e burimeve njerëzore;
- Nxjerrjen e rregullores se re "Për funksionimin e Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave";
- Miratimi i një skeme të re definitive mbi afatet e kompensimit në përputhje me orientimet e GJEDNJ;
- Projekt Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në të holla për vitin 2012";
- iratimi i aktit të ri të metodikës së rishikuar.
- Propozimi për ndryshimin e Vendimit nr. 34 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi".
- VKM për pagesën prej 20 mijë Eurosh të kootizacionit të përvitshëm që duhet të paguajë qeveria shqiptare si pjesë e iniciativës "Dekada e Përfshirjes së Romve"
- VKM për rezervimin e kuotave për studentët romë në institucionet e arsimit të lartë, në kuadër të Planit të Veprimit të "Dekadës së Përfshirjes së Romve";

Masat legjislative afatshkurtra ne fushen e Mbrojtjes se te Dhenave Personale përfshijnë:

- Projekt/Udhëzimi "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi";

- Projekt-Udhëzimi “Mbi kohën e mbajtjes së të dhënave personale që përdoren nga organet e policisë së shtetit për qëllime parandalimi, hetimi, zbulimi dhe ndjekje të veprave penale”;
- Projekt-Udhëzimi për "Përcaktimin e Rregullave për Ruajtjen e të Dhënave Personale të Përpunuara nga Kontrolluesit e Vegjël";
- Projekt-Udhëzim “Mbi përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar”;
- Projekt-Udhëzim mbi “Masat e sigurisë për ndërmarrjet e mëdha që përpunojnë të dhëna personale”;
- Projekt-Udhëzim mbi “Grumbullimin e të dhënave të marra nga shenjat e gishtave”;
- Projekt-Udhëzim për “Kompanitë që ofrojnë shërbime telefonike "Call Center";
- Projekt-Udhëzim për “Mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në sektorin shëndetësor”;
- Projekt-Udhëzim mbi “Përpunimin e të dhënave personale për kërkime dhe statistika”.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Aktivitete ne lidhje me permiresimin e kushteve te te sistemit penitenciar:

- Vizita monitoruese në vendet e kufizimit të lirisë nga Njësia kundër Torturës, Avokati i Popullit.
- Rekrutimi i stafit për paraburgimin e ri të Elbasanit;
- Trajnimi i stafit të sapozgjedhur civil e policor të paraburgimit të Elbasanit;
- Realizimi i projektit për bllokuesit e valëve celularë në IEVP Jordan Misja dhe Fushë-Krujë;
- Ndërtimi i Paraburgimit të ri në Berat;
- Ndërtimi i Paraburgimit të ri në Fier;
- Realizimi i një sistemi të veçantë për punësimin e të dënuarve dhe paraburgosurve;
- Projekte për përmirësimin e kushteve të përgjithshme në disa institucione penitenciare;
- Përfshirja e të burgosurve në skemën e sigurimeve shëndetësore;
- Punësimi i mjekëve psikiatër në të gjitha institucionet penale;
- Trajnimi i stafeve të edukimit që merren me trajtimin e të miturve në ambientet e vuajtjes së dënimit dhe ato të paraburgimit;
- Trajnimi i gjithanshëm të gjithë stafit civil dhe policor të burgjeve në çështjet e të drejtave të njeriut dhe nxitja dhe respektimi i të drejtave për sa i përket trajtimit të paraburgosurve dhe dënuarve;
- Zbatimi i VKM “Për përfshirjen e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë”;
- Dërgimi i projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë për Drejtësinë për të Mitur” për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave;
- Përmirësimi i ruajtjes së të dhënave mjekësore të të burgosurve.

Aktivitete ne fushen e lirise se shprehjes dhe barazise ne fushen e medias

- Organizimi i fushatës sensibilizuese për informimin e publikut në kuadër të kalimit në transmetimet numerike.

- Organizmi i takimeve dhe konferencave për mënyrat e detajuara të kalimit në transmetimet numerike për secilin operator analog ekzistues, afatet e zbatimit të "ishujve numerikë" dhe penalitetet për moszbatimin e tyre.

Aktivitete ne fushen e mbrojtjes nga diskriminimi

- Realizimi i një një studimi për të evidentuar nevojat për ndryshime në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimit";
- Rishikimi dhe ndërmarrja e ndryshimeve të nevojshme në strukturën organizative dhe organogramën e KMD;
- Zbatimi dhe monitotimi i Planit të Veprimit të Planit Strategjik 2012-2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Botimi i broshurave dhe katalogëve e manualeve per grupe specifike dhe sipas formave të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara;
- Zhvillimi i një spoti publicitar dhe transmetimi në TV;
- Pjesmarrje në emisione dhe debate televizive;
- Organizimi i ditëve të hapura dhe në rajone të ndryshme;
- Përmirësimi i infrastrukturës së institucionit me pajisjet e nevojshme kompjuterike dhe informatike;
- Trajnimi i stafit të zyrës me qëllim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të punonjësve;
- Trajtim efektiv, me profesionalizëm dhe në respektim të afateve ligjore të ankesave për diskriminim;
- Organizimi dhe pjesmarrja në konferenca, tryeza të rrumbullakta, seminare me institucione të tjera publike, OJF dhe organizma ndërkombëtarë;
- Organizimi i trainimeve me grupe të ndryshme profesionale si forcat e rendit, punonjësit e shëndetësisë, punonjësit e arsimit etj;
- Monitorim në fushën e arsimit parauniversitar i përqendruar tek diskriminimi për shkak të racës, gjendjes ekonomike dhe aftësisë së kufizuar;
- Monitorim në fushën e punësimit, në sektorin publik dhe privat, me fokus të veçantë tek aksesi i grupeve vulnerabël tek mundësitë e punësimit;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me INSTAT, Departamentin e Administratës Publike, Ministrinë e Brndshme, Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Avokatin e Popullit, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Ministrinë e Shëndetësisë;
- Nënshkrimin e marrëveshjeveve të bashkëpunimit me OJF ;
- Vendosja e bashkepunimit me pushtetin vendor;
- Në bashkëpunim me Ministrinë Arsimit dhe Shkencës dhe me përfshirjen e aktorëve të tjerë nga bota akademike dhe shoqëria civile, KMD do të angazhohet në hartimine e një plani masash për ndërhyrjen në kurrikulat shkollore në kuadër të parashikimeve të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi";
- Dhënia e opinioneve të specializuara për legjislacionin me qëllim shmangien e parashikimeve diskriminuese;
- Në bashkëpunim me institucionet perkatese do të ndërmerren hapat e nevojshme për përfshirjen e KMD-së në rrjetin europian të institucioneve të barazisë EQUINET.

- Vazhdimi i aktiviteteve të trajnimit për forcimin e kapaciteteve të personelit për ofrimin e shërbimeve ndaj migrantëve., në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Miracionin (IOM Tirana).
- Vazhdimësi e forcimit të kapaciteteve me pajisje dhe mjete pune për SKP,ZRP dhe ZVP, sipas nevojave , mbështetur gjithashtu nga IOM.

Aktivitete ne fushen e barazise gjinore dhe parandalimit te dhunes ne familje:

- Bashkëpunim i vazhdueshëm dhe monitorim lidhur me emërimin e nëpunësve gjinorë në nivel qëndror dhe vendor;
- Trajnim i mëtejshëm i nëpunësve gjinorë në minisritë dhe në bashkitë e vendit;
- Ngritja e Mekanizmit të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje dhe trajnimi i ekipeve teknike multidisiplinare;
- Bahkëpunim me shoqërinë civile për përmirësime në Kodin Zgjedhor pranë komisionit Ad Hoc për kuotën gjinore;
- Nxitja e fuqizimit ekonomik të grave sipërmarrëse nëpërmjet organizimit të panaireve të përvitshme.

Aktivitete ne fushen e te drejtave te femijeve:

- Promovimi i ligjit Nr 10347 datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" dhe Planit të Veprimit për Fëmijët 2012-2015.
- Takime periodike të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve për të analizuar zbatimin e politikave, situatën e realizimit të të drejtave të fëmijëve në vend dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes.
- Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të stafit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
- Promovimi i rolit të ASHMDF dhe vendosja e bashkëpunimit me njësitë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në institucionet e qeverisjes vendore.
- Monitorimi i zbatimit të ligjit dhe hartimi i raporteve periodike mbi situatën e realizimit të të drejtave të fëmijëve në vend.
- Vendosja e marrëdhënieve të formalizuara të bashkëpunimit në marrveshje konkrete midis institucioneve shtetërore në nivel qëndror dhe vendor dhe OJF-ve.
- Trajnime/workshope në nivel qëndror/vendor lidhur me cështje të mbrojtjes/respektimit së të drejtave të fëmijëve.
- Rishikimi i rregulloreve, udhëzimeve aktuale që ka shërbimi shëndetësor i fëmijës, konsultoret e nënës dhe fëmijës në kujdesin shëndetësor parësor dhe përditësimi simbas nevojave dhe udhëzimeve të OBSh, UNICEF;
- Hartimi standarteve të reja për këto shërbime;
- Ndërhyrje në komunitetet e zonave rurale të qarqeve Kukës dhe Shkodër për përfshirjen e tyre ne kujdesin për shëndetin e fëmijës;
- Futja e protokolleve të Menaxhimit të integruar të sëmundjeve të fëmijërise në shërbimet shëndetësore te KSHP;
- Lancimi i një fushate komunikimi në media lidhur me ushqyerjen e fëmijës që ka si synim të përmirësojë mënyrën e ushqyerjes së fëmijëve;
- Vaksimi i plotë në kohë të gjithë fëmijevë simbas kalendarit kombëtar të vaksinimit
- Identifikimi dhe mbulimi me shërbime të imunzimit i grupeve të marginalizuara/në rrezik në çdo rreth (popullata rome, zonat rurale, etj).

Aktivitete ne lidhje me te drejtat e minoriteteve:

- Përmbushja e angazhimeve të ndërmarra në fushën e respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të minoriteteve. Përgatitja e komenteve të qeverisë shqiptare lidhur me pyetësorin e dërguar nga Komiteti Këshillimor i Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e minoriteteve në kuadër të Raportit të tretë kombëtar të Shqipërisë të dorëzuar në janar të vitit 2011;
- Ndjekja dhe përmbushja e detyrimeve periodike që rrjedhin nga Konventa Kuadër për mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, pas paraqitjes së Opinionit të Komitetit Këshillues, të Konventës Kuadër lidhur me raportin mbi minoritetet të paraqitur nga Shqipëria;
- Organizimi i takimeve të veçanta me përfaqësues të shoqatave të minoriteve, shoqërisë civile;
- Seminari Folloë- up në kuadrin e mbylljes së ciklit të tretë të raportimit mbi zbatimin e Konventës Kuadër "Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare" nga Shqipëria;
- Takime tematike me qëllim nxitjen dhe forcimin e dialogut me përfaqësuesit e minoriteteve në Shqipëri;
- Tryezë e rrumbullakët me pjesëmarrjen e shoqatave të minoriteteve, mbi përmirësimin e kuadrit ligjor mbi të drejtat e minoriteteve;
- Përmbushja e angazhimeve që rrjedhin nga Konventa Kuadër për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të minoriteteve;
- Përmirësimi i kuadrit ligjor për minoritetet në mënyrë që të përmbushë kërkesat e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës "Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare" dhe të sigurohet zbatimi i saj në të gjithë Shqipërinë;
- Shqyrtimi i nivelit aktual të detyrimeve që rrjedhin nga nënshkrimi i Kartës së Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare dhe evidentimi i dispozitave të cilat mund të përmbushen nga Shqipëria;
- Zbatimi i Strategjisë kombëtare për romët, si pjesë e strategjisë së qeverisë për të luftuar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror;
- Zbatimi i angazhimeve të ndërmarra në kuadër të Iniciativës "Dekada e Romëve", monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit për zbatimin e Deklaratës "Dekada e romëve";
- Forcimi dhe zhvillimi i dialogut zyrtar me përfaqësuesit e minoriteteve, nxitja dhe mbështetja e veprimtarisë dhe aktiviteteve të shoqatave që përfaqësojnë minoritetet, për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre kombëtar, gjuhësor, kulturor, etnik
- Pjesëmarrje në nivel të lartë në Konferencën Ndërkombëtare në Gjenevë mbi të drejtat e minoriteteve;
- Në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, janë organizuar një sërë veprimtarish mbi të drejtat e minoritetit rom dhe ruajtjen e identitetit të tyre në Shqipëri;
- Veprimtari promovuese mbi romanin "Nata e syrit të gjelbër" të autorit Mina Qirici financim nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me temë nga romët e Shqipërisë, veprimtari e cila shërbeu edhe si një ceremoni sensibilizuese për të ndërgjegjësuar shkrimtarët bashkëkohorë për të rrokur dhe trajtuar tema dhe subjekte nga jeta e romëve, traditë kjo e njohur në letërsitë dhe kulturat e huaja.

Aktivitete ne fuhen e te drejtave te pronesise

- Përmirësimi i dhënies së shërbimeve të ZRPP në të gjithë Shqipërinë;
- Zbatimi i Strategjisë së IT (Information Technology Strategy) nëpërmjet kompjuterizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- Zbatimi i strategjisë dhe zhvillimi i fushatës për informimin publik për funksionimin e ZRPP dhe për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme;
- Përfundimi i Regjistrimit Fillestar i 150.000 pasurive të paluajtshme në zonat urbane;
- Zhvillim i mëtejshëm i kuadrit rregullator;
- Rishikimi dhe përgatitja e Planit të Biznesit dhe e strategjive në zbatim të tij;
- Ngritja e kapaciteteve administrative. Kryerja e trajnimeve të stafit të ZRPP për procedurat dhe legjislacionin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe punën me sistemin e kompjuterizuar të regjistrimit;
- Përgatitja e projektligjit për ndryshimin e ligjit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, në funksion të kalimit të ZRPP në institucion vetë-financues si dhe përgatitja e akteve nënligjore qe do të mundësojnë zbatimin e këtyre ndryshimeve ligjore;
- Konsultimi i draft strategjisë "Për të drejtat e Pronës", si dhe reflektimi i komenteve të ardhura nga subjektet e interesuara;
- Përditësimi i legjislacionit ekzistues mbi të drejtat pronësore;
- Hartimi dhe miratimi i programeve vjetore periodike të trajnimit;
- Trajnimi i stafit për mbushjen e detyrave funksionale pas riorganizimit, të orientuara drejt shërbimit ndaj publikut;
- Rekrutimi i stafit mbi bazat e meritave profesionale dhe të integritetit;
- Dixhitalizimi i dokumentacionit arkivor ekzitues (dokumentet ligjore, kartelat dhe hartat treguese të regjistrimit) për zyrat vendore të regjistrimit Tiranë dhe Durrës;
- Zbatimi i arkitekturës së miratuar të sistemit elektronik të regjistrimit dhe ngritja e infrastrukturës hardëare, softëare, rrjet kompjuterik dhe përshtatja e ambienteve në zyrat vendore të regjistrimit Tiranë dhe Durrës;
- Adoptimi i sistemit elektronik në zyrat vendore të regjistrimit, Tiranë dhe Durrës;
- Shtrirja e sistemit të aplikimit elektronik të kërkesave të qytetarëve për shërbim në të gjitha zyrat vendore të regjistrimit;
- Aksesimi i noterëve në sistemin elektronik në zyrat vendore të regjistrimit Durrës dhe Tiranë;
- Krijimi i regjistrit kombëtar të tokës për një shërbim efektiv, cilësor dhe të shpejtë për publikun.
- Konsultimi i draft strategjisë "Për të drejtat e Pronës", si dhe reflektimi i komenteve të ardhura nga subjektet e interesuara;
- Zbatimi i skemës kalimtare aktuale të kompensimit;
- Përmirësimi i organizimit strukturor dhe funksional;
- Përditësimi i informacionit mbi fondin fizik të objekteve;
- Përditësimi i fondit fizik të tokave;
- Krijimi i fondit fizik të kompensimit, realizimi i shpërndarjes se tij nga AKKP-ja sipas procedurave qe do te miratohen me Vendim të Këshillit te Ministrave duke e bere procesin transparent korrekte dhe ne përputhje me ligjin dhe me aktet e tjera nënligjore në fuqi;

- Shpërndarjen e fondit të kompensimit në të holla për vitin 2012 për subjektet e shpronësuara prona e të cilëve është njohur për kompensim me vendim;
- Shpërndarjen e fondit në të holla për subjektet që preken nga ndërtimet informale;
- Përmbushja e rekomandimeve të analizës teknike që do të kryhen nga institucionet e eprore, përmes masave strukturore dhe institucionale;
- Trajnimi i stafit të AKKP-së për ngritjen e kapaciteteve të tyre;
- Përditësimi i legjislacionit ekzistues mbi të drejtat pronësore;
- Krijimi i bazës së të dhënave elektronike për vendimet administrative që lidhen me pronën;
- Përfundimi i shqyrtimit administrativ të kërkesave në lidhje me njohjen e pronës, për rreth 7000 dosje, për të cilat nuk është marrë një vendim ende;
- Përfundimi i proçesit për lirimin e banesave të ish - pronarëve, nëpërmjet aplikimit të kredive të buta për personat, sipas ligjit;
- Përgatitja e metodikës së rishikuar për vlerësimin e të gjithë tokës, të pasurive të paluajtshme, në bazë të vlerës së tregut dhe konsultimit me personat e interesuar;
- Identifikimi i pasurive të paluajtshme shtetërore dhe regjimit të tyre juridik, pas reformimit të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, sipas vlerës së tregut.

Aktivitet ne fushen e Mbrojtjes se te Dhenave Personale:

- Trajtimin e ankesave, duke përcaktuar saktë tipologjitë e shkeljeve;
- Inspektime për përpunimin e të dhënave;
- Kontrolle administrative të planifikuara në kontrollues publik (katër kontrollues publik të mëdhënj në fushat statistikë/pushtet vendor etj) dhe privat;
- Inspektime pa njoftim paraprak të kontrolluesve, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Komisioneri për gjatë viteve 2009-2012 ne sektorët publik dhe privat;
- Rekomandime për subjektet kontrollues;
- Njoftimin nga subjektet kontrollues;
- Njoftime në shtyp për subjektet që nuk kanë njoftuar sipas nenit 21 të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Njohja e publikut dhe subjekteve kontrollues me ligjin, në kuadrin e strategjisë për ndërgjegjësimin.

Gjithashtu ne kuadër te bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore dhe private do ndërmerren këto masa:

- Memorandum Bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme në kuadër të nënshkrimit të marrëveshjes midis Shqipërisë dhe Eurojustin dhe të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje për Strukturat e Luftës kundër Pastrimit të Parave dhe të Hetimit të Krimeve Financiare ne Shqipëri;
- Memorandum Bashkëpunimi me Universitetet private qe synon që të ndërgjegjësojë studentët nëpërmjet mbajtjes së leksioneve, njohjes dhe informimit mbi të rejat në fushën e mbrojtjes së të dhënave, zhvillimit të praktikës mësimorë pranë KMDP-së, ofrimit të asistencës së KMDP-së për trajtimin e të dhënave personale të studentëve, ofrimin e mundësisë së mbrojtjes së doktoraturave nga ana e specialistëve të KMDP-së në fushën e mbrojtjes së të drejtës së privatësisë, etj;

- Bashkëpunim me Sektorin e shëndetësisë për të evidentuar nevojat kryesore në përgatitjen e akteve ligjore me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale;
- Memorandum Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare dhe me Shoqatën e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë;
- Memorandum Bashkëpunimi me autoritetin e mbrojtjes kundër diskriminimit të individit.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatmesme synohet përmirësimi i infrastrukturës të burgjeve dhe paraburgimeve, ulja e mbipopullimit në sistemin e burgjeve, shtimin e numrit të shkollave në institucionet penale, forcimi i kapaciteteve të stafit të punonjësve të burgjeve, duke siguruar trajtim me dinjitet për personat e privuar nga liria, si dhe informatizimi i të dhënave.

Masat legjislative afatmesme janë si vijon;

- Hartimi i një drafti të një ligji të ri të drejtimit, menaxhimit dhe funksionimit të burgjeve dhe paraburgimeve;
- Rishikimi i legjislacionit për personat me probleme mendore në qëndrat e burgimit dhe paraburgimit;
- Projekt-VKM "Për miratimin e disa ndryshimeve në Strategjinë "Për kalimin nga transmetime analoge në atë numerik";
- Projekt-ligj për amendimin e kuadrit ligjor në fushën e transmetimeve;
- Nisma për ndryshime në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi";
- Nisma për ndryshime në ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit shqiptar me aktet komunitare;
- Dhënia e rekomandimeve për amendime të legjislacionit të brendshëm në përputhje me ligjin *"Për mbrojtjen nga diskriminimi";*
- Në vazhdimësi do të synohet për përditësimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimin e plotë të tij;
- Hartimi dhe miratimi i Projek-Urdhrit te Ministrit të Punës " Për metodologjinë e veprimit të njësive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për trajtimin e rasteve të fëmijëve në rrezik";
- Nisma për ndryshime në ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi";
- Përgatitja e bazës ligjore mbështetëse ne zbatim të ligjit të ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në funksion të kalimit të ZRPP në institucion vetë-financues;
- Propozim i projekt marreveshjeve bilaterale me shtetet e rajonit per mbrojtjen e ndersjellte te pakicave kombetare;
- Projekt-Udhëzimi "Mbi aktivitetet gjatë fushatave zgjedhore";
- Projekt-Udhëzimi për "Operatorët e shërbimeve celulare, lidhur me përpunimin e të dhënave të aplikuesve të shërbimeve celulare";
- Projekt-Udhëzimi për "Përpunimin e të dhënave personale nga organet e qeverisjes vendore" (bashkitë dhe komunat);
- Projekt-Udhëzimi për "Përpunimin e të dhënave të punonjësve nga burimet njerëzore në çdo fazë të punësimit";

- Projekt-Udhëzimi “Mbi transparencën e të dhënave personale në një sondazh elektoral”;
- Guidë praktike për “Mbrojtjen e të dhënave për prokurorët”.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Aktivitete ne lidhje me permiresimin e kushteve te te sistemit penitenciar:

- Vizita monitoruese në vendet e kufizimit të lirisë nga Njësia kundër Torturës, Avokati i Populit.
- Ndërtimi i Paraburgimit të ri në Shkodër;
- Vënia në efiçensë të plotë të paraburgimit në Berat, Fier;
- Rekrutimi i stafit për paraburgimin e ri të Berat, Fier dhe Shkodër;
- Trajnimi i stafit të sapozgjedhur civil e policor të IEVP Berat, Fier, Shkoder;
- Sisteme kamerizimi të reja dhe përmirësim i sistemeve aktuale në IEVP Peqin, Lezhë, Tepelenë, Qendra Spitalore e Burgjeve, Krujë, Lushnjë, Mine Peza, Rrogozhinë dhe Vaqarr si dhe permiresim i sistemeve aktuale;
- Ndërtimi i një institucioni të ri në ambientet e Burgut 313 dhe 325 Tiranë;
- Linja te reja elektrike ne Lezhe dhe Fushe Krujë;
- Përgatitja e projekteve për depo dhe puse uji si dhe linja ujësjellësi të reja;
- Rikonstruksion i plotë i IEVP Lushnje;
- Rikonstruksion në godinat e rregjimit të brendshëm dhe të jashtëm në IEVP Rrogozhinë;
- Rikonstruksion në godinat e 1,4,5 në IEVP Lezhë;
- Rikonstruksion në tualete në sigurinë e lartë në IEVP Peqin;
- Informatizimi i sistemit penitenciar;
- Komunikimi online (radio rele) i të gjitha IEVP dhe D.P.Burgjeve;
- Përmirësimi i sistemit të ngrohjes në IEVP Vaqarr, Sarandë dhe Peqin;
- Mbrojtje perimetrike në disa IEVP;
- Godine e re qëndër trainimi;
- Ngritja e një ambienti për stërvitje për stafin policor si dhe poligon qitje;
- Projekte për rritjen e sigurisë fizike përmes mbikëqyrjes dhe kontrollit me kamera dhe sisteme sigurie;
- Projekte për linja të reja elektrike dhe linja te reja ujësjellësi e puse uji në institucionet penitenciare;
- Projekte për përmirësimin e kushteve të punës në institucionet penitenciare;
- Hartimi i planit tematik të inspektimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;
- Ofrimi i kujdesit shëndetësor të burgosurve, veçanërisht personave të sëmurë mendorë;
- Studimi i projektit për administrimin dhe trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor;
- Krijimi i standardeve për trajtimin e personave nën masën mjekësore të “mjekimit të detyruar” dhe “mjekim të detyruar të përkohshëm”;
- Bashkëpunimi për organizimin e tryezave të rrumbullakëta me OJF-të për përmirësimin e disa praktikave dhe proçedurave në sistemin e burgjeve dhe paraburgimit;

- Kryerja e inspektimeve;
- Marrja e masave në zbatim të rekomandimeve që dalin nga inspektimet;
- Identifikimi i problemeve të ngritura në Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit;
- Marrja e masave për reflektimin përkundrejt vërejtjeve të Avokatit të Popullit;
- Rritja e numrit të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve në rrugë jashtëgjyqësore nëpërmjet zbatimit me efiçencë te ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve";
- Inspektime tematike nga strukturat inspektuese të gjyqësorit dhe prokurorisë për verifikimin e zbatimit të ligjit në rastin e të miturve të paraburgosur;
- Investigimi i ankesave administrative;
- Trajnimi në lidhje me Kodin e Etikës së Policisë dhe kufirin e përdorimit të forcës nga ana e Policisë dhe e stafit të sistemit penitenciar, në përputhje me standardet evropiane (Kodi Evropian i Etikës Policore) dhe praktikën e Gjykatës Europiane;
- Trajnime në lidhje me Kodin e Etikës Mjekësore, për personelin mjekësor në sistemet penitenciare në lidhje me dinjitetin njerëzor;
- Identifikimi dhe trajtimi i ankesave administrative ndaj kushteve të trajtimit në komisariatet e policisë dhe qëndrat e paraburgimit dhe burgimit;
- Analiza e bazave të ankesave, rezultatet dhe ndjekja e rekomandimeve.
- Zbatimi i plotë i angazhimeve që rrjedhin nga Strategjia e kalimit në sistemin numerik.

Aktivitete ne fushen e mbrojtjes nga diskriminimi:

- Zbatimi dhe monitotimi i Planit Strategjik 2012-2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe promovimi i parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit;
- Botimi i broshurave dhe katalogëve e manualeve per grupe specifike, në gjuhën e minoriteteve dhe sipas formave të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.
- Pjesmarrje në emisione dhe debate televizive;
- Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe krijimi i një programi elektronik (softëare), për menaxhimin e ankesave dhe gjenerimin e dhenave statistikore dhe trajnimi i stafit të KMD për përdorimin e sistemit;
- Trajnimi i stafit të zyrës me qëllim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative të punonjësve;
- Trajtim efektiv, me profesionalizëm dhe në respektim të afateve ligjore të ankesave për diskriminim;
- Organizimi dhe pjesmarrja në konferenca, tryeza të rrumbullakta, seminare me institucione të tjera publike, OJF dhe organizma ndërkombëtarë;
- Realizimi i sondazheve/anketave me tematika të ndryshme, në mënyrë periodike, për të evidentuar grupet me të prekura nga diskriminimi;
- Realizimi i monitorimeve në fusha dhe grupe të ngryshme të mbrojtura nga ligji, të identifikuara si më të prekura nga diskriminimi, për të adresuar më pas rekomandimet dhe rregullimet e nevojshme për eleminimin e situatave diskriminuese;
- Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional;
- Zhvillimi i rregullt i dialogut me shoqërinë civile;
- Përfshirja e KMD-së në rrjetin europian të institucioneve të barazisë EQUINET.

- Forcimi i kapaciteteve dhe koordinimi ndërinstitucional.
- Vlerësim lidhur me përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar me Konventën CEDAË, *acquis communautaire* të BE-së, LBGJSH, LDHF, LMD;

Aktivitete ne fushen e barazise gjinore dhe parandalimit te dhunes ne familje:

- Forcimi i kapaciteteve për të mbledhur dhe analizuar të dhëna të ndara sipas përkatësisë gjinore;
- Studim mbi situatën e dhunës në familje në Shqipëri;
- Vazhdimi i fushatave sensibilizuese ndërgjegjësuese për barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje;
- Vazhdimi i fushatave sensibilizuese ndërgjegjësuese për fuqizimin ekonomik të grave.

Aktivitete ne fushen e te drejtave te femijeve:

- Bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore për ngritjen e njësive të reja për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në kuadër të zbatimit të ligjit Nr 10347 datë 4.11.2010.
- Ngritjen e kapaciteteve të njësive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel qarku/bashkie/komune.
- Rritja e numrit te stafit të ASHMDF.
- Implementimi i metodologjisë veprimit të njësive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për trajtimin e rasteve të fëmijëve në rrezik
- Trajnime/ëorkshope në nivel qëndror/vendor lidhur me cështje të mbrojtjes/respektimit së të drejtave të fëmijëve.
- Ngritja e një sistemi të unifikuar treguesish statistikor për vlerësimin e realizimit të te drejtave të fëmijëve.
- Rajonalizimi i kujdesit neonatal në nivel qarku simbas niveleve të kujdesit
- Trajnimi personelit që ofron kujdes obstetrikal dhe neonatal mbi praktikat (evidence based) të kujdesit për foshnjen e porsalindur;
- Perfshirja te indikatorëve për kujdesin perinatal në sistemin kombetar të indikatoreve shëndetësor, të disagreguar simbas gjendjes social ekonomike, barazisë gjinore, seksit, ndarjes gjeografike;
- Ofrimi i promocionit dhe edukimit shëndetësor të ndjeshem ndaj gjinisë per ndërgjegjesimin e familjeve, komunitetit për mënyrat e shëndeteshme të ushqyerjes dhe aktivitetit fizik tek fëmijët;
- Hartimi dhe zbatimi i aktiviteteve ndersektoriale për përmirësimin e sigurimit te ushqimit për fëmijët në familjet e grupeve tëpopullsisë me në disavantazh;
- Përgatitja e protokolleve të unifikuara për ndjekjen e rregullt te rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve nga personeli i kujdesit shëndetësor parësor;
- Vendosja e sistemit te rregullt te supervizionit të shërbimeve të shëndetit të fëmijës;
- Ofrimi i promocionit dhe edukimit shëndetësor për ndërgjegjësimin e familjeve, komunitetit për mënyrat e shëndetëshme të ushqyerjes dhe aktivitetit fizik të ndjeshem ndaj gjinisë;
- Vaksimi i plotë në kohë i fëmijëve simbas kalendarit kombëtar të vaksinimit dhe zgjerimi i skemës të vaksinimit nëpërmjet futjes së vaksinave te reja;

- Promovimi dhe përdorimi i modelit të Manaxhimit të Integruar të Sëmundjeve Kryesore të Fëmijërisë, për ndjekjen dhe trajtimin e femijeve 0-5 vjeç në të gjitha shërbimet e kujdesit për fëmijën;
- Promovimi programeve edukuese për reduktimin e keqtrajtimit dhe dhunes në shkolla, familje dhe komunitete;
- Ofrimi i mbështetjes sociale dhe psikologjike në shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijët dhe adoleshentet që janë ekspozuar ndaj ambienteve të dhunshëm;
- Promovimi i programeve të stimulimit të hershëm konjitiv dhe psikosocial të fëmijëve, me vëmendje të veçantë ndaj grupeve të fëmijeve me nevoja të veçanta dhe në dizavantazh.

Aktivitete ne lidhje me te drejtat e minoriteteve:

- Organizimi i takimeve periodike të Sektorit të Minoriteteve me përfaqësuesit e shoqatave të minoriteteve në vendin tonë;
- Tryezë e rrumbullakët me pjesëmarrjen e shoqatave të minoriteteve, shoqërisë civile si dhe institucioneve shtetërore, mbi përmirësimin e kuadrit ligjor mbi minoritetet;
- Organizimi i takimeve periodike të Grupit ndërministror të punës, lidhur me hartimin e Raportit të Katërt periodik mbi zbatimin e angazhimeve të ndërmarra në kuadrin e Konventës Kuadër "Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare";
- Zhvillimi dhe nxitja e dialogut zyrtar me përfaqësuesit e minoriteteve dhe mbështetja e aktiviteteve të shoqatave që përfaqësojnë minoritetet;
- Përmbushja e angazhimeve të ndërmarra në fushën e respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të minoriteteve, për arritjen e standardeve më të larta në këtë fushë;
- Përmirësimi i kuadrit ligjor për minoritetet në mënyrë që të përmbushë kërkesat e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës "Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare";
- Zhvillimi, nxitja, mbështetja e dialogut zyrtar me përfaqësuesit e shoqatave të minoriteteve dhe e aktiviteteve të shoqatave që përfaqësojnë minoritetet;
- Hartimi i Raportit të Katërt periodik mbi zbatimin e angazhimeve të ndërmarra në kuadrin e Konventës Kuadër "Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare".
- Kremtimi i Ditëve Ndërkombëtare të Minoriteteve në Shqipëri. Këto veprimtari organizohen dhe kanë një shtrirje gjithëvjetore;
- Organizimi i ceremonive dhe takimeve jubilare për festimin e përvjetorëve të krijimit të Shoqatave dhe organizmave të ndryshme që përfaqësojnë kulturën e minoriteteve në Shqipëri;
- Veprimtari në bashkëpunim me Shoqatën e Arumunëve të Shqipërisë pranë shkollës së gjuhës arumune në Divjakë;
- Pjesëmarrje në nivel të lartë në Konferencën Ndërkombëtare në Gjenevë mbi të drejtat e minoriteteve;
- Në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, janë organizuar një sërë veprimtarish mbi të drejtat e minoritetit rom dhe ruajtjen e identitetit të tyre në Shqipëri.
- Përmirësimi i dhënies së shërbimeve të ZRPP në të gjithë Shqipërinë;
- Zbatimi i Strategjisë së IT (Information Technology Strategy) nëpërmjet kompjuterizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive te paluajtshme;

- Kryerja e investimeve për rikonstruksionin, zgjerimin dhe pajisjen e ambienteve të punës së Zyrës Qendrore dhe Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- Përfundimi i Regjistrimit Fillestar i 400.000 pasurive të paluajtshme në zonat urbane.
- Zhvillim i mëtejshëm i kuadrit rregullator;
- Rishikimi, përditësimi dhe përgatitja e të akteve te nevojshme ligjore e nënligjore qe do të mundësojnë implementimin e strategjisë afatgjate të ZRPP-së, akte që do të mundësojnë rregullimin e procedurave te regjistrimit dhe lëshimit të dokumenteve të pronësie dhe të të drejtave reale mbi pasuritë, në rrugë elektronike;
- Ngritja e kapaciteteve administrative. Kryerja e trajnimeve të stafit të ZRPP për procedurat dhe legjislacionin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe punën me sistemin e kompjuterizuar të regjistrimit;
- Ngritja e kapaciteteve administrative;
- Dixhitalizimi i dokumentacionit arkivor ekzitues (dokumentet ligjore, kartelat dhe hartat treguese të regjistrimit) për zyrat e tjera vendore të regjistrimit;
- Zbatimi i arkitekturës miratuar elektronik të sistemit të regjistrimit dhe ngritjen e hardëare, softëare infrastrukturës, rrjetit kompjuterik dhe adaptimin e zonave në zyrat e regjistrimit të tjera lokale;
- Zbatimi i arkitekturës së miratuar të sistemit elektronik të regjistrimit dhe ngritja e infrastrukturës hardëare, softëare, rrjet kompjuterik dhe përshtatja e ambienteve në zyrat e tjera vendore të regjistrimit;
- Aksesimi i noterëve në sistemin elektronik në zyrate tjera vendore të regjistrimit;
- Vazhdimi i proçesit të regjistrimit fillestar;
- Identifikimi dhe krijimi i fondit fizik të tokës (toka dhe ndërtesat nën pronësinë të shtetit).
- Evidentimin e trojeve të lira, brenda zonave të stimuluara, për efekt të kompensimit fizik të ish-pronarëve;
- Krijimin e një baze të dhënash dixhitale për informacionin gjeografiko-hartografik GIS të të gjitha vendimeve për njohjen/kthimin apo kompensimin e pronës të dhëna në vite;
- Hartimi i një baze të dhënash arkivore dixhitale për të evidentuar të gjitha vendimet e dhëna ndër vite nga organet paraardhëse që kanë ushtruar këtë veprimtari administrative;
- Dixhitalizimin e Arkivës së Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, në bashkëpunim edhe me donatorë vendas apo të huaj;
- Dixhitalizimin dhe informatizimin e të gjithë veprimtarisë së Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, në mënyrë që ky institucion të jetë transparent dhe i hapur për publikun dhe personat e interesuar në lidhje me veprimtarinë e saj;
- Fillimi i procedurave të aplikimit dhe shpërndarjes së fondit në të holla për subjektet që preken nga ndërtimet informale;
- Fillimi i procedurave të aplikimit dhe shpërndarjes së fondit në të holla për subjektet e shpronësuara prona e të cilëve është njohur për kompensim;
- Trajnimi i stafit të AKKP-së për ngritjen e kapaciteteve të tyre.

Aktivitet ne fushen e Mbrojtjes se te Dhenave Personale:

- Intensifikimi i zhvillimit të inspektimeve, dhënies së rekomandimieve, si dhe dhënies së masave admistrative sipas parashikimeve ligjore;

- Autoriteti i Komisionerit do të rrisë kualitetin dhe performancën e saj, medodat e punës dhe organizimin e saj;
- Njoftimin nga subjektet kontrollues;
- Njoftime në shtyp për subjektet që nuk kanë njoftuar sipas nenit 21 të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- Monitorim i vazhdueshëm i përpunimit të të dhënave nga të gjithë kontrolluesit publik dhe privat;
- Ndërgjegjësim i publikut të gjerë për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale.
- Rritja e volumit dhe të trajtimit të njoftimit nga subjektet kontrollues, si dhe rritje progresive e subjekteve që regjistrohen.

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.23.3 Të drejtat themelore

Në Lekë

	2012	**2013**	**2014**	**2015**
Kostot totale e vlerësuar	**45.237.000**	**46.000.000**	**48.000.000**	**49.000.000**
Mbulohen nga buxheti i	45.237.000	46.000.000	48.000.000	49.000.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.24. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA

3.24.1. KUFIJTË E JASHTËM

Objektivi strategjik

Menaxhimi dhe siguria në kufi, përbën një angazhim dhe është e shprehur dhe në misionin e Policisë Kufitare dhe Migracionit, si në raport me detyrimet ligjore, politike dhe sigurinë kombëtare brenda vendit, ashtu edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare veçanërisht në procesin e anëtarësimit në strukturat euroatlantike, për ndërtimin e besimit me shtetet fqinje dhe më gjerë, si dhe për të kontribuar në luftën kundër krimit të organizuar.

Menaxhimi efiçent i kufirit dhe siguria në kufi, janë të rëndësishme jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë rajonin. Për këtë arsye, Policia Kufitare dhe Migracionit është e angazhuar të punojë së bashku me organizatat homologe për të arritur, në shkallë rajonale, për realizimin në praktikë të parimit të kufijve të hapur, por në të njëjtën kohë të kontrolluar dhe të sigurt.
Do të forcohet kontrolli i kufijve për të parandaluar aktivitetet kriminale, si dhe çdo aktivitet tjetër që mund të vërë në rrezik sigurinë. Këto kontrolle do të synojnë të pengojnë kryerjen e aktivitete ilegale ndërkufitare, duke parandaluar ose duke zbuluar aktivitetet e tyre.
Lufta ndaj trafiqeve të të gjitha llojeve, imigracionit të paligjshëm, terrorizmit dhe krimit të organizuar, janë në fokusin e strukturave që merren me kontrollin e kufirit. Kontrolli i "dyerve" konsiderohet mjaft i dobishëm dhe efiçent për parandalimin e zhvillimit dhe përhapjes së krimit, ndëshkimin e kriminelëve dhe pakësimin e përfitimeve të tyre të paligjshme.

Institucionet kombëtare (sidomos policia kufitare, doganat, autoritetet fito-sanitare, veterinare etj.) bashkëpunojnë dhe do të punojnë për forcimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, për t'i bërë pikat e kalimit të kufirit më efiçente, si për sa i përket flukseve të mallrave dhe personave, ashtu edhe për sa i përket kontrollit të aktiviteteve kriminale ndërkufitare.

Forcimi i masave për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror bazohet në standardet e Katalogut Schengen.
Gjithashtu bashkëpunimi në fushën e menaxhimit të kufijve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenin 80 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Situata aktuale

Baza ligjore e PKM është e plotë në drejtim të kufijve të jashtëm. Ekziston një Strategji Kombëtare Ndërsektoriale për MIK dhe Plani i saj i Veprimit, i cili është përditësuar në vitin 2009. Gjithashtu është përafruar baza ligjore me legjislacionin e BE-së dhe Procedurat e Punës së PKM, janë përshtatur sipas Katalogut Schengen. PKM është e pajisur me infrastrukturë dhe pajisje moderne të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit shtetëror.

Tashmë Policia e Kufirit dhe Migracionit, është qartësisht e strukturuar brenda Policisë së Shtetit, me burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe teknike. Procedurat Standarde Operative, janë tashmë një realitet dhe përbëjnë një tregues të qartë të standardizimit të punës së kësaj strukture me ato të standardeve Schengen.

Ato janë përgatitur dhe miratuar bazuar në Rregulloren (EC) Nr. 562/2006, Rregulloren (EC) Nr. 296/2008 dhe Manualin Schengen. Në vitin 2013 do të aktivizohet Grupi Ndërministror i Punës për hartimin e projektit të Strategjisë së re të Menaxhimit të Integruar të Kufirit, për vitet 2014-2018.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/nënligjore në këtë nënkapitull, janë:

- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë
- Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë
- Ligj Nr. 9749 , datë 04.062007 "Për Policinë e Shtetit"
- Ligji Nr. 9861, datë 24.1.2008 "Për kontrollin e mbikëqyrjen e kufirit". Ky ligj është i përafruar pjesërisht me:
  - Rregulloren (EC) Nr. 562/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 Mars 2006 që krijon një Kod të Komunitetit mbi rregullat që qeverisin lëvizjen e personave ndërmjet kufijve (Kodi i Kufijve Schengen) (GZ L 105, datë 13 Prill 2006, fq.1);
  - Vendimi i Këshillit 2003/170/JHA datë 27 Shkurt 2003 mbi përdorimin e përbashkët të oficerëve ndërlidhës të postuar jashtë vendit nga agjencitë e zbatimit të ligjit të Shteteve Anëtare (GZ L 67, datë 12 Mars 2003, fq.27);
  - Vendimi i Këshillit 2006/560/JHA, datë 24 Korrik 2006 që ndryshon Vendimin 2003/170/JHA Mbi përdorimin e përbashkët të oficerëve ndërlidhës të vendosur jashtë vendit nga agjencitë e zbatimit të ligjit nga Shtetet Anëtare (GZ L 219, datë 10 Gusht 2006, fq.31).
- Ligji Nr. 8663, datë 18.9.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 t".
- Ligji Nr.9509, datë 3.4.2006 "Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese në Republikën e Shqipërisë".
- Konventa e Bashkëpunimit Policor ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore, nënshkruar më 5 Maj 2006 dhe hyrë në fuqi në 10 Tetor 2007.
- Marrëveshja e Bashkëpunimit me KFOR-Kosovë, nënshkruar më datë 13.08.2008.
- Marrëveshje Teknike e Bashkëpunimit me FRONTEX, e nënshkruar më datë 19 shkurt 2009.
- Ligji Nr.9893, datë 27.3.2008 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për Bashkëpunimin Policor Ndërkufitar""
- Memorandumi i Mirëkuptimit me vendet e Ballkanit Perëndimor "Për paralajmërimin e hershëm dhe shkëmbimin e të dhënave statistikore migracionin e paligjshëm", nënshkruar më 20 Nëntor 2008 dhe implementuar më 1 janar 2009.

- Protokolli me Malin e Zi “Për patrullimet e përbashkëta në kufi”, nënshkruar më 22 shkurt 2008 dhe hyrë në fuqi më 1 janar 2009.
- Protokolli me Maqedoninë “Për organizmin dhe kryerjen e takimeve të rregullta mes drejtuesve të Policive Kufitare në të gjitha nivelet”, nënshkruar më 22 Shkurt 2008 dhe hyrë në fuqi po në këtë datë.
- Protokolli me Malin e Zi “Për organizimin dhe kryerjen e takimeve të rregullta mes drejtuesve të Policive Kufitare në të gjitha nivelet”, nënshkruar më 22.02.2008 dhe hyrë po në këtë datë.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.668, datë 29.9.2007 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare "Menaxhimi i Integruar i Kufirit" dhe të Planveprimit””, i cili është përafruar në mënyrë të pjesshme me:
  - Rregulloren (EC) Nr. 562/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 Mars 2006 që krijon një Kod të Komunitetit mbi rregullat që qeverisin lëvizjen e personave ndërmjet kufijve (Kodi i Kufijve Schengen) (GZ L 105, datë 13 Prill 2006, fq.1);
  - Rregulloren (EC) Nr. 296/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datë 11 Mars 2008 i cili ka ndryshuar Rregulloren (EC) Nr. 562/2006 i cili ka krijuar një Kod të Komunitetit mbi rregullat që qeverisin lëvizjen e personave ndërmjet kufijve (Kodi I Kufijve Schengen), në lidhje me kompetencat zbatuese të dhëna Komsionit (GZ L 97 datë 9 Prill 2008, fq.60)
  - Rregulloren (EC) Nr. 81/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datë 14 Janar 2009 që ndryshon Rregulloren (EC) Nr. 562/2006 lidhur me përdorimin e Sistemit të Informacionit për Vizat (VIS) sipas Kodit të Kufijve Schengen (GZ L 35, datë 4 Shkurt 2009, fq.56).
- Vendimi i Këshillit te Ministrave Nr. 1021, date 14.10.2009, “Për miratimin e Planit të Veprimit të Përditësuar të Strategjisë Kombëtare te MIK-ut”.
- Vendimi Nr. 954, date 30.09.2009, “Për organizimin, strukturën, dhe funksionimin e QNOD-se”.
- Vendimi Nr. 1125, date 13.11.2009, “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 954, date 30.09.2009, “Për organizimin, strukturën, funksionimin e QNOD-se dhe bashkëveprimin me institucionet qe kane interesa ne det””.
- Vendimi Nr. 1018, date 30.09.2009, “Për përcaktimin e standardeve dhe kritereve të kontrollit në PKK e Republikës së Shqipërisë” Ky vendim përputhet pjesërisht me Regulation (EC) N° 562/2006, Regulation (EC) No 296/2008 dhe Manualin Schengen.
- Urdhri i Ministrit të Brendshëm Nr. 1240, datë 13.10.2008 "Për përbërjen dhe funksionimin e Komisioneve kryesore dhe sektoriale të përzier me shtetet fqinj për çështjet kufitare”.
- Marrëveshja “Për hapjen e PPKK Muriqan – Sukobinë”, nënshkruar me 17 Janar 2007 dhe Protokollit me Malin e Zi “Për funksionimin e PPKK Muriqan – Sukobinë”, nënshkruar me 18 Qershor 2009. Kjo marrëveshje perputhet me Rregulloren (EC) N° 562/2006, Rregulloren (EC) No 296/2008.
- Tre marrëveshjet dhe tre protokollet “Për kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit në PKK Morinë-Vermicë, Qafë Morinë dhe Qafë Prush me Kosovën”, nënshkruar me 3 Prill 2011. Këto marrëveshje përputhen me Rrgulloren (EC) N° 562/2006, Rregulloren (EC) No 296/2008.

Struktura institucionale

Institucioni përgjegjës për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror është Policia Kufitare dhe e Migracionit, e cila është pjesë përbërëse e Policisë së Shtetit. Struktura e saj është vertikale sipas parimit "komandë-kontroll".

Misioni i saj është:

- të kontrollojë dhe mbikëqyrë kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë;
- të sigurojë kushtet e përshtatshme për kalimin legal të shtetasve shqiptarë e të huaj dhe të mjeteve nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- të marrë masa për parandalimin e kalimeve të paligjshme të kufirit, njerëzve, mallrave e mjeteve;
- të organizojë punën për të parandaluar e goditur trafiqet ilegale, që zhvillohen nëpërmjet kufirit shtetëror;
- të sigurojë kushtet për kontrollin e shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë.

Aktualisht Policia Kufitare, si pjesë përbërëse e Policisë së Shtetit, është e organizuar, në qendër, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin me 3 drejtori dhe një zyrë:

- Drejtoria e Shërbimeve Operacionale
- Drejtoria e Migracionit dhe Ripranimeve
- Drejtoria e Administratës së Kufirit e Migracionit
- Zyra e Analizës së Riskut dhe Krimit Ndërkufitar.

Në bazë është e organizuar me 8 Drejtori Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, 3 komisariate, stacione të PKM dhe Njësinë e Lëvizshme Territoriale të Kufirit e Migracionit "Delta-Force".

Bashkëpunimi realizohet sipas drejtimeve qe parashikon Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufijve;

Bashkëpunimi brenda shërbimit realizohet nëpërmjet bashkëpunimi vertikal—koherencë përgjatë linjës së komandës psh. nga Policia Kufitare deri tek Ministria e Brendshme dhe bashkëpunimi horizontal—komunikimi ndërmjet niveleve administrative që nga organi shtetëror deri tek njësitë që punojnë në kufi. Bashkëpunimi brenda shërbimit garantohet nga dy elementë kryesorë:

- Procedura standarde për veprimtarinë e shërbimit dhe shkëmbimin e informacionit.
- Teknologji me pajisje të përshtatshme që lehtësojnë veprimtarinë e mësipërme.

Bashkëpunimi ndërmjet agjencive realizohet në koordinimin e punës në pikat e kalimit kufitar dhe operacionet e përbashkëta në kufijtë e gjelbër dhe blu, aksesi në sistemet qendrore të integruara të teknologjisë së informacionit, shkëmbimin e informacionit dhe punën e përbashkët në forcimin e masave për sigurinë kufitare. Aktualisht bashkëpunimi ndërmjet agjencive të përfshira në menaxhimin e kufirit shtetëror është në nivelin e duhur, si në nivelin qendror ashtu dhe rajonal dhe lokal.

Bashkëpunimi ndërkombëtar bazohet në bashkëpunimin rajonal dhe më gjerë. Ky bashkëpunim zbatohet; në nivel lokal ndërmjet punonjësve në të dy anët e kufirit, dypalësh

ndërmjet shteteve fqinje dhe bashkëpunimin shumëpalësh të fokusuar në çështjet e menaxhimit të kufirit. Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe të bashkëpunimit dhe marrëveshjeve të ripranimit.
Ky bashkëpunim realizohet;

- ndërmjet zyrtarëve në të dyja anët e kufirit;
- ndërmjet rajoneve kufitare;
- midis vendeve fqinje;
- ndërkombëtar për çështjet e menaxhimit kufitar.

Masat legjislative afatshkurtra

- Hartimi i Protokollit shtesë për procedurat e punës në PPKK Muriqan-Sukobinë, me Malin e Zi.
- Hartimi i Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit "Për përgatitjen e draftit të planifikimit elektronik".
- VKM "Për miratimin e marrëveshjes "Për qendrën e përbashkët të shkëmbimit të informacionit me Republikën e Greqisë"".
- VKM "Për miratimin e marrëveshjes "Për qendrën e përbashkët të shkëmbimit të informacionit me Maqedoninnë"".
- VKM "Për miratimin e marrëveshjes "Për qendrën e përbashkët të shkëmbimit të informacionit me Republikën e Kosovës""
- VKM "Për miratimin e marrëveshjes "Për qendrën e përbashkët të shkëmbimit të informacionit me Maqedoninë".
- VKM "Për miratimin e Marrëveshjes për PKK e Përbashkët Grabon-Zatrijebacka Cijena, me Malin e Zi"".

Masat zbatuese afatshkurtra

- Ngritja e qendrave të përbashkëta të shkëmbimit të informacionit me Malin e Zi, Kosovë, Maqedoni, Greqi.
- Hapja e PKK së Përbashkët Grabon-Zatrijebacka Cijena, me Malin e Zi.
- Implementimi i planifikimit elektronik të punës në strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit.
- Përgatitja e procedurave të punës për qendrat e përbashkëta të shkëmbimit të informacionit me Malin e Zi, Kosovë, Maqedoni, Greqi.

Masa legjislative afatmesme

- Urdhri i Kryeministrit "Për Ngritjen e Grupit Ndërministror të Punës "Për Hartimin e Strategjisë MIK dhe Planit të Saj të Veprimit, 2014-2018".
- Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë MIK dhe Planit të saj të Veprimit 2014-2018".

Masat zbatuese afatmesme

- Funksionimi i qendrave të përbashkëta të shkëmbimit të informacionit me Malin e Zi, Kosovën, Maqedoninë, Greqinë.
- Vlerësimi i standardeve të Policisë Kufitare duke u bazuar në Standardet Schengen:
    - Ngritja dhe trajnimi i grupeve të vlerësimit;
    - Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë për vlerësimin;
    - Vlerësimin e standardeve të Katalogut Shengen.
- Vazhdimi i procesit të trajnimit të PKM sipas Strategjisë së Trajnimit 2011-2016.
    - Përfundimi i trajnimit një mujor i punonjësve të PKM nga grada Inspektor deri Nënkomisar.
    - Trajnime një javore dhe të specializuara për specifikat e punës së PKM.

QENDRA NDËRINSTITUCIONALE OPERACIONALE DETARE

Misioni: Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) është një institucion ndërdikasterial që ka për detyrë të sigurojë vëzhgimin e hapësirës detare shqiptare, për të realizuar organizimin, planizimin, bashkërendimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjislacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar.

Qëllimi i kësaj qendre është përcaktimi i kritereve të përgjithshme për të unifikuar veprimet e funksionarëve të institucioneve qendrore shtetërore që kanë përgjegjësi dhe interesa në det, të përfaqësuara në QNOD për garantimin e kontrollit civil të operacioneve detare.

Garantimi i kontrollit civil të operacioneve bazohet në strukturën drejtuese civile, legjislacionin kombëtar dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara dhe të pranuara nga Republika e Shqipërisë.

Në bazë të VKM Nr. 439, datë 13.05.2011 janë miratuar "Politikat dhe Proçedurat e Funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)", e cila garanton organizimin, strukturën, funksionimin e QNOD-së dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore që kanë interesa në det.
Këtu përfshihen: Ministria e Brendshme; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Financave; Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave; Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit; Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
QNOD garanton menaxhimin dhe kontrollin e kufijve detarë shqiptarë, sigurinë e jetës në det dhe ndërveprimin e institucioneve shtetërore që kanë përgjegjësi dhe interesa në hapësirën detare.

Ky objektiv arrihet nëpërmjet:

- Harmonizimit dhe aplikimit të Proçedurave Standarde Operacionale;
- Zhvillimit të stërvitjeve të përbashkëta ndërmjet QNOD dhe institucioneve pjesëmarrëse në të;
- Rritjes së performancës dhe rolit të QNOD si qendër bashkëreduese kombëtare me të gjithë institucionet që kanë interesa të përbashkëta në det;

- Modernizimit të sistemeve aktuale dhe implementimit të sistemeve të reja për vëzhgimin e integruar të hapësirës detare.

Situata aktuale

Ndërveprimi në përgjithësi përfshin, përdorimin e të njëjtave doktrina dhe manuale për suksesin e operacionit. Me qëllim unifikimin e këtyre manualeve, QNOD do të marrë iniciativën duke propozuar hartimin, miratimin dhe botimin e tyre. Disa nga manualet dhe dokumentet më të rëndësishme për përmbushjen e misionit të QNOD-së, janë:

- Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë
- Politikat dhe proçedurat e funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare
- Manuali i Kërkimit dhe Shpëtimit në Det
- Manuali i Rojës Bregdetar
- Plani Kombëtar i Emergjencave etj.

– Sistemet elektronike në dispozicion të QNOD-së:

Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD) kontrollon dhe menaxhon hapësirën detare. Ai përbehet nga 7 radarë të cilët komunikojnë me anë të një sistemi të qendërzuar të përpunimit të të dhënave në QNOD. Aktualisht është përfunduar instalimi i sistemit të radio-komunikimit TETRA (sistem i integruar me SIVHD, i cili është sistem komunikimi i kriptuar për drejtimin e operacioneve në det nga ana e QNOD-së) dhe ai i Blue-Box-it (monitoron dhe vëzhgon hapësirën detare në formë satelitore i instaluar në Peshkatoret Shqiptare me gjatësi mbi 12 m).

– Asetet në dispozicion të QNOD-së:
  - Mjete të Policisë Kufitare (25)
  - Mjete të Doganës (7)
  - Mjete të Rojes Bregdetare (31)

– Regjimet juridike në det:

***1.* Regjimi i shërbimit të ndihmës dhe kërkim – shpëtimit në det:**

<u>Institucioni përgjegjës kombëtar</u>:
Ministria e Mbrojtjes (Roja Bregdetare).
<u>Operacionet:</u>

- Operacionet për dhënien e ndihmës në det
- Operacionet e kërkimit dhe shpëtimit në det

***2.* Regjimi i lundrimit dhe siguria në det**

<u>Institucionet përgjegjëse kombëtare</u>:
Ministria e Mbrojtjes (Roja Bregdetare);
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.
<u>Operacionet:</u>

- Operacionet për zbatimin e ligjeve për sigurinë e lundrimit dhe të jetës në det.
- Operacionet për sigurinë e trafikut detar, zbatimin e ligjit për zonat endaluara për lundrim dhe regjimin e kushteve të forcës madhore.
- Operacione për zbatimin e ligjit mbi kalimin paqësor të anijeve të huaja.

3. **Regjimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit detar**

Institucionet përgjegjëse:

Ministria e Brendshme (Departamenti i Kufirit dhe Migracionit),
Ministria e Mbrojtjes (Roja Bregdetare),
Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave)
Ministria e Mjedisit, Pyjeve Administrimit të Ujërave (Inspektoriati i Peshkimit).

Operacionet:

- Operacionet për zbatimin e ligjit për kalimin e paligjshëm të kufirit të njerëzve dhe mallrave.
- Operacionet e luftës kundër terrorizmit.
- Operacionet e luftës kundër drogës.
- Operacionet e luftës kundër përhapjes së Armëve të Dëmtimit në Masë.
- Operacione për shkeljen e ligjit të peshkimit nga anijet e huaja.

4. **Regjimi doganor**

Institucioni përgjegjës:

Ministria e Financave (Drejtoria e përgjithshme e Doganave).

Operacionet:

- Operacionet për zbatimin e legjislacionit doganor dhe fiskal

5. **Regjimi i peshkimit dhe akuakulturës**

Institucioni përgjegjës:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Operacionet:

- Operacione për zbatimin e ligjit për peshkimin dhe akuakulturën.

6. **Regjimi i mbrojtjes së mjedisit detar**

Institucionet përgjegjëse:

Ministria e Mjedisit, pyjeve dhe Administrimit të Ujërave,
Ministria e Mbrojtjes (Roja Bregdetare)
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (Administrata Detare).

Operacionet:

Operacionet për mbrojtjen e mjedisit detar, masat e marra dhe reagimin në rast ndotje të mjedisit detar.

7. **Regjimi i mbrojtjes së pasurive detare dhe nëndetare**

Institucioni përgjegjës:

Ministria e Mbrojtjes (Roja Bregdetare) dhe Ministritë e tjera që kanë përgjegjësi dhe interesa në det.

Operacionet:

- Operacione që konsistojnë në zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për studimin dhe shfrytëzimin e pasurive detare dhe nëndetare

8. **Regjimi i mbrojtjes së pasurive historike dhe arkeologjike**

Institucioni përgjegjës: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Operacionet:

- Operacionet për mbrojtjen e pasurive historike dhe arkeologjike konsistojnë në zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për shfrytëzimin dhe studimin e pasurive historike dhe arkeologjike

9. **Regjimi i lundrimit turistik**

Institucioni përgjegjës:

Ministria e Turizmit Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (Administrata Detare).
Operacionet: konsistojnë në zbatimin e ligjit për lundrimin turistik dhe zhytjet sportive. Këto operacione realizohen nga QNOD në ujërat e brendshme detare dhe detin territorial.

***10.* Regjimi fito-sanitar**

Institucioni përgjegjës:
Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit
Operacionet: për zbatimin e legjislacionit fito-sanitar. Realizohet nga QNOD në ujërat e brendshme detare dhe detin territorial.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Konventa e Kombeve të Bashkuara "Mbi të Drejtën e Detit" firmosur në Montego Bay, Jamaica 10 dhjetor 1982;
- Konventa Ndërkombëtare Për Sigurinë e Jetës në Det, SOLAS 1974/1978;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope 1988;
- Konventa Ndërkombëtare mbi kërkim – shpëtimin detar, Hamburg 1979;
- Konventa Ndërkombëtare e Torremolinos "Mbi sigurinë e anijeve të peshkimit", Sfv-1977;
- Konventa Ndërkombëtare "Për parandalimin e ndotjeve nga anijet në det", Marpol-1973/78;
- Ligji Nr.10027 datë 11.12.2008 "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore", Paris 2001;
- Protokolli mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve në plotësim të konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar;
- Ligj Nr.9251, datë 8.7.2004 "Kodi detar i Republikës së Shqipërisë";
- Ligji Nr. 8449 datë 27.01.1999 "Për kodin doganor të Republikës së Shqipërisë";
- Ligji Nr.10109, datë 2.4.2009, "Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë";
- Ligji Nr. 9749, datë 4.6.2007 "Për policinë e shtetit";
- Ligji Nr. 8875, datë 4.4.2002 "Për Rojën Bregdetare shqiptare", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9861, datë 24.1.2008 "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror";
- Ligji Nr. 8663, datë 18.9.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT";
- Ligji Nr. 10220 datë 4.4.2010 "Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 7908, datë 5.4.1995 "Për peshkimin dhe akuakulturën", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8671 datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit strategjik të FA RSH";
- Ligji Nr. 8290 datë 24.2.1998 "Për përdorimin e armëve të zjarrit";
- Ligji Nr. 9093 datë 3.7.2003 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun";

- Ligji Nr. 9401 datë 19.5.2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për nxitjen e respektimit të masave ndërkombëtare të menaxhimit dhe të ruajtjes së burimeve nga anijet e peshkimit në det të hapur”;
- Ligji Nr. 9822 datë 29.10.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut (ICCAT - International Convention for the Conservation of Atlantic Tuna)”;
- V.K.M. Nr. 606 datë 4.12.2002 "Për miratimin e manualit të rojës bregdetare";
- V.K.M. Nr. 954, datë 30.9.2009 “Për organizimin, strukturën, funksionimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare dhe bashkëveprimit me institucionet shtetërore që kanë interesa në det” (i ndryshuar);
- V.K.M. Nr. 205, datë 13.3.1999 “Për dispozitat zbatuese të kodit doganor të Republikës së Shqipërisë”;
- V.K.M. Nr. 1062, datë 16.7.2008 “Për përcaktimin e kompetencave të inspektoratit të peshkimit dhe ngritjen e sistemit të kontrollit për zbatimin e politikave menaxhuese në peshkim”.

Struktura institucionale

Organograma e QNOD-së përbëhet nga: Personeli i QNOD-së, Personeli i Ministrive të Linjës dhe Sistemet dhe asetet.
QNOD ka në përbërje strukturore personel nga të gjitha institucionet që kanë kompetenca dhe kryejnë detyra në hapësirën detare, sipas nenit 32 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, siç janë:

- Ministria e Financave (prani 24-orësh të doganave);
- Ministria e Brendshme (prani 24-orësh të Policisë së Kufirit dhe Migracionit);
- Ministria e Mbrojtjes (prani 24-orësh të Rojës Bregdetare);
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (prani 24-orësh të Inspektoratit të Peshkimit);
- Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (kapacitet bashkërendues sipas nevojës);
- Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (kapacitet bashkërendues sipas nevojës);
- Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (kapacitet bashkërendues sipas nevojës).

Personeli i caktuar në QNOD përfaqëson institucionet e sipërpërmendura dhe janë në varësi të institucionit, që përfaqësojnë.
Përfaqësuesit e institucioneve pjesëmarrëse në QNOD garantojnë zbatimin e të gjitha detyrave dhe misionit që ka QNOD, për zhvillimin e operacioneve në det.

Drejtori Administrativ i Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare është drejtuesi më i lartë që ngarkohet me autoritet dhe përgjegjësi, për të siguruar mbarëvajtjen, funksionimin dhe efektivitetin e qendrës dhe të njësive që varen apo jepen përkohësisht në varësi të saj.

Personeli i QNOD-së përbëhet nga 28 punonjës.

Përfaqësues të ministrive në QNOD, janë në total 51 punonjës.

Masat Afatshkurtra

Masat legjislative afatshkurtra

- Propozimi dhe bashkëpunimi për projektin e SAR-it kombëtar.
- Bashkëpunimi për përsosjen e legjislacionit për sportet e ujit.
- Bashkëpunimi në lidhje më projektin e legjislacionit mbi moratoriumin e skafeve.
- Përmirësimin e VKM 439, datë 13.05.2011 mbi "Politikat dhe Proçedurat e Funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)".

Masat zbatuese afatshkurtra

- Zhvillimi i stërvitjes së përbashkët për operacionet detare ndërmjet QNOD-së dhe flotës së VI Amerikane. (Mars 2012). Gjatë vitit do të zhvillohen në mënyrë periodike stërvitje me Flotën e VI Amerikane në lidhje me problematika të ndryshme.
- Trajnimet e mëtejshme për personelin e QNOD-së dhe institucioneve pjesëmarrëse në të, si:
    - Familjarizimi e njohja me teatrin detar dhe specifikat e veçanta gjeografike;
    - Njohja dhe përdorimi i radiove Sepura STP 8000 dhe SRG 3900;
    - Njohuri mbi anglishten detare;
    - Njohuri mbi komunikimin detar për personelin pranë QNOD-së;
    - Hetimi i fatkeqësive dhe aksidenteve detare;
    - Planifikimi e menaxhimi i emergjencave civile;
    - Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, drogës dhe armëve.

Masat Afatmesme

Masat legjislative afatmesme

- Përafrimi legjislacioneve mbi detin në përputhje me standardet e BE.
- Realizimi i marrëveshjeve të ndryshme me shtetet fqinje që kanë qendra homologe me QNOD.
- Perfeksionimi i legjislacionit në lidhje me ndotjet në det.
- Inicimi i një vendimi për pavarësinë ekonomike të menaxhimit dhe buxhetit të integruar të institucioneve pjesëmarrëse në QNOD.
- Rritja e kompetencave në det për aplikimin e penaliteteve ndaj shkelësve të ligjeve në det.

Masat zbatuese afatmesme

- Ngritja e një grupi pune për hartimin e manualit të sistemeve në dispozicion të QNOD-së.
- Ngritja e një grupi pune për hartimin e manualit për mjetet detare në dispozicion të QNOD-së.
- Trajnimi i mëtejshëm i personelit në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurisë dhe regjimeve në det.

- Ngritja e një grupi pune për vlerësimin e riskut.
- Implementimi i projekteve të reja për modernizimin e sistemeve në QNOD. Ngritja e një grupi pune ndërinstitucional për të gjetur modulet e përshtatshme ekonomike dhe ligjore në pavarësinë e menaxhimit të financimit dhe përdorimit të fondeve me buxhet të integruar.
- Ngritja e një grupi pune për harmonizimin e marrëdhënieve dhe kontakteve me institucionet homologe në rajon për dhënien dhe marrjen e informacionit për rritjen e sigurisë në det.

3.24.2. MIGRACIONI

Objektivi strategjik

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e migrimit është menaxhimi i dukurisë migratore për ta vënë këtë dukuri në shërbim të zhvillimit të përgjithshëm socio-ekonomik të vendit, njëherësh edhe në të mirë të shoqërisë, individit dhe familjes së tij, duke bërë kujdes që të ngrihet në një shkallë më të lartë mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe krijimi i lehtësirave politike, ekonomike dhe sociale për ato dhe pjesëtarët e familjeve të tyre.
Vizioni politik për fushën migratore është hartimi i Strategjisë se re Kombëtare të Migracionit dhe Planit të saj Kombëtar të Veprimit, 2013-2018.

Politika migratore e Republikës e Shqipërisë përbëhet nga politikat imigratore dhe politikat emigratore, të shprehur këto në normativën migratore të hartuar dhe miratuar për këtë qellim, në përputhje me politikën migratore dhe normativën migratore të BE-se, duke synuar minimizimin e kostove nga migracioni i paligjshëm dhe maksimizimin e përfitimeve nga migracioni i ligjshëm, si për migrantët ashtu dhe për vendet, nëpërmjet menaxhimit të flukseve migratore, duke garantuar liritë dhe të drejtat themelore të migrantëve nga njëra ane dhe luftë kundër migracionit të paligjshëm nga ana tjetër, si dhe përmes parandalimit të migracionit të parregullt, nxitjes së kthimit vullnetar dhe promovimit të lidhjes migracion-zhvillim i vendit.

Politika migratore në vetëvete përbëhet nga politika e dokumenteve të udhëtimit, politika e vizave, politika e punësimit, politika e qëndrimit, politika e ribashkimit familjar, politika e të miturve të pashoqëruar, politika e luftës kundër migracionit të paligjshëm, përfshirë këtu hyrjen e paligjshme, qëndrimin e paligjshëm, punësimin e paligjshëm, martesat me qellim dokumentacioni, përgjegjësitë e transportuesit, politika e kthimit, ripranimeve dhe riintegrimit të qëndrueshëm të të kthyerve, politika e largimeve dhe dëbimeve, politika e ndalimit, politika e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të migranteve dhe mbrojtjes së të dhënave personale, politika e masave represive dhe ankimimit, politika e integrimit të emigrantëve, etj.
Në hartimin e politikës migratore është bërë kujdes që të përafrohet ajo me traktate dhe konventa mbi migrimin, si ato të Këshillit të Evropës, OKB-së, Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO). E njëjta gjë mund të thuhet edhe për përvetësimin dhe zbatimin e praktikave më të mira administrative. Politika Migratore shqiptare është e shprehur në Kushtetutë, si kornizë garantuese e të drejtave dhe lirive të të huajve, e rregulluar me anë normativës

migratore e cila përbëhet nga legjislacioni në fuqi mbi të huajt, akteve nënligjore të dala posaçërisht si dhe urdhrave dhe udhëzimeve përkatëse.

Në interes të përafrimit të plotë të politikës migratore shqiptare me atë të BE-së, PKZMSA parashikon një ndërhyrje në normativën aktuale migratore bazuar në analizën e mangësive dhe rekomandimet e ekspertëve të BE-së, por dhe organizatave ndërkombëtare të specializuara në fushën e migracionit.

Gjithashtu në Nenet 4, 80 dhe 81 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit është parashikuar bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, në fushën e migracionit.

Situata aktuale

Menaxhimi i migracionit në Shqipëri, gjatë 5 viteve të fundit 2005-2010 është mbështetur në Strategjinë Kombëtare mbi Migracionin dhe Planin e saj të veprimit 2005-2010, si dhe normativën migratore të hartuar posaçërisht.
Përfundimi i Strategjisë Kombëtare të Migracionit si dhe Planit të saj të Veprimit, kërkon hartimin e dokumenteve të rinj mbi migracionin, së paku për një periudhë tjetër 5 -vjeçare.

Legjislacioni mbi të huajt në Shqipëri është përgjithësisht i përafruar me *acquis communautaire.* Aspektet e trajtimit të të huajve, që kanë të bëjnë me hyrjen dhe qëndrimin e tyre në Republikën e Shqipërisë, pajisjen me vizë, leje pune dhe leje qëndrimi, largimin e të huajve nga territori, masat ndëshkuese ndaj të huajve që shkelin legjislacionin mbi të huajt apo atyre që mbështesin dhe favorizojnë këto shkelje përfshirë dhe kompanitë e transportit, ndalimin e të huajve, etj, përgjithësisht janë përafruar me legjislacionin e BE-së.

Ligji Nr.9959, datë 17.07.2008 “Për të huajt” përcakton kritere të njëjta me atë të legjislacionit të BE-së, lidhur me llojet e lejeve të qëndrimit dhe afatet e lëshimit të tyre. Një rregullim më i përafruar me atë të BE-së, kërkohet të bëhet në drejtim të të drejtave për bashkim familjar, pasi në dispozitat ekzistuese janë parashikuar disa kritere te cilat nuk janë në standardet e legjislacionin të BE-së, por dhe me përcaktimet në Kodin e Familjes së Republikës se Shqipërisë.

Lejet e qëndrimit me afat të përhershëm megjithëse janë të parashikuara në ligjin në fjalë, kërkohet të standardizohen me modelet në BE. Lejet e qëndrimit për punëtorë shumë të kualifikuar pak ose aspak gjejnë pasqyrim në legjislacion. Lejet e qëndrimit për viktimat e trafikimit megjithëse janë të përcaktuara në ligj, duhet më mirë që ky përcaktim të përafrohet tërësisht me Direktivat e posaçme të BE-së për këtë qëllim.

Gjithashtu, dispozitat mbi lejet e qëndrimit për studentët duhet të përputhen tërësisht me *acquis communautaire,* veçanërisht mbi kriteret për ripërsëritjen e lejeve të qëndrimit për këtë motiv, si dhe qëndrimi ndaj ish studentëve pas përfundimit të studimeve.

Legjislacioni shqiptar mbi të huajt ka parashikuar dispozita të veçanta mbi ndalimin të huajve në qendër duke tentuar t’i përafrojë ato me legjislacionin e BE-së. Megjithëse në legjislacionin për të huajt është përcaktuar se gjithmonë i jepet prioritet largimit vullnetar, në

dispozitat mbi largimin me forcë dhe mbylljen në qendër të mbyllur janë përfshirë një numër i zgjeruar rastesh sa që e kufizon shumë përcaktimin e parë, atë të prioritetit të largimit vullnetar. Përcaktimi në legjislacion i gjykimit rast pas rasti mbi bazën e disa kritereve të përcaktuara me parë do të ishte zgjidhje me pozitive se sa ajo ekzistuese. Gjithashtu ndalimi në qendër të mbyllur nuk është paraparë në legjislacion të zëvendësohet me zgjidhje alternative të mundshme.
Veprimtaria parandaluese dhe goditëse ndaj migracionit të paligjshëm, përfshirë dhe qëndrimin ndaj punësimit të emigrantëve ilegal, duhet të gjejë më shumë pasqyrim në normativën migratore.

Monitorimi i flukseve migratore dhe analiza e riskut për këtë qëllim megjithëse janë një risi e re dhe pothuajse e zhvilluar në këto 2 vite sipas standardeve të FRONTEX, duhet me shumë të zërë rëndësinë e vet lidhur me migracionin, në raport kjo me analizën e aktiviteteve të tjera të kundraligjshme ndërkufitare.
Dispozitat mbi vizat, megjithëse janë të përafruara në një masë të konsiderueshme me atë të BE-së, duhet të përmirësohen me tej, e diktuar kjo dhe nga ndryshimet e fundit në Kodin Shengen të Vizave.

Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisje me leje qëndrimi të punëtorit emigrant nga BE, si dhe familjarëve të tij, janë të rregulluara me anë të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit Nr.9959, datë 17.07.2008 "Për të huajt". Dokumenti leje qëndrimi vazhdon të jetë jo në kërkesat e duhura për sa i përket elementeve të sigurisë, megjithëse që nga viti 2009 është miratuar forma, modeli dhe specifikimet teknike të lejes biometrike të qëndrimit. Procedura e lëshimit të lejes së qëndrimit është manuale, ndërsa informacioni mbi lejen e qëndrimit pasi hidhet në mënyrë manuale në sistemin TIMS konsultohet online nga strukturat përgjegjëse, përfshirë dhe ato në të gjithë PKK të Shqipërisë. Të huajt aplikojnë për leje qëndrimi ne zyrat e Migracionit pranë Drejtorive Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, ku kanë vendbanimin dhe afati i pajisjes me leje qëndrimi është 30 ditë. Përfundimi i regjistrit elektronik kombëtar për të huajt, do të rrisë më tej kapacitetet në drejtim të menaxhimit të migracionit. Trajnimi i vazhdueshëm i stafeve përgjegjëse për migracionin në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin, procedurat por dhe etikën në punë, do të ndikojnë direkt në rritjen e performancës në drejtim të menaxhimit të migracionit.

Transparenca në drejtim të menaxhimit të migracionit dhe veçanërisht të stokut migrator, mund të bëhet nëpërmjet hartimit dhe publikimit të Profileve të zgjeruara kombëtare mbi migracionin. Kjo do të ishte dhe një kontribut në kuadër të partneritetit rajonal, evropian e më gjerë mbi migracionin.

Rekomandimet e ekspertëve të vlerësimit të BE-së në drejtim të përmirësimeve në fushën e migracionit, ndryshimet në legjislacionin e brendshëm në Shqipëri pas miratimit të ligjit aktual për të huajt dhe që diktojnë ndryshime në këtë ligj, si dhe mangësitë dhe vështirësitë e ndeshura deri tani, gjatë implementimit të legjislacionit aktual mbi të huajt, kërkojnë ndërmarrjen e disa iniciativave ligjore afatshkurtra.

Përcaktimet ligjore afatshkurtra do të synojnë të përafrojnë legjislacionin tërësisht me atë të BE-së në fushën e migracionit me qëllim plotësimin e të gjitha kushteve për anëtarësim në

BE. Iniciativat ligjore afatshkurtra do të pasohen me të tilla afatmesme deri në vitin 2015, duke shoqëruar dhe mbështetur kështu procesin e anëtarësimit.
Implementimi i iniciativave ligjore, por dhe plotësimi i standardeve të kërkuara në fushën e migracionit, do të mundësohet nëpërmjet disa masave zbatuese afatshkurtra dhe afatmesme që do të planifikohen për t'u kryer.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/nënligjore në këtë nënkapitull janë:
Kuadri Ligjor:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; me anë të së cilës janë garantuar liritë dhe të drejtat themelore të njeriut sipas përcaktimeve në Deklaratën Universale të të drejtave të njeriut miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e vitit 1948, Konventa Ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore e vitit 1966, Konventa Ndërkombëtare për te drejtat Civile Politike, e vitit 1966, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, hyrë në fuqi më 4 janar 1969, Konventa Evropiane për të Drejtat dhe liritë themelore të njeriut e 3 Shtator 1953, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në datën 02.03.2005, etj.
- Konventa e OKB-së "Mbi mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre" . (E ratifikuar nga Republika e Shqipërisë).
- Konventa e Këshillit të Evropës 1997 "Për statusin ligjor të punëtorëve migrantë, ratifikuar me Ligjin nr.9555, datë 08.06.2006. Kjo Konventë është një prej atyre të hartuara në kontekstin e Këshillit të Evropës, e cila lidhet me trajtimin e të huajve në territorin e shteteve anëtarë të KE.
- Konventa nr.97 "Migracioni për punësim" (E rishikuar)-ILO, ratifikuar me Ligjin nr. 9320, datë 25.11. 2004. Konventa i kërkon Palëve Nënshkruese të ngrejnë dhe të ruajnë shërbime asistence dhe shërbime informacioni falas për punëtorët migrantë, marrjen e masave kundër propagandës së rremë mbi migrimin. Shtetet Palë duhet të zbatojnë trajtim jo më pak të favorshëm të migrantëve, nga ai i rezervuar për shtetasit e tyre, lidhur me disa fusha, përfshirë kushtet e punësimit, lirisë së organizimit dhe sigurimeve shoqërore.
- Konventa nr.143 "Për punëtorët migrantë"- ILO, ratifikuar me Ligjin nr.9564, datë 19.06.2006. Konventa parashikon masa për t'iu kundërvënë migrimit klandestin dhe ilegal, njëherësh duke parashtruar detyrimin e përgjithshëm për të respektuar të drejtat themelore të të gjithë punëtorëve migrantë.
- Konventa nr.181 "Mbi Agjencitë Private të Punësimit"- ILO, ratifikuar me Ligjin nr.8350, datë 20.05. 1998. Konventa mbulon punëtorët migrantë. Ajo njeh veprimtarinë e APP-ve, garanton ruajtjen e punëtorëve migrantë nga abuzimet, rregullon liritë e tyre, si ajo e organizimit, pjesëmarrjes në bisedimet kolektive dhe në dialogun social. Po kështu Konventa rregullon marrëdhëniet juridike mes autoriteteve licencues dhe monitorues, APP-ve dhe punëtorëve migrantë, që përfitojnë nga shërbimet e ofruara nga APP-të.
- Konventa OKB "Mbi statusi e personave pa shtetësi" ratifikuar në prill 2003.
- Konventa OKB "Mbi reduktimin e numrit të personave pa shtetësi" ratifikuar në prill 2004. Konventa OKB "Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre" ratifikuar me Ligjin nr.9703, datë 02.04.2007. Konventa në themel të saj kërkon që të gjithë ato, që kualifikohen si punëtorë migrantë, sipas neneve të saj të gëzojnë të drejtat e tyre të njeriut, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor.

- Karta Sociale Evropiane e Rishikuar (Nenet 18-19) (E ratifikuar nga Republika e Shqipërisë).
- Ligji për të huajt" nr. 9959, datë 17.7.2008, i përafruar pothuajse plotësisht me *acquis* dhe konkretisht me:
    - Konventa Europiane për te Drejtat dhe liritë themelore te njeriut e 3 Shtator 1953 dhe veçanërisht Protokolli i 4-tert i saj,
    - Konventa "Mbi migrimin për qëllime punësimi"nr. 97 e datës 22 janar 1952, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë ne datën 02.03.2005,
    - Konventa nr. 143 "Mbi punëtoret migrante" e datës 4.6.1975 se bashku me Rekomandimin nr.151 "Për punëtorët migrante" te datës 24.06.1075,
    - Konventa Europiane për statusin ligjor te migrantit e hyre ne fuqi me 1.05.1983, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me 3.04.2007,
    - Karta sociale evropiane e rishikuar e Këshillit te Europes, e nënshkruar me 3 Maj 1996 dhe hyre ne fuqi me 1 Korrik 1999, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me 14 Nëntor 2002,
    - Konventa Europiane "Për pjesëmarrjen e te huajve ne jetën publike ne nivel lokal" hyre ne fuqi ne vitin 1997, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë ne 19 Korrik 2005.
    - Konventa për Zbatimin e Marrëveshjes Shengen të datës 14 qershor 1985, botuar në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane të datës 22.9.2000, faqet 19-62.
    - Direktiva e Këshillit 2002/90/EC, datë 28.11.2002 «Për përcaktimin e dhënies së ndihmës ndaj hyrjes, tranzitit dhe qëndrimit të paautorizuar», botuar në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane datë 5.12.2002.
    - Vendimi i Këshillit (98/701/JHA), datë 3.12.1998 «Për standardet e përbashkëta në plotësimin e formatit uniform të lejeve të qëndrimit»,
    - Direktivën e Komisionit Evropian CCOM/2001/386 final - CNS 2001/0154, Bruksel, 11 korrik 2001:"Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve nga një vend i tretë me qëllim ushtrimin e aktiviteteve ekonomike, si punëmarrës, apo të vetëpunësuar".
    - Direktivën e Komisionit Evropian CCOM/2003/109 EC, Bruksel, 25 nëntor 2003, « Mbi Statusin e shtetasve të vendeve të treta, që janë rezidente afatgjatë ».
    - Direktivën e Komisionit Evropian CCOM/2003/86 EC, Bruksel, 22 shtator 2003, « Mbi te Drejtën e Ribashkimit Familjar';
    - Direktivën e Komisionit Evropian CCOM/2004/114/EC, Bruksel, 13 dhjetor 2004, «Mbi kushtet e pranimit të shtetasve të vendeve të treta, për qëllime studimi, shkëmbimeve shkollore, formim profesional pa pagesë ose shërbimet vullnetare».
    - Rezolutë legjislative e Parlamentit Europian e 18 qershor 2008 mbi propozim për një direktivë të Parlamentit Europian dhe Këshillit mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në Shtetet Anëtare për kthimin ilegalisht me qëndrim të shtetasve të vendeve të treta (– C6-0266/2005
    - 31996Y0919(08) "Rekomandimi i Këshillit i 24 korrik 1995 mbi parimet udhëzuese për t'u ndjekur për hartimin e protokolleve mbi zbatimin e marrëveshjeve të ripranimit "Fletore Zyrtare C 274 , 19/09/1996 P. 0025 – 0033
    - 31996Y0919(07) Rekomandimi i Këshillit i datës 30 nëntor 1994 në lidhje me modelin e një marrëveshje ripranimi dypalëshe ndërmjet një Shteti Anëtar dhe një vendi të tretë Fletore Zyrtare C 274 , 19/09/1996 P. 0020 – 0024

- 31996Y0919(06) Rekomandimi i Këshillit i datës 30 nëntor 1994 në lidhje me miratimin e një dokumenti standard udhëtimi për dëbimin e shtetasve të vendeve të treta.
- 41997D0039 Shengen acquis - Vendimi i Komitetit Ekzekutiv të 15 dhjetorit 1997 mbi parimet udhëzuese për mjetet provës dhe provave ne dukje brenda kuadrit të marrëveshjeve të ripranimit ndërmjet Shteteve të Shengenit (sch / Com-ex (97) 39 rev.)Fletore Zyrtare *L 239 , 22/09/2000 P. 0188 – 0190*
- Vendimi i Këshillit i datës 26 maj 1997 mbi shkëmbimin e informacionit në lidhje me ndihmën për riatdhesimin vullnetar të shtetasve të vendeve të treta Fletore Zyrtare *L 147 , 05/06/1997 P. 0003 – 0004.*

- Ligji nr. 10060, datë 26.1.2009 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8432, datë 14.12.1998 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".
- V.K.M. nr 362 date 01.04.2009 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe te dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e te huajve ne Republikën e Shqipërisë".
- V.K.M. nr. 470, date 06.05.2009 "Për miratimin e modelit, specifikimeve teknike dhe formatit të dokumenteve të udhëtimit për të huajt".
- V.K.M. nr 493, date 06.05.2009 "Për miratimin e modelit dhe specifikimeve teknike te vizës pulle".
- V.K.M. nr. 469, date 06.05.2009 "Për caktimin e elementeve të sigurisë dhe për miratimin e formës dhe të modelit të lejes se qëndrimit për shtetasit e huaj".
- V.K.M. nr 431 date 27.04.2009 "Për një shtese ne vendimin Nr. 362, date 01.04.2009 te Këshillit te Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe te dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e te huajve ne Republikën e Shqipërisë"".
- V.K.M. nr. 603, date 10.06.2009 "Për një shtese ne vendimin nr. 362 date 01.04.2009 te Këshillit te Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe te dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e te huajve ne Republikën e Shqipërisë"".
- VKM nr. 1083 date 28.10.2009 "Për ngritjen e Qendrës se Mbyllur dhe miratimin e Rregullores se organizimit dhe funksionimit te saj", për te huajt e parregullt ne territor.
- VKM nr.242, datë 13.4.2010 "Për një ndryshim në V.K.M. Nr 362, datë 01.04.2009 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë".
- Urdhër i përbashkët i Ministrit të Brendshëm Nr. 2864, datë 30.09.2009, i Ministrit të Punëve të Jashtme Nr. 11766, datë 06.10.2009 dhe i Ministrit të PÇSSHB Nr. 1857, datë 16.10.2009 "Për miratimin e Plan-Veprimit "Për implementimin e ligjit Nr. 9959, datë 17.07. 2008 "Për të huajt"".
- Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Punëve të Jashtme, Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror Nr. 2102, datë 03.08.2009, "Mbi bashkëpunimin në mes strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror për procedurat e lëshimit te vizave".
- Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror nr. 2947, datë 06.10.2009, "Mbi bashkëpunimin në mes strukturave të Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror për procedurat e trajtimit të huajve në Republikën e Shqipërisë".

- Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Punëve të Jashtme, Ministrit të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta dhe SHISH "Mbi ndërtimin dhe funksionimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar për të Huajt" nr.1909/1, datë 12.02.2010.
- Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1111, datë 29.09.2009 "Mbi koordinimin dhe bashkëpunimin brenda strukturave të Policisë Kufitare dhe Migracionit, bashkëpunimin e këtyre strukturave me strukturat e tjera të Policisë së Shtetit, si dhe me struktura dhe aktorë të tjerë, jashtë Policisë së Shtetit në kuadrin e zbulimit të imigracionit të paligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë".
- Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Nr. 851, datë 03.08.2009 "Procedurat standarde të punës së Policisë Kufitare dhe Migracionit", me anë të cilit përcaktohen procedurat standarde të punës së strukturave të migracionit, në çështjet e migracionit.
- Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 1016 datë 8.9.2009 "Mbi Funksionimin e Zyrës së Analizës së Riskut dhe Krimit Ndërkufitar në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe rregullimin e bashkëpunimit për këtë qëllim me strukturat e tjera".

Struktura institucionale

Niveli qeveritar

Në nivel qeveritar nuk ka një strukturë koordinuese apo lider mbi migracionin. Struktura qeveritare dhe organe të tjera shtetërore, si dhe të drejtat dhe obligimet e ministrive përkatëse janë të shprehura në thelb të Kushtetutës Shqiptare dhe akteve të ndryshme ligjore dhe nënligjore. Me një Vendim të Këshillit të Ministrave MPÇSSHB është emëruar si institucion lider për koordinimin e aktiviteteve për implementimin e Strategjisë së Migracionit dhe Planit të saj të Veprimit, ndërkohë që Ministria e Brendshme është përgjegjës për menaxhimin e pjesës më të madhe të fushave të migracionit.

Niveli ndërinstitucional

Ministria e Brendshme është përgjegjëse kryesore për parandalimin dhe luftën e migracionit të paligjshëm nëpërmjet menaxhimit të integruar të kufijve; kontrollit të te huajve në procedurat e aplikimit për vizë për të hyrë në Republikën e Shqipërisë, kjo në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e tjera të MPJ-së dhe SHISH; të kontrollit kufitar mbi kushtet dhe kritereve për të hyrë, qëndruar dhe tranzituar në Republikën e Shqipërisë; për pajisjen e të huajve me leje qëndrimi; për të kontrollin e ligjshmërisë së qëndrimit të të huajve në territor dhe marrjen e masave të largimit vullnetar, largimit me forcë, dëbimit, ndalimin e të huajve të parregullt në territor dhe kthimin e tyre në vendin e origjinës apo në vendin transit nga kanë ardhur; për zbatimin e Marrëveshjeve të Ripranimit me vendet e tjera; për pritjen, intervistimin dhe përzgjedhjen e shtetasve të kthyer në kufi, si dhe informimin e tyre mbi mundësitë e riintegrimit në vend; për bashkëpunimit rajonale dhe më gjerë në fushën e shkëmbimit të të dhënave statistikore mbi migracionin e paligjshëm dhe paralajmërimin e hershëm; për identifikimin dhe trajtimin viktimave të qenieve njerëzore në bashkëpunim me struktura të tjera nën autoritetin e Koordinatorit Kombëtar pranë këtij institucioni; për luftën kundër trafikimit dhe kontrabandimit të qenieve njerëzore, për azilin dhe shtetësinë, etj.

Strukturat e Ministrisë së Brendshme që realizojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e MB në fushën e migracionit janë: Policia e Shtetit, (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Departamenti Kundër Krimit të Organizuar dhe Kundër Krimeve të Renda), Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme, etj.

Ministria e Punëve të Jashtme është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikes së vizave si dhe negocimin e akteve të nevojshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e migracionit. Gjithashtu MPJ është përgjegjëse për mbështetjen e emigrantëve shqiptar jashtë vendit dhe mbrojtjen të drejtave të tyre, organizimin e diasporës shqiptare, bashkërendimin e veprimeve me strukturat e MB për ripranimin e shtetasve shqiptar, etj.
Strukturat e MPJ-së që realizojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e MPJ-së në fushën e migracionit janë Drejtoria e Çështjeve Konsullore, Drejtoria e Traktateve dhe Çështjeve Ndërkombëtare, Instituti i Diasporës, Ambasadat dhe Postet Konsullore jashtë vendit, etj.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me emigracionin dhe imigracionin e punës; monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarive të agjencive private të punësimit; përkujdesjen ndaj emigrantëve shqiptarë para largimit nga vendi dhe gjatë rikthimit të tyre në Republikën e Shqipërisë; hartimin dhe miratimin e programeve aktive dhe pasive të punësimit dhe formimit profesional në vend, për emigrantët e rikthyer me probleme ekonomike; koordinimin e procesit të informimit për shtetasit shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë në mënyrë të rregullt si dhe ata që rikthehen e dëshirojnë të riintegrohen dhe qëndrojnë në Shqipëri; sigurimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, si dhe mbështetjen për plotësimin e kërkesës për përfitimin e ndihmës ekonomike, për emigrantët e rikthyer"; koordinon dhe monitoron zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionin; koordinon dhe monitoron zbatimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015.
Strukturat e MPÇSSHB që realizojnë detyrimeve dhe përgjegjësive e MPÇSSHB në fushën e migracionit janë Drejtoria e Politikave të Migracionit, Kthimit dhe Riintegrimit, Drejtoria e Politikave të Punësimit, Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale dhe drejtoritë e tjera brenda këtij institucioni. Krahas tyre rol të rëndësishëm në zbatimin e politikave të migracionit kanë Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Zyrat Rajonale e Vendore të Punësimit, në të cilat ndodhen edhe Sportelet e Migracionit.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës është përgjegjëse për të kontribuar në integrimin e shtetasve të huaj në Shqipëri në fushën e arsimimit, kulturës dhe shkencës, si dhe për krijimin e kushteve për arsimimin dhe edukimin e emigranteve shqiptar në vendet ku ata ndodhen, në gjuhen amtare.
Instituti i Statistikave (INSTAT) është përgjegjës për grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe shpërndarjen dhe publikimin e statistikave në fushën e migracionit. Ky Institut kryen anketime dhe prodhon raporte mbi situatën e migracionit në vend.

Masat legjislative afatshkurtra

- Përgatitja dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare mbi Migracionin 2013-2018 dhe Planit të saj të Veprimit.
- Ndryshimi i Ligjit Nr. 9959, datë 17.07.2008 "Për të huajt" me qëllim për ta përafruar atë 100% me *acquis communautaire.*
- Ndryshimi i V.K.M. Nr. 362, datë 01.04.2009 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", diktuar nga ndryshimet në ligjin aktual nr. 9959, datë 17.07.2008 "Për të huajt".
- VKM "Për miratimin e Protokollit të Zbatimit të Marrëveshjes së Ripranimit Shqipëri-KE, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Francës".
- VKM "Për miratimin e Protokollit të Zbatimit të Marrëveshjes së Ripranimit Shqipëri-KE, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Çekisë".
- VKM "Për miratimin e Protokollit të Zbatimit të Marrëveshjes së Ripranimit Shqipëri-KE, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Portugalisë".
- VKM për miratimin e Profilit të Zgjeruar Kombëtar mbi Migracionin për vitin 2011.
- Urdhër i Përbashkët i Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për ngritjen e një grupi ndërministror pune për përgatitjen e ndryshimeve në legjislacionin ekzistues për të huajt.
- Ndryshimi në Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 920, datë 11.07.2008 me qëllim përmirësimin e modelit të statistikave mbi migracionin sipas standardeve të EUROSTAT.
- Përgatitja dhe miratimi i Procedurave të reja Standarde të Punës për strukturat e Migracionit, në përputhje me risitë që do të sjellin ndryshimet ligjore dhe nënligjore.
- Përgatitja dhe miratimi i Përshkrimeve të reja të punës në varësi me ndryshimet që mund të diktohen nga përmirësimi strukturor i Policisë së Shtetit.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Ristrukturimi i strukturave të Migracionit në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, në kuadër të ristrukturimit të Policisë së Shtetit.
- Përfundimi i ndërtimit nga ana teknologjike i Regjistrit Elektronik Kombëtar për të Huajt dhe vënia e tij në funksionim, për të gjitha agjencitë e ngarkuara me ligj për menaxhimin informacionit mbi të huajt në këtë regjistër.
- Përkthimi së paku në gjuhën angleze i akteve të reja ligjore dhe nënligjore të përgatitura, përfshirë dhe Profilet e Zgjeruara Kombëtare mbi Migracionin të miratuara dhe publikimi i tyre në faqen e MB dhe Policisë së Shtetit.
- Krijimi i faqes së posaçme interaktive të migracionit, ku përveç informacionit të nevojshëm mbi migracionin, të huajt do të mund të dërgojnë pyetje dhe me pas të marrin përgjigje brenda një dite pune.
- Prodhimi i lejeve biometrike të qëndrimit për të huajt duke zëvendësuar ato ekzistuese në format A4.
- Mundësimi i regjistrimit në mënyra alternative i të huajve pranë shërbimeve të migracionit, duke përfshirë dhe atë online nëpërmjet internetit.

- Krijimi i një trupe të përzgjedhur për kthimet dhe veçanërisht për kthimet e përbashkëta, si dhe trajnimi i saj.
- Trajnimi i stafeve të migracionit pranë DKM mbi ndryshimet e reja në legjislacionin dhe procedurat për të huajt në Republikën e Shqipërisë.
- Trajnimi i stafeve të PKM dhe veçanërisht i Qendrës së Mbyllur për të Huajt, në lidhje me procedurat e trajtimit të të huajve subjekt ndalimi në Qendër të Mbyllur dhe veçanërisht në aspektin e respektimit të të drejtave të njeriut ndaj tyre.
- Përmirësimi i kushteve në Qendrën e Mbyllur për të Huajt lidhur me furnizimin me energji elektrike dhe infrastrukturën rrugore që lidh Qendrën e Mbyllur me rrugën nacionale.
- Përmirësimi i sistemit të informimit i të huajve në Qendrën e Mbyllur për të Huajt, mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre nëpërmjet shtimit të numrit të gjuhëve të huaja, në të cilat do të përgatiten fletëpalosjet e posaçme.
- Përmirësimi i mekanizmit të monitorimit aktiv të brendshëm të procesit të liberalizimit të vizave, si në drejtim të parandalimit nëpërmjet informimit të qytetarëve, ashtu dhe të reagimit ndaj fenomeneve negative.
- Organizimi i aktiviteteve rajonale në Shqipëri me qëllim shkëmbimin e eksperiencave positive, në luftën kundër migracionit të paligjshëm.
- Monitorimi i implementimit të Strategjisë për Riintegrimin e të Kthyerve dhe Planit te saj të Veprimit.

Masat legjislative afatmesme

- Projektligj "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Moldavisë, për Ripranimin e Personave me qëndrim të parregullt dhe Protokollit të zbatimit të saj".
- Përditësimi i legjislacionit për të huajt, në përputhje me Konventat Ndërkombëtare që do të njihen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë, si dhe legjislacionin e BE-së që do të dalë në vazhdimësi mbi migracionin.
- Përditësimi i legjislacionit për të huajt, në përputhje me ecurinë e procesit integrues të Shqipërisë në BE, si dhe detyrimeve në kuadër të këtij procesi, në fushën e migracionit dhe veçanërisht lidhur me hyrjen, qëndrimin dhe punësimin e shtetasve të BE-së, në Republikën e Shqipërisë.
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Ripranimit dhe Protokollit të Zbatimit me Turqinë.
- Nënshkrimi i Protokollit të zbatimit të Marrëveshjes së Ripranimit Shqipëri-KE, me Greqinë.
- Nënshkrimi i Protokollit të Zbatimit të Marrëveshjes së Ripranimit Shqipëri-KE, me çdo vend të BE-së që do të jetë i gatshëm të nënshkruajë një të tillë me Shqipërinë.
- Identifikimi i vendeve të treta me të cilët duhet dhe mund të nënshkruhet Marrëveshje ripranimi dhe Protokolle zbatimi, si dhe nënshkrimi i tyre.
- Nënshkrimi i Marrëveshjeve të Partneritetit në fushën e migracionit me vende të interesuara.

Masat zbatuese afatmesme

- Përmirësimi i infrastrukturës logjistike dhe performancës së shërbimit ndaj emigrantëve në procedurat e trajtimit të tyre me leje qëndrimi.
- Thjeshtësimi i procedurave të trajtimit të emigrantëve në Republikën e Shqipërisë, duke u orientuar drejt shërbimit "në një sportel" dhe unifikimit të lejes së punës dhe lejes së qëndrimit në një dokument, i cili të përmbajë informacioni mbi lejen e punës dhe atë të qëndrimit.
- Trajnimi i vazhdueshëm i strukturave përgjegjëse në fushën e migracionit sipas analizës e nevojave për trajnim.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve logjistike dhe të IT në interes të menaxhimit të migracionit.
- Përmirësimi i ambienteve të pritjes në PKK dhe Stacionet e PKM për shtetasit e kthyer.
- Monitorimi i implementimit të Strategjisë për Riintegrimin e të Kthyerve dhe Planit të saj të Veprimit, si dhe i Strategjisë së re mbi Migracionin dhe Planit të saj të Veprimit që parashikohet të miratohet në periudhën afatshkurtër.

Tabela 1.

Llogaritja e kostos për kurset bazë të policisë kufitare për vitet 2012-2015 në DKM

Në lekë

		Nr. Nëpunësve		**Nr. Nëpunësve**		**Nr. Nëpunësve**		**Nr. Nëpunësve**	
Trajnimet	**Njësia**	**Shtesa**	**Kosto**	**Shtesa**	**Kosto**	**Shtesa**	**Kosto**	**Shtesa**	**Kosto**
	Matjes	**2012**		**2013**		**2014**		**2015**	
Numri Nëpunësve									
	Nëpunës	132	225 720	300	513 000	580	991 800	595	1 017 450
Shuma		132	225 720	300	513 000	580	991 800	595	1 017 450

Tabela 2

Shtesa e kapaciteteve instuticionale të strukturave përgjegjëse për fushën e Menaxhimit të kufijve.

Në lekë

			N. Nenpunesve		*Nr.Nenpunesve*		*Nr.Nenpunesve*		Nr.Nenpunesve	
Personeli	***Gjendja***	***Kostua***	**Shtese**	**Kostua**	**Shtesa**	**Kostua**	**shtesa**	**Kostua**	**shtesa**	**Kostua**
	Aktuale		**2012**	**2012**	**2013**	**2013**	**2014**	**2014**	**2015**	**2015**
Shtesa	*1547*	1.417.772	40	42.975.	20	21.487	0	0	0	0
Personeli										

Shuma	1547	1.417.772	40	42.975	20	21.487	0	0	0	0

MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA

Politikat e Migracionit

Imigracioni

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në Strategjinë e saj për punësimin e të huajve në Shqipëri, ka për qëllim zbatimin e nje strategjie ku të përcaktohet ushtrimi efektiv i së drejtës së punëtorëve migrantë dhe familjeve të tyre për lëvizje të lirë, punësim, dhe sigurimin e mbrojtjes dhe asistences në kuadrin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së dhe të detyrave, që i dalin Qeverisë shqiptare për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Ky qëllim po realizohet nëpërmjet :

- Përmirësimit të legjislacionit Për të huajt në Shqipëri
- Forcimit institucional dhe zhvillimit të kapaciteteve institucionale të zyrave të punësimit

Emigracioni

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) është institucioni i cili harton dhe ndjek zbatimin e politikave të nevojshme në fushën e emigracionit për motive punësimi. Në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme ajo menaxhon dhe mbikqyr të gjitha aspektet e emigrimit për motive punësimi[130]. MPÇSSHB ushtron funksionet e veta për të ngritur shërbime për përkujdesjen ndaj emigrantëve shqiptarë para largimit nga vendi dhe gjatë rikthimit të tyre në Republikën e Shqipërisë. MPÇSSHB është institucioni që propozon nënshkrimin e marrëveshjeve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të vendeve të tjera në fushën migratore, në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore të fushës.

MPÇSSHB ka koordinuar punën për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe planit të saj të veprimit 2005-2010, miratuar përkatësisht, me Vendim të Këshillit të Ministrave, me numër 760, më 19 Nëntor 2004 dhe VKM Nr. 296, datë 06.05.2005. Kjo strategji ndërsektoriale afatmesme synonte të siguronte një politikë më të plotë për migracionin, nga një politikë që kryesisht ka reaguar në luftën ndaj flukseve të parregullta në

[130] Ligji Nr.9668, datë 18.12.2006, "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi", (I ndryshuar).

një politikë më të plotë bazuar në menaxhimin e migracionit, dhe në mënyrë të veçantë të flukseve të emigracionit. Strategjia Kombëtare për Migracionin ka përfunduar dhe në dhjetor 2010-s u hartua raporti përfundimtar i monitorimit të saj. Një vend të rëndësishëm në këtë strategji zinin edhe marrëveshjet dypalëshe të punësimit ndërmjet vendit tonë dhe shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për sigurimet shoqërore me vendet me një numër të madh emigrantësh shqiptarë.

MPÇSSHB me qëllim nxitjen e bashkëpunimit të ndërsjelltë me shtetet anëtare, në zbatim edhe të detyrimeve të MSA, ka nënshkruar me shtetin Italian në 2 dhjetor 2008, "Marrëveshjen e bashkepunimit në fushën e punës si dhe protokollin e saj të zbatimit"[131]. Me synim lehtësimin e hyrjes dhe qëndrimit për motive punësimi Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta së bashku me institucione të tjera si Ministria e Brendshme (MB), Ministria e Arsimit dhe Shkences (MASH), Ministria e Puneve te Jashtme (MPJ) etj, kanë negociuar dhe kanë finalizuar me palën franceze tekstin e një Marrëveshjeje që ka në fokus lehtësimin e qarkullimit të të rinjve të dy vendeve tona. Kjo marrëveshje është miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendim Nr.157, datë 2.3.2011, "Për miratimin në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze, për qarkullimin e të rinjve". Aktualisht, jemi ende në pritje të nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje. Ka filluar puna për hartimin e Strategjisë së re Kombëtare për Migracionin 2013-2018. Për këtë ka dalë Urdhri i Kryeministrit Nr. 103, datë 20.12.2011, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2013-2018". MPÇSSHB është institucioni i cili koordinon punën për hartimin e kësaj strategjie. Grupi ndërinstitucional i punës për hartimin e strategjisë së re do të kryesohet nga zëvendësministri i MPÇSSHB, por në varësi të problematikës edhe nga përfaqësuesit e MPJ dhe MB. Për hartimin e kësaj strategjie do të bashkëpunohet ngushtë me organizatat ndërkombëtare që punojnë në këtë fushë si dhe akademikë e shoqërinë civile. Strategjia e re, ndër të tjera, do të synojë të plotësojë realizimin e disa masave të paplotësuara të strategjisë së mëparshme si dhe do të ketë në vëmendje edhe cështje të cilat lidhen me marrëveshjet dypalëshe për sigurimet shoqërore si dhe marrëveshjet e punësimit.

Lidhur me monitorimin e flukseve migratore, vazhdon marrja dhe perditesimi i informacioneve mbi emigrantet e rikthyer ne vend dhe te huajt e punesuar me leje pune.

Në vijim të rekomandimit nr. 1, te Komisionit Evropian (Raport progresi 2011) në mbështetje dhe zbatim të strategjisë si dhe urdhrit të Ministrit të Punës Nr.84, datë 06.06.2011 "Për formën pëmbajtjen e "regjistrit për emigrantët" dhe procedurat e regjistrimit", të ndryshuar" në mënyrë përiodike bëhet mbledhja e të dhënave mbi numrin e shtetasve të kthyer në vend dhe shtetasve shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë. Analiza dhe monitorimi i këtyre fukseve shërben si bazë për menaxhimin e tyre dhe ndërmarrjes së nismavë ligjore e praktike për këtë qëllim.

[131]Miratuar me VKM Nr.876, datë 12.12.2007 "Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë në fushën e punës dhe të Protokollit Ekzekutiv të Marrëveshjes"(E ndryshuar).

Eshte bashkepunuar me Grupin ndërinstitucional te ngritur me nismën e Ministrisë së Brendshme, për hartimin e Profilit te Migracionit Shqiptar, me te dhenat e disponuara per emigracionin dhe imigracionin (te huajt e punesuar ne Shqiperi) per vitin 2010.

Situata aktuale

Imigracioni

Pas vlerësimit të nevojave, Sporteleve të Migracionit i është ofruar mbështetje me pajisje për zyrat si dhe me materiale informative. Për të fuqizuar më tej kapacitetet, 36 Sportelet e Migracionit si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit janë pajisur me kompjutera dhe akses interneti.

Janë organizuar trajnime për punonjësit e 36 Sporteleve të Migarcionit. Objektivi kryesor i këtyre trajnimeve ka qenë rritja dhe forcimi i profesionalizmit të punonjësve të Sporteleve të Migracionit në ushtrimin e detyrave të tyre për intervistimin, identifikimin e nevojave, dhënien e informacionit dhe referimit për migrantët që paraqiten pranë Sporteleve të Migracionit.

Në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Miracionin (IOM Tirana) është duke u zbatuar projekti për rritjen e kapaciteteve të qeverisë për të kontribuar në procese migratore më të qëndrueshme.

Emigracioni

Ka filluar puna për zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me Italinë. Është ngritur në Tiranë Zyra Italiane Vendore e Koordinimit, strukturë e parashikuar në Memorandum.

Edhe pse është miratuar me VKM Nr.157, datë 2.3.2011, "Për miratimin në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze, për qarkullimin e të rinjve", ende nuk është bërë nënshkrimi i saj. Aktualisht jemi duke ndjekur procedurat me strukturat përgjegjëse për nënshkrimin sa më shpejt të saj.

Në dhjetor 2010, është hartuar Raporti përfundimtar monitorues për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionin 2005-2010.

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit Nr. 103, datë 20.12.2011, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2013-2018" për hartimin e Strategjisë së re Kombëtare për Migracionin ka filluar puna me institucionet e përfshira për organizimin e takimeve dhe fillimin e procesit të hartimit të këtij dokumenti.

Gjatë vitit 2010 është punuar për përditësimin e paketave informative të 36 shteteve, 27 shtetet anëtare dhe shtete të tjera që përbëjnë interes për hyrje dhe qëndrim për punësim për shtetasit shqiptarë. Të 36 Sportelet e Migracionit në Zyrat Rajonale dhe Vendore të Punësimit janë pajisur me paketa informative. Punonjësit e sporteleve janë trajnuar për shpërndarjen e

këtij informacioni shtetasve shqiptarë të interesuar. Kjo punë është bërë në bashkëpunim me IOM në kuadër të një projekti i cili ka në fokus forcimin e kapaciteteve të sporteleve.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Imigracioni

Në Ligjin aktual "Për të Huajt", Nr.9959, datë 17.7.2008, në nene të veçanta synohet përfshirja dhe zbatimi i angazhimeve të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në kuadrin e Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit dhe të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Gjithashtu në këtë ligj, janë pasqyruar edhe dispozita të Acquis-së së Bashkimit Evropian, në fushën e migrimit, rekomandime të fundit të BE-së, sidomos të Direktivës të Komisionit Evropian (CCOM/2001/386final-CNS 2001/0154, Brussels, 11 July 2001) "Mbi kushtet e hyrjes dhe të qendrimit të shtetasve nga një vend i tretë me qëllim ushtrimin e aktiviteteve ekonomike, si punëmarrës, apo të vetëpunësuar", por edhe të përvojave pozitive të legjislacionit dhe praktikave administrative të disa shteteve anëtare të BE-së.

Përafrimi është i pjesshëm lidhur me punësimin e të huajve shtetas të BE-së, të cilët janë të detyruar të aplikojnë për leje pune për t'u punësuar në Republikën e Shqipërisë.

Procedurat dhe dokumentacioni per percaktimin e kritereve, per pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes se punes per te gjitha tipet e lejeve te punes jane percaktuar me Vendime të Këshillit të Ministrave. Jane gjithsejt 15 VKM te cilave ju referohen zyrat e punesimit rajonale dhe vendore si dhe DPSHKP, per pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejeve te punes per te gjitha tipet e lejeve te punes.

Më poshtë jepet lista e plotë e 15 VKM-ve, në fuqi në zbatim të Ligjit për të Huajt :

- VKM nr.348, datë dates 6.3.2009 "Për caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedures per pajisjen, refuzimin, riperteritjen dhe anulimin e lejes se punes" "Për A/NK (Punetore nderkufitare).
- VKM nr.349, datë dates 6.3.2009 "Per caktimin e kritereve, te dokumentacionit dhe procedures per pajisjen, refuzimin, riperteritjen dhe anulimin e lejes se punes" "Për A/PS (Punetore stinore)".
- VKM nr.350, datë dates 6.3.2009 "Per caktimin e kritereve, te dokumentacionit dhe procedures per pajisjen, refuzimin, riperteritjen dhe anulimin e lejes se punes" "Për A/SH (Sherbime vullnetare)".
- VKM nr.351, datë dates 6.3.2009 ""Per caktimin e kritereve, te dokumentacionit dhe procedures per pajisjen, refuzimin, riperteritjen dhe anulimin e lejes se punes" "Për B/VP Veprimtari te pavarur ekonomike si i vetepunesuar"
- VKM nr.352, datë dates 6.3.2009, "Per caktimin e kritereve, te dokumentacionit dhe procedures per pajisjen, refuzimin, riperteritjen dhe anulimin e lejes se punes" "Për A/AF (Anetare te familjes").
- VKM nr.353, datë 6.3.2009 "Per caktimin e kritereve, te dokumentacionit dhe procedures per pajisjen, refuzimin, riperteritjen dhe anulimin e lejes se punes" "Për A/S (Studente).

- VKM nr.354, datë 6.3.2009 "Per caktimin e kritereve, te dokumentacionit dhe procedures per pajisjen, refuzimin, riperteritjen dhe anulimin e lejes se punes" “Për raste te veçanta- Tipi C”.
- VKM nr.355, datë 6.3.2009 “"Per caktimin e kritereve, te dokumentacionit dhe procedures per pajisjen, refuzimin, riperteritjen dhe anulimin e lejes se punes" “Për B/I (Veprimtari te pavarur ekonomike si investitor).
- VKM nr.356, datë 6.3.2009 "Per caktimin e kritereve, te dokumentacionit dhe procedures per pajisjen, refuzimin, riperteritjen dhe anulimin e lejes se punes" “Për A/TN (Te transferuarit brenda ndermarrjes)”.
- VKM nr.357, datë 6.3.2009 “Per caktimin e kritereve, te dokumentacionit dhe procedures per pajisjen, refuzimin, riperteritjen dhe anulimin e lejes se punes" “Për leje pune te vazhdueshme Tipi D”.
- VKM nr.358, datë 6.3.2009 "Per caktimin e kritereve, te dokumentacionit dhe procedures per pajisjen, refuzimin, riperteritjen dhe anulimin e lejes se punes" “Për A/FP (Arsimin profesional”).
- VKM “"Per caktimin e kritereve, te dokumentacionit dhe procedures per pajisjen, refuzimin, riperteritjen dhe anulimin e lejes se punes"nr.359, datë 6.3.2009 “Për punemarres A/P”.
- VKM nr. 360, datë 6.3.2009 “Per dokumentacionin dhe proceduren per perjashtimin nga detyrimi per pajisje me leje pune".
- VKM Nr.467, dt.29.6.2011."Per caktimin e kritereve, te dokumentacionit dhe procedurave per pajisjen, refuzimin, riperteritjen dhe anulimin e lejes se punes së tipit C/SP (për sportistët).
- VKM Nr.518, dt.6.7.2011."Per caktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe procedurave per pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes se punes së tipit C/SHP (për punëtorët shtëpiakë).

Zhvillimet e fundit për këtë ceshtje lidhen me daljen e një urdhri të përbashkët me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Jashtme, (te iniciuar nga MB) , nr.1848, dat.15.12.2011., “Për ngritjen e grupit ndërministror të punës për përgatitjen e ndryshimeve në Ligjin Nr. 9959, dt.17.7.2008,”Për të Huajt” si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, në përputhje me rekomandimet e BE-së në kuadër të vlerësimeve për anëtarësim të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Emigracioni

Gjatë periudhës 2010 – 2011, bazës ligjore aktuale i është shtuar edhe,

- Nënshkrimi në 19 Korrik 2011, i Memorandumit të Mirëkuptimit, “Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale të Republikës Italiane dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të Republikës së Shqipërisë në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për Migracionin e Punës të nënshkruar në 2 dhjetor 2008”;
- Miratimi i Urdhrit të Kryeministrit Nr. 103, datë 20.12.2011, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2013-2018”;

- Miratimi i marrëveshjes dypalëshe me shtetin francez me VKM Nr.157, datë 2.3.2011, "Për miratimin në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze, për qarkullimin e të rinjve".

Struktura institucionale

Imigracioni

Sipas Ligjit për të Huajt, Autoriteti shtetëror qendror, përgjegjës për trajtimin e marrëdhënieve të punësimit të të huajve në Shqipëri, është Drejtoria e Politikave të Migracionit në MPCSSHB dhe autoriteti shtetëror përgjegjës, në nivel qendror është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe në nivel rajonal dhe vendor, për punësimin e të huajve, është zyra rajonale dhe vendore e punësimit.

Është konkretisht pergjegjësia e zyrave përkatëse të punësimit që sipas Ligjit "Për të Huajt", dhe VKM-ve në zbatim të tij, për pajisjen me leje pune të të huajve, të kryejnë me përgjegjësi, detyrat si më poshtë:

- të presin personat e interesuar për pajisje me leje pune për të huajin;
- të japin informacionin e duhur për çdo paqartësi rreth procedurave për pajisje me leje pune;
- të shqyrtojnë dokumentacionin përkatës dhe të pranojnë, ose të bëjnë vërejtjet e duhura, bazuar në ligj dhe VKM, për ta pranuar brenda afatit të lejuar në VKM;
- të respektojnë afatet sipas VKM-së përkatëse për pajisjen me leje pune të të huajit ;
- të evidentojnë në kohë lejet e punës duke i regjistruar në regjistrin elektronik;
- një kriter i rëndësishëm që duhet të zbatohet nga zyrat e punësimit është ai i vlerësimit të tregut të punës sipas Nenit 40, "Nevojat e tregut të punës për punëmarrësit" të Ligjit "Për të Huajt".

Emigracioni

MPÇSSHB është institucioni i cili harton dhe ndjek zbatimin e politikave të nevojshme në fushën e emigracionit për motive punësimi. Në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme ajo menaxhon dhe mbikqyr të gjitha aspektet e emigrimit për motive punësimi[132]. MPÇSSHB ushtron funksionet e veta për të ngritur shërbime për përkujdesjen ndaj emigrantëve shqiptarë para largimit nga vendi dhe gjatë rikthimit të tyre në Republikën e Shqipërisë. MPÇSSHB është institucioni që propozon nënshkrimin e marrëveshjeve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të vendeve të tjera në fushën migratore, në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore të fushës.

Masat legjislative afatshkurtra

[132] Ligji Nr.9668, datë 18.12.2006, "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi", (I ndryshuar).

Duke patur parasysh edhe rekomandimet e Komisionit Evropian për progresin e arritur lidhur me Kapitullin 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria" të paraqitura në Raport Progresin për vitin 2011, përkatësisht : "1) *Strategjia dhe plani i veprimit për migrantët e kthyer është duke u zbatuar në mënyrë të sukseshme, por analiza e riskut dhe monitorimi i flukseve të migracionit ka ende nevojë që të përmirësohet; 2) Strategjia Kombëtare për Migracionin nuk është zbatuar plotësisht deri në fund të vitit 2010. 3) Kuadri legjislativ ka ende nevojë që të jetë në përputhje me acquis communautaire. Përgatitjet në këtë drejtim kanë përparuar në mënyrë të moderuar",* janë parashikuar masat e mëposhtme legjislative dhe zbatuese afatshkurtra dhe afatmesme.

Imigracioni

- Përmirësimi i e Ligjit "Për të Huajt";
- Përmirësime të tjera ligjore, si rrjedhim i ndryshimit të legjislacionit për të huajt nga ministritë e tjera.

Emigracioni

- Nënshkrimi i marrëveshjes për lehtësimin e qarkullimit të të rinjve me shtetin francez.

Masat zbatuese afatshkurtra

Imigracioni

- Vazhdimi i aktiviteteve të trajnimit për forcimin e kapaciteteve të personelit për ofrimin e shërbimeve ndaj migrantëve., në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM Tirana).
- Vazhdimësi e forcimit të kapaciteteve me pajisje dhe mjete pune për Shërbimin Kombëtar të Punësimit, Zyrat Rajonale të Punësimit dhe Zyrat Vendore të Punësimit sipas nevojave, mbështetur gjithashtu nga Organizata Ndërkombëtare e Migracionit në Tiranë (IOM).
- Përgatitja e informacionit vjetor me analizen e flukseve per te huajt e pajisur me leje punesimi ne Shqiperi.

Emigracioni

- Zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale të Republikës Italiane dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të Republikës së Shqipërisë në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për Migracionin e Punës, i nënshkruar më 19 korrik 2012.
- Ndjekja e proçesit të nënshkrimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze, për qarkullimin e të rinjve.
- Krijimi i një database eficent për mbledhje të dhënash për shtetasit shqiptarë që duan të punojnë jashtë vendit, në shërbim të qasjes kërkesë - ofertë. Jemi duke punuar aktualisht për këtë në kuadër të zbatimit të marrëveshjes me shtetin Italian.
- Organizimi i takimeve dhe tryezave të rrumbullakëta për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2013-1018.

- Zbatimi i Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer në Vend, 2010 – 2015.
- Në mbështetje dhe zbatim të strategjisë si dhe urdhrit të Ministrit të Punës Nr. 84, datë 06.06.2011 "Për formën, përmbajtjen e "regjistrit për emigrantët" dhe procedurat e regjistrimit", të ndryshuar" në mënyrë përiodike do te vazhdoje mbledhja e të dhënave mbi numrin e shtetasve të kthyer në vend dhe shtetasve shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë.
- Ndjekja e zbatimit dhe monitorimit te informacionit nga institucionet pergjegjese e si dhe hartimi i raporteve perkates 6 mujore dhe 1 vjecare monitorues mbi zbatimin e masave te planit te veprimit te kesaj strategjie.
- Organizimi i trajnimeve të parashikuara per personelin e sporteleve te migracionit ne dhenien e informacionit dhe referimit per shtetasit shqiptare te kthyer.
- Ndjekja e zbatimit të konventave në fushën e migrimit nëpërmjet hartimit të Raporteve periodike për zbatimin e konventave të ratifikuara.

Masat legjislative afatmesme

Imigracioni

- Në vazhdimësi do të synohet për përditësimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me atë evropian dhe zbatimin e plotë të tij, lidhur me ceshtjet e punësimit që mbulon MPCSSHB.

Emigracioni

- Miratimi i P/VKM Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2013 – 2018".

Masat zbatuese afatmesme

Imigracioni

- Aktivitetet për forcim kapacitetesh dhe koordinim ndërinstitucional do të realizohen në vazhdimësi në përputhje me ndryshimet që mund të realizohen në legjislacion dhe kërkesat për forcim kapacitetesh nga zyrat përkatëse të punësimit.

Emigracioni

- Zbatimi i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze, për qarkullimin e të rinjve;
- Zbatimi i Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë në fushën e punës dhe të Protokollit Ekzekutiv të Marrëveshjes;
- Analiza e situatës së tregut të punës në shtetet anëtare të BE –së dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të reja dypalëshe të punësimit, menaxhimit të flukseve migratore...etj.

- Organizimi i takimeve dhe tryezave të rrumbullakëta për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2013-1018.
- Fillimi i zbatimit të Strategjisë së re Kombëtare për Migracionin 2013-2018.

Efektet financiare

Kostot për ndryshime të legjislacionit janë administrative që mbulohen nga buxheti i shtetit, në zërin e pagave të personelit që do të punojë në këtë fushë, kurse për forcimin e kapaciteteve, ato parashikohen vetëm nga donatorët e mundshëm, ku më potenciali mbetet IOM.

3.24.3. POLITIKA E VIZAVE

Objektivi Strategjik

Qeveria Shqiptare është thellësisht e angazhuar për të përqasur legjislacionin kombëtar në fushën e vizave me standardet dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian, në përputhje të plotë me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (neni 80,64, 57 dhe 4).

Dispozitat mbi vizat, edhe pse janë të përafruara konsiderueshëm me dispozitat e BE-së, duhet të përmirësohen më tej, si rrjedhojë e ndryshimeve të fundit në Kodin Shengen të Vizave. Një rregullim më i përafruar me atë të BE-së kërkohet të bëhet në drejtim të të drejtave për bashkim familjar, pasi në dispozitat ekzistuese janë parashikuar disa kritere të cilat nuk janë në standardet e legjislacionin e BE-së.

Bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, në këtë fushë, është përcaktuar në Nenin 80 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Situata aktuale

Legjislacioni mbi të huajt në Shqipëri është përgjithësisht i përfaruar me *acquis* e BE. Aspektet e trajtimit të të huajve, që kanë të bëjnë me hyrjen dhe qëndrimin e tyre në Republikën e Shqipërisë, pajisjen me vizë, leje pune dhe leje qëndrimi, etj, përgjithësisht janë përafruar me legjislacionin e BE-së.

Ligji Nr. 9959, datë 17.07.2008 “Për të huajt” përcakton kritere të njëjta me atë të legjislacionit të BE-së, lidhur me tipet e vizave dhe autoritetet përgjegjëse dhe bashkëpunuese për trajtimin e kërkesave. Një rregullim më i përafruar me atë të BE-së kërkohet të bëhet në drejtim të të drejtave për bashkim familjar, pasi në dispozitat ekzistuese janë parashikuar disa kritere të cilat nuk janë në standardet e legjislacionin e përbashkët të BE-së, por dhe me përcaktimet në Kodin e Familjes së Republikës së Shqipërisë. Ndryshime duhet të bëhen edhe në lidhje me afatet e riaplikimit, procedurat e aplikimit dhe afatet e lëshimit të vizës pas marrjes së miratimit nga MPJ. Duhet parashikuar aplikimi i taksës së shërbimit për vizën e

cila duhet të jetë standarde për të gjithë aplikantët pavarësisht taksës së vizës e cila vendoset mbi bazën e reciprocitetit.

Dispozitat mbi vizat, edhe pse janë të përafruara konsiderueshëm me dispozitat e BE-së, duhet të përmirësohen më tej, si rrjedhojë e ndryshimeve të fundit në Kodin Shengen të Vizave.

Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisje me vizë të shtetasve e e kanë atë të nevojshme për të hyrë në Shipëri, janë të rregulluara me anë të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit Nr.9959, datë 17.07.2008 "Për të huajt". Megjithatë formati i vizës pullë që vendoset në pasaportë është jo i ngjashëm me atë të përdorur nga vendet e BE-së dhe lë shumë për të dëshiruar, për sa i përket elementëve të sigurisë. Po ashtu viza pullë plotësohet në mënyrë manuale nga konsulli çka rrit më shumë mundësinë e manipulimit të saj. Rekomandimet e eksperteve të vlerësimit të BE-së për ndryshimet në legjislacionin e brendshëm në Shqipëri pas miratimit të ligjit aktual "Për të huajt" dhe që diktojnë ndryshime në këtë ligj, si dhe mangësitë dhe vështirësitë e ndeshura deri tani gjatë implementimit të legjislacionit aktual mbi të huajt, kërkojnë ndërmarrjen e disa iniciativave ligjore afatshkurtra të cilat synojnë të përafrojnë legjislacionin tonë tërësisht me atë të BE-së në fushën e migracionit me qëllim plotësimin e të gjitha kushteve për anëtarësim në BE. Iniciativat ligjore afatshkurtra do të pasohen me të tilla afatmesme deri në vitin 2015, duke shoqëruar dhe mbështetur kështu procesin e anëtarësimit.

Baza ligjore ekzistuese

Veprimtaria në fushën e politikës së vizave mbështetet në legjislacionin parësor të mëposhtëm:

- Ligji nr. 9959, date 17/07/2008 "Për te Huajt" (në fuqi nga 01.12.2008)
- Ligji nr. 9095, date 3/7/2003 "Për shërbimin e jashtëm të RSH"
- Ligji nr. 8372, date 09.07.1998 "Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga perfaqesite diplomatike ose konsullore"
- Ligji nr. 8686, date 11/12/2000 "Për lëshimin e pasaportave për jashtë shtetit"
- Ligji nr. 8977, date 12/12/2002 "Për sistemin fiskal në RSH"
- VKM nr. 335, date 2/9/1997 "Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit", me shtesat dhe ndryshimet
- VKM nr. 362 date 01.04.2009 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në R.Sh."
- VKM nr. 431 date 27.04.2009 "Për një shtesë në VKM nr. 362 date 01.04.2009 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në R.Sh.""
- VKM Nr. 365 date 19.05.2010 "Për një shtesë në VKM nr. 362 date 01.04.2009 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në R.Sh"". Sipas këtij vendimi gjatë periudhës 30.5.2010 deri në 31.10.2010 shtetasit ukrahinas dhe rus hyjnë pa viza në Shqipëri. (Ky vendim ka patur fuqi vepruese deri me 31.10.2010).
- VKM nr. 493 date 06.05.2009 "Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe elementeve të sigurisë të vizës pullë"

- VKM. nr. 242, date 13.04.2010 “Për një shtesë në vendimin nr. 362 datë 01.04.2009 te Këshillit te Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë””. Me anë të kësaj VKM-je në listën e vendeve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë, është shtuar edhe Serbia.
- VKM. nr. 367, date 13.05.2010 “Për një shtesë në vendimin nr. 362 datë 01.04.2009 te Këshillit te Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë””.
  Me anë të kësaj VKM-je në listën e vendeve shtetasit e të cilëve hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë, janë shtuar edhe Ukrahina, Armenia, Azerbaxhani dhe Kazakistani, ndërsa për Rusinë janë hequr periudhën qershor deri më 31 tetor 2011.
- Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Punëve të Jashtme, Ministrit të Punëve të Brendshme dhe SHISH, nr 9486/1, datë 11.08.2009 mbi “ Bashkëpunimin në mes strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror për Procedurat e lëshimit të vizave për të huajt”
- Urdhri i Kryeministrit "Për ngritjen e Qendës Kombëtare të Vizave", iniciative e cila do te jete pjeserisht ne perputhje me Udhëzimet e Përbashkëta Konsullore "Për vizat në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore" GZ C 310 , 19/12/2003 P. 0001 – 0108.
- Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Jashtme "Për kryerjen e një studimi per përmirësimin e kapaciteteve të përpunimit të vizave në MPJ/PDK ne kuader te Trajnimit te personeleve që përpunojnë vizat", iniciative e cila do te jete pjeserisht ne perputhje me Udhëzimet e Përbashkëta Konsullore "Për vizat në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore" GZ C 310 , 19/12/2003 P. 0001 – 0108.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Punëve të Jashtëme, Ministrit të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta “Mbi ndërtimin dhe funksionimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar për te Huajt” nr.1909/1, datë 12.02.2010.

Struktura institucionale

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e politikës së vizave në Ministrinë e Punëve të Jashtme janë përgjegjëse këto drejtori:
Drejtoria e Përgjithshme e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Çështjeve Konsullore, në Ministrinë e Punëve te Jashtme. Brenda Drejtorisë së Përgjithshme të së Drejtës Ndërkombëtare dhe Çështjeve Konsullore, funksionon Drejtoria Konsullore, që në organikën e saj ka një sektor të posaçëm për çështjet e vizave, Sektorin e Vizë – Pasaportave, sektor ky që përbëhet nga 3(tre) ekspertë.

Prioritetet Afatshkurtra

- Lëshimi i dokumenteve të udhëtimit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe vendosja një rrjet kompjuterik (IT) të centralizuar për administrimin e vizave.
- Hartimi dhe miratimi i legjislacionit për prodhimin dhe administrimin e vizave pullë.

Masat legjislative afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

- Miratimi i ndryshimeve ne Ligjin nr. 8977, dt. 12/12/2002, "Për sistemin fiskal në RSH", iniciative e cila do te jete pjesërisht ne përputhje me Rregulloren e KE, 454/2003, "Për tarifat e vizave";
- Miratimi i ndryshimit të VKM, nr. 335, dt. 2/9/1997 "Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit", iniciativë e cila do të jete pjesërisht ne përputhje me Rregulloren e Këshillit (KE), nr. 2252/2004, 13/12/2004, "Për standardet e sigurisë dhe biometriken në pasaportat dhe dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga shtetet anëtare";
- Ndryshimi i Ligji nr. 9959, datë 17.07.2008 “Për të huajt” me qëllim për ta përafruar atë 100% me acquis communautaire.
- Ndryshimi i V.K.M. nr. 362 datë 01.04.2009 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, diktuar nga ndryshimet në ligjin aktual nr. 9959, date 17.07.2008 “Për të huajt”.
- Ndryshimi i V.K.M. nr. 493 datë 06.05.2009 “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve teknike të vizës pullë”, diktuar nga kërkesat e Kodit Shengen.

Masat zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese.

- Përkthimi së paku në gjuhën angleze i akteve të reja ligjore dhe nënligjore të përgatitura.
- Prodhimi i vizës së re pullë dhe vënia e saj në përdorim.
- Organizimi i moduleve të trajnimit të personeleve që trajnojnë për çështjet e vizave;
- Përmirësimi në vazhdimësi i informacionit për të huajt dhe aksesit për të marrë informacion;
- Ngritja e Qendrës Kombëtare të Vizave (QKV).

Janë ndërrmarrë tashmë aktivitetet e mëposhtme:

- Moduli E-vizës vazhdon funksionimin. Ky modul është instaluar në sistemin TIMS dhe është në funksionim dhe përdorim të plotë nga strukturat konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme brenda dhe jashtë vendit, Ministrisë së Brendshme dhe SHISH.
- Ka filluar funksionimin Regjistri Kombëtar i të Huajve.

Prioritetet Afatmesme

Të sigurohet përputhje e plotë e dokumenteve shqiptare të udhëtimit me standardet ndërkombëtare.

Masat legjislative afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

- Miratimi i Urdhrit të Ministrit të Puneve të Jashtme "Për pajisjen e përfaqësive me mjetet e nevojshme për zbulimin e dokumentave te fallsifikimeve", iniciativë e cila do

të jetë pjeserisht në përputhje me Udhëzimet e Përbashkëta Rekomandim i Këshillit, 29/4/l 1999, "Për paisjen e njësive që trajtojnë vizat dhe përfaqësitë jashtë shtetit me mjetet për dedektimin e dokumenteve të fallsifikuara" GZ C 140 , 20/05/1999 p. 0001 – 0002.

- Përmirësimi i legjislacionit aktual për vizat dhe trajtimin e të huajve.

Masat zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- Ngritja e Sistemit të Integruar (informatizuar) të trajtimit të Vizave (InViS).
- Përgatitja e Manualit të Dokumenteve të Njohura, ku fiksohen vizat.
- Përgatitja e formularit të vizës në dokumentet e panjohura.
- Pajisja e përfaqësive dhe QKV me mundësitë e detektimit të falsifikimeve.
- Përmirësimi i kapaciteteve të MPJ dhe përfaqësive diplomatike.

3.24.4. AZILI

Objektivi strategjik

Republika e Shqipërisë ka tashmë një sistem azili për të cilin po punohet gjithmonë e më shumë, për t'iu afruar standardeve evropiane, duke bërë funksionimin e plotë të procedurave në përcaktimin e Statusit të Refugjatit për personat që kërkojnë Azil.

Objektivat kryesorë që duhen patur parasysh për një funksionim të gjithë hallkave të këtij sistemi, janë:

- Konsolidimi dhe zhvillimi i procedurave ekzistuese për azlikërkuesit dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë.
- Zbatimi i legjislacionit vendas në përputhje me standardet e Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Protokollit të New York-ut 1967.
- Krijimi i një kuadri të plotë në menaxhimin e çështjeve të Azilit, si çështje të një rëndësie të veçantë, si në nivel kombëtar, ashtu edhe rajonal, si nga pikëpamja politike, ashtu edhe vepruese.
- Rritja e efiçencës së institucioneve.
- Zbatimi i parimit të Non – Refoulement (moskthimit) dhe i të drejtave të tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve.
- Sigurimi i të drejtave të udhëtimit të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë.
- Trajtim i njëjtë me shtetasit e vendeve të treta që qëndrojnë ligjërisht në territorin shqiptar.

Gjithashtu Neni 80 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit përcakton se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në këtë fushë, do të përqendrohet në zbatimin e legjislacionit të brendshëm për përmbushjen e standardeve të Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Protokollit të New Yorkut të vitit 1967, për të siguruar në këtë mënyrë respektimin e parimit të mos-kthimit të individit në atë vend që përbën kërcënim për jetën e tij, si dhe të të drejtave të tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve.

Situata aktuale

Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, si strukturë brenda Ministrisë së Brendshme, është autoriteti i vetëm i njohur me ligj për marrjen e vendimeve në rrugë administrative, për dhënien dhe mohimin e azilit në Republikën e Shqipërisë, si dhe për ndjekjen e procedurave për dhënien, lënien dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare. Ajo organizon dhe kontrollon në këtë fushë, është e angazhuar në mirëfunksionimin konkret e ligjor të gjithë punës duke u angazhuar me të gjitha strukturat lidhëse për rezultate.

Duke u mbështetur në punën e arritur, dokumentacionin ligjor ekzistues, punën për përafrimin ligjor me vendet e BE-së në këtë fushë, si në anën ligjore dhe zbatuese, detyrave të Progres Raporteve të Komisionit Evropian, synohet:

- Plotësimi i kuadrit ligjor me nivele me të larta kërkuese e zbatuese, si detyrë e domosdoshme e zhvillimit të mëtejshëm paralel me vendet e tjera.
- Mirëfuksionimi i plotë i të gjitha hallkave organizuese, zbatuese dhe mbështetëse.

Në përgjithësi është plotësuar dhe punuar kuadri ligjor për zbatimin e rregullave të përcaktuara për fitimin e azilit dhe formave të tjera plotësuese, që nga :

- Ligji nr. 8432, datë 14.12.1998 ”Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 10060, datë 26.01.2009 ”Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998, ”Për azilin në Republikën e Shqipërisë.
- Ligji nr. 9098, datë 03.07.2003 ”Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Repubikën e Shqipërisë”, i cili po punohet nga një grup pune me përfaqësues nga institucione që marrin pjesë në segmente të caktuara të zbatimit të këtij ligj, duke e sjellë atë si një ligj bashkëkohor dhe të pacënueshëm në zbatim.
- Ligji nr. 9959, datë 17.07.2008 ”Për të huajt”.
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 ”Për mbrojtjen e të dhënave personale “.

Realizimi i objektivave në veprimtarinë e Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët, është e fokusuar në katër shtylla kryesore :

- Veprimtaria ligjore “Zbatimi i kuadrit ligjor dhe udhëzues në një shkallë të lartë, gjë që ka sjellë funksionimin e plotë dhe konkret të punës me plotësimin deri në Dekretimin e plotë të të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga kjo drejtori”.
- Veprimtaria verifikuese “Parandalimi dhe hetimi paraprak për të gjithë dokumentacionin duke bashkëvepruar me institucione të specializuara”.
- Veprimtaria zbatuese “Lidhja me institucionet e organizmat mbështetës për një punë të plotë dhe efikase”.
- Menaxhimi dhe trajnimi i personelit (burimeve njerëzore).

Tashmë procedura e përzgjedhjes në kufi, kryhet nga Policia Kufitare në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr. 1085, datë 12.06.2006 “Për procedurën që zbatohet nga Policia e Shtetit për përzgjedhjen e të huajve”.

Procedura e përzgjedhjes vazhdon të synojë në parandalimin e kthimit të personave të huaj që hyjnë në mënyrë të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe bën të mundur që ata të identifikohen si azilkërkues apo emigrantë të parregullt. Duke qenë se kjo procedurë tashmë kryhet nga Policia e Kufirit dhe Migracionit, është dashur një bashkpunim i ngushtë dhe i vazhdueshëm midis kësaj të fundit dhe Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët, gjatë këtyre dy viteve si eksperienca të para, bashkëpunim që sigurisht nuk ka munguar.

Megjithëse numri i azilkërkuesve është i ulët, është e rëndësishme që Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët të sigurojë një zbatim të përpiktë të ligjit për azilin. Kjo do të tregojë angazhimin e plotë të vendit kundrejt të drejtave më themelore – të drejtën e mbrojtjes ndërkombëtare nga persekutimi dhe tortura, apo forma të tjera trajtimi dhe e aftë të përballojë realizimin e plotë të angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga Zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/nënligjore në ketë nënkapitull janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, e ndryshuar.
- Konventa e Gjenevës ”Mbi statusin e Refugjatit”, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 28 korrik e vitit 1951, hyrë në fuqi më 22 prill 1954 dhe Protokollit të New York-ut, 4 tetor 1967, miratuar me Dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, nr. 200, datë 03.06.1992.
- Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut e 3 shtatorit 1953 dhe veçanërisht Protokolli 4, ratifikuar me ligjin nr. 8137 , datë 31.07.1996.
- Konventa kundër torturës dhe vuajtjeve të tjera, ose trajtimit mizor, jonjerëzor a degradues”, ratifikuar me ligjin nr.7727, datë 30.06.1993.
- Konventa Evropiane “Për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues “, ratifikuar me ligjin nr.8135, datë 31.07.1996.
- Ligji nr. 8432, datë 14.12.1998 ”Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 10060, datë 26.01.2009 ”Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998, ”Për azilin në Republikën e Shqipërisë””. Ky ligj është përafruar pjesërisht me këto akte të legjislacionit të BE-së:
  - Direktivën e Këshillit 2005/85/EC, datë 1.12.2005 “Për përcaktimin e standardeve minimale të procedurave në Shtetet Anëtare për dhënien dhe heqjen e statusit të refugjatit”, botuar në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane të datës 13.12.2005, fq.13.
  - Direktivën e Këshillit 2004/83/EC, datë 29 Prill 2004 “Për përcaktimin e standardeve minimale për cilësimin dhe statusin e personave me kombësi nga vendet e treta ose të personave pa shtetësi si refugjat ose si persona që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe përmbajtja e mbrojtjes së dhënë”, botuar në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane datë 30.9.2004, fq.12.
  - Direktivën e Këshillit 2003/9/EC, datë 27 Janar 2003 që parashtron standardet minimale për pritjen e azilkërkuesve, botuar në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Evropiane, datë 6 shkurt 2003, fq.18.

- Direktivën e Këshillit 2001/55/EC, datë 20 Korrik 2001 "Për përcaktimin e standardeve minimale për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rastet e flukseve masive të personave të shpërngulur dhe të masave që nxisin një ekuilibër në përpjekjet ndërmjet Shteteve Anëtare në pritjen e këtyre personave dhe përballimin e pasojave", botuar në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane datë 7.8.2001, fq.12.

- Ligji nr. 9098, datë 03.07.2003 "Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Repubikën e Shqipërisë". Ky ligj është i përafruar pjesërisht me:
  - Direktivën e Këshillit 2003/86/EC, datë 22 shtator 2003 "Mbi të drejtën e bashkimit familjar" (GZ, datë 3 Tetor 2003, fq.12).
- Ligji nr. 9959, datë 17.07.2008 "Për të huajt".
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
- VKM nr. 1102, datë 04.11.2009 "Për trajtimin dhe përfitimin e shërbimeve shëndetësore të personave që kanë fituar azil dhe të personave që kanë aplikuar për azil në RSH".
- VKM nr. 1260, datë 23.12.2009 "Për miratimin e listës së vendeve të treta të sigurta".
- Vendimi nr. 362, datë 01.04.2009 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Vendimi nr. 470, datë 06.05.2009 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e modelit, specifikimeve teknike dhe formatit të dokumentave të udhëtimit për të huajt".
- Vendimi nr. 469, datë 06.05.2009 i Këshillit të Ministrave "Për caktimin e elementeve të sigurisë dhe për miratimin e formës dhe të modelit të lejes së qëndrimit për shtetasit e huaj".
- Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm, nr. 1085, datë 12.06.2006 "Mbi procedurat që zbaton Policia e Shtetit për përzgjedhjen e të huajve të parregullt në kufi".
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit nr. 32, datë 26.10.2009 "Për regjistrimin dhe vlerësimin e nxënësve që kanë përfituar azil në RSH".
- Udhëzim i Ministrit të Punëve të Jashtme, nr. 1909/1, datë 12.02.2010, Ministrit të Brendshëm, nr. 408/2, datë 11.02.2010, Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nr. 331, datë 12.02.2010 dhe Shërbimit Informativ të Shtetit, nr. 1601/1, datë 12.02.2010 "Mbi ngritjen dhe funksionimin e regjistrit elektronik kombëtar për të huajt".
- Urdhër i Ministrit të Brendshëm nr. 752, datë 09.12.2009 "Për marrjen e informacionit dhe verifikimin e deklarimeve nga vendi i origjinës së azilkërkuesit".
- Urdhër i Ministrit të Brendshëm nr. 220, datë 07.07.2010 "Për regjistrimin në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të shtetasve të huaj që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë".
- Rregullorja e funksionimit të Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkues, Babrru, nr. 1561/2, datë 16.05.2007.

Aktualisht pas miratimit të ligjit nr.10060, datë 26.01.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8432, datë 14.12.1998 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë"", përafrimi i kuadrit ligjor është arritur në masën 50%. Kuadri ligjor në shkallën e plotë të përafrimit do të realizohet me përfundimin e ndryshimit të ligjit Nr.9098, datë 03.07.2003 "Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë fituar azil në Republikën e Shqipërisë".

Struktura institucionale

Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët. Kjo drejtori është pjesë e administratës publike dhe pjesë e strukturës së Ministrisë së Brendshme, në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit të Sigurisë Publike.

Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, si strukturë e Ministrisë së Brendshme ka për mision krijimin e një terreni të përshtatshëm ligjor, në drejtim të procedurave për shtetas të huaj që kërkojnë azil në Republikën e Shqipërisë.

Masat Afatshkurtra

Prioritetet e përcaktuara nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët në periudhën e vitit 2012, janë :

- Krijimi i një sistemi operacional.
- Zbatimi i një procedure të caktuar të Statusit të Refugjatit.
- Funksionimi korrekt i sistemit të Azilit: Drejtori, Komisioner Drejtori e Kufirit, Ministri e Punëve të Jashtme, Ministri e Punës dhe Gjykatë.
- Rritja e niveleve trajnuese që i shërbejnë punës dhe riorganizimeve që drejtoria do të realizojë gjatë kësaj periudhe.
- Rritja e bashkpunimeve të saj me institucione paralele e ndihmëse për një mbarëvajtje dhe punë bashkërenduese.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projektligj "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9098, datë 03.07.2003 "Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë fituar azil në Republikën e Shqipërisë".
- Projektligj "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë".
- Aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të këtyre 2 ligjeve.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Hartimi i Regjistrit elektronik (databazë) i refugjatëve të Shqipërisë.
- Organizimi i takimeve dhe trajnimeve me institucione të specializuara që ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve ekzistuese.
- Përfshirja në Regjistrin Kombëtar Elektronik të Gjendjes Civile, të gjithë personave të cilët kanë fituar statusin e refugjatit në Republikën e Shqipërisë.
- Pajisja me dokumente biometrike (letërnjoftimi për të huajt dhe Dokument Udhëtimi biometrik).

Masat Afatmesme

Prioritetet e përcaktuara nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët për periudhën 2013-2015, janë :

- Të sigurohet për Refugjatët që kanë fituar këtë Status në Republikën e Shqipërisë, asistencë e plotë shëndetësore falas, asistencë sociale dhe trajnime profesionale.
- Të sigurohet kalimi i përgjegjësive të plota tek shteti shqiptar për integrimin e refugjatit në jetën shoqërore.

Masat legjislative afatmesme

- Përfundimi i ndryshimeve në "Udhëzimin e Procedurave standarde për Shtetësinë Shqiptare, në Republikën e Shqipërisë".

Masat zbatuese afatmesme

- Paraqitje të modeleve të specializuara që do të shërbejnë si baza përafrimi me organizma dhe misione të vendeve të rajonit.
- Zhvillimi i mirëfunksionimit të drejtorisë duke synuar paraqitje sa më dinjitoze të punës së saj.
- Të arrihen rezultate të dukshme në punën e saj në të gjitha drejtimet.
- Të arrihen rezultate të dukshme kjo dhe me strukturat paralele dhe ndihmëse të saj.
- Vazhdimi i koordinimit të punës me organizma shtetërorë dhe jo vetëm.
- Vazhdimi i specializimit dhe trajnimit të stafit.

Rivlerësimi dhe ripërcaktimi i kapaciteteve administrative të nevojshme

INVESTIME	NJ.MATJES	Gjendja Aktuale	VITET				
			2011	2012	2013	2014	2015
Shtim personeli	specialist	4	4	-	-	-	-
Trajnime	(mijë lekë)						

Për sa i përket trajnimeve të punonjësve të Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët ato do të realizohen nga misionet partnere, si dhe nga organizata mbështetëse, si UNHCR etj.

3.24.5. BASHKËPUNIMI POLICOR DHE LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

Objektivi strategjik

Fenomenet e trafiqeve të paligjshme janë me karakter transnacional dhe si rezultat është domosdoshmëri bashkëpunimi ndërkombëtar me qëllim realizimin e objektivave për parandalimin e luftën kundër trafiqeve, identifikimin, sekuestrimin dhe më pas konfiskimin e aseteve, produkt i kësaj veprimtarie kriminale, me pasoja në shoqëri dhe në ekonomitë e shteteve përkatëse. Vendi ynë si një vend me pozicion gjeografik të favorshëm për t'u përdorur si origjinë, transit apo edhe destinacion për trafiqe të paligjshme nga individë apo grupe individësh, të cilët janë të implikuar në këto trafiqe e kryesisht atë të qënieve njerëzore,

trafikimin e armëve dhe municionit, veprat e artit e kulturës apo të mjeteve motorike etj, është i angazhuar maksimalisht të bashkëpunojë me strukturat homologe të rajonit apo me gjerë, të kryejë hetime e operacione të përbashkëta etj.

Gjithashtu Shqipëria është mjaft e interesuar në ratifikimin e konventave të ndryshme dhe implementimin e suksesshëm të tyre, duke përshtatur legjislacionin dhe ngritjen e strukturave shtetërore të specializuara në këtë drejtim.

Shqipëria ka oficerë ndërlidhës me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe inicimin e hetimeve e operacioneve policore të përbashkëta me vende të ndryshme në Itali, Greqi, Gjermani, Kosovë etj. Gjithashtu një sërë shtetesh kanë të akredituar në Shqipëri oficerët e kontaktit të cilët shkëmbejnë informacione dhe iniciojnë operacione të përbashkëta me Policinë e Shtetit. Vendi ynë ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për Krimin e Organizuar Ndërkombëtar dhe protokollet shtesë", Konventën e Këshillit të Evropës" për Masat Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore", Konventën për Bashkëpunimin Policor për vendet e Evropës Juglindore" etj. Vendi ynë është pjesë e INTERPOL dhe ka nënshkruar marrëveshje strategjike e synon të nënshkruajë marrëveshje operacionale me EUROPOL. Gjithashtu aderon në një sërë organizmash rajonalë e ndërkombëtarë për luftën kundër krimit të organizuar.

Gjithashtu në Nenet 4, 82, 84 dhe 85 Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit është parashikuar bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE në këtë fushë.

LUFTA KUNDËR TRAFIQEVE TË PALIGJSHME

Objektivi strategjik

Fusha e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve të paligjshme është një ndër fushat prioritare edhe në të ardhmen për Qeverinë Shqiptare, si dhe një element shumë i rëndësishëm në përmbushjen e standardeve në kuadër të integrimit të Shqipërisë dhe të marrjes së Statusit të Vendit Kandidat për në BE. Angazhimet e ndërmarra dhe objektivat e përcaktuara shkojnë në një linjë me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Detyrimet parashtrojnë domosdoshmërinë e angazhimit të Shqipërisë në nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, për çështje që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, migrimit të paligjshëm dhe trafikimit, duke përfshirë në veçanti atë të qënieve njerëzore, kontrabandën, trafikimin e paligjshëm të armëve dhe të makinave, etj. Këto detyrime përbëjnë një faktor kyç për zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në stabilitetin rajonal.

Strukturat e luftes kundër trafikut të paligjshëm janë plotësisht të angazhuar në forcimin e luftës ndaj fenomenit të krimit të organizuar dhe trafiqeve të paligjshme, duke synuar arritjen e standardeve të kërkuara dhe plotësimin e angazhimeve të marra.

Gjithashtu në Nenet 4 dhe 85 Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit është parashikuar bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE në këtë fushë.

Statusi Aktual

Lufta për parandalimin dhe goditjen e trafiqeve të paligjshme është mbështetur dhe mbështetet në planizimin e punës dhe koordinimin ndërstrukturor e ndërinstitucional sikurse parashikohet në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Krimit të Organizuar Trafiqeve dhe Terrorizmit dhe Planit përkatës të Veprimit, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1103, datë 14.11.2009, strategji e cila është referencë për strategjitë Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore dhe dokumentit shtesë për të mitur etj.

Legjislacioni shqiptar në drejtim të luftës për parandalimin dhe goditjen e trafiqeve të paligjshme është përgjithësisht i përafruar me EU *acquis.* Elementët kryesorë ku evidentohet përputhshmëria janë në trajtimin e veprave penale të veçanta sikurse "Kontrabandimi i migrantëve" parashikuar nga legjislacioni penal shqiptar, si "Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve", parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal. Në këtë dispozitë ka përputhje të plotë si në parashikimin e rekrutimit, transportimit, tranzitimit, strehimit etj. të migrantëve të paligjshëm me qëllim kalimin e paligjshëm të kufijve shtetërorë apo hyrjen në kufirin e një shteti tjetër, në të cilin nuk janë rezidentë apo nuk kanë leje të qëndrimit të përkohshëm nga autoritetet e shtetit destinacion. Pra kjo dispozitë është plotësisht e përputhur, siç u përmend me EU *acquis*. Gjithashtu edhe në parashikimin që legjislacioni shqiptar i bën trajtimit të veprave penale të trafikimit të qënieve njerëzore, sikurse "Trafikimi i femrave", "Trafikimi i të miturve" etj. apo dhe veprave penale sikurse "Trafikimi i mjeteve motorike", "Trafikimi i veprave të artit e kulturës" etj. Për sa i përket trajtimit të trafikimit të armëve dhe municioneve, me qëllim përafrimin e legjislacionit me BE-në, në këtë drejtim, ka nevojë për ndryshime për të cilat është duke u punuar nga grupe ndërinstitucionale pune për ndryshimet e nevojshme.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/nënligjore, janë:

- Ligji Nr.8920, datë 11.07.2002, "Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara, kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj", Protokolli i Palermos, i vitit 2000 "Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave veçanërisht të femrave dhe fëmijëve, në plotësim të konventës së OKB-së "Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar", si dhe 2 protokollet e po kësaj konvente "Për kontrabandimin e migrantëve nga toka, deti dhe ajri". Ky ligj *përafrohet plotësisht* me:
- Vendimin e Këshillit 2006/619/EC, datë 24 Korrik 2006 Mbi konkluzionet nga ana e Komunitetit Evropian të Protokollit për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të qënieve njerëzore, në veçanti grave dhe fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar në lidhje me dispozitat e Protokollit, për aq sa dispozitat e Protokollit, deri më tani, janë brenda

fushës së veprimit të Pjesës III, Titulli IV të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian (GZ L 262, të datës 22 shtator 2006, fq. 51);

- Vendimin e Këshillit 2006/617/EC datë 24 korrik 2006 Mbi konkluzionet nga ana e Komunitetit Evropian, të Protokollit kundër kontrabandimit të migrantëve nga toka, deti dhe ajri, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar në lidhje me dispozitat e Protokollit, për aq sa dispozitat e Protokollit, deri më tani, janë brenda fushës së veprimit të Pjesës III, Titulli IV të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian (GZ L 262, të datës 22 shtator 2006, fq.34);
- Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Palermo, Dhjetor 2000;
  a) Protokollin e datës 15 Nëntor 2000 për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit në njerëz, në veçanti grave dhe fëmijëve, që plotëson Konventën e kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar;
  b) Protokollin e datës 15 Nëntor 2000 kundër kontrabandimit të migrantëve nga toka, deti dhe ajri që plotëson Konventën e kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar;
  c) Protokollin e datës 31 Maj 2001 kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre, Komponentëve dhe Municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar;
  d) Vendimin e Këshillit 2004/579/EC mbi konkluzionet nga ana e Komunitetit Evropian, të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GZ L 261 datë 6 Gusht 2004, fq.69).

- Ligj Nr.9838, datë 10.12.2007 "Per aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar". Ky ligj *përafrohet plotësisht* me:

- Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Palermo, Dhjetor 2000;
  a) Protokollin e datës 15 Nëntor 2000 për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit në njerëz, në veçanti grave dhe fëmijëve, që plotëson Konventën e kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar;
  b) Protokollin e datës 15 Nëntor 2000 kundër kontrabandimit të migrantëve nga toka, deti dhe ajri që plotëson Konventën e kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar;
  c) Protokollin e datës 31 Maj 2001 kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre, Komponentëve dhe Municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar;
  d) Vendimin e Këshillit 2004/579/EC mbi konkluzionet nga ana e Komunitetit Evropian, të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GZ L 261 datë 6 Gusht 2004, fq.69).

- Memorandumi i Mirëkuptimit i nënshkruar me 1 dhjetor 2009 në Hagë "Për krijimin e linjave të sigurta të komunikimit midis Europol dhe Republikës së Shqipërisë", Plani i Veprimit për Implementimin e Marrëveshjes Strategjike të Bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe EUROPOL, si dhe Dokumentin Teknik i Marrëveshjes Bilaterale midis Europol dhe Republikës së Shqipërisë, për instalimin dhe lidhjen e Rrjeteve Kompjuterike.

- Ligji Nr.9642, Datë 20.11.2006 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore". Ky ligj përputhet me;
- Vendimin e Këshillit 2006/619/EC, datë 24 Korrik 2006 Mbi konkluzionet nga ana e Komunitetit Evropian të Protokollit për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të qënieve njerëzore, në veçanti grave dhe fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar në lidhje me dispozitat e Protokollit, për aq sa dispozitat e Protokollit, deri më tani, janë brenda fushës së veprimit të Pjesës III, Titulli IV të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian (GZ L 262, të datës 22 shtator 2006, fq. 51).
- Ligji Nr. 10 071, datë 9.02.2009 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit dhe abuzimeve seksuale"";
- Ligji Nr. 9749, Datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit";
- Ligji Nr. 8677, datë 02.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë Gjyqësore", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7895, Datë 27.01.1995 "Kodi Penal" të cilit në mënyrë të vazhdueshme i janë bërë disa herë ndryshime duke shtuar figura të reja veprash penale kryesisht në fushën e luftës kundër krimit të organizuar. Ky ligj përputhet me:
  1. Rezolutën e datës 23 Nëntor 1995 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në luftën kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GZC 327 datë 7 Dhjetor 1995, fq. 5) (*në mënyrë të pjesshme*);
  2. Rezolutën e datës 20 Dhjetor 1996 mbi Individët që bashkëpunojnë me proceset gjyqësore në luftën kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GZ C 10 datë 11 Janar 1997, fq. 1) (*në mënyrë të pjesshme*);
  3. Vendimin Kuadër të Këshillit 2004/68/JHA datë 22 Dhjetor 2003 mbi luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë për fëmijë (GZ L 13 datë 20 Janar 2004, fq. 44) (*në mënyrë të pjesshme*);
  4. Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/946/JHA datë 28 Nëntor 2002 mbi forcimin e kuadrit penal për të parandaluar lehtësimin e hyrjes së paautorizuar, tranzitit dhe banimit (GZ L 328 datë 5 Dhjetor 2002, fq. 1) (*në mënyrë të pjesshme*).
- Ligji Nr. 9686, datë 26.2. 2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7895, Datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9859, datë 21.1.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1. 1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"", të ndryshuar;
- Ligji Nr. 7905, Datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të cilit i janë bërë gjatë këtyre viteve një sërë ndryshimesh dhe përmirësimesh në lidhje me procedimin penal të autorëve të krimit dhe aplikimin e teknikave dhe metodave speciale të hetimit;
- Ligji Nr. 9959, datë 17.07.2008 "Për të huajt" Ky ligj përputhet në mënyrë të pjesshme me:
- Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/946/JHA datë 28 Nëntor 2002 mbi forcimin e kuadrit penal për të parandaluar lehtësimin e hyrjes së paautorizuar, tranzitit dhe banimit (GZ L 328 datë 5 Dhjetor 2002, fq. 1).
- Ligji Nr.10 220, datë 04.02.2010 "Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese në Republikën e Shqipërisë". Ky ligj përputhet me:
- Vendimin e Komisionit 2007/675/EC datë 17 Tetor 2007 për ngritjen e Grupit të Ekspertëve mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore (GZ L 277datë 20 Tetor 2007, fq. 29);

- Vendimin e Komisionit 2008/604/EC datë 22 Korrik 2008 Mbi caktimin e anëtarëve të Grupit të Ekspertëve për Trafikimin e Qenieve Njerëzore (GZ L 194 datë 23 Korrik 2008, fq. 12);
- Ligji Nr. 10252, datë 11.03.2010 "Për disa shtesa në ligjin Nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore"" (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 10193, datë 3.12.2009 "Për marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale". Ky ligj përputhet *në mënyrë të pjesshme,* me:
  1. Rezolutën e datës 23 Nëntor 1995 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në luftën kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GZ C 327 datë 7 Dhjetor 1995, fq. 5);
  2. Vendimin Kuadër të Këshillit datë 26 Qershor 2001 Mbi pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e mjeteve dhe të ardhurave nga krimi (GZ L 182 datë 5 Korrik 2001, fq. 1);
  3. Vendimin Kuadër të Këshillit 2006/783/JHA datë 6 Tetor 2006 Mbi aplikimin e njohjes reciproke të urdhrave të konfiskimit (GZ L 328 datë 24 Nëntor 2006, fq. 59);
  4. Rezolutën e datës 20 Dhjetor 1996 mbi Individët që bashkëpunojnë me proceset gjyqësore në luftën kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GZ C 10 datë 11 Janar 1997, fq. 1).
- Ligji Nr. 10173, datë 22.10.2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë". Ky ligj përputhet në *mënyrë të pjesshme* me:
  1. Rezolutën e datës 23 Nëntor 1995 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në luftën kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GZ C 327 datë 7 Dhjetor 1995, fq. 5);
  2. Rezolutën e datës 20 Dhjetor 1996 mbi Individët që bashkëpunojnë me proceset gjyqësore në luftën kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GZ C 10 datë 11 Janar 1997, fq. 1)
- Ligji Nr.10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë". Ky ligj *përputhet në mënyrë të plotë* me:
  1. Vendimin Kuadër të Këshillit 2005/212/JHA datë 24 Shkurt 2005 mbi konfiskimin e të ardhurave të lidhura me krimin, mjeteve dhe pronës (GZ L 68 datë 15 Mars 2005, fq. 49).
- Ligji Nr. 9544, date 29.05.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktima të trafikimit", iniciativë e cila është në *përputhje të plotë* me Veprimin e Përbashkët, të 24 Shkurt 1997, i adoptuar nga Këshilli në bazë të nenit K. 3 të Traktatit të Bashkimit Evropian në lidhje me veprimin për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve. Kjo marrëveshje është në përputhje me:
  1. Vendimin Kuadër të Këshillit 2004/68/JHA datë 22 Dhjetor 2003 mbi luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë për fëmijë (GZ L 13 datë 20 Janar 2004, fq. 44) (*në mënyrë të pjesshme*);
- VKM Nr. 215, datë 11. 02. 2009, "Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 933, datë 2.7.2008 "Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë dhe Europol "". Kjo VKM është në *përputhje të pjesshme*, me:
  1. Vendimin e Këshillit 2009/371/JHA datë 6 Prill 2009 Për krijimin e Zyrës së Policisë Evropiane (GZ L 121 datë 15 Maj 2009, fq. 37).

- VKM nr. 483 datë 6.5.2009, i cili miraton në parim Marrëveshjen me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Hollandës, për Privilegjet dhe Imunitetet e Oficerëve Ndërlidhës gjatë kohës që do të shërbejnë pranë Zyrës Shqiptare të Ndërlidhjes në Europol.
- VKM Nr. 759, datë 08. 07. 2009 "Për përballimin e shpenzimeve të punonjësve shqiptarë, që shërbejnë si oficerë kontakti pranë Ministrive të Brendshme të shteteve të ndryshme, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë".
- Urdhër i Ministrit të Brendshëm Nr. 141, datë 27.04.2010 "Për referimin dhe regjistrimin e aktit të lindjes të personave që figurojnë të paregjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile".
- Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit "Për manualin e punës në sistemin e vlerësimit të rrezikut të krimit të organizuar".
- Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr.23, datë 15.01.2009 "Për vëzhgimin e fshehtë të personave e mjediseve dhe procedurat standarde gjatë aplikimit të tyre".
- Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr.93, datë 25.02.2009 "Për menaxhimin e punonjësve të policisë nën mbulim apo të infiltruar".

Dokumentet strategjikë të miratuara për fushën e luftës kundër trafiqeve të paligjshme, janë:

- "Strategjia Kombëtare e Luftës Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore", si dhe Dokumenti Plotësues "Për Luftën Kundër Trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve–viktima të trafikut", miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.1083, datë 23.07.2008;
- Plani i Veprimit "Për Luftën Kundër Trafikimit te Qenieve Njerëzore dhe dokumenti shtesë i mbrojtjes së fëmijëve viktima të trafikut", miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.142 datë 23.02.2011;
- Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm Nr. 30, datë 05.02.2010 "Për veprimin e përbashkët të strukturave zbatuese të Strategjisë Kombëtare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore", akte të cilat përputhen me:
  1. Vendimin Kuadër të Këshillit 2004/68/JHA datë 22 Dhjetor 2003 mbi luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë për fëmijë (GZ L 13 datë 20 Janar 2004, fq. 44)
- "Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve dhe Terrorizmit", miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.1140, datë 30.07.2008, si dhe Plani i Veprimit i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1103, datë 14.11.2009, "Për miratimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve dhe Terrorizmit"".
- Urdhër i përbashkët midis Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes Nr. 4529, datë 9.06.2008 "Për dhënien e ndihmës mjekësore personave të marrë nën mbrojtje".
- Plani Kombëtar i Veprimit "Per parandalimin dhe Luftën Kundër Vjedhjes e Trafikimit të Veprave të artit e Kulturës", miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.917, datë 28.12.2011, i cili përputhet me:

1. Konkluzionet e Këshillit mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikut të paligjshëm të veprave të kulturës, miratuar në datë 27 Nëntor 2008 (I papublikuar në Fletoren zyrtare).

Struktura Institucionale

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për luftën kundër krimit të organizuar, përveç institucioneve të tjera, është përgjegjëse edhe Drejtoria Kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve, në përbërje të Departamentit Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda të Hetimit të Krimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendshme, e përbërë nga 3 tre sektorë:

- Sektori i Luftës Kundër Narkotikëve;
- Sektori i Luftës Kundër Trafikut të Paligjshëm;
- Sektori për Hetimin e Aseteve kriminale.

Në strukturat vendore: kjo drejtori ka në varësi në 12 Drejtoritë e Policisë së Qarqeve, Sektorët kundër Krimit të Organizuar dhe ka Seksionet e Luftës Kundër Drogës dhe Seksionet e Luftës Kundër Trafiqeve të Paligjshme.

Drejtoria Kundër Narkotikeve dhe Trafiqeve ka për mision bashkërendimin, kontrollin, parandalimin, zbulimin dhe luftën kundër të gjithë formave të krimit të organizuar dhe trafiqeve të paligjshme.

Struktura kryesore përgjegjëse për organizminin e punës për parandalimin dhe luftën kundër trafiqeve të paligjshme në Policinë e Shtetit, është Sektori i Luftës Kundër Trafiqeve të Paligjshme. Ky sektor ka për mision bashkërendimin, kontrollin, dhe ushtrimin e veprimtarisë për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe ndërprerjen e veprimtarisë kriminale që zhvillohet në fushën e trafiqeve të paligjshme, ndërsa në nivel vendor 12 seksionet kanë për mision parandalimin dhe zbulimin e veprave penale në fushën e trafiqeve të paligjshme.

Sektori i Luftës Kundër Trafiqeve të Paligjshme ushtron veprimtarinë e tij në përbërje të Drejtorisë Kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve në Departamentin Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda në Policinë e Shtetit dhe ka atributet e Shërbimit të Policisë Gjyqësore. Ky sektor përbëhet nga Shefi i Sektorit dhe 8 (tetë) specialistë të cilët mbulojnë drejtimet e trafiqeve të paligjshme sikurse janë: Trafikimi i personave (neni 110/a i K.Penal), Shfrytëzimi i prostitucionit (neni 114 i K.Penal), Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (neni 114/a i K.Penal), Trafikimi i femrave (neni 114/b i K.Penal), Mbajtja e lokaleve për prostitucion (neni 115 i K.Penal), Trafikimi i të miturve (neni 128/b i K.Penal), Trafikimi i veprave të artit (neni 138/a i K.Penal), Trafikimi i mjeteve motorike (neni 141/a i K.Penal), Trafikimi i armëve dhe municioneve luftarake (neni 278/a i K.Penal), Trafikimi i L.Plasëse, Helmuese dhe Radioaktive (neni 282/a i K.Penal), Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit shtetëror (neni 298 i K.Penal).

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e krimit të organizuar dhe trafiqeve të paligjshme, bashkëpunon me:

- Ministrinë e Drejtësisë në hartimin e legjislacionit në fushën e luftës kundër krimit organizuar dhe të trafiqeve të paligjshme.
- Prokurorinë e Përgjithshme (Prokurorinë per Krime të Rënda) në hetimin e rasteve kriminale dhe ecurinë e tyre.

- Shërbimin Informativ Shtetëror në kuadër të shkëmbimit të informacioneve dhe realizimit të operacioneve të përbashkëta.
- Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në kuadrin e akomodimit dhe riintegrimit të viktimave të trafikimit.
- Ministrinë e Punëve Publike dhe Transporteve për parandalimin dhe goditjen e trafikimit të mjeteve motorike.
- Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Luftës kundër Pastrimit të Parave), për trafiqet e paligjshme, në mënyrë të veçantë kundër trafikimit të mjeteve motorike, armëve e municioneve.
- Ministrinë e Mbrojtjes si në drejtim të shkëmbimit të informacioneve (me SHIU-n) edhe në operacione të përbashkëta (me Distriktin Detar).
- Organet e pushtetit vendor dhe qendror.
- Misionet e huaja policore që operojnë në Shqipëri

Në kuadër të parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në bazë të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 203, Datë 19.12.2005, pranë Koordinatores Kombëtare për Antitrafikun/Zëvendësministres së Brendshme, është ngritur Njësia Antitrafik e cila monitoron, bashkërendon, mbledh informacione dhe raporton mbi çështje që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore.

Masat legjislative afatshkurtra

- Draft për ndryshimin e nenit 75/a "Kompetencat e Gjykatës për Krimet e Rënda" në ligjin Nr.9276, datë 16.09.2004. Qëllimi i ndryshimit në këtë nen, është përfshirja e nenit 141/a "trafikimi i mjeteve motorike", si vepër penale, kompetencë e Gjykatës për Krimet e Rënda.
- Ndryshim të dispozitës të nenit 297 të Kodit Penal. Në nenin 297 "Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror", do të ndryshohet dhe të bëhet "Kalimi i paligjshëm i kufijve shtetëror".
- Miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit (shtesë) "Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të trafikimit të mjeteve motorrike të vjedhura, kontrabanduara dhe me shkelje të tjera ligjore".
- Nënshkrimi i Marrëveshjeve/Protokolleve për shkëmbimin e të dhënave dhe për kryerjen e hetimeve të përbashkëta me Malin e Zi, Greqinë, Kosovën, Maqedoninë, si edhe me vendet e tjera të BE-së sipas nevojës.
- Fillimi i bisedimeve dhe nënshkrimi i Marrëveshjes Operacionale të Bashkëpunimit mes EUROPOL dhe Policisë së Shtetit.
- Nënshkrimi i marrëveshjes se bashkëpunimit me CEPOL (Kolegji Policor Europian).
- Nënshkrimi i marrëveshjes me Austrinë për shkëmbimin e të dhënave për menaxhimin e migracionit dhe azilit.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Zbatimi i "Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, si dhe Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktima të trafikimit 2011-2013".

- Përfundimi i lidhjes online ndërmjet D.P.SH.T.RR dhe D.P.P.SH, për shkëmbim informacioni, në bazë të detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjen e bashkëpunimit me nr.prot.4290/2 datë 26.11.2007.
- Realizimi i dhënies së aksesit në Sistemin ASF2 të Interpolit në përdorim të Organinit Shtetëror të Gjykimit të Kundravajtjeve Administrative, pranë Njësive Rajonale të Policisë Rrugore.
- Shkëmbimi i informacionit ndërmjet shërbimeve doganore dhe policisë rrugore, për mjete që kanë shkelur rregullat e lejimit të përkohshëm të qarkullimit të mjeteve me targa të huaja.
- Përdorim efikas i bazës së të dhënave për viktimat e trafikimit, për gjenerimin e një informacioni të plotë për rastet e viktimave të trafikimit të kthyera, referuara, trajtuara dhe mbrojtura në Shqipëri.
- Funksionimi i plotë i Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) - Zbatimi i Procedurave Standarde të Veprimit per identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.
- Rritja e numrit të punonjëseve femra në strukturat antitrafik dhe në pikat e kalimit kufitar.
- Bashkëpunimi me Sekretariatin e Konventës së Bashkëpunimit Policor për Vendet e Evropës Juglindore (Konventa e Vjenës), për krijimin e grupeve të përbashkëta hetimore, për hetimin e trafikimit të Qënieve Njerëzore me vendet e rajonit.
- Vazhdimi i pjesëmarrjes në veprimtaritë rajonale/ndërkombëtare kundër trafikimit, organizuar nga Qendra SELEC, si dhe Interpoli.
- Trajnimi i strukturave të ngarkuara drejtpërsëdrejti me zbatimin e Proçedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit, miratuar me VKM nr.582, datë 27.07.2011.
- Krijimi i grupit ndërinstitucional të punës, për monitorimin e luftës kundër vjedhjes dhe trafikimit të veprave të artit e kulturës, me pjesmarrjen e një perfaqësuesi të çdo institucioni pergjegjës (Policia, Ministria e Kulturës, Drejtoria e Doganave, etj)
- Trajnimi i Oficerëve të policisë (specialistëve të L.K.Trafiqeve të paligjshme), në drejtim të njohjes së legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, në fushën e veprave të artit dhe kulturës (Ligji i Trashëgimise Kulturore, konventa e UNESCO-s, etj) format e trafikimit të veprave të artit, dhe mjetet e metodat më efikase hetimore në luftë kundër këtij fenomeni.
- Krijimi i pikave të kontaktit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Shtetit, dhe Drejtorisë së Trashëgimisë Kulturore, Q.K.I.P.K në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Institutin e Arkeologjisë.
- Krijimi i grupit Task Force për parandalimin dhe goditjen e trafikimit të mjetevemotorrike me miratimin e planit te veprimit.
- Akreditimi i oficerit ndërlidhës ne Francë.

Masat legjislative afatmesme

- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit rajonal me policitë homologe kundër krimit të organizuar.
- Hartimi i ndryshimeve te dispozitës se nenit 278/a te Kodit Penal "Për trafikimin e armëve dhe municioneve", në përputhje me Ligjin Nr. 9838, datë 10.12.2007 "Për

aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, që plotëson konventën e kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar".

Masat zbatuese afatmesme

- Përgatitja e një materiali përmbledhës në bazë rajonesh (qarku), në lidhje me fondet e trashëgimisë kulturore në rajonin përkatës, për sa i përket parqeve arkeologjike, muzeve historikë e arkeologjikë, arkivave të shtetit në rrethe, objekteve të kultit, monumenteve të kulturës, në tërësi gjendja e objekteve, si dhe vendeve që ruajnë dhe ekspozojnë trashëgimi kulturore.
- Krijimi i një baze të dhënash në TIMS, ose një lidhje (link) ndërmjet kësaj baze të dhënash të re dhe TIMS, që bën të mundur një "vetëkontroll", të ngjashëm me sistemin ndërmjet Interpol dhe Sistemit TIMS, për evidentimin e mjeteve të vjedhura, në Republikën e Shqipërisë, si dhe regjistrimin e tyre në sistemin TIMS.
- Realizimi i dhënies së aksesit në Sistemin TIMS në përdorim të shërbimit doganor, me qëllim zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në V.K.M me nr. 1922, datë 14.10.2009, lidhur me monitorimin për mbylljen e regjimit të përkohshëm të mjeteve me targa të huaja.

NJËSIA ANTITRAFIK

Statusi Aktual

Shqipëria ka demonstruar arritje në fushën e luftës kundër trafikimit të personave. Disa nga arritjet më të rëndësishme janë krijimi i strukturave të posaçme qendrore dhe lokale të ngarkuara dhe të pajisura me burimet për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e personave. Disa nga arritjet më të rëndësishme janë:

- Caktimi i Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave dhe zyrës mbështetëse, Njësisë Antitrafik;
- Ngritja dhe funksionimi i 12 Komiteteve Rajonale Antitrafik në 12 qarqe të vendit;
- Ngritja dhe funksionimi i Autoritetit Përgjegjës për Identifikimin, Referimin dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit;
- Shqipëria ka hartuar Planin e ri Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, si dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Viktima të trafikimit 2011-2013, ky Plan është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 23.2.2011. Ky Plan Veprimi mbulon të gjitha aspektet e hetimit, ndjekjes penale, mbrojtjes, asistencës, parandalimit, koordinimit dhe partneritetit në fushën e antitrafikimit.
- Funksionin prej disa vitesh Mekanizmi Kombëtar i Referimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit. Ky Mekanizëm është institucionalizuar me një Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Policisë së Shtetit, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Qendrës Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, Qendrës Tjetër Vizion-Elbasan,

Qendrës "Të ndryshëm & të barabartë-Tiranë, Qendrës "Vatra"-Vlorë, Organizatës ARSIS-Tiranë, IOM. Me qëllim përmirësimin dhe forcimin e procedurave për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat/viktimat e mundshëm të trafikimit janë miratuar Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshëm të Trafikimit. Këto procedura janë miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 582, datë 27.7.2011. Aktualisht, identifikimi dhe referimi i viktimave të trafikimit në vend kryhet në përputhje të plotë me Procedurat Standarde të Veprimit.

Masat legjislative afatshkurtra

- Propozime për ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë që kanë për qëllim të përmirësojnë dispozitat penale për trafikimin si dhe plotësimin me disa figura të reja penale që rregullojnë këtë fushë.
- Propozime për ndryshime në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë që kanë për qëllim rritjen e aksesit në drejtësi për viktimat e trafikimit.
- Projektvendim "Për Trajtimin dhe Përfitimin e Shërbimeve Shëndetësore të Viktimave të Trafikimit".

Masat zbatuese afatshkurtra

- Funksionimi i plotë i Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) - Zbatimi i Procedurave Standarde të Veprimit si pjesë integrale e marrëveshjes së riparë për MKR.
- Funksionimi i plotë i Autoritetit Përgjegjës për Mekanizmin Kombëtar Referues (MKR), i cili bashkërendon procesin e referimit për ndihmë dhe mbrojtje fillestare dhe rehabilitimin afatgjatë të viktimave të trafikimit.
- Funksionimi i plotë i Komiteteve Rajonale Antitrafik të ngritura me Urdhër të Kryeministrit Nr. 139, Datë 19.06.2006 "Për Krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore".
- Përdorim efikas i bazës së të dhënave për viktimat e trafikimit, për gjenerimin e një informacioni të plotë për rastet e viktimave të trafikimit te kthyera, referuara, trajtuara dhe mbrojtura në Shqipëri.

Masa legjislative afatmesme

- VKM "Për miratimin e "Planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore" dhe të dokumentit plotësues "Plani i veprimit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktima të trafikimit"".

Masat zbatuese afatmesme

- Zbatimi i plotë i Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore si dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve, Viktima të Trafikimit 2011-2013".

HETIMI I ASETEVE KRIMINALE

Objektivi Strategjik

Objektivi afatgjatë i strukturave për hetimin e aseteve kriminale në luftën kundër krimit të organizuar, është parandalimi dhe goditja e tij nëpërmjet hetimit me qëllim sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të personave që ushtrojnë këtë aktivitet kriminal.

Statusi Aktual

Hetimi i aseteve kriminale vlerësohet si një mjet efikas në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Megjithatë, aplikimi në praktikë i standardeve ndërkombëtare dhe për më tepër i dispozitave ligjore ekzistuese, mbetet një sfidë jo vetëm për vendin tonë, por dhe për shumë vende anëtare të Bashkimit Europian. Vendi jonë ka miratuar ligje të cilat mundësojnë kryerjen e hetimeve me qëllim, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit, si dhe ka krijuar struktura të posaçme për hetimin dhe administrimin e produkteve që burojnë nga aktivitete të paligjshme.
Për më tepër, duhet theksuar se përqasja e legjislacionit tonë për hetimin e aseteve kriminale është bërë në përputhje apo në bazë të detyrimeve të dala nga konventa të ndryshme si dhe me acquis communautaire. Konkretisht, si më poshtë:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Substancave Narkotike dhe Psikotrope;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekustrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe për Financimin e Terrorizmit;
- Konventa Evropiane për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen, Konfiskimin dhe Depistimin e Produkteve të Krimit,
- Konventa e Këshillit të Evropës për Ndihmën e Ndërsjelltë Juridike;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Ndihmën e Ndërsjelltë Juridike në Fushën Penale,

si dhe në bazë të një sërë direktivash dhe vendimesh të institucioneve të Bashkimit Europian, si:

- Vendim Kuadër 2003/577 i Bashkimit Evropian për zbatimin në BE të urdhërave për ngrirjen e aseteve ose të pronave;
- Vendim Kuadër 2005/212 i Bashkimit Evropian, për Konfiskimin e Produkteve, të Instrumenteve dhe të Pasurive të Lidhura më Krimin;
- Vendim Kuadër 2006/783 i Bashkimit Evropian për zbatimin e njohjes reciproke të urdrave të konfiskimit;
- Vendim Kuadër 2007/845 i Bashkimit Evropian për bashkëpunimin ndërmjet zyrave të rikuperimit të aseteve, etj.

Lufta kundër krimit të organizuar ka qenë dhe mbetet një ndër prioritet strategjike qeveritare dhe të vetë Policisë së Shtetit. Ky objektiv është pasqyruar më së mirë dhe në strategjinë 7-vjeçare të Policisë së Shtetit. Duke patur parasysh tendencat dhe tiparet e krimit të organizuar

u vlerësua e nevojshme aplikimi i metodës së sekustrimeve dhe konfiskimeve të pasurive që burojnë nga aktivitete kriminale. Edhe pse, aplikimi i metodës së hetimeve parandaluese ose pasurore ka filluar të kryhet vitet e fundit, rezultatet e arritura janë premtuese dhe demonstrojnë suksesin në luftë kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Është e rëndësishme të theksojmë se kjo metodë nuk përdoret si mjet për fajësimin e personave të përfshirë në aktivitete kriminale, por si mjet parandalues nëpërmjet zbatimit të masave të sekuestrimit dhe konfiskimit të këtyre pasurive.

Konkretisht, neni 4 i Ligjit Nr. 10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", saktëson se masë parandaluese është çdo masë me karakter pasuror që gjykata vendos në një procedim gjyqësor, nëpërmjet sekuestrimit të pasurisë, veprimtarisë ekonomike, tregëtare, dhe profesionale të personave, si dhe nëpërmjet konfiskimit të tyre. Pra. është e qartë se vetë legjislacioni në thelb përcakton këto dy lloj masash parandaluese, zbatimi në praktikë i të cilave ndërthuret me detyrimet e përcaktuara në Kodin Civil dhe në Kodin e Procedurës Penale.

Suksesi në luftë kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda nëpërmjet zbatimit të masave parandaluese do të arrihet duke rritur kapacitetet e strukturave për hetimin e aseteve kriminale, përmirësimin e infrastrukturës, si dhe forcimit të bashkëpunimit me institucione, brenda dhe jashtë vendit dhe identifikimit të përvojave më të përparuara.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/nënligjore janë:

- Ligji Nr.10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i përafruar me:
  1. Konventën e Këshillit të Evropës "Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale" të datës 20 prill 1957 dhe të protokollit të saj shtesë të datës 17 mars 1997.
  2. Konventën për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit", New York, 10 qershor 1958, hyrë në fuqi, më datë 7 qershor 1959.
  3. Konventën e Kombeve te Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, e miratuar nga Konferenca në mbledhjen e saj të 6-të plenare, më datë 19 dhjetor 1988.
  4. Konventën e vetme mbi drogat narkotike, e ndryshuar nga protokolli i vitit 1972 "Për ndryshimin e konventës së vetme mbi drogat narkotike, 1961".
  5. Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj, "Protokolli kundër kontrabandimit të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare" dhe "Protokolli për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve".
  6. Konventën Evropiane "Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale".

Gjithashtu është e përafruar me një sërë direktivash dhe vendimesh të institucioneve të Bashkimit Evropian, si:

- Vendimi Kuadër 2003/577 i Bashkimit Evropian për zbatimin në BE të urdhërave për ngrirjen e aseteve ose të pronave;

- Vendimi Kuadër 2005/212 i Bashkimit Evropian, për Konfiskimin e Produkteve, të Instrumenteve dhe të Pasurive të Lidhura më Krimin;
- Vendimi Kuadër 2006/783 i Bashkimit Evropian për zbatimin e njohjes reciproke të urdhërave të konfiskimit;
- Vendimi Kuadër 2007/845 i Bashkimit Evropian për bashkëpunimin ndërmjet zyrave të rikuperimit të aseteve, e të tjera.

Ligji i ri në krahasim me ligjin e mëparshëm, ka sjellë disa qartësime që lidhen me procedurat e sekuestrimit dhe konfiskimit, pavarësisht gjendjes apo ekzistencës së procedimit penal, dënimit penal ose jo për këto vepra, si dhe zgjerimin e fushës së vet të veprimit për vepra penale të reja si shpërndarja e lëndëve narkotike, shfrytëzim e prostitucionit në rrethana rënduese dhe pastrimin e produkteve të krimit, si dhe zgjeruar rrethin e personave subjekt të vetë ligjit.
Gjithashtu, ky ligj ka mundësuar krijimin e Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar, përfshirjen e përmbaruesve gjyqësorë në procesin e sekuestrimit dhe konfiskimit, si dhe saktësimin e procedurave në lidhje me administrimin e këtyre pasurive.

Struktura institucionale

Hetimi i Aseteve Kriminale kryhet nga Sektori për Hetimin e Aseteve Kriminale, e cila është strukturë e posaçme brenda Drejtorisë Kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve, në Drejtorinë Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, i ci u krijua me Urdhrat e Ministrit të Brendshëm, Nr 372/6, datë 26.01.2010 "Për miratimin e strukturës dhe limitin e organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit" dhe Nr. 200, datë 16.06.2010, "Për miratimin e strukturës dhe limitit të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit". Në bazë të këtyre dy akteve nënligjore u bë e mundur shtrirja e plotë e strukturës për hetimin e aseteve kriminale në nivel vendor dhe qendror. Këto struktura në përmbushjen e misionit të tyre bashkëpunojnë ngushtë me Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë.

Për rritjen e kapaciteteve si dhe identifikimin e përvojave më të përparuara në hetimin e aseteve kriminale me punonjësit e këtyre strukturave janë kryer një sërë trajnimesh me OPDAT, ICITAP dhe PAMECA III, në të cilat kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga Prokuroria për Krime të Rënda dhe struktura të tjera si Ministria e Financave, e Drejtësisë, Zyrat e Përmbarimit Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Aktualisht, janë hartuar përshkrimet e punës për çdo funskion për hetimin e aseteve kriminale, formularët statistikorë, procedurat standarde për hetimin e aseteve kriminale, si dhe një manual orientues për hetimin e aseteve kriminale dhe Letër Porosinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 308, datë 12.04.2011 "Për forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve, nëpërmjet masave kundër pasurisë".

Masat zbatuese afatshkurtra

- Përmirësimi i infrastrukturës në mjete dhe pajisje të cilat ndikojnë në cilësinë e hetimeve të aseteve kriminale.

- Zhvillimi i kapaciteteve të stafit nëpërmjet trajnimeve për hetimin aseteve kriminale të specialistëve të strukturave përkatëse në nivelin vendor, 4 trajnime në QFP me 76 pjesëmarrës.
- Njohja dhe shkëmbimi i eksperiencave të mira me Zyrat për gjetjen e aseteve kriminale të rrjetit CARIN.
- Orientimi i të gjitha strukturave të hetimit të krimit të organizuar, narkotikëve, trafiqeve, terrorit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në gjetjen e pasurive të dyshuara se janë vënë nga veprimtaria kriminale, që me fillimin dhe gjatë hetimeve penale.
- Miratimin dhe zbatimin e manualit të procedurave për hetimin e pasurive kriminale.
- Angazhimi në Komitetin Ndërinstitucional Këshillimor të ekspertëve për masat kundër pasurisë, dhe përfitimi nga fondi i posaçëm i krijuar, si rezultat i zbatimit të ligjit për blerjen e pajisjeve për mbështetjen e strukturave të hetimit të aseteve kriminale.
- Forcimi i monitorimit dhe analizimit të rasteve të hetimit pasuror.
- Rritja e përgjegjësisë së strukturave të policisë të cilat ndjekin veprat penale, objekt i fushës së zbatimit të ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009 për hetimin e pasurive të subjekteve të këtyre veprave penale dhe forcimi i bashkëpunimit me strukturat e posaçme të hetimit të aseteve kriminale.
- Forcimi i bashkëpunimit me Prokurorinë, ZVRPP, ALUIZNI, Tatimet, Dogana, agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit dhe njësitë e inteligjencës, brenda dhe jashtë vendit.

Masat legjislative afatmesme

- Përmirësimi në ligjin Nr. 10192, datë 03.12.2011 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafiqeve të paligjshme nëpërmjet masave kundër pasurisë," duke zgjeruar fushën e veprimit të ligjit, përfshirë dhe korrupsionin dhe kalimin e kompetencave për hetime, sekuestrime, konfiskime e gjykime pasurore, prokurorit dhe gjykatat e rretheve gjyqësore.

Masat zbatuese afatmesme

- Përmirësimi i infrastrukturës në mjete dhe pajisje të cilat ndikojnë në cilësinë e hetimeve të aseteve kriminale.
- Zhvillimi i kapaciteteve të stafit nëpërmjet trajnimeve për hetimin aseteve kriminale të specialistëve të strukturave përkatëse në nivelin vendor.
- Njohja dhe shkëmbimi i eksperiencave të mira me Zyrat për gjetjen e aseteve kriminale të rrjetit CARIN.
- Orientimi i të gjitha strukturave të hetimit të krimit të organizuar, narkotikëve, trafiqeve, terrorit, pastrimit parave dhe financimit të terrorizmit, në gjetjen e pasurive të dyshuara se janë vënë nga veprimtaria kriminale që me fillimin dhe gjatë hetimeve penale.
- Angazhimi në Komitetin Ndërinstitucional Këshillimor të ekspertëve për masat kundër pasurisë, dhe përfitimi nga fondi i posaçëm i krijuar si rezultat i zbatimit të

ligjit për blerjen e pajisjeve për mbështetjen e strukturave të hetimit të aseteve kriminale.

- Forcimi i monitorimit dhe analizimit të rasteve të hetimit pasuror.
- Rritja e përgjegjësisë së strukturave të policisë të cilat ndjekin veprat penale objekt i fushës së zbatimit të ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009, për hetimin e pasurive të subjekteve të këtyre veprave penale dhe forcimi i bashkëpunimit me strukturat e posaçme të hetimit të aseteve kriminale.
- Forcimi i bashkëpunimit me prokurorinë, ZVRPP, ALUIZNI, Tatimet, Dogana, agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit dhe njësitë e inteligjencës brenda dhe jashtë vendit.

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

Baza ligjore

- Ligji 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafiqeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë";
- Ligji nr. 9258, datë 15.7.2004, "Për masat kundër financimit të terrorizmit";
- VKM nr. 687, datë 05.10.2011 "Për organizmin dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe mënyrën e administrimit të Pasurive të Sekuetsruara dhe të Konfiskuara".

Me ndryshimin e strukturës së AAPSK në Dhjetor 2010 numri i stafit të saj u rrit në 8, duke sjellë një rritje të ndjeshme të kapaciteteve profesionale dhe financiare të Agjencisë. Me rritjen e kapaciteteve u rrit edhe numri i pasurive në administrim dhe në fund të vitit 2011, AAPSK kishte në administrim:

- Pasuri të sekuestruara në zbatim të ligjit 9258 (total*) 131, me vlerë monetare* 1 691 799 879 lekë
    - *Pasuri te paluajteshme 55*
    - *Pasuri të luajtëshme (llogari bankare) nr. 44 :*

- *5,656,748.33 ALL*
- *2,195,408.44 EUR*
- *447,721.76 USD*

Pasuri të sekuestruara/konfiskuara në zbatim të ligjit 10192:

- Pasuri te paluajteshme 31
- Pasuri të luajtëshme (llogari bankare) nr. 38
- Pasuri të luajtëshme (automjete) 21

Totali i vlerës së pasurive në administrim të AAPSK ne 31.12.2011

Të sekuestruara	Të revokuara	Të konfiskuara
1,828,365,160 ALL	836,775,886 ALL	733,622,135 ALL

Masat legjislative afatshkurtra

- Hartimi dhe miratimi i Udhëzimit të Ministrit të Financave në zbatim të VKM Nr.687, datë 5.10.2011 dhe implementimi i manualeve të administrimit të pasurive.
- Ndryshimi i Rregullores së Brendshme të Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara me qëllim rritjen e efiçencës së punës së administratorëve të pasurive, administratorëve të Agjencisë dhe rritjen e efektivitetit të aktivitetit të Agjencisë.
- Ndryshimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave mbi tjetërsimin e pasurive të paluajtshme mbi të cilat është dhënë vendim i formës së prerë për konfiskim, si dhe mbi tjetërsimin e pasurive të luajtshme mbi të cilat është vënë masa e sekuestros.
- Hartimi dhe propozimi i një projektligji organik për funksionimin e AAPSK.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Stafi i AAPSK
- Asistenca e huaj në kuadër të bashkëpunimit me OPDAT, Delegacionin e BE-së në Shqipëri dhe projekti i Binjakëzimit me Qeverinë Spanjolle.

Masat legjislative afatmesme

- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit organik për funksionimin e AAPSK.

Masat zbatuese afatmesme

- Stafi i AAPSK
- Asistenca e huaj në kuadër të bashkëpunimit me OPDAT, Delegacionin e BE në Shqipëri

Efektet Financiare

Buxheti i Shtetit- nuk ka kosto shtesë në buxhetin e shtetit
Asistenca e huaj- nuk ka

RRITJA DHE FORCIMI I KAPACITETEVE TË POLICISË SHKENCORE

Masat legjislative afatshkurtra

- Përgatitja e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit "Mbi krijimin e bankës qendrore elektronike për regjistrimin dhe administrimin e të dhënave për personat e shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar".

Masat zbatuese afatshkurtra

- Blerja e aparaturave Live Skanera për një pjesë të Laboratorëve të Policisë Shkencore në D.P. Qarqeve dhe Komisariatet e Policisë.
- Ristrukturimi i sistemit aktual AFIS duke blerë serverë shpejtues për të bërë të mundur ndarjen e punës të procesit të kërkimit me gjurmë gishtash në databazën e tij, nisur nga pajisjet Live Skanera dhe veçmas nisur nga postet e punës të sistemit AFIS, duke ulur në këtë mënyrë kohën e kërkimit dhe duke ndarë punën e serverave shpejtues për kërkesat e dërguara on-line.
- Trajnimi i personelit të Policisë Shkencore në DPQ dhe Komisariate e Policisë për përdorimin e pajisjeve të reja Live Skanera që do të instalohen në këto vende.
- Trajnimi i 1 specialisti të Sektorit te Ekzaminimeve Kompjuterike në Irlandë në datën 7-8 Mars 2012, për teknika të reja të ekzaminimeve kompjuterike.
- Rritja e kapaciteteve të Policisë Shkencore nëpërmjet blerjes për Laboratorët e Policisë Shkencore të paisjeve për këqyrjen dhe fiksimin me shkencore të vendit të ngjarjes.
- Rritja e kapaciteteve të Sektorit të Ekzaminimit të Kompjuterave pranë Drejtorisë së Policisë Shkencore, duke e fuqizuar me blerjen e pajisjeve të reja për leximin e hardwereve.
- Ndjekja e procedurave për kontratat e mirëmbajtjeve për Mikroskopin Elektronik, pajisjeve të analizave të ADN-së dhe të pajisjes GKSM për analizat e substancave që dyshohen për drogë.

Masat legjislative afatmesme

- Përgatitja e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit "Mbi krijimin e Bankës Kombëtare Qendrore të profileve të ADN-së".

Masat zbatuese afatmesme

- Blerja e aparaturave Live Skanera për një pjesë të Laboratorëve të Policisë Shkencore në D.P. Qarqeve dhe Komisariatet e Policisë.
- Trajnimi i personelit të Policisë Shkencore në DPQ dhe Komisariatet e Policisë për përdorimin e pajisjeve të reja Live Skanera që do të instalohen në këto vende.
- Rritja e kapaciteteve të Policisë Shkencore nëpërmjet blerjes për Laboratorët e Policisë Shkencore të pajisjeve për këqyrjen dhe fiksimin me shkencore të vendit të ngjarjes.
- Rritja e kapaciteteve të Sektorit të Balistikës pranë Drejtorisë të Policisë Shkencore, duke e fuqizuar me blerjen e pajisjeve të reja ekzaminuese traseologjike.
- Rritja e kapaciteteve të Sektorit të Dokumenteve pranë Drejtorisë të Policisë Shkencore, duke e fuqizuar me blerjen e pajisjeve të reja ekzaminuese VSC5000.
- Trajnimi i personelit të Sektorit të Balistikës (4 specialistë) për përdorimin e pajisjeve të reja të ekzaminimeve traseologjike.
- Trajnimi i personelit të Sektorit të Dokumenteve (5 specialistë) për përdorimin e pajisjes VSC5000.

- Ndjekja e procedurave për kontratat e mirëmbajtjeve për Mikroskopin Elektronik, paisjeve të analizave të ADN-së dhe të pajisjes GKSM për analizat e substancave që dyshohem për drogë.

LUFTA KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE

Objektivi strategjik

Në zbatim të detyrimeve të parashikuara në Rekomandimet e BE-së , Policia e Shtetit do të forcojë luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në këtë mënyrë, synohet që të sekuestrohen dhe konfiskohen asetet me origjinë kriminale dhe të dënohen autorët e pastrimit të parave dhe krimit të organizuar. Fuqizimi i kapaciteteve në këtë drejtim do të ketë vëmendjen kryesore me qëllim arritjen e rezultateve të dukshme dhe konkrete.
Në përmbushje të këtyre detyrimeve, është e rëndësishme rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, për çështje që kanë të bëjnë veçanërisht me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër pastrimit të parave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenin 82 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Statusi Aktual

Legjislacioni i kësaj fushe synon të luftojë në mënyrë aktive dhe të pandërprerë krimin në tërësi, veçanërisht pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Veprimtaria e strukturave të luftës kundër pastrimit të parave bazohet në një sërë aktesh të rëndësishme ligjore si: Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", ndryshuar me Ligjin Nr.10391, datë 3.3.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit""; Ligji Nr. 9258 datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"; Ligji Nr.10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë".

Gjithashtu vlen të permenden dokumentet strategjike shumë të rëndësishme si: Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve dhe Terrorizmit, si dhe Plani i saj Veprimit; Dokumenti Strategjik Kombëtar për Hetimin e Krimit Financiar dhe Plani i Veprimit për zbatimin e tij.

Dokumenti Strategjik Kombëtar për Hetimin e Krimit Financiar përcakton politikat orientuese kombëtare për të garantuar sigurimin e një suksesi afatgjatë, krijon një vizion dhe mision strategjik kombëtar, përcakton objektivat strategjik, përfshin detyrimet gjithë strukturore brenda vendit dhe me partnerët ndërkombëtarë, parashikon burimet dhe mënyrën e zbatimit për lutën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ai parashikon rritjen e vullnetit, zhvillimin e prioriteteve, ndërtimin e partneritetit, zhvillimin e inteligjencës

dhe të kapaciteteve teknike profesionale hartimin dhe zhvillimin e programeve operacionale në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare në këtë drejtim.

Ky dokument përcakton objektivat strategjikë në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si më poshtë:

- Harmonizimi i legjislacionit me standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare;
- Rritja e efikasitetit, kontrollit dhe zbatimit të ligjit;
- Rritja e nivelit dhe kapaciteteve institucionale gjithëpërfshirëse;
- Evidentimi dhe dokumentimi efektiv i hetimeve financiare;
- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar;
- Ndërgjegjësimi i publikut dhe subjekteve raportuese;
- Forcimi i kapaciteteve dhe regjimit të konfiskimit të produkteve të krimit.

Po ashtu Memorandumi i bashkëpunimit i datës 6 maj 2009, "Për krijimin e 6 Njësive të Përbashkëta Hetimore të reja", në përbërje të strukturës së Prokurorisë të Rretheve Gjyqësore Durrës, Vlorë, Fier, Shkodër, Korçë dhe Gjirokastër, është një hap i rëndësishëm për luftën kundër pastrimit të parave.

Ky është tashmë një model i konsoliduar i bashkëpunimit të institucioneve të ngarkuar me ligj, për luftën kundër pastrimit të parave dhe krimit financiar, ku aktualisht funksionojnë 7 Njësi të Përbashkëta Hetimore pranë të cilave punojnë 30 oficerë të policisë, specialistë të strukturave të hetimit të krimit financiar.

Nga analizat e veprimtarisë së strukturave të hetimit të pastrimit të parave, rezulton se metodat e pastrimit të parave në Shqipëri, janë të ndryshme, që variojnë nga më të thjeshtat, deri në ato më komplekse, të cilat kryhen nëpërmjet blerjes së automjeteve, bizneseve të vogla, si lokale tregtie, restorante e banesa.

Pjesa më e madhe e grupeve që veprojnë në vend përdorin këtë metodë të thjeshtë të pastrimit të parave; Blerje e aseteve shtetërore nëpërmjet privatizimeve dhe ankandeve; Krijimin e kompanive fiktive me qëllim mashtrime financiare dhe pastrimin e parave; Shitblerjeve të pasurive të patundshme jashtë sistemit financiar, Investimeve në sektorët e ndërtimit, Transaksioneve bankare ne shuma të mëdha; Copëtimi i shumave të mëdha të parave dhe kryerja e transaksioneve brenda pragut të përcaktuar nga ligji, duke u përpjekur për të shmangur në këtë mënyrë kontrollin e strukturave përgjegjëse për pastrimin e parave; Transporti Cash i parave nga njëri shtet në tjetrin, pa i deklaruar në kufi, lojrat e fatit etj.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

1. Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", ndryshuar me Ligjin Nr.10 391, datë 3.3.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit"". Ky ligj është i përafruar me:

- Vendimin e Këshillit datë 17 Tetor 2000 lidhur me marrëveshjet për bashkëpunim ndërmjet njësive të inteligjencës financiare të Shteteve Anëtare në lidhje me shkëmbimin e informacionit (GZ L 271 datë 24 Tetor 2000, fq. 4) *(përafruar në mënyrë të plotë);*
- Vendimin e Këshillit 2000/642/JHA lidhur me marrrëveshjet për bashkëpunim ndërmjet njësive financiare të inteligjencës së Shteteve Anëtare në lidhje me shkëmbimin e informacionit (GZ L 271 datë 24 Tetor 2000, fq. 4) (*përafruar në mënyrë të plotë*);
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2005/212/JHA datë 24 Shkurt 2005 mbi konfiskimin e produkteve të lidhura me krimin dhe pasurisë (GZ L 68 datë 15 Mars 2005, fq. 49) (*përafruar në mënyrë të plotë*);
- Vendimi i Këshillit 2007/845/JHA, datë 6 Dhjetor 2007 lidhur me bashkëpunimin ndërmjet Zyrave për Rimëkëmbjen e Aseteve të Shteteve Anëtare në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave ose pasuri të tjera të lidhura me krimin (GZ J 332, datë 18 Dhjetor 2007, fq. 103) (*përafruar në mënyrë të pjesshme*);
- Pozicioni i Përbashkët i Këshillit datë 27 Dhjetor 2001 në luftën kundër terrorizmit (GZ L 344 datë 28 Dhjetor 2001, fq. 90) (*përafruar në mënyrë të pjesshme*);
- Direktiva 2005/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 Tetor 2005 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të tërrorizmit (GZ L 309 datë 25 Nëntor 2005, fq. 15) (*në mënyrë të pjesshme*);
- Vendimi Kuadër i Këshillit 92005/212/JHA), datë 24 Shkurt 2005 mbi konfiskimin e të ardhurave të lidhura me krimin, mjeteve dhe pasurisë (GZ L 68 datë 15 Mars 2005, fq. 49) (*në mënyrë të plotë*);

2. Ligji Nr. 9258 datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit". Ky ligj është i përafruar me acquis dhe konkretisht me;

- Vendimi i Këshillit 2007/845/JHA, datë 6 Dhjetor 2007 lidhur me bashkëpunimin ndërmjet Zyrave për Rimëkëmbjen e Aseteve të Shteteve Anëtare në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave ose pasuri të tjera të lidhura me krimin (GZ J 332, datë 18 Dhjetor 2007, fq. 103) (*përafruar në mënyrë të pjesshme*);
- Pozicioni i Përbashkët i Këshillit datë 27 Dhjetor 2001 në luftën kundër terrorizmit (GZ L 344 datë 28 Dhjetor 2001, fq. 90) (*përafruar në mënyrë të pjesshme*);
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2005/212/JHA datë 24 Shkurt 2005 mbi konfiskimin e produkteve të lidhura me krimin dhe pasurisë (GZ L 68 datë 15 Mars 2005, fq. 49) (*përafruar në mënyrë të plotë*).

3. Ligji Nr.10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë". Ky ligj është i përafruar me acquis dhe konkretisht me:

- Vendimi Kuadër i Këshillit 2005/212/JHA datë 24 Shkurt 2005 mbi konfiskimin e produkteve të lidhura me krimin dhe pasurisë (GZ L 68 datë 15 Mars 2005, fq. 49) (*përafruar në mënyrë të plotë*);
- Vendimi i Këshillit 2007/845/JHA, datë 6 Dhjetor 2007 lidhur me bashkëpunimin ndërmjet Zyrave për Rimëkëmbjen e Aseteve të Shteteve Anëtare në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave ose pasuri të tjera të lidhura me krimin (GZ J 332, datë 18 Dhjetor 2007, fq. 103) (*përafruar në mënyrë të pjesshme*);
- Pozicioni i Përbashkët i Këshillit datë 27 Dhjetor 2001 në luftën kundër terrorizmit (GZ L 344 datë 28 Dhjetor 2001, fq. 90) (*përafruar në mënyrë të pjesshme*).
  - Ligji Nr.10193, datë 3.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaj në çështjet penale". Ky ligj është *pjesërisht i përafruar me acquis* dhe konkretisht me:

- Vendimin e Këshillit 2007/845/JHA, datë 6 Dhjetor 2007 lidhur me bashkëpunimin ndërmjet Zyrave për Rimëkëmbjen e Aseteve të Shteteve Anëtare në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave ose pasuri të tjera të lidhura me krimin (GZ J 332, datë 18 Dhjetor 2007, fq. 103);
- Pozicioni i Përbashkët i Këshillit datë 27 Dhjetor 2001 në luftën kundër terrorizmit (GZ L 344 datë 28 Dhjetor 2001, fq. 90).
- Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve dhe Terrorizmit", miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.1140, datë 30.07.2008, si dhe Plani i Veprimit në zbatim të saj i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1103, datë 14.11.2009.
- Dokumenti Strategjik Kombëtar "Per hetimin e krimit Financiar", dokument i cili është hartuar me mbështetjen e CARDS – Projektit të Binjakëzimit me Zyrën Kriminale Federale Gjermane (BKA): "Lufta kundër pastrimit të parave dhe krimit financiar", miratuar me VKM Nr. 1077, datë 27.10.2009.

Struktura institucionale

Një nga institucionet kryesore në luftën kundër pastrimit të parave është Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Drejtoria Kundër Krimit Financiar). Kjo Drejtori është krijuar në qershor të vitit 2007 dhe ka filluar të funksionojë në mënyrë të plotë nga data 1 Janar 2008, dhe ka strukturat e saj, në 12 Drejtori të Policisë në Qarqe, ku është e organizuar në Sektorë/Seksione.
Mbi bazën e një Memorandumi Bashkëpunimi në vitin 2007, mes Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë se Financave dhe Shërbimit Informativ Shqiptar, është krijuar dhe është operacionale Njësia e Përbashkët Hetimore Kundër Krimit Financiar dhe Korrupsionit pranë Prokurorisë Tiranë. Kjo strukturë vepron si një Task Force operacionale për hetimin, zbulimin dhe vënien para drejtësisë të individëve të përfshirë në vepra penale në sferën ekonomike, duke përfshirë këtu edhe pastrimin e parave.

Drejtoria Kundër Krimit Financiar në përbërje të Departamentit Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendshme, e përbërë nga katër sektorë:

- Sektori Kundër Pastrimit të Parave
- Sektori Kundër Korrupsionit
- Sektori Kundër Krimit Ekonomik dhe Financiar
- Sektori Kundër Krimeve Kompjuterike.

Kjo drejtori ka në varësi vendore në 12 drejtoritë e policisë së qarqeve, Seksionet e Luftës Kundër Korrupsionit, kundër pastrimit të parave dhe kundër krimit ekonomik dhe financiar. Përgjegjësitë e Drejtorisë Kundër Krimit Financiar, janë të parandalojë, të zbulojë dhe hetojë, në përputhje me ligjin penal dhe me ligjin procedurial penal, veprat penale të korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimet ekonomike dhe financiare.

Strukturat e parandalimit të pastrimit të parave bashkëpunojnë me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokuoritë e Rretheve Gjyqësore, sipas juridiksionit territorial, për hetimin e krimeve financiare, veçanërisht me Njësitë e Përbashkëta Hetimore.

Gjithashtu bashkëpunon me Shërbimin Informativ Shtetëror për shkëmbimin e informacioneve dhe realizimit të operacioneve të përbashkëta. Sektori i Luftës Kundër Pastrimit të Parave në Drejtorinë Kundër Krimit Ekonomiko-Financiar, në Ministrinë e Brendshme ka për detyrë drejtimin, bashkërendimin, kontrollin. Aktualisht në strukturat e hetimit të pastrimit të parave janë 20 oficerë policie, nga këta 4 në Sektorin Kundër Pastrimit të Parave në qendër dhe 16 oficerë të policisë në 12 Drejtoritë e Policisë në Qarqe.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Zbatimi i Planit të Veprimit, për vitin 2012, të Dokumentit Strategjik Kombëtar, "Për hetimin e krimit financiar 2009 - 2015".
- Fuqizimi i kapaciteteve nëpërmjet 2 trajnimeve të 20 specialistëve të strukturave të luftës kundër pastrimit të parave të Policisë së Shtetit për metodat e pastrimit të parave në fushën fiskale.
- Trajnimi i specialistëve të strukturave të luftës kundër pastrimit të parave në kuadër të Projektit të Binjakëzimit të Komisionit Evropian Nr. AL-2009-IB-JH-03 "Mbështetje për Strukturat e Hetimit të Pastrimit të Parave dhe Krimit Financiar në Shqipëri".
- Forcimi i bashkëpunimit me Njësitë e Përbashkëta Hetimore, FIU dhe institucionet e ngarkuara me ligj, për luftën kundër pastrimit të parave.
- Rrija e numrit të hetimeve proaktive duke përdorur teknikat speciale të hetimit për rastet në hetim të pastrimit të parave.
- Kryerja e analizave periodike me Prokurorinë, gjatë hetimit të veprave penale të pastrimit të parave, sipas rasteve në hetim.
- Rritja e vlerës së aseteve të sekuestruara për veprën penale të pastrimit të parave.

Masat zbatuese afatmesme

- Zbatimi i Planit të Veprimit të Dokumentit Strategjik Kombëtar "Per hetimin e krimit financiar 2009 - 2015".
- Kryerja e 6 trajnimeve (2 për çdo vit) të 20 specialistëve të strukturave të luftës kundër pastrimit të parave të Policisë së Shtetit, për metodat e pastrimit të parave në vendin tonë.
- Trajnimi i specialistëve të strukturave të luftës kundër pastrimit të parave, në kuadër të Projektit të Binjakëzimit të Komisionit Evropian Nr. AL-2009-IB-JH-03 "Mbështetje për Strukturat e Hetimit të Pastrimit të Parave dhe Krimit Financiar në Shqipëri".
- Forcimi i bashkëpunimit me Njësitë e Përbashkëta Hetimore, FIU dhe institucionet e ngarkuara me ligj, për luftën kundër pastrimit të parave.
- Rritja e numrit të rasteve të investigimit paraprak dhe numrit të rasteve në hetim për pastrimin e parave.
- Kryerja e analizave periodike me Prokurorinë, gjatë hetimit të veprave penale të pastrimit të parave sipas rasteve në hetim.

- Rritja e vlerës të aseteve të sekuestruara për veprën penale të pastrimit të parave.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TE PARAVE

Në zbatim të detyrimeve të parashikuara në Nenet 4 dhe 82 të MSA-së, Qeveria Shqiptare është plotësisht e angazhuar për të forcuar më tej luftën kundër pastrimit të parave, finacimit të terrorizmit, si dhe për formalizimin e ekonomisë në vend. Në këtë mënyrë, synohet rritja e besueshmërisë në vend dhe në sistemin e tij ekonomik e ligjor. Fuqizimi i kapaciteteve në këtë drejtim, do të ketë vëmendjen kryesore me qëllim arritjen e rezultateve të dukshme dhe konkrete.

Situata aktuale

Legjislacioni i kësaj fushe synon të luftojë në mënyrë aktive dhe të pandërprerë krimin ekonomiko-financiar, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit të cilat dëmtojnë rëndë stabilitetin politik dhe ekonomik të vendit, sigurinë kombëtare e në tërësi demokracinë dhe shtetin e të drejtës.

Miratimi i ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" përbën një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin evropian.
Një hap i rëndësishëm në këtë fushën është edhe miratimi me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1077, datë 27.10.2009, i Dokumentit Strategjik Kombëtar "Për hetimin e krimit financiar".

Në Maj të vitit 2011 Komiteti i MONEYVAL i KE publikoi raportin e raudit të katërt të vlerësimit të Shqipërisë, në fushën e parandalimit të PP dhe FT.
Në raportin përmbledhës të sipërcituar, për sa i përket rekomandimit 26 që ka të bëjë drejtpërdrejt me aktivitetin e Njësisë së Inteligjencës Financiare – DPPPP, vlerësimi u rrit në "LC" (Largely Compliant).
Duke qënë se sipas raportit të Komitetit MONEYVAL pjesa më e madhe e rekomandimeve për raundin e IV të vlerësimit kanë një nivel të pamjaftueshëm (Non Compliant/Partially Compliant), DPPPP si kryesuese e delegacionit, ka adresuar mënjëherë problematikat tek instutucionet përgjegjëse për marrjen e masave të nevojshme.
Në mbështetje edhe të rekomandimeve të sipërcituara, u miratua Ligji Nr. 10 391, datë 03.03.2011, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit"", i cili ka hyrë në fuqi më datë 15.04.2011. Gjatë draftimit të këtij ligji, janë marrë në konsideratë kriteret esenciale të Rekomandimeve 5 dhe 6 të FATF. Gjithashtu u cilësua më tej paravësia e DPPPP duke përcaktuar një mandat për Drejtorin e Përgjithshëm.

Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të sipërcituara, u draftuan dhe u miratuan udhëzimet e mëposhtme:

- Udhëzim i Ministrit të Finanacave Nr. 20, datë 08.09.2011 "Për metodat dhe procedurat e raportimit të subjekteve raportuese të Ligjit Nr.9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar""[133].
- Udhëzim i Ministrit të Finanacave Nr. 21, datë 08.09.2011 "Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare"[134].

Në lidhje me mënyrën e funksionit të DPPPP dhe përmbushjes së detyrimeve administrative, qeveria shqiptare ka miratuar dy vendime, si më poshtë:

- VKM Nr. 871, datë 14.12.2011 " Për përcaktimin e procedurave të konstatimit, të shqyrtimit, të prozimit dhe të vandosjes së masave administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)";
- VKM Nr. 922, datë 21.12.2011 " Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave".

DPPPP ka bashkëpunuar ngushtësisht me ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë në funksion të përgatitjeve për raportin e vlerësimit të Shqipërisë si dhe ka marrë pjesë në Konferencën e Palëve për Konventën e Këshillit të Evropës (CET 198) "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit", të zhvilluar në datat 7-8 mars 2011, në Strasburg të Francës.

DPPPP, gjatë vitit 2011 ka marrë pjesë në një sërë takimesh dypalëshe/shumëpalëshe dhe në aktivitete të tjera, si:

- Më dt. 26 Prill 2011 është mbajtur një takim me përfaqësues të Bankës së Shqipërisë (BSH) në të cilin është diskutuar mbi mënyrat që duhet të ndiqen për të përforcuar më tej bashkëpunimin ndërinstutucional pësa i përket përforcimit të cilësisë së mbikqyrjes për subjeketet raportuese si dhe përmbushjen e standarteve ndërkombëtare;
- Më dt. 27 Prrill 2011 është mbajtur një takim me përfaqësues të Autoritetit të Mbikqyrjes Finaciare (AMF) në lidhje me kosolidimin e bashkëpunimit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave;
- Më 17 Maj 2011 është mbajtur një takim me përfaqësues të Shoqatës së Bankave dhe oficereve të përputhshmërisë në bankat tregrate që operojnë në vend. Fokusi kryesor i takimit ishin risitë dhe detyrimet që sillnin ndryhimet e fundit ligjore si dhe konsultimi mbi aktet e nevojshme nënligjore;
- Më dt. 21 Qershor 2011, DPPPP, me mbështejen e projektit PACA, prezantoi një udhëzues për organizatat jo fitimprurëse (OJF) dhe parandalimin e finacimit të terrorizmit;
- Më dt. 28 Qershor 2011, DPPPP, me mbështejen e projektit PACA, prezantoi një udhëzues për ekspertët kontabël të rregjistruar, kontabilistët e miratuar, shoqëritë audituese dhe të kontabilitetit, në lidhje me parandalim dhe dedektimin e pastrimi të parave dhe finacimti të terrorizmit;

[133] Ky udhëzim shfuqizon Udhëzimin e Ministrit të Finacave nr.12, datë 05.02.2009, "Për metodat dhe procedurat e raportimit të subjekteve raportuese të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".

[134] Ky udhëzim shfuqizon Udhëzimin e Ministrit të Finacave nr.11, datë 05.02.2009, "Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare".

- Më datat. 11-15 Qershor 2011, Drejtori i Përgjithshëm i DPPPP mori pjesë në mbledhjen e 26 plenare të Grupit Egmond të mabjtur të Yerevan (Armeni). Gjatë këtij takimi u nënshkruan memorandume bashkëpunimim homologët e Mbretërisë së Bashkuar Arabe dhe Izraelit.
- Sërisht, më dt. 19 Shtator 2011, DPPPP ka zhvilluar një takim me Shoqatën e Bankave dhe përfaqësuesit e bankave tregtare në lidhje me probleme si numri i RAD; përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së tyre dhe përshtatja e sistemeve softëare nga bankat për të gjeneruar informacion akoma më cilësor, në përputhje me kërkesat e DPPPP;
- Nisur nga fakti që një nga rekomandimet që është vlerësuar si i pa plotësuar nga Raudi i IV i vlerësimit të Moneyval, është Rekomandimi Special VIII, që lidhet me masat që duhet të ndërmerren për moslejimin e OJF të përdoren për financim të terrorizmit, DPPPP, më dt. datë 27 shtator 2011, zhvilloi një takimim me përfaqësues të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB), istitucion që sipas parashikimeve ligjorë është përgjgjës për mbikqyrjen e një pjese të OJF që ushtrojnë veprimtari në vendin tonë. Gjatë këtij takimi u diskuua në lidhje me marrjen e masave të mëtejshme për përmirësimin e kësaj fushe. Në lidhje me mbiqyrjen konkrete të sektotit të OJF, u mor takim edhe me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinise e Sporteve (më dt. 20.10.2011) dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (më dt. 5 Tetor 2011);
- Në datat 13-14 Tetor 2011, DPPPP, bashkë me drejtuesit e NIF-eve për parandalimin e pastrimit të parave nga Republikat e Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Kroacisë, Maqedonisë dhe Sllovenisë zhvilluan konferencën e pestë rajonale në Otocec, Sllloveni. Gjatë këtij takimi u konstatua se bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit midis NIF-eve (pjesëmarrës në konferencë) ka arritur ose ndonjëherë edhe tejkaluar nivelin e standarteve ndërkombëtare dhe u ra dakord që organizimi i aktiviteteve të tilla duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen. Po ashtu, u rekomandua që NIF-et të vetë-informohen mbi tipologjitë e reja dhe të shpeshta të transaksioneve të dyshimta, të cilat kryhen në territorin e një vendi nga shtetasit e një vendi tjetër;
- Më datë 15.11.2011, DPPPP ka zhvilluar një takim me përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Noterisë në lidhje me për shqyrtimin e problematikave që lidhen me zbatimin e masave parandaluese nga subjektet noter;
- Më dt. 09.12.2011 DPPPP ka nënshkruar një memenorandum bashkëpunuimi me homologët e Afrikës së Jugut. Me nënshkrimin e këtij memorandumi, numri total i nënshkruar nga DPPPP është 39.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave është angazhuar seriozisht në një sërë projektesh që po zhvillohen në vëndin tonë si:

- Projekti Kundër Korrupsionit në Shqipëri (Project Against Corruption in Albania);
- Njësitë Ndërkombëtare të Bashkëpunimit të Agjensive të Zbatimit të Ligjit (International Laë Enforcement Cooperation Units);
- Mbështetje e Strukturave të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Investigimit të Krimit Financiar në Shqipëri (Support to Anti-Money Laundering and Financial Crimes Investigations Structures in Albania);
- Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit (Millenium Challenge Corporation);
- Projekti i BE-së mbi bashkëpunimin ndërkombëtar të agjencive të zbatimit të ligjit (ILECU I dhe II) etj.

Gjatë vitit 2011, me anë të pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme është arritur që stafi i DPPPP, veçanërisht Sektori i Analizës, të trajnohet (brënda dhe jashtë vendit) në fusha të ndryshme që lidhen me analizimin e rasteve të dyshuara për pastrim parash apo finacim terrorizmi. Gjithashtu, DPPPP gjatë vitit 2011 është rritur nga 26 në 27 punonjës.
Në lidhje me raportimet nga subjeketet e ligjit, vlen të theksohet se më shumë se 98 % e tyre raportojnë online, element ky që ka kontribuar në saktësinë dhe cilësinë e raportimeve.

Gjatë vitit 2011 DPPPP, ka vazhduar me trend rritës (afro 5 % krahasuar me vitin 2010) të dërgojë në organet e zbatimit të ligjit, informacione mbi rastet e dyshimta për pastrim parash, si më poshtë:

Institucioni marrës	**Nr. i rasteve të dyshimta të dërguara nga DPPPP në**
Policia e Shtetit	160
Prokuroria	51
Total	211

Të dhënat e mëposhtme paraqesin të dhënat e detajura për RAD e raportura pranë gjatë vitit 2011 . Gajtë këtij viti është bërë edhe ndarja e raporteve të transaksioneve të dyshimta (RTD) të marra për çdo RAD.

Dërguesi	**Numri i RAD**	**Numri i RTD**
Banka	329	1334
DPD	20	149
Ekspert kontabel	1	1
Noter	17	19
ZKV	1	1
Shoqeri transfertash	7	173
ZQRPP	8	9
Totali	383	1686

Vlen të theksohet se viti 2011 ka pasur një rritje cilësore dhe sasiore (81%) të RAD të marra nga subjeketet e ligjit. Kështu ndër 211 rastet e dyshimta të referuara në organet e zbatimit të ligjit, 99 raste (pra 47 %) kanë si indicie RAD-të e subjekteve të ligjit. Ky tregues (47 % e rasteve të referuara mbi bazë RAD) është përmirësuar ndjeshëm, krahasuar me vitin 2010, në të cilin ndër 201 rastet e referuara në organet e zbatimit të ligjit mbi bazë të infromacionit të RAD-ve janë referuar 61 raste (29%).

Burim i vlefshëm informacioni kanë qenë edhe kërkesat/infomacionet spontane të dërgura nga homologët, nga të cilat janë gjeneruar 16 raste që janë referuar në organet e zbatimit të ligjit (në vitin 2010, informacioni i marrë nga homologët ka shërbyer si indicie për 10 raste të dërguara në organet e zbatimit të ligjit).

Në lidhje me inspektimet e kryera nga në subjektet e ligjit,

Subjektet e inspektuar	**Viti 2011**
Banka	9
Shoqëri Ndërtimi	13
Fondet e pensionit	3
ZKV	25
Shoqëri tregtimi automjetesh	1
Lojra fati	10
Notere	8
Agjensi Imobiliare	1
Shoqëri sigurm jete	3
Ekspert Kontabel	14
Agjensi Udhëtimesh	3
Total	**90**

Të dhënat e mëposhtme paraqesin shkëmbimin e informacionit me homologët në vitin 2011:

Kërkesa nga homologët	Kërkesa nga DPPPP	Përgjigje nga homologët	Përgjigje nga DPPPP
69	54	55	62

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" i ndryshuar.

Legjislacioni evropian në këtë fushë është:

- Direktiva 91/308/EC, datë 10.06.1991 "Për parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për pastrimin e parave" dhe Direktiva 01/97/EC e datës 04.12.2001 e cila amendon Direktivën 91/308/EC si dhe Direktiva 2005/60/EC.
- Direktiva 2005/60 EC, datë 26 tetor 2006 "Mbi parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".
- Direktiva 2006/70 EC, datë 1 gusht 2006, e cila parashikon masat për zbatimin e Direktivës 2005/60 EC .

Rregullorja 1781/2006 EC, datë 15 nëntor 2006 "Mbi informacionin e paguesit, i cili bën transferimin e fondeve".

Aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 9917 datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit te terrorizmit" janë:

- Udhëzim i Ministrit të Finanacave Nr. 21, datë 08.09.2011 "*Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare*";
- Udhëzim i Ministrit të Finanacave Nr. 20, datë 08.09.2011 "*Për metodat dhe procedurat e raportimit të subjekteve raportuese të Ligjit nr.9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit",* i ndryshuar";

- Udhëzim i Ministrit të Financave Nr. 15, datë 16.02.2009, " Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës për financimin e terrorizmit në sistemin doganor";
- Udhëzim i Ministrit të Financave Nr. 16, datë 16.02.2009, " Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës për financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave";
- Udhëzim i Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 01.04.2009 "Për formën, mënyrat e procedurat e raportimit të të dhënave të subjekteve, Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në kuadrin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit";

Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 343, datë 8.4.2009, "Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse".

Ligji Nr. 9258, datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit".

Direktiva 91/308/EC, datë 10.06.1991 "Për parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për pastrimin e parave" dhe Direktiva 01/97/EC e datës 04.12.2001 e cila amendon direktivën 91/308/EC.

- Ligji Nr. 8677, datë 02.11.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë Gjyqësore" i ndryshuar.
- Ligji Nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal" dhe Ligji Nr. 9686, datë 26.2. 2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të cilit i janë bërë gjatë këtyre viteve një sërë ndryshimesh dhe përmirësimesh në lidhje me procedimin penal të autorëve të krimit dhe aplikimin e teknikave dhe metodave speciale të hetimit.
- Ligji Nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë".
- Ligji Nr. 9749, date 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit".
- VKM Nr. 1077 datë 27.10.2009, "Për miratimin e Dokumentit Strategjik Kombëtar për Hetimin e Krimit Financiar".
- Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr.93, datë 25.02.2009 "Për menaxhimin e punonjësve të policisë nën mbulim apo të infiltruar ".
- Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 23, datë 15.01.2009 "Për vëzhgimin e fshehtë të personave dhe mjediseve dhe procedurat standarde gjatë aplikimit të tyre".

Me qëllim zbatimin e standardeve dhe mekanizmave të përshtatshëm, për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në standardet e Bashkimit Evropian dhe instrumenteve të tjerë ndërkombëtare në këtë fushë, janë nënshkruar 39 memorandume mirëkuptimi në fushën e bashkëpunimit në shkëmbimin e informacioneve financiare të lidhura me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit me njësitë homologe të vendeve të tjera, si dhe 8 Memorandume Mirëkuptimi për bashkëpunimin ndërinstitucional në luftën për parandalimin e pastrimit të parave.

Struktura institucionale

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave janë përgjegjëse këto institucione:

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), e cila është në rolin e Njësisë së Inteligjencës Financiare. Misioni i kësaj Drejtorie konsiston në: Parandalimin e "pastrimit të parave" dhe në luftën kundër financimit të terrorizmit, nëpërmjet grumbullimit, verifikimit, vlerësimit, kontrollit, ruajtjes së informacioneve nga subjektet e ligjit, pezullimit, bllokimit dhe ngrirjes të çdo veprimi me qëllim parandalimin e transferimit, tjetërsimit ose kalimit të pasurisë dhe produkteve që rrjedhin nga veprimtaria kriminale; Bashkërendimin me struktura të tjera të zbatimit të ligjit te tilla si Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, Shërbimi Informativ Shtetëror, me Organizma homologe dhe Institucione ndërkombëtare; Hartimin e programeve të bashkëpunimit dhe asistencave të ndërsjella në drejtim të parandalimit të "pastrimit të parave" me vende të ndryshme, në bazë të konventave ndërkombëtare të nënshkruara dhe ratifikuara.

Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP) i cili funksionon në bazë të Rregullores së Re për Komitetin e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave të miratuar në datë 16.12.2008. Ky komitet drejtohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje të tij Prokurorin e Përgjithshëm, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Ministrin e Punëve të Jashtme, Ministrin e Mbrojtjes, Ministrin e Brëndshëm, Ministrin e Financave, Ministrin e Drejtësisë, Drejtorin e SHISH-it dhe Inspektorin e Përgjithshëm të ILDKP-së.

Komiteti është përgjegjës për përcaktimin e drejtimeve të politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave e financimit të terrorizmit Komiteti ka për detyrë shqyrtimin dhe analizimin e raporteve për veprimtaritë e kryera nga "Autoriteti Përgjegjës", nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, si dhe raportet për dokumentet e përgatitura nga institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë, të cilat ushtrojnë veprimtaritë e tyre në fushën e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
Banka e Shqipërisë (Departamenti i Mbikëqyrjes), e cila ka detyrimin të njoftojë DPPPP në rast se vëren se ka elementë të pastrimit të parave, sipas së njëjtës formë dhe mënyrë, sikur se parashikohet për të gjithë subjektet e përcaktuara nga ligji.
Drejtoria e Kundër Krimit Financiar në përbërje të Departamentit të Hetimit të Krimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendshme.

Prioritetet Afatshkurtra

Për periudhën afatshkurtër, prioritetet në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, do të jenë:

- Të merren masa për zbatimin më të mirë të legjislacionit kundër pastrimit të parave, për sa i takon parandalimit, dënimeve, konfiskimit, sekuestrimit dhe ngrirjes së aseteve.

- Të rriten kapacitetet e Njësisë së Inteligjencës Financiare (FIU), duke i siguruar burimet e përshtatshme, njerëzore, financiare dhe IT, si dhe të përmirësohet bashkëpunimi midis niveleve të ndryshme.
- Të sigurohet përputhshmëria e mëtejshme e ligjit ekzistues për Parandalimin e Pastrimit të Parave, me standardet e BE-së në linjë me *acquis* dhe me rekomandimet e Task Forcës për Ndërhyrjen Financiare dhe ato të Këshillit të Evropës.
- Të përmirësohet më tej bashkëpunimi me autoritetet e vendeve të tjera. Të përmirësohet më tej bashkëpunimi me njësitë homologe te shteteve ne te cilat legjislacioni përkatës parashikon nënshkrimin e Memorandumeve te Bashkëpunimit te ndërsjelltë.
- Kontrolli dhe monitorimi i sistemit bankar dhe subjekteve te tjera te ligjit mbi zbatimin e kërkesave te Ligji nr. 9258 datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", për sa i përket klientëve të tyre që mund te ndodhen në Listën e personave të shpallur të Këshillit të Sigutimit të OKB OKB.
- Të sigurohet zbatim i duhur i detyrimeve të raportimit dhe të rishqyrtohen pragjet e raportimit të transaksioneve.

Masat legjislative afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren iniciativat ligjore të mëposhtme:

- Miratimi i VKM-ve përkatëse në lidhje me listat e individëve qe figurojnë si financues të terrorizmit në Listën e personave të shpallur të Këshillit të Sigurimit të OKB, në zbatim të ligjit Nr. 9258, datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit".
- Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit me njësinë homologe të Spanjës.

Masat zbatuese afatshkurtra

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet zbatuese të mëposhtme:

- Krijimi dhe funksionimi i një grupi pune për hartimin e VKM shtesë në lidhje me listat e individëve që figurojnë si financues të terrorizmit, në Listën e personave të shpallur të Këshillit të Sigurimit të OKB, në zbatim të Ligjit Nr. 9258, datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit".
- Trajnimi i specialistëve të strukturave të luftës kundër pastrimit të parave dhe krimeve ekonomiko-financiare për teknikat e hetimit të veprave penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- Trajnimi i subjekteve të ligjit mbi zbatueshmërinë dhe përputhshmërinë me kërkesat e Ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" i ndryshuar.
- Inspektimi i subjekteve të ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008, për një zbatim sa më të mirë të ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008, i ndryshuar.
- Zhvillimi i tryezave të rrumbullakëta me Grupin e Kontaktit (teknik ndërinstitucional), dhe strukturat e tjera lidhur me: direktivat e BE-së, 40+9 rekomandimet e FATF–së, si dhe strategjitë e nevojshme ndërinstitucionale e kombëtare për përafrimin me standardet ndërkombëtare të luftës kundër PP/FT;
- Përdorimi me efiëencë i pajisjeve hardware dhe software në dispozicion të FIU-t Shqiptar, sidomos atyre të akorduara me fonde të BE-së, si dhe trajnimi i mëtejshëm i stafit të analizës për përdorimin me efiçencë të software analitik;

- Identifikimi i subjekteve me rrezik të lartë për pastrim parash;
- Rishikimi dhe përditësimi i listës së indikatorëve në fushën e pastrimit të parave dhe finacimit të terrorizmit;
- Zbatimi i objektivave të përcaktuar në Dokumentin Strategjik "Për hetimin e krimit finaciar" dhe të Strategjisë së Luftës kundër krimit të organizuar.

Prioritetet afatmesme

Për periudhën afatmesme, prioritetet në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, do të jenë:

- Përforcimi i luftës kundër krimit ekonomik dhe financiar, përfshirë pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- Të shënohen rezultate të qarta në luftën kundër pastrimit të parave, si brenda ashtu edhe jashtë sektorit financiar;
- Harmonizimi i vazhdueshëm i legjislacionit shqiptar të fushës së luftës kundër PP/FT me standardet e reja ndërkombëtare;
- Dixhitalizimi i procesit të dërgimit të RAD nga subjektet e ligjit.

Masat legjislative afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat ligjore të mëposhtme:

- Nënshkrimi i memorandumeve të Bashkëpunimit me partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim rritjen e bashkëpunimit dy dhe shumë palësh në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Masat zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet zbatuese të mëposhtme:

- Trajnimi i subjekteve raportuese mbi legjislacionin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional kombëtar në kuadër të aktiviteteve të parashikuara, sipas Planit të Zbatimit të Strategjisë Kombëtare "Për Hetimin e Krimit Financiar".

Prioritetet afatmesme

Për periudhën afatgjatë, prioritetet në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, do të jenë:

- Monitorimi i pajtueshmërisë ligjore të subjekteve raportuese të ligjit.
- Përpunimi efiëent i informacionit financiar të marrë nëpërmjet raporteve të Raporteve të Transaksioneve të Vlerave dhe Raporteve të Aktiviteteve të Dyshimta, me qëllim zhvillimin e kompletimin e dosjeve që lidhen me procesimin e aktiviteteve financiare kriminale.
- Zhvillimi, përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional kombëtar e ndërkombëtar nepermjet zbatimit të rekomandimeve të vlerësimit të katërt të Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Evropës.

- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së teknologjisë se informacionit dhe rritja e performancës së burimeve njerëzore.

Tabela 1
Forcimi i kapaciteteve institucionale të strukturës përkatëse

INVESTIME	NJËSIA MATËSE	GJENDJA AKTUALE	VITET			
			2010	2011	2012	2013
Shtim stafi	persona	27	26	27	28	30

PROKURORIA E PERGJITHSHME

Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Mjedisit, si dhe institucione të tjera që kanë në varësi forca të Policisë Gjyqësore, asistuar edhe nga ekspertë të EURALIUS-it, kanë ngritur grupe të përbashkëta pune, për hartimin e akteve nënligjore, të cilat kanë qenë detyrim për zbatimin e Ligjit Nr.8677, datë 02.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", i ndryshuar me ligjin Nr.10301, datë 15.07.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8677, datë 02.11.2000"".

Aktualisht janë hartuar dhe nënshkruar nga Prokurori i Përgjithshëm këto akte nënligjore:

1."Kriteret për përcaktimin e vështirësive, gjatë kryerjes së punës së Oficerit të Policisë Gjyqësore";
2."Kriteret për shpërblim për merita të veçanta për oficerët e Policisë Gjyqësore, të emëruar nga Prokurori i Përgjithshëm".

Janë hartuar dhe janë dërguar për nënshkrim në institucionet që kanë në varësi Polici Gjyqësore, keto akte nënligjore :
1. "Për trajnimin vazhdues të Oficerëve dhe Agjentëve të Policisë Gjyqësore";
2. "Për fillimin e procedimit displinor";
3. "Për kryerjen dhe përfundimin e hetimeve të kallëzuara drejtperdrejt në Prokurori apo të filluara kryesisht" (është nënshkruar nga Ministri i Brendshëm).

Janë hartuar dhe dërguar për mendim, këto akte nënligjore:

1."Për procedurat e konkurimit për caktimin në seksionet e policisë gjyqësore";
2."Për mënyrën e vlerësimit të rezultateve individuale në punë të Oficerëve të Seksioneve të Policisë Gjyqësore".

Është dërguar për mendim EURALIUS-it akti nënligjor "Për caktimin e organikës në seksionet e Policisë Gjyqësore".

Për sa i përket rivlerësimit dhe ripërcaktimit të kapaciteteve administrative të nevojshme, aktualisht organikat në Prokurori, janë të plotësuara dhe nuk janë bërë kërkesa për shtesë të numrit të punonjësve, për periudhën 2012 – 2014.

Lidhur me rivlerësimin dhe ripërcaktimin e kostove financiare në përputhje me Buxhetin 2012 dhe PBA-në 2012 – 2014, të gjitha kostot financiare (shpenzimet buxhetore) të Prokurorisë së Përgjithshme, janë paraqitur në buxhetin e vitit 2012 dhe për vitet në vijim në PBA-në 2012 – 2014, tregues për të cilët përgjithësisht është rënë dakord. Me këta tregues të shpenzimeve buxhetore sigurohet një funksionim normal i institucionit të Prokurorisë, për vitet e ardhshme.

3.24.6.LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT

Objektivi strategjik

Shqipëria synon të sigurojë koordinimin dhe bashkëpunimin e të gjitha institucioneve në planin kombëtar, rajonal e ndërkombëtar, me qëllim që të zvogëlojë në maksimum rrezikun e akteve të terrorizmit në vend, duke siguruar përmirësimin e elementeve të sigurisë dhe rritjen e besimit të komunitetit për masat parandaluese ndaj akteve terroriste.

Lufta kundër terrorizmit, e vlerësuar si një ndër sfidat më të mëdha të njerëzimit, përbën një ndër angazhimet kryesore të organeve të sigurisë, në kuadër edhe të detyrimeve ndërkombëtare që rrjedhin nga konventat dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.
Lufta kundër Terrorizmit përbën një detyrim në kuadër të integrimit të vendit tonë strukturat evropiane, si dhe detyrim si vend anëtar i NATO-s. Bazuar në këto detyrime, strukturat antiterror në Policinë e Shtetit do të vazhdojnë të bashkëpunojnë edhe me institucionet e tjera të sigurisë me qëllim përmbushjen e misionit për zbulimin, parandalimin dhe goditjen e akteve të mundshme terroriste, si dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet me fenomenin terrorist.
Gjithashtu në Nenet 82 dhe 84 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit është parashikuar bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE në këtë fushë.

Situata aktuale

Të gjitha institucionet në vend të përfshira në luftën kundër terrorizmit janë duke zbatuar Planin e Veprimit në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Terrorizmit 2011 – 2015. Të dy këto dokumente janë hartuar në bashkëpunim të plotë midis institucioneve në vend dhe janë në përputhje me standardet bashkëkohore ndërkombëtare. Shqipëria vazhdon të jetë anëtare e denjë e koalicionit ndërkombëtar të luftës kundër terrorizmit, duke marrë pjesë aktive në forumet ndërkombëtare për trajtimin e kësaj çështje dhe duke kontribuar me trupa paqeruajtëse në kuadrin e operacioneve të NATO-s në mbështetje të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit.
Lufta kundër terrorizmit mbetet një nga sfidat më të mëdha të njerëzimit dhe përbën një nga angazhimet kryesore të strukturave antiterror. Gjithashtu kjo merr një rendësi akoma më të madhe, pasi vendi ynë tashme është anëtar i NATO-s. E rëndësishme është përmbushja e

detyrimeve që rrjedhin nga konventat dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë.
Shqipëria është e angazhuara plotësisht për të përmbushur detyrimet e saj në mënyrë aktive me të gjitha kapacitetet në luftën globale kundër terrorizmit, duke e konsideruar atë si rrezikun dhe armikun numër një të paqes, sigurisë dhe demokracisë në botë.

Dokumentet strategjike mbi te cilat është mbështetur puna e strukturave antiterror janë;

- Strategjia Ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve dhe terrorizmit, e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1140, datë 30.7.2008 dhe Plani i saj i Veprimit, i miratuar me VKM Nr. 1103, datë 14.11.2009.
- Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë, e miratuar me Ligjin Nr. 9858, datë 27.12.2007.
- Strategjia Kombëtare e Luftës Kundër Terrorizmit e miratuar me VKM Nr. 675, datë 06.7.2011 "Për miratimin e Strategjisë së Luftës Kundër Terrorizmit dhe Planit të saj të Veprimit" 2011- 2015, e cila synon:
  - Të identifikojë gjerësisht fenomenin e krimit të terrorizmit dhe fenomenet e tjera që rrjedhin prej tij, duke analizuar shkaqet e faktorët e tij;
  - Të evidentojë dhe dokumentojë veprimtarinë institucionale të gjithë aktorëve që marrin detyrime për luftën kundër krimit të terrorizmit;
  - Të përcaktojë situatën aktuale ku ndodhet vendi ynë dhe masat për ndjekjen, parandalimin, mbrojtjen dhe reagimin ndaj këtij fenomeni ;
  - Të shpallë objektivat për zbulimin dhe parandalimin e terrorizmit, si dhe masat për realizimin e tyre;
  - Të planifikoje e tregoje rrugët e të implementimit të strategjisë;
  - Të evidentoje nevojat financiare apo burimet e mundshme financiare për realizimin e detyrimeve në funksion të implementimit të kësaj strategjie.

Ngjarjet e kohëve të fundit kanë dëshmuar se të gjitha shtetet evropiane mbeten të ekspozuara ndaj kërcënimit të terrorizmit dhe ekstremizmit, si nga kërcënimet që vijnë nga brenda vendit ashtu edhe ato që vijnë nga jashtë dhe Shqipëria nuk bën përjashtim në këtë drejtim. Pavarësisht se vendi ynë nuk ka përjetuar një fushatë të vazhdueshme terrori, ka elementë brenda shoqërisë që përpiqen të shfrytëzojnë njerëzit e pambrojtur për arritjen e objektivave të tyre ekstremistë. Megjithëse këto incidente të shfrytëzimit të situatës janë kontrolluar në mënyrë efektive në të shkuarën, ekzistojnë mundësitë që në të ardhmen mund të rishfaqen incidente të tilla, të cilat do të kenë ndikim mbi sigurinë dhe unitetin brenda komuniteteve tona. Jo vetëm individët janë të ekspozuar, por shumica e fushave të shoqërisë sonë mund të jenë të ekspozuara për t'u shfrytëzuar nga terroristët, sidomos sektori financiar.
Strategjia e luftës kundër terrorizmit mbështetet në strategjinë evropiane e cila bazohet në katër drejtime të punës: *Parandalimi, Mbrojtja, Ndjekja dhe Reagimi*. Kjo strategji reflekton shumë prej këtyre karakteristikave strategjike evropiane, ndërkohë që mbetet me rëndësi shumë të madhe për nevojat e sigurisë së vendit tonë.

Misioni i strukturave antiterror është zbulimi, parandalimi dhe goditja e akteve të mundshme terroriste, si dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet me fenomenin terrorist, brenda dhe jashtë vendit.

Krahas Sektorit Kundër Akteve Terroriste në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, detyrime të veçanta në luftën kundër terrorizmit kanë edhe Shërbimi Informativ Shtetëror, Shërbimi Informativ i Ushtrisë, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/nënligjore në këtë nënkapitull janë:

Konventat e nënshkruara dhe të ratifikuara:

- Konventa mbi Veprat Penale dhe Aktet e tjera te Kryera ne Bordin e Avionit, Tokio, 14.09.1963, ratifikuar me ligjin Nr. 8197, datë 06.3.1997.
- Konventa mbi Shtypjen e Akteve të Paligjshme të Rrëmbimit të Avionit, Hagë, 16.12.1970, ratifikuar me ligjin Nr. 8197, datë 06.03.1997.
- Konventa "Mbi Shtypjen e Akteve te Paligjshme kundër Sigurisë se Aviacionit Civil, Montreal", date 23.09.1971, ratifikuar me ligjin Nr. 8197, datë 06.03.1997.
- Konventa "Mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimeve kundër Personave me Imunitet Ndërkombëtar, përfshirë Agjentet Diplomatike", New York, 14.12.1973, ratifikuar me ligjin Nr. 8832, datë 22.11.2001.
- Konventa Evropiane "Mbi Shtypjen e Terrorizmit", Strasburg, 27.01.1977, ratifikuar me ligjin Nr. 8642, datë 13.7.2000.
- Konventa ndërkombëtare "Kundër Marrjes së Pengjeve, Neë York, 17.12.1979, ratifikuar me ligjin nr. 8837, date 22.11.2001.
- Konventa "Mbi Mbrojtjen fizike të materialit bërthamor", Vjenë më datë 03.03.1980.
- Protokolli "Mbi Shtypjen e Akteve të Paligjshme të Dhunës në Aeroportet që i shërbejnë Aviacionit Civil Ndërkombëtar", Montreal, 24.02.1988, ratifikuar me ligjin Nr. 8835, datë 22.11.2001.
- Konventa "Mbi Shtypjen e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar", Romë, 10.03.1998, ratifikuar me ligjin Nr. 8850, datë 27.12.2001.
- Protokolli "Mbi Shtypjen e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse, të Vendosura në Platformën Kontinental", Romë, 10.03.1988, ratifikuar me ligjin Nr. 8850, datë 27.12.2001.
- Konventa "Mbi Etiketimin e Eksplozivëve Plastik për Qellim Zbulimi", Montreal, 01.03.1991, ratifikuar me ligjin Nr. 9020, datë 06.3.2003.
- Konventa Ndërkombëtare mbi Ndalimin e Bombardimeve Terroriste, New York, 15.12.1997, ratifikuar me ligjin Nr. 8836, date 22.11.2001.
- Konventa ndërkombëtare "Për luftën kundër financimit të terrorizmit" New York, 10.01.2000, ratifikuar nga Parlamenti Shqipar me ligjin Nr. 8865, datë 14.03.2002.
- Konventa Evropiane **(**Strasburgut), "Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit", ratifikuar me ligjin Nr. 8646, datë 20.7.2000.
- Konventa e Këshillit të Evropës, "Mbi pastrimin, kërkimin dhe konfiskimin e procedurave të krimit të organizuar dhe financimit të terrorizmit", datë 6.5.2005, nënshkruar më 22 dhjetor 2005, hyrë në fuqi 1 maj 2008.
- Konventa e Këshillit të Evropës, Varshavës, "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit", ratifikuar me ligjin Nr. 9646, datë 27.11.2006.

- Ratifikimi i "Protokollit ndryshues i Konventës Evropiane për shtypjen e terrorizmit", ratifikuar me ligjin Nr. 9230, datë 13.5.2004.
- Konventa Ndërkombëtare për Shtypjen e Akteve të Terrorizmit Nuklear (Bërthamor) (2005), nënshkruar nga vendi ynë.

Ligjet në fushën e luftës kundër terrorizmit janë:

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr. 9322, datë 25.11.2004.
- Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 9858, datë 27.12.2007.
- Strategjia Kombëtare e Luftës kundër Terrorizmit e miratuar me VKM Nr. 675, datë 06.7.2011 "Për miratimin e Strategjisë së Luftës Kundër Terrorizmit dhe Planit të saj të Veprimit". Kjo Strategji është e përafruar me:
  - Strategjinë e BE-së për Luftimin e Terrorizmit, Vendimi Kuadër 2002/475/JHHA/1.
- Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" . Ky ligj është i përafruar me:
  - Pozicionin e Përbashkët të Këshillit datë 27 Dhjetor 2001, në luftën kundër terrorizmit (GZ L 344, datë 28 Dhjetor 2001, fq. 90) (*përafruar në mënyrë të pjesshme*);
  - Vendimin e Këshillit, datë 17 Tetor 2000 në lidhje me marrëveshjet për bashkëpunim ndërmjet Njësive Financiare të Inteligjencës të Shteteve Anëtare në lidhje me shkëmbimin e informacionit (GZ L 271, datë 24 Tetor 2000, fq. 4) (*përafruar në mënyrë të plotë*);
  - Vendimin e Këshillit 2000/642/JHA në lidhje me marrëveshjet për bashkëpunim ndërmjet Njësive Financiare të Inteligjencës të Shteteve Anëtare në lidhje me shkëmbimin e informacionit (GZ L 271, datë 24 Tetor 2000, fq. 4) (*përafruar në mënyrë të plotë*);
  - Vendimin Kuadër të Këshillit 2005/212/JHA, datë 24 Shkurt 2005 mbi konfiskimin e të ardhurave të lidhura me krimin, instrumenteve dhë pronën (FZ L 68, datë Mars 2005, fq. 49) (*përafruar në mënyrë të plotë*);
  - Vendimi i Këshillit 2007/845/JHA, datë 6 Dhjetor 2007 lidhur me bashkëpunimin ndërmjet Zyrave për Rimëkëmbjen e Aseteve të Shteteve Anëtare në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave ose pasuri të tjera të lidhura me krimin (GZ J 332, datë 18 Dhjetor 2007, fq. 103) (*përafruar në mënyrë të plotë*);
  - Direktiva 2005/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 26 Tetor 2005 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar me qëllim pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit (GZ L 309, datë 25 Nëntor 2005, fq. 15) (*përafruar në mënyrë të pjesshme*);
- Ligji Nr. 9686, datë 26.02.2007 "Për disa shtesa në ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal". Ky ligj është i përafruar me:
  - Pozicionin e Përbashkët të Këshillit datë 27 Dhjetor 2001 në luftën kundër terrorizmit (GZ L 344, datë 28 Dhjetor 2001, fq. 90) (*përafruar në mënyrë të pjesshme*) ;
  - Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/475/JHA, datë 13 Qershor 2002 në luftën kundër terrorizmit (GZ L 164, datë 22 Qershor 2002, fq. 3) (*përafruar në mënyrë të pjesshme)*;

- Vendimin Kuadër të Këshillit 2008/919/JHA, datë 28 Nëntor 2008 i cili ka ndryshuar Vendimin Kuadër 2002/475/JHA në luftën kundër terrorizmit (GZ L 330, datë 9 Dhjetor 2008, fq. 21) (*përafruar në mënyrë të pjesshme)* ;
- Vendimin Kuadër të Këshillit datë 28 Maj 2001 për luftimin e mashtrimit dhe falsifikimit të mënyrave jo kesh të pagesës (GZ L 149, datë 2 Qershor 2001, fq. 1);
- Vendimin Kuadër të Këshillit datë 26 Qershor 2001 mbi pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave të krimit (GZ L 182 datë 5 Korrik 2001, fq. 1);

- Ligji Nr. 8642, datë 13.07.2000, "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës në luftën kundër terrorizmit". Ky ligj është i përafruar plotësisht me:
  - Konventën e Këshillit të Evropës mbi shtypjen e terrorizmit datë 27 Janar 1977;

- Ligji Nr. 7905, datë 21/03/1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Ky ligj është në përputhje me:
  - Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/475/JHA, datë 13 Qershor 2002 në luftën kundër terrorizmit (GZ L 164, datë 22 Qershor 2002, fq. 3) (*përafruar në mënyrë të pjesshme)*;
  - Vendimin Kuadër të Këshillit 2008/919/JHA, datë 28 Nëntor 2008 I cili ka ndryshuar Vendimin Kuadër 2002/475/JHA në luftën kundër terrorizmit (GZ L 330, datë 9 Dhjetor 2008, fq. 21) (*përafruar në mënyrë të pjesshme*) ;
  - Vendimin e Këshillit 2005/671/JHA datë 20 Shtator 2005 mbi shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimit lidhur me veprat terroriste (GZ L 253 datë 29 Shtator 2005, fq. 22) (*përafruar në mënyrë të pjesshme*);
  - Vendimin Kuadër të Këshillit 2006/783/JHA datë 6 Tetor 2006 mbi aplikimin e njohjes reciproke të urdhrave të konfiskimit (GZ L 328 datë 24 Nëntor 2006, fq. 59);
  - Vendimin Kuadër të Këshillit datë 28 Maj 2001 në luftën kundër mashtrimit dhe falsifikimit të mënyrave jo kesh të pagesës (GZ L 149 datë 2 Qershor 2001, fq. 1);
  - Vendimin Kuadër të Këshillit datë 26 Qershor 2001 mbi pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e mjeteve dhe të ardhurave të krimit (GZ L 182 datë 5 Korrik 2001, fq. 1);

- Ligji Nr.9258, datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të Terrorizmit". Ky ligj është në përputhje me:
  - Vendimin e Këshillit 2007/845/JHA, datë 6 Dhjetor 2007 lidhur me bashkëpunimin ndërmjet Zurave për Rimëkëmbjen e Aseteve të Shteteve Anëtare në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave ose pasuri të tjera të lidhura me krimin (GZ J 332, datë 18 Dhjetor 2007, fq. 103) (*përafruar në mënyrë të pjesshme*) ;
  - Vendimin Kuadër i Këshillit (2005/212/JHA), datë 24 Shkurt 2005 mbi Konfiskimin e të Ardhurave të lidhura me krimin, on Confiscation of Crime-Related Proceeds, Instrumenteve dhe Pronës (GZ L 68 , datë 15 Mars 2005, fq. 49) (*përafruar në mënyrë të plotë*).

Struktura institucionale

Në drejtim të luftës kundër terrorizmit, strukturat e posaçme në Ministrinë e Punëve të Jashtme bashkëpunojnë ngushtë me strukturat përkatëse në Ministrinë e Brendshme/ Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ministrinë e Financave/Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Mbrojtjes/SHIU, Prokurorinë e Përgjithshme, SHISH.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit funksionon Sektori Kundër Akteve Terroriste në varësi të Drejtorisë së Krimeve të Rënda në Departamentin Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda. Misioni i strukturave antiterror është zbulimi, parandalimi dhe goditja e akteve të mundshme terroriste, si dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet me fenomenin terrorist.
Strukturat antiterror janë të organizuara si më poshtë:
Në qendër funksionon Sektori Kundër Akteve Terroriste, i përbërë nga 4 specialistë dhe një Shef Sektori, ndërsa në qarqe funksionojnë 12 seksione me 23 punonjës gjithsej.
Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, në fushën e luftës kundër terrorizmit Sektori Kundër Akteve Terroriste bashkëpunon me:

- Shërbimin Informativ Shtetëror (SHISH);
- Prokurorinë për Krimet e Rënda;
- Zyrën e Luftës kundër Terrorizmit në Shërbimin Informativ Ushtarak (SHIU), në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, e cila është një tjetër strukturë që ka si objekt të saj, luftën kundër terrorizmit.
- Me Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), e cila garanton menaxhimin dhe kontrollin e kufijve shqiptar dhe ndërveprimin e institucioneve shtetërore që kanë përgjegjësi dhe interesa në hapësirën detare shqiptare.
- Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP).

Masat legjislative afatshkurtra

- Hartimi i Rregullores për Funksionimin e Strukturave të Luftës Kundër Terrorizmit.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Në bashkëpunim me Departamentin e Trajnimeve dhe partnerë të tjerë, do të hartohen kurrikulat për trajnimin e vazhdueshëm të strukturave policore që marrin pjesë në luftën kundër krimit të terrorizmit.
- Zhvillimi i takimeve të përbashkëta dhe informimi i komunitetit mbi goditjen e fenomeneve që prodhojnë radikalizëm apo ekstremizëm.

Masat legjislative afatmesme

- Hartimi i një akti normativ “Për funksionimin e Komitetit Ndërinstitucional për Bashkërendimin Institucional të veprimeve, në luftën kundër terrorizmit”;
- Hartimi i një ligji organik sipas standardeve Evropiane për luftën kundër terrorizmit.

Masat zbatuese afatmesme

- Krijimi i një njësie të specializuar për ndjekjen e individëve apo grupeve me prirje radikale apo ekstremiste.
- Rishikimi dhe përmirësimi i mënyrave të bashkëpunimit midis agjencive të zbatimit të ligjit, si dhe me organizmat rajonale dhe ndërkombëtare që marrin pjesë në luftën kundër terrorizmit.
- Rritja dhe perfeksionimi i mënyrave të bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe lokale, entet e kultit etj, me qëllim gjetjen e formave efikase për vlerësimin e sensibilizimin e komunitetit mbi fenomenin e radikalizmit dhe ekstremizmit.
- Ndërtimi i një rrjeti komunikimi të sigurt për shkëmbimin e informacionit midis agjencive të zbatimit të ligjit që marrin pjesë në luftën kundër terrorizmit.
- Negocimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të reja dy dhe shumëpalëshe për luftën kundër terrorizmit.

3.24.7. BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR DROGËS

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik në fushën e luftës kundër drogës është i fokusuar në:

- Krijimin e një mjedisi të sigurt për shoqërinë përmes reduktimit të ofertës dhe aksesit ndaj drogave për përdorim të paligjshëm.
- Parandalimin e abuzimit me drogat përmes rritjes së ndërgjegjësimit të publikut për rreziqet dhe pasojat negative të përdorimit të drogës.
- Minimizimin e problemit të përdorimit të drogave në gjithë shoqërinë, duke siguruar në kohën e duhur trajtimin e përshtatshëm, shërbimet rehabilituese përkatëse dhe reduktimin e dëmit që vjen nga konsumi i paligjshëm i drogave.
- Ofrimin e një politike koordinuese dhe menaxhuese në luftën kundër drogave, si dhe të krijimit të sistemeve efikase të informacionit.

Gjithashtu në Nenet 83 dhe 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit është parashikuar bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE në këtë fushë.

Situata aktuale

Lufta kundër drogës mbetet një nga prioritetet kryesore të Qeverisë shqiptare sepse përbën një rrezikshmëri të lartë për qytetarët tanë dhe për impaktin potencial në procesin integrues të Shqipërisë në BE.

Gjatë periudhës 2004 – 2010, Shqipëria zbatoi një Strategji Kombëtare Antidrogë. Pas vlerësimit të kryer për shkallën e zbatimit të kësaj strategjie, u arrit në përfundimin se në përgjithësi Shqipëria ka patur sukses në zbatimin e programit të saj, lidhur me reduktimin e prodhimit dhe trafikimit të drogave, si dhe garantimit të një kontrolli efektiv dhe sigurimin e territorit të saj. Forcimi i veprimit të ligjit dhe i bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar, ka ndihmuar në sigurimin më të mirë të kufijve tanë dhe reduktimin e gjithë llojeve të

trafikimit. Në përgjithësi, ka një përmirësim të konsiderueshëm në sigurimin e kontrollit të kufirit, të vijës bregdetare dhe transportit ajror. Gjithashtu vihet re përmirësimi dhe rritja e profesionalizmit të punonjësve të Policisë së Shtetit, ku për këtë qëllim janë marrë masa në drejtim të modernizimit të pajisjeve dhe rritjen e trajnimeve të këtyre punonjësve.

Gjatë viteve të fundit, është vënë re eliminimi i disa prej organizatave më të mëdha kriminale. Mundësia që grupet kriminale të trafikimit të drogës të lëvizin lirshëm në territorin shqiptar, është reduktuar dhe një numër i konsiderueshëm i personave të angazhuar në organizatat e grupet kriminale, janë gjykuar dhe dënuar.

Me gjithë rezultatet e arritura deri tani, trafikimi i lëndëve narkotike vazhdon të mbetet një nga format më fitimprurëse të krimit të organizuar, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon e më gjerë. Organizatat dhe grupet kriminale përveç ndarjes së brendshme të detyrave, karakterizohen nga një përshtatshmëri ekstreme me kushtet e reja në bashkëpunim me grupet kriminale të rajonit dhe më gjerë. Lufta kundër këtyre grupeve dhe organizatave kriminale vazhdon të mbetet në qendër të vëmendjes së strukturave ligjzbatuese në vendin tonë. Rritja e efikasitetit në këtë veprimtari, kërkon ngritjen në nivel më të lartë të bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe mes institucioneve brenda vendit.
Kështu, është e nevojshme të vazhdojë me intensitet puna për arritjen e rezultateve të qëndrueshme të drejtuara nga hetimet proaktive dhe rritjes së bashkëpunimit, mes agjencive të zbatimit të ligjit. Një drejtim tjetër i rëndësishëm është reduktimi i mëtejshëm i prodhimit të marijuanës në vend.

Miratimi i një strategjie të re antidrogë është në proces. Strategjia e re do të materializojë angazhimin e shtetit shqiptar për të arritur standardet ndërkombëtare, në luftën ndaj drogës, si dhe për të ardhur në ndihmë të individëve apo grupe individësh të prekur nga konsumi i drogave.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji Nr. 8722, datë 26.12.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Lëndëve Psikotrope, 1988", *i përafruar plotëssht me:*
  - Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikimit të Paligjshëm të Lëndëve Narkotike dhe Substancave Psikotrope (Vienna, 20 Dhjetor 1988).
- Ligji Nr. 8723, datë 26.12.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën e Vetme Mbi Drogat Narkotike", e ndryshuar nga Protokolli i vitit 1972 "Për ndryshimin e Konventës së Vetme mbi drogat narkotike, 1961", *i përafruar plotësisht me:*
  - Konventën e Vetme Mbi Drogat Narkotike (New York, 30 Mars 1961), të ndryshuar nga Protokolli i vitit 1972.
- Ligji Nr. 8965, datë 07.11.2002 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi substancat psikotrope, 1971", *i përafruar plotësisht me:*
  - Konventën mbi Substancat Psikotrope (Vienna, 21 Shkurt 1971).

- Ligji Nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", shtuar dhe ndryshuar për veprat penale në fushën e drogës dhe krimit të organizuar me ligjet e mëposhtme:
  a) Ligji Nr. 8279, datë 15.01.1998 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", neni 2.
  b) Ligji Nr. 8733, datë 24.01.2001 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", nenet 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71 dhe 79.
  c) Ligji Nr. 9275, datë 16.09.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar", nenet 32, 33, 34.
  - Veprimin e Përbashkët datë 17 Dhjetor 1996 lidhur me përafrimin e ligjeve dhe praktikave të Shteteve Anëtare të BE-së për të luftuar varësinë ndaj drogës dhe për të parandaluar dhe luftuar trafikun e paligjshëm të drogës (GZ L 342 datë 31 Dhjetor 1996, fq. 6) (*e përafruar plotësisht);*
  - Vendimin Kuadër të Këshillit 2004/757/JHA datë 25 Tetor 2004 që vendos dispozitat minimale mbi elementët përbërës të veprave penale dhe dënimet në fushën e trafikimit të paligjshëm të drogës (GZ L 335 datë 11 Nëntor 2004, fq. 8) (e *përafruar pjesërisht*).
- Ligji Nr.7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", shtuar dhe ndryshuar në nenet për përdorimin e mjeteve speciale hetimore, me ligjet e mëposhtme:
  a) Ligji Nr.8813, datë 13.06.2002 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", nenet 22, 23, 24 dhe 25.
  b) Ligji Nr.9187, datë 12.02.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar", nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.
  - Veprimin e Përbashkët datë 17 Dhjetor 1996 lidhur me përafrimin e ligjeve dhe praktikave të Shteteve Anëtare të BE-së për të luftuar varësinë ndaj drogës dhe për të parandaluar dhe luftuar trafikun e paligjshëm të drogës (GZ L 342 datë 31 Dhjetor 1996, fq. 6) (*e përafruar plotësisht).*
- Ligji Nr.8750, datë 26.03.2001 "Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope", *e përafruar plotësisht me:*
  - Veprimin e Përbashkët datë 17 Dhjetor 1996 lidhur me përafrimin e ligjeve dhe praktikave të Shteteve Anëtare të BE-së për të luftuar varësinë ndaj drogës dhe për të parandaluar dhe luftuar trafikun e paligjshëm të drogës (GZ L 342 datë 31 Dhjetor 1996, fq. 6)
- Ligji Nr.7975, datë 26.07.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", ndryshuar dhe shtuar me ligjin Nr.9271, datë 09.09.2004; shtuar me ligjin Nr.9559, datë 08.06.2006, *i përafruar plotësisht me:*
  - Veprimin e Përbashkët datë 17 Dhjetor 1996 lidhur me përafrimin e ligjeve dhe praktikave të Shteteve Anëtare të BE-së për të luftuar varësinë ndaj drogës dhe për të parandaluar dhe luftuar trafikun e paligjshëm të drogës (GZ L 342 datë 31 Dhjetor 1996, fq. 6).

- Ligji Nr. 8874, datë 29.03.2002 "Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope", *i përafruar plotësisht me:*
  - Veprimin e Përbashkët datë 17 Dhjetor 1996 lidhur me përafrimin e ligjeve dhe praktikave të Shteteve Anëtare të BE-së për të luftuar varësinë ndaj drogës dhe për të parandaluar dhe luftuar trafikun e paligjshëm të drogës (GZ L 342 datë 31 Dhjetor 1996, fq. 6).
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 299, datë 14.4.2011 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Komitetit Kombëtar të bashkërendimit të luftës kundër drogës, sekretarisë së këtij Komiteti dhe Zyrës së Sistemit Kombëtar të të dhënave për drogën"".
- Udhëzimi i Përbashkët midis Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit "Për kontrollin dhe monitorimin e subjekteve që mbjellin kërp industrial ", përkatësisht me Nr. 2538/1, datë 14.5.2007 dhe Nr. 348/3 datë 3.5.2007.
- Udhëzimi i përbashkët midis Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë "Për trajtimin e lëndëve narkotike apo psikotrope", përkatësisht me Nr. përkatës 469/2, datë 3.4.2008 dhe 1572/2, datë 3.4.2008 dhe 1569, datë 17.4.2008.

Struktura institucionale

- **Ministria e Brendshme** (Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit), luan rolin kryesor në zbatimin e masave për reduktimin e ofertës për drogë.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit funksionon një strukturë e specializuar për luftën kundër drogës që është Sektori Kundër Narkotikëve, në përbërje të të cilit janë 13 oficerë policie, të trajnuar mirë dhe me eksperiencë.

Në 12 Drejtoritë e Policisë në Qarqe janë ngritur dhe funksionojnë Seksionet Kundër Narkotikëve që janë struktura vendore në përbërjen e të cilëve janë 106 punonjës policie. Këto struktura sigurojnë aplikimin e masave policore, shkencore dhe proceduriale për parandalimin, zbulimin, dokumentimin e veprave penale në fushën e drogës dhe procedimin e personave përgjegjës. Pjesa më e madhe e personelit të këtyre strukturave është trajnuar për luftën kundër drogës.
Në mbështetje të strukturave kundër narkotikëve operon edhe personeli i forcës së posaçme të operacioneve speciale.

Këto struktura disponojnë gjithë ekspertizën dhe mjetet e nevojshme për të zbatuar siç duhet legjislacionin në fushën e luftës kundër drogës.

Përveç tyre, policia e rendit dhe ajo kufitare kryejnë detyra në luftën kundër drogës. Në veçanti Policia Kufitare vepron në drejtim të parandalimit, zbulimit dhe goditjes së aktiviteteve kriminale të lidhura apo të kryera nëpërmjet kufirit shtetëror ku përfshihet dhe trafikimi i lëndëve narkotike.

Disa nga kompetencat më kryesore të policisë së shtetit, renditen më poshtë:

- Veprimtaria informative, me të cilën kuptohet grumbullimi, sistemimi, vlerësimi, analizimi, shpërndarja dhe përdorimi i informacioneve në interes të mbrojtjes së rendit dhe sigurisë publike ose për nevoja të parandalimit e zbulimit të veprave penale.
- Mbledhja e të dhënave duke shfrytëzuar çdo burim që mund të japë të dhëna: si bashkëpunimi i fshehtë me individët; vëzhgimin e fshehtë të personave dhe mjediseve, si dhe pajisjet gjurmuese të vendndodhjes, përgjimet e telekomunikimeve etj.
- Ftohen qytetarët për paraqitjen në polici për të marrë informacionet e nevojshme.
- Kontrolli i identitetit të personave.
- Kontrolli i personit, bagazheve, automjeteve.
- Kontrolli i banesave dhe mjediseve në kushtet e flagrancës ose me vendim të gjykatës.
- Ndalimi ose arrestimi në flagrancë i personit që ka kryer vepër penale.
- Sigurimi i burimeve të provave dhe bllokimi i sendeve dhe provave materiale.
- Kapja e personave të kërkuar.
- Kryerja e veprimeve hetimore me iniciativë ose të deleguara nga Prokurori.
- Kryerja e operacioneve të fshehta me miratim të Prokurorit.
- Kryerja e "dorëzimeve të kontrolluara" me autorizim të Prokurorit.

- **Prokuroria**

Për luftën kundër trafikimit, prodhimit e shitjes së narkotikëve Policia e Shtetit bashkëpunon me Prokurorinë e Përgjithshme, në rastet e operacioneve për "dorëzim të kontrolluar", arrestimin e personave në kërkim ndërkombëtar apo për ekzekutimin e "letër-porosive", të ardhura nga autoritetet gjyqësore të huaja; me Prokurorinë për Krimet e Rënda për rastet e trafikimit të drogave dhe ndjekjen e grupeve të strukturuara apo organizatave kriminale të trafikut të drogës; si dhe me Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore për rastet e veprave të tjera penale në fushën e drogës.
Struktura kryesore e Prokurorisë në luftën kundër trafikimit të lëndëve narkotike, është Prokuroria për Krime të Rënda. Numri i përgjithshëm i prokurorëve në këtë prokurori është 18. Gjithashtu janë të atashuar pranë kësaj prokurorie 22 oficerë të policisë gjyqësore, ndërkohë që për hetimet, sidomos në terren, janë angazhuar oficerë të sektorit të luftës kundër narkotikëve. Në dispozicion të hetimeve është qendra e pergjimeve pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Në funksion të rritjes së kapaciteteve janë zhvilluar trajnime periodike për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në këtë fushë, brenda dhe jashtë vendit. Në dispozicion të Prokurorisë dhe Gjykatës për krime të rënda është një godinë e re, ndërtimi i së cilës u financua nga Bashkimi Evropian, me hapësira të mjaftueshme për një funksionim normal të tyre.

- **Shërbimi Doganor**

Është i përfshirë në luftën kundër trafikut të drogës e të prekursorëve dhe jep kontributin e tij nëpërmjet Drejtorisë Antitrafik, e cila ka në përbërje të saj Sektorin e Luftës kundër Drogës. Në funksion të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, janë realizuar kontakte dhe trajnime me strukturat e Policisë Kufitare, si dhe me ato të Sektorit Kundër Narkotikëve.

Në praktikën e përditshme, shërbimi doganor, në Pikat e Kalimit të Kufirit kryen kontrolle të përbashkëta me punonjësit e policisë së shtetit për automjete dhe persona që përcaktohen për kontroll të vijës së dytë, me synim identifikimin e goditjen e trafikut të lëndëve narkotike.

- **Shërbimi Informativ Shtetëror**

- **Ministria e Arsimit dhe Shkencës**, e cila bashkëpunon me Ministrinë e Brendshme në përmbushje të akt – marrëveshjes tre palëshe ku është përfshirë dhe Ministria e Shëndetësisë "Për parandalimin e shpërndarjes së drogave në mjediset shkollore e universitare" Nr. 268/3, datë 18.3.2008 dhe 134, datë 24.3.2008 dhe 1834, datë 18.3.2008.

- **Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,** e cila bashkëpunon me Ministrinë e Brendshme në përmbushje të akt- marrëveshjes dy palëshe "Për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike" .

- **Ministria e Shëndetësisë**, e cila bashkëpunon me Ministrinë e Brendshme në përmbushje të akt - marrëveshjes dy palëshe "Për forcimin e masave të kontrollit kundër prekursorëve dhe drogave që përdoren në mjekësi" dhe njëkohësisht si institucion përgjegjës për edukimin me qëllim uljen e numrit të përdoruesve.
  Qendra Kombëtare për Kontrollin mbi Drogat, e cila është përgjegjëse për analizat dhe mbikëqyrjen administrative në lidhje me kontrollin e drogave që përdoren në mënyrë të ligjshme.
  Departamenti Farmaceutik, i cili është përgjegjës për zbatimin e ligjit lidhur me monitorimin e aktiviteteve farmaceutike nëpërmjet Shërbimit të Inspektimit Farmaceutik.
  Instituti i Shëndetit Publik, i cili monitoron praktikat lidhur me përshkrimet e recetave dhe përgatit udhëzues për përshkrimin e ilaçeve me përmbajtje narkotike.

- **Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave**

Drejtoria e Koordinimit të Kontrollit në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave e cila bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, në zbatim të Akt - Marrëveshjes "Për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike" përkatësisht me numrat, Nr. 3510, datë 15.08.2008 dhe Nr. 4586, datë 15.08.2008. Marrëveshja ka për qëllim parandalimin dhe luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike në fondin pyjor dhe kullosor në pronësi të qeverisjes qendrore.

- **Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit të Luftës Kundër Drogës**

Komiteti është përgjegjës për monitorimin e zbatimit Strategjisë Kombëtare Antidrogë, duke koordinuar veprimtaritë e institucioneve të përfshira.

Masat legjislative afatshkurtra

- VKM "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare Antidrogë 2012-2015";
- Ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, lidhur me:

- teknikat speciale të hetimit;
- asgjësimin e lëndëve narkotike, para përfundimit të procesit gjyqësor.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Në bashkëpunim me EMCDDA dhe UNODC do të vihet në funksionim të plotë Zyra e Sistemit Kombëtar të të Dhënave për Drogën.
- Do të krijohet një Njësi e Përbashkët mes Policisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganeve për analizën e riskut dhe kontrollin e konteinerave, në kuadër të zbatimit të një projekti të UNODC, për këtë qëllim. Projekti përfshin financimin nga UNODC të pajisjeve dhe trajnimin e njësisë.
- Vazhdimi i trajnimit të njësive të zbatimit të ligjit për luftën kundër drogës.
- Do të vazhdojë goditja e rrjeteve kriminale të shpërndarjes dhe trafikimit të lëndëve narkotike në bashkëpunim me Agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit dhe partnerët ndërkombëtarë.

Masat legjislative afatmesme

- Ndryshime në Kodin Penal për përcaktimin më të mirë të veprave penale në fushën e drogës në përputhje me Konventat Ndërkombëtare.

Masat zbatuese afatmesme

- Vazhdimi i trajnimit të njësive të zbatimit të ligjit për luftën kundër drogës.
- Do të vazhdojë goditja e rrjeteve kriminale të shpërndarjes dhe trafikimit të lëndëve narkotike në bashkëpunim me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit dhe partnerët ndërkombëtarë.

PARANDALIMI DHE LUFTA KUNDËR KULTIVIMIT TE BIMËVE NARKOTIKE

Masat legjislative afatshkurtra

- Urdhër i Ministrit të Brendshëm "Për miratimin e Planit të Veprimit "Për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve"".
- Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, "Për hartimin e Planit Operacional "Për kontrollin, monitorimin, evidentimin dhe asgjësimin e parcelave të mbjella me bimë narkotike Kanabis Sativa"**"".**
- Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm, "Për hartimin e Planit Operacional "Për monitorimet ajrore të sipërfaqeve të kultivuara me bimë narkotike kanabis sativa"".

Masat zbatuese afatshkurtra

- Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit "Për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve".

- Monitorimi i planeve operacionale për kontrollin e territorit me forca policore nga toka dhe me helikopter.

Masat legjislative afatmesme

- Urdhër i Ministrit të Brendshëm "Për miratimin e Planit të Veprimit "Për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve"" (për vitin 2013, 2014 dhe 2015).
- Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, "Për miratimin e Planit Operacional "Për kontrollin, monitorimin, evidentimin dhe asgjësimin e parcelave të mbjella me bimë narkotike Kanabis Sativa"" (për vitin 2013, 2014 dhe 2015).

Masa zbatuese afatmesme

- Ndjekja dhe monitorimi i Planeve të Veprimit dhe planeve operacionale me objektivin për uljen në masën 3% të numrit të bimëve të kultivuara në çdo vit.
- Reduktimin e monitorimeve ajrore dhe rritjen e fuqisë goditëse të policisë ndaj kultivimit të bimëve narkotike.

Kapacitetet institucionale

Tabela 3. Numri i punojesve dhe kostoja per nje vit (2012)

Në lekë

Emërtimi	**Nr.punonj**	**Paga**	**Sig Shoq**	**Totali**
Asetet kriminale	30	25,326	4,152	29,477
Trafiqet e paligjshme	96	74,879	12,384	87,263
Pastrimi i parave dhe korrupsioni	55	46,322	7,591	53,913
Policia Shkencore	151	126,041	20,378	146,419
Terrorizmi	28	23,822	3,901	27,723
Lufta kunder Droges	124	95,725	15,832	111,558
Parandalimi Krimit	976	672,432	112,045	784,477
TOTALI	1,460	1,064,546	176,282	1,240,829

Tabela 3.a Numri i punojesve dhe kostoja per vitet 2012, 2013.2014, 2015.

Nr.	**Viti 2012**	**Viti 2013**	**Viti 2014**	**Viti 2015**
Nr.punonjesve	1,460	1,460	1,460	1,460
Paga	1,064,546	1,064,546	1,064,546	1,064,546
Sigurime Shoqërore	176,282	176,282	176,282	176,282
Totali	1,240,829	1,240,829	1,240,829	1,240,829

Shënim: Lidhur me tabelen e kapaciteteve institucionale sqarojme se per vitet e ardhshme nuk do te kete shtesa organike.Bashkëlidhur tabela e efekteve financiare.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit, Qendra Kombëtare e Informacionit për Drogat, është vendosur në Institutin e Shëndetit Publik, si një njësi e Departamentit të Epidemiologjisë dhe Sistemeve Shndetësore. Dy specialistë do të punojnë me kohë të plotë në këtë qendër, ndërkohë që do të mbështeten nga dy ekspertë të tjerë me kohë të pjesshme. Adaptimet në strukturen e ISHP i janë propozuar Ministrit të Shëndetesisë dhe aprovimi pritet brenda tremujorit të parë të 2012. Infrastruktura e përshtatshme është identifikuar, teknologjia hardware dhe software si dhe pajisje të tjera janë prokuruar me mbeshtetjen e UNODC. Kapacitetet janë duke u zhvilluar me mbeshtetjen e EMCDDA;

- Raporti i parë kombëtar mbi drogat është përgatitur.
- Të gjithë standardet epidemiologjike janë adaptuar në shqip. Pesë Indikatoret Epidemiologjikë janë marrë nga EMCDDA dhe janë përkthyer nën mbikqyrjen e EMCDDA.
- Studimi i parë ESPAD në Shqipëri është kryer.
- Është përgatitur një plan operativ i detajuar mbi sistemin kombëtar të informacionit për drogat. Një grup ekspertësh (ISHP, Klinika e Toksikologjisë dhe Sektori i Luftës kundër Narkotikëve në DPPSH) kanë punuar me asistencën e EMCDDA për ndërtimin e këtij plani. Plani do të ndihmojë punën e Qendrës Kombëtare të Informacionit mbi Drogat dhe do të lehtësojë harmonizimin e sistemeve tona të informacionit në këtë drejtim me ato të BE-së. Kohëzgjatja është 2011-2015.

Masat legjislative afatshkurtra

- Miratimi i Planit të veprimit për sistemin e informacionit për drogat nga Komiteti Kombetar i Luftës kundër Drogës.
- Miratim i Bordit Ndërdisiplinor të Sistemit të Informacionit mbi Drogat nga Komiteti Kombetar i luftes Kunder Drogës.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Trajnim i profesionistëve mbi indikatorët epi.
- Botimi i protokolleve të informimit mbi drogën.
- Instalimi i DTBase te unifikuar ne sherbimet e trajtimit.
- Përgatitja e Raportit Kombëtar mbi Drogat 2012 (sipas EMCDDA).
- Vlerësim i numrit të përdoruesve problematikë të drogës për vitin 2012.
- Botimi i raportit përfundimtar të ESPAD 2011.
- Botimi i raportit përfundimtar te BioBSS 2011

Masat zbatuese afatmesme

- Studimi pilot (Tiranë) bazuar në popullatën e përgjithshme mbi drogat (GPS).
- Përgatitja e Raportit Kombëtar mbi Drogat 2013 (sipas EMCDDA).
- Përgatitja e Raportit Kombëtar mbi Drogat 2014 (sipas EMCDDA).

- Kryerja e ESPAD 2014.
- Përgatitja e Raportit Kombëtar mbi Drogat 2015 (sipas EMCDDA).
- Studimi Kombëtar bazuar në popullatën e përgjithshme mbi drogat (GPS 2015).
- Përditësim dhe shtrirje e DTBase të unifikuar në shërbimet e trajtimit.
- Kryerja e YRBS 2014.
- Kryrja e BioBSS 2015 (vetëm pjesa e IDU).
- Konferencë kombëtare mbi sistemin e informacionit mbi drogat.
- Vlerësim i numrit të përdoruesve problematikë të drogës për vitin 2013.
- Vlerësim i numrit të përdoruesve problematike të drogës për vitin 2014.
- Ndërtimi i regjistrit kombëtar të vdekjeve nga droga për vitin 2015.
- Vlerësim i numrit të përdoruesve problematikë të drogës për vitin 2015.
- Trajnim i profesionistëve mbi indikatorët epi (viti 2013).
- Trajnim i profesionistëve mbi indikatorët epi (viti 2014).
- Trajnim i profesionistëve mbi indikatorët epi (viti 2015)

3.24.8. BASHKËPUNIMI DOGANOR

Statusi Aktual

Objektivi strategjik

Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim –Asoccimit nenet 14, 15, 34, 43 dhe 97.

Objektivi kryesor për fushën e doganave është harmonizimi i procedurave dhe praktikave me standardet e Bashkimit Evropian, ruajtja e interesave financiare dhe ekonomike të Shqipërisë, lehtësimi i tregtisë duke implementuar metoda dhe teknologji moderne pune dhe lehtësimi i barrierave administrative në dogana, ndalimi i kontrabandës, korrupsionit, monopoleve, praktikave klienteliste, krijimi i një klime të favorshme konkurrence për biznesin, si dhe forcimi i mbrojtjes dhe sigurise kombëtare, mbrojtja e shoqërisë dhe të partnerëve tanë të biznesit duke u mbështetur në menaxhimin e riskut dhe kontrolle efikase dhe efektive, bashkëpunimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me të gjithë aktorët përkatës.
Shërbimi doganor bazohet në strategji dhe plane të specifikuara, të cilat konsistojnë në këto objektiva kryesore:

- Përgatitja e administratës doganore për hyrjen në BE;
- Sigurimi i bazave ligjore dhe standardeve, si dhe përafrimi i legjislacionit doganor shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian si dhe me praktikat e tyre më të mira, me qëllim unifikimin e tyre;
- Rritja e ndjeshme të nivelit të vjeljes së të ardhurave si dhe rritja e nivelit të zhdoganimit kryesisht të mallrave që paguajnë akcize;
- Përfshirja gjithnjë e më intensive e Shërbimit Doganor në mbrojtjen dhe sigurinë, në luftën kundër kontrabandës dhe trafiqeve (trafikut te drogës, armëve, makinave të vjedhura, qenieve njerëzore, pastrimit te parave etj;) dhe mallrave te ndaluara apo të kufizuara;

- Përmirësimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe i shkëmbimeve të informacionit, si brenda vendit ashtu edhe me vendet fqinje, për të përmirësuar sigurinë në kufi dhe luftën kundër trafiqeve të paligjshme;
- Përmirësimi i mjedisit të teknologjise se informacionit, informatizimi i plotë i sistemit doganor, përpunimi në rrugë elektronike i deklaratave doganore, thellimi i moduleve të sigurisë dhe analizës së riskut etj;
- Rritja e lehtësirave për biznesin përmes lehtësimit të procedurave doganore duke siguruar ruajtjen e nje balance ndërmjet lehtësimit të tregtisë dhe kontrolleve doganore;
- Sigurimi i kapaciteteve te duhura për të zbatuar dhe siguruar respektimin e acquis së BE-së lidhur me legjislacionin doganor perfshire edhe zbatimin korrekt dhe uniform të Marrëveshjeve të Tregtisë se Lirë dhe respektimin e rregullave të veçanta të parashtruara në fushat e acquis që kanë lidhje me doganat;
- Përforcimi i stabilitetit dhe pavarësisë se administratës doganore per t'ju përgjigjur sfidave të së ardhmes, veçanërisht në lidhje me statusin e punonjësve të saj, zbulimin dhe goditjen e akteve korruptive, transparenca me publikun dhe sensibilizimi i tij në luftën kundër korrupsionit;
- Përmirësimi i mjedisit të punës perfshire infrastrukturen dhe pajisjet dhe rritja e nivelit te profesionalizmit të punonjësve.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 (i ndryshuar)
- Rregullore e Këshillit 2913/92/EEC "Për Kodin Doganor Komunitar"
- Ligji nr. 9981, datë 08. 09.2008, "Për Miratimin e **Niveleve të Tarifës Doganore**", i ndryshuar
- Rregullorja e BE është 948/2009/EC "Mbi tarifat dhe nomenklaturën statistikore dhe tarifat e përbashkëta doganore.
- Ligji nr. 9461, datë 21.12.2005, "Për **Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore**",
- i ndryshuar
- Rregulloren 2658/87/EEC, datë 23 korrik 1987 "Për tarifën dhe nomenklaturën statistikore dhe për tarifat e përbashkëta doganore"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 205, datë 13.04.1999, "Për **Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor**", i ndryshuar.
- Rregullorja 2454/1993/EEC

Kuadri institucional ekzistues

Administrata Doganore përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoritë Rajonale dhe nga Degët Doganore. Ajo varet nga Ministria e Financave dhe është nën mbikëqyrjen e saj.
Administrata doganore mbështetet në tre misionet thelbësore te miratuara me VKM 232, datë 13.02.2008 "***Për miratimin e Strategjisë Sektoriale te Financave Publike, 2007-2013*".**

Misioni Fiskal

Misioni fiskal është një nga misionet kryesore të Doganës Shqiptare që konsiston në mbledhjen e taksave doganore te mallrave qe importohen ne Republikën e Shqipërisë. Krahas taksës doganore, autoritetet doganore mbledhin edhe disa taksa të tjera ne import, me cilësinë e agjentit tatimor.

Misioni ekonomik

Ky mision ka një rendësi te veçante ne mbrojtjen dhe zhvillimin e ekonomisë se vendit.
Ne përmbushjen e misionit ekonomik, bazuar ne legjislacionin doganor shqiptar, ligjin Nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës se Shqipërisë" i ndryshuar dhe Vendimin Nr. 205, date 13.04.1999 i Këshillit te Ministrave "Për Dispozitat Zbatuese te Kodit Doganor" i ndryshuar, autoritetet doganore:
Menaxhojnë te gjitha Regjimet Doganore dhe ne veçanti, autorizojnë dhe menaxhojnë Regjimet Doganore Ekomomike, kontrollojnë dhe garantojnë mbarëvajtjen e MTL-ve, administrojnë politikat nxitëse me fushën e investimeve, krijojnë lehtësira ne shlyerjen e detyrimeve doganore, ndikojnë ne lëvizjen e shpejte te mallrave, mjeteve, udhëtareve

Misioni Mbrojtës

Dogana shqiptare, si edhe ato te vendeve evropiane, i kushtojnë një rendësi te madhe misionit mbrojtës. Misioni mbrojtës konsiston ne:
A. Mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe rendit publik
B. Mbrojtjen e shëndetit publik.
C. Mbrojtjen e mjedisit
D. Mbrojtjen e faunës dhe florës
E. Mbrojtjen e pasurisë kulturore
F. Mbrojtjen e konsumatorëve
G. Mbrojtjen e moralit publik

Bashkëpunimi ndërinstitucional

Në përmbushjen e këtyre misioneve thelbësore, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave bashkëpunon me:

- Ministrinë e Financave
- Ministrinë e Brendshme
- Ministrinë e Bujqësisë
- Ministrinë e Ekonomisë
- Ministrinë e Drejtësisë
- Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit,
- Ministrinë e Shëndetësisë etj

Kapacitetet administrative

Në lidhje me kapacitetet administrative, referuar VKM Nr. 205, datë 13.04.1999 "Për dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor" te ndryshuar (së fundmi ndryshuar me VKM 927, date 17.11.2010), numri i punonjësve të administratës doganore aktualisht eshte 984 punonjës.

Aktualisht nuk ka parashikime për shtesë personeli sa lidhet me aktivitetet në kuadër të këtij kapitulli.

Masat zbatuese afatshkurtra

- Rehabilitimi i Pikës së Kalimit të Kufirit Morinë – Kukës, Faza I (IPA 2009).
- Mundësimi i një Programi për parandalimin e trafikut të drogës dhe të një databaze specifike, pjesë e Programit të Sigurisë së Kontenierëve, për t'u realizuar në bashkëpunim me Policinë e Kufirit dhe UNODC (shuma e financimit nga UNODC është e papërcaktuar për momentin, ndërsa nga Dogana mbulohen shpenzimet nga buxheti vjetor).

Masat zbatuese afatmesme

- Vijimi i Programit për parandalimin e trafikut të drogës dhe të një databaze specifike, pjesë e Programit të Sigurisë së Kontenierëve, për t'u realizuar në bashkëpunim me Policinë e Kufirit dhe UNODC (shuma e financimit nga UNODC është e papërcaktuar për momentin, ndërsa nga Dogana mbulohen shpenzimet nga buxheti vjetor).
- Rehabilitimi i Pikës së Kalimit të Kufirit Morinë – Kukës, Faza II (IPA 2012);
- Ndërtimi i Pikës së re të Kalimit të Kufirit Hani i Hotit. (IPA 2012).

3.24.9. BASHKËPUNIMI GJYQËSOR NË ÇËSHTJE CIVILE DHE PENALE

Situata aktuale

Qeveria Shqiptare do të respektojë angazhimet e marra dhe do të jetë plotësisht e hapur për një bashkëpunim institucional me institucionet e specializuara ndërkombëtare dhe të vendeve të tjera, duke qenë mjaft aktive në zbatimin e angazhimeve që do të marrë në kuadër të këtij bashkëpunimi.

Shqipëria ka ratifikuar një sërë Konventash dhe Traktatesh Ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, të cilat janë:

- Konventa Europiane "Për ekstradimin" dhe protokollet e saj shtesë ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8322, datë 2.04.1998;
- Konventa Europiane "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale" dhe protokollet e saj shtesë ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8498, datë 10.06.1999;
- Protokolli i dytë shtesë i Konventës Europiane "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale" dhe protokollet e saj shtesë ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8883, datë 18.04.2002 ;

- Konventa Europiane “Për transferimin e personave të dënuar” ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8499, datë 10.06.1999;
- Konventa Europiane “Për transferimin e proçedimeve penale” ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8497, datë 10.06.1999;
- Konventa Europiane “Për vlefshmërinë e gjykimeve ndërkombëtare penale” ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 9068, datë 15.05.2003;
- Konventa Europiane “Për mbikqyrjen e personave të dënuar apo të liruar me kusht” ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8724, datë 26.12.2000;
- Konventa Europiane “Për pastrimin, kërkimin, kapjen, konfiskimin e produkteve të krimit” ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8646, datë 20.07.2000;
- Konventa Europiane “Për korrupsionin në fushën penale” ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr.8778, datë 26.04.2001;
- Protokolli shtesë i Konventës Europiane “Për korrupsionin në fushën penale” ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 9245, datë 24.06.2004;
- Marrevëshja Europiane “Për transmetimin e kërkesave për ndihmë gjyqësore”.
- Konventa Europiane “Për informimin mbi të drejtën e huaj”, ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8703, datë 1.12.2000;
- Konventa Europiane “Për shtypjen e terrorizmit”, ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8642, datë 13.07.2000;
- Konventa Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” e ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996;
- Protokolli VI i Konventës Europiane “ Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, e ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8641, datë 13.07.2000;
- Konventa Europiane “Për krimin kibernetik”, e ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8888 datë 25.04.2002;
- Protokolli ndryshues të Konventës Europiane për shtypjen e terrorizmit, miratuar me ligjin nr. 9230, datë 13.05.2004;
- Konventa Europiane “ Për mbrojtjen e individeve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”;
- Protokollit shtesë i Konventës Europiane “ Për mbrojtjen e individeve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale, “Mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale nga organet mbikqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave;
- “Marrëveshja Europiane për Transmetimin e Kërkesave për Ndihmë Juridike”, miratuar me ligjin nr. 8705, datë 1.12.2000;
- “Konventa Europiane për Informimin për të Drejtën e Huaj”, ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8703, datë 1.12.2000;
- “Konventa Europiane Civile kundër korrupsionit”, miratuar me ligjin nr. 8635, datë 6.07.2000.
- “Konventa e Hagës “Për Heqjen e Kërkesës për legalizimin e dokumentave zyrtare të huaja”, miratuar me ligjin nr. 9060, datë 08.05.2003;

- Konventa e OKB-së “Për krimin e organizuar ndërkufitar” dhe dy protokolleve të saj shtesë e ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002;
- Konventa e OKB-se kundër trafikut të paligjshem të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope, ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8722, datë 26.12.2000;
- Konventa e Konferences se Hages “Per dorezimin dhe njoftimin jashte shtetit te dokumentave gjyqesore dhe jashtegjyqesore ne ceshtjet civile dhe tregtare” e 15 Nentorit 1965, ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin Nr. 9554, date 8.6.2006;
- “Marreveshjes, ndermjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikes se Italise, shtesë e Konventës Evropiane të Ekstradimit, të datës 13 dhjetor 1957 dhe e Konventës Evropiane të ndihmës gjyqësore në fushën penale të datës 20 prill 1959, që synon të lehtësojë zbatimin e tyre.

Ministria e Drejtësisë organizohet dhe funksionon në përputhje me Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë, me ligjin nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", me dispozitat ligjore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, si dhe me dispozita të tjera ligjore dhe nënligjore (deri tek Rregullorja e Brendshme e organizmit dhe funksionimit) që parashikojnë rregulla të organizimit, funksionimit dhe kompetencave për Ministrinë e Drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet dhe në zbatim të ligjit Nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit te vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera te drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

Në ushtrimin e veprimtarisë se saj, Ministria e Drejtësisë ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integrimit evropian të Republikës së Shqipërisë.
Ministria e Drejtësisë, në përputhje me ligjin, mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me organet e pushtetit gjyqësor dhe me prokurorinë, duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë.

Në përputhje me kuadrin ligjor që normon veprimtarinë, Ministria e Drejtësisë është angazhuar në përmbushjen me vizion të qartë dhe ritëm të lartë të të gjitha funksioneve të saj, ku rolin më të rëndësishëm e ka zënë Reforma në Drejtësi. Reforma në Drejtësi është konceptuar në marrjen e masave me karakter ligjor, institucional dhe administrativ, të cilat synojnë në forcimin e shtetit ligjor, rikthimin e besimit të qytetarëve te drejtësia, lufta pa kompromis kundër korrupsionit dhe transparenca e punës së organeve të drejtësisë.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Kushtetuta e Shqipërisë;
- Ligji nr. 7895, date 27. 1. 1995 « Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr 7905, datë 21. 3. 1995 "Kodi i Proçedurës Penale të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 7850, date 29. 07. 1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 8116, datë 29. 3. 1996 "Kodi i Proçedurës Civile të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10 193, date 3.12.2009 "Per marredheniet juridiksionale me autoritetet e huaja ne ceshtjet penale".
- Ligj Nr. 3920, date 21.11.1964 "Mbi gezimin e te drejtave civile nga te huajt dhe zbatimin e ligjit te huaj".

Struktura institucionale

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe aktet nderkombetare ne fushen e drejtesise jane përgjegjës:
Drejtoria e Pergjithshme e Kodifikimit e cila ka kompetence koordinimin e inisiativave ligjore qe lidhen me aktet nderkombetare dhe perqasjen e tyre me ligjin vendas dhe Drejtoria e Pergjithshme e Ceshtjeve te Drejtesise, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Ministrinë e Drejtësisë, e cila ndjek dhe realizon marrëdhëniet e Ministrisë së Drejtësisë me institucionet kushtetuese te drejtesise, në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga instrumentat e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombetar. Institucionet me të cilët Ministria e Drejtësisë bashkëpunon për realizimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar janë:

- Prokuroria, bashkëpunim i cili konsiston në ndjekjen, realizimin brenda afateve kohore të procedurave lidhur me marrëdhëniet juridiksionale si dhe në zgjidhjen e problematikave të hasura në kuadrin e praktikave të ndryshme midis dy institucioneve;
- Gjykatat, roli i të cilave mbështetur në ligjin "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, Kodin e Proçedurës Civile, Kodin Penal dhe Proçedurës Penale si dhe aktet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërise është palë, është shumë i rëndësishëm në realizimin dhe ekzekutimin e kërkesave për ndihmë juridike. Bashkëpunimi konsiston në realizimin e proçedurave që lidhen me marrëdhëniet juridiksionale;
- Ministrinë e Brendshme, Zyra Qëndrore Kombëtare – Interpol Tirana, mbështetur në aktet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë roli i këtij institucioni është mjaft i rëndësishëm në lokalizimin dhe kapjen e personave që kërkohen për shkak të një urdhëri arresti ndërkombëtar si dhe në realizimin me sukses kryesisht të ekstradimeve, transferimit të personave të dënuar si dhe marrëdhënieve të tjera juridiksionale;
- Ministria e Punëve të Jashtme, e cila mbështetur ne ligjin nr. 9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë"dhe aktet ndërkombëtare ku

Republika e Shqipërisë, është rruga diplomatike e komunikimit me autoritetet e huaja, rrugë e cila sa vjen e zbehet në praktikën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, por përsëri ajo vazhdon të jetë e pranueshme nga palët.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkutër synohet përcaktimi i qartë i kompetencave të institucioneve të përfshira në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, si dhe përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Projektligj "Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Urdhrin Rajonal për Arrestimin në Shtetet e Europës Juglindore";
- Projektligj "Për aderim në Konventën e Luganos"Për juridiksionin, njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështje civile dhe tregtare";
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në çështjet tregtare dhe civile";
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale";
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Serbisë "Për ekstradimin";
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Serbisë "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën civile dhe penale";
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Serbisë "Për njohjen e vendimeve në fushën penale";
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Bosnje Hercegovinën "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën civile dhe penale".

Aktet ligjore e nënligjore të planifikuara për vitin 2012, nga Ministria e Drejtësisë, janë identifikuar dhe janë listuar në vijim të këtij teksti.

- Analizë e Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqiperisë. Gjatë vitit 2012 është parashikuar analizimi i *Kodit të Procedurës Civile* dhe i Kodit Civil me qëllim adresimin të gjitha rekomandimet e organizmave ndërkombëtare dhe transpozimin e disa direktivave evropiane, si dhe për shkurtimin e procedurave gjyqësore. Kjo nismë është në përputhje me nenin 70 të MSA-në, parashikohet në PKZMSA, bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian të dhëna në Dokumentin e Partneritetit Evropian dhe në Strategjinë Ndërsektorale të Drejtësisë. Miratimi i ndryshimeve ligjore qe do te propozohen nga kjo analize duhet te miratohet me shumice te cilesuar te votave te Kuvendit te Shqiperise. **Council Directive 86/653/EEC of 18 December 1986 on the**

coordination of the laws of the Member States relating to self-employed commercial agents; CELEX 31986L0653. Council Directive 85/374/EEC of 25 July 1985 on the approximation of the laws, regulations and administrative provisions of the Member States concerning liability for defective products; CELEX: 01985L0374-19990604. Hartimi i këtyre akteve sjell shpenzime administrative. Në lidhje me zbatimin e këtij akti, ai ka karakter gjithëpërfshirës.

- Projektligj "*Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Urdhrin Rajonal për Arrestimin në Shtetet e Europës Juglindore";*
- Ky akt synon nxitjen dhe forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit gjyqësor në fushën penale, në nivel rajonal. Kjo nismë është në përputhje me nenet 1, 2, 4, 13 81 të MSA dhe me PKZMSA.
- Projektligj "*Për aderim në Konventën e Luganos"Për juridiksionin, njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështje civile dhe tregtare";*
- Ky akt synon rritjen e bashkëpunim rajonal në fushën civile duke thjeshtuar proceduar për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve civile gjyqësore të shteteve anëtare, ne përkrahje të iniciativës se Ministrisë Serbe të Drejtësisë për anëtarësimin kolektiv të vendeve të rajonit në këtë konvente. Kjo nismë është në përputhje me nenet 1, 2, 4, 13 81 të MSA dhe me PKZMSA.
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës "*Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në çështjet tregtare dhe civile*";Kjo marrëveshje do të parashikojë në mënyrë të detajuar rregullat dhe procedurat e forcimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtare ndërmjet palëve. Kjo nismë është në përputhje me detyrimet e ndërmarra në nivel ndërkombëtar për forcimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërmjet autoriteteve homologe të drejtësisë. Parashikuar në Strategjinë e Drejtësisë.
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës "*Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale*";Kjo marrëveshje do të parashikojë në mënyrë të detajuar rregullat dhe procedurat e forcimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtare ndërmjet palëve. Kjo nismë është në përputhje me nenet 1, 2, 4, 13 81 të MSA dhe me PKZMSA. Kjo nismë është në përputhje me detyrimet e ndërmarra në nivel ndërkombëtar për forcimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërmjet autoriteteve homologe të drejtësisë. Parashikuar në Strategjinë e Drejtësisë.
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Serbisë "*Për ekstradimin*";Kjo marrëveshje do të parashikojë në mënyrë të detajuar rregullat dhe procedurat e forcimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtare, mbi ekstradimin, ndërmjet palëve. Kjo nismë është në përputhje me nenet 1, 2, 4, 13 81 të MSAdhe me PKZMSA. Propozim i bërë nga pala Serbe në Konferencën e tretë Ministrore mbi "Bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në luftën kundër krimit të Organizuar në Evropën Jug Lindore", i mbajtur në datat 29-30 nëntor 2011, në Beograd.
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Serbisë "*Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën civile dhe penale*";Kjo marrëveshje do të parashikojë në mënyrë të detajuar rregullat dhe procedurat e forcimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtare ndërmjet palëve. Propozim i bërë nga pala Serbe në Konferencën e tretë Ministrore mbi

"Bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në luftën kundër krimit të Organizuar në Evropën Jug Lindore". i mbajtur në datat 29-30 nëntor 2011, në Beograd.

- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Serbisë "*Për njohjen e vendimeve në fushën penale*";Kjo marrëveshje do parashikojë në mënyrë të detajuar rregullat dhe procedurat për njohjen e vendimeve penale me qëllim kryesor përshpejtimin e procedurave në këtë fushë. Kjo nismë është në përputhje me nenet 1, 2, 4, 13 81 të MSA dhe me PKZMSA. Propozim i bërë nga pala Serbe në Konferencën e tretë Ministrore mbi "Bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në luftën kundër krimit të Organizuar në Evropën Jug Lindore". i mbajtur në datat 29-30 nëntor 2011, në Beograd.
- Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Bosnje Hercegovinën "*Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën civile dhe penale";*Kjo marrëveshje do të parashikojë në mënyrë të detajuar rregullat dhe procedurat e forcimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtare ndërmjet palëve. Është në përputhje me nenet 1, 2, 4, 13 81 të MSA dhe me PKZMSA-në. Propozim i bërë nga pala Boshnjake në Shqipëri në maj 2011, gjatë negociatave për nënshkrimin e marrëveshjes administrative midis dy ministrive respektive te drejtësisë.
- Projektligj "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8730 datë 18.01.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarimor gjyqësor";* Ky projektligj do të fokusohet në përmirësimin e funksionimit të sistemit përmbarimor, me synimin e forcimit të kapaciteteve të këtij sistemi, në zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, materializimin e një të drejte të fituar në një proces të rregullt gjyqësor. Kjo nismë është kërkuar nga Drejtoria e Shërbimit Përmbarimor për të bërë më efikas këtë shërbim. Parashikohet në PKZMSA.
- Projektligj "*Për disa ndryshime në ligjin nr.10186, datë 5.11.2009, "Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin*";Ky akt synon të zhvillojë të drejtat e pronësisë në zonat me përparësi turizmin të llojit troje, nëpërmjet ndryshimit të dispozitave që referojnë tek ndjekja e procedurave të parashikuara në Udhëzimin nr. 4, datë 21.11.2007 "*Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve, të kryera në kundërshtim me ligjin, dhe atyre që krijojnë mbivendosje në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme*", akt i cili është shfuqizuar me Vendimin nr. 17, datë 23.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese, si i papajtueshëm me kushtetutën. Akti është në përputhje me PKZMSA.
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave *"Për miratimin e Strategjisë mbi të Drejtat e Pronësisë";* Ky akt do të përcaktoje prioritetet dhe qëllimet strategjike, për realizimin e të drejtës së pronës. Në përmbajtjen e saj ajo do të trajtohen çështje konkrete lidhur me situatën aktuale dhe problematikat e konstatuara për çështjet e pronësisë, në këndvështrimin e të gjitha institucioneve fusha e veprimatrisë së të cilave lidhet me çështje të pronësisë, vizioni, prioritetet dhe qëllimet strategjike të cilat synojnë të realizohen me miratimin e këtij dokumenti, politikat që do të ndërmarrë secili institucion që trajton çështjet e pronësisë, për të mundësuar realizimin e objektivave të përcaktuara në të; burimet financiare që parashikohen të përdoren për realizimin e objektivave të saj, mekanizmi monitorues i strategjisë dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e saj. Është në përputhje me PKZMSA. Pas miratimit të Strategjisë do të miratohen dhe aktet ligjore e

nënligjore të parashikuara në planin e veprimit të saj. Ky akt del në zbatim të Rekomandimit Nr. 10 te Opinionit te Komisionit Evropian per Shqiperine.

- Projektvendim i Këshillit të Ministrave *"Për miratimin e rregullores se organizimit dhe funksionimit të brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore për pasuritë e paluajtshme*"; Ky akt do të hartohet pas miratimit të projektligjit "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me qëllim detajimin e procedurave për administrimin dhe përdorimin e bazës se te dhënave te, nivelet e sigurisë, dhe nivelin e aksesit ne këtë baze te dhënash për personat e përcaktuar në këtë ligj. Është në përputhje me MSA-në.
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e satusit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme";*Ky akt do të përcaktojë mënyrën e funksionimit dhe rregullat e mbledhjes së Bordit Drejtues të ZRPP si dhe rregullat në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së kësaj të fundit.*Ky projektakt është në përputhje të plotë me PKZMSA-në dhe propozohet për miratim në zbatim nenit 9 të parashikuar në projektligjin e përcjellë për miratim në Kuvend.* Në varësi të miratimit të projektligjit "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", dhe hyrjes në fuqi të tij".
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave "*Për caktimin e nivelit të pagave të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme";* Ky akt do të përcaktojë nivelin dhe kategoritë e pagave të punonjësve të ZRPP-së referuar legjislacionit në fuqi.Ky projektakt është në përputhje të plotë me PKZMSA-në dhe propozohet për miratim në zbatim nenit 10 të parashikuar në projektligjin e përcjellë për miratim në Kuvend. Në varësi të miratimit të projektligjit "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", dhe hyrjes në fuqi të tij".
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave *"Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të ushtrimit të drejtës së aksesit të informacionit nga personat juridik/fizik, vendas apo të huaj";* Ky akt ka si qëllim përcaktimin e rregullave të përdorimit të bazës së të dhënave të ZRPP nga personat fizik apo juridik që plotësojnë kushtet për të fituar të drejtën e aksesit në këtë të fundit.Ky projektakt është në përputhje të plotë me PKZMSA-në dhe propozohet për miratim në zbatim nenit 70, të parashikuar në projektligjin e përcjellë për miratim në Kuvend. Në varësi të miratimit të projektligjit "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", dhe hyrjes në fuqi të tij."
- Projektvendimi Këshillit të Ministrave *"Për miratimin e listës së shërbimeve të ofruara nga ZRPP";* Ky akt do të përcaktojë llojet e tarifave të shërbimit të ofruara nga ZRPP. Ky projektakt është në përputhje të plotë me PKZMSA-në dhe propozohet per miratim në zbatim nenit 72, të parashikuar në projektligjin e përcjellë për miratim në Kuvend. Në varësi të miratimit të projektligjit "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", dhe hyrjes në fuqi të tij."
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave *"Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen";* Ky akt ka si qëllim përcaktimin e procedurave te hollësishme në lidhje me regjistrimin e pasurive të paluajtshme për të cilat disponohen dokumente pronësie por nuk është përcaktuar sipërfaqja, duke parashikuar dhe rregullat e njoftimit dhe procedurat e ankimit të aktit qe do të lëshohet nga regjistruesi në zbatim të nenit 26/b të ligjit.Ky projektakt është në përputhje të plotë me PKZMSA-në dhe propozohet për miratim në zbatim nenit 26/b të parashikuar në projektligjin e përcjellë për miratim në Kuvend. Në varësi të miratimit të projektligjit "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", dhe hyrjes në fuqi të tij";

- Projektvendim i Këshillit të Ministrave *"Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim, për llogari të fondit të kompensimit financiar";* Ky akt ka si qëllim përcaktimin e kushteve dhe kritereve për tjetërsimin e oborreve në përdorim të përcaktuar si të tilla në aktin e fitimit të pronësisë, në zbatim të përcaktimeve të bëra në nenin 26/c të ligjit. Ky projektakt është në përputhje të plotë me PKZMSA-në dhe propozohet për miratim në zbatim nenit 26/c të parashikuar në projektligjin e përcjellë për miratim në Kuvend. Në varësi të miratimit të projektligjit "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", dhe hyrjes në fuqi të tij.
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave *"Për procedurën e kalimit në pronësi të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më datë 10.08.1991, dhe truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie te detyrueshme për regjistrim";* Ky akt ka si qëllim të përcaktojë organin kompetent për trajtimin e rasteve të pasurive të paluajtshme të ndërtuara para datës 1991 për të cilat nuk posedohen tituj pronësie, di dhe procedurat për tjetërsimin dhe regjistrimin e tyre në favor të përdoruesve. Ky projektakt është në përputhje të plotë me PKZMSA-në dhe propozohet për miratim në zbatim nenit 26/d të parashikuar në projektligjin e përcjellë për miratim në Kuvend. Në varësi të miratimit të projektligjit "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", dhe hyrjes në fuqi të tij.".
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave *"Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për kryerjen e përmirësimit dhe përditësimit të të dhënave gjate afishimit publik të regjistrimit te pasurive te paluajtshme";* Ky akt ka si qëllim të përcaktojë në mënyrë të detajuar rregullat dhe procedurat që duhet të ndiqen nga ZRPP në procesin e përmirësimit dhe përditësimit të dhënave pas përfundimit të regjistrimit fillestar, për ti afruar ato me përmbajtjen e titullit të pronësisë.Ky projektakt është në përputhje të plotë me PKZMSA-në dhe propozohet për miratim në zbatim nenit 66, të parashikuar në projektligjin e përcjelle për miratim në Kuvend. Në varësi të miratimit të projektligjit "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", dhe hyrjes në fuqi të tij.".
- Projektudhëzim i Këshillit të Ministrave *"Për caktimin e kriteret dhe procedurat për regjistrimin e lejes së ndërtimit dhe akteve noteriale të lidhura për zhvillimin në cilësinë e investitorit dhe pronarëve të truallit apo blerësve/porositësve të njësive individuale, te objektit ne fazën e karabinasë dhe të objektit të përfunduar";*Ky akt do të parashikojë rregulla të hollësishëm në lidhje me regjistrimin e lejeve te ndërtimit dhe akteve noteriale te lidhura ne baze te tyre, si dhe rregulla për regjistrimin e objektit në fazën e karabinasë, dhe të objektit të përfunduar së ndërtuari.Ky projektakt është në përputhje të plotë me PKZMSA-në dhe propozohet për miratim në zbatim të nenit 45 paragrafi 5, nenit 46 paragrafi 5, nenit 47 paragrafi 6, nenit 48 paragrafi 5 të parashikuar në projektligjin e përcjellë për miratim në Kuvend. Në varësi të miratimit të projektligjit "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", dhe hyrjes në fuqi të tij.".
- Projektudhëzim i Këshillit të Ministrave *"Për procedurën e regjistrimit të pasurive të fituara me vendim gjykate, akt administrativ apo noterial, në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme";* Ky projektakt ka si qëllim përcaktimin e elementeve të formës dhe përmbajtjes që duhet të verifikojnë punonjësit e ZRPP-së në aktet administrative, noteriale apo vendimet e gjykatës, që do të paraqiten për regjistrim pranë kësaj të fundit nga personat e interesuar.Ky projektakt është në përputhje të plotë me PKZMSA-në dhe propozohet për miratim në zbatim nenit 43, 45, 46, të parashikuar në projektligjin e përcjellë për miratim në Kuvend. Në varësi të miratimit të projektligjit "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", dhe hyrjes në fuqi të tij."

Masat zbatuese afatshkurtra

Nga nismat e mëposhtme konstatojmë se nuk lind nevoja për një riorganizim institucionesh ekzistues apo për krijimin e institucioneve të reja. Aktet e mëposhtme planifikohen të hartohen deri në fund të vitit 2012.

Masat Afatmesme

Përsa i përket masave afatmesme Ministria e Drejtësisë nuk planifikon akte ligjore që priten të harmonizohen me acquis gjatë periudhës 2013-2015.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Përkthimi i akteve ndërkombëtare në përputhje me kalendarin vjetor të përcaktuar nga Ministria e Integrimit në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë;
- Bashkëpunimi me Këshillin e Europës në kuadrin e projekteve të ketij organizmi për trainimin e specialistëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve, në fushën e marrëdhenieve juridiksionale me jashtë, si dhe përkthyesve zyrtarë

Efektet Financiare

Përsa i përket efekteve financiare, hartimi i akteve nuk sjell kosto shtesë për buxhetin e shtetit, ato mbulohen me shpenzimet administrative të parashikuara për Ministrinë e Drejtësisë.

3.25. KËRKIMI SHKENCOR

Objektivi strategjik

Zhvillimi i veprimtarisë shkencore dhe investimet në kërkimin shkencor mbështesin zhvillimin ekonomik të vendit, promovojnë ekselencën (kapital njerëzor dhe qendra ekselente kërkimore) në vend dhe ndikojnë në transferimin e dijeve dhe teknologjive moderne në laboratorët mësimorë të universiteteve me qëllim aplikimin e shkencës në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës.

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e kërkimit shkencor për periudhën afatgjatë është inkurajimi i bashkëpunimit në kërkimet civile shkencore dhe zhvillimin e veprimtarisë kërkimore shkencore në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit të vendit, si dhe ato evropiane e botërore. Ky bashkëpunim mendohet të bëhet mbi bazën e përfitimit të ndërsjellët, hyrjes në programet përkatëse, si dhe nxitjes së vendeve të përfshira në procesin e Stabilizim-Asociimit për shkëmbim përvojash në kuadër të zhvillimit të arsimit, zhvillimit social dhe kulturës (neni 109 dhe 54 i MSA-s).

Situata aktuale

Në vitin 2011 Ministria e Arsimit dhe Shkencës kontribuoi me 544.2 milion lekë në fushën e kërkimit shkencor. Investimet në shkencë (fondi i Ministrisë) u përqendruan kryesisht në mbështetjen e institucioneve kërkimorë dhe universiteteve për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës laboratorike kërkimore shkencore, nxitjen e punës kërkimore në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) publik nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 2,800 kërkuesve, si dhe kërkimit fondamental në IAL publike. Gjithashtu, financimi në shkencë ka lehtësuar zgjerimin e bashkëpunimit të universiteteve me biznesin privat në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, ka mundësuar pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet dypalëshe me partnerë të huaj, në programet komunitare si Programi i Shtatë Kuadër (FP7), Erasmus Mundus, dhe Tempus, si dhe ka mbështetur vazhdimësinë e programit Brain Gain si një promotor i tërheqjes së trurit (kapitali njerëzor i formuar jashtë vendit) dhe vazhdimësinë e Fondit të Ekselencës.

Përmes fondeve të kërkimit shkencor (fonde të Ministrisë) u mbështetën 53 projekte kërkimore shkencore që u shërbejnë edhe studentëve të doktoratës. Projektet e gjuhës dhe të historisë të Qendrës së Studimeve Albanologjike u mbështetën me përparësi. Për herë të parë u zbatua modeli i financimit të kërkimit bazë në nivel departamenti, çka u dha mundësi pedagogëve dhe punonjësve shkencorë të departamenteve të përzgjedhin dhe të vendosin vetë projektet që do të mbështeten nga fondi total dhënë departamentit mbështetur në numrin e personelit mësimor kërkimor dhe në veçoritë e fushës. Fondi për kërkim bazë, që u përdor në vitin 2011, ishte rreth 340 milionë lekë ose rreth 3.4 milion USD. Gjatë vitit 2011, përmes Fondit të Ekselencës u mbështetën me bursa 109 studentë të ekselencës për të kryer studimet e doktoratës (85 studentë) dhe ato universitare (24 studentë) në 15 universitetet më të mira të botës. Programi i Fondit të Ekselencës ka ndikuar në rritjen e burimeve njerëzore në arsimin e lartë.

Sot, Shqipëria ka burime njerëzore të mjaftueshme dhe me kualifikim të lartë që, brenda 10-15 viteve, të formojë profesoratin e ri krejtësisht të krahasueshëm, për nga niveli, me atë të vendeve të zhvilluara dhe plotësisht të aftë për të përballuar sfidat e mëdha të zhvillimit të arsimit të lartë shqiptar në 4-5 dekadat që vijnë.

Sfida kryesore në fushën e kërkimit shkencor mbetet rritja e investimit privat në shkencë.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik", i ndryshuar me Ligjin Nr. 8401, datë 9.09.1998, I përafruar me vendim e Këshillit Evropian Nr. 1999/65/EC të Programit kuadër të VI të Komunitetit Evropian. Shkalla e përafrimit: I pjesshëm.
- Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 863, datë 29.07.2009, "Për Strategjinë Kombëtare të Kërkimit, Zhvillimit Teknologjik dhe Inovacioneve (SHKKZHTI).
- VKM nr. 567, datë 23.10.1995 "Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të veprimtarisë Shkencore e Teknologjike" i përafruar me vendimin e Këshillit dhe Parlamentit Evropian Nr. 1513/2002/EC lidhur me Programit Kuadër VI të Komunitetit Evropian (2002-2006) Shkalla e përafrimit: I pjesshëm.

Ligje dhe akte që nuk transpozojnë akte evropiane

- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Shkences Nr. 01, datë 06.04.2010 "Për procedurën e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve që financohen në kuadrin e Programeve Kombëtare për Kërkim dhe Zhvillim";
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 02, datë 06.04.2010 "Për vlerësimin e Projekteve që financohen në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit";
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 03, datë 06.04.2010 "Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit";
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 04, datë 01.10.1998 "Për mënyrën e paraqitjes së raporteve shkencore (studimeve) për projekte që financohen në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit";
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 05, datë 06.04.2010 "Për mënyrën e raportimit mbi zbatimin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit";
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 11, datë 16.06.2005 "Për procedurën e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve që financohen në kuadrin e Programeve të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik me vendet e tjera";

Struktura institucionale

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e kërkimit shkencor është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)
  Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka për detyrë të hartojë strategji dhe politika të Kërkim-Zhvillimit si dhe të përcaktojë fushat prioritare, t'i harmonizoje ato me ato të BE, të promovojë bashkëpunimin e kërkuesve shqiptarë ndërmjet tyre dhe me

homologë të huaj, si dhe të nxisë pjesëmarrjen e kërkuesve dhe institucioneve shkencore shqiptare në aktivitetet, programet dhe Projektet ndërkombëtare.

- Akademia e Shkencave (ASH)
  Akademia e Shkencave është institucioni më i lartë shkencor në Republikën e Shqipërisë e cila mbështet veprimtarinë e kërkimit dhe zhvillimit në përputhje me interesat kombëtare duke siguruar shprehjen e mendimit të lirë shkencor. Ajo ka për detyrë të këshillojë qeverinë dhe MASH për hartimin e politikave, strategjive dhe përcaktimin e prioriteteve të kërkimit dhe zhvillimit..
- Shkollat e Larta (Universitetet dhe Akademitë)
  Universitetet me Departamentet e tyre apo Qendrat Kërkimore, Agjencitë dhe Qendrat e Transferimit të Teknologjive në varësi të Ministrive të ndryshme, si dhe Institucione/grupe studimore private janë organizma që kryejnë aktivitete kërkuese, zhvilluese dhe Inovative. Qendrat e Transferimit të Teknologjive kanë gjithashtu edhe detyrën e transferimit të njohurive në ndërmarrjet industriale apo bujqësore, të prodhimit/shërbimit, në varësi të fushës së kompetencës (NVM-të e më gjerë).
    - Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 903, date 26.08.2009.

  AKTI ka mision mbështetjen, monitorimin dhe vlerësimin e programeve dhe të projekteve në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit (SHTI), në shkallë vendi. AKTI, bazuar në VKM-në e miratuar: (i) bashkëpunon me ministritë dhe institucionet e tjera për zbatimin e strategjisë së SHTI-së dhe promovon kërkimin në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit; (ii) realizon financimin e programeve dhe të projekteve të SHTI-së, në përputhje me përparësitë e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave dhe me vlerësimin e bërë nga komisionet përkatëse; (iii) zhvillon procedurat e aplikimit, të vlerësimit fillestar, monitorimit dhe vlerësimit përfundimtar të programeve dhe projekteve të SHTI-së; (iv) monitoron dhe vlerëson veprimtaritë e SHTI-së, në shkallë vendi; (v) krijon dhe pasuron, në mënyrë të vazhdueshme, bazën e të dhënave, të analizës dhe dokumentacionit të sistemit të SHTI-së; (vi) ofron asistencë teknike për të gjitha institucionet në fushën e investimeve në SHTI; (vii) promovon ngritjen e strukturave të SHTI-së në të gjitha nivelet; (viii) promovon bashkëpunimin me sektorin privat në fushën e SHTI-së; (ix) promovon, ofron ekspertizë, bashkërendon dhe monitoron bashkëpunimin dy dhe shumëplanësh me BE-në, vendet e veçanta dhe organizatat e huaja, në fushën e SHTI-së; (x) zbaton politikat e qeverisë për mbështetjen me përparësi të shkencëtarëve më të kualifikuar, të grupeve kërkimore dhe qendrave të ekselencës, në SHTI; (xi) zbaton politikat e qeverisë për nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve dhe të shkencëtarëve të rinj në veprimtarinë e SHTI-së; (xii) zbaton politikat nxitëse të qeverisë për kthimin e trurit dhe rritjen e angazhimit të diasporës intelektuale shqiptare në zhvillimin e arsimit, të shkencës, administratës publike dhe sektorit privat në vendin tonë dhe (xii) ofron mbështetje teknike për institucionet ekzekutive, legjislativin dhe institucionet e tjera, për përmirësimin e plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe nënligjor, në fushën e SHTI-së.

  AKTI është institucion buxhetor dhe financohet nga buxheti i shtetit, në formë granti, zëri "Fondi për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin (FSHTI)", në nënzërat e mëposhtëm: i) Fondi për programet kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit; ii) Fondi për infrastrukturën e kërkimit; iii) Fondi për qendrat e ekselencës në kërkim; iv) Fondi

për transferimin e teknologjisë dhe inovacionin; v) Fondi për kërkuesit e rinj; vi) Fondi për programin Brain Gain.

Prioritetet afatshkurtra

Bazuar në angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, prioritetet afatshkurtra (2012-2013) për fushën e kërkimit shkencor janë:

- Vlerësim i legjislacionit mbi kushtet e reja pas reformës së sistemit të kërkimit shkencor;
- Përmirësimi dhe harmonizimi në mënyrë progresive i legjislacionit shqiptar në përputhje me atë të Bashkimit Evropian, për kushtet e reja pas reformës së sistemit të kërkimit shkencor.

Masat ligjore afatshkurtra

Në përputhje me këto prioritete afatshkurtra, për realizimin e tyre, do të ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës:

- Projektligj për rishikimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik", i ndryshuar me Ligjin Nr. 8401, datë 09.09.1998.

Aktivitet zbatuese afatshkurtra

Për realizimin e angazhimeve gjatë periudhës afatshkurtër, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- Organizimi i konferencave, seminareve etj, në zbatim të Ligjit Nr. 7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik";
- Zhvillimi i seminareve dhe trajnimeve për njohjen e legjislacionit evropian në lidhur me mënyrat e konkurrimit me projekt-propozime për fushat prioritare të kërkimit shkencor në hapësirën evropiane të kërkimit;
- Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore shkencore;
- Hartimi dhe aplikimi për projektet ne fushën e kërkimit shkencor kombëtare dhe ndërkombëtare.

Prioritetet afatmesme

Bazuar në angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, prioritete afatmesme për fushën e kërkimit shkencor janë:

- Vlerësim i legjislacionit mbi kushtet e reja pas reformës së sistemit të kërkimit shkencor;
- Krijimi i 4-5 Qendrave të Ekselencës;

- Përmirësimi dhe harmonizimi në mënyrë progresive i legjislacionit shqiptar në përputhje me atë të Bashkimit Evropian, për kushtet e reja të reformës së sistemit të kërkimit shkencor;
- Realizimi i plotë i reformimit të sistemit të kërkimit shkencor në Shqipëri.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Në përputhje me këto prioritete afatmesme, për periudhën 2014-2015, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës do të ndërmerren aktivitetet zbatuese të mëposhtme ligjore:

- Hartimi dhe aplikimi për projektet ne fushën e kërkimit shkencor kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore shkencore;
- Organizimi i konferencave, seminareve, trajnimeve, etj, në zbatim të Ligjit Nr. 7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik".

Implikimet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**848.150.000**	**860.100.000**	**991.100.000**	**1.001.900.000**
Mbulohen nga buxheti i	848.150.000	860.100.000	991.100.000	1.001.900.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.26. ARSIMI DHE KULTURA

3.26.1. ARSIMI

Arsimi parauniversitar

Objektivi strategjik

Objektivi prioritar i qeverisë shqiptare në fushën e arsimit është promovimi i shoqërisë së dijes, zhvillimi i kapitalit njerëzor, dhe ndërthurja e teknologjisë moderne me mësimdhënien dhe mësimnxënien në funksion të progresit ekonomik të vendit dhe të një zhvillimi të qëndrueshëm të shoqërisë shqiptare me standarde bashkëkohore evropiane. Në këtë kontest, Ministria e Arsimit dhe Shkencës zhvillon politikat dhe reformat në fushën e arsimit me qëllim rritjen e cilësisë në gjitha nivelet e arsimit, zgjerimin e pjesëmarrjes (aksesi në arsim) duke promovuar një arsim gjithë-përfshirës, si dhe përshtatjen e kurrikulës mësimore me kërkesat dhe nevojat në tregun e punës.

Në arsimin parauniversitar prioritetet janë:

- përmirësimi dhe sigurimi i cilësisë së shërbimit arsimor që ofrojnë institucionet arsimore parauniversitare (kopshtet dhe shkollat publike dhe jopublike, DAR/ZA-të);
- fuqizimi dhe shtrirja e mëtejshme e sistemit të arsimit parashkollor për fëmijët 3-5-vjeçar;
- shtrirja e shërbimeve të fëmijërisë së hershme për shtresat në nevojë dhe grupet e margjinalizuara, veçanërisht në zonat e thella rurale;
- rishikimi dhe reformimi i kurrikulës së arsimit bazë (klasat1-9) si dhe rishikimi i kurrikulës së arsimit të mesëm të përgjithshëm, pas përfundimit të ciklit të parë tre vjeçar (2009-2012);
- integrimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në arsim; dhe
- reformimi dhe zhvillimi i arsimit profesional me synim formimin e kapaciteteve të aftë për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë së vendit.

Këta objektiva do të realizohen nëpërmjet:

- Studimet krahasuese dhe përvojat nga praktikat më të mira si dhe bashkëpunimi me të gjithë grupet e interesit për zhvillimin e arsimit, duke i përfshirë ata në vendimmarrje;
- Përforcimi i kapaciteteve mësimore për një mësimdhënie më efektive;
- Zhvillimi i Arsimit Profesional pas të mesëm;
- Modernizimi i modelit kurrikular për ta afruar me kërkesat e tregut së punës;
- Plotësimi i kuadrit ligjor-normativ të arsimit dhe formimit profesional (AFP) në mbështetje të të gjitha ndryshimeve reformuese në këtë sektor;
- Krijimi i një sistemi (portali) të integruar dhe të zgjeruar për Arsimin dhe Formimin Profesional në Shqipëri;
- Përmirësimi i procedurave në Provimet e Lirimit dhe Maturën Shtetërore;
- Përdorimi i një metodologjie bashkëkohore për vlerësimin e institucioneve arsimore

parauniversitare;

- Nxitja dhe përhapja e kulturës së vetëvlerësimit (vlerësimit të brendshëm) në institucionet e arsimit parauniversitar;
- Zbatimi i "Programit Kombëtar për braktisjen zero 2009-2013", plani i veprimit për Dekadën e Përfshirjes Rome 2010-2015, plani i veprimtarive të Strategjisë kombëtare për personat me aftësi të kufizuar, të projektit të "Shansit të dytë", i cili ndiqet nga 626 nxënës të arsimit bazë prej të cilëve 417 fëmijë janë romë.

Analiza e situatës aktuale

Përgjatë vitit 2011, si dhe në vazhdimësi po ndërmerret një ndërhyrje e thellë në kurrikulën e arsimit parauniversitar me qëllim modernizimin e përmbajtjes së teksteve shkollore dhe përshtatjen e programeve mësimore me kërkesat e shoqërisë së dijes dhe informacionit si dhe kërkesat e tregut të punës. Në vitin 2012 pritet miratimi i projekt-ligjit për arsimin parauniversitar (shkurt 2012 në Këshillin e Ministrave), amendimet e të cilit do të sjellin risi dhe rritjen e cilësisë në sistemin arsimor shqiptar. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është shtrirë gjerësisht në sistemin arsimor, duke u bërë kështu motori i modernizimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollat shqiptare.

Buxheti për arsimin bazë për vitin 2011 ishte 23 miliard e 636.6 milion lekë, realizimi i të cilit është kryer në masën 97%. Në veçanti, i është kushtuar vëmendje modernizimit të infrastrukturës fizike (rikonstruksioni dhe ndërtimi i kopshteve dhe shkollave të reja me standarde evropiane) dhe pajisjes me laboratorë shkencorë dhe laboratorë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), zgjerimit të arsimit parashkollor, hartimit të kornizës kurrikulare të arsimit bazë, përfshirjes në arsim të fëmijëve të shtresave të margjinalizuara, konsolidimit të shërbimit psikologjik në shkollë.

Sa i përket arsimit bazë të detyruar (klasat 1-9), treguesit statistikorë pasqyrojnë një përqindje të lartë të nxënësve që përfundojnë me sukses arsimin e detyruar. Rreth 91.5% e nxënësve që përfunduan arsimin e detyruar, vijuan arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe atë profesional. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në konsultim të gjerë me grupet e interesit dhe grupet e punës të përbërë nga mësues, prindër, dhe ekspertë në çdo rreth të vendit është angazhuar për hartimin e kornizës kurrikulare (klasat 1-9) dhe për vendosjen e standardeve moderne në programet lëndore.

Krahas arritjeve, Ministria e Arsimit dhe Shkencës përballet me sfida në arsimin parashkollor dhe arsimin bazë. Disa nga sfidat kryesore vazhdojnë të jenë sigurimi i cilësisë në kopshte dhe shkolla (cilësia në infrastrukturë dhe në kurrikul), ulja e braktisjes në shkollë, trajnimi i vazhduar i mësuesve dhe rritja e një menaxhimi eficent dhe transparent akademik dhe financiar në çdo shkollë.

Buxheti për arsimin e mesëm të përgjithshëm në vitin 2011 arriti në 5 miliard e 267.7 milion lekë që zë 13.3% të buxhetit të MASH.

Në arsimin e mesëm të përgjithshëm, vazhdon konsolidimi i cilësisë së Maturës Shtetërore, e cila konsiston në 4 provime (2 provime të detyruara dhe 2 provime me zgjedhje). Për herë të

parë nxënësit që përfunduan me sukses Maturën Shtetërore gjatë vitit 2011 u pajisen me diplomë të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP); çdo diplomë përmban të njëjtin numër identifikues ID të nxënësit, që ka dhënë provimin e Maturës Shtetërore, dhe që regjistrohet në sistemin e të dhënave pranë AKP-së. Ky është një standard i ri cilësor që e përafron shumë Maturën shqiptare me atë të vendeve të tjera.

Sfida kryesore në arsimin e mesëm vazhdon të mbetet rritja e cilësisë në përputhje me standardet bashkëkohore dhe përafrimi i kurrikulës së klasës 10-12 në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.

Buxheti për arsimin e mesëm profesional në vitin 2011 është planifikuar 2 miliard e 315 milion lekë dhe zë 6% të buxhetit të MASH.

Në vitin 2011 -2012, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ndërmori një fushatë intensive informimi për prindërit dhe nxënësit përmes projektit të Këshillimit të Karrierës, spoteve televizive, fletëpalosjeve, ditëve të hapura të organizuara nga shkollat në bashkëpunim më drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Gjatë vitit shkollor 2011-2012 është ofruar për herë të parë programi me kohë të pjesshëm në arsimin e mesëm profesional për të gjithë ata që janë të punësuar në një profesion të caktuar dhe kërkojnë të formalizojnë kompetencat e tyre. Për çdo vit shkollor akordohen rreth 1600-1700 bursa për arsimin e mesëm profesional në 16 rrethe të vendit (kryesisht në degët bujqësi, pyje dhe ndërtim).

Modernizimi i arsimit profesional mbetet sfida kryesore në këtë sektor. Në vazhdim, synohet të ndërhyhet në të gjithë sistemin e arsimit profesional për të fuqizuar ofertën e arsimit profesional, në nivel të mesëm dhe post-të mesëm me degë të rëndësishme dhe profile teknike që kërkohen në tregun e punës dhe kështu rrisin nivelin e punësueshmërisë dhe të punësimit në Shqipëri.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/ nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji Nr. 7952 datë, 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” i ndryshuar. Ky ligj është i përafruar me Acquis Communitare si më poshtë vijon: Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Europian (2000/c, 364/01) datë 18.12.2000; Fletorja Zyrtare e Komuniteteve Europiane c 364/1 (celex no.12010p001); Rekomandimet e Parlamentit të Këshillit Europian i cili përcakton kompentencat for mësimin gjatë gjithë jetës, datë 18.12.2009 (2006/962/ec (celex no. 32006h0962);
- Ligji Nr. 10434, datë 23.06.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8872 datë 29.03.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i cili konsiston në modernizimin e sistemit të VET në Shqipëri, nëpërmjet sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë në institucionet arsimore profesionale. Ky Ligj ka përputhshmëri me këto dokumente të BE-së: Traktati i Lisbonës “Për funksionimin e BE”, Pjesa III, Titulli XII “Arsimi, Trajnimi Profesional dhe Rinia” OJ C 115 date

9.5.2008, p 120-1; Rekomandimi i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit (të BE) të datës 18 Qershor 2009 "Mbi Krijimin e një Sistemi Evropian Kreditesh për AFP (SEKAFP) OJ(2009/C 155/02); Konkluzionet e Këshillit (të BE) të 12 Majit 2009 mbi një kuadër strategjik për bashkëpunimin evropian në arsim dhe formim ('ET 2020') OJ(2009/C 119/02; Konkluzione të Këshillit (të BE) dhe përfaqësuesve të qeverive të Vendeve anëtare të mbledhur në Këshill (të BE) mbi prioritetet e të ardhmes për një bashkëpunim të përforcuar në AFP (21 Nëntor 2008) 16459/08 EDUC 278 SOC 736 MI 499; Konkluzione të Këshillit (të BE) dhe përfaqësuesve të qeverive të Vendeve anëtare të mbledhur në Këshill (të BE) mbi prioritetet e të ardhmes për një bashkëpunim të përforcuar në AFP (2006) OJ (2006/C 298/05 date 8.12.2006);

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 799 datë 22.07.2009 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të Arsimit Parauniveristar për periudhën 2009-2013";
- Rregullorja e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 957, datë 15.02.2011 "Për zhvillimin e provimeve të nivelit të parë dhe dytë në shkollat e Arsimit Profesional";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 321, datë 21.04.2011 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve";
- VKM nr. 1013, datë 10.12.2010 "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve";
- VKM nr. 78, datë 08.02.2006 "Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat" të ndryshuar (VKM Nr. 876 datë 03.11.2010);
- VKM Nr. 759, datë 15.09.2010 "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe të studentëve në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2010 - 2011";
- VKM nr. 67, datë 10.02.2010 "Për krijimin e Institutit të Zhvillimi të Arsimit";
- VKM Nr. 56, datë 03.02.2010 "Për Krijimin e Inspektoratit Kombëtar te Arsimit Parauniversitar".

Struktura institucionale

Funksionet politikëbërëse realizohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, aktorët përgjegjës për mbështetjen e zhvillimit të arsimit parauniversitar janë 3 drejtori si më poshtë dhe 4 institucione varësie:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Drejtoria e Edukimit Parauniversitar;
Drejtoria e E-Edukimit dhe Statistikës;
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal.

Institucione varësie

- Instituti i Zhvillimit të Arsimit;
- Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar;
- Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve;
- Agjencia Kombëtare e Provimeve.

Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) ka mision t'u ofrojë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve arsimore të të gjitha niveleve ekspertizë dhe këshillim me nivel të lartë profesional, të mbështetur në rezultatet e punës kërkimore-studimore dhe praktikës së

arsimit. Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) përbëhet nga:

- Drejtoria e Zhvillimit të Politikave Arsimore: bën studime dhe analiza për zbatimin e VKM-ve, Urdhrave, Udhëzimeve të MASH-it;
- Drejtoria e Kurrikulës, Standardeve dhe Kualifikimit: Kryen studime në fushën e hartimit dhe zhvillimit të kurrikulës dhe të trajnim/kualifikimit të mësuesve;
- Drejtoria e Metodologjisë dhe Teknologjisë në Mësimdhënie: Zhvillon punë kërkimore studimore si dhe ofron ekspertizë e këshillim për institucionet arsimore.

Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (IKAP) është institucion i posaçëm i inspektimit, monitorimit, vlerësimit e këshillimit të cilësisë së arsimit parauniversitar dhe funksionimit të strukturave menaxhuese të tij (shkolla, drejtori arsimore rajonale, zyra arsimore).

IKAP-i përbëhet nga:

- Drejtoria e Inspektimit të Kurrikulës dhe Cilësisë: Inspekton dhe vlerëson cilësinë e kurrikulës së zbatuar në arsimin parauniversitar;
- Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes Institucionale dhe Ligjshmërisë: Inspekton dhe vlerëson zbatimin e ligjshmërisë, drejtimin, menaxhimin dhe funksionimin e institucioneve të arsimit parauniversitar.

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve synon t'i japë një shtysë dhe mbështetje të fuqishme zhvillimit të AFP-së në Shqipëri, në përputhje me standardet evropiane. Agjencia synon të arrijë zhvillimin e AFP-së në lidhje me nevojat e teknologjisë moderne, tregun e punës dhe zhvillimit social të vendit; Sigurimin e partneritetit social në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AFP-së; Integrimin e arsimit, formimit dhe punës në këndvështrimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës; Zhvillimin e dimensionit evropian të AFP-së, duke siguruar një transparencë të kualifikimeve dhe përafrimit të kompetencave me tregun e përbashkët evropian.

Institucionet e përfshira në zhvillimin e Arsimit dhe Formimit Profesional janë:

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës si dhe institucione të varësisë: Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve me funksionet zbatuese zhvillimit të arsimit profesional, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Drejtoritë Arsimore Rajonale/Zyrat Arsimore dhe shkollat profesionale.
- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, dhe institucionet e varësisë së saj: Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe qendrat e formimit profesional.

Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) është një institucion i posaçëm për organizimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore, për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve të pranimit në shkollat e larta, si dhe të provimeve dhe ka një funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit dhe organizimit të Provimeve të Maturës dhe të Shtetit.

- Drejtoria e Vlerësimit: Organizon dhe përpunon të dhënat për: Provimet e Lirimit, Maturës Shtetërore dhe PISA.
- Drejtoria e Pranimeve: Harton dhe përpunon të dhënat për pranimet në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik.
- Drejtoria e Provimeve të Shtetit: Fokusohet në licencimin e profesioneve të rregulluara.

Masat legjislative afatshkurtra

- Projektligji "Për sistemin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë";
- Projektvendim për format, kriteret dhe kushtet për përfitimin e mbështetjes nga shteti të shoqërive tregtare të cilat pranojnë nxënësit e shkollave profesionale për të zhvilluar praktikën mësimore;
- Projektvendim për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe e sekretariatit teknik (neni 17, pika 4) neni 21, pika 4;
- Projektvendim për format dhe mënyrat e organizimit të veprimtarive ekonomike të institucioneve ofruese të arsimit dhe formimit profesional;
- Projektvendim"Për mënyrën e ushtrimit të funksioneve dhe të kompetencave të Këshillit të KSHK-së dhe të njësisë (sekretariatit)";
- Projektvendim "Për fondin e vënë në dispozicion të MASH për blerjen e librave për Diasporën";
- Udhëzimi i përbashkët i MASH me MPÇSSHB për funksionimin e bordeve të institucioneve ofruese të AFP.

Aktivitetet zbatuese

- Reforma e kurrikulës në arsimin bazë (1-9);
- Analiza e kurrikulës së re të gjimnazit;
- Kualifikimi i mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore për vitin 2012;
- Hartimi i programeve për praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit;
- Integrimi në procesin mësimor-edukativ i shtresave të margjinalizuara, në veçanti komunitetit rom dhe ballkano-egjiptian;
- Ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të "Planit kombëtar të aktiviteteve për braktisjen zero" dhe planit të veprimit për Dekadën e Përfshirjes Rome 2010-2015;
- Funksionimi i komiteteve ndërsektoriale kundër braktisjes fizike në rrethet pilot (Kukës, Tiranë Qytet, Tiranë Qark; Durrës; Berat; Korçë; Gjirokastër);
- Studimi i përvoja të huaja në lidhje me përfshirjen e kulturës rome në edukim;
- Hartimi i udhëzuesit për drejtuesit ,mësuesit për t'u lehtësuar atyre punën me fëmijët romë dhe me prindërit e këtyre fëmijëve;
- Monitorimi i zbatimit të procesit të maturës shtetërore, i provimeve të lirimit, i procesit të përzgjedhjes dhe shpërndarjes së teksteve shkollore;
- Monitorimi i procesit të praktikave profesionale të mësuesve të rinj.

Masat legjislative afatmesme

- VKM për miratimin e listës kombëtare të kualifikimeve profesionale;
- Udhëzimi i përbashkët i MASH me MPÇSSHB për funksionimin e qendrave shumë funksionale (i hartuar në zbatim të ligjit të AFP);
- Udhëzimi i përbashkët i MASH me MPÇSSHB për hyrjen, vijimin dhe transferimin nga një nivel/drejtim i AFP në një nivel/drejtim tjetër (i hartuar në zbatim të ligjit të AFP).

Aktivitetet zbatuese

- Përmbushja e standardeve ISO 9000 për menaxhimin e plotë të cilësisë;
- Integrimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në veprimtaritë e përditshme të institucioneve në arsimin parauniversitar;
- Bashkëpunimin me organizata homologe në vende të tjera të Evropës dhe më gjerë si p.sh. Rrjeti Global i UNESCO/BE, UNICEF, SAVE THE CHILDREN etj.
- Ngritja e kapaciteteve të IKAP-it me struktura rajonale të inspektimit;
- Inspektim i plotë i një institucioni arsimor parauniversitar si kopshte, shkollë, DAR/ZA të paktën njëherë në 3 vite, duke respektuar kështu standardet evropiane të inspektimit;
- Hartimi i plani të veprimit për zhvillimin e arsimit profesional 2012-2020;
- Ndërtimi i 5 shkollave të reja me fondet IPA 2008;
- Organizimi i qendrës shumëfunksionale në Kamëz mbështetur nga qeveria gjermane;
- Do vazhdojë zbatimi i projekteve të financuar nga donatorët e huaj përkatësisht:
    - Projekti "Programi në Mbështetje të Arsimit dhe Trajnimit Profesional në Shqipëri" (AlbVET) Faza III për periudhën 1 korrik 2011 – 30 qershor 2014, financuar nga Qeveria Zvicerane në kuadër të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane.
    - Projekti " Forcimi i reformës në sistemin e arsimimit profesional në Shqiperi AL BIZ, për periudhën 16.11.2009 – 15.11.2013. Ky projekt mbeshtetet nga Qeveria Austriake në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Kultur Kontakt Austria
    - Projekti "Programi në Mbështetje të Arsimit dhe Trajnimit Profesional me fokus në zonën verilindore të Shqipërisë" për periudhën 2011 –2014, e financuar nga Qeveria Gjermane në kuadër të Marrëveshjes së Zbatimit midis Deutsche Gesellschaft fuer Technische Zusammenarbeit (GTZ) {sot GIZ} dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Shqipërisë si dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta .
- Pajisja e shkollave me laboratorë shkencorë, virtual; pajisjes së shkollave me mjete për praktikat profesionale; ndërtimi i shkollave të reja profesionale në kuadër të projektit IPA 2011;
- Akordimi 1700 bursave te reja, sidomos për ato në degët Bujqësi, Blegtori e Ndërtim, për çdo vit te PBA;
- Akreditimi i 10 shkollave sipas standardeve AKAFPK,
- Rishikimi i 50 skelet-kurrikulave të kualifikimit profesional për klasat 1, 2, 3, 4; 6.

Arsimi i lartë

Objektivi Politik

Politika e Qeverisë në fushën e arsimit të lartë synon ekselencën dhe cilësinë në arsimin e lartë, pjesëmarrje të gjerë, diversitet të njohurive, kompetencave dhe aftësive të domosdoshme për të mbështetur prosperitetin e aspiruar dhe integrimin evropian të Shqipërisë. Fokusi kryesor i politikave në arsimin e lartë do të jetë sigurimi i cilësisë institucionale, cilësisë në mësimdhënie dhe në aktivitete kërkimore, forcimi i lidhjes mes edukimit dhe tregut të punës, diversifikim të instrumenteve të financimit të arsimit të lartë si dhe forcimi institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) nëpërmjet rritjes së autonomisë, llogaridhënies publike si dhe qeverisjes dhe menaxhimit të reformuar.

Ky objektiv politik mbështetet në "Strategjinë Kombëtare për Arsimin e Lartë 2008-2013" dhe "Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013". Objekti i vendosur realizon një përputhshmëri të trajektores së zhvillimit të arsimit të lartë shqiptar me atë të hapësirës evropiane të përcaktuar në strategjinë evropiane "Europe Strategy 2020" si dhe parashikimeve të caktuara në agjendën e Komisionit Evropian për "Modernizimin e Arsimit të Lartë" - Shtator 2011.
Këto objektiva do të realizohen nëpërmjet:

- Sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në nivel institucional dhe programesh studimi mbi bazën e kritereve e standardeve kombëtare e ndërkombëtare si dhe në përputhje me kërkesat e procesit të Bolonjës nëpërmjet forcimit të sistemit institucional të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe sistemeve të kontrollit që kanë lidhje me të;
- Zgjerimit të kapaciteteve për t'iu përgjigjur nevojave në rritje të shoqërisë për kualifikim;
- Integrimit të mësimdhënies me kërkimin shkencor duke ofruar studime të thelluara apo aplikative, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe në mbështetje të zhvillimit ekonomik e social të vendit;
- Thellimit të autonomisë institucionale dhe financiare në IAL;
- Sigurimit të kualifikimit të vazhdueshëm profesional bazuar në konceptin e të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- Ngritjes së nivelit cilësor të kërkimeve shkencore në universitete duke rritur konkurrencën e tij brenda programeve evropiane e rajonale të kërkimit;
- Nxitjes dhe mbështetjes së studentëve ekselentë që realizojnë studimet Bachelor, Master, Doktoratë dhe Postdoktoratë, jashtë vendit, në mbështetje të programit të Fondit të Ekselencës.
- Zgjerimit të sistemit të arsimimit në këtë sektor, në mënyrë që të mundësohet arritja e treguesve evropianë të aksesit dhe shkollimit terciar të popullsisë;
- Sigurimit të shumëllojshmërisë së ofertave të formimit, në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit;
- Përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe të përvetësimit të dijeve në sistemin e arsimit të lartë nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe të kulturës së cilësisë;
- Përmirësimit të mekanizmave të qeverisjes nëpërmjet zhvillimit të autonomisë së

IAL-ve, përkundrejt rritjes së cilësisë së menaxhimit me llogaridhënie dhe transparencë;

- Diversifikimin e burimeve të financimit, në mënyrë që të optimizohet investimi publik dhe privat në sistem në funksion të arritjes së objektivave të përgjithshme;
- Rritjen e kapaciteteve sasiore dhe cilësore në Vlerësim dhe Akreditim duke mundësuar që ekspertiza ndërkombëtare të bëhet pjesë normale e sistemit të vlerësimit dhe akreditimit. Përfshirja e studentëve si anëtarë të përhershëm të grupeve të vlerësimit të jashtëm do të institucionalizohet.
- Krijimin pranë të gjitha IAL publike dhe private e Njësive të Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJBSC), si mekanizëm i krijimit të kulturës së sigurimit të cilësisë dhe rritjes së transparencës dhe informimit të publikut mbi aktivitetin akademik të IAL-ve;
- Arritjen e marrëveshjeve të njohjeve reciproke midis sistemeve kombëtare të akreditimit mes vendeve të rajonit dhe më gjerë, për të lehtësuar transferimin e studentëve dhe njohjen respektive akademike.

Situata aktuale

Zhvillimet aktuale në arsimin e lartë shënojnë realizimin e dy prej sfidave të zhvillimit të arsimit të lartë; (i) përmirësimin e aksesit dhe pjesëmarrjes së të rinjve në arsimin e lartë (ii) zbatimin e strukturës së reformuar treciklore të studimeve, në përputhje me procesin e Bolonjës, në të gjitha institucionet e arsimit të lartë.

Përmirësimi i kapaciteteve në institucionet publike të arsimit të lartë, zhvillimi i arsimit të lartë privat, liberalizimi i kuotave të pranimeve në arsimin e lartë si dhe reforma e Maturës Shtetërore kanë qenë faktorët kryesorë në përmirësimit e treguesve të aksesit dhe dyfishimin e numrit të studenteve në arsimin universitar. Arsimi i lartë në Shqipëri, përfaqësohet nga 11 institucione të arsimit të lartë publik dhe Qendra e Studimeve Albanologjike, 31 institucione të arsimit të lartë privat. Edukimin tercial në Shqipëri e ndjekin 134 mijë studentë (në të tre ciklet, me kohë të plotë dhe të pjesshme), numër që për një periudhë kohore 5 vjeçare është rritur rreth 2.5 herë. Aktualisht numri i studentëve të regjistruar në Institucionet e Arsimit të Lartë Privat përfaqëson 12% të numrit total të studentëve.

Zbatimi i plotë i procesit të Bolonjës, përpjekjet për të afruar edukimin me tregun e punës kanë sjellë reformim të thellë të kurrikulës universitare ekzistuese dhe kanë shtuar larminë e programeve të reja bashkëkohore. Aktualisht sistemi i arsimit të lartë publik ofron një numër të madh programesh, nga të cilat rreth 173 janë programe të reja në tre ciklet e studimit janë hapur në vitin akademik 2011-2012. Këto programe janë të orientuara drejt Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, në përputhje me zhvillimet e tregut të punës vendas dhe më gjerë.

Aktualisht të gjitha institucionet e arsimit të lartë përgatisin suplementin e diplomës dhe programet e studimit janë të organizuara në kredite (ECTS). Studentët e diplomuar pajisen me diplomë (Udhëzimi Nr. 5, datë 18.02.2009, për "Përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë") dhe suplementin e diplomës (Udhëzim Nr. 7, datë 18.04.2009 për "Suplementin e Diplomës").

Profesorati në institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme) vlerësohet në 1,128 profesorë, 2,114 lektorë dhe 2,614 ndihmës lektorë. Kërkimi bazë në nivel departamenti u inkurajua me mbështetjen e fondeve publike, 8% e financimit publik të arsimit të lartë shkoi për të mbështetur kërkimin akademik bazë. Fondet për kërkim shkencor mbështetën 53 projekte kërkimore si dhe instalimin e 32 laboratorëve kërkimorë shkencorë. Është rritur mobiliteti i jashtëm i studentëve dhe personelit akademik nëpërmjet Fondit të Ekselencës. Qeveria Shqiptare, nëpërmjet Fondit të Ekselencës i cili administrohet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, po kontribuon një shumë prej 100 milionë lekë (1 milion USD) në vit për kryerjen e studimeve të plota të Doktoratës, Postdoktoratës, Master dhe Bachelor të studentëve dhe shkencëtarëve shqiptarë të rinj në universitete perëndimore prestigjioze.

Gjatë 2010-2011 është hartuar dhe diskutuar gjerësisht plani kuadër i reformës në arsimin e lartë, një platformë ndryshimesh rrënjësorë në sistem që do të ketë ndikime të ndjeshme në vetë konceptin e universitetit. Reforma kuadër e arsimit të lartë promovon cilësinë dhe forcon mekanizmat e sigurimit të saj, rrit autonominë e universiteteve publike duke nxitur partneritetin publik-privat. Kjo reformë planifikohet të implementohet duke filluar nga viti akademik 2013-2014 në institucionet e arsimit të lartë publik në kuadër të programin Cilësi dhe Barazi në Arsim.

Në kuadër të reformës në arsimin e lartë janë realizuar studime të hollësishme mbi modelin e financimit, kredinë studentore, procesin akademik, instrumentet e sigurimit të cilësisë, kapaciteteve menaxheriale të institucioneve të arsimit të lartë dhe modernizimit të procesit të mësimdhënies.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka organizuar diskutimin e gjerë publik me gjithë grupet e interesit të "Planit Kuadër të Reformave në Arsimin e Lartë". Gjatë vitit 2011, janë zhvilluar aktivitete të rëndësishme si takime dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare me ekspertë dhe konsulentë të huaj në arsimin e lartë të cilat kanë mundësuar shkëmbimin e mendimeve dhe rekomandimeve mbi të gjitha aspektet e reformës mbi bazën e dokumenteve strategjikë të hartuar.

Në zbatim të detyrimeve të Ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është miratuar rregullorja e provimeve të shtetit dhe paketa e akteve nënligjore, që rregullon procesin e ngritjes së komisioneve për hartimin e katalogut të pyetjeve, komisioneve të provimeve të shtetit, tarifave dhe gjithë elementët përbërës të dhënies së provimit. Gjatë periudhës janar-shkurt 2012, Agjencia Kombëtare e Provimeve organizoi Provimin e Shtetit për 6 profesionet e para të rregulluara duke siguruar një besueshmëri të lartë tek publiku. Për herë të parë në Shqipëri u zhvillua dhe implementua një standard i mirëfilltë ndërkombëtar i provimit tërësisht digjital, me zero korrupsion dhe transparencë maksimale.

Ndërkohë, në Agjencinë Kombëtare të Provimeve po ndërtohet Baza Elektronike e të dhënave të arsimit të lartë, që përfshin Regjistrin Kombëtar të Studentëve, ku çdo student i regjistruar në çdo shkollë të lartë, publike apo private, që nga viti akademik 2011-2012, në të

tri ciklet e studimeve universitare do të ketë numrin kombëtar të identifikimit, përveç numrit që ka marrë në universitetin ku studion.

Në kuadër të Programit "Cilësi dhe Barazi në Arsim", janë kontraktuar gjatë periudhës 2009-2011, kompania gjermane DAAD me qëllim vlerësimin e programeve të studimit në universitetet shqiptare në përputhje me direktivat e Kartës së Bolonjës si dhe Qendra për Zhvillimin e Arsimit të Lartë (Center for Higher Education Development – CHE) e cila në bashkëpunim me Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) finalizuan Projektin e Renditjes së Institucioneve shqiptare të arsimit të lartë. Qëllimi kryesor i raportit të renditjes, ishte sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë, informimi më i mirë i studentëve si dhe krijimi i kapaciteteve për ngritjen e sistemit të cilësisë pranë çdo IAL-je

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 424, datë 02.06.2010 "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë" ka rregulluar më tej strukturën organizative të APAAL duke krijuar sektorin e ri të Analizave dhe Statistikave në këtë agjenci. Ndryshimi i numrit të anëtarëve të Këshillit të Akreditimit me dy ekspertë të huaj të propozuar nga agjencitë ndërkombëtare të akreditimit është gjithashtu një tregues tjetër kryesor për të orientuar proceset e vlerësimit dhe akreditimi nga standardet më të mira evropiane e më gjerë me qëllim arritjen e rezultateve sa më realiste për vendin tonë. Agjencia është duke ngritur sistemin digjital të menaxhimit, si mekanizëm që do të lehtësojë procedurat e vlerësimit dhe akreditimit dhe do të shërbejë për fuqizimin e bashkëpunimit dhe mirinformimit me grupet e interesit dhe publikun e gjerë.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Të gjitha aktet e tjera nënligjore kanë dalë në bazë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar, i cili është në përputhje me: Traktati i Komuniteteve Evropiane (TKE), Kapitulli III "Arsimi, Trajnimi Profesional dhe Rinia"; Rekomandimi Nr. 2008/C111 të datës 23 prill 2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit "Mbi krijimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës" OJ C 111 , 06/05/2008 P. 0001 – 0007; Direktiva 2005/36/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të BE të datës 7 shtator 2005 "Mbi njohjen e Kualifikimeve Profesionale". OJ L 255, 30.9.2005 p. 28–32; Vendimi Nr. 2241/2004/EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE të datës 15 dhjetor 2004 "Mbi një Kuadër të vetëm Komunitar për transparencën e kualifikimeve dhe të kompetencave (Europass)" OJ L 390, 31.12.2004, p. 6–20; Deklarata e Bolonjës miratuar në datën 19 Qershor 1999, Komunikatat e Pragës 19 maj 2001, Berlinit 19 shtator 2003, Bergenit e datës 19-20 maj 2005, Londrës 18 maj 2007, Lëvenit 28 – 29 prill 2009; Deklarata e Vjenës – Budapestit të datës 12 mars 2010.

Aktet ligjore/ nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar me Ligjin Nr 9832, datë 12.11.2007, i ndryshuar me Ligjin Nr. 10307, datë 22.7.2010; i ndryshuar me Ligjin Nr. 10493, datë 15.12.2011;
- Ligji Nr. 10247, datë 04.03.2010 "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve", i cili përafron plotësisht "Kornizën e Kualifikimeve në Sistemin e Arsimit të Lartë Evropian", miratuar nga Ministrat përgjegjës të arsimit të lartë evropian në

Konferencën e Bergenit, datë 20.05.2005;

- Ligji nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 862 Datë 10.11.2011 "Për përcaktimin e tarifave për provimin e shtetit";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 649 date 14.09.2011 "Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve, apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara";
- Vendim Nr. 424, datë 28.04.2010 "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", i amenduar me Vendim Nr. 368, datë 14.04.2011;
- Udhëzimi Nr. 45 datë 19.12.2011 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit" i ndryshuar;
- Udhëzim Nr. 11, datë 28.02.2011 "Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, programeve të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës";
- Udhëzim Nr. 4, datë 22.01.2008 "Për Hapjen, Mbylljen dhe Riorganizimin e Programeve të Studimit"; Udhëzim Nr. 5, datë 22.01.2008 "Për Përcaktimin e standardeve akademike të nevojshme për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës si dhe elementeve bazë sipas të cilave institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse";
- Udhëzim Nr. 14 datë 03.04.2008 "Për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë";
- Udhëzim Nr. 15, datë 04.04.2008 "Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë";

Struktura institucionale

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e arsimit të lartë, është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës: Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit; Shkencor; Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat;
- Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) dhe Këshilli i Akreditimit;
- Agjencia Kombëtare e Provimeve;
- Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës;
- Institucionet Publike dhe Institucionet Private të Arsimit të Lartë.

Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor si dhe Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit të Lartë Privat pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, janë dy njësitë bazë që mbështesin politikat në lidhje me objektivat kryesore të arsimit të lartë në vend duke mbështetur, Institucionet Publike dhe Institucionet Private të Arsimit të Lartë në përputhje me Strategjinë e Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim në bashkëpunim edhe me Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, si organ këshillimor pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Institucionet e përfshira në sigurimin e jashtëm të cilësisë janë APAAL dhe Këshilli i Akreditimit.

Këshilli i Akreditimit funksionon pranë Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe organizohet sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe në përputhje me Vendimin Nr. 424, datë 28.04.2010 "Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", i amenduar me Vendim Nr. 368, datë 14.04.2011;

Numri i anëtarëve të Këshillit të Akreditimit është 11 nga të cilët pesë anëtarë janë propozuar nga institucionet e arsimit të lartë, 3 ekspertë të fushës, dy nga të cilët janë të huaj, të propozuar nga agjencitë ndërkombëtare të akreditimit, dhe një ekspert, përfaqësues i sektorit privat, një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, një përfaqësues nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës, dhe një student i propozuar nga Këshilli Kombëtar Studentor. Ministri i Arsimit dhe Shkencës emëron anëtarët e Këshillit të Akreditimit nga kandidatët e propozuar nga palët e përfaqësuar.

Kryetari i Këshillit të Akreditimit përzgjidhet nga kandidatët e propozuar nga ky Këshill. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Mbledhja e Këshillit të Akreditimit zhvillohet, kur marrin pjesë jo më pak se 8 (tetë) anëtarë të tij. Ajo nuk zhvillohet nëse dy ekspertët e huaj nuk janë të pranishëm.

Vendimet e Këshillit të Akreditimit merren me shumicë të cilësuar, prej ¾ të të gjithë anëtarëve

APAAL, në bazë të Vendimit të KM nr. 424, datë 02.06.2010 "Për miratimin e strukturës së Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë", është agjencia e ngarkuar me vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin e IAL në vend. Organika aktuale e institucionit përbëhet nga:

- Drejtori i APAAL;
- Sektori i Promovimit dhe Vlerësimit të Cilësisë;
- Sektori i Statistikave dhe Analizave;
- Sektori i Shërbimeve dhe Publikimit.

Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) përbëhet (për më shumë informacion për AKP referoju tek Nënkapitulli 1 "Arsimi Parauniversitar") nga:

- Drejtori i Përgjithshëm;
- Drejtoria e Vlerësimit: Organizon dhe përpunon të dhënat për: Provimet e Lirimit, Maturës Shtetërore dhe PISA;
- Drejtoria e Pranimeve: Harton dhe përpunon të dhënat për pranimet në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik;
- Drejtoria e Provimeve të Shtetit: Fokusohet në licencimin e profesioneve të

rregulluara.

Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës është organ këshillimor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe i Këshillit të Ministrave për politikat e zhvillimit në arsimin e lartë dhe shkencë.

Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës formulon mendime dhe propozime për:

- hartimin e strategjive e programeve kombëtare për arsimin e lartë e kërkimin shkencor, drejtimet e politikave respektive dhe përgatitjen e akteve ligjore;
- fushat parësore dhe programet e kërkimit shkencor e zhvillimit teknologjik;
- projektbuxhetin e parashikuar për arsimin e lartë dhe shkencën dhe metodologjinë e shpërndarjes së tij;
- standardet për vlerësimin dhe akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë ose programeve të studimeve;
- kriteret për dhënien e titujve dhe gradës shkencore, së bashku me Komisionin e Vlerësimit të Titujve Akademikë;
- zhvillimin e politikave të veçanta, të kërkuara nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe rrugët e financimit të tyre;
- çdo problem tjetër që kërkohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës etj.

Institucionet Publike dhe Institucionet Private të Arsimit të Lartë

Arsimi i lartë ofrohet nga institucionet e arsimit të lartë, që krijohen, funksionojnë dhe akreditohen në përputhje me këtë ligj. Ato synojnë:

- të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve; të zhvillojë dhe të çojë përpara artet, edukimin fizik dhe sportet; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj;
- të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë të gjithë jetës;
- të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;
- të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

Masa ligjore afatshkurtra

- Rregullore e Ministrit te Arsimit dhe Shkencës për Standardet e Kërkimit në Arsimin e Lartë;
- Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Projektvendim për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në vitin akademik 2012-2013 në studimet me kohë të plotë për ciklin e parë të studimeve;
- Projektvendim për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në vitin akademik 2012-2013 në studimet me kohë të plotë për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional dhe Master Shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë";
- Projektvendim për kuotat e pranimit në vitin akademik 2012-2013 në studimet me kohë të pjesshme cikli e parë Bachelor në institucionet publike të arsimit të lartë";
- Projektvendim për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në vitin akademik 2012-

2013 në studimet me kohë të plotë për ciklin e tretë të studimeve doktoratë në institucionet publike të arsimit të lartë;

- Projektvendim "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për kualifikimin, shkencor, pedagogjik të personelit akademik";
- Projektvendim për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në vitin akademik 2012-2013 në studimet e ciklit të tretë, të studimeve specializuese Afatgjata ne Fakultetin e Mjekësisë te Universitetit të Tiranës.

Aktivitete zbatuese afatshkurtra

- Konsolidimi i kuadrit institucional përgjegjës për zbatimin e fazës përgatitore të implementimit të reformës financiare të arsimit të lartë në Kryeministri, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Financave dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë;
- Ndërtimi dhe bërja operacionale e sistemit të informacionit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë në funksion të implementimit të skemës së financimit;
- Zhvillimi i udhëzuesve dhe shpjeguesve të detajuar për Institucionet e Arsimit të Lartë mbi parametrat e formulës së financimit dhe efektet e tyre në pranimet e studentëve dhe të ardhurat e pritshme të universitetit;
- Zhvillimi i fushatave sensibilizuese për grupet e interesit mbi reformën e financimit të arsimit të lartë (studentët, prindër, punëdhënësit, institucionet e arsimit të lartë, politikbërësit);
- Ngritja e Institucionit qe do të menaxhojë kredinë studentore, formalizimi i rolit, procedurave dhe ndërtimi i infrastrukturës të domosdoshme për të bërë operativ këtë sistem;
- Reformimi i qeverisjes dhe menaxhimit të universiteteve;
- Rritja e transparencës, komunikimit të universiteteve publike me publikun, si mjet i sigurimit te cilësisë dhe llogaridhënies. Universiteteve publike do t'u vendosen standarde për raportimit vjetore dhe guidat e studentëve potenciale;
- Hapja dhe miratimi i programeve të studimit në dy ose tre profile të ndryshme si dhe programeve profesionale të lartë, të cilat shikohen si mundësi të reja të punësimit të nesërm të studentëve në tregun rajonal të punës, por edhe të përmirësimit dhe balancës midis profesioneve të rregulluara dhe atyre të reja;
- Konsolidimi i Instrumentit të Provimit të Shtetit, si mekanizëm i sigurimit të cilësisë të arsimit të lartë;
- Përcaktimi dhe përmirësimi i kritereve dhe procedurave për kualifikimin, shkencor e pedagogjik, të personelit akademik;
- Ndërtimi i një mekanizmi nxitës dhe mbështetës për universitete publike që duan të bëjnë një akreditim test, përpara akreditimit formal institucional;
- Realizimi i studimeve dhe takimeve për përmirësimin e strukturave akademike dhe rritjen e kapaciteteve të Institucioneve të AL;
- Vlerësimi i Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë nga Agjencia Evropiane e Sigurimit të Cilësisë ENQA, sipas kërkesave të Bolonjës.

Masat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat ligjore të mëposhtme:

- Projekt VKM "Për Vlerësimin dhe akreditimin sipas standardeve të Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA);
- Projekt VKM për miratimin e përshkruesve sektorialë të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

Aktivitete zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet zbatuese të mëposhtme:

- Ri-vlerësimi i efekteve afatshkurtra të reformës financiare në arsimin e lartë publik, dhe konsolidimi i skemës së financimit të aplikueshme në të gjithë sferën e arsimit të lartë. Rivlerësimi synon të evidentojë efektet pozitive dhe negative të aplikimit të këtij mekanizmi dhe të ndërtojë vazhdimësinë e reformave në arsimin e lartë në përputhje me objektivat strategjike dhe zhvillimin e arsimit të lartë;
- Ri-vlerësimi i standardeve dhe cilësisë në sistemin e arsimit të lartë, mbi bazën e treguesve të cilësisë të bëra transparent për IAL dhe publikun;
- Hartimi i marrëveshjeve kontraktuale me universitet publike, të bazuara në tregues të performancës akademike dhe menaxheriale;
- Zhvillimi i kredisë studentore, në funksion të aksesit të gjerë dhe qëndrueshmërisë së skemës së financimit;
- Forcimi i institucioneve të sigurimit të cilësisë (agjencisë të akreditimit dhe mekanizmave të brendshme sigurimit të cilësisë në IAL) dhe akreditim i plotë institucional dhe programor në gjithë sistemin, publik dhe privat;
- Përafrimi i standardeve në fushat e studimeve të Arsimit të Lartë publik dhe privat me standardet evropiane;
- Regjistrimi i Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) në Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë (EQAR);
- Rritja e mobilitetit të studenteve dhe profesoratit të IAL-ve (trefishohet numri i studentëve dhe profesorëve që angazhohen në programe mobiliteti);
- Rritja e ndjeshme e kapaciteteve të kërkimit dhe aktivitetit kërkimor shkencor në IAL (dyfishohet numri i projekteve kërkimore të financuara nga fondet evropiane të kërkimit);
- Fuqizim të mekanizmit financues "grant kompetitiv" dhe shtrirja e tij në financimin e projekteve infrastrukturore,kërkim shkencor, hapjen e programeve të reja të studimit në përgjigje të kërkesave të zhvillimit rajonal dhe tregut të punës;
- Mbështetja e studentëve ekselentë me qëllim ngritjen e kapaciteteve të reja në akademinë universitare;
- Promovimi i modeleve më të mira menaxheriale në universitet publike, forcimi i autonomisë dhe standardeve të llogaridhënies dhe transparencës ndaj publikut.
- Inkurajimit të skemave të të mësuarit gjatë gjithë jetës;

Implikimet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015

Kostot totale e vlerësuar	1.346.211.000	1.167.086.000	1.195.136.000	1.224.586.000
Mbulohen nga buxheti i shtetit	1.146.211.000	1.167.086.000	1.195.136.000	1.224.586.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	200.000.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.26.2. KULTURA

Rinia

Objektivi strategjik

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS) udhëheq Strategjinë Kombëtare të Rinisë dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë 2007-2013, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 782, datë 16.11.2006. Kjo strategji është ndërsektoriale, afatgjatë dhe përfshin politika të gjithanshme në fushën e rinisë si dhe fokusohet në bashkëpunimin me partnerë dhe organizatat rinore.

Objektivat e kësaj strategjie janë mbështetur edhe në instrumentin mbështetës të politikave për rininë, programi me titull "Rinia në Veprim" për periudhën 2007-2013, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Parlamentit Evropian Nr. 1719, 2006, botuar në Gazetën zyrtare më 24.11.2006 L 327/30, CODEX 32008D1349.

Strategjia Kombëtare e Rinisë është e ndarë në këto kapituj: Përfaqësimi dhe Pjesëmarrja Rinore, Të rinjtë dhe Ekonomia, Shëndeti dhe Mbrojtja Sociale, Rekreacioni Rinor dhe Koha e Lirë, Të rinjtë shqiptarë-Qytetarët e rinj Evropianë, (Secili prej kapitujve shoqërohet me programe specifike në Planin Kombëtar të Veprimit Rinorë).

Analiza e situatës aktuale

Bashkëpunimi më përfaqësinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (ONE UN) - MTKRS në bashkëpunim me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë, (UNFPA) ka realizuar projektin me vlere 8.000.000 lekë mbi "Promovimin e një jete të shëndetshme përmes pjesëmarrjes së vetë të rinjve". Projekti ka mbështetur MTKRS-në për implementimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar të Veprimit të rinisë 2007 – 2013, përmes kurseve të trajnimit, zhvillimit të fushatave sensibilizuese me pjesëmarrjen e gjerë të të rinjve, forcimin e bashkëpunimit dhe partneritetit me Ministritë e linjës dhe mbështetjen organizatave që punojnë me të rinjtë dhe për të rinjtë.

Mbështetja e Projekteve Rinore me qëllim promovimin e nismave rinore dhe zhvillimin i një sektori të qëndrueshëm të OJF-ve rinore, me fokus pjesëmarrjen dhe angazhimi e të rinjve në jetën publike, punësimi (nxitja drejt kreativitetit dhe zhvillimit të karrierës), shëndeti, vullnetarizmi dhe puna e të rinjve, përfshirja sociale, rekreacioni rinor. Bashkëpunimi dhe

mbështetja OJF-ve rinore është një nevojë e domosdoshme për përmirësimin e rolit të këtyre organizmave të cilët duke u konsideruar si partnerë qeveritarë shërbejnë si "përfaqësues" të pazëvendësueshëm të interesave të të rinjve.

Në kuadër të Programit të Kombeve të Bashkuara (UN) "Youth Employment and Migration" është hartuar Plani Kombëtar i Aksionit për Punësimin e të Rinjve për vitet 2010-2013 , si rezultat i punës së politikëbërësve në ministritë e linjës. Plani përvijohet në katër objektiva strategjikë si dhe në një sërë çështjesh të rëndësishme që duhet të ndiqen për të mbështetur punësimin e plotë, të frytshëm dhe në përputhje me zgjedhjet e vetë të rinjve.

MTKRS në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, në Nëntor 2011, në kuadër të Raportit të Rishikimit të Politikave Rinore nga KE, ka zhvilluar një kurs trajnimi ndërkombëtar mbi "Pjesëmarrjen dhe Politikat Rinore në Shqipëri". Qëllimi i këtij aktiviteti ishte prezantimi i modeleve më të mira për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve, si dhe inkurajimin e të rinjve për tu përfshirë më shumë në proceset demokratike, në nivelin rajonal kombëtar dhe ndërkombëtar

Mbështetja dhe zhvillimi i vazhdueshëm i programeve të intership-it me qëllim krijimin e mundësive për studentët që studiojnë jashtë vendit, për t'u integruar në tregun e punës dhe zhvillimin e karrierës në Shqipëri. Zhvillimi i Panaireve te punësimit rinor, të cilat ndihmojnë në lançimin e vendeve të reja të punës nga administrata publike dhe biznesi duke bërë të mundur rritjen e aksesit të informacionit tek të rinjtë.

Këta objektiva do të realizohen nëpërmjet:

- Programeve trajnuese për rininë "Si të nisësh një biznes ose si të hartosh një plan biznesi", për të rritur kapacitetin e tyre në këtë drejtim;
- Studimin e nevojave të tregut për mundësi punësimi;
- Realizimin e seminare informuese, për organizatat rinore në bashkëpunim me SALTO (Qendra Burimore për Evropën Juglindore) me qëllim prezantimin dhe promovimin programit komisionit evropian "Youth in Action-Rinia në Veprim";
- Organizimin e sesioneve informuese që kanë ndikuar në rritjen e mundësivë të rinjve, grupeve rinore, organizatave rinore dhe të gjithë të interesuarve të jenë pjesë e mbështetjeve financiare të ofruara nga programi;
- Ndërmarrjen e fushatave sensibilizuese mbi krijimin e Këshillave Rinorë, Parlamentet Rinore, forumet rinore me qëllim pjesëmarrjen e suksesshme e të rinjve në çështjet lokale dhe rajonale.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2007-2013, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 782, datë 16.11.2006.

Struktura institucionale

Drejtoria e Politikave Rinore (DPR) në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, është strukturë politikëbërëse që zhvillon dhe administron politikat kombëtare në fushën e rinisë mbështetur dhe në Strategjinë e Rinisë. Prioritet e kësaj drejtorie fokusohen në forcimin e srtatusit social ekonomik, përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve si dhe rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimarrje dhe në jetën publike.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Organizimi i Aktivitete sensibilizuese dhe edukuese mbi promovimin e një jete të shëndetshme në 12 Prefekturat e vendit duke pasur si objektiv kryesor ngritjen dhe forcimin e grupeve të edukatorëve bashkëmoshatarë, krijimin dhe forcimin e rrjeteve të organizatave rinore që ofrojnë shërbime në fushën e shëndetit si dhe rritjen e eksesit ndaj informacionit mbi planifikim familjar, shëndetin riprodhues dhe shërbimet shëndetësore.
- Zhvillimi i programeve të trajnimit mbi pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje dhe forcimin e kapaciteteve rinore. Aktivitete të tilla synojnë nxitjen e përfshirjes së të rinjve në proceset demokratike, në nivelin rajonal kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe zhvillimin e një qytetarie aktive duke rritur pjesëmarrjen e të rinjve në jetën publike dhe vendimmarrje.
- Në kuadër të projektit "Promovimi i një jete të shëndetshme përmes pjesëmarrjes së vetë të rinjve" MTKRS do zhvillojë aktivitetet e parashikuara për implementimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar të Veprimit të rinisë 2007 – 2013, përmes kurseve të trajnimit, zhvillimit të fushatave sensibilizuese me pjesëmarrjen e gjerë të të rinjve, forcimin e bashkëpunimit dhe partneritetit me ministritë e linjës dhe mbështetjen e organizatave që punojnë me të rinjtë dhe për të rinjtë.
- Krijimi i mundësive rekreative për të rinjtë në Shqipëri: Mbështetja e projekteve artistike, kulturore e sportive të të rinjve, mbështetja dhe nxitja e OJF-ve për iniciativat dhe punën rinore dhe krijimi i klubeve artistike/kulturore/sportive në shkolla për një jetë më aktive të të rinjve në këto mjedise.
- Rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, me synim rritjen e partneriteteve midis organizatave rinore dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve në programe komunitare dhe ndër-rajonale.
- Organizimi i Panaireve të Punës do të ndihmojë në lancimin e vendeve të reja të punës nga administrata publike dhe nga sektori privat, duke krijuar mundësinë e integrimit në tregun e punës.

Masat ligjore afatmesme

Miratimi i ligjit për Rininë, i cili do të ketë si qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimit të statusit të tyre përmes mbështetjes së iniciativave rinore, rritjen e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën publike dhe në proceset e vendimmarrjes. Ky ligj do të përafrohet me një komunikim të Komisionit mbi Strategjinë e BE-së për rininë, Investimi dhe dhënia e mundësisë, një metode e hapur koordinimi për të adresuar sfidat dhe mundësitë e rinisë (27.4.2009SEC/2009/0545).

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Fuqizimi i kapaciteteve rinore duke bërë te mundur rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje dhe në jetën publike;
- Ofrimi i informacioneve të dobishme për të rinjtë shqiptar që kthehen nga studimet jashtë Shqipërisë, në kuadër të programit "Brain Gain".
- Realizimi i programeve të punësimit sezonal;
- Trajnimin e të rinjve për çështjet që lidhen me sipërmarrjen rinore;
- Mbështetja e Projekteve Rinore në kuadër të programeve kuadër;
- Mbështetje për projektet për nxitjen e punësimit të të rinjve, veçanërisht për të rinjtë që i nënshtrohen rrezikut të përjashtimit social.

Arti, Libri dhe Bibliotekat

Objektivi strategjik

Në fushën e artit prioritet është nxitja dhe zhvillimi i industrisë kulturore turistike në vend, lidhur ngushtë me vënien në funksion të trashëgimisë kulturore kombëtare, forcimin e identitetit kombëtar, nxitjen dhe promovimin e artit dhe kulturës.

Në fushën e Librit dhe Bibliotekave një ndër prioritetet bazë mbetet, respektimim i së drejtës kushtetuese të shtetasve për informim dhe formim nëpërmjet kulturës së shkruar si vlerë themelore në kulturën dhe identitetin e një kombi, si edhe mbrojtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i infrastukturës dhe kushteve të shërbimit në institucionet e ruajtjes së kujtesës kombëtare.

Analiza e situatës aktuale

Arti dhe Kultura përbën një nga fushat me impakt më të fortë në zhvillimin demokratik të vendit si dhe riafirmimit të identitetit kulturor në rajon dhe Evropë.

Është bërë një rivlerësim i përgjithshëm i kuadrit ligjor aktual të vendit për fushat përkatëse, të nivelit të harmonizimit me legjislacionin evropian, të kuadrit institucional për përmirësimin e kapaciteteve institucionale dhe infrastrukturore në zbatim të objektivave dhe pikësynimeve strategjike për vitet në vazhdim.

Ka përfunduar hartimi i Draft - Strategjisë për Artin dhe Kulturën në Republikën e Shqipërisë për vitet 2011-2020 dhe plan veprimi që e shoqëron atë, sipas reflektimeve të bazuara në rekomandimet dhe konsulencës së jashtme, pajtuar nga PNUD dhe aktorëve të interesuar.

Miratimi i Ligjit Nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe Kulturën", u bazua mbi parimet bazë në zhvillimin dhe njohjen e kulturës shqiptare, si një prej faktorëve më të rëndësishëm të komunikimit dhe si faktor nxitës në integrimin Evropian; Vënien e kulturës në shërbim të turizmit; Ruajtjes në kujtese dhe orientimin e institucioneve të kulturës dhe arteve drejt pavarësisë, kompeticionit dhe rritjes së rolit shumëdimensional në jetën qytetare, demokratike dhe ekonomike të vendit. Në zbatim të ligjit të mësipërm është bërë kalimin në varësi të MTKRS i Cirkut të Tiranës më anë të VKM 458, datë 22.06.2011 dhe është miratuar krijimi i

Teatrit Kombëtar të Komedisë me anë të VKM nr. 68, datë 08.07.2011 për "Miratimin e Strukturës dhe të organikës së Teatrit Kombëtar të Komedisë". Gjithashtu nga ky ligj rrjedh detyrimi ligjor për krijimin e Qendrës Kombëtare për Artin dhe Kulturën, si i institucion i ri publik.

Tregu i librit në Shqipëri është tashmë një treg krejtësisht i shndërruar në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut dhe ruajtjen e ekuilibrave dhe mundësive të barabarta për të gjithë protagonistët dhe faktorët kryesor në këtë fushë. Në këtë kontekst, janë hartuat dhe miratuar ligjet përkatëse për të dy sektorët si: Ligji Nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për librin në Republikën e Shqipërisë" si edhe Ligji Nr. 8576, datë 3.2.2000 "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin Nr. 9217, datë 8.4.2004, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8576, datë 03.02.2000 "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë".

Përgjatë këtyre viteve është ndjekur një politikë lehtësuese sa i përket reduktimit të sistemit fiskal për librat që botohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si edhe bazuar në Ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për librin në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve parashikon dhe vë në zbatim "Fondin Kombëtar për Librin në R.Sh".

Përgjatë këtyre viteve është punuar kryesisht në drejtim të botimit të veprave të panjohura të mendimit shqiptar, të cilat për shkak të një politike izolacioniste, kishin mbetur të papublikuara nëpër arkiva. Në të njëjtën kohë është investuar në drejtim të organizimit të veprimtarive të mëdha kombëtare dhe ndërkombëtare, në të cilat janë promovuar jo vetëm vlerat më të qenësishme të kulturës së shkruar shqipe dhe autorëve shqiptarë, por edhe është shpalosur dhe promovuar ndjeshëm imazhi dhe identiteti ynë kombëtar.

Referuar Nenit 101 "Bashkëpunimi kulturor" të MSA si dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), me qëllim promovimin për njohjen e artit shqiptar dhe vlerave të tij në arenën ndërkombëtare, janë në proces draft- marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi në fushën e artit dhe kulturës, trashëgimisë, sportit dhe rinisë me vende të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe më gjerë.

U nënshkrua më datë 21 Dhjetor 2011, Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin "Kultura 2007 – 2013".

Është siguruar pjesëmarrja e Republikës së Shqipërisë në Programin e Bashkimit Evropian "Evropa për Qytetarët", pas nënshkrimin në datë 2 Shkurt 2009 të "Memorandumit të Bashkëpunimit", miratuar nga Këshilli i Ministrave në datë 25 Shkurt 2009 dhe ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr. 10096 datë 19.03.2009 "Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KE për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin "Evropa për Qytetarët". Për promovimin e programit gjatë vitit 2010 dhe 2011 në bashkëpunim me Programin e Asistencës Teknike nga Komisioni Evropian dhe ekspertët ndërkombëtarë janë organizuar gjatë viteve 2010-2011 mbi 8 sesione informimi për autoritetet lokale si dhe organizatat jo qeveritare mbi programin, mënyrën e aplikimit, kushtet e pranimit si dhe partneritet e nevojshme.

Kanë filluar procedurat për Aderimin në Marrëveshjen e Pjesshme të Zgjeruar për Itineraret Kulturore.

Është treguar vëmendje e veçantë ndaj thithjes së potencialit krijues vendas dhe potencialeve që ushtrojnë aktivitetin e tyre artistik jashtë vendit, nëpërmjet konkurrimit dhe realizimit të projekteve të paraqitura nga operatoret që veprojnë sot në fushën e artit dhe kulturës në vend si dhe aktiviteteve të përbashkëta me institucionet e varësisë dhe atyre analoge të vendeve të tjera të huaja.

Lehtësimi i klimës për zhvillimin e industrisë kulturore në vend nëpërmjet mbështetjes dhe përkujdesjes ndaj vlerave që ata kanë, ka siguruar pasurimin dhe ridimensionimin e potencialit të krijuesve shqiptarë në krijimin e koncepteve, formave e hapësirave të reja në fushat përkatëse.

Zhvillimi i aftësive të artistëve dhe operatorëve kulturorë, realizohet përmes programeve të ndryshme të institucioneve publike apo me sektorin jo-qeveritar dhe atë privat. Ministria e TKRS financon një numër të konsiderueshëm festivalesh, ekspozitash të përvitshme, konkursesh me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, duke i vlerësuar me çmime dhe tituj për kontributin e tyre në zhvillimin e artit.

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar, MTKRS ofron asistencë dhe financon pjesëmarrjen e artistëve dhe operatorëve kulturorë, sipas programeve të nënshkruara me organizma ndërkombëtar të formimit profesional në Evropë dhe më gjerë. Gjithashtu MTKRS, në fushën e artit dhe kulturës ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktivitetesh me qëllim promovimin e diversitetit kulturor, komunikimit ndërkulturor dhe bashkëjetesën mes kulturave të ndryshme.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji Nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe Kulturën” në RSH. Reforma legjislative dhe administrative gjatë procesit të saj ka për qëllim përmirësimin e një menaxhimi modern që nxit konkurrencën dhe cilësinë artistike për institucionet qendrore të artit dhe kulturës duke rritur afrimin dhe aksesin e publikut në përmirësimin e kualitetit të jetës social kulturore të mbarë shoqërisë;
- Ligji Nr. 9616, datë 27.9.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 8576, datë 3.2.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9217, datë 8.4.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8576, datë 03.02.2000 ‘Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin Nr. 10096 datë 19.03.2009 “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KE për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin “Evropa për Qytetarët”.

Kuadri institucional

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave për Artin ideon politika dhe projekte zhvillimi në fushën e kulturës së shkruar dhe të arteve në përputhje me programin e Qeverisë Shqiptare, në dobi të intensifikimit, mbrojtjes, promovimit dhe njohjes së vlerave më përfaqësuese të artit dhe kulturës së shkruar shqipe.

Institucionet në varësi të MTKRS në fushën e Artit dhe Kulturës janë:

- Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP)
- Teatri Kombëtar (TK)
- Teatri Kombëtar i Komedisë (TKK)
- Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë (QKKF)
- Galeria Kombëtare e Arteve (GKA)
- Arkivi Qendror Shqiptar i Filmit (AQSHF)
- Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA)
- Qendra e Restaurimit të Veprave të Artit (QRVA)
- Qendra Kombëtare Kinematografike (QKK)
- Cirku Kombëtar (CK)
- Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës (QKAK)
- Biblioteka Kombëtare (BSH)

Masat ligjore afatshkurtra

- Miratimi me VKM për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Artit dhe Kulturës, e cila krijohet në zbatim të Ligjit Nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën" në RSH, me statusin e Institucionit Publik Qendror në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
- Ratifikimi me ligj i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komunitetit evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin "Kultura 2007 – 2013".
- Miratimi me VKM i Strategjisë "Për Artin dhe Kulturën në Republikën e Shqipërisë".
- Urdhër Kryeministri për miratimin e Agjencisë së Standardizimit të Periodikëve ISSN.

Aktivitet zbatuese afatshkurtra

- Pjesëmarrja në programin komunitar "Kultura 2007-2013", i cili ka për qëllim të inkurajojë dhe të mbështesë bashkëpunimin kulturor në Evropë në mënyrë që nxjerrë në pah trashëgiminë e përbashkët kulturore evropiane.
- Përmirësim në infrastrukturë për institucionet publike dhe vendore të artit.
- Lehtësimi i klimës për zhvillimin e industrisë kulturore në vend nëpërmjet mbështetjes dhe përkujdesjes ndaj vlerave që ata kanë, mbështetjes së projekteve artistike, përfaqësimeve në aktivitete me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, konkurse ekspozita, etj.
- Pjesëmarrja në programin Evropa për Qytetarët

Masat ligjore afatmesme

- Ratifikimi me ligj i Marrëveshjes së Pjesshme të Zgjeruar për Itineraret Kulturore"
- Miratimi i Ligjit "Për statusin e Artistit"

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Pjesëmarrja në Programi "Kultura 2007-2013". MTKRS do të vazhdojë të promovojë pjesëmarrjen në këtë program për të gjithë operatorët kulturë nëpërmjet sesioneve të informimit, workshopeve etj.
- Përmirësim në infrastrukture për institucionet publike dhe vendore të artit
- Pjesëmarrja në programin Evropa për Qytetarët.

Trashëgimia kulturore

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik është ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore**.**

Analiza e situatës aktuale

Trashëgimia kulturore është pasuri e brezave, vijimësia materiale dhe shpirtërore e një kombi. Si e tillë, trashëgimia kulturore është një sfidë e pareshtur për të ruajtur gjurmët e gjeniut krijues mbarëshekullor dhe për ta përcjellë atë drejt ardhmërisë. Ajo përbëhet nga vlera materiale (monumente kulture, site arkeologjike, qendra historike etj) si dhe nga vlera shpirtërore siç janë gjuha, folklori gojor dhe muzikor traditat dhe besimet e të gjitha llojeve, dhe zejet.

Aktualisht Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore ka përcaktuar drejtimet kryesore të zhvillimit dhe detyrimet ligjore për sa i përket trashëgimisë kulturore në tri dokumente strategjikë dhe ligjorë:

- Në Draft Strategjinë për Kulturën, në të cilën në kapituj të veçantë përcaktohen prioritetet e ruajtjes dhe rekomandimet për të ardhmen,
- Në Ligjin "Për trashëgiminë Kulturore" (dhe aktet nënligjore të tij) i cili është në proces amendimi për të reflektuar dhe adresuar sa më mirë problematikën e kohës dhe përafrimin ligjor me Acquis.
- Në ligjin "Për muzetë" (dhe aktet nënligjore të tij).

Aktualisht, çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore, rregullohen me ligjin nr. 9048 datë 7.4. 2003 "Për trashëgiminë kulturore", si dhe nga ligji nr. 9386 datë 04.05.2005 "Për muzetë".

Çështja e kthimit të një objekti të marrë ilegalisht nga një shtet anëtar i BE, në vendin e origjinës, nuk rregullohet shprehimisht nga dy ligjet e mësipërme. Ky ligj, objekti i të cilit janë vlerat e trashëgimisë kulturore, nuk është i përafruar me Direktivën 93/7/EEC të 15

Marsit 1993 (31993L0007) mbi kthimin e objekteve të zhvendosura ilegalisht nga territori i një Shteti Anëtar.
Aktualisht në ligjin "Për trashëgiminë kulturore", janë përfshirë detyrimet që burojnë nga Direktiva 93/7/EC e 15 Mars 1993 "Mbi kthimin e objekteve kulturore të marra ilegalisht nga një shtet tjetër", Direktiva 96/100 EEC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e cila amendon aneksin e Direktivës 93/7/EC,Rregullorja e Komisionit Nr. 752/93e datës 30 Mars 1993 për dispozitat për zbatimin e Rregullores së Këshillit Nr. 391/92 mbi eksportin e mallrave kulturore, Rregullorja e Këshillit Nr. 3911/92 e datës 9 Dhjetor 1992 mbi eksportin e mallrave kulturore. Shkalla e përputhshmërisë në këtë draft është e plotë. Projektligji është në proces konsultimi me gjithë institucionet përkatëse si publike dhe private.

Krahas kësaj, me VKM nr. 917 datë. 28.12.2011, është miratuar nga Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me MTKRS një Plan Veprimi Kombëtar "Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të veprave të artit të kulturës" plan në të cilin parashikohen aktivitete të ndryshme në lidhje me ndërgjegjësimin, trajnimin dhe luftën në tërësi të zhvendosjes së paligjshme të pasurive kulturore.

Gjithashtu vazhdon zbatimi i Konventës së 2005 të UNESCO mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e Shumëllojshmërisë së Shprehjeve Kulturore dhe i Konventës së 2003-it të UNESCO-s për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Trashëgimisë Shpirtërore.

Së fundmi, në Strategjinë Kombëtare të Kulturës që do të miratohet brenda vitit 2012, një kapitull i veçantë i dedikohet ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligjin nr. 9048 datë 7.4. 2003 "Për trashëgiminë kulturore",
- Ligji nr. 9386 datë 4.05.2005 "Për muzetë".

Kuadri institucional

Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore (DTK) në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, është strukturë politikëbërëse që përcakton prioritetet e zhvillimit dhe ruajtjes në këtë fushë, prioritete të cilat i zbaton përmes institucioneve teknike në varësi të saj.

DTK gjithashtu orienton investimet e ndryshme të buxhetit të shtetit për monumentet e kulturës, sitet arkeologjike e muzetë, si dhe financon një sërë aktivitetesh që synojnë të promovojnë vlerat e kësaj trashëgimie përmes festivaleve, botimeve, panaireve, ekspozitave etj.

Masat ligjore afatshkurtra

- Miratimi i projektligjit "Për trashëgiminë kulturore", katërmujori i III.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Fuqizimi institucional dhe përmirësimi i kapaciteteve të stafit të Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore. Organizimi i një trajnimi me punonjës të kësaj qendre pranë Policisë së Trashëgimisë Kulturore Italiane. (brenda 2012-ës);
- Ruajtja dhe përmirësimi i kushteve fizike të monumenteve të kulturës dhe muzeve në funksion të turizmit kulturor

  1.1: Restaurimi i banesës së Gjergj Fishtës, Tiranë

  1.2 Restaurim i banesave Kokobobo, Ficaj, Cuberi, Gjirokastër

  1.3 Restaurim i kishës së Lubonjës Korçë

  1.4 Restaurime në lagjet e Qendrës Historike Berat

  1.5 Restaurim i Manastirit të Shën Kollit Mesopotam

  1.6 Restaurim banesa e Markagjonit dhe banesa Pashko Vaso, Shkodër

  1.7 Restaurim Muzeu i Pavarësisë Vlorë

  1.8. Rikonstruksion i Muzeut të Diktaturës Shkodër

  1.9 Restaurime ne Qendrat Historike Shkodër, Elbasan, Korçë, Berat (IPA 2009).
- Inventarizimi i pasurive kulturore

  2.1 Inventarizimi i pasurive kulturore në pronësi të Qendrës së Studimeve Albanologjike

  2.2 Inventarizimi i pasurive kulturore në pronësi të institucioneve dhe individëve privatë.
- Ruajtja dhe promovimi i diversitetit kulturor dhe trashëgimisë shpirtërore

  1.1 Organizimi i Festivaleve tipologjike të QKVF

  1.2 Digjiitalizimi i trashëgimisë shpirtërore (folklori gojor,proze e poezi popullore, folklor koreografik, folklor muzikor) etj

  1.3 Hartimi i Direktorisë të diversitetit kulturor në Shqipëri (ku të përfshihen të gjitha shoqatat me karakter kulturor që u përkasin minoriteteve

  1.4 Organizimi i Panairit Kulturor "AlbCulture Diverse" (në këtë panair përvec këngëve e valleve të ketë edhe gatime, punime artizanati. Mund të propozohet Korça si qytet që ka Romë, Vlleh, Maqedonas, dhe si një trevë afër me Greqinë".

  1.5 Krijimi i Fondit të Diversitetit Kulturore- "AlbDiverseFund", i cili t'u japë mundësinë shoqatave apo grupeve të aplikojnë.

  1.6 Trajnim/tryezë e rrumbullakët për diversitetin kulturor, kuptimin, misionin, shprehitë, institucionet dhe përvojat ndërkombëtare në trajtimin dhe promovimin e tij.

Masat ligjore afatmesme

- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore për eksportin e pasurive kulturore.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Hartimi dhe vënia në funksion e regjimit të licencave të eksportit të pasurive kulturore.

Implikimet financiare

Në lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**789.058.000**	**888.565.000**	**931.195.000**	**10.000.000**
Mbulohen nga buxheti i shtetit	782.198.000	882.125.000	931.195.000	10.000.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	6.860.000	6.440.000	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.27. MJEDISI

3.27.1. CILESIA E AJRIT

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe institucioneve të tjera me detyra në këtë fushë eshte përmirësimi i cilësisë së ajrit urban përmes forcimit te zbatimit të legjislacionit të ri të përafruar me direktivat e BE-së për ajrin deri në vitin 2015. Për këtë arsye do të adoptohen plotësisht standartet mjedisore të cilesise se ajrit urban dhe te shkarkimeve në ajër, duke i përafruar me standartet europiane.

Fusha e cilësisë së ajrit është një nga fushat prioritare në kuadër të MSA-se, detyrimet e së cilës përcaktohen qartë në nenet 70/3 dhe 108. Këto nene parashikojnë domosdoshmërinë e përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis e Bashkimit Evropian*, si dhe zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit të luftës kundër degradimit mjedisor, me qëllim nxitjen e qëndrueshmërisë mjedisore.

Qeveria shqiptare synon rritjen e investimeve për mbrojtjen e mjedisit për të siguruar përafrimin e standarteve tona mjedisore me ato të Bashkimit Evropian e sidomos në përmiresimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit në të gjitha qendrat urbane duke ruajtur nivelet e SO2 brenda normave të lejuara kombëtare dhe të ndalohet rritja e mëtejshme e NO2, PM2.5 dhe O3.

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Bashkëpunimit të ministrive të linjës, MMPAU, METE, MPPT lidhur me adoptimin dhe zbatimin e legjislacionit te BE mbi cilësinë e lëndëve djegëse dhe kontrollin teknik të automjeteve.
- Bashkëpunimit me pushtetin vendor për miratimin e planeve rregulluese urbane që zgjidhin përfundimisht problemin e trafikut të rënduar dhe rrisin siperfaqet e gjelbra në qytetet tona.
- Adoptimit te iniciativave për një sjellje miqësore me mjedisin të aktiviteteve ekonomike e njerëzore dhe që njëkohësisht respektojnë principet e tregut të lirë.
- Adoptimit te lehtësirave fiskale për uljen e ndotjeve nga bizneset dhe konsumi, për investime në teknologji të pastra, për konservimin e energjisë, për përdorimin racional të burimeve natyrore dhe për nxitjen e investimeve mjedisore.

Situata aktuale

Në periudhën 2002-2009 në nën-fushën e cilësisë së ajrit janë hartuar një numër aktesh ligjore dhe nën-ligjore që mbështeten në direktivat respektive të BE-së dhe konventa të ndryshme ndërkombëtare. Shkalla e transpozimit të Direktivës Kuadër të Ajrit në aktet vendase është vlerësuar në masën 21 %. Me gjithë legjislacionin në fuqi dhe përpjekjet për zbatimin dhe detyrimin e tij mbetet akoma për të bërë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së ajrit në disa zona urbane dhe industriale. Në të ardhmen do të vazhdohet me hartimin e disa

akteve të tjera që synojne thellimin e mëtejshëm të transpozimit të kësaj direktive, të direktivave bija të saj, si dhe akte për aderime në konventa e protokolle të ndryshme për ajrin.

Monitorimi i cilësisë së ajrit urban është realizuar per indikatorët më kryesorë te cilësisë se ajrit, PM10 (grimca nën 10 mikron), LNP (lëndë e ngurtë pezull), NO_2, SO_2, O_3 , Pb,CO dhe Benzen në qytetet Tirane, Durres, Elbasan, Shkoder, Korce, Vlore dhe Fier. Me mbeshtetjen e projektit CEMSA, te financuar nga BE, në 4 qytete kryesore Durres, Shkoder, Vlore dhe Korce, jane vendosur stacionet automatike te standarteve europiane per monitorimin e cilesise se ajrit urban. Gjithashtu me mbeshtetje dhe financuar nga OBSH ne qytetin e Tiranes eshte rritur me dy numri i stacioneve automatike per minitorimin e cilesise se ajrit.

Megjithe perpjekjet per te permiresuar sistemin e monitorimit te cilesise se ajrit, akoma ky sistem nuk ploteson standartet europane per shkak te mungeses se investimeve per blerjen e stacioneve te monitorimit, pajisjeve dhe reagenteve, kostos per mirembajtjen dhe kalibrimin e tyre.

Aktualisht Agjensia e Mjedisit dhe Pyjeve eshte duke u asistuar nga nje projekt i financuar nga KE, CEMSA qe synon konsolidimin e Sistemit Kombetar te Monitorimit ne vend dhe krijimin e Struktures Institucionale për Sistemin e Monitorimit Mjedisor.

Sipas nenit 11 te ligjit 8897/2002 dhe VKM Nr. 435, Date 12.09.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër", operatorët e burimeve të mëdha dhe mesatare të ndotjes detyrohen të kryejnë vetmonitorimin e shkarkimeve në ajër dhe të raportojnë periodikisht të dhënat e tij, si dhe masat e marra për kufizimin e ndotjes prane Agjensive Rajonale te Mjedisit. Aktualisht zbatimi i kerkesave te ketij vendimi eshte i ulet. Agjensia e Mjedisit dhe Pyjeve ka kapacitete te uleta ne pajisje laboratori dhe stafi te kualifikuar per verifikimin e vetmonitorimeve te shkarkimeve ne mjedis nga operatoret industriale. Mungesa e laboratoreve te certifikuar ka bere qe shkalla e besueshmerise se te dhenave te vetmonitorimit te shkarkimeve te jete e ulet. Inspektorati i Mjedisit ne nivel qendror dhe lokal nuk ka pajisje per kontrollin e shkarkimeve ne ajer nga subjektet industriale. Gjithashtu kjo pengon ne zhvillimin e rregjistrave kombetare te shkarkimeve per grumbullimin e te dhenave mbi bazen e matjeve. Gjithashtu MMPAU do te asistohet nga Projekti i KE, SELEA (2012-2014) " Per forcimin e zbatimit te legjislacionit mjedisor dhe kapaciteteve te MMPAU, perfshire stafin e ministrise, Agjensine e Mjedisit dhe Pyjeve dhe Inspektoratin e Mjedisit. Nje nga komponentet e projektit eshte permiresimi i sistemit te inspektimit ndaj aktiviteteve industriale qe shkaktojne shkarkime ne ajer ne nivel qendror dhe lokal.

Mbi bazen e marreveshjes se bashkepunimit midis MMPAU dhe Ministrise se Mjedisit, Tokes dhe Detit te Italise ne kuader te Projektit " Inventari i ndotësve të ajrit dhe planifikimi i Cilësisë së ajrit" eshte hartuar Inventari i emisioneve te ajrit per Shqiperine sipas Udhezuesit per Raportimin e te Dhenave te Emisioneve te Konventes mbi Ndotjen e Ajrit ne Distance te Larget Nderkufitare (CLRTAP), Udhezuesit te Inventarit te Emisioneve te Ndotesve te Ajrit 2009 te EMEP/EEA dhe Udhezuesit per Inventaret Kombetare te Gazeve Serre 2006 IPCC. Intervali i kohes i perdorur si reference eshte viti 1990 dhe periudha e shqyrtuar eshte 1990 2008;

Pengesat ne arritjen e standarteve per treguesit e cilesise se ajrit jane te lidhura me nje numer faktoresh qe kane te bejne me bashkepunimin jo efektiv midis institucioneve pergjegjese qe mbulojne fushen e ajrit dhe qe jane pergjegjes per (i) legjislacionin ne fushen e ajrit (ii) trafikun e renduar ne qytetet kryesore te vendit, (ii) cilesine e karburanteve, (iii) infrastrukturen rrugore, (iv) moshen e automjeteve dhe (v) kontrollin teknik te tyre.

Transporti mbetet një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit urban. Rritja e numrit të automjeteve dhe sidomos e automjeteve të perdorura dhe që punojnë me naftë ndikojnë në rritjen e shkarkimeve të ndotësave të gaztë. Një rëndësi të veçante ka dhe cilësia e lëndës djegese që përdoret nga automjetet si dhe qendrimi per nje kohe te gjate te automjeteve ne trafik duke favorizuar shkarkimi e ngazeve ne atmosfere.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Kuadri ligjor kryesor ku mbeshtetet mbrojtja e cilesise se ajrit eshte :

- Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Ky ligj është përafruar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 Prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin" e ndryshuar. Numri CELEX: 32004L0035, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 143, datë 30.4.2004, faqe 56-75
- Ligji Nr.10266, Date. 15.04.2010 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr. 8897, Date 16.05.2002 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja"qe perafron Direktiven 2008/50/EC e Parlamentit dhe e Keshillit Europian te dates 21 Maj 2008 "Per cilesine e ajrit te mjedisit dhe nje ajer me te paster per Europen"; si dhe Direktiven nr 96/62/EC date 27 Shtator 1996 "Për cilësinë e ajërit", e amenduar nga vendimi i komisionit 01/752/EEC.
- Vendimi i Keshillit te Ministrave (VKM) Nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë" Fletorja zyrtare Nr. 56, viti 2002, faqe 1579, data e botimit 19.09.2002 qe perafron pjeserisht Direktiven e Parlamentit dhe te Keshillit te Europes 2001/80/EC, date 24 Tetor 2001 per " Limitimin e emisioneve te ndotesve te caktuar ne ajer nga Impiantet e Medha te Djegies"
- Vendimi i Keshillit te Ministave Nr 803, datë 4.12. 2003 " Per miratimin e normave te cilesise se ajrit" (Fletore Zyrtare e RSH" Nr 101, dhjetor, 2003, faqe 4337). Ky vendim vendosi standarte qe bazohen ne Standartet/Udhezimet e vitit 1987 (Organizata Boterore e Shendetesise Publikime Rajonale, Seria Europiane, No. 91 2000, x + 273) te revizionuara ne vitin 2000 nga Zyra e Organizates Boterore te Shendetesise (OBSH) per Europen "Porosite mbi Cilesine e Ajrit ne Europe" ne objektivin nr. 10 te kreut "Shendeti per te gjithe". Per nje sere standartesh vlerat e miratuara ne RSH sipas VKM Nr. 803, date 04.12.2003 jane me te larta se ato te vendeve te BE (LNP, PM10, SO2, NO2, Pb, etj).
- Ligji nr. 10 422, date 26.05.2011" Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin per Financimin Afat-Gjate te Programit Kooperues per Monitorimin dhe Vleresimin e Transferimit te Ndotesve te Ajrit ne Distance te Medha ne Europe" (Gjeneve, Shtator 1984);

- Ligji nr. 10 436, dated 28.06.2011 " Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin per reduktimin e metejshem te shkarkimeve te SO2 (Oslo 1994)" (Oslo, June 1994).
- Ligji nr.10 476, dated 3.11.2011 " Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin per të pakësuar acidifikimin, eutrofikimin dhe perqendrimin e nivelit te ozonit ne shtresen e poshteme te atmosferes (Gothenburg, November 1999)";

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në mbrojtjen e cilesise se ajrit janë Ministria e Mjedisit dhe institucionet e varësisë së saj, Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, Ministria e Puneve Publike dhe Transportit, Ministria e Shendetesise dhe institucionet e varësisë së tyre si dhe organet e qeverisjes vendore.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave eshte institucioni pergjegjes per hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive, planeve kombetare dhe legjislacionit per mbrojtjen e ajrit urban nga ndotja, per te formuluar masa per uljen e nivelit te ndotjes se ajrit dhe per te garantuar organizimin dhe funksionimin e procesit te monitorimit te cilesise se ajrit si dhe inspektimin e aktiviteteve industriale qe shkaktojne shkarkime ne ajer.

Ne MMPAU ka nje sektor me dy specialist dhe nje pergjegjes sektori qe mbulon fushat e ajrit, ndryshimeve klimatike, kimikateve dhe zhurmave. Kapacitetet politikëbërëse/ ligjbërëse ne MMPAU jane jane te uleta. Rritja e kapaciteteve eshte një nevoje që duhet plotesuar në vazhdimësi.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AMP) është autoriteti kompetent për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit. Monitorimi i cilesise se ajrit urban kryhet nga Agjensia e Mjedisit dhe Pyjeve nepermjet institucioneve te kontraktuara nga MMPAU. AMP grumbullon, perpunon dhe ben publike raportin e gjendjes se cilesise se ajrit.
Inspektorati i Mjedisit eshte autoriteti kompetent qe siguron përmbushjen e kushteve të lejes përkatëse të mjedisit nepermjet kontrollit dhe monitorimit te aktiviteteve industriale qe shkaktojne shkarkime ne ajer.
Ministria e Shendetesise (MSH) eshte pergjegjese per mbrojtjen e shëndetit publik nga sëmundjet që transmetohet përmes ajrit, bashkëpunues në hartim aktesh me MMPAU. Instituti i Shendetit Publik ne varesi te kesaj ministrie eshte vazhdimisht i angazhuar me monitorimin e cilesise se ajrit urban, i kontraktuar nga MMPAU.

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes harton dhe zbaton politika ne bashkepunim me MMPAU, lidhur me cilesine e lendeve djegese qe synojne mbrojtjen e cilësisë së ajrit.
Cilesia e karburanteve kontrollohet nga Inspektoriati Qendror Teknik (IQT). Ne zbatim te Ligjit Nr. 8450, date 24.02.1999, "Per Perpunimin,per Transportin dhe Tregtimin e Naftes, te Gazit dhe Nenprodukteve te tyre" i ndryshuar me ligjin nr. 9218, datë 8.4.2004, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8450, date 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre Fletorja Zyrtare: Viti 2004, Nr 30, Faqe 2509; Data e botimit: 19-05-2004;" dhe te Urdherit te Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes Nr. 166, date 01.07.2004, "Per kontrollin e cilesise, menyren e marrjes se

mostres, sasine e saj, pagesat dhe dokumentacionin perkates si dhe per kontrollin e respektimit te normave e kushteve teknike ne instalimet e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre", IQT merr kampione per cdo ngarkese produkti qe hyn ne cdo dogane shqiptare (detare apo tokesore), per kryerjen e analizave te cilesise, rezultatet e te cilave dokumentohen. Gjithashtu, e njejta procedure ndiqet per cdo kampion te gazoilit te prodhuar ne vend, si dhe kryhen kontrolle periodike e me sondazhe gjate gjithe vitit ne gjithe stacionet e tregtimit me pakice te karburanteve (benzine, gasoil dizel, dhe gaz te lengezuar te naftes) dhe ne te gjitha depozitat e tregtimit me shumice te produkteve te naftes dhe gazit.

Ministria e Puneve Publike dhe Transportit eshte pergjegjese per zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe të transportit duke respektuar normat e caktuara për cilësinë e ajrit dhe shkarkimeve nga automjetet, bashkëpunues në hartim aktesh me MMPAU.

Kontrolli Teknik i detyrueshëm i mjeteve rrugore, kryhet në qendrat e kontrollit teknik (QKT) të miratuara nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit mbi baza vjetore dhe periodike.

Vlerësimi i gjendjes teknike të automjetit për efekt të ndotjes së ajrit nga shkarkimet e gazeve dhe zhurmat e shkaktuara prej tij, janë pjesë përbërëse e procesit të kontrollit teknik të mjeteve, kryerja e të cilit disiplinohet me udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit nr.3413, datë 16.7.2003 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”. Sherbimi i kontrollit teknik te detyrueshem te mjeteve, perfshire dhe kontrollin e nxjerrjeve te gazrave te mjeteve kryhet ne baze te Kontrates se Koncesionit date 3.9.2009, midis Ministrise se Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe shoqerise se krijuar ne Konfederaten Helvetike “ Societe Generale de Surveillance” SA, nga kjo e fundit me te drejten ekskluzive per 10 vjet ne kryerjen e ketij kontrolli. Bashkepunimi midis MMPT dhe MMPAU dhe AMP lidhur me raportimin e te dhenave, mbetet i ulet.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë te BE-se dhe zbatimi i plotë i tij. Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- P/Ligj **“**Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, qe transpozon plotesisht Direktiven 2008/50/EC te Parlamentit Europian “Per cilesine e ajrit te mjedisit dhe nje ajer me i paster per Europen” (OJL152/1, 11.6.2008); Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me MPPT, METE, MSH, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit dhjetor 2012.
- P/Akt “Per reduktimin e permbajtjes se squfurit ne lendet djegese te lengeta”, qe transpozon Direktiven 1999/32/EC mbi reduktimin e permbajtjes se squfurit ne disa lende te caktuara djegese te lengeta qe amendon Direktiven 93/12/EC e amenduar nga Rregullorja (EC) 1882/2003 dhe Direktiva 2005/33/EC; Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte METE ne bashkepunim me MMPAU, MPPT, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda 6-mujorit te pare te vitit 2012.

- Projekt VKM për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, transpozon Direktivën 2008/50/EC për cilësinë e ajrit të ambjentit dhe ajrit më të pastër për Evropën dhe Direktivën 2004/107/EC në lidhje me arsenikun, kadmiumin, mërkurin, nikelin dhe hidrokarburet policiklike aromatike në ajrin e ambjentit. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me MPPT, METE, MSH, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit qershor 2012.
- Draft VKM mbi " Sistemin e integruar te monitorimit mjedisor". Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU, AMP nen asistencen e Projektit CEMSA
- Draft VKM per Miratimin e Rregullores mbi zonat bio-gjeografike, zonat e monitorimit dhe treguesit mjedisor. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU, AMP nen asistencen e Projektit CEMSA

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Monitorimi i cilësisë së ajrit nga institucionet vendase
- Ngritja e qendres se mirembajtjes dhe kalibrimit te pajisjeve te monitorimit te ajrit;
- Shpenzime per mirembajtjen teknike te paisjeve te stacioneve automatike te instaluara per monitorimin e cilësisë së ajrit nga institucionet vendase;
- Trajnime per metodologjine e perpunimit e raportimit te te dhenave ne Agjencine Europiane te Mjedisit
- Trajnime ne lidhje me funksionimin dhe kalibrimin e pajisjeve te cilesise se ajrit
- Forcimi i disiplinës së ligjit në mbrojtjen e mjedisit për aktivitetet që shkaktojnë ndotje të ajrit;;
- Forcimi i kapaciteteve inspektuese nëpërmjet trajnimeve që do të zhvillohen nga RENA, "Rrjeti Europian Mjedisor i Para - Zgjerimit" i Komisionit Europian dhe Inspektoriati Qendror në varësi të Kryeministrit.
- Kryerja e inventarit te emisioneve ne ajer ne zbatim te detyrimeve qe rrjedhin nga Konventa e ndotjes nderkufitare te ajrit në distanca të mëdha CLRTAP.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatmesme synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat legjislative afatmesme janë si vijon;

- P/Akt "Per Miratimin e Planit Kombetar te Veprimit per Cilesine e Ajrit". Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me MPPT, METE, MSH, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit dhjetor 2013 nen asistencen e projektit SELEA;
- Projekt akt " Per miratimin e tavaneve kombetare te shkarkimit per ndotes te caktuar atmosferike" qe transpozojne Direktivat 2001/81/EC te Keshillit dhe Parlamentit Europian e dates 23 Tetor 2001 mbi tavanet kombetar te shkarkimeve per ndotes te caktuar atmosferike, amenduar nga Direktiva 2006/105/EC dhe Rregullorja EC/219/2009. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne

bashkepunim me MPPT, METE, MSH, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit dhjetor 2013, nen asistencen e projektit SELEA;

- Projekt akt " Per permbajtjen e arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve aromatike policiklike ne ajer" qe transpozon Direktiven 2004/107/EC te Keshillit dhe Parlamentit Europian e dates 15 Dhjetor 2004 ne lidhje me permbajtjen e arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve aromatike policiklike ne ajer amenduar nga direktiva EC/219/2009. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me METE, MSH, MPPT,, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit dhjetor 2013
- Projekt akt " Per kontrollin e emisioneve te komponimeve organike te avullueshme (VOC), qe rezultojne nga ruajtja dhe shperndarja e hidrokarbureve nga terminalet dhe pikat e karburanteve" qe transpozon Direktiven 94/63/EC te Keshillit dhe Parlamentit Europian te dates 20 Dhjetor 1994 e amenduar nga rregulloret EC/1882/2003 dhe EC/1137/2008. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me METE, MSH, MPPT,, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit dhjetor 2015
- P/Akt "Për ngritjen e një sistemi informacioni për mbrojtjen e mjedisit", i cili synon të transpozojë aktet komunitare 2004/224/EC, 2004/461/EC, 97/101/EC. Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e plotë; Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me METE, MSH, MPPT,, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit dhjetor 2015.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Monitorimi i cilësisë së ajrit nga institucionet vendase
- Investime per mirembajtjen teknike te paisjeve te stacioneve automatke te instaluara per monitorimin e cilësisë së ajrit nga institucionet vendase;
- Shpenzime per mirembajtjen teknike te paisjeve te stacioneve automatike te instaluara per monitorimin e cilësisë së ajrit nga institucionet vendase;
- Forcimi i kapaciteteve teknike në Sektorin e Ajrit, Ndryshimeve Klimatike, Zhurmave dhe Kimikateve dhe ne Agjensine Kombetare te Mjedisit;
    - Trajnime per monitorimin e cilesise se ajrit
    - Trajnime per hartimin e inventarit te emisioneve ne ajer
    - Asistence e huaj për draftimin e akteve nenligjore dhe udhezuesve, të cilat do të hartohen gjatë periudhës afatmesme
- Forcimi i disiplinës së ligjit në mbrojtjen e mjedisit për aktivitetet që shkaktojnë ndotje të ajrit;
- Forcimi i kapaciteteve inspektuese nëpërmjet trajnimeve që do të zhvillohen nga RENA, "Rrjeti Europian Mjedisor i Para - Zgjerimit" i Komisionit Europian dhe Inspektoriati Qendror në varësi të Kryeministrit.
- Kryerja e inventarit te emisioneve ne ajer ne zbatim te detyrimeve qe rrjedhin nga Konventa e ndotjes nderkufitare te ajrit në distanca të mëdha CLRTAP.
- Percaktimi i zonave te grumbullimit ne te cilat nivelet e ndotesve jane me te larta se normat e lejuara;

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 27.1 cilesia e ajrit[135]

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**99.285.000**	**127.212.000**	**99.702.000**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	53.565.000	105.213.000	90.702.000	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	45.720.000	21.999.000	9.000.000	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.27.2. LEGJISLACIONI HORIZONTAL

Objektivi Strategjik

Në kuadër të zbatimit të nenit 108 te MSA, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave është angazhuar në përafrimin e legjislacionit të vlerësimit të ndikimit në mjedis me atë të vendeve të Bashkimit Europian. Hartimi dhe zbatimi i legjislacionit horizontal për të siguruar mbrojtjen e integruar të mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, përbën një ndër detyrimet themelore të MSA. Paralel me plotësimin e bazës ligjore kërkohet edhe përcaktimi i proçedurave të vlërësimit të ndikimit në mjedis, aprovimit të lejes mjedisore si dhe forcimi i strukturave dhe kapaciteteve vendase për zbatimin e legjislacionit horizontal. Në kuadër të zbatimit të MSA-së kërkohet forcimi i bashkëpunimit midis institucioneve qëndrore dhe lokale të përfshira në administrimin e mjedisit, burimeve natyrore dhe territorit me qëllim integrimin e mjedisit në të gjitha hallkat e vendim-marrjes dhe realizimin e një vendim-marrje mjedisore gjithpërfshirëse. Forcimi i përfshirjes së publikut në proçesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, rritje e aksesit të individëve dhe OJF-ve në informacionin mjedisor si dhe tërheqja e tyre në vendim-marrjen mjedisore është një pjesë integrale të detyrimeve të MSA.

Qeveria Shqiptare ka programuar një sërë masash që adresojnë detyrimet e MSA lidhur me hartimin e legjislacionit horizontal dhe të zbatimit të tij. Për periudhën 2010 – 2014 Qeveria Shqiptare (QSh) është angazhuar te:

- Te harmonizoje plotesisht legjislacionin e vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe vleresimin strategjik mjedisor
- të disiplinojë zhvillimin ekonomik të vendit duke e harmonizuar atë dhe përdorur në mënyrë racionale burimet natyrore, mbrojtjen e vlerave natyrore të vendit,
- te forcoje zbatimin e ligjit per disiplinimin e kontrollin e ndotjes së mjedisit nga aktivitetet ekonomike si dhe plotësimin e kuadrit të standarteve mjedisore. Programi i QSH përmban angazhime në fushën e
- nxitjen e iniciativave ekonomike miqësore me mjedisin.

[135] Për më shumë informacion në lidhje me shpenzimet për çdo aktivitet ose institucion të veçantë, ju lutemi konsultoni Shtojcën 3 Vlerësimi financiar i zbatimit të PKZMSA

- të informojë publikun mbi gjendjen e mjedisit, të rishikojë të drejtat ligjore të publikut dhe
- të përmirësojë proçedurat e ankimimit administrativ dhe gjyqësor për t'i dhënë akses më të lartë grupeve që kërkojnë mbrojtje te larte te mjedisit;

Pjesë e rëndësishëm e legjislacionit horizontal është dhe Informimi i Publikut, i cili parashikon zhvillimin e drejtimeve kryesore që lidhen me (i) përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communitaire* në fushën e informimit, (ii) zbatimin e këtij legjislacioni lidhur me përmirësimin e proçesit të informimit e ndërgjegjësimit të publikut për çështje mjedisore, si dhe (ii) rritjen e kapaciteteve në nivel qëndror dhe lokal, të cilat lidhen direkt me "Qeverisjen e mirë" si dhe me nxitjen e shkëmbimit të ndërsjellë të informacionit (neni 105 MSA). Ky objektiv është shkrirë edhe në dokumentet strategjike sektoriale të mjedisit.
Politika e këtij programi ka për qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin mbi (i) praktikat e reja në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor për të gjithë elementet e saj që lidhen me cilesinë e ajrit, ujit, tokës, ndotjen akustike, resurset natyrore e pyjore, (ii) njohjen e problemeve e mënyrat e përmirësimit të sjelljes se individit kundrejt mjedisit, si dhe (iii) rritjen e interesit të publikut në vendimarrje.

Situata Aktuale

Transpozimi i Direktivës 85/335/EEC e amenduar nga Direktiva e Këshillit 97/11/EEC "Mbi vlerësimin e efekteve që shkaktohen nga aktivitetet private dhe publike në mjedis" në legjislacioni horizontal kombëtar është vlerësuar në masën 93 %. (European Commission, DG ENV, Progress Monitoring for the countries of South East Europe ("pre-candidates") Progress Report, Year 13, September 2009 – June 2010). Nderkohe qe perafrimi i plote i kesaj Direktive arrihet nepermjet ligjit te ri te miratuar te vleresimit ne ndikimit ne mjedis nr. 10440 date 7.7 2011 i i hartuar ne bashkepunim meprojektin e"Plani Kombetar i Zbatimit te Legjislacionit Mjedisor ne Shqiperi" (INPAEL) financuar nga CARDS 2006 (EU Ref: No. 124909/C/SER/AL).

Lidhur me shkallën e transpozimit të Direktivës 2001/42/EC "Mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe projekteve për mjedisin" është vlerësuar që direktiva është përafruar në masën 32%. (European Commission, Progress Monitoring for the countries of South East Europe ("pre-candidates") Progress Report, Year 13, September 2009 – June 2010 Projektligji i vleresimit strategjik mjedisor që perafron plotesisht direktiven eshte hartuar dhe planifikohet që të miratohet brenda 3 mujorit te I-re te vitit 2012. Legjislacioni i vleresimit të ndikimit në mjedis ka për qëllim të mbroje mjedisin nga projektet me ndikim begativ ne mjedisi pasoje e zhvillimit ekonomik të vendit. Detyrimin e zbatimit të këtij legjislacioni e kanë subjektet private dhe shtetërore që zbatojnë projekte të ndryshme zhvillimi.

Në mënyrë të drejpërdrejtë për zbatimin e legjislacionit horizontal janë angazhuar rreth 50 punonjës që përfshijnë stafin e Agjensive Rajonale të Mjedisit në Qarqe, stafin e Drejtorisë së Mbrojtjes së Mjedisit dhe Inspektoriatin e Mjedisit si struktura qëndrore pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave. Megjithe eksperiencën e kapacitetet egzistuese nevojitet mbështetja e strukturave lokale me mjete llogjistike, shtim punonjësish si dhe trajnime edhe strukturat qëndrore kanë nevojë për trajnime të avancuara të stafit.

Baza ligjore aktuale në fushën e informimit është pjesërisht e përafruar me direktivën e Bashkimit Europian 2003/4/EC të 28 Janarit 2003 "Për të drejtën e publikut për të patur informacion mjedisor" si edhe përmbushjen në mënyrë specifike të detyrimeve që burojnë nga ratifikimi i Konventës së Aarhusit.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Në fushën e legjislacionit horizontal, është punuar në drejtim të konsolidimit të bazes ligjore për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe ngritjen e zhvillimin e një sistemi bashkëkohor të tij, bazuar në detyrimet e përcaktuara në MSA dhe Direktivat përkatëse të BE dhe Konventat ndërkombëtare. Kuadri ligjor ekzistues në lidhje me vlerësimin strategjik mjedisor dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis, përbëhet nga një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore ku percaktohen standartet dhe kriteret mjedisore qe duhet te zbatohen nepermjet procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe atij te vleresimit strategjik mjedisor.

- Ligji Nr. 8990, Date 23.01.2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar dhe ne fuqi deri ne vitin 2013. Ky ligj qe po zbatohet qe ne vitin 2003 ka perafruar pjeserisht Direktiven nr. 85/337/EEC"Mbi vlerësimin e efekteve që shkaktohen nga aktivitetet private dhe publike në mjedis" e amenduar nga Direktiva e Këshillit 97/11/EEC dhe 35/2003;. Nderkohe ne vitin 2013 hyn ne fuqi ligji Nr. 10440 date 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis". Ligji i ri perafron plotesisht Direktiven nr. 85/337/EEC"Mbi vlerësimin e efekteve që shkaktohen nga aktivitetet private dhe publike në mjedis" e amenduar nga Direktiva e Këshillit 97/11/EEC dhe 35/2003;
- Ligji nr. 9700 date Per mbrojtjen e mjedisit ne kontekstin nderkufitar qe transpozon kerkesat e Konventes se Espoos "Per vleresimin e ndikimit ne konteksion nderkufitar" ne VKM nr. 994 date 2.7.2008 "Per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimarrjen per mjedisin" qe transpozon plotesisht kerkesat per informimin dhe pjesemarrjen e publikut ne vendimarrjen mjedisore te parashikuara ne Direktiven nr. 85/337/EEC"Mbi vlerësimin e efekteve që shkaktohen nga aktivitetet private dhe publike në mjedis" e amenduar nga Direktiva e është 97/11/EEC dhe 35/2003 dhe Direktiven 2001/42/EC "Për vlerësimin e ndikimeve nga plane dhe programe të caktuara në mjedis" si dhe kerkesat e Konventes se se Arhusit "Per të drejtën e informimit për mjedisin dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimarrje" (1998);
- Ligji Nr. 8503, Datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtarë" Direktiva e 2003/4/EC të 28 Janarit 2003 "Për të drejtën e publikut për të patur informacion mjedisor" Shkalla e Përafrimit: E pjesshme
- Ligji Nr 10431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" ,Direktiva e 2003/4/EC të 28 Janarit 2003 "Për të drejtën e publikut për të patur informacion mjedisor", Shkalla e Përafrimit: e pjesshme
- Udhezim Nr. 6, Date 27.12.2006 "Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimeve ne mjedis te nje veprimtarie" qe eshte ne perputhje me Udhezuesin perkates te KE "Udhezuesi për vleresimin e VNM 2001" Fletorja Zyretare e EC, 2001/ISBN 92-894-1336-0

- Udhezim Nr. 3, Date 19.11. 2009 ”Per metodologjine e vleresimit te raportit te vleresimit te ndikimit ne mjedis” ne perputhje me te plote me Udhezuesin perkates te KE “Udhezuesi për vleresimin e VNM 2001” Fletorja Zyretare e EC, 2001/ISBN 92-894-1336-0

  Akte te tjera te legjislacionit horizontal (VNM) që nuk transpozojnë akte komunitare:
  - VKM Nr. 805, Datë 4.12.2003, “Për miratimin e listës së veprimtarive, që ndikojnë në mjedis, për të cilat kërkohet leje mjedisore”;
  - VKM Nr. 249, Datë 24.04.2003, “Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementëve të lejes mjedisore”;
  - Udhezimi Nr 2, Date 21. 05. 2007 “Per miratimin e listes se veprimtarive me ndikim ne mjedis, menyren e aplikimit dhe rregullat e proçedurat e dhenies se autorizimit dhe pelqimit mjedisor nga agjensite rajonale te mjedisit”;
  - Udhëzim Nr. 1, Datë 07.01.201 “Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore”.
  - Urdhër i Kryeministrit Nr. 202 dt.16.12.2005 “Për Forcimin e Trasparencës, nëpërmjet Rritjes së Përdorimit të Internetit dhe Përmirësimit të Faqeve Ekzistuese të Internetit”

Struktura institucionale

Drejtoria e Mbrojtjes se Mjedisit harton, mikqyr e koordinon veprimet për zbatueshmërinë e këtij legjislacioni me Agjensite Rajonale të Mjedisit dhe sektoret e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.
Forcimi i zbatimit te legjislacionit si dhe ndjekja e zbatimit te ketij legjislacioni realizohet nga:

- Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit;
- Agjensite Rajonale te Mjedisit ne qarqe;
- Inspektoriati i Mjedisit;
- Agjensite e Baseneve Ujembledhese;
- Drejtorite e Sherbimit Pyjor ne Rrethe;
- Njesite e Qeverisjes Vendore (bashkite dhe komunat)

Në mënyrë të drejpërdrejtë për zbatimin e legjislacionit horizontal janë angazhuar rreth 50 punonjës që përfshijnë stafin e Agjensive Rajonale të Mjedisit në qarqe, stafin e Drejtorisë së Mbrojtjes së Mjedisit dhe Inspektoriatin e Mjedisit si struktura qëndrore pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave.
Brënda strukturës së MMPAU-së funksionon Sektori i Përpunimit të të Dhënave, Publikimeve dhe Teknologjisë së Informacionit, i cili ka si objektiv kryesor dhënien e informacionit mjedisor për publikun e gjërë. Ky sektor ka si veprimtari kryesore të sigurojë komunikimin me publikun dhe shoqërinë civile dhe të marri masat për pjesmarrjen e tyre në veprimtaritë e ministrisë.

Gjithashtu kjo strukturë duhet të bashkëpunojë me Ministritë e Linjës, strukturat e varësisë dhe drejtoritë teknike të Ministrisë për grumbullimin e informacionit dhe përpunimin e tij. Ky

sektor ndjek dhe përgjigjet për mirëmbajtjen dhe përditësimin e informacionit në të gjitha format e shpërndarjes së informcionit (web-site e ministrisë, buletinet, publikimet e ndryshme, tabelat informuese etj) si dhe ndjek dhe administron informacionin lidhur me kërkesat e publikut.
Një institucion i rëndësishëm për dhënien e Informacionit Mjedisor është dhe Agjensia e Mjedisit dhe Pyjeve e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.579 dt.23.08. 2006 "Për Krijimin e Agjensisë së Mjedisit dhe Pyjeve". Në nenin 1 pika 3 të këtij vendimi theksohet se kjo agjensi grumbullon, përpunon dhe informon publikun për rezultatet e monitorimit në fushën e mjedisit.

Agjensitë Rajonale Mjedisore, sipas nenit 19, të ligjit nr. 9890, datë 20.3.2008, "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, kanë për detyrë të hartojnë dhe paraqesin për miratim në Këshillin e Qarkut raportin dyvjeçar të gjendjes së mjedisit per Qarkun që ato mbulojnë. Agjensitë Rajonale të Mjedisit, shërbejnë si një hallkë më e afërt me publikun për dhënien dhe sigurimin e informacionit mjedisor.

Masat Legjislative Afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat ligjore të mëposhtme:

- Projekt-ligji "Për vlerësimin strategjik mjedisor". Ligji synon të rregullojë proçesin e vlerësimit strategjik mjedisor të planeve, programeve apo strategjive të ndryshme në sektorët e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Akti synon të përafrojë direktivën 2001/42/EC të Parlamentit dhe të Këshillit mbi vlerësimin e efekteve te planeve dhe projekteve për mjedisin si dhe Protokolli "Për Vleresimin Strategjik Mjedisor", ligji do adresojë edhe kërkesa të veçanta të Konventës "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekstin ndërkufitar", Kiev, Ukraine, 22 Maj 2003. Ky P/ligj synon te arrije perafrim te plote te Direktives 2001/42/EC.

Ne kuader te ligjit te ri te vleresimit te ndikimit ne mjedis nr. 10440 date 7.7 2011 jane parashikuar aktet nenligjore si me poshte vijon :

- VKM "Per rregullat, përgjegjësitë dhe afatet për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis". Vendimi do te percaktoje, afatet kohore te porcedures, pergjegjesite dhe rregullat e shqyrtimit te projekteve me ndikim ne mjedis deri ne marrjen e vendimit perfundimtar.
- VKM "Per rregullat, kërkesat dhe procedurat për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore". Vendimi do te percaktoje pergjegjesite e institucioneve/subjekteve dhe proceduren e informimit dhe perfshirjes se publikut ne vendimarrjen mjedisore.
- VKM "Per rregullat dhe procedura për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar". Vendimi do te percaktoje rregullat procedriale te vleresimit te ndikimit ne mjedis ne rast te projekteve me ndikim ne mjedisin nderkufitar ku kerkohet edhe perfshirja e shteteve qe mund te ndikohen nga projekti.
- VKM "Per percaktimin e rregullave, procedurave dhe kritereve per certifikimin e individëve, si specialistë për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor". Vendimi do te percaktoje kriteret e certifikimit te eksperteve te mjedisit qe angazhohen ne vleresimin e ndikimit ne mjedis.

- Udhezim “Metodologjia kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis” Udhezimi synon te lehtesoje zbatimin ne praktike te legjislacionit te vleresimit te ndikimit ne mjedis duke dhene sqarime te hollesishme per palet e perfshira ne procesin e VNM-se. Ne Udhezim do te përcaktohen me hollësi metodikat dhe kërkesat për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis.
- Udhezim “Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të varësisë së ministrisë, në procesin e VNM”. Udhezimi do te saktesoje menyren e zbatimit te procedures se vleresimit te raportit dhe procedures se VNM-se nga strukturat e MMPAU perpara se per projektin me ndikim ne mjedis tejepet nje opinion (deklarate mjedisore) nga MMPAU.
- Udhezim i perbashket “Tarifat për shërbimet që kryen ministria për procesin e VNM-së” (udhëzim i përbashkët të ministrit për mjedisin dhe Ministrit të Financave). Udhezimi do te perckatoje tarifat e sherbimit qe paguhen nga subjektet private apo shteterore per vleresimin e ndikimit ne mjedis.
- Udhezim “Per formatin e duhur për përgatitjen e raportit te zbatimit te ligjit te VNM-se”. Udhezimi do te percaktoje strukturen e raportit te zbatimit te ligjit te vleresimit ne ndikimit ne mjedis. Ne baze te struktures se percktuar do te mblidhet informacion per hartimin e raportit te zbatimit.
    - P/VKM “Për të drejtën e publikut për të patur informacion mjedisor” ;

Aktivitetet Zbatuese

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do të ndërmerren aktivitetet zbatuese të mëposhtme:

- Trajnime te stafit te ARM-te per njohjen dhe zbatimin e akteve ligjore të reja për mbrojtjen e mjedisit;
- Seminar me stafin e ARM-ve për ndërveprimin dhe bashkerendimin me Qendren Kombetare të Liçensave;
- Takime pune me stafin e Agjencise Kombetare te Planifikimit te Territorit per forcimin e bashkerendimin ne zbatimin e legjislacionit te vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe vleresimit strategjik mjedisor;
- Takime pune te ndryshme për rritjen e informimin dhe pjesemarrjes se publikut vendimarrjen mjedisore (VNM).
- Trajnim me pikat e informimit të Ministrive të linjës
- Trajnime të vazhduara me stafin lokal të MMPAU-së (ARM, DSHP, AUB)

Masat Legjislative Afatgjata

Gjate kesaj periudhe do te hartohen disa akte nenligjore te ligjit per vleresimin strategjik mjedisor qe renditen ne vijim.

- VKM ‘Rregullat dhe procedurat per konsultimin/degjesen e publikut dhe autoriteteve me pergjegjesi mjedisore gjate procesit te VSM »
- Udhezim i Ministrit “Metodika kombetare te vleresimit strategjik mjedisor”
- Udhezim i Perbadhket me Ministrine e Finances “Tarifat e sherbimit per shqyrtimin e procedures dhe raportit te VSM nga MMPAU”

- Udhezim i Ministrit "Rregullat dhe procedurat e shqyrtimit te brendshem dhe dhenies se opininit"
- Identifikimi i pikave të kontaktit në ministritë e linjës apo institucioneve të tjera, të cilat janë poseduese të informacionit mjedisor.
- Politika mbështetëse dhe bashkëpunuese me Organizatat Jofitimprurëse, të cilat janë prodhuese dhe poseduese të një informacioni mjedisor mjaft të vlefshëm jo vetëm për publikun, por dhe për organet vendimmarrëse.

Aktivitetet Zbatuese

Për adresimin e prioriteteve afatgjata do të ndërmerren aktivitetet zbatuese të mëposhtme:

- Trajnime me ARM-te per forcimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis
  - Seminare me AKPT per forcimin e integrimit te mjedisit ne procesin e planifikimit (legjislacioni vnm dhe vsm);
  - Takime me qeverisjen vendore dhe qendrore per forcimin e proçesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis;
  - Trajnime të strukturave te MMPAU për rritjen e transparences te vendimarrjes mjedisore (VNM).
  - Forcimi i Bashkëpunimit nëpërmjet Memorandumit të Bashkëpunimi me Organizatatat JoFitimprurëse që veprojnë në fushën e mjedisit.
  - Aktivitetete sensibilizuese të financuara nga MMPAU-ja në bashkëpunim me Organizatat Jofitimprurëse në kuadër të ditëve mjedisore.

Efektet Financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**199.796.000**	**543.877.104**	**110.521.104**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	95.796.000	1.897.000	46.521.000	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	104.000.000	541.980.000	64.000.000	0
Ndryshim	0	-104	-104	0

3.27.3. NDRYSHIMET KLIMATIKE

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe institucioneve të tjera me detyra në këtë fushë, në kuadër edhe të angazhimeve që rrjedhin nga MSA-ja, eshte të hartojë dhe përafroje kuadrin ligjor me atë të BE-së për të zbutur ritmin e rritjes së përqendrimit të gazeve serrë në territorin e saj dhe adaptimin ndaj ndryshimeve të pritshme klimatike.

Ndryshimet Klimatike përbëjnë një sfidë të përmasave globale, e cila kërkon përpjekjen dhe bashkëpunimin e të gjithë vendeve të botës pavarësisht nga kontributi që kanë në përqendrimin e gazeve serrë në atmosferë dhe ndikimet negative nga këto shkarkime. Ne takimet e paleve te Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) te zhvilluara ne Kopenhagen COP 15, Ne Kankun COP16 dhe ne Durban, Afrika e Jugut COP 17, Shqipëria, si Palë në KKKBNK dhe Protokollin të saj të Kiotos ka mbeshtetur qendrimin e Bashkimin Evropian dhe komunitetin ndërkombëtar për të zbutur ndryshimet klimatike.
Nje objektiv specifik eshte hartimi i nje Strategjie Kombetare per adresimin e ndryshimeve klimatike dhe integrimin e ceshtjeve te ndryshimeve klimatike ne sektore te ndryshem te ekonomise se vendit.

Situata aktuale

Shqipëria është anëtarësuar në Konventen Kuader te Kombeve te Bashkuara per Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) në Janar të vitit 1995 ndërsa ne Janar të vitit 2005 Shqipëria u anëtarësua në Protokollin e Kiotos. Duke gëzuar statusin si vend në Aneksin jo I të KKKBNK si dhe të protokollit të saj të Kiotos, Shqipëria nuk ka detyrime të forta për të reduktuar shkarkimet e gazeve serrë. Megjithatë vendi ynë ka për detyrim të formulojë strategji dhe të ndërmarrë veprime që ndihmojnë në reduktimin e ritmit të rritjes së këtyre shkarkimeve. Shqipëria si çdo vend anëtar duhet të raportojë rregullisht mbi nivelin e gazeve që shkarkohen nga territori i saj, shkallën e ndikimit të ndryshimeve klimatike dhe programet për zbutjen e këtyre ndryshimeve, si dhe masat për adaptim ndaj tyre.

Sipas kerkesave baze te KKKBNK, Shqipëria duhet të ndërmarrë veprime për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit, trajnimit, ndërtimit dhe zhvillimit të kapaciteteve për ndryshimet klimatike, dhe të marrë këto të fundit në konsideratë në proçesin e hartimit të politikave të zhvillimit kombëtar e rajonal.

Me ratifikimin e protokollit të Kiotos, Shqipëria ka mundësi të bashkëpunojë me vendet e zhvilluara/industrializuara nëpërmjet Mekanizmit për Zhvillim te Pastër (MZHP), i cili do të mundësojë investime në formë projektesh që bëjnë të mundur transferimin e teknologjive moderne dhe të pastra.

Sipas detyrimeve që ka ndaj KKKBNK, Shqipëria përgatit raportime ose komunikime kombëtare. Komunikimi i Parë Kombëtar ka përfunduar në vitin 2002; Vlerësimi i Nevojave për Teknologji ka përfunduar në 2004; Të gjithë këto projekte/aktivitete janë realizuar me asistencën financiare të Fondit për Mjedisin Global (GEF). Me asistencën e këtij Fondi, u hartua Komunikimi i Dytë Kombëtar, dokumenti i Vlerësimit te nevojave për përgatitjen e Komunikimit të Tretë Kombëtar për KKKBNK dhe janë ne zbatim projektet si me poshtë:

- Zbatimi i projektit te plote (UNDP/GEF: Ndërtimi i kapaciteteve adaptuese në pritje të ndryshimeve të pritshme të klimës në zonën e midis Deltave të lumenjve Drini – Mati);
- Zbatimi i projektit të plotë (UNDP/GEF: Krijimi i tregut të paneleve diellore për ngrohjen e ujit).

Gjithashtu, me mbeshtetjen financiare te Qeverise Austriake permes Agjensise se Zhvillimit ADA u zbatua edhe projekti: “Lehtësimi i procedurave të pjesëmarrjes së Shqipërisë në tregun e karbonit”, produkt i te cilit eshte Dokumenti Politik per Financimet e Karbonit ne Shqiperi, i cili trajton zhvillimet e derimetanishme dhe jep rruget strategjike per ta pozicionuar vendin ne tregun e karbonit dhe ne relevance me zhvillimet e pritshme post Kioto-2012. Ne mbeshtetje te tij eshte hartuar gjithashtu edhe draft Plani Kombetar i Veprimit per zbatimin e ketij dokumenti.

Aktualisht Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, MBUMK e asistuar nga Banka Boterore, ka pergatitur dokumentin mbi programin per Uljen e Vulnerabilitetit ndaj Ndryshimeve Klimatike te Sistemeve Bujqesore ne Shqiperi, ne kuader te Programit Rajonal per Uljen e Vulnerabilitetit ndaj Ndryshimeve Klimatike ne vendet e Evropes dhe Azise Qendrore. Bazuar ne kete dokument ne fazen e trete te projektit do te hartohet nje plan veprimi qe synon pergatitjen e Sektorit Bujqesor Shqiptar per te qene me i qendrueshem ndaj ndryshimeve te klimes, aktuale dhe ato qe parashikohen.

Ministria e Shendetesise ne bashkepunim me institucionet perkatese dhe mbeshtetur nga Organizata Boterore e Shendetesise ka pergatitur draft Strategjine per Adaptimin e Shendetsor Shqiptare ne kuader te ndryshimeve Kimatike.

Komunikimi i Dyte Kombetar (KDK) konsideron tre gazet me efekt serre te drejtperdrejte (CO_2, CH_4 and N_2O) dhe tre gazet me efekt serre jo te drejtperdrejte ose indirekte (CO, NO_x, SO_x and NMVOC). Perveç ketyre jane perfshire vleresimet per HFCs, PFCs dhe SF_6 (keto nuk ishin perfshire ne Komunikimi e Pare Kombetar te Shqiperise). Ne vleresimet per Komunikimin e Dyte Kombetar si vit baze eshte marre viti 2000 dhe jane plotesuar edhe serite kohore 1990 – 2000. Nje rivleresim eshte bere gjithashtu per vitin 1994.

Totali i shkarkimeve te gazeve serre ne Shqiperi per vitin 2000 eshte 7619.90 Gg ose rreth 2.47 ton CO_2 eqv. per fryme. Sektori kryesor emetues eshte Energjia (44.00%) nepermjet transportit, i ndjekur nga Bujqesia (27.12%) dhe Ndryshimi i Perdorimit te Tokes dhe Pyjet (21.60%). Pjesa e kesaj te fundit po ulet gjithnje e me shume, ndersa roli i energjise dhe mbetjeve po rritet. Nga nen-sektoret e energjise, transporti eshte ai me rritje me te shpejte.

Ne KDK per te gjithe sektoret e analizuar jane ndertuar dy skenare: Skenari Baze dhe ai i Reduktimit te gazeve me efekte serre. Viti baze eshte viti 2000 dhe kuadri kohor eshte deri ne vitin 2025. Skenari Baze konsideron zhvillimin e sektoreve pa konsideruar efektin e ndryshimeve klimatike. Skenari i Reduktimit merr ne konsiderate zbatimin e nje seti masash te prioritizuara, duke patur si qellim te arrije nje reduktim te shkarkimeve te gazeve me efektin serre deri ne 48% ne vitin 2025 ne raport me skenarin baze.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Legjislacioni mjedisor në fushën e ndryshimeve klimatike përfshin ligjet dhe aktet që nuk transpozojnë akte komunitare:

- Ligji "Për aderimin e Republikës se Shqipërisë në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike" i Vitit 1994. Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike – Adoptuar 31994D0069 DP15/12/92 (BE)
- Ligji Nr. 9334, Date 16.12.2004 "Për aderimin e Republikës se Shqipërisë në Protokollin e Kiotos". Protokolli i Kiotos i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike – Deklaratë e adoptuar prej 32002D0358
- Ligji Nr. 10431 date 9.06.2011 " Per Mbrojtjen e Mjedisit
- VKM Nr. 1553, Date 26.11.2008 "Për Krijimin e Autoritetit Kombëtar te Përcaktuar te Mekanizmit te Zhvillimit te Pastër ne Kuadër te zbatimit te angazhimeve te Protokollit te Kiotos"
- Urdheri i Ministrit te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave, Nr. 24, Date 10.02.2009 per "Perberjen e Komitetit te Autoritetit Kombetar te Percaktuar (AKP) dhe te Sekretariatit te tij Teknik".
- Vendimi nr. 290, date 28.04.2010 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 453, datë 23.0.2005 "Për miratimin e listës së pajisjeve, që përdorin lëndë ozonholluese, të cilat ndalohen të prodhohen e të importohen, si dhe rregullat e procedurat e zëvendësimit të lëndëve ozonholluese në pajisjet ekzistuese".

Struktura institucionale

MMPAU eshte insitucioni pergjegjes per procesin e hartimit te politikave dhe per zbatimin e masave qe lidhen me Ndryshimet Klimatike ne Shqiperi. MMPAU eshte percaktuar si Autoritetit Kombetar te Percaktuar (AKP) ne kuader te detyrimeve te Protokollit te Kiotos per te ndjekur dhe zbatuar projektet e Mekanizmavet te Zhvillimit te Paster (MZHP) ne Shqiperi. Per kryerjen e funksioneve qe lidhen me rishikimn dhe miratimin e projekteve nen Mekanizmin per Zhvillim te Paster (MZHP) te Protokollit te Kiotos, ne Ministrine e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave funksionon edhe Komiteti i Autoritetit Kombetar te Percaktuar (ne perberje te te cilit jane 7 anetare nen drejtimin e Ministrit te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave) dhe Sekretariati Teknik i tij (ne perberje te te cilit jane 4 anetare).
Ne MMPAU eshte krijuar Sektori I Ajrit, Ndryshimeve Klimatike, Zhurmave dhe Kimikateve (1+2 specialiste), ku 1 specialist mbulon edhe ceshtjet qe lidhen me Ndryshimet Klimatike.
Institucione te tjera të cilat kanë një rol të rëndësishëm në zbatimin e politikës së mjedisit, përfshirë politikën e ndryshimeve klimatike dhe zbatimin e veprimtarive të projekteve te Mekanizmit te Zhvillimit te Paster jane: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Shendetesise, Ministria e Finances, dhe Ministria e Arsimit dhe Shkences.

Nuk ka mandate te percaktuara ne detyrat funksionale te ketyre institucioneve qe te jene ne menyre eksplicite te percaktuara per ndryshimet klimatike. Meqenese Konferencat e Palëve, e Kankunit (COP16) dhe Durbanit (COP 17) krijoi nje regjim te ri per vendet ne zhvillim persa i perket reduktimit, raportimit te shkarkimeve te gazeve serre dhe hartimin e Masave

Perkatese Kombetare Mitiguese per Reduktimin e Gazeve Serre, kjo kerkon nje bashkepunim dhe koordinim te forte nder-institucional per te identifikuar dhe zbatuar keto masa.

Programi i PNUD-it per Ndryshimet Klimatike në Shqipëri, eshte krijuar dhe funksionon prane MMPAU dhe asiston kete ministri ne te gjitha ceshtjet qe lidhen me ndryshimet klimatike. Ai ndihmon ministrine ne te gjitha ceshtjet mbi ndryshimet Klimatike. Ky program menaxhon të gjithë projektet e ekzekutuara nga PNUD-i, si dhe shpërndan të dhënat dhe rezultatet e tyre tek te gjithe grupet e interesit brenda dhe jashte vendit.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Amendimi i VKM nr. 1553, date 26.11.2008, për krijimin e autoritetit kombëtar të përcaktuar të mekanizmit të zhvillimit të pastër, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të protokollit të Kiotos. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU Parashikohet miratimi i tij brenda shtatorit 2012.
- P/Akt "Per reduktimin e permbajtjes se squfurit ne lendet djegese te lengeta", qe transpozon Direktiven 1999/32/EC mbi reduktimin e permbajtjes se squfurit ne disa lende te caktuara djegese te lengeta qe amendon Direktiven 93/12/EC e amenduar nga Rregullorja (EC) 1882/2003 dhe Direktiva 2005/33/EC; Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte METE ne bashkepunim me MMPAU, MPPT, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda 6-mujorit te pare te vitit 2012.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Ngritja e nje grupi nderministror qe te adresoje ceshtjet e ndryshimeve klimatike qe rrjedhin nga KKKBNK dhe Direktivat e BE per Klimen.
- Krijimi i rrjetit nderinstitucional dhe rritja e kapaciteteve per integrimin e ceshtjeve te ndryshimeve klimatike ne strategjite e zhvillimit, planet dhe buxhetet
- Trajnime per rritjen e kapaciteteve për të hartuar inventarin e gazeve serre (GHG)
- Raportimi i inventarit te gazeve serre (viti baze 2000)
- Analiza e zbutjes se GHG;
- Identifikimi i Vulnerabilitetit dhe mundesia per adaptim.
- Zbatimi i projektit të plotë (UNDP/GEF Ndërtimi i kapaciteteve adaptuese në pritje të ndryshimeve të pritshme të klimës në zonën midis lumenjve Drini - Mati) futjes se riskut te Ndryshimeve Klimatike ne planet/programe e zones Deltes se lumit Matit dhe Drin;
- Zbatimi i projektit të plotë (UNDP/GEF Krijimi i tregut të paneleve diellore për ngrohjen e ujit);
- Ngritja e kapaciteteve te përdoruesve te fundit (qytetareve) dhe ndertuesve per të marre në konsideratë integrimin e paneleve diellore per uje te ngrohte ne tipe te ndryshme banesash;

- Hartimi dhe venia ne funksionim e skemes se çertifikimit dhe kontrollit të cilësisë per panelet dhe sistemet diellore per uje te ngrohte

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatmesme synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat legjislative afatmesme janë si vijon;

- Draft akt "Mbi krijimin e mekanizmit te monitorimit te gazeve me efekt serre" qe transpozon Vendimin 280/2004/EC te Parlamentit dhe Keshillit Evropian lidhur me mekanizmin e monitorimit te gazev eserre te Komunitetit dhe zbatimin e Protokollit te Kiotos. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me METE, MPPT, MBUMK, MF. Parashikohet miratimi i tij brenda dhjetorit 2013
- Draft akt "Mbi parandalimin dhe reduktimin e emisioneve te gazeve serre te florinuara" qe transpozon Regulloren EC/842/2006 te Parlamentit dhe Keshillit Evropian date 17 Majit 2006 "Mbi disa gaze serre te florinuar qe amendon Rregulloren EC/1137/2008. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me METE, MF. Parashikohet miratimi i tij brenda dhjetorit 2014
- Draft akt "Mbi skemen e lejuar te tregetimit te gazeve me efekt serre" qe transpozon Direktiven 2003/87/EC te Parlamentit dhe Keshillit Evropian te dates 13 Tetor 2003. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me METE, MF. Parashikohet miratimi i tij brenda dhjetorit 2015

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Pergatitja dhe zbatimi i masave kombetare per reduktimin e gazeve serre, NAMA-s dhe doresimi i tyre prane Sekretariatit te KKKBNK;
- Përgatitjen e Komunikimit te Trete Kombëtar për Konventën e Ndryshimeve Klimatike te Kombeve te Bashkuara (projekti UNDP dhe ministrite e linjes)
- Hartimi I Strategjise Kombetare me Karbon te Ulet (2014)
- Pergatitja e Planit Kombetar per Adaptim ndaj Ndryshimeve Klimatike (2014)
- Zbatimi i projektit (GEF/UNDP Përgatitjen e Komunikimit te Trete Kombëtar për Konventën e Ndryshimeve Klimatike te Kombeve te Bashkuara) (2013)
- Zbatimi i projektit të plotë (UNDP/GEF Krijimi i tregut të paneleve diellore për ngrohjen e ujit).

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 27.1 e ndryshimeve klimatike136

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015

[136] Për më shumë informacion në lidhje me shpenzimet për çdo aktivitet ose institucion të veçantë, ju lutemi konsultoni Shtojcën 3 Vlerësimi financiar i zbatimit të PKZMSA

Kostot totale e vlerësuar	**99.285.000**	**127.212.000**	**99.702.000**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	53.565.000	105.213.000	90.702.000	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	45.720.000	21.999.000	9.000.000	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.27.4. MENAXHIMI I MBETJEVE

Objektivi Strategjik

Objektivi kryesor i Qeverisë Shqiptare në përputhje edhe me angazhimin e marrë në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit është zhvillimi dhe forcimi i bashkëpunimit për të luftuar degradimin mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë në mjedis (neni 108 MSA). Politika Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve do të mbështetet në 4 shtylla kryesore: Planifikimi; Edukimi; Burimet; Legjislacioni.

Draft Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve Mjedisit përcakton drejtimin e politikës së Qeverisë Shqiptare për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve deri në vitin 2025 e ndarë në 3 faza operacionale me nga 5 vjet secila.

Objektivat e kësaj draft strategjie janë:

Deri në vitin 2015 synon riciklimin/kompostimin e 25% të mbetjeve bashkiake; Deri në vitin 2020 synon të ndaloje rritjen e mbetjeve bashkiake të prodhuara; Riciklimin/kompostimin 55% të mbetjeve bashkiake; Deri në 2025: Rikuperimin e energjisë nga 15 % e mbetjeve bashkiake. Reduktimin e mbetjeve bashkiake në lendfill nga 90% qe është aktualisht, në rreth 30%; Objektivat e Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve do të realizohen nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të (i) Planit Kombëtar të Mbetjeve (ii) Planeve Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve (iii) Planeve Lokale të Menaxhimit të Mbetjeve.

Situata aktuale

Gjate vitit 2011 eshte miratuar me VKM nr. 175, datë 19.01.2011 “Strategjia Kombëtare dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve” dhe janë hartuar 5 plane rajonale për menaxhimin e mbetjeve për qarkun e Tiranës, Elbasanit, Durrësit, Vlorës dhe Korçës nga të cilat janë miratuar nga qarqet përkatëse plani i Tiranës dhe i Elbasanit. Në shtator të 2011, është miratuar në parlament ligji ”Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i cili transpozon Direktivën e re Kuadër të Mbetjeve 2008/98/EC. Me qellim plotesimin e kuadrit ligjor per kete fushe jane hartuar 7 akte nënligjore që transpozojnë direktiva të Bashkimit evropiane per fushen e mbetjeve. Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve, Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve, si dhe planet rajonale për këtë qëllim do të jenë baza e informacionit të nevojshëm për planifikimin e ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve, sipas standardeve europiane dhe kërkesave të direktivave që janë transpozuar apo do të transpozohen në vazhdimësi.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) është institucioni kryesor në hartimin e politikës dhe legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve, inspektimin dhe kontrollin e situatës lidhur me zbatimin e ligjit. Në maj të 2011 në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) është krijuar dhe Sektori i Mbetjeve dhe Aksidenteve Industriale (tre punonjës), i cili merret me hartimin e legjislacionit në përputhje me legjislacionin e BE-së. Strukturat e tjera bashkëpunëtore në këtë fushë janë Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK).
Pra, në këtë fushë nevojat janë shumë të mëdha: për asistencë teknike, rritje kapacitetesh si në numër ashtu dhe në cilësi, zgjerim të institucioneve, por dhe ç'është më e rëndësishmja, edhe për investime/ndërtime.

Një ndër objektivat kryesorë për përmirësimin e situatës, për ndërtimin e një sistemi modern dhe të qëndrueshëm në menaxhimin e mbetjeve të ngurta, është edhe përmirësimi i legjislacionit të menaxhimit të mbetjeve nëpërmjet perafrimit të acquis se BE. Ky legjislacion synon:

- Ndërtimi i landfilleve për përpunimin e mbetjeve të ngurta urbane.
- Mbyllja e vend depozitimeve ekzistuese të mbetjeve urbane.
- Hartimi i studimeve të fizibilitetit dhe projekt-zbatimit.

Me plotësimin e këtyre angazhimeve ne sigurojmë një menaxhim të mbetjeve duke ruajtur:

- Mjedisin, eliminuar ndotjen e ujerave nëntokësore, sipërfaqësore, territorit dhe ajrit.
- Zvogëlimin e ndikimit negativ në shëndetin e popullsisë
- Ulen e nivelit te varfërisë.
- Një zhvillim të qëndrueshëm.

Baza ligjore dhe perafrimi i legjislacionit

- Ligji Nr. 8934, Datë 05.09.2002 *"Për mbrojtjen e mjedisit"* i ndryshuar me Ligjin Nr. 9890, Datë 20.3.2008, i ndryshuar me Ligjin Nr.10431, Datë 09.06. 2011. Ligji 10431/2011 ka përafruar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 Prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin" e ndryshuar.
- Ligji Nr. 10463, Datë22.09.2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*" i cili perafron Direktiven kuader te mbetjeve 2008/98 date 19 nentor 2007 "Per mbetjet dhe qe shfuqizon disa Direktiva".
- VKM Nr. 175, Datë 19.01.2011 "*Strategjia dhe Plani Kombëtar i menaxhimit të mbetjeve".*
- Ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 "Mbi mbrojtjen e mjedisit", ndryshuar me ligjin nr. 9890, datë 20.03.2008, ndryshuar meligjin nr. 9983 datë 08.09.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr.10431, datë 09.06.2011.
- Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 "Përmenaxhimin e integruar të mbetjeve".

- VKM nr. 175, datë 19.01.2011 “Strategjia dhe Plani Kombëtar i menaxhimit të mbetjeve”.

Struktura institucionale

Sipas Ligjit Nr. 10463, Date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, menaxhimi i mbetjeve të ngurta është detyre e institucioneve MMPAU, MPPTT, MSH, METE, MBUMK.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU), që tashmë ka një sektor (të përbërë nga 3 persona) që mbulon çështjet e menaxhimit të mbetjeve në tërësi dhe çështjet e aksidenteve industriale, e cila ka për detyrë:

- Të hartojë rregullat/ligjet për menaxhimin e mbetjeve në të gjitha fazat (ndarje, ripërdorim, riciklim, kompostim, hedhje, djegie).
- Jep leje për mbetjet.
- Vendos rregullat për monitorimin dhe inspektimin/kontrollin për zbatimin e akteve lidhur me mbetjet.

Ministria e Punëve Publike, dhe Transportit (MPPT), ka Drejtorinë e Politikave të Mbetjeve të Ngurta (për mbetjet urbane dhe mbetjet e ndërtimit-inerte), pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave për Ujësjellës Kanalizime dhe Mbetjeve të Ngurta. MPPT në zbatim të akteve ligjore ka për detyrë :

- Të monitorojë sasinë vjetore të prodhimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe inerte në rang bashkie, qarku dhe republike si dhe të hartojë Raportin Vjetor, duke e dërguar në MMPAU.
- Ndërtimin e impianteve të përpunimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe inerte.
- Mbylljen e vend depozitimeve ekzistuese, të cilat janë një shqetësim i madh për ndotjen e mjedisit dhe shëndetin e njerëzve.
- Në bashkëpunim me MMPAU të hartojë :
    - Legjislacionin për administrimin e mbetjeve të ngurta urbane.
    - Strategjinë dhe Planin Kombëtar të administrimit të mbetjeve të ngurta.
- Të sigurojë burime financiare për vënien në jetë të politikave për administrimin e mbetjeve të ngurta urbane.

MSH është përgjegjëse për mbetjet spitalore;
METE është përgjegjëse për mbetjet industriale dhe mbetjet e vëllimshme nga industria;
MBUMK është përgjegjëse për mbetjet e bujqësisë dhe të rritjes së kafshëve.

Masat legjislative afatshkurtra

Ne nje perspektive afatshkurter synohet percaktimi me i qarte i kometencave te institucioneve te perfshira ne realizimin e fushes se menaxhimit te mbetjeve, permiresimi i koordinimit te institucioneve te perfshira ne realizimin e fushes se menaxhimit te mbetjeve, permiresimi i

koordinimit nderinstitucional, perafrimi i metejshem i legjislacionit shqiptar me ate te Bashkimit Evropian dhe zbatimi i plote i tij.

Masat kombetare per periudhen afatshkurtër do të jenë:

- P/Vendim "Kriteret dhe rregullat per menaxhimin e mbetjeve bio" (grumbullimi, kompostimi, digjestimi dhe pakesimi i mbetjeve ne landfill).
- P/Vendim "Kostot e menaxhimit te mbetjeve ".
- P/Vendim "Për landfillimin e mbetjeve", i cili do të transpozojë Direktivat 1999/31/EC, Direktivën 1999/31/EC. Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e plotë;
- P/Vendim "Për incinerimin e mbetjeve", i cili do të transpozojë Direktivat 1999/31/EC, Direktivën 2000/76/EC. Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e plote;
- P/Vendim "Për ambalazhimin dhe mbetjet e ambalazheve", i cili do të transpozojë Direktivat 94/62/EC, amenduar nga Direktiva 2004/12/EC, Vendimet e KE 97/129/EC, 2001/524/EC, 2001/171/EC. Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e plotë;
- P/Vendim "Për menaxhimin e baterive te përdorura", i cili do të transpozojë Direktivat 2006/66/EC, 2008/12/EC, 2008/103/EC, Vendimi i Komisionit 2008/763/EC. Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e pjesshme;
- P/Vendim "Për mbetjet elektrike dhe elektronike", i cili do të transpozojë Direktivën 2002/96/EC (WEEE), 2003/108/EC (WEEE);. Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e plotë.
- P/Vendim "Për administrimin e vajrave te përdorur", e cila do të transpozojë direktivën 75/439/EEC. Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e plotë;
- P/Ligj "Për automjetet në fund të jetës", i cili transpozon Direktivën e Automjeteve ne Fund te jetës te Parlamentit dhe Këshillit Evropian 2002/53/EC). Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e plotë.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Zbatimi i projektit CARDS për zbatimin e PKZMSA, i cili ka një komponent për hartimin e planit kombëtar te menaxhimit te mbetjeve urbane dhe te rrezikshme.
- Klasifikimi i landfilleve.
- Përcaktimi i kërkesave te aplikimeve për leje mjedisi për landfillet.
- Përcaktimi i kushteve për leje mjedisi për landfillet.
- Përcaktimi i procedurave te pranimit te mbetjeve ne landfill.
- Përcaktimi i një mekanizmi për llogaritjen e kostos se landfillit.
- Marrja e masave që landfillet të mbyllen vetëm në përputhje me procedurat e specifikuara dhe të jenë nën kontroll edhe pas mbylljes.
- Subjekteve që merren me landfillet/fushat e depozitimit ekzistuese t'ju kërkohet hartimi i planeve të masave për përshtatjen me kërkesat e direktivës së landfillit.
- Ngritja e një database dhe mekanizmi raportimi me informacion për landfillet.
- Zhvillimi i një workshopi për administrimin e vajrave të përdorura.
- Studime dhe përkthime të direktivave për kompostimin e mbetjeve.

- Grumbullimi i të dhënave sasiore për makinat jashtë përdorimit, mënyrën e zbërthimit dhe ruajtjes së pjesëve përbërëse dhe pajisjen me leje mjedisore të tyre.

Masat ligjislative afatmesme

Për nje perspektive afatmesem synohet permiresimi i koordinimit nderinstitucional, perafrimi i metejshem i legjislacionit shqiptar me ate te Bashkimir Evropian dhe zbatimi i plote i tij.

- P/Vendim "Për mbetjet portuale (nga anijet)", i cili do të transpozojë Direktivën 2000/59/EC. Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e pjesshme.
- P/Akt qe transpozon Rregulloren (EC) No. 1013/2006 të Parlamentit dhe Këshillit te Evropës të 14 Qershorit 2006 mbi transportin e mbetjeve, e amenduar nga Rregullorja e Komisionit (EC) No 1379/2007.
- P/Vendim "Për llumrat e kanalizimeve",i cili do të transpozojë Direktivën 91/271/EC.
- P/Vendim "Për dioksidin e titaniumit", i cili do të transpozojë Direktivat 78/176/EC; 82/883/EC; 92/112/EC.
- P/Vendim "Për mbetjet minerare",i cili do të transpozojë Direktivën 2006/21/EC.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Studime dhe përkthime të direktivave për mbetjet portuale;
- Bashkepunim i ngushte me institucionet qendrore qe gjenerojne mbetje, per perpunimin dhe riciklimin e tyre.
- Bashkepunim me institucionet nderkombetare (Banka Boterore, kfW, JICA, SIDA, etj) per permiresimin e legjislacionit, ndergjegjesimin e komunitetit, ndertimin e impianteve pilot per riciklimin e mbetjeve te ngurta, ndertimin apo mbylljen e landfilleve.
- Bashkepunimi me shoqaten e ricikluesve per venien ne jete te objektivit per riciklimin e mbetjeve te letres, qelqit, plastikes, metaleve, bio deri ne vitin 2018, bazuar ne Planin Kombetar te Menaxhimit te Mbetjeve.
- Përmirësimi i komunikimit dhe ndërgjegjësimit
- Përmirësimi i sistemit te monitorimit.

Efektet Financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**0**	**38.474.000**	**39.960.000**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	0	38.474.000	39.960.000	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.27.5. MENAXHIMI I UJIT

Objekti strategjik

Objekti strategjik i Qeverise Shqiptare Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe institucioneve të tjera me detyra në këtë fushë eshte mireadministrimi,

shfrytezimi sa me racional i burimeve ujore, permiresimi i mjedisit ujor, mbrojtja e ujerave siperfaqesore te brendshem, ujerave te perkohshem, ujerave bregdetare, nentokesore dhe statusin e tyre nepermjet krijimit te nje kuadri ligjor ne perputhje te plote me direktivat kuader te Bashkimit Europian, per mbrojtjen dhe perdorimin e qendrueshem te burimeve ujore, bazuar ne nevojen per te parandaluar perkeqesimin e metejshem te cilesise dhe sasise te tyre.

Qeveria Shqiptare synon zhvillimin e infrastruktures dhe permiresimin e sherbimeve vitale qe lidhen me to si prioritet per te stimuluar nje rritje te qendrueshme ekonomike, ruajtjen e mjedisit dhe rritjen e mivelit te jeteses ne vend.

Shqipëria, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të ndërmarra në dokumentin e Partneritetit, synon të zhvillojë dhe zbatojë strategjinë kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Sanitetit si dhe Strategjinë Rurale të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve. Do të zhvillohet dhe të niset zbatimi i një strategjie për harmonizimin progresiv me *acquis* në fushën e furnizimit me ujë dhe higjienës, që do të përafrojë legjislacionin kombetar me standardet europiane të cilësisë së ujërave në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Fusha e Menaxhimit te Ujerave eshte nje nga fushat prioritare ne kuader te proçesit te integrimit, detyrimet e se ciles ne pergjithesi percaktohen ne nenin 70/3 te Marreveshjes se Stabilizim-Asociimit, i cili parashikon domosdoshmerine e perafrimit te legjislacionit vendas me "*acquis e Bashkimit Evropian*". Nderkohe qe neni 108 i MSA ve theksin ne zhvillimin dhe bashkepunimin e paleve me qellim qe te promovojne qendrueshmerine mjedisore.

Ky objektiv do te realizohet nepermjet:

- Permiresimit te legjislacionit ne fushen e cilesise se ujerave, ne perputhje te plote me ate europian;
- Forcimin e kapaciteteve ne nivel qendror dhe vendor me qellim sigurimin e zbatimit te legjislacionit dhe arritjen e objektivave ne fushen e manxhimit te burimeve ujore.

Situata Aktuale

Ne fushen e administrimit te ujerave jane hartuar nje sere aktesh ligjore e nenligjore te cilat mbeshteten ne direktivat e BE-se si dhe konventat e ndryshme nderkombetare.

Ligji baze ne fushen e administrimit te ujerave eshte Ligji Nr. 8093, Date 21.3.1996 "Per Rezervat Ujore" i cili eshte pjeserisht i perafruar me direktivat dhe rregulloret e BE-se. Prioritet per të ardhmen mbetet plotesimi i kuadrit ligjor që do synojne thellimin e mëtejshëm të perafrimit te direktivave te BE-se për cilesine e ujerave.

Referuar Ligjit Nr. 8093, Date 21.03.1996, "Per Rezervat Ujore", administrimi i burimeve ujore ne Republiken e Shqiperise kryhet nga Keshilli Kombetar i Ujit (KKU), nga Sekretariati Teknik i KKU-se (aktualisht Drejtoria e Pergjithshme e Administrimit te Ujerave), dhe nga autoritetet e baseneve ne nivel lokal (KBU, AUB). Ne 26 Shkurt te 2011, ne kuader te forcimit te kapaciteteteve ne nivel qendror u krijua Drejtoria e Pergjithshme e

Administrimit te Ujerave (DPAU) prane Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave e cila luan rolin e Sekretariatit Teknik te KKU-se. Në përgjithësi, institucionet pergjegjese për menaxhimin e burimeve ujore janë shumë të dobëta. Nevojat për ngritjen e kapaciteteve përfshijnë një sërë ndërhyrjesh: trajnimin e stafit e AUB-ve dhe KBU-ve si dhe anëtarët e tyre, përmirësimin e infrastrukturës së zyrave, transportit, mjeteve për menaxhimin e burimeve ujore (bazën e të dhënave / sistemin GIS, modelimin, monitorimi, etj).

Per te permiresuar kete situate, jane realizuar nje sere masash. Aktualisht, ka perfunduar hartimi i draft ligjit te ri ‘’Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore’’ i cili u pergatit me mbeshtetjen e projektit te KE “Plani Kombetar i Zbatimit te Legjislacionit Mjedisor ne Shqiperi” (INPAEL) financuar nga CARDS 2006, mbi bazen e Direktives Kuader te Ujit te Parlamentit Europian Nr 2000/60, Date 23 Tetor 2000. Ne vazhdim, ka perfunduar drafti i Planit Pilot te Menaxhimit te Basenit te Lumit Mat i cili mbeshtetet ne Aneksin VII te Direktives Kuader te Ujit te BE-se.
Me asistencen e Bankes Boterore ka perfunduar draft Leter Pozicionin, ne kuader te projektit ‘’Per Rezervat Ujore dhe Ujitjen’’. Komponenti i (iii) i ketij projekti Mbeshtetje institucionale per menaxhimin e integruar te burimeve ujore perfshin keto nen-komponente:

- Mbeshtetje per pergatitjen e Strategjise se menaxhimit te integruar te burimeve ujore;
- Forcimi i kuadrit institucional;
- Pergatitja e planeve te menaxhimit te baseneve ujembledhese Drin-Bune dhe Seman.

Me tej, me mbeshtetjen e Qeverise Italiane ka perfunduar «Projekti i Monitorimit te Burimeve Ujore per Basenin e Lumit te *Erzenit*», si dhe eshte rene dakord per vazhdimin e ketij projekti edhe per hartimin e nje plani menaxhimi per Basenin *Ishem* - *Erzen* ne perputhje me Direktiven Kuader te Ujit te BE-se.

DPAU-ja është duke pare mundësinë e hartimit të planeve të menaxhimit për të tre basenet ujëmbledhëse (Vjosa, Shkumbin dhe Ishem-Erzen) nga buxheti i shtetit si dhe nga donatorë të ndryshëm. Eshte miratuar Vendimi i KKU Nr.1, Date 07.07.2011 ’’Per ndalimin e shfrytezimit te zhavorreve dhe inerteve te lumenjve’’.

Per nje administrim te mire te rezervave ujore eshte hartuar dhe do te paraqitet ne KKU per miratim, regjistri i lejeve te rezerves ujore dhe te inerteve lumore duke krijuar nje data base. Te dhenat e ketij regjistri do te sherbejne per hartimin e kadastres elektronike te burimeve ujore ne Shqiperi.

Ne lidhje me administrimin e burimeve ujore nderkufitare jane zhvilluar aktivitete te ndryshme, si: arritja e nje marreveshje bashkepunimi midis Republikes se Shqiperise dhe asaj te Malit te Zi (2001); midis Republikes se Shqiperise dhe Greqise (2003). Gjate vitit 2010 - 2011 jane mbajtur kater (4) takime dypaleshe te Komisioneve Ndershteterore midis Republikes se Shqiperise dhe Republikes se Malit te Zi ne kuader te Memorandumit te Mirekuptimit ‘’Per Realizimin e masave per rregullimin e regjimit ujor te pellgut ujembledhes te liqenit te Shkodres, lumit te Bunes dhe Drinit’’, firmosur me 14 Dhjetor 2010 ndermjet Ministrise se Bujqesise, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave te Malit te Zi, dhe Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave te Shqiperise. Me 25 Nentor

2011 ne Tirane u firmos Memorandumi i Mirekuptimit per 'Drinin: Nje vizion i perbashket strategjik'', midis Republikes se Shqiperise, Republikes se Maqedonise, Republikes se Kosoves, Republikes se Greqise dhe Republikes se Malit te Zi, me qellim promovimin e veprimeve te perbashketa per menaxhimin e integruar te burimeve ujore ne basenin e Drinit si nje menyre per te ruajtur ekosistemet dhe sherbimet qe ato ofrojne, si dhe per te promovuar zhvillimin e qendrueshem ne kete basen.

Per sa i perket ujit te pijshem, përafrimi i legjislacionit me legjislacionin aktual Europian ka mbetur prapa. Në kuadër të prioriteteve dhe detyrimeve të MSh, është parashikuar që deri në gusht të vitit 2012 të përgatitet dhe miratohet në KM projekt-rregullorja e ujit te pijshem ne përafrim me direktivën 98/83/EC të Këshillit Europian "Mbi cilësinë e ujit me qëllim konsumimi nga njerëzit" (O.J. No. L 330, 5.12.1998, p. 32). Përafrimi i legjislacionit në fjalë do të jetë i pjesshëm, për shkak të disa të drejtave dhe detyrimeve që i lindin Shqipërisë pas hyrjes në BE. Përafrimi i plotë do të realizohet me amendimet e mëtejshme të kësaj VKM.Përgjegjës për zbatimin e kësaj VKM do të jenë Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave si dhe Njësitë e Pushtetit Vendor.Kapacitetet sasiore dhe cilësore për zbatimin e kësaj VKM nuk janë të mjaftueshme.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Kuadri ligjor kryesor ne te cilin mbeshtetet menaxhimi i ujerave eshte:

- Ligji Nr 8093, datë 21.03.1996 "Për Rezervat Ujore**"**, (Fletore Zyrtare Viti 1996, nr 12, faqe 507; data e botimit 06.05.1996). Ky ligj ka per objekt "Rezervat Ujore" qe perfshijne te gjitha ujerat e brendshme detare, siperfaqesore e nentokesore, ujerat e shirave, ujërat e zeza, shtretërit, brigjet e lumenjve dhe rrjedhjet ujore,
- Ligji Nr 9115, Datë 24.7.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura" i cili perafron direktiven 91/271/EEC te BE-se.
- Ligji Nr. 7643, date 02.12.1992 "Per shendetin Publik dhe Inspektoratin Sanitar Shteteror", i ndryshuar (Fletore Zyrtare Viti 1992, Nr 9, Faqe 464, Data 28.01.1993), percakton organizimin dhe kompetencat e Inspektoratit Sanitar Shtetëror si dhe kundervajtjet administrative sanitare. Ai siguron survejimin dhe sigurine e shperndarjes se ujit per qellime pirjeje, per te siguruar shendetin dhe higjenen.
- Ligji Nr. 9103, Date 10.7.2003, "Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare" (Fletore Zyrtare Viti 2003, Nr 65, Faqe 2895, data e botimit 04.08.2003), synon mbrojtjen mjedisore te liqeneve, te gjendjes se tyre natyrore, duke garantuar kushtet perkatese per zhvillimin e jetes dhe ekosistemit ne 3 liqenet, Liqeni i Shkodres, i Ohrit dhe i Prespes.
- VKM Nr. 124, Datë 2.03.2006 "Për krijimin e Komisionit Qeveritar për problemet ujore me vendet fqinjë"; Fletorja Zyrtare: Viti 2006, Nr 19, Faqe 622; Data e botimit: 09-03-2006). Te dy keto akte ligjore jane ne zbatim te Konventes per vleresimin e ndikimit ne mjedis ne kontekst nderkufitar (Espoo), Konventes per mbrojtjen dhe perdorimin e ujerave nderkufitare dhe liqeneve nderkombetare (UNECE) me protokollet e saj.

- Ligji Nr. 8905, date 6.06.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe demtimi”. Ky akt ligjor synon mbrojtjen e mjedisit detar te Republikes se Shqiperise nga ndotjet e demtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre, te shkaktuara nga veprimtarite njerezore ne det e ne zonen bregdetare, te cilat prishin cilesine e ujit, demtojne burimet e detare, rrezikojne faunen dhe floren, kercenojne shendetin e njeriut si dhe veshtiresojne zhvillimin normal te veprimtarive ne kete mjedis.
- Ligji Nr. 8102 datë 28.3.1996 mbi “Kuadrin rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimin e ujerave te ndotura”, i ndryshuar (Fletore Zyrtare Viti 1996, Nr 14, faqe 581, data e botimit 09.05.1996), vendos nje kuader rregullator te pavarur per furnizimin me uje dhe largimin dhe perpunimin e ujerave te ndotura.
- Ligji Nr 8934, date 5.09.2002 ,“Per mbrojtjen e Mjedisit”, (Fletorja Zyrtare: Viti 2002, Nr 60, Faqe 1673; Data e botimit: 16-10-2002.
- Kuadri ligjor për ujin e pijshëm konsiston kryesisht në VKM Nr 145, datë 26.02.1998 "Për miratimin e rregullores higjeniko-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm", që rregullon kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm të furnizuar në popullatë. Kjo VKM bazohet në udhëzimet e OBSh-së dhe Direktivën e Këshillit 80/778/EEC të 15 Korrikut 1980 në lidhje me cilësinë e ujit për konsum nga njerëzit (OJ L 229, 30.8.1980, f. 11).

Akte ligjore te tjera të fushës së ujit të pijshëm që transpozojnë akte komunitare:

- VKM Nr 609, datë 17.11.2000 "Për industrializimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale", që përafron pjesërisht Direktivën 80/777/EEC “Për përafrimin e legjislacionit të Shteteve Anëtare në lidhje me shfrytëzimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale” (OJ L 229, 30.8.1980, p. 1).
- VKM Nr. 835, date 30.11.2011 për miratimin e rregullores “Për kërkesat higjieno-sanitare të pishinave”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 150, datë 11.11.2010. Kjo VKM përafron pjesërisht Direktivën 2006/7/BE te Parlamentit dhe te Keshillit Europian, i dates 15 shkurt 2006, lidhur me administrimin e cilesise se ujerave te larjes, qe shfuqizon Direktiven 76/160/KEE.

Ne zbatim te Ligjit nr 8906, date 6.06.2002 “Per Zonat e mbtrojtura jane miratuar disa Vendime te Keshillit te Ministrave, per shpalljen e zonave te mbrojtura qe perfshijne edhe siperfaqe ujore:

- VKM nr.413, datë 22.8.1994 “Për shpalljen e lagunës së Karavastasë dhe parkut të Divjakës si ekosistem natyror veçanërisht i mbrojtur për t’u përfshirë në listën e konventës së Ramsarit”, (Fletorja Zyrtare Nr.17, Viti 1994, Faqe 17.
- VKM nr. 80, datë 18.02.1999 "Për shpalljen "Park Kombëtar" të Prespës dhe "Peizazhi i Mbrojtur Tokësor/Ujor" të Pogradecit", Fletorja Zyrtare Nr. Ekstra Gusht, Viti 2000, Faqe 139, Data e botimit 28.08.2000.
- VKM nr. 82, nr. 82, datë 2.3.2000 “Për shpalljen park kombëtar në mbrojtje të shtetit të zonës arkeologjike të Butrintit”, Fletorja Zyrtare Nr 15, Viti 2000, Faqe 714, Data e botimit 21.06.2000.
- VKM nr. 531, datë 31.10.2002, “Për shpalljen ekompleksit ligatinor të Butrintit dhe të territorit përreth tij zonë natyrore veçanërisht e mbrojtur dhe përfshirjen e tij në listën

e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujore", Fletorja Zyrtare Nr.70, Viti 2002, Faqe 1969, Data e botimit 12.11.2002.

- VKM nr. 680, date 22.10.2004 "Për shpalljen e sistemit ligatinor Vjosë-Nartë "Peizazh Ujor/Tokësor i Mbrojtur", Fletorja Zyrtare Nr. 77, Viti 2004, Faqe 5764, Data e botimit 29.10.2004.
- VKM nr. 682, datë 02.11.2005 "Për shpalljen e lumit Buna dhe të territoreve ligatinore përreth tij "Peizazhi ujor/tokësor i mbrojtur", Fletorja Zyrtare Nr. 91, Viti 2005, faqe 2907, Data e botimit 01.12.2005.
- VKM nr. 683, datë 02.11.2005 "Për shpalljen e kompleksit ligatinor të liqenit të Shkodrës e të zonës së lumit Buna, zonë natyrore veçanerisht e mbrojtur, dhe përfshirjen e tij në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë", Fletorja Zyrtare Nr. 91, Viti 2005, faqe 2910, Data e botimit 01.12.2005.
- VKM nr. 684, datë 02.11.2005 "Për shpalljen e zonës shqiptare të liqenit të Shkodrës "Rezervat natyror i menaxhuar", Fletorja Zyrtare Nr.91, Viti 2005, faqe 2912, Data e botimit 01.12.2005.
- VKM nr. 693, date 10.11.2005 "Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit "Park Kombëtar", Fletorja Zyrtare Nr.91, Viti 2005, faqe 2913, Data e botimit 01.12.2005.
- VKM nr. 687, datë 19.10.2007 "Per shpalljen, me siperfaqe te zgjeruara, te ekosistemit natyror Divjake-Karavasta "Park Kombetar", Fletorja Zyrtare Nr.144, Viti 2007, faqe 4017, Data e botimit 30.10.2007, Viti 2008, Nr 87, Faqe 3824, Data e botimit 11.06.2008.
- Eshte miratuar Vendimi i KKU-se Nr. 2, date 21.11.2010 "Per shpalljen e zones ujembledhese te burimit te Bogoves, si zone e mbrojtjes se veçante".
- Ne 14.09.2011, eshte miratuar VKM Nr. 643 "Per miratimin e Strategjise Kombetare Sektoriale te Sherbimeve te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve, per Ujesjelles-Kanalizimet" (fletore zyrtare Nr. 141, 17.10.2011)
- VKM nr. 660 "Për transferimin e shoqërive ujësjellës kanalizime pranë njësive te qeverisjes vendore". Fletorja Zyrtare Nr.141, Data e botimit 24.10.2007
- VKM nr. 677, date 3.10.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne VKM. Nr.642, date 11.10.2005 të Këshillit të Ministrave për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore" Fletorja Zyrtare Nr.146 , Data e botimit 2.11.2007
- VKM nr. 678, date 3.10.2007 "Për një shtese ne VKM nr.271, datë 9.05.1998 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statutit tip te shoqërive anonime, shtetërore" Fletorja Zyrtare Nr.146 , Data e botimit 2.11.2007
- VKM nr.1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e modelit të rregullores "Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve, sh.a."" Fletorja Zyrtare Nr.197 , Data e botimit dhjetor 2009.

Struktura Institucionale

Institucionet e përfshira në mbrojtjen e cilesise se ujerave janë Ministria e Mjedisit dhe institucionet e varësisë së saj, Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, Ministria e Puneve Publike dhe Transportit, Ministria e Shendetesise dhe institucionet e varësisë së tyre si dhe organet e qeverisjes vendore.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave eshte institucioni pergjegjes per hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive, planeve kombetare dhe legjislacionit per mbrojtjen e rezervave ujore nga ndotja, shfrytezimin sa me racional te burimeve ujore, permiresimin e mjedisit ujor, mbrojtjen e ujerave siperfaqesore te brendshem, ujerave te perkohshem, ujerave bregdetare, nentokesore dhe statusin e tyre.

KKU eshte organi qendror vendim-marres per administrimin e rezervave ujore (neni 6 i Ligjit 8903/1996) dhe drejtohet nga Kryetari i Keshillit te Ministrave. KKU miraton strategjine kombetare te ujit dhe planin kombetar te rezervave ujore. Ne zbatim te ligjit ka dale VKM Nr. 125, Date 2.03.2006 "Per krijimin e Keshillit Kombetar te Ujit", i cili percakton se KKU perfshin 7 ministra qe menaxhojne probleme te ndryshme te fushes se ujit. Ne kete menyre KKU ofron nje forum te nivelit shume te larte brenda te cilit çeshtjet e planifikimit dhe administrimit te rezervave ujore mund te diskutohen ne nje menyre te integruar.
DPAU (Sekretariati Teknik) prane Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave) eshte organ ekzekutiv i KKU-se, dhe perbehet nga tre drejtorite e saj:

- Drejtoria e politikave te Ujit (1 + 6)
    - Sektori i Menaxhimit dhe Planifikimit (1 + 2)
    - Sektori i GIS dhe i arkives elektronike (1 + 2)
- Drejtoria Teknike (1 + 4)
- Drejtoria e Peshkimit (1 + 5)
    - Sektori i Peshkimit dhe Akuakultures (1 + 1)
    - Sektori i Menaxhimit dhe Planifikimit (1 + 2)

KBU-te jane autoritetet lokale pergjegjese per administrimin e rezervave ujore ne basenet perkatese. KBU-te drejtohen nga Prefekti dhe perbehen nga 9-19 anetare, perfaqesues keto te ministrive, bizneseve, si dhe perfaqesues te kufizuar te perdoruesve.

AUB-te jane krijuar nga KKU-ja. Aktualisht ne Shqiperi jane krijuar 6 AUB-te, detyrat e te cilave miratuar nga KKU me Vendimin Nr. 3 date 19.7.2002. Numri total i punonjesve profesioniste eshte 23, ku 8 (tete) punonjes jane ne AUB Ishem-Erzen dhe AUB-te e tjera jane te plotesuara me 3 (tre) punonjes.

MPPT mbulon problemet e furnizimit me uje, ujesjelles kanalizime, si dhe problemet e digave te medha. Institucionet pergjegjese per menaxhimin e ujit te pijshem jane MMPT, MMPAU, MBUMK, MSH, etj. Disa departamente brenda kesaj ministrie jane pergjegjese ne lidhje me politikat ne sektorin e ujit, veçanerisht per sa i perket sektorit te furnizimit me uje dhe kanalizimeve, ku perfshihet Drejtoria e Politikave te Rajonalizimit dhe Ujesjelles Kanalizimeve, si dhe Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles-Kanalizimeve. Kjo drejtori merr pjese ne hartimin e project programeve te investimeve ne perputhje me strategjine dhe politiken e Qeverise, si dhe merr pjese ne hartimin e politikave dhe reformave ligjore e institucionale per sektorin e ujesjelles-kanalizimeve. Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles Kanalizimeve (DPUK) eshte institucion ne varesi te MPPT, e cila mbeshtet teknikisht politikat e MPPT-se ne kete fushe ne perputhje me legjislacionin dhe politikat e qeverise te percaktuara ne strategjite sektoriale. Ne nivel lokal, kjo ministri mbeshtetet nga Ndermarjet e Ujesjelles - Kanalizimeve sh.a.

MBUMK mbulon problemet e perdorimit te ujit per ujitje. Kjo ministri e konsideron ujitjen dhe kullimin si faktor te rendesishem me ndikim te ndjeshem ne rritjen e qendrueshme te prodhimit bujqesor ne vendin tone duke synuar drejt nje mjedisi te pandotur. Keto pergjegjesi kjo ministri i mbulon nepermjet Bordeve te Kullimit te ngritura ne nivel lokal.

MSH është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm të furnizuar në popullatë. dhe eshte e perfshire ne zbatimin e legjislacionit ne sektorin e ujit nepermjet Inspektoriatit Shteteror Sanitar te saj. Ky inspektoriat eshte pergjegjes per vendosjen e standardeve te ujit te pijshem dhe per sigurimin e pajtueshmerise me keto standarde. Ato kryejne monitorime rutine te cilesise se ujit te pijshem.
Këtë përgjegjësi MSh e realizon nëpërmjet:

- Sektorit të Higjienë-Epidemiologjisë në MSh
- Institutit të Shëndetit Publik, Tiranë
- Autoritetit Shëndetësor Rajonal Tiranë, Drejtorive Rajonale të Shëndetësisë dhe Drejtorive të Shëndetit Publik në rrethe (Inspektorati Sanitar Shtetëror).
- Njësitë e Pushtetit Vendor, kanë për detyrë që të sigurojnë furnizimin e popullatës me ujë të pijshëm të shëndetshëm dhe të pastër, dhe marrjen e masave konstruktive dhe higjieniko-shëndetësore, sipas detyrave të lëna nga Inspektorati Sanitar Shtetëror gjatë inspektimit.

METE luan nje rol te rendesishem ne sektorin e ujit meqenese ajo eshte pergjegjese per prodhimin e energjise elektrike ne hidrocentrale, e cila perfaqeson mbi 90% te kapacitetit te instaluar prodhues. Kjo ministri eshte pergjegjese per miratimin e centraleve te reja hidrike.
MB eshte institucioni kyç ne lidhje me delegimin e kompetencave territoriale dhe ne hartimin e reformave. Drejtoria perkatese eshte Drejtoria e Pergjithshme e Politikave te Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit. Kjo ministri mundeson lidhjen ndermjet pushtetit vendor dhe atij qendror. Kjo ministri ka ne perberje te saj edhe drejtorine e emergjencave civile e cila mbulon çeshtjet e emergjencave, si permbytjet, zjarret, termetet, etj.

MF eshte pergjegjese per shperndarjen e financimeve per sektorin e ujerave. Keshtu ajo i jep prioritet nevojave per menaxhimin e burimeve ujore duke i pershtatur me nevojat e shoqerise.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përcaktimi më i qartë i kompetencave të institucioneve të përfshira në realizimin e administrimit te burimeve ujore, përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë te Bashkimit Evropian dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat ligjore per periudhen afatshkurter do te jene:

- Miratimi i Pr/Ligjit te Ri “Per Menaxhimin e Integruar te Burimeve Ujore”, i cili eshte hartuar ne bashkepunim me MPPT, METE, MBUMK dhe MSH. Ky Pr/ligj do te transpozoje kerkesat e Direktives Kuader te Ujit te BE-se 2000/60/EC, Direktiven

per Mbrojtjen e ujerave nentokesore nga ndotja dhe perkeqesimi 2006/118/EC, dhe Direktiven per Vleresimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga permbytjet 2007/60/EC. Ky ligj eshte parashikuar te miratohet ne Qershor 2012.

- Amendimi i VKM nr. 1189, date 18.11.2009 dhe miratimi i VKM mbi " Vendosjen e sistemit te integruar te monitorimit mjedisor" (Projekti CEMSA ne bashkepunim me AMP);
- Hartimi i "Planeve te Menaxhimit te Ujit" per Basenet Ujembledhese Drin – Bune dhe Seman, ne zbatim te kerkesave te Direktives Kuader te Ujit 2000/60/EC., dhe Direktives se permbytjeve 2007/60/EC. Institucioni pergjegjes per hartimin e ketyre planeve do te jete MMPAU ne bashkepunim me institucionet e tjera ne nivel lokal dhe qendror.
- Miratimi i Projekt VKM per ''Permbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjise kombetare per ujerat, planeve te menaxhimit te baseneve te lumenjve dhe planeve te menaxhimit te rrezikut nga permbytjet. Kjo Pr/VKM do te transpozoje kerkesat e Direktives Kuader te Ujit te BE-se 2000/60/EC, Direktiven per Vleresimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga permbytjet 2007/60/EC, Direktiven per Percaktimin e specifikimeve teknike per analizat kimike dhe monitorimin e statusit te tyre 2009/90/EC, si dhe Direktiven Per mbrojtjen e ujerave nentokesore ndaj ndotjes dhe perkeqesimit 2006/118/EC. Institucioni pergjegjes per miratimin e ketij akti nenligjor eshte MMPAU. Ky Pr/VKM eshte parashikuar te miratohet ne Nentor 2012.
- Miratimi i Projekt VKM ''Per trajtimin e ujerave te perdorura urbane''. Insitucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim. Ky vendim do te transpozoje Direktiven per trajtimin e ujerave te perdorur urbane 91/271/EEC, amenduar nga Direktiva 98/15/EC, Rregullorja EC/1882/2003 dhe Rregullorja EC/1137/2008. Ky vendim eshte parashikuar te miratohet ne Dhjetor 2012.
- Miratimi i Projekt VKM ''Per normat e cilesise se mjedisit per ujerat siperfaqesore''. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU. Ky Pr/VKM do te transpozoje Direktiven per standartet e cilesise se mjedisit ne fushen e politikes se ujerave 2008/105/EC. Ky akt eshte parashikuar per mmiratim ne Dhjetor 2012.
- Miratimi i Projekt VKM per ''Listen e substancave prioritare''. Institucioni pergjegjes per miratimin e ketij vendimi eshte MMPAU. Nderkohe ky vendim do te transpozoje Aneksin X te Direktives Kuader te Ujit 2000/60/EC. Afati i parashikuar per miratimin e tij eshte Dhjetor 2012.
- Miratimi i Projekt VKKU-se "Plani i menaxhimit te basenit te Matit", i cili transpozon Direktiven Kuader te Ujit 2000/60/EC. Institucioni pergjegjes per miratimin e tij eshte MMPAU, dhe ky Pr/VKKU eshte parashikukar te miratohet ne Nentor 2012.
- Nenshkrimi i marreveshjes per menaxhimin e ujerave nderkufitare me Republiken e Kosoves, ne baze te Ligjit Nr. 9103, Date 10.7.2003, "Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare" dhe ne zbatim te VKM Nr. 124, Datë 2.03.2006 "Për krijimin e Komisionit Qeveritar për problemet ujore me vendet fqinjë". Institucioni pergjegjes per kete eshte MMPAU. Kjo marreveshje eshte parashikuar te arrihet ne Dhjetor 2012.
- Projekt-VKM per miratimin e rregullores për ujin e pijshëm në përafrim të pjesshëm të Direktivës së Këshillit 80/778/EEC. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij

akti eshte MSh ne bashkepunim me MBUMK, MPPT dhe MMPAU. Miratimi i tij parashikohet deri në gusht të vitit 2012

Aktivitetet zbatuese afatshkurter

- Miratimi i planit te masave per zbatimin e PMBM;
- Hartimi i termave te refernces per krijimin e Kadasters elektronike te basenit te Matit;
- Grumbullimi i te dhenave, pergatitja e hartave GIS;
- Trajnimi i stafit dhe gjithe aktoreve nderinstitucional, mbi zbatimin e Plan Menaxhimit te Basenit Ujembledhes Mat si dhe forcimin e kapaciteteve ne nivel lokal
- Trajnime per permiresimin e raportimit te dhenave ne Agjencine Europiane te Mjedisit ne fushen e ujerave;
- Identifikimi dhe pajisja me leje shfrytezimi per rezervat ujore per 35 subjekte;
- Hartimi i grafikut te perfundimit ose reduktimit te lejeve per shfrytezim inertesh lumore;
- Perditesimi i regjistrit te lejeve te shfrytezimit te ujerave dhe atyre te inerteve lumore;
- Ndjekja dhe monitorimi i likuidimit te detyrimeve financiare te subjekteve qe shfyrtezojne inerte lumore dhe ujera;
- Takime rajonale mbi ndergjegjesimin e Autoriteteve Lokale, Shoqerise Civile dhe Grupeve te Interesit ne Basene, lidhur me mbrojtjen dhe ruajtjen e burimeve ujore, nga ana cilesore dhe sasiore;
- Monitorime te zbatimit te legjislacionit ne fuqi dhe kontrolle te vazhdueshme ndaj perdoruesve te rezervave ujore, per te siguruar miradministrimin dhe mbrojtjen e qendrueshme te tyre;
- Monitorimi i cilesise se ujerave siperfaqesore dhe nentokesore nga institucionet vendase;
- Forcimi i disiplines se ligjit ne mbrojtjen e mjedisit per aktivitetet qe shkaktojne ndotje te ujerave, si dhe ndaj atyre qe shfrytezojne basenet ujore;
- Forcimi i kapaciteteve inspektuese nepermjet trajnimeve te ndryshme qe do te zhvillohen;
- Takime te grupeve te perbashketa me vendet fqinje per shfrytezimin e rezervave ujore te perbashketa;
- Hartimi i raportit te monitorimit te Strategjise Kombetare Sektoriale te Sherbimit te Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve, bazuar ne raportet me shkrim te institucioneve pergjegjese;
- Ngritja e grupit të punës për përgatitjen e Projekt-VKM per miratimin e rregullores për ujin e pijshëm në përafrim të pjesshëm të Direktivës së Këshillit 80/778/EEC.
- Vlerësimi i skemës së monitorimit të ujit të pijshëm.
- Inventarizimi dhe vlerësimi i gjendjes së laboratorëve fiziko-kimikë dhe bakteriologjikë.
- Vlerësimi sasior dhe cilësor i stafit të Inspektoratit Sanitar Shtetëror dhe të laboratorëve.
- Përcaktimi i masave që rrjedhin nga rregullorja e re e cilësisë së ujit të pijshëm

Masat legjislative Afatmesme

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

- Miratimi i projekt VKM per vendimin e KKU-se mbi ‘’Percaktimin e kufinjve territoriale higrografike te baseneve te lumenjve’’. Ky akt nenligjor do te transpozoje Direktiven Kuader te Ujit 2000/60/EC, ku institucioni pergjegjes per kete do te jete MMPAU.
- Hartimi i Planeve te Menaxhimit te Baseneve Ujembledhes Vjosa dhe Shkumbin, ne zbatim te kerkesave te Direktives Kuader te Ujit 2000/60/EC, dhe Direktives se permbytjeve 2007/60/EC. Institucioni pergjegjes per hartimin e ketyre planeve do te jete MMPAU ne bashkepunim me institucionet e tjera ne nivel lokal dhe qendror.
- Hartimi i Strategjise Kombetare te Menaxhimit te Burimeve Ujore;
- Nenshkrimi i marreveshjes per menaxhimin e ujerave nderkufitare me Republiken e Maqedonise. ne baze te Ligjit Nr. 9103, Date 10.7.2003, “Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare” dhe ne zbatim te VKM Nr. 124, Datë 2.03.2006 "Për krijimin e Komisionit Qeveritar për problemet ujore me vendet fqinjë". Institucioni pergjegjes per kete eshte MMPAU. Kjo marreveshje eshte parashikuar te arrihet ne Dhjetor 2013.
- Hartimi të një ligji te ri për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve
- Projekt Urdher i Ministrit te MPPT per “Zbatimin i Planit te veprimit sipas “Studimit të fizibilitetit të ndërmarrjeve rajonale të sektorit të ujëejellës kanaliizmeve në Shqipëri”,

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Hartimi i termave te references TOR per 4 PMB per 2 Basenet, per krijimin e Kadastres elektronike te baseneve te Drin – Buna dhe Semanit;
- Perditesimi i regjistrit te lejeve te shfrytezimit te ujerave dhe atyre te inerteve lumore;
- Ndjekja dhe monitorimi i grafikut te reduktimit te lejeve per shfyrtezimin e inerteve lumore;
- Ndjekja dhe monitorimi i likuidimit te detyrimeve financiare te subjekteve qe shfyrtezojne inerte lumore dhe ujera;
- Evidentimi dhe pajisja me leje shfrytezimi rezervash ujore per 33 subjekte;
- Takime rajonale dhe seminare per ndergjegjesimin e publikut dhe gjithe aktoreve te perfshire ne perdorimin e burimeve ujore dhe inerteve lumore, sensibilizimin e autoriteteve lokale, shoqerise civile dhe grupeve te ineteresit lidhur me mbrojtjen dhe ruajtjen e burimeve ujore nga pikepamja cilesore dhe sasiore;
- Krijimi i arkives elektronike (GIS), si nje sistem te dhenash te parametrave sasiore dhe cilesore te burimeve ujore;
- Takime te grupeve te perbashketa me vendet fqinje per shfrytezimin e rezervave ujore te perbashketa;
- Kontrolle te vazhdueshme ndaj perdoruesve te rezevave ujore, per te siguruar miradministrimin dhe mbrojtjen e qendrueshme te tyre;
- Monitorimi i cilesise se ujerave siperfaqesore dhe nentokesore nga institucionet vendase;
- Ritja e investimeve per monitorimin e cilesise se ujerave siperfaqesore,

- (ujerave detare, rritje e numrit te stacioneve dhe treguesve);

- Forcimi i disiplines se ligjit ne mbrojtjen e mjedisit per aktivitetet qe shkaktojne ndotje te ujerave, si dhe ndaj atyre qe shfrytezojne basenet ujore;
- Forcimi i kapaciteteve inspektuese nepermjet trajnimeve qe do te zhvillohen;
- Sqarimi i ceshtjeve te pronesise individuale dhe te perbashket sa i perket aseteve ne kuadrin e nje strukture rajonale sherbimi;
- Ngritja e grupit të punës për përcaktimin e kapaciteteve sasiore dhe cilësore të Inspektoratit Sanitar Shtetëror.
- Ngritja e grupit të punës për përcaktimin e kapaciteteve analizuese të laboratorëve fiziko-kimikë dhe bakteriologjikë, të nevojshme sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,
- Përmirësimi i kapaciteteve sasiore dhe cilësore të Inspektoratit Sanitar Shtetëror nëpërmjet shtimit të nevojshëm të stafit dhe trajnimeve,
- Forcimi i kapaciteteve analizuese të laboratorëve fiziko-kimikë dhe bakteriologjikë,
- Forcim i kapaciteteve administrative dhe bashkërendimi në nivel kombëtar dhe vendor.
- Përmirësimi i infrastrukturës së komunikimit
- Shqyrtimi i mangesive ne zbatimin e ligjit per shoqerite tregtare ne lidhje format e korportave ne kuadrin e rajonalizimit aktual apo te ardhshem.
- Sqarimi i çeshtjeve te pronesise individuale dhe te perbashket sa i perket aseteve ne kuadrin e nje strukture rajonale sherbimi.
- Dhenia e nje kapitali fillestar per Sh.a. qe deshirojne te bashkohen ne kuader te rajonalizimit.

Efektet Financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**30.352.000**	**9.485.000**	**17.073.000**	**3.794.000**
Mbulohen nga buxheti i	30.352.000	9.485.000	17.073.000	3.794.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.27.6. MBROJTJA E NATYRES

Objektivi strategjik

Mbrojtja e Natyrës është një prej nënfushave prioritare që lidhen me *acquis communautaire* në fushën e mjedisit. Siç përcaktohet nga MSA (neni 70/3 si dhe neni 108), përafrimi i legjislacionit shqiptar me acquis në fushën e mjedisit, lidhet direkt me standardet mjedisore dhe detyrën jetësore për të luftuar degradimin e mjedisit me qëllim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Ky objektiv, është përfshirë në dokumentet strategjike sektoriale: Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit dhe Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin.

Objektivat kryesorë të kësaj fushe konsistojnë në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, nëpërmjet mirë administrimit në 3 nivelet përbërëse të tij: lloje, habitate dhe ekosisteme dhe arritjen e statusit të favorshëm për llojet e florës dhe faunës së egër që do të

sigurojnë mbijetesën e tyre. Këto objektiva themelore parashikohet të arrihen nëpërmjet rritjes së sipërfaqes së Zonave te Mbrojtura dhe zbatimit me efikasitet të planeve të tyre të menaxhimit si dhe nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të administratave të Zonave të Mbrojtura.

Analiza e situates aktuale

Aktualisht sipërfaqja e ZM-ve në Shqipëri ka arritur në 15 % të territorit të vendit. Parashikohet që në fund të vitit 2015 sipërfaqja e Zonave të Mbrojtura të arrijë në 17 % të territorit të vendit në përputhje me objektivat e Strategjisë së Biodiversitetit të BE-së për periudhën 2011-2020 (miratuar në Korrik 2011 si dhe në kuadër të zbatimit të 'Aichi targets' të Konventës së Biodiversitetit. Në këtë proces krijimi i Parkut të Alpeve është me rëndësi të veçantë, pasi do shërbejë si bazë për krijimin e zonës së parë të mbrojtur ndërkufitare tripalësh me Malin e Zi dhe Kosovën).

Në fushën e mbrojtjes së natyrës procesi i përafrimit të direktivave kryesore të BE-së është tashmë në një fazë të avancuar. Konkretisht Direktiva e Shpendëve (versioni i kodifikuar 2009/147/EC) dhe Direktiva e Habitateve (92/43/EC) janë transpozuar në masën 85 % të dispozitave të tyre.

Direktiva e Shpendëve e përafruar me ligjin "Për mbrojtjen e faunës së egër", nr.10006, Datë 23.1.2008, u përafrua më tej ne ligjin "Për gjuetinë", nr. 10253, datë 11.3.2010. ndërsa përafrimi i plotë është parashikuar nëpërmjet hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të dy ligjeve të lartpërmendura në periudhën afatmesme.

Direktiva e Habitateve është transpozuar nëpërmjet dy ligjeve përkatësisht Ligjit "Për mbrojtjen e biodiversitetit" të vitit 2006 dhe Ligjin "Për zonat e Mbrojtura", të 2002, të ndryshuar.

Ligji "Për mbrojtjen e faunës së eger" përmban gjithashtu dispozita të veçanta lidhur me koleksionet dhe kopshtet zoologjike dhe trajtimin e llojeve të faunës së eger në to duke siguruar transpozimin e dispozitave bazë të Direktivës "Për mbajtjen e kafshëve në Kopshtet Zoologjike".
Për tregtinë ndërkombëtare të jetës së egër Ligji "Për pëcaktimin e rregullave dhe procedurave pë tregëtimin ndëkombëtar të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër" në 2008, siguron zbatimin e plotë të dispozitave të Konventës "Për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër" (CITES) në të cilën Shqipëria është Palë prej Shtatorit 2003. Për zbatimin e ligjit të sipër permendur një rol kyç luan Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me kontrollet në pika e kalimit kufitar. Për këtë qëllim është në vazhdimësi proçesi i trajnimit te personelit të doganave dhe forcimit të kapaciteteve të tyre.

Në fushën e masave zbatuese janë organizuar një numër ëorkshopesh në kuadër të projekteve të donatorëve që janë në zbatim në fusheën e natyrës, si projekti i BB Menaxhimi i Integruar i Ekosistemit të Liqenit të Shkodrës (MIELSh), projekti i KfW Menaxhimi Integruar i basenit të Liqeneve të Prespës dhe projekti UNDP-GEF për zonat e mbrojtura bregdetare dhe detare në Shqipëri.

Në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të progres raporteve respektive të KE-së të Nëntorit 2010 dhe Tetorit 2011 janë hartuar plane masash për reflektimin e tyre, që lidhen kryesisht me forcimin e zbatimit të ligjit dhe ngritjen e kapaciteteve veçanërisht të administratave të ZM-ve dhe organeve të kontrollit të ngarkuara për zbatimin e kuadrit ligjor që lidhet me mbrojtjën e faunës së egër dhe aktivitetin e gjuetisë.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji "Për Zonat e Mbrojtura" no. 8906, datë 6.6.2002, i ndyshuar (botuar në Gazetën Zyrtare nr.18/2008). Ligji përafron pjesërisht Direktivën e Habitateve 31992L0043.
- Ligji "Për mbrojtjen e biodiversitetit", nr. 9587, date 20.07.2006 (botuar në Gazetën Zyrtare 84/2006). Ligji përafron pjesërisht Direktivën e Habitateve 31992L0043.
- Ligji "Për pëcaktimin e rregullave dhe procedurave për tregëtimin ndëkombëtar të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër" nr. 9867, datë 31.1.2008 (botuar në Gazetën Zyrtare 18/2008). Ligji zbaton Rregulloren 31997R0338 për tregtinë e jetës së egër.
- Ligji "Për mbrojtjen e faunës së egër" nr. 10006, datë 23.10.2008 (botuar në Gazetën Zyrtare 168/2008). Ligji përafron pjesërisht Direktivën e Shpendëve (version i kodifikuar) 32009L0147.
- Ligji "Për gjuetinë" nr. 10253, datë 11.3.2010 (botuar në Gazetën Zyrtare 2010) Ligji përafron plotësisht dispozitat e Direktivës së Shpendëve (version i kodifikuar) 32009L0147.
- VKM nr. 897, datë 21.12.2011 "Për miratimin e rregullave për shpalljen e Zonave të Veçanta të Ruajtjes" (botuar ne Gazeten Zyrtare 178/2011, 178). Vendimi përafron plotesisht Aneksin 1 të Direktivës së Habitateve 31992L0043.
- VKM nr. 546, date 07.07.2010 "Për miratimin e listes se llojeve te faunes se eger, objekt gjuetie" (botuar ne Gazeten Zyrtare 102/2010).
- VKM nr. 553, date 07.07.2010 "Per percaktimin e sezonit te gjuetise ne Republiken e Shqiperise" (botuar ne Gazeten Zyratre 103/2010).

Akte për miratimin e Planeve të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura

- Urdhër i Ministrit të MMPAU Nr. 143, datë 24.10.2005 "Për miratimin e planit të menaxhimit të zonës së peizazhit të mbrojtur Vjose-Nartë";
- Urdhër i Ministrit të MMPAU Nr. 144, datë 24.10.2005 "Për miratimin e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar të Dajtit";
- Urdhër i Ministrit të MMPAU Nr. 147, datë 24.10.2005 "Për miratimin e planit të menaxhimit të kompleksit Llogara-Rreza e Kanalit-Orikum-Tragjas-Radhime-Karaburun".
- Urdhër nr. 404, datë 9.6.2011 "Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar Butrint";
- Urdhër nr. 405, datë 9.6.2011 "Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Rezervës Natyrore të Menaxhuar Kune-Vain-Tale".

Struktura institucionale

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nëpërmjet Drejtorisë se Biodiversitetit në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave, mbulon çështjet e lidhura me hartimin e politikave për mbrojtjen e natyrës respektivisht me sektorët e faunës, florës dhe tokës dhe sektorin e zonave te mbrojtura dhe parqeve kombetare duke kontribuar në hartimin e legjislacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Integrimit dhe të Projekteve (Sektori i Përafrimit të Legjislacionit) dhe hartimin e dokumenteve strategjike në këtë fushë. Bashkëpunimi shtrihet dhe me Drejtoritë e tjera te ministrisë dhe me institucionet zbatuese Agjencinë e Mjedisit dhe të Pyjeve, Agjencitë Rajonale të Mjedisit dhe Drejtoritë e Shërbimit Pyjor në qarqe, të cilat kanë në përbërje të tyre administratat e zonave të mbrojtura.
Në fushën e mbrojtjes së natyrës MMPAU bashkëpunon me:

Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit për biodiversitetin bujqësor;
Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, duke siguruar vendim-marrjen për përdorimin e territorit;
Ministrinë e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, e cila harton dhe zbaton politikat për zhvillimin e turizmit;
Ministrinë e Brendshme me qëllim menaxhimin e burimeve natyrore lokale në pronësi komunalë. Për bashkërendimin e punës për menaxhimin e aktivitetit të gjuetisë sportive dhe turistik;
Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për kontrollin doganor të tregëtimit ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër.

Masat Legjislative afatshkurtra

- VKM "Për shpalljen e ekosistemit natyror të Malit të Tomorrit Park Kombëtar me sipërfaqe të zgjeruar". Ky akt do të shërbejë për zgjerimin e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura për të arritur mesataren e vendeve anëtare të BE-së (17%) dhe është në linjë me objektivat e identifikuara në strategjinë e biodiversitetit të BE-së për periudhën 2011-2020.
- Urdhër i Ministrit "Për miratimin e listës së llojeve të shpendëve të egër, veçanërisht vulnerabël (Aneksi I i Direktivës së Shpendëve) në zbatim të nenit 14, pika 2 të Ligjit "Për mbrojtjen e faunës së egër" nr. 10006, datë 23.10.2008. Ky akt do të transpozojë plotësisht Aneksin 1 të Direktivës së Shpendëve (versioni i kodifikuar) 32009L0147.
- Urdhër i Ministrit "Për miratimin e formularit të kërkesave për regjistrim" në zbatim të nenit 24, pika 2 te Ligjit "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër", nr. 9867, datë 31.1.2008: (i.) formatin e kërkesës për regjistrim, si dhe formatin e kërkesës për t'u pajisur me leje; (ii.) formatin e lejeve për import e për eksport; (iii.) formatin e regjistrave ku hidhen të dhënat nga personat fizikë e juridikë të pajisur me leje; (iv.) formatin e kërkesës për të dhënat dhe infomacionet që raportojnë personat e regjistruar e të pajisur me leje; dhe (v.) formatin e Regjistrit të ekspertëve të çertifikuar". Ky akt do të realizojë zbatimin në praktikë të Rregullores 31997R0338 për tregtinë e jetës së egër.
- Urdhër i Ministrit për miratimin e planit të veprimit për mbrojtjen e breshkave detare.

- Urdhër i Ministrit për ngritjen e komitetit të menaxhimit të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta.
- Përfundimi i planit të menaxhimit të RNM "Liqeni i Shkodrës".

Aktivitetet Zbatuese afatshkurtra

- Trajnime me stafin e administrative të Zonave të Mbrojtura në kuadër të projektit të Liqenit të Shkodrës dhe të projektit për zonat e mbrojtura detare dhe bregdetare;
- Zbatimi i planeve të menaxhimit për Zonat e Mbrojtura që kanë plane të tilla:
    - Parku Kombëtar Dajti;
    - Parku Kombëtar Llogara dhe ekosistemi natyror Karaburun-Rreza e Kanalit-
    - Orikum-Tragjas;
    - Peizazhi i Mbrojtur Vjose-Narte;
    - Parku Kombëtar Butrint;
    - RNM Kune-Vain-Tale;
- Bashkëpunim me Drejtoritë e Shërbimit Pyjor në rrethe për zbatimin e kuadrit ligjor kombëtar për mbrojtjen e faunës së egër dhe aktivitetit të gjuetisë sportive dhe turistikë;
- Rishikimi i Listës së Kuqe të florës dhe faunës së egër të Shqipërisë;
- Fillimi i rishikimit dhe përditësimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Biodiversitetit (SPVB) për një periudhë 5-vjeçare;
- Zgjerimi i bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për zbatimin e Konventës së CITES për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër

Masat Legjislative Afatmesem

- VKM për miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin së rishikuar dhe përditësuar; sipas objektivave të identifikuara në strategjinë e biodiversitetit të BE-së për periudhën 2011-2020.
- VKM "Për shpalljen e ekosistemit natyror të Alpeve "Park Kombëtar". Kjo do të shërbejë për zgjerimin e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura në nivele të njëjta me mesataren e vendeve anëtare të BE-së (aktualisht 17 %).
- Urdhër i Ministrit për rregullat e mbajtjes së kafshëve në Kopshtet Zoologjike;
- Urdhër i Ministrit për formatin e regjistrimit dhe për pagesat për lejet CITES;
- Urdhër i Ministrit për miratimin e Planit të menaxhimit të RNM Liqeni i Shkodrës;
- Hartimi i Planit të menaxhimit të PK Prespë dhe Urdhri i Ministrit për miratimin e tij;
- Hartimi i Planit të menaxhimit dhe Urdhri i Ministrit për miratimin e planit të menaxhimit të PM lumi Buna-Velipojë;
- Hartimi i planit të menaxhimit dhe urdhri i Ministrit për miratimin e planit të menaxhimit të PK Shebenik-Jabllanicë;
- Hartimi i planit të menaxhimit dhe urdhri i Ministrit për miratimin e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta;
- Rishikimi i kapitullit të natyrës dhe biodiversitetit në Strategjinë Ndërsektoriale të Mjedisit;

- Urdhra të Ministrit për ngritjn e Komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura për ato zona që ende nuk i kanë këto komitete të krijuara.

Masat zbatuese

- Bashkëpunim me Drejtoritë e Shërbimit Pyjor në rrethe për zbatimin e kuadrit ligjor kombëtar për mbrojtjen e faunës së egër dhe aktivitetit të gjuetisë sportive dhe turistikë;
- Zbatimi i planeve të menaxhimit për Zonat e Mbrojtura që miratohen progresivisht:
  - Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta
  - Rezerva Natyrore e Menaxhuar e Liqenit të Shkodrës
  - Parku Kombëtar Prespë
  - Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë
  - Peizazhi i Mbrojtur Velipojë
- Forcimi i kapaciteteve të administrative të Zonave të Mbrojtura nëpërmjet organizmit të workshopeve dhe seminareve trajnuese;
- Forcimi i kapaciteteve te stafit te seksioneve të administrim menaxhimit dhe Policisë Pyjore në përbërje të drejtorive të Shërbimit Pyjor për zbatimin në praktikë të legjislacionit për mbrojtjen e fauëns së egër dhe biodiversitetit në përgjithësi.

Implikimet financiare

Në lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**47.007.000**	**31.407.000**	**25.210.000**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	11.807.000	10.907.000	9.010.000	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	35.200.000	20.500.000	16.200.000	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.27.7. NDOTJA INDUSTRIALE, MENAXHIMI I RISQEVE DHE AKSIDENTEVE

Objektivi strategjik

Rehabilitimi i vatrave të nxehta mjedisore dhe zhvillimi i një industrie sa më pak ndotëse, që zbaton normat dhe standartet mjedisore është një prioritet i përcaktuar në një sërë dokumentash strategjikë si MSA (neni 108), dokumenti i Partneritetit Europian 2007, Raporti Vjetor i KE. Në të njëjtën kohë ky objektiv përcaktohet edhe në Programin e Qeverisë Shqiptare 2009-2013 për rritjen e investimeve për mbrojtjen e mjedisit. Investimet do të përballohen me fonde nga buxheti i shtetit, donatorët, pushteti vendor dhe subjektet private. Ato do të synojnë përafrimin e standarteve tona mjedisore me ato të Komunitetit Evropian në të gjitha fushat e sidomos në rehabilitimin e terreneve të ndotura nga industritë e dikurshme dhe të vatrave kryesore të ndotjes si PVC-ja e Vlorës, Metalurgjiku i Elbasanit, Patos-Marinza e Gjanica, Rubiku etj.

Analiza e Situates Aktuale

Si pjese e Ministrise se Mjedisit, Pyjeve, dhe Administrise se Ujrave funksionon Drejtoria e Mbrojtjes se Mjedist i cila perbehet nga 3 sektore, dhe nje prej tyre eshte Sektori i mbetjeve dhe aksidenteve idustriale. Numri i personave të angazhuar në MMPAU në lidhje me zbatimin e legjislacionit egzistues në fushën e aksidenteve industriale jane dy, nje tek sektori dhe nje tek Inspektorati i Mjedisit.Me miratimin e ligjit do te percaktohen personat në Agjensitë Rajonale të Mjedisit (A.R.M) si dhe ne Agjensine Kombetare e Mjedisit (A.K.M) te cilet do ndjekin zbatimin e ligjit.

Bazat ligjore dhe perafrimin e Legjislacionit

Ligji Nr. 8934, Datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar me ligjin Nr. 9890, Datë 20.3.2008 i ndryshuar me ligjin Nr. 10 431 Date 09.06.2011. "Për mbrojtjen e mjedisit" është miratuar në fletoren zyrtare Nr: 89 dhe futet në fuqi 09.12.2012

Strukturat institucionale

Institucionet përgjegjëse (Ministrite) për çështjet e aksidenteve industriale, per hartimin e politikave, akteve ligjore, strategjise dhe inspektimeve jane:

- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave, (M.M.P.A.U) te Projekt/ligjit "Për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet Industriale madhore që shkaktohen nga subtanca të rrezikshme", ka si qellim parandalimin e aksidenteve madhore që shkaktohen nga substanca të rrezikshme dhe kufizimin e pasojave të tyre mbi njerëzit dhe mjedisin, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë mbrojtje.
- Ministria e Punës, Çeshtjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta (MPÇSSHB), Ka si qellim sigurimin e një niveli të lartë mbrojtje te njeriut ne sigurine ne pune.
- Ministria e Brendshme (MB), ka si qellim shërbimet e emergjencës, zhvillimin e veprimeve, informacion specifik të tyre, për t'u marrë me një aksident me rrezik madhor.
- Ministria e Shendetesise (M.SH), ka si qellim të kryjë vlerësimin e rrezikut për të përcaktuar kërkesat për pajisje personale mbrojtëse, për shkak të kimikateve të përdorura në ndërmarrje.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë te BE dhe zbatimi i plotë i tij. Për periudhën afatshkurter, prioritetet në fushën e ndotjes industriale do të jenë:

- Pergatitja e Projekt/Ligjit "Për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet Industriale madhore që shkaktohen nga subtanca të rrezikshme, Ky Ligj transpozon plotësisht Direktivën 96/82/EC për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që shkaktohen

nga substanca të rrezikshme, të amenduar nga Rregullorja EC/1882/2003, Direktiva 2003/105/EC dhe Rregullorja EC/1137/2008.
Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte M.M.P.A.U ne bashkepunim me (MPÇSSHB), (MB), (M.SH),

- Pergatitja e Draft/VKM "Për Raportin e Sigurisë dhe Plani i Emergjencës." Ky Vendim transpozon Direktivën 96/82/EC për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që shkaktohen nga substancat kimike, amenduar nga Rregullorja EC/1882/2003, Direktiva 2003/105/EC dhe Rregullorja EC/1137/2008, në lidhje me Raportet e Sigurisë dhe Planet e Emergjencës. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte M.M.P.A.U ne bashkepunim me (MPÇSSHB), (MB), (M.SH),

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Trajnime te specialisteve te M.M.P.AU, dhe specialisteve te Agjensise Kombetare se Mjedisit per te krijuar nje sistem te kontrollit dhe inspektimit efektiv te instalimeve te djegies.
- Aktivitete konsultuese me ministrite e linjes per percaktimin e Autoritetit Kompetent qe do te kryeje detyrat e detajuara sipas Direktives SEVESO;
- Takime konsultuese me ekspertet e projektit SELEA per krijimin e nje sistemi notifikimi per perdorimin, perpunimin, ruajtjen e substancave te rrezikeshme per operatoret e instalimeve SEVESO.
- Trajnime lidhur me krijimin e nje sistemi per konsultimet nderkufitare ne zbatim te Direktives IPPC te kontrollit dhe parandalimit te integruar te ndotjes;
- Konsultime me eksperte te huaj lidhur me ngritjen e sistemit te mbledhjes se te dhenave per te raportuar ne Komision ne lidhje me zbatimin e Direktives IPPC;
- Trajnime te inspektoreve per te koordinuar kontrollin e aktiviteteve IPPC, te Parandalimit dhe Kontrollit te Integruar te Ndotjes me mekanizmin e kontrollit te aksidenteve industriale.
- Konsultime me palet e interesuara (Industrialistet, Dhoma e Tregetise, Konfindustria, NGO) dhe me publikun per IPPC;
- Klasifikimi i impianteve te djegies dhe identifikimi Impianteve te Medha te Djegies (Termocentralet etj);
- Trajnime per metodologjine e identifikimit te ndermarrjeve ose grupeve te ndermarrjeve te cilat paraqesin risk per aksidente madhore ose "efektin domino"
- Krijimi dhe zbatimi i programeve trajnuese per çeshtjet lidhur me Direktives SEVESO per stafin dhe operatoret.
- Forcimi i disiplinës së ligjit në mbrojtjen e mjedisit nga aktivitetet industriale;
- Forcimi i kapaciteteve inspektuese nëpërmjet trajnimeve që do të zhvillohen nga RENA, "Rrjeti Europian Mjedisor i Para - Zgjerimit" i Komisionit Europian.

Masat legjislative afatmesem

Në një perspektivë afatmesme synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë te bashkimit Evropian dhe zbatimi i plotë i tij. Për periudhën afatmesem, prioritetet në fushën e ndotjes industriale do të jenë:

- Pergatitja e Draft/V.K.M "Per Raportimin". Ky Vendim synon perafrim me Direktivën 96/82/EC për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që shkaktohen nga substancat kimike, amenduar nga Rregullorja EC/1882/2003, Direktiva 2003/105/EC. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me (MPÇSSHB), (MB), (M.SH),

- Pergatitja e Draft/V.K.M "Per Tarifat e Autoritetit Kompetent". Ky Vendim synon perafrim me Direktivën 96/82/EC për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që shkaktohen nga substancat kimike, amenduar nga Rregullorja EC/1882/2003, Direktiva 2003/105/EC. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me (MPÇSSHB), (MB), (M.SH),
- Pergatitja e Draft/V.K.M "Per Inspektimet dhe Investigimet". Ky Vendim synon perafrim me Direktivën 96/82/EC për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që shkaktohen nga substancat kimike, amenduar nga Rregullorja EC/1882/2003, Direktiva 2003/105/EC. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me (MPÇSSHB), (MB), (M.SH),
- Pergatitja e Draft/V.K.M "Per Dhenie te Informazionit ndaj Publikut". Ky Vendim synon perafrim Direktivën 96/82/EC për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që shkaktohen nga substancat kimike, amenduar nga Rregullorja EC/1882/2003, Direktiva 2003/105/EC. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me (MPÇSSHB), (MB), (M.SH),

Aktivitetet zbatuese afatmesem

- Trainime dhe Konsulence per implementimin e Ligjit mbi IPPC me inspektoret, qe do te kontrollojne ne aktivitet industriale (Fabrike Cimento etj);
- Trajnime dhe Konsultime per procedurat e dhenies se lejes per instalimet e medha te djegies egzistuese dhe te reja;
- Trajnime per krijimin e inventareve te emisioneve totale vjetore nga impiantet egzistuese dhe impiantet e reja te djegiese;
- Pergatitja e inventarit te emisioneve totale te SO_2 dhe Nox;
- Krijimi dhe trajnimi i nje stafi teknik qe do te asistoje autoritetin kompetent ne lidhje me çeshtjet teknike te Direktives SEVESO;
- Konsulenca per krijimin dhe zbatimin e programeve trajnuese per stafin dhe operatoret per çeshtjet lidhur me Direktiven SEVESO;
- Krijimi i metodologjive te aprovuara per monitorimin e emisioneve ne ajer nga operatoret.
- Rritja e zbatueshmërisë së legjislacionit të përafruar nëpërmjet hartimit të akteve të tjera nënligjore
- Nxitja dhe forcimi i kontrollit mbi zbatimin e legjislacionit mjedisor të përafruar në fushën e ndotjes industriale.
- Përmirësimi i legjislacionit të aksidenteve industriale me transpozimin të direktivave të KE.
- Forcimi i disiplinës së ligjit në mbrojtjen e mjedisit nga aktivitetet industriale;
- Forcimi i kapaciteteve inspektuese nëpërmjet trajnimeve që do të zhvillohen nga RENA, "Rrjeti Europian Mjedisor i Para - Zgjerimit" i Komisionit Europian.

Efektet Financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**35.294.000**	**38.475.000**	**39.960.000**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	35.294.000	38.475.000	39.960.000	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.27.8. ORGANIZMAT E MODIFIKUARA GJENETIKISHT

Objektivi strategjik

Organizmat e Modifikuara Gjenetikisht janë një prej nënfushave prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e mjedisit. Objektivi politik i kësaj fushe ka të bëje me përafrimin e legjislacionit me acquis lidhur me standartet mjedisore.

Analiza e situatës aktuale

Kuadri ligjor mbështetet në ligjin Nr. 9279, Datë 23.09.2004 "Për aderimin e RSH–së në Protokollin e Kartagjenës për Biosigurinë të Konventës "Për larminë biologjike"".

Në zbatim të përmbushjes së detyrimeve të dala nga Progres Raporti i Komisionit Europian 2009 dhe 2010, aktualisht janë hedhur hapa konkretë për të arritur progres në këtë fushë.

Me nismën e Ministrisë së Integrimit u ngrit një grup pune ndërministror me Urdhër të Kryeministrit nr. 135, datë 28.6.2010 "Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërministror të punës për hartimin e planit të veprimit sipas institucioneve për përafrimin e legjislacionit me 'acquis communautaire' në fushën e Organizmave të Modifikuara Gjenetikisht.
Ky grup ndërministror përgatiti planin e veprimit për OMGJ-të me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve, i cili u miratua me VKM nr. 200, datë 2.3.2011 "Për miratimin e planit të veprimit për fushën e OMGJ-ve për periudhën 2011-2013".

Në zbatim të këtij plani veprimi nga MMPAU janë realizuar masat e mëposhtme:
Ligji "Për mbrojtjen e mjedisit" nr. 10431, datë 9.6. 2011 neni 36, parashikon dispozita të veçanta që përcaktojne qartë ndarjen e përgjegjësive dhe detyrimeve të institucioneve shtetërore që lidhen me OMGJ-të. Ky ligj hyn në fuqi në Janar 2013.

Më tej pika 3 e nenit të sipërcituar përcakton se rregullat e detajuara për leshimin e qëllimshëm në mjedis të organizmave të modifikuar gjenetikisht, për qëllime të tjera përveç hedhjes së tyre në treg si produkte qe synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut do te miratohen nga Keshilli i Ministrave.

Aktualisht, është identifikuar acquis respektive për këtë fushë. Eshte ne proces përkthimi i direktivave dhe vendimeve që janë të shumta në këtë fushë dhe pa të cilat nuk mund të fillojë

përgatitja e legjislacionit të përafruar me shumë rëndësi në fazën aktuale. Eshtë hartuar lista e përditësuar dhe e plotë, e legjislacionit komunitar për ushqimet e reja dhe OMGJ-te (Ushqimet e Modifikuara Gjenetikisht), bazuar në Kapitullin 12 të acquis "Për Politikat e Sigurisë Ushqimore - Veterinarisë - Fitosanitarisë", nën kapitulli 11 "Ushqimet e reja dhe OMGJ–të", që do të transpozohet nga DSUMK në MBUMK. **Eshtë paraqitur në MIE, kërkesa për përkthimin e akteve komunitare sipas listës.**

Në Dhjetor 2011, ka përfunduar përkthimi dhe rishikimi i terminologjisë për ushqimin, për tre aktet bazë të legjislacionit komunitar për "Ushqimet e reja dhe OMGJ –të, përkatësisht:

- Rregullore (EC) No 258/97 "Për ushqimet e reja dhe ingredientët e ushqimeve të reja".
- Rregullore (EC) N° 1829/2003 "Për ushqimet dhe ushqimet për kafshë të modifikuara gjenetikisht".
- Rregullore (EC) N° 1830/2003 në lidhje me gjurmueshmërinë dhe etiketimin e organizmave të modifikuar gjenetikisht dhe gjurmueshmërinë e produkteve ushqimore dhe ushqimet për kafshë të prodhuara nga OMGJ- të dhe amendimi i Direktives 2001/18/EC.

Struktura institucionale

Ndonese nuk ka struktura te percaktuara me ligj per OMGJ-te, ne kuader te zbatimit te protokollit te Biosigurise jane identifikuar aktoret kryesore. Kjo eshte nje fushe ndertematike qe kerkon kontributin e te gjithe aktoreve kryesore te percaktuar dhe bashkerendimin e punes ndermjet tyre.

Institucionet kryesore jane MMPAU per introduktimin ne mjedis perfshire vendosjen dhe menyrat e sistemit te lajmerimit midis shteteve dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për mbjelljet, ushqimet dhe tregtimin.

Në nivel kombëtar në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin" është ngritur dhe funksionon Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) në varësi të MBUMK me VKM nr. 1081, datë 21.10.2009 "Për organizmin dhe funksionimin e AKU-së". Ndërmjet detyrave AKU-së përcaktohet se 'drejton procesin e vlerësimit të riskut në fushën e ushqimit dhe ushqimeve për kafshë'.

Aktorë të tjerë për politikat janë Ministria e Shëndetësisë për mikroorganizmat në gjendje të mbyllur dhe ndikimet në shëndetin e njeriut dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës per zhvillimin e bioteknologjisë. Duhet që Ministritë të bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për zbatimin e Protokollit të Biosigurisë lidhur me lëvizjet ndërkufitare të OMGJ-së.
Në kuadër të reformës së institucioneve kërkimore shkencore është krijuar Departmamenti i Bioteknologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës, i cili në bashkëpunim me institucione të tjera në varësi të ministrive të përmendura dhe me Akademinë e Shkencave janë të rëndësishëm për kryerjen e procedurës së vlerësimit të rrezikut të OMGJ -së.

Masat legjislative afatshkurtra

- Zbatimi i masave te parashikuara ne Planin e Veprimit:
- Përkthimi nga MIE i acquis për OMGJ, që lidhet me përgjegjësitë dhe detyrimet e MMPAU për lëshimin e qëllimshëm në mjedis të OMGJ-ve, sipas përcaktimit të planit të veprimit të miratuar me VKM nr. 200, datë 2.3.2011.
- Përditësimi me EU acquis për fushën e OMGJ-ve.

Masat zbatuese

- Bashkëpunim me PIU e projektit të biosigurisë financuar nga UNEP për zbatimin e kuadrit kombëtar për biosigurinë në Shqipëri (nga Maj 2011). Projekti do të kontribojë për ndërtimin e institucioneve dhe kapaciteteve në fushën e biosigurisë në vend.
- Seminare trajnuese për përgatitjet lidhur me përgatitjen për transpozimin e kuadrit ligjor që lidhet me lëshimin e qëllimshëm në mjedis të OMGJ-ve që do të hartohet nga MMPAU.

Masat legjislative afatmesem

- Hartimin i legjislacionit për OMGJ-të që lidhet me lëshimin e qëllimshëm në mjedis që mbulohet nga MMPAU, sipas përcaktimeve të planit të veprimit
- "VKM për lëshimin e qëllimshëm në mjedis të rregullat e detajuara për leshimin e qëllimshëm në mjedis të organizmave të modifikuar gjenetikisht, për qëllime të tjera përveç hedhjes së tyre në treg si produkte qe synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut" që do të përafrojë plotësisht Direktivën 2001/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 12 Marsit 2001 për lëshimin e qélllimshëm në mjedis të OMGJ-ve dhe që shfuqizon Direktivën 90/220/EEC.

Masat zbatuese

- Focimi i kapaciteteve të organeve që ngarkohen me zbatimin e kuadrit ligjor për OMGJ-të;
- Bashkëpunimi me ministritë e linjës dhe institucionet kërkimore shkencore në kuadër të zbatimin të projektit të biosigurisë për ngritjen e kapaciteteve në nivel kombëtar dhe lokal për zbatimin e legjislacionit mjedisor që lidhet më OMGJ-të.
- Vazhdimi i bashkëpunimit me PIU të projektit të biosigurisë, të financuar nga UNEP, për ngritjen e laboratorit kombëtar për identifikimin e OMGJ-ve.
- Ngritja e grupit te punes nga MBUMK per hartimin e legjislacionit per OMGJ, me perberje nga:

    - MBUMK (teknik + specialist ligjor)
    - Ministria e Mjedisit
    - ISUV
    - Fakulteti i Shkencave te Natyres

- Trajnimi i stafit teknik per hartimin e kuadrit ligjor per OMGJ-te, nga TAIEX dhe asistenca e projekteve (IPA).
- Ngritja e infrastruktures laboratorike per analizimin e OMGJ–ve dhe trajnimi i stafit te ISUV.

Implikimet Financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**4.437.000**	**1.537.000**	**637.000**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	237.000	1.137.000	237.000	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	4.200.000	400.000	400.000	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.27.9. KIMIKATET

Objektivi strategjik

Ngritja e sistemit kombëtar të menaxhimit të kimikateve deri në vitin 2015 dhe menaxhimi i qëndrueshëm i kimikateve, përveçse një detyrim që rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, përbën dhe një nga objektivat strategjike te qeverisë shqiptare.

Nje objektiv specifik eshte vendosja e rregullave per importin dhe eksportin e kimikateve te rrezikshme ne perputhje me rregulloret e BE dhe Konventen e Roterdamit.

Ky objektiv do te realizohet nepermjet:

- perafrimit te legjislacionit vendas me acquis ne fushen e kimikateve
- rritjes se bashkepunimit te MMPAU me ministrive te linjes, MSH, METE, MPPT, MBUMK
- percaktimit dhe ndarjes se qarte te pergjegjesive ne fushen e kimikateve dhe rritjes se kapaciteteve administrative.
- stimulimi i zhvillimit të teknologjive të pastra, të përdorimit te lëndëve kimike të çertifikuara dhe te rregistruara në mënyrë që të pakësojnë shkarkimet e dëmshme në mjedis (ujë, ajër, tokë, etj).

Analiza e situatës aktuale

Kuadri ligjor per kimikatet dhe substancat e rrezikeshme egziston, megjithese eshte pjeserisht ne linje me legjislacionin Europian ne kete fushe (Rregulloren REACH dhe Regulloren mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe perzjerjeve te tyre). Plotesimi i pyetesorit ne fushen e kimikateve identifikoi mangesite ne legjislacion dhe mungesen e kapaciteteve ne ministrite perkatese. Në kuadër të prioriteteve të përcaktuara për përgatitjen e projekt-fishave IPA 2010 Programi Kombëtar për Shqipërinë, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU), do te mbështetet nga projekti i BE SELEA

"Forcimin e kapaciteteve për hartimin e ligjit dhe zbatimin e legjislacionit kombëtar për mjedisin".Projekti do të asistoje MMPAU:

- në hartimin e ligjeve për të mbushur boshllëqet e identifikuara, në veçanti transpozimit të legjislacionit primar për sektorin e Kimikateve.
- Përgatitjen e Planeve të Veprimit të veçanta për Direktiva te Kimikateve.
- Përgatitjen e akteve legjislative në lidhje me Konventat Ndërkombëtare
- Në krijimin e një numëri të duhur të stafit në çdo njësi teknike, në veçanti drejtorine e mbrojtjes se mjedisit, duke bërë analizen institucionale ndaj nevojave të vendit, krahasuar me praktikat më të mira në Shtete të tjera Anëtare ose të vendeve të pranuara

Ne baze te legjislacionit egzistues, METE duhet te krijoje sherbimin e import-eksportit te kimikateve si dhe te kontrollit te kimikateve te konsumit. MSh dhe MPÇSSHB kane detyra te vecanta qe lidhen me normat e lejuara, masat e sigurise dhe emergjences, kualifikimin e punonjesve etj lidhur me incidentet nga kimikatet.
Ne Republiken e Shqiperise nuk ka akoma nje regjister te kimikateve qe te plotesoje kerkesat e legjislacionit Europian. Ligji nr.9108, dt.17.07.2003 "Për substancat dhe preparatet kimike" Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave duhet te ngreje Zyren e Regjistrimit te kimikateve. Aktualisht akoma nuk eshte ngritur nje zyre e tille.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Ne Republiken e Shqiperise, ligji baze qe rregullon administrimin e substancave dhe preparateve kimike eshte ligji nr. 9108, date 17.7. 2003 per "Substancat dhe Preparatet Kimike", botuar Fletorja zyrtare Nr 66, Viti 2003, faqe 2925, data e botimit 04.08.2003, qe perafron Direktiven e Këshillit 76/769/EEC e dt.27 Korrik 1976 'Mbi përafrimin e legjislacionit, rregullave dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare në lidhje me ndalimin e shitjeve dhe përdorimin e disa substancave e preparateve të rrezikshme".

Ne zbatim te ligjit 9108/03 Keshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 824, date11.12.2003 "Për klasifikimin, paketimin, etiketimin dhe ruajtjen e sigurtë të substancave dhe preparateve të rrezikshme" qe perafron Direktiven e Këshillit 67/548/EEC e dt. 27 Qeshor 1967 "Mbi përafrimin e legjislacionit, rregullave dhe dispozitave administrative në lidhje me klasifikimin, paketimin, etiketimin dhe ruajtjen e sigurtë të substancave dhe preparateve të rrezikshme"dhe ka për qëllim të rregullojë prodhimin, tregtimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, duke respektuar legjislacionin shqiptar dhe rregullat ndërkombëtare.
Sa i perket biocideve Ministria e Shendetesise ka pergatitur aktualisht nje Projekt-ligj për produktet biocide, i cili synon te mbroje shendetin publik nga organizmat e dëmshëm për shëndetin, përmes sherbimit te specializuar te dezinfektim, dezinsektim dhe deratizimit (DDD). Ky projektligj eshte ne proces diskutimi brenda MSH.

Gjate vitit 2011, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit ka hartuar draft rregulloren "Mbi masat administrative për mbrojtjen e kafshëve të përdorura në eksperimente dhe për qëllime shkencore", qe transpozon pjeserisht direktiven 86/609 EEC qe percakton kriteret specifike ne mireqenien e kafsheve te laboratorit.

Ligje dhe akte te tjera te fushes se kimikateve që nuk transpozojnë akte te Bashkimit Evropian:

- Ligji nr. 10277 date 13.05.2010 per Aderimin e Republikes se Shqiperise ne Konventen e Roterdamit per Proceduren e Njoftimit Paraprak te pelqimit per Kimikate te caktuara te Rrezikshme dhe Pesticideve ne Tregetine Nderkombetare
- Ligji nr.9263, dt. 29.07.2004 "Për ratifikimin e Konventës për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (Stockholm Convention, POPs)
- VKM nr. 860, datë 20.12.2006, " Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eleminimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm "; Fletorja Zyrtare: Viti 2006, Nr 145, Faqe 5723; Data e botimit: 09.01.2007.
- VKM nr. 447, datë 19.09.1994, "Për ndalimin e përdorimit të asbestit si material termoizolues në të gjitha llojet e ndërtimit "; Fletorja Zyrtare: Viti 1994, Nr 17, Faqe 791; Data e botimit: 20.12.1994.
- VKM nr 100, date 03.02.2008 "Per percaktimin e substancave te rrezikshme" botuar në Fletoren Zyrtare nr 19. datë. 22.02.2008 faqe 679.

Struktura institucionale

Çështjet e menaxhimit të kimikateve janë detyrë e disa institucioneve ndërmjet të cilëve janë ndarë përgjegjësitë për këtë fushë ne baze te Ligjit nr.9180, dt.17.7.2003 "Per substancat dhe preparatet e rrezikeshme".

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave është përgjegjëse për Regjistrin Kombëtar (ku te dhënat për këtë regjistër sigurohen nga ministritë e ngarkuara nga ky ligj), për substancat dhe preparatet kimike grumbullimit dhe shperndarjes se informacionit per importet, eksportet, sasite e hedhura ne treg, percaktimin e procedurave te vleresimit te rrezikut, te hartimit te listave te kimikateve te rrezikshme, inspektimet, etj.; MMPAU ka autoritetin per te kontrolluar dhe inspektuar cdo aktivitet me ndikim ne mjedis qe menaxhon kimikatet. Ne perberje te kesaj ministrie funksionojne agjencite rajonale te mjedisit ne shkalle prefekture dhe Inspektorati i Mjedisi.

Ministria e Shendetesise është përgjegjëse për grumbullimim e informacionit per kimikatet (biocidet) dhe barnat si dhe lejimin e perdorimit te biocideve.
MMPAU dhe Ministria e Shendetesise kane pergjegjesine per kontrollin e substancave te rrezikshme. Ligji ngarkon agjensite rajonale te mjedisit dhe dy inspektoratet shteterore ate te Mjedisit dhe Sanitar per ushtrimin e kompetencave qe ju jep ligji ne rast te shkeljeve te detyrimeve qe kane subjektet private apo shteterore per administrimin dhe ruajtjen e substancave te rrezikshme .

Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes është përgjegjëse për kimikatet si lëndë e parë për industrinë, import-eksportin dhe kontrollin e kimikateve te konsumit;

Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit është përgjegjëse për lejet e prodhimit e te importimit te produkteve te mbrojtjes se bimeve dhe pleherat kimike, vleresimin, testimin, administrimin dhe kontrollin e tyre. Importi dhe eksporti i tyre

kontrollohen nga kjo ministri, permes Agjensise Kombetare te Ushqimit (AKU). Ministri ka autoritetin te pezulloje ose ndaloje cdo lloj produkti per mbrojtjen e bimeve (PMB) apo pleh kimik qe nuk i pergjigjet kerkesave te standarteve te miratuara. Ne kontrollin e tyre jane te angazhuar institutet kerkimore ne vartesi te MBUMK, si Instituti i Sigurise Ushqimore dhe Veterinarise (ISUV) si dhe Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujqesore (QTTB) ne Fushe-Kruje. Gjithashtu mbulon direktivat qe lidhen me produktet e mbrojtjes se bimeve dhe perdorimet ne bujqesi si dhe per mbrojtjen e kafsheve te laboratorit.

Ministria e Punes Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta MPÇSSHB ka percaktuar punet e veshtira ose te rrezikshme si dhe listen e substancave te rrezikshme, me qellim mbrojtjen e shendetit dhe sigurimin ne pune nga perdorimi i tyre. Inspektorati shteteror i punes ne vartesi te kesaj ministrie dhe ne bashkepunim me inspektoriatet e tjera te shtetit koordinojne punen per te siguruar zbatimin e legjislacionit te punes nga punedhenesit dhe personat e siguruar prej tyre.

Ministria e Puneve Publike dhe Transportit (MPPT) pergjigjet per transportin e mallrave te rrezikshme. Ajo leshon lejen per automjete qe trasportojne mallrat e rrezikshme, ben kontrollin teknik dhe bashkerisht me Ministrine e Rendit Publik i shoqeron keto mallra deri ne destinacion brenda vendit.Transporti i lendeve eksplozive te importit sigurohet me mjetet dhe personelin e Ministrise se Mbrojtjes.

Ministria e Mbrojtjes jep lejet dhe ka pergjegjesine kryesore per importin, eksportin, testimin e lendeve eksplozive dhe transportin e lendeve kimike te rrezikshme.
Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksportit (AKSHE) në zbatim te ligjit nr.9707, datë 5.4.2007 “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake, mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë”, sipas kërkesës së subjekteve, fizike a juridike, që kryejnë transferime ndërkombëtare të mallrave ushtarake, mallrave me përdorim të dyfishtë, si dhe të teknologjive të tyre, për pajisjen me licencë importi, eksporti, tranziti, me autorizim, me certifikatë ndërkombëtare importi, certifikatën e përdoruesit të fundit, certifikatë shpërndarjeje dhe certifikatë doganore, të mbërritjes së mallit në destinacion.

Ministria e Financave (MF). Autoritetet doganore kontrollojnë në pikat e kalimit të kufirit shtetëror mallin e deklaruar si substancë dhe preparat i rrezikshëm, për importin dhe eksportin e të cilave kërkohet miratim nga ministria përkatëse përcaktuar nga Ligji Nr.9108, datë 17.7.2003 ”Për Substancat dhe Preparatet Kimike”. Autoritetet doganore regjistrojnë ngarkesën me substanca dhe preparate të rrezikshme, që kalon kufirin shtetëror.
Gjithashtu institucione te tjera jane Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, Agjencitë Rajonale të Mjedisit, Inspektoriati Sanitar, Drejtoria e Pergjithshme e Standardizimeve organet e pushtetit vendor, OJQ dhe pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje dhe në zbatim të tij.
Ne vecanti nuk ka nje autoritet kompetent te vetem dhe pergjegjesite ne fushen e kimikateve jane te shperndara midis disa ministrive me pergjegjesi jo te qarta, mbivendosje te detyrave dhe kapacitete te uleta administrative.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet ndarja e qarte e pergjegjesive midis institucioneve, përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- P/Vendimin "Për miratimin e substancave dhe të preparateve kimike, prodhimi, hedhja në treg dhe përdorimi i të cilave kufizohet ose ndalohet", i cili synon perafron plotësisht Aneksin XVII "Për Ndalimin dhe kufizimin e prodhimit, hedhjes në treg dhe përdorimit të substancave të cilat përbëjnë një rrezik të papranueshëm për shëndetin e njeriut dhe mjedisin", **,** të Rregullores nr. 1907/2006 të Këshillit të Europës, datë 18 Dhjetor 2006, mbi Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH). Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me METE, MSH, MBUMK, MPPT, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit qershor 2012.
- P/Vendimin ''Mbi Ndotesit Organik te Qendrueshem", i cili synon perafrim Rregulloren e Parlamentit dhe të Këshillit Europian (KE) Nr. 850/2004 të 29 Prillit 2004 mbi Ndotësit Organik të Qëndrueshëm. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me METE, MSH, MBUMK, MPPT, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit qershor 2012. Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e plote.
- Projektakt për importin dhe eksportin e substancave te rrezikshme qe synon perafrim rregulloren (EC) Nr 689/2008 te Keshillit dhe Parlamentit Europian te 17 qershorit 2008, ne lidhje me importin dhe eksportin e kimikateve te rrezikshme. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me METE, MSH, MBUMK, MPPT, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit shtator 2012. Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e plote.
- Projekt/akt "Lista e substancave te rrezikeshme qe prej natyres se tyre perbejne nje rrezik serioz per jeten dhe shendetin e njeriut dhe per mjedisin", e cila synon te perafroje direktivat e Këshillit 76/769/EEC, 79/663/EEC, 82/806/EEC, 82/828/EEC, 83/264/EEC, 85/467/EEC, 85/610/EEC, 89/678/EEC, 89/677/EEC, 91/173/EEC, 91/338/EEC, 91/339/EEC. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me METE, MSH, MBUMK, MPPT, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit shtator 2012. Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e plote.
- Projektligji "Per produktet biocide ne shendet publik" qe synon te perafroj direktivën 98/8/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 16 Shkurtit 1998 lidhur me hedhjen në treg të produkteve biocide (31998L0008, *OJ L 123, 24.4.1998, p. 1–63).* Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MSH ne bashkepinim me MBUMK. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit qershor 2012. Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e pjesshme
- Draft rregullore "Mbi masat administrative për mbrojtjen e kafshëve të përdorura në eksperimente dhe për qëllime shkencore", qe synon te perafroj pjeserisht direktiven 86/609 EEC qe percakton kriteret specifike ne mireqenien e kafsheve te laboratorit. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte Ministria e Bujqësisë,

Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit shkurt 2012.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Forcim kapacitetesh ne Agjensine e Mjedisit dhe te Pyjeve. Trajnime të Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve dhe ARM-ve për Direktivat e kimikateve
- Forcimi i kapaciteteve inspektuese nëpërmjet trajnimeve që do të zhvillohen nga RENA, "Rrjeti Europian Mjedisor i Para - Zgjerimit" i Komisionit Europian.
- Forcimi i disiplinës së ligjit në mbrojtjen e mjedisit për aktivitetet që prodhojnë dhe/ose menaxhojnë substanca dhe preparateve të rrezikshme.
- Trajnime të Autoriteteve Doganore për legjislacionin për kimikatet
- Forcim i kapaciteteve administrative dhe bashkërendimi në nivel kombëtar dhe vendor.
- Mbledhja e te dhenave dhe pergatitja e Raportimeve kombetare dhe nderkombetare ne kuader te zbatimit te Konventes se Stokholmit dhe Roterdamit.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatmesme synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë te Bashkimit Evropian dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat legjislative afatmesme janë si vijon:

- Projekt/akt per Regjistrimin, Vleresimin, Autorizimin dhe kufizimin e kimikateve e cila synon te perafroje plotesisht Rregulloren nr. 1907/2006 te Keshilit te dates 18 Dhjetor 2006 mbi Regjistrimin, Vleresimin, Autorizimin dhe Kufizimin e kimikateve (REACH). Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me METE, MSH, MBUMK, MPPT, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit qershor 2015. Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e plote.
- Projekt/ akt mbi Klasifikimin, Etiketimin, Paketimin e substancave dhe preparative kimike, e cila synon te perafroje plotesisht Rregulloren (EC) 1272/2008 (CLP) te Parlamentiit dhe Keshillit te Europes te 16 Dhjetor 2008 mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe preparative. Shkalla e përputhshmërisë e cila synon të arrihet: e plote. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me METE, MSH, MBUMK, MPPT, MF, MD. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit qershor 2015
- Draftvendim " Mbi rregullat e klasifikimit, regjistrimit dhe kriteret e vlerësimit të Produkteve Biocide" qe synon perafrim me direktivën 98/8/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 16 Shkurtit 1998 lidhur me hedhjen në treg të produkteve biocide Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MSH ne bashkepunim me MBUMK, MMPAU. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit dhjetor 2013.
- Projektakt "Për mënyrën e ruajtjes dhe transportit të produkteve biocide" qe synon perafrim me Direktivën 98/8/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 16 Shkurtit 1998 lidhur me hedhjen në treg të produkteve biocide Institucioni pergjegjes per

pergatitjen e ketij akti eshte MSH ne bashkepunim me MBUMK, MMPAU. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit qershor 2014

- **P**rojektakt "Mbi kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë personat fizik dhe juridik të licensuar për prodhimin e produkteve biocide" qe synon perafrim me direktivën 98/8/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 16 Shkurtit 1998 lidhur me hedhjen në treg të produkteve biocide Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MSH ne bashkepunim me MBUMK, MMPAU. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit qershor 2014

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Trajnime të Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve për Direktivat e kimikateve
- Trajnime të ARM-ve, për legjislacionin për kimikatet
- Forcimi i kapaciteteve inspektuese nëpërmjet trajnimeve që do të zhvillohen nga RENA, "Rrjeti Europian Mjedisor i Para - Zgjerimit" i Komisionit Europian.
- Forcimi i disiplinës së ligjit në mbrojtjen e mjedisit për aktivitetet që prodhojnë dhe/ose menaxhojnë substanca dhe preparateve të rrezikshme
- Trajnime të Autoriteteve Doganore për legjislacionin për kimikatet.
- Krijimi dhe funksionimi i zyres se regjistrimit te kimikateve (2015)
- Evidentimi dhe rregjistrimi i kimikateve te reja te gjeneruara nga aktiviteti privat
- Mbledhja e te dhenave dhe pergatitja e Raportimeve kombetare dhe nderkombetare ne kuader te zbatimit te Konventes se Stokholmit dhe Roterdamit.
- Pergatitja e nje Trajnimi mbi detyrimet e eksportuesve sipas regullores 689/2008 per import-eksportin e kimikateve e rrezikeshme.
- Trajnim i Doganierëve dhe inspektorëve të mjedisit për kontrollet në kufi dhe parandalimin e hyrjeve dhe përdorimit ilegal të produkteve që përmbajnë HCFC.
- Krijimi apo ripercaktimi i formes se organizmit te organeve pergjegjese qe sigurojne zbatimin e dispozitave ligjore per biocidet: Inspektoratit Sanitar Shtetëror; Sekretariatit të Regjistrimit të Produkteve Biocide, Komisionit të Regjistrimit të Produkteve Biocide; Institutit te Shendetit Publik.
- Hartimi dhe miratimi i praktikave te punes per menaxhimin e biocideve.
- Forcimi i laboratoreve ne ISHP per biocidet
- Trajnimi i personelit per menaxhimin e biocideve.
- Hartimi dhe miratimi i planit te monitorim – vleresimit te veprimtarise se regjistrimit te produkteve biocide ne shendet publik.

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 27.1 cilesia e kimikateve[137]

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**72.969.000**	**17.500.000**	**14.000.000**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	32.969.000	15.000.000	11.000.000	0
Mbuluar nga ndihma e	40.000.000	2.500.000	3.000.000	0

[137] Për më shumë informacion në lidhje me shpenzimet për çdo aktivitet ose institucion të veçantë, ju lutemi konsultoni Shtojcën 3 Vlerësimi financiar i zbatimit të PKZMSA

huaj				
Ndryshim	0	0	0	0

3.27.10. ZHURMAT

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Qeverisë shqiptare, Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe institucioneve të tjera me detyra në këtë fushë eshte reduktimi i ndotjes akustike permes forcimit te zbatimit te legjislacionit egzistues dhe hartimit te legjislacionit sekondar ne perputhje me rregulloret specifike te BE per fushen e zhurmave.
Fusha e zhurmave është një prej nënfushave prioritare që lidhen me acquis e Bashkimit Evropian në fushën e mjedisit. Siç përcaktohet nga MSA (neni 70/3 si dhe neni108), përafrimi i legjislacionit shqiptar me acquis në fushën e mjedisit, lidhet direkt me standardet mjedisore dhe detyrën jetësore për të luftuar degradimin e mjedisit me qëllim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Ky objektiv, është shkrirë në dokumentet strategjike sektoriale si: Plani Kombëtar i Veprimit në Mjedis, Strategjia Ndersektoriale e Mjedisit dhe Plani Kombetar i Veprimit per menaxhimin e zhurmave ne mjedis".

Analiza e situatës aktuale

Zhurmat jane nje problem i zakonshem urban. Burimet e tyre kryesore jane transporti, gjeneratoret, ndertimet, industria dhe disa aktivitete tregtare. Per kete qellim, eshte miratuar ligji per "Vleresimin dhe menaxhimin e zhurmes ne mjedis", qe transpozon pjeserisht Direktiven 2002/49/EC e Parlamentit dhe Këshillit Europian, datë 25 Qershor 2002 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis".

Ka nje program monitorimi te zhurmave ne mjedis qe ndjek Programin Kombetar te Monitorimit te mbeshtetur ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 1189, date 18.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e programit kombetar te monitorimit te mjedisit", fletorja zyrtare nr. 200, dhjetor 2009. Monitorimi i zhurmave urbane në shumicën e qyteteve të rëndesishëm organizohet dhe financohet nga MMPAU dhe kryhet nga Instituti i Shendetit Publik. Monitorimi i zhurmave urbane në qytetet, Tirane,Durres, Fier, Shkoder, Vlore, Sarande dhe Korçe kryhet nga Instituti i Shendetit Publik dhe financohet nga MMPAU.

Te dhenat mbi gjendjen e ndotjes akustike paraqiten ne Raportin e Gjendjes ne Mjedis te pergatitur nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve
Per zbatimin e legjislacionit ne fuqi eshte i domosdoshm krijimi i Këshilli Teknik për Zhurmat prane MMPAU-se dhe krijimin e njësise bazë te referencës për matjen, monitorimin dhe vlerësimin e saj, prane Institutit te Shendetit Publik.

Ne MMPAU ne sektorin e ajrit, ndryshimeve klimatike, zhurmave dhe kimikateve ka vetem dy specialiste të angazhuar njekohesisht me hartimin e politikave per zhurmat,cilesine e ajrit, ndryshimet klimatike dhe kimikatet. Për këtë arsye është e domosdoshme forcimi i

kapaciteteve administrative me 1 specialist zhurmash në Sektorin e Ajrit, Ndryshimeve Klimatike, Zhurmave dhe Kimikateve që të mund t'i dedikohet tërësisht kësaj fushe si në drejtim të hartimit, ashtu edhe të zbatimit të legjislacionit.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Kuadri ligjor kryesor ku mbeshtetet mbrojtja nga zhurmat ne mjedis eshte Ligji Nr. 9774, date 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" Fletorja Zyrtare: Viti 2007, Nr 93, Faqe 2667, i cili transpozon pjeserisht Direktiven 2002/49/EC, date 25.06.2002, Gazeta Zyrtare 189, dt. 18.07.2002, per menaxhimin dhe administrimin e zhurmes urbane.

Ne zbatim te ketij ligji eshte miratuar Udhezimi i perbashket i Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave (MMPAU) dhe Ministrise se Shendetesise Nr.8, date 27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara", i cili eshte mbeshtetur ne rekomandimet e OBSH-se. Si mjedise te caktuara, per efekt te zbatimit te ketij udhezimi, jane identifikuar mjediset e zonave te banimit, (jashte baneses, mjediset e brendshme te baneses), institucionet (arsimore, parashkollore e shendetesore), zona me aktivitet social-ekonomik, mjedise urbane dhe parqet publike. Ne Aneksin 1 i ketij udhezimi percaktohen nivelet kufi te zhurmes per mjedise te caktuara.

Ne zbatimi te ligjit 9774/2007 u hartua VKM nr. 123, date 17.02.2011 "Për miratimin e Planit Kombetar te Veprimit per menaxhimin e zhurmave ne mjedis" si dhe VKM nr. 587 datë 07.07. 2010 "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike",ku percaktohen qarte detyrat e institucioneve pergjegjese per administrimin e zhurmave.
Ne bashkepunim me Ministrine e Transporteve eshte hartuar Udhëzimi Nr.12, datë 15.6.2010 "Mbi disa ndryshime në udhëzimin nr.6527, datë 24.12.2004 "Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotëse të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre" i shoqeruar me Manualin e Kontrollit të Mjeteve, qe transpozon Direktiven 2009/40/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit 6 Maj 2009 "Mbi kontrollin teknik për mjetet motorike dhe rimorkiot e tyre".

Struktura institucionale

Institucionet përgjegjëse janë Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit Ujerave (MMPAU), MSH, MPPTT.
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave eshte institucioni pergjegjes per hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive, planeve kombetare dhe legjislacionit për parandalimin, reduktimin e efekteve të dëmshme të shkaktuara nga zhurmat mbi nivelin kufi me synim mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe të mjedisit, si dhe garantimin e qetësisë publike në të gjitha qendrat e urbane dhe turistike.

Ne zbatim te ligjit Nr.9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" dhe VKM nr. 587 datë 07.07. 2010 "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike", Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të

Ujërave dhe Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet strukturave të tyre qëndrore dhe rajonale duhet të marrin të gjitha masat për monitorimin e situatës në qendrat urbane dhe turistike në vend, duke ushtruar kontroll në të gjitha aktivitetet e subjekteve fizikë dhe juridikë të cilat janë burim zhurme.

Monitorimi i zhurmave ne mjedis kryhet nga Instituti i Shendetit Publik mbi bazen e kontratave te monitorimit te hartuara nga MMPAU. Rezultatet e gjendjes se zhurmave ne mjedis paraqiten ne Raportin e Gjendjes se Mjedisit te hartuar nga Agjensia e Mjedisit dhe Pyjeve.

Ministria e Brendshme nëpërmjet strukturave të Policisë së Shtetit ka per detyre te mbështese e organeve dhe strukturave shtetërore që ushtrojnë monitorimin dhe kontrollin e zhurmave në mjedis. Strukturat vendore të Policisë së Shtetit dhe strukturat ekzekutive të Njësive të Qeverisjes Vendore ndjekin zbatimin e vendimit të marrë nga ana e Inspektoriatit të Mjedisit pa praninë e tyre, në subjektet që gjenerojnë zhurmë në kundërshtim me ligjin.

Organet e qeverisjes vendore që hartojnë apo miratojnë planet e rregullimit të territorit kane per detyre te kërkojnë nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari apo përdorin impiante dhe instalime që lëshojnë zhurmë, marrjen e masave parandaluese për respektimin e vlerës kufi të zhurmës.

Legjislacioni egzistues parashikon ngritjen e Këshilli Teknik për Zhurmat prane MMPAU dhe krijimin e njësise bazë te referencës për matjen, monitorimin dhe vlerësimin e saj, prane Institutit te Shendetit Publik, struktura qe aktualisht nuk jane ngritur.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë te Bashkimit Evropian dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Draft Udhezim “Per treguesit, mënyrat e vlerësimit, rregullat dhe kërkesat teknike e metodike për vlerësimin e nivelit të zhurmës, si dhe për verifikimin e ndërhyrjeve të bëra për zgjidhjen dhe përmirësimin e gjendjes” i cili synon te perafroj pjeserisht Direktiven 2002/49/EC e Parlamentit dhe Këshillit Europian datë 25 Qershor 2002 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis”, OJL 189, 18.07.2002. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me, METE, MSH, MPPT. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit dhjetor 2012.
- Draft Udhezim “Për kërkesat minimale për hartezimin strategjik të zhurmës”, synon te perafroj pjeserisht Direktiven 2002/49/EC e Parlamentit dhe Këshillit Europian datë 25 Qershor 2002 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis”, OJL 189, 18.07.2002. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me, METE, MSH, MPPT. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit dhjetor 2012.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Monitorimi i zhurmave urbane nga institucionet vendase;
- Forcim kapacitetesh teknike ne Sektorin e Ajrit, Ndryshimeve Klimatike, Kimikateve dhe Zhurmave;
- Monitorimi i zbatimit te Planit Kombëtar te Veprimit për Menaxhimin e Zhurmave
- Kontrolli ndaj aktiviteteve ekonomike qe shkaktojne zhurma ne mjedis;
- Vendosja e sanksioneve ndaj subjekteve qe tejkalojne normat e lejuara te zhurmave ne mjedisin urban.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatmesme synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.
Masat legjislative afatmesme janë si vijon:

- P/ligj "Për kufizimin e zhurmave nga aviacioni", i cili synon të perafroj pjeserisht Direktivat e Këshillit 89/629/EEC, 92/14/EEC, 98/20/EEC, Rregulloren e Komisionit 991/2001, si dhe Rregulloren 1592/2002 EEC e Parlamentit. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me, METE, MSH, MPPT. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit dhjetor 2014.
- P/vendim "Per kriteret, procedurat dhe rregullat per çertifikim, pezullimin dhe heqjen e certifikates se ekspertit te zhurmes ne mjedis. Ky akt rrjedh nga ligji i zhurmave qe ka perafruar Direktiven 2002/49/EC; Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me, METE, MSH, MPPT. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit dhjetor 2015.
- P/vendim "Per perberjen dhe organizimin e Komitetit Teknik te Zhurmave (KTZH)" Ky akt rrjedh nga ligji i zhurmave qe ka perafruar Direktiven 2002/49/EC. Institucioni pergjegjes per pergatitjen e ketij akti eshte MMPAU ne bashkepunim me, METE, MSH, MPPT. Parashikohet miratimi i tij brenda muajit dhjetor 2015.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Hartëzimi i zhurmës në nivel kombetar me ane te GIS (sistem dixhital i shfaqjes dhe monitorimit te te dhenave nepermjet shtresave).
- Çertifikimi i pajisjeve per testet e zhurmave;
- Ngritja e një sistemi monitorimi për të verifikuar konformitetin, përfshirë kontrollet në vend;
- Përcaktimi dhe ndjekja e proçedurave të penalizimit në rast mosrespektimit të rregullave për nivelet e zhurmave;
- Krijimi nje regjistri tip per zhurmat.
- Përgatitja e programit vjetor të inspektimit
- Inspektimet në terren për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore

- Përcaktimi i 15 stacioneve të reja të monitorimit

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 27 zhurmat[138]

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**0**	**0**	**47.952.000**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	0	0	47.952.000	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.27.11. PYJET DHE KULLOTAT

Objektivi strategjik

Te zhvilloje sektorin pyjor për ta bere atë te rëndësishëm ne zhvillimin rural dhe ne çrrënjosjes se varfërisë. Te zhvilloje një sistem pyjor te zhvillimit e qëndrueshëm, efektiv nga pikëpamja ekonomike, te pranueshme nga shoqëria dhe miqësore me mjedisin.

Ndërkohë Shqipëria është vend qe ka firmosur dokumentet themelore te FOREST EUROPE te cilat synojnë zhvillimin gjithëpërfshirës te sektorit te pyjeve ne Europe dhe adaptimin e politikave e strategjive te përbashkëta për te siguruar integritetin e mjedisit pyjor.
Po ashtu, neni 108 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit përcakton se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian do të ketë si synim modernizimin dhe ristrukturimin e pylltarisë shqiptare e te sistemeve agro-pyjore e silvo-pastorale, si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave me rregullat dhe standardet te Bashkimit Evropian.

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet :

- zhvillimit te qëndrueshëm te pyjeve dhe pylltarisë;
- sigurimit te integritetit dhe shumë funksionalitetit te pyjeve;
- rritjes se rolit te pyjeve ne zhvillimin rural, nëpërmjet procesit te transferimit te pyjeve ne komuna e familje, bazuar ne te drejtën zakonore te përdorimit dhe forcimit te kapaciteteve te nj.q.v për menaxhimin e qëndrueshëm te pyjeve me baze komuniteti;
- rritja e performancës së shërbimit pyjor në drejtim të përsosjes së shërbimit, bazës së të dhënave asistencës teknike,
- Forcimi i ligjit për reduktimin e prerjeve ilegale dhe tregtimin te pa ligjshëm te materialit drusor;
- pjesëmarrja aktive e aktorëve të interesuar në forumin e pyjeve dhe rritja e transparencës ne proceset e ristrukturimit te sektorit pyjor;

[138] Për më shumë informacion në lidhje me shpenzimet për çdo aktivitet ose institucion të veçantë, ju lutemi konsultoni Shtojcën 3 Vlerësimi financiar i zbatimit të PKZMSA

- adaptimi i pyjeve kundrejt ndryshimeve klimatike, kontrollit te erozionit dhe ruajtjes se biodiversitetit e cilësisë se ujit, nëpërmjet vendosje se skemave për pagesa ne ekosistem;
- hartimi i një plani kombëtar pyllëzimesh duke stimuluar ato specie qe harmonizojnë kërkesat për siguri ushqimore, energji te rinovueshme dhe shërbime ekologjike;
- ruajtja e monitorimi i gjendjes shëndetësore të pyjeve;
- zhvillimi i sistemit te kërkimit, zhvillimit teknologjik, inovacioneve dhe përmirësimi i edukimit e trajnimit në pyje,
- Përsosja e monitorimit dhe certifikimit te pyjeve;
- bashkëpunimit ndër-sektorial e Pan-Europian.

Politikat e programit te sektorit te pyjeve kane për qellim zhvillimin e qëndrueshëm dhe shume funksional te resurseve pyjore dhe kullosore qe sigurojnë shtimin e sipërfaqeve pyjore, rrisin prodhimtarinë dhe aftësinë ripërtëritëse te pyjeve, parandalojnë degradimin e mëtejshëm te tokës, mbrojnë biodiversitetin e sigurojnë potencial maksimal për te përmbushur funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale ne nivel lokal, kombëtar dhe global, pa cenuar ekosisteme te tjera
Kjo politikë mbështet:

- trajnimin e strukturave te njësive të qeverisjes vendore për pyjet dhe kullotat të transferuara në pronësi;
- shtimin e sipërfaqeve të reja pyjore, rehabilitimin e sipërfaqeve të djegura dhe të degraduara, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ujëmbajtëse në kullota, kontrollin e fenomenit të erozionit, përmirësimin e menaxhimit të produkteve pyjore dhe jo pyjore, të cilat do të çojnë në gjenerimin e të ardhurave.
- forcimin e zbatimit të legjislacionit rregullator ne fushën e pyje, kullotave dhe kontrolli rigoroz i aktiviteteve qe zhvillohen ne fondin pyjor, kullosor e atë të gjuetisë

Situata aktuale

Nga territori i përgjithshëm i Shqipërisë prej 27.748 km^2, 60% e saj është klasifikuar si pyje dhe kullota, duke krijuar fondin Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave. Sipas Inventarit Kombëtar të Pyjeve, sipërfaqja pyjore arrin 1.498.570 ha. Rritja natyrore e pyjeve të Shqipërisë rezulton te jetë rreth 2.0 m^3/ha/vit; që do të thotë se ne mund të shfrytëzojmë rreth 1.000.000 m^3/ha/vit. Sipërfaqja pyjore për person, gjithashtu paraqitet e ulët: rreth 0.442 ha/person ose më pak se 1 m^3/person/vit.

Pyjet dhe kullotat përgjithësisht shtrihen në terrene kodrinore e malore, shpesh herë të pa mbritshëm për t'ju shërbyer, pa infrastrukturën e nevojshme për ti përdorur dhe larg për të shijuar intensivisht vlerat rekreative dhe çlodhëse.
Shqipëria mund të konsiderohet e pasur me sipërfaqe pyjore, madje dhe me potencial të lartë prodhues, por me mundësi të ulët prodhimi aktual. Rreth 60% e pyjeve ndodhen në lartësitë mbi 800m mbi nivelin e detit, me infrastrukture larg te qenit brenda standardeve evropiane dhe shpesh here e pa mbritëshme. Gjithashtu rreth 65% e pyjeve të lartë (burimi kryesor i materialit drusor për industrinë) dhe rreth 73% të cungishtave (burimi kryesor i druve të

zjarrit) akoma janë në periudhën e rritjes intensive dhe nuk kanë arritur moshën e pjekurisë për tu përdorur.

Në fondin pyjor, në rreth 23% të sipërfaqes vërehet nivel i lartë i gërryerjes, ku ndërmarrja e masave efektive rehabilituese është e domosdoshme. Ky degradim ka ardhur si rezultat i mbikullotjes dhe shfrytëzimit intensiv historik (2-2.5 herë më shumë se rritja natyrore e pyjeve. Ndërsa që rritet erozioni në male, çka shkakton varfërimin e tokës, rritet dhe niveli i sedimenteve në lumenj e në det, çka sjell shqetësime në zonën e ulët fushore, përfshi përmbytje masive.

Ndërkohë akoma rreth 50% e popullsisë jeton në zonat rurale, ku materiali i vetëm energjetik për ngrohje dhe gatim mbeten drutë e zjarrit. Një pjese e mire e këtyre familjeve janë tërësisht te varura nga pyjet.
Zjarret në pyje janë një tjetër shqetësim i rëndësishëm i cili vazhdimisht shkakton humbje të mëdha ekonomike.

Informaliteti në pyje, e sidomos ai i vlerësimit të prerjeve reale të druve të zjarrit në zonat rurale dhe vlerësimi real i kontributit të pyjeve në zhvillimin rural/ekonomik të vendit, mbetet akoma i lartë.

Përsa i përket rrjetit të zonave të mbrojtura (sipas kategorive të IUCN) Shqipëria ka arritur standardet Europiane duke e rritur sipërfaqen me status specifik mbrojtës në 373.997 ha ose rreth 14% të territorit.

Analiza e situatës aktuale

Bazuar ne këta tregues pyjore dhe nevojat jetike familjare te zonave rurale e atyre malore, kërkohet një menaxhim me i mirë e me eficient i materialit drusor, i lidhura me proceset e shtimit te sipërfaqes pyjore nëpërmjet pyllëzimeve dhe sidomos atyre me cikël te shkurtër prodhimi për energji te rinovueshme, rritjes se eficiencës se përdorimit te materialit drusor nëpërmjet prodhimit te materialeve destinuar për energji nga mbeturinat e drurit, përfitimit te materialeve për energji nga shërbimet silvikulturore etj.

Zbatimi i sistemit te pagesave për shërbime ne ekosistem dhe shfrytëzimi i mekanizmave ndërkombëtare te lidhura me kontrollin e erozionit, sekuestrimin e karbonit dhe ruajtjes se biodiversitetit do nxite rritjen e përgjegjësisë dhe interesin për mbjellje, duke ulur ne maksimum interesin për prerjet.

Përmirësimet ligjore te lidhura me përdorimin racional e sidomos me masat preventive ndaj zjarreve si dhe rritja e aftësive menaxhuese te shërbimit pyjor do intensifikonte rritjen e pyjeve te degraduar e shkurreve duke rritur ne këtë mënyrë potencialin prodhues te tyre.

Përmirësimet strukturore ku ne themel qëndron ndarja e kompetencave e detyrave kontrolluese e menaxhuese do rite ndjeshëm aftësinë e strukturave pyjore për te menaxhuar e mbrojtur sipërfaqet pyjore. Shërbimi këshillimor pyjor, i krijuar për here te pare ne Shqipëri,

për te asistuar ne nj.q.v. ka bere realitet transferimin e dijeve dhe përhapjen e përvojave e praktikave me te mira.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis e bashkimit Evropian* në fushën e Pyjeve e Kullotave, lidhet direkt me standardet mjedisore dhe detyrën jetësore për të luftuar degradimin e mjedisit me qëllim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore (neni 108 MSA). Ky objektiv, është shkrirë në dokumentet strategjike sektoriale si Plani i Veprimit në Mjedis, Strategjia dhe Plani i Veprimit të Biodiversitetit dhe Strategjia e Zhvillimit të Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave.
Baza ligjore aktuale në fushën e pyjeve e kullotave është pjesërisht e përafruar me direktivat dhe rregulloret e BE-së. Është ne proces ndarja e funksioneve menaxhuese nga ato kontrolluese nëpërmjet realizimit te reformës institucionale ne pyje, krijimi i drejtorive rajonale te shërbimit pyjor dhe ne përbërje te tyre, struktura e re e shërbimit këshillimor.

Janë miratuar këto iniciativa ligjore:

- Ligji nr. 10120 datë 23.04.2009 "Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore
- Ligji Nr 10 279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtet administrative”
- Ligji Nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”
- VKM nr. 632, datë 11.06.2009 " Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave e livadheve për kullotje e kositje"
- VKM nr. 746, datë 23.06.2009 “Për përcaktimin e tarifave për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqeve që përdoren për ndërtimin e veprave industriale”
- **V**endim Nr. 1064, datë 22. 12. 2010 **“**Për disa ndryshime ne vendimin nr. 391, date 21.6.2006 te Këshillit te Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave**”.**
- Vendim Nr. 734, datë 1.09. 2010 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë”
- Vendim Nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje”
- Vendim nr. 361 datë 12.5. 2010 “Për miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullosor, publik”
- Udhëzim nr. 2, datë 14.05.2009 “Për kriteret e konkurrimit proçedurat e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor”
- Udhëzim i përbashkët me Nr. 1457/2 Prot. datë 24.07.2009 MMPAU dhe Nr.5869/2 Prot. date 24.07.2009 METE “Për proçedurat për mënyrën e kryerjes së pagesës, si dhe për lidhjen e kontratës për sipërfaqet e hequra nga fondi pyjor dhe kullosor që do të përdoren për ndërtimin e veprave industriale”.
- Rregullore Nr.3 datë 08.07.2009. “Për certifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota” kategoria III. 7. A”
- Udhëzim nr. 2, datë 26.04.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 4, datë 25.8.2010 të MMPAU “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave e grup ngastrave

për shfrytëzim, rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore”

Kuadri ligjor ekzistues i përafruar me acquis e BE

- Ligji Nr.9385, Date 04.05.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor” i ndryshuar i cili perafron Direktiven e Këshillit 88/332/EEC 13 Qershor 1988 për amendimin e disa Direktivave mbi tregtimin e farave dhe shpërndarjen e tyre në mënyrë që të jepen rregullat për aplikimin e masave që lidhen me farat dhe përhapjen e materialit që përmbush kërkesat më pak të forta; Vendimin e Këshillit 89/367/EEC i 29 Majit 1989 për krijimin e Komitetit të Përhershëm të Pyjeve; Vendimin e Komisionit 96/653/EC i 11 Nëntorit 1996 i cili autorizon vendet anëtare për lejimin e përkohshëm të tregtimit të materialeve riprodhuese pyjore të cilat nuk përmbushin kërkesat e Direktivës së Këshillit 66/404/EEC dhe 71/161/EEC. Gjithashtu ky ligj synon perafrim me Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 1460/98 e 8 Korrikut 1998 që amendon Rregulloren (EEC) Nr 1170/93 që heq disa rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EEC) Nr 2158/92 mbi mbrojtjen e Pyjeve të vendeve komunitare nga zjarri, si dhe me Rregulloren (EC) Nr 2152/2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës e 17 Nëntorit 2003 për monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimit mjedisor në vendet Komunitare (Fokus Pyjet); dhe me Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 1737/2006 e 7 Nëntorit 2006 “Për heqjen e disa rregullave të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr 2152/2003 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës për monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimin mjedisor në vendet e Komunitetit”.
- Ligji Nr.9693, date 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor”i cili perafron pjeserisht acquis-in e Bashkimit Evropian per fushen.

Ligjet dhe aktet e tjera që nuk transponojnë akte te bashkimit Evropian:

- Vendim Nr. 394, datë 21.6.2006 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të prodhimeve të tjera pyjore dhe jo pyjore”;
- Vendim Nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”;
- Vendim Nr. 396, datë 21.6.2006 “Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve dhe kullotave nga njësitë e qeverisjes vendore”;
- VKM. Nr. 804 , datë 4.12.2003 "Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare, që vihen në mbrojtje”;
- VKM Nr. 247, datë 23.4.2004 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Pyjeve dhe Kullotave”;
- VKM Nr. 48, datë 31.1.2007 “Për përcaktimin e rregullave për mbajtjen, përbërjen, afatet e përdorimit e të zëvendësimit të uniformës dhe të pajisjeve e të mjeteve të tjera në përdorim të punonjësve të shërbimit pyjore”
- VKM Nr. 887, datë 19/12/ 2007 “Për miratimin e tarifave te përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje”;
- VKM Nr. 22, datë 09/01/ 2008 “Për proçedurat dhe kriteret e administrimit të pyllit komunal”;
- Ligj Nr. 8294, datë 02.03.1998 “Për ratifikimin e Konventës së Bernës" ;

- Ligji Nr. 7722, datë 15.06.1993 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”;
- VKM Nr. 1354, Date 10/10/2008 “Për përcaktimin e kritereve për caktimimin e vlerës se demit te shkaktuar ne fondin kullosor”;
- VKM Nr. 1374, Date 10/10./2008 “Për rregullat dhe proçedurat, qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor **“;**
- VKM Nr.1353, Date 10/10/2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe proçedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”
- VKM Nr. 746, Date 23.06.2009 "Për përcaktimin e tarifave për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor te sipërfaqeve qe përdoren për ndërtimin e veprave industriale";
- VKM Nr. 632, Date 11.06.2009 "Për miratimin e tarifave te përdorimit te kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje";
- Udhëzim i MMPAU Nr. 5, Datë 13.9.2006 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave e nën ngastrave për shfrytëzim, të damkosjes së drurëve, të prerjes e asortimit, të transportit e stivosjes së materialit drusor në anë të rrugës”.
- Udhëzim i MMPAU Nr. 4, Datë 8.5.2006 “Për pajisjen me Çertifikate Origjine Për Eksport”;
- Udhëzim i MMPAU Nr. 3, Datë 13.9.2006 “Për organizimin dhe zhvillimin e ankandit të shitjes se materialit drusor të asortuar e të magazinuar në anë të rrugës”;
- Udhëzim i MMPAU Nr. 6, Datë 2.10. 2007 “Për rregullat dhe proçedurat e dhënies ne përdorim te fondit pyjor e kullosor”;
- Udhëzim i MMPAU Nr.4, Datë 10/04/ 2008 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”;
- Udhëzim Nr 2, Date 14/05/2009 “Për procedurat e dhënies ne përdorim te fondit pyjor dhe kullosor”;
- Udhëzim i përbashkët i MMPAU dhe METE me Nr.1457/2 Prot. Datë 24.07.2009 MMPAU dhe Nr. 5869/2, Date 24.07.2009 METE “Për proçedurat për mënyrën e kryerjes se pagesës, si dhe për lidhjen e kontratës për sipërfaqet e hequra nga fondi pyjor dhe kullosor qe do te përdoren për ndërtimin e veprave industriale”;
- Rregullore Nr.3, Datë 08.07.2009 “Për çertifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale ne pyje dhe kullota” kategoria III. 7. A.
- Udhëzim nr. 2, datë 26.04.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 4, datë 25.8.2010 të MMPAU “për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave e grup ngastrave për shfrytëzim, rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”
- VKM Nr. 1080, datë 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare për shuarjen e zjarreve**”.**
- Rregullore Nr. 1, datë 21.02.2011 “Rregullore për funksionimin e postblloqeve pyjore”
- Udhëzim i përbashkët midis MMPAU dhe MB, Nr. 3, date 27.05.2010 “Për bashkëpunimin e organeve te shërbimit pyjor me organet e qeverisjes vendore”

Struktura institucionale

Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave ne përbërje te Ministrisë se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, është autoriteti përgjegjës shtetëror i ngarkuar për administrimin e qëndrueshëm dhe shume-funksional te fondit pyjor e kullosor kombëtar.
Ndryshimet në politikat ekonomike kombëtare dhe kërkesat shoqërore në pyje kanë patur ndikime direkte dhe substanciale në institucionet e qeverisjes së pyjeve dhe në rregullimet administrative për menaxhimin e qëndrueshëm dhe shumë-funksional të tyre. Këto përfshijnë përshtatje të rolit të administratave pyjore, një lëvizje drejt decentralizimit dhe ndryshime në kërkimin, edukimin pyjor dhe të strukturave.

Organizimi i Shërbimit Pyjor Shqiptar qe po zbatohet është i hierarkizuar ne rang piramidal nga qendra ne 10 rajone, me 36 zona pyjore e 386 njësi territoriale menaxhimi.
Shqipëria klasifikohet në grupin e vendeve që kanë nxitur përfshirjen e fuqishme të qeverisjes lokale në menaxhimin e burimeve natyrore.

Forcimi i kapaciteteve, koordinimi i rolit dhe detyrave brenda dhe ndër-sektoriale, sipas parimit të ndarjes funksionale të roleve, rritja e shkallës së profesionalizim, përgjegjshmërisë dhe motivimit të punonjësve dhe përfshirja e harmonizuar e faktorëve politike e shoqërore në këto procese janë detyra esenciale që adresohen në reformën institucionale
Përmirësimi i teknologjisë tregon dobinë e lartë publike të saj dhe mbështetjen që ato i japin rritjes së cilësisë dhe efektivitetit në kryerjen e funksioneve publike, prandaj kërkimi, përmirësimi teknologjik dhe inovacioni në përsosjen e bazës së të dhënave e përgatitjes së projekteve të menaxhimit e aktiviteteve në pyje, nëpërmjet formatizimit të sistemit të kërkimit, zhvillimit teknologjik, inovacionit dhe shërbimit të ekstensionit, zë një vend të veçantë. Kjo nënkupton vendosjen e një raporti të ri më cilësor bashkëpunimi ndërmjet DPK, Akademisë, Universiteteve dhe Agjencisë së Mjedisit.

Me strukturën e re synohet që objektivi i qeverisë për "*përdorimi efiçient i burimeve publike për sektorët më premtues të ekonomisë"* të fokusohet krahas bujqësisë edhe në pylltari, si sektor që mbart potenciale të qenësishme të zhvillimit të integruar ekonomik e rural.
Ndarja e funksioneve administruese nga ato kontrolluese përbën domosdoshmërinë më të madhe për ndërmarrjen e reformës institucionale ne sektorin e pyjeve.

Riorganizimi i strukturës organizative përbën një domosdoshmëri për të përmbushur misionin e saj në përputhje me strategjinë e sektorit pyjor dhe objektivat madhore të strategjive e iniciativave Europiane dhe Ndërkombëtare, ku Shqipëria aderon (Strategjia e Lisbonës, CDB, Protokolli i Kyotos, Strategjia për energjitë e rinovueshme, Strategjia Pan Europiane për Ruajtjen e Diversitetit Biologjik dhe të Peizazheve etj.).

Menaxhimi i fondit pyjor kombëtar mbështetet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm e shumë funksional të pyjeve e kullotave. Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave për administrimin dhe qeverisjen e fondit pyjor kombëtar, të kullotave, bimëve mjekësore e të burimeve të tjera pyjore e jo pyjore dhe të infrastrukturës rrugore, ushtron detyra të karakterit projektues menaxhues e këshillues, në përputhje me organizimin e strukturave vartëse. Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, funksionon e organizuar në dy sektorë **(i)** Sektori i Mbarështimit dhe i Trajtimit **(ii)** Sektori i Shërbimit Këshillimor dhe Pyjeve Komunale. Ajo bashkëpunon me Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve, Ministrinë e Brendshme (AITPP), MBUMK, METE,

Njësitë e Qeverisjes Vendore, Shoqatat e Përdoruesve te Pyjeve dhe Kullotave Komunale, si dhe Shoqatat e Bimëve Mjekësore, Eterovajore.

Sektori për Policinë Pyjore ne përbërje te Drejtorise se Kontrollit per Mjedisin ne MMPAU është organ i specializuar i shërbimit pyjor, me funksione teknike e kontrolluese. Ajo kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për pyjet, kullotat, zonat e mbrojtura, florën e faunën e egër, veprimtarinë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar pavarësisht formës së pronësisë mbi fondin. Drejtoria e Kontrollit për Mjedisin funksionon e organizuar ne tre sektorë: (i) Sektori për Policinë Pyjore, (ii) Sektori për Kontrollin e Peshkimit dhe (iii) Inspektoratin e Mjedisit. Ajo bashkëpunon me Policinë e Shtetit, Tatimet, INUK etj.

Masat ligjore afatshkurtra

Ne nje perspektive afatshkurter synohet percaktimi me i qarte i kometencave te institucioneve te perfshira ne realizimin e fushes se pyjeve, permiresimi i koordinimit te institucioneve te perfshira ne realizimin e fushes se pyjeve, permiresimi i koordinimit nderinstitucional, perafrimi i metejshem i legjislacionit shqiptar me ate te Bashkimit Evropian dhe zbatimi i plote i tij.

Për adresimin e prioriteteve afatshkurtra do te ndërmerren iniciativat e mëposhtme ligjore:

- Projektligj i ri "Për pyjet dhe kullotat"
- Projektligj i ri ”Për materialin mbjellës dhe riprodhues pyjor”
- Projektvendim “Për miratimin e tarifave të mbledhjes dhe grumbullimit të bimëve mjekësore, eterovajore tanifere natyrore (BMET) në fondin pyjor dhe kullosor kombëtar.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Seminare e takime për funksionimin e shërbimit këshillimor ne nivel qendror, rajonal dhe lokal;
- Trajnimi i strukturave te reja te menaxhimit te pyjeve komunal dhe te shërbimit këshillimor ne nivel komune dhe qarku;
- Takimet rajonale për problemet e zbatimit te ligjshmërisë ne pyje dhe kullota;
- Monitorimi i gjendjes shëndetësore te pyjeve e pyllëzimeve nëpërmjet vendosjes se treguesve te FORES EUROPE;
- Aktivitete për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për përdorimin e qëndrueshëm dhe sa me efektiv te burimeve natyrore.
- Organizim trajnimesh për përsosjen e strukturave e njohurive te grumbullimit, përpunimit e shpërndarjes se te dhënave;
- Vendosja e taksave e tarifave për te siguruar eficiencen ekonomike te sektorit;
- Përpunimi i metodologjive dhe strukturave për sigurimin e shërbimeve ne ekosistem

Masat ligjore afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren iniciativat ligjore të mëposhtme:

- Projektakt “Mbi zbatimin e Programit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave”
- projektakt “Mbi inventarin kombëtar te pyjeve”
- hartimi i strategjisë 10 vjeçare te pyjeve

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Për adresimin e prioriteteve afatmesme do të ndërmerren aktivitetet zbatuese të mëposhtme:

- Trajnimi i strukturave te menaxhimit te pyjeve/kullotave tre nivelet, qendror, rajonal dhe lokal;
- Seminare e takime për funksionimin e shërbimit këshillimor ne nivel rajonal dhe lokal;
- Trajnime te shërbimit këshillimor ne tre nivelet, qendror, rajonal dhe lokal;
- Aktivitetet ndergjegjesuese me synim ndryshimin e sjelljes se komunitetit ne drejtimin e duhur për vlerat jetësore te pyjeve, kullotave dhe burimeve te tjera natyrore.
- Përsosja e sistemit te kërkimit, zhvillimit teknologjik e inovacioneve ne pyje
- Përhapja e praktikave me te mira ne pyje
- Nxitja e kompanive për te përmirësuar teknologjitë e shfrytëzimit me makineri me kosto te ulet e miqësore me mjedisin;
- Nxitja e pyllëzimeve me arrore e me interes bio energjie
- Takime rajonale e workshop-e per diskutimin dhe marrjen e mendimeve për projektligjin e ri te pyjeve dhe kullotave,
- Seminare trajnimi për materialin mbjellës dhe certifikimin e farave e fidanëve
- Testimi i inspektorëve të Policisë Pyjore, në të gjithë vendin, mbi njohjen dhe zbatimin e legjislacionit rregullator në fushën e pyjeve, kullotave e gjuetisë
- Trajnime te inspektoreve te Policisë Pyjore ne tre nivelet, qendror, rajonal dhe lokal;
- Aktivitetet ndergjegjesuese me synim parandalimin e dëmtimit të pyjeve nga dëmtuesit dhe sidomos nga zjarret nw pyje dhe kullota.

Efektet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**91.700.000**	**27.093.000**	**164.177.000**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	1.700.000	27.093.000	0	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	90.000.000	0	164.177.000	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.28. MBROJTJA E KONSUMATORËVE DHE SHËNDETI PUBLIK

3.28.1. MBROJTJA E KONSUMATORËVE

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Ministrisë se Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes (METE), në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve është krijimi i kushteve për funksionimin e sistemit institucional në drejtim të garantimit të sigurisë së produkteve të konsumatorëve dhe mbrojtjes së interesave ekonomike e të drejtave të tjera të konsumatorëve. Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet përafrimit në mënyre graduale të legjislacionit shqiptar dhe të praktikave më të mira me ato evropiane, si dhe forcimit të kapaciteteve institucionale. Këto detyrimet janë të parashikuara në nenin 70 dhe 76 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Situata aktuale

Objektivat kryesorë të politikës së mbrojtjes të konsumatorit në Shqipëri përcaktohen në Strategjinë kombëtare ndërsektoriale të miratuar me VKM nr. 797, datë 14.11.2007 "Për Mbrojtjen e konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e tregut për periudhën 2007-2013", e cila është pjesë edhe e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Strategjia është e bazuar në tri strategji sektoriale, si pjesë integrale të këtij dokumenti, që janë përkatësisht: mbrojtja e konsumatorit dhe mbikëqyrja e tregut të produkteve industriale – METE, produktet ushqimore – MBUMK dhe produktet farmaceutike –MSH.

Strategjia parashtron, prioritetet strategjike, objektivat dhe adoptimin e iniciativave ligjore si dhe zbatimin e masave në një periudhë 7 vjeçare në mbrojtje të konsumatorit dhe mbikëqyrjes se tregut në Shqipëri. Strategjia trajton një gamë të gjerë lidhur me të drejtat e konsumatorit, duke përfshirë çështje të sigurisë së produkteve dhe shërbimeve, mbikëqyrjen e tregut, aspektet ekonomike dhe ligjore që lidhen me pozitën e konsumatorit në treg, informacionin dhe edukimin e konsumatorit, mekanizmat e dëmshpërblimit të konsumatorëve, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësorit te konsumatorëve, nxitjen e shoqatave të konsumatorit dhe kontributin e tyre me aktorë të tjerë në hartimin dhe zbatimin e politikave për mbrojtjen e konsumatorit, si edhe propozon një kuadër konkret dhe të saktë për realizimin e objektivave.

Legjislacioni për mbrojtjen e konsumatorëve ka shënuar një hap të rëndësishëm jo vetëm në drejtim te procesit te harmonizimit te legjislacionit shqiptar me atë evropian, por dhe në drejtim të zgjidhjeve rregulluese duke siguruar zbatueshmërinë e tij, sipas modeleve të eksperiencave më te mira. Ne kete drejtim, janë ngritur dhe funksionojne struktura zbatuese si Komisioni i Mbrojtjes se Konsumatoreve apo struktura konsultative si Keshilli Bashkerendues i Mbrojtjes se Konsumatoreve.

Baza ligjore dhe perafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” , i cili përafron plotësisht Direktivat 2006/114/EC “Mbi publicitetin çorientues dhe krahasues”; 2005/29/EC “Mbi praktikat e padrejta tregtare”; 98/6/EC “Mbi treguesin e çmimeve të produkteve ofruar konsumatorit”; 93/13/EEC “Mbi kushtet e padrejta në kontrata”; 1999/44/EC “Mbi disa aspekte te shitjes së mallrave dhe garancive shoqëruese”; 2009/22/EC “Mbi vendimet gjyqësore për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve”; dhe pjesërisht Direktivat 85/577/EEC “Mbi respektimin e kontratave te negociuara jashtë qendrave të biznesit”; 97/7/EC “Mbi kontratat ne distance”; 98/7/EC “Mbi kreditë e konsumatorëve” ; 90/314/EEC “Mbi kontratat e paketave te udhetimit”;
- Ligji nr. 10444, date 14.07.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 9902, dt. 17.4.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” i cili përafron pjesërisht Direktiven 2008/122/EC “Mbi disa aspekte te kontratave te përdorimit me afat, pushimeve afatgjata, rishitjes dhe shkëmbimit te kontratave” dhe Direktiven 2008/48/EC “Mbi marrëveshjet e kredive te konsumatorëve”;
- Ligji nr. 10480, date 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme te produkteve jo ushqimore” i cili përafron plotësisht Direktivën 2001/95/EC “Mbi sigurinë e përgjithshme te produkteve”;
- VKM nr. 1444, date 22/10/2008 “Për mënyrën e funksionimit e te pagesës se anëtareve te komisionit te mbrojtjes se konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave te vlerësimit te shkeljeve”;
- VKM nr. 797, datë 14.11.2007 “Për miratimin e Strategjisë Ndersektoriale te Mbrojtjes se Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes se Tregut 2007-2013” ;
- VKM nr. 63, date 21/01/2009 “Për kontratat jashtë qendrave te tregtimit”, e cila transpozon plotësisht Direktivën 85/577/EEC “Mbi respektimin e kontratave te negociuara jashtë qendrave te biznesit”;
- VKM nr. 64, date 21/01/2009 “Për kontratat ne largësi”, e cila transpozon plotësisht Direktivën 97/7/EC “Mbi kontratat ne distance”;
- VKM nr. 65, date 21/01/2009 “Për kontratat e paketave te udhëtimit”e cila transpozon plotësisht Direktivën 90/314/EEC “Mbi kontratat e paketave te udhetimit”;
- VKM nr. 833, date 8/07/2009 “Për përcaktimin e rregullave për kontratat e përdorimit me afat të pasurive të paluajtshme”,e cila transpozon plotësisht Direktivën 94/47/EC “Mbi kontrata e perdorimit mbi bazen e afateve kohore te pasurive te paluajtshme”;
- VKM nr. 615, date 7.09.2011 “Për tregtimin në largësi te shërbimeve financiare për konsumatorët” e cila transpozon plotësisht Direktivën 2002/65/EC “Mbi kontratat ne largesi te sherbimeve financiare te konsumatoreve”;
- Urdhër i Kryeministrit nr. 82, dt. 3.7.2008 “Për Miratimin e Përbërjes se Këshillit Bashkërendues te Mbrojtjes se Konsumatorëve”;
- Urdhër i Kryeministrit nr. 94, date 4.11.2011 “Për emërimin e kryetarit dhe te anëtarëve te Komisionit te Mbrojtjes se Konsumatorëve”;
- Rregullore Nr. 6772 date 21.07.2010 “Për funksionimin e Këshillit Bashkërendues te Mbrojtjes se Konsumatorëve”;
- Udhëzim i ministrit të METE Nr. 721 datë 27.10.2010 “Për kriteret e organizimit dhe drejtimit te Qendrave te Këshillimit te Konsumatorëve”.

Struktura Institucionale

Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve përcakton kuadrin institucional që siguron zbatimin e detyrimeve për mbrojtjen e konsumatorëve. METE nëpërmjet Drejtorisë se Tregut të Brendshëm është përgjegjëse për zhvillimin e politikave të fushës, hartimin dhe përditësimin e legjislacionit për konsumatorët, si edhe për sigurimin e instrumenteve rregullatorë për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit.

Komisioni i Mbrojtjes se Konsumatorit është një organ vendimmarrës dhe ka përgjegjësinë e shqyrtimit te shkeljeve në rastet e praktikave te padrejta tregtare, kushteve te padrejta ne kontrata, ne lloje te ndryshme te kontratave me konsumatorët, etj. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut kontrollon zbatimin e disa prej dispozitave te ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve ne lidhje me treguesin e çmimit, etiketimin, udhëzuesit e përdorimit, etj. Kjo strukture eshte përcaktuar si strukture përgjegjëse edhe për zbatimin e ligjit për sigurinë e përgjithshme te produkteve jo ushqimore.
Krijimi i strukturës eficente te mbikëqyrjes se tregut pritet te realizohet ne varësi te konkluzioneve përfundimtare te Reformës se Inspektimit.

Iniciativat ligjore afatshkurtra

- Projekt VKM "Për vendosjen e kufizimeve për çakmakët /ndezësit e rinj rezistent ndaj fëmijëve". Ky projekt VKM transpozon Vendimin e KE 2006/502/EC "Për vendosjen e kufizimeve për çakmakët/ndezësit e rinj rezistent ndaj fëmijëve".
- Projekt VKM "Për ndalimin e tregtimit te produkteve qe përmbajnë biocidedimethylfumarate". Ky projekt VKM transpozon Vendimin e KE nr. 2009/251/EC "Për garantimin qe produktet e vendosura ne treg te mos permbajnebiocidedimethylfumarate".
- Projekt VKM "Për Imitimet e rrezikshme". Ky projekt VKM transpozon Direktivën 87/357/EEC "Mbi përafrimin e ligjeve te Shteteve Anëtare ne lidhje me produktet,te cilat duket ndryshe nga çfarë janë, duke rrezikuar shëndetin ose sigurinë e konsumatorëve".

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Trajnimi i stafit te DMTNSH ne METE, ne lidhje me zbatimin e direktivave te kredisë se konsumatorëve dhe shërbimeve financiare te konsumatorëve ne largësi;
- Funksionimi i Komisionit te Mbrojtjes se Konsumatorëve për zbatimin e legjislacionit te mbrojtjes se konsumatorëve.

Iniciativat ligjore afatmesme

- Draft udhëzimi i Ministrit te METE "Për metodat/mënyrat e klasifikimit te risqeve dhe vlerësimit te riskut serioz, qe transpozon Udhëzimin për vlerësimin e riskut te produkteve te konsumatorëve, pjese e Vendim te KE nr. 16 Nëntor 2009 "Mbi paraqitjen e udhëzueseve për menaxhimin e 'RAPEX', i krijuar sipas nenit 12 te Direktivës 2001/95/EC "Mbi sigurinë e përgjithshme te produkteve";
- Projekt VKM " Për kontratat e përdorimit me afat, pushimeve afatgjata, rishitjes dhe shkëmbimit te kontratave". Ky projekt VKM transpozon Direktivën Evropiane

2008/122/EC "Mbi disa aspekte te kontratave te përdorimit me afat, pushimeve afatgjata, rishitjes dhe shkëmbimit te kontratave";

- Projekt VKM "Mbi kriteret e strukturave te përfshira ne zgjidhjen jashtëgjyqësore te mosmarrëveshjeve te konsumatorëve". Ky projekt VKM transpozon Rekomandimet e Komisionit Evropian 98/257/EC "Mbi zgjidhjen jashtëgjyqësore te mosmarrëveshjeve te konsumatorëve" dhe 2001/310/EC "Mbi parimet për strukturat e jashtë gjyqësorit te përfshira ne zgjidhjet konsensuale te mosmarrëveshjeve te konsumatorëve".

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Funksionimi i Komisionit te Mbrojtjes se Konsumatorëve për zbatimin e legjislacionit te mbrojtjes se konsumatorëve.

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.28.1"Mbrojtja e konsumatorëve"

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**2.000.000**	**890.000**	**1.020.000**	**1.020.000**
Mbulohen nga buxheti i	1.370.000	890.000	1.020.000	1.020.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	630.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.28.2. SHËNDETI PUBLIK

Objektivi strategjik

Sigurimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kujdesit shëndetësor për popullatën është objektiv madhor i qeverisë shqiptare. Për arritjen e këtij objektivi, prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme do të fokusohen në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit publik duke iu përshtatur ndryshimeve ekonomike, shoqërore dhe epidemiologjike të vendit; rishikimin dhe përmirësimin e legjislacionit lidhur me mbikëqyrjen, jo vetem të situatave të sëmundjeve ngjitëse por edhe sëmundjeve jo te komunikueshme si dhe inspektimit sanitar duke i adoptuar ato sipas standardeve të BE-së. Aktivitetet të cilat duhet të plotësojnë dhe mbështetin politikat kombëtare, do të orientohen drejt përmirësimit të shëndetit publik, parandalimit të sëmundjeve dhe shmangies së burimeve të rrezikut ndaj shëndetit. Aktivitete të tilla do të mbulojnë luftën kundër plagëve më të mëdha të shëndetit, duke promovuar kërkimet për shkaqet e tyre, transmetimin dhe parandalimin e tyre, si dhe informacionin dhe edukimin shëndetësor.

Situata aktuale

Ministria e Shëndetësisë është e angazhuar në plotësimin e detyrimeve qe rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Janë përafruar në legjislacionin tonë disa Direktiva Evropiane sidomos gjatë hartimit të ligjit nr.

9518, datë 18.04.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit; ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit"; ligjit nr. 9739, datë 21.5.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 10 454, date 21.07.2011 “Për transplantin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë” dhe mund të thuhet që rreth 60-70% janë përafruar me këto ligje.
Në zbatim të ligjeve në fushën e shëndetit publik do të hartohen edhe akte nënligjore për të synuar drejt një përputhshmërie më të madhe me legjislacionin evropian.

Ndërkohë janë miratuar dhe ligjet kuadër: ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik” dhe ligji nr.10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ministria e Shëndetësisë ka miratuar dhe strategjinë shqiptare dhe planin e veprimit për parandalimin dhe minimizimin e dëmeve nga alkooli 2011-2015; Strategjine Kombetare te Kontrollit te Kancerit dhe Plan i Veprimit, të titulluar “Programi Kombetar i Kontrollit te Kancerit 2011-2020”; “Platforma e përgjithshme të Ministrise së Shëndetësisë për menaxhimin e riskut dhe të fatkeqësive”; Dokumenti strategjik dhe Plani i Veprimit “Per pershtatjen e sistemit shendetesor ndaj ndryshimeve klimatike;

Këshilli i Ministrave ka miratuar me vendimin nr. 339, datë 4/05/2011 përbërjen, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve, kompetencat, detyrat dhe mënyren e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Shëndetit Publik, në zbatim të ligjit nr. 10138 datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”. Objekti i punës së Këshillit Kombëtar të Shëndetit Publik është këshillimi i Ministrit të Shëndetësisë për zhvillimin dhe zbatimin e bashkërenduar të politikave në fushën e shëndetit publik me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e shendetit të popullatës.

Ndërkohë, Ministria e Shëndetesisë po punon për kryerjen e analizes së plotë të mangësive ndërmjet legjislacionit europian dhe atij vendas. Strukturat kyçe për zbatimin e këtyre iniciativave ligjore janë Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet vartëse të saj. Në fushën e shëndetit publik është mjaft i nevojshëm trajnimi stafit që merret me hartimin e legjislacionit por edhe trajnimi i asaj pjese të stafit që e zbaton legjislacionin.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore dhe nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji nr. 9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" i cili perafrohet pjeserisht me Direktiven 2001/37/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 Qershorit 2001 mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me prodhimin, paraqitjen dhe shitjen e produkteve të duhanit; Direktiven 2003/33/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 Majit 2003 mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me reklamat dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit; Vendimin e Komisionit te 5 Shtatorit 2003, mbi përdorimin e fotografive me ngjyra dhe ilustrimeve të tjera si paralajmërime për shëndetin mbi paketat e duhanit.
- Ligji nr. 9518, datë 18.04.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit". (Fletore zyrtare 2006 nr 46, fq 1390).

- Ligji nr.9739, datë 21.5.2007 "Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i përputhur pjesërisht me Direktiven 2002/98/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 27 Janarit 2003, për vendosjen e standardeve të cilësisë dhe sigurisë për mbledhjen, testimin, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e gjakut human dhe të komponentëve të gjakut; Direktiven 2004/33/EC e 22 Marsit 2004 në zbatim të Direktivës 2002/98/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kërkesat teknike për gjakun dhe përbërësit e gjakut; Direktiven 2005/61/EC e 30 shtatorit 2005 në zbatim të Direktivës 2002/98/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kërkesat e gjurmimit dhe njoftimit të reaksioneve dhe ngjarjeve të rënda negative; Direktiven 2005/62/EC e 30 shtatorit 2005 në zbatim të Direktivës 2002/98/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me standardet dhe specifikimet Komunitare në lidhje me sistemin e cilësisë për qendrat e gjakut.
- Ligji nr. 10107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr. 10138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik";
- Ligji nr. 10454, date 21.07.2011 "Per transplantin e indeve, te qelizave dhe te organeve ne Republiken e Shqiperise i perafruar me Direktiven 2004/23/EC te Parlamentit Europian dhe te Keshillit e 31 Marsit 2004 per vendosjen e standarteve te cilesise dhe sigurise per dhurimin, perzgjedhjen, testimin, perpunimin, konservimin, ruajtjen dhe shperndarjen e indeve dhe qelizave; Direktiven 2006/17/EC e 8 shkurtit 2006 kerkesat teknike per dhurimin, perzgjedhjen dhe testimin e indeve dhe qelizave ; Direktiven 2006/86/EC e 24 tetor 2006 kerkesat per gjurmimin, identifikimin e reaksioneve dhe ngjarjeve te padeshiruara si dhe kerkesat teknike per kodimin, pepunimin, konservimin, ruajtjen dhe shperndarjen e indeve dhe qelizave
- Ligji Nr. 9952, datë 14.07.2008 "Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS –it.

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në garantimin e mbrojtjes se shendetit publik jane Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e varësisë së saj.

- Ministria e Shëndetësisë (MSH) është organi qendror në Sistemin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, misioni i së cilës është realizimi i politikës shëndetësore në shkallë vendi. Bazuar në Urdhërin e Kryeministrit Nr 81, datë 12.04.2010, struktura e Ministrisë përbëhet nga dy drejtori të Përgjithshme (Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Planifikimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse), 11 drejtori teknike dhe shume sektorë të tjerë pjesë e këtyre drejtorive. Në total ka një staf prej 131 punonjësish.
- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) është institucion publik, buxhetor, në varësi administrative të Ministrit të Shëndetësisë. ISHP-ja është qendër e kërkimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër informacioni. ISHP ka në total një staf prej 199 punonjësish dhe kryen këto funksione:
    - mbikëqyrjen epidemiologjike të sëmundjeve infektive dhe joinfektive;
    - menaxhimin e regjistrave kombëtarë;
    - kërkimin shkencor në shëndetin publik;

- ndjekjen e të rejave shëndetësore ndërkombëtare, përfshirë sistemet dhe praktikat;
- trajnimin dhe edukimin universitar në shëndetin publik;
- është qendër reference në shëndetin publik;
- informimin e popullatës rreth çështjeve të shëndetit publik.

- Inspektorati Sanitar Shtetëror është organi më i lartë i kontrollit sanitar dhe është nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe funksionon mbi bazën e Ligjit Nr.7643, datë 2.12.1992 "Për inspektoratin sanitar shtetëror", i ndryshuar. Inspektorati Sanitar Shtetëror përbehet nga Kryeinspektori sanitar shtetëror dhe nga inspektorët sanitare në qender (Ministria e Shendetesise, Ministria e Mbrojtjes, Instituti i Shëndetit Publik) dhe në rrethe të cilët janë të specializuar. Inspektoriat eshtë organ ekzekutiv i specializuar, që kontrollon zbatimin e ligjeve e të akteve nënligjore sanitare në sektorët shtetërorë, privatë, veprimtaritë e ndryshme të ushtruara nga persona fizikë e juridikë vendas e të huaj. Numri total i inspektorëve është: 143 (inspektorë të lartë) dhe 235 (nd/inspektorë).
- Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut është institucion nën përgjegjësinë direkt menaxhuese të Ministrisë së Shëndetësisë. Me një staf prej 57 punonjësish Kjo Qendër përbëhet nga:
  - Sektori i mbledhjes dhe përpunimit të gjakut,
  - Sektori i laboratorëve
  - Sektori i sigurimit të cilësisë
  - Sektori Banka e gjakut QSUT, Maternitete dhe Sanatorium
  - Sektori Banka e Gjakut Spitali Universitar Qendror i Ushtrisë

Në Republikën e Shqipërisë shërbimi i transfuzionit të gjakut organizohet si më poshtë:

- Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, në Tiranë;
- 4 Banka gjaku rajonale (Vlorë, Korçë, Kukës, Shkodër);
- 15 banka gjaku mbledhëse dhe shpërndarëse;
- 11 banka gjaku shpërndarëse.

Masat legjislative afatshkurtra

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Projekt-ligj "Për biocidet", i cili është një ligj kuadër dhe do të përafrohet pjesërisht me direktiven 98/8/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit e 16 Shkurtit 1988 lidhur me hedhjen ne treg te produkteve biocide;
- Projektligj "Për shëndetin mendor";
- Strategjia dhe Plani i veprimit 2012-2020 "Për shërbimet e shendetit mendor në Republikën e Shqipërisë";
- Vendim i Këshillit Ministrave për përcaktimin e kritereve për hapjen dhe mbylljen e bankave të indeve, qelizave dhe organeve'
- Vendim i Këshillit Ministrave për kriteret për hapjen dhe mbylljen e qendrave të transplantimit ne përputhje Direktiven 2004/23/EC te Parlamentit Europian dhe Këshillit e 31 Mars 2004 per vendosjen e standardeve të cilësisë dhe

sigurisë për dhurimin, testimin e prokurimit, përpunimin, ruajtjen, magazinimin dhe shpërndarjen e indevetë njeriut dhe qelizat;

- Urdher i Ministrit të Shëndetësisë për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Qendrës për Koordinimin e Transplantimeve ne perputhje me Direktiven 2004/23/EC te Parlamentit Europian dhe Këshillit e 31 Mars 2004 per vendosjen e standardeve të cilësisë dhe sigurisë për dhurimin, testimin e prokurimit, përpunimin, ruajtjen, magazinimin dhe shpërndarjen e indevetë njeriut dhe qelizat;
- Strategjia per e-Health.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Ngritja e grupit të punës për hartimin e projektligjit "Për biocidet" dhe konsultime me aktoret e interesuar gjatë procesit të hartimit dhe dikutimit të projektligjit.
- Fushata sensibilizuese mbi edukimin shëndetësor të popullatës për dëmet e shkaktuar nga përdorimi i duhanit dhe produkteve të tij; Organizimi i Ditës Botërore kundër Duhanit.
- Forcimi i zbatimit të ligjit nr.9636, datë 6.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" nga strukturat e Inspektoratit Sanitar Shtetëror përmes reformimit të strukturave dhe procedurave të inspektimit; forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve inspektuese: trajnim i inspektoreve.
- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve në nivel lokal në fushën e promocionit të shendetit, komunikimit me publikun në lidhje me faktorete e riskut, vecanërisht ato që lidhen me ushqyerjen.
- Fuqizimi i sistemit të mbledhjes së gjakut, përpunimit dhe testimit të gjakut në QKTGJ.
- Rikonstruksioni i ambienteve te seleksionimit te dhuruesve dhe mbledhjes se gjakut.
- Trajnime të mjekëve të familjes lidhur me depistimin dhe kapjen e hershme te kancerit te gjirit dhe kancerit te qafes se mitres; pergatitje e udhezuesve perkates.
- Ndergjegjesim i grave lidhur me perdorimin sistematik dhe ne kohen e duhur te sherbimeve shendetesore lidhur me depistimin dhe kapjen e hershme te kancereve te traktit riprodhues; adresimi i faktoreve te riskut.
- Fushata sensibilizuese mbi edukimin shëndetësor të popullatës për mbrojtjen nga HIV/AIDS; Organizimi i Ditës Botërore kundër HIV/AIDS.
- Ngritja e sistemit te survejances per infeksionet nozokomiale.

Masat legjislative afatmesme

- Projektligji "Për Sëmundjet Infektive" që do te perafrohet me vendimet e Parlamentit Europian: Vendimi nr 2119/98/KE i Parlamentit Europian dhe Këshillit 24 Shtator 1998 që përcakton ngritjen e një rrjeti për mbikqyrjen epidemiologjike dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse në Komunitet ; Rregulloren (KE) Nr. 1882/2003 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit 29 Shtator 2003 që përshtat Vendimin e Këshillit 1999/468/KE ndaj dispozitave që lidhen me komitetet që ndihmojnë Komisionin në ushtrimin e pushteteve të tij zbatuese; Rregulloren (KE) Nr. 596/2009 e Parlamentit Europian dhe Këshillit 18 Qershor 2009 që përshtat një numër instrumentesh që i nënshtrohen proçedurës referuar në Nenin 251 të Traktatit të KE-së me Vendimin e

Këshillit 1999/468/KE në lidhje me procedurën rregull; Vendimin e Komisionit 17 Korrik 2003 që amendon Vendimin Nr. 2119/98/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit dhe Vendimi 2000/96/KE për sa i përket sëmundjeve ngjitëse radhitur në ato vendime dhe që amendon Vendimin 2002/253/KE për sa i përket; 2007/875/KE: Vendimin e Komisionit 18 Dhjetor 2007 që amendon Vendimin Nr 2119/98/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit dhe Vendimin 2000/96/KE për sa i përket sëmundjeve ngjitëse të radhitura në ato vendime.

- Amendimi i ligjit nr. 9636, datë 6.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" i cili do te perafrohet me Direktivën 2001/37/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 5 qershorit 2001 "Mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me prodhimin, paraqitjen dhe shitjen e produkteve të duhanit; Direktivën 2003/33/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 majit 2003 mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me reklamat dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit; Direktiven 2003/33/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 26 majit 2003 mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me reklamat dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit'
- Pergatitja e akteve nenligjore ne zbatim te projektligjit "Per Biocidet";
- Pergatitja e akteve nenligjore ne zbatim te projektligjit "Per shendetin mendor";
- Urdher i Ministri te Shendetesise per organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombetar te Transplanteve;
- Urdher i Ministri te Shendetesise per dokumentat për verifikimin e përshtatshmërisë së dhuruesve, për informacionin e marrë dhe dhënë dhuruesve e për mënyrën e dhurimit të indeve, qelizave e organeve, si dhe trajtimi i dhuruesve pas dhurimit;
- Urdher i Ministri te Shendetesise per kriteret e përzgjedhjes së dhuruesve, testet laboratorike të detyrueshme që duhet të kryejnë para dhurimit të indeve, qelizave dhe organeve, si dhe afatet kohore;
- Urdher i Ministri te Shendetesise per kriteret mjekësore, për certifikimin e vdekjes;
- Urdher i Ministri te Shendetesise per rregullat për vlerësimin e cilësisë dhe të sigurisë së indeve, qelizave dhe organeve për qëllime transplantimi;
- Urdher i Ministri te Shendetesise per procedurat për njoftimin e efekteve të padëshiruara, si dhe përpunimin e të dhënave për rastet e efekteve të padëshiruara në të gjitha hallkat e procesit;
- Urdher i Ministri te Shendetesise per procedurat e vlerësimit të aftësisë shëndetësore, si dhe ekzaminimet që i bëhen dhuruesit që ka ndërruar jete;
- VKM per masat dhe mënyren e dhënies së kompensimit te dhuruesve vullnetare pa pagese se transplanteve.

Te gjithe urdherat e mesiperm do te perafrohem me Direktiven 2006/17/EC e 8 shkurtit 2006 ne zbatim te Direktives 2004/23/EC te Parlamentit Europian dhe te Keshillit e 31 Marsit 2004 per vendosjen e standarteve te cilesise dhe sigurise per dhurimin, perzgjedhjen, testimin, perpunimin, konservimin, ruajtjen dhe shperndarjen e indeve dhe qelizave

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Ngritja e grupit te punes per hartimin e projektligjit "Per semundjet ngjitese" dhe konsultime me aktoret e interesuar gjate procesit te hartimit dhe diskutimit te projektligjit.
- Njohja e strukturave përgjegjëse zbatuese dhe monitoruese të Ligjit për "Sëmundjet ngjitese". Kjo do të realizohet nëpërmjet lancimit te ligjit, komunikimit apo takimeve të organizuara nga MSH dhe ISHP me institucionet pergjegjese per zbatimin e ligjit.
- Forcim i mëtejshëm i kapaciteteve administrative në nivel qendror dhe lokal me qellim zbatueshmerine e ligjit "Per biocidet": riorganizim i burimeve njerezore duke iu pershtatur kerkesave te projekt ligjit, pergatitje e instrumentave te punes, trajnime te personelit).
- Njohja e strukturave përgjegjëse zbatuese me aktet nenligjore (rregullore, udhezime).
- Trajnime të burimeve njerëzore si pjesë e survejances epidemiologjike dhe kontrollit te infeksionit (epidemiologe, punonjes te laboratoreve, kliniciste).
- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve laboratorike egzistuese, si dhe ngritja e kapaciteteve të reja (burime njerëzore, aparatura, pajisje laboratorike).
- Fushata sensibilizuese mbi edukimin shëndetësor të popullatës për dëmet e shkaktuar nga përdorimi i duhanit dhe produkteve të tij; Organizimi i Ditës Botërore kundër Duhanit.
- Forcimi i zbatimit të Ligjit Nr. 9636, datë 6.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" nga strukturat e Inspektoratit Sanitar Shtetëror permes forcimit te mëtejshëm i kapaciteteve inspektuese: trajnim i inspektoreve.
- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve në nivel lokal ne fushen e promocionit te shendetit, komunikimit me publikun ne lidhje me faktorete e riskut.
- Fushata sensibilizuese mbi edukimin shëndetësor të popullatës për mbrojtjen nga HIV/AIDS; Organizimi i Ditës Botërore kundër HIV/AIDS.
- Ngritja e qendrës rajonale të bankës së gjakut në Shkodër për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e gjakut dhe produkteve te tij
- Ngritja e qendrës rajonale të bankës së gjakut në Korcë për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e gjakut dhe produkteve te tij.
- Ngritja e qendrës rajonale të bankës së gjakut në Kukes për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e gjakut dhe produkteve te tij.
- Rikonstruksioni dhe sigurimi i infrastruktures se nevojshme ne 7 bankat gjaku mbledhese dhe shperndarese.
- Rikonstruksioni dhe sigurimi i infrastruktures se nevojshme ne 11 bankat gjaku shperndarese.
- Hapja e repartit te aferez produktive ne QKTGJ ne Tirane.
- Krijimi i njësisë së hemovigjilencës në Tiranë.
- Implementimi i Rekordit Elektronik Shëndetësor Kombëtarë (eHR).
- Implementimi i Sistemit të Informacionit Spitalor (HIS).
- Implementimi i programit ASTRAIA.

Efektet financiare

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**118.337.000**	**11.896.000**	**9.660.000**	**12.420.000**
Mbulohen nga buxheti i	61.230.000	10.999.000	9.660.000	12.420.000

Mbuluar nga ndihma e huaj	57.107.000	897.000	0	0
Ndryshim	0	0	0	0

3.29. BASHKIMI DOGANOR

Objektivi strategjik

Objektivat strategjike të Ministrisë së Financave dhe Administratës Doganore në fushën doganore janë ruajtja e interesave financiare dhe ekonomike të Shqipërisë, kontribuimi në mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe rendit publik, mbrojtjen e shëndetit publik, konsumatorëve, pasurisë kulturore kombëtare dhe ambjentit.

Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe më konkretisht, neni 97 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian do të ketë si synim garantimin e përputhjes me dispozitat që do të miratohen në fushën e tregtisë, dhe për të arritur përafrimin e sistemit doganor shqiptar me atë të Komunitetit, duke ndihmuar kështu në hapjen e rrugës për marrjen e masave liberalizuese të planifikuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar për doganat me atë të *acquis*.

Shqipëria mbështetur në nenet 14 dhe 43 të MSA-së ndjek bashkëpunimin rajonal me vendet e tjera, që marrin pjesë në Procesin e Stabilizim-Asociimit, në disa ose të gjitha fushat e bashkëpunimit që mbulon kjo Marrëveshje, dhe veçanërisht në fushat me interes të përbashkët dhe njëkohësisht duke vënë theksin tek bashkëpunimi administrativ dhe angazhimi për të luftuar parregullsitë dhe mashtrimin në dogana dhe çështje që lidhen me to.

Këto objektiva strategjike do të realizohen nëpërmjet:

- Harmonizimit dhe përafrimit të legjislacionit doganor shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian si dhe harmonizimit të procedurave dhe praktikave me standartet e BE-së, me qëllim unifikimin e tyre;
- Përgatitjes së administratës doganore për anëtarësimin në BE dhe garantimit të kapaciteteve administrative adekuate për të zbatuar dhe siguruar respektimin e *acquis* së BE-së në fushën doganore;
- Zbatimit korrekt dhe uniform të Marrëveshjeve të Tregtisë se Lirë dhe respektimin e rregullave të veçanta të parashtruara në fushat e *acquis* që kanë lidhje me doganat;
- Rritjes së ndjeshme të nivelit të vjeljes së të ardhurave si dhe rritja e nivelit të zhdoganimit kryesisht të mallrave që paguajnë akcize;
- Rritja e lehtësirave për biznesin përmes lehtësimit të procedurave doganore dhe uljen e barrierave doganore duke siguruar ruajtjen e nje balance ndërmjet lehtësimit të tregtisë dhe kontrolleve doganore;
- Forcimi i mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, mbrojtja e shoqërisë dhe partnerëve tanë të biznesit duke u mbështetur në menaxhimin e riskut dhe kontrolle efikase dhe efektive, dhe bashkëpunimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

- Përforcimi i stabilitetit dhe pavarësisë së administratës doganore, veçanërisht në lidhje me statusin e punonjësve të saj, transparencen me publikun dhe sensibilizimi e mëtejshëm në luftën kundër korrupsionit;
- Përmirësimi i teknologjisë së informacionit, informatizimi i plotë i sistemit doganor, përpunimi në rrugë elektronike i deklaratave doganore, thellimi i moduleve të sigurisë dhe analizës së riskut etj;
- Përmirësimi i mjedisit të punës perfshire infrastrukturen dhe pajisjet dhe rritja e nivelit te profesionalizmit të punonjësve.
- Përfshirja gjithnjë e më intensive e Shërbimit Doganor në mbrojtjen dhe sigurinë, në luftën kundër kontrabandës, trafiqeve dhe mallrave te ndaluara apo të kufizuara; parandalimin e korrupsionit, monopoleve dhe praktikave klienteliste;
- Përmirësimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërinstitucional si brenda vendit ashtu edhe me vendet fqinje, për të rritur shkallën e zbulimit të shkeljeve dhe luftën sigurinë në kufi.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Në kuadër të Projektit të Binjakëzimit "Mbështetja dhe harmonizimi i procedurave doganore me standartet e BE-së", të financuar nga IPA 2008 janë hartuar dispozitat përkatëse të draft ligjit te ri "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" ne perputhje te plote me Rregulloren 450/2008 te Komisionit Evropian, dhe drafti i dizpozitave zbatuese të Kodit te ri Doganor si dhe akte te tjera të nivelit të tretë, në harmonizim me dispozitat aktuale te BE-së. Dorëzimi i draft Kodit te ri Doganor do te realizohet në vitin 2012. Projekt ligji do te përfshije edhe dispozitat për shkeljet doganore dhe per dhënien e Statusit te Nëpunësit Civil punonjesve te Sherbimit Doganor.

Ne kuadër të PROJEKTIT IPA 2007 për tatimet- nënkomponenti akcizë eshte hartuar me asistencen e BE-se projekt ligji i ri "Për Akcizat ne Republikën e Shqipërisë", i cili pritet të miratohet ne vitin 2012. Përmes këtij projekt-ligji bëhet e mundur permiresimi i te gjitha procedurave duke i përafruar me standartet e BE-së dhe procesi i mbledhjes se akcizes kalon nga organet tatimore tek ato doganore.

Me qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me ate te Bashkimit Europian, në fushen doganore, gjate muajit shkurt 2012, Këshilli i Ministrave ka miratuat projekt ligjin "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën Ndërkombëtare mbi Thjeshtimin dhe Harmonizimin e Proçedurave Doganore" të ndryshuar bere ne KIOTO; projekt ligjin **"**Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Sistemin e Harmonizuar të Kodifikimit dhe Përshkrimit të Mallrave".
Gjatë këtij viti janë miratuar disa marrëveshje dhe protokolle me Republikën e Kosovës "Për kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit të hyrje/daljeve nëpërmjet pikave të kalimit kufitar" duke sjelle thjeshtëzim dhe lehtësim të kryerjes së procedurave të kontrollit kufitar në interes të lehtësimit në qarkullimin e njerëzve dhe mjeteve në PKK, bazuar në parimin një ndalesë-një kontroll.

Me VKM, Nr. 124, datë 22.2.2012 është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave Memorandumi i Mirëkuptimit midis BE dhe RSH për pjesëmarrjen e RSH në Programin e BE- "Doganat 2013".
Në funksion të plotësimit të rekomandimeve te BE janë bërë disa përparime në lidhje me kapacitetet administrative dhe operacionale. Infrastruktura në pikat e kalimit kufitar është përmirësuar dhe vazhdojnë te bëhen përpjekje ne kete drejtim. Se shpejti pritet te perfundoje Projekti i implementimit te sistemit me kamera monitorimi ne te gjithe sistemin doganor dhe kryesisht ne doganat kufitare (IPA 2008).

Laboratori Kimik Doganor është duke punuar për hartimin e dokumentacionit të nevojshëm për akreditimin e laboratorit. Synohet realizimi i procesit te akreditimit brenda vitit 2012.
Gjatë kësaj periudhe, vlen te theksohet bashkëpunimi me administratat doganore homologe. si ajo e Malit te Zi, Kosovës dhe Maqedonisë. Italisë, Greqisë dhe Turqisë. Njëkohësisht janë në proces negocimi një serë marreveshjesh bashkepunimi ne fushen doganore me vende të ndryshme.Aktualisht po punohet per implementimin e fazes se dyte te SEED.

Bashkëpunimi ndërinstitucional brenda vendit është përmirësuar, sidomos bashkëpunimi me policinë, per goditjen, zbulimin, parandalimin e trafiqeve me mallra akcize, sensitive, etj.
Në kuadër të luftës antikorrupsion është rritur bashkëpunimi me institucione të tjera të zbatimit të ligjit si dhe marrja e informacionit nga operatoret e tjerë (bankat, institucioni i deklarimit të pasurive të personave publik, zyra e regjistrimit te pasurive etj).

Pas denoncimeve për korrupsion bëra nga subjeke tregtare kanë filluar hetimi gjithashtu vërehet një sensibilizim në rritje për denoncimin e korrupsionit. DPD, organizon takime të vazhdueshme me biznesin si dhe njofton pëmes faqes së web-it për ndryshimet ligjore, të cilat perfshijnë edhe taksat.

Janë bërë disa përmirësime në Teknologjine e Informacionit (TI) me rritjen e kapacitetit të sistemit Asycuda World si dhe me blerjen e serverëve për ngritjen e një qendre të re operative dhe eshte ne perfundim konstruktimi i Server Room-t sipas standarteve TIA.
DPD ka aplikuar nepermjet projekteve IPA per tu parapergatitur dhe per te siguruar kushtet e teknikat e nevojshme qe aplikacionet doganore te nderveprojne (interoperability) me aplikacionet NCTS, ITMS, EMCS etj.

Në kuadrin e Programit IPA 2007- Nënkomponenti Akciza nëpermjet nënshkrimit të kontratës së sherbimit me UNCTAD parashikohet kompjuterizimi i procedurave te regjistrimit të operatoreve, procedurave të deklarimit të produkteve të akcizës me qarkullim nen pezullim, procedurat e stokimit, garantimit dhe pagesës. Në vazhdimesi punohet për permiresimin e procesit të targetimit nëpermjet profileve të riskut, me qëllim përzgjedhjen për kontroll fizik të ngarkesave me të riskuara duke ulur nivelin e kontrolleve dhe rritur eficencen e tyre, si dhe per te lehtesuar biznesin. Profilet e riskut janë përditësuar dhe përqindja e kontrolleve fizike ka rënë nga 14.2% qe ishte ne vitin 2010 në 12.9% ne vitin 2011.

Në lidhje me kapacitetet administrative, referuar VKM Nr. 205, dt 13.04.1999 "Për dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor" të ndryshuar (së fundi ndryshuar me VKM 927, datë 17.11.2010), numri i punonjësve të administratës doganore aktualisht eshte 984 punonjës.

Në kuadër të hyrjes në fuqi të ligjit të ri për Akcizat në Republikën e Shqipërisë, bëhet e mundur menaxhimi i procesit të akcizës nga administrata doganore (e menaxhuar deri tani nga tatimet) dhe për këtë qëllim parashikohet krijimi i Departamentit të ri të Akcizës në administratën doganore, gjë e cila do të sjellë shtimin e personelit doganor për menaxhimin e këtij procesi.

Pritet të miratohet se shpejti Strategjia e Teknologjisë së Informacionit (është ne fazën e miratimit, drafti është hartuar me ekspertet e BE-se, ne kuader te Projektit te Binjakezimit. Gjithashtu, gjatë tre mujorit të tretë të vitit 2012 pritet te miratohet Strategjia Doganore e Biznesit te administrates doganore shqiptare, e cila eshte hartuar ne kuader te Projektit te Binjakezimit. Projekt Strategjia për burimet njerëzore dhe trajnimet pritet te miratohet gjate vitit 2013, pas miratimit te Strategjise se biznesit.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/ nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji nr. 8449, datë 27.01.1999[139], "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Ligji përafron pjesërisht Rregulloren e Këshillit 2913/92/EEC (Celex 31992R2913) "Për Kodin Doganor Komunitar".
- Ligji nr. 9981, datë 08. 09.2008, "Për Miratimin e Niveleve të Tarifës Doganore", i ndryshuar [140] . Ligji përafron pjesërisht Rregulloren e BE 948/2009/EC (Celex 32009R0948) "Mbi tarifat dhe nomeklaturën statistikore dhe tarifat e përbashkëta doganore.
- Ligji nr. 9461, datë 21.12.2005, "Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore", i ndryshuar, hyrë në fuqi më datë 01.01.2006 (botuar në Fletore Zyrtare Nr. 105, Janar 2006). Ligji përafron plotësisht Rregulloren e Këshillit 2658/87/EEC (Celex 31987R2658), datë 23 korrik 1987 "Për tarifën dhe nomenklaturën statistikore dhe për tarifat e përbashkëta doganore"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999, "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor", i ndryshuar[141]. i cili përafron pjesërisht Rregulloren e Komisionit (EEC) Nr. 2454/93, të datës. 02.07.1993 "(Celex 31993R2454,Official Journal Nr. 253, Series L, dated 11/10/1993, p. 1-766) Për përcaktimin e dispozitave për zbatimin e Rregullores se Keshillit (EEC) Nr 2913/92 (Celex 31993R2454 31992R2913) per themelimin e Kodit Doganor të Komunitetit".
- Ligji nr.8759, dt 26.3.2001 Konventa e Nairobit "Për aderimin e Republikës se Shqipërisë se "Konventën Ndërkombëtare për asistence te ndërsjelle administrative për parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore".

[139] botuar në Fletore Zyrtare Nr 4, dt 19.02.1999, hyrë në fuqi më datë 06.03.1999.
[140] botuar në Fletore Zyrtare Nr. 144, date 22 Shtator 2008, hyrë në fuqi më datë 08.10.2008
[141] botuar në Fletore Zyrtare Nr. Extra 2004, hyrë në fuqi më datë 06.03.1999

- Ligji nr. 9316 dt. 18.11.2004, Konventa e Johanesburgut "Për Aderimin e Republikës se Shqipërisë ne Konventën Ndërkombëtare "Për Asistence te Ndërsjellë Administrative ne çështjet Doganore".
- Ligji nr.10077, datë 16.02.2009 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për lejimin e përkohshëm", bërë në Stamboll me 26 Qershor 1990", e cila tashme është në fuqi.
- Shqipëria u be anëtare e Organizatës Botërore te Doganave me 31.08.1992 përmes aderimit ne "Konventën për krijimin e Këshillit e Kooperimit Doganor" (Organizata Botërore e Doganave), e cila u nënshkrua ne Bruksel me 15 Nëntor 1950, dhe ka hyre ne fuqi me 4 nëntor 1952.
- Shqipëria ka aderuar ne Konventën TIR "Transport International Routier" e OKB te vitit 1975, me 4 janar 1985. Kjo konvente ka hyre ne fuqi me 4 korrik 1985.
- Ligji nr. 8648 dt. 28.07.2000 "Për ratifikimin e "Protokollit te anëtarësimit te Republikës e Shqipërisë ne Marrëveshjen e Marakeshit qe themeloi Organizatën Botërore te Tregtisë".

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar dhe aktualisht zbaton disa Marrëveshje të Tregtisë së Lirë si poshtë vijojnë:

- Marrëveshjen për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA); Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian për tregtinë dhe bashkëpunimin tregtar (MSA); Marrëveshjen e Tregtisë së lirë me Republikën e Turqisë; Marrëveshjen e Tregtisë së lirë me Shtetet EFTA dhe marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës dhe Principatës së Lihtenshtejnit, Mbretërisë së Norvegjisë dhe Republikës së Islandës.
- Marrëveshja për amendimin dhe zgjerimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) filloi të zbatohet për Shqipërinë, Maqedoninë, Kosovën, Malin e Zi dhe Moldavinë më 26.07.2007, ndërsa për Kroacinë më 22.08.2007, për Bosnjën dhe Hercegovinën më 22.11.2007 dhe për Republikën e Serbisë më 24.10.2007. Në kuadër të liberalizimit të tregtisë rajonale, vendi ynë filloi zbatimin e Protokollit shtesë të kësaj marrëveshje për produktet bujqësore nga Maqedonia dhe Kroacia më 13.11.2011, nga Serbia më 15.12.2011, nga Mali i Zi më 06.01.2012 dhe nga Moldavia më 13.01.2012, duke sjellë liberalizimin e plotë të të gjitha produkteve nga këto vende.
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë e ratifikuar me ligjin Nr 9733 datë 14.05.2007 filloi të zbatohet nga 01.05.2008 ndërsa Protokolli II shtesë ligji nr 10199 datë 17.12.2009 "Për përkufizimin e konceptit "Produkte origjinuese" dhe metodat e bashkëpunimit ekonomik", që zëvëndësoi protokollin me të njëjtin numër të kësaj marrëveshjeje hyri në fuqi më 01.08.2011.
- Marrëveshja e Tregtisë së lirë me Shtetet EFTA dhe marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës dhe Principatës së Lihtenshtejnit, filloi të zbatohet më 01.11.2010, me Mbretërinë e Norvegjisë më 1.08.2011 dhe me Republikën e Islandës më 01.10.2011.

Struktura institucionale

Administrata Doganore, e përbërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoritë Rajonale dhe nga Degët Doganore, është nën varësinë dhe mbikqyrjen e Ministrisë së Financave. Administrata doganore mbështetet në tre misionet thelbësore te miratuara me VKM nr. 232, datë 13.02.2008 "Për miratimin e Strategjisë Sektoriale te Financave Publike, 2007-2013", që janë Misioni fiskal, ekonomik dhe mbrojtes.

Në përmbushjen e misioneve thelbësore te saj Drejtoria e Përgjithshme e Doganave bashkëpunon me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrinë e Shëndetësisë etj.

Misioni fiskal është një nga misionet kryesore te Doganës Shqiptare qe konsiston ne mbledhjen e taksave doganore te mallrave qe importohen ne Republikën e Shqipërisë. Krahas taksës doganore, autoritetet doganore mbledhin edhe disa taksa te tjera ne import, me cilësinë e agjentit tatimor.

Misioni ekonomik, ka një rendësi të veçante në mbrojtjen dhe zhvillimin e ekonomisë së vendit. Në përmbushjen e misionit ekonomik, bazuar ne legjislacionin doganor shqiptar, ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës se Shqipërisë" i ndryshuar dhe Vendimin nr. 205, date 13.04.1999 i Këshillit te Ministrave "Për Dispozitat Zbatuese te Kodit Doganor" i ndryshuar, autoritetet doganore menaxhojnë te gjitha Regjimet Doganore dhe ne veçanti:

- autorizojnë dhe menaxhojnë Regjimet Doganore Ekomomike,
- kontrollojnë dhe garantojnë mbarëvajtjen e MTL-ve,
- administrojnë politikat nxitëse me fushën e investimeve,
- krijojnë lehtësira ne shlyerjen e detyrimeve doganore,
- ndikojnë ne lëvizjen e shpejte te mallrave, mjeteve, udhëtareve.

Lidhur me misionin e mbrojtjes, Doganat Shqiptare si edhe ato te vendeve evropiane, i kushtojnë një rendësi te madhe misionit. Misioni mbrojtës konsiston në:

- Mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe rendit publik;
- Mbrojtjen e shëndetit publik;
- Mbrojtjen e mjedisit;
- Mbrojtjen e faunës dhe florës;
- Mbrojtjen e pasurisë kulturore;
- Mbrojtjen e konsumatorëve;
- Mbrojtjen e moralit publik.

Masat legjislative afatshkurtra

Në një perspektivë afatshkurtër synohet përcaktimi më i qartë i kompetencave të institucioneve/drejtorive të përfshira në realizimin e administrimit të ardhurave doganore,

përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian dhe zbatimi i plotë i tij.

- Projektligji "Për Akcizat" mbi shfuqizimin e Ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002, "Per Akcizat" (botuar ne Fletore Zyrtare Nr.89, 2002. Ky ligj do të përafrojë plotësisht me Direktivën e Këshillit nr. 2008/118/EC datë 16 dhjetor 2008 në lidhje me masat e përgjithshme për të akcizës dhe shfuqizimi i Direktivës 92/12/EEC (Celex 32008L0118), Direktivën e Këshillit nr. 2003/96/EC datë 27 tetor 2003 në kuadër të ristrukturimit të Komunitetit për të taksimit të produkteve të energjisë dhe energjisë elektrik (Celex 32003L0096), Direktivën e Këshillit nr. 92/83/EEC datë 19 tetor 1992 mbi harmonizimin e strukturave të akcizave mbi alkoolin dhe pijet alkoolik (Celex 31992L0083), Direktivën e Këshillit nr. 92/84/EEC datë 19 tetor 1992 mbi përafrimin e normave të akcizës për alkool dhe pije alkoolike (Celex 31992L0084), Direktivën e Këshillit 92/12/EEC të datë 25 shkurt 1992 në rregullimet e përgjithshme për produktet që i nënshtrohen akcizës dhe në mbajtjen, lëvizjes dhe monitorimin e produkteve të tilla (Celex**.** 31992L0012) dhe Vendimin e Komisionit (Celex 32008R0450), datë 22 qershor 2006. Autoriteti përgjegjës për përgatitjen e këtij akti është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i dytë 2012.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për dispozitat zbatuese të ligjit "Për Akcizat ", i cili mbështetet në praktikat më të mira të legjislacionit francez dhe italian, dhe që përafron plotësisht këto akte komunitare: Direktivën 2008/118/EC datë 16.12.2008 në lidhje me masat e përgjithshme për akcizës dhe shfuqizimin e Direktivës 92/12/EEC (Celex 32008L0118)**,** dhe pjesërisht Direktivën 2008/450/EC (Celex 32008R0450). Autoriteti përgjegjës për përgatitjen e këtij akti është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i dytë 2012.
- Projektvendim i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave", përmes së cilit do të bëhet i mundur harmonizimi i kodeve tarifore me përshkrimet e Kodeve të CN të Komunitetit Evropian (si rregull miratohet çdo vit, në dhjetor, bazuar në Ligjin nr. 9461, datë 21.12.2005 "Për Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave dhe Tarifën Doganore" i ndryshuar). Autoriteti përgjegjës për përgatitjen e këtij akti është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i katërt 2012.
- Projektligj "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën Ndërkombëtare mbi Thjeshtimin dhe Harmonizimin e Proçedurave Doganore", bërë në Kyoto, më 18 Maj 1973", të ndryshuar"". Ky projektligj konsiston kryesisht në realizimin e proçedurave doganore të thjeshtëzuara dhe të harmonizuara, në nxitjen dhe mbajtjen e proçedurave doganore efikase dhe moderne në përputhje me standartet ndërkombëtare, etj. Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i katërt 2012.
- Projektligj "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën Ndërkombëtare mbi Sistemin e Harmonizuar të Kodifikimit dhe Përshkrimit të Mallrave", bërë në Bruksel, më 14 qershor 1983, e ndryshuar. Aderimi ka si qellim harmonizimin e të

dhënave të sakta dhe të krahasueshme për qëllimet e negociatave të tregtisë ndërkombëtare, përditësimin e Sistemit të Harmonizuar me ndryshimet e teknologjisë apo modelet e tregtisë ndërkombëtare, lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare, etj. Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i dytë 2012.

- Projektligj "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e Konventës për Krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit Doganor, bërë në Bruksel, më 15 dhjetor 1950". Nxitet bashkëpunimi ndërmjet Qeverive të çdo pale kontraktuese për të siguruar shkallën më të lartë të harmonizimit dhe uniformitetit të sistemit të tyre doganor. Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i dytë 2012.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për Denoncimin e "Konventës mbi krijimin e Bashkimit Ndërkombëtar për Publikimet e Tarifave Doganore, rregullave të veprimit dhe Protokollin e nënshkrimeve", bërë në Bruksel më 5 Korrik 1890. Qellimi eshte dalja nga kjo Konvente, per shkak se informacioni qe ofrohet permes kesaj Konvente sigurohet nga administrata doganore ne forma te tjera me te shpejta elektronike dhe pa pagese. Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i katërt 2012.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave për ndryshimin e VKM nr. 205**,** datë 13.04.1999, "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor", të ndryshuar. Ndryshime ne VKM nr. 205, datë 13.04.1999 lidhur me strukturen organike te DPD si dhe lidhur me procedurat doganore. Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, dhe Ministria e Financave. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i dytë 2012. Ky akt nuk transpozon legjislacion evropian.
- Memorandum Mirekuptimi mbi pjesemarrjen e vendit tonë në programin e KE "Dogana 2013". Memorandumi miratohet në parim me VKM. Autoritetet përgjegjësë për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i dytë 2012.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së RSH dhe Qeverisë së Federates Ruse për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjelltë në cështjet doganore. Qëllimi është ofrimi i asistencës së ndërsjellte në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e shkeljeve doganore, marrjen e masave për thjeshtëzimin dhe përshpejtimin e levizjes së mallrave dhe udhëtareve etj. Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i katërt 2012.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave për miratim në parim të "Marreveshjes ndërmjet Keshillit te Ministrave të RSh dhe Qeverisë së Australisëëë**,** për bashkëpunim dhe ndihme të ndersjelltë në ceshtjet doganore. Qellimi është ofrimi i asistences së ndersjelltë në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e shkeljeve doganore , marrjen e masave për thjeshtëzimin dhe përshpejtimin e levizjes së mallrave dhe

udhetareve etj. Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i katërt 2012.

- Nenshkrimi i Protokollit SEED – faza e II. Qellimi eshte shkëmbimi sistematik elektronik i të dhënave ne Kushtet paraprake Procedurale (veçanërisht futja e UNR); (Eshte ne faze shqyrtimi nga DPD ne lidhje me URN) Aktualisht po punohet pasi kërkohen zgjidhje teknike ne varësi të cilave është dhe koha e nënshkrimit te protokollit. Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i katërt 2012.
- Memorandumi i mirëkuptimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Shqiptare dhe Nënsekretariatit të Doganave Turke. Qellimi shkembimi i informacionit me Doganen Turke ne kohe reale. Drafti eshte gati per nenshkrim dhe jemi ne pritje te caktimit te dates nga Pala Turke. Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i tretë 2012.
- Projekt Strategjia Doganore e Biznesit te administrates doganore shqiptare (ne kuader te Projektit te Binjakezimit). Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i tretë 2012.
- Projekt Strategjia e Teknologjise se Informacionit (është ne fazën e miratimit, drafti është hartuar me ekspertet e BE-se, ne kuader te Projektit Binjakezimit). Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i dytë 2012.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Hartimi dhe implementimi i Planit Vjetor të Trajnimeve, për të mundësuar ngritjen e aftësimit profesional të stafit doganor;
- Hartimi dhe Implementimi i Planit Vjetor të Investimeve;
- Forcimi i kapaciteteve administrative, shtese ne burime njerëzore;
- Zbatimi i Planit të veprimit bazuar në Strategjinë ndërsektoriale për parandalimin e luftën kundër korrupsionit dhe për një qeverisje transparente;
- Zbatimi i “Planit te Punës” te Projektit te Binjakëzimit "Mbeshtetje per harmonizimin e procedurave doganore me standartet e BE” sipas skedulimeve te aktiviteteve për secilin komponent; perfshire asistence, etj., (IPA 2008);
- Projekt Binjakezimi për përgatitjen e terrenit për të gjitha projektet e lidhura me BE-ne (ITMS, NCTS) nga pikëpamja legjislative dhe proceduriale si dhe percaktimi i nje strategjie për aderimin ne Konventen e Tranzitit te Perbashket. (IPA 2012);
- Aktivitete ne kuader te zbatimit te Nomenklatures se Kombinuar te Mallrave e njesuar me CN te BE-se (Analize nevojash.negociata me strukturat relevante, etj.);
- Shpenzime ne kuader te aderimit ne Konventa Nderkombetare;
- Pjesemarrje ne Programin e Komunitetit “Doganat 2013”;
- Rehabilitimi i Pikes se Kalimit te Kufirit Morine – Kukes, Faza I (IPA 2009);
- Rikonstruksion i Pikes se Kalimit te Kufirit Hani i Hotit si dhe perfundimi i punimeve ne Piken e Kalimit Morine – Kukes Faza II, (IPA 2012);

- Rikonstruksion i Deges se Doganes Rinas;
- Ndertimi i Terminal i ri doganor Tirane.
- Asistence Teknike per Administraten Doganore ne Ngritje Kapacitetesh per Drejtorine e Inteligjences ne fushen e analizes dhe menaxhimit te riskut, Drejtorine e Kontrollit te pas Zhdoganimit, Drejtorine e Mbrojtjes se Pronesise Intelektuale dhe Drejtorine e Laboratorit Kimik Doganor. (IPA 2011);
- Asistence Teknike per Departamentin e IT ne Drejtorine e Pergjithshme te Doganave per te percaktuar infrastrukturen e duhur, aftesite e menaxhimit te projekteve dhe te biznesit ne zhvillimin e Projekteve te lidhura me BE-ne. (IPA 2012);
- Permiresim i infrastruktures (blerje komjuterash, printerash, pajisje zyrash, automjetesh etj.) per zyrat e Sherbimit Doganor Shqiptar;
- Mirembajtja, modernizimi i Sistemit informatik doganor (Blerje licensash Oracle dhe support)
- Zbatimi i Ligjit te Ri per Akcizat ne RSH si dhe Krijimi i Aplikacionit EMCS;
- Blerje makinerish dhe pajisjesh per Laboratorin Kimik Doganor (IPA 2011) Përmirësimi dhe reduktimi i kotrolleve fizike në 12% dhe aktivizimi i kanalit "jeshil";
- Rishikimi dhe përditësimi i PKPL si dhe thellimi i vlerësimit dhe përzgjedhjes se acquis ne kuadër te përafrimit te legjislacionit
- Përmirësimi dhe përditësimi i kuadrit ligjor në përputhje dhe në varësi të ndryshimeve të legjislacionit të BE dhe krijimi dhe/ose përshtatja e manuale/udhëzimeve për personelin doganor (kur është mundësia në përputhje me ato të BE);
- Sigurimi i përputhshmërisë të legjislacionit kombëtar me rregullat ndërkombëtare, në veçanti me OBT-në, OBD-në dhe garantimi i menaxhimit korrekt e të standardizuar i aplikimit të duhur të Metodollogjisë së Vlerësimit Doganor të Mallrave, në të gjithë territorin doganor shqiptar.
- Përmirësimi i proçesit të targetimit të Modulit të Selektivitetit që do të thotë; Përmirësim i përqindjes së suksesit të profileve nëpërmjet azhornimit të tyre bazuar në informacionet koherente dhe krijimit të profileve të reja; dhe Lehtësim i proçedurave doganore për biznesin nëpërmjet reduktimit të kontrolleve fizike. Synohet rritja e përqindjes së deklaratave që kalojnë vetëm me kontroll dokumentar, dhe përzgjedhja për kontroll fizik synohet të jetë sa më e fokusuar nëpërmjet uljes së nivelit të kanalit të kuq duke e përafruar me nivelin e përgjithshëm të kontrolleve fizike në rang BE-je.
- Monitorimi i proçesit të kontrollit fizik në pikat doganore duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet teknike të vëna në dispozicion në kuadër të implementimit të projektit të kamerave.
- Përzgjedhja e ngarkesave për skanim bazuar në analizën e riskut, nëpërmjet krijimit të profileve të posaçme.
- Monitorim dhe kontroll i vazhdueshëm i gjithë aktivitetit import-eksport, në kuadër të luftës kundër trafiqeve të paligjshme dhe të lëndëve narkotike, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe institucionet e tjera të linjës.
- Mundësimi i një programi të mirëfilltë për parandalimin e trafikut të drogës dhe mundësimin e një database specifik.
- Përmirësimi i kontrolleve doganore për mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale.
- Rritja e bashkëpunimit në nivel kombëtar/ndërkombëtar me aktorë të tjerë lidhur me shkembim informacioni, mbrojtje të të drejtave të pronësisë intelektuale, etj.

- Implementimi i sistemit ATA Carnet, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe komunitetin e biznesit për garantuesin kombëtar.

Masat legjislative afatmesme

Në një perspektivë afatmesme synohet përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional, përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe zbatimi i plotë i tij.

Masat legjislative afatmesme për periudhën 2013-2015 janë si vijon:

- Projektigj "Kodi Doganor i Republikës se Shqipërisë" mbi shfuqizimin e Ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor i RSh" i ndryshuar" (Botuar ne Fletore Zyrtare nr. 4, 1999 dt. 19.02.1999). Ky ligj do të përafrojë plotësisht Rregulloren 450/2008 e Komisionit Europian (Celex No**.** 32008R0450). Ky ligj do të përfshijë edhe dispozitat për shkeljet doganore dhe për dhënien e Statusit të Nëpunësit Civil punonjësve të Shërbimit Doganor. Autoriteti përgjegjës për përgatitjen e këtij akti është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i parë 2013.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor" mbi shfuqizimin e VKM nr. 205, datë 13.4.1999, "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor te Republikes se Shqiperise" (Botuar ne Fletore Zyrtare Nr. Extra 2004). Ky akt do të sigurojë përputhjen e plotë me Dispozitat Zbatuese te Kodit Doganor Evropian te Modernizuar (të pamiratuara ende nga BE). Autoriteti përgjegjës për përgatitjen e këtij akti është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave. Miratimi është në varësi të afatit te miratimit të ligjit përkatës si dhe të kohës që do të përcaktohet në ligj për hyrjen në fuqi të VKM-së.
- Projekt - Marreveshje ndermjet Keshillit te Ministrave te RSH dhe Serbise**,** ne lidhje me bashkepunimin dhe ndihme te ndersjellte ne ceshtjet doganore. Qellimi eshte ofrimi i asistences se ndersjellte ne parandalimin, zbulimin dhe hetimin e shkeljeve doganore , marrjen e masave per thjeshtezimin dhe pershpejtimin e levizjes se mallrave dhe udhetareve etj. Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i dytë 2013.
- Projekt - Marreveshja ndermjet Keshillit te Ministrave te RSH dhe Gjeorgjise, ne lidhje me bashkepunimin dhe ndihme te ndersjellte ne ceshtjet doganore. Qellimi eshte ofrimi i asistences se ndersjellte ne parandalimin, zbulimin dhe hetimin e shkeljeve doganore, marrjen e masave per thjeshtezimin dhe pershpejtimin e levizjes se mallrave dhe udhetareve etj (ne proces negociimi). Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i dytë 2013.
- Projekt - Marreveshja ndermjet Keshillit te Ministrave te RSH me Norvegjine ne lidhje me bashkepunimin dhe ndihme te ndersjellte ne ceshtjet doganore. Qellimi eshte ofrimi i asistences se ndersjellte ne parandalimin, zbulimin dhe hetimin e shkeljeve doganore, marrjen e masave per thjeshtezimin dhe pershpejtimin e levizjes

se mallrave dhe udhetareve etj (ne proces negociimi). Autoritetet përgjegjëse për përgatitjen e këtij akti janë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i dytë 2013.

- Udhëzime në zbatim të Kodit të Ri Doganor dhe të Dispozitave Zbatuese të tij, nëpërmjet të cilave synohet përputhje e plotë me udhëzimet e BE. Këto udhëzime janë në fazë hartimi, në kuadër të Projektit të Binjakëzimit IPA 2008. Autoriteti përgjegjës për përgatitjen e këtij akti është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave. Miratimi i tyre mbetet në varësi të miratimit të Kodit të Ri Doganor dhe Dispozitave Zbatuese të tij.
- Projektligj "Për Aderimin në Konventën e Tranzitit të Përbashkët", i cili synon përafrim të plotë Vendimin e Keshillit 87/415/EEC **(**Celex 31987D0415). Autoriteti përgjegjës për përgatitjen e këtij akti është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i katërt 2015.
- Projekt Strategjia për Burimet Njerëzore dhe Trajnimet (pas miratimit të Strategjisë së Biznesit), e cila synon rritjen e kapaciteteve njerezore ne administraten doganore. Autoriteti përgjegjës për përgatitjen e këtij akti është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i tretë 2013.
- Projektvendim "Mbi Forcimin e te Drejtave te Pronësisë Intelektuale". Ky vendim do të sigurojë një përafrim të plotë i Direktivës 2004/48/EC (32004L0048)të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 29 Prill 2004 "Mbi Forcimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale. Autoriteti përgjegjës për përgatitjen e këtij akti është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave. Afati i parashikuar për miratim është tremujori i tretë 2014.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Hartimi dhe implementimi i Planit Vjetor të Trajnimeve, për të mundësuar ngritjen e aftësimit profesional të stafit doganor;
- Forcimi i kapaciteteve administrative, shtese ne burime njerëzore;
- Hartimi dhe Implementimi i Planit Vjetor të Investimeve;
- Zbatimi i Planit të veprimit bazuar në Strategjinë ndërsektoriale për parandalimin e luftën kundër korrupsionit dhe për një qeverisje transparente;
- Projekt Binjakezimi per pergatitjen e terrenit per te gjitha projektet e lidhura me BE-ne (ITMS, NCTS) nga pikepamja legjislative dhe proceduriale si dhe percaktimi i nje strategjie per aderimin ne Konventen e Tranzitit te Perbashket. (IPA 2012);

- Aktivitete ne kuader te zbatimit te Nomenklatures se Kombinuar te Mallrave e njesuar me CN te BE-se (Analize nevojash.negociata me strukturat relevante, etj.);
- Shpenzime ne kuader te aderimit ne Konventa Nderkombetare;
- Pjesemarrje ne Programin e Komunitetit "Doganat 2013";
- Rikonstruksion i Pikes se Kalimit te Kufirit Hani i Hotit si dhe perfundimi i punimeve ne Piken e Kalimit Morine – Kukes Faza II, (IPA 2012);
- Asistence Teknike per Administraten Doganore ne ngritje kapacitetesh per Drejtorine e Inteligjences ne fushen e analizes dhe menaxhimit te riskut, Drejtorine e Kontrollit

te pas Zhdoganimit, Drejtorine e Mbrojtjes se Pronesise Intelektuale dhe Drejtorine e Laboratorit Kimik Doganor. (IPA 2011);

- Asistence Teknike per Departamentin e IT ne Drejtorine e Pergjithshme te Doganave per te percaktuar infrastrukturen e duhur, aftesite e menaxhimit te projekteve dhe te biznesit ne zhvillimin e Projekteve te lidhura me BE-ne. (IPA 2012);
- Permiresim i infrastruktures (blerje komjuterash, printerash, pajisje zyrash, automjetesh etj.) per zyrat e Sherbimit Doganor Shqiptar;
- Mirembajtja, modernizimi i Sistemit informatik doganor (Blerje licensash Oracle dhe support);
- Blerje makinerish dhe pajisjesh per Laboratorin Kimik Doganor (IPA 2011);
- Blerje e Makinave te specializuara (per Kontrollin e Pozicionit ne Levizje) per Drejtorine e Anti-Kontrabandes. (IPA 2012);
- Përmirësimi i proçesit të targetimit të Modulit të Selektivitetit që do të thotë; Përmirësim i përqindjes së suksesit të profileve nëpërmjet azhornimit të tyre bazuar në informacionet koherente dhe krijimit të profileve të reja; dhe Lehtësimin e proçedurave doganore për biznesin nëpërmjet reduktimit të kontrolleve fizike. Synohet rritja e përqindjes së deklaratave që kalojnë vetëm me kontroll dokumentar, dhe përzgjedhja për kontroll fizik synohet të jetë sa më e fokusuar nëpërmjet uljes së nivelit të kanalit të kuq duke e përafruar me nivelin e përgjithshëm të kontrolleve fizike në rang BE-je;
- Monitorimi i proçesit të kontrollit fizik ne pikat doganore duke shfrytezuar te gjitha kapacitetet teknike te vena ne dispozicion ne kuader te implementimit te projektit te kamerave;
- Aktivizimi i kanalit "blu" për kryerjen e kontrolleve pas zhdoganimit;
- Përzgjedhja e ngarkesave për skanim bazuar në analizën e riskut, nëpërmjet krijimit të profileve të posaçme;
- Ndertimi i nje rrjeti informatik i cili synon shkëmbimin e informacionit ndërmjet strukturave të ndryshme të sistemit doganor, që përmban edhe të dhëna mbi historikun e subjekteve operuese dhe sanksionet e praktikave doganore;
- Monitorim dhe kontroll i vazhdueshëm i gjithë aktivitetit import-eksport, në kuadër të luftës kundër trafiqeve të paligjshme dhe të lëndëve narkotike, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe institucionet e tjera të linjës;
- Sigurimi i përputhshmërisë të legjislacionit kombëtar me rregullat ndërkombëtare, në veçanti me OBT-në, OBD-në dhe garantimi i menaxhimit korrekt e të standardizuar i aplikimit të duhur të Metodollogjisë së Vlerësimit Doganor të Mallrave, në të gjithë territorin doganor shqiptar;
- Mundësimi i një programi të mirëfilltë për parandalimin e trafikut të drogës dhe mundësimin e një database specifik;
- Përmirësimi i kontrolleve doganore për mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale;
- Rishikimi dhe përditësimi i PKPL si dhe thellimi i vlerësimit dhe përzgjedhjes se acquis ne kuadër te përafrimit te legjislacionit;
- Përmirësimi dhe përditësimi i kuadrit ligjor në përputhje dhe në varësi të ndryshimeve të legjislacionit të BE dhe krijimi dhe/ose përshtatja e manuale/udhëzimeve për personelin doganor (kur është mundësia në përputhje me ato të BE);
- Sigurimi i një moduli elektronik për procedimin e kërkesave për veprim doganor dhe procedurave të tjera doganore të lidhura me mbrojtjen e pronësisë intelektuale

- Rritja e bashkëpunimit në nivel kombëtar/ndërkombëtar me aktorë të tjerë lidhur me shkembim informacioni, mbrojtje të të drejtave të pronësisë intelektuale etj.

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.29 "Doganat"

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**510.262.000**	**6.900.000**	**6.900.000**	**6.900.000**
Mbulohen nga buxheti i	**195.504.000**	**0**	**0**	**0**
Mbuluar nga ndihma e huaj	**314.758.000**	**6.900.000**	**6.900.000**	**6.900.000**
Ndryshim	**0**	**0**	**0**	**0**

3.30. MARRËDHËNIET ME JASHTË

3.30.1. POLITIKA E PËRBASHKËT TREGTARE

Objektivi strategjik

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit parashikon marrëdhenie bashkëpunim të ngushtë mes Shqipërisë dhe BE-së, kryesisht në prioritetet që lidhen me përmbushjen e detyrimit për përafrimin e legjislacionitë me atë të acquis. Objektivat kryesore për krijimin e një politike të përbashkët tregtre janë (i) harmonizimi i legjislacionit Shqiptarë me atë të acquis si dhe (ii) forcimi i kapaciteteve instiucionale dhe zbatimi i politikave të përbashkëta tregtare.

Politika tregare e përbashket është një komponent i nevojshem i tregut te përbashkët. Në këto kushte është e nevojshme të zhvillohen kapacitetet administrative për përballimin e kërkesave të politikës strukturore të BE-së.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Lidhur me politikën e përbashket tregtare, Shqipëria është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë nga shtatori i vitit 2000. Shqipëria ka përafruar legjislacionin e saj të brendeshëm më atë të BE-së në fushën e importit të mallrave, ndihmës shteterore, prokurimit publik, aviacionit civil, subvencioneve, etj, në përputhje me angazhimet e saj në kete organizatë. E gjithë strategjia e politikës tregtare pas anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë është mbështetur në (i) Raportin e Anëtarësimit së Shqipërisë në këtë organizatë, (ii) ligjin nr. 8649, datë 28.07.2000, "Për ratifikimin e rezultateve të Raundit të Uruguait të negociatave tregtare shumëpalëshe". Gjithashtu, kjo politike ndjek parimet dhe angazhimet e marra ne kuadër te Marrëveshjes se Stabilizim-Asocimit, marrëveshjes së tregtisë të lirë me vendet e Evropës Qendrore CEFTA 2006, marrëveshjes së tregtisë të lirë me Turqinë, marrëveshjes së tregtisë të lirë me shtetet e EFTA-s.

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit shënoi një etapë të re cilësore në fushën e politikës tregtare e cila e ngarkoi Shqipërinë të ndërmarrë një sërë angazhimesh politike për realizimin e objektivave të përbashkëta si dhe të harmonizoje legjislacionin e saj me atë të acquis. Për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga MSA, është punuar për ngritjen e kapaciteteve te administrates publike, nëe fushën e hartimit dhe zbatimit te politikave tregtare.

Duke vlerësuar se niveli i njohurive të administratës publike për politikën e perbashkët tregtare konsiderohet ende i pamjaftueshem për plotesuar neojojat e së cilës Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) ka hartuar një plan paraprak per trajnim, mbështetur në nevojat e vlerësuara paraprakisht. METE në bashkepunim me GIZ, po harton nje plan të qendrueshëm trainimi për administratën publike në fushën e politikës së përbashket tregtare si dhe të curriculave të trainimit që do tëe përdoren në trainimin e administrates publike me filozofine "trainim për trainuesit

Shqiperia ka tashme në zbatim marreveshje të tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian (pjesë e marreveshjes së stabilizim asociimit) ndermjet Bashkimit Evropian dhe Shqiperisë, vendet e Evropës Juglindore (CEFTA 2006), vendet EFTA dhe Turqisë. Këto marrëveshje janë ndertuar në përputhje të plotë me parimet dhe rregullat themelore të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe zbatohen në respektim të plotë të tyre. Shqiperia respekton të gjitha angazhimet e marra në secilën prej marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe strukturat e përfshira në zbatimin e tyre vleresojne në menyrë të vazhdueshme mundesinë e thellimit të liberalizimit teë tregtisë.

Republika e Shqipërisë ka ne zbatim 38 marrëveshje dypalëshe për "Mbrojtjen dhe nxitjen reciproke të investimeve", të cilat janë aktualisht në fuqi. Gjithashtu janë nënshkruar dhe 4 marreveshje të reja për mbrojtjen dhe nxitjen reciproke të investimeve me San Marinon, shtetin e Katarit, Republikën e Maltës si dhe Republikën e Kosovës.Në proces janë marrëveshjet për mbrojtjen dhe nxitjen reciproke të investimeve me Azerbajxhanin, Qipron, Kanadanë, Bjellorusinë, Arabine Saudite, Marokun dhe Gjeorgjinë.

Republika e Shqipërisë ka ne zbatim 37 marrëveshje bashkëpunimi ekonomik dhe teknik me vende të ndryshme në zhvillim. Në proces janë marreveshjet me Bosnje Hercegovinën, Hungarinë, Palestinën.

Në zbatim të Ligjit nr. 9707, datë 5.4.2007 "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë" është ngritur Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE) i cili është në varësi të Ministrit të Mbrojtjes. Ky Autoritet është institucioni përgjegjës për zbatimin e politikës shtetërore për kontrollin e eksportit dhe jep kontributin e tij në realizimin e objektivave në fushën e kontrollit të eksport-importit.

AKSHE në bashkëpunim edhe me institucione të tjera të përfshira në sistemin e kontrollit të eksporteve është përgjegjës për liçensimin e veprimtarive mbi transferimet ndërkombëtare (import, eksport, tranzit, ndërmjetësim) të mallrave me përdorim të dyfishtë. Legjislacioni aktual i cili rregullon fushën e transferimeve ndërkombëtare të mallrave me përdorim të dyfishtë si dhe sistemin e kontrollit të eksporteve në tërësi, është kryesisht në përputhje me legjislacionin dhe politikat e Bashkimit Evropian në këtë fushë, gjithashtu për përafrim të mëtejshëm dhe të plotë të këtij legjislacioni dhe përditësimin e tij, Autoriteti i kontrollit Shtetëror të Eksporteve po punon në përgatitjen e projekt-drafteve në bashkëpunim edhe me institucionet e BE-së të cilat asistojnë në këtë fushë.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 8648, date 28.07.2000, "Për ratifikimin e Protokollit të anëtaresimit të Republikës së Shqiperisë në "Marrëveshjen e Marrakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë" , botuar ne GZ nr. 24, viti 2000.
- Ligji nr. 8649, date 28.07.2000, "Për ratifikimin e Marrevëshjeve të rezultateve të raundit të Uruguait për negociatat shumëpaleshe tregtare", botuar në GZ nr. 24, viti 2000.
- Ligji nr. 9590, datë 27.07.2006, "Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe

shteteve të tyre anëtare", e botuar në GZ nr. 87, viti 2006 Ligji nr. 9696, datë 21. 3. 2007 "Për ratifikimin e marrëveshjes për ndryshimin dhe pranimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës qendrore", botuar ne GZ nr. 37, viti 2007.

- Ligji nr. 9733, datë 14.5.2007, "Për ratifikimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë", botuar në GZ nr. 66, viti 2007.
- Ligji nr.10288, date 17.6.2010, "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve EFTA dhe të marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës e Principatës së Lihtenshtejnit, Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë dhe Republikës së Shqipërisë e Republikës së Islandës", si pjesë përbërëse të saj.
- Ligji Nr. 9707, datë 5.4.2007, "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë", Flet.Zyrtare Nr.48, Faqe:1237, viti 2007, përafron pjesërisht Rregulloren e Këshillit nr 1337/2000 e Qershorit 2000.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 43, datë 16.1.2008 "Për organizimin, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve" Flet.Zyrtare Nr.8, Faqe,240 viti 2008.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 106, datë 9.2.2011 "Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve", Flet.Zyrtare Nr.37, Faqe:1331, viti 2008. Përafron plotësisht listën e mallrave me përdorim të dyfishtë sipas Aneksit I, të Rregullores së BE-së nr 428/2009, të Majit, 2009.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 305, datë 25.3.2009 "Për përcaktimin e procedurës së lëshimit të dokumenteve ligjore të garancisë në fushën e kontrollit shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe të mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë", Flet.Zyrtare Nr.51, Faqe: 2468 viti 2009.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 304, datë 25.3.2009 "Për përcaktimin e procedurave për kryerjen e ekspertizave dhe të kontrollit nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE)", Flet.Zyrtare Nr.51, Faqe: 2466 viti 2009.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 341, datë 08.04.2009 "Për përcaktimin e tarifave për lëshimin e dokumentave ligjorë nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë".

Struktura institucionale

Struktura pergjegjëse për politikën e përbashket tregtare është grupi i punës, i ngritur në zbatim të urdhërit të Kryeministrit nr. 133, date 28.6.2010. "Për disa ndryshime ne urdhrin nr 102, date 6.8.2009 për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për vleresimin e politikave tregtare në Republikën e Shqipërise nga momenti i anëtaresimit të Republikës së Shqiperisë në Organizatën Botërore të Tregtisë".

Në këtë proces do te perfshihen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si përgjegjese për hartimin, ndjekjen dhe monitorimin e politikave tregtare në Shqiperi,

Ministria e Integrimit, si institucioni përgjegjës për politikat e integrimit europian të Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Puneve Publike dhe Tranportit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Konkurences, Agjencia e Prokurimit Publik; Ministri për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Drejtoria e Pergjitheshme e Markave dhe Patentave; Zyra shqiptare per Mbrojtjen e te Drejtave te Autorit; Drejtoria e Pergjitheshme e Aviacionit Civil, Drejtoria e Pergjitheshme e Doganave; si dhe çdo ministri apo institucion tjeter qe gjykohet e aresyeshme gjate procesit.
Institucionet e mesiperme punojne per përgatitjen e raportit te politikave tregtare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në anëtarësimin në Organizatën Botërore të Tregtisë, marreveshjet e tregtise se lire, perfshire marreveshjen e stabilizim asociimit, ku perfshihen:

- Të dhënat tarifore dhe tregtare;
- Funksionimi dhe bashkërendimi institucional;
- Masat në politikat tregtare, përfshirë : Importet, eksportet, rregullat teknike dhe masat sanitare /fitosanitare antidumpingu, barrierat teknike në tregti, lehtësimi i tregtisë, konkurenca, ndihma shtetërore, prokurimi publik, etj
- Çështjet e lidhura me pronësinë industriale dhe intelektuale, politikat e konkurrences, reformat në bërjen e biznesit, etj.
- Përgatitja çdo vit e raportit vjetor për zhvillimin e politikave tregtare ne Shqiperi, si një instrument i monitorimit të politikave tregtare në Shqipëri.

Këto institucione janë të përfshira në procesin e rishikimit të legjislacionit për fushat që mbulojnë dhe hartimin e ndryshimeve apo akteve të reja ligjore në përputhje me Direktivat përkatese të Bashkimit Evropian.

Aktivitete zbatuese afatmesme

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes si përgjegjëse per politiken e përbashkët tregtare ne masat afat shkurtra, brenda vitit 2012 parashikon:

- Bashkëpunimin me GIZ për te kryer Analiza e Mosperputhjeve (boshllekut) legjislative (LGA) përkatëse te ndryshimeve ndërmjet legjislacionit evropian dhe atij shqiptar ne ketë fushe. Kjo do te lejoje hartimin e masave legjislative afatmesme.
- Hartimin e një plani veprimi, me synim: (i) ngritjen e kapaciteteve te lektoreve, te cilët do te zhvillojnë kualifikimet e administratës publike, dhe (ii) përcaktimin e përparësive te ndërhyrjeve legjislative për përputhjen e legjislacionit vendas me atë te Bashkimit Evropian.
- Bashkerendimi me te gjitha ministrite dhe institucionet e interesuara gjate vitit 2012 per per organizimin e takimeve te komiteteve te perbashketa, me vendet e CEFTA, EFTA dhe me Turqine. Ne keto takime do te vendoset per fillimin e zbatimit te

Konventes rajonale te rregullave te origjines preferenciale PanEuroMed, duke marre vendimet perkatese.

Masat legjisative afatmesme

- Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 9707, datë 05.04.2007, "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave teknologjike me përdorim të dyfishtë" duke e përafruar me Rregulloren 428/2008 e 5 Majit 2009 të Bashkimit Europian.
- Urdhri nr 133, datë 28.6.2010 " Për disa ndryshime në urdhrin Nr 102, date 6.8.2009 per ngritjen e grupit nder institucional të punës për vleresimin e politikave tregtare në Republikën e Shqiperise nga momenti i anëtaresimit të Republikës së Shqiperisë në Organizaten Boterore te Tregtise".

Aktivitete zbatuese afatmesme

- Zbatimi i planit të trajnimeve të hartuar në bashkëpunim me GIZ. Për ketë do të bashkepunohet edhe me Institutin e Trajnimit te Administratës Publike duke përcaktuar edhe kalendarin përkates per te gjitha ministrite dhe institucionet e perfshira ne hartimin dhe zbatimin e politikes se perbashket tregtare.
- Rikonceptimi i grupit te punes te ngritur në zbatim të urdhërit të Kryeministrit nr.133, date 28.6.2010. "Per disa ndryshime ne urdhrin Nr 102, date 6.8.2009 per ngritjen e grupit nder institucional te punes per vleresimin e politikave tregtare ne Republiken e Shqiperise nga momenti i anetaresimit te Republikes se Shqiperise ne Organizaten Boterore te Tregtise" per ta pershtatur me kerkesat Traktatit te Lisbone (ex 133 Committee)
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës do te bashkerendoje me të gjitha ministritë dhe institucionet e interesuara qe ne periudhen 2013-2014 te zhvilloje negociata me Turqine per rritjen e shkallës së liberalizimit të tregtisë së produkteve bujqesore, për perfshirjen e shërbimeve në marrëveshjen e tregtise se lire etj.

3.30.2. BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIM DHE NDIHMA HUMANITARE

Ministria e Punëve të Jashtme po shqyrton angazhimin e saj ne kuader te PKZMSA per Kapitullin 30 per ngritjen e nje departamenti per "Politikat e zhvillimit dhe ndihmes". Duke qëne se ky proces perfshin edhe brenda dhe jashte ketij institucioni, do te nise nje proces konsultimi edhe me Departamentin e Administrates Publike, Ministrine e Finacave, etj si dhe me konsulentet ndërkombetare.

3.31. POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES

3.31.1. DIALOGU POLITIK

Integrimi evropian i Shqipërisë konsiderohet objektiv strategjik, dhe garanci për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin në rajon e më gjerë. Në këtë kuadër, qeveria shqiptare ka vullnet të plotë për të ndërmarrë të gjitha reformat e duhura në kuadër të procesit të integrimit evropian.

Shqipëria mbështet fuqimisht politikën e jashtme të sigurisë dhe mbrojtjes së BE-së, e cila synon forcimin e rolit të Bashkimit Evropian si një entitet me influencë politike gjithnjë në rritje në politikën ndërkombëtare.

Shqipëria, ka një dialog politik të ngushtë me Bashkimin Evropian dhe vendet anëtare të tij, dialog i cili me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), zhvillohet në kuadër të kësaj Marrëveshjeje në Këshillin e Stabilizim Asociimit dhe strukturave të tjera të përbashkëta. Objektivi i Shqipërisë është marrja e statusit të vendit kandidat dhe hapja e negociatave të anëtarësimit.

Me konfirmimin e perspektivës së qartë evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor, në Samitin e Selanikut të qershorit 2003, Shqipëria që prej janarit 2004, i është bashkuar rregullisht qëndrimeve të përbashkëta të Bashkimit Evropian në fushën e CFSP. Shqipëria ka kontribuar dhe kontribuon në misionet ushtarake të Bashkimit Evropian të ndërmarra në kuadër të ESDP (CSDP me Traktatin e Lisbonës).

Republika e Shqipërisë beson thellësisht në vlerat evropiane të demokracisë, shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes e respektimit të të drejtave të njeriut.

Në themel të vizionit të politikës së jashtme të Shqipërisë qëndron ndërtimi i marrëdhënieve dy dhe shumëpalëshe të karakterizuara nga fryma e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit. Në zbatim të këtij orientimi themelor të politikës së jashtme, Shqipëria ka adoptuar gjithnjë e më shumë një rol të dukshëm aktiv në favor të paqes dhe stabilitetit në rajon, e më gjerë.

Republika e Shqipërisë konsideron se bashkëpunimi rajonal dhe pronësia rajonale janë jo vetëm parakushte të integrimit europian, por edhe domosdoshmëri e kohës për të transformuar përfundimisht imazhin e rajonit tonë. Ky orientim i politikës sonë të jashtme reflektohet në të pjesëmarrjen tonë proaktive në të gjitha nismat dhe organizatat shumëpalëshe që veprojnë në rajonin e Europës Juglindore e më gjerë.

Në planin ndërkombëtar, Republika e Shqipërisë i kushton vëmendje gjithnjë e në rritje pjesëmarrjes aktive dhe përfaqësimit të saj në organizatat ndërkombëtare, me të cilat ndan vlera të përbashkëta. Republika e Shqipërisë është tashmë anëtare me të drejta të plota në shumë organizata ndërkombëtare si dhe është palë në shumë akte ndërkombëtare të konkluduara në kuadër të këtyre organizatave.

Shqipëria do të vazhdojë të sigurojë koordinimin dhe bashkëpunimin në planin kombëtar, rajonal e ndërkombëtar, me qëllim që të zvogëlojë në maksimum rrezikun ndaj terrorizmit që lidhet me vendin dhe interesat tona, duke siguruar përmirësimin e elementeve të sigurisë dhe rritjen e besimit të komunitetit për masat parandaluese ndaj akteve dhe fenomeneve terroriste.

a) Në kuadër të integrimit Evropian

Shqipëria, zhvillon një dialog politik të ngushtë me institucionet e Bashkimin Evropian dhe vendet anëtare të tij. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) në datë 1 prill 2009, dialogu politik institucional me Be-në zhvillohet në kuadër të takimeve të Këshillit të Stabilizim Asociimit, të Komitetit dhe gjashtë Nënkomiteteve të Stabilizimi Asociimit, si dhe në kuadër të Komitetit ndër-parlamentar midis Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Shqipërisë. Dialogu politik zhvillohet intensivisht edhe në nivel të marrëdhënieve dypalëshe me vendet anëtare të BE-së në kuadër të vizitave të përfaqësuesve të lartë të shtetit.

b) Bashkëpunimi në kuadër të nismave dhe organizatave rajonale

Objektivi Strategjik

Objektivi strategjik i Shqipërisë është që përmes një angazhimi aktiv në të gjitha forumet dhe nismat rajonale të kontribuojë me qëndrimet parimore e të balancuara në trajtimin e çështjeve të ndryshme sensitive të rajonit. Nëpërmjet aktivitetit të saj në këto forume rajonale, Shqipëria synon që të nxisë zhvillimin ekonomik rajonal nëpërmjet projekteve të përbashkëta, në fusha të tilla si energjia dhe transporti. Shqipëria do të lobojë pa ndërprerje për përfaqësimin e Kosovës në nismat dhe organizatat rajonale duke kontribuar për paqen, stabilitetin dhe sigurinë në rajon.

Për sa i përket marrëdhënieve dypalëshe me vendet e rajonit lutem referohuni ne kapitullin e Kriterit Politik.

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Republika e Shqipërisë konsideron se bashkëpunimi dhe pronësia rajonale janë jo vetëm parakushte të integrimit evropian, por edhe domosdoshmëri e kohës për të transformuar përfundimisht imazhin e rajonit tonë. Ky orientim i politikës sonë të jashtme reflektohet në të pjesëmarrjen tonë proaktive në të gjitha nismat dhe organizatat shumëpalëshe që veprojnë në rajonin e Evropës Juglindore e më gjerë. Shqipëria është anëtare e nismave rajonale të mëposhtme:

- Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP)
- Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC)
- Nisma e Evropës Qendrore (CEI)

- Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ/BSEC)
- Nisma Adriatiko-Joniane (NAJ)
- MARRI (Nisma Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët)
- RACVIAC (Qendra Rajonale për Verifikimin e Kontrollit të Armëve)
- Karta e Partneritetit të Adriatikut (A-5)
- Ministeriali i Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM)

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Karta e BSEC, nënshkruar më 05.06.1998, hyrë në fuqi më 01.05.1999;
- Marrëveshje për bashkëpunimin në luftën kundër krimit me vendet e BSEC, në veçanti kundër krimit të organizuar, nënshkruar më 02.10.1998, ratifikuar me ligjin nr. 8512, datë 15.07.1999, hyrë në fuqi më 23.07.2008;
- Protokolli shtesë për luftën kundër terrorizmit të marrëveshjes ndërmjet Qeverive të shteteve pjesëmarrëse të bashkëpunimit të Detit të Zi, në luftën kundër krimit, në veçanti kundër krimit të organizuar, nënshkruar më 03.12.2004, hyrë në fuqi më 23.06.2006;
- Protokoll shtesë i Marrëveshjes për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në veçanti kundër krimit të organizuar, nënshkruar më 15.03.2002, hyrë në fuqi më 26.11.2003;
- Memorandumi i mirëkuptimit për zhvillimin e bashkërenduar të autostradës Unazë në Detin e Zi, nënshkruar më 19.04.2007;
- Memorandum i mirëkuptimit në zhvillimin e autostradave të deteve, nënshkruar më 19.04.2007, hyrë në fuqi në 1.05.2007;
- Memorandum i mirëkuptimit për lehtësimin e transportit rrugor të mallrave në rajonin e BSEC, nënshkruar më 06.03.2002, hyrë në fuqi më 20.07.2006;
- Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet akademive diplomatike dhe Instituteve të Ministrive të Punëve të Jashtme, nënshkruar më 19.04.2007, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit;
- Protokolli mbi imunitetet dhe privilegjet e Asamblesë Parlamentare të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi, nënshkruar më 31.10.2003, hyrë në fuqi më 01.03.2010;
- Protokolli shtesë mbi privilegjet dhe imunitetet e BSEC, nënshkruar më 30.04.1999;
- Marrëveshja për thjeshtëzimin e procedurave të vizave për tregtarët e vendeve anëtare të BSEC, nënshkruar më 23.10.2008, hyrë në fuqi më 05.03.2010;
- Marrëveshja për thjeshtëzimin e procedurave të vizave për shoferët profesionistë të kamionëve të transportit ndërkombëtar të mallrave të vendeve anëtarë të BSEC, nënshkruar më 23.10.2008, hyrë në fuqi më 05.03.2010;
- Marrëveshja ndërmjet vendeve të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ) për bashkëpunimin në ndihmën dhe përgjigjen ndaj emergjencave dhe fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, hartuar në Soçi më 15.04.1998 dhe protokolli shtesë i saj, hartuar më 20.10.2005, marrëveshja hyn në fuqi më 03.05.2011, ndërsa Protokolli hyn në fuqi më 25.06..2011.
- Marrëveshja shumëpalëshe e transportit për vendet e Evropës Juglindore, nënshkruar më 26.09.1998, hyrë në fuqi 29.11.2009;
- Traktati për kartën e Energjisë dhe protokolli, hartuar më 17.12.1998, instrumenti i dorëzimit të Shqipërisë më 12.02.1998, hyrë në fuqi më 13.05.1998;

- Marrëveshja për krijimin e Qendrës Rajonale Ballkanike për nxitjen e tregtisë, nënshkruar më 13.10.1998, miratuar me VKM nr. 138, datë 25.03.1999;
- Marrëveshja për krijimin e forcës shumëkombëshe të Evropës Juglindore, nënshkruar më 26.09.1998, ratifikuar me ligjin nr. 8544, datë 04.11.1999;
- Protokolli shtesë për krijimin e forcës shumëkombëshe të Evropës Juglindore, nënshkruar më 26.09.1998, ratifikuar me ligjin nr. 8544, datë 04.11.1999;
- Protokolli i dytë për krijimin e forcës shumëkombëshe paqeruajtëse të Evropës Juglindore, nënshkruar më 30.11.2000;
- Protokolli i tretë për krijimin e forcës shumëkombëshe paqeruajtëse të Evropës Juglindore, nënshkruar më 26.06.2001, hyrë në fuqi më 15.10.2001;
- Marrëveshja e SECI-t mbi bashkëpunimin për parandalimin dhe luftën kundër krimit ndërkufitar, nënshkruar më 26.05.1999, ratifikuar me ligjin nr. 8541, datë 21.10.1999;
- Memorandumi i mirëkuptimit për krijimin e lehtësirave për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave në rajonin e SECI-t, nënshkruar më 28.04.1999, ratifikuar me ligjin nr. 8540, datë 21.10.1999;
- Protokoll bashkëpunimi në fushën e navigimit ajror në rajonin e Ballkanit, nënshkruar më 17.11.1999 dhe hyrë në fuqi datën e nënshkrimit;
- Memorandumi i mirëkuptimit për zhvillimin e rrjetit të transportit Rajonal të Evropës Juglindore, nënshkruar më 11.06.2004;
- Marrëveshja shumëpalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Komunitetit Evropian, Republikës së Islandës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Serbi-Mali i Zi, Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të Aviacionit Evropian (ECAA), nënshkruar më 09.06.2006, zbatohet përkohësisht nga datat e nënshkrimit;
- Shtesë e Memorandumit të Mirëkuptimit mbi zhvillimin e rrjetit Qëndror të Transportit Rajonal në Evropën Juglindore, nënshkruar më 04.12.2007;
- Memorandumi i Mirëkuptimit për krijimin e forumit dhe qendrës rajonale të migrimit, azilit dhe kthimit të refugjatëve, nënshkruar më 02.07.2004, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit;
- Konventa për bashkëpunimin policor në Evropën Juglindore, nënshkruar më 05.05.2006, hyrë në fuqi më 10.10.2007;
- Memorandumi i mirëkuptimit për bashkëpunimin e luftës kundër korrupsionit nëpërmjet nismës antikorrupsion të Evropës Juglindore, nënshkruar më 13.04.2007;
- Konventa trepalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Maqedonisë, për sistemin e naftësjellësit transballkanik, nënshkruar më 31.01.2007;
- Protokoll Karte mbi Marrëdhënie të mira fqinjësie, stabiliteti, sigurie dhe bashkëpunimi në Evropën Juglindore midis vendeve të SEECP, nënshkruar më 11.05.2007;
- Memorandum i mirëkuptimit për iniciativën e vendeve të Evropës Juglindore për parapërgatitjen dhe parandalimin e fatkeqësive (DPPI SEE), nënshkruar më 24.09.2007, hyrë në fuqi më 01.01.2010;
- Shtesë e Memorandumit të Mirëkuptimit mbi zhvillimin e Rrjetit Qendror të Transportit Rajonal në Evropën Juglindore, nënshkruar më 04.12.2007;
- Marrëveshja për Themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA), nënshkruar me 21.11.2008;

- Memorandum për garancitë ligjore dhe juridike kundër procedimit të paligjshëm të të dhënave personale ndërmjet vendeve të Europës Juglindore, nënshkruar në Kishinjev më 31.10.2008;
- Marrëveshja për krijimin e një rrjeti hekurudhor të performancës së lartë në Evropën Juglindore, nënshkruar më 04.05.2006, hyrë në fuqi më 06.03.2009;
- Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Sigurisë dhe Policisë Kufitare të Bosnjë-Hercegovinës, Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të Kroacisë, Ministrisë së Marrëdhënieve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë, Ministrisë së Brendshme dhe Administratës Publike të Malit të Zi dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë mbi themelimin e një sistemi statistikor për shkëmbimin e informacionit mbi migracionin e paligjshëm dhe pjesëmarrjen në një sistem të paralajmërimit të hershëm, nënshkruar më 20.11.2008;
- Marrëveshje mbi ngritjen dhe veprimtarinë e Observatorit të Transportit për Evropën Juglindore (SEETO), nënshkruar më 10.11.2005, hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit;
- Marrëveshja për ndryshimin dhe anëtarësimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Evropës Qëndrore (CEFTA), nënshkruar më 19.12.2006, hyrë në fuqi më 26.07.2007;
- Protokolli shtesë i marrëveshjes ndryshuese të saj dhe anëtarësimin në marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qëndrore, nënshkruar më 11.02.2011, hyrë në fuqi për Shqipërinë, Kroacinë dhe Maqedoninë më 13.11.2011;
- Traktati për krijimin e Komunitetit të Energjisë, nënshkruar më 25.10.2005, ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 03.04.2006;
- Marrëveshja ndërmjet Austrisë, Bullgarisë, Çekisë, Hungarisë, Polonisë, Rumanisë, Sllovakisë, Sllovenisë, për mbështetjen e bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë në kuadrin e Shkëmbimeve të Studimeve Universitare në Evropën Qendrore (CEPUS II), hyrë në fuqi për Shqipërinë më 10.05.2006;
- Konventa e qendrës për zbatimin e ligjit në Evropën Juglindore (SELEC), nënshkruar më 09.12.2009;
- Protokolli i privilegjeve dhe imuniteteve të Qendrës për zbatimin e ligjit në Europën Juglindore, nënshkruar më 24.11.2010;
- Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në fondin e sigurimeve rajonal ndaj fatkeqësive natyrore, për vendet e Evropës Juglindore dhe Qendrore "Europa Reinsurance Limited" (SECE CRIF), nënshkruar më 30.10.2009;
- Deklaratë e përbashkët për projektin e gazsjellësit Adriatiko-Jonian mes Kroacisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi, nënshkruar më 25.09.2004, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit;
- "Tirana Declaration" mbi koordinimin e Sigurimeve sociale në Europën Juglindore, nënshkruar më 16.10.2007, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit;
- "Montenegro Conclusions", nënshkruar gjatë konferencës III Ministrore mbi Punësimin dhe Politikat Sociale në Evropën Juglindore më 26.10.2007, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit;
- Protokolli i Zagrebit për bashkëpunimin për vendet e Evropës Juglindore për bashkëpunimin për turizmin, nënshkruar me 05.04.2008;
- Marrëveshje e tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve EFTA, dhe marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës dhe Principatës së Lihtenshtejnit; Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë; Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Islandës si pjesë përbërëse të

saj, nënshkruar më 17.12.2009, në fuqi për Shqipërinë, Zvicrën dhe Lihtenshtejnin më 01.11.2010, ndërsa për Norvegjinë më 01.08.2011.

- Deklaratë e përbashkët për projektin e gazsjellësit Adriatiko-Jonian ndërmjet Kroacisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi, nënshkruar më 25.09.2004, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit;
- Protokoll për bashkëpunimin ndërmjet SME-ve në kuadrin e Nismës Adriatiko-Joniane, nënshkruar më 11.02.2010, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit;
- Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Bosnjë-Herzegovinës, Republikës së Maqedonisë, Malit të Zi dhe Republikës së Serbisë për shërbimet dhe mbrojtjen e përbashkët konsullore, nënshkruar më 21.04.2010, hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit;
- Deklarata e përbashkët "Korridori VIII: Një urë ndërmjet Adriatikut dhe Detit të Zi, Tiranë", 29-30.04.2010;
- Marrëveshje për konservimin e cetaceve në detin e Zi, detin Mesdhe dhe zonës vazhduese të atlantikut, nënshkruar më 24.11.1996, hyrë në fuqi më 01.10.2001;
- Marrëveshja për "RACVIAC – Qendra për bashkëpunim për sigurinë", hartuar në Budva, Mali i Zi, më 14.04.2010, hyrë në fuqi më 01.12.2011, për Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kroacisë, Republikën e Maqedonisë, Malit të Zi dhe Republikën e Serbisë;
- Memorandum për forcimin e bashkëpunimit rajonal si parakusht për një luftë të suksesshme kundër krimit në Evropën Juglindore, nënshkruar më 05.10.2010 dhe hyrë në fuqi në datën e nënshkrimit;
- Protokolli shtesë i Marrëveshjes ndryshuese të saj dhe anëtarësimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qëndrore CEFTA, nënshkruar në Bruksel më 11.02.2011, hyrë në fuqi dhe zbatohet për Republikën e Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë nga data 13.11.2011, kurse me Republikën e Serbisë zbatohet duke filluar nga data 15.12.2011;
- Marrëveshje ndërmjet Shteteve të Evropës Juglindore për qendrën e Sekretariatit të rrjetit shëndetësor të Evropës Juglindore, nënshkruar më 09.11.2010;
- Memorandum Mirëkuptimi për bashkëpunimin policor dhe mbështetjen për Sekretariatin e Konventës së bashkëpunimit Policor të Evropës Juglindore, nënshkruar më 19.10.2010, VKM nr. 43, datë 19.01.2011;
- Memorandum Mirëkuptimi për krijimin e një rrjeti për bashkëpunimin ndërmjet Njësive të Policisë Kufitare në pikat e qarkullit ndërkombëtar të aeroporteve në vendet anëtare të MARRI, nënshkruar më 21.12.2010, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit;
- Deklaratë e përbashkët e Konferencës së nivelit të lartë të Nismës Elektronike të Evropës Juglindore mbi zhvillimin e shoqërisë së Informacionit, nënshkruar më 08.11.2011;
- Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrive të Mbrojtjes së Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi në lidhje me parimet e kontributit në shkollën e policisë ushtarake në Misionin e Trajnimit të NATO-s në Afganistan brenda operacionit ISAF, nënshkruar më 06.10.2011.

Struktura Institucionale

Strukturat institucionale përgjegjëse janë si më poshtë:

- Ministria e Punëve të Jashtme

- Përfaqësitë diplomatike
- Koordinatorët kombëtarë pranë BEDZ, RCC dhe MARRI.

Aktivitete zbatuese afatshkurtra

- Kontribut mendimesh dhe idesh në Ministerialin e Ministrave të Jashtëm të SEECP, që do të mbahet në Beograd, më 15.06.2012, për të forcuar bashkëpunimin, paqen, sigurinë, stabilitetin, zhvillimin politik, ekonomik e shoqëror të vendeve të rajonit.

Aktivitete zbatuese afatmesme

- Anëtarësim të Kosovës në nismat rajonale;
- Pjesëmarrja aktive e Shqipërisë në të gjitha nismat rajonale
- Ushtrimi me sukses i kryesive të rradhës në këto nisma
- Rritje e vizibilitetit dhe sigurimi i përfitimeve nga projektet në kuadrin e nismave rajonale.

Masa ligjore afatmesme

Në zbatim të projekteve që mund të përfitohen, mund të kërkohen masa ligjore specifike (VKM, Urdhëra, etj).

3.31.2. BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Objektivi strategjik

Forcimi i bashkëpunimit të Shqipërisë me organizatat ndërkombëtare, ku ajo është palë, dhe pjesëmarrja aktive e saj ne veprimtaritë e tyre në fushat që ato mbulojnë.

Situata aktuale

Ndër organizatat ndërkombëtare ku vendi ynë është anëtar veçojmë:

- Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) së bashku me sistemin e organizatave ndërkombëtare të specializuara që veprojnë në të(UNESCO, FAO, OBT, OBSH, etj);
- NATO
- OSBE
- Këshilli i Evropës
- Bashkimi për Mesdheun
- Organizata e Frankofonisë
- Organizata e Konferencës së Bashkëpunimit Islamik

Angazhimi i vendit tonë në këto organizata është përqendruar si më poshtë:

- Forcimi i dialogut dhe marrëdhënieve politike, ekonomike, ushtarake, social-kulturore, etj me vendet anëtare të këtyre organizatave;
- Pjesëmarrja aktive në diskutimin e çështjeve të rendit të ditës;

- Bashkëpunim i plotë me të gjitha strukturat e Kombeve të Bashkuara, NATO, OSBE, etj në luftën kundër terrorizmit;
- Shqipëria ka kontribuar me trupa në misionin paqeruajtës në Çad, Bosnje Hercegovinë, Afganistan.
- Shqipëria, duke synuar anëtarësimin e plotë në BE, i është bashkuar të gjitha deklaratave politike të Bashkimit Evropian në OKB dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, për çështje të ndryshme të rendit të ditës;
- Shqipëria është një ndër vendet pilot të programit "Një OKB" dhe së bashku me 7 vendet e tjera pilot, po kontribuon dukshëm në reformën e menaxhimit të Kombeve të Bashkuara.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- **OKB**. Karta e Kombeve të Bashkuara, dhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, San Françisko, bërë 26.06.1945, hyrë në fuqi më 24.10.1945, Miratuar pranimi i Republikës së Shqipërisë me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme, 995 (X), datë 14.12.1955.
- **UNESCO.** Republika e Shqipërisë është bërë palë më 10.07.1989.
- **FAO.** Organizata e Bujqësisë dhe Ushqimit të Kombeve të Bashkuara (FAO) në Konventën për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjencive të Specializuara, bërë në Romë më 08.12.1965, hyrë në fuqi më 03.03.1966; Republika e Shqipërisë ka aderuar më 15.12.2003.
- **NATO.** Traktati i Atlantikut të Veriut, bërë në Uashington më 04.04.1949, hyrë në fuqi më 01.04.2009.
- **Këshilli i Evropës.** Statuti i Këshillit të Evropës, krijuar më 05.05.1949; Shqipëria është bërë palë më 13.07.1995.
- **Organizata e Konferencës së Bashkëpunimit Islamik.** Organizata e Konferencës së Bashkëpunimit Islamik, krijuar më 25.09.1969; Shqipëria është bërë palë në vitin 1992.

Struktura institucionale

Bashkëpunimi i vendit tonë me organizatat ndërkombëtare realizohet nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, Përfaqësive Diplomatike shqiptare të akredituara pranë këtyre organizatave dhe me të gjitha ministritë apo institucionet e tjera qendrore në vend.

Aktivitete zbatuese afatshkurtra

- Organizimi në qershor 2012 i takimit në kuadrin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara me temë: "Një OKB, praktikat më të mira, sfidat dhe e ardhmja".
- Në periudhën maj-nëntor 2012, Shqipëria mban kryesimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

Aktivitete zbatuese afatmesme

- Marrja e kryesimit të OSBE-së nga ana e Shqipërisë.

- Mbështetje e gjithanshme për anëtarësimin e Kosovës në organizatat apo forumet ndërkombëtare.
- Anëtarësim i vendit tonë në organet e mëposhtme:
  - Anëtar jo i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për periudhën 2022-23.
  - Si anëtar të ECOSOC për periudhën 2013-2015
  - Anëtar i Këshillit të të Drejtave të Njeriut për periudhën 2015-17.

Masa ligjore afatmesme

Këto aktivitete zbatuese nuk shoqërohen me masa ligjore deri në momentin e marrjes së kryesimit të këtyre organizmave, ndërkohë që në periudhën në fjalë mund të kërkohen akte ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar për ushtrimin e plotë të detyrave që parashikon kryesimi përkatës.

3.31.3. KONTROLLI I ARMATIMIT

Kontrolli i Armatimit dhe Çarmatimi

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Qeverisë shqiptare është garantimi i sigurisë së qytetarëve dhe ruajtja e integriteti territorial të vendit tonë. Në këtë kuadër, rritja e rolit dhe e kontributit të Republikës së Shqipërisë në kuadrin e konventave dhe bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare aktive në fushën e Sigurisë për çështje që kanë të bëjnë me armkontrollin dhe çarmatimin, si dhe në kuadrin e organizatave rajonale të sigurisë është kontribues i drejtpërdrejtë në arritjen e këtij objektivi madhor.

Analiza e situatës aktuale

Shqipëria ka fituar një status dhe rol të ri në marrëdhëniet ndërkombëtare, si rrjedhojë e partneritetit në rritje me të gjithë strukturat e sigurisë rajonale dhe globale, pas anëtarësimit në NATO, pas shpalljes se Pavarësisë së Kosovës dhe liberalizimin e vizave me vendet e hapësirës Shengen.

Shqipëria është pjesë kontribuese në shumë iniciativa rajonale që kanë të bëjnë me luftën kundër trafiqeve, sigurinë e kufijve, krimin e organizuar, konfiskimit të parave që disponojnë organizatat kriminale, forcimit deri në përmbushjen e standardeve më të larta të sigurisë etj. Gjatë viteve të fundit ka patur një shkëmbim të suksesshëm të informacionit me vendet e rajonit dhe më gjerë, në luftën kundër trafikimit të armëve te vogla dhe të lehta (SALW).

Qeveria shqiptare ka identifikuar si një nga kërcënimet për sigurinë e vendit dhe më gjerë, ekzistencën në vend, të stoqeve të tepërta të municioneve dhe të Armëve të Vogla dhe të Lehta (SALW). Për këtë arsye Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me OSBE dhe PNUD,

është duke u zbatuar një Plan Pune, i cili parashikon shkatërrimin e stoqeve të tepërta të municioneve në vend, brenda vitit 2013.

Si shtet palë në marrëveshjet ndërkombëtare, si Plani Rajonal i Implementimit të SALW, Plani i Veprimit i Kombeve të Bashkuara për SALW dhe Dokumentet e OSBE-së për SALW dhe Tepricat e Municioneve, Kodi i Sjelljes i Bashkimit Evropian për SALW, vendi ynë ka ndërmarrë angazhime substanciale në fushën e kontrollit të transfertave të armëve.

Duke iu referuar mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe çështjeve të tjera të çarmatimit, Shqipëria ka paraqitur qëndrimet e saj të cilat kanë qenë në të njëjtën linjë me qëndrimet e mbajtura nga Bashkimi Evropian.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare të RSH, 2004
- Aktet e OSBE-së, Dokumenti i Vjenës, 2011

Aktet e OSBE-së:

- Konventa mbi ndalimin, ose kufizimin e Përdorimit të disa Armëve Konvencionale, të cilat mund të jenë të dëmshme ose kanë efekte (me Protokollet I, II, III), hartuar në Gjenevë, më 10.10.1980.
- Protokolli shtesë i Konventës mbi ndalimin, ose kufizimin e Përdorimit të disa Armëve Konvencionale, të cilat mund të jenë të dëmshme ose kanë efekte (Protokolli IV, I titulluar Protokolli mbi armët verbuese lazer), hartuar në Vjenë, më 13.10.1995.
- Protokolli mbi Ndalimin ose Kufizimin e Përdorimit të Minave, ose Grackave dhe pajisjeve të tjera, e ndryshuar më 03.05.1996 (Protokolli II I ndryshuar më 03.05.1996), I aneksuar Konventës mbi ndalimin, ose kufizimin e Përdorimit të disa Armëve Konvencionale, të cilat mund të jenë të dëmshme ose kanë efekte, hartuar në Gjenevë, më 03.05.1996.
- Ndryshimi i Konventës mbi ndalimin, ose kufizimin e Përdorimit të disa Armëve Konvencionale, të cilat mund të jenë të dëmshme ose kanë efekte, hartuar në Gjenevë, më 21.12.2001
- Protokolli mbi Mbetjet Eksplozive të Luftës Konventës mbi ndalimin, ose kufizimin e Përdorimit të disa Armëve Konvencionale, të cilat mund të jenë të dëmshme ose kanë efekte (Protokolli V), hartuar në Gjenevë më 28.11.2003.
- Konventa mbi Ndalimin e Zhvillimit, Prodhimit, Magazinimit dhe Përdorimit të Armëve Kimike dhe Shkatërrimin e tyre, hartuar në Gjenevë, më 03.09.1992.
- Traktati mbi Ndalimin e testeve bërthamore, hartuar në Nju Jork, më 10.09.1996.
- Konventa për ndalimin e përdorimit, magazinimit, prodhimit dhe transferimit të Minave Anti- personel dhe për shkatërrimin e tyre, hartuar në Oslo, më 18.09.1997.
- Konventa mbi municionet thërrmuese, hartuar në Dublin më 30.05.2008.

Struktura institucionale

Në kuadrin e angazhimeve të vendit tonë në fushën e Armëkontrollit, Çarmatimit dhe Mospërhapjes, Sektori i Armëkontrollit dhe Çarmatimit pranë MPJ-së koordinon aktivitetet

në këtë drejtim me përfaqësitë e RSH në NATO dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Brendshme.

Kjo strukturë përbëhet nga dy diplomatë dhe ka si synim koordinimin institucional me institucionet kombëtare, me qëllim hartimin, zhvillimin dhe aplikimin e politikave të qeverisë shqiptare në fushën e sigurisë kombëtare.

Institucionet e përfshira në respektimin e detyrimeve të vendit tonë në kuadrin e bashkëpunimit të vendit tonë në organizatat aktive në fushën e armëkontrollit dhe çarmatimit, janë Ministria e Punëve të Jashtme (rol politik dhe koordinues), Ministria e Mbrojtjes, si dhe Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit).

Masa legjislative afatshkurtra

- Hartimi i projektligjit të ri "Për Armët", që parashikohet të shfuqizojë ligjin ekzistues, nr. 7566, dt. 25.05.1992;
- Hartimi i Dokumentit të ri për Sigurinë Kombëtare të RSH. MPJ koordinon aktivitetin e grupit të punës, përgjegjës për përgatitjen dhe ndjekjen e zbatimit të Dokumentit të ri për Sigurinë Kombëtare të RSH;
- Finalizimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare për SALW;
- Zhvillimi i mëtejshëm i regjistrit elektronik për armatimin, nën mbikqyrjen dhe menaxhimin e Policisë së Shtetit;
- Shkatërrimi i armatimit shtesë, bazuar në planin e veprimit ekzistues.

Aktivitete zbatuese afatshkurtra

- Përgatitja, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse në vend të Raportimeve vjetore të Republikës së Shqipërisë në fushën e armëkontrollit dhe çarmatimit.

Aktivitete zbatuese afatmesme

- Bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Eksporteve (AKSHE) për përmirësimin e vazhdueshëm të kontrollit të eksporteve të të gjitha transfertave ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, për të cilat nevojitet të kërkohet paraprakisht mendimi politik i MPJ-së.

3.31.4. ZBATIMI I MASAVE KUFIZUESE DHE SANKSIONET EKONOMIKE

Objektivi strategjik

Shqipëria mbështet fuqimisht politikën e jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes së BE-së, e cila synon forcimin e rolit të Bashkimit Evropian në politikën ndërkombëtare. Në kuadër të procesit të anëtarësimit, Shqipëria përafron politikën e saj të jashtme me atë të Bashkimit Evropian. Shqipëria zbaton masa shtrënguese të ndërmarra nga BE drejt vendeve të treta.

Situata aktuale

Për periudhën Janar – Maj 2012, Shqipëria zbaton 37 masa shtrënguese ndaj vendeve të treta. Të gjitha qëndrimet, të cilave vendi ynë u bashkohet, sipas Kushtetutës bëhen pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe janë të zbatueshme për të gjitha institucionet.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese të pasurisë", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 181, Faqe 8069, datë 24.12.2009 (hyrë në fuqi më 24.01.2010);
- Ligji nr. 9959, datë 17.07.2008 "Për të huajt", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 124, Faqe 5479, datë 01.08.2008;
- Ligji nr. 9917 datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 83, Faqe 3645, datë 10.06.2008;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1077, datë 27.10.2009 "Për miratimin e dokumentit strategjik kombëtar "Për hetimin e krimit financiar"";
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 15, datë 16.02.2009 "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftës për Financimin e Terrorizmit në Sistemin Doganor";
- Ligji nr. 9707, datë 05.04.2007 "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishte", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 48, Faqe 1237, datë 24.04.2007;
- Ligji 9258, datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 54, Faqe 3538, datë 11.08.2004;
- Ligji nr. 8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 14, Faqe 635, datë 06.06.2000, ndryshuar me ligjin nr. 9084, datë 19.06.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8610, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 57, Faqe 2422, datë 14.07.2003";
- Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë – Ligji nr. 8449, datë 27.01.1999, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 48, Faqe 1237, datë 24.04.2007.

Strukturat institucionale

Ministria e Punëve të Jashtme merr vendimin politik për t'iu bashkangjitur propozimeve të BE në këtë fushë. Këto vendime u përcillen për zbatim ministrive të linjës, të cilat janë përgjegjëse direkte për zbatimin dhe monitorimin në vazhdimësi të masave shtrënguese dhe sanksioneve ekonomike. Strukturat që merren me zbatimin dhe monitorimin e masave kufizuese dhe sanksioneve ekonomike në Republikën e Shqipërisë, janë si më poshtë:

- Ministria e Punëve të Jashtme, nëpërmjet Misionit të RSH pranë BE, si edhe Sektorit të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë me BE-në në Drejtorinë e Përgjithshme të Çështjeve Evropiane në MPJ;
- Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE) në Ministrinë e Mbrojtjes;

- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në varësinë e Ministrisë së Financave;
- Ministria e Brendshme;
- Policia Kufitare dhe Migracionit;
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Masa zbatuese afatshkurtra

- Zbatimi i masave shtrënguese ndërmerret rast pas rasti, në varësi të zhvillimeve të politikës globale. Një prej masave me karakter të përhershëm është ndërtimi i një baze të dhënash nga MPJ ku pasqyrohen të gjitha qëndrimet e përbashkëta, të cilave u bashkohet Shqipëria.

Aktivitete zbatuese afatshkurtra

- MPJ ndërmerr hapat e bashkimit të qëndrimit politik të Shqipërisë me atë të BE-së.

Aktivitete zbatuese afatmesme

- Të gjitha institucionet e tjera të sipërpërmendura merren me zbatimin në praktikë të masave ligjore që vijojnë pas bashkimit të qëndrimit politik të Shqipërisë me atë të BE-së. Krijimi i një baze të dhënash elektronike me të gjitha bashkimet e qëndrimeve të Shqipërisë. Kjo bazë të dhënash ka për qëllim informimin e ministrive të linjës me të gjitha qëndrimet e mbajtura nga Shqipëria dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në këtë fushë.

3.31.5. POLITIKA EVROPIANE E SIGURISË DHE MBROJTJES

Objektivi strategjik

Objektivi kryesor në këtë fushë është përafrimi i politikës së jashtme dhe sigurisë të Shqipërisë me atë të Bashkimit Evropian.

Republika e Shqipërisë ka vullnet të plotë për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme institucionale dhe organizative për të qenë në gjendje, që me aderimin e saj në BE të marrë pjesë aktive dhe të plotë në CFSP/CSDP.

Duke iu referuar në veçanti dimensionit ushtarak, Republika e Shqipërisë i bashkohet përpjekjeve të BE-së për rritjen e kapaciteteve ushtarake dhe krijimin e një bashkëpunimi strukturor permanent në këtë fushë.

Shqipëria ka shprehur interesin për nënshkrimin e marrëveshjes mbi shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar me BE-në.

Republika e Shqipërisë mbështet fuqimisht të gjitha politikat në fushën e CFSP/CSDP të identifikuara në strategjinë e Sigurisë Evropiane, të cilat përkojnë njëkohësisht dhe me objektivat e saj strategjikë të sigurisë.

Situata aktuale

Shqipëria nëpërmjet procedurës së bashkimit të qëndrimeve përshtat politikën e saj të jashtme dhe i bashkohet qëndrimeve të BE-së lidhur me çështje të ndryshme ndërkombëtare.

Shqipëria mbështeti fuqimisht rezolutën e OKB për pjesëmarrjen e BE dhe zërin e saj në Kombet e Bashkuara, pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës. Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB nr.11079 (A/RES/65/276) "Mbi Pjesëmarrjen e Bashkimit Evropian në punimet e Kombeve të Bashkuara" u miratua më 03.05.2011.

Shqipëria vijon të kontribuojë me një personel prej 6 personash në Operacionin EUFOR-Althea në Bosnjë-Hercegovinë: 5 persona EOD (Explosive and Ordinance Disposal Team) dhe 1 person në Shtabin e Përgjithshëm.

Përtej angazhimit të vazhdueshëm në operacionet në Afganistan, Shqipëria ka vendosur për herë të parë në historinë e saj një kontigjent prej 5 oficerë të policisë, në Misionin Trajnues të NATO (NTM-A – NATO Training Mission in Afghanistan), në kuadër të Operacionit ISAF të NATO në Afganistan. Këta oficerë kanë si detyrë këshillimin dhe trajnimin e Komandës së Përgjithshme të Trajnimit të Policisë Kombëtare Afgane. Misioni i tretë i rradhës, i cili fillon në Korrik 2012 dhe që ka për detyrë këshillimin e Policisë Afgane në nivel distrikti, do të ketë në përbërje 16 ekspertë të Policisë së Shtetit shqiptar. Gjatë operacioneve të kontigjentit ushtarak shqiptar në Afganistan, humbi jetën kapiten Feti Vogli dhe u plagos n/tetar Aleksandër Peçi. Shqipëria ka rikonfirmuar angazhimin e saj në kuadrin e operacioneve ushtarake ndërkombëtare në Afganistan.

Në kontekstin e krizës në Libi, Shqipëria përveç dhënies së mbështetjes politike ndaj Operacionit "Unified Protector" të NATO-s në brigjet e Libisë, ofroi facilitetet e porteve detare dhe aeroporteve të saj për NATO-n. Pas përmbylljes së revolucionit në Libi, Shqipëria ka ofruar asistencë ndaj Këshillit Kombëtar të Tranzicionit të Libisë, duke marrë parasysh nevojat e vendit në këtë fazë të tranzicionit.

Baza Ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 9095, datë 03.07.2003 "Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë";
- Ligji nr. 9322, datë 25.11.2004 "Për Strategjinë Kombëtarë të Sigurisë";
- Ligji nr. 8696 datë 23.12.2000 "Për ratifikimin e Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve", i cili bën të zbatueshëm në legjislacionin e brendshëm Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve;
- Ligji nr. 8371, datë 09.07.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare";

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 342, datë 12.03.2008 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim”;
- Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 9858, datë 27.12.2007 “Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar me ligjin nr. 9541, datë 22.05.2006;
- VKM nr. 5, datë 05.01.2002 “Për miratimin e rregullores “Për punën me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar;
- VKM nr. 121, datë 15.03.2001 “Për rregullat e sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar”, i ndryshuar me VKM nr. 387, datë 28.06.2007;
- VKM nr. 122, datë 15.03.2001 “Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e “Çertifikatës së Sigurisë” personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, i ndryshuar me VKM nr. 388, datë 28.06.2007;
- VKM nr. 123, datë 15.03.2001 “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror, procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të delegimit të autoritetit të klasifikimit”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 12/376/2001;
- VKM nr. 124, datë 15.03.2001 “Për deklasifikimin e zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” që ndodhet në rrjetin kombëtar të arkivave”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 10/337/2001;
- VKM nr. 377, datë 31.05.2001 “Për Sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” në marrëdhëniet ndërkombëtare”;
- VKM nr. 380, datë 31.05.2000 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” në fushën industriale, i ndryshuar me VKM nr. 121, datë 02.02.2009;
- VKM nr. 922, datë 19.12.2007 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit (INFOSEC)”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 186/5837/2007;
- VKM nr. 58, datë 29.01.2004 “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 4/105/200;
- VKM nr. 390, datë 28.06.2007 “Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr. 5, datë 05.01.2002 të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e rregullores për punën me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”;
- Protokolli i Traktatit të Atlantikut Verior për pranimin e Republikës së Shqipërisë në NATO, nënshkruar më 09.07.2008;
- Marrëveshje për mbrojtjen e ndërsjellë të teknologjive sekrete në fushën e mbrojtjes dhe për të cilat është bërë aplikimi i patentës, bërë në Paris më 21.09.1960, aderuar me ligjin nr.10284, datë 03.06.2010, hyrë në fuqi më 22.09.2010;
- Marrëveshja ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut për sigurinë e informacionit, bërë më Bruksel më 06.03.1997, hyrë në fuqi 03.06.2010;
- Marrëveshje ndërmjet Bashkimit Europian dhe Republikës së Shqipërisë mbi pjesëmarrrjen e Shqipërisë në operacionin ushtarak të Bashkimit Evropian për menaxhimin e krizave në Bosnjë-Hercegovinë (ALTHEA), nënshkruar më 07.03.2005, hyrë në fuqi më 01.08.2005;
- Marrëveshje strategjike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Policor Europian, nënshkruar më 05.02. 2007, hyrë në fuqi më 10.05.2007;
- Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian në pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Bashkimit

Europian në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qëndrore (operacioni EUFOR TCHAD/RCA), nënshkruar më 13.07.2008;

- Memorandumi i Mirëkuptimit në krijimin e një linje të sigurtë komunikimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit, si dhe zbatimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit strategjik ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit, nënshkruar më 01.12.2009;
- Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për krijimin e kuadrit për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionet e menaxhimit të krizave të Bashkimit Evropian, nënshkruar në Bruksel më 05.06.2012.

Strukturat institucionale

- Ministria e Punëve të Jashtme, nëpërmjet Misionit të RSH pranë BE, si edhe Sektorit të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë me BE-në në Drejtorinë e Përgjithshme të Çështjeve Evropiane në MPJ;
- Ministria e Mbrojtjes.

Masa legjislative afatshkurtra

- Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi e Marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e vendit tonë në operacionet civile dhe të menaxhimit të krizave.

Aktivitete zbatuese afatshkurtra

- Caktimi i Korrespondentit Evropian në përputhje me angazhimet e marra nga pala shqiptare;
- Caktimi i Drejtorit Politik në përputhje me angazhimet e marra nga pala shqiptare.

Masa legjislative afatmesme

- Përfundimi i Marrëveshjes për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë.

Aktivitete zbatuese afatmesme

- Instalimi i sistemit të shkëmbimit të informacionit të klasifikuar me BE (COREU);
- Vendosja e Shifrës Kombëtare (Keyone Desktop), e çertifikuar në nivelin “Sekret” nga DSIK dhe përfundimi i Rrjetit Kombëtar të Komunikimit të Sigurt midis institucioneve kyçe të administratës publike;
- Finalizimi i Strategjisë Kombëtare të Sigurisë;
- Përmirësimi i mëtejshëm i shërbimit të emergjencave civile dhe përgatitja ndaj fatkeqësive në dritën e kontributeve në këtë fushë.

3.32. KONTROLLI FINANCIAR

3.32.1. AUDITIMI I JASHTËM (SHTETËROR)

Objektivi Strategjik

Neni 90 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit parashikon se bashkëpunimi mes Palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me acquis e BE-së në fushat e kontrollit financiar publik të brendshëm (KFPB) dhe auditimit të jashtëm. Palët bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar një sistem efikas KFPB dhe sisteme të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuara botërisht si edhe me praktikat më të mira të BE-së. Në këtë kuadër forcimi i kapaciteteve operacionale të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), si institucioni qendror, përgjegjës për këtë fushë, dhe sigurimi i pavarësisë funksionale dhe financiare mbetet një prioritet në fushën e Auditimit të Jashtëm, ndërsa në periudhë afatmesme zhvillimi i procedurave dhe kapaciteteve administrative për të siguruar mbrojtje efektive të interesave financiare të BE-se do të jetë prioritet parësor.

Situata aktuale

KLSH-ja nuk është institucion vendimmarrës por rekomandues. Ai raporton para Kuvendit të Shqipërisë dhe i paraqet atij raportin mbi zbatimin e buxhetit të shtetit, mendimin rreth raportit të qeverisë për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi dhe informacione nga rezultatet e auditimit kur këto kërkohen prej tij. Kuvendit i paraqitet edhe raporti vjetor për veprimtarinë e institucionit.

Veprimtaria audituese e KLSH-së, e sanksionuar në Kushtetutë dhe në ligji nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit, ligji organik i KLSH-së. KLSH e konsideron një objektiv të rëndësishëm strategjik që duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit, të zhvillojë dhe konsolidojë më tej, veprimtarinë e vet audituese, veçanërisht nëpërmjet zgjerimit të fushave të auditi. Në këtë kontekst janë duke u zhvilluar dhe konsoliduar më tej, veçanërisht në drejtim të përvetësimit, thellimit dhe përmirësimit cilësor të veprimtarisë audituese, nëpërmjet zgjerimit të tematikave objekt auditimi, ngritjes të nivelit cilësor të ushtrimit të procesit të auditimit, përmirësimit të përmbajtjes dhe mënyrës së paraqitjes së materialeve të auditimit e të rekomandimeve, si dhe ndjekjes e rritjes së shkallës së përgjegjësisë të stafit të KLSH-së dhe atij drejtues të subjekteve të audituara për zbatimin e masave të rekomanduara. Një drejtim tjetër që KLSH po ndërmerr është zhvillimi i metodologjive të veçanta për auditimin e mashtrimeve dhe korrupsionit, si dhe hartimin e një guide për referimin e veprave penale në prokurori.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Veprimtaria audituese e KLSH-së, është e rregulluar nga:

- Nenet 158/5 dhe 162 – 165 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë[142] ;
- Ligji nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit"[143]; ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000 ;[144]
- Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 212, datë 29.10.2002 [145]

Struktura institucionale

Duke marrë në konsideratë, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KLSH-së, arritjet dhe përparimet e bëra sidomos këto vitet e fundit, mund të shprehemi se institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit plotëson parametrat e funksionimit të institucioneve të auditimit të Bashkimit Evropian. KLSH-ja, është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko - financiar i Republikës së Shqipërisë. Ai përbëhet nga 4 departamente auditimi, 1 departament mbështetës dhe 5 drejtori mbështetëse. Strukturat drejtuese (departamentet) të auditimit, përfshijnë: auditimin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë në zbatimin e buxhetit, përdorimin e fondeve publike nga institucionet e administratës së lartë shtetërore, administrimin e të ardhurave buxhetore nga organet e sistemit fiskal e doganor, zbatimin e procedurave ligjore dhe efektshmërinë në privatizimin e pronës publike, dhënien me qira dhe administrimin e pasurisë në ndërmarrje, shoqëri e institucione financiare me kapital shtetëror.

Masat legjislative afatshkurtra

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër do të jenë:

- Hartimi dhe përditësimi i komenteve mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8270 datë 23.12.1997 "*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*" me ndryshimet përkatëse.

Projektligji, synon të jetë në përputhje me Deklaratën e Limës, Standardet e Auditimit të INTOSAI-t dhe praktikat më të mira Evropiane.
Drafti i projektligjit është hartuar në versionin fillestar në kuadër të Projektit të Binjakëzimit KLSH, në bashkëpunim me ekspertët e Zyrën Kombëtare të Kontrollit të Holandës. Në vijim të këtij procesi është hartuar drafti me propozimet e bëra për ndryshimet në ligjin aktual. Në fund të vitit 2009 për draftin me propozimet e bëra për ndryshimet në ligjin aktual të KLSH-së dhanë mendim të gjithë departamentet e auditimit. Më tej ky draft është hedhur në një proces konsultimi me ekspertë të SIGMA-s, EURALIUS dhe ekspertë të strukturave respektive në institucionet e BE. Parashikimi është që deri në fund të vitit 2012, të jetë përfunduar projektligji në versionin përfundimtar, ku do të jenë reflektuar komentet e SIGMA-s dhe komentet përfundimtare të DG Budget. Ky version përfundimtar i projektligjit do t'i përcillet Komsionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, në mënyrë që të marrë rolin e agjentit nxitës për përcjelljen për miratim në Kuvend të kësaj nisme ligjore.

[142] Fletore zyrtare nr. 28 faqe 1073, datë 07.12.1998
[143] Fletore zyrtare nr. 20, faqe 503, date 7.01.1998
[144] Fletore zyrtare nr.15, faqe 699, date 21.06.200

[145] Fletore zyrtare nr. 69, faqe 1923, datë 08.11.2002

Aktivitetet zbatuese

Brenda vitit 2012, parashikohet të realizohen aktivitetet zbatuese në vijim:

- Përfundimi i hartimi të Planit Afatmesëm Strategjik 2013 – 2015 dhe Planit Afatgjatë Strategjik 2013 – 2018;
- Përmirësim i metodologjisë së kontrollit, duke kthyer vëmendjen tek Auditimi i Performancës, krahas rritjes së efiçiencës së Auditimit Financiar;
- Rritja e numrit të audituesve të trajnuar për Auditimin e Performancës;
- Vendosja e bazave të bashkëpunimit me IEKA, me synim forcimin e kapaciteteve për Auditimin dhe dhënien e opinioneve mbi Pasqyrat Financiare.
- Hartimi i moduleve specifike të trajnimit për çertifikimin e audituesve.
- Kryerjen e disa vizita studimore në formën e workshopeve me SAI-t homolog duke përfshirë veprimtaritë e përbashkëta të auditimit.
- Rritja e mëtejshme e transparencës dhe e përgjegjshmërisë së qeverisjes së sektorit publik me publikimin e revistave dhe librave në lidhje me përdorimin e burimeve publike dhe përmirësimin e imazhit dhe rolit të KLSH-së si dhe forcimin e besimit të publikut ndaj këtij institucioni.
- Trajnim i stafit për përdorimin e softwareve të auditimit dhe të sistemeve të IT në subjektet publike.

Masat legjislative afatmesme

Masat kombëtare për periudhën afatmesme do të jenë:

- Projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8270 datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" me ndryshimet përkatëse. *(shiko Tabela nr.1).*

Projektligji është parashikuar të miratohet nga Kuvendi brenda 6-mujorit të I-rë të vitit 2013.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Gjatë viteve 2013 – 2015, duke konsideruar ndryshimet dhe miratimin e tyre në ligjin nr. 8270 date 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", aktivitetet kryesore zbatuese do të përqendrohen në:

- Ruajtjen e rezultateve dhe forcimin e metodologjisë dhe kontrollit të cilësisë për Auditimin Financiar;
- Forcimin dhe zgjerimin e kapaciteteve për Auditimin e Performancës dhe pasurimin e metodologjisë dhe kontrollit të cilësisë për këtë auditim;
- Ngritjen e kapaciteteve për kryerjen sistematike të Auditimit dhe dhënien e opinioneve mbi Pasqyrat Financiare;
- Planifikimin dhe fillimin sa më shpejt të kryerjes së Auditimeve të Teknologjisë së Informacionit[146] ;

[146] Auditime të Sistemeve dhe proceseve të punës që kryhen nga administrata publike nëpërmjet sistemeve TI;

- Forcimin dhe modernizimin e mëtejshëm të sistemeve të analizave të nevojave për trajnim dhe shtimin e trajnimit të stafit nga ekspertizë e jashtme deri në nivelin 10 ditë trajnimi/vit për person, duke synuar orientimin drejt trajnimeve të specializuara për lloje të ndryshme të auditimit;
- Forcimin dhe modernizimin e mëtejshëm të sistemit të vlerësimit të anëtarëve të stafit, duke synuar orientimin drejt vlerësimit sipas rezultateve;
- Vendimmarrjen përfundimtare në bashkëpunim me Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave për ambientet e zyrave të KLSH, pasi gjëndja e pasigurisë, pengon planifikimin e investimeve në infrastrukturën e Teknologjisë së Informacionit.

Efektet financiare

Buxheti i Shtetit: Për realizimin e masave ligjore dhe zbatuese afatmesme, parashikohen që të mbulohen nga buxheti i shtetit: pagat për punonjës të rinj, kostot për investime në ambiente të reja zyrash dhe pajisje, kostot për trajnimet, kostot e pagesave për ekspertizën etj; *(shiko Tabela nr.2)*

Tabela nr.1

Masa Kombëtare	**Autoritetet Përgjegjëse**	**Afati i miratimit**	**Celex – Masa BE**
Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8270 datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" me ndryshimet përkatëse.	KLSH Kuvendi	Maj 2013	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit(ISSAI) të INTOSAI-t

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.32.1 Auditimi i Jashtem

Në Lekë

	2012	**2013**	**2014**	**2015**
Kostot totale e vlerësuar	**12.176.000**	**236.868.416**	**219.875.520**	**109.985.520**
Mbulohen nga buxheti i	12.176.000	106.868.000	69.875.000	24.985.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	0	130.000.000	150.000.000	85.000.000
Ndryshim	0	-416	-520	-520

Shënime:

1. Në parashikimin e kostove nuk janë përfshirë shpenzimet për infrastrukturë, që mund të bëhen të nevojshme, në momentin kur do të vendoset përfundimisht për ambientet e zyrave të KLSH

2. Në shpenzimet për konsulencë dhe për trajnime, nuk është përfshirë kosto që duhet parashikuar në rast të trajnimeve me ekspertizë të jashtme për Auditimin e Çertifikimit të Pasqyrave Financiare dhe për Auditimet TI.

3.32.2. AUDITIMI I BRENDSHËM

Objektivi Strategjik

Reformat e ndërmarra nga Qeveria në kuadrin e Integrimit Evropian në fushën e menaxhimit të financave publike kanë fokusuar përpjekjet në drejtim të rritjes së përgjegjshmërisë së drejtuesve për përdorimin me efiçencë të burimeve publike dhe krijimin e përsosjen e një sistemi të qëndrueshëm dhe modern të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Shqipëri. Miratimi i ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ka hapur rrugën prezantimit gjithpërfshirës dhe zhvillimit të mëtejshëm të konceptit të KBFP, i cili tashmë merr një kuptim tjetër nën këndvështrimin e parimeve të përgjegjshmërisë dhe trasparencës, sikurse dhe përdorimit me dobi, frytshmëri dhe ekonomi të burimeve dhe fondeve publike për arritjen e prioriteteve strategjike.

Zhvillimet e fundit në kuadrin ligjor të financave publike si ndryshimet në ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 " *Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*", miratimi i "*Manualit të Auditimit të Brendshëm*", miratimi ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" dhe ligjit "*Për Inspektimin Financiar*", kërkojnë një ristrukturim të sistemit të KBFP, duke synuar zhvillimin dhe përsosjen e tij në pajtueshmëri të plotë me standartet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane.

Një nga mekanizmat më të rëndësishëm të sistemit të KBFP është dhe shërbimi i Auditimit të Brendshëm. Me qëllim që të vlerësojë dhe dhe përmirësojë strukturat e menaxhimit dhe të kontrollit, si dhe të menaxhimit efektiv të riskut, proceseve të menaxhimit dhe kontrollit të transaksioneve financiare në administrimin publik, shërbimi apo veprimtaria e auditimit të brendshëm kryhet në një mënyrë sistematike, të vazhdueshme dhe të disiplinuar, e cila nënkupton hartimin e një Strategjie 5-vjeçare dhe Plani Vjetor të Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm.

Situata Aktuale

Analiza e Situatës Aktuale

Detyrimet e Qeverisë Shqiptare për fushën e auditimit të brendshëm përcaktohen, ndër të tjera, nga Neni 90 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Ky nen parashikon nevojën e bashkëpunimit ndërmjet palëve në aspektet prioritare që lidhen me *acquis e BE-së* për krijimin dhe forcimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe modern të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP). Palët duhet të bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë me qëllim zhvillimin e një sistemi efikas KBFP në Shqipëri, në përputhje me standardet e BE-së në këtë fushë. Për realizimin e këtij objektivi, do të vijojë zhvillimi i mëtejshëm i këtij sistemi duke theksuar adoptimin dhe implementimin e standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të Bashkimit Evropian me qëllim që të sigurohet mënyra më optimale për reformimin e sistemeve tradicionale të kontrollit. Për këtë qëllim, forcimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të KBFP-së në Shqipëri në të ardhmen konsiston në krijimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor, procedural dhe metodologjik bazë për zhvillimin e KBFP-së si dhe për përcaktimin e strukturave përgjegjëse për zbatimin e KBFP-së. Ngritja e një sistemi të tillë të

kontrollit të brendshëm publik për nga natyra e tij parandaluese synon të sigurojë se janë vendosur sisteme të përshtatshme të cilat minimizojnë dhe parandalojnë sa më shumë të jetë e mundur korrupsionin në të gjithë format e tij.

Funksioni i auditimit të brendshëm si veprimtari e pavarur mbështet menaxhimin e subjekteve publike për arritjen e objektivave të tyre, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë. Njësitë e auditimit të brendshëm të krijuara në zbatim të ligjit nr. 9720 datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010, ushtrojnë veprimtarinë e tyre audituese brenda autioritetit, objektit dhe sipas përgjegjësive e të drejtave të parashikuara në këtë ligj dhe kuadrit rregullator në fuqi.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm e fokusuar në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të qeverisjes jep siguri të arsyeshme nëse:

- informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacionale janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
- burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- asetet janë ruajtur;
- veprimtaritë e subjekteve janë në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara; dhe
- Objektivat kryesore të përcaktuara në programet dhe planet e subjekteve do të arrihen.

Si pjesë e misionit të saj Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (NjQH/AB) ka ndërmarrë veprimtari konkrete për të krijuar një mjedis të plotë ligjor, proçedurial dhe profesional për ushtrimin e funksionit të auditimit të brendshëm. Përderisa kuadri ndërkombëtar është në zhvillim të vazhdueshëm dhe kuadri kombëtar i hartuar në bazë të këtij të fundit do të jetë në një proces të pandërprerë zhvillimi e përmirësimi. Pikërisht këtij qëllimi i ka shërbyer dhe rishikimi i LAB, si dhe hartimi i Manualit të ri të Proçedurave të Auditimit, proçese që kanë përfunduar gjatë vitit 2011. Në këto dy veprimtari shumë të rëndësishme NjQH/AB është mbështetur nga asistenca teknike e ekspertëve të Projektit PIFC 2.

Në lidhje me kapacitetet audituese theksojmë se nga analiza e plotësisë dhe përbërjes së strukturave audituese konstatojmë se deri në fund të vitit 2011, në të gjitha Institucionet publike të qeverisjes qendrore dhe në nivel vendor, janë të punësuar 406 auditues, ndër të cilët 332 auditues janë të çertifikuar, 15 janë në proces dhe 74 nuk janë të çertifikuar.

Drejtoria e Zhvillimit Profesional dhe Analizës në NjQH/AB, në kuadër të reformave të ndërmarra për përmirësimin dhe zhvillimin e aftësive të stafit të strukturave të auditimit të brendshëm, me qëllim që ato të jenë sa më të qëndrueshme, profesionale dhe efiçente vijon të implementojë programin e trajnimit për "Çertifikimin e Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik".

Organizimi, administrimi dhe zhvillimi i trajnimeve për çertifikimin "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik" janë produkt i drejtpërdrejtë i bashkëpunimit midis Drejtorisë së Zhvillimit Profesional dhe Analizës dhe Komisionit të Kualifikimit, si organet përkatëse dhe përgjegjëse të këtij procesi. Hartimi, miratimi dhe më pas implementimi i akteve ligjore sekondare kanë synuar të krijojnë dhe plotësojnë mjedisin e nevojshëm për zhvillimin profesional të punonjësve.

Treguesi i nivelit të aftësive dhe kapaciteteve profesionale të stafit të strukturave të KBFP është rritur ndjeshëm. Si rezultat i implementimit të procesit të trajnimit për titullin "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik", vetëm gjatë vitit 2011, nga grupi i të trajnuarve për sezonin 2010-2011 janë vlerësuar fitues të këtij titulli 283 kandidatë, përfaqësues të strukturave audituese dhe të menaxhimit financiar. Ndërkohë që kanë filluar trajnimin në shtator 2011 dhe vijojnë të trajnohen 335 kandidatë, ku trajtohen kurrikulat për 4 module të ndryshme: Kontabilitet, Legjislacion, Qeverisja dhe Kontrolli si dhe Auditimi i Brendshëm,.

Procesi i trajnimit të audituesve të brendshëm krahas implementimit është në çdo kohë nën vlerësim dhe rishikim duke pasur gjithnjë në fokus qëllimin që titulli "Auditues i Brendshëm" të pasqyrojë profesionalizëm i cili mund të arrihet vetëm pas ndjekjes së trajnimit bazë për çertifikim si auditues i brendshëm i kombinuar me trajnimin e vijueshëm të detyrueshëm dhe eksperiencën në punë. Programet e trajnimit rishikohen cdo vit mbi bazën e "Analizës së Nevojave për Trajnim" që realizohet gjatë procesit të Planifikimit Strategjik dhe Vjetor për strukturat e auditimit të brendshëm.

Baza Ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Kuadri ligjor për auditimin e brendshëm reflekton standardet evropiane në këtë fushë dhe përbëhet nga:

- Ligji nr. 9720 datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"[147] , ndryshuar me ligjin nr. 10318 datë 16.09.2010 " Për disa ndryshime në ligjin "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 806 datë 6.12.2006 "Për miratimin e metodologjisë së auditimit financiar"[148] publik;
- VKM nr 886, datë 19.12.2007 "Për Krijimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit për Çertifikimin e Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik"[149];
- VKM nr. 548, datë 1.5.2008 "Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm"[150] ;
- VKM nr 640, datë 11.6.2009, "Për Miratimin e letërpolitikave për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik dhe të Planit të Veprimit 2009-2014"[151];

[147] Fletore Zyrtare Nr 92/2007
[148] Fletore Zyrtare Nr 139/2006
[149] Fletore Zyrtare Nr 179/2007
[150] Fletore Zyrtare Nr 83/2008
[151] Fletore Zyrtare Nr 101/2009

- VKM nr. 680, datë 05.10.2011, "Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit të menaxhimit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik dhe të Komitetit të Auditimit të Brendshëm" [152];
- Urdhri i Ministrit të Financave Nr. 69, datë 29.09.2010 "Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".

Ky kuadër është në përputhje me modelin Committee of Sponsoring Organizations (COSO) dhe praktikat më të mira të EU-së dhe ka një shkallë përafërimi të plotë.

Struktura Institucionale

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e auditimit të brendshëm është nën përgjegjësinë e këtyre strukturave:

- Ministrit të Financës, i cili ka përgjegjësi të përcaktuara me ligjin e Auditimit të Brendshëm.
- Njësia Qendrore e Harmonizimit për AB, ka për detyrë udhëheqjen metodologjike dhe harmonizimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në shkallë kombëtare si dhe mbikëqyrjen apo sigurimin e cilësisë në zbatimin e standardeve për veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

Struktura e NjQH/AB në Ministrinë e Financave është e përbërë nga 15 punonjës, të ndarë në dy Drejtori (Drejtoria e Metodologjisë, Monitorimit dhe Vlerësimit të Cilësisë dhe Drejtoria e Zhvillimit Profesional dhe Analizës), përkatësisht me nga 7 dhe 4 specialistë auditimi. NjQH/AB është përgjegjëse për:

- zhvillimin dhe përvijimin e kuadrit ligjor, primar dhe mbështetës për kryerjen e auditimit të brendshëm në sektorin publik;
- udhëheqjen e procesit të adoptimit dhe zbatimit të standarteve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e auditimit të brendshëm;
- krijimin dhe zhvillimin e rrjetit të auditimit të brendshëm i cili do të shërbejë për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacionit dhe eksperiencës midis elementëve institucional të auditimit të brendshëm në të gjithë sektorin public;
- sigurimin e një procesi me cilësi të auditimit të brendshëm në sektorin publik nëpërmjet krijimit dhe mbajtjes së një programi për sigurimin e cilësisë;
- monitorimin e zbatimit të politikave të sistemit të auditimit të brendshëm;
- përgatitjen e raportit të konsoliduar vjetor dhe periodik për politikat, programet, standardet dhe çdo aspekt tjetër auditimi të veprimtarisë së strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik i cili, pas shqyrtimit dhe miratimit në Komitetin e Auditimit të Brendshëm, i paraqitet Ministrit të Financave dhe nëpërmjet tij Këshillit të Ministrave;
- bashkërendimin dhe bashkëpunimin me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, ndër të tjera, për përgatitjen e raportit vjetor

[152] Fletore Zyrtare Nr 146/2011

për sistemin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, i cili i paraqitet Ministrit të Financave dhe nëpunësit të parë autorizues;
- hartmin dhe zhvillimin e strategjisë dhe politikave kombëtare për sistemin e edukimit të përditësuar, në trajnimin e vijueshëm, të detyrueshëm dhe procedurat e punësimit të audituesve;

Komiteti i Auditimit të Brendshëm (KAB) është i përbërë nga 9 (nëntë) anëtarë, organizimi, funksionimi dhe detyrat e të cilit janë të përcaktuara në ligjin e Auditimit të Brendshëm:

- Komisioni i Kualifikimit për Çertifikimin e Audituesve të Brendshëm në sektorin publik i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, organizimi, funksionimi dhe detyrat e të cilit janë të përcaktuara me VKM nr. 886, datë 19.12.2007 "Për Krijimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit për Çertifikimin e Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik"[153]
- Strukturat (Njësitë) e auditimit të brendshëm në të gjitha ministritë, institucionet qëndrore dhe lokale dhe ato të varësisë.

Masat legjislative afatshkurtra

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e kontrollit të brendshëm financiar publik, për periudhën afatshkurtër 2012, është kompletimi i kuadrit ligjor për KBFP-në dhe zbatimi i politikave afatshkurtra të përcaktuara në Letër Politikat për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (PIFC) dhe Planit të Veprimit 2009-2014 duke siguruar zhvillimin e mëtejshëm të elementeve që qëndrojnë në qendër të këtij sistemi, përgjegjshmëria manaxheriale dhe auditimi i brendshëm i decentralizuar dhe funksionalisht i pavarur. Kuadri ligjor është parashikuar të kompletohet më tej me miratimin e disa akteve ligjore si VKM, Udhëzime e Urdhra të Ministrit të Financave.

Masat kombëtare për periudhën afatshkurtër në fushën e AB në sektorin publik do të jenë:

- Hartimi i Projekt Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e ngritjes së Njësive të Auditimit të Brendshëm në subjektet publike
- Hartimi i Udhëzimit të Ministrit të Financave "Mbi procedurat e e kryerjes së veprimtarisë së AB në sektorin publik"

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Reflektimi i komenteve dhe sugjerimeve të bëra nga Ministria e Drejtësisë dhe dërgimi i Projekt Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e ngritjes së Njësive të Auditimit të Brendshëm në subjektet publike" në Këshillin e Ministrave për miratim.
- Përgatitja e draftit të Udhëzimit të Ministrit të Financave "Mbi procedurat e e kryerjes së veprimtarisë së AB në sektorin publik" dhe dërgimi i tij te Ministri i Financave për Miratim.

[153] Fletore Zyrtare Nr 179/2007

Masat legjislative afatmesme

Në periudhën afatmesme 2013-2015, qeveria shqiptare do të punojë për të siguruar implementimin e sistemit të KBFP-së në tre shtyllat e tij: përgjegjshmëria menaxheriale (sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit) auditimi i brendshëm funksionalisht i pavarur (sistemet e auditimit të brendshëm) dhe dy njësitë qendrore të harmonizimit (NjQH) për zhvillimin e metodologjive dhe standardeve për dy të parat, e cila do të ketë në qendër implementimin e standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të BE-së në këtë fushë.

Masat legjislative afatmesme

- Projekt-Urdhëri i Ministrit të Financave mbi "Hartimin e Metodikës për kontrollin e jashtëm të cilësisë dhe vlerësimin e strukturave të AB në sektorin publik. Afati i miratimit, dhjetor 2014;
- Projekt-Urdhëri i Ministrit të Financave mbi "Hartimin e Kodit të Etikës dhe standarteve ndërkombëtare për praktikat profesionale të AB në sektorin publik. Afati i miratimit, Dhjetor 2014.

Masat zbatuese afatmesme

- Për hartimin e Metodikës për kontrollin e jashtëm të cilësisë dhe vlerësimin e strukturave të AB në sektorin publik janë parashikuar këto masa zbatuese:
- Ngritja e grupit të punës dhe grumbullimi i materialeve;
- Dërgimi për mendim në strukturat e Ministrisë së Financave;
- Reflektimi i Komenteve dhe kalimi për diskutim në Komitetin e AB dhe kalimi për miratim te Ministri i Financave.
- Për hartimin e Kodit të Etikës dhe standarteve ndërkombëtare për praktikat profesionale të AB në sektorin publik janë parashikuar këto masa zbatuese:
- Ngritja e grupit të punës dhe grumbullimi i materialeve;
- Dërgimi për mendim në strukturat e AB në sektorin publik dhë në Ministrinë ë Financave;
- Reflektimi i Komenteve dhe kalimi për diskutim në Komitetin e AB dhe kalimi për miratim te Ministri i Financave.
- Hartimi i akteve që miraton Ministri i Financave në zbatim të ligjit dhe VKM-ve që lidhen me AB në sektorin publik, janë parashikuar të merren këto masa zbatuese:
- Zbatimi i procedurave lidhur me hartimin e akteve që miraton Ministri i Financave;
- Bashkëpunimi me grupet e interesit dhe përgatija e drafteve për KAB;
- Reflektimi i ndryshimeve për KAB dhe kalimi për miratim nga Ministri i Financave.

Efektet Financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.32.2 Auditimi i Brendshëm

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e	**430.470.000**	**443.384.000**	**456.685.000**	**470.386.000**

vlerësuar				
Mbulohen nga buxheti i	430.470.000	443.384.000	456.685.000	470.386.000
Ndryshim	0	0	0	0

3.32.3. MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI

Objektivi Strategjik

Objektivi i Qeverisë Shqiptare në fushën e kontrollit të brendshëm është krijimi dhe forcimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe modern të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP) në përputhje me standardet e BE-së. Ngritja e një sistemi modern të kontrollit të brendshëm publik për nga natyra e tij parandaluese synon të sigurojë se janë vendosur sisteme të përshtatshme të cilat minimizojnë dhe parandalojnë sa më shumë të jetë e mundur korrupsionin në të gjithë format e tij.

Realizimi i këtij objektivi konsiston në përmirësimin e kuadrit ligjor, proçedural dhe metodologjik bazë për zhvillimin e KBFP-së si dhe implementimi i tyre në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian me qëllim që të sigurohet mënyra më optimale për reformimin e sistemeve tradicionale të kontrollit. Neni 90 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit parashikon nevojën e bashkëpunimit ndërmjet palëve në aspektet prioritare që lidhen me acquis communautaire për krijimin dhe forcimin e një sistemi të qendrueshëm dhe modern të KBFP.

Situata Aktuale

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e kontrollit të brendshëm financiar publik gjatë periudhës 2010-2011 ka qënë kompletimi i kuadrit ligjor për KBFP-në dhe zbatimi i politikave të përcaktuara në Letër Politikat dhe Planin e Veprimit 2009-2014 për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik (KBFP) duke siguruar zhvillimin e mëtejshëm të elementeve që qëndrojnë në qendër të këtij sistemi: përgjegjshmërinë manaxheriale dhe auditimin e brendshëm të decentralizuar dhe funksionalisht të pavarur.

Kuadri ligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin është krijuar dhe ka hyrë në fuqi dhe si rrjedhojë në të ardhmen fokusi do të jetë sigurimi i implementimit të këtij kuadri ligjor me qëllim ngritjen e një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe forcimin e përgjegjshmërisë menaxheriale në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të BE-së në këtë fushë. Me hyrjen në fuqi të bazës ligjore të MFK-së, janë zhvilluar disa aktivitete implementuese të cilat konsistonin në përhapjen e risive që sjell kuadri ligjor dhe ndërgjegjësimin e aktorëve kryesorë të përfshirë në proçes. Gjatë vitit 2011 e në vazhdim janë organizuar seminare për menaxhimin e riskut dhe aktivitete këshilluese për hartimin e regjistrit dhe strategjisë së riskut në disa njësi të sektorit publik.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Baza ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin përbëhet nga aktet në vijim:

- Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i cili hyri në fuqi më 01.01.2011[154];
- VKM nr. 640, datë 11.06.2009, "Për Miratimin e Letër Politikave dhe Planit të Veprimit 2009-2014 për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik";
- Urdhër nr. 54 i Ministrit të Financave, datë 15.07.2010 mbi miratimin e Manualit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin";
- Urdhër i Ministrit të Financave nr. 11841, datë 10.06.2011 "Mbi Planin 5-vjeçar të Implementimit të një Sistemi Modern **të** MFK-së në Sektorin Publik (2011-2016)";
- Urdhër nr. 92, datë 29.12.2011, "Për gjurmët Standarte të Auditit për Prokurimin me Vlerë të Vogël dhe të Lartë";
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"[155];
- Udhëzimi nr.8, datë 29.03.2012, "Për procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm".

Struktura institucionale

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e menaxhimit financiar e kontrollit është nën përgjegjësinë e Ministri i Financave sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin":

Njësia Qëndrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit e krijuar në vitin 2008 si pjesë e strukturës së Ministrisë së Financave në varësi direkte nga Sekretari i Përgjithshëm, e cila është përgjegjëse për:

- përgatitjen e ligjeve, të udhëzimeve, të urdhrave dhe të manualeve për fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- përgatitjen, shpërndarjen dhe përditësimin e strategjive dhe të udhëzimeve metodologjike për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara për kontrollin e brendshëm, rregulloret e zbatueshme dhe praktikat e mira të Bashkimit Europian;
- përcaktimin e nevojave dhe udhëheqjen e trajnimeve e të trajnimeve në vijueshmëri në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik;
- bashkërendimin e punës për ngritjen dhe zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik;
- ndërgjegjësimin për KBFP-në me anë të seminareve dhe krijimit të faqes së internetit.

Gjithashtu NjQH/MFK-ja siguron monitorimin sistematik të sistemeve të MFK-së në njësitë e sektorit publik, me qëllim mbledhjen e informacionit për të përmirësuar metodologjinë dhe standardet e punës. Ajo ndihmon nëpunësin e parë autorizues dhe Ministrin e Financave për monitorimin e sistemeve të MFK-së dhe për përgatitjen e raportit vjetor për gjendjen e këtyre sistemeve. Stafi i NjQH/MFK përbëhet nga një drejtor dhe 4 specialistë. Stafi është trajnuar

[154] Fletore Zyrtare Nr.97, datë 26.07.2010.
[155] Fletore Zyrtare Nr.170, datë 30.12.2011

me mbështetjen e Projektit PIFC II të financuar nga BE dhe aktualisht po asistohet nga SIGMA[156].

Është në fazë miratimi financimi nga Agjencia Ndërkombetare Suedeze për Zhvillim dhe Kooperim (Swedish International Development Cooperation Agency –SIDA) i ushtrimit pilot (në rreth tre njësi publike) mbi zbatimin e parimeve të MFK-së si dhe është miratuar parimisht "Projekti IPA 2012" i cili do të mbështesë zgjerimin e parimeve të MFK-së në një numër të konsiderueshëm të njësive qëndrore dhe vendore të sektorit publik, gjatë periudhës 2013-2016.

Masat legjislative afatshkurtra

- Udhëzim mbi Gjurmët Standarte të Auditimit për Monitorimin e Buxhetit.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian të dhëna në Raportin e Progresit 2011, prioritet afatshkurtra për fushën e menaxhimit financiar kanë të bëjnë me implementimin e një sistemi modern të MFK-së në njësitë e sektorit publik. Është përzgjedhur institucioni pilot (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit-Programi i Rrugëve Nacionale) për implementimin e MFK-së bazuar në kritere të vendosura nga Ministria e Financave në bashkëpunim me SIGMA.

- Aktivitete në kuadër të ushtrimit pilot në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit si institucion pilot i përzgjedhur për implementimin e kuadrit ligjor dhe parimeve të MFK-së;
- Trajnime në vazhdimësi të stafit të NJHQ/MFK-së për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të tyre;
- Seminare ndërgjegjësimi kryesisht për nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues të njësive të sektorit publik;
- Krijimi i forumit të MFK-së në faqen e internetit të Ministrisë së Financave me qëllim krijimin e një rrjeti të nëpunësve autorizues dhe zbatues publikë;
- Aktivitete këshilluese në njësi të sektorit publik lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore të MFK-së[157].

Masat legjislative afatmesme

Në përputhje me prioritetet afatmesme, gjatë implementimit të projektit pilot për ngritjen e një sistemi modern të MFK-së në institucionet pilot të përzgjedhura, do të kryhet vlerësimi nëse ka nevojë për ndryshime ligjore në kuadrin ligjor të MFK-së dhe në përgjithësi të financave publike. Aktualisht nuk janë planifikuar iniciativa ligjore konkrete, por do të ketë të tilla në rast do të rezultojë e domosdoshme pas pilotimit. Prioritetet afatmesme lidhen me përhapjen në shkallë të gjërë të parimeve të MFK-së bazuar në mësimet e nxjerra nga

[156] Projekti është implementuar nga Shtator 2008 deri Korrik 2010
[157] Menaxhimi i riskut, raportimi vjetor mbi gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, gjurmët e auditimit, etj

ushtrimi pilot në MPPT dhe në njësi të tjera publike qëndrore e vendore të përzgjedhura për pilotim.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

Gjatë fazës së parë do të vazhdojë ushtrimi pilot në njësitë publike të përzgjedhura (deri ne tre) dhe pas kompletimit të këtij pilotimi do të fillojë shtrirja dhe në njësi të tjera publike të pushtetit qëndror dhe vendor me mbështetjen e BE.

- Tryeza të rrumbullakëta për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me MFK-në me nëpunësit autorizues, zbatues dhe menaxherë të njësive publike;
- Përgatitja e programeve të trajnimit për menaxherët në njësitë e zgjedhura publike, duke përfshirë hartimin e curriculave për stafin e institucioneve pilot të përzgjedhura;
- Ngritja e kapaciteteve në administratën publike për zbatimin e kuadrit të ri të MFK-së përmes ofrimit të trajnimit të menaxherëve dhe niveleve operacionale të sektorit publik, në fushën e përgjegjshmërisë menaxheriale, menaxhimit financiar dhe kontrollit, menaxhimit të riskut dhe gjurmëve të auditimit;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit të NJQH/MFK për të kryer vlerësimin e nevojave për trajnim dhe për përgatitjen e strategjisë së trajnimit si dhe rritja e kapaciteteve në teknikat e menaxhimit financiar;
- Zhvillimi i seminareve të ndërgjegjësimit për menaxhimin e lartë në mënyrë që ata të mund të vlerësojmë rolin e tyre në vendosjen e "tonit nga lart";
- Zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme teknike për stafin në nivel operacional;
- Përgatitja për një përfshirje të plotë në 2016 të njësive të tjera publike, duke monitoruar nga afër njësitë e përzgjedhura të çdo viti.

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.32.3 “Menaxhimi financiare dhe kontrolli”

Në Lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	**10.501.208**	**62.604.000**	**121.934.000**	**121.934.000**
Mbulohen nga buxheti i	10.501.000	7.334.000	11.534.000	11.534.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	0	55.270.000	110.400.000	110.400.000
Ndryshim	-208	0	0	0

Kursi i këmbimit[158]

3.32.4. INSPEKTIMI FINANCIAR PUBLIK

[158] Bazuar në kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë datë 17/01/2012

Pavarësisht se inspektimi finaciar publik nuk është pjesë e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik sipas konceptit të BE-së, të dhënat mbi funksionimin e tij si dhe mbi strukturat përkatëse në mbështetje të këtij funskioni, janë përfshirë në këtë kapitull. Kjo dhe për të evidentuar qartë ndarjen e funskionit të auditimit të brendshëm nga inspektimi.

Objektivi strategjik

Objektivi strategjik i Ministrisë së Financave, me detyra ligjore në fushën e inspektimit financiar publik, është garantimi i përdorimit në mënyrë ligjore dhe të disiplinuar të fondeve publike, me synim mbrojtjen e interesave financiare të njësive publike kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit dhe korrupsionit.
Objektivi strategjik përcaktohet në zbatim të plotë të dokumentave strategjikë si Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2010-2014, si dhe Progres Raporti 2011 për Shqipërinë, Kapitulli 32 "Kontrolli financiar".

Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet:

- Rritjes së kapaciteteve për rishikimin e bazës ligjore në fuqi, në përafrim me praktikat më të mira të Bashkimit Europian;
- Trajnimin e punonjësve të Drejtorisë së Inspektimit Financiar dhe inspektorët financiarë publikë ad-hoc.

Situata aktuale

Funksionimi i Inspektimit Financiar Publik ka filluar gjatë vitit 2011, në zbatim të ligjit nr.10294, datë 01.07.2010 "Për inspektimin financiar publik". Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e interesave financiare të njesive publike kundrejt keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit dhe korrupsionit. Subjekt i inspektimeve financiare publike janë njësitë publike dhe individët, për fondet publike që përdorin.

Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik është krijuar strukturë në Ministrinë e Financave, bazuar në Urdhërin e Kryeministrit nr. 9, datë 02.02.2011 "Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Ministrisë së Financave". Organika e miratuar përbëhet nga 6 punonjës, aktualisht kjo strukturë funksionon me 4 punonjës. Misioni i inspektimit financiar publik realizohet nga inspektorët financiarë publikë ad-hoc, punonjës të administratës publike, të përzgjedhur nga Ministri i Financave. Për periudhën prill-dhjetor 2011, në zbatim të detyrimeve ligjore në fushën e inspektimit financiar publik, janë realizuar:

- Udhëzimi nr.11, datë 16.05.2011 "Për kriteret për fillimin e inspektimit financiar public";
- Urdhëri nr. 36, datë 16.05.2011 "Për kriteret e përzgjedhjes së inspektorëve financiarë publikë";
- Udhëzimi nr. 17, datë 25.07.2011 "Për përmbushjen e inspektimit financiar publik dhe kontrollin e cilësisë";
- Memorandum Mirëkuptimi nr.18769, datë 03.10.2011 "Për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe hetimin e parregullsive lidhur me zbatimin e instrumentit e asistencës

së para-zgjerimit (IPA) për Republikën e Shqipërisë, nën menaxhimin e decentralizuar midis Zyrtarit Kombëtar Autorizues dhe Shërbimit të Koordinimit kundra Mashtrimit (AFCOS) në strukturën e Ministrisë së Financave";

- Përzgjedhja e inspektorëve financiarë publik, në zbatim të procedurave ligjore e kritereve të miratuara nga Ministri i Financave. Janë përzgjedhur gjithsej 126 inspektorë financiarë publikë, me profesione të fushave të ndryshme. Në veprimtarinë e inspektimit financiar publik, janë shqyrtuar 10 sinjalizime të ardhura në Ministrinë e Financave. Në përmbushjen e misioneve të inspektimit financiar publik, janë zbatuar parimet dhe procedurat ligjore, si dhe kompetencat nga autoritetet përgjegjëse. Në kuadrin e Projektit IPA 2012, nga negocimet është arritur paraprakisht mbështetje financiare në vlerën 500000 euro. Ky projekt do të asistojë kryesisht në mbështetje të strukturës së inspektimit financiar në lidhje me forcimin e kapaciteteve dhe zbatimin e ligjshmërisë.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/ nënligjore në këtë nënkapitull *(soft acquis):*

- Ligji nr. 9936, dt. 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë";[159]
- Ligji nr. 10294, datë 01.07.2010 "Për inspektimin financiar publik"[160];
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"[161];
- VKM nr. 492, datë 06.07.2011 "Për shpërblimin e inspektorit financiar publik"[162];
- VKM nr. 850, datë 14.12.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 23, datë 12.01.2012 "Për përcaktimin e funksioneve të përgjegjësive dhe të marëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decantralizuar të asistencës së Bashkimit Europian, në kuadër të instrumenentit të parazgjerimit (IPA), komponenti I, Asistenca e tranzicionit dhe forcimi institucional"[163];
- Akte normativë të miratuara nga Ministri i Financave, për rregullimin e funksionimit të inspektimit financiar publik;
- Urdhër nr. 36, datë 16.05.2011 "Për kriteret e përzgjedhjes së inspektorëve financiarë publikë"[164];
  Udhëzimi nr. 11, datë 16.05.2011 "Për kriteret për fillimin e inspektimit financiar publik"[165],
- Udhëzimi nr.17, datë 25.07.2011 "Për përmbushjen e inspektimit financiar publik dhe kontrollin e cilësisë";[166]

Strukturat institucionale

[159] Fletore Zyrtare Nr.112, datë 21.07.2008.
[160] Fletore Zyrtare Nr.97, datë 26.07.2010
[161] Fletore Zyrtare Nr.97, datë 26.07.2010.
[162] Fletore Zyrtare Nr.114, datë 17.08.2011.
[163] Fletore Zyrtare Nr. 176, dhjetor 2011.
[164] Nuk është botuar në gazetë zyrtare
[165] Fletore Zyrtare Nr.122, datë 26.08.2011
[166] Fletore Zyrtare Nr.122, datë 26.08.2011.

Autoritetet përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e ligjit nr.10294, datë 01.07.2010 "Për inspektimin financiar publik", janë:

Ministri i Financave, autoriteti përgjegjës për rregullimin e funksionimit të centralizuar të inspektimit financiar publik dhe përzgjedhjen e inspektorëve financiarë publikë; vendimarrjen përfundimtare për vlerësimin e raporteve të inspektorëve financiarë dhe mendimit nga Nëpunësi i parë autorizues;
Nëpunësi i Parë Autorizues, autoriteti përgjegjës për fillimin e inspektimit financiar publik, ka të drejtë të inspektojë, në çdo kohë, çdo dokument e sistem financiar të njësive publike, objekt inspektimi. Në përmbushje të këtyre detyrave, mbështetet nga Drejtoria e Inspektimit Financiar;
Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, funksionon si strukturë në Ministrinë e Financave. Objekti ligjor e funksional është shqyrtimi i sinjalizimeve të ardhura dhe dhënia e mendimit pranë Nëpunësit të parë autorizues, mbikëqyrja e përmbushjes së veprimtarisë së inspektimit dhe ushtron kontrollin e cilësisë; koordinimi i shërbimit kundër mashtrimit dhe korrupsionit për fondet e Bashkimit Europian dhe shërben si pikë kontakti e Zyrës Europiane kundër Mashtrimit;
Inspektorët financiarë publikë ad-hoc, punonjës të administratës publike, të përzgjedhur nga Ministri i Financave;
Njësitë ose individët, subjekte inspektimi, janë të detyruar të bashkëpunojnë dhe të mos pengojnë inspektorët financiarë në procesin e ekzekutimit të detyrave të tyre.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Synohet monitorimi i zbatimit te ligjshmërisë dhe procedurave të miratuara në kryerjen e misioneve të inspektimit financiar;
- Plotësimi i organikës së miratuar të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik me dy punonjës;
- Trajnimi i punonjësve të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik, veçanërisht zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve për të siguruar mbrojtje efikase të interesave financiare të BE-së;
- Trajnimi i inspektorëve financiarë publikë ad-hoc, të zgjedhur nga administrata publike;

Masat legjislative afatmesme

- Rishikimi i bazës ligjore në fuqi, në përafrim me praktikat më të mira të Bashkimit Europian, përkatësisht:
  1. Ligji nr. 10294, datë 01.07.2010 "Për inspektimin financiar publik";
  2. Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 17, datë 25.07.2011 "Për përmbushjen e inspektimit financiar publik dhe kontrollin e cilësisë".
- Kompletimi i bazes ligjore me hartimin e manualit te inspektimit financiar publik.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Trajnimi i punonjësve të Drejtorisë së Inspektimit Financiar, veçanërisht për zhvillimin e kapaciteteve, për të siguruar mbrojtje efikase të interesave financiare të BE-së;

- Trajnimi i inspektorëve financiarë publikë ad-hoc, të zgjedhur nga administrata publike;
- Masat zbatuese do të realizohen nga Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, në bashkëpunim me asistencën e huaj teknike, në kuadër të Projektit IPA 2012, në vlerën e negociuar 500000 euro.

Efektet financiare

Në Lekë

Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**
Kosto gjithsej	**3,7**	**70**	**0**	**0**
Të mbuluara nga buxheti	3,7	0	0	0
Të mbuluara nga asistenca e huaj (IPA 2012)	0	70	0	0
Të pambuluara	0	0	0	0

Bazuar në pikën 3 "Mbrojtja e interesave financiare të Bashkimit Europian", planin e veprimit për Kapitullin 32, Drejtoria e Inspektimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Autoriteti i Auditimit të Asistencës Financiare të Bashkimit Europian, Njësia e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit si edhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, do të përfshihen në punën e rrjetit AFCOS (Struktura koordinuese kunder mashtrimit).

3.32.5. MBROJTJA E MONEDHAVE DHE KARTËMONEDHAVE NGA FALSIFIKIMI

Objektivi strategjik

Në kuadër të objektivave strategjik në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të kartëmonedhave dhe monedhave false, si dhe mbrojtjes së tyre nga falsifikimi, Departamenti i Emisionit pranë Bankës së Shqipërisë synon:

- Zëvendësimin e të gjitha kartëmonedhave të emisioneve të vjetra (përpara vitit 1996) me kartëmonedha të reja të emisioneve të mëvonshme;
- Zhvillimin e një programi i cili të sigurojë një informacion sa më të saktë mbi cilësinë e kartëmonedhës në qarkullim dhe të mundësojë zëvendësimin e emisioneve të para vitit 1996;
- Rritjen e besimit të publikut te kartëmonedha shqiptare me anë të programeve të veçanta për njohjen me elementet e sigurisë;
- Plotësimin e bazës ligjore që rregullon të gjithë aktivitetin e parasë cash në Republikën e Shqipërisë, duke konverguar drejt legjislacionit të Bankës Qendrore Evropiane. Përditësimi i kuadrit ligjor lidhur me riciklimin e kartëmonedhave shqiptare dhe me klasifikimin e tyre;
- Përmirësimin e efektivitetit në procesimin e kartëmonedhave.

Situata aktuale

Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive dhe është emetuesi i vetëm i kartëmonedhës dhe monedhës kombëtare që ka kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Në bazë të ligjit për Bankën e Shqipërisë, ajo është autoriteti përgjegjës për sekuestrimin dhe konfiskimin e kartëmonedhave dhe monedhave false.

Gjatë vitit 2011, me Vendimin nr. 57, datë 27.07.2011 të Këshillit Mbikëqyrës "Për disa ndryshime në strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë", pranë Departamentit të Emisionit është ngritur Zyra e Qendrës Kombëtare të Analizës. Kjo strukturë është përgjegjëse për mbledhjen dhe analizën e kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara, raportimin e elementëve kryesorë të falsifikimit të kryer, përpilimi i informacionit statistikor dhe teknik mbi kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara si dhe bashkëpunimi me autoritetet shqiptare dhe të huaja në lidhje me raportimin e informacionit teknik të përpiluar. Zyra e qendrës Kombëtare të Analizës përbëhet nga 3 punonjës prej të cilëve 1 në funksionin e përgjegjësit të sektorit dhe 2 specialistë.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

- Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 "Për miratimin e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Ligji përafron pjesërisht Vendimin Kuadër të Këshillit të Bashkimit Evropian nr. 29, datë 29.05.2000, mbi "Rritjen e mbrojtjes me anë të penaliteteve kriminale dhe sanksioneve të tjera kundër falsifikimit në kuadër të futjes së euros"[167].
- Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"[168] i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 28, datë 30.03.1998 për miratimin e Udhëzimit "Për njohjen e autenticitetit të monedhave kombëtare në qarkullim e për qëndrimin ndaj monedhave që konstatohen të jenë të falsifikuara";
- Udhëzimi i Bankës së Shqipërisë "Për njohjen e autenticitetit të monedhave kombëtare në qarkullim e për qëndrimin ndaj monedhave që konstatohen të jenë të falsifikuara"; Udhëzimi synon te përafrojë pjesërisht Rregulloren e Këshillit të BE-së nr. 1338/2001, datë 28.06.2011 mbi "Masat e nevojshme për mbrojtjen kundër falsifikimit të euros"[169] dhe Vendimin e Këshillit të BE-së nr. 2001/887/JHA, datë 06.12.2001 mbi "Mbrojtjen kundër falsifikimit të euros"[170].

Struktura institucionale

Gjatë vitit 2011, me Vendimin nr. 57, datë 27.07.2011 të Këshillit Mbikëqyrës, pranë Departamentit të Emisionit është ngritur Zyra e Qendrës Kombëtare të Analizës. Kjo strukturë është përgjegjëse për mbledhjen dhe analizën e kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara, raportimin e elementëve kryesorë të falsifikimit të kryer, përpilimi i informacionit statistikor dhe teknik mbi kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara si dhe

[167] CELEX 32000F0383; OJL 140 datë 14.06.2000, faqe 1-3
[168] Fletore Zyrtare nr.20, datë 07.01.1998, faqe 479
[169] CELEX: 32001R1338 OJL 181 datë 04.07.2001 faqe 6-10
[170] CELEX: .32001D0887 OJL 329, datë 14.12.2001, faqe 1-2

bashkëpunimi me autoritetet shqiptare dhe të huaja në lidhje me raportimin e informacionit teknik të përpiluar.

Masa legjislative afatshkurtra

Aktivitete zbatuese

- Plotësimi me punonjës të rinj i Zyrës së Qendrës Kombëtare të Analizës;
- Ngritja pranë Zyrës së Qendrës Kombëtare të Analizës të laboratorit për analizimin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike të dyshuara si të falsifikuara;
- Trajnimi në vazhdimësi i punonjësve të zyrës për mbrojtjen nga falsifikimi.
- Vizite pune me qëllim trajnimin e punonjësve në lidhje me mbledhjen dhe analizimin e mostrave të kartëmonedhave të dyshuara si të falsifikuara, mënyrën e tërheqjes dhe administrimit të tyre si dhe përgatitjen e raporteve mbi kartëmonedhat e falsifikuara të zbuluara, formatin e përgatitjes së tyre dhe niveli i raportimit.

Aktivitete zbatuese afatmesme

- Miratimi i ndryshimeve të ligjit për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me sanksionet e parashikuara në rast të falsifikimit të kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare.

3.33. DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE

Objektivi strategjik

Objektivi kryesor i këtij kapitulli është sigurimi i përafrimit të parimeve bazë dhe funksionimit efikas të institucioneve përkatëse mbi llogaritjen e saktë, parashikimin, mbledhjen, pagimin, kontrollin e burimeve vetjake tradicionale, burimeve të TVSH-së dhe burimet AKB (të ardhurat kombëtare bruto).

Situata aktuale

Analiza e situatës aktuale

Me anëtarësimin në Bashkimin Europian, Shqipëria duhet të kontribuoje në buxhetin e Bashkimit Europian. Burimet financiare për këtë kontribut përbëhen kryesisht nga:

- burimet tradicionale që rrjedhin kryesisht nga taksat doganore dhe taksat e sheqerit;
- burimet me bazë TVSH-në, dhe;
- burimet me bazë nivelin e të ardhurave kombëtare bruto (AKB).

Ky kapitull përfshin tërësinë e rregullave lidhur me burimet financiare, me të cilat Shqipëria do të kontribuojë në buxhetin e Bashkimit Europian. Ashtu sikurse konstatuar edhe nga Komisioni Europian ne Raportin Analitik 2010 dhe Progres Raportin e vitit 2011, në Shqipëri ekzistojnë parimet dhe institucionet bazë për fushat kryesore të politikave që ndikojnë në sistemin e burimeve të veta. Është në funksionim një sistem kombëtar i TVSH-së, taksat doganore janë vendosur për importet, dhe llogaritë kombëtare dhe vlerësimet e PBB-së bazohen në standardet ESA95. Instituti i Statistikave ka krijuar një version zyrtar të Ardhurave Kombëtare Bruto (AKB). Në Raportin Analitik që shoqëron Opinionin e Komisionit Europian mbi aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian, theksohet se "*nuk ka divergjenca domethënëse ndërmjet sistemit shqiptar dhe sistemit të BE-së për sa i përket parimeve bazë dhe institucioneve në fushat përkatëse që ndikojnë në zbatimin e saktë të rregullave për burimet vetjake*". Megjithatë, me qëllim që të strukturohen dhe drejtohen përgatitjet e para-anëtarësimit në fushën e burimeve vetjake, është e nevojshme ngritja e një organi koordinues.

Në fushën e *programimit buxhetor*, qeveria shqiptare synon të përmirësojë procesin e programimit afatmesëm dhe harmonizimin e plotë të tij me dokumentet strategjikë, nën konceptet bazë të Sistemit të Planifikimit të Integruar. Kjo reformë synon shpërndarjen strategjike të burimeve në përputhje me objektivat dhe politikat e qeverisë, përmirësimin e lidhjes së objektivave afatmesme me ato të buxhetit vjetor si dhe buxhetimin në bazë programesh dhe performance.

Veprimtaria e buxhetimit në Shqipëri rregullohet nëpërmjet ligjit nr. 9936, date 26.06.2008 "Për Manaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i cili ka si objekt kryesor përcaktimin e procedurave për buxhetimin si dhe evidentimin e rolit të Institucioneve në kuadër të procesit të buxhetimit. Ligji organik i buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për

Manaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" është hartuar në përputhje me praktikat me te mira lidhur me menaxhimin e sistemeve buxhetore. Në zbatim të ketij ligji, duke filluar prej vitit 2010 procesi i planifikimit të buxhetit afatmesëm (PBA) eshte zbatuar në të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre. Objektivi kryesor i ligjit të mësiperm është përmirësimi i procedurave të buxhetimit nëpërmjet forcimit të lidhjes mes politikave dhe buxhetit si dhe rritjen e efiçences dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve buxhetore.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Aktet ligjore/ nënligjore në këtë kapitull janë:

- Ligj nr.7928, datë 27.04.1995, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar[171]. Ligji përafron pjesërisht Direktivën 2006/112/KE datë 28 .11.2006 mbi sistemin e përbashkët të TVSH-së, e konsoliduar ;
- Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar me ligjin nr. 10364, datë 16.12.2010[172];
- "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", miratuar me Ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999, i ndryshuar, [173] . Ligji përafron pjesërisht Rregulloren e Këshillit 2913/92/EEC "Për Kodin Doganor Komunitar";
- Ligji nr. 9461, datë 21.12.2005, "Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore", i ndryshuar [174] . Ligji përafron plotësisht Rregulloren e Këshillit 2658/87/EEC, datë 23 korrik 1987 "Për tarifën dhe nomenklaturën statistikore dhe për tarifat e përbashkëta doganore";
- Ligji nr. 9981, datë 08.09.2008, "Për Miratimin e Niveleve të Tarifës Doganore", i ndryshuar,[175] Ligji përafron pjesërisht Rregulloren e BE 948/2009/EC "Mbi tarifat dhe nomeklaturën statistikore dhe tarifat e përbashkëta doganore;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për Manaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"[176];
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999, "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor", i ndryshuar[177], i cili përafron pjesërisht Rregulloren e Këshillit 2454/1993/EEC "Për përcaktimin e dispozitave për zbatimin e Rregullores se Keshillit (EEC) Nr 2913/92 per themelimin e Kodit Doganor te Komunitetit" ;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 167, datë 29.2.2012 "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, 2013-2015[178]
- Udhëzim nr.8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm";
- Udhëzim nr.2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"[179].

[171] Fletore Zyrtare nr. 12 datë 16.06.1994, faqe 469, shpallur me dekretin nr. 1096 datë 12.05.1995
[172] Fletore Zyrtare Nr. 179, dhjetor 2010.
[173] Fletore Zyrtare Nr 4, dt 19.02.1999
[174] Fletore Zyrtare Nr. 105, Janar 2006.
[175] Fletore Zyrtare Nr. 144, date 22 Shtator 2008
[176] Fletore Zyrtare nr. 112, fq 4933
[177] Fletore Zyrtare Nr. Extra 2004
[178] Flet.Zyrtare Nr.35, Faqe:1666
[179] Fletore Zyrtare nr. 15 date 08/03/2012

Në zbatim të Ligjit nr.9461, datë 21.12.2005 "Për Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave dhe Tarifën Doganore" me Vendim të Këshillit të Ministrave miratohet çdo vit, duke filluar nga viti 2009, Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave e njëjtë me vendet e Bashkimit Europian. Ajo bëhet publike në faqen e internetit www.dogana.gov.al dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Struktura institucionale

Institucionet e përfshira në sigurimin e përafrimit të parimeve bazë, dhe funksionimit efikas të strukturave përkatëse mbi llogaritjen e saktë, parashikimin, mbledhjen, pagimin, kontrollin e burimeve vetjake tradicionale, burimeve të TVSH-së dhe burimet AKB, janë Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Instituti i Statistikave.

Funksionet politikëbërëse realizohen nga Ministria e Financave, dhe nën varësinë dhe mbikqyrjen e saj operojnë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të ngarkuara me përgjegjësinë e administrimit të të ardhurave tatimore dhe doganore.

Ministria e Financave, në kuadër të këtij kapitulli është përgjegjëse për hartimin e politikave fiskale dhe planifikimin buxhetor.

- *Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Fiskale* (DPPMF) është përgjegjëse për hartimin dhe analizën e politikave makroekonomike dhe fiskale në përputhje me programet e zhvillimit ekonomik të vendit. Më konkretisht, në varësi të DPPMF, Drejtoria e Politikave Fiskale, është struktura përgjegjëse për hartimin e politikave tatimore dhe kuadrit ligjor tatimor në vend, zhvillimin e një modeli të plotë fiskal, parashikimin e të ardhurave, përgatitjen e parashikimeve dhe analizave të situatës fiskale të qeverisë.

- *Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit* ka rolin kryesor në menaxhimin e proçesit të hartimit dhe ndjekjes së zbatimit të Buxhetit të Shtetit. Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e buxhetimit është nën përgjegjësinë e:
  - Sekretarit të përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për financat si nëpunësi i parë autorizues për buxhetin e njësive të qeverisjes qëndrore, për fondet speciale të qeverisjes qëndrore dhe transfertat e njësive të qeverisjes vendore. Nëpunësi i parë autorizues përgjigjet te Ministri i Financave për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe kontrollin e brendshëm financiar publik, sipas ligjit nr.9936, date 26.06.2008 për "Manaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit të buxhetit vjetor dhe akteve nënligjore.
  - Nëpunësit autorizues në njësitë e qeverisjes qendrore si punonjësi i administratës publike i nivelit më të lartë të shërbimit civil. Për ministrinë përgjegjëse për financat, nëpunësi i parë autorizues emëron një punonjës të nivelit të lartë ose të mesëm të administratës publike si nëpunës autorizues. Në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që nuk janë pjesë e pushtetit ekzekutiv, nëpunësi autorizues është punonjësi i nivelit më të lartë menaxhues.

- Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave,
- Fondet speciale (ISKSH, ISSH, AKKP)

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është institucioni qëndror i taksave në Shqipëri, dhe është përgjegjëse për mbledhjen dhe administrimin e të gjitha tatimeve dhe taksave kombëtare, përfshirë edhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve së bashku me Drejtoritë Rajonale përbëjnë tërësinë e Administratës Tatimore Shqiptare, e cila është nën varësinë dhe mbikqyrjen e Ministrisë së Financave. Detyrat e DPT-së në kuadër të këtij kapitulli konsistojnë në maksimizimin e mbledhjes së të ardhurave tatimore dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndëtsore për tatimpaguesit, ofrimi i shërbimeve të një cilesie të lartë në mbeshetje të përmbushjes vullnetare të detyrime ligjore tatimore, minimizimi i kostove të mbledhjes së të ardhurave tatimore pa rrezikuar efektivitetitn e mbledhjes, duke ofruar shërbimet e nevojshme për tatimpaguesit, si dhe ngritja e kapaciteteve administrative. Në këtë kuadër, DPT ka përmirësuar sistemin e llogaritjes dhe mbledhjes së të ardhurave tatimore, është vendosur sistemi kompjuterik i nevojshëm për deklarimin dhe pagesën elektronike të tatimeve nga bizneset si dhe ka zbatuar me forcë ligjin duke luftuar ekonominë informale dhe evazionin, në mbrojtje të të ardhurave fiskale.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është përgjegjëse për mbledhjen dhe administrimin e të taksave doganore. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave së bashku me Drejtoritë Rajonale dhe Degët Doganore përbëjnë tërësinë e Administratës Doganore Shqiptare, e cila është nën varësinë dhe mbikqyrjen e Ministrisë së Financave. Detyrat e DPD-së në kuadër të këtij kapitulli janë të specifikuara në misionin fiskal dhe ekonomik të këtij institucioni dhe më specifikisht, mbledhja e taksave doganore dhe mbrojtja dhe zhvillimi i ekonomisë së vendit. Krahas taksës doganore, autoritetet doganore mbledhin edhe disa taksa te tjera ne import, me cilësinë e agjentit tatimor. Në mënyrë më të detajuar çështjet e doganës janë përshkruar në Kapitullin 3.29 DOGANA.
Instituti i Statistikave, në kuadër të këtij kapitulli është përgjegjës për llogaritjen dhe publikimin e të ardhurave kombëtare bruto, sipas standarteve ESA 95. Me këtë detyrë është ngarkuar Drejtoria e Llogarive Kombëtare, pranë INSTAT, dhe në përbërjen e saj "Sektori i Llogarive kombëtare të sektorëve institucionalë".

Masat legjislative afatshkurtra

- Hartimi dhe miratimi i projektligjit të Buxhetit vjetor për vitin 2013. Për këtë projektligj institucioni përgjegjës për përgatitjen dhe për dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave dhe më pas në Kuvend është Ministria e Financave. Ky projektakt parashikohet të përgatitet dhe të miratohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2012;
- Hartimi dhe miratimi i projektvendimit të Këshillit të Ministrave "Për numrin e punonjësve me kontratë të përkohëshme të institucioneve buxhetore për vitin 2012". Ky projektakt përgatitet dhe miratohet për të bërë të mundur përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkoheshme për çdo ministri dhe institucion buxhetor. Miratimi i këtij projektakti parashikohet gjatë vitit 2012;
- Hartimi dhe miratimi i projektvendimit "Per miratimin e dokumentit të Programit

Buxhetor Afatmesëm 2013-2015". Ky projektakt parashikohet te miratohet ne tremujorin e katërt te vitit 2012;

- Hartimi dhe miratimi i Udhëzimit vjetor, në kuadër të PBA 2013-2015. Ky udhëzim do të përmbajë kryesisht tavanet përgatitore për përgattijen e PBA 2013-2015 për institucionet e qeverisjes qendrore, si dhe afatet dhe datat e përgatitjes së tyre dhe të kryerjes së negociatave ndërinstitucionale në kuadër të përgatitjes së PBA 2013-2015;
- Hartimi dhe miratimi i Udhëzimit vjetor plotesues, në kuadër të PBA 2013-2015. Ky udhezim do të përmbajë tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe rregullat për rishikimin e kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, në bazë të tavaneve përfundimtare të shpenzimeve. Përgatitja dhe miratimi i ketij udhezimi parashikohet të realizohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- Ngritja dhe funksionimi i Grupit të Punës për Menaxhimin e procesit të PBA-së si dhe ngritja e Grupit për Menaxhim dhe Strategji (GMS);
- Ngritja dhe funksionimi i Grupeve të analizës në funksion të PBA-së me specialistë të Drejtorisë së Buxhetit, Ministrisë së Integrimit, Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj.

Masat legjislative afatmesme

- Hartimi dhe miratimi i projektligjit të Buxhetit Vjetor për vitin 2014;
- Hartimi dhe miratimi i projektligjit të Buxhetit Vjetor për vitin 2015;
- Hartimi dhe miratimi i projektligjit të Buxhetit Vjetor për vitin 2016.

Aktivitetet zbatuese afatmesme

- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë";
- Përgatitja e PBA-së 2014-2016;
- Përgatitja e PBA-së 2015-2017;
- Përgatitja e PBA-së 2016-2018.

DOGANA

Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim –Asociimit konkretisht nenet 14, 15, 34, 43 dhe 97.
Objektivat strategjike në fushën doganore janë ruajtja e interesave financiare dhe ekonomike të Shqipërisë, kontribuimi në mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe rendit publik, mbrojtjen e shëndetit publik, konsumatorëve, pasurisë kulturore kombëtare dhe ambjentit. Për më tepër informacion në lidhje me zhvillimet dhe iniciativat afatshkurtër dhe afatmesme, konsultoni Kapitullin 29 "Dogana".

TATIMET

Në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar, janë bërë ndërhyrje të rëndësishme me synimin e përmirësimit të procedurave, lehtësimit të pagesave dhe rritjen e dispozitivit penalizues për evazoret dhe fshehësit e taksave. Per me teper informacion ne lidhje me tatimet indirekte (TVSH), konsultoni Kapitullin 16 "Tatimet".

INSTAT

INSTAT përgatit dhe publikon Llogaritë Kombëtare Vjetore bazuar në Sistemin e Llogarive Evropiane (European System of Accounts (ESA95)), si version evropian i Sistemit botëror të Llogarive Kombëtare të Kombeve të Bashkuara (1993 SNA). Pas një bashkëpunimi midis INSTAT dhe Bankës të Shqipërisë, u arrit të llogaritet për herë të parë treguesi i tëAKB-së, i cili u publikua për herë të parë në vitin 2011 me të dhëna që nga viti 1996 e në vazhdim. Tabela e kalimit nga të dhënat PBB me çmimet e tregut në treguesin e AKB është botuar në faqen e ëebsite të INSTAT www.instat.gov.al.
Të dhënat për të ardhurat neto nga pagat dhe pronat, kanë si burim informacioni, rubrikat përkatëse të Bilancit të Pagesave, hartuar nga Banka e Shqipërisë.
E Ardhura Kombëtare Bruto është shuma e Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (PBB) vlerësuar me çmimet e tregut nga të gjithë prodhuesit rezidentë plus të ardhurat nga pagat neto të të punësuarve jashtë vendit plus të ardhurat neto nga prona nga jashtë vendit. AKB për frymë është e Ardhura Kombëtare Bruto pjestuar me popullsinë mesatare vjetore.
Përgjegjësia e përgatitjes të Llogarive Kombëtare në INSTAT, është e lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Llogarive Kombëtare, ku përgjegjës për përgatitjen e AKB është sektori i llogarive kombëtare të sektorëve institucionalë, gjithsej 3 persona, me eksperiencë në Llogaritë Kombëtare.
Eurostat, nëpërmjet "Monitorimi i burimeve të veta" analizon krahasueshmërinë, besueshmërinë dhe gjithpërfshirjen e të dhënave të të ardhurave kombëtare bruto (GNI) të shteteve anëtare të përdorura për qëllime të burimeve të veta të BE-së, siç parashikohet në Rregulloren e Këshillit 1287/2003. Kjo do të thotë se të dhënat e Llogarive Kombëtare të përdorura për qëllime buxhetore do të shqyrtohen dhe të përmirësohen më tej në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje, bazuar në inventaret e burimeve statistikore dhe metodat për hartimin e GNI, dhe procesit të transmetimit të tabelave nga Shtetet Anëtare. Eurostat do të kryejë verifikimin më të drejtpërdrejtë të të dhënave në Shtetet Anëtare sipas pyetësorëve vjetore GNI.
Me anëtarësimin e Shqipërisë në BE, cilësia e të dhënave të llogarive kombëtare të hartuara, që do të përdoret për qëllime buxhetore duhet të verifikohet dhe të përmirësohet më tej sipas mënyrave të përcaktuara nga Eurostat.
Për këtë qëllim, INSTAT, Drejtoria e Llogarive Kombëtare, ka përgatitur dhe transmetuar në Eurostat, në nëntor të vitit 2009, dokumentin e titulluar "Përshkrimi i burimeve dhe metodave të përdorura për GNI". Ky dokument, i vlerësuar dhe pranuar nga ana e EUROSTAT, është rezultat i projektit të financuar nga Bashkimi Evropian 'IPA-2007 Multi-beneficiary Statistical Cooperation Programme, Project 5 National Accounts".

Masat legjislative afatshkurtra

- Projekt Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare për periudhën 2012-2016.

Aktivitetet zbatuese afatshkurtra

- INSTAT do të kryejë në vazhdimësi përditësimin e dokumentit "Përshkrimi i burimeve dhe metodave të përdorura për GNI"

Efektet financiare

Shpenzimet e përgjithshme për nënkapitullin 3.33 "Dispozitat Financiare dhe Buxhetore"

Në Lekë

	2012	**2013**	**2014**	**2015**
Kostot totale e vlerësuar	511.162.000	0	**0**	**0**
Mbulohen nga buxheti i	196.404.000	0	0	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	314.758.000	0	0	0
Ndryshim	000	0	0	0

4. PËRGATITJA E VERSIONIT KOMBËTAR TË LEGJISLACIONIT EUROPIAN

Një shtet që paraqet një kërkesë për anëtarësim në Bashkimin Europian duhet të jetë i përgatitur të pranojë legjislacionin evropian në tërësi dhe t'i kushtojë rëndësi të njëjtë gatishmërisë për zbatimin e tij. Politikisht, ky është rregulli kyç i cili është i panegociueshëm dhe një nga kushtet paraprake të pranimit. Duke marrë parasysh se nenet e asociimit janë të ndryshme nga marrëveshjet ndërkombëtare tradicionale dhe marrëveshjet e lidhura nga shtetet anëtare, ku dispozitat e tyre i japin të drejta dhe detyrime jo vetëm shteteve, por edhe qytetarëve dhe subjekteve ekonomike të tyre, njohuria mbi rregulloret është pika kyçe në respektimin dhe ushtrimin e veçantë të të drejtave, të cilat mund të sigurohen vetëm nëse rregulloret janë të disponueshme në gjuhën zyrtare të shtetit anëtar.

Për shkak të volumit të rregulloreve të BE-së, të publikuara në Gazetën Zyrtare të BE-së (afërsisht 115.000 faqe nga Gazeta Zyrtare, të cilave i korrespondojnë 150.000 faqe në format standard, me një shtesë mesatare vjetore prej 3.000 deri në 5.000 faqe), përgatitja e versionit kombëtar të legjislacionit evropian paraqitet si sipërmarrja më e madhe e përkthimit në historinë e shumicës së anëtarëve të rinj. Por sfida nuk kufizohet vetëm tek numri i stërmadh i faqeve për përkthim dhe rishikim, por edhe tek kompleksiteti i procesit në përgjithësi, angazhimi i ekspertëve të fushave të ndryshme, niveli i njohurive dhe aftësive profesionale dhe bashkëpunimi ndërdisiplinor i nevojshëm. Në mënyrë që projekti i përgatitjes së versionit kombëtar të legjislacionit europian të realizohet me cilësi të lartë, nga një këndvështrim gjuhësor, teknik dhe ligjor, është e detyrueshme që ky proces të përbëhet nga katër elementë përbërës teknik të fushës, të cilët janë: përkthimi, rishikimi teknik, rishikimi ligjor dhe redaktimi. Shpërndarja e punës ndërmjet ekspertëve të fushave të ndryshme duhet të organizohet në një mënyrë të tillë që përkthimi të kryhet nga përkthyesit, rishikimi teknik nga ekspertët e ministrive të linjës dhe rishikimi ligjor nga juristët përgjegjës për çështjet ligjore sistematike në fusha specifike.

Meqenëse puna për një projekt të tillë, si versioni i praktikës ligjore të Bashkimit Europian (legjislacioni europain), është një përvojë e re për ekspertët e fushave të ndryshme, vëmendje të veçantë i duhet dhënë trajnimit të ekspertëve, që nënkupton modernizimin e programeve shkollore dhe studimore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nga aspekti i detyrimeve të një vendi të caktuar, në mënyrë që të zotërohet një numër i mjaftueshëm përkthyesish dhe interpretuesish, juristësh, linguistësh, terminologësh dhe redaktuesish të formuar, të cilët do të punësohen në institucione të BE-së, pas aderimit në BE.

Situata aktuale

Kuadri normativ

Dokumenti themelor në marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian dhe Shteteve Anëtare është Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), miratuar me Ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e Shteteve të tyre Anëtare”. Kjo

Marrëveshje, është pjesë e sistemit tonë juridik[180] dhe ka superioritet ndaj kuadrin tonë ligjor[181]. Në nenin 70 të MSA-së parashikohet se: p*ërafrimi i legjislacionit do të fillojë ditën e nënshkrimit të Marrëveshjes dhe do të vazhdojë në mënyrë graduale me të gjitha elementet e legjislacionit europian deri në fund të periudhës kalimtare të përcaktuar në nenin 6 të Marrëveshjes*[182]. Në zbatim të këtij detyrimi, të gjitha aktet e Legjislacionit Europian të parashikuara për t'u përafruar në legjislacionin tonë të brendshëm, do të përkthehen, duke i paraprirë përafrimit të tyre.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja dhe dokumenteve të tjera strategjikë, si Raporti Vjetor i Komisionit Europian, Dokumenti i Partneritetit Europian etj., Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 1317, datë 1.10.2008 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit". Ky plan është hartuar nga Ministria e Integrimit në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore. Ky dokument rishikohet çdo vit, në përputhje me rekomandimet e Raportin Vjetor të Komisionit Europian dhe Partneritetit Europian. Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, përbën dokumentin bazë mbi të cilin hartohet kalendari vjetor i përkthimit. Në plan janë parashikuar sipas fushave aktet ligjore europiane me të cilat do të përafrohet legjislacioni shqiptar si dhe afatet kohore brenda të cilit duhet të realizohet ky përafrim.

Akti nënligjor, i cili lidhet drejtpërdrejt me procesin e përgatitjes së versionit shqip të legjislacionit europian dhe i përkthimit të legjislacionit shqip në një nga gjuhët e BE-së është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 7.04.2009 "Për përcaktimin e procedurave të përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Europian në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Europian". Vendimi përcakton Ministrinë e Integrimit si institucionin përgjegjës për përgatitjen e versionit shqip të legjislacionit europian dhe përkthimin e legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e BE-së. Në këtë vendim janë parashikuar procedurat që do të ndiqen për këtë proces si dhe strukturat përkatëse që do të ngrihen për administrimin e tij.

Administrimi i procesit të përkthimit dhe miratimit të akteve ligjore të Bashkimit Europian do të kryhet sipas dispozitave të përcaktuara në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar. Për shkak të veçorive që ka ky proces, do t'i kushtohet përparësi cilësisë krahasuar me kohën apo çmimin. Për këtë, Ministria e Integrimit ka nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të ligjit të mësipërm si më poshtë.

Udhëzim nr. 1, datë 14.05.2009, "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm për përkthimin e legjislacionit të Bashkimit Europian në gjuhën shqipe dhe të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët zyrtare të BE-së".

---

[180] Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

[181] Nenin 122 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë cilëson se: "Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesën e sistemit të brendshëm juridik...". si dhe " Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të".

[182] Asociimi zbatohet në mënyrë progresive dhe do të realizohet plotësisht përgjatë një periudhe transitore që mund të shkojë deri në dhjetë vjet, e ndarë në dy faza të njëpasnjëshme.

Udhëzim nr. 2 datë 14.05.2009, **"**Për funksionimin e Komisionit të Posaçëm për miratimin e materialeve të përkthyera të legjislacionit të Bashkimit Europian në gjuhën shqipe". Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për ngritjen dhe funksionimin e Komisioneve të Posaçme, të cilët do të vlerësojnë dhe miratojnë përkthimin në gjuhën shqipe të legjislacionit europian. Komisioni i Posaçëm është komision me karakter *ad hoc* i cili ngrihet me urdhër të Ministrit të Integrimit, bazuar në pikën 5 të VKM-së nr. 119, datë 07.03.2007 "Për përcaktimin e procedurave të përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Europian në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Europian".

Udhëzim nr. 3 datë 6.07.2009, për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 1 datë 14.05.2009, "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm për përkthimin e legjislacionit të Bashkimit Europian në gjuhën shqipe dhe të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët zyrtare të BE-së". Krijimi i versionit kombëtar të legjislacionit europian në gjuhën kombëtare është një nga kushtet që duhet të plotësohen nga shteti kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian. Plotësimi i këtij kushti do të kërkojë përkthimin dhe rishikimin e rreth 115.000 faqeve të legjislacionit europian përpara datës së anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Për këtë arsye Drejtoria e Përkthimit të Legjislacionit pranë Ministrisë së Integrimit ka përgatitur të gjithë bazën ligjore për organizimin e këtij procesi. Po ashtu, në funksion të procesit të përkthimit, është vënë në përdorim programi i specializuar i përkthimit *Trados*, përdorimi i të cilit do të garantojë cilësinë e mirë gjatë përkthimit dhe do të ulë koston e këtij procesi.

Në ndihmë të punonjësve të administratës publike që merren me përafrimin e legjislacionit, përkthyesve, studiuesve dhe publikut të gjerë, është krijuar, vënë në përdorim dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme *Alterm*, një fjalor elektronik *on-line*, i cili përmban për momentin 18.3016 terma të legjislacionit europian të përkthyera në gjuhën shqipe.

Në periudhën 2008-2011 janë trajnuar 35 përkthyes në teknikat e përkthimit dhe përdorimin e programeve të specializuara të përkthimit.

Baza ligjore dhe përafrimi i legjislacionit

Deri në fund të vitit 2008, ky proces rregullohej nga Udhëzimi nr. 3165, datë 12.05.2004 i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët", i ndryshuar. Kështu çdo institucion përkthente, në bazë të nevojave kryesisht të lidhura me procesin e përafrimit të legjislacionit. Përkthimi kryhej kryesisht nga përkthyes të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë ose nga vetë punonjësit e institucioneve, ndërkohë që përkthimi certifikohej nga Ministria e Drejtësisë. Kjo ministri do të vazhdojë të kryejë certifikimin e përkthimit të marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të tjera.

Ndërsa Ministria e Integrimit Europian në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 7.04.2009 "Për përcaktimin e procedurave të përkthimit të legjislacionit të

Bashkimit Europian në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Europian", është institucioni përgjegjës për koordinimin e procesit të përkthimit të legjislacionit europian në gjuhën shqipe dhe përkthimit të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Europian.

Në këtë kuadër, në fund të vitit 2008, në Ministrinë e Integrimit është ngritur Drejtoria e Përkthimit të Legjislacionit Europian. Kjo drejtori është njësia e vetme përgjegjëse për administrimin e procesit të përkthimit të legjislacionit europian në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Drejtoria u krijua në fund të vitit 2008 dhe u plotësua me staf sipas strukturës së miratuar nga Këshilli i Ministrave, në fillim të vitit 2009. Drejtoria përbëhet nga dy sektorë:

(i) Sektori i Përkthimit, i cili është përgjegjës për administrimin e procedurave të përkthimit, komunikimin me të gjitha institucionet e përfshira në procesin e përafrimit si dhe përkthyesit që do të ndërmarrin përkthimin e akteve të përzgjedhura çdo vit. Sektori përbëhet nga një përgjegjës sektori dhe tre specialistë përkthyes.
(ii) Sektori i Rishikimit, i cili është përgjegjës për kontrollin e akteve të përkthyera dhe rishikuara, si dhe njehsimin e terminologjisë në fushat përkatëse. Ky sektor përbëhet nga një përgjegjës sektori dhe dy specialistë rishikues të gjuhës shqipe.

Administrimi i procesit të përkthimit dhe miratimit të akteve ligjore të Bashkimit Europian do të kryhet sipas dispozitave të përcaktuara në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar. Për shkak të veçorive që ka ky proces, do t'i kushtohet përparësi cilësisë krahasuar me kohën apo çmimin. Për këtë, Ministria e Integrimit ka nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të ligjit të mësipërm, si më poshtë:

Për rishikimin e cilësisë së përkthimit krijohen Komisione të Posaçme që kanë në përbërjen e tyre ekspertë të ministrive të linjës të fushës përkatëse dhe ekspertë të fushës nga institucionet arsimore dhe kërkimore shqiptare, në mënyrë që projekti i përgatitjes së versionit kombëtar të legjislacionit europian të realizohet me cilësi të lartë, nga një këndvështrim gjuhësor, teknik dhe ligjor, duke përfshirë katër elementët teknik të fushës: përkthimi, rishikimi teknik, rishikimi ligjor dhe redaktimi.

Status përgatitor i versionit kombëtar të legjislacionoit evropian

Për shkak se deri përpara miratimit të VKM-së nr. 119, datë 07.03.2007, procesi i përkthimit ka qenë i decentralizuar, ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore kanë përkthyer akte europiane, sipas nevojave të tyre për përafrimin e legjislacionit. Deri në muajin korrik 2012, DPL ka përkthyer dhe rishikuar gjithsej 2445 faqe të akteve të legjislacionit europian, nga këto 1200 faqe të përkthyera përmes fondit limit sipas kërkesave të ministrive të linjës dhe 1245 faqe të përkthyera nga institucione të tjera dhe organizmave të huaja, por të rishikuara nga DPL. Të gjitha aktet europiane të përkthyera/rishikuara deri më tani janë hedhur në CC-Vista.

Gjithashtu janë rishikuar 18360 terma në funksion të pasurimit të bazës së të dhënave terminologjike në web, e emërtuar *Alterm*. Kjo bazë të dhënash terminologjike në gjuhën shqipe do të shërbejë si mjet i rëndësishëm përkthimi. Qëllimi i saj është që të përgatisë një

terminologji të vetme për një sërë fushash, e cila do të shërbejë si burim i besueshëm si për përkthyesit, institucionet të cilat merren me harmonizimin e legjislacionit shqiptar dhe me atë europian, universitetet, organizatat, ashtu edhe për publikun e gjerë. Gjithashtu në botimet e kësaj drejtorie përfshihen fjalori "Për integrimin europian, institucionet dhe politikat e Bashkimit Europian, fjalori "Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit", versioni i konsoliduar "Traktatet të Bashkimit Europian" si dhe manuali "Për përkthimin e legjislacionit shqiptar në anglisht".

Një rol të rëndësishëm në procesin e përkthimit dhe të rishikimit të akteve ligjore luan dhe teknologjia e informacionit dhe e komunikimit në ndihmë të procesit të përkthimit të legjislacionit europian. Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit nëpërmjet sistemit kompjuterik është një mjet shumë i rëndësishëm që ndihmon dhe mbështet procesin e përkthimit të versionit kombëtar të legjislacionit europian dhe të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e BE-së. Ky sistem kompjuterik konsiston në sistemin kompjuterik *Trados*. Nëpërmjet këtij sistemi kompjuterik, menaxhohet gjithashtu dhe terminologjia, që nga krijimi i termave të reja e deri në miratimin e tyre, gjë e cila shërben në njehsimin e terminologjisë gjatë përkthimit të legjislacionit europian dhe të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e BE-së. Drejtoria e Përkthimit të Legjislacionit Europian ka ndërmarrë trajnimin e një numri të konsiderueshëm përkthyesish të jashtëm, 35 përkthyes, të cilët janë njohur me teknikat e përkthimit përmes sistemit *Trados***.**

Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve administrative, stafi i DPLE-së ka kryer disa trajnime me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm si Komisioni Europian TAIEX, GTZ, Olof Palme Center, IATE si dhe vizita studimore me vendet e rajonit. Kështu, në funksion të qëllimit për forcimin e kapaciteteve administrative, është zhvilluar workshop-i me temë "Përkthimi i legjislacionit europian në gjuhën shqipe". Qëllimi ishte diskutimi i politikave dhe bashkëpunimi në të ardhmen në fushën e përkthimit të legjislacionit europian në gjuhën shqipe me vendet e rajonit të cilat kanë gjuhë zyrtare shqipen. Dy eksperte të zyrës së përkthimeve kroate, vizituan Ministrinë e Integrimit. Qëllimi ishte ofrimi i eksperiencës kroate për procesin e përkthimit. Nga një eksperte sllovene, u realizua trajnimi i stafit dhe formulimi i një plani strategjik për përkthimin, duke u bazuar dhe në eksperiencat e mëparshme të vendeve të tjera të rajonit. Përfaqësues të Drejtorisë së Përkthimit të Legjislacionit Europian vizituan Drejtorinë e Përgjithshme të Përkthimit në Komisionin Europian. Qëllimi ishte njohja me punën dhe mënyrën e funksionimit të kësaj drejtorie si dhe të procesit të përkthimit të legjislacionit në përgjithësi. Në maj 2009 u zhvillua tryeza e rrumbullakët me temë "Përkthimi i legjislacionit europian – detyrim për anëtarësim në Bashkimin Europian". Qëllimi ishte informimi dhe përfshirja e aktorëve të mundshëm në procesin e përkthimit të legjislacionit. Në të morën pjesë përfaqësues nga ministritë e linjës, ambasadorë të vendeve të Bashkimit Europian të akredituar në Shqipëri, përkthyes, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare si dhe përfaqësues nga drejtoria përkatëse e Kosovës. Përfaqësues nga Drejtoria e Përkthimit të Legjislacionit Europian / MIE kryen një vizitë studimore pranë drejtorisë homologe, në Sekretariatin për Çështjet Europiane të Republikës së Maqedonisë. Pjesëtarët e drejtorisë u njohën me procedurat dhe programet e

specializuara kompjuterike që drejtoria homologe maqedonase përdor për mbarëvajtjen e procesit të përkthimit.

Sërish në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve administrative për procesin e përkthimit të legjislacionit europian u zhvillua në Luksemburg një vizitë studimore, e cila kishte si qëllim krijimin e një baze të terminologjisë së përkthimit dhe pasqyrimin e kësaj terminologjie në aplikimin e sistemeve kompjuterike.

Në takimet e ndryshme mbi shkëmbimin e eksperiencave, me Shtetet Anëtare të BE-së, siç ishte edhe vizita në Sekretariatin për Çështje Europiane në vitin 2010 në Slloveni, është trajtuar domosdoshmëria e rritjes së numrit të stafit brenda ministrisë, specifikisht për Drejtorinë e Përkthimit, pasi kjo do të mundësonte një koordinim më efikas me përkthyesit që do angazhohen në përkthimin e legjislacionit të Bashkimit Europian, por edhe do të garantojë një cilësi të kënaqshme të përkthimeve. Duhet theksuar fakti se procesi i përkthimit të legjislacionit europian nuk mbaron me përkthimin e akteve në gjuhën shqipe, por merr më tepër rëndësi në fazën e rishikimit dhe finalizimit, pasi këto akte të përkthyera do të jenë në një të ardhme drejtpërdrejt ndikuese në sistemin ligjor shqiptar.

Prioritetet afatshkurtra

Përgatitja e versionit kombëtar të legjislacionit europian është një proces i rëndësishëm, voluminoz dhe i gjatë, kështu që duhet trajtuar në një mënyrë të koordinuar, sistematike dhe të njëtrajtshme, në kushte të mira bashkëpunimi rajonal dhe nisma të përbashkëta, nëpërmjet projekteve nga fondet rajonale europiane.

Bashkëpunimi rajonal duhet, mbi të gjitha, të përfshijë vetëm përkthimin e rregulloreve dhe fazat e tjera duhet të bien nën juridiksionin e organeve të shteteve kandidate. Kështu, prioriteti kyç afatshkurtër i Shqipërisë është një marrëveshje mbi bashkëpunimin në nivel rajonal në këtë fushë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, të cilat ndajnë gjuhë dhe tradita ligjore të përbashkëta, kështu që projekti të zhvillohet në mënyrë të duhur, logjike, efikase dhe profesionale.

Në një periudhë të shkurtër, Shqipëria do të zhvillojë modelin e saj përgatitor të versionit kombëtar të legjislacionit europian duke filluar nga: nivelet e terminologjisë ligjore dhe teknike, prania e një numri të përshtatshëm përkthyesish dhe partnerësh në nivele të ndryshme rishikimi, prania e institucioneve profesionale për të bashkëpunuar dhe punuar mbi projektin, praktika dhe tradita administrative dhe gjuhësore, burime financiare dhe shumë faktorë të tjerë. Brenda këtij kuadri, kryesisht, do të përcaktohet modeli i përkthimit (i centralizuar, i decentralizuar ose i kombinuar), mbi të cilin do të varet numri fillestar i përkthyesve që do të caktohen. Krijimi i rrjetit të përkthyesve është shumë i rëndësishëm, duke qenë se përkthimi mund të zhvillohet në të gjitha nivelet, edhe jashtë administratës shtetërore.
Një vëmendje e konsiderueshme do t'i kushtohet mbështetjes IT të projektit në tërësi dhe, veçanërisht, përdorimit të ndihmës elektronike për përdorimin dhe arkivimin e kujtesave të përkthimit (translation memory).

Do të përpilohen bazat e terminologjisë dhe do të përgatiten dhe shtohen në bazat e terminologjisë fjalorë të fushave të ndryshme teknike, në mënyrë që të krijohen kushtet për përkthimin e njëtrajtshëm.

Duke punuar bashkërisht me organet përgjegjëse, Drejtoria e Përkthimit të Legjislacionit Europian do të parashtrojë shpenzimet financiare të llogaritura që nevojiten për këto qëllime si dhe burimet e tyre të financimit (buxheti i shtetit).

Prioritetet afatmesme

Gjatë kësaj periudhe DPLE do të angazhohet vazhdimisht në hartimin e bazës së të dhënave terminologjike të përkthimit, në mënyrë që të mundësohen kushte, si për efikasitet në punë ashtu dhe njëtrajtshmërinë e terminologjisë në procesin e përgatitjes së versionit kombëtar të legjislacionit europian dhe përdorimi i tyre në aderimin e Shqipërisë në BE.

Gjithashtu, është e nevojshme të krijohen në kohë kushtet sistematike për formimin e duhur të përkthyesve, juristëve, linguistëve, redaktorëve dhe terminologëve për të plotësuar nevojat e aderimit dhe anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Plani i punësimit i institucionit shtetëror (përfituesit nga buxheti):

Emri i institucionit	I planifikuar ekzistues	2007	numri i planifikuar i punonjësve				
			2011	2012	2013	2014	2015
Drejtoria e Përkthimit të Legjislacionit Europian	Ekzistues	8	7	8	12	15	18

Implikimet financiare

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 07.03.2007 "Për procedurat e përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe të përkthimit të legjislacionit shqiptar në një nga gjuhët e Bashkimit Evropian".

	2012	**2013**	**2014**	**2015**
kostot e infrastrukturës	20.404.000	20.659.000	21.333.000	21.188.000
shpenzimet e trajnimit	11.063.000	1.148.000	1.132.000	1.232.000
Kostot totale e vlerësuar	**31.467.000**	**21.807.000**	**22.465.000**	**22.420.000**
Mbulohen nga buxheti	21.467.000	21.807.000	22.465.000	22.420.000
Mbuluar nga ndihma e huaj	10.000.000	0	0	0
Ndryshim	0	0	0	0